RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK "PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË PERIUDHËN 01.07.2021-31.12.2021"

Nëntor 2022

Përmbajtja **faqe**

Përmbledhje 3
Hyrje 4
Objekti i Auditimit 4
Qëllimi i Auditimit 4
Metodologjia 4
Konkluzioni 4
Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm 5
1. Autoriteti i Aviacion Civil 5
2. Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për projektin "Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin" 21
3. ALBCONTROL SHA 26
4. Autoriteti Portual Durrës 54
5. Autoriteti Rrugor Shqiptar 119
6. Drejtoria e Përgjithshme Detare 167
7. Enti Kombëtar i Banesave 176
8. Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale", ...208
9. Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Funizimi me Ujë i Zonave Rurale III" 208
10. Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizimit" 208
11. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare për projektin "Plani i Ristrukturimit të KESH SHA" 247
12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Moderinizimi i Asistencës Sociale" 255
13. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor" 261
14. Operatori i Sistemit të Transmetimit SHA për projektin "Efiçenca Energjitike, Programi për Sektorin e Transmetimit të Energjisë Elektrike" 287
15. Radio Televizioni Shqiptar 299
16. Spitali Psikiatrik "Ali Mihali".....360
17. Spitali Rajonal Durrës 389
18. Spitali Rajonal Shkodër 426
19. Spitali Rajonal Vlorë 453
20. Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" 486
21. Spitali Universitar i Traumës 511
22. Ujësjellës Kanalizime Kurbin 531
23. Ujësjellës Kanalizime Vlorë 551
Konkuzione dhe rekomandime.....581
Anekse 671

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

a. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore është rekomanduar 1 masë, e cila rezulton e pranuar 100% dhe e zbatuar 100%;
b. Janë rekomanduar 563 masa organizative nga të cilat janë pranuar 555 masa ose 98.6%, nuk janë pranuar 8 masa ose 1.4%; statusi i zbatimit të tyre është: 200 masa janë zbatuar plotësisht ose 36.1%, 247 masa janë në proces zbatimi ose 44.5%, 19 masa janë zbatuar pjesërisht ose 3.4% dhe 89 masa nuk janë zbatuar ose 16%;
c. Janë rekomanduar 79 masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,441,649 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 77 masa në vlerën 1,436,671 mijë ose 97% dhe nuk janë pranuar 2 prej tyre në vlerë 4,978 mijë lekë ose 3%; statusi i zbatimit të tyre është 11 masa të zbatuara në vlerën 7,796 mijë lekë ose 11%, 35 masa janë në proces zbatimi në vlerën 69,372 mijë lekë ose 45%, 1 masa është zbatuar pjesërisht në vlerën 36 mijë lekë ose 1% dhe 30 masa të pa zbatuara në vlerën 1,359,467 mijë lekë ose 39%;
d. Janë rekomanduar 2 masa shpërblimi dëmi me kusht në vlerën 38,278 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 2 masa në vlerën 38,278 mijë lekë ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 0 masa të zbatuara ose 0%, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 2 masa të pa zbatuara në vlerën 38,278 mijë lekë ose 100%;
e. Janë rekomanduar 8 masa në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 527,334 mijë lekë e cila janë pranuar 8 masa në vlerën 527,334 mijë lekë ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 3 masa të zbatuara në vlerën 62,774 mijë lekë ose 37.5%, 3 masa në proces në vlerën 345,153 mijë lekë ose 37.5%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 2 masa të pa zbatuara në vlerën 119,407 mjë lekë ose 25%;
f. Janë rekomanduar 114 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 4,212,381 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 113 masa në vlerën 4,027,131 mijë lekë ose 99% dhe 1 masë nuk është pranuar në vlerën 185,250 mijë lekë ose 1%; statusi i zbatimit të tyre është 29 masa të zbatuara në vlerën 139,792 mijë lekë ose 25%, 62 masa në proces në vlerën 3,763,813 mijë lekë ose 55%, 1 masa e zbatuar pjesërisht ose 1% dhe 22 masa të pa zbatuara në vlerën 308,774 mijë lekë ose 19%;
g. Është rekomanduar 1 masë për vlera të rekuperueshme e cila është pranuar 100% dhe është në process zbatimi.
i. Janë rekomanduar 245 masa disiplinore të cilat janë pranuar 245 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 216 masa të zbatuara ose 88%, 8 masa në proces ose 3% dhe 21 masa të pa zbatuara ose 9%.

j. Janë rekomanduar 16 masa administrative të cilat janë pranuar 16 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 2 masa të zbatuara ose 13%, 11 masa në proces ose 69% dhe 3 masa të pa zbatuara ose 9%.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I. S. *(Përgjegjës grupi)*
2. A. R.
3. E. S.
4. Xh. L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

a. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore është rekomanduar 1 masë, e cila rezulton e pranuar 100% dhe e zbatuar 100%;
b. Janë rekomanduar 563 masa organizative nga të cilat janë pranuar 555 masa ose 98.6%, nuk janë pranuar 8 masa ose 1.4%; statusi i zbatimit të tyre është: 200 masa janë zbatuar plotësisht ose 36.1%, 247 masa janë në proces zbatimi ose 44.5%, 19 masa janë zbatuar pjesërisht ose 3.4% dhe 89 masa nuk janë zbatuar ose 16%;
c. Janë rekomanduar 79 masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,441,649 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 77 masa në vlerën 1,436,671 mijë ose 97% dhe nuk janë pranuar 2 prej tyre në vlerë 4,978 mijë lekë ose 3%; statusi i zbatimit të tyre është 11 masa të zbatuara në vlerën 7,796 mijë lekë ose 11%, 35 masa janë në proces zbatimi në vlerën 69,372 mijë lekë ose 45%, 1 masa është zbatuar pjesërisht në vlerën 36 mijë lekë ose 1% dhe 30 masa të pa zbatuara në vlerën 1,359,467 mijë lekë ose 39%;
d. Janë rekomanduar 2 masa shpërblimi dëmi me kusht në vlerën 38,278 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 2 masa në vlerën 38,278 mijë lekë ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 0 masa të zbatuara ose 0%, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 2 masa të pa zbatuara në vlerën 38,278 mijë lekë ose 100%;

e. Janë rekomanduar 8 masa në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 527,334 mijë lekë e cila janë pranuar 8 masa në vlerën 527,334 mijë lekë ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 3 masa të zbatuara në vlerën 62,774 mijë lekë ose 37.5%, 3 masa në proces në vlerën 345,153 mijë lekë ose 37.5%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 2 masa të pa zbatuara në vlerën 119,407 mjë lekë ose 25%;
f. Janë rekomanduar 114 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 4,212,381 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 113 masa në vlerën 4,027,131 mijë lekë ose 99% dhe 1 masë nuk është pranuar në vlerën 185,250 mijë lekë ose 1%; statusi i zbatimit të tyre është 29 masa të zbatuara në vlerën 139,792 mijë lekë ose 25%, 62 masa në proces në vlerën 3,763,813 mijë lekë ose 55%, 1 masa e zbatuar pjesërisht ose 1% dhe 22 masa të pa zbatuara në vlerën 308,774 mijë lekë ose 19%;
g. Është rekomanduar 1 masë për vlera të rekuperueshme e cila është pranuar 100% dhe është në process zbatimi.
i. Janë rekomanduar 245 masa disiplinore të cilat janë pranuar 245 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 216 masa të zbatuara ose 88%, 8 masa në proces ose 3% dhe 21 masa të pa zbatuara ose 9%.
j. Janë rekomanduar 16 masa administrative të cilat janë pranuar 16 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 2 masa të zbatuara ose 13%, 11 masa në proces ose 69% dhe 3 masa të pa zbatuara ose 9%.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (ACC)

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në AAC mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", AAC, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 1960/4 prot., datë 12.11.2021, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin*

dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me shkresën nr. 563/1, datë 25.04.2022 "Dërgohet ecuria e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së"

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 580/28, datë 21.10.2021 dhe në AAC nr. 1960 prot., datë 26.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar 18 masa organizative;
c. Janë rekomanduar 1masa për shpërblim dëmi në vlerën 233,350 lekë pa TVSH;
d. Janë rekomanduar 0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë;
e. Janë rekomanduar 0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë;
f. Janë rekomanduar 3 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 24,192,978 lekë;
e. Janë rekomanduar 0 masa disiplinore;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	18	17	-	1
3	Shpërblim dëmi	1	-	-	1
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	3	3	-	-
7	Masa disiplinore	-	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e AAC

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	17	5	0	11	1
3	Shpërblim dëmi	0	0	0	0	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0

5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	3	2	0	1	0
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L..

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimve rezulton se AAC nga 18 masa organizative ka pranuar 17 prej tyre ose 94.4% të masave dhe nga 17 masat e pranuara 5 janë zbatuar plotësisht ose 27.8% e masave të rekomanduara, janë 11 masa janë në proces zbatimi ose 61% e masave të rekomanduara dhe 1 masa nuk janë zbatuar ose 5.6% e masave të rekomanduara. Nga 1 masë shpërblim dëmi që është rekomanduar ajo nuk është pranuar pra 0% e masave janë pranuar.

Nga 6 masa 3-E, 2 janë zbatuar plotësisht ose 33% e masave të rekomanduara, 4 janë në proces ode 67% e masave të rekomanduara.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 27.8%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", AAC, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 1960/4 prot., datë 12.11.2021, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me shkresën nr. 563/1, datë 25.04.2022 "Dërgohet ecuria e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së".

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A: OPINIONI I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË

Opinioni i auditimit i modifikuar/kualifikuar:
Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të Autoritetit të Aviacionit Civil, Tiranë. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000[1].
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Autoritetit të Aviacionit Civil, Tiranë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.
Baza për Opinionin
Për gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet, jemi dakortësuar me menaxhmentin e Institucionit, si dhe jemi siguruar prej Tij, që vendimmarrjet në ardhmen të jenë më të spikatura, që të japin shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur

[1]ISSAI 4000 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë.

këtë, menaxhmenti i këtij Institucioni të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas programit ekonomik.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin "Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë" të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Autoriteti i Aviacionit Civil, Tiranë , theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të AAC

Strukturat drejtuese të AAC, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike.

Strukturat drejtuese të AAC janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Menaxhmenti i Institucionit është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet e dispozitave ligjor në fuqi. Gjithashtu menaxhmenti i Institucionit është përgjegjës kryesor për ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive në realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve, duke nisur nga hartimi i rregullave të brendshme, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi të këtij Institucioni, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë.

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse aktiviteti i Institucionit, nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të aktivitetit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur

me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Aviacionit Civil nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH.
-Autoriteti Aviacionit Civil, nuk ka respektuar afatet 20 ditore dhe 6-mujor, të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, veprime në kundërshtim me nenet 15 germa "j" dhe 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:
-Nga 28 masa organizative gjithsej, të rekomanduara, 11 janë zbatuar plotësisht, 13 nuk janë pranuar, 1 është në proces dhe 3 janë zbatuar pjesërisht.
-Nga 2 masa për shpërblim dëmi të rekomanduara, nuk është pranuar asnjë prej tyre. -Nga 4 masa dëm potencialisht i mundshëm gjithsej, 3 masa nuk janë pranuar dhe 1 është zbatuar.
-Nga 8 masa për eliminimin e efekteve negative gjithsej, 3 masa nuk janë pranuar dhe 5 janë zbatuar.
-Nga 2 masa për eliminimin e procedurave jo ligjore gjithsej, 2 masa janë zbatuar.
-Nga 7 masa sugjerime gjithsej, nuk është pranuar asnjë prej tyre.
-Nga 2 masa disiplinore, nuk është pranuar asnjë prej tyre.
-Niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet në nivele të ulta, rreth 36%.
-Drejtoria e AAC nuk ka marrë në konsideratë 64% të rekomandimeve të lëna nga KLSH.
-Nuk janë respektuar afatet e kthimit të përgjigjes mbi rekomandimet e lëna nga KLSH sipas përcaktimeve ligjore.
-Rekomandimet e KLSH-së, dërguar me shkresën nr.1312/24, datë 02.05.2019, rezultojnë të zbatuara në nivelin 53%. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
1.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara ose në proces, si edhe të ndiqen në të gjitha shkallët e gjykimit, ato që janë në procese gjyqësore.

Menjëherë dhe Në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Do të vijohet me zbatimin e sipas Planit të masave të dërguar në KLSH me shkresën nr. 152/2, datë 07.02.2020.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

2. Gjetje nga auditimi: Me urdhrin nr. 152, datë 24.03.2021, është ngritur nga titullari AAC komisioni për hartimin e termave të referencës dhe përllogaritjes së fondit limit për procedurën "Asistencë për hartimin dhe negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës". Procedura për fillimin e procedurës nga urdhri i prokurimit, ftesat/ofertë, argumentimi i kritereve, hartimi i termave të referencës, datojnë më 24.03.2021, pra brenda 1 dite pa u konsumuar edhe afati 3 ditor i përcaktuar në urdhrin e prokurimit nga Titullari. Kjo procedurë është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 10.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Kreu II, pika 1 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 40, pasi nuk mund të kryhej nga AAC, por nga vetë Ministria, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Ministria duhet të zhvillonte procedurën dhe të mbulonte koston e procedurës së shërbimit "Asistencë për hartimin dhe negocimin e termave

të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Mbulimi i shpenzimeve të kësaj natyre e kthen AAC në rolin e financuesit duke sjellë rritje të shpenzimeve, për më tepër në vitin ku AAC ka rezultuar me humbje. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme të marrin masa që në të ardhmen të analizojnë kërkesat e ardhura nga MIE (për prokurime) dhe në çdo rast të përmbushen vetëm nëse ato janë në interes të AAC, si edhe në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi të përcaktuara për çdo Autoritet Kontraktor, me qëllim që mbulimi i shpenzimeve të kësaj natyre të mos kthej AAC në rolin e financuesit duke sjellë rritje të shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Të gjitha kërkesa të cilat përmbajnë efekt financiar në zbatim të Nenit 13 pika (c) e Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", paraqiten nga Drejtori Ekzekutiv për miratim në Këshillin Drejtues. Për këtë gjetje AAC paraqitur observacionet të cilat nuk janë marrë parasysh gjatë punës së audituesve në subjekt si dhe gjatë projekt-raportit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:e Papranuar

3. Gjetje nga auditimi: Miratimi i strukturës organizative vetëm me Vendimin e Këshillit drejtues, pa miratimin e Ministrit të linjës. Konkretisht struktura organizative është miratuar vetëm me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 8, datë 28.06.2019 dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 28.06.2019, ndërsa struktura organizative e vitit 2021 është miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 359, datë 18.12.2020, protokolluar në AAC me nr. 2118, datë 28.12.2020. Në strukturën e vitit 2019 dhe 2020 janë miratuar 73 të punësuar, por organika është shtuar dhe me 4 punonjës me kontratë me Vendim të Këshillit Drejtues, struktura nuk është miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilët janë përfshirë në strukturën e vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të marrin masa që në të ardhmen, ndryshimet e strukturës së institucionit, të hyjnë në fuqi vetëm pas miratimit nga Ministri.

Në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Realizuar me ristrukturimin e vitit 2021, Shkresa MIE Nr.7957/3 date 18.12.2020 Urdher nr. 359, date 18.12.2020 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AAC", numri i punonjësve është 79.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:E zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga ana e AAC për periudhën 01.10.2019-01.04.2021, është vepruar në kundërshtim me VKM Nr. 142, datë 12.3.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", pasi përshkrimi dhe klasifikimi i pozicioneve të punës është miratuar vetëm me miratimin e Këshillit Drejtues dhe jo nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga DAP. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1 Rekomandimi:Për shkeljen e konstatuar në përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës për periudhën e auditimit, edhe pse kjo praktikë është korrigjuar në vitin 2021, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja më e këtij fenomeni në të ardhmen.

Në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Realizuar në 2021, rekomandimi do të merret parasysh edhe në të ardhmen.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

5. Gjetje nga auditimi. AAC nuk ka arritur të arkëtojë vlerën 1,935,032 lekë nga ish-drejtuesit që janë larguar nga institucioni. Kjo vlerë ka të bëjë pajisjet informatike që kanë pasur në ngarkim për shkak të detyrës që ato kanë ushtruar, të cilët nuk i kanë dorëzuar. AAC nuk duhet të kishte dhënë librezat e punës pa dorëzuar inventarin në ngarkim dhe detyrimet e tjera financiare. Por është mjaftuar vetëm me njoftimet që u ka bërë personave me përgjegjësi materiale dhe nuk ka ndërmarrë asnjë hap ligjor. Konkretisht referuar urdhrit të brendshëm nr. 285, datë 06.06.2019 të ish-Drejtorit Ekzekutiv të AAC K. K. janë njoftuar me shkresën nr. 1119/1 A. L. me detyrë ish-Drejtor Ekzekutiv, me shkresën nr.1119/2 A. C. me detyrë ish-anëtar i Këshillit Drejtues, me shkresën nr. 1119/3 Afroviti Andrea me detyrë ish-anëtar i Këshillit Drejtues, me shkresën nr. 1119/4 F. G. me detyrë ish-drejtor i departamenti ekonomik dhe me shkresën nr. 1119/4 I. H. me detyrë ish-anëtar i Këshillit Drejtues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 86-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AAC, të marrë masa të menjëhershme për ndërmarrjen e të gjithë hapave ligjor për arkëtimin e detyrimeve që kanë ndaj Institucionit.

Menjëherë

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: AAC ka ndjekur në vazhdimësi hapat ligjor për arkëtimin e detyrimeve ndaj institucionit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së" me fond limit 3,999,670 lekë, viti 2019, Titullari i AAC K.K.ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën "Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së", pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës. Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë "Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së" nga dokumentacioni i vënë në pozicion dhe i gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe riskun e kalkuluar që i kanos stafin e këtij institucion; Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë" dhe Ligjin i prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, gërma; a) një përshkrim të shkurtër të mallrave,punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen**, ose të nevojës për prokurim,** për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi:AAC, në çdo rast përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë të administruar kërkesat e dërguara nga sektorët apo drejtorit përkatëse, duke argumentuar nevojën e kryerjes së shpenzimit apo investimit, domosdoshmërinë e tij dhe nevojën që institucioni ka.

Në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Realizuar në 2021, rekomandimi do të merret parasysh edhe në të ardhmen.

1-Kerkesa nga DASHM per rregullimin e rrjetit te kondicionimit, nr. 101 prot, date 19.01.2022

2-Kerkese nga DASHM per materjale pastrimi, nr.403 prot, date 02.03.2022. Do të verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së" me fond limit 3,995,553 lekë, viti 2020, Titullari i AAC E. K. ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe

përllogaritjen e fondit limit për procedurën "Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së", pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës. Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë " Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së" nga dokumentacioni i vënë në pozicion dhe i gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe riskun e kalkuluar që i kanoset stafin e këtij institucion; Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë" dhe Ligjin i prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, gërma, a) një përshkrim të shkurtër të mallrave,punëve ose shërbimeve,që do të prokurohen**, ose të nevojës për prokurim,** për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1 Rekomandimi:AAC, në çdo rast përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë të administruar kërkesat e dërguara nga sektorët apo drejtorit përkatëse, duke argumentuar nevojën e kryerjes së shpenzimit apo investimit, domosdoshmërinë e tij dhe nevojën që institucioni ka.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Realizuar në 2021, rekomandimi do të merret parasysh edhe në të ardhmen.

1-Kerkesa nga DASHM per rregullimin e rrjetit te kondicionimit, nr. 101 prot, date 19.01.2022

2-Kerkese nga DASHM per materjale pastrimi, nr.403 prot, date 02.03.2022. Do të verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC/0-së" me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2019, Titullari i AAC K.K.ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën "Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së", pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës. Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë "Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së" nga dokumentacioni i vënë në pozicion dhe i gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe riskun e kalkuluar që i kanos asetet e këtij institucioni, veprime në kundërshtim me Ligjin i prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, gërma, a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve,q ë do të prokurohen**, ose të nevojës për prokurim,** për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi:AAC, në çdo rast përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë të administruar kërkesat e dërguara nga sektorët apo drejtorit përkatëse, duke argumentuar nevojën e kryerjes së shpenzimit apo investimit, domosdoshmërinë e tij dhe nevojën që institucioni ka.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Realizuar në 2021, rekomandimi do të merret parasysh edhe në të ardhmen.

1-Kerkesa nga DASHM per rregullimin e rrjetit te kondicionimit, nr. 101 prot, date 19.01.2022

2-Kerkese nga DASHM per materjale pastrimi, nr.403 prot, date 02.03.2022. Do të verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

9. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së" me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2019, Komisioni për përllogaritjen e fondit limit ka dërguar kërkesat për ofertë kompanive që ofrojnë shërbim në sektorin përkatës duke ju referuar "Raportit financiarë të Audituesve të pavarur" për sa i përket vlerës së aseteve që do sigurohen. Në termat e referencës Komisioni kërkon dhe: mbulim nga: **Rreziku i vjedhjes** apo dëmtimit të pasurive nga veprimet që vijnë si rezultat i së parës. Për ruajtjen e objektit dhe zyrave të AAC, ky institucion ka një kontratë me kompaninë "I." guard ku në rregulloren bashkangjitur kontratës është e mirëpërcaktuar detyrat e këtij shërbimi duke ofruar ruajtje fizike dhe me sistem vëzhgimi 24/7 pa ndërprerje. Ky element i kërkuar të mbulohet nga polica e sigurimit është i pa nevojshëm duke dubluar shpenzimet për këtë pjesë dhe **shtuar kostot për policë**, veprime në kundërshtim me Ligjin i prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar neni 1, pika 2, gërma, b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale, Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi:AAC, në çdo rast përpara nxjerrjes së fondit limit duhet të analizojë të gjithë faktorët e nevojshëm të cilët kanë ndikim financiar, teknik dhe juridik në përllogaritjen e fondit me qëllim administrimin sa më të mirë të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Realizuar në 2021, rekomandimi do të merret parasysh edhe në të ardhmen.

1-Kerkesa nga DASHM per rregullimin e rrjetit te kondicionimit, nr. 101 prot, date 19.01.2022

2-Kerkese nga DASHM per materjale pastrimi, nr.403 prot, date 02.03.2022. Do të verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

10. Gjetje nga auditimi: Këshillit Drejtues për programin ekonomik të vitit 2021 ka zhvilluar mbledhjen e datës 18.12.2020 dhe të datës 24.12.2020. Në këto dy mbledhje dhe në veçanti në mbledhjen e datës 29.01.2021 është diskutuar "Mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestro konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në "EUROCONTROL" dhe nuk është marr vendimmarrje, pavarësisht se zgjidhja e kësaj çështje rezulton me pasoja financiare, duke konsideruar se tarifa en-route e mbledhur nga Eurocontrol për llogari të RSH-së për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror është një e ardhur e rëndësishme për Autoritetin e Aviacionit Civil, e cila përbën rreth 30% të të ardhurave totale..

Vendimmarrja eKëshillit Drejtues nuk ka marr në konsideratë për sa më poshtë vijon:

-a. Njoftimi i Eurocontrol për AAC nëpërmjet komunikimit elektronik bën me dije se shuma e mbajtur nga llogaria e Shqipërisë për llogari të B., deri në datën 15 dhjetor 2020 ***është n***ë vlerën ***171,653 Euro***, ndërsa Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 1879/1, datë 23.03.2021, njofton AAC se kjo shumë në datën 28 Janar 2021 është ***në vlerën 1,687,755 Euro.****Theksojmë se referuar procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Drejtues të datës 28.12.2020, detyrimi total është mbi në vlerën140 milion euro.*

- b. Urdhri i ekzekutimit dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Belge për të cilën është lëshuar, nuk është realizuar në mënyrë zyrtare për Republikën e Shqipërisë, sikurse parashikohet në Konventën "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare" të vitit 1965. Ky njoftim është bërë nëpërmjet Eurocontrol, e cila ka njoftuar AAC mbi objektin e urdhrit të ekzekutimit, me anë të shkresës Ref. DCF 126_20 të datës 7 dhjetor 2020.

-c. Autoriteti i Aviacionit Civil do të përballojë shpenzimet ekonomike të cilat do të rezultojnë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike për çështjen e ngrirjes së llogarive të Republikës së

Shqipërisë në EUROCONTROL, sipas Urdhër Ekzekutimit të Autoriteteve Belge me objekt ngrirjen e llogarive të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimit përkatës te Gjykatës së Shkallës së Parë Belge të datës 1 Dhjetor 2020, pra do t'i duhet të përshijë në programin ekonomik të viti 2021 shpenzimet të asistencës juridike, që nga auditimi rezultuan se nuk ka asnjë korrespodencë me Avokaturën e Shtetit n.q.s ka/ose jo të kontraktuar zyrë avokatie dhe sa shkojnë kostot e gjykimit.

-c. Edhe pseçështja paraqet rëndësi të veçantë për interesat e Shtetit dhe AAC, ka një natyrë të veçantë e të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në një fushë apo legjislacionit Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtardhe urgjencën e kohës, Avokatura e Shtetit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 15/8 dhe 18/1 të Ligjit 10018/2008, si dhe të Kapitulli 4 pika D të VKM nr. 893, datë 18.11.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës", pasi ka deleguar një të drejtë AAC që është tagër ekskluziv i saj.

-d. Mbledhja e Këshillit Drejtues e datës 29.01.2021 me pikë të parë të rendit të ditës mbi mbarëvajtjen e procesit të kundërshtimit të veprimeve përmbarimore lidhur me llogaritë e Republikës së Shqipërisë në EUROCONTROL, është zhvilluar në fillim të viti buxhetor, ku AAC gjendet në pozitë financiare të vështirë që pasqyron qartazi vetëm një krizë të mprehtë likuiditeti, si rrjedhojë e mungesës së tarifës en-route dhe uljen rreth 50% të tarifës së sigurisë për shkak të numrit të ulët të fluturimeve nga kufizimet e COVID-19.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 "Për autoritetin e aviacionit civil", me ndryshimet vijuese të tij neni 5 "Këshilli drejtues" , pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 45-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të AAC ti bëhet prezent Instancave më të Larta Shtetërore, pozita financiare e AAC e krijuar, si rrjedhojë e urdhrit të ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në "EUROCONTROL" dhe pamundësia e deritanishme e zgjidhjes së kësaj situate nga institucionet e përfshira në këtë çështje si Avokatura e Shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, jo vetëm për sa i përket mos përfitimit të tarifës en-route, por edhe për shpenzimet e pritshme të asistencës juridike (shpenzime avokatie).

Menjëherë

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Gjatë periudhës 2020 – 2021 Drejtori Ekzekutiv i AAC ka bërë me dije të e Këshilli Drejtues dhe MIE situatën financiare të institucionit në mungesë të tarifës en-route.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

11. Gjetje nga auditimi: Këshilli Drejtues për vitin 2020 ka marrë 7 vendime qarkulluese. Konkretisht Vendimi nr. 2 datë 14.05.2020, vendimi nr. 4 datë 15.06.2020, vendimi nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8 datë 30.07.2020, vendimi nr. 12 datë 16.11.2020, ndërsa për vitin 2021 ka marrë 2 vendime qarkulluese konkretisht vendimin nr. 1 datë 08.01.2021 dhe vendimi nr. 2 datë 23.03.2021. Rregullorja "Për rregullat e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC", e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, nuk ka të përcaktuar rregulla dhe procedura si organizohen mbledhjet në distancë dhe si merret vendimmarrja me vendime qarkulluese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 45-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1 Rekomandimi:Këshillit Drejtues të bëjë amendimin e Rregullores "Për rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC", e miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 68, datë 23.02.2017, ku të përcaktoj rregulla dhe procedura si organizohen mbledhjet në distancë dhe si merret vendimmarrja e tyre.

11.2 Rekomandimi:Këshilli Drejtues të shqyrtojë, analizojë me vëmendje, të debatojë dhe të miratojë me votim në mbledhje çështjet që vihen në rendin e ditës dhe të tjera për diskutim, me qëllim që të rritet performanca e AAC, duke shmangur sa më shumë të jetë e mundur vendimmarrjet nëpërmjet vendimeve qarkulluese.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Këshilli Drejtues i AAC me Vendimin Nr. 2, datë 02.03.2022 ka miratuar rregulloren e re për funksionimin e KD, në të cilën është marrë parasysh rekomandimi.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:e Zbatuar

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

12. Gjetje nga auditimi: Vendimi nr. 2 datë 23.03.2021 "Mbi miratimin e financimit dhe kontraktimit të "Asistencë për negocim të termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës". Nuk ka proces verbal të zhvillimit të mbledhjes, vendimi është firmosur nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje, është protokolluar me nr. 488/2 prot., datë 23.03.2021, dhe nuk është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së.

-Vendimi nr. 4 datë 15.06.2020 "Për Miratimin e Propozimit për Përfshirjen në Paketën Lehtësuese Financiare për Shkak të Situatës së Krijuar nga Covid-19, të Organizatës Evropiane për Sigurinë e Lundrimit Ajror (këtu e në vijim Eurocontrol). Nuk ka proces verbal të zhvillimit të mbledhjes, ndërsa vendimi është firmosur nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe kryetari, është protokolluar në datën 15.06.2020 me nr. 992/1 prot., dhe është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 "Për autoritetin e aviacionit civil", me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika 5, Rregullorja "Për rregullat e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC", e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, neni 9 pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 45-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1 Rekomandimi:Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në mbledhjet e Këshillit Drejtues, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

Në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Këshilli Drejtues i AAC me Vendimin Nr. 2, datë 02.03.2022 ka miratuar rregulloren e re për funksionimin e KD, në të cilën është marrë parasysh rekomandimi. Do verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

13. Gjetje nga auditimi: Nuk është paraqitur në Këshillin Drejtues një raport i hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave, të dhënat e regjistrave, si dhe rastet e trajtimit të kërkesave të, qoftë nga operatorët, qoftë nga konsumatorët, që i janë paraqitur autoritetit. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 111.02.2010 "Për autoritetin e aviacionit civil", neni 13, pika iii. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 45-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1 Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, dërgimit të raportit të hollësishëm në Këshillin Drejtues për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave dhe të dhënave të regjistrave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion ndonjë dokument, por do të verifikoet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:e pazbatuar

14. Gjetje nga auditimi:Të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit, merret nëpërmjet Aeroporti Nënë Tereza. Për të garantuar sigurinë, TIA ka të drejtën të grumbullojë nga pasagjerët që përdorin aeroportin një tarife sigurie ("Pagesa e Sigurisë") deri në 4 EUR për pasagjer (2 EUR për pasagjeret që mbërrijnë dhe 2 EUR për pasagjeret që largohen) me qellim që të mbulojë shpenzimet e arsyeshme për dhënien e shërbimit te sigurisë. TIA do të paguaj 25% **(ose 1 euro),** të tarifës së sigurisë të mbledhur AAC në baza mujore me vonesë, dhe do të këtë të drejtën të mbajë diferencën. TIA, bazuar në Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, "Për marrëveshjen konçesionare, SHTOJCA 44" do të mbajë regjistrime me shkrim të numrit të pasagjerëve dhe shumat e tarifës së sigurisë së mbledhur, këto regjistrime do t'i paraqiten AAC-së për inspektim sipas kërkesës së arsyeshme. Nga AAC nuk është kryer asnjë inspektim në Aeroporti Nënë Tereza referuar SHTOJCËS 44. Përfitimi i të ardhurës nga tarifa e sigurisë së aviacionit, paraqet risk të lart, pasi të dhënat mbi pasagjer në dalje duke llogaritur 1 euro për pasagjer për llogari të AAC dhe tarifa e komunikimi duke llogaritur 25 euro për fluturim, bëhet e njëanshme vetëm nga Aeroporti Nënë Tereza. Pra nuk ka as verifikim nga ndonjë burim tjetër p.sh. operatoret e fluturimit, për saktësinë e pasagjerëve që raporton TIA. Referuar akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilat ushtron aktivitetin AAC, nuk i mundësohet të kërkoj të dhëna të tjera nga burime alternative për të verifikuar saktësinë e të dhënave të raportuara nga TIA. Për sa më sipër grupi i auditimit mori në përzgjedhje dy operatorë shqiptar të cilët kryejnë fluturime të rregullta (skedulë) në TIA. Konkretisht u morën në auditim operatori A. dhe A. A.. Duke marrë për bazë aplikimet për leje fluturimi dërguar nga dy kompanitë e mësipërme për sezonin veror IATA 2020, u konstatua se nuk ka asnjë të dhënë për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje. Gjithashtu, këto të dhëna i referohen vetëm numrit të fluturimeve sipas frekuencës së kërkuar nga secili operator. Bazuar në Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, "Për marrëveshjen konçesionare", AAC nuk ka tagër ligjor për ti kërkuar operatorëve të dhënat statistikore për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje. Nga informacioni verbal i dhënë nga Sektori i Licencave te Operimit dhe Shërbimit te Lejeve te Fluturimit, jemi bërë me dije se AAC po bashkëpunon me MIE në lidhje me transpozimin e direktivës së BE nr. 437/2003 (e cila ka pësuar 5 ndryshime), " Për rregulloren mbi raportet statistikore në lidhje me transportin e pasagjerëve, mallrave dhe postës". Aktualisht Bashkimi Evropian ka në fuqi Rregulloren me nr. 437/2003 "Mbi statistikat në lidhje me transportin e udhëtarëve, transportin e mallrave dhe postës" (Regulation (EC) No 437/2003 of the European Parliament and of the Council of 27 February 2003 on statistical returns in respect of the carriage of passengers, freight and mail by air). Pra Bashkimi Evropian e ka, Republika e Shqipërisë nuk ka një rregullore për këtë qëllim.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, "Për marrëveshjen konçesionare, SHTOJCA 44". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
14.1 Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv të merren masa për kryer për inspektime të herë pas hershme në regjistrat e mbajtura nga TIA për numrin e pasagjerëve dhe shumat e tarifës së sigurisë së mbledhur.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.2 Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale bashkëpunimit me MIE në lidhje me transpozimin e direktivës së BE nr. 437/2003 "Për rregulloren mbi raportet statistikore në lidhje me transportin e pasagjerëve, mallrave dhe postës", edhe për AAC.

Menjëherë

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Është kryer inspektimi i regjistrave të nr. të pasagjerëve në TIA për periudhën 2018 – 2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Zbatuar

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Rregullorja BE nr.437/2003 është pwrfshirw nw planin e punws për transpozim brenda vitit 2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

15. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 10.11.2017 -22.04.2020, nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil vendimet lidhur me dhënien, pezullimin apo anulimin e licencave të operimit. Veprim në kundërshtim me pikën 3 të Nenit 11 të Udhëzimit të Ministri të Punëve Publike dhe Transportit nr. 17, datë 2.9.2010 "Mbi Rregullat e Zbatueshme të Operimit në Fushën e Shërbimeve Ajrore", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
15.1 Rekomandimi:Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara për periudhën 10.11.2017 - 22.04.2020, edhe pse kjo praktikë është korrigjuar, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

Në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Rekomandimi është zbatuar dhe do të vijojë zbatohet në vazhdimësi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nëpërmjet bankës, janë kryer pagesat për "pensionin vullnetar" të punonjësve të AAC prej vitit 2014 e në vazhdim. Për periudhën objekt auditimi janë shpenzuar nga AAC për këtë qëllim 58,918,231 lekë. Nga grupi i auditimit në lidhje me bazën ligjore të dhënies së këtij financimi për punonjësit me fondet e institucionit u kërkua dokumentacion ligjor mbi argumentimin e financimit. Administrata e AAC është administratë publike, Statusi i punonjësve të AAC është me statusin e Nëpunësit Civil dhe pagat janë paga të miratuara me VKM dhe paga të barazvlefshme me pagat e grupeve përfituese të përcaktuara në ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit" neni 1, pikat 5 dhe 9. Në këto pika përcaktohet se përfitojnë punonjësit e Administratës Publike si edhe personat e barazvlefshëm me pagë sipas grupeve përkatëse. Nga AAC, nuk janë vazhduar procedurat për futjen e institucionit në skemën e pensionit suplementar, pasi sipas pikës 4, të VKM nr. 499, datë 21.09.2000 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 382, datë 20.05.1996, të KM "Për zbatimin e ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", AAC duhej ti drejtohej sipas hierarkisë Këshillit të Ministrave pasi është ky organ që miraton ndryshimin ose jo të emërtesës dhe jo Ministria. Në ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil" neni 3, citohet se: AAC është person juridik publik, jo buxhetor, në varësi të Ministrit që mbulon çështjet e transportit ajror, po kështu referuar nenit 16, struktura dhe pagat e AAC miratohen me VKM dhe punonjësit e AAC trajtohen me Statusin e Nëpunësit Civil. Pra, AAC futet në institucionet publike dhe si e tillë nuk mund të veprojë jashtë kuadrit ligjor të përdorimit të fondeve të institucionit, etj.
Gjithashtu, financimi i fondit të pensionit për punëmarrësin është në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010, pika 4, ku citohet se: Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, të nevojshme për funksionimin normal të Autoritetit, si edhe për pagesat e kontributeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare të aviacionit civil". Pagesat

e kryera sa më sipër janë pagesa për financim të pensionit profesional dhe nuk hyjnë në pagesat e cilësuara në ligjin për AAC. Me vendimin nr. 57, datë 03.08.2016, të Këshillit Drejtues është miratuar një rregullore "Për pensionet vullnetare të punëdhënësit", ku përcaktohet se AAC, merr përsipër detyrimin për të paguar kontribute në favor të punëmarrësve. Në këtë rregullore nuk janë përcaktuar kufijtë minimal dhe maksimal të % mbi pagë që do të llogaritet dhe përfitohet sipas grupeve të përcaktuara, por janë ndarë vetëm 3 grupe punonjësish sipas moshës dhe vjetërsisë në punë. Në pikën 2.4 të rregullores citohet se: Kontributi përllogaritet si % e cila është variabël dhe përcaktohet çdo vit në bazë të mundësive financiare të institucionit nëpërmjet fondit të miratuar për pensionet vullnetare të parashikuar në programin ekonomiko-financiar të vitit dhe depozitohet në llogaritë individuale të punëmarrësit. Për periudhën objekt auditimi konstatohet se % e përfituar nga punonjësit për vitet 2019-2021 varjon nga 20-25%, megjithëse aktiviteti i AAC për vitin 2020, rezulton me humbje (në shumën 14,920,327 lekë), dhe në vështirësi financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1 Rekomandimi:

Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të AAC, brenda mundësive të financimit dhe referuar kompetencave ligjore për miratim, parashikuar në legjislacionin në fuqi të krijojnë fondin për financimin e pensionit vullnetar dhe përqindjen e pjesëmarrjes, vetëm duke marrë miratimet përkatëse si edhe përcaktimin e këtij financimi në ligjin "Për AAC".

Brenda datës 30.12.2021

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Përfitimi i pensionit vullnetar është përfshirë në Projektligjin "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i cili pritet të miratohet nga parlamenti.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Zbatuar

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit"Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së" me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2020, Komisioni për llogaritjen e fondit limit ka hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës dhe fondin limit për procedurën e prokurimit "Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC" prej 2,198,500 lekë. Fondi i llogaritur nga komisioni i përbërë nga A. D., S. K. dhe E. K. është 232,534 lek më i lartë se kontrata aktuale, element që ngarkon me përgjegjësi komisionin pasi:

-Së pari vlera e aseteve të siguruar për vitin 2020 është 105,514,767 lekë ndërsa për vitin 2019 kjo vlerë arrinte në 111,909,234 lekë pra vlera e aseteve ka rënë me 6,394,467 lek ose me 0.5% ndërkohë që vlera e fondit limit e llogaritur nga komisioni është rritur me 11.8%. Kjo lidhje duhet të jetë e drejt e jo e zhdrejtë.

-Së dyti AAC ka një kontratë të realizuar me sukses dhe nuk është e nevojshme marrja e ofertave, madje duke marrë oferta dukshëm më të larta se kontrata e mëparshme ndërkohë që vlera e aseteve ka rënë;

-Veprimet e mësipërme kanë sjellë një fryrje të pa justifikuar të fondit limit me një efekt financiar për buxhetin e institucionit AAC në vlerën 2,197,950 lekë (oferta e suksesshme) - 1,964,600 lekë (kontrata e mëparshme) = **233,350 lekë , vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 pika b) VKM 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Neni 59 Përllogaritja e vlerës limit të kontratës 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi:AAC, në çdo rast përpara nxjerrjes së fondit limit duhet të analizoj të gjithë faktorët e nevojshëm të cilët kanë ndikim financiar, teknik dhe juridik në përllogaritjen e fondit me qëllim administrimin sa më të mirë të fondeve publike. AAC të ndjek të gjitha rrugët

administrative dhe ato ligjore për arkëtimin e shumës **prej 233,350 lek** nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit.

Brenda datës 31.12.2021

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Për këtë gjetje janë paraqitur observacionet gjatë punës së audituesve në terren, pas lëshimit të akt konstatimeve si dhe në projekt-raport, të cilat nuk janë marrë parasysh nga audituesit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:i Papranuar

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: AAC ka shpenzuar nga humbja e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimi i detyruar i titujve ekzekutivë (punonjës të larguar nga puna)për periudhën 2019-2020, shumën 13,933,903 lekë. Kjo vlerë përfaqëson dëmshpërblimin e punonjësve në shumën 13,294,846 lekë, shpenzime gjyqësore në shumën 114,400 lekë dhe shpenzime përmbarimi në shumën 524,657 lekë. Vlera prej ***13,933,903 lekë, përbën efekt negativ financiar*** për institucionin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, në të ardhmen të marrin masa për eliminimin e procedurave të largimeve nga puna të punonjësve të paargumentuara ligjërisht, me qëllim minimizimin e rasteve që shoqërohen me efekte negative financiare dhe venë në vështirësi institucionin.

Në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Rekomandimi do të merret parasysh në vijimësi.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2.Gjetje nga auditimi: Nëpërmjet bankës për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa për "Sigurimin e jetës & shëndetit të punonjësve" në kompanitë e sigurimeve "S." dhe "I.". Për 3 vjet prej fillimit të kryerjes së këtij shërbimi vlera prej ***8,970,950 lekë***, është shpenzuar për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve, **vlerë e cila konsiderohet efekt ekonomik negativ** pasi nuk ka asnjë argumentim ligjor për arsyet e kryerjes së këtij shërbimi. Mungon analiza dhe hartimi i një programi mbi argumentimin e kryerjes së këtij shërbimi, nuk ka asnjë dokumentacion ku të arsyetohen kategoritë dhe vendet e punës që kanë më shumë risk, si është vlerësuar nga institucioni risku i punonjësve të administratës krahasuar me personelin teknik, etj, bazuar në detyrimet e punëmarrësit sipas Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 72-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të analizojnë dhe përcaktojnë kategoritë përfituese të punonjësve për sigurim jete dhe shëndeti, referuar vështirësisë së vendit të punës dhe nivelit të riskut për çdo pozicion pune, referuar legjislacionit në fuqi dhe me miratim nga Ministria e linjës, me qëllim përfitimin e shërbimit nga punonjësit dhe minimizimin e rasteve që shoqërohen me efekte negative financiare.

Brenda datës 30.12.2021

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Përfitimi i sigurimit të jetës dhe shëndetit për punonjësit e AAC-së është përfshirë në Projektligjin "Për Autoritetin e Aviacionit Civil".

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave për punonjësit e AAC , është konstatuar se pjesë përbërëse e pagës totale është dhe pagesa për shërbimin e telefonisë celulare. Pagesat për telefonin celulare për administratën janë paguar referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 5, date 20.01.2011 "Për tarifat e shërbimit të telefonisë celulare për punonjësit e AAC", vendim ky që është marr në kundërshtim me VKM Nr. 864, datë 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë" i ndryshuar. Edhe pse ky fenomen është konstatuar dhe nga grupet e mëparshme të KLSH-së, vazhdon dhe zbatohet nga ana e AAC.
Për periudhën 1.11.2020-30.04.2021 pagesa e këtij shërbimi është rregulluar referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 11, datë 27.10.2020, konform VKM nr. 673, datë 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë " (Tabela me punonjësit që e kanë përfituar pa të drejtë këtë shërbim paraqitet në aneksin nr. 3 të këtij Projekt Raporti).
Nga data 01.09.2019-31.10.2020 punonjësit që kanë përfituar pagesën për shërbimin e telefonive celulare në kundërshtim me VKM Nr. 864, datë 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë" janë paraqitur në aneksin nr. 3. Vlera totale e përfituar për këtë periudhë është **1,288,125 lekë** e cila ka shkaktuar efekt negativ për buxhetin e AAC. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi:Për shkeljen e konstatuar në pagesat e kryera për shërbimet telefonike dhe pse kjo praktikë është korrigjuar në vitin 2020, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja më e këtij fenomeni në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i AAC për Rekomandimin: Realizuar me Vendim të KD Nr. 11, datë 27.10.2020. Rekomandimi do të merret parasysh edhe në të ardhmen.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

E. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të AAC, si dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga "Vërejtje" deri "Largim nga shërbimi civil".
Për punonjësit e identifikuar me përgjegjësi për shkeljet e konstatuara, Titullari i AAC, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA PËR PROJEKTIN "OFRIMI I SHËRBIMEVE ME NË QENDËR QYTETARIN"

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për projektin "Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin"

mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, për periudhën vitet 2016, 2017 dhe vitin 2020, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ADISA, <u>nuk ka kthyer përgjigje</u> në KLSH, pasi nuk ka janë dhënë rekomandime por vetëm opinion auditimi.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, pasi nuk janë dhënë rekomandime por vetëm opinion auditimi.

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 1179/8, datë 29.12.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **0 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **0 masa për shpërblim dëmi në vlerën 0 lekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **0 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	-	-	-	-
3	Shpërblim dëmi	-	-	-	-
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-

5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	-	-	-	-
7	Masa disiplinore	-	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e ADISA

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	**Lloji i rekomandimit**	**Pranuar Plotësisht (numër)**	**Statusi i zbatimit**			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	0	0	0	0	0
3	Shpërblim dëmi	0	0	0	0	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	0	0	0	0	0
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L..

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nga KLSH nuk janë dhënë rekomandime pasi projekti ka përfunduar por vetëm opinion auditimi.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 1179/8, datë 29.12.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **0 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **0 masa për shpërblim dëmi në vlerën 0 lekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **0 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masa disiplinore**;

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ADISA, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, pasi nuk ka janë dhënë rekomandime por vetëm opinion auditimi.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar nuk është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për*

organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pasi nuk janë dhënë rekomandime por vetëm opinion auditimi.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i shprehur mbi Raportet Financiare (IFR) për vitet 2016, 2017 dhe viti 2020. Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar Raportet Financiare (IFR) të shpenzimeve të ligjshme të programit (EEP) të cilat përfshijnë shpenzimet e llogarive 600 "Paga personeli" dhe 601 "Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore" të Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/Ish-ZRPP) për periudhën vitet 2016, 2017 dhe nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020. Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, Manualin e Auditimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI 1000-1999), në parimet ISSAI-P1, "Deklarata e Limës"; ISSAI P-10, "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe Standardeve të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 200, 2000, 2200-2810.

Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer në auditim, është marrë siguri e arsyeshme dhe është siguruar një evidencë e mjaftueshme, e përshtatshme dhe relevante për të arritur në konkluzionin se Raportet Financiare (IFR) në aspektin material paraqesin një pamje të vërtetë dhe janë përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për raportimin financiar sipas marrëveshjes së huasë të ratifikuar me Ligjin nr. 3/2016, datë 28.01.2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin"".

Nga auditimi i shpenzimeve për llogaritë (600, 601) në Agjencitë Pjesëmarrëse të Projektit me shpenzimet e raportuar në Raportet Financiare (IFR) nuk rezultuan diferenca materiale, rezultat ky i cili justifikon dhënien e një Opinionit të pakualifikuar.

Baza për Opinionin e pakualifikuar[2]

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit nuk ka devijime materiale dhe opinioni i dhënë mbështetet në faktin se devijimet e konstatuara për shpenzimet e ligjshme të programit (EEP) për llogaritë (600 dhe 601) të raportuara nga Agjencitë Pjesëmarrëse (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/ish-ZRPP) në zyrën e Njësisë së Menaxhimit të Projektit (PMU) pranë ADISA përmbajnë gabime të cilat në gjykimin profesional të audituesve të pavarur nuk janë të përhapura dhe janë nën kufirin e vlerave materiale, që justifikon dhënien e opinionit të pakualifikuar

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) si dhe Agjencitë Pjesëmarrëse të Projektit (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/ish-ZRPP) janë përgjegjëse për koordinimin e duhur, funksionimin dhe për raportimin e drejtë dhe të saktë duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe menaxhimin e Projektit duke pasur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet. Ndërsa Agjencitë pjesëmarrëse të cilat

[2] ***Opinion i pakualifikuar.*** *Audituesi duhet të shprehë një opinion të pakualifikuar kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar.*

ofrojnë shërbime administrative, janë përgjegjëse për realizimin e shpenzimeve të ligjshme sipas programit EEP për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen nga Projekti.
Përgjegjësitë e audituesve
Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse paraqiten anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi shpenzimet e ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen nga Projekti për agjencitë pjesëmarrëse. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit. Përveç Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI-t), ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale agjencive pjesëmarrësve të Projektit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin financiar dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

ALBCONTROL SHA

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Albcontrol SHA mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", shoqëria Albcontrol ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.566/70 Prot., datë 31.01.2022, duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas nenit 30 të Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, dhe me shkresën nr. 1794 Prot., datë 08.07.2022 ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brënda afatit **6 Mujor**.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr.445/9 Prot., datë 06.01.2022 dhe në Albcontrol me nr.566/69 Prot., datë 11.01.2022, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **24 masa organizative**;

b. Janë rekomanduar **1 masë për shpërblim dëmi në vlerën 1,400,670 lekë**;

c. Janë rekomanduar **9 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit.**

d. Është rekomanduar që Albcontrol të analizojë **dhe të përcaktojë personat përgjegjëz dhe të marrë masa disiplinore përkatëse.** Subjekti nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Organizative	24	24	-	-
2	Shpërblim dëmi	1	1	-	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	9	9	-	-
4	Masa disiplinore	-	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e Albcontrol

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	24	11	1	10	2
2	Shpërblim dëmi	1	-	-	1	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në	9	7	-	2	-

	administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit					
4	Masa disiplinore	-	zbatuar	-	-	

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L..

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nr.	**Lloji i rekomandimit**	**Pranuar Plotësisht (numër)**	**Statusi i zbatimit**			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	24	11	1	10	2
2	Shpërblim dëmi	1	-	-	1	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në	9	7	-	2	-

	administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit					
4	Masa disiplinore	-	zbatuar	-	-	

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 45.8%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", shoqëria Albcontrol ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.566/70 Prot., datë 31.01.2022, duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas nenit 30 të Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, dhe me shkresën nr. 1794 Prot., datë 08.07.2022 ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brënda afatit **6 Mujor**.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se sipas pikës 3, Nenit 7 "Karakteristika të përgjithshme të aksioneve", kreut II "Aksionet dhe Kapitali" të statutit të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë nr. 25, datë 01.11.2013, aksionari i vetëm i shoqërisë Albcontrol SHA vazhdon të figurojë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
Ndërkohë që aktualisht aksionari i vetëm i shoqërisë është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila me Urdhrin nr. 148, datë 21.11.2017, ka miratuar edhe zmadhimin e kapitalit themeltar. Konstatohet gjithashtu se, sipas Nenit 16 "Numri, emërimi, përbërja dhe kriteret", Seksioni II "Këshilli Mbikëqyrës", i Statutit të Shoqërisë Aksionare anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës propozohen si në vijim: *2 anëtarë nga Ministria e Financës, 2 nga Ministria e*

Transportit dhe Infrastrukturës dhe 2 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes.
Për sa më sipër rezulton se shoqëria e zhvillon veprimtarinë e vet mbështetur në një Statut të pa përditësuar dhe njeh si organ propozues të antarëve të Këshillit Mbikëqyrës, një Ministri që nuk ekziston më, pas ristrukturimit të bërë në vitin 2017, konkretisht *Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,* kjo jo në përputhje me pikën 2 "Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: ndryshime të statutit", nenin 135 të Ligjit nr. 9901,datë 14.08.2008, i ndryshuar dhe shkronjën b, pikën 2 të Nenit 13 "Të drejtat dhe detyrimet" të Seksionit i "Asambleja e përgjithshme" e Statutit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
1.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA të marrin masa duke i drejtuar kërkesë Asamblesë së Aksionarit, me qëllim ndryshimin e emërtimit të aksionarit dhe përditësimin e Statutit. ***Menjëherë***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Vendim Nr.08, datë 30.03.2022 i Këshillit Mbikëqyrës "Për një ndryshim në statutin e shoqërisë Albkontroll;
-Shkresa nr.1708, datë 29.06.2022 e Drejtorit të Përgjithshëm "Mbi miratimin e statutit të përditësuar të shoqërisë Albcontrol", drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA për periudhën objekt auditimi, konstatohet se për propozimet dhe vendimmarrjet e ndryshimeve në Programin e Zhvillimit Ekonomik nuk janë relatuar me detaje arsyet mbi këto ndryshime.
Materialet argumentuese relatuese mbi këto vendimmarrje i janë vënë në dispozicion këtij organi vetëm një ditë përpara miratimit duke mos marrë kohë të mjaftueshme për njohjen dhe vlerësimin e tyre dhe si rrjedhojë këto ndryshime janë miratuar brenda ditës, jo në përputhje me nenin 21 , pika 4, Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"* sipas të cilit Raportet dhe materialet e përgatitura për t'u paraqitur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, sipas rendit të ditës të miratuar, u dorëzohen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nga drejtuesit e shoqërisë deri në 10 ditë para mbledhjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA, të marrë masa që të relatojë dhe të argumentojë në procesverbalet dhe mbledhjet e tij, çdo vendimmarrje sipas afateve të përcaktuara në kuadrin rregullator të funksionimit të shoqërisë.
Menjëherë dhe në vijimësi
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
--Vendim Nr.08, datë 30.03.2022 i Këshillit Mbikëqyrës "Për një ndryshim në statutin e shoqërisë Albcontrol (neni 22 pika 6 e statutit);
--Vendim Nr.08, datë 30.03.2022 i Këshillit Mbikëqyrës "Për një ndryshim në statutin e shoqërisë Albcontrol (neni 21 pika 4 e statutit);
Nga auditimi, u konstatua praktika si më poshtë:
-Relacion nr. 797 datë 24.03.2022 "Për një ndryshim në statut ...."
-Rendi i Ditës nr 9, datë 25 .03.2022;
-Vendimi nr.08, datë 30.03.2022 I Këshillit Mbikëqyrës;
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol SHA ka marrë vendimin Nr. 2 datë 25.02.2021 "Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë "Albcontrol" sha të vitit 2021.
Nga relacioni bashkëlidhur këtij vendimi argumentohet se shtohet nënzëri "Asistencë ligjore për çështjen e ngrirjes së llogarive bankare në Eurocontrol" në vlerën 12,500,000 lekë, vlerë e cila programohet të mbulohet nga zbritja e zërit "amortizim", në kuadër të lëshimit të një urdhër ekzekutimi nga shërbimi përmbarimor Belg me objekt "Bllokimin/ngrirjen e llogarive të Shqipërisë në Eurocontrol.
Pasi pala shqiptare si palë e paditur ka humbur çështjen pala paditëse i është drejtuar gjykatës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata dhe si rrjedhojë është lëshuar një urdhër ekzekutimi nga shërbimi përmbarimor Belg për bllokimin e llogarive të Albcontrol. Për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës Belge është angazhuar Eurocontrol, Avokatura e shtetit dhe një studio ligjore Belge e kontraktuar nga Albcontrol për asistencë ligjore.
Konstatohet se vendimi nr. 2 datë 25.02.2021 i Këshillit Mbikëqyrës për kontraktimin e studios ligjore belge është jo në përputhje me pikën 1, Nenin 9 "Zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar" të Ligjit Nr.10018, datë 13.11.2008 "Për avokaturën e shtetit" sipas të cilit, përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhen nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA, në lidhje me mbrojtjen për kundërshtimin e vendimit të gjykatës belge dhe angazhimin në këtë proces të një studio ligjore nga ana e Albcontrol SHA, të sigurohet koordinimi i mbrojtjes me Avokaturën e Shtetit duke garantuar eficencën maksimale në strategjinë e mbrojtjes, si dhe në interesin më të mirë të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të saj.

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Shkresa nr.1193, datë 05.04.2022 "Mbi vendimin e gjykatës shkalla e I^{rë} Belge", dërguar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit;
-Kthim përgjigje nr.1193/1 Prot., dat♪7 12.04.2022 nga Avokatura e shtetit, për vazhdimin e ankimimit në shkallën e II^{të} në Bruksel.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pjesëmarrjen e anëtarëve dhe sekretares së Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e shoqërisë dhe shpërblimeve të përfituara, u konstatua se pavarësisht faktit se mund të mos kenë marr pjesë në mbledhje ose kanë marr pjesë në një numër të kufizuar mbledhjesh vjetore, pagesat e tyre vlerësohen mujore, kjo e mbështetur nga Neni 24 "Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës" i Statutit i cili parashikon se "anëtarët përfitojnë shpërblim mujor për pjesëmarrje në Këshillin Mbikëqyrës i cili jepet sipas akteve ligjore në fuqi" dhe pika 7 e VKM Nr. 570, datë 3.10.2018 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore" e cila parashikon se "Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e parë e Këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonime".
Për sa më sipër edhe pse pjesëmarrja në mbledhje nuk është mujore dhe sipas Statutit Këshilli Mbikëqyrës bënë të paktën 4 Mbledhje në vit, shpërblimi është caktuar që të jetë mujor. Për periudhën objekt auditimi shpërblimet për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe sekretares

rezultojnë në vlerën 6,245,140 lekë bruto ose 5,308,369 lekë neto, pas mbajtjes së tatimit në burim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Nga administratori i shoqërisë Albcontrol SHA të merren masa për propozimin e rishikimit të VKM Nr. 570 datë 3.10.2018 me qëllim shpërblimin e anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhje. ***Menjëherë***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

---Vendim Nr.08, datë 30.03.2022 i Këshillit Mbikëqyrës "Për një ndryshim në statutin e shoqërisë Albcontrol (neni 22 pika 5 e statutit dhe neni 24);

Komenti i grupit të auditimit:

Për mungesë kompetence për ndryshimin e VKM Nr. 570, datë 3.10.2018.

Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.

5. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) raste nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të pasqyrës së asteve të Albcontrol SHA në tenderin me objekt: "Sigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHA" me nr. Reference të prokurimit: REF-23459-05-23-2019" dhe tenderit me objekt: "Sigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHA)" me nr. Reference të prokurimit: REF-23459-05-23-2018, u kostatua se:

- Në zbatim të procedurave për prokurimin "Sigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHA" viti 2019, grupi i punës me shkresën Nr. 1106/2, datë 21.05.2019, i përbërë nga: D. Z., H. P. dhe T. F. ka mbajtur proces –verbal për përgatitjen e specifikimeve teknike si dhe hartimin e pasqyrës së aseteve të shoqërisë në shumën 5,150,365,227 lekë, ku në k'të pasqyrë janë përfshirë programe/Pajisje informatike në shumën 71,280,236 lekë. Këto pajisje informatike/programe informatike, në gjykimin e audituesit mund të konsiderohen të pasqyruara në mënyrë të pa argumentuar dhe grupuar më saktë në asetet e shoqërisë me emërtimin pajisje dhe jo zëra të cilat paraqiten me veprime "Blerje" "Furnizim" apo "Instalime" për t'u siguruar nga rreziqet e mundshme.
- Në zbatim të procedurave për prokurimin "Sigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHA" viti 2018, grupi i punës, me shkresën Nr. 660/2, datë 02.05.2018, i përbërë nga: D. Z., H. P. dhe T. F. ka mbajtur proces –verbal për përgatitjen e specifikimeve teknike si dhe hartimin e pasqyrës së aseteve të shoqërisë në shumën 5,218,035,800 lekë, ku në k'të pasqyrë janë përfshirë, përfshirë programe/pajisje informatike në shumën 146,914,175 lekë. Këto pajisje informatike/programe informatike, në gjykimin e audituesit mund të konsiderohen të pasqryruara në mënyrë të pa argumentuara dhe grupuar më saktë asetet e shoqërisë me emërtimin pajisje dhe jo zëra të cilat paraqiten me veprime "Blerje" "Furnizim" apo "Instalime" për t'u siguruar nga rreziqet e mundshme. Për sa më sipër trajtuar, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, Kreu II, pika 2, shkronja "a"; me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 28. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Nga administratori i shoqërisë Albcontrol SHA si dhe nga Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i të Dhënave Konkurruese të merren masa që në zhvillimin e prokurimeve me natyrë të njëjtë në përllogaritjen e fondit limit të kontratave të ngjashme me objekt "Sigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHA" të bazohen në inventarin e saktë të aseteve të shoqërisë, duke argumentuar dhe grupuar më saktë asetet e shoqërisë me emërtimin pajisje dhe jo zëra të cilat paraqiten me veprime "Blerje" "Furnizim" apo "Instalime" për t'u siguruar nga 11 rreziqet. Disa zëra që nuk i përkasin këtij grupimi të adresohen me emërtim të ri të zërit dhe në grupin e duhur teknikisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhër nr.189, datë 04.02.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm "Për trajtimin dhe përmisimin të regjistrit të aktiveve";
-Raportim nr.373/1datë 13.04.2022 mbi rregullimin e emërtesave të regjitrit të aktiveve;
-Regjistri, llogaria 2189 Licenca dhe software etj, i përmisuar.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zhvillimin e prokurimit me objekt "Investime për infrastrukturën e Divizionit Teknik" me nr. Reference të prokurimit: REF-14539-03-20-2019, me fond limit 83,261,772 lekë pa TVSH, fituar nga BOE fitues "Rr. U. A. Nr. 2" SHA & "C." SHPK", me vlerë të kontratës së sipërmarrjes 79,098,683 lekë pa TVSH, u konstatua se në hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivit të punimeve, Autoriteti Kontraktor i është referuar markës/prodhuesit për zërat:
- zëri (An) F.V. Pajisje e brendshme kasetë AUXA54GALH, marka G. F., ngarkesë ftohëse 14 kw, ngarkesë ngrohëse 16 kw <u>në sasinë 12 copë.</u>
- *zëri i pajisjes, pompë e jashtme VRF V III "*G. F.*" për "*F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka G. F.: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90). Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw*".*
Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 23, pika 5, të LPP, me nenin 59, të VKM nr. 914, datë datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>6.1. Rekomandimi</u>: Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, si dhe Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i të Dhënave Konkurruese, në rastin konkret si dhe në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit me objekte/kontrata me natyrë të ngjashme, duhet të evidentojnë kritere të veçanta dhe të kryejnë një argumentim të thelluar teknik dhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre, kritere të cilat nuk mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së Operatorëve Ekonomik, ofertues të mundshëm të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri nr.190, datë 04.02.2022, i Drejtorit të Përgjithshëmpër për caktimin e grupit të punës;
-Raportimi nr.374/1 datë 22.04.2022 i grupit të punës;
-Procesverbal datë 20.06.2022 "Për argumentimin e kritereve të veçanta" në procedurën e prokurimit me object "Rishikimi i procedurave të afrimit RNP dhe SID RNAV të aeroportit të Tiranës".
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zhvillimin e prokurimit me objekt "Studim "Kukës obstacle survey" me nr. Reference të prokurimit: REF-85935-09-17-2018, me fond limit 40,000,000 lekë pa TVSH, fituar nga BOE "A. C." SHPK dhe "E." SPA, me vlerë të kontratës së sipërmarrjes 23,180,500 lekë pa TVSH, u konstatua se në procedurën e mësipërme morën pjesë 4 OE, konkretisht: BPOE "A.C." SHPK dhe "E." SPA me çmim oferte 23,180,500 lekë pa TVSH; BPOE "B.V. E." SHPK & "I. Y. S." SA me çmim oferte 19,800,000 lekë pa TVSH; OE "C. & M. A." SHPK me çmim oferte 36,800,000 lekë pa TVSH dhe OE "L. & C." SHPK me çmim oferte 39,000,000 lekë pa TVSH.
Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës në tender, KVO ka kualifikuar BPOE "A. C." SHPK & "E." SPA dhe BPOE "C. & M. A." SHPK si dhe ka s'kualifikuar BPOE "B.-V. E." SHPK & "I. Y. S." SA dhe BPOE "L. & C." SHPK.

Fitues nga KVO është shpallur BPOE "A. C." SHPK dhe E. S.P.A. me çmim oferte 23,180,500 lekë pa TVSH, si BOE i cili plotëson të gjitha kushtet e DST dhe me një diferencë me FL në vlerën 16,819,500 lekë. AK "Albcontrol" SHA, me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi OE "B.-V. E." SHPK me shkresën me nr. 108 prot., datë 22.10.2018 (Protokolluar në Albcontrol SHA me nr. prot. 2135, datë 22.10.2018) për procedurën me objekt "Studim "Kukës obstacle survey", ka urdhëruar Njësinë e Prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO me urdhrin e brendshëm nr. 1916/5 datë 23.10.2018, të pezullojë vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në kthimin e përgjigjes së ankesës.
Në vijim, titullari i AK Albcontrol SHA, me shkresën me nr. 2135/1 prot., datë 24.10.2018 me objekt: Kthim përgjigje, informon OE "B.V. E." SHPK, se ankesa nuk merret parasysh nga Autoriteti Kontraktor "Albcontrol" SHA duke argumentuar pretendimet e operatorit ofertues ankimues.
Konstatohet se nga Titullari i Albcontrol SHA nuk është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Komisioni i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, kreu "X" "Shqyrtimi i ankesave", neni 78 "Ankesat në autoritetin kontraktor" pika 6 (a) dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK "Albcontrol" SHA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 82-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandim: Titullari i Autoriteti Kontraktor, për rastin konkret si dhe në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit, duhet të eliminojë praktikat e kthimit të përgjigjes mbi pretendimet e ngritura nga vetë titullari, por të ngrejë Komisionin e Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhër nr.1900/3, datë 20.12.2021 "Për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave" për ankesën e operatorit ekonomik "A.", për objektin e prokurimit "shpenzime për mirëmbajtjen të mjeteve të transportit" me fond limit 7,496,200 lekë pa TVSH.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, rezulton se, sistemi i NjAB në Albcontrol SHA për periudhën e audituar 2018 – 31.03.2021 ka funksionuar në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", me emërtesën "Njësia e Auditimit të Brendshëm" por ka ende nevojë për përmirësime me qëllim përdorimin sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, adresimin e risqeve dhe auditimin e sektorëve me risk të lartë në veprimtarinë ekonomike dhe financiare në Albcontrol SHA, për të dhënë garanci të mjaftueshme që objektivat e njësisë audituese do të arrihen duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë. Është miratuar Karta e Auditit, janë hartuar planet strategjike, planifikimet vjetore, si dhe raportimet vjetore të aktivitetit të njësisë, dërguar në DHAB brenda afateve dhe standardeve ligjore të përcaktuara Manualin e Auditimit të Brendshëm. Por gjithsesi, nga NjAB janë realizuar 7 auditime nga 15 auditime të planifikuara ose në masën 46.66 %. Disa nga subjektet e audituara, kanë pranuar rekomandimet e lëna dhe kanë paraqitur një Plan Veprimi të pjesshëm për zbatimin e rekomandimit, veprime që nuk përmbushin tërësisht ligjin 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",

dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për forcimin e procesit të auditimit të brendshëm duke planifikuar auditime në sektorë me risk të lartë dhe të rrisë numrin e auditimeve në Kompaninë Albcontrol SHA. ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Shkresa nr.1475/1, datë 20.10.2021 Plani strategjik Vjetor i veprimtarisë së Auditit të Brendshëm për 2022-2024, dërguar Drejtorisë të Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

9. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit, në 9 raste rezultuan parregullsi mbi fillimin/inicimin e procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor, për periudhën 01.09.2018- 30.09.2020, jo në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 12, pika 2, germa a) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të ardhshme të prokurimit, t'i iniciojë këto procedura duke evidentuar në kërkesat nga Divizionet/Drejtoritë e shoqërisë, arsyet dhe relacionet sipas planifikimeve në programet ekonomike të nevojave për investime/shpenzime të shoqërisë, duke bërë një përshkrim të shkurtër/relacion, bashkëlidhur kërkesës për fillimin e procedurave. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri nr191, datë 04.02.2022;

-Raportimi nr.375/1, datë 04.02.2022;

-Raportimi nr.375/1, datë 22.04.2022 , bashkëlidhur formati tip i kërkesës për fillim procedure;

-Kërkesë nr.1507, datë 06.06.2022 e Drejtorit të Divizionit Teknik, për fillimin e procedurave të prokurimit me objekt "Shpenzim për Flight Check", mbi nevojën dhe qëllimin e shpenzimit.

-Urdfhër nr,1507/1, datë 08.06.2022 për ngritjen e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike;

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

10. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit u konstatua se, në **5** raste, përllogaritja e fondit limit, është kryer jo në përputhje me kërkesat e nenit 59 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar dhe nenit 26 e 28 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2016, për Prokurimin Publik, i ndryshuar, për të cilët kërkohet minimumi 3 operatorë ekonomik, për të marrë një mesatare mbi çmimet e tregut. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Nga Titullari i shoqërisë të merren masa për zhvillimin e prokurimeve me natyrë të njëjtë që përllogaritja e fondit limit të bëhet në mënyrë të saktë, që në rast të zgjedhjes së alternativës me tre OE në përllogaritjen e fondit limit, duhen përzgjedhur ata operatorë ekonomik që kanë për objekt fushën e prokurimit dhe fenomene të ngjashme mos përsëritet në të ardhmen, në Procedurat e Prokurimit Publik.

- Për procedurën me objekt: "Shërbime për kontrollin mjekësor", nga grupi i punës në përllogaritjen e fondit limit dhe grupi i punës që ka hartuar specifikimet teknike, në procedurat e ardhshme të përcaktojnë qartë shërbimet e planifikuara, shoqëruar me numrin e saktë të

shërbimeve, duke argumentuar në mënyrë transparente dhe çmimin e shërbimeve që planifikohen të kryhen, shoqëruar me dokumentacionin përkatës në grafikun e Dokumenteve Standarde të Tenderit. ***Në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Procesverbal nr.647/3 datë 14.04.2022 " Për përcaktimin e vlerës limit për procedurën e prokurimit me objekt "Shpenzime për kontrollin mjekësor".

-Urdhër nr.1507/3, datë 15.06.2022 për ngritjen e grupit të punës për përllogaritjen e vlerës së fondit limit me objekt "Shpenzim për Flight Check";

-Ofertat nr.17, datë16.06.2022, nr.42 dhe nr88, datë 17.06.2022;

-Procesverbali nr.1507/4 datë 20.06.2022 për përcaktimin e vlerës limit.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin e specifikimeve teknike u konstatua se, në 9 raste hartimi i tyre është bërë jo në përputhje me kërkesat e nenit **23**, pika **3**, shkronja **b)** dhe pika **4** të Ligjit **nr. 9643**, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe jo sipas kërkesave të nenit 61, pika 2, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 'Për miratimin e rregullave të prokurimit publik' i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Nga Titullari i shoqërisë Albcontrol SHA, të merren masa, që në zhvillimin e Procedurave të Prokurimit Publik, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, për çdo kriter të kërkuar në DST, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, me qëllim të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike dhe funksionale. ***Në vazhdimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

- Specifikime teknike nr. 1430/2 datë 03.06,2022 "Rishikimi i draft procedurave të afrimit të RNP dhe RNAV SID në aeroportin e Tiranës";

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi paraqitjen e dokumenteve të tenderit nga operatorë ekonomikë pjesëmarrës, në **3** raste u konstatuan parregullsi mbi verifikimin dhe vërtetësinë e dokumenteve të tenderit, respektivisht në Procedurën e Prokurimit me objekt: "Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-Indra 2019", "Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VSC-INDRA, GAREX 2019", "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbajte VSC-INDRA, GAREX 2020". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, të analizohen rastet dhe të merren masa që për procedurat e shqyrtuara respektive, si dhe në procedurat e tjera në vijim, të vërtetohet dhe dokumentohet vërtetësia e dokumenteve, që janë kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) që janë autorizime/letra e prodhuesit, për pajisjet navigacionale, prodhuar nga Indra apo Garex duke kontaktuar me prodhuesin që ka lëshuar dokumentin, siç është përshkruar në pikën përkatëse. ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri nr199, datë 04.02.2022 për ngritjen e grupit të punës;

-Raportimi nr.383/1 datë 22.04.2022 i grupit të punës;

Shoqëria Albcontrol, duhet të veprojë me akte (manuale, udhëzime ose urdhëra) në mënyrë që njësia e prokurimit të parashikojë në DST dokumentimin për vërtetimin e dokumenteve të kërkuara në kuadrin e marrjes së masave korigjuese.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratave për punë publike/mallra/shërbime, në **15** raste u konstatuan problematika mbi pagesat paraprake, respektivisht për kontratat si vijon:
- Kontratë për punë publike "Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencës" me Nr. 2317/4 Prot, datë 27.12.2017 lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE "A.-I. Gj. C." me vlerë 44,753,785.2 lekë me TVSH ku, nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **70 %** të vlerës totale të kontratës. Kjo pagesë do të jepet për krijimin e kushteve që kanë të bëjnë me punimet për rehabilitimin e Kullës së Kontigjencës.
- Kontratë me objekt "Shpenzime mirëmbajtja dhe blerje pjesë ndërrimi e sistemeve të instaluara ne ACC/APP/TWR /ADMINISTRATE)" me Nr. 948/4 Prot, datë 10.06.2019 lidhur ndërmjet Albcontrol SHA, dhe Operatorit Ekonomik (OE) "4.M." SHPK, me vlerë 35,098,711.20 lekë me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt "Studim "Kukës obstacle survey" me Nr. 1916/7 Prot, datë 12.11.2018 lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe BPOE "A. C." SHPK & E. S.P.A, me vlerë 27,816,600 lekë me TVSH, do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30 %** të vlerës së ofertës ekonomike.
- Kontratë me objekt "Rehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACC" me Nr. 2255/5 Prot, datë 27.12.2018 lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe BOE "R. U. A. Nr. 2" SHA & "T. E. 2" SHPK, në vlerën 46,507,990.8 lekë me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **20%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt "Trajnim KTA të rinj (Rating ACS/TWR) dhe gjuhën Angleze'" me Nr. 2185/4 Prot, datë 13.11.2019, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE "C. & M. A."SHPK në vlerën 53,904,000 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt "Trajnim refresh të emergjencave ATCO" me Nr.351/5 Prot, datë 15.03.2019, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe BOE "C. & M.A. dhe E.P. N. AB", në vlerën 79,999,200 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt "Shpenzime për kontrollin mjeksor" me Nr. 2278/4, datë 24.12.2019, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE "A. H."sha, në vlerën 49,200,000 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt "Shpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optike" me kontratë Nr. 373/4, datë 20.03.2019, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE "R . T." SHPK, në vlerën 25,356,072 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt "Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-Indra" me kontrata Nr. 374/4, datë 20.03.2019, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE "R ." SHPK, në vlerën 10,999,980 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.

- Kontratë me objekt "Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VSC-INDRA, GAREX" 2019 me kontratë Nr. 577/4, datë 09.04.2019, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE "R ." SHPK, në vlerën 41,988,960 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **40%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbatje VSC-INDRA, GAREX'" 2020 me kontratë Nr. 459/6, datë 19.05.2019, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE "R." SHPK, në vlerën 66,146,400 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt "Masterplani i Navigimit Ajror për Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës" me kontratë Nr. 459/6, datë 19.05.2020, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE "R & T" SHPK, në vlerën 66,146,400 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga "I Siguruari" do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.

Grupi i auditimit mendon se përcaktimi i pagesës paraprake është bërë jo në përputhje me: DST të miratuara nga AK dhe konkretisht me shtojcat mbi "Kushtet e veçanta" si dhe "Pagesat paraprake" por edhe në kundërshtim me kërkesat e nenit **60**, pika **1** të ligjit **Nr. 9643,** datë **20.11.2006** "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar.

Paradhënie e pargumentuar nga Autoriteti Kontraktor në 3 procedura prokurimi, përkatësisht në kontratat e lidhura të procedurave:

- Kontratë me objekt "*Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*
- Kontratë me objekt "*Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019;*
- Kontratë me objekt "*Blerje Brifing System", viti 2018;*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi. Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, për rastet konkrete dhe gjatë zhvillimit të prokurimeve me natyrë të njëjtë t'i kërkojë NjP dhe Juristit që të analizohen rastet mbi paradhënien e operatorit ekonomik fitues, në vlerën nga 20 % deri në 70 % të vlerës së kontratës, dhe këto veprime të parashikohen që në fazën fillestare të hartimit të DST me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në garën e zhvillimit të prokurimeve.

Në vazhdimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhër Nr.184 datë 04.02.2022, nr.368 Prot., i Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës;

-Raportimi nr.368/1, datë 19.04.2022 i grupit të punës;

-DST në procedurën e prokurimit me objekt "Rishikimi i procedurave instrumentale të afrimit e uljes me VOR dhe ILS në aeroportin e Tiranës", datë 26.10.2021;

Nga auditimi, është konstatuar se në kushtet e veçanta të kontratës, në rastin kur parashikohet paradhënie, kjo e fundit nuk mbulohet nga garancia 10 % e kontratës. Shoqëria duhet të parashikojë riskun e dështimit të kontraktorit në këtë rast, duke kërkuar sigurim të mjaftueshëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është në proces.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AK mbi zbatmin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm u konstatua se; për 4 masa organizative të mbetura në proces zbatimi nga Albcontrol SH: **1** masë është zbatuar pjesërisht, **2** masa janë zbatuar plotësisht, **1** masë është në proces. **1** (një) masë për shpërblim dëmi në vlerën **33,435,330 lekë** është në proces; **1** (një) masë në vlerën **1,512,840 lekë** për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me

ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike rezulton në proces zbatimi. Nga Albcontrol SHA rezulton se 1 (një) masë disiplinore nuk është zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Albkontrol SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos realizimin e masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, si dhe të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri nr.196, datë 04.02.2022 për ngritjen e grupit të punës.

-Raportimi nr.380/1, datë 19.04.2022 i grupit të punës. ku është konstatuar përsëri mos ekzekutim i zërave të punimeve dhe tejkalim afatesh punimesh për kontratën nr.1646/4 datë 16.03.2016, me objekt "Blerje pajise ILS për procedurën RW36" me OE TCN &TCN International. Nga ana e Drejtorisë Juridike Albcontrol është përgatitur draft-padia civile për arkëtimin e vlerës 33,435,330 lekë, e cila është në pritje të vendimmarrjes për depozitimin në gjykatë.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është në proces.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve të prokurimeve në **9** raste u konstatua, mos argumentim nga Autoriteti Kontraktor Albcontrol SHA, i kërkesave nga strukturat përkatëse për fillimin e procedurave të prokurimit si dhe në procesin e përllogaritjes së fondit limit, përkatësisht për prokurimet:

- *"Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*
- *"Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol", viti 2019;*
- *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019;*
- *"Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*
- *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019;*
- *"Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza II", viti 2019;*
- *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*
- *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*
- *"E-Brifing System", viti 2018;*

Kërkesat për fillimin e procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor nuk përmbajnë asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol sha për realizimin e këtyre prokurimeve, si dhe nuk kanë të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës, në të cilin të jetë parashikuar kryerja e këtyre investimeve / shpenzimeve, për nevojat e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të ardhshme të prokurimit të:

- T'i iniciojë këto procedura duke evidentuar në kërkesat nga Divizionet/Drejtoritë e shoqërisë, arsyet dhe relacionet sipas planifikimeve në programet ekonomike të nevojave për investime/shpenzime të shoqërisë.
- Përdoret metoda e llogaritjes së fondit limit përmes studimit të tregut, të marrë parasysh dhe të vlerësojë vetë ato oferta të operatorëve ekonomikë administrimi shkresor i të cilave në shoqëri është i mirë dokumentuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri nr.185 datë 04.02.2022;
-Raportimi nr.369/1 datë 22.04.2022,
-Raportimi nr.375/1, datë 22.04.2022 , bashkëlidhur formati tip i kërkesës për fillim procedure;
-Urdhër nr.1507/3, datë 15.06.2022 për ngritjen e grupit të punës për përllogaritjen e vlerës së fondit limit me objekt "Shpenzim për Flight Check";
-Ofertat nr.17, datë16.06.2022, nr.42 dhe nr88, datë 17.06.2022;
-Procesverbali nr.1507/4 datë 20.06.2022 për përcaktimin e vlerës limit.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit u konstatua mos respektim i LPP në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, përkatësisht për prokurimet:

- "*Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*
- *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019;*
- "*Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*
- "*Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019;*
- "*Blerje Brifing System", viti 2018;*
- "*Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*
- "*Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018; (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Albcontrol sha. të marrë masa që në të gjithë procedurat e prokurimit që kanë objekt ofrimin e shërbimeve apo blerjen e mallrave që lidhen me sisteme aktuale të teknologjisë së informacionit që posedon shoqëria, të argumentojë dhe të përshkruajë në mënyrë të qartë të gjithë situatën aktuale të sistemeve dhe ambienteve teknologjike në të cilët do të kryhen shërbimet apo implementohen produktet duke paraqitur të dhëna të përgjithshme (Nr. Pajisjesh, mënyra e lidhjes në rrjet, llojet e infrastrukturës/topologjisë mbi të cilat janë ngritur platformat) me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, duke pasur në konsideratë që informacioni i publikuar të mos-përmbajë të dhëna teknike konfidenciale, publikimi i të cilave mund të përbëjë risk për cenimin e sigurisë së informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri nr.185 datë 04.02.2022;
-Raportimi nr.369/1 datë 22.04.2022,
- Specifikime teknike nr. 1430/2 datë 03.06,2022 "Rishikimi i draft procedurave të afrimit të RNP dhe RNAV SID në aeroportin e Tiranës";
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin e DST në **2** raste të zhvillimit të procedurës së prokurimit përkatësisht për prokurimet me objekt:
1. "Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018, u konstatua se kërkesa Nr. 289, dt. 01.02.2018, e z. S. R., me detyrë Drejtor i Divizionit Operacional për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol

sha. për realizimin e këtij prokurimi, dhe gjithashtu nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës. Veprim ky në kundërshtim me LPP në lidhje me hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit.
- "Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019 VOIP, u *konstatua se, n*ë DST është kërkuar nga operatorët ekonomikë të cilët janë të interesuar për të marrë pjesë në procedure që të jenë të pajisur me autorizim të prodhuesit të sistemeve të IT por nuk është pëcaktuar se cili është prodhuesi i këtyre sistemeve që ka në përdorim Albcontrol. Ky veprim dhe mosveprim është në kundërshtim me Nenin 61, Pika 2, e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 127-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1 Rekomandimi: Albcontrol sha. të marrë masa që në të gjithë procedurat e prokurimit që kanë objekt ofrimin e shërbimeve apo blerjen e mallrave që lidhen me sisteme aktuale të teknologjisë së informacionit që posedon shoqëria, për të cilat Njësia e Prokurimit konsideron se duhet të kërkojë në DST që operatorët ekonomikë të jenë të autorizuar nga prodhuesi përkatës i këtyre sistemeve, të përcaktojë dhe të bëjë të njohur për operatorët ekonomikë se cili është prodhuesi përkatës i këtyre sistemeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri nr.185 datë 04.02.2022;
-Raportimi nr.369/1 datë 22.04.2022,
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për 3 procedura prokurimit përkatësisht:
- "*Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*
- *"Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol", viti 2019;*
- *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019;*

Nuk është respektuar legjislacioni i prokurimit publik në lidhje me përllogaritjen e fondit limit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 167-175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë të nxirren përgjegjësitë për këto raste dhe të merren masa që mos të përsëritet ky fenomen, nga grupet e përllogaritjeve të fondit limit për procedurat e prokurimit në të ardhmen. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me urdhërin e brendshëm nr.196, datë 04.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngarkuar sektori i AB për zbatimin e rekomandimit të KLSH;
-Raportimi nr.380/1 datë 19.04.2022 i Auditit të Brendshëm.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit "Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol", viti 2019, në Urdhrin e Prokurimit Nr. 500, Datë 21.02.2019, NjP ka përcaktuar që lloji i procedurës së prokurimit të jetë 'Kërkesë me Propozim' me qëllim nxitjen për pjesëmarrje të operatorëve ekonomikë në këtë procedurë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, konstatohet se nuk ka asnjë argumentim të arsyes së përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar njoftimi për ftesë për propozim, gjë e cila bie në

kundërshtim me pikën 4 të Nenit 39 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
- Nga auditimi i likuidimit dhe zbatimit të kontratës është konstatuar se AK është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës 42590535 të datës 16/12/2019 në vlerën 973,920 lekë me TVSH për shërbimet (Pjesëmarrje në mbledhjen e Nëntorit të Komitetit të Zgjeruar të CRCO për miratimin e kostos të shërbimit "En-route" për vitin 2020; Pjesëmarrje në takime konsulence në lidhje me koston e terminalit e miratimin e saj për vitin 2020; Përgatitje e raportit përkatës; Shpenzime të tjera lidhur me shërbimet e mësipërme) ku pagesa e faturës së sipërpërmendur është konfirmuar përmes procesverbalit Nr. 500/10, Datë 17.12.2019, të dy prej anëtarëve të grupit të punës për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës ngritur me Urdhrin Nr. 500/5, datë 29.03.2019 konkretisht znj. R. D. dhe znj. H. P., ndërkohë që procesverbali nuk është sigluar nga anëtari tjetër i grupit të punës së sipërpërmendur, znj. D. Z.. Ky veprim nuk është në përputhje me Pikën 54 të Udhëzimit Nr. 30, Datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 134-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Albcontrol Sha në rastet e procedurave të prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen duke përdorur llojin e procedurës 'Kërkesë për Propozim', në çdo rast të dokumentojë arsyen e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që do të ftojë për të paraqitur propozimet për procedurën përkatëse si dhe pavarësisht eksperiencave të mëparshme të suksesshme me operatorë ekonomikë të caktuar, të ndjekë me përpikmëri të gjithë hapat dhe veprimet që përcakton legjislacioni për prokurimin publik.
- Albcontrol Sha të marrë masa që në rastet e pamundësisë së arsyeshme së anëtarëve të grupeve të punës për prezencë në momentin e marrjes në dorëzim të shërbimeve apo mallrave të kryejë zëvendësimin e anëtarit i cili nuk mund të jetë prezent.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me urdhëri i brendshëm nr.188, datë 04.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngarkuar sektori i prokurimeve për zbatimin e rekomandimit të KLSH;
-Raportimi nr.372/1 datë 19.04.2022 i grupit të punës.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces

20. Gjetje nga auditimi: Parregullsi në procedurën e prokurimit *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019; (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 168-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi: Albcontrol Sha të marrë masa që në të ardhmen të dokumentojë përmes procesverbaleve përkatës dorëzimin e shërbimeve apo mallrave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri nr.185 datë 04.02.2022;
-Raportimi nr.369/1 datë 22.04.2022,
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës "***Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019***, u konstatua se kërkesa Nr. 228, dt. 25.01.2019, për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol SHA, për realizimin e këtij prokurimi, dhe

nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.

-Kriteri për punimet e ngjashme konsiderohet i paargumentuar pasi sistemi i akses control dhe sistemi i evakuimit në raste alarmi nuk lidhen me aviacionin civil, por janë sisteme që funksionojë në mënyrë universale dhe kanë të njëjtët parime dhe standarde pune pavarësisht fushës ku aplikohen.

- Kriteret për zoterim të çertifikates **ISO 14001:2015** mbi "Sistemet e menaxhimit te ambjentit", të certifikates PAS 99:2012 për Sistemin e Integruar të Menaxhimit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anetaret e bashkimit duhet të jenë në zoterim të kësaj certifikate ose ekuvalente me to", të certifikates për sistemin e menaxhimit të energjisë ISO 50001:2011. Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jete e vlefshme në kohen e zhvillimit te tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kësaj certifikate. Ose ekuvalente me to", të certifikates për sistemin e menaxhimit të përgjegjshmërisë sociale SA 8000:2014 Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohen e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtaret e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kësaj certifikate. Ose ekuivalente me to" në opinionin e grupit të auditimit, përcaktimi i tyre si kriter për kualifikimin e operatorëve ekonomikë nuk nxit operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në këtë procedurë dhe konsiderohen si kritere që nuk lidhen me realizimin e objektit të procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 178-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës sipas objektit të prokurimit për të hartuar një raport për domosdoshmërinë e çdo kriteri të veçantë të përcaktuar në këtë procedurë. Në varësi të rezultateve të raportit të hartuar nga specialistët e fushës, sipas përgjegjësive përkatëse të merren masa administrative përkatëse nga ana e shoqërisë.

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Planveprimi nr.566/70, datë 03.01.2022;

-Urdhëri nr.195 datë 04.02.2022;

-Raportimi nr.379/1 datë 22.04.2022, në të cilin grupit të punës është shprehur se nuk ka diskrecion ligjor për trajtim;

Nga auditim, është konstatuar se shoqëria Albcontrol e ka pranuar rekomandimin në planveprimin e saj nr.566/70 datë 03.01.2022 dhe nuk ka marrë masa korrigjuese .

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim nuk është zbatuar.

21.2 Rekomandimi: Albcontrol sha të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në lidhje me sisteme të teknologjisë të përcaktojë në Njësinë e Prokurimit të paktën një specialist të fushës dhe të mos përcaktojë kritere që nuk lidhen me objektin e shërbimit apo mallit që prokurohet. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri nr.195 datë 04.02.2022 për ngritjen e grupit të punës;

-Raportimi nr.379/1 datë 22.04.2022;

-Urdhëri nr.1430/1 datë 30.05.2022 për ngritjen e grupit për hartimin e specifikimeve teknike ;

-Specifikime teknike nr.1430/2 datë 03.06.2022.

-Urdhër nr786/1 datë 24.03.2022 për ngritjen e grupit për hartimin e specifikimeve teknike ;

-Specifikime teknike nr.789/2 datë 28.03.2022;
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

22. Gjetje nga auditimi: Për 2 procedura prokurimit përkatësisht :
- *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*
- *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*

nuk është respektuar legjislacioni i prokurimit publik në lidhje me nënkontraktimin, veprim ky në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar, neni 61 dhe VKM 914 datë 29.12.2014 'Për miratimin e rregullave të prokurimit publik' i ndryshuar, neni 75.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 178-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
22.1 Rekomandimi: Albcontrol sha. të marrë masa që në të gjithë procedurat e prokurimit në të cilat operatori ekonomik fitues i tenderit lidh marrëveshje nënkontraktimi, pavarësisht nëse operatori i nënkontraktuar ka pasur eksperienca të mëparshme në procedurat e zhvilluara nga Albcontrol, të shqyrtojë dhe të vlerësojë dokumentacionin e kërkuar në tender për operatorin ekonomik të nënkontraktuar njësoj sikurse për operatorin ekonomik të kontraktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhër nr.186, datë 04.02.2022 "Për ngritjen e grupit të punës dhe trajtimin e rekomandimit 22.1 të KLSH;
-Raportimi 370/1, datë 22.04.2022 i grupit të punës;
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen teknike të zbatimit, në **2** kontrata të lidhura përkatësisht :
1. "Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018 (Kontrata 1873/5, dt. 23.10.2018);
2. "Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018 (Kontrata 1872/4, dt. 23.10.2018);
Është përdorur metoda VPN (Virtual Private Network) për ofrimin e shërbimit të mbështetjes teknike për Albcontrol sha, nga operatorët ekonomikë, pa dokumentuar arsyen dhe domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj metode, dakordësimin midis autoritetit kontraktor dhe kontraktuesit si dhe të dhëna të tjera teknike në lidhje me këtë shërbim, në mos-përputhje me detyrimet kontraktuale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
23.1 Rekomandimi: Albcontrol të marrë masa që në të gjithë rastet, kur nga kontraktorët me të cilët lidhen kontrata me objekt sistemet e informacionit të të gjithë niveleve ofrohet shërbimi i suportit përmes metodës VPN, të dokumentojë të gjithë procedurën e kryer për çdo rast të ofrimit të shërbimit, duke nisur nga dakordësimi për përdorimin e VPN për çdo rast deri në dokumentimin e zgjidhjes së dhënë në lidhje me problematikën e raportuar apo shërbimin e kryer.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhër nr.187, datë 04.02.2022 "Për ngritjen e grupit të punës dhe trajtimin e rekomandimit 23.1 të KLSH;
-Raportimi 371/1, datë 22.04.2022 i grupit të punës;

-E-mail datë 31.03.2022 me subject “Kontrolle periodike CMS & HD” nga Air Navigation Services of Albania.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës gjatë vitit 2019, lidhur me ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, janë marrë ose një ditë para, ose brenda të njëjtës ditë, me atë kur është miratuar relacioni përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm që i propozonte.
Referuar materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, konstatohet se miratimet e ndryshimeve me *Vendimet nr. 19 dhe nr. 22 e Këshillit Mbikëqyrës*, janë marrë brenda të njëjtës ditë me relacionet përkatëse të Drejtorit të Përgjithshëm, për ndryshimin e programit të zhvillimit ekonomik. Veç të tjerash, propozimet e përfshira në relacionet shpjeguese kanë qenë në të dyja rastet të shumta dhe koha brenda të cilës janë marrë vendimet nga Këshilli Mbikëqyrës, ka qenë e pamjaftueshme për anëtarët e tij, për të marrë informacion, për të bërë vlerësime dhe për të marrë vendime të kujdesshme në interes të aktivitetit të shoqërisë, duke anashkaluar parimin e përgjithshëm mbi ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, në shoqëritë tregtare të cilat menaxhohen nga një sistem administrimi me dy nivele, ku ndarja e funksioneve, ai i hartimit të politikave, i ushtruar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe ai i zbatimit të politikave, i ushtruar nga Drejtori i Përgjithshëm, mbetet detyrim i cili duhet respektuar në thelb.
Konstatohet se, relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm japin një përshkrim të shkurtër të propozimeve, pa një analizë të hollësishme mbi domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve, në shtesa apo pakësimi të zërave të shpenzimeve, ndërsa nga procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës rezulton mospjesëmarrje e përfaqësuesve të Divizioneve që kanë lidhje me çështjet, objekt propozimi për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të cilët do të duhej të prezantonin materialin për pjesën teknike, e po kështu dhe mungesa e nënshkrimeve në relacionet propozuesve për ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 163, neni 164, neni 166, të Statutit të shoqërisë “ALBCONTROL” SHA, nenit 21 dhe me Rregulloren e Brendshme të “ALBCONTROL” SHA, miratuar me Vendimin nr. 9, datë 26.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, Kreu IV “Funksionimi i shoqërisë”, nenet 21, 37, 38, 39 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 43-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>24.1 Rekomandimi</u>: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për ushtrimin e kompetencave të tij për miratimin e propozimeve të ndryshimeve të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, vetëm pasi të jetë paraqitur nga shoqëria i gjithë dokumentacioni shpjegues për nevojën e këtyre ndryshimeve, duke marrë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe njohur relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm e duke shmangur vendimmarrjen e përshpejtuar.
Titullari i Albcontrol SHA dhe Departamentet e shoqërisë të marrin masa të hartojnë dhe administrojnë propozimet për ndryshimet e mundshme të ardhmen të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, shoqëruar me relacione të hollësishme teknike dhe financiare.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nuk u paraqit dokumentacion justifikues.
Ky rekomandim nuk është zbatuar.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga ana e Titullarit të njësisë publike (Albcontrol SHA), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim ***shpërblimin e dëmit në vlerën*** **5,602,680** ***lekë pa TVSH***, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Mos realizim i detyrimeve kontraktuale me pasojë dëmtimin e fondeve publike në vlerën **5,602,680 lekë me TVSH** për procedurën e prokurimit *"Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019.* Nisur nga konstatimet e kryera në terren nga grupi i auditimit është konstatuar se në zbatim të kontratës së lidhur për procedurën e sipërpërmendur, nuk është realizuar njëra nga komponentët e zërit "Integrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim&trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering System", konkretisht komponentja 'integrimi i sistemit të akses control me Rostering System". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 152-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albcontrol sha të marrë masa për ngritjen e grupi pune të përbërë nga specialistë të fushës, i cili të analizojë situatën e realizimit të pjesshëm të zërit "Integrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim&trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering System", zë i cili është faturuar në vlerën **5,602,680 lekë me TVSH** dhe të hartojë një raport ku të përcaktohet vlera financiare përsa i përket "Integrimit me Rostering System". Të merren masa që vlera financiare e mos realizimit të integrimit me Rostering System që do të nxirret nga ky raport të arkëtohet pranë shoqërisë nga ana e OE 'R.' SHPK.

Brenda datës 30.03.2022

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhër i brendshëm nr.175, datë 04.02.2022;
-Relacion i grupit të punës nr 566/71 prot., datë 28.02.2022, në të cilin është përcaktuar vlera financiare prej 1,400,670 lekë pa TVSH, që duhet të arkëtohet nga shoqëria R. SH.P.K, përsa i përket procedurës së prokurimit "Instalimi i Aksses Control System në ACC/TWR dhe integrimi Rostering System".
-Shkresa me nr.1216 Prot., datë 08.04.2022 drejtuar shoqërisë R. SH.P.K;
-Kthim përgjigje nr.1216/1, datë 10.05.2022 e shoqërisë R. SH.P.K;
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "Investime për infrastrukturën e Divizionit Teknik" Albcontrol SHA, fituar nga BOE fitues "Rr. U. A. Nr. 2" SHA & "C." SHPK", me vlerë 94,918,419.60 lekë me TVSH, u konstatua realizimi i zërit të punëve "*F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka G. F.: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90)"* jo në përputhje me specifikimet teknike për treguesit: *Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw*".
Pra, vendosja e pompës së nxehtësisë (Chiller) VRF nga sipërmarrësi i punimeve BOE "Rr. U. A. Nr. 2" SHA & "C." SHPK me tregues më të ulët sesa treguesit e përcaktuar në Specifikimet Teknike të pranuara dhe nënshkruara nga sipërmarrësi i punimeve në DST, ka shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën **5,354,194 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me:
- Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike (Shtojca 5) e DST.
- Projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike (Shtojca 13).
- Shtojcën 18 (Kushtet e përgjithshme të kontratës), Neni 13 "Kontraktori që Kryen Punimet", pika 13.1 ku citohet se: " Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit" të kontratës me Nr. 732/45 Prot, datë 21.05.2019. Pika 13.3 ku citon se: "Kodet dhe standardet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standardeve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor", Neni 14 (Materialet dhe pajisjet) të kontratës nr. 732/4 prot, datë 21.05.2019. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/2 dhe neni 15; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" Kreu II, Pika 3.2. (Më hollësisht *trajtuar në pikën 7 faqe 77-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të realizimit të zërit të punëve "*F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka G. F.: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90); Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw*" apo të çdo lloj pajisje të preventivuar jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e Kontratës sipërmarrëse dy palëshe. Të eliminohen praktikat e realizimit të zërave të punëve të ndërtimit ku mund të konsiderohen devijime të vogla dhe për rastin konkret dhe në vijimësi, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi duhet të kërkojnë ndryshimin e specifikimeve teknike nëse në treg nuk gjenden pajisje siç janë ofertuar në preventivin fitues dhe të merrnin miratimin e investitorit, duke bërë edhe negocimin e çmimit të zërit të ri të punës, duke mundësuar përdorimin e buxhetit të shoqërisë Albcontrol SHA, sipas 3-E me Efiçiencë, Efektivitet, Ekonomicitet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me urdhëri i brendshëm nr.183, datë 04.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngarkuar grupi i punës për zbatimin e rekomandimit të KLSH;
-Raportimi nr.367/1 datë 20.04.2022 i grupit të punës dhe mbikëqyrësit të punimeve në prani të sipërmarsit dhe drejtuesit të punimeve.
Nga raporti ndryshimet gjatë zbatimit janë janë evidentuar dhe pranuar nga Mbikëqyrësi, duke garantuar funksionalitetin dhe sigurimin e specifikimeve teknike (Modeli i pajisjes ka qenë dhënë në specifikimet teknike në mënyrë të gabuar duke përcaktuar markën).
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "Rehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACC" Albcontrol SHA, fituar nga BOE "Rr. U.A. Nr. 2" SHA & "T. E." SHPK, me vlerë vlerë 46,507,991 lekë me TVSH, u konstatua realizimi i zërit të punëve "*F.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw. Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumlin. Modeli: WSAN-XEE 702*" jo në përputhje me specifikimet teknike:
Pra, vendosja e pompës së nxehtësisë (Chiller) nga sipërmarrësi i punimeve BOE "Rr. U. A. Nr. 2" SHA & "T. E." SHPK me tregues më të ulët sesa treguesit e përcaktuar në Specifikimet Teknike të pranuara dhe nënshkruara nga sipërmarrësi i punimeve në DST, ka shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën **4,680,214 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me:
- Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike (Shtojca 5) e DST.
- Projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike (Shtojca 12).
- Shtojca 17 (Kushtet e përgjithshme të kontratës), Neni 13 "Kontraktori që Kryen Punimet", pika 13.1 ku citohet se: " Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentet e tenderit"; Neni 14 "Materialet dhe pajisjet" të kontratës të kontratës me Nr. 2255/5 Prot, datë 27.12.2018.

të kontratës nr. 2255/5 prot datë 27.12.2018. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 15; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" Kreu II, Pika 3.2 (Më hollësisht *trajtuar në pikën 7 faqe 77-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të realizimit të zërit të punëve "F.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw. Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumulim. Modeli: WSAN-XEE 702" apo të çdo lloj pajisje të preventivuar jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e Kontratës sipërmarrëse dy palëshe. Të eliminohen praktikat e realizimit të zërave të punëve të ndërtimit ku mund të konsiderohen devijime të vogla dhe për rastin konkret dhe në vijimësi, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi duhet të kërkojnë ndryshimin e specifikimeve teknike nëse në treg nuk gjenden pajisje siç janë ofertuar në preventivin fitues dhe të merrnin miratimin e investitorit, duke bërë edhe negocimin e çmimit të zërit të ri të punës, duke mundësuar përdorimin e buxhetit të shoqërisë Albcontrol SHA, sipas 3-E me Eficencë, Efektivitet, Ekonomicitet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri nr.181, datë 04.02,2022 për krijimin e grupit të punës;
-Raportimi nr.365/1 datë 22.04.2022 i grupit të punës, i cili raporton se janë vendosur pajisje të ndryshme nga ato të specifikimeve teknike (Kapaciteti në ftohje 268 kW dhe në ngrohje 261.9 kW), ndryshime që gjatë zbatimit janë janë evudentuar dhe pranuar nga Mbikëqyrësi (marka Daikin më cilësore), duke garantuar funksionalitetin dhe sigurimin e specifikimeve teknike
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "Shtesë kontrate, për, Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencës" Albcontrol SHA, me vlerë 4,742,340 lekë me TVSH, fituar nga OE "A.-I. G. C." SHPK si dhe kontratës për punë publike me objekt "Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencës" Albcontrol SHA, me vlerë 44,753,785 lekë me TVSH, fituar nga OE "A.-I. G. C." SHPK rezultuan zëra punime,

respektivisht: "*Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm*", "*Veshje fasade me Alekubond, përfshi strukturën*", "*Llamarinë D=2 mm, galvanizuar për fasadën*" të paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP në vlerën **2,373,260 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2611/4 prot datë 31.12.2018 dhe kontratës me nr. 2317/4 prot., datë 27.12.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA dhe OE "A.-I. G. C." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 74-75 të Raporit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Albcontrol SHA, të marrë masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve: "*Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm*" dhe "*Veshje fasade me Alekubond, përfshi strukturën*" të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit me saktësi në librezën e masave.

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri nr.180, datë 04.02,2022 për krijimin e grupit të punës;
-Raportimi nr.364/1 datë 22.04.2022 i grupit të punës, i cili analizon se zërat e punimeve "*Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm*" dhe "*Veshje fasade me Alekubond, përfshi strukturën*" si dhe ndryshimet përkatatëse të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave, rezultojnë të jenë realizuar nën mbikëqyrjen e supervizorit të punimeve. Grupi i punës në prani të Mbikëqyrësit ka konstatuar realizimin e plotë të volumeve.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Shpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optike" me REF-07076-02-08-2019, me fond limit 22,416,560 lekë pa TVSH, me fitues operatori ekonomik "R ." SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 21,130,060 lekë pa TVSH, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, hartuar nga AK me procesverbalin e datës 08.02.2019, me pasojë shpalljen fitues në paligjshmëri të prokurimit në vlerën **21,130,060 lekë pa TVSH.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 110-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Titullari i Albcontrol SHA, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë shpalljen fitues në paligjshmëri të prokurimit në vlerën **21,130,060 lekë pa TVSH**. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi në fushën e prokurimit, si pasojë e së cilës e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si dhe përbën kusht për s'kualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhër nr.179, datë 04.02.2022 "Për ngritjen e grupit të punës dhe trajtimin e rekomandimit 4.1 të KLSH;
-Raportimi 363/1, datë 22.04.2022 i grupit të punës;
Nga auditimi, rezultojnë të larguar anëtarët e KVO, M.E. dhe E. N., përgjegjës për vlerësimin e procedures së prokurimit
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt Trajnim re-fresh të emergjencave ATCO me REF-06695-02-06-2019, me fond limit 66,666,666 lekë pa TVSH, me fitues operatorin ekonomik Bashkimin i Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik "C. & M. A.dhe E.P. N. AB" SHPK me vlerë të ofertës ekonomike **66,666,666** lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO-ja nuk ka kërkuar sqarime për operatorin ekonomik Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë "A.C." SHPK dhe "G.A. D. IVS" me çmimin e ofertës: 54,800,000 lekë pa TVSH, për arsye se është s'kualifikuar nga KVO-ja sepse nuk ka dorëzuar bilancet për vitin 2015, 2016, 2017 e cila pretendon se në bilancet e dorëzuara nga kjo kompani ato nuk i përkasin kompanisë G. A. D.IVS, por i përkasin kompanisë G. A. L., në (England Walel) dhe se këto dy shoqëri nuk kanë asnjë lidhje me njëra tjetrën, ndërkohë Operatori Ekonomik pretendon se kjo është e njëjta kompani me **50%** aksione në bashkëpronësi, duke dhënë edhe mundësi verifikimi për këtë rast, përshkruar në formularin e ankesës Nr. 640 Prot, datë 06.03.2019**.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 89-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: - Titullari i Albcontrol SHA, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për s'kualifikimin e ofertës ekonomike për të cilën nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e operatorit ekonomik konkurrues, Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë "A. C." SHPK dhe "G. A. D. IVS", me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **66,666,666 lekë pa tvsh**. Të konsiderojë faktin se shqyrtimi i ofertave, duhet të udhëhiqet në përputhje me parimet e përgjithshme të përzgjedhjes, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, duke respektuar kërkesat e nenit 2, dhe nenit nenit 53, pika 1 dhe 4 të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

- Në procedurat e së njëjtës natyrë, në rast se do të ketë pretendime apo sqarime mbi ofertat e paraqitura apo dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik konkurrues, nëse ekzistojnë të tilla, nga KVO-ja të kërkohen sqarime shtesë për të bërë një krahasim sa më të drejtë të tyre në fazën e shqyrtimit të ofertave dhe ti kthehet një përgjigje operatorit ekonomik të s'kualifikuar duke argumentuar arsyet e s'kualifikimit të tij. ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhër nr.178, datë 04.02.2022 "Për ngritjen e grupit të punës dhe trajtimin e rekomandimit 5.1 të KLSH;

-Raportimi 362/1, datë 19.04.2022 i grupit të punës;

Nga auditimi, rezultojnë të larguar anëtarët e KVO, E. N., përgjegjës për vlerësimin e procedures së prokurimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është në proces.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019, për zërin* 'Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1-vjeçare" u konstatua se, në ST të hartuara nga grupi i punës, i ngritur me Urdhrin Nr. 441/1, datë 15.02.2019, në pikën 5. "Kërkesat teknike" ndër të tjera janë kërkuar dy komponentë kryesore, rinovimi i suportit të prodhuesit të pajisjeve dhe sistemeve si dhe shërbime të mirëmbajtjes së pajisjeve nga ana e OE. Ky specifikim përbën mbivendosje të shërbimeve që janë kërkuar nisur nga fakti se rinovimi i suportit të prodhuesit nënkupton, ndërhyrjen e prodhuesit të pajisjeve dhe të sistemeve për marrjen e masave korrigjuese ose ndërrimin e pajisjeve në raste të problematikave madhore që mund të shfaqen gjatë përdorimit të pajisjeve. Në Nenin 35 "Drejtoria e IT" të Rregullores së

Brendshme të "Albcontrol SHA", Pika 1 d) përcaktohet se: Sektori i Shërbimeve Teknike ka për detyrë *"Të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të Ticketing System (Sistem i kërkesës për mbështetje teknike nëpërmjet biletave elektronike) dhe OpManager (Sistemi i monitorimit të funksionimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik)"*. Në Nenin 35 "Drejtoria e IT" të Rregullores së Brendshme të Albcontrol sha, Pika 2 përcaktohet se Sektori i Asistencës Informatike ka për detyrë: (Të sigurojë mbikëqyrje konstante të rrjetit të brendshëm kompjuterik në "Albcontrol" SHA, të sigurojë mbikëqyrje konstante të datacenter-it që i përket Drejtorisë IT; të sigurojë mbështetje teknike për printerat dhe PC-të e "ALBCONTROL" SHA; të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të Ticketing System (Sistem i kërkesës për mbështetje teknike nëpërmjet biletave elektronike) dhe të gjitha sistemeve të monitorimit të funksionimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik; Të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit lidhur me informacionin që qarkullon, ruhet dhe aksesohet; të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit të e - mail dhe vazhdimësinë e shërbimit të internet-it; Të sigurojë shërbimin back - up (kopje rezervë) me qëllim përdorimin e tij në rast defektesh). Pra, për mirëfunksionimin e sistemeve të sigurisë, shërbimeve të rrjetit, sistemit Wireless, sistemit të Telekonferencës, sistemeve të menaxhimit të rrjetit dhe sistemeve të telefonisë, Albcontrol SHA, ka prokuruar në këtë procedurë prokurimi rinovimin e suportit të prodhuesit të pajisjeve dhe sistemeve ç'ka nënkupton sigurimin nga prodhuesi për marrjen e masave korrigjuese në raste të problematikave ose avarive që mund të shfaqen. Gjithashtu në strukturën organizative funksionon një drejtori e cila në bazë të rregullores së brendshme të Albcontrol ka për detyrë sigurimin dhe mbikëqyrjen e mirëfunksionimit të rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve të monitorimit të rrjetit të brendshëm. Në këtë procedurë, shoqëria Albcontrol SHA ka kryer investim <u>*pa eficiencë*</u> për zërin 'Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1-vjeçare', në vlerën **4,233,360 lekë pa TVSH.**

Grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, i ngritur me Urdhrin 591/5, datë 17.04.2019 nuk ka mbajtur procesverbal për verifikimin e realizimit të zërit "Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit" për një periudhë 1-vjeçare nga momenti i lidhjes së kontratës, në kundërshtim me Pikën 47, Kapitulli 3 i Udhëzimit Nr. 30, Datë 27.12.2011, i ndryshuar. Grupi i punës i sipërpërmendur ka firmosur raportet mujore të shërbimit të mirëmbajtjes të dorëzuar nga operatori ekonomik, por nuk ka konfirmuar kryerjen e shërbimeve me anë të ndonjë procesverbali, ç'ka bie në kundërshtim me Nenin 37 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>6.1 Rekomandimi</u>: Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të realizimit të prokurimit të paargumentuar të një shërbimi i cili i mbivendoset detyrave që rregullorja e brendshme e Albcontrol përcakton se duhet të kryhen nga strukturat e brendshme të shoqërisë si dhe shmangien e përdorimit të fondeve pa eficiencë, për procedurat e prokurimit që lidhen me sisteme të IT.

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri i brendshëm nr. **177** datë 04.02.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm,

-Raporti nr 361/1 datë 04.02.2022;

Grupi i punës ka rishikuar dhe ndryshuar, një nga procedurat e IT në rregulloren e brendshme, duke saktësuar nivelin e ndërhyrjes dhe mënyrën e operimit si nga Drejtoria e IT dhe nga nënkontraktorët.Gjithashtu, është rishikuar përshkrimi i punës për specalistët e IT.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019 u konstatua se, n*ga ana e kontraktuesit nuk është dorëzuar pranë AK kodi burim i sistemit në format elektronik dhe në format shkresor sikurse përcaktohet në pikën 9. "Të Drejtat e Kodit të Aplikacionit", të ST të hartuara përmes procesverbalit Nr. 1182/2, Datë 02.09.2019 të grupit të punës të ngritur me Urdhrin Nr. 1182/1, Datë 22.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm. Pavarësisht se sistemi është hostuar në infrastrukturën fizike të Albcontrol SHA dhe menaxhimi dhe administrimi i tij kryhet nga ana e Albcontrol SHA, nga ana e OE në përputhje me kontratën Nr. 2076/4, Dt. 16.12.2019 duhet të ishte dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, kodi burim i sistemit në format shkresor dhe elektronik. Sistemi i Intranet të Albcontrol SHA nuk është përdorur në asnjë rast për nevoja të shoqërisë apo për mbështetjen e proceseve të punës së shoqërisë. Nga gjurmët e auditimit të veprimeve të kryera në sistemin Intranet të Albcontrol SHA konstatohet se, që nga momenti i implementimit të sistemit, pra data 16.01.2020 deri më datë 27.09.2021 në sistem janë kryer vetëm veprime në formën e testimeve nga kontraktori ose nga punonjës së strukturave IT të Albcontrol SHA, gjithsej 21 veprime. Sa më sipër trajtuar kemi të bëjmë me shpenzim të fondeve <u>*pa efektivitet*</u> në vlerën ***1,333,100 lekë pa TVSH*** në procedurën e prokurimit *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 149-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>7.1 Rekomandimi</u>: Administratori i shoqërisë Albcontrol ShA të marrë masa për analizimin e situatës aktuale, të nevojës së institucionit për këtë sistem dhe nxjerrjen e rezultateve për të konstatuar përgjegjësitë përkatëse dhe arsyet e mos-përdorimit të sistemit Intranet të Albcontrol. Në rast se nga analizimi i situatës rezulton se sistemi INTRANET është i dobishëm për shoqërinë të merren masa për të organizuar punën e divizioneve përkatës me qëllim shfrytëzimin e sistemit me kapacitet të plotë për nevojat e shoqërisë.

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri i brendshëm nr. **176** datë 04.02.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm,
-Raporti nr 360/1 datë 22.04.2022;
Janë marrë masa për popullimin (pasurimion) e aplikacionit Intranet me dokumentacionin e shoqërisë dhe vazhdon trainimi për përdorimin e tij. Aplikacioni po përdoret nga punonjësit.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "Investime për infrastrukturën e Divizionit Teknik" Albcontrol SHA, fituar nga BOE fitues "R.U. A.Nr. 2" SHA & "C." SHPK, me vlerë 94,918,419.60 lekë me TVSH, rezultuan zëra punime, konkretisht: *"Shtrim dysheme me Rezinë EPOXY Autoniveluese 3-5 mm (Rezistente ndaj kalimit të mjeteve të magazinës)", "F.V Porte metalike dekorative rrëshqitëse", "Pajisje të brendshme kasetë AUXA54GALH, marka General Fujitsu, ngarkesë ftohëse 14 kw, ngarkesë ngrohëse 16 kw"* të paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP në vlerën **2,401,029 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 732/4 prot datë 21.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA dhe BOE fitues "Rr. U. A. Nr. 2" SHA & "C." SHPK. (Më hollësisht *trajtuar në pikën 7 faqe 76-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>8.1. Rekomandimi</u>: Nga Albcontrol SHA, të merren masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punime të cilat të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit

me saktësi në librezën e masave.

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me urdhëri i brendshëm nr.183, datë 04.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngarkuar grupi i punës për zbatimin e rekomandimit të KLSH;

-Raportimi nr.367/1 datë 20.04.2022 i grupit të punës dhe mbikëqyrësit të punimeve në prani të sipërmarsit dhe drejtuesit të punimeve.

Nga raporti ndryshimet gjatë zbatimit janë janë evudentuar dhe pranuar nga Mbikëqyrësi, duke garantuar funksionalitetin dhe sigurimin e specifikimeve teknike (Modeli i pajisjes ka qenë dhënë në specifikimet teknike në mënyrë të gabuar duke përcaktuar markën).

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "Rehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACC" Albcontrol SHA, fituar nga BOE "Rr. U. A. Nr. 2" SHA & "T. E." SHPK, me vlerë vlerë 46,507,991 lekë me TVSH, rezultuan në objekt zëra të punimeve, respektivisht : "F.V bolier 80 litër, ujë të ngrohtë" dhe zëri "Shtresë termoizoluese me lesh guri", të paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP në vlerën në vlerën **923,494 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2255/5 prot datë 27.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA dhe BOE "Rr. U. A. Nr. 2" SHA & "T. E." SHPK. (Më hollësisht *trajtuar në pikën 7 faqe 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Nga Albcontrol SHA, të merren masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit me saktësi në librezën e masave.

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri nr.181, datë 04.02,2022 për krijimin e grupit të punës;

-Raportimi nr.365/1 datë 22.04.2022 i grupit të punës, i cili raporton se janë vendosur pajisje të ndryshme nga ato të specifikimeve teknike (4 Bolier 80 lit dhe shtresa termoizoluese), ndryshime që gjatë zbatimit janë janë evudentuar dhe pranuar nga Mbikëqyrësi duke garantuar funksionalitetin dhe sigurimin e specifikimeve teknike.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

D. MASAT DISIPLINORE.

Referuar shkeljeve të konstatuara:

- Në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në dokumentet e auditimit, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative"; nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i

ndryshuar, Kreu III, neni 7/2 dhe neni 15; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" Kreu II, Pika 3.2, *për*:
- Shkeljet e konstatua për mos eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet të fondeve publike kryesisht në prokurimet publike.
- Shkeljet e konstatua për mos realizimin e disa zërave të ndërtimit gjatë zbatimit të kontratave për punë publike si dhe kontratat e shërbimit.
- Shkeljet e konstatua për mos realizimin e disa zërave në përputhshmëri me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës së lidhur.
- Mbi ndryshimet e përshpejtuara të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, në mungesë dokumentacionit justifikues mbi nevojën e ndryshimeve të pa shoqëruara me relacione të hollësishme teknike dhe financiare.
KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; germat (b, c, ç) e nenit 58 "Llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil ; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë"; shkronja (b) e nenit 9 "Masa disiplinore ", të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i **rekomandojmë Titullarit të Shoqërisë "Albcontrol" SHA** që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhër nr.1338, datë 28.04.2022;
-Raportimi 1338/1, datë 11.05.2022 i grupit të punës nuk ka nxjerrë asnjë përgjegjësi për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të KLSH;
-Me procesverbalin nr. 2000/2, datë 05.08.2022 është dhënë masa disipinore.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar.

AUTORITETI PORTUAL DURRËS

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në APD mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e

veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", APD, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 130/67 prot., datë 03.12.2021, është dërguar plani i veprimeve mbi realizimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III. Rekomandimet e KLSH
Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 877/67 port.,datë 11.10.2021 dhe në Autoritetin Portual Durrës me nr. 130/66 prot., datë 15.11.2021, janë rekomanduar gjithsej:
a. Janë rekomanduar **57 masa organizative**;
b. Janë rekomanduar **13 masa për shpërblim dëmi**;
c. Janë rekomanduar **22 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit.**
d. Janë rekomanduar **86 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH
Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Organizative	57	57	-	-
2	Shpërblim dëmi	13	13	-	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	22	22	-	-
4	Masa disiplinore	86	86	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e APD

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	57	26	1	25	5
2	Shpërblim dëmi	13	1	-	9	3
3	Për eleminimin e efekteve negative	22	2	-	19	1

	të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit					
4	Masa disiplinore	86	79	-	-	7

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.j.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	57	26	1	25	5
2	Shpërblim dëmi	13	1	-	9	3
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	22	2	-	19	1
4	Masa disiplinore	86	79	-	-	7

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 45.6%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", APD, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 130/67 prot., datë 03.12.2021, është dërguar plani i veprimeve mbi realizimin e rekomandimeve.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: KLSH me shkresën nr. 579/8, datë 05.10.2018, ka rekomanduar 81 masa gjithsej, nga këto 34 masa organizative, 31 masa për shpërblim dëmi, 9 masa për eliminimin e efekteve negative dhe 7 masa disiplinore.
Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:
-Nga 34 masa organizative gjithsej, të rekomanduara dhe të pranuara, 20 janë zbatuar plotësisht, 13 janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.
-Nga 31 masa për shpërblim dëmi gjithsej, të rekomanduara dhe të pranuara, 5 janë zbatuar plotësisht, 3 janë zbatuar pjesërisht, 19 janë në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 4.
-Nga 9 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike të rekomanduara dhe të pranuara, 1 është zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 6 janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.
-Nga 7 masa disiplinore të rekomanduara dhe të pranuara, 6 janë zbatuar plotësisht dhe 1 është në proces zbatimi.
Autoriteti Portual Durrës (APD), nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH, nuk ka respektuar jo vetëm afatin 20 ditor dhe 6-mujor, mbi raportimin e planit të veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, por ende nuk ka asnjë korrespondencë për këtë qëllim, veprime në kundërshtim me nenet 15 germa "j" dhe 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Këshilli Drejtues i APD nuk ka vepruar për marrjen në shqyrtim dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, megjithëse nga Drejtoria Ekzekutive janë dërguar informacione të vazhdueshme shkresore shoqëruar me masat për përmirësimin e punës në APD. Drejtoria Ekzekutive, ka vepruar me ritme të ngadalta sa i takon zbatimit të rekomandimeve, referuar numrit të rekomandimeve në proces. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,1, faqe 32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>1.1. Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekzekutive dhe Këshilli Drejtues, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara ose në proces zbatimi, si edhe të ndiqen në të gjitha shkallët e gjykimit, për ato që janë në procese gjyqësore.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nga ana e subjektit APD nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.
<u>Rekomandimi do të konsiderohet i pa zbatuar.</u>
Zbatimi të rekomandimit: Pa zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Në plan bizneset e APD, u konstatuan zëra të cilët kanë një parashikim të ulët dhe larg realizimit, ose nuk janë realizuar, si dhe zëra të cilat nuk janë parashikuar por janë realizuar. Një situatë e tillë flet për parashikime apriori të pa studiuara dhe të pabazuara në mundësitë reale të APD. Në programimin e të ardhurave nga APD për vitet 2018-2019, nuk janë mbajtur nivelet e arritura në vitet e mëparshme si: terminali i mallrave rifuxho ka planifikim të të ardhurave rreth 50% më të ulët se fakti i vitit 2018 (i cili vijon të mbetet në këtë nivel) dhe të ardhurat jashtë zonave terminale janë programuar rreth 70% më të ulta nga viti 2017. Ndikim në realizimin e të ardhurave ka dhënë realizimi i tyre jashtë zonave terminale. Në hartimin e plan-bizneseve konstatohen parashikime të pa studiuara dhe të pabazuara në mundësitë reale të APD. Nuk janë marrë në analizë treguesit ekonomiko financiar të APD si edhe nuk janë

diskutuar më parë ndryshimet në zërat e plan biznesit, në GMS (Grupin e Menaxhimit Strategjik). Ndryshimet e fondeve në plan-biznese, me vendime të Këshillit Drejtues, janë bërë pa relacion shpjegues si dhe pa argumentuar impaktin që do të sjellë ky ndryshim, dhe në mungesë të analizës kosto-përfitim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të APD, Divizioni i Financës dhe Administrimit dhe Këshilli Drejtues për hartimin e plan-biznesit të shoqërisë, të bazohen në rezultatet e arritura në vitin paraardhës duke analizuar treguesit ekonomik-financiar dhe përcaktuar prioritetet, me qëllim hartimin e një plan-biznesi sa më real për arritjen e objektivave të zhvillimit të shoqërisë.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Argumentimi i APD-së është se që nga viti 2021 hartimi i plan-biznesit bëhet mbi baza 3-5 vjeçare duke u fokusuar tek objektivat dhe prioritetet kryesore kjo me qellim hartimin e një plan biznesi lehtësisht te realizueshëm te shtrire ne afatet 3-5 vjeçare me qëllimin final te rritjes se te ardhurave apo rritjes se eficenses dhe duke ulur shpenzimet.

Bazuar në argumentimin e mësipërm rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe do të verifikohet në auditimin e rradhës.

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

2.2.Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të APD, Divizioni i Financë - Administrimit dhe Këshilli Drejtues, për ndryshimet në plan-biznes, të argumentojnë shtesat/pakësimet, arsyet e ndryshimit të fondeve shoqëruar me analizën kosto-përfitim dhe impaktin që do të sjellin ndryshimet.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Nga ana e Divizionit të Financës është kryer analizë e detajuar për çdo ndryshim në plan biznes, drejtuar Këshillit Drejtues me relacionet përkatëse për çdo ndryshim në zërat përkatëse në plan biznes dhe impaktin që mund të sjellin.

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Aktiviteti kryesor, mbi të cilin APD-ja siguron të ardhurat, është përpunimi i mallrave dhe pasagjerëve, volumet e punës të parashikuara janë produkt i kompanive koncesionare. Koncesionarët gjenerojnë të ardhura ku një pjesë e të cilave në bazë të përqindjes të përcaktuar në to i kalojnë APD-së dhe përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Plani i të ardhurave të APD është në varësi të volumeve të punës të parashikuara nga shoqëritë koncensionare, nga ku konstatohet se nuk janë bërë ndryshime ose diskutime në lidhje me volumet e përpunimit mallra/pasagjerë të paraqitura nga koncensionarët, por janë pranuar volumet e punës të paraqitura nga koncensionarët, për pasojë konstatohet rënie e të ardhurave, dhe fitimit të APD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të APD dhe Divizioni i Financë - Administrimit, për hartimin e plan-biznesit (plani i të ardhurave), të bashkëpunojnë me shoqëritë koncensionare, të analizojnë dhe mos të marrin të mirëqena volumet e punës të paraqitura prej tyre, me qëllim rritjen e të ardhurave për APD.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Divizioni i Financës ne hartimin e plan biznesit ka bashkepunim te ngushte me shoqerite koncesionare, analizon parashikimet e volumeve te ofruara nga shoqerite koncesionare dhe ku e gjykon te arsyeshme ben edhe azhornimet perkatese, pasi jane shoqerite koncesionare qe

bashkepunojne ngushte me operatoret ekonomike private dhe ne bashkerendim me kerkesat e tyre behen edhe parashikimet perkatese.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

3.2. Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe Drejtoria Ekzekutive, të marrë në analizë situatën ekonomike-financiare të APD, duke përcaktuar rregulla të sakta bazuar në legjislacionin në fuqi për menaxhim më të mirë të burimeve dhe mundësive të shoqërisë, rritjen e rolit monitorues të proceseve të punës nga koncensionarët, uljen e shpenzimeve, etj, me qëllim rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e situatës ekonomike.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Është marrë në analizë situata ekonomike-financiare për kontrollin e shpenzimeve nga të cilat janë evidentuar si problematike shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit me një detyrim të ndjeshëm të pambledhur në të ardhurat e APD-së, gjatë vitit ushtrimor të vitit 2021 dhe 2022 nga masat e marra jo vetëm nëpërmjet investimit të kryer për mirmbajtjen e rrjetit por edhe të kontrolleve të vazhdueshme dhe të faturimeve korrekte energjia elektrike është me 0 humbje. Për ujin është prokuruar shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit hidrik për të cilin vlersohet se do të ketë përmisim të ndjeshëm nga faturimi edhe arkëtimi.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe do të kontrollohet në auditimin e rradhës.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

4. Gjetje nga auditimi: Investimet kapitale të kryera nga APD nuk janë trajtuar sipas parimit të prioritetit, por janë kryer në mënyrë rutinë pa analizuar arritjen e një impakti pozitiv në arritjen e objektivave, çka për APD përbën risk të lartë mbi realizimin e investimeve me rëndësi dhe ndikim në rritjen e të ardhurave. Treguesit për investime dhe shpenzime, janë planifikuar tej kapaciteteve reale të realizimit të tyre. Parashikime apriori për investime të pa studiuara kanë sjellë nivel tejet të ulët realizimi, për vitin 2018, realizuar 3% e parashikimit, për vitin 2019, realizuar 24% e parashikimit dhe për 6-mujorin 2020, janë realizuar 25% e parashikimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1.Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të APD, Divizioni i Financë - Administrimit dhe Divizioni Teknik, të hartojnë programin e investimeve sipas prioriteteve të zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë, referuar kapaciteteve dhe nevojave reale të tyre me qëllim arritjen e objektivave, përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e të ardhurave për APD.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Strukturat Drejtuese te APD-së dhe Divizioni Teknik cdo fund viti parashikon nevojat e APD mbi hartimin e planit te investimeve nisur nga kerkesat e divizioneve te tjera, nevojat e dala nga viti ushtrimor dhe vitet qe leme pas si dhe parashikime per te mundesuar rritjen e performances teknike dhe financiare te Kompanise.Per vitin 2022 APD ka parashikuar investime kryesisht ne mjete dhe mekanizma perpunues duke pare amortizimin e mekanizmave ku operon aktualisht duke i zevendesuar me mekanizma te rinj me garanci prodhuesi dhe performance te larte perpunuese nisur kjo dhe nga rritja e konkurences brenda portit (koncesionaret) por dhe Portit te ri Privat ne Porto Romano-MBM.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Administrata e APD, nuk ka plotësuar konform përcaktimeve në Urdhrin e Ministrit të PPT nr. 125, datë 26.12.2011 "Për miratimin e hartave të azhurnuara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve në RSH", dokumentet për harxhimin e karburantit, për distancat TR-DR dhe DR-SR-TR. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekzekutive dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për hartimin e dokumentacionit për harxhimin e karburantit, lëvizjeve të automjeteve dhe kilometrave, referuar normativave të harxhimit/mjet, qëllimit të udhëtimit, duke respektuar distancat kilometrike ndërmjet qyteteve sipas përcaktimeve në Urdhrin e Ministrit të PPT nr. 125, datë 26.12.2011 "Për miratimin e hartave të azhurnuara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve në RSH".

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin e brëndshëm nr. 3828., datë 11.11.2021 është bërë caktimi i personave përgjegjës mbi secilin automjet në pronësi të Autoritetit Portual Durrës, ku edhe është përcaktuar edhe sasia e karburantit për konsum për çdo muaj. Duke marrë parasysh dokumentacionin e vendosur në dispozicion rekomandimi do të konsiderohet i realizuar. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Transportit kane hartuar dhe miratuar nga Drejtoria Ekzekutive dokumentacionin:
"Urdhër Shërbimi "Kodi nr. .P.2070-F.04. për lëvizjen e automjeteve ne funksion te Administratës se APD-se.
"Pasqyre e lëvizjes se mjeteve" Kodi nr. .P.2070-F.01, për pasqyrimin e lëvizjes se mjeteve te ne funksion te lëvizjes se personelit te APD-se.
"Plani i lëvizjes se ambulancës për marrjen e praktikes se lire dhe dhënien e ndihmës se pare" Kodi nr. P.2070-F.02 ku pasqyrohen te gjithë lëvizjet e ambulancave gjate orarit te punës ne funksion te marrjes se praktikes se lire dhe për emergjencat e ndodhura.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nuk është argumentuar vlera e kontratës, në tenderin me objekt "Libri i tarifave" me fond limit 10 milion lekë, por është përcaktuar mbi mesataren e 3 ofertave të siguruara nga kompani të pa specializuara ose që nuk kanë në objektin e aktivitetit shërbime të kësaj natyre: D. A., Tiranë, me vlerë 100 mijë euro, R. A., A. G. 100 mijë euro dhe 6.-P. SHPK, Fier, me vlerë 11 milion lekë.
Duke qenë se vlera mesatare e 3 ofertave është 10,299 mijë lekë, pothuajse sa fondi limit i miratuar në plan-biznesin e vitit 2019 prej 10 milion lekë, komisioni ka përcaktuar vlerën e kontratës 10 milionë lekë, e barabartë me fondin e miratuar në plan-biznesin e vitit 2019.
Grupi i punës nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me nenin 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, dhe nenit 37/4, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1.Rekomandimi: Përllogaritja e vlerës së kontratës nga njësia e prokurimit/komisionet e ngritura për këtë qëllim, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen dhe llogaritje të sakta të vlerës së kontratës.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Rekomandim i cili ndiqet ne vijimesi.
Përllogaritja e vlerës së kontratës nga njësia e prokurimit/komisionet e ngritura për këtë qëllim do te behet duke pasur parasysh parashikimet e legjislacionit per Prokurimin ne RSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

7. Gjetje nga auditimi: Nuk është argumentuar vlera e kontratës, në tenderin me objekt "Libri i tarifave" me fond limit 10 milion lekë, nuk janë argumentuar kriteret e kualifikimit dhe u konstatuan mangësi në hartimin e kritereve të veçanta/kualifikim, kapaciteti teknik, kapaciteti ekonomiko-financiar, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për

Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe nenin 61/2, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit në APD, për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që kërkesat e veçanta kualifikuese, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kritere kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Kerkesat e vecanta per kualifikim jane detyre e komisionit te ngritur posacerisht per cdo procedure prokurimi dhe ky rekomandim merret ne zbatim ne vijimesi nga ana e komisioneve perkatese sipas procedures.
Ligji per Prokurimin Publik ka shtuar si dokumentacion Procesverbalin e Argumentimit te kritereve ne te cilin argumentohen ligjerisht dhe teknikisht te gjitha kriteret e vendosura.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga APD janë rishikuar tarifat portale çdo vit sipas nivelit të zhvillimit të aktivitetit në port. Rishikimi i vazhdueshëm i tarifave si edhe studimi, përdorimi i tarifave të reja deri në vitin 2019, nuk bëjnë të domosdoshëm dhe nuk justifikojnë përdorimin e fondeve për kryerjen e një procedure tenderimi. APD nuk ka qenë në kushtet e një emergjence për të zhvilluar një procedure prokurimi konsulence për ndryshimin e tarifave me fond limit në vlerën 10,000,000 lekë, në kundërshtim me nenin 35 të ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual", si dhe nuk është marrë mendim dhe miratim nga këshilli konsultativ dhe palët e interesuara për ndryshimin e tarifave.
Rishikimi i vazhdueshëm i tarifave si edhe studimi, nuk bëjnë të domosdoshëm dhe nuk justifikojnë përdorimin e fondeve për kryerjen e një procedure tenderimi, veprime në kundërshtim me nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe nenit 35 "Përcaktimi i tarifave", të ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, të kryejë procedura prokurimi të studiuara, të domosdoshme dhe sipas prioriteteve, të cilat i shërbejnë zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë, duke marrë mendim dhe miratim nga palët e interesuara, me qëllim rritjen e efiçencës dhe efikasitetit në shpenzimet publike.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe do të kontrollohet në auditimin e rradhës.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

9. Gjetje nga auditimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave, në tenderin me objekt "Libri i tarifave" me fond limit 10 milion lekë, ka vlerësuar ofertën ekonomike dhe shpallur fituese pa dhënë analizën e çmimeve dhe kërkuar sqarime rreth saj, në kundërshtim nenin 17 "Oferta ekonomike", të VKM nr. 914, datë 19.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, dhe dokumenteve të tenderit seksioni 4/1 "Përllogaritja e ofertës ekonomike".
KVO edhe me shkresën 3701/1, datë 04.11.2019, i ka kërkuar BOE (bashkimi operatorëve ekonomikë) detajimin e strukturës së propozimit ekonomik, me nënzërat përbërës të tarifave sipas kategorive të punës dhe kostove të drejtpërdrejta dhe më datë 05.11.2019, BOE ka sjellë ofertën ekonomike, e cila ka qenë po njësoj, e pa argumentuar dhe pa detajuar, KVO ka pranuar dhe shpallur fitues operatorin pa sqarimet rreth ofertës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Njësia e prokurimit të mbikëqyrë dhe japë mendimin ligjor gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave (në rastet kur kërkohet nga KVO, analizë e kostos së zërave të ofertës), të dokumentacionit ligjor dhe administrativ dhe ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ne bazë te Nenit 75 VKM 285 date 19.05.2021 "Per percaktimin e rregullave te prokurimit publik" citon: Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë.
Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
Ne referim te ketij neni si dhe nenit 74 ku jane te mirepercaktuara detyrat qe i caktohen Njesise se Prokurimit , tregohet qarte se nese KVO do te kete nevoje per qartesime ne lidhje me dokumentat e tenderit atehere mund te kerkohet sqarim nga njesia e prokurimit, por jo te analizoje koston e zërave të ofertës, të dokumentacionit ligjor dhe administrativ dhe ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik , pasi kjo detyre i eshte caktuar qartesisht komisionit te vleresimit te ofertave sipas nenit 75 te VKM 285 date 19.05.2021.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt "Libri i tarifave", referuar materialit të paraqitur nga shoqëria fituese citohet se: tarifa e indeksuar është krahasuar më pas me tarifat aktuale të porteve konkurrues të Barit, Koperit dhe Selanikut, rezulton se krahasimi nuk është bërë pas indeksimit por me tarifat aktuale, p.sh. tabelat e tarifave të kontejnerëve nuk janë krahasuar të indeksuara, por vetëm janë konvertuar nga lekë në euro me kursin 1 euro/123 lekë. Ndërsa në tabelat e tarifave të mallrave rifuxho dhe gjenerale, si edhe tabela e tarifave në terminalin e trageteve është shtuar me 20% të vlerës aktuale. Edhe pas indeksimit, krahasimi i tarifave është bërë vetëm në vlerë, por nuk është konvertuar shërbimi. Tarifat nuk janë të studiuara në detaje sipas elementëve përbërës të saj, duke parë koston se si është ndërtuar tarifa, duke kryer matje të çdo procesi pune, kronometrimi, normimi, etj. Edhe krahasimi i tarifave aktuale me portet e rajonit, varet nga natyra e punës e çdo porti si dhe nga struktura e tarifave të secilit, prandaj do të ishte më i drejtë ndërtimi i tarifave me bazë koston. Pra, mungojnë analizat e thelluara të proceseve të punës. Ende nuk është bërë miratimi i tarifave të reja në Këshillin Drejtues, Këshillin Konsultativ si edhe nuk janë miratuar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave me finalizimin e një udhëzimi të përbashkët për përdorimin e tyre në vitin 2021, referuar ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003,*"Për Autoritetin Portual"* duke sjellë pamundësi në aplikimin e tarifave të reja dhe ndikim në uljen e të ardhurave për APD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe drejtori ekzekutiv, të marrë masa për njohjen, analizimin dhe miratimin e tarifave të reja në Këshillin Drejtues, Këshillin Konsultativ, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Financave me finalizimin e një udhëzimi të përbashkët për përdorimin e tyre në vitin 2021 e në vazhdim, për zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003,"Për Autoritetin Portual".

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Eshte miratuar Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr. 4, datë 11.6.2021 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2021".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: APD, ka nënshkruar kontrata me kompanitë stivadore, në kushtet kur nuk janë plotësuar detyrimet midis palëve. Me Amendamentin nr.3, datë 06.01.2020, nënshkruar nga Drejtori i APD dhe Përfaqësues i kompanisë A., bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues (KD) nr. 24, datë 12.12.2019 "Mbi rinovimin/nënshkrimin e kontratës me shoqërinë A. S. C. .", është zgjatur afati i kontratës me 10 vjet, deri në 20.07.2029. Prej datës 21.07.2019 deri më 06.01.2020, (rreth 6 muaj), operatori A. ka kryer veprimtarinë e përpunimit të mallrave pa nënshkruar kontratë me APD. Amendamenti i nënshkruar daton më 06.01.2020 me fuqi prapavepruese për 6 muaj. Drejtoria ekzekutive në informacionin nr. 2407, datë 10.07.2019, drejtuar KD, ka marrë në analizë ecurinë e kontratave stivadore dhe ka arritur në përfundimin se për vitin 2018, totali i mallrave i cili përpunohet nga 3 kompanitë stivadore, bazuar në kushtet dhe parashikimet e kontratave të përpunimit të mallrave është ulur dukshëm. Krahasuar me vitin 2012, sasia e mallrave të përpunuara në terminalin perëndimor është ulur me 366,041 ton. Po kështu, referuar performancës së operacioneve, në disa raste ka rezultuar 20% poshtë niveleve të përcaktuara në kontratë, i cili përbën një nga kushtet kryesore të kontratave të përpunimit të mallrave bazuar në nenin 30, të kontratës. Nisur nga sasia e mallrave të përpunuara Drejtoria Ekzekutive e APD, nuk e ka vlerësuar të nevojshëm rinovimin e kontratës qoftë edhe për një periudhë 1 vjeçare referuar nenit 25, pika 2 dhe nenit 39, pika 2, të kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria Juridike dhe Divizioni i Administrimit dhe financës, të analizojnë ecurinë e kontratave stivadore bazuar në volumet e përpunimit, performancën e operacioneve, ligjshmërinë e nënshkrimit dhe afateve të kontratave, me qëllim arritjen e shërbimit në nivele cilësore, shfrytëzimin e kapaciteteve të portit dhe rritjen e treguesve ekonomik-financiar.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Nga ana e APD-së i është propozuar me shkresën nr. 4673.,datë 23.12.2020 Këshillit Drejtues mbi kontratën stivadore me OE L.-1. për zgjidhjen e kontratës por nga Këshilli Drejtues nuk është miratuar propozimi i bërë nga APD. Gjithashtu me shkresën nr. 2671 prot.,datë 26.07.2022 i është propozuar Këshillit Drejtues për amendimin e kontratës duke parashikuar që të rregullohet mënyra e faturimit, mbledhja e të ardhurave edhe ndarja e përqindjes të realizohen nga APD me qëllim minimizimin e detyrimeve nga subjekti L.-1., Këshilli Drejtues nuk ka marrë akoma vendim mbi propozimin e bërë nga APD.

Për këto arsye rekomandimi do të konsiderohet në proces edhe do të kontrollohet nga auditimi i ardhshëm mbi realizimin e rekomandimit.

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

12. Gjetje nga auditimi: Investimet e kryera nga koncensionari "A." nga fillimi i kontratës koncensionare janë paraqitur në shumën 93,226,185 lekë, kundrejt 426,020,000 lekë, të parashikuara sipas propozimit ekonomik, ose janë realizuar në masën 21.8%. Deri në vitin 2020, koncensionari duhet të realizonte investime në makineri e pajisje në shumën 33,600,000 lekë. Shuma e investimeve e pretenduar nga "A.", nuk përfshihet në kategorinë investime, pasi janë blerje mallrash të cilat nuk kanë qenë parashikuar në propozimin ekonomik të koncensionarit. Vlera e këtyre investimeve nuk është pranuar nga APD dhe Ministria, pra investimet nuk janë realizuar duke shkelur përcaktimet në kontratën koncensionare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandimi: Drejtori ekzekutiv nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit e teknikës dhe Njësisë së Zbatimit të Projektit, të marrë masa për evidentimin e saktë (dypalësh) të investimeve të kryera nga koncensionari "A.", të njoftojnë strukturat që ndjekin zbatimin e kontratave koncensionare në MIE, mbi nivelin e realizimit të investimeve me qëllim përmbushjen e

kushteve kontraktore nga palët për rritjen e investimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Në bazë të kontratës së koncesionit, neni 8.6 "Vlera e investimit", rezulton se shoqëria koncesionare parashikohet të investojë gjatë gjithë periudhës koncesionarë në Terminalin e Trageteve një vlerë prej 4,143,000 Euro, në përputhje me Ofertën sipas Aneks 2 të Kontratës. e cila do të konsistojë në mjete, infrastrukturë, zyra, sistemin e rrjetit kompjuterik etj.
Me qëllim verifikimin e investimeve të kryera deri me tani sipas Propozimit Ekonomik nga koncesionari "A." shpk, është ngritur Urdhëri i Brendshëm nr. 1173 prot, datë 23.04.2019, me objekt "Marrjen në shqyrtim të investimeve të realizuara nga shoqëria koncesionare A. F. T. O.".
Grupi i punës me qëllim kryerjen e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër ka vendosur korrespondencë me shoqërinë koncesionare me anë të shkresave nr. 1197 prot, datë 27.04.2020, "Njoftim mbi Urdhërin e Brendshëm mbi marrjen në shqyrtim të investimeve të realizuara nga shoqëria koncesionare A. F. T. O.", nr.1501 prot, datë 20.05.2020, "Kërkesë për vënien në dispozicion të dokumentacionit justifikues mbi investimet", nr. 3300 prot,datë 11.09.2020, "Rikujtesë për plotësimin e dokumentacionit mbi investimet".
Pavarëshisht shkresave të dërguara nga ana e APD-së drejt shoqërisë koncensionare "A.", ku kësaj të fundit i është kërkuar vënia në dispozicion e dokumentacionit justifikues tekniko-ligjor mbi investimet e realizuara, aktualisht nuk ka asnjë përgjigje zyrtare ndaj kërkesave të APD-së, por në përmbushje të detyrimit grupi i ngritur ka përgatitur një raport në përmbushje të detyrave të ngarkuara mbi dokumentacionin e dorëzuar nga ana e shoqërisë koncesionare në vitin 2019, për investimet e pretenduara nga ana e tyre në vitet 2013-2019.
Ky raport i hartuar nga grupi i punës i është përcjell Njësisë së Zbatimit të Projekteve për A., ende nuk kemi një përgjigje konkrete mbi investimet e njohura apo jo.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

13. Gjetje nga auditimi: Në APD u konstatuan mangësi në menaxhimin e sistemit për monitorimin e kontratës së koncesionit në terminalin e trageteve. Sektori monitorimit punon me sistem 8 orë, ndërsa koncensionari me sistem 24 orë si edhe mungon një sistem monitorimi për të përmbushur plotësisht kërkesat e detyrimeve ligjore të përcaktuara në Kontratën Koncensionare, si dhe lëvizje të shpeshta të punonjësve në sektorin e monitorimit të kontratave koncensionare, veprime të cilat nuk kanë mundësuar monitorimin efektiv. Nuk janë të miratuara nga titullari modeli tip i Akt Konstatimit, për ti dhëne dokumenteve vërtetësinë e një dokumenti ligjor. Koncensionarët nuk raportojnë çdo ditë dhe çdo turn, detyrim ky i përcaktuar në protokollet e dorëzimit mes palëve. Nuk është implementuar sistemi i rrjetit kompjuterik, sipas përcaktimit të bërë në pikën 12.1.7 "Sistemi dhe Rrjeti kompjuterik" i Kontratës së koncensionit, duke sjell risk me pasoja për administrimin e vlerave monetare, për vetë koncensionarin (mos pasqyrim të saktë të xhiros vjetore), dhe për pasojë për detyrimin që lind nga kjo xhiro për ndarjen e të ardhurave 2 % e MIE dhe 21% e APD. Mungesa e marrjes së informacionit on-line për çdo shërbim të kryer, nga Koncensionari A. tek Njësia e Monitorimit, mos implementimi i një sistemi dhe rrjeti kompjuterik, e bëjnë këtë proces pothuajse të pa-monitorueshëm nga Njësia e Monitorimit duke sjellë një administrim të vlerave monetare pa efektivitet dhe efikasitet, në kundërshtim me pikën 12.1.7, të kontratës së koncensionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
13.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, NJZP dhe Drejtoria Ekzekutive, të njoftojë MIE "Mbi mosrespektimin nga koncesionari "A.", të detyrimeve ligjore të përcaktuara në Kontratën Koncensionare si dhe mbi implementimin e sistemit dhe rrjetit kompjuterik, sipas përcaktimit

të bërë në pikën 12.1.7 "Sistemi dhe Rrjeti kompjuterik"i Kontratës së koncensionit dhe Protokollit nr. 2373, datë. 06.09.2013 "shkëmbimi i informacionit" pika b.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Në zbatim të Kontratës Konçesionare Neni 12.1.7 "Sistemi dhe rrjeti kompjuterik" ku citohet se:
12.1.7 "A. do të mirëmbajë sistemet aktuale të teknologjisë së informacionit, dhe të informacionit të TTD, në përputhje dhe në respektim të rregulloreve përkatese me qëllim garantimin e funskionimit të tyre sipas kërkesave aktuale dhe të ardhshme të TTD.
Mbetet për tu theksuar problematika e implementimit të sistemit elektronik të monitorimit dhe menaxhimit të mjeteve të cilat qëndrojnë të parkuara në sheshin e qëndrimit të mjeteve të import-eksportit të "*A."-s*. Në mënyrë të përsëritur i është përcjellë zyrtarisht me shkresë konçesionarit problematika e mospërmbushjes së këtij detyrimi kontraktual të përcaktuar në Nenin 12.1.7 të Kontratës Konçesionare, por pavarësisht të gjithë shkëmbimit shkresor ndërmjet APD dhe shoqërisë koncesionare "A.", deri më sot nuk është ndërmarrë asnjë hap apo veprim konkret nga ana e tyre për përmbushjen e këtij detyrimi kontraktual.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

13.2.Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kontratave, të bëjnë të mundur hartimin e një Udhëzuesi "Mbi funksionimin e inspektimit dhe monitorimit të Kontratës së Konçensionit "Për Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen të Terminalit Trageteve në Portin e Durrësit", duke specifikuar hapat e punës (Gjurmët e Auditimit) për mënyrën se si do të kryhet rakordimi nëpërmjet pranimit siç i raporton konçensionari, rikontrollit apo riregjistrimit të çdo formulari për çdo turn/në ditë, nga Autoritetit Portual Durrës.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ka nisur hartimi i nje Udhëzuesi "Mbi funksionimin e inspektimit dhe monitorimit të Kontratës së Konçensionit "Për Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen të Terminalit Trageteve në Portin e Durrësit".
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

14. Gjetje nga auditimi: Konçensionari A. (Terminali Trageteve) ka në përdorim pajisje të sistemit të check-in elektronik në pronësi të APD – së në vlerën 12,537,316 lekë dhe nuk paguan asnjë detyrim ndaj APD-së. Drejtoria Juridike e APD-së, me shkresën nr. 527, datë 11.11.2016, drejtuar Drejtorisë Teknike dhe Drejtorisë Ekzekutive të APD-së, ka propozuar ngritjen e një grupi pune "*Për evidentimin dhe vlerësimin e pajisjeve të sistemit check-in elektronik për vlerën 12,537,316 lekë".* Konstatohet se nga kjo periudhë nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të bërë të mundur zgjidhjen e kësaj problematike. Në amendamentin nr. 3216, datë 27.12.2013, është përcaktuar që të hiqen asetet të cilat i përkasin Terminalit të Trageteve dhe që janë dorëzuar shoqërisë Koncensionare (A.). Në pikën 12.1.7 "Sistemi dhe rrjeti kompjuterik" i kontratës konçensionare midis APD-së dhe A., *citohet se… konçensionari do të mirëmbajë sistemet aktuale të IT…*, këto sisteme janë asete në zotërim të APD-së. Në protokollin e dorëzimit me nr. 2373, datë 06.09.2013, midis APD-se dhe Konçensionarit A., nuk është përcaktuar nëse këto asete (Sistemi Multimedial & check-in elektronik) do të jepen në përdorim, me/pa qira ose ti propozohet Koncensionarit për shitje, por ka vetëm nënshkrimin si pajisje të instaluar në vepër. Këto sisteme kanë përdorim të përbashkët APD dhe A., mbi bazën e përdorimit është ndarë edhe mirëmbajtja në %, nga operatori privat T. S.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike, Drejtoria e Zhvillimit dhe Drejtoria Ekonomike, të rishikojnë mundësinë, kundrejt kostos financiare për ndarjen e sistemeve të IT, që janë në përdorim të përbashkët, ndarjen në zotërim 100% nga A. ose APD, si edhe të rishikojnë protokollin e dorëzimit nr. 2373, datë 06.09.2013, midis APD-së dhe A., për sistemet e IT, në zotërim të APD dhe në përdorim të A., për tarifimin e vlerës për përdorim nga A..

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
APD arsyeton se e ka të pamundur realizimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi do të konsiderohet i pazbatuar.
Zbatimi të rekomandimit: Pa Zbatuar.

15. Gjetje nga auditimi: Shoqëria koncensionare "E.", nuk ka raportuar në lidhje me volumet e punës të kryera me operacionet (shërbimet) si: mbushja e kontejnerëve, transport ulje ngritje kontejnerëve, lëvizje ekstra/kapje bosh, magazinim peshime, veprime këto në kundërshtim me nenin 12.1.6 "Raportime" të kontratës koncensionare dhe Protokollit të dorëzimit nr. 1810, datë 12.07.2013 kapitulli "Shkëmbim informacioni". Këto shërbime iu janë faturuar përdoruesve të Portit Durrësit nga "E." në kundërshtim me nenin 8 të kontratës. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 8.4. pika 3, ku koncensionari duhet të lëshojë faturat për të ardhurat e tij për shërbimet e ofruara. Me vendimin e datës 24.04.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur që "E." të paguajë dëmin e shkaktuar si e ardhur e munguar për APD në shumën 91,852,869 lekë, dhe 3,294,231 lekë për kamatëvonesa (periudha korrik 2013-nëntor 2017). Koncensionari "E.", edhe për periudhën dhjetor 2017- 31 dhjetor 2020, vazhdon të kryejë këtë proces përpunimi dhe të gjenerojë të ardhura pa deklaruara, duke ndikuar në uljen e të ardhurave që përfitohen nga APD dhe Ministria. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
15.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria Juridike dhe Njësia e Zbatimit të projektit, të marrë masa për monitorimin dhe evidentimin e proceseve të punës që kryen nga koncensionari "E." dhe të forcojnë mekanizmat e monitorimit të detyrimeve koncensionare, me qëllim ndalimin e veprimtarive të kryera në kundërshtim me kontratën koncensionare dhe faturimin e vlerës së të ardhurave të koncensionarit si edhe rritjen e të ardhurave që përfitohen nga APD dhe MIE.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ka nisur hartimi i nje Udhëzuesi "Mbi funksionimin e inspektimit dhe monitorimit të Kontratës së Konçensionit me E.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

15.2.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria Juridike, të analizojnë situatën e krijuar nga koncensionari "E." për kryerjen e proceseve e volumeve të punës të pa deklaruara për periudhën dhjetor 2017- 31 dhjetor 2020, i cili vazhdon të kryej proces përpunimi jashtë kontratës koncensionare dhe të gjenerojë të ardhura pa i deklaruar, si edhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e të ardhurave të munguara.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Për periudhën dhjetor 2017- 31 dhjetor 2020 koncensionari "E." volumet e punës nuk janë deklaruar nga koncensionaret
Zbatimi të rekomandimit: Pa **Zbatuar.**

16. Gjetje nga auditimi: Koncensionari "E. Sh. & T. GmbH", nuk ka realizuar investimet e parashikuara sipas parashikimit në kontratën koncensionare dhe ofertën ekonomike. Bazuar në

kontratën koncensionare, neni 8.6 "Vlera e Investimit" përcaktohet se shoqëria "E.-A.", do të investojë vlerën prej 2,069,371,737 lekë, në mjete, infrastrukturë, zyra, sistemin e rrjetit kompjuterik, etj. Nga koncensionari nuk janë kryer investimet e programuara. Koncensionari nuk ka bërë të mundur, implementimin e sistemit dhe rrjetit kompjuterik. Raportimet e Konçensionarit mbi shërbimet/të ardhurat, janë të njëanshme. Mungesa e marrjes së informacioneve on-line, për çdo shërbim të kryer, nga Koncensionarët tek Njësia e Monitorimit, implementimi i një sistemi dhe rrjeti kompjuterik, e bën të vështirë që ky proces i ngritur për monitorimin e këtyre kontratave të jetë i besueshëm dhe me efektivitet për një administrim sa më të mirë të vlerave monetare, detyrim ky i përcaktuar në pikën 12.1.7 "Sistemi dhe Rrjeti kompjuterik" i Kontratës së koncesionit, dhe Protokollit nr. 1810, datë 12.07.2013 "shkëmbimi i informacionit" pika b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1.Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit e teknikës dhe Njësisë së Zbatimit Projektit, të marrë masa për evidentimin e saktë (dypalësh) të investimeve të kryera nga koncensionari "E.", të njoftojnë strukturat që ndjekin zbatimin e kontratave koncensionare në MIE, mbi nivelin e realizimit të investimeve dhe treguesve të performancës sipas ofertës ekonomike, me qëllim përmbushjen e kushteve kontraktore nga palët për rritjen e investimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
APD i është drejtuar me shkresën nr. 1501 prot., datë 20.05.2020 koncensionarit "E." me lëndë Kërkesë për venien në dispozicion të dokumentacionit justifikues mbi investimet por nga ana e koncensionarit nuk është kthyer përgjigje. APD me shkresën nr. 1623 prot.,datë 27.04.2022 është bërë raportimi në MIE mbi kontratën koncensionare "Për menaxhimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Terminalit Lindor të Portit të Durrësit" për periudhën Janar-Mars 2022.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

17. Gjetje nga auditimi: Konçensionarët kryejnë operacionet e shërbimit me sistem 24-orë ndërsa sektori i Inspektimit dhe monitorimit të kontratave konçensionare, operon me sistem 8 (tetë) orë (08.00-16.00). Në Kontratat Konçensionare nuk janë parashikuar penalitete për mos përmbushje të detyrimeve kontraktore, duke mos u penalizuar kur nuk arrihet performanca e parashikuar si në propozimin ekonomik, propozim teknik, protokoll dorëzimi dhe në mospërmbushje të kontratave konçensionare mosrespektim të saj kundrejt përdoruesve të terminaleve. Në rregulloren e APD-së, nuk janë përfshirë kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe të Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", duke mos pasur të përcaktuar hapat e punës dhe gjurmët e auditit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv, Njësia e Zbatimit Projektit dhe Drejtoria e Zhvillimit dhe Teknikës, të marrë masa për përcaktimin në rregullore të proceseve që do të ndiqen dhe gjurmës së auditit për monitorimin e operacioneve të punës të koncensionarëve, të njoftojnë strukturat që ndjekin zbatimin e kontratave koncensionare në MIE, mbi nivelin e realizimit të treguesve të performancës sipas ofertës ekonomike, me qëllim përmbushjen e kushteve kontraktore nga palët.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
APD me shkresën nr. 1623 prot.,datë 27.04.2022 është bërë raportimi në MIE mbi kontratën koncensionare "Për menaxhimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Terminalit Lindor të Portit të Durrësit" për periudhën Janar-Mars 2022.

Rekomandimi do të konsiderohet në proces.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

18. Gjetje nga auditimi: Performanca e shoqërisë koncensionare "E.", në lidhje me volumin e përpunimeve krahasuar me propozimin ekonomik (oferta ekonomike), realizimi i përpunimit rezulton në masën 100%, vetëm për vitin 2014, ndërsa në vitet e tjerë paraqitet i realizuar në nivelet rreth 40 %-50%, pra, performanca e realizimit të treguesve është shumë e ulët dhe për këtë nuk ka asnjë analizë, ose penalizim të koncensionarit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
18.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria e Zhvillimit dhe teknikës dhe Njësia e Zbatimit Projektit, të marrë masa për evidentimin e saktë (dypalësh) të investimeve të kryera nga koncensionari, të njoftojnë strukturat që ndjekin zbatimin e kontratave koncensionare në MIE, mbi nivelin e realizimit të investimeve dhe treguesve të performancës sipas ofertës ekonomike, me qëllim përmbushjen e kushteve kontraktore nga palët për rritjen e investimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
APD i është drejtuar me shkresën nr. 1501 prot., datë 20.05.2020 koncensionarit "E." me lëndë Kërkesë për venien në dispozicion të dokumentacionit justifikues mbi investimet por nga ana e koncensionarit nuk është kthyer përgjigje. APD me shkresën nr. 1623 prot.,datë 27.04.2022 është bërë raportimi në MIE mbi kontratën koncensionare "Për menaxhimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Terminalit Lindor të Portit të Durrësit" për periudhën Janar-Mars 2022.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

19. Gjetje nga auditimi: Strukturat drejtuese të APD-së, nuk kanë zbatuar Vendimin nr. 567, datë 07.11.2018, pika II/a, të Autoritetit të Konkurrencës, ku i rekomandohet APD-së, që brenda 90 ditëve, të marrë masa për: -Miratimin e një rregulloreje për funksionimin e Terminalit Lindor të Portit, Durrës, ku të jenë përcaktuar ndër të tjera: -procedurat për sigurimin e shërbimeve që ofrohen nga koncensionari "E. Sh.&T. GmbH", -Funksionimi i agjentit detar dhe atij spedicioner, si përfaqësues të pronarit /chartertuesit të mjetit lundrues dhe pronarit të mallrave në raport me të drejtën për të përzgjedhur operatorin e licencuar stivador. -Marrëdhënia midis koncensionarit, përdoruesit të portit, agjentit detar dhe ndërmarrjeve stivadore. -Detyrimi i APD për mbajtjen e grafikut të charterimit të vinçave (në pronësi të koncensionarit) dhe ngarkim-shkarkimit të mallrave sipas kërkesave të përdoruesve të portit dhe parimit të mos-diskriminimit (si parashikohet në kontratën e koncensionit) -Draft rregullorja përpara miratimit të dërgohet paraprakisht për mendim pranë Autoritetit të Konkurencës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
19.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria Juridike, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Autoriteti i Konkurencës, monitorimin e proceseve të punës të kryera nga koncensionarët bazuar në rregullore e udhëzime të miratuara, për mirëmenaxhim të marrëdhënieve midis koncensionarit dhe përdoruesve të portit.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Për pjesën e tij të rekomandimeve, Autoriteti Portual Durrës i është drejtuar nëpërmjet shkresës nr. 3601, dt. 24.10.2019, Ministrisë së Infrastrukturës, në cilësinë e autoritetit kontraktor, pikërisht për faktin se përgatitja e një rregulloreje për Terminalin Lindor, sikurse kërkohet nga Autoriteti i Konkurrencës, kërkon adresimin e disa çeshtjeve si e drejta per të përzgjedhur operatorin e licencuar stivador, marrëdhënia ndërmjet koncesionarit dhe ndërmarrjes stivadore etj., çështje të cilat implikojnë kontratën e koncesionit "Për menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Terminalit Lindor në portin e Durrësit", per te cilen nuk kemi nje pergjigje.

Pra, permbushja e pikes 2 te vendimit lidhet me sa realizohen detyrimet ne piken 1 te Vendimit dhe marredhenies mes Autoritetit Kontraktor (MIE) dhe Koncesionarit (E. A.).
Ne muajin Korrik 2022 është zhvilluar takim mes APD dhe MIE per analize te rekomandimeve te Autoritetit të Konkurrencës dhe marrje masash. Është në proces hartimi i rregullores për sa i përket rekomandimeve të lëna.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

20. Gjetje nga auditimi: Rezultatet në shfrytëzimin e shesheve të përdorimit, janë me efektivitet mjaft të ulët, si rezultat i mos-faturimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për kontrata të lidhura dhe të përfunduara, për "Kontrata Operacionale mbi dhënien në shfrytëzim të shesheve të përdorimit", 100 % e kontratave realizojnë të ardhura me çmimin 2 lek/m² dhe 0% e tyre japin produktivitet në vlerat maksimale (4 lekë/m², 6 lekë/m² dhe 10 leke/m²). Kjo përqindje e lartë (100%), e shfrytëzimit të shesheve në kufijtë minimal të pagesës (për 2 lekë/m² për 45 ditë), ka ardhur si rezultat i hartimit nga koncensionari E.-A., të disa kontratave, brenda periudhës së të njëjtës kontratë (për sipërfaqe të njëjtë & subjekte të njëjtë dhe mallra të njëjtë) pa e tejkaluar kufirin 45 ditë. Bazuar në pikën 2 të Kontratës tip "Mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit" ku citohet... bazuar në Udhëzimin e MF dhe Ministrisë se PPTT, subjekti nënshkrues i kësaj kontrate ka të drejtë të shfrytëzojë sheshin e përdorimit brenda një afati kohor prej 180 ditë, (shesh të cilin nuk mund ta shfrytëzoj asnjë subjekt tjetër), pra kur afati kohor i shfrytëzimit të sheshit është deri në 180 ditë, koncensionari brenda periudhës, ka nënshkruar 4 (katër) kontrata duke shmangur faturimin e përshkallëzuar, në përputhje me Udhëzimin e MF dhe PPTT nr. 581/1, datë 06.02.2013 dhe Udhëzimi i Përbashkët i MTI & MF nr. 1568/3, datë 14.07.2015. Rezultatet, në shfrytëzimin e shesheve të përdorimit, janë me efektivitet mjaft të ulët, si rezultat i mos-faturimit në përputhje me Udhëzimin nr. 581/1, datë 06.02.2013 dhe nr. 1568/3, datë 14.07.2015, dhe me pikën 2, të "Kontratës mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
20.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e kontratave, të analizojnë dhe nënshkruajnë kontrata për shfrytëzimin e shesheve të përdorimit me faturim të përshkallëzuar, duke respektuar kërkesat e udhëzimit të MTI & MF nr. 1568/3, datë 14.07.2015 me qëllim rritjen e të ardhurave.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk u paraqit dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi, për këto arsye rekomandimi do të konsiderohet i pazbatuar.
Zbatimi të rekomandimit: Pa Zbatuar.

21. Gjetje nga auditimi: Procedura e përzgjedhur për Kontratën "Shërbime konsulence për reformën rregullatore, nevojat e sigurisë dhe hartimin e Masterplanit Strategjik 2030", është "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës". Argumentimi i aplikimit të kësaj procedure bazohet në vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01, datë 14.10.2020, pikën 3 dhe 4, të cilat kanë ngarkuar autoritet portale që për vendndodhjet e reja apo të zgjerimit të porteve, të marrin masat e nevojshme në zbatim të legjislacionit sektorial dhe atij për planifikim dhe zhvillim të territorit, si dhe APD që brenda muajit nëntor 2020, të marrë masa për: *"a. hartimin e planit të ri të përdorimit dhe administrimit të tokës (masterplan); b. hartimin e dokumenteve tekniko ligjore që do të orientojnë APD për zhvillimin e operacioneve portuale, shërbimeve dhe investimeve në infrastrukturën detare dhe tokësore të terminaleve përkatëse, në përputhje me zonat e përcaktuara në Planin Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale; etj".*

Pavarësisht përcaktimit në Vendimin e KKT të një afati, realizimi i një masterplani nuk është ngjarje e paparashikueshme. Hapat për përcaktimin e termave të referencës, prokurimin e shërbimeve konsulente, zbatimin e kontratës së shërbimeve konsulente dhe marrja në dorëzim e produktit, dërgimi për miratim në strukturat përkatëse, kërkojnë një afat të konsiderueshëm, veprimtari e cila nuk mund të ndikohet nga përshpejtimi i procedurës së prokurimit duke aplikuar procedura me afat të reduktuar.
Në vendimin e KKT, afati deri në fund të muajit nëntor 2020, është vendosur për hartimin e masterplanit, por edhe për hartimin e dokumenteve tekniko ligjore që do të orientojnë APD për zhvillimin e operacioneve portuale, shërbimeve dhe investimeve në infrastrukturën detare dhe tokësore të terminaleve përkatëse, si dhe përgatitjen e praktikës tekniko-ligjore për miratimin e masterplanit në përputhje me përcaktimet e legjislacionit sektorial".
Për hartimin e masterplanit strategjik është përcaktuar një grafik kohor 1 muaj, ndërsa për dy drejtimet e tjera është vendosur afati 2 muaj, periudhë e cila e kapërcen afatin deri në fund të muajit nëntor 2020, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pika 2.c. dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 36, pika 2.c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
21.1. <u>Rekomandimi</u>: Autoriteti Portual Durrës të marrë masa për trajnimin e stafit i cili angazhohet me realizimin e procedurave të prokurimit, me synimin shmangien e gabimeve gjatë proceseve përkatëse.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Njësia e Prokurimit është trajnuar nga APP me daljen e ligjit të ri, kjo vertetohet nga konfirmimi i pjesmarrjes nga secili anëtar.
Rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

22. Gjetje nga auditimi: Fondi limit për procedurën e prokurimit "Thellimi emergjent i basenit dhe kanalit hyrës në Portin e Durrësit" është bazuar në përllogaritjet e bëra nga kontraktori i përzgjedhur për hartimin e projekt-preventivit në shumën 8,623,184 Euro. Analiza e kostos është marrë në konsideratë për përcaktimin e fondit limit. Bazuar në përllogaritjen e kostos janë përfshirë shpenzime të përgjithshme në masën 15 % dhe fitim në masën 10 %. Sa më sipër, fondi limit është përllogaritur mbi vlerën reale me vlerë *593,347 Euro,* ose 74,346,379 lekë dhe fondi i argumentuar duhet të ishte me vlerë 1,006,224,621 lekë.
-Fondi limit për procedurën "Shërbime konsulence për reformën rregullatore, nevojat e sigurisë dhe hartimin e Masterplanit Strategjik 2030" është përcaktuar me vlerë 61,450,000 lekë, bazuar në studimin e tregut duke marrë oferta nga OE "M." SHPK, OE "E. & Y." GmbH dhe OE "A." SHPK, OE që nuk ushtrojnë aktivitet në fushën e objektit të kontratës, duke mos ezauruar të gjitha alternativat e përcaktuara në aktet ligjore, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59.
-Për përllogaritjen e fondit limit të Kontratës "Shërbimi i mirëmbajtjes së gjelbërimit, për tre vite, realizuar në vitin 2019", është aplikuar studimi i tregut, nëpërmjet marrjes së ofertave nga 3 OE. Nga verifikimi i zërave të shërbimit rezulton se për zërat "Blerje dhe mbjellje lulesh sezonale të llojit Cyclamen, primula dhe dekorative"dhe "F.V fidanë lule dekorative", nuk janë marrë në konsideratë çmimet e publikuara në manualet e çmimeve të ndërtimit, duke rritur *në mënyrë të pa argumentuar fondin limit me vlerë 494,730 lekë.*
-Fondi limit për procedurën e prokurimit "Rikonstruksion i magazinave 4, 5, terminali perëndimor, viti 2019" është përllogaritur me vlerë 22,092,898 lekë duke marrë për referencë manualet e çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre të vitit 2015, por janë hartuar edhe analiza çmimesh të reja, konkretisht analiza "Shtresë betoni C 20/25, t=15 cm, me

helikopter", me çmim 12,500 lekë për m^3. Në këtë çmim është përfshirë nivelimi me helikopter 2,985 lekë për m^3 [(2.2 orë pune x 1,150 lekë/orë) + 8 % shpenzime të përgjithshme + 10 % fitimi i planifikuar]. Duhet theksuar se vetëm për nivelimin e betonit sipas përcaktimeve të mësipërme është përfshirë në fond limit vlera 2,310,390 lekë (2,985 lekë/m^3x 774 m^3), ose në masën 10.4 %.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 9, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59 dhe VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika 2 dhe 112. c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën ,2.7, faqe 96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
22.1.<u>Rekomandimi</u>: Autoriteti Portual Durrës të marrë masa që për prokurimet në vijim do të llogarisë saktë fondin limit pavarësisht se praktikat janë hartuar nëpërmjet procedurave të prokurimit të veçanta.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Fondi Limit percaktohet nga Komisioni i hartimit te specifikimeve teknike dhe perllogaritjes se fondit limit. Rishikim per përllogaritjet e fondit limit pavarësisht se praktikat janë hartuar nëpërmjet procedurave të prokurimit të veçanta. Krysisht per projektet ne ndertim.
Ky rekomandim do të konsiderohet në proces dhe do të auditohet nga auditimi i ardhshëm mbi zbatimin e tij.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit "Shërbime konsulence për reformën rregullatore, nevojat e sigurisë dhe hartimin e Masterplanit Strategjik 2030", pika 2.3.2 "Kapaciteti Teknik", është përcaktuar që ofertuesi duhet të demonstrojë eksperiencë teknike për të paktën 3 projekte.
-Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit "Prishje e godinave të amortizuara plotësisht në zonën e ish peshkimit dhe magazinën 4-5", janë vendosur kritere të cilat nuk përputhen me objektin e kontratës pasi është kërkuar disponimi i licencës profesionale NP-2. 1A "Ndërtime civile dhe industriale", ndërkohë që të gjitha punimet e përcaktuara kanë të bëjnë me shkatërrime objektesh dhe në asnjë rast me ndërtime të reja, apo rikonstruksione, si dhe është kërkuar disponimi ose marrja me qira e dy fadromave me goma dhe 2 ekskavatorë me zinxhirë, ndërkohë që bazuar në preventiv dhe analizat e zërave të punimeve, proceset e punës janë parashikuar të realizohen me mjete: ekskavator me kovë 0.25 m^3, ekskavatorë me çekiç dhe automjete për transport, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 33, neni 40, pika 4, neni 46, pika 32, c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
23.1.Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës duhet të tregojë kujdesin e duhur për realizimin dhe menaxhimin e procedurave të prokurimit, në përcaktimin e kritereve në përputhje me llojin dhe objektin e kontratës duke rritur rolin kontrollues në të gjitha fazat e zbatimit të procedurës së prokurimit, me synim parandalimin e diskriminimit të operatorëve ekonomikë, ofrimin e mundësisë për pjesëmarrje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, të cilët kanë interes të ofrojnë shërbimet e tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Autoriteti Portual Durres ndjek ne vijimesi zbatimin e rekomandimit gjate cdo faze te zbatimit te procedurave te prokurimit.
Ky rekomandim do të konsiderohet në proces dhe do të auditohet nga auditimi i ardhshëm mbi zbatimin e tij.

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

24. Gjetje nga auditimi: Monitorimi dhe mbrojtja e mjedisit në territorin në administrim të APD menaxhohen nga Sektori i Monitorimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Me Urdhër të Brendshëm nr. 99, datë 14.01.2020, është ngritur grupi i punës për evidentimin e problematikave mjedisore nga ku ka rezultuar: Në zonën 2 "Terminali perëndimor", ku ushtrojnë aktivitetin kompanitë "L.1", "E. 1" dhe "A.", si pasojë e shfryrjes së pluhurit nga thithësit pneumatik të cilët përdoren gjatë përpunimit të çimentos, pluhuri emetohet në ajër; Në zonën 5 "terminali i trageteve", herë pas here në pjesën e kalatës nr. 8, ku akostohen tragetet, është vënë re ngjyrë e errët e ujit dhe arome e rëndë, po ashtu për pasojë të lyerjes së trageteve janë konstatuar shenja boje; Në zonën 17 "Terminali lindor" ku ushtron aktivitet Konçesionari "E.-A.", është konstatuar se ka ngritje të grimcave të mineraleve që depozitohen në shesh në ajër; Në zonën 1 "Zona kufitare", në sheshin e kalatës 1, vendosen anije për ndërtim apo riparim, nga ku shkaktohen ndotje nga skoriet; Në zonën 8 dhe 20, kryesisht ka mbeturina inerte nga objektet e shembura dhe hekurishte.
Pavarësisht përpjekjeve për konstatimin e problematikave mjedisore, nuk janë përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me realizimin e inspektime periodike, evidentimin e masave të marra për parandalimin e ndotjeve. APD nuk ka bashkëpunuar në mënyrë të mjaftueshme me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Drejtorinë e Përgjithshme Detare, për parandalimin e ndotjes së mjedisit, si dhe ndëshkimin e shkaktarëve të ndotjes së mjedisit në territorin e portit. Nga APD nuk është kërkuar zhdëmtimi i pasojave që janë krijuar nga ndotja e mjedisit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" neni 4, 122, c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11, faqe 346 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
24.1.Rekomandimi: APD të marrë masa që me evidentimin e problematikave mjedisore të shkaktuara nga subjektet që operojnë në port, të ndjekin në rrugë ligjore të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit përmes strukturave të posaçme që ushtrojnë kompetencat përkatëse, për ndëshkimin e subjekteve që i shkaktojnë ato.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Njesia e mjedisit per cdo rast te ndotjeve te evidentuara se bashku me burimin ndotes, ka bere njoftimet perkatese ne rruge zyrtare te institucioneve ligjzbatuese ne fushen e inspektimit ne mjedis. Per secilin rast institucionet kane reaguar duke vijuar me proceduren e tyre sipas legjislacionit sektorial mjedisor.
Grupi i inspektimit i IKMT-Durres eshte organizuar per te verifikuar problematiken ne terren. Specialistet e njesise se mjedisit asistojne ne menyre qe inspektimi te kryhet ne bashkepunim mes dy institucioneve.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

25. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Thellimi emergjent i basenit dhe kanalit hyrës në Portin e Durrësit", OE i shpallur fitues ka pasur mangësi në plotësimin e kërkesave pasi uk ka të regjistruar në QKB aktivitetin e punimeve për gërmime nënujore, thellim porti; nuk plotëson kriterin e punimeve të ngjashme, si dhe llogaritjet për kapacitetin e anijeve janë bërë për distancë 1.6 milje ose 2.56 kilometër, ndërkohë që distanca e largimit të materialeve të gërmuara është 7.4 kilometër.
-Në procedurën e prokurimit "Shërbime konsulence për reformën rregullatore, nevojat e sigurisë dhe hartimin e Masterplanit Strategjik 2030", OE fitues nuk ka paraqitur shërbime të ngjashme të realizuara sa i takon masterplaneve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 12, c.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje goma për mjete të renda dhe kamionët e Terminalit të Kontejnerëve", OE fitues nuk ka përkthyer në gjuhën shqipe fletët e katalogut që ka paraqitur tek aneksi i specifikimeve teknike, në kundërshtim me seksionin nr. 4.6, të DST. Në autorizimin e prodhuesit mungonte informacioni i prodhuesit *si* telefon/fax/e-mail/ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, veprime këto në kundërshtim me pikën 4, Kapacitetet teknike.
-Në procedurën e prokurimit me objekt " Blerje gomash", u konstatua se pika 2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, dhe kapaciteti teknik 2.3, pika 4, dhe pika 10 specifikimet janë të përgjithshme dhe pa përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin OE, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Nga OE fitues nuk janë paraqitur dokumente për kërkesat e mësipërme dhe KVO nuk kërkuar sqarime për to. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1.Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, të tregojë kujdesin e duhur për realizimin dhe menaxhimin e procedurave të prokurimit, duke rritur rolin kontrollues në të gjitha fazat e zbatimit të procedurës së prokurimit, me synim parandalimin e diskriminimit të operatorëve ekonomikë, ofrimin e mundësisë për pjesëmarrje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, të cilët kanë interes të ofrojnë shërbimet e tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Autoriteti Portual Durres ndjek ne vijimesi zbatimin e rekomandimit gjate cdo faze te zbatimit te procedurave te prokurimit.
Ky rekomandim do të konsiderohet në proces dhe do të auditohet nga auditimi i ardhshëm mbi zbatimin e tij.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

26. Gjetje nga auditimi: Në kontratën "Thellimi emergjent i basenit dhe kanalit hyrës në Portin e Durrësit", Raporti i Survejimit Nënujor pika 5, përcaktohet: "*Janë regjistruar dhe analizuar 40 objekte gjatë studimit. Janë vërejtur disa mbetje të vogla në basenin e portit, por zbulohet se nuk kishte rreziqe për lundrim gjatë studimit dhe nuk rekomandohen veprime të menjëhershme korrigjuese bazuar mbi analizën e rezultateve të studimit...*".
Në certifikatën e lëshuar nga Kontraktori datë 02.09.2019, përcaktohet: "*Në përfundim të këtij survejimi, Kontraktori "V. C. G." SHPK, i cili ka kryer identifikimin e mbetjeve metalike dhe shpërthyese vërteton dhe garanton pastrimin e zonës nga të gjitha objektet e sipërpërmendura deri në 3 m nën tabanin e detit...".*
Bazuar në Raportin e konsulentit muaji maj 2020, më datë 10.03.2020, gjatë punës në kthesën e kanalit është hasur një mjet metalik shpërthyes në dukje aktiv. Sipas Kontraktorit dhe Mbikëqyrësit të punimeve në zonën ku është konstatuar objekti po punohet në thellësinë 10 m nga niveli i detit, gërmim i cili është kryer referuar kuotës 6 m, duke theksuar faktin se survejimi është bërë për thellësi 3 m nga tabani i detit, dhe thellësia 4 m nuk i përket survejimit nënujor). Nga ana e Kontraktorit është pretenduar se një mjet plasës luftarak është zbuluar në bazamentin për thellim. Pretendohet se ky mjet është hequr nga forcat e ushtrisë, *por grupit të audtimit nuk ju paraqit dokumentacion justifikues mbi realizimin e procesit, për të vërtetuar pozicionin dhe vendndodhjen e objektit (nëse i përket thellësisë mbi 3 m dhe në zonën e survejuar nga Kontraktori), si dhe largimin e tij*.
-Nga ana e kontraktorit pretendohet për rritje çmimi të gërmimit në sektorët e pa thelluara më parë, në kundërshtim me specifikimet teknike, ndërkohë që analizat laboratorike të sjella janë realizuar pa miratimin e punëdhënësit, në kundërshtim me Kontratën e Punimeve Civile, "Specifikimet teknike", pika 4.15. "Preventivi"2.c. Kostos është paraqitur mbi një analizë të kostos së punimeve me çmim 949.45 lekë për m^3, e cila është në kundërshtim me Specifikimet

Teknike, pika 4.15. Ndryshimi i fortësisë së rërës nuk përbën faktor për ndryshimin e çmimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1 Rekomandimi: APD të shqyrtojë pretendimet e Kontraktorit "V." SHPK, lidhur me mjetin metalik plasës luftarak, duke kërkuar dokumentet përkatëse dhe justifikuese, për të përcaktuar saktësisht vendndodhjen e objektit. Bazuar në thellësinë e vendndodhjes, nëse ishte më pak se 3 metra, Kontraktori mban përgjegjësi për vonesat dhe kostot e mundshme të krijuara.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Mjetet metalike plasëse luftarake te gjetura gjate punimeve per Thellimin e kanalit hyres dhe basenit ne Portin e Durresit jane dokumentuar si nga ana ligjore dhe nga ana teknike. Kontraktori dhe mbikqyresi i punimeve ne momentin qe sapo kane konstatuar mjetet metalike plasëse luftarake kane nderprere automatikisht punimet, kane rrethuar me shenja sinjalizuese perimetrin e sigurise dhe kane njoftuar zyrtarisht Autoritetin Portual Durres, Komanden e Forcave te Bashkuara, Drejtorine e Pergjithshme Detare, Kapitenerine e Portit Durres sipas legjislacionit te Ministrise se Mbrojtjes te RSH. Referuar kontrates se zbatimit e cila parashikon qe ekstraktimi i mbetjeve metalike dhe mbeturinave te tjera ne zonen e interesuar per germim (perjashtuar objektet eksplozive).

Ekstraktimi i te gjithe mbetjeve metalike te gjetura nen bazamentin e detit gjate survejimeve, me perjashtim te objekteve eksplozive (te cilet do te shenohen me bova me flamur te kuq ne pritje te nderhyrjes nga njesite e specializuara te ushtrise). Nga keto insitucione jane marre masa urgjente per verifikimin e mjeteve metalike plasëse luftarake mbi pozicionin gjeografik dhe kordinativ ku ndodheshin dhe me pas largimin e tyre. Operacioni u krye nga ushtria me ekipe zhytesish te mbeshtetur nga nje mjet lundrues me krah vinci. Te gjithe keto hapa te ndermarra jane te parashikuara ne kontraten e zbatimit te punimeve dhe kontraktori ka zbatuar me rigorozitet te gjitha etapat. Vlen te theksohet se pasi forcat e armatosura kane bere largimin e mjeteve metalike plasëse luftarake dhe rikonjicionin e asaj zone, kontraktori eshte lejuar te vazhdoje me punimet e dragimit.

Komanda e Forcës Detare me shkresën nr. 2857/5., datë 22.10.2020 konfirmon për kryerjen e operacioneve në datat 02, 19, 20 të muajit Tetor të vitit 2020 ku kanë identifikuar një predhë artilerie në thellësinë 8.5 metra e cila është nxjerrë në siperfaqe edhe i është kaluar me procesverbal Komandës Mbështetëse.

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

26.2.Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës dhe Mbikëqyrësi i Punimeve të marrin masa për zbatimin e specifikimeve teknike të DST, që janë pjesë e kontratës së lidhur mes palëve dhe gjatë analizimit të pretendimeve të kontraktorit të mbajnë në konsideratë faktin se kostot e paraqitura për punimet me çmim 949.45 lekë për m^3, janë në kundërshtim me Specifikimet Teknike, pika 4.15, pasi ndryshimi i fortësisë së rërës nuk përbën faktor për ndryshimin e çmimit.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Nga ana e APD nuk ka patur ndryshim cmimi ne kete kontrate, kontraktori i punimeve ka bere nje kerkese per rishikim cmimi por autoriteti kontraktor nuk e ka marre ne konsiderate dhe ka proceduar me cmimet e parashikuara ne kontrate.

Kjo shikohet shume qartesisht ne situacionet e paguara kontraktorit por disponojme dhe shkrese zyrtare ku i kemi komunikuar nga ana jone Kontraktorit qe ndryshim cmimi nuk pranohet dhe te vijohet me cmimin e kontrates.

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

27. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare 2018-2019 janë përllogaritur shpenzime amortizimi në vlerën 565,319,714 lekë dhe 527,555,116 lekë, pa paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve, duke e rritur riskun për vlerat e mbartura të aktiveve si dhe për rastet e dhënies në shfrytëzim apo me qira.
-Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirë-argumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, APD rrezikon të mos kryejë me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.
-APD nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, 75 të SNK 16 dhe me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
27.1. Rekomandim: Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të merren masa që në të ardhmen, hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me përgjegjshmëri dhe besueshmëri. Drejtimi i shoqërisë të marrë masa për përcaktimin e sistemeve dhe procedurave për zëvendësimin/shtimin e aktiveve afatgjata. Jetëgjatësia e aktiveve të përcaktohet mbështetur në manualet përkatëse, ekspertiza të specialistëve të fushës, me përgjegjshmëri dhe besueshmëri.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
APD ka ngritur grupet e punës për vlersimin e të gjitha aktiveve mbi të cilën do të gjykohet për rivlersimin e tyre në kontabilitet cka do të ofroj me afer vlerat e aseteve të APD-së.
Rekomandimi është në proces.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

28. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i pagesave të bankës të kryera për kontratën me nr. 3592, datë 24.10.2019, fatura nr. 11, datë 15.06.2020, me vlerë 3,662,098 lekë dhe fatura nr. 12, datë 15.06.2020, me vlerë totale 4,145,834 me TVSh, nuk është mbajtur 5 % e vlerës së kontratës si garanci e punimeve, respektivisht në vlerat 183,105 lekë dhe 207,291 lek me TVSh, veprime në kundërshtim me nenin 44 të kontratës së lidhur me OE fitues të procedurës së prokurimit.
Mos mbajtja e garancisë krijon risk për AK, nëse punimet e kryera nuk janë në standardet e kërkuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
28.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të marrë masa që në të ardhmen, sistemet e kontrollit të menaxhimit financiar, të mos lejojnë likuidimin total të detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik fitues, pa mbaruar periudha e garancisë.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe do të kontrollohet në auditimin e rradhës.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

29. Gjetje nga auditimi: Mënyra e ndjekur nga APD për rekrutimin e punonjësve nuk është transparente, pasi nuk janë konstatuar gjurmë të publikimit të vendeve vakante, dhe procedurat e punësimit, veprime janë në kundërshtim me nenin 4, pika 9, nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Mos kryerja e procesit transparent të rekrutimit të brendshëm ka efekt negativ në motivimin e punonjësve që kanë performancë të mirë në aktivitetin e tyre në shoqëri. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1. <u>Rekomandim</u>: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa që në të ardhmen procesi i rekrutimit të burimeve njerëzore të kryhet me profesionalizëm, si dhe marrjen e masave për dokumentimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve të punësuar rishtazi, për të sigurimin e transparencës në procesin e rekrutimit të burimeve njerëzore.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Procesi i rekrutimit te burimeve Njerezore kryhet sipas procedurës "Rolet Organizative, Përgjegjësitë dhe Autoritetet", miratuar me Urdhërin e Brendshëm Nr. 3514/2, datë 22.12.2020, i ndryshuar. Kete procedure e gjeni tek Standartet ISO, e ndare per njohje nga Njesia perkatese.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

30. Gjetje nga auditimi: Vendimet e marra nga Këshilli Drejtues i APD në lidhje me ndryshimet e strukturës organike dhe nivelit të pagave të APD, janë marrë pa miratim nga MIE. Për pasojë drejtimi ka angazhuar, rekrutuar punonjës dhe ka kryer shpenzime për paga e shpërblime pa marrë miratimin përkatës nga Ministri, si i vetmi autoritet ligjor, në kundërshtim me nenin 53 "Aktet nënligjore", pika 2 të ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
30.1.<u>Rekomandim</u>: Organet drejtuese të APD të marrin masa për miratimin e strukturës së pagave në Ministrinë e linjës, duke respektuar kështu kompetencat institucionale të institucioneve përkatës.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ne vijimësi çdo ndryshim i strukturës së pagave do të paraqitet për miratim tek Ministri.
Nga auditimi nuk rezulton te ketë pasur ndryshime në strukturën organike dhe nivelit të pagave, për këto arsye rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe të shikohet nga auditimi i ardhshëm.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

31. Gjetje nga auditimi: Pas mbarimit të kontratës me shoqërinë V.–E., për mirëmbajtjen e Infrastrukturës Operacionale, APD ka marrë 10 punonjës për kryerjen shërbimeve, në prill të vitit 2018. Punonjësit nuk kanë qenë pjesë e strukturës së aprovuar nga KD dhe nuk kanë përfituar nga shpërblimet vjetore që kanë përfituar punonjësit e APD-së, bazuar në Vendimin e KD nr. 9, datë 18.03.2016 "Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimeve suplementare dhe të ndihmave financiare në Autoritetin Portual Durrës", neni 5, Përjashtimet nga shpërblimet, pika d, veprime në kundërshtim me nenin 115, të Kodit të Punës, duke sjellë diskriminim të punonjësve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
31.1.<u>Rekomandim</u>: Nga Këshilli Drejtues të merren masa për integrimin e 10 punonjësve që kryejnë mirëmbajtjen e infrastrukturës civile në strukturën organizative të APD-së, duke u mundësuar trajtim të barabartë për përfitimin e shpërblimeve sipas Kodit të Punës.

Brenda datës 31.12.2021

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me vendimin të Këshillit Drejtues është realizuar integrimi i 10 punonjësve që kryejnë mirëmbajtjen e infrastrukturs civile në strukturën organizative të APD-së. VKD Nr. 03, date 26.02.2021.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

32. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Portual Durrës, nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër, veprime janë në

kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30. Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk të lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1<u>Rekomandim</u>: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që APD zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Brenda datës 31.12.2021

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

APD ka ngritur grupet e punës për vlersimin e të gjitha aktiveve mbi të cilën do të gjykohet për rivlersimin e tyre në kontabilitet cka do të ofroj me afer vlerat e aseteve të APD-së.

Rekomandimi është në proces.

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

33. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore 2018, në zërin e huave afatgjata, APD, ka të regjistruar detyrimin ndaj E. I. B. për shumën prej 12,000,000 Euro, e miratuar me ligjin nr. 9691, datë 08.03.2007, "Për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin me kredi të projektit "Ndërtimi i Terminalit të Trageteve dhe shesheve përreth në Portin e Durrësit" në total 18,000,000 Euro, por disbursuar 12,000,000 Euro. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) me shkresën nr. 4609, datë 03.12.2018, ka sqaruar se në kushtet kur në marrëveshjen e sipërpërmendur nuk përcaktohen detyrime financiare të APD dhe nuk ka marrëveshje nën-huaje ndërmjet APD dhe MFE, APD nuk ka detyrime financiare lidhur me këtë marrëveshje.

APD, në kushtet kur ka marrë konfirmimin se vlera 12,000,000 Euro nuk është detyrim, duhet ta klasifikonte në kategorinë e grandeve. Mos pasqyrimi i amortizimit të AAM, të vlerës 12,000,000 Euro si të ardhura nga grandet, APD, ka deformuar rezultatin financiar të fund vitit. Nga një vlerësim i kryer duke marrë normën e amortizimit më të ulët, që përdoret për kalatat, e ndërtesat, prej 5% në vit mbi vlerën e ngelur, deri në 2019, amortizimi i akumuluar, pra dhe të ardhurat nga grandi janë në vlerën 392,339,000 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe SNK nr. 20, dhe me Standardin Ndërkombëtar i Kontabilitetit 38 Aktivet Jo-materiale, paragrafi nr. 11 Identifikueshmëria. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>33.1.Rekomandim:</u> Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa, për sqarimet e mëtejshme me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, për të saktësuar natyrën e zërit kontabël hua në vlerën 12,000,000 euro, kontabilizimin e tij në të ardhurat/shpenzimet e vitit ushtrimor, si dhe veprimet e mëtejshme për pasqyrimin e saktë në pasqyrat financiare dhe rezultatin financiar të institucionit.

Brenda datës 31.12.2021

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Nga Drejtoria e Përgjithshme Ekzekutive janë ndjekur te gjitha hapat e domosdoshme duke kerkuar zyrtarisht, ne menyre shkresore informacion mbi dokumentacionin e duhur per huane me vlere 12,000,000 Euro. DPE u ka kerkuar edhe audituesve te jashtem ti drejtohen MFE per tiu vene ne dispozicion ky informacion.

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

34. Gjetje nga auditimi: APD deri në fund të vitit 2020, ka një total të llogarive të pa-arkëtueshme në vlerën 593,074,000 lekë. Nga këto vlera 107,766,982 lekë përbëhet nga debitorë të vjetër te periudhave të mëparshme deri më vitin 2009. Për këto llogari APD ka mungesë informacioni mbështetës me fatura tatimore për të realizuar ndjekjen e arkëtimit të tyre. Në vlerën 421,552,611 lekë, të debitorëve për të cilët po ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e tyre, vlera më e madhe e detyrimit përbëhet nga L. 1 dhe N. M. Në vlerën 63,754,506 lekë, shoqëritë koncesionare A. dhe E., përbëjnë vlerën 38,628,894 lekë dhe në vlerën e mbetur 25,125,614 lekë janë detyrime të dërguara në përmbarim. Situata debitore konstatohet e përkeqësuar, e cila vështirësohet dhe për arsye se pjesa më e madhe e tarifave mblidhen te përdoruesit fundorë nga operatorët e ndryshëm, të cilët më pas i transferojnë fondet në llogaritë e APD-së, duke krijuar vonesa në pagesa. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3, g, të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Mos arkëtimi i borxheve rëndon situatën financiare të APD-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

34.1. Rekomandim: Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat ligjore për mbledhjen e borxheve që debitorët i detyrohen APD-së.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Drejtoria e Përgjithshme Ekzekutive ka marrë masa duke:

- Njoftuar debitorët për detyrimet që kanë;
- Lëshuar urdhër ndalim përdorimi të portit për debitorët

Deri në momentin e mbajtjes së këtij akt konstatimi nuk është arkëtuar asnjë vlerë nga OE që operojnë në APD, për këto arsye rekomandimi do të konsiderohet i realizuar pjesërisht.

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar Pjesërisht.

34.2. Rekomandim: Këshilli Drejtues të marrë vendimet përkatëse për të caktuar që pagesa e tarifave të ndryshme portuale, që janë të ardhura të APD-së, për shërbimet që ofron, të kryhet direkt në llogaritë bankare të APD, pa u përdorur operatorë të tretë për mbledhjen e tyre.

Brenda datës 31.12.2021

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
I është propozuar KD që të rregullohet mënyra e faturimit, mbledhja e të ardhurave edhe ndarja e përqindjes të realizohen nga APD me qëllim minimizimin e detyrimeve nga subjekti L.-1, Këshilli Drejtues nuk ka marrë akoma vendim mbi propozimin e bërë nga APD.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata, të APD, u konstatua se me gjithë Vendimin nr. 14, me nr. 2079, datë 17.08.2019, të Këshillit Drejtues, ku miratohet nxjerrja jashtë përdorimit bazuar në relacionin e komisionit të vlerësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe artikujve të inventarit, duke ngarkuar Drejtorinë Ekzekutive për ta zbatuar, nuk është marrë asnjë masë për kryerjen e tij. Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 108, 109 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Mos kryerja e veprimeve të mësipërme përkeqëson gjendjen e materialeve si dhe krijon bllokime logjistike në magazinat e APD-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

35.1. Rekomandim: Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa që në të ardhmen, të kryhen procedurat e ankandit për shitjen e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit në ankand, dhe pjesën tjetër për tu asgjësuar.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Drejtoria e Përgjithshme Ekzekutive ka marrë masa duke:

- Ngritur urdhërat për vlerësimin e aseteve dhe nxjerrjen jashtë përdorimi;
- Do vijohet me procedurat e shitjes me ankand;

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

36. Gjetje nga auditimi: APD për periudhat 2019-2020, nuk ka ngritur Komisionet e Ekspertizës, të cilët miratojnë listat konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare. Nga sektori i arkivës nuk është bërë përpilimi i pasqyrës çelëse të dosjeve për vitin pasardhës, veprime në kundërshtim me nenet nr. 5, nr. 6 dhe 7, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017. Mos përgatitja e listës së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare, rrit riskun e asgjësimit të tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.12, faqe 349 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

36.1.Rekomandim: Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të merren masa që në të ardhmen, të bëhet ngritja e Komisionit të Ekspertizës, për realizimin e listave konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare, si dhe përpilimin e pasqyrës çelëse të dosjeve për vitin pasardhës.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Grupi i Komisionit të Ekspertizës për realizimin e listave konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve me RHK është ngritur çdo vit. Për vitin 2022 është ngritur Urdhëri i Brendshëm Nr. 477, datë 10.02.2022. Pasqyrat celëse të dosjeve për vitin 2022 janë perpiluar dhe miratuar nga Drejtori i Pergjithshem Ekzekutiv. Kopje e njësuar me origjinalin e Urdhërit 3080, date 21.08.2020 "Për ngritjen e Komisionit për vlerësimin e dokumentacionit me vlerë të rëndësisë historike kombëtare (RHK)".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

37. Gjetje nga auditimi: APD, nuk ka respektuar standardet e pozicionimit të rafteve metalike të ruajtjes së dokumenteve, nuk ka siguruar vend-ruajtjen duke e vulosur ose aktivizuar sistem elektronik mbrojtje. APD, nuk ka kryer inventarizimin e plotë të sallave të vend-ruajtjes për të parë gjendjen e njësive të ruajtjes, veprime në kundërshtim me nenin 10, pika 3, 12, pika 1, dhe 13 të VKM nr. 4, datë 19.06.2017. Mos ruajtja e dokumenteve sipas kushteve të paracaktuara rrit riskun për dëmtimin e tyre. Mos inventarizimi i plotë i sallave të vend-ruajtjeve të dokumenteve dhe mos sigurimi i tyre me elementët përkatës sjellin rritje të riskut të humbjes dhe dëmtimit të tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.12, faqe 349 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

37.1. Rekomandim: Sektori i arkivës të marrë masa për plotësimin e standardeve të sigurisë së vendruajtjeve dhe kryerjen e inventarizimit të plotë të sallave të vend-ruajtjes.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Per zyren e Arkives, sipas rekomandimeve te KLSH procedurat e blerjes jane realizuar per:
- Nje aparat, i cili thith lageshtine ne ambientet e Arkives
- Blerja e nje dylli qe vulos deren e jashtme te kesaj zyre

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

38. Gjetje nga auditimi: APD ka realizuar prokurimin me objekt "Pjesë këmbimi për skafin Ranieri dhe skafin Merkuri 90 të polumbarëve të FSPD-së" dhe prokurimin me objekt "Blerje koron-pinion për vinçin MHC 5150 model Terex", nga ku është konstatuar se procedurat e marrjes në dorëzim janë kryer në mungesë të certifikatave të origjinës së mallit, si dhe për prokurimin me objekt "Materiale Bateri", Drejtoria e Divizionit Teknik nuk i është drejtuar magazinës së APD-së, për mallrat e prokuruara nëse ka pasur gjendje në magazinë. Veprime në

kundërshtim me shkronjën c, të pikës 25 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në institucionet publike", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

38.1. Rekomandim: Në të gjitha rastet të merren masa nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim, që të mos pranohet malli i prokuruar, nëse nuk paraqitet Certifikata e origjinës së mallit. Të merren masa që në të gjitha rastet, Drejtoritë ti drejtohen magazinës së Autoritetit Portual Durrës nëse ka gjendje të mallrave që do të prokurohen.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Referuar disa procedurave të marra me përzgjedhje rezulton se ky rekomandim është realizuar pasi janë paraqitur Certifikata e origjinës së mallit, gjithashtu i janë drejtuar magazinës së Autoritetit Portual Durrës nëse ka gjendje të mallrave që do të prokurohen.

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

39. Gjetje nga auditimi: Këshilli Drejtues në vitin 2020, ka aprovuar leje dhe licenca për riparim anijesh në territorin e APD-së, kur licencimi i OE që kryejnë aktivitetet përkatëse, vlerësohet dhe aprovohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Vendimi Qarkullues i KD nr. 26, datë 16.09.2020, *"Për miratimin e rregullores për lejet dhe autorizimet në Portin e Durrësit", ku përfshihet licencimi për riparim anijesh në territorin e APD-së*, është në kundërshtim me ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009,*"Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë"*, nenet 18-20 dhe Udhëzimin nr. 2565, datë 23.05.2016 *"Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve portuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

39.1. Rekomandim: Të merren masa nga Këshilli Drejtues që në rregulloret dhe vendimmarrjet e tij, të ushtrojë aktivitetin brenda kompetencave ligjore përkatëse.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Rekomandim për tu ndjekur në vijimësi.
Lidhur me këtë rekomandim zbatimi i tij do të kontrollohet në auditimin e ardhshëm.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

40. Gjetje nga auditimi: Procedura e kryer për miratimin e tarifave administrative për pajisjen me leje ose autorizim, zhvilluar në vitin 2020, relacioni dhe projekt vendimi i propozuar për miratim në Këshillin Drejtues, është paraqitur pa kryer asnjë analizë ekonomiko-financiare, si dhe propozimi për tarifat nuk është dërguar në Këshillin Konsultativ. Tarifat e propozuar janë *1000 €/në vit* për pajisje me autorizim për shërbimet portuale në territorin/ambientet e APD-së dhe *100 €/në vit* për pajisjen me leje për shërbimet portuale në territorin/ambientet e APD-së, të cilat janë miratuar nga KD me Vendimin Qarkullues nr. 28, datë 16.09.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

40.1. Rekomandim: Të merren masa që në të gjitha rastet që vendosen tarifa të reja nga ato të mëparshmet, pas kryerjes së analizave ekonomiko-financiare të merret mendimi i Këshillit Konsultativ dhe miratimi nga të dy Ministritë përkatëse ku dalin me një udhëzim të përbashkët.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
APD i është drejtuar Këshillit Konsultativ mbi rishikimin e librit të tarifave, mbledhje e cila është mbajtur me datën 12.05.2022 ku edhe janë miratuar të gjitha ndryshimet në librin e tarifave dhe këto ndryshime i janë propozuar KD për miratim.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

41. Gjetje nga auditimi: Në procedurën për miratimin e lejeve dhe autorizimeve iniciuar me urdhrin nr. 3760, datë 08.10.2020 *"Mbi krijimin e komisionit për miratimin e lejeve dhe autorizimeve në Autoritetin Portual Durrës",* u konstatuan parregullsi në vlerësimin e OE të klasifikuar fitues, nga komisioni përkatës.
Referuar rregullores së miratuar me Vendimi Qarkullues të KD nr. 26, datë 16.09.2020, OE fitues nuk përmbush kriteret si përvoja për punë të ngjashme, nuk ka paraqitur punime apo eksperienca të ngjashme në fushën e ngarkim shkarkimit, nuk e ka objekt të aktivitetit në QKB shërbimin e ngarkim/shkarkimit. Asnjë nga mjetet apo automjetet e listuara nga OE nuk mund të kryej shërbimin e ngarkim shkarkimit të kontejnerëve, pasi nga të dhënat e tyre ato nuk përshtaten për këtë shërbim, ato janë automjete që përdorën për transport inertesh, dhe nuk kanë tonazhin e duhur. Komisioni i ngritur për miratimin e lejeve dhe autorizimeve nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë mbi dokumentacionin e OE duke e vlerësuar me pikët maksimale dhe shpallur fitues.

Lloji i Shërbimit	Oferta e OE B.I. SHPK (me TVSH)	Tarifat ekzistuese të APD	Diferenca ofertë/tarifë ekzistuese
Mbushje Kontejneri 20 feet	144€	78€	+65€
Zbrazje Kontejneri 20 feet	144€	78€	+65€
Mbushje Kontejneri 40 feet	180€	103.2€	+76€
Zbrazje Kontejneri 40 feet	180€	103.2€	+76€

Nga krahasimi i tarifave të aplikuara më parë nga APD dhe tarifat e ofertës së pranuar nga OE BE-IS SHPK, rezulton që tarifat e propozuara të aplikohen nga OE janë më ë larta se tarifat e aplikuara nga APD.
Për shërbimet Slokers, Mallra Gjeneralë, Mallra Rifurxho, etj, Transport Cargo brenda dhe jashtë hapësirës territoriale të Portit të Durrësit dhe Lashing-Unlashing, OE *"B.I."* ShPK nuk ka paraqitur tarifat që do aplikojë për këto shërbime, dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka argumentuar dhe dokumentuar vlerësimin në mënyrë individuale për këtë kriter, veprim në kundërshtim me rregulloren për lejet dhe autorizimet në Portin e Durrësit, miratuar me Vendimin Qarkullues të KD nr. 26, datë 16.09.2020 dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004, *"Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij"*, neni 9, *Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues*, pikat 9-13. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
41.1 Rekomandim: Të merren masa që në çdo rast, Komisioni i Autorizimeve të argumentojë dhe dokumentojë vlerësimin në mënyrë individuale për çdo kriter që kërkohet ndaj Operatorëve konkurrues.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Komisioni i Autorizimeve nuk argumenton dhe dokumenton vlerësimin në mënyrë individuale për çdo kriter që kërkohet por Komisioni jep vlersimin mbi OE në mënyrë kolegjiale.
Zbatimi të rekomandimit: Pa Zbatuar.

42. Gjetje nga auditimi: Midis Autoriteti Portual Durrës dhe OE "B.I." SHPK është lidhur kontrata me nr. 4421/1, 03.12.2020, me afat 5 vjeçar dhe objekt *"Shërbimin Logjistik (Slokers/Ngarkim/Shkarkim Automjetesh/Mallra Gjenerale/Mallra Rifurxho/Transport Cargo, etj) brenda/jashtë hapësirës territoriale të Portit të Durrësit Lashing-Unlashing"*.
Kontrata në nenin 2, pika 1, *Të drejtat dhe Detyrimet e APD-së*, nuk ka specifikuar sa m² do ti vihet në dispozicion e shoqëruar me genplan ndaj OE "B.I." ShPK për ushtrimin e aktivitetit; në nenin 2, pika 3, nuk ka ndarë hapësirat e operimit, pasi në hapësirën e dhënë në përdorim për OE B.I. rezulton që i është dhënë për operim edhe OE H.; si dhe nuk janë caktuar tarifat që do

aplikohen nga OE, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003*"Për Autoritetin Portual"*, neni 35, *Përcaktimi i tarifave*, pika 1, germa c, dhe pika 3.
Në kontratën e nënshkruar nuk parashikohet në asnjë nen apo pikë të saj ndarja e tarifës që do të ketë APD për shërbimet që do të ofrojë OE B.I. ShPK. Përpara lidhjes së kësaj kontrate këto shërbime i kryente vetë Autoriteti Portual Durrës duke aplikuar tarifat e miratuara me udhëzimin e përbashkët të dy Ministrive, dhe e gjithë tarifa e aplikuar ishte e ardhur për APD-në, me nënshkrimin e kontratës së lartë përmendur kjo e ardhur është e munguar për APD-në, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003,*"Për Autoritetin Portual"*, neni 36, *përgjegjësia për tarifat*, pika 1 dhe 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
42.1.Rekomandim: Drejtoria Ekzekutive të marrë masa për që në të gjitha rastet e lidhjes së kontratave të shërbimeve të përcaktohen qartë në kontratë se cila është përqindja që përfiton APD nga shërbimet sipas përcaktimeve në Statutin e APD-së.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Këshilli Drejtues me Vendimin nr. 04., datë 27.07.2022 *"Mbi përcaktimin e marrëdhënies financiare të APD dhe subjekteve që ofrojnë shërbime portuale në Portin e Durrësit"* është përcaktuar që do të jetë 10% mbi të ardhurat neto që ato gjenerojnë nga aktiviteti në APD.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

43. Gjetje nga auditimi: Tarifat që aplikohen nga Operatori Ekonomik janë rreth 2 herë më të larta dhe të ndryshme nga tarifat e miratuara e të publikuara në librin e tarifave që aplikohet në APD. Deri më 31.12.2020, nuk është zbatuar detyrimi i përcaktuar nga neni 2, pika 5 i kontratës për *"Shërbimin Logjistik (Slokers/Ngarkim/Shkarkim Automjetesh/Mallra Gjenerale/Mallra Rifurxho/Transport Cargo, etj) brenda/jashtë hapësirës territoriale të Portit të Durrësit Lashing-Unlashing",* duke mos u raportuar për zbatimin apo rastet e shkeljes nga ana e OE B.I. ShPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
43.1. Rekomandim: Drejtoria Ekzekutive të marrë masa për ngritjen e njësisë të monitorimit për kontratën me Operatorin Ekonomik B.I. ShPK, dhe analizuar shkeljet e kontratës të cilat janë konstatuar nga Grupi i Auditimit të KLSH-së.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Është ngritur Grupi Monitorimit të Kontratave të shërbimeve të autorizuara. Urdher 1389 date 09.04.2021 "Per monitorimin e zbatimit te Kontrates".
Kontrata me operatorin është zgjidhur me kërkesë të vetë operatorit ekonomik që ushtronte veprimtarinë sipas autorizimit për shërbimin e përpunimit të kontejnerëve me auto. Ky sherbim ofrohet nga vete APD.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

44. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Portual Durrës dhe OE B.I. SHPK kanë nënshkruar një kontratë qiraje me nr. 4552, datë 15.12.2020, me objekt "Shesh për zyrë mobile", me sipërfaqe 10 m² me tarifë 7 lekë/dita pa TVSH. Në këtë kontratë nuk ishte përcaktuar hapësira se ku do të kryhet aktiviteti i realizimit të shërbimit nga ky operator. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
44.1. Rekomandim: Drejtoria Ekzekutive të marrë masa për evidentimin e hapësirës që ka në përdorim OE B.I. ShPK dhe të procedohet me lidhjen e kontratës për hapësirat që shfrytëzon ky operator.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Kontrata me operatorin është zgjidhur me kërkesë të vetë operatorit ekonomik që ushtronte veprimtarinë sipas autorizimit për shërbimin e përpunimit të kontejnerëve me auto. Ky sherbim ofrohet nga vete APD.
Për arsyet e lartpërmëndura rekomandimi do të konsiderohet i ezauruar.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

45. Gjetje nga auditimi: Këshilli Drejtues me vendimin nr. 26 datë 20.12.2018 ka miratuar shpërblim për anëtarët e vet, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative", për vlerën totale prej 827,750 lekë të përfituar nga Këshilli Drejtues në trajtën e shpërblimit financiar për festat e fund vitit për punonjësit e APD-së dhe anëtarëve të KD. Shpërblimi për anëtarët e Këshillit Drejtues nuk provohet plotësisht bazueshmëria ligjore e përfitimit të tij, për pasojë grupi i auditimit shprehet me rezervë për përfitimin financiar të KD (organi kolegjial i APD).
-Këshilli Drejtues me vendimin nr. 24 datë 15.11.2018, ka miratuar dhënien me qiratë objektit ish Interklubi i vjetër me sipërfaqe 202.07 m² në Portin e Durrësit, kur në momentin e nënshkrimit të kontratës subjekti O. I. ka pasur një debi ndaj APD, në vlerën 1,975,780 lekë. Pavarësisht mos respektimit të kontratës së mëparshme nga subjekti, KD ka vendosur për rinovimin e kontratës me këtë subjekt për një afat 10 vjeçar, si dhe nuk i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për miratimin e dhënies me qira të 202.07 m² veprim në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".
-Këshilli Drejtues me vendimin nr. 24 datë 12.12.2019 ka vendosur rinovimin e kontratës me shoqërinë "A. S.C. sh.p.k". Këshilli Drejtues nuk ka marrë parasysh kërkesat dhe relacionet nga Drejtoria Ekzekutive për problematikat e hasura me këtë shoqëri dhe ka vendosur rinovimin e kontratës me shoqërinë për një periudhë 10 vjeçare.
-Këshilli Drejtues me vendimin nr. 06 datë 30.01.2019 ka vendosur për një ndryshim në plan biznesin ekonomik financiar të APD-së për vitin 2019, akti i miratuar pa një relacion nga Drejtoria Ekzekutive për qëllimin e këtij ndryshimi, veprim në kundërshtim me nenin 14 të rregullores së brendshme të KD të APD-së, si dhe për vitin 2019, nuk është mbledhur për një periudhë prej 4 muaj, veprim i cili është në kundërshtim me ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual", neni 21, pika 1 "Këshilli Drejtues, si rregull, mblidhet 1 herë në tre muaj".
-Këshilli Drejtues me vendimin nr. 12, datë 02.07.2020 ka vendosur miratimin e dhënies së huas nga APD për Portin Detar Vlorë SHA në shumën 50,000,000 lekë pa interes dhe me një afat kthimi të shumës në 2 vjet nga disbursimi i shumës. Miratimi nga KD është bërë në kushtet kur APD ka propozuar që afati për kthimin e huadhënies të jetë 1 vit nga disbursimi i shumës, pra afati i kthimit të shumës është ndryshuar nga KD pa një relacion shpjegues nga 1 vit i propozuar nga APD në 2 vjet. Gjithashtu u konstatua se nuk ka vendim nga Ministri i MIE për dhënien e kësaj huaje, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003.
-Këshilli Drejtues me vendimin qarkullues nr. 28, datë 16.09.2020, "Miratimin e tarifave administrative për pajisjen me leje ose autorizim për subjektet për Shërbimet Portuale", ka vendosur miratimin e tarifave administrative për pajisjen me leje ose autorizim për subjektet për shërbimet portale, vendim i pa dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku të dyja Ministritë të dilnin me një udhëzim të përbashkët për zbatim, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003, si dhe relacioni dhe projekt vendimi i propozuar në KD për miratim, është pa asnjë analizë ekonomiko financiare, dhe propozimi për tarifat e lartë përmendura nuk është dërguar në Këshillin Konsultativ, veprim në kundërshtim me nenin 16 pika "a" të ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

45.1. Rekomandim nr.1: Këshilli Drejtues të marrë masa që shpërblimet për anëtarët e tij ti propozohen Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për miratim pasi Këshilli Drejtues nuk e gëzon të drejtën për shpërblimin e anëtarëve të tij, dhe në të gjitha rastet kur ka ndryshime në propozimet e Drejtorisë Ekzekutive, projekt vendimet të shoqërohen me relacionin shpjegues për ndryshimet e bëra.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Është dakortësuar që shpërblimet për Këshillin Drejtues mos të jepen më, e rikonfirmuar në mbledhjen e datës 27.07.2022 që në mbledhjen e rradhës KD do të dali me vendim të posaçëm.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe do të kontrollohet në auditimin e rradhës.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

45.2. Rekomandim nr.2: Këshilli Drejtues të marrë masa që në të gjitha rastet që vendosen tarifa të reja nga ato të mëparshmet, të merret mendimi i Këshillit Konsultativ dhe miratimi nga të dy Ministritë dhe daljen me një udhëzim të përbashkët për zbatim.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
APD i është drejtuar Këshillit Konsultativ mbi rishikimin e librit të tarifave, mbledhje e cila është mbajtur me datën 12.05.2022 ku edhe janë miratuar të gjitha ndryshimet në librin e tarifave dhe këto ndryshime i janë propozuar KD për miratim.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

46. Gjetje nga auditimi: Nuk është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk janë dorëzuar sipas afateve ligjore të caktuara në nenin 18, të ligjit dhe pikat nr. 4 e 6 të UMF nr. 28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se "Deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave".
-Sistemi i monitorimit për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave nuk funksionon.
-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nuk merr raporte periodike në mënyrë shkresore nga Drejtorët e Drejtorive, por vetëm nga disa sektor/drejtorie. Raportimi kryhet në formën e relacioneve, e-mail apo verbale gjatë mbledhjeve, mbi aktivitetet apo operacionet që shfaqin probleme.
-Nuk ka një procedurë të shkruar për mënyrën e komunikimit brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit, e cila duhej të ishte pjesë e rregullores së brendshme. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.
-Nuk ka regjistra risku të hartuara specifikisht për çdo drejtori.
-Mungojnë manuale të procedurave për aktivitetet operacionale dhe financiare të bazuara në harta dhe në procese pune dhe në procedurat e shkruara sipas formateve të ofruara nga manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe të miratuara nga nëpunësi autorizues.
-Nuk ka një procedurë të shkruar për përdorimin e paautorizuar të aktiveve afatgjata në APD, kërkesë e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik i ndryshuar."
-Nuk ka një rregullore të brendshme të miratuar mbi informimin dhe komunikimin në institucion.
-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 309 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

46.1.Rekomandim: Këshilli Drejtues dhe Drejtoria Ekzekutive të marrë masa për zbatimin e të gjithë komponentëve dhe kritereve ligjore të pa plotësuara.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nuk merr raporte periodike në mënyrë shkresore nga Drejtorët e Drejtorive, raportimi kryhet në formën e relacioneve, e-mail apo verbale gjatë mbledhjeve, mbi aktivitetet apo operacionet që shfaqin probleme. Këto raportime kryhen mujore dhe 3 mujore.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

47. Gjetje nga auditimi: Në dy raste nuk ka kontrata për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm midis subjekteve dhe APD-së.
APD nuk respekton kreun VI, neni 1 të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore",* për tarifimin e subjekteve që kanë ambiente ose sheshe në territorin e APD-së por tarifimi bëhet sipas tarifave të miratuara nga APD. Në ndjekjen e kontratave nuk janë mbajtur raporte periodike për ecurinë e investimeve të kryera nga ana e subjekteve të cilat operojnë në APD, duke mos administruar saktë procesin e dokumentimit të punës, veprime në kundërshtim me nenin 11, të ligjit nr 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe nenin 50 dhe 51 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
47.1. Rekomandim: Drejtoria Ekzekutive të marrë masa që për të gjitha rastet e marrjes me qira të ambienteve dhe shesheve mbi 200 m², të merret miratimi nga Ministria përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të ngrihen grupet e punës për monitorimin e kontratave për investimet e kryera nga operatorët ekonomik.
Drejtoria Ekzekutive të marrë masa për lidhjen e kontratave për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, me subjektet që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të APD.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk ka pasur kontrata mbi 200 m² gjatë kësaj periudhe, persa i përket lidhjen e kontratave për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm nga auditimi me përzgjedhje i disa praktikave rezulton se kontratat për këto dy shërbime janë lidhur rregullisht.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

48. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: "Shërbimi i Menaxhimit dhe Operimit të Terminalit të Kontejnerëve në Portin e Durrësit tek operatorë privatë të specializuar për 5 vjet" ", u konstatua se dokumentet janë kërkuar në gjuhën shqipe ose në anglisht, por anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave nuk dëshmojnë kapacitetet për vlerësimin e dokumenteve në gjuhën angleze.
Komisioni i vlerësimit të ofertave, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin, ka skualifikuar OE H. për mos plotësim të kritereve të veçanta të kualifikimit, për mos pasje të disponueshmërisë së ISO-ve, dhe OE H. për mos plotësim të pikës 3 e 6 të kapacitetit teknik mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas kritereve të veçanta të kualifikimit.
Titullari i AK e ka pezulluar procedurën pas ankesës së OE H. I. GmbH dhe H. C. duke urdhëruar ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave. KSHA më datë 27.10.2020, ka vendosur të pranojë ankesën e OE, H. C. L., duke shfuqizuar vendimin e KVO për skualifikimin dhe për rivlerësim, duke e kualifikuar këtë OE.
OE H. I., nuk duhej ri-kualifikuar nga KSHA pasi për plotësimin e pikës 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ka paraqitur si dokumente pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë, të cilat janë *jo të certifikuara nga autoritetet përkatëse, jo me pullë "apostile",* si dhe për pikën

3.6, mungon dokumentacioni për të dëshmuar kapacitetet e kërkuara në DST, duke sjellë që në fazën e parë të procedurës të ngelte vetëm një OE, veprime në kundërshtim me nenin 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

48.1.Rekomandim: Autoriteti Portual Durrës të marrë masa për trajnimin e stafit i cili angazhohet me realizimin e procedurave të prokurimit, me synimin e shpenzimit të fondeve me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet.

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Njesia e Prokurimit eshte trajnuar nga APP me legjislacionin e ri te LPP, trajnim online i organizuar nga APP.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

49. Gjetje nga auditimi: Kontrata e punimeve civile "Zbatimi i projektit të thellimit emergjent të basenit dhe kanalit hyrës në Portin Durrës", me kontraktorin "V." SHPK, me vlerë 1,180,694,037 lekë, paraqet të dhëna të pa sakta të kapacitetit të dragave, kjo bazuar në llogaritjet e kontraktorit ku dragat kanë kapacitet gërmimi ditor 22766 m^3/ditë, ndërkohë që nga llogaritjet (grupit të auditimit) kapaciteti maksimal i gërmimit është 13,950 m^3/ditë. Referuar kapacitetit ditor të dragave (kapaciteti maksimal), si dhe ditëve të punës të realizuara sipas periudhave respektive të situacioneve të certifikuara arrihet në konkluzionin se nuk ka verifikim dhe raportim të saktë të volumit të punimeve të realizuara, pavarësisht se janë realizuar batimetri për certifikimin e punimeve. Deri në momentin e auditimit punimet sipas kontratës nuk janë përfunduar. Është likuiduar vlera 770,419,541 lekë, nga vlera e kontratës në shumën 1,180,694,037 lekë, ose në masën 65 %. Në termat e kontratës është përcaktuar që volumi i gërmimeve do të përcaktohet nëpërmjet realizimit të batimetrive, në këto kushte nevojitet realizimi i një batimetrie të përgjithshme për përcaktimin me saktësi të volumeve të realizuara në fakt. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

49.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës dhe Mbikëqyrësi i Punimeve, t'i kërkojnë kontraktorit realizimin e një batimetrie të përgjithshme për punimet e realizuara për thellimin e basenit dhe rrugës së hyrjes për në port. Në këtë proces duhet të marrin pjesë edhe përfaqësues të administratës së portit, në mënyrë që të përcaktohen saktë volumet e gërmimeve të realizuara.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ne zbatim te rekomandimit dhe ne zbatim te kontrates se punimeve eshte realizuar batimetria e pergjithshme perfundimtare ku jane percaktuar volumet e sakta te germimeve te realizuara te shprehura ne situacionet perkatese.
Gjithashtu APD nepermjet shkresve drejtuar Hidrografise Shqiptare i ka kerkuar te beje dhe ato dy batimetri ne kohe te ndryshme sipas parashikimeve ligjore ne fuqi ku Sherbimi Hidrografik Shqiptar eshte i vetmi instutcion publik i miratuar per kryerje batimetrish detare.
Perpuethshmeria e dy batimetrive e lexuar ne kuota (jo ne volume sipas kontrates me V. shpk) eshte pothuajse 98% e njejte pasi duhen marre ne konsiderate dhe koha e matjeve e cila eshte e kontraktorit ne fund gushti 2021 dhe e SHHSH e nentorit 2021 dhe Janarit 2022, levizja e sedimentit ne kohe dhe marxhi i gabimit te paisjeve pasi nuk jane te njejta (lehtesisht e verifikueshme nga skeda teknike e paisjeve e cila e deklaron marzhin e gabimit si dhe deklarimet ne raportin e SHHSH protokolluar ne APD me nr.3945 prot date 16.11.2021).
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

50. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Portual Durrës më datë 01.03.2019, ka lidhur kontratën me shoqërinë Vodafone SHA, për përfitimin e shërbimit të sistemit të telefonisë. Kohëzgjatja e kontratës është 36 muaj dhe vlera totale e shpenzimit që APD detyrohet ti paguajë shoqërisë

Vodafone është 4,984,560 lekë me TVSH, brenda afatit të kontratës, për një numër 171 përdoruesish, me një vlerë shpenzimi fiks mujor prej 136,100 lekë, të cilët nuk përfshihen në vendimin nr. 6, datë 02.03.2015, të Këshillit Drejtues, ku janë përcaktuar kuotat dhe pozicionet e punës të cilat përfitojnë mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare. Në pikën 2.1, Oferta, të kontratës me V. SHA, APD, ka marrë përsipër një debi të akumuluar në shumën 350,000 lekë me tvsh, për shërbimet e komunikimeve elektronike të pashlyera, të periudhës së mëparshme. Kjo debi do të shlyet në muajin e 36 të marrëveshjes. Nga kontrata e mëparshme, konstatohet se APD, ka pasur 350,000 lekë detyrime të pambledhura nga përdoruesit e numrave të telefonisë celulare. Dhënia e garancisë ndaj shoqërisë Vodafone për mbulimin e shpenzimeve për të gjithë numrat e kontraktuar përfshirë dhe pozicionet e tjera jo të aprovuara në vendimin e KM, krijon risk për shoqërinë për efekte të mundshme ekonomike negative dhe janë në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.7.2010"Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë", i ndryshuar, neni 13. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

50.1.<u>Rekomandim</u>: Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv të marrë masa që në të ardhmen të mos jepen garanci ndaj palëve të treta, në kontrata shërbimi telefonie, për kategoritë e punonjësve të cilët nuk janë aprovuar nga Këshilli Drejtues.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Për të gjithë punonjësit që janë aktualisht në marrëdhënie pune me APD-në për ofertat e ofruara nga kompanitë telefonike/celulare kanë dhënë pelqimin me shkrim që ofertat e ofruara të mbahen nga paga mujore për llogari të kompanive. Në këtë formë APD nuk del më garant për punonjësit e vet por thjesht ofron shërbimin e mbledhjes së detyrimit dhe pagesës ndaj kompanive përkatëse për ofertat e ofruara.

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt "Pjesë këmbimi për vinçat e APD" me vlerë të kontraktuar prej 20,184,500 lekë dhe OE fitues "2. A. G." SHPK, është konstatuar se OE i shpallur fitues nuk ka respektuar kushtet e kontratës nr. 1762, datë 08.6.2020, për zërin "elektromotorë". Konkretisht rezultoi se me dokumentin nr. 1762/1, datë 22.7.2020, është bërë amendimi i kontratës, bazuar në kërkesën nr. hyrës 216, datë 22.7.2020 të OE, sipas të cilës artikujt: litar çeliku 22 mm dhe 24 mm si dhe elektromotor 9.7 kë, shoqëria prodhuese "A. G." kërkon 60 ditë për prodhimin dhe dërgimin e tyre, kjo për shkak të situatës së pandemisë Covid 19. Amendimi është bërë 1 ditë para përfundimit të kontratës.

Kërkesa i referohet dy artikujve "Litar Celiku 22 mm dhe 24 mm", të kompanisë "A. G.", por nuk ka asnjë argumentim për artikullin e tretë "elektromotor 9.7 kŵ", i cili sipas ofertës teknike është i markës "Evig" dhe është ofertuar për vlerën prej 2,400,000 lekë.

Sa sipër, sjellja me vonesë e këtij produkti nga OE "2. A. G." SHPK dhe mos llogaritja e afateve të dërgimit të mallit nga AK, është në shkelje të kushteve të kontratës dhe konkretisht nenit 24 "Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar", pika 24/1/a.

Kontrata nr. 1762, datë 08.6.2020, përfundonte afatin e zbatimit më datë 23.7.2020, ndërsa produkti i sjellë nga OE është dorëzuar më datë 10.08.2020, ose 17 ditë me vonesë, duke mos ju llogaritur penaliteti për çdo ditë vonesë, në vlerën prej 163,000 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga mos respektimi i kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>1.1.Rekomandim</u>: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, *duke e konsideruar si mos respektim i kushteve të kontratës* vonesat në lëvrimin e mallit, të marrë të

gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej **163,000 lekë** për penalitetet e pa vendosur ndaj kontraktorit "2. A. G." SHPK, për dorëzimin e mallit me 17 ditë vonesë.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm
Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga ana e subjektit Autoriteti Portual Durrës rezulton se APD ka njoftuar OE "2. A. G." SHPK me shkresën nr. 323 prot., datë 28.01.2022 me lëndë "Njoftim mbi pagimin e shumës **163,000 lekë** në favor të Autoritetit Portual Durrës". Me shkresën nr. 2618 prot., datë 22.07.2022, Autoriteti Portual Durrës i është drejtuar me kërkesë padi kundrejt OE "2. A. G." SHPK pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës.

Rekomandimi do të konsiderohet në proces.
Zbatimi të rekomandimit: Në proces.

2. Gjetje nga auditimi: Kontrata e qirasë nr. 4299/1 prot., datë 11.01.2018, nënshkruar me subjektin "M. A. shpk", me objekt dhënien me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallra gjeneral, 200 m² me vlerë 4 lekë m²/ditë, pa TVSH, vijuar pa u mbajtur raporte periodike për ecurinë e investimeve të kryera nga ana e subjektit, sipas plan biznesit të përcaktuar në procedurën e marrjes me qira, veprim në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", kreu VI, neni 1. Në terren, ambienti dhe sheshi i dhëna me qira, nuk shfrytëzohet 200 m² sipas kontratës së qirasë, por subjekti shfrytëzon 657 m² brenda sheshit, pa nënshkruar kontratë me APD dhe pa u tarifuar. Për sheshin prej 457 m² për të cilin nuk ka kontratë me APD-në, të ardhurat e munguara nga shfrytëzimi i këtij sheshi për periudhën objekt auditimi janë në vlerën 1,334,440 lekë pa TVSH. Mos respektimi i kontratës dhe mos tarifimi për sipërfaqen tepër është pasojë e mos raportimit të inspektorëve të inspektimit në terren për ambientet e dhëna me qira subjekteve dhe drejtorisë për monitorimin e kontratave, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011*"Për Menaxhimin e Njësive të Sektorit Publik"*, Përgjegjësia e nëpunësve të autorizuar të gjithë niveleve të njësive publike, pika 7, dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010*"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* Neni 9, *" Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues",* Neni 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 310 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1 Rekomandim: Nga Autoriteti Portual Durrës, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 1,334,440 lekë** nga subjekti ***"M. A. shpk"***, për llogari të APD.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga ana e subjektit Autoriteti Portual Durrës rezulton se APD ka njoftuar OE "M. A." SHPK me shkresën nr. 324 prot., datë 28.01.2022 me lëndë "Njoftim mbi pagimin e shumës 1,334,440 lekë në favor të Autoritetit Portual Durrës". Me shkresën nr. 2618 prot., datë 22.07.2022, Autoriteti Portual Durrës i është drejtuar me kërkesë padi kundrejt OE "M. A." SHPK pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor, Durrës.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Zbatimi të rekomandimit: Në proces.

3. Gjetje nga auditimi: Kontrata e shërbimeve konsulente "Shërbime konsulence për reformën rregullatore, nevojat e sigurisë dhe hartimin e Masterplanit Strategjik 2030", nënshkruar me OE "E. & Y." GmbH – Shtutgart, me vlerë 73,740,000 lekë, me afat për dorëzimin e masterplanit deri me datë 02.12.2020, ndërsa i dy shërbimeve të tjera deri me datë 02.01.2020 dhe likuiduar deri në momentin e auditimit për vlerën 200,792 euro, pagesë që i përket realizimit të komponentit të hartimit të masterplanit, nuk është dorëzuar brenda afatit kontraktor.
Kontraktori me shkresë e protokolluar në APD me nr. 4085/2 prot., datë 31.12.2020, ka kërkuar shtyrjen e afatit të shërbimit për 60 ditë, me argumentimin se: "Pandemia Covid-19, ka shkaktuar vonesa të papritura, duke përfshirë kufizime në mundësinë për të udhëtuar që ka kushtëzuar punën në distancë të ekipit. Këto rrethana kanë ndikuar në aftësinë e ekipit për të përfunduar dy zërat e kontratës. Kontraktori e konsideron ketë fakt si forcë madhore.
Kontraktori nuk ka përmbushur detyrimet për njoftimin menjëherë me shkrim, por 2 ditë para përfundimit të afatit kontraktor për dorëzimin e shërbimit, ose 58 ditë nga nënshkrimi i kontratës; nuk ndodhet në kushtet e forcës madhore, pasi pandemia ka ndodhur më parë nënshkrimit të kontratës; si dhe nuk ka paraqitur me detaje ose dokumentacion mbështetës për pretendimet e tij, veprime në kundërshtim me Kontratën e Shërbimeve, neni 18, pika 5, dhe neni 24, pika 2.
Bazuar në Kontratën e Shërbimeve Konsulente, neni 19 "Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar", **Kontraktori duhet të penalizohet për vonesa për një periudhë 30 ditë me vlerë 5,882,095** lekë (30 ditë (vonesa deri me datë 02.02.2021) x 4/1000 (koeficienti sipas kontratës) x 49,042,460 lekë (vlera e shërbimit të pa realizuar akoma) = 5,882,095 lekë) 2.c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1.Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, të marrë masa për zbritjen nga situacioni pasardhës dhe situacion përfundimtar të **vlerës 5,882,095 lekë**, Kontraktorit "E. & Y." GmbH– Shtutgart, llogaritur si penalitet për dorëzim të vonuar të produktit (masterplanit).

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Rekomandimi do të konsiderohet i pazbatuar.
Operator ekonomik i huaj me reputacion nderkombetar te cilit i eshte shtyre afati kontrates, shtyrje qe nuk eshte marre ne konsiderate KLSH, por qe nuk mund te kerkohet kamatvonese persa kohe ka amendim kontrate per shtyrje afati e gjithashtu subjekti ka seli jashte vendi ne Gjermani.
Zbatimi të rekomandimit: Pa zbatuar.

3.2. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, të marrë masa për përllogaritjen dhe zbritjen e penaliteteve të mëtejshme deri në përfundim të kontratës.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Operator ekonomik i huaj me reputacion nderkombetar te cilit i eshte shtyre afati kontrates, shtyrje qe nuk eshte marre ne konsiderate KLSH, por qe nuk mund te kerkohet kamatvonese persa kohe ka amendim kontrate per shtyrje afati e gjithashtu subjekti ka seli jashte vendi ne Gjermani.
Rekomandimi do të konsiderohet Pa zbatuar.

Zbatimi të rekomandimit: Pa zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit "Shërbimi i pastrimit të Akuatoriumit, për tre vite", Komisioni i përllogaritjes së fondit limit ngritur me Urdhërin nr. 2132, datë

19.06.2019, në përcaktimin e fondit limit me vlerë 23,239,185 lekë, është referuar në studimin e tregut, pa marrë në konsideratë kontrata e realizuar nga AK për vitin 2018 (me vlerë të prokuruar 7,500,000 lekë, dhe kontratë nënshkruar me vlerë 7,450,000 lekë, kontratë e cila përcakton shërbimin për një periudhë 1 vjeçare), me arsyetimin për të qenë sa më aktual me çmimin e tregut. Për vitin 2019, kontrata është parashikuar për një afat 3 vjeçar dhe fondi limit është përcaktuar mbi bazën vjetore e shumëzuar për tre vite. Theksojmë se shërbimi i përcaktuar për prokurim për vitin 2019 është i njëjtë me shërbimin e realizuar për vitin 2018. Fondi limit sipas kësaj procedure është përllogaritur me vlerë 23,239,185 lekë (7,746,395 lekë mbi bazë vjetore. Kontrata është nënshkruar me vlerë 23,200,000 lekë (7,733,333 lekë mbi bazë vjetore). Diferenca me vlerë 670,000 lekë [(7,733,333 lekë – 7,500,000 lekë) x 3 vite], konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e APD dhe veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59 2.c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, të marrë masa për shqyrtimin e përllogaritjes së fondit limit me mangësi dhe të fillojë procedurat për arkëtimin e **vlerës 670,000 lekë** nga z. E. Sh., z. O. M. dhe znj. H. M., shkaktuar si pasojë e mos dokumentimit të fondit limit.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Është analizuar rasti dhe eshte konkluduar qe ka efekt negativ financiar por jo dem ekonomik. Per me teper qe ky efekt nuk mund ti atribuohet punonjesve Eshte procedura konkuruese qe percakton cmimin e kontrates pavaresisht fondit limit te procedures se prokurimit.
Rekomandimi do të konsiderohet i pa marrë në konsideratë dhe do të konsiderohet i pazbatuar.

Zbatimi të rekomandimit: Pa zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Kontrata e punimeve civile "Prishje e godinave të amortizuara plotësisht në zonën e ish peshkimit dhe magazinën 4-5", është nënshkruar me nr. 3847 prot., datë 15.10.2020, me Kontraktorin "A.-A." SHPK, me vlerë 9,858,655 lekë. Për ndryshimet e volumeve është hartuar një relacion teknik shpjegues nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi i punimeve. Në lidhje me volumet sipas zërit 2 "Prishje soleta beton arme" argumentimi i rritjes së sasisë argumentohet: "*Peshën më të madhe të mos llogaritjes së saktë të këtij volumi e zë soleta beton arme tek magazinat 4 dhe 5. Nga matjet faktike rezultoi se trashësia e saj është e barabartë me 18 cm, nga të cilat 12 cm i përbën soleta bazë dhe 6 cm i janë shtuar nga riparimet e bëra ndër vite për mirëmbajtjen e saj*".
-Në zërin "Prishje soleta beton arme", nuk është marrë në konsideratë fakti se ndërtesa (magazinat 4 dhe 5) janë shembur si pasojë e tërmetit dhe volumi kryesor që ka të bëjë më prishjen është një proces i ndodhur si pasojë e tërmetit.
- Nuk mund të vërtetohet fakti se mbi soletat ekzistuese (pavarësisht ndonjë riparimi të vogël) soleta është mbingarkuar me një shtresë 6 cm.
- Nuk është marrë në konsideratë se shtresa 6 cm (nëse është realizuar mbi soletën e objektit) është shtresë betoni i varfër dhe jo beton arme.
- Nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, referuar arshivës në këtë sistem, rezulton se për rikonstruksionin e soletës së këtyre magazinave, është ndërhyrë vetëm në vitin 2012 për heqjen e hidroizolimit ekzistues dhe vendosjen e një shtrese të re për të gjithë sipërfaqen në sasinë 6000 m^2. Nuk rezultojnë prokurime të bëra për ndërhyrjen në soletën e magazinave.
Sa më sipër, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve dhe komisionit i cili ka dhënë miratimin për ndryshimin, çmimi që duhet të aplikohej duhet të ishte sipas zërit 7 të preventivit "Prishje shtresa betoni" i cili është ofertuar me çmim 1,000 lekë për m^3 dhe jo sipas zërit 2 "Prishje

soleta beton arme", i cili është ofertuar me çmim 2,934 lekë për m^3. Sasia e përfshirë si shtresë beton arme, ndërkohë që është shtresë vetëm betoni është me volum 424.9 m^3. Kjo sasi duhet të likuidohej me çmim 1,000 lekë për m^3 dhe jo 2,934 lekë për m^3. **Vlera 821,756 lekë [424.9 m^3 (2,934 – 1000)] është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1.Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës të marrë masa për zbritjen e vlerës **821,756 lekë**, nga garancia e punimeve, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "A.-A." SHPK, për referencë të gabuar të çmimit të zërit të punimeve të betonit.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga ana e subjektit Autoriteti Portual Durrës rezulton se APD ka njoftuar OE "A. A." SHPK me shkresën nr. 325 prot., datë 28.01.2022 me lëndë "Njoftim mbi pagimin e shumës 821,756 lekë në favor të Autoritetit Portual Durrës". Me shkresën nr. 2622 prot., datë 22.07.2022, Autoriteti Portual Durrës i është drejtuar me kërkesë padi kundrejt OE "A.A." SHPK pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Zbatimi të rekomandimit: Në proces.

6. Gjetje nga auditimi: Kontrata e punimeve civile "Rikonstruksion i magazinave 4 dhe 5, terminali perëndimor, viti 2019", është nënshkruar me nr. 1267 prot., datë 04.04.2019, me OE "V. K." SHPK, me vlerë 23,401,447 lekë. Nga mbikëqyrësi i punimeve është bërë një relacion teknik shpjegues në lidhje me disa zëra të punimeve, duke bërë bilancin e punimeve që kërkojnë shtesa volumi, ose zëra të rinj dhe punime të cilat u zvogëlohet volumi. Vlera e punimeve pas rakordimeve përkatëse është përcaktuar 19,500,887 lekë.
Në lidhje me zërat e rinj të punimeve rezulton se zëri nr. 8 "Bojë vaji në sipërfaqe metalike" me çmim njësi 382 lekë për m^2, është zëvendësuar me zërin "Lyerje me bojë bikomponente", me çmim 1,198 lekë për m^2. Bazuar në analizën e çmimit sipas preventivit fillestar 2.204, si dhe duke konsideruar çmimin e bojës bikomponente 800 lekë/kg (sipas analizës së manualit të çmimeve të ndërtimit nr. 3, viti 2015 (nr. 3.An.127), çmimi i llogaritur për këtë zë punimi rezulton 605 lekë/m^2. **Vlera 208,759 lekë** [(1,198 – 605) x 352.1 m^2], është certifikuar padrejtësisht.
Me datë 22.10.2020, u bë verifikimi i realizimit të punimeve sipas pikës 7 të preventivit "Konstruksione metalike të thjeshta", vetëm sa i përket dimensioneve, pasi sasia ishte e pa mundur të verifikohej. Në preventivin fillestar ka qenë parashikuar vendosja e 152 konstruksioneve me tub çeliku me diametër 150 mm dhe spesor 5 mm. Nga verifikimi rezulton se ato janë realizuar me tub metalik me diametër 127 mm dhe trashësi të parapetit të tubit 3 mm, në sasinë 154 copë. Për një konstruksion (kalunë), gjatësia e tubit të vendosur është 5.6 metër. Nga llogaritjet rezulton se konstruksioni i vendosur është me peshë 9.2 ton[(51.3 kg për copë x 154 copë) + 308 pllaka mbështetëse (0.25 cm x 0.25 cm x 0.08 cm]. Theksojmë se për këtë zë punimi është certifikuar sasia 11.62 ton. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është certifikuar më tepër (padrejtësisht) **vlera 288,713 lekë** [(11.62-9.2) x 119,303 lekë/ton]. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1.Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës të marrë masa për zbritjen nga garancia e kontratës të vlerës **497,472 lekë**, Kontraktorit "V. K." SHPK, si përfitim i padrejtë nga mangësitë në hartimin e analizave të çmimeve dhe diferencë në sasinë e punimeve.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Vlera e lënë si dëm ekonomik është vlerë që nuk i është likujduar operatorit ekonomik e për rrjedhojë nuk mund ti kërkohet.
Rekomandimi do të konsiderohet i ezauruar.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2019 janë dhënë shpërblime në masën e një page mujore për punonjësit e APD në vlerën 41,778,934 lekë, me vendimin nr. 4885, datë 21.12.2020. Dhënia e shpërblimeve nuk është bazuar në performancën e punonjësve dhe nuk është miratuar nga Ministri përkatës.
Komisioni i ngritur për propozimin për shpërblim, në relacionin me nr. 502 Prot., datë 07.12.2020, drejtuar drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv, ka propozuar për dhënien e shpërblimit për të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune, në datën e hartimit të relacionit. Nga shqyrtimi i punonjësve që kanë marrë shpërblim për vitin financiar 2019, u konstatua se 140 punonjës kanë marrë shpërblim të plotë një pagë, kur janë në kushtet e mos përputhjes së kritereve për shpërblim pasi ose kanë kohë pjesore pune në periudhën 2019 ose kanë filluar punë në vitin 2020. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6 pika 1/a, dhe me Vendimin e KD nr. 9, datë 18.03.2016 "Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimeve suplementare dhe të ndihmave financiare në APD", neni 4 "Përfitimi i shpërblimit", pika 4.1, dhe me Vendimin e KD nr. 9, datë 18.03.2016 "Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimeve suplementare dhe të ndihmave financiare në APD", neni 6.
Vlera e shpërblimit **10,547,130 lekë** është vlerë e përfituar padrejtësisht nga punonjësit të cilët nuk kanë punuar ose kanë punuar pjesërisht në vitin 2019, dhe jo e justifikuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandim: Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të merrin masa që në të ardhmen, dhënia e shpërblimeve vjetore të akordohet bazuar në plotësimin e kritereve e aprovuara. Lidhur me vlerën **10,547,130 lekë**, detajuar në aneksin nr. 3, të merren masa për tu arkëtuar nga punonjësit që e kanë përfituar në mënyrë jo të drejtë dhe jo të merituar shpërblimin.
Deri më 31.12.2021

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Rekomandimi është marrë në konsideratë në dhënien e shpërblimeve në vijim. Për realizimin e këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv do të nxjerrë një urdhër ku të ngrihet një grup pune për verifikimin e punonjësve që kanë perfituar nga shperblimi i dhënë dhe që janë në marrëdhënie pune me APD-n, pas verifikimit do të procedohet për arkëtimin e vlerës dhe realizimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

8. Gjetje nga auditimi: Këshilli Drejtues me vendimin nr. 26, datë 20.12.2018, "Për dhënien e shpërblimit për Festat e fund vitit për punonjësit e Autoritetit Portual Durrës, dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues", ka miratuar shpërblim për anëtarët e vet, në vlerën 827,750 lekë, dhe për vitin 2019 shpërblim për vlerën 373,180 lekë, miratuar me urdhrin nr. 4446, datë 07.12.2020, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative" dhe ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, neni 5 "Interesat private", pika 1/a, shpërblimi financiar për të cilin nuk provohet bazueshmëria ligjore e përfitimit të tij. Vlera 1,200,900 lekë përbën vlerë të përfituar padrejtësisht nga anëtarët e Këshillit Drejtues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrë masa për arkëtimin e përfitimeve të padrejta nga Këshilli Drejtues, në vlerën **1,200,900 lekë**, për periudhën 2018-2019.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Është dakortësuar që shpërblimet për Këshillin Drejtues mos të jepen më, e rikonfirmuar në mbledhjen e datës 27.07.2022 që në mbledhjen e rradhës KD do të dali me vendim të posaçëm gjithashtu edhe për vlerën objekt rekomandimi.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe do të kontrollohet në auditimin e rradhës.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

9. Gjetje nga auditimi: Kontrata e qirasë, nr. 1259/3, datë 11.06.2019, lidhur me subjektin *"I. D.*" SHPK, me objekt "*Marrjen me qira të sheshit për zyrë mobile* për ushtrimin e aktivitetit të Bar-Kafe 200m²", me vlerë 7 lekë m²/ditë pa TVSH, është në mungesë të genplanit bashkangjitur se ku ndodhet sheshi i marrë me qira, veprim në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014,*"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërorë"*, kreu II, pika ç. Kontrata midis subjektit dhe APD-së ka përfunduar dhe nuk është ndërmarrë asnjë hap ligjor për rinovimin e kontratës ose për ndalimin e aktivitetit të subjektit Infotech në territorin e APD, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 *"Për Autoritetin Portual"*.
Nga verifikimi në terren i ambienteve dhe shesheve, u konstatua se subjekti *"I.D."* nuk shfrytëzon 200 m² sipas kontratës së qirasë, por shfrytëzon dhe 45m² të tjera brenda sheshit por pa nënshkruar kontratë dhe pa u tarifuar, veprim i cili ka sjellë të ardhura të munguara për APD në **vlerën 229,950 lekë pa TVSh**, *vlerë e cila është përllogaritur për periudhën objekt auditimi.*
Nga APD nuk është kryer asnjë verifikim në terren për këtë subjekt nëse po respekton kushtet e kontratës së nënshkruar, veprim në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014, kreu VI, neni 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 310 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandim: Autoriteti Portual Durrës, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **229,950 lekë** nga subjekti *"I. D."*.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nga dokumentacioni i vendusur në dispozicion nga ana e subjektit Autoriteti Portual Durrës rezulton se APD ka njoftuar OE "I.D." SHPK me shkresën nr. 320 prot., datë 28.01.2022 me lëndë "Njoftim mbi pagimin e shumës 229,950 lekë në favor të Autoritetit Portual Durrës". Me shkresën nr. 2623 prot., datë 22.07.2022, Autoriteti Portual Durrës i është drejtuar me kërkesë padi kundrejt OE "I.D." SHPK pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Zbatimi të rekomandimit: Në proces.

10. Gjetje nga auditimi: Kontrata e qirasë, nr. 37, datë 09.01.2011, lidhur me subjektin *"M.A." SHPK*, me objekt "Dhënien me qira afatgjata të shesheve 830 m²", me vlerë 7.3 lekë m²/ditë, pa TVSH, është realizuar pa u mbajtur raporte periodike për ecurinë e investimeve të kryera nga ana e subjektit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014, kreu VI, neni 1.
Nga verifikimi në terren i ambienteve dhe shesheve, u konstatua se subjekti *"M. A. shpk"* nuk shfrytëzon 830 m² sipas kontratës së qirasë, por shfrytëzon dhe 144 m² të tjera brenda sheshit, por pa nënshkruar kontratë dhe pa u tarifuar, veprim i cili ka sjellë të ardhura të munguara nga shfrytëzimi i këtij sheshi vlerë e cila është përllogaritur për periudhën objekt auditimi është në

vlerën 766,252 lekë pa TVSH, shkaktuar si pasojë e mos raportimit të inspektorëve të inspektimit në terren për ambientet e dhëna me qira subjekteve dhe drejtorisë për monitorimin e kontratave, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011*"Për Menaxhimin e Njësive të Sektorit Publik"*, Përgjegjësia e nëpunësve të autorizuar të gjithë niveleve të njësive publike, pika 7, dhe ligjin nr. 10296, date 08.07.2010*"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* neni 9*, "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues",* dhe neni 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 310 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandim: Autoriteti Portual Durrës, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 766,252 lekë** nga subjekti *"M.A."*.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Nga dokumentacioni i vendusur në dispozicion nga ana e subjektit Autoriteti Portual Durrës rezulton se APD ka njoftuar OE *"M. A."* SHPK me shkresën nr. 322 prot., datë 28.01.2022 me lëndë "Njoftim mbi pagimin e shumës 766,252 lekë në favor të Autoritetit Portual Durrës". Me shkresën nr. 2619 prot., datë 22.07.2022, Autoriteti Portual Durrës i është drejtuar me kërkesë padi kundrejt OE *"M.A."* SHPK pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Zbatimi të rekomandimit: Në proces.

11. Gjetje nga auditimi: Kontrata e qirasë nr. 976/2, datë 04.01.2019, lidhur me subjektin *"O.I.",* me objekt "Dhënien me qira të ambienteve të portit 202.2 m²", me vlerë 1000 lekë m²/muaj, pa TVSH dhe kontrata e qirasë nr. 977/2, datë 04.01.2019, nënshkruar me subjektin *"O.I.",* me objekt "Dhënien me qira të ambienteve të portit 12 m²", me vlerë 1000 lekë m²/muaj, pa tvsh, nuk nuk shfrytëzohet për ambientin 214.2 m², por shfrytëzohet 219.21 m², nga ku diferenca prej 5 m² nuk është faturuar për të gjithë periudhën objekt auditimi. Nga mos faturimi i kësaj sipërfaqe të ardhurat e munguara janë në vlerën 120,000 lekë pa tvsh.

Në momentin e nënshkrimit të kontratës subjekti O. I. ka pasur një debi në vlerën 1,975,780 lekë, por pavarësisht mos respektimit të kontratës së mëparshme KD ka vendosur për rinovimin e kontratës me këtë subjekt, si dhe KD nuk i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për miratimin e dhënies me qira të 202.07 m² *veprim në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*". *(Më hollësisht trajtuar në 2.9, faqe 310 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandim: Autoriteti Portual Durrës, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 120,000 lekë** nga subjekti *"O. I."*.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Nga dokumentacioni i vendusur në dispozicion nga ana e subjektit Autoriteti Portual Durrës rezulton se APD ka njoftuar OE *"O.I."* SHPK me shkresën nr. 321 prot., datë 28.01.2022 me lëndë "Njoftim mbi pagimin e shumës 120,000 lekë në favor të Autoritetit Portual Durrës". Me shkresën nr. 2620 prot., datë 22.07.2022, Autoriteti Portual Durrës i është drejtuar me kërkesë padi kundrejt OE *"O. I."* SHPK pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Zbatimi të rekomandimit: Në proces.

12.Gjetje nga auditimi: Automjeti me targë AA438JV, në dispozicion të z. A.Sh. ka harxhuar 6,896 litra karburant të pajustifikuara në vlerën 930,960 lekë. Plotësimi dhe nënshkrimi i

dokumentacionit justifikues, si urdhër shërbime, fletë udhëtimi, përmbledhëse e harxhimit të karburantit, nuk janë nënshkruar nga drejtuesi i mjetit, por nga persona të tjerë. Lëvizjet e njëkohshme, paralele dhe të pajustifikuara të automjeteve në të njëjtin destinacion, krijojnë dyshime për plotësim të dokumentacionit thjesht për justifikim të shpenzimeve për karburant. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekzekutive, Divizioni Ekonomik dhe Administrimit, të marrin masat që të rregullohen me urdhër struktura që menaxhon mbajtjen e karburantit, që në vijimësi të hartohen kartelat përkatëse të secilit automjet, të caktohen personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e shpenzimeve për automjetet, të kryhen kontrollet përkatëse periodike për monitorimin e shpenzimeve për karburantin dhe riparimin e automjeteve dhe të dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i karburantit, si dhe nxjerrja e përgjegjësive materiale, dhe arkëtimin e **vlerës 930,960 lekë**, shpenzime jo të justifikuara për harxhimin e karburantit.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Me urdhërin e brëndshëm nr. 3828., datë 11.11.2021 është bërë caktimi i personave përgjegjës mbi secilin automjet në pronësi të Autoritetit Portual Durrës, ku edhe është përcaktuar edhe sasia e karburantit për konsum për çdo muaj. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Transportit kane hartuar dhe miratuar nga Drejtoria Ekzekutive dokumentacionin:

"Urdhër Shërbimi "Kodi nr. .P.2070-F.04. për lëvizjen e automjeteve ne funksion te Administratës se APD-se.

"Pasqyre e lëvizjes se mjeteve" Kodi nr. .P.2070-F.01, për pasqyrimin e lëvizjes se mjeteve te ne funksion te lëvizjes se personelit te APD-se.

"Plani i lëvizjes se ambulancës për marrjen e praktikes se lire dhe dhënien e ndihmës se pare" Kodi nr. P.2070-F.02 ku pasqyrohen te gjithë lëvizjet e ambulancave gjate orarit te punës ne funksion te marrjes se praktikes se lire dhe për emergjencat e ndodhura.

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i Menaxhimit dhe Operimit të Terminalit të Kontejnerëve në Portin e Durrësit tek operatorë privatë të specializuar për 5 vjet", me fond limit 3,736,183,195 lekë pa TVSH dhe oferta fituese ishte 3,175,756,155 lekë pa TVSh, me diferencë prej 560,427,039 lekë, u konstatuan parregullsi në miratimin e vlerës së fondit limit të kontratës. Relacioni për përllogaritjen e fondit limit të kontratës, nuk është i mirëargumentuar, për sa është referuar në të dhëna jo plotësisht të sakta dhe jo i formuluar në modele ekonomiko-financiare të llogaritjes së kostos, veprime në kundërshtim me nenin 59, "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës", të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, ku citohet: "*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet",* si dhe në kundërshtim me neni 2 dhe 28, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar.

Nga mos mirë-argumentimi i fondit limit për vlerën 292,643,461 lekë për një vit të ushtrimit të aktivitetit nga operatori, ose në terma maksimale të zbatimit të kontratës (5-vjeçare), ofrimi i këtij shërbimi mund të sjellë efekte të mundshme financiare për APD në vlerën prej 1,463,217,305 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të analizojë problematikën e konstatuar mbi rritjen e paargumentuar të vlerës së fondit limit dhe vlerës së kontratës, e cila mund të shkaktojë efekte të mundshme financiare për periudhën 5-vjeçare të kontratës dhe në të ardhmen të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm administrative për përmirësimin e situatës.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

1.2. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrë masa për ndjekjen me përparësi të zbatimit të propozimeve OE, mbi Planin për Gatishmërinë dhe Përmirësimin Teknik të Terminalit, Planit të Mirëmbajtjes Parandaluese dhe Riparimet e Mjeteve, të përcaktuara në DST-në e procedurës, pjesë e kontratës lidhur me Kontraktorin. Realizimi i mirëmbajtjeve dhe riparimeve, është kusht thelbësor për pasjen e gatishmërisë teknike të mjeteve dhe mekanizmave operues në Terminal, duke reflektuar që për këto asete nuk janë parashikuar investime të reja.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

2. Gjetje nga auditimi: Procedurat e prokurimit, viti 2018, me objekt "Sistemet Tik Loti 1", me vlerë kontrate 16,312,450 lekë, dhe OE fitues "I. S." SHPK dhe "Sigurim i Pasurisë 2018", me vlerë kontrate 22,990,000 lekë, dhe BOE fitues "A. S." & "I." SHA, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO, nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në përdorim të fondeve pa efektivitet, efiçensë dhe ekonomicitet në vlerën **39,302,450 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, në faqe nr. 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, në vlerën **39,302,450 lekë** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

3. Gjetje nga auditimi: Përllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit "Sigurimi i pasurisë 2018", për 2 nga mjetet e siguruara, është realizuar kur mjetet i janë dorëzuar Koncensionarit të DCT, sipas marrëveshjes të dorëzimit nr. 456, datë 06.02.2013. Në këto kushte, duke qenë se mjetet i kaluar në përdorim të përhershëm (deri në përfundim të kontratës më DCT) koncensionarit, ato nuk duhet të ishin përfshirë në listën e objekteve për tu siguruar, duke sjellë për pasojë rritje të paargumentuar të vlerës së fondit limit dhe vlerës së kontratës në

shumën prej **1,003,503 lekë** që i korrespondon: Mjetit tip vinç i lëvizshëm MHC 200 Fantuzzi Reggiane siguruar për vlerën prej **499,814** lekë dhe mjeti MHC 150 Fantuzzi Reggiane siguruar për vlerën prej **503,589** lekë.
Përveç mjeteve, automjeteve, makinerive apo objekteve rezulton se janë siguruar edhe mallra të konsumit të përgjithshëm, të bëra hyrjen në magazinë. Një pjesë e tyre konstatohet se është mall konsumi dhe sigurimi i tyre është i argumentuar financiarisht por edhe logjikisht dhe këtu i referohemi mallrave si veshmbathje të siguruara për vlerën **73,951** lekë. Në total vlera e sendeve të magazinës është siguruar në shumën prej **3,041,859 lekë**, veprime të cilat kanë çuar në përdorim të fondeve të prokuruar pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet në vlerën totale prej **4,045,362 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për mos përsëritjen në të ardhmen të sigurimit të mjeteve të cilat i kanë kaluar në përdorim të palëve të treta, si dhe mos sigurimin e mallrave të konsumit të përditshëm, duke eliminuar efektet negative të konstatuara dhe menaxhimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për personat të cilët kanë shkaktuar rritjen e paargumentuar të vlerës së fondit limit dhe vlerës së kontratës në shumën prej **4,045,362 lekë.**

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

4. Gjetje nga auditimi Procedurat e prokurimit, viti 2019, me objekt "Shpenzime Materiale Teknologjike Informacioni dhe Komunikimi", me vlerë kontrate 14,274,845 lekë, dhe OE fitues "I. D. SHPK; "Shpenzime materiale elektrike", me vlerë kontrate 8,323,102 lekë, dhe OE fitues "G." SHPK; "Sigurim i Pasurisë 2019", me vlerë kontrate 20,863,711 lekë, dhe BOE fitues "A." & "A." SHA; "Blerje dhe Instalim UPS, transformator fuqie, Gjenerator", me vlerë kontrate 9,200,000 lekë dhe OE fitues "A. L. I." SHPK; "Shërbimi për mirëmbajtjen e aseteve elektroenergjetike për 4 vite", me vlerë kontrate 105,384,000 lekë me BOE fitues "HTM & A." SHPK, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO, nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në përdorim të fondeve pa efektivitet, efiçensë dhe ekonomicitet në vlerën **158,045,658 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, në faqe nr. 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, në vlerën **158,045,658 lekë,** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

5. Gjetje nga auditimi: Përllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit "Sigurimi i pasurisë 2019", për 2 nga mjetet e siguruara, është realizuar kur mjetet i janë dorëzuar Koncensionarit të DCT, sipas marrëveshjes të dorëzimit nr. 456, datë 06.02.2013. Në këto kushte, duke qenë se mjetet i kanë kaluar në përdorim të përhershëm (deri në përfundim të kontratës më DCT) koncensionarit, ato nuk duhet të ishin përfshirë në listën e objekteve për tu siguruara, duke sjellë për pasojë rritje të paargumentuar të vlerës së fondit limit dhe vlerës së kontratës në shumën prej **1,361,880 lekë** që i korrespondon: Mjetit tip vinç i lëvizshëm MHC 200 Fantuzzi Reggiane siguruar për **vlerën prej 678,300 lekë** dhe mjeti MHC 150 Fantuzzi Reggiane siguruar për **vlerën prej 683,580 lekë**.
Përveç mjeteve, automjeteve, makinerive apo objekteve rezulton se janë siguruar edhe mallra të konsumit të përgjithshëm, veshje, uniforma të bëra hyrje në magazinë. Në total vlera e sendeve të magazinës është siguruar në shumën prej **1,126,650 lekë**, veprime të cilat kanë çuar në përdorim të fondeve të prokuruar pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet në vlerën totale prej **2,488,530 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për mos përsëritjen në të ardhmen të sigurimit të mjeteve të cilat i kanë kaluar në përdorim të tretëve, si dhe mos sigurimin e mallrave të konsumit të përditshëm, duke eliminuar efektet negative të konstatuara dhe menaxhimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për personat të cilët kanë shkaktuar rritjen e paargumentuar të vlerës së fondit limit dhe vlerës së kontratës në shumën prej **2,488,530 lekë.**

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.
6. Gjetje nga auditimi: Procedurat e prokurimit, viti 2020, me objekt "Zbatimi i projektit për sallën operacionale ndërinstitucionale dhe rrjetin e sigurisë portuale në APD", me vlerë kontrate 21,108,750 lekë, dhe OE fitues "A. C." SHPK; "Sigurim i Pasurisë", me vlerë kontrate 22,775,076 lekë, dhe BOE fitues "A." & "A." SHA; "Pjese këmbimi për vinçat e APD" me vlerë kontrate 20,184,500 lekë dhe OE fitues "2. A. G." SHPK; "Shpenzime materiale elektrike", me vlerë kontrate 11,984,650 lekë dhe OE fitues "2.A. G." SHPK; "Veshmbathje", me vlerë kontrate 21,750,000 lekë dhe OE fitues "U. P." SHPK; dhe "Shërbim auditim energjetik në APD", me vlerë kontrate 11,520,000 lekë dhe BOE fitues "N.-G." & "H.-C." SHPK, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO, nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në përdorim të fondeve pa efektivitet, efiçensë dhe ekonomicitet në vlerën **115,647,900 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për personat të cilët kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **115,647,900 lekë**

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

7. Gjetje nga auditimi: Zbatimi i kontratës "*Zbatimi i projektit për sallën operacionale ndërinstitucionale dhe rrjetin e sigurisë portuale në APD*", me vlerë kontrate 21,108,750 lekë, dhe OE "A. C." SHPK, është situacionuar kur OE i shpallur fitues nuk ka respektuar kushtet e kontratës dhe kriteret e përcaktuara në DST, duke dorëzuar produkte të ndryshme nga ato të ofertuar dhe konkretisht referuar faturës nr. 64, seria 84096489, datë 10.7.2020:
-Në pikën 9 të akt-pranimit rezulton se ka marrë në dorëzim (9 video ŵall nga kompania Philips modeli 49BDL3005X) për vlerën prej 325,000 lekë për njësi ose 2,925,000 lekë në total, produkt i ndryshëm nga ai i ofertuar (ofertuar produkt i kompanisë AGNEOVO), po ashtu është kërkuar videoŵall 46 ndërsa janë sjellë e marrë në dorëzim 49.
-Për zërin UPS 10 KVA, ka rezultuar se OE ka ofertuar për produktin e markës LEGRAND, produkti Trimod HE 10 kvA, kur në fakt ka dorëzuar produktin e markës GMI model Pro 10KVA, për të gjithë vlerën e mallit prej 500,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1.Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, në shkelje të detyrimeve të kontratës nga OE, APD, të marrë masa për eleminimin e praktikave që kanë cuar në përdorimin pa ekonomicitet e eficencë të fondeve të prokuruara në vlerën prej 3,425,000 lekë për subjektin "A.C." SHPK dhe të nxjerrë përgjegjësitë për personat të cilët kanë shkaktuar këtë keqpërdorim dhe duke e konsideruar si mos respektim i kushteve të kontratës dhe ofertës për të gjithë vlerën e mallit prej **3,425,000 lekë** të kërkoj nga subjekti "A. C." SHPK, zbatimin e kushteve të kontratës dhe dorëzimin e të njëjtit produkt sipas kritereve të kërkuara në DST me ofertën e deklaruar në DST.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

8. Gjetje nga auditimi: Zbatimi i kontratës "Pjesë këmbimi për vinçat e APD" me vlerë të kontraktuar 20,184,500 lekë dhe OE "2. A. G." SHPK, është situacionuar kur OE i shpallur fitues nuk ka respektuar kushtet e kontratës dhe kriteret e përcaktuara në DST, duke dorëzuar produkte të të njëjtit lloj por të markave të ndryshme nga ato të ofertuar. OE në ofertën teknike për zërin "filtra" ka ofertuar produkte të markës FILTRON, ndërsa ka dorëzuar jo të gjitha produktet e kësaj marke por marka të tjera (kryesisht më të lira) si FILTRE, ONFIL, ASAS. Po ashtu për sa i përket zërit "elektromotorë" ka ofertuar për produkte të markës EVIG për vlerën prej 2,400,000 lekë, kur në fakt për produktin elektromotor 9.7 kva ka dorëzuar produktin e markës ELECTRO ADDA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, duke e konsideruar si mos respektim i kushteve të kontratës dhe ofertës për të gjithë vlerën e mallit prej **2,400,000 lekë** për zërin "elektromotor" dhe zërin "filtra", me vlerë të papërcaktuar, të kërkoj nga subjekti "2. A. G." SHPK, zbatimin e kushteve të kontratës dhe dorëzimin e të njëjtit produkt sipas kritereve të kërkuara në DST me ofertën e deklaruar në DST.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

9. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e procedurës së prokurimit "Veshmbathje", me vlerë të kontraktuar 21,750,000 lekë dhe OE "U. P." SHPK, është konstatuar se OE i shpallur fitues nuk ka respektuar kushtet e kontratës dhe kriteret e përcaktuara në DST, duke dorëzuar produkte të të njëjtit lloj por që nuk plotësojnë kriteret dhe specifikimet teknike të DST *(aneksi bashkëlidhur). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, duke e konsideruar si mos respektim i kushteve të kontratës dhe ofertës për të gjithë vlerën 21,750,000 lekë të mallit, duke kërkuar nga subjekti "U. P." SHPK, zbatimin e kushteve të kontratës dhe dorëzimin e të njëjtit produkt sipas kritereve të kërkuara në DST me ofertën e deklaruar në DST.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.

Zbatimi të rekomandimit: Proces.

10. Gjetje nga auditimi: APD ka ndjekur dhe përmirësuar tarifat e shërbimeve portuale çdo vit sipas nivelit të zhvillimit të aktivitetit në port, rishikimi i vazhdueshëm i tarifave si edhe studimi, përdorimi i tarifave të reja deri në vitin 2019, nuk bëjnë të domosdoshëm dhe justifikojnë përdorimin e fondeve për kryerjen e një procedure tenderimi, nuk është imediate inicimi/kryerja e një procedure prokurimi konsulence për ndryshimin e tarifave me fond limit të paargumentuar në vlerën **10 milion lekë, shumë e cila përbën efekt negativ sepse tarifat ende nuk janë miratuar.**

Nga APD nuk është zbatuar ligji nr. 9130, datë 08.09.2003, *"Për Autoritetin Portual",* nenet 16 "Krijimi dhe veprimtaria e këshillit konsultativ" dhe 35 "Përcaktimi i tarifave", pasi nuk është marrë mendim dhe miratim nga këshilli konsultativ dhe palët e interesuara për ndryshimin e tarifave.

-Komisioni i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike, termat e referencës, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe llogaritjen e fondit limit, shprehet mbi nevojën e kryerjes së prokurimit me pretendimin se tarifat nuk kanë ndryshuar prej vitit 2008. Me këtë argument janë përcaktuar edhe faktorët që do të merren në konsideratë në zhvillimin e tarifave të reja.

Bazuar në ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004, "Kodi Detar", neni 84 "Tarifat Portuale", ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual" neni 35, VKM nr.596, datë 10.09.2004, neni 9, pikat 11,12,13, përcakton qartë se libri i tarifave ka qenë në një proces të vazhdueshëm monitorimi dhe rishikimi duke u miratuar edhe tarifa të reja për procese pune dhe shërbimi sipas kërkesave të APD dhe operatorëve privat që operojnë në port.

Për ndryshimin e tarifave, janë nxjerrë urdhrat e Drejtorit Ekzekutiv nr. 472, datë 16.02.2017 "Për rishikimin e tarifave portuale të vitit 2017" dhe nr.1513, datë 13.04.2018 "Për rishikimin e tarifave portuale të vitit 2018", ku është ngarkuar një komision i përbërë prej 8 specialistësh të drejtorisë ekonomike, financës, plan biznesit, statistikave, projekteve, etj. Në urdhra përcaktohen hapat që do të ndiqen për përmirësimin e tarifave, komunikimi me shoqëritë koncensionare, studimet krahasimore me portet konkurente, afatet, etj. Rishikimi i vazhdueshëm i tarifave si edhe studimi, përdorimi i tarifave të reja deri në vitin 2019 nuk bëjnë të domosdoshëm dhe justifikojnë përdorimin e fondeve në shumën 10,00,000 lekë, për kryerjen e një procedure tenderimi dhe janë veprime në kundërshtim me nenin 1"Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe nenin 35 "Përcaktimi i tarifave", të ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për shërbime, të cilat kanë çuar në paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike në vlerën **10,000,000 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i përdorimit të fondeve me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

10.2. Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria Juridike dhe Divizioni Administrimit dhe Financës, të analizojë tarifat dhe të marrë masa për miratimin në strukturat përkatëse si Këshill Konsultativ Këshill Drejtues, Ministri, etj, me qëllim sigurimin e përdorimit me efektivitet të fondeve dhe rritjen e të ardhurave.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Eshte miratuar Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr. 4, datë 11.6.2021 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2021". APD i është drejtuar Këshillit Konsultativ mbi rishikimin e librit të tarifave, mbledhje e cila është mbajtur me datën 12.05.2022 ku edhe janë miratuar të gjitha ndryshimet në librin e tarifave dhe këto ndryshime i janë propozuar KD për miratim.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

11. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 4106, datë 17.10.2018, ish Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka urdhëruar pjesëmarrjen e E. Gj., në trajnimin e organizuar nga Instituti i Menaxhimit të Riskut, në Singapor; me shkresën nr. 4139, datë 19.10.2018, ka urdhëruar pjesëmarrjen e Shqiponja Ibrahimi, dhe Ana Miho, në seminarin e organizuar nga APEC "Tasks and Responsibilities of forwards agencies and shipping lines 2018", duke mbuluar shpenzimet e udhëtimit dhe të transfertave.
Shkresat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nuk kanë të argumentuar rëndësinë e aktivitetit për shoqërinë dhe lidhjen e aktivitetit me pozicionin e punës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe me udhëzimin nr. 22, datë 10.07.2013, "Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të KM "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", pika 2. Vlera 28,800 lekë x 2 persona, dhe 1 x 100,480 lekë në total, **158,080 lekë** përbën efekt financiar negativ për APD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1. Rekomandim: Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për mos përsëritjen në të ardhmen të shpenzimeve të paargumentuara për trajnime duke eliminuar efektet negative të konstatuara dhe menaxhimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për personat të cilët kanë shkaktuar vlerën 158,080 lekë efekt financiar negativ.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

12. Gjetje nga auditimi: Struktura organizative e APD-së, nuk pasqyron aktivitetin aktual të saj pasi është e strukturuar me divizione, drejtori, përgjegjës sektori, të panevojshëm, jo funksional, duke pasur një ndarje mekanike të detyrave dhe pa e harmonizuar dhe lidhur horizontalisht.
Nisur nga fakti që pjesa më e madhe e shërbimeve në APD, u është dhënë koncesionarëve, aktiviteti thelbësor është në Terminalin Perëndimor, monitorimi i kontratave, siguria dhe shërbime të tjera dytësore, struktura organizative e tej ngarkuar nuk justifikohet, duke sjellë kosto financiare në buxhetin e APD-së.
Në strukturë, në sektorin e burimeve njerëzore ka 2 punonjës për kriteret e rekrutimit dhe performancës, ndërkohë që APD si kriter për punësimin në pozicion drejtori dhe specialist ka vetëm arsimin e lartë dhe një periudhë vitesh eksperiencë, pa cilësuar kualifikimet e veçanta si dhe arsimin përkatës. Në sektorin e forcave të sigurisë është dhe pozicioni i sekretares së drejtorit të sektorit. Sektori i programimit, plan biznesit, statistikave dhe tarifave ka një përgjegjës sektori dhe 5 specialistë, kur plan biznesi përgatitet vetëm në një periudhë të caktuar të vitit, tarifat e APD kanë pasur shumë pak ndryshime në vite. Në drejtorinë e financës, ekonomisë dhe administrimit janë 4 specialistë për vjeljen e të ardhurave nga kontratat dhe debitorët, si dhe në drejtorinë juridike është sektori i kontratave dhe i hipotekimit të pronave, me një përgjegjës sektori dhe 5 specialistë, ndërkohë që procesi i hipotekimit të pronave duhet të kishte përfunduar dhe shumica e kontratave janë format i paracaktuar.
Aktualisht struktura organizative dhe nivelet e pagave janë miratuar me vendimet e KD, nr. 09 dhe nr. 10 datë 02.07.2020. Ndryshimet e kryera nuk janë të argumentuara si dhe nuk pasqyrojnë aktivitetet që zhvillon APD, si dhe implementimi i strukturës së re është kryer pa miratimin e rregullores së re, në përshtatje me pozicionet e reja, duke i lënë pa përshkrime pune. Në strukturën e pagave janë propozuar e miratuar rritje pagash vetëm për pozicionet e Drejtoreve të Divizioneve dhe Drejtuesve të Njësive, sekretaren e Këshillit Drejtues, duke mos vlerësuar punonjësit operacionalë, që mbulojnë operacionet ditore të aktivitetit të APD-së. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe me nenin 2, Objekti i APD, të VKM nr. 596, datë 10.19.2004, "Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij".
Vendimi për ndryshimin e strukturës, dhe rritjen e pagave ka sjellë një rritje të shpenzimeve në periudhën korrik-dhjetor 2020, krahasuar me muajin qershor 2020, **në vlerën 7,492,227 lekë** për zërin paga. **Kjo vlerë përbën efekt ekonomik financiar negativ për APD.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1. Rekomandim: Këshilli Drejtues, të marrë masa për shqyrtimin e strukturës organizative, analizimin e proceseve operacionale dhe administrative që zhvillohen në APD, vlerësimin për personelin e nevojshëm për kryerjen e tyre, dhe kohën përkatëse, për reduktimin e strukturës duke sjellë uljen e shpenzimeve vjetore. si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për personat të cilët kanë shkaktuar **vlerën 7,492,227 lekë**, efekt financiar negativ.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

13. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Portual Durrës ka bërë zgjidhje të kontratave të punësimit pa shkaqe të arsyeshme. Gjatë periudhës objekt kontrolli janë ekzekutuar vendimet gjyqësore për 36 ish-punonjës në vlerën totale 64,878,664 lekë (vlera sipas vendimit të gjykatës dhe shpenzime përmbarimore). Në 23 raste është bërë ekzekutimi nëpërmjet shërbimit përmbarimor në vlerën totale 42,745,491 lekë nga të cilat shpenzime përmbarimore në vlerën 4,282,976 lekë. Në 15 nga këto raste janë me ekzekutim të përkohshëm dhe APD ka bërë kërkesën për pezullim

dhe ankimin e veçantë. Në 13 raste, pas kërkesës së ish-punonjësit është bërë ekzekutimi vullnetar, për vlerën totale 22,133,173 lekë. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenet 143, 144, 146 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, "Kodi i Punës", duke sjellë efekt ekonomik financiar negativ për buxhetin e APD-së, **në vlerën 64,878,664 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandime: APD të marrë masa që në të ardhmen, në zgjidhjet e kontratave të punësimit, të zbatohen afatet e njoftimit, të vlerësohet me kujdes argumentimi i shkaqeve të ndërprerjes së marrëdhënies me punonjësit. APD të analizojë rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve përmbarimore, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për APD-në, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për personat të cilët kanë shkaktuar **vlerën 64,878,664 lekë** efekt financiar negativ.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

14. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2018 janë dhënë shpërblime në masën e një page mujore për punonjësit e APD në vlerën 16,439,270 lekë. Dhënia e shpërblimit nuk është miratuar nga Ministri përkatës. Dhënia e shpërblimeve nuk është bazuar në performancën e punonjësve. Meqenëse në vitin 2018, punonjësit kanë marrë një shpërblim në muajin gusht, me Urdhrin e Brendshëm, nr. 3582, datë 30.08.2018 nuk duhet të ishte akorduar shpërblim i dytë. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6 pika 1/a, dhe me Vendimin e KD nr. 9, datë 18.03.2016 "Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimeve suplementare dhe të ndihmave financiare në APD", neni 4 "Përfitimi i shpërblimit", pika 4.1. Vlera e shpërblimit prej **16,439,270 lekë** përbën efekt financiar negativ për APD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 , faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandim: Organet drejtuese të APD të analizojnë vlerën 16,439,270 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ dhe në të ardhmen nga APD të akordohet dhënia e shpërblimeve vjetore jo më shumë se një pagë mujore në vit bazuar në performancën individuale të punonjësve, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga Ministri përkatës.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe do të kontrollohet në auditimin e rradhës.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

15. Gjetje nga auditimi: Në listë pagesat e dorëzuara në organet tatimore, janë konstatuar të punësuar mbi planin strukturor të miratuar nga KD, për periudhën 2018, korrik-dhjetor, 15 persona, për periudhën shkurt mars 2019, 5 persona, në total 20 të punësuar mbi strukturë. Veprimet sa më sipër kanë sjellë efekt financiar negativ në **vlerën 2,023,724 lekë**, dhe janë në kundërshtim me ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual" dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 "Për miratimin e statutit të APD dhe për Riorganizimin e tij", neni 9, pika 2. Vlera 2,023,724 lekë përbën efekt financiar negativ për APD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandim: Këshilli Drejtues të shqyrtoj shkeljet e konstatuara në punësimin e personave mbi strukturën organike, për periudhën 01.07.2018-31.12.2020, të cilat kanë krijuar efekte negative në buxhetin e institucionit në vlerën 2,023,724 lekë.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Këshilli Drejtues nuk ka ndërmarrë asnjë hap për realizimin e këtij rekomandimi.

Zbatimi të rekomandimit: Pa Zbatuar.

16. Gjetje nga auditimi: Aktivet jo materiale të APD-së, të periudhës 2019, në zërin Licenca për sistemin e administrimit të burimeve njerëzore (400 copë), etj., kanë amortizim të akumuluar në vlerën 3,378,000 lekë, dhe në pajisje të leximit, në vlerën 1,343,563 lekë, në total 4,721,563 lekë. Nga verifikimet e kryera në procesin e mbajtjes së listë prezencave, hartimit të borderove të punonjësve të APD-së, u konstatua se sistemi i administrimit të burimeve njerëzore nuk është përdorur që nga marrja në dorëzim në periudhën 2017.
-Nga verifikimi i aktiveve jo materiale të APD-së, u konstatua se deri në fund të periudhës 2019, në zërin Licenca për Projektin e Arkivës Elektronike, ka amortizim të akumuluar në vlerën 7,916,250 lekë. Projekti i Arkivës Elektronike, përfshinte skanera, printera, skanimin fizik të arkivës për periudhën 2012-2016, dhe ngritjen e sistemit të arkivës elektronike, dhe administrimit të proceseve dhe lëvizjes së brendshme të informacionit, duke shërbyer si mjet kryesor për administrimin qendror të dokumentacionit dhe qarkullimit të tij ndërmjet strukturave të protokollit, strukturave që prodhojnë dokumentacion shkresor, arkivës dhe ndjekësve të kontratave. Nga verifikimet e kryera në protokollin e APD, u konstatua se sistemi nuk është përdorur që nga marrja në dorëzim në periudhën 2017.
Vlera 12,637,813 lekë, e amortizimit të akumuluar, por jo të përdorur realisht përbën shpenzim jo të justifikuar nga APD. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv, të marrë masa që në të ardhmen, të analizohen me kujdes asetet që ka gjendje, për të mundësuar shfrytëzimin maksimal të tyre me efektivitet dhe efiçencë, si dhe vënien në funksionim për realizimin e objektivave të përcaktuara, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për personat të cilët kanë shkaktuar vlerën **12,637,813 lekë** efekt financiar negativ.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Rekomandim për tu ndjekur menjëherë dhe në vijimësi.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe do të kontrollohet në auditimin e rradhës.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

17. Gjetje nga auditimi: Nga filtrimi i informacionit për artikujt me qarkullim të ngadalshëm, në magazinat e APD-së u konstatua se në inventarin e datës 31.12.2019, kishte gjendje artikuj, blerje të bëra në vitin 2014, 12,676,940 lekë, në vitin 2015 në vlerën 8,261,520 lekë, në vitin 2016 në vlerën 4,562,530, në vitin 2017 në vlerën 86,516,870 lekë, në total 112,017,860 lekë.
Në vitin 2014 nga 9,818 artikuj të bërë hyrje janë gjendje 9,352 pra janë përdorur vetëm 5%.
Në vitin 2015 nga 12,842 artikuj të bërë hyrje, janë gjendje 8,870, pra janë përdorur vetëm 30 %.
Në vitin 2016 nga 2,030 artikuj të bërë hyrje, janë përdorur vetëm 225, pra janë përdorur vetëm 11 %. Në vitin 2017 nga 18,034 artikuj të bërë hyrje, janë gjendje 13,014, pra janë përdorur vetëm 28%.
-Grupet e punës të ngritura për përllogaritjen e nevojave për blerje nuk kanë kryer me saktësi llogaritjet për sasitë e artikujve të kërkuar, duke krijuar material stok, që përveç se ka impenjuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. **Vlera 112,017,860 lekë** përbën efekt ekonomik financiar negativ për APD.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv të marrë masa që në të ardhmen, të ndiqen me kujdes dhe përgjegjshmëri proceset e përllogaritjeve të nevojave për blerje, duke kërkuar argumentimin dhe relacionet përkatëse si dhe analizat e duhura në rastet e mospërputhjeve në konsumin e tyre.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

18. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Rikonstruksion i magazinave 4, 5, terminali perëndimor, viti 2019", sipas pikës 2.3 është vendosur kriteri "Operatori ose bashkimi i operatorëve ekonomikë duhet të paraqesë licencë për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B për transport mbetjesh inerte. Kriteri i vendosur ka të bëjë me menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe jo me thjeshtë me transportin e mbetjeve inerte të nevojshme në vendet e paracaktuara nga AK. Vendosja e kriterit të disponimit të licencës sipas kategorisë III.2.B, ka bërë që një OE, konkretisht BOE "K." & "A." & "S." SHPK, me ofertë ekonomike 15,267,819 lekë (oferta fituese me vlerë 19,501,206 lekë), të përjashtohet nga gara vetëm për mos plotësim të këtij kriteri. **Vlera 4,233,287 lekë** (19,501,206 lekë– 15,267,919 lekë), e cila përfaqëson diferencën ndërmjet ofertës fituese me ofertën e mos pranuar për shkak të mos disponimit të licencës së kërkuar në dokumente të tenderit në kundërshtim me ligjin, konsiderohet efekt negativ financiar. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 202.c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
18.1. Rekomandim: Komisionet e vlerësimit të ofertave, krahas verifikimit të dokumentacionit të ofertave, duhet t'i kushtojnë rëndësi të veçantë përllogaritjeve të cilat paraqiten nga operatorët ekonomikë për paraqitje kapacitete mjetesh, analiza çmimesh etj.

Në vijimësi

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Ky rekomandim do të verifikohet në pikën e auditimit të prokurimeve publike në auditimin e ardhshëm nga KLSH.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

19. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 4 automjetet e administratës kanë harxhuar 35,014 litra në vlerën 4,726,890 lekë. Dokumentacioni justifikues për harxhimin e karburantit është plotësuar me mangësi të theksuara, konkretisht: urdhër shërbimet nuk janë nënshkruar nga përgjegjësi i njësisë së shërbimeve mbështetëse, dokumentacioni është plotësuar dhe nënshkruar nga kërkuesit e shërbimeve. Në disa raste u konstatuan shmangie të destinacioneve nga ai i paraqitur në dokumentacionin justifikues. Dokumentacioni justifikues është mbajtur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe pa përcaktuar mënyrën e menaxhimit, megjithëse numri i punonjësve të këtij sektori ishte i mjaftueshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
19.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtoria Ekzekutive, Divizioni Ekonomik dhe Administrimit të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive administrative dhe materiale, si për hartimin e dokumentacionit justifikues për harxhimin e karburantit, ashtu edhe për mënyrën e deklarimit të lëvizjeve të pajustifikuara të cilat nuk përputhen me dokumentacionin e paraqitur dhe kanë sjellë një efekt negativ në shumën 4,726,890 lekë.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin e brëndshëm nr. 3828., datë 11.11.2021 është bërë caktimi i personave përgjegjës mbi secilin automjet në pronësi të Autoritetit Portual Durrës, ku edhe është përcaktuar edhe

sasia e karburantit për konsum për çdo muaj. Duke marrë parasysh dokumentacionin e vendosur në dispozicion rekomandimi do të konsiderohet i realizuar. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Transportit kane hartuar dhe miratuar nga Drejtoria Ekzekutive dokumentacionin:
"Urdhër Shërbimi "Kodi nr. .P.2070-F.04. për lëvizjen e automjeteve ne funksion te Administratës se APD-se.
"Pasqyre e lëvizjes se mjeteve" Kodi nr. .P.2070-F.01, për pasqyrimin e lëvizjes se mjeteve te ne funksion te lëvizjes se personelit te APD-se.
"Plani i lëvizjes se ambulancës për marrjen e praktikes se lire dhe dhënien e ndihmës se pare" Kodi nr. P.2070-F.02 ku pasqyrohen te gjithë lëvizjet e ambulancave gjate orarit te punës ne funksion te marrjes se praktikes se lire dhe për emergjencat e ndodhura.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

19.2 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për monitorimin, plotësimin e dokumentacionit dhe argumentimin e nevojës për përdorimin e automjeteve, me qëllim përdorimin e automjeteve të administratës në funksion të detyrave të ngarkuara dhe minimizimin e shpenzimeve të karburantit.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin e brëndshëm nr. 3828., datë 11.11.2021 është bërë caktimi i personave përgjegjës mbi secilin automjet në pronësi të Autoritetit Portual Durrës, ku edhe është përcaktuar edhe sasia e karburantit për konsum për çdo muaj. Duke marrë parasysh dokumentacionin e vendosur në dispozicion rekomandimi do të konsiderohet i realizuar. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Transportit kane hartuar dhe miratuar nga Drejtoria Ekzekutive dokumentacionin:
"Urdhër Shërbimi "Kodi nr. .P.2070-F.04. për lëvizjen e automjeteve ne funksion te Administratës se APD-se.
"Pasqyre e lëvizjes se mjeteve" Kodi nr. .P.2070-F.01, për pasqyrimin e lëvizjes se mjeteve te ne funksion te lëvizjes se personelit te APD-se.
"Plani i lëvizjes se ambulancës për marrjen e praktikes se lire dhe dhënien e ndihmës se pare" Kodi nr. P.2070-F.02 ku pasqyrohen te gjithë lëvizjet e ambulancave gjate orarit te punës ne funksion te marrjes se praktikes se lire dhe për emergjencat e ndodhura.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

D. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Kompanitë stivadore janë favorizuar të kryejnë procese pune të cilat gjenerojnë më shumë të ardhura në favor të tyre, duke krijuar një të ardhur të munguar për APD në shumën **119,406,605 lekë.** Terminali perëndimor, përpunon mallra gjeneralë (mallra të paketuar) dhe mallra rifuxho (grurë, misër, bërsi, plehra kimike rifuxho, squfur dhe çimento rifuxho). **Përpunimi i mallrave rifuxho të lehta (grurë, misër dhe bërsi)**, bëhet nëpërmjet një procesi operacional me mjet teknologjik (Hinkë), përpunim i cili realizohet me 2 mënyra:
-Përpunim me mjet teknologjik, i cili ka çmimin 375.10 lekë/ton.
-Përpunim në Sillosë, me çmim 619 lekë/ton.
Operatorët privat (kompanitë stivadore) kanë përdorur metodën me mjet teknologjik, me çmim 375.10 lekë/ton. Për vitin 2017 nga 61 anije të përpunuara, 2 prej tyre janë përpunuar nëpërmjet mënyrës me sillosa, për vitin 2018, nga 67 anije të përpunuara, 5 prej tyre janë përpunuar nëpërmjet mënyrës me sillosa, për vitin 2019, nga 70 anije të përpunuara, nuk është përpunuar asnjë anije me mënyrën me sillosa dhe për 6-mujorin e I të vitit 2020, nga 35 anije të përpunuara, 2 prej tyre janë përpunuar nëpërmjet mënyrës me sillosa. Për 6-mujorin e I të vitit 2020, rezulton

se nga 19 anije të përpunuara, vetëm 2 prej tyre janë përpunuar në sillosa, veprime në kundërshtim me vendimin e KD nr.4, datë 28.02.2020 dhe emalin e datës 27.03.2020, ku urdhërohet Dispeçeria Qendrore që përpunimi i të gjitha anijeve duhet të bëhet në sillosë sipas tarifave të reja.
Referuar tenderit të zhvilluar për zhvendosjen e sillosave në vitin 2016, me vlerë kontrate 14,594,000 lekë, i cili ka pasur objekt afrimin e tyre dhe krijimin e kushteve për përdorim sa më afër destinacionit të përpunimit rezulton se punimet janë marrë në dorëzim dhe kolauduar në datën 09.11.2016, megjithë, sillosat nuk janë përdorur duke krijuar një të ardhur të munguar për APD në rastin e përpunimit të mallit rifuxho në sillosë në masën 70% ose në shumën **119,406,605 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10 faqe 319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria Juridike dhe Divizioni i Administrimit dhe financës, të analizojë problematikën e konstatuar e cila ka krijuar mungesë të ardhurash nga procesi i përpunimit të mallit rifuxhio në "sillosë" në shumën 119,406,605 lekë dhe marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore për përmirësimin e gjendjes.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Për këtë rekomandim nuk janë marrë masa për zbatimin e tij.
Zbatimi të rekomandimit: Pa Zbatuar.

1.2.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv, dhe Drejtoria Juridike, të marrin masa që në kontratat e nënshkruara me kompanitë stivadore, të përcaktohet me saktësi kryerja e proceseve përkatëse të punës, duke mos përfshirë përpunimet e mallrave që mund të realizohen nga autoriteti, me qëllim gjenerimin e më shumë të ardhurave për APD.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Për këtë rekomandim nuk janë marrë masa për zbatimin e tij.
Zbatimi të rekomandimit: Pa Zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Kontratat licencë nuk monitorohen nga APD. Konkretisht vetëm kompania "L." ka detyrime ndaj APD 345,153,286 lekë, për të cilat nga APD nuk janë marrë masa shtrënguese, por vazhdojnë aktivitet përpunim mallrash pa asnjë penalitet/pengesë, duke favorizuar operatorin ekonomik dhe duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e APD.
Amendamenti nr.3, datë 19.06.2015 nënshkruar nga ish drejtori G. Sh. dhe A. B., përfaqësues i kompanisë "L.", janë ndryshuar nenet 1,2,3, dhe 4 të kontratës në lidhje me masën e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mallrave, me kohëzgjatjen e kontratës, garancitë dhe afatet e shlyerjes së detyrimeve, në kundërshtim *me nenin 3.2,* ku afati është edhe për 10 vite të tjerë (31.05.2025), dhe kontrata do të përsëritet nëse operatori do të shlyej detyrimet. Deri në vitin 2015, ky operator ka rezultuar me detyrime të papaguara ndaj APD në shumën **43,958,662 lekë** dhe në këto kushte i është rinovuar kontrata edhe me 10 vjet.
Në nenin 3.3 të këtij amendamenti "Kohëzgjatja e kontratës" është caktuar që "L." duhet të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj APD, brenda datës 30.09.2016 dhe nëse pas kësaj date do të ketë akoma detyrime financiare të pashlyera kontrata do të quhet e përfunduar.
Në nenin 3.4, Shoqëria " L. pavarësisht shlyerjes së gjithë detyrimeve ndaj APD, në lidhje me debinë e akumuluar duhet të shlyej detyrimin e prapambetur prej **43,958,662 lekë,** brenda datës 31.12.2015. Ky detyrim konsiston në pagimin e 6 kësteve mujore duke filluar me të parin në vlerën prej 5,458,662 lekë dhe 5 kështet e tjera në vlerën 7,700,000 lekë.
Amendamenti është nënshkruar në kundërshtim me kontratën nr. 363, datë 31.05.2005, neni 3 "Periudha e kontratës" dhe neni 5 "Mbledhja e të ardhurave".

-Me aktmarrëveshjen nr. 1391, datë 03.04.2018 "Për shlyerjen e debisë së akumuluar të kompanisë së ngarkim-shkarkimit "L.", nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv z. A. B. dhe përfaqësuesi i kompanisë z. A. B., bazuar në kërkesën e kompanisë datë 28.03.2018 dhe vendimin e KD nr. 27, datë 30.09.2016, palët kanë vendosur respektimin e detyrimeve të parashikuara në këtë marrëveshje. Detyrimi financiar i akumuluar deri më datë 31.08.2018, është në shumën 167,481,243 lekë (principali dhe kamatëvonesa). Debitori ka marrë përsipër të shlyej detyrimin sipas kushteve të përcaktuara dhe përshkallëzuar/muaj në aktmarrëveshje dhe ta shlyej detyrimin total deri në muajin maj të vitit 2025.
Referuar dokumentacionit financiar në dispozicion, kompania "L." ka shlyer detyrimet sipas aktmarrëveshjes nga muaji prill i vitit 2018- në muajin tetor të vitit 2019, me këste mujore 1,300,000 lekë dhe në total ka shlyer detyrimin prej 23,400,000 lekë. Kompania "L." nuk ka respektuar marrëveshjen e nënshkruar pasi deri në 30.06.2020 duhet të shlyente detyrimin në shumën **35,100,000 lekë.**
APD, nuk ka respektuar detyrimet e përcaktuara në këtë aktmarrëveshje duke lejuar vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e portit nga kjo kompani pa përdorur asnjë detyrim shtrëngues për vjeljen e detyrimeve, në kundërshtim me nenin 9, pika 7 ku citohet se: *Në rast se shoqëria "L." dështon në kryerjen e pagesave sipas kësaj aktmarrëveshje dhe vendimit të KD nr. 27, datë 30.09.2016, APD zgjidh menjëherë aktmarrëveshjen e detyrimit dhe rimerr masën e ndalimit të përdorimit të portit.*
- Detyrimi nga kompania stivadore "L." ndaj APD për periudhën objekt auditimi është **133,308,793 lekë** dhe detyrime të papaguara nga aktmarrëveshja e datës 03.04.2018 në shumën **143,800,899 lekë** (141,982,432 +1,818,467 kamatëvonesa).
Detyrimi i krijuar pas aktmarrëveshjes është në shumën 187,451,251 lekë (184,777,945 + 2,673,305 kamatëvonesa). Detyrimi i kompanisë "L." ndaj APD është **345,153,286 lekë** (**331,252,150 lekë + 13,901,136 lekë 6 mujori II 2020).**
Referuar dokumentacionit konstatohet se të ardhurat e krijuara nga kompanitë (sipas % të përcaktuara në kontratat përkatëse për kryerjen e shërbimeve) kalojnë në llogaritë e tyre dhe APD është në varësi të kompanive private për të arkëtuar të ardhurat. Një praktikë e kësaj natyre e ve APD në vështirësi financiare, pasi konstatojmë se arkëtimi i të ardhurave bëhet me vonesë dhe jo me kryerjen e shërbimit, vetëm kompania "L." ka detyrime ndaj APD **345,153,286 lekë**, për të cilat nga APD nuk janë marrë masa shtrënguese, por vazhdojnë aktivitet përpunim mallrash pa asnjë penalitet/pengesë, duke favorizuar operatorin ekonomik dhe venë në vështirësi financiare APD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria Juridike dhe Divizioni i Administrimit dhe financës, të marrë masa dhe gjejnë mekanizmat ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitore nga kompania stivadore "L.", në shumën **345,153,286 lekë.**

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nga ana e APD-së i është propozuar me shkresën nr. 4673.,datë 23.12.2020 Këshillit Drejtues mbi kontratën stivadore me OE L.për zgjidhjen e kontratës por nga Këshilli Drejtues nuk është miratuar propozimi i bërë nga APD. Gjithashtu me shkresën nr. 2671 prot.,datë 26.07.2022 i është propozuar Këshillit Drejtues për amendimin e kontratës duke parashikuar që të rregullohet mënyra e faturimit, mbledhja e të ardhurave edhe ndarja e përqindjes të realizohen nga APD me qëllim minimizimin e detyrimeve nga subjekti L., Këshilli Drejtues nuk ka marrë akoma vendim mbi propozimin e bërë nga APD.
Për këto arsye rekomandimi do të konsiderohet në proces edhe do të kontrollohet nga auditimi i ardhshëm mbi realizimin e rekomandimit.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

2.2.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria Juridike dhe Divizioni i Administrimit dhe financës, të analizojë, të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar nga kompania stivadore "L.", për detyrimet debitore në shumën **345,153,286 lekë,** si pasojë e nënshkrimit të kontratave dhe vazhdimin e aktivitetit në port, në kundërshtim me detyrimet kontraktore.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nga ana e APD-së i është propozuar me shkresën nr. 4673.,datë 23.12.2020 Këshillit Drejtues mbi kontratën stivadore me OE L.për zgjidhjen e kontratës por nga Këshilli Drejtues nuk është miratuar propozimi i bërë nga APD. Gjithashtu me shkresën nr. 2671 prot.,datë 26.07.2022 i është propozuar Këshillit Drejtues për amendimin e kontratës duke parashikuar që të rregullohet mënyra e faturimit, mbledhja e të ardhurave edhe ndarja e përqindjes të realizohen nga APD me qëllim minimizimin e detyrimeve nga subjekti L., Këshilli Drejtues nuk ka marrë akoma vendim mbi propozimin e bërë nga APD.
Për këto arsye rekomandimi do të konsiderohet në proces edhe do të kontrollohet nga auditimi i ardhshëm mbi realizimin e rekomandimit.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

2.3.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe Divizioni i Administrimit dhe financës të marrë masa për gjetjen e mundësive që të ardhurat e krijuara nga këto kompani (sipas tarifave të përcaktuara në kontratat përkatëse për kryerjen e shërbimeve) të kalojnë në llogarinë e APD, me qëllim që shoqëria të mos jetë në varësi të kompanive private për të arkëtuar të ardhurat dhe të eleminojë krijimin e detyrimeve debitore të cilat e venë në vështirësi financiare.

Menjëherë

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Rekomandim për tu ndjekur menjëherë dhe në vijimësi.
Rekomandimi do të konsiderohet në proces dhe do të kontrollohet në auditimin e rradhës.
Zbatimi të rekomandimit: Proces.

E. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv ti kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:
Subjektit BOE **"E. S." SHPK dhe "H. C." SHPK**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin "Prishje e godinave të amortizuara plotësisht në zonën e ish peshkimit dhe magazinën 4-5"për certifikimin e prishjes së materialit beton arme, ndërkohë që punimi ishte shtresë betoni, shoqëruar me rritje të çmimit me dëm ekonomik me vlerë ***821,756 lekë*** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:

Në momentin që ka ardhur raporti përfundimtar i auditimit nga KLSH, prishja edhe evadimi i materialeve sipas objektit të kontratës së prokurimit ishte realizuar dhe për rrjedhoje nuk kishte objekt për tu inspektuar nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës.
Zbatimi të rekomandimit: Pa Zbatuar.

F. MASA DISIPLINORE

Masa për "Anëtarit të Këshillit Drejtues", nga organet zgjedhëse (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, dy anëtarë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, një anëtarë prefektura Durrës, një anëtar dhe Këshilli Konsultativ i Autoritetit Portual Durrës dy anëtar) për:
V. H., kryetare
I. C., zv. Kryetar,
E. B.,
E. E.,
A. R.,
A. R., anëtarë të Këshillit Drejtues
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është marrë asnjë masë disiplinore kundrejt anëtarve të Këshillit Drejtues.
Zbatimi të rekomandimit: Pa Zbatuar.

F/I. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, statutit të APD neni 12, i kërkojmë Këshillit Drejtues, që në varësi të kompetencave të Tij ligjore, të analizojë punën e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv **P. V.** dhe të marrë masat e nevojshme administrative dhe disiplinore në përputhje me statutin e Portit, sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit,të performancës së punës së tij.

"Vëretje" deri në "Zgjidhje të kontratës së punësimit
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nga ana e Këshillit Drejtues nuk është marrë asnjë masë disiplinore kundrejt Drejtorit Ekzekutiv.
Zbatimi të rekomandimit: Pa Zbatuar.

F/II. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, kontratës kolektive të punës nr. 1446 prot, datë 09.05.2017 neni 37, kontratave individuale të punës neni 11, i kërkojmë Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, që në varësi të kompetencave ligjore të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejte" deri në "Zgjidhje të kontratës së punësimit"
z. A. M. me detyrë Drejtor Juridik
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1351, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

z. A. M. me detyrë Drejtor Drejtoria e Financës,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1382, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.
z. U. N., me detyrë Përgjegjës Dispeçeri Qendrore,

Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1381, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

H. K.. Përgjegjës i SOMT,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1340, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

B. H., me detyrë Drejtor Drejtoria e Kontratave,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. Sh. me detyrë këshilltar koordinativ, përgjegjës për:
-Ka plotësuar dokumentacion të pasaktë për automjetin në dispozicion, ka harxhuar 6896 litra, ose *930,960 lekë,* karburant të pajustifikuar, e cila përbën dëm ekonomik për APD.
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1377, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

D. A., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Kontratave, Shërbimeve dhe Administrimit të Pronave
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1370, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

Masën disiplinore "Vërejtje" për punonjësit:

A. Xh., me detyrë Përgjegjëse sektorit të magazinimit, *dhe*
S. T., me detyrë Ekonomist i karburantit,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1367, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Me urdhërin nr. 1386, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

Gj. K., me detyrë Specialist/Sektori i Zhvillimit dhe Infrastrukturës,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1335, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

R. R., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe Zhvillimit,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1338, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

I. K., me detyrë Specialiste/Sektori i Financës dhe Kontabilitetit,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1349, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

R. K., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Teknike
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

I. H., ish Drejtor i shërbimeve operacionale,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1442, datë 14.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. V., me detyrë Drejtor i FSPD,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1358, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. B., me detyrë Përgjegjës/Sektori i Infrastrukturës Civile-Detare,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1339, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

E. R., me detyrë Specialiste/Njësia e Prokurimeve
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1337, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

B. O., me detyrë Drejtore e Njësisë së Standardeve,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1348, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. V., në cilësinë e anëtarit të KVO, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1331, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. Y., në cilësinë e anëtarit të KPISPVFL,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

E. D., në cilësinë e anëtarit të KVO, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1330, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

F. L., me detyrë Përgjegjës Sektorit Programimit, përgjegjës për:
plan biznesin tarifave dhe taksave.
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1375, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

B. V., ish Drejtor i teknikës dhe zhvillimit, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

L. D., me detyrë K/Dispeçer, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1366, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

F. Xh., me detyrë Ekonomiste në Drejtorinë e Financës Sektori Planifikimit Strategjik;
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1357, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

E. R., me detyrë Specialist në Sektorin e Administrimit të Pronave dhe Shërbimeve,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1355, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.
dhe:
E. Gj., me detyrë Specialiste në Sektorin e Kostos dhe Buxhetit,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1347, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

K. O., me detyrë Përgjegjës i terminalit të mallrave gjenerale, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

E. Sh.
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

O. M., në cilësinë e anëtarit të KPLLFLST përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1346, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

M.P., ish Përgjegjës i Prokurimeve, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

S. Zh., me detyrë Specialiste në sektorin e kostos dhe buxhetit, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1368, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

H.M., në cilësinë e anëtares së KPLLFLST, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1380, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

I. R., me detyrë Jurist në NJHDT,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1336, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

D. Z., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1384, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

E. Th.
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

V. P., në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesave,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

V. H., në cilësinë e anëtarit të KVO, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1342, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

E. S., në cilësinë e anëtarit të NJHDT, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1369, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

L. M., në cilësinë e anëtarit të NJHDT, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1343, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

F. G., në cilësinë e anëtarit të NJHDT, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1441, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

B. L., në cilësinë e anëtarit KPLLFLST, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1352, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

J. Xh., në cilësinë e kryetarit të KVO dhe NJHDT, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1341, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

Q. K., në cilësinë e anëtarit të KVO dhe NJHDT, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1345, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

V. B., në cilësinë e anëtarit të KVO përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1328, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

I. I., në cilësinë e anëtarit të NJHDT, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

I. K.
M. I. në cilësinë e anëtarit të KPISPVFL,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1353, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Me urdhërin nr. 1376, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

E. I., në cilësinë e anëtarit të KVO dhe NJHDT, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1329, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. Gj., në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe KPLLFLST, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1332, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

T. L. *dhe*
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
V. S. në cilësinë e anëtarit të KPLLFLST, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1374, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

Sh. Xh., në cilësinë e anëtarit të KPLLFLST,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1360, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

M. R., në cilësinë e anëtarit të KVO,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1333, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

S. M., në cilësinë e anëtarit të NJHDT, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1354, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. C., në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe KPLLFLST,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1334, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

K. N., në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe KPLLFLST
Me urdhërin nr. 1356, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. B., në cilësinë e anëtarit të NJHDT/KPLLFLST dhe KVO
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1364, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

K. H., në cilësinë e anëtarit të KPLLFLST
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1373, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

S. K., në cilësinë e anëtarit të KVO, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

H. V., në cilësinë e anëtarit të KPLLFLST, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1372, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

S. T. *dhe*
M. K., në cilësinë e anëtarit të KVO,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1378, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Me urdhërin nr. 1379, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

Xh. L., në cilësinë e anëtarit të KPLLFLST
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Nuk është dhënë masë disiplinore pasi janë shkëputur marrëdhëniet e punës.

Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. C., në cilësinë e anëtarit të KPLLFLST, përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1344, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

D. K.,
G.Th. *dhe*
M. K., në cilësinë e anëtarit të KPLLFLST,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1350, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Me urdhërin nr. 1359, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Me urdhërin nr. 1363, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

K. S. *dhe*
R. M., në cilësinë e anëtarit të KVO,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1361, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Me urdhërin nr. 1365, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

A. B., në cilësinë e anëtarit të KPLLFLST
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1383, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

M. K. *dhe*
A. C., në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe KPLLFLST,
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1338, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

"Vërejtje" për drejtuesit e automjeteve të APD
z. I. Ç.,
z. E. L.,
z. A. N.,
z. Ç. Q.,
z. Sh. D. dhe
z. B. K., përgjegjës për:
Qëndrimi i APD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Me urdhërin nr. 1362, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Me urdhërin nr. 1371, datë 12.04.2022 është dhënë "Vërejtje me shkrim".
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar.

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në ARRSH mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit*

2021" për auditimin e kryer në vitin 2021, për periudhën nga 01.08.2019 deri në 31.12.2020, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

Në zbatim të nenit 15, gërma "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 9345/10 prot., datë 02.11.2021, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 513 prot., 17.01.2022, duke respektuar kështu afatin 6 mujor të raportimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar Tiranë, administruar në KLSH me nr. 874/33 prot., datë 15.10.2021, dhe protokolluar në ARRSH me nr. 9345 prot., datë 18.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:

- **47** masa organizative.
- **9** masa për shpërblim dëmi në vlerën **46,132,617 lekë.**
- **6** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **126,513,139 lekë** (124,502,969 lekë + 16,531 euro * 121.6 kursi i datës 15.10.2021, i Bankës së Shqipërisë datë e cila është dërguar RPA = 2,010,170 lekë).
- **4** masa administrative.
- **2** masa disiplinore.

<u>IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:</u>

Sipas shkresës së administruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar Tiranë të Drejtorit të Përgjithshëm z. E. B. me nr. 513 prot., 17.01.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Në lekë

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	47	47	0

Masa për shpërblim dëmi	9 46,132,617 lekë	9 46,132,617 lekë	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	6 126,513,139 lekë	6 126,513,139 lekë	0
Masa administrative	4	4	0
Masa disiplinore	2	2	0
Totali	**68**	**68**	**0**

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit:

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara	Vlera e arkëtuar
Masa organizative	47	1	7	15	24	0
Masa për shpërblim dëmi	9 46,132,617 lekë	3		3	3	
Masa për eliminimin e efekteve negative	6 126,513,139 lekë	0	0	2	4	0
Masa administrative	4	0	0	4	0	0
Masa disiplinore	2	0	0	0	2	0
Totali	68					
Totali në %	100%					

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është i ulët.

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

Në zbatim të nenit 15, gërma "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 9345/10 prot., datë 02.11.2021, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Në zbatim të nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 513 prot., 17.01.2022, duke respektuar kështu afatin 6 mujor të raportimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. MASA ORGANIZATIVE

1 Gjetje nga auditimi. Bordi i menaxhimit ka dokumentuar veprimtarinë nëpërmjet vendimeve të marra dhe të nënshkruara. Bordi i menaxhimit ka shqyrtuar propozimet e dërguara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të ARrSh, dhe ka marrë vendimet në lidhje me miratimin e hartimit të buxhetit vjetor dhe ri-alokimet e fondeve financiare, kalimin kapital të aktiveve, ankandin e aseteve, miratimin e rregullores së parandalimit të konfliktit të interesave, unifikimin e çmimeve të mirëmbajtjes, ripunimin e aktit mbi rrjetin rrugor dhe transferimin e rrugëve, etj.

Nga auditimi i veprimtarisë së Bordit të Menaxhimit konstatohet se, ka funksionuar në mungesë të një rregulloreje të miratuar dhe veprimtarinë e tij mbi bazën e një programi vjetor të miratuar si dhe mospërcaktimi i detyrave të sekretarit të bordit të menaxhimit sipas kuadrit rregullator në fuqi. Për sa më sipër është në kundërshtim me; - Ligjin Nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", neni 8-11; - Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 4-7, 11, 16-18; - VKM nr.276, datë 16.5.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar", Kreu II, pika 1/ germat "ë" dhe "f", Kreu III pika 4, germa "c", , Kreu III pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Bordi i Menaxhimit të marrë masa për hartimin e një rregulloreje funksionimi, planifikimi, dokumentimi dhe raportimin e veprimtarisë tij; analizën e zbatimit të vendimeve të marra; ushtrimin e kompetencave në kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave në veprimtarinë e institucionit.

Brenda datës 31.12.2021

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën Janar 2019-Shtator 2020, nga ana e Drejtorëve të Përgjithshëm të ARrSh (sipas periudhave respektive), konstatohet se nuk janë marrë masat për hartimin e raporteve për veprimtarinë ekonomike e financiare vjetore të institucionit. Si rrjedhojë, nuk janë dërguar për miratim në Bordin e Menaxhimit, për vitin 2018 dhe 2019, dhe nuk janë përcjellë as në Ministrinë e linjës administrative (MIE) raportet mbi performancën vjetore të institucionit ARrSh. Për sa më sipër është në kundërshtim me:, të ligjit Nr. 10164, datë 15.10.2009 *"Për Autoritetin Rrugor Shqiptar"*, neni 5, pika 2:, - VKM Nr. 276, datë 16.5.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të autoritetit rrugor shqiptar", pika 11 dhe 12 ; Kreu II. "Funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e Autoritetit Rrugor Shqiptar", pika 1/ë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për hartimin e raportit të veprimtarisë së institucionit duke e adresuar në arritjen e objektivave institucionale, paraqitjen e tij për miratim në Bordin e Menaxhimit dhe në ministrinë e linjës.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, nga ARRSH është paraqitur shkresa nr. 657/1 prot., datë 28.01.2021, e Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës Sektori i Planifikimit të Buxhetit me objekt "Dërgohen Raportet e monitorimit, evidencat mbi raportimin e shpenzimeve faktike buxhetore sipas produkteve për 12-mujorin e vitit 2020 dhe relacionin shpjegues, në Sektorin e Rrugëve", drejtuar MIE-së, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Me shkresën nr. 985/3 prot., datë 31.01.2022, të Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës Sektori i Planifikimit të Buxhetit me objekt "Dërgohen Raportet e Monitorimit, evidencat mbi raportimin e shpenzimeve faktike buxhetore sipas produkteve për 12-mujorin e vitit 2021 dhe relacionin shpjegues, në Sektorin Rrugor", drejtuar MIE-së, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Për sa trajtuar më sipër ARRSH ka dërguar pranë MIE-së raportet vjetore mbi realizimin e shpenzimeve faktike (performancën vjetore të institucionit) gjithashtu nuk ka dërguar për miratim në Bordin e Menaxhimit dhe në MIE jo raportet e veprimtarisë së institucionit duke adresuar arritjen e objektivave institucionale.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

3. Gjetje nga auditimi: Referuar shpenzimeve, Autoriteti Rrugor Shqiptar për vitin 2020 ka bërë një parashikim në planifikimin e Buxhetit afatmesëm për vitin 2020-2022, në vlerën 21,793,046 mijë lekë. Sipas ligjit nr.88, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i ndryshuar, është miratuar në vlerën 25,677,200 mijë lekë. Fakti i realizimit të shpenzimeve për periudhën Janar – Shtator vitit ushtrimor rezulton 16,760,551 lekë. Ndërkohë, realizimet e shpenzimeve për periudhën Janar – Shtator 2020 janë afërsisht 65%, vetëm për 9-mujorin, pra pak më shumë se gjysma e buxhetit e planifikuar për këtë periudhë, kjo sjell që për pjesën e mbetur të vitit kjo përqindje të thellohet akoma më tepër. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.88, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 33-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve, të marrin masa të përcaktojnë qartë në programin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përllogaritjes së kostos, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve të larta mes nivelit të programuar dhe atij të realizuar.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës harton Projekt Buxhetin Afatmesëm për fazën e parë dhe fazën e dytë të secilit vit buxhetor në mbështetje të tavaneve buxhetore të përcaktuara nga MIE. Në fazat e hartimit të PBA-së, parashikohen dhe objektet e reja që mund të realizohen në secilin vit buxhetor. Nevojat për objektet e reja dhe vlerat e parashikuara të tyre, DPBF i pasqyron në mbështetje të kërkesave të ardhura nga Drejtoritë e ARRSH-së. Përcaktimi i vlerave dhe i kostos së projekteve të reja, bëhet nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve dhe Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni justifikues për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Në shpenzimet e kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla u konstatuan problematika në kryerjen e tyre nga ku në mënyrë të përmbledhur rezultoi se;

- Në procesverbalin për përcaktimin e fondit limit mungon plotësimi i numrit të protokollit, **në 21 raste**.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, nuk argumentohet nevoja e kryerjes së prokurimit, në **11 raste.**
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se specifikimet nuk janë hartuar nga një specialist i fushës, **në 12 raste**.
- Bazuar në përshkrimin e ftesës për ofertë, AK ka kërkuar paraqitje të mostrave të produktit të prokuruar, në **2 raste.**
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, mungon urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim së bashku me procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallrave, **në 21 raste**.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se fatura e tatimore shitjes nuk është firmosur nga të tre anëtaret e komisionit, **në 16 raste**.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, evidentohet mungesa e nënshkrimit të Deklaratës për Konfliktin e Interesit nga anëtarët e Komisionit të Prokurimit, **në 15 raste**.
- Në hartimin e specifikimeve teknike janë përdorur kritere diskriminuese (emra të përveçëm, marka produkti), **në 1 rast**.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 23, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi 2 dhe 3, dhe neni 56, udhëzimi nr.3, datë 11.01.2018 "Për blerjet me vlerë të vogël", pika 8 dhe 19, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", neni 42 dhe 47. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Përgjegjësi i Prokurimeve, anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla të marrin masa që, për procedurat e prokurimit të BVV, të mos përsëriten shkeljet e konstatuara sa më sipër, gjithashtu të veprohet në përputhje me kuadrin rregullator ligjor në fuqi.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël janë prokuruar konform Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", si dhe rekomandimeve të APP-së. Zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla konstatohet se; Për vitin 2020 janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla *duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat normale të prokurimit*, **në shumën totale të fondit limit në vlerën 1,300,000 lekë pa TVSH**, procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim, dhe konkretisht është kryer procedura "Pjesë këmbimi dhe goma për automjetet", në muajin shtator 2020 me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSh, e vlerë kontrate në shumën 570,000 lekë pa TVSh dhe procedura "shpenzime blerje vaji filtra, bateri për automjetet", në muajin korrik 2020, me fond limit në shumën 500,000 lekë pa TVSh, dhe vlerë kontrate në shumën 324,500 lekë pa TVSh. Për rastet e mësipërme evidentohet se nga përgjegjësit e prokurimeve nuk janë analizuar dhe siguruar të dhënat e nevojshme sipas kërkesave të marra nga sektorët, për të krijuar një regjistër prokurimesh në përputhje me kuadrin rregullator të LPP. Veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu IV, neni 40, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Përgjegjësi i Prokurimeve dhe strukturat përgjegjëse të marrin masat që, në hartimin e regjistrave të prokurimit, të analizojnë dhe grupojnë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve.

Brenda datës 31.12.2021

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, regjistrat e prokurimit janë hartuar konform Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021, "Për hartimin e regjsitrit të parashikimeve të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik". Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni justifikues për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave, të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara të ARrSh-së, u konstatua se, **mungojnë analizat inventariale** të 5 (pesë) llogarive të Aktivit në Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të ARrSh, në shumën **310,352 mijë lekë** përkatësisht në, llogaritë: 202 "Studime e projektime", 210 "Toka, troje e terrene", 213, "Rrugë, rrjete, vepra ujore", 230 "Investime të AAGJ Jo materiale" 230 "Investime të AAGJ Materiale" *Sa sipër,* nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 7, "Dokumenti kontabël", Kreu II, të ligjit Nr. 25/2018, datë 10.5.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", pika1 si dhe **nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara** që nga viti 2010, që shënon marrjen e këtyre shumave në llogarinë e aktiveve. Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e *paragrafit nr. 107 dhe 110,* të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5, "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale", i përmirësuar, si dhe kërkesat e Kapitulli III, Seksionit II, "Aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara", të VKM nr. 783, datë

22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të ARrSh-së/Drejtoritë Rajonale, të marrin masat e nevojshme për kryerjen e analizave inventariale të zërave të aktivit me qëllim pasqyrimin e drejtë të tyre në pasqyrat financiare të konsoliduara të institucionit si dhe unifikimin e mënyrës së llogaritjes së amortizimit të aktiveve.

Brenda datës 31.12.2021

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, DPBF harton bilancin e ARRSH Qendër dhe bilancin përmbledhës të ARRSH-së. Sektori i Financës së Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, me shkresën nr. 2482 prot., datë 10.03.2021, "Kërkesë për informacion", i është drejtuar Sektorit të Mirëmbajtjes së Rrugëve dhe Sektorit të Sigurimit të Cilësisë dhe Dorëzimit, në lidhje me informacioni mbi objektet e kolauduara dhe marra përfundimisht në dorëzim. Me shkresën nr. 2482/2 prot., datë 24.03.2021, Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe Dorëzimit ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar. Mbështetur në informacionin e mësipërm, Sektori i Financës, në mbyllje të llogarive vjetore të vitit 2020 te ARRSH Qendër, ka kryer kalimin e vlerës prej 117,005,825,171 lekë, të objekteve të kolauduara dhe marrjes përfundimtare në dorëzim për periudhën 2007-2020 nga llogaria 231 "Aktive Afatgjata Materiale" në llogarinë 213 "Rrugë, Rrjete, Vepra Ujore". Mbi llogarinë 213 është aplikuar norma e amortizimit 1%. Ky veprim është pasqyruar dhe në Pasqyrat Financiare Vjetore të Konsoliduara te ARRSH-së. Gjithashtu, i njëjti veprim kontabël është bërë dhe në mbylljen e llogarive vjetore të vitit 2021. Mbështetur në informacionin e marrë nga Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Sektori i Financës ka kaluar vlerën prej 14,883,007,784 lekë, për objektet e kolauduara gjatë vitit 2021, nga llogaria 231 "Aktive Afatgjata Materiale" në llogarinë 213 "Rrugë, Rrjete, Vepra Ujore". Ky veprim është pasqyruar dhe në Pasqyrat Financiare Vjetore të Konsoliduara te ARRSH-së. Këto veprime kontabile janë pasqyruar në Pasqyrën F5 "Shënime Shpjeguese" dhe në Relacionin mbi hartimin e bilancit të vitit 2021. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH në pasqyrat financiare të vitit 2021, janë kryer reflektimet përkatëse gjë e cila është trajtuar edhe në shënimet shpjeguese.
Rekomandimi deri më datë 29.07.2022, është zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të kontabilitetit (llogaria 212), vlera e AQT “Ndërtesa” të regjistruar me koston historike është 34,520 mijë lekë, u konstatua se:

a. Në bilancet vjetore të institucioneve të varësisë të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të ARrSh për qëllime të konsolidimit të informacionit, përkatësisht në DRQ Tiranë, DRV Shkodër dhe DRJ Gjirokastër, rezulton se, në llogarinë 212 “Ndërtesa”, në ***11 raste****, objektet që janë në inventar kanë ndërruar destinacionin, janë tjetërsuar apo janë zënë nga privat***i** duke mos pasqyruar në mënyrë të drejtë gjendjen e aktiveve te qëndrueshme të trupëzuara.

b. Konstatohet se, në zërin “Ndërtesa” janë përfshirë Kati II, Kati III, Kati IV , Kati V dhe Shtesë kati nga Godina e ARrSh, por nuk është përfshirë sipërfaqja dhe vlera e katit të parë dhe bodrum, që janë në përdorim nga ky institucion. Nga ana e ARrSh i janë dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të KM dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesat me nr. 2506, datë 13.03.2019 dhe 2465, datë 11.03.2019 për kalimin në përgjegjësi administrimi të katit të parë dhe bodrumit të kësaj godine, por nuk ka asnjë përgjigje dhe veprim*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të ARrSh-së/Drejtoritë Rajonale, të marrin masat e nevojshme për kryerjen e procedurave dhe veprimeve kontabile për të gjitha ato aktive të cilat

nuk eksitojnë më, me qëllim pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të llogarisë "Ndërtesa" në pasqyrat e konsoliduara financiare të institucionit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 1682 prot., datë 14.02.2022, dhe Urdhrin nr. 23, datë 14.02.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së z. E. B. është ngritur komisioni për të bërë vlerësimin e aseteve, në mënyrë analitike për llogarinë 212 "Ndërtesa" që kanë në administrim të gjitha drejtoritë rajonale dhe ARRSH (Qendër). Me shkresën nr. 5493 prot., datë 09.05.2022, nga Komisioni i ngritur në zbatim të Urdhrit nr. 23, datë 14.02.2022, me shkresën nr. 5493 prot., datë 09.05.2022, ka mbajtur raport evidentimi dhe vlerësimi paraprak të aseteve "Ndërtesa" të ARRSH-së që kanë në administrim Drejtoritë Rajonale.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

7.2. Rekomandimi: Titullari i institucionit të RRSH-së, të vijojë komunikimin me MIE me qëllim kalimin në përgjegjësi administrimi të katit të parë dhe bodrumit të kësaj godine.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Në relacionin që shoqëron bilancin e konsoliduar, është vendosur shënimi që, llogaria 210 **"Toka, Troje, Terrene"** me vlerë **547,460 mijë lekë** është vlerë e mbartur që nga llogaritë vjetore të vitit 2006 dhe përfaqëson shpronësimet për segmentet rrugore, dhe që **nuk ka patur ndryshime gjatë vitit 2019"**.
Nga auditimi u konstatua se,
-Gjatë **vitit 2019 dhe 2020**, rezulton se, sipas **15 VKM** të nxjerra **janë kryer shpronësime për interes publik** për ndërtimin e segmenteve rrugore , sipas dokumentacionit të dërguar nga ana e Sektorit të Sigurimit të Tokës/ Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacional arrin vetëm për vitin 2019 gjithsej **621,793 mijë lekë, që nuk janë pasqyruar në këtë llogari**.
-Gjithashtu konstatohet se, **nuk është pasqyruar në kontabilitet vlera e truallit** për ARrSh dhe Drejtoritë Rajonale në vlerën totale për **229,812 mijë lekë** dhe konkretisht: për objektet ARrSh Tiranë, Zyra Qendrore për 39,047 mijë lekë, ARrSh Tiranë, Laboratori në vlerën për 9,004 mijë lekë, DRQ Tiranë në vlerën për 151,402 mijë lekë, DRJ Gjirokastër në vlerën për 30,358 mijë lekë ndërkohë nuk ka informacion për RDRV Shkodër. Nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)", paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"
-Konstatohet se, nga ana e ARrSh **nuk është kryer asnjë veprim për marrjen në listën e inventarit të ARrSh të objekteve të përcaktuara në VKM nr.78, datë 3.2.2016** *"Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës,* ***për Autoritetin Rrugor Shqiptar****,* ***të disa sipërfaqeve të truallit funksional****, brenda territorit të pronës nr. 1019, me emërtim "Reparti Ushtarak nr. 4030, aerodromi", me vendndodhje në Urën Vajgurore, Berat, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave*

të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së mbrojtjes", të ndryshuar, (Fletorja Zyrtare, viti 2016 - numri 19*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të ARrSh-së/Drejtoritë Rajonale, të marrin masat e nevojshme për kryerjen e procedurave dhe veprimeve kontabile me qëllim përfshirjen në kontabilitetin e institucionit të të gjitha shpronësimeve të kryera për interes publik si dhe vlerës së truallit të pa regjistruar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, përsa i përket Drejtorive Rajonale, këto Drejtori nuk kanë në llogarinë e tyre shpronësime, pasi nuk kanë patur investime në rrjetin rrugor. Në Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2021, të ARRSH Qendër, vlera 9,257,486,727 lekë e shpronësimeve të periudhës 2008-2021 është zbritur nga llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale" dhe është kaluar te llogaria 210 "Toka, troje, terrene". Kjo është pasqyruar dhe në Pasqyrat Financiare Vjetore të Konsoliduara të ARRSH. Ky veprim kontabël është sqaruar ne formatin F5 si dhe në relacion mbi Pasqyrat Financiare Vjetore të ARRSH (Qendër) si dhe Pasqyrat Financiare Vjetore të Konsoliduara të vitit 2021.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

8.2. Rekomandimi: Titullari i ARRSH-së, të marrë masat e nevojshme me qëllim marrjen e listës së inventarit të ARrSh të objekteve të përcaktuara në VKM nr.78, datë 3.2.2016 dhe pasqyrimin e këtyre objekteve në Pasqyrat Financiare të ARrSh-së.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Drejtoria e Rajonit Verior duke qenë një institucion në varësi, e ka të pamundur pasqyrimin e këtyre akseve referuar inventarit të miratuar me VKM, pasi një procedurë e tillë që të jetë tërësisht e ezauruar, duhet që ky inventar të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, dhe të bëhet kalimi në pronësi të ARRSH të këtyre akseve, ku më pas të ndahen sipas drejtorive. Ky proces ka nisur dhe zbatimi i rekomandimit në fjalë, do jetë ne vijimësi.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë **213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"** në vlerën për **37,894,858 mijë lekë** sipas formatit nr. 7/a *"Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*" të pasqyrave financiare, u konstatua se, përgjatë vitit 2019, ndonëse kanë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim investime të përfunduara, **ato nuk janë kontabilizuar dhe pasqyruar në rritje të aktiveve të trupëzuara** referuar kërkesave të Kapitullit II, "Rregulla të përgjithshme për pasqyrat financiare vjetore", të VKM nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël", dhe Manualit të Klasifikimit Ekonomik**.** Gjithashtu konstatohet se, "Rrugët dhe rrjetet rrugore" nuk janë evidentuar në kontabilitet sipas karakteristikave të përcaktuar në Ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 2, pika 2, ku përcaktohet se, "*Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale rrugët klasifikohen autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore, rrugë urbane kryesore, rrugë urbane dytësore dhe rrugë lokale*". Për pasojë**, nuk ka një vlerë të saktë dhe të drejtë të zërave të mësipërm dhe vlerës së konsoliduar në pasqyrat financiare të shtetit.**
-Ndonëse me Vendimin e Bordit të Menaxhimit nr. 10, datë 27.05.2020 është miratuar propozimi i paraqitur mbi inventarin e rishikuar të rrjetit rrugor kombëtar, ende nuk është miratuar VKM-ja për aprovimin e këtij inventari, në përputhje me përcaktimet e Kodit Rrugor.

-Konstatohet se, nuk është ndjekur një politikë kontabile e unifikuar dhe e standardizuar midis ARrSh dhe Drejtorive Rajonale në lidhje me amortizimin e rrjetit rrugor kombëtar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit)..
9.1. Rekomandimi: Strukturat drejtueses të ARrSh-së në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, nisur nga problematikat e shumta të bëjnë të mundur **rishikimin e inventarit të rrjetit rrugor dhe saktësimin e tij përfundimtar**, i cili është përfunduar nga ana e strukturave përgjegjëse të ARrSh, por nuk është finalizuar ky proces nëpërmjet inicimit të një VKM, me qëllim shfuqizimin e të gjithë VKM të mëparshme dhe ndarjen përfundimtare në mënyrë ekzakte të rrjetit të rrugëve kombëtare nga ato rurale, bazuar përcaktimeve në Kodin Rrugor.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar. **Koment i grupit të auditimit:** Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, është miratuar dhe publikuar VKM nr. 600 date 13.10.2021. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi **regjistrimin e pasurisë së paluajtshme,** *u konstatua se,* nga ana e strukturave drejtuese të ARRSH, për periudhën objekt auditimi, **pasuritë e paluajtshme rezultojnë të regjistruara në mënyrë jo të plotë** në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë dhe më pas në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë 07.01.2005.
-Nuk është regjistruar sipërfaqja totale e Ndërtesës së ARRSH prej 1379,92 m2, por është pasqyruar në kartelën dhe certifikatën e regjistrimit të pronësisë në ZVRPP vetëm 439 m2, ose nuk janë regjistruar në kartelat e pronësisë së institucionit 940.92 m2, Bazuar në Fletën e Inventarit të hartuar nga Komisioni i Inventarizimit të pasurisë, në inventarin e llog.212. "Ndërtesa" përfshihen 6 zëra (nga këto, një objekt është godina e ARRSH me përfshirjen e Katiti 2, 3, 4, 5 dhe shtesës) dhe objektit "Laboratori", me vlerë kontabile prej 3,622,664 lekë.
-Nga krahasimi i Hartës Treguese dt. 29.01.2019 që shoqëron Vërtetimin e Pronësisë ZVRPP Tiranë të datës 23.04.2019, me Planin e Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, konstatohen **kundërshtim** në pasqyrimin e objekteve ndërtimore, si vijon: Në Certifikatën për Vërtetimin e Pronësisë me nr. 1867034, datë 23.4.2019 për ZK nr. 8320, nuk janë pasqyruar dy objektet (objekti "H" sipas Plan Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, përkatësisht me sipërfaqe 401 m2 dhe një shtojcë ngjitur me zyrat 2 katëshe).
Për DRV Shkodër: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk është regjistruar pronësia dhe nuk disponohen certifikata për DRV Shkodër nga ZVRPP e përfshira në këtë rajon dhe sipas pasqyrave të inventarit të dërguara në ARrSh shumica e objekteve rezultojnë të dëmtuara..
Për DRJ Gjirokastër: Rezulton se bazuar në certifikatën e pronësisë sipërfaqja e truallit rezulton 3,556 m2, ndërsa sipas VKM nr. 3, datë 07.01.2005 rezultojnë sipërfaqe trualli prej 2,607 m2, duke mos patur përputhje të këtyre shifrave dhe arsyetim të gjurmës së auditimit për diferencën e sipërfaqes së regjistruar me atë sipas VKM përkatëse. Sipas VKM nr. 789, datë 07.10.2020 është vendosur ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të kësaj pasurie me sipërfaqe prej 3,556 m2 duke kaluar nga ARrSh të DPSHTR.
- për objektet e tjera të përfshira në këtë rajon nuk disponohen certifikatat e regjistrimit të pronësisë. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë

07.01.2005, gjë që tregon për parregullsi dhe pasaktësi dokumentare. Nuk kanë gjetur zbatim të plotë kërkesat e Kreut 3.7, paragrafi 85, i UMF nr. 8, 2018, në lidhje me shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore, pasi ato nuk japin informacion të përgjithshëm në lidhje me rakordimet financiare me debitorët dhe kreditoret në lidhje me elementë specifikë të pasqyrave financiare të dorëzuara, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARRSH-së, të marrin masat e nevojshme me qëllim regjistrimin e pasurisë për të gjitha rastet e konstatuara si të pa regjistruara si dhe rifreskimin e kartelave të regjistrimin të pasurisë së paluajtshme apo për të gjithë ato objekte për të cilat janë konstatuar problematika në drejtim të regjistrimit jo të saktë të tyre.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura, u konstatua se,

a. vlerat e raportuara si detyrime të pa likuiduara deri më datën 31.12.2019 nga ana e Ministrisë së linjës (MIE), ku integrohet dhe raportimi i ARrSh-së, nuk rakordojnë me pasqyrat financiare të konsoliduara të ARrSh Tiranë si dhe me sistemin e të dhënave të raportuara për detyrimet e prapambetura të ARrSh,(në vlerë dhe në strukturë), për vlerën prej **97 milionë lekë më shumë për ARRSH-në.** Sa sipër, nuk janë zbatuar përcaktimet e VKM nr. 50, datë 05.02.2015 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin edhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", UMF nr.5 datë 27.2.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetur", i ndryshuar dhe UMF nr. 28, datë 18.12.2014, i ndryshuar.

b. Konstatohet se**, ka një mospërputhje në vlerën e borxhit për 1.3 milion lekë** ndërmjet vlerës së paraqitur në bilancin e konsoliduar të institucionit prej 3,751 milion lekë me shumën e stokut të raportuar me datën 24 Janar 2020 si shifër e detyrimit të prapambetur prej 3,750 milion lekë. Nga ana tjetër, konstatohet se në bilanc, në kolonën 41, Formati 1 të Bilancit Kontabël 2019, llogaria 486 "Shpenzime për periudhat e ardhshme" është pasqyruar për 3,752 milion lekë, ose 2,6 milion lekë më shumë se stoku i detyrimeve. Sa sipër, nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i paragrafit nr.42, kapitulli 3.1,"Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të UMFE nr. 8, date 9.3.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"

c. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion evidentohet se, fondet operative (llogaria buxhetore 602) të papërdorura në datën 31.12.2019 ishin **90 milion lekë** një vlerë kjo e konsiderueshme, sidomos në kushtet e ekzistencës së një stoku të lartë borxhi, që nuk janë adresuar për likuidimin e detyrimeve të kontratave të mirëmbajtjes (brenda llogarisë së shpenzimeve operative, llog.602), e cila me 31.12.2019 ekspozonte saldon debitore prej **358 milion lekë**, detyrime të mbartura nga viti 2018 gjë që tregon për menaxhim joefektive të fondeve buxhetore nga ana e drejtorive rajonale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARrSh-së/Drejtori i Përgjithshëm, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim përmirësimin e situatës në lidhje me raportimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga kryerja e testimeve në Modulin e Pagesave të SIFQ, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor**.** Bazuar dhe në Regjistrin e detyrimeve të prapambetura, evidentohet se me datën 31.12.2019 rezultojnë detyrime të pa likuiduara në tejkalim të afatit 30 ditor, (madje ekzistojnë detyrime me afat krijimi deri në 515 ditë), të cilat e ekspozojnë ARrSh përballë kërcënimeve dhe risqeve të shumta të penaliteteve për shkelje të afateve të likuidimit të detyrimeve të pagesës sipas kontratave të nënshkruara midis palëve. Kështu, stoku i detyrimeve të prapambetura evidenton një nivel të lartë detyrimi ndaj operatorëve ekonomikë si në ndërtimin e akseve rrugore, ashtu dhe në mirëmbajtjen e tyre.
Shuma e stokut të detyrimeve të ARrSh më 31.12.2019 është **3,752 milionë lekë**, dhe përfaqëson **45.7 % të detyrimeve të prapambetura** në shkallë vendi, që sipas matricës së hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku totali i detyrimeve më 31.12.2019 janë 8,200 milionë lekë. Si pasojë e ndërmarrjes së angazhimeve pa patur fondet në dispozicion, janë krijuar implikime e risqe të shoqëruara me lindjen e detyrimeve të reja (të prapambetura).
Duke u bazuar në vlerën e stokut të detyrimit prej 3,752 milionë lekë, vetëm për një muaj efektet e mundshme të penaliteteve nga llogaritja e kamatëvonesave ligjore, (llogaritur vetëm për një muaj, bazuar në formulën ekonomike : I = C x r x (t:360), precedentin e Vendimit Gjyqësor të shoqërisë "V. I. I.", do të rezultonte një efekt financiar që kërcënon fondet e buxhetit të shtetit prej 28,9 milionë lekë, si më poshtë: (3,752 milionë x 9.25 % x (30 :365)= 28,9 milionë lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*
12.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARrSh-së/Drejtori i Përgjithshëm, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive dhe nisjen e masave administrative apo disiplinore për personat përgjegjës.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, për pamjaftueshmërinë e fondeve dhe mundësinë e krijimit të detyrimeve të prapambetura e ka shprehur gjithmonë që në fazën e hartimit te PBA-së për secilën fazë si dhe në fazën e detajimit të buxhetit, si dhe ka dërguar vazhdimisht në MIE, kërkesat për fonde buxhetore shtesë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara si dhe ka kërkuar fonde buxhetore shtesë për financimin e objekteve deri në fund të secilit vit buxhetor për të eliminuar krijimin e detyrimeve të prapambetura. Detyra funksionale e Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës është që ti paraqesë në mënyrë të vazhdueshme kërkesat për fonde shtesë në MIE. Tavanet buxhetore ARRSH-së i caktohen nga MFE dhe tavanet e caktuara janë më të vogla sesa nevojat reale që ka ARRSH-ja për realizimin e objektivave të saj si institucion. Kjo shprehet në relacionin shoqërues të shkresës nr. 10379.3 prot., datë 30.12.2020, "Përcillet Vendimi i Bordit të Menaxhimit të ARRSH-së "Mbi detajimin e buxhetit për vitet 2021-2022-2023 për zërin investime me financim të brendshëm, financim të huaj dhe shpenzimet korrente, në programin "Transporti Rrugor". Gjithashtu dhe në relacionin shoqërues të shkresës nr. 834.3 prot., datë 26.01.2022, "Përcillet Vendimi i Bordit të Menaxhimit të ARRSH-së "Mbi detajimin e buxhetit për vitet 2022-2023-2024 për zërin investime me financim të brendshëm, financim të huaj dhe

shpenzimet korrente, në programin "Transporti Rrugor". Me shkresën nr. 985.3 prot., datë 31.01.2022, "Dërgohen raportet e monitorimit, evidencat mbi raportimin e shpenzimeve faktike buxhetore sipas produkteve për 12-mujorin e vitit 2021 dhe relacionin shpjegues në Sektorin Rrugor", tregohet që ARRSH e ka mbyllur vitin 2021 pa detyrime të prapambetur në zërin financimi huaj, kontratat e mirëmbajtjes dhe zërit investime me financim të brendshëm. Viti 2021 është mbyllur me detyrime të prapambetura vetëm në zërin Vendime Gjyqësore në Proces në vlerën 133,711,658 lekë.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare u konstatua se,
-Transferime kapitale të aktiveve nuk janë shoqëruar me aktet e konfirmimit nga institucioni marrës.
-Nuk kanë gjetur zbatim vendimet e BM në lidhje me kalimin kapital të mjeteve tip rul-vibrues për Bashkinë Gjirokastër dhe automjetin tip Mitsubish Station Pajero për Bashkinë Memaliaj, si dhe nuk ka gjurmë të Auditimit për njoftimin e këtij institucioni mbi vendimmarrjen e Bordit të Menaxhimit, me qëllim inicimin e praktikave të transferimit të aktiveve.
-Nga ana e magazinierit janë mbajtur kartelat e inventarit ekonomik për çdo zyrtar dhe drejtori, por nuk është mbajtur libri i magazinës për të saktësuar gjendjen e magazinës për çdo artikull. Si rrjedhojë, nuk janë kryer rakordime periodike mujore apo tre mujore nga ana e Sektorit të Financës me magazinën. Regjistrimet e veprimeve me magazinën e ARrSh si për dokumentet letë-hyrje, fletë-dalje, etj., janë kryer nga ana e Sektorit të Financës në ditarin e magazinës, duke kontabilizuar efektet e veprimeve ekonomike në llogarinë dhe nën llogarinë që i përket veprimit ekonomik.
-Në Rregulloren e Brendshme të ARrSh-së, nuk janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit që është përgjegjës për administrimi material (magazinierit).
-konstatohet se kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, nuk janë nënshkruar nga personat materialisht përgjegjës që kanë këto inventarë në ngarkim sipas kartelave të prera, por janë nënshkruar në çdo rast vetëm nga komisioni i inventarizimit dhe nga magazinieri, duke treguar për një proces formal dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.
-Nga ana e strukturave drejtueses, nuk ka veprime të mëtejshme pas relacionit të përgatitur nga ana e komisionit të vlerësimit në lidhje me aktivet të cilat janë propozuar për dalje nga përdorimi. Veprimet e lartpërmendura bien në kundërshtim me udhëzimin nr. 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*
13.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARrSh-së të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim plotësimin e dokumentacionit të munguar referuar dispozitave ligjore në fuqi si dhe përmirësimin e rregullores së brendshme të funksionimit të ARRSH-së në drejtim të përcaktimit të detyrave të magazinierit të institucionit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

14. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e strukturës janë përcaktuar detyrat funksionale të çdo drejtorie dhe sektori por:
- nuk është e përcaktuar dhe e ndarë për çdo post pune specialisti.

- nuk ka të përshkruar asnjë procedurë për vlerësim performancë në punë dhe nuk është kryer asnjë vlerësim pune periodik dhe as për ngritjen në detyrë apo përfundimit të periudhës së provës.
- nuk ka të përcaktuar llojin dhe nivelin e arsimimit, eksperiencën në punë që duhet të plotësojë çdo punonjës për postin e punës që mbulon.

Si dhe nuk është i bashkëlidhur si formular në vendimin nr. 21, datë 10.11.2020, "Mbi miratimin e formularit "Vlerësimi i Punës" për punonjësit në Autoritetin Rrugor Shqiptar". Gjithashtu, ARrSh-ja nuk ka të përcaktuar llojin dhe nivelin e arsimimit, eksperiencën në punë për çdo punonjës sipas kërkesave të punës që kryen. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 276, datë 16.05.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar", pika 6 dhe 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të marrin masa të përcaktojnë qartë çdo post pune, të miratojnë me dokumentat bashkëlidhur "Vlerësimin e Punës", sipas performancës së punës së çdo punonjësi për ngritjet në detyrë, përfundimin e periudhës së provës dhe vlerësimin periodik, si dhe të përcaktohet lloji i nivelit të arsimimit, eksperienca në punë që duhet të plotësojë çdo punonjës për pozicionin e punës që mbulon.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Rregulloren e Brendshme janë të përcaktuara detyrat funksionale të drejtorisë dhe sektorit. Shpërndarja e detyrave brenda sektorit do të realizohet në vazhdimësi. Ashtu sikurse e kemi shprehur në observacionet e mëparshme:
1.Është miratuar me Vendim Bordit Nr. 21, datë 10/11/ 2020 formulari i "Vlerësimit të Punës " për punonjësit në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Gjithashtu ju informojmë se është realizuar vlerësimi vjetor i punonjësve për vitin 2020. (*bashkëngjitur Vendim Bordit Nr. 21, datë 10/11/ 2020 dhe një formular vlerësimi –shembull- **DOC 1**).*
2.Është realizuar vlerësimi i punës për punonjësin pas përfundimit të periudhës së provës. *(bashkëngjitur një formular vlerësimi shembull -**DOC 2**)*
3.Në lidhje me llojin e arsimimit, në shpalljen e vendit vakant në faqen e ARRSH përcaktohet sipas nevojave të institucionit rast pas rasti, realizuar shpallja e vendeve vakante me Urdhri Nr.204, datë 08/10/2020 për " Proçedurën e shpalljes së vendit vakant në faqen zyrtare të Autoritetit Rrugor Shqiptar. *(bashkëngjitur Urdhri Nr.204, datë 08/10/2020 dhe lista e shpalljeve të pozicioneve vakante – **DOC 3**).*
4. Për eksperiencën në punë është e shprehur në rregullore konkretisht neni 16 "Kërkesa të përgjithshme për të qenë punonjës i Autoritetit, konkretisht pika j dhe k"
j) Personat që kandidojnë për pozicionin përgjegjës sektori, përveç kërkesave të pikës 1, të këtij neni, duhet të kenë edhe të paktën 2 vjet eksperiencë pune.
k)Personat që kandidojnë për pozicionin Drejtor Drejtorie përveç kërkesave të pikës 1, të këtij neni duhet të kenë edhe të paktën 5 vite eksperiencë pune.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht .

15. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e emërimeve vërehet që ARrSh-ja nuk e ka të përcaktuar datën e fillimit të marrëdhënieve të punës për punonjësit. Gjithashtu, në kundërshtim me kërkesat e miratuara nuk përcakton pagën e punonjësit bashkë me elementët përkatës të pagës. Për çdo emërim në detyrë konstatohet se në urdhrin e emërim ka vetëm emërimin në postin e punës dhe datën e fillimit të marrëdhënieve të punës por mungon përcaktimi i pagës dhe elementët përbërës të saj, element i cili është përcaktuar në dokument të dytë të firmosur nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme. Për sa më sipër është në kundërshtim me Nenin 19 "Akti i emërimit" të Rregullores së Brendshme të Funksionimit të ARrSh-së, miratuar me Vendimin

e Bordit të Menaxhimit nr. 10, datë 04/09/2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar).*

15.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të marrin masa të përcaktojnë qartë në çdo rast emërimesh datën e fillimit të marrëdhënieve të punës si dhe pagën bashkë me elementët përkatës të kësaj të fundit.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 11665 prot., datë 23.12.2021, znj. M. Sh. është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm z. E. B. me një relacion në lidhje me zbatimin e rekomandimit 15.1, ku bashkëlidhur këtij relacioni ka vendosur shkresën nr. 10362/5 prot., datë 19.11.2021, në të cilën ndodhet emërimi i punonjësit znj. J. Gj. ku në këtë emërim është përcaktuar paga dhe data e fillimit të marrëdhënieve të punës. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH është paraqitur si dokumentacion justifikues vetëm një rast emërimi punonjësi në kushte të tilla zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

16. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i ngritjeve në detyrë nuk ka procedura vlerësimi performance dhe të marrëdhënieve të punës u konstatua se ka 12 raste ngritje në detyrë për të cilat nuk ka asnjë procedurë vlerësimi performance por vetëm me urdhër titullari duke mos siguruar transparencë dhe kushte të barabarta midis punonjësve.
Për sa më sipër në kundërshtim Kodin e Punës i Republikës së Shqipërisë, neni 9. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa që për çdo rast të ketë një procedurë të mirëfilltë për vlerësimin e performancës së punës së punonjësve menjëherë pas miratimit të formularit të "Vlerësimit të Punës".

Menjëherë pas miratimit të formularit "Vlerësimi i Punës"

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 11665 prot., datë 23.12.2021, znj. M. Sh. është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm z. E. B. me një relacion në lidhje me zbatimin e rekomandimit 16.1, ku bashkëlidhur këtij relacioni ka vendosur shkresën nr. 8580/1 prot., datë 10.11.2020, dhe Vendimit të Bordit të Menaxhimit me nr. 21, datë 10.11.2020, është miratuar formulari i vlerësimit të punës për punonjësit e ARRSH-së. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH është paraqitur si dokumentacion justifikues formulari i vlerësimit të punës i miratuar nga Bordi i Menaxhimit por nuk është paraqitur vlerësime konkrete të punonjësve në kushte të tilla zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

17. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi rezulton se janë dhënë 17 masa disiplinore për marrëdhëniet e punës 5 masa "Vërejtje me shkrim" dhe 12 masa "Vërejtje me paralajmërim"), këto masa janë bazuar në nenin 11 "Masat disiplinore" të kontratës individuale, në Rregulloren e Brendshme të institucionin nuk ka asnjë nen që të parashikojë procedurën e plotë administrative për dhënien e masave disiplinore ku punëmarrësit ti garantohen e drejta për t'u informuar dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Për sa më sipër është në kundërshtim me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë dhe Kontrata

Individuale e Punës së ARrSh-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa që të plotësohen dhe përmirësohen parashikimet e kontratës individuale të punës së institucionit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

18. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka 8 raste të uljes në detyrë nga Drejtor Drejtorie në Përgjegjës Sektori 1 rast dhe nga Përgjegjës Sektori në Specialist në 7 raste. U audituan me zgjedhje 3 prej tyre. Procedura nuk është e parashikuar në rregulloren e brendshme të institucionit si dhe nuk ka vlerësim pune dhe nuk është dokumentuar komunikimi i kësaj lëvizjeve dhe dakortësia e punonjësit. Për sa më sipër në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ARrSh-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin dhe përmirësimin e rregullores së brendshme për përfshirjen e procedurave të uljes në detyrë.

Menjëherë pas miratimit të formularit "Vlerësimi i Punës"

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

19. Gjetje nga auditim: Deri në fund të periudhës objekt auditimi u konstatua se ka 20 procese gjyqësore për marrëdhëniet e punës në proces në të dy shkallët e gjykimit (11 në shkallën e parë dhe 9 në shkallën e apelit). Për periudhën objekt auditimi janë ekzekutuar 5 vendime të gjykatës për marrëdhëniet e punës në total 9,793,030 lekë nga të cilat 9,126,599 lekë janë për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i gjykatës dhe 666,431 lekë shpenzime për shërbim përmbarimor. Vlera prej 9,793,030 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar me strukturat përkatëse, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, të marrin masa që largimet nga puna të jenë konform kërkesave të rregullores dhe kontratave. Gjithashtu, të ketë një planifikim buxheti të saktë që Vendimet e Gjykatës të ekzekutohen pa lindur nevoja e shpenzimeve për shërbimin përmbarimor.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, largimet nga puna janë realizuar konform kërkesave të rregullores dhe kontratës individuale të punës. Lidhur me

planifikimin e buxhetit, theksojmë se raportimi për detyrimet monetare, për vendimet gjyqësore të formës së prerë bëhet çdo muaj nga ana e Sektorit Juridik dhe Përputhshmërisë, drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës. Ndërsa ekzekutimi i një vendimi gjyqësor si titull ekzekutiv, bëhet konform dispozitivit të vendimit. Një ndër pikat e çdo vendimi gjyqësor (vendime të cilat janë kryesisht të gjykatës administrative) përmban përcaktimin "Ky vendim gjyqësor përben titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij ngarkohet shërbimi përmbarimor". Kjo, bazuar në nenin 65 të Ligjit nr. 49/2012, ku parashikohet si vijon: "1.Vendimi përfundimtar i gjykatës administrative, që ka marrë formë të prerë, dhe vendimi për sigurimin e padisë vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor me kërkesën e kreditorit". Sa më sipër, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore nëpërmjet shërbimit përmbarimor (veçanërisht kur specifikohet edhe në dispozitivin e vendimit), përbën në fakt një detyrim ligjor. ARRSH në rast kërkesë për ekzekutim vullnetar, e ka kryer pagesën direkt ndaj kreditorit, pa shërbim përmbarimor. Në të kundërt ka detyrimin që ta kryej pagesën nëpërmjet përmbaruesit, si detyrim ligjor. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk janë paraqitur si dokumentacion justifikues si është procedura në raste të ndërprejes së marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj por gjithashtu nuk është paraqitur detajimi ose analiza e buxhetit për të cilat janë planifikuar fondet për likudimin e detyrimeve të cilat lindin nga proceset gjyqësore si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

20. Gjetje nga auditimi: Me përzgjedhje rastësore i dosjeve personale të stafit të ARrSh në lidhje me dokumentacionin që përmbanin u konstatuan mangësitë e mëposhtme:
Në disa raste ka dokumente në lidhje me arsimimin të panoterizuara, libreza pune fotokopje, në dy rast mungon raporti mjeko-ligjor.
- Konstatohet se të gjithë punonjësit e ARrSh nuk kanë nënshkruar vetë deklarata në lidhje me "Lidhje të mundshme me Kontraktor të ARrSh" dhe "Lidhje familjare" në kundërshtim nenin 16 "Kërkesa të përgjithshme për punonjësit e " të Rregullores së Brendshme të Funksionimit të ARrSh miratuar me Vendimin e Bordit të Menaxhimit nr. 10, datë 04/09/2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
20.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin dosjeve me të gjithë dokumentet sipas kërkesave të sanksionuara në rregulloren e brendshme si dhe deklaratës së konfliktit të interesave për të gjithë punonjësit e ARrSh-së.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, është bërë verifikimi i të gjitha dosjeve në lidhje me plotësimin e dokumenteve sipas kërkesave të sanksionuara në rregulloren e brendshme, gjithashtu është plotësuar deklarata e konfliktit të interesit nga të gjithë punonjësit (Autorizimi i miratuar me Udhëzim nr.622, datë 30.11.2012). Për sa trajtuar më sipër me shkresën nr. 11665 prot., datë 23.12.2021, znj. A. G. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme është drejtuar me memo Drejtorit të Përgjithshëm z. E. B. në lidhje me zbatimin e rekomandimit nr. 20.1, në të cilën bashkëlidhur ndodhet edhe modeli tip i autorizimit si dhe një model i plotësuar nga punonjësja znj. B. D., në kushte të tilla zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

21. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit rezultoi se; në 6 raste, nga Njësia e Prokurimit (NjP), në procesverbalin e mbajtur mbi hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, konstatohet se janë vendosur kritere të cilat janë konfuze në disa raste, nuk janë

të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht, konkretisht për pajisje e automjete, pa dhënë shpjegimet përkatëse të cilat duhet të jenë në përputhje me grafikun e ekzekutimin e punimeve dhe volumin e tyre. Pra nga AK kriteret duhet të vendosen kritere sipas qëllimit të LPP në atë mënyrë që ti shërbejnë objektit të kontratës, të jenë në përputhje me punët apo shërbimet që do të kryhen dhe të argumentohen në mënyrë të kuptueshme për të gjithë OE pjesëmarrës. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.12.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 1, me nenin 2, parimet e përzgjedhjes, si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi II. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar).*

21.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i hartimit të kritereve të merren masat që në të gjitha rastet të argumentohet çdo kriter të vendosur me qëllim shmangien e paqartësive nga Operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", gjithashtu, Rekomandimit nr. 1797/1 prot, datë 10.03.2022, "Mbi Hartimin e Kritereve për Kualifikim për Procedurat e Prokurimit për Mallra, Pune, Shërbime", Rekomandimit nr. 3872 Prot., datë 10.06.2021, "Mbi hartimin e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim", Njësia e Prokurimit ka argumentuar çdo kriter të vendosur në DST, në të gjitha procedurat e prokuruara, duke mbajtur në dosjen e tenderave përkatës dhe publikuar në SPE Procesverbalin e argumentimit të kritereve të kualifikimit për çdo procedurë dhe tip kontrate. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni jusitifikues për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

22. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit u konstatua se; në 6-raste fondi limit i evidentuar në regjistrin e parashikimeve, nuk është i njëjtë me fondin limit në fazën e shpalljes së procedurës, kjo për faktin se, në momentin e hartimit të regjistrit fondi limit është hedhur me TVSh, ndërkohë që FL duhet të evidentohej pa TVSh. Veprime në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 4 dhe neni 9, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Përgjegjësi i Prokurimeve të merren masat e duhura që, plotësimi i regjistrit të realizimeve dhe hedhja në sistem e fondit të secilës procedurë të evidentohet pa TVSh.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, regjistrat e prokurimit janë hartuar konform Udhëzimit nr. 04, datë 18.06.2021, "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik". Ne regjistrat e realizimeve fondi për çdo procedure është hedhur pa TVSH. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni jusitifikues për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

23. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit konstatohet se; në 5 raste, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, publikimi i njoftimit të kontratës për shpalljet e procedurave të reja është kryer me datë 22.10.2019, çka do të thotë se janë marrë angazhime të cilat nuk mund të kryhen dhe likuidohen brenda mbylljes së vitit buxhetor, pra pas datës 15 tetor, për të cilën sipas DST-ve, kontrata me OE fitues i shtrin afatin për 12 muaj nga data e lidhjes së saj. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 51, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 76, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Përgjegjësi i Prokurimeve të merren masat e duhura që, shpallja e procedurave të reja të prokurimit të bëhet brenda afateve ligjore me qëllim shmangien e marrjes së angazhimeve jashtë afateve që shtrihen përtej vitit buxhetor.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Titullari i ARRSH-së dhe Përgjegjësi i Prokurimeve kanë marrë masat e duhura që, shpallja e procedurave të reja të prokurimit të bëhet brenda afateve ligjore, përveç procedurave të reja që janë me akt normativ të ri. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni justifikues për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

24. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Urës së Zemblakut", me fond limit në shumën 43,049,588 lekë pa TVSh, me OE fituese në shumën 32,370,126 lekë pa TVSh, u konstatua se; Vendimi KVO për rivlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar është bërë me datë 26.12.2019, në të cilin është klasifikuar OE fitues, gjeneruar gjithashtu edhe në sistemin elektronik të prokurimeve. Raporti përfundimtar i hartuar nga KVO dhe nënshkruar nga titullari i AK është mbajtur me datë 07.02.2020, administruar me shkresën nr. 1142prot. Formulari i njoftimit të fituesit është dërguar me shkresën nr. 1142/1prot, datë 07.02.2020, i cili është publikuar në Buletinin nr. 6, datë 17.02.2020 të APP. Pra nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se njoftimi i fituesit i cili duhet të dërgohej për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike, nuk është dërguar brenda 5 ditëve. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, referuar nenit 58, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar, të merren masat që, me përfundimin e procedurës dhe shpalljen e fituesit të dërgohet njoftimi në APP.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, për të gjitha procedurat e prokuruara nga ARRSH, janë respektuar afatet ligjore (hapja dhe vlerësimi i ofertave, shpallja e Njoftimit të Fituesit, Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar shpallur në SPE, brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontrates, si dhe për procedurat e anuluara është shpallur Njoftimi i anulimit. Të gjitha fazat e procedurave të prokurimeve janë ndjekur konform LPP. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni jusitifikues për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

25. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Urës së Leklit", me fond limit në shumën 10,852,985 lekë, me OE fituese në shumën 7,372,740 lekë pa TVSh, u konstatua se; Procesverbali i hartimit të kritereve të veçanta të kualifikimit dhe Dokumentet standarde të Tenderit nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e NjP, dhe konkretisht nga zj. Miranda Shkurti, në cilësinë dhe të përgjegjësit të prokurimeve. Veprim në kundërshtim me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Përgjegjësi i Prokurimeve të merren masat e duhura që të gjitha dokumentet e tenderit të nënshkruhen nga komisionet e krijuara për këtë qëllim.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Personat përgjegjës të prokurimeve kanë marra masat e duhura që komisionet e krijuara për procedurat e prokurimit të nënshkruajnë çdo dokumentacion në baze të Rekomandimit tuaj. Të gjitha fazat e procedurave të prokurimeve janë ndjekur konform LPP. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni justifikues për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

26. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit rezultoi se, në 3 raste me vlerë totale 708,731,493 lekë pa TVSH, ARrSh ka shpallur procedura prokurimi ndërkohë që sipas udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, është njoftuar që të gjitha procedurat e prokurimit ishin pezulluar për shkak të pandemisë së Covid-19, ku në njoftim përcaktohet se Autoritetet kontraktore, të pezullojnë të gjitha procedurat e prokurimit përfshirë këtu edhe ato procedura prokurimi me vlerë të vogël, objekti i të cilave nuk lidhen ngushtësisht me situatën, duke përfshirë edhe ato procedura që janë në proces, deri në një njoftim të dytë. *Edhe pse në komunikim të vazhdueshëm nga APP për pezullimin dhe mos kryerje të procedurave të prokurimit për objekte që nuk lidhen me situatën e pandemisë, nga AK konstatohet se ka vijuar procesi me shpallje të procedurave.* Veprime në kundërshtim me njoftimin e APP nr. 2371, datë 31.03.2020 "Për pezullimin e shpalljes së procedurave të reja të prokurimit publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar, të merren masat e duhura që, të respektohet çdo akt i dalë nga Agjencia e Prokurimit Publik, për përmbushjen e qëllimit për të cilat këto akte janë nxjerrë.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Titullari i ARRSH-së ka marrë të gjitha masat e duhura për respektimin e të gjitha akteve të dala nga APP (Udhëzime, Rekomandime, Njoftime, etj.,) duke i përcjellë ato (në formë shkresore dhe e-mail) brenda institucionit, konkretisht, strukturave të ngritura për kryerjen e procedurave të prokurimit. Të gjitha fazat e procedurave të prokurimeve janë ndjekur konform LPP. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni jusitifikues konkretisht dokumentacioni në formë shkresore apo email-et të cilat citohen referuar përgjigjeve të pyetësorit.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

27. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt *"Ndërtimi i rrugës Porto-Romano"*, me fond limit në shumën 669,384,858 lekë pa TVSh, sipas dokumentacionit të dosjeve përkatëse dhe sistemit të prokurimeve elektronike(SPE) u konstatua se; kjo procedurë është anuluar dy herë ku, referuar SPE rezulton të jetë paraqitur ankesë nga OE në lidhje me Dokumentet Standarde të Tenderit Në lidhje me anulimin e të dy procedurave, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe sistemit të prokurimit elektronik, konstatohet se arsyet e të dy rastet kanë ardhur si rezultat i vetë Autoritetit Kontraktor, konkretisht për vendosje të kritereve jo sipas LPP dhe RrPP, të cilat nuk janë në frymën e objektit, qëllimit, parimeve të përzgjedhjes për trajtimin e kërkesave të barabarta dhe jo diskriminuese për operatorët ekonomikë si dhe nuk përmbushet asnjë kriteret e parashikuara për anulimin e procedurave të prokurimit publik. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenet 1 e 2, nenin 20, nenin 24, neni 55, neni 46, pika 1/c, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 25/1, neni 31/1, neni 61. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Kontraktor dhe Përgjegjësi i Prokurimeve të merren masat e duhura që, në vendosjen e kritereve dhe hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, të shmangen kriteret e panevojshme të cilat nuk janë në përputhje me objektin e kontratës, me qëllim trajtimin e barabartë ndërmjet operatorëve dhe shmangien e anulimit të procedurave të prokurimit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", gjithashtu, Rekomandimit nr. 1797/1 prot, datë 10.03.2022, "Mbi Hartimin e Kritereve për Kualifikim për Procedurat e Prokurimit për Mallra, Pune, Shërbime", Titullari i ARRSH-së dhe Përgjegjësi i Prokurimeve kanë marrë masat e duhura për shmangien e kritereve të panevojshme. Çdo kriter i vendosur në DST është në përputhje me objektin e kontratës dhe i argumentuar nga specialistet e fushës. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni justifikues për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

28. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtim rruga Korçë-Ersekë, Loti II, (pjesa e parë)*", me fond limit në shumën 2,399,999,882 lekë pa TVSh, me OE fituese në shumën 2,352,012,509 lekë pa TVSh rezultoi: Llogaritja e fondit limit është bazuar në preventivin e hartuar nga drejtoria e planifikimit strategjik dhe operacioneve në shumën 2,399,999,882 lekë pa TVSh dhe në shumën 2,879,999,858 lekë me TVSh, nga z. E. E. në cilësinë e Drejtorit të drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve dhe preventivit të hartuar nga grupi i punës, miratuar nga titullari i AK me shkresën nr. 6139 prot, datë 02.08.2020. Preventivi i punimeve është miratuar nga titullari i AK z. E. V. dhe drejtori i DPSO i cili është bazuar në preventivin e punimeve të hartuara nga Bashkia Kolonjë, referuar zërave e volumeve të cilat janë vendosur sipas manualit të punimeve të miratuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15.07.2015 dhe çmimeve të projektuesit për zërat të cilat nuk përfshihen në manualin në fuqi. Preventivi është bazuar gjithashtu në vendimin e Këshillit teknik me nr. 43, administruar me shkresën nr. 4677/1prot, datë 14.08.2020, nënshkruar nga kryetari z. E. V. dhe sekretari z. E. E. Referuar llogaritjes së vlerës së kontratës, nga analiza e zërave të preventivit të punimeve të miratuara nga AK si dhe referuar relacionit teknik konstatohet se; Në zërin e punimeve me *nr.analizë 3.159/e gërmim e transport dheu kat II-të*

me skrepër, L=500 dhe V=6~6.5m3 nuk është e argumentuar distanca e transportit deri në 500m e përfshirë në këtë zë, e cila sipas manualit të punimeve të ndërtimit është në vlerën 507lekë/m3. Bazuar kontratave të ngjashme të lidhura nga ARSSH, rezulton se për llogaritjen e fondit limit të tyre është përzgjedhur zëri me ref; *3.159/a gërmim e transport dheu kat II-të me skrepër, me distancë L=100 dhe V=6~6.5m3 dhe me* çmim analize në vlerën 134 lekë/m3, sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre", i ndryshuar. Rrjedhimisht distanca e transportit L=500m me mjetin e gërmimit skrepër e vendosur në preventivin e punimeve për llogaritjen e fondit limit është e pa argumentuar. Diferenca e çmimit midis dy zërave të mësipërm ref; *3.159/e* dhe ref; *3.159/a* është në vlerën 373 lekë/m3 (507-134).Për volumin e punimeve sipas preventivit 830,500 m3 dhe diferencës së çmimit midis dy zërave 373 lekë/m3 kemi shumën prej 309,776,500lekë pa TVSh, e cila është vlerë e pa argumentuar dhe dokumentuar e referencës L=500 dhe V=6~6.5m3. Për sa më sipër shuma prej 309,776,500 lekë pa TVSh, nga ana e grupit të auditimit konsiderohet vlerë e pa argumentuar teknikisht e përdorimit të për këtë projekt dhe buxhetin e shtetit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.12.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 1, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.514, date 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandimi: Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Këshilli Teknik, të merren masat e duhura që, në miratimin e preventivave të çdo projekti, investimi, për nxjerrjen e fondit limit të kontratave, të bëhen analizat e detajuara tekniko-ligjore, me qëllim shmangien e rritjes së fondeve të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, në projektet e ardhshme, ARRSH do te marre masat që në detyrat e projektimit, për përgatitjen e projekt preventivit, t`u kërkojë projektuesve të thellohen në përzgjedhjen e zërave të preventivit duke u bazuar në Manualin shtetëror të miratuar. Zbatimi i këtij rekomandimi do të verifikohet nga grupi i auditimit që ndodhet aktualisht në ARRSH.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

29. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 1049, datë 08.12.2019, në shumën 316,022 lekë është likuiduar fatura nr. 299, datë 30.11.2019 nda subjektit "E. S." ShPK. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion bashkëlidhur këtij shpenzimi konstatohet se; kjo pagesë është kryer bazuar në kontratën nr. 4839/11, datë 01.07.2019, për shërbimin e ruajtjes së sigurisë fizike e kryer për muajin nëntor 2019. Ky shpenzim është kryer pa patur asnjë dokumentacion justifikues për mbikëqyrjen e kontratës, pra nga titullari i AK nuk është krijuar komision për monitorimin e shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike, për të mbikëqyrur veprimtarinë e kontraktorit në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me zbatimin e kontratës. Nga nëpunësi zbatues nuk janë kryer kontrolli i duhur për plotësimin e dokumentacionit në lidhje me kryerjen e shpenzimit, për të siguruar vendimmarrjen se përdorimi i fondeve është justifikuar me dokumentacion përkatës. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4 pikat 17 dhe 26, dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 77, pikat 1 dhe 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit Përfundimtar).*

29.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masat që, për garantimin e zbatimit të kontratave të lidhura, të ngrihen komisionet përkatëse me qëllim monitorimin e veprimtarisë së kontraktorëve.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

30. Gjetje nga auditimi: Në projektin me objekt ***"Ndërtim By-Pass Tepelenë, Loti 1"*** konstatohet se, Autoritetit Kontraktor, me Vendimet e Këshillit Teknik ka miratuar shtesë kontrate prej 19.7% në vlerën 470,058,451 pa TVSH. Krahas nevojave për punime shtesë për realizimin e kontratës fillestare, ARRSH sipas kërkesave të Bashkisë Tepelenë, me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.38 datë 28.10.2019, ka miratuar "*Ndërtimin e shëtitores mbi punimet e mbrojtjes lumore"*, me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.32 datë 08.06.2020, ka miratuar "*Ndërtimi i trotuarit me konstruksion metalik përreth kalasë dhe ndriçimi i saj me gjatësi 492 ml"*, "*Ndërtimi i rrugës së lagjes Gurës*" si dhe "*Rikonstruksioni i këmbëve të urës pasarelë mbi lumin Vjosë"*. Miratimi final për rikonstruksionin e urës pasarelë është bërë me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.51 datë 29.09.2020 pas miratimit të projektit nga Këshilli Kombëtar për Trashëgimisë Kulturore Materiale pranë Ministrisë së Kulturës. Miratimi i shtesës së kontratës me objekt *"Ndërtimi By-Pass Tepelenë, Loti 1"*, ku përfshihen punimet sipas kërkesave të Bashkisë Tepelenë kanë rritur vlerën e kontratës fillestare me **121,926,889 lekë pa TVSH** ose 5.1% të cilat nuk kanë qenë të përfshira në projektin fillestar dhe këto ndryshime nuk vijnë si domosdoshmëri e realizimit të kontratës. Në rast se punimet e kërkuara, nga Bashkia Tepelenë, do të kryheshin me fondet e saj ose institucioneve të tjera përgjegjëse do ti nënshtroheshin garës së prokurimit publik, pra kemi shmangie nga procedurat e prokurimit publik në vlerën **121,926,889 lekë pa TVSH.** Veprim në kundërshtim me: Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; Ligjin nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar"; VKM Nr.276, datë 16.05.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raporit të Auditimit).*

30.1. Rekomandimi: ARRSH të marri masa që në të ardhmen, për projektet e reja dhe ato në proces të mos miratojë ndryshime dhe shtesa punimesh, që nuk janë të lidhura me zbatimin teknik të punimeve dhe në funksion të objektit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

31. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me politikat, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullator në fuqi u konstatua se, Rregullorja e brendshme e funksionimit administrativ të ARRSH si dhe disa akte të tjera, nuk janë të harmonizuar me kërkesat e legjislacionit për menaxhimin financiar publik si dhe VKM nr. 279, datë 16.5.2018, dhe kanë nevojë për përmirësim e plotësim për aspektet e mëposhtme:

a) Në kundërshtim me Kreun III, germa "ç", të VKM nr. 276, datë 16.05.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të ARRSH", në Rregulloren e Brendshme të ARRSH ***nuk janë përcaktuar "rregullat për mbledhjet, kuorumin dhe vendimet e bordit të menaxhimit të Autoritetit".*** Po kështu, në kundërshtim me Kreun I, "Organizimi dhe funksionimi", pika nr.8, të VKM nr. 276, datë 16.05.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të ARRSH", në Rregulloren e Brendshme të ARRSH ***nuk janë përcaktuar sistemi i masave disiplinore dhe procedurat disiplinore, të cilat sipas VKM përcaktohen në rregulloren e brendshme të Autoritetit.*** *Gjithashtu, ky veprim nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 37, të Nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, që sanksionon se masat disiplinore përcaktohen në kontratën kolektive të punës.*

b) Nuk gjejnë pasqyrim në dokumentin e Rregullores së brendshme ***detyrat dhe përgjegjësitë e oficerëve/zyrtarëve që ndjekin zbatimin e kontratave***, kur për to janë caktuar mbikëqyrës të kontratave të ndërtimit apo mirëmbajtjes. Gjithashtu, mungojnë në dokumentin e Rregullores së Brendshme (apo në ndonjë udhëzim apo akt tjetër administrativ), *kriteret e shkruara se, në cilat raste, proceset e mbikëqyrjes/ supervizionimit të punimeve të ndërtimit dhe mirëmbajtjes do të kryhen me punonjës të brendshëm të licencuar të ARRSH-së, (në çfarë situatash, për çfarë kufijsh monetarë, numri maksimal i kontratave që mund të mbikëqyren nga një punonjës i institucionit gjatë një viti kalendarik, etj),* kjo në përputhje me nenin 7, të ligjit Nr.8402, date 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit".

c) Gjithashtu, nuk gjejnë pasqyrim në dokumentin e Rregullores së Brendshme ***detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit të ngarkuar me magazinën dhe administrimin material***,

d) Mungon një rregullim i përgjithshëm mbi organizimin dhe funksionimin e **Këshillit Teknik të ARRSH-së. n**ë kundërshtim me Kreun II, pika 4, të VKM nr. 276, datë 16.5.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe Statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar": Konstatohet se, nuk ka gjetur zbatim detyrimi që "*Drejtori i Përgjithshëm nxjerr urdhrin për ngritjen e Këshillit Teknik dhe firmos rregulloren e përgjithshme të veprimtarisë dhe funksionimit të tij". Deri në datën e hartimit të këtij raporti, nuk është hartuar dhe miratuar rregullorja e përgjithshme të veprimtarisë dhe funksionimit të Këshillit Teknik të ARRSH-së.*

e) Rastet e delegimit të autoriteti dhe përgjegjësive tek nivelet e tjera menaxheriale, sa duhet plotësuar Kreu XI i Rregullores së brendshme, *duke vendosur afatin maksimal të delegimit të të drejtave dhe detyrave tek strukturat e varësisë si dhe afatin maksimal të komandimit në detyrë, etj*. Gjithashtu, në Rregulloren e Brendshme të ARRSH, (miratuar me Vendimin e BM nr. 10, datë 4 Shtator 2018 në kreun X "Mirëmbajtja e godinës, aktiveve dhe pajisjeve", neni 53 "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve", në pikën nr.4 referohet "Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse", duke mos reflektuar pozicionet e strukturës organike të miratuar me VKM nr. 276, datë 16 Maj 2018, ku në strukturë janë "Drejtoria e Planifikimit Buxhetor dhe Financës" dhe "Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme".

f) *Nuk ka një proces dhe gjurmë të qartë të auditimit mbi mënyrën e kalimit të objekteve (rrugë, akse rrugore, vepra arti etj), pas marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të tyre përfundimtar nga ARRSH, për mirëmbajtje nga Drejtoritë e Rajoneve, në bazë të përcaktimit të Kreut II, pikës 2.d, ku thuhet se Drejtoritë Rajonale* "Organizojnë programin e supervizionit të shërbimeve të mirëmbajtjes me performancë (rutinë dhe dimërore), të rehabilitimit të Rrjetit Rrugor Kombëtar në administrim si dhe ndjekin kontratat".

g) *Mungon një sistem i qartë raportimi dhe një dokument i miratuar mbi mënyrën e raportimit për shkeljet e rregullave në fuqi, apo rastet e raporteve mashtrues, shënime fiktive, humbja e pasurive, korrupsioni, etj., aspekte të pranuar dhe në paragrafin nr. 56, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit (dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 1140, datë 07.02.2020).*

e) Mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" i ndryshuar

f) Grupi i auditimit të KLSH konstaton se për Drejtorinë e Përgjithshme të ARRSH janë përcaktuar nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ) ne pozicionin e Drejtorit të Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, *si vijon:*Për periudhën objekt auditimi në pozicionin e Nëpunësit Autorizues është z. E. V., me detyrë Zv/Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, i cili sipas Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Znj. B. B. me nr. 360, (nr. 8610 prot.), datë 04.10.2019 "*Për autorizimin e Zv./Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të ushtrojë kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH",* është urdhëruar autorizimi "të ushtrojë krahas detyrave funksionale edhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm me qëllim mbarëvajtjen e institucionit".

Referencat e vendosura në këtë urdhër janë ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për ARRSH" dhe neni 72, paragrafi 3, i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 (i ndryshuar), ***ndërkohë që neni 72, ka si objekt prokurat dhe ka vetëm dy paragrafë***. Ndonëse ka kaluar më shumë se një vit, ende nuk ka një emërim të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, pra, nuk kanë gjetur përcaktim dispozitat e Nenit 12, pika 2 të ligjit nr. 10164/2009, *Drejtori i Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes është njëkohësisht dhe Zv/Drejtor i Përgjithshëm. Pra, z. K. pas këtij delegimi, kryen njëkohësisht tre funksione: atë të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm, të Drejtorit të Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes dhe atë të Drejtorit të Drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë, gjë që efektivisht është e pa mundur dhe janë pozicione që mund të krijojnë konflikt midis tyre.*

g) Nga ana e institucionit, për vitin 2019, janë përgatitur Pyetësorët e Vetëvlerësimit, por mungon Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.

Më hollësisht ato janë përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave për gjithë vitet objekt auditimi. U testuan pyetësorët dhe raportet e plotësuara për vitin 2019 dhe rezultoi si më poshtë: **Nuk është dërguar në Ministrinë e linjës Raporti Vjetor mbi Sistemet e Kontrollit të Brendshëm,** sipas strukturës së parashikuar në Manualin e MFK (Kreu II, pika 2.2.7) dhe detyrimeve të Nenit 18/1, "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm", Kreu II, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010: *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 122-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARRSH-së, të marrin masat e nevojshme me qëllim përditësimin dhe harmonizimin e normave dhe akteve në fuqi mbi të cilat ngrihet dhe funksionon ARRSH me kuadrin nënligjor mbështetës.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

32. Gjetje nga auditimi: Dokumenti i Planit vjetor dhe strategjik të auditimit, nuk është konsultuar dhe marrë opinioni i Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Bordit të Menaxhimit, përpara miratimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm i ARRSH në kundërshtim me Kreu III, pika 3.1, i Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit te Financave nr.100, date 25.10.2016, i ndryshuar me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Nga auditimi gjithashtu u konstatua se, nga ana e kësaj njësie publike për vitin 2019 - 2020, nuk janë kryer vlerësime periodikë e vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, në përputhje me përcaktimet e rregullores se brendshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 122-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARRSH-së, të marrin masat e nevojshme me qëllim përmirësimin e situatës duke marrë opinionin e Auditit të Brendshëm dhe Bordit të Menaxhimit si dhe kryerjen e vlerësimeve periodike e vjetore të punës për punonjësit.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, është realizuar vlerësimi i punonjësve, dhe në rastet kur është e nevojshme opinioni i Auditit të Brendshëm dhe Bordit të Menaxhimit do të kërkohet opinion i tyre. Është miratuar me Vendim Bordit nr. 21, datë 10.11.2020, "Formulari i Vlerësimit të Punës për punonjësit në Autoritetin Rrugor Shqiptar". Gjithashtu ju informojmë se është realizuar vlerësimi vjetor i punonjësve për vitet 2020, 2021 si dhe vlerësimi i punës për punonjësit pas përfundimit të periudhës së provës. Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH është paraqitur edhe një vlerësim punonjësi si model. Zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna, ARRSH i ka kthyer përgjigje institucionit të KLSH me shkresën nr. 9789/1 prot. datë 18.12.2020, ku konstatohet se nuk është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor (20 ditë), pasi shkresa e KLSh është protokolluar në ARRSH me nr. 7532 datë 8.10.2020 dhe përgjigja është kthyer vetëm me datë 18.12.2020. gjithashtu konstatohet se akoma nuk ka gjetur zbatim 1 masë zhdëmtimi ku kërkohet që: *"ARrSh në bashkëpunim me MIE dhe me departamentin e Administratës Publike, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën 51,238,754 lekë"*, si dhe janë ende në proces zbatimi 4 rekomandime për eliminimin e efekteve negative në administrimin dhe menaxhimin e fondeve publike. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", neni 15(j). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1. Rekomandimi: ARrSh të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna të rikërkuara me shkresën KLSH me nr.675/36 prot. datë 06.10.2020 "Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve", për të cilat duhet të informohet në vijimësi institucioni i auditimit të jashtëm publik, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

34. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i ankesës mbi pretendimin se me datë 15.10.2020, janë prerë 150 pemë pishe dhe të gjitha këto pemë janë prerë pa u marrë miratimi i lejes mjedisore, nga audituesit e autorizuar të KLSH evidentohet se, deri në datën e hartimit të akt-konstatimit nuk është miratuar dhe zbardhur leja e mjedisit. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARrSh z. E. V. është lidhur Kontratat me nr.6160/5, datë 08.10.2020 për "Ndërtimin e rrugës Korçë-Ersekë", Loti 2, (Pjesa e parë)",me përfaqësuesin e shoqërisë "A." ShPK z. A. K., por deri në datën e mbajtjes së këtij dokumenti nuk kemi gjurmë që vërteton se leja e mjedisit të jetë miratuar. Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion korrespondenca shkresore e mbajtur me Bashkinë e Kolonjës për këtë çështje**.** Për sa më sipër është në kundërshtim me: Ligjin Nr.

10296/2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollon", Neni 4; Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
34.1. Rekomandimi: Nga ARrSh, të merren masat, për projektet në të ardhmen, të aplikohet për leje mjedisore para nënshkrimit të kontratës dhe punimet e zbatimit të fillojnë pas miratimit të saj.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve ka aplikuar në kohë, përpara nënshkrimit të kontratave për lejet mjedisore. Ky rekomandim do të ndiqet edhe në vijimësi, për çdo objekt. Shembull, aplikimi për objektin "Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri Strelcë". Aplikimi i kryer në fillim qershori dhe VNM miratuar me 07.07.2022.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

35. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se, aplikimi për leje ndërtimi për objektin "Ndërtimin e rrugës Korçë-Ersekë", Loti 2, (Pjesa e parë)", është bërë me datën 30 Tetor 2020 dhe leja e ndërtimit është miratuar me Vendimin e Këshillit të Territorit me nr. 7, datë 03.12.2020. Sipas dokumentacionit konstatohet se kontrata me nr. 6160/5, me datë 08.10.2020, datë në të cilën ka hyrë dhe në fuqi, është nënshkruar me përfaqësuesin e shoqërisë së ndërtimit "A." ShPK. Pra, sipas gjykimit të grupit të auditimit rezulton se kontrata e punimeve të ndërtimit është lidhur pa miratimin e lejes së ndërtimit të këtij objekti, leje e cila është miratuar 57 ditë pas lidhjes së kontratës referuar akt dorëzimit të sheshit të ndërtimit**.** Për sa më sipër është në kundërshtim me: Ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit". neni 9; Udhëzimin e Këshillit të Ministrave me Nr.3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pikat 4 dhe 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar).*
35.1. Rekomandimi: Nga ARrSh, të merren masat, për projektet në të ardhmen, të aplikohet për lejen ndërtimore para nënshkrimit të kontratës dhe punimet e zbatimit të fillojnë pas miratimit të saj.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve ka aplikuar në kohë, përpara nënshkrimit të kontratave për lejet mjedisore. Ky rekomandim do te ndiqet edhe ne vijimësi, për çdo objekt.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

36. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi analizimin e pretendimit të ankimuesit z. R.N. mbi ndryshimin e projektit të parë nga projekti i dytë pasi ka ndryshuar gjurma e projektit nga rruga ekzistuese në një rrugë krejtësisht të re, rezulton se; Nga ana e Ish-Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në vitin 2010 me fondet e buxhetit të shtetit është hartuar projekti i rrugës Korçë-Ersekë (loti 2), ku Projekt Ideja është miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të datës 8.7.2009, kurse projekti i zbatimit është miratuar me vendimin e Këshillit Teknik datë 06.07.2010, ku kanë marrë në shqyrtim projekt zbatimin e objektit "Studim, Projektim, Rruga Ersekë-Leskovik" Loti 2, hartuar nga firma konsulente "I. PKS" ShPK. Projekt zbatimi dhe preventivi përmbledhës, i objektit të projektit "Studim, Projekt Zbatimi Rruga Korçë-Ersekë Loti II, është përllogaritur me vlerë totale në

shumën 2,832,157,151.53 lekë me TVSh, për një segment prej 17,894 metra, pra rreth 17.9 km, konkretisht;
Sipas Projektit të Parë, (v.2010): hartuar nga firma konsulente "I. PKS" ShPK dhe miratuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve me vendimin e Këshillit Teknik datë 06.07.2010, objekti "Rruga Ersekë-Leskovik" Loti 2" ka gjatësinë ekzistuese 22 km (shiko fq.3 e Raportit te Projekt-Zbatimit) dhe sipas projektit të këtij konsulenti rruga bëhet 17.894 km (shiko fq.7 e Raportit te Projekt-Zbatimit). ***Pra, ky segment rrugor sipas këtij varianti rruga shkurtohet 4.106 km.***
Sipas Projektit të dytë (v.2020):
-Pjesa e parë e Lotit të dytë është 4.15 km (në bazë të studimit dhe projektit të hartuar nga firma konsulente "A . E." SHPK dhe miratuar në Autoritetin Rrugor Shqiptar me vendimin e Këshillit Teknik Nr.43, datë 14.08.2020, objekti "Rruga Ersekë-Leskovik" Loti 2" ka gjatësinë ekzistuese 4.15 km.
Pjesa e dytë e Lotit të Dytë (sipas shkresës së ARrSh me nr. 8069/2, datë 17.12.2020 dërguar institucionit te Presidencës dhe institucioneve te tjera shtetërore), ka gjatësie L= 12.85 km. Pra, sipas këtij versioni, gjatësia e përgjithshme e rrugës bëhet 17 km, (4.15 +12.85 km). ***Pra, ky segment rrugor sipas këtij varianti rruga shkurtohet nga 22 km në 17, ose me 5 km.*** Hartimi i detyrës se projektimit dhe projekt zbatimit nga ana e Bashkisë Kolonjë nuk është i mbështetur në legjislacion në fuqi që rregullon funksionet, përgjegjësit dhe organiken e Qeverisjes Vendore, pasi aksi Korçë-Ersekë është rrugë ***interurbane shtetërore*** dhe është në inventarin dhe administrimin e entit pronar të rrugëve, ARrSh-së. ***Për sa më sipër, grupit të auditimit nuk i është vendosur ndonjë praktike shkresore që të argumentojë teknikisht ndryshimin e gjurmës së projektit të miratuar nga Këshilli Teknik i DP Rrugëve me vendimin e datës 06.07.2010, i cili është miratuar jashtë periudhës objekt auditimi.*** Për sa më sipër është në kundërshtim me, Neni 2, pika 2 dhe 6 e Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i RSH", i ndryshuar; VKM nr. 276, datë 16.5.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar"; Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
36.1. Rekomandimi: Nga ARrSh të merren masat që, në të ardhmen projektet për rrugët e reja të hartohen nga vetë ARrSh dhe të mos pranohen projekte të hartuara nga pushteti vendor të cilët nuk kanë kapacitet teknike për miratimin e tyre.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

37. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm e ARrSh është organizuar në nivel sektori dhe përbëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe 2 auditues. Nga verifikimi i të dhënave të mbi përvojën në punë të përgjegjësit të sektorit, rezulton se nuk plotëson kriterin e përvojës profesionale si auditues i brendshëm ose i jashtëm, për tu zgjedhur drejtues i njësisë së auditimit, pasi *ka* gjithsej 2 vite e 8 muaj përvojë në fushën e auditimit të brendshëm e të jashtëm të sektorit publik, përkatësisht nga data 1 Janar 2010 deri 31 Gusht 2012 në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, (në pozicionin e Inspektores në Sektorin e Auditimit të Brendshëm). (Konstatim deri në fund të periudhës së auditimit)
Gjithashtu, procedura e emërimit të Përgjegjësit të SAB nuk është realizuar me konkurrim të hapur, mungon shpallja e pozicionit vakant dhe e kritereve për këtë pozicion punësimi dhe

rezulton se nuk përmbushen kriteret minimale të përcaktuara në ligj për emërimin në këtë pozicion. Për sa sipër, është pjesë e dosjes një raport i hartuar nga Komisioni i ngritur për rekrutimin/intervistimin, i përbërë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, i cili nuk ka lidhje me profesionin e auditimit; Drejtori i DSHB, Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore të ARrSh, dhe specialisti i Sektorit të Burimeve Njerëzore, lidhur me *"plotësimin e kritereve të pranimit në punë në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm".* Për sa më sipër është në kundërshtim me: ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm të sektori publik", neni 11, pika 2/b & 2/c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

37.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme (Sektori i Burimeve Njerëzore) të marrin masa që në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm të emërojnë staf me përvojën e nevojshme profesionale si hallkë e rëndësishme në mirë funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së punës audituese.

37.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme (Sektori i Burimeve Njerëzore) të marrin masa që procesin e rekrutimit të Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm të zhvillojë procedurë konkurruese duke shpallur vendin vakant dhe kriteret specifike që duhet të plotësohet me qëllim që të sigurohet një procedurë transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, do të merret parasysh në momentit kur do të miratohet struktura e re.
Rekomandimi 37.1 dhe 37.2 nuk është zbatuar.

38. Gjetje nga auditimi: Përgjegjësja e Sektorit te Auditimit të Brendshëm, aktualisht është zotëruese e 50 % të kuotave të aksioneve në subjektin privat "T. V." shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT: L61611036A, regjistruar me 11.4.2016. Statusi i shoqërisë: aktiv. Objekti i veprimtarisë së ShPK-së përkon, pritet ose përputhet me aktivitetin e ARrSh, pasi përfshin: "*Konsulenca të fushave të ndërtimit, Raport vlerësimi, projektim, super vizim, dhe drejtim punimesh. Përgatitje dhe dhënie reklama me pajisje vizuale e audio. Import-Eksport, tregtim me shumice e pakice i te gjitha llojeve te mallrave industriale, ushqimore, bujqësore, metale, duralumin, elektroshtëpiake dhe te tjera ndërtimore. Prodhimin e materialeve inerte ne përgjithësi, përpunimin dhe shitjen e tyre . Ndërtime rrugore, ndërtim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndërtime hidroteknike (ujësjellës, kanalizime, ndërtime vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditëse, ndërtime impiante te trajtimit te ujit, te trajtimit te mbeturinave, punime mbrojtëse dhe sistemimi hidraulik, punime montimi dhe teknologjike, punime topogjeodezike. Prodhimi dhe tregtimi i materialeve te ndërtimit. Projektimin, ndërtimin, ristrukturimin dhe modernizimin (përtëritjen) e objekteve civile, industriale, ndërtimin dhe shtrimin e rrugëve në përgjithësi. .... Kategoritë ne fushën e studimit dhe projektimit ne ndërtim. Projektues urbanist, masterplane, studime plane rajonale urbanistike, plane rregulluese te përgjithshme për qendra te banuara dhe qytete. Studime pjesore urbanistike. Projektues arkitekt. Projektim arkitektonik për objekte civile industriale, turistike, vepra arti ne infrastrukturë. Projektim arkitektonik për objekte sportive. Projektim interiere. Projektim peizazhi. Sistemim sipërfaqe te gjelbëruara, lulishte e parqe. Trajnim ne dhënien e njohurinë te mnz-së."*
Znj.S. përpara se të fillonte marrëdhëniet e punësimit në ARrSh ka punuar në subjektin privat "Gj.. K." i cili ka disa marrëdhënie kontraktore me ARrSh. Marrëdhëniet e punësimit me këtë subjekt privat i ka ndërprerë me datën 3 Dhjetor 2019, ose 33 ditë pas emërimit në ARrSh, gjë që do të thotë se ka vijuar të jetë e dy punësuar. Nuk ka nënshkruar dhe depozituar në dosjen e

personelit deklaratën e konfliktit të interesave me subjektin shtetëror. Për sa më sipër është në kundërshtim me: ligjin nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm të sektorit publik", neni 17; Rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, miratuar nga Bordi i Menaxhimit me Vendimin nr. 5, datë 13.02.2020, neni 19, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

38.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme (Sektori i Burimeve Njerëzore) të marrin masa që në të ardhmen për plotësimin e vendeve vakante, procesi i rekrutimit, të shmangin rastet e konfliktit të interesit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme ka marrë të gjitha masat që në plotësimin e vendeve vakante të shmangen rastet e konfliktit të interesit dhe autorizimi është realizuar nga të gjithë punonjësit (Autorizimi i miratuar me Udhëzim nr. 622, datë 30.11.2012*).* Është miratuar dhe plotësuar autorizimi për deklaratë konflikt interesi (si më lartë). Zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për realizimin e të paktën 80 orëve trajnim në dy vite, në kushtet që trajnimet e vijueshme profesionale janë kritere detyruese për audituesit e brendshëm në detyrë në sektorin publik rezulton se nuk janë kryer. Nisur nga situata e pandemisë 2019-2020, me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Nr. 259, datë 27.10.2020 "Për Miratimin e ndryshimit te kalendarit te Programit te Trajnimit te Vijueshëm Profesional për audituesit e brendshëm ne sektorin publik për vitin 2020, miratuar me Urdhër nr. 427, date 20.12.2019", është vendosur që, *"Struktura përgjegjëse e harmonizimit të auditimit të brendshëm, bazuar në analizën e nevojave për trajnim të audituesve të brendshëm, kushtet dhe infrastrukturën e trajnimeve mund t'i paraqesë, Komisionit të Kualifikimit të* Audituesve të Brendshëm propozime për Programet /Temat e Trajnimit të cilat do të zhvillohen në platformën online si pjesë e Programit *vjetor të Trajnimit të Vijueshëm Profesional*". Për sa më sipër është në kundërshtim me: Ligjin Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 20, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

39.1. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Auditimit të Brendshëm të marrë masa që të kryejë trajnime të vijueshme profesionale dhe azhurnimin e njohurive me qëllim sigurimin e cilësisë në materialet e trajtuara.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, stafi i Sektorit të AB, ka marrë pjesë çdo vit në trajnimet e vijueshme profesionale, të organizuara nga DHAB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, konform Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ''Për auditimin e brendshëm në sektorin Publik", neni 20 "Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm". Për sa trajtuar më sipër nga ARRSH nuk është paraqitur dokumentacioni justifikues për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

40. Gjetje nga auditimi: Nëpërmjet shkresës me nr. 9804/1 prot, datë 11.12.2019, është dërguar Projekt Raporti i angazhimit të Auditimit të hartuar nga Sektori i Auditimit të Brendshëm ne ARrSh, në bazë të programit te auditimit me nr. 9804, date 24.10.2019.

Ne vijim, me shkresën Nr.9804/23 date 23.12.2019 janë dërguar observacionet ne lidhje me projekt raportin e auditimit.
Me shkresën Nr. 9804/26 prot, date 31.12.2019, është dërguar Raporti Përfundimtar i angazhimit te Auditimit pranë DSHB, sipas se cilit kërkohet te konfirmohet zyrtarisht plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve te lëna brenda periudhës kohore 30 dite referuar Ligjit Nr. 114/2015 date 22.10.2015 "Mbi Auditimin e Brendshëm ne Sektorin Publik"
Me tej, me shkresën Nr.443/2, date 02.10.2020 është njoftuar për "Raportin Përfundimtar te Auditimit te Brendshëm" dhe "Përfundimet e Angazhimit te Auditimit te Brendshëm te veprimtarisë se DSHB".
Raporti i auditimit është dërguar nga SAB në DSHB me datën 31.12.2019 dhe njoftimi mbi përfundimet e angazhimit janë dërguar pas një afati 9 mujor, (me datën 02.10.2020). Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe DSHB nuk është bërë hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit brenda afatit 30 ditor. Për sa më sipër është në kundërshtim me: ligji organik mbi auditim, neni 12/d; Manualin e Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publik, të miratuar me urdhrin nr.4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, pika 4.1.12; Hapi 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
40.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Auditimit të Brendshëm të marrin masa që rezultatet e auditimit bashkë me rekomandimet përkatëse ti adresohen sa më parë njësisë së audituar.
40.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe të gjitha njësitë objekt auditimit të marrin masa që të hartojnë plane pune konkrete me afate dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve të lëna brenda afateve 30 ditore me qëllim përmirësimin e punës.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, për çdo angazhim auditimi, nga ana Sektorit të AB rezultatet e auditimit, rekomandimet e lëna, dhe konfirmimi zyrtarisht i planit të veprimit për zbatimin e tyre nga subjektet e audituara, janë dërguar sipas afateve të vendosura në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.12 "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar".
Rekomandimi 4.1 dhe 40.2 është në proces zbatimi.

41. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së auditimit të brendshëm të kryer në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme të ARrSh konstatohet se në dosje nuk administrohet asnjë observacion si dhe nuk janë trajtuar në projekt raport e as në raport përfundimtar të auditimit, ndërkohë që në email datë 26.12.2019 audites Reshit Kuqi, u komunikon takimin pajtues.
Gjithashtu, konstatohet se Përgjegjësia e Sektorit të Auditimit të Brendshëm është pjesë e grupit të auditimit, duke qenë në kundërshtim me Standardet e Auditimit. Për sa më sipër është në kundërshtim me: Standardi IIA nr. 2320 – "Analiza dhe vlerësimi"; Manuali i Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publik Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhrin nr.4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Kreu 4.1.12. Hapi 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
41.1. Rekomandimi: Nga Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm të merren masa që në të gjitha misionet e auditimit të trajtohen me rigorozitet dhe profesionalizëm observacionet e njësisë së audituar si edhe të përfshihen në dosjen e auditimit. Përgjegjësi i Sektorit të mos jetë pjesë e grupit të auditimit pasi cënon zbatimin e standardeve.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, nga ana e Sektorit të AB, ky rekomandim është marrë në konsideratë në angazhimet e auditimit të kryera.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

42. Gjetje nga auditimi: Në segmentin rrugor Vlorë – Sarandë, konkretisht në segmentin Kthesa e Fterës (Borsh)–Piqeras, progresivi km 54+185-54+275, rruga ka pësuar një rrëshqitje të konsiderueshme, duke kufizuar qarkullimin e automjeteve dhe krijimin e rrezikut për aksidente. Mirëmbajtja e rrjetit rrugor në këtë segment realizohet sipas kontratës Nr.549/1Prot. datë 24.01.2017 me objekt *"Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate", Loti i dy*të lidhur midis ARrSh-së dhe *BOE "E. T. C. S. A. & S. SHPK"* me vlerë 16,543,350.20 Euro me TVSH. Monitorimi dhe konsulenca e projektit *"Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate*" për të gjitha lotet kryhet nga BOE "*I. E. S.r.l & S. S.p.a & S. S.p.a"* sipas kontratës të lidhur me ARRSH, Nr.9999 Prot. datë 05.12.2016 me vlerë fillestare 4,800,300 Euro pa TVSH, të cilës i janë bërë 9 (nëntë) shtesa (addendum) me kohëzgjatje deri në përfundim të kontratës së zbatimit.
Projekti*"Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate*" financohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në formën e huas dhe kontributit financiar, me një kosto totale të parashikuar në vlerën 128.47 milionë Euro, ndër të cilat shuma e huas është 65.9 milionë Euro ndërsa pjesa tjetër e mbetur 62.57 milion Euro financohet nga fondet Qeverisë Shqiptare.
Mirëmbajtja e rrjetit rrugor kryhet për të mbajtur nivelin e shërbimit (kondicionet e rrugës) në përputhje me standardet në fuqi. ***Për realizimin e nivelit të shërbimit, nga të gjitha palët pjesëmarrëse të kontratës, kërkohet monitorimi i rrjetit rrugor, raportimi i gjendjes së rrjetit rrugor me problematikat e tij si dhe marrja e masave për zgjidhjen e këtyre problemeve*.**
Nga auditimi nuk konstatohen gjurmë shkresore, kërkesa, për sigurimin e fondeve për realizimin e punimeve për stabilizimin e rrëshqitjeve të parashikuara në projektin e hartuar në vitin 2015.
Nga materiali i vendosur në dispozicion rezulton se ne asnjë nga raportet e hartuar nga konsulenti *BOE "I. E. S.r.l & S. S.p.a & S. S.p.a"* çarja dhe zhvendosja e murit mbajtës në progresivin 54+185- 54+275 nuk është adresuar përpara fillimit të punimeve të kryera sipas urdhër ndryshimin ChOD12.
Nga vizita në terren e grupit të auditimit u konstatua se: *Në segmentin rrugor K/Fterës-Piqeras në progresivin km 54+185-54+275 trupi i rrugës është dëmtuar si pasojë e rrëshqitjes së tokës e bashkë me të edhe muri mbajtës. Uljet e bazamentit të rrugës në këtë segment ka filluar vite më parë dhe janë riparuar vetëm shtresat e rrugës duke ruajtur niveletën e saj. Në murin mbajtës vrimat e kullimit janë në një numër shumë të vogël ose në disa pjesë të tij nuk ekzistojnë fare. Formacioni gjeologjik ku shtrihet tabani i rrugës është i pa qëndrueshëm dhe zona njihet si me burime të shumta nëntokësore të cilat e bëjnë më të pa qëndrueshëm formacionin si dhe pjerrësia e rrëshqitjes është e madhe.*
Grupi i auditimit, krahas dëmtimit në segmentin Kthesa e Fterës (Borsh)-Piqeras në progresivin km 54+185-54+275, konstatoi se përgjatë segmentit rrugor Orikum-Llogora (pjesa në ngjitje e Llogorasë) ka seksione të dëmtuara për të cilat nuk janë marrë masa për zgjidhje konkrete për parandalimin e rrëshqitjeve dhe dëmtimin e mëtejshëm të rrugës, por janë bërë zgjidhje provizore, duke ndërhyrë me gërmime të shpateve në pjesën e sipërme të rrugës. Mos ndërhyrja me zgjidhje teknike për stabilizimin e rrëshqitjeve, bën që shpenzimet për stabilizimin e rrugës të rriten me kalimin e kohës. Për sa më sipër është në kundërshtim me Kontratën Nr.9999Prot. datë 05.12.2016 me objekt Monitorim Konsulencë e Projektit *"Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate*" pika 3 "Detyrat e shërbimit" të konsulentit Part. III/Monitorimi i kushteve të rrjetit përgjatë fazave periodike të mirëmbajtjes rutinë/Inspektimi në terren, pika

28. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
42.1. Rekomandimi: Të merren masa për hartimin e projekt-zbatimit për stabilizimin e rrëshqitjeve si dhe riparimin e dëmtimeve në trupin e rrugës, në segmentin rrugor Orikum-Llogora, me synim parandalimin e aksidenteve rrugore dhe uljen e kostos së riparimit, e cila rritet me kalimin e kohës.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, nga ana e Sektorit të AB, ky rekomandim është marrë në konsideratë në angazhimet e auditimit të kryera.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

43. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin e fondeve buxhetore për projektin *"Supervizion Punimesh, për rehabilitimin e segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rreth rrotullimi Shqiponja Loti 2"* u konstatua se;
a. Procedura e prokurimit të shërbimit të konsulencës është zhvilluar **me parregullsi e mangësi, të cilat janë trajtuar dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike.** Nga ana e Drejtorive të ARRSH ka ekzistuar një mungesë koordinimi, pasi ndonëse **nuk janë programuar fondet për prokurimin e shërbimit** të mbikëqyrjes së lotit të dytë kontratës së punimeve me nr. 7733/5, datë 02.11.2018 , ka vijuar procedura e prokurimit për disa muaj. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" dhe ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
b. Në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit", për periudhën 25 Shkurt 2019 deri më 10 Qershor 2020, d.m.th. **mbi 100 ditë kalendarike, ka munguar mbikëqyrja e kontratës së punimeve** me nr. 7733/5, datë 02.11.2018.
c. Nga shqyrtimi i kësaj kontrate, konstatohet se ekzistojnë disa kundërshtime midis përcaktimeve të pjesës së përgjithshme të kontratës së nënshkruar me OE "S." dhe pjesës së Kushteve të Veçanta:
Në nenin 3/3 "Afati i kontratës", të Kushteve të Përgjithshme përcaktohet se: "3.3.1.Afati maksimal i përfundimit të punimeve është ***24 muaj (nga data e lidhjes së kontratës), sipas grafikut të punimeve bashkëlidhur***, pjesë e kësaj kontrate."
Në nenin 14 "Ekzekutimi i punimeve", të Kushteve të Përgjithshme përcaktohet se: "14.1. Kontraktori ***duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë***, dhe ti mbarojë punët brenda afatit të mbarimit".
Në nenin 5 "Data e fillimit", të Kushteve të Veçanta përcaktohet se: "5.1. Kontraktorit do ti jepet leja të hyjë në kantier më: ***Kontraktori do të njoftohet nga AK zyrtarisht, me shkrim për datën e fillimit të punimeve. Data e fillimit të punimeve do të konsiderohet data e dërgimit të njoftimit nga AK"***
d. Kontrata e punimeve me nr. 7733/5, datë 02.11.2018 është lidhur pa patur Lejen e Ndërtimit për këtë objekt, e cila është lëshuar pas një viti e gjysmë nga kjo kontratë e nënshkruar, dhe mban Nr.05 dhe datën e lëshimit 28.07.2020.
e. Supervizorja Klarita Konomi e ngarkuar për mbikëqyrjen për periudhën 09 nëntor 2018 deri 25 shkurt 2019, dhe pasi është rikthyer në detyrë nuk është rikthyer në detyrën e supervizionimit të këtij objekti. Veprime të tilla bien në kundërshtim me: Kreu III, Neni 7, i Ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit": Pika 11, e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave, Nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit": *P*ika 2, e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave, nr.3, datë 15.2.2001 "Për

mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit": *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit Përfundimtar).*

43.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARRSH-së/Drejtori i Përgjithshëm, të analizojë parregullsitë e konstatuara dhe marrjen e masave të nevojshme për shmangien e tyre në të ardhmen.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës planifikon fondet për objekt në vazhdim dhe për objektet e reja në mbështetje të kërkesave të ardhura nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve, Drejtoria e Ndërtimit të Buxhetit dhe Financës në mbështetje të shkresave të ardhura nga drejtoritë e ARRSH-së me shkresën e MIE nr. 383/4 prot., datë 28.01.2021, "Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2021-2023, për shpenzimet kapitale në programin buxhetor "Transporti Rrugor" (nr. 996 prot., datë 28.01.2021, protokolluar në ARRSH) e ka planifikuar këtë objekt në buxhetin e viteve 2021-2023 të ARRSH-së". Për sa trajtuar më sipër konstatohet se rekomandimi është në proces zbatimi për arsye se është në fazën e planifikimit të fondeve ecila është parashikuar të implementohet në 2022-2023.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

B.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Për projektin me objekt ***"Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 4"*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe BOE "C." ShPK &"Gj. K." ShPK me Nr.6706/6Prot. datë 24.09.2018 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 2,359,623,275.6 lekë pa TVSH ose 2,831,547,930 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës Nr 6621/3Prot. datë 23.09.2020 ku shtohet me 6 (gjashtë), si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet pjesore, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 2 (dy) zëra punimesh, në shumën **1,756,456 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis ARrSh dhe *BOE "4. E. 7. & I. P.K.S sh.p.k & GJ. & CO* me Nr. 3159/12Prot. datë 16.07.2018 me objekt *"Supervizion Punimesh Ndërtim Rruga Kardhiq - Delvinë, Loti 4, Loti 5, Loti 6"*, Neni 7 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: ARrSh në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **1,756,456 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik**,** në situacionin përfundimtar**,** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve *BOE "C.ShPK & Gj. K. sha"* me të cilin është lidhur kontrata Nr. 6706/6Prot. datë 24.09.2018 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën e datës 03.11.2021, protokolluar në ARRSH me nr. 9984 prot., datë 04.11.2021, mbikëqyrësi i punimev ka kthyer përgjigje drejtuar ARRSH në lidhje me rekomandimet dhe Raportin Përfundimtar të KLSH për objektet "Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 4, Loti 5 dhe Loti 6", duke u shprehur "asnjë nga të ashtuquajtura gjetje ose dëm ekonomik i konstatuar prej Audituesve të KLSH nuk qëndron". **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***"Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 5"*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe OE "A.-S." ShPK me Nr.6707/5Prot. datë 24.09.2018 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 2,142,535,887.70 Lekë me TVSH ose 1,785,446,573 lekë pa TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës Nr.6766/2 Prot. datë 18.09.2020 ku shtohet me 6 (gjashtë) muaj, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet pjesore janë përfshirë volume punimesh, të pakryera në fakt për 4 (katër) zëra punimesh, në shumën **7,443,875 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis ARrSh dhe *BOE "4. E. 7. & I. P.K.S sh.p.k & GJ. & C.* me Nr. 3159/12Prot. datë 16.07.2018 me objekt *"Supervizion Punimesh Ndërtim Rruga Kardhiq - Delvinë, Loti 4, Loti 5, Loti 6"*, Neni 7 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: ARrSh në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **7,443,875 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik**,** në situacionin përfundimtar**,** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve *OE* "A.-S." ShPK me të cilin është lidhur kontrata Nr. 6707/5Prot. datë 24.09.2018 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën e datës 03.11.2021, protokolluar në ARRSH me nr. 9984 prot., datë 04.11.2021, mbikëqyrësi i punimev ka kthyer përgjigje drejtuar ARRSH në lidhje me rekomandimet dhe Raportin Përfundimtar të KLSH për objektet "Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 4, Loti 5 dhe Loti 6", duke u shprehur "asnjë nga të ashtuquajtura gjetje ose dëm ekonomik i konstatuar prej Audituesve të KLSH nuk qëndron". **Rekomandimi nuk është zbatuar..**

3. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***"Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 6"*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe *BOE "A. K. ShPK & A. ShPK"* me Nr. 6708/5 Prot. datë 24.09.2018. në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 2,378,643,105.31 lekë pa TVSH ose 2,854,371,726.37 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës Nr.6711/2Prot. datë 23.09.2020 ku shtohet me 6(gjashtë) muaj, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet pjesore, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën **18,448,939 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar,

Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis ARrSh dhe *BOE "4. E.7. & I. P.K.S sh.p.k & GJ. & CO* me Nr. 3159/12Prot. datë 16.07.2018 me objekt *"Supervizion Punimesh Ndërtim Rruga Kardhiq - Delvinë, Loti 4, Loti 5, Loti 6"*, Neni 7 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: ARrSh në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **18,448,939 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik**,** në situacionin përfundimtar**,** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve *BOE "A. K. ShPK & A. ShPK"* me të cilin është lidhur kontrata me Nr. 6708/5Prot. datë 24.09.2018 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën e datës 03.11.2021, protokolluar në ARRSH me nr. 9984 prot., datë 04.11.2021, mbikëqyrësi i punimev ka kthyer përgjigje drejtuar ARRSH në lidhje me rekomandimet dhe Raportin Përfundimtar të KLSH për objektet "Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 4, Loti 5 dhe Loti 6", duke u shprehur "asnjë nga të ashtuquajtura gjetje ose dëm ekonomik i konstatuar prej Audituesve të KLSH nuk qëndron".
Rekomandimi nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***Projekti By-Pass-i Tepelenë, Loti 1*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe "G. C."& "G. L." ShPK me Nr.4193/6 Prot. datë 12.07.2018. në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 2,389,686,891 lekë pa TVSH ose 2,867,624,269 Lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 22 muaj dhe ky afat i ndryshuar me tre amendime të kontratës ku shtohet me 6(gjashtë) muaj, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Supervizorit të punimeve rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet pjesore, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën **6,841,546 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3- Kontratën e shërbimit Nr. 4963/7 datë 17.08.2018 me objekt *"Supervizionim By-Pass-it Tepelenë, Loti 1"*, Neni 7 pika 1.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: ARrSh në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **6,841,546 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik**,** në situacionin përfundimtar**,** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve *BOE "G.. C." &" G. L." ShPK* me të cilin është lidhur kontrata Nr.4193/6 Prot. datë 12.07.2018 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 9345/7 prot., datë 25.10.2021, Drejtori i Përgjithsëm i ARRSH z. E. B. i ka dërguar mbikëqyrësit të punimeve gjetjet dhe rekomandimet pjesë të Raportit Përfundimtar të KLSH.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***"Ndërtim Rruga Kukës-Morinë, (Dy Viadukte) Dublimi Loti 2"*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe BOE "S. d.d S. & V. ShPK" me Nr. 3680/4Prot. datë 07.07.2009. në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 838,851,314 lekë pa TVSH ose 1,006,621,577 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 18 muaj, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Supervizorit të punimeve rezultuan se; në librezat e masave në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 4 (katër) zëra punimesh në shumën **637,596 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3;- Kontratën e shërbimit Nr. 4492/7 Prot, datë 07.07.2009 me objekt "Supervizionim "Ndërtim Rruga Kukës-Morinë, (Dy Viadukte) Dublimi Loti 2", Neni 8 pika 8.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: ARrSh të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **637,596 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve *BOE "S. d.d S. & V. ShPK"* me të cilin është lidhur kontrata Nr. 3680/4 Prot. datë 07.07.2009, për zbatimin e punimeve civile.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Shkresën nr.914/4 prot datë 10.02.2022 "Pagesë e garancisë së difekteve të punimeve në objektin 'Ndërtim rruga Kukës-Morinë (dy viaduktet, dublimi) loti 2", është vendosur bashkëlidhur situacioni përfundimtar. Në kolonën Vlera përmbledhëse, rezulton se është mbajtur garanci vlera 50,243,179 lekë. Ndërsa në shkresën për pagesë dhe në Urdhër Shpenzimin nr.72 datë 23.02.2022 & Nr.94 datë 02.03.2022, rezulton se vlera totale e paguar si çlirim garancie është: 32,087,317 lekë +17,518,266 lekë= 49,605,583 lekë.
50,243,179 lekë – 49,605,583 = **637,596 lekë, shuma e zbritur.**
Rekomandimi është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***"Plotësimi, rakordimi, masa mbrojtëse dhe siguria në viaduktet e aksit Kukës-Morinë",*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe OE "V." ShPK me Nr. 4566/6Prot. datë 11.09.2018, në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 207,331,536 lekë pa TVSH ose 248,797,843 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 8 muaj dhe i zgjatur me 2 muaj me amendimin e kontratës Nr.3770/2 Prot. datë 10.05.2019, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Supervizorit të punimeve rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 5 (pesë) zëra punimesh, në shumën **660,759 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e shërbimit Nr. 4725/8Prot datë 12.09.2018 me objekt "Supervizionim punimesh, plotësim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore në viaduktet e aksit Kukës-Morinë", Neni 7 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: ARrSh të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **660,759 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve *OE "V." ShPK* me të cilin është lidhur kontrata Nr.4566/6 Prot. datë 11.09.2018, për zbatimin e punimeve civile.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: në Shkresën nr.916/5 prot datë 10.02.2022 "Pagesë e garancisë së difekteve të punimeve në objektin 'Plotësimi, rakordimi, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore në viaduktet e aksit Kukës-Morinë", është vendosur bashkëlidhur situacioni përfundimtar. Në kolonën Vlera përmbledhëse, rezulton se është mbajtur garanci vlera 12,438,681 lekë. Ndërsa në shkresën për pagesë dhe në Urdhër Shpenzimin nr.40 datë 11.02.2022 & Urdhër shpenzimin nr.119 datë 10.03.2022, rezulton se vlera totale e paguar si çlirim garancie është: 8.489.162 lekë +3.288.759 lekë= 11,777,921 lekë.
12,438,680 -11,777,921 = **660.759 lekë, shuma e zbritur.**
Rekomandimi është zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***"Stabilizim i rrëshqitjes në aksin Tunel-Elbasan, km.17.36-17.46 segmenti 3, aksi Tiranë-Elbasan (dalje Tuneli i Kërrabës km. 15.2-Elbasan km. 27"*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe OE "2." ShPK me Nr.6604/5 Prot. datë 24.09.2018 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 371,178,286 lekë pa TVSH ose 445,413,943.25 lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 4 muaj dhe zgjatur 3 muaj me amendimin e kontratës Nr.481/2 Prot. datë 21.01.2019, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Supervizorit të punimeve rezultuan se; në librezat e masave në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën **1,930,528 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandimi: ARrSh në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **1,930,528 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik**,** në situacionin përfundimtar**,** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve *OE "2."* ShPK me të cilin është lidhur kontrata Nr.6604/5 Prot. datë 24.09.2018 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga Mbikëqyrësi i punimeve është bërë rakordimi/saktësimi sipas rekomandimeve të Auditit të KLSH dhe është mbajtur proces-verbali datë 20.08.2021, me Sipërmarrësin e punimeve. Bazuar në ketë proces-verbal të dorëzuar në ARRSH me nr. 1449 prot., datë 08.02.2022, është bërë ndalesa nga vlera e garancisë së defekteve me nr.1449/1 prot., datë 03.03.2022.
Rekomandimi është i zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***"Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë, Lot 3"*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe OE "E. P." me Nr. 4194/5 Prot. datë 09.07.2018 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 1,548,619,680 lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 18 muaj dhe zgjatur 59

muaj me amendimet e kontratës Nr. 624/1 Prot. datë 27.01.2017, Nr. 11506/2 Prot. datë 31.12.2018, dhe Nr. 4435/2 Prot. datë 01.07.2020, konstatohet se krahas çmimeve të reja të miratuara, preventivit i është shtuar edhe një zë për të cilin nuk është përcaktuar si zë i ri punimi dhe konkretisht zëri IV.5.9.
-Zëri IV.5.9 ″Beton C 25/30 për bordurat e rrugës (kunetë)", është marrë çmimi 13,649 lekë/m^3, ndërkohë që referuar manualit të çmimeve të ndërtimit, për zë të ngjashëm sipas analizës së çmimit nr. 3.245 ‘’Struktura monolite betoni C 25/30’’ paraqitet me çmim 12,263 lekë/m^3.
Vlera 416,654lekë** [(13,649 lekë/m^3 – 12,263lekë/m^3) x 300.4 m^3], **është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 *“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, pika 2 dhe 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: ARrSh të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **416,654 lekë pa TVSH** nga Kontraktorin BOE “R. S. A. dhe E. SHPK”, përfituar si pasojë e referencave të gabuara në përcaktimin e çmimeve për zëra të rinj punimesh.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe komunikimeve verbale me strukturat e ARRSH të cilat janë angazhuar për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve janë ngritur pretendimet se: Kontrata është në periudhën e garancisë së defekteve.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

9. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***“Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore Nyja Milot”*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe *OE “E. P.” ShPK* me Nr. 4194/5 Prot. datë 09.07.2018, në lidhe me zbatimin e punimeve civile, me vlerë 1,548,619,680 lekë me TVSH**,** me afat përfundimi të punimeve 15 muaj dhe zgjatur 12 muaj me amendimet e kontratës Nr. 8141/2 Prot. datë 09.10.2020, Nr. 11097/3 Prot. datë 23.12.2019, dhe Nr. 3778/2 Prot. datë 29.06.2020, konstatohet se ka pasaktësi në paraqitjen e sipërfaqeve të realizuara të shtresës së binderit, kryesisht në kryqëzimet e rrugëve dytësore. Sipas zërit të punimeve B.3.3 *“Shtresë binderi me zall lavatrice, 6 cm me makineri*”, rezulton se ***është certifikuar më shumë sipërfaqja 3328.8 m^2,me vlerë 5,093,064 lekë*** (3328.8 m^2 x 1,530 lekë/m^2).
- Në librezën e masave për zërin e punimeve B.4.10 *“Tombino me llamarinë të valëzuar tip Tubosider*”, rezultoi se sipas përllogaritjeve të bëra për rrugën nr. 19, tubo me diametër 1000 mm, në kilometër 0+349, me gjatësi 11.85 metër, pesha e tubit është përllogaritur 616 kilogram për metër linear, ndërkohë që pesha reale e këtij tubi është 116 kilogram për metër linear. Nga përllogaritjet rezulton se pesha e tubit është 1374.6 kg ose 1.374 ton (11.85 m x 116 kg/m), ndërsa nga përllogaritjet sipas librezës së masave rezulton 7.4 ton. Sa më sipër, ***është certifikuar me shumë sasia 6.026 ton (7.4-1.374), me vlerë 2,410,400 lekë*** (6.06 ton x 400,000 lekë/ton).
- Në rrugën nr. 1, kilometër 0 + 007, është vendosur një tombino (tubosider), gjatësia e raportuar e të cilit është 25.7 m. Nga verifikimi në objekt, rezulton se gjatësia e tombinos (mesatare) është 23.7 ml, me një diferencë 2 ml dhe peshë 1,232 ton (2 m x 0.616 ton/ml). ***Sasia 1.232 ton, me vlerë 492,800 lekë (1,232 ton x 400,000 lekë/ton), është certifikuar padrejtësisht.***
- Shtresa e binderit është realizuar pothuajse në të gjithë gjatësinë e rrugëve lokale, por nuk është realizuar shtresa e asfaltobetonit. Realizimi i këtyre shtresave në diferencë kohe sjell amortizimin e shtresës së binderit dhe nevojën për punime shtesë për lidhjen e shtresave, duke

rritur koston e realizimit të punimeve. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar neni 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: ARrSh në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **7,996,264 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik**,** në situacionin përfundimtar**,** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve *OE "E. P." ShPK* me të cilin është lidhur kontrata Nr.4194/5 Prot. datë 09.07.2018 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 9345/4 prot., datë 25.10.2021, Drejtori i Përgjithsëm i ARRSH z. E. B. i ka dërguar OE "4. & I. P. SHPK" gjetjet dhe rekomandimet pjesë të Raportit Përfundimtar të KLSH të cilat janë dhënë për këtë OE.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

B.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt "*Largimi i inerteve të rrugës provizore dhe kthimi i bregut të liqenit në gjendjen e mëparshme në aksin Lin-Pogradec*", me fond limit në shumën 20,551,687 lekë pa TVSh, me OE fituese në shumën 13,166,167 lekë pa TVSh, u konstatua se; Referuar procesverbalit nr.1, datë 26.05.2020, mbi hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, e deri në vlerësimin e ofertave të OE konstatohet se; Vendosja e kriterit të Licencës e nënkategorisë III.2.A, e cila ka si veprimtari *"Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor me kodet respektive A.1 dhe A.2.",* nuk është e argumentuar dhe nuk është në përputhje me objektin e kontratës, janë kërkuar 5-Kamiona vetëshkarkues, si dhe 2-Ekskavatorë me zinxhirë pa përcaktuar kapacitetet e tyre, çka e bën dhe konfuze për OE këtë kriter. Është kërkuar rul 15 ton (***vlerë absolute***) pa asnjë argumentim teknik pasi në relacionin e grupit të punës është parashikuar përhapja dhe ngjeshja e inerteve për volumin dhe sasinë që do të zënë në vend depozitimin e përcaktuar, pra ky kriter është shumë kufizues për OE. Gjithashtu janë kërkuar 5 shoferë por nuk përcaktohet kategoria e tyre, gjë e cila përsëri e bën të paqartë këtë kriter dhe konfuz. Referuar kritereve të vendosura nga komisioni i përcaktimit të kritereve, dhe vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit të ofertave, rezulton se janë s'kualifikuar OE të cilët kanë dhënë oferta më të ulëta se OE fitues, të cilat konsiderohen si oferta me përparësi më të mëdha ekonomike për AK. Pra nëse kriteret do të vendoseshin të mirë argumentuara në përputhje me LPP dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave për prokurimin publik, ARrSh do të shpenzonte një **shumë 2,478,508 lekë pa TVSh më pak e cila konsiderohet efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit** (si diferencë e ofertës fituese 13,166,167 lekë me ofertën më të ulët 10,687,659 lekë nga "N." shpk). Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.12.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 1, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi II. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122të Projektraportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Njësia e hartimit të kritereve të kualifikimit, të merren masat e duhura që, vendosja e kritereve të jetë në përputhje me objektin e kontratës si dhe të argumentohet në mënyrë teknike e ligjore, me qëllim shmangien e pasojave financiare për autoritetin në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga veprimet bankare për likuidimin e detyrimeve kontraktuale për kontratën Nr. 1 562/5 Prot. datë 04.04.2018 me objekt *"Menaxhim e mirëmbajtja e shpenzimeve të operimit të Tunelit të Kërrabës"* u konstatua se:
Me urdhër shpenzimin Nr. 1061, datë 09.12.2019, nga pjesa e kontingjencës janë likuiduar 786,932 lekë për sasinë 5,977 litra karburant të pasqyruara në situacionin e muajit Dhjetor 2019. Me urdhër shpenzimin Nr. 1056, datë 09.12.2019, nga pjesa e kontingjencës janë likuiduar 438,814 lekë për sasinë 3,354 litra karburant të pasqyruara në situacionin e muajit Tetor 2018.
Në situacionin e muajit Dhjetor 2018 është pasqyruar konsum karburanti, me arsyen "Tension i lartë", 1720 litra me vlerë 226,352 lekë (1720 litra x 131.6 lekë/litër); në situacionin e muajit Nëntor 2019 është pasqyruar konsum karburanti, me arsyen "Tension i lartë", 3398 litra me vlerë 441,610 lekë (3398 litra x 131.6 lekë/litër); në situacionin e muajit Dhjetor 2019 është pasqyruar konsum karburanti, me arsyen "Shkëputje energjie", 361.2 litra me vlerë 46,959 lekë (361.2 litra x 130 lekë/litër) dhe në situacionin e muajit Janar 2020 është pasqyruar konsum karburanti, me arsyen "Tension i lartë", 3458 litra me vlerë 449,540 lekë (3458 litra x 130 lekë/litër).
Tabela që tregon ndërprerjeve të energjisë/ luhatjeve të tensionit nuk është shoqëruar me asnjë praktikë shkresore nga OSHEE dhe është bazuar në një raport të hartuar nga menaxheri i kontratës.
Rekordet në të cilat bazohet likuidimi i karburantit të konsumuar nga ndërprerje të energjisë dhe luhatje të tensionit nuk janë gjeneruar automatikisht nga sistemi SCADA por të eksportuara në pasqyra me shënimin "Tension i lartë", pasi ato janë me zona të ngjyrosura në disa vende, kanë një titull, si dhe kanë në fund emrin e kontraktorit dhe vulën e tij. Si të tillë ato nuk janë dokumente justifikues origjinal që të shërbejë për efekt të kryerjes së pagesës.
Vlera prej **1,124,461 lekë,** për sasinë 8,937 litra të karburantit të situacionuar dhe likuiduar të pa bazuar në dokumentacion justifikues, nga grupi i auditimit konsiderohet shpenzim **pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet** për buxhetin e shtetit.
Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me: - Kontratat Nr.1562/5 Prot. datë 04.04.2018 dhe Nr. 2279/10 Prot. datë 25.06.2019 me objekt *"Menaxhim e mirëmbajtja e shpenzimeve të operimit të Tunelit të Krrabës"* kreu C.2 te ToR, pika; - Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Neni 8, pika 8.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Projektraportit të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: ARrSh të marri masa për furnizimin e Tunelit të Kërrabës, si objekt i rëndësisë së veçantë, me sistem unazor për të garantuar energji elektrike pa ndërprerje dhe funksion sa më të mirë duke shmangur kështu kostot e larta të operimit nga ndërprerja e energjisë.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, duke qenë se edhe nga OE është propozuar vazhdimisht ndryshimi i linjës së furnizimit me energji elektrike me qëllim shmangien e kostove të punës së gjeneratorit, Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH-së z. E. B. me shkresën nr. 10739/1 prot., datë 17.12.2021, i ka kërkuar Shoqërisë "A." SHPK i ka kërkuar llogaritjen e një kostoje të përafërt me realizimin e kësaj ndërhyrjeje.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

2.2. Rekomandimi: ARrSh të marri masa për përmirësimin (Update) e sistemit SCADA në tunelin e Kërrabës, që të bëjë të mundur kontrollin/komandimin e pajisjeve elektro-mekanike dhe gjenerimin e të dhënave në mënyrë automatike duke realizuar një funksionim sa më të mirë të sistemit të operimit e kështu zvogëlimin e kostos të mirëmbajtjes së tunelit në tërësi.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe komunikimeve verbale me strukturat e ARRSH të cilat janë angazhuar për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve janë ngritur pretendimet se: Nga ana e ARRSH në vijimësi, do të organizohet puna me specialistë të fushës me qëllim realizimin e një projekti dhe nxjerrjen e fondeve të nevojshme për kërkesë në vitet e ardhshme.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së ndjekur për krijimin e bazës së të dhënave gjyqësore/regjistrit të të dhënave gjyqësore dhe ekzekutimit të detyrimeve monetare nga ana e kësaj njësie të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit, u konstatua se,
a. Sa i takon vendimeve gjyqësore të formës së prerë të ekzekutuara dhe të pa ekzekutuara nga ARrSh për periudhën 2016-2020, referuar sistemit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se, vendimeve gjyqësore **në pritje për ekzekutim në shtator 2020**, janë në vlerën për **655.7milion lekë.**
b. Konstatohet se, për periudhën 2018-2020, janë kryer shpenzime **jo efektiv**e për buxhetin e shtetit në vlerën për **75,7 milion lekë** si pasojë e likuidimit të shpenzimeve gjyqësore nëpërmjet përmbaruesve gjyqësor dhe kamatëvonesave të krijuara nga mos likuidimi në kohë i detyrimeve dhe konkretisht:
-Në 24 raste për vendimet gjyqësore të formës së prerë në vlerën për 42,2 milion lekë apo 73 % e likuidimeve të vitit 2019 të janë me përmbarues gjyqësorë, duke shtuar artificialisht koston e shërbimit me afro 5%.
-Nga ana e kreditorit "Viktoria Invest International", është fituar procesi gjyqësor, nga ku ka lindur detyrim për kamatëvonesa në likuidimin e faturave për situacionet e ndërtimit të segmentit Librazhd-Qafë Studen, në shumën prej 33,5 milion lekë vlerë kjo jo efektive pasi me veprimet apo mosveprimet e tyre zyrtarët e autoritetit kanë sjellë pasoja në lidhje me penalizimin e institucionit nga pamjaftueshmëria dhe mosplanifikimi i duhur i fondeve të buxhetit të shtetit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" të ndryshuar, duke krijuar angazhime buxhetore të paligjshme, si dhe duke rritur detyrimet buxhetore për vitet pasardhëse të paparashikuara, për kamatë vonesa nga mos likuidimi në afat dhe në përputhje me kontratën e nënshkruar midis palëve për faturat tatimore të lëshuara për punimet e kryera, si më sipër.
c. Konstatohet se, nuk është respektuar radha e pagesave për vendimet gjyqësore të formës së prerë (FIFO), pasi rezulton se disa vendime gjyqësore të formës se prerë, që janë regjistruar nga viti 2018 apo viti 2019, nuk ishte kryer asnjë pagesë për to. Veprime në kundërshtim me piken nr.62, të UMF nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit të shtetit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Projektraporit të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARrSh-së/Drejtori i Përgjithshëm, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim përmirësimin e situatës së krijuar si dhe nxjerrjen e përgjegjësive dhe nisjen e masave administrative apo disiplinore për personat përgjegjës.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se:

-Me shkresën nr. 10929 prot., datë 03.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore Sh. Gj. etj.,.
-Me shkresën nr. 11519/1 prot., datë 31.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore I. Sh. etj.,.
-Me shkresën nr. 11198 prot., datë 10.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore E. B. etj.,.
-Me shkresën nr. 10245/2 prot., datë 10.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore M. S. etj.,.
-Me shkresën nr. 1188/1 prot., datë 09.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore E. K. etj.,.
-Me shkresën nr. 10626/1 prot., datë 14.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore A. S..
-Me shkresën nr. 11839 prot., datë 25.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore A. J..
-Me shkresën nr. 11146 prot., datë 09.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore S. Ll..
-Me shkresën nr. 10928 prot., datë 03.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore M. R. etj.,.
-Me shkresën nr. 11016 prot., datë 07.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore M. R. etj.,.
-Me shkresën nr. 11016 prot., datë 07.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore “M.” SHPK.
-Me shkresën nr. 10740/1 prot., datë 07.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore N. J..
-Me shkresën nr. 11147 prot., datë 09.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore G. L.
-Me shkresën nr. 10659/1 prot., datë 14.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore “E. A.” SHPK.
-Me shkresën nr. 4733/1 prot., datë 14.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore “A.” SHA.
-Me shkresën nr. 10544/1 prot., datë 14.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore K. B., G. B..

-Me shkresën nr. 11396 prot., datë 15.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore B. D.
-Me shkresën nr. 11408/1 prot., datë 29.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore D. F. etj.
-Me shkresën nr. 11395 prot., datë 15.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore S. B. etj.
-Me shkresën nr. 11395/1 prot., datë 29.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore S. B. etj.
-Me shkresën nr. 11839 prot., datë 29.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. E. B. i cili është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës për realizimin e pagesës në favor të palës kreditore A. R.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me projektin e investimit "Instalimi i Sistemit Web Gis" në vlerën për **45.2 milion lekë** me bashkimin e operatorëve ekonomik "G. C." ShPK dhe "I." ShPK, ku sipas Aneksit "Shërbimet dhe Grafiku i realizimit" të kontratës, instalimi dhe mirëmbajtja e këtij sistemi duhet të kishte përfunduar në të gjithë komponentët e tij me ***datën 20 Qershor 2020,*** pasi "Krijimi dhe instalimi i sistemit" sipas pikës nr. 2 te grafikut, duhet të përfundonte brenda 6 muajsh, (pra më 20 maj 2016) dhe mirëmbajtja për 4 vite (20 qershor 2016 deri 20 qershor 2020) u konstatua se, **nga Qershori 2016 deri në Tetor 2020 nuk është finalizuar qëllimi i këtij projekti investimi,** për më tepër që prej 4 vitesh është kryer mirëmbajtja e këtij sistemi, por nuk ka një inventar përfundimtar të digjitalizuar të rrugëve të kolauduar dhe marrë në dorëzim në sistemin Web Gis. Si përfundim, ARrSh nuk ka përditësuar dhe përfunduar hartën për të saktësuar distancat kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë, sidomos kjo për situatat kur nuk ka asnjë udhëzim si do të veprohet për rastet e kundërshtimve të gjatësive të këtyre segmenteve rrugore (në Km) midis të dhënave të inventarit te rrugëve sipas emërtimeve dhe VKM-ve respektive dhe të dhënave mbi gjatësinë e rrugëve *(në km)* sipas sistemit Web Gis. Nga sa më sipër, ARrSh nuk ka kryer detyrimin ligjor të përditësimit të këtyre hartave dhe distancave kilometrike. Nisur nga numri i madh i Institucioneve të administratës shqiptare që operojnë me këtë udhëzim dhe VKM, *mos përditësimi i Hartës së Rrjetit Rrugor të Republikës së Shqipërisë si dhe tabelës së Distancës kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë shton risqet e përfitimit të padrejtë të fondeve të buxhetit të shtetit në trajtimin financiar të punonjësve.* Për sa më lart kemi një përdorim pa ekonomicitet, efikasitet dhe eficience të fondeve në vlerën **45,2 milion lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARrSh-së/Drejtori i Përgjithshëm, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim përfundimin e këtij procesi të tej zgjatur dhe nxjerrjen e përgjegjësive dhe nisjen e masave administrative apo disiplinore për personat përgjegjës.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Në segmentin rrugor Vlorë – Sarandë, konkretisht në segmentin

Kthesa e Fterës (Borsh)–Piqeras, progresivi km 54+185-54+275, ku ka ndodhur rrëshqitja, kontraktori BOE *"E. T. C. S. A. ." & "S." SHPK,* sipas Urdhër Ndryshimit ChO D12 datë 16.05.2019 në seksionin e dëmtuar në gjatësinë 90 m *ka bërë ndërhyrje për rehabilitimin e shtresave rrugore, por jo për mbrojtjen e trupit të rrugës.* **Vlera 16,531.09 Euro,** e shpenzuar për riparimin e shtresave, ndërkohë që nuk janë bërë punime të mbrojtjes së trupit të rrugës**, konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet** për buxhetin e shtetit.
5.1. Rekomandimi: ARRSH të marri masa që në të ardhmen, për projektet e reja dhe ato në proces të mos kryej punime pa marrë masa paraprake që investimi i tyre të jetë i qëndrueshëm dhe rezultativ.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, nga ARRSH janë ngritur pretendimet se, rekomandimi është pranuar dhe do të zbatohet në vijim në projektet e reja.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

C. MASA ADMINISTRATIVE

C. 1 - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Tepelenë, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:
Subjektit *"A. C."* me përfaqësues ligjor A. D. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.134/7, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin *"Ndërtim By-Pass Tepelenë", Loti 1*, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **6,841,546 lekë pa TVSH**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***;**

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 9345/9 prot., datë 25.10.2021, Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH z. E. B. i ka dërguar pjesët respektive (rekomandimet përkatëse) nga Raportit Përfundimtar të Auditimit të ushtruar nga KLSH, të cilat i adresohen për vlerësim Inspektioriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Tepelenë.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

C. 2 - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e*

Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Delvinë, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:

1. Subjektit BOE *"4. E. 7. & I. P.K.S sh.p.k & GJ. & C. sh.p.k"* me përfaqësues ligjor K. Ç., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh, MK.0466/8 dhe MK.1735/20, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin *"Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë", Loti 5*, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **7,443,875 lekë pa TVSH.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2. Subjektit BOE *"4.E. 7. & I. P.K.S sh.p.k & GJ. & C.sh.p.k"* me përfaqësues ligjor K. Ç., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.0466/8 dhe MK.1735/20, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin *"Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë", Loti 6*, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **18,448,939 lekë pa TVSH.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 9345/9 prot., datë 25.10.2021, Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH z. E. B. i ka dërguar pjesët respektive (rekomandimet përkatëse) nga Raportit Përfundimtar të Auditimit të ushtruar nga KLSH, të cilat i adresohen për vlerësim Inspektioriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Delvinë.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

C. 3 - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Gjirokastër, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:
Subjektit BOE *"4. E. 7. & I. P.K.S sh.p.k & GJ. & C. sh.p.k"* me përfaqësues ligjor K.Ç., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.0466/8 dhe MK.1735/20, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin *"Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë", Loti 4*, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **1,756,456 lekë pa TVSH**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***;**

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 9345/9 prot., datë 25.10.2021, Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH z. E. B. i ka dërguar pjesët respektive (rekomandimet përkatëse) nga Raportit Përfundimtar të Auditimit të ushtruar nga KLSH, të cilat i adresohen për vlerësim Inspektioriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Gjirokastër.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

C. 4 - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit

nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Kurbin, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:
Subjektit *"I.-D." sh.p.k* me përfaqësues ligjor I. D., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1641/12, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin *"Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore Nyja Milot"*, për certifikimin e punimeve të pakryera si dhe përcaktim i gabuar i peshës së tombinove (kontratë e pa përfunduar), me diferencë në vlerën **7,996,264 lekë pa TVSH**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 9345/9 prot., datë 25.10.2021, Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH z. E. B. i ka dërguar pjesët respektive (rekomandimet përkatëse) nga Raportit Përfundimtar të Auditimit të ushtruar nga KLSH, të cilat i adresohen për vlerësim Inspektioriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Kurbin.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

D. MASA DISIPLINORE

D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

D.1.1Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe në nenin 11 të kontratës individuale të punës kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: ***"Vërejtje me shkrim"*** për personat si më poshtë:

1. *Zj. M. Sh.*, me detyrë Përgjegjëse e sektorit të prokurimeve, në cilësinë e Përgjegjësit të prokurimit dhe anëtar i Njësisë së Prokurimit në tenderat e zhvilluar si dhe në për procedurat blerje me vlera të vogla.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARrSh nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

Z. E. E., me detyrë Drejtor i Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve, në cilësinë e sekretarit të Këshillit Teknik.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se, deri më datë 29.07.2022, nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

Me shkresën nr. 8624/2 datë 30.09.2022 (protokolluar në KLSH nr. 600/63, datë 03.10.2022) janë paraqitur pretendimet e ARRSH lidhur me statusin e rekoandimeve duke vendosur në dispozicion dokumentacion shtesë të cilat u morrën parasysh dhe u bënë reflektimet në material, ndërsa përr një pjesë ishte ardumentuar që do të merren parasysh në të ardhmen, gjë që do verifikohet në auditimin e rradhës.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Drejtorinë e Përgjithshme Detare mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", DPD, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 184/11 prot., datë 08.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm, nuk ka respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 1110/2 prot., datë 30.06.2022.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 283/12 port., datë 31.12.2021 dhe në Drejtorinë e Përgjithshme Detare me nr. 283/12 prot., datë 31.12.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **8 masa organizative**;
b. Janë rekomanduar **0 masa për shpërblim dëmi në vlerën 0 lekë**;
c. Janë rekomanduar **3 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit.**
d. Janë rekomanduar **5 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Organizative	8	8	-	-
2	Shpërblim dëmi	-	-	-	-

3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	3	3	-	-
4	Masa disiplinore	5	5	-	

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	**Lloji i rekomandimit**	**Pranuar Plotësisht (numër)**	**Statusi i zbatimit**			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	8	6	2	-	-
2	Shpërblim dëmi	-	-	-	-	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	3	-	1	1	1
4	Masa disiplinore	5	2	-	3	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda

tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nr.	**Lloji i rekomandimit**	**Pranuar Plotësisht (numër)**	**Statusi i zbatimit**			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	8	6	2	-	-
2	Shpërblim dëmi	-	-	-	-	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	3	-	1	1	1
4	Masa disiplinore	5	2	-	3	-

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 75%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", DPD, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 184/11 prot., datë 08.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm, nuk ka respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 1110/2 prot., datë 30.06.2022.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për*

rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projektbuxhetit të dërguar nga DPD për vitin 2018 dhe vitin 2019 në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, rezultoi se ai nuk është shoqëruar me një analizë të objektivave për vitin si dhe me produktet për realizimin e objektivave. Gjithashtu në kërkesat për buxhet, nuk rezultojnë të plotësuar formularët për kërkesat shtesë mbi tavanet limit të miratuara dhe argumentimin e domosdoshmërisë së këtyre fondeve, me qëllim alokimin e tyre nga Ministria e Financave sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, VKM nr. 185, datë 29.03.2018 *"Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike"*, Aneksi 1, UMF nr. 22, datë 17.11.2016 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*".

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e DPD-së, të marrë masa që gjatë hartimit të PBA-së, të plotësohen formularët për fondet jashtë tavaneve të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave referuar nevojave për investime, mallra e shërbime mbi këto tavane si kusht për mundësinë e çeljeve të fondeve për plotësimin e këtyre nevojave si dhe të merren masa për një planifikim e menaxhim të koordinuar të buxheteve vjetore me ato të PBA. PBA dhe raportet e monitorimit të shoqërohen me analiza të treguesve si dhe të objektivave e produkteve përkatëse.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm
Janë plotësuar dhe realizuar të gjitha kërkesat e sipër përmendura. Është dërguar materiali PBA 2021-2023, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 1495/1 prot., Datë 04.09.2020. Është dërguar materiali me raportet e monitorimit për vitin 2020, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.170 prot., Datë 25.01.2021..Është dërguar materiali i analizave e raporteve të monitorimit për vitin 2021, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.170/1 prot., Datë 20.01.2022.
Rekomandimi do të konsiderohet i realizuar.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar plotësisht.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme Detare, për vitin 2018 ka realizuar 14 procedura prokurimi me vlerë totale të prokuruar 8,891,984 lekë me TVSH nga të cilat 4 procedura kanë objekte që i përkasin një grupi mallrash të ngjashëm dhe kapin vlerën e 2,640,900 lekë pa TVSH. Njësoj ka vepruar DPD edhe për vitin 2019 ku nga 13 procedura prokurimi të realizuara me vlerë totale të prokuruar 7,062,872 lekë me TVSH, 4 procedura kanë objekte që i përkasin një grupi mallrash të ngjashëm me vlerë totale të prokuruar prej 2,325,710 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 28, pika 2 dhe nenin 40, pika 1 e Ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006 i ndryshuar *"Për prokurimin publik"*, nenin 40, pika 1 dhe pika 8 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* dhe pikën 3, të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, i ndryshuar *"Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël".*

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat që në të ardhmen të mos copëzohen fondet për grup mallrash të ngjashëm duke shmangur në këtë mënyrë kryerjen e procedurave normale të prokurimit në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm
Referuar regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik për vitin 2022, datë 08.02.2022, u konstatua se nuk rezulton copëzim fondesh.
Rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar plotësisht.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar plotësisht.

3. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë kryer me parregullsi, kjo për sa i përket justifikimit të fillimit të disa prej procedurave të prokurimit. Konkretisht u konstatua mungesa e argumentimit dhe dokumentimit të nevojës për mallra, shërbime apo riparime. Për rastet e kryerjes së procedurave për blerje mallrash, DPD nuk ka dokumentuar nevojën përmes verifikimeve paraprake të gjendjes së këtyre mallrave në magazinë apo duke ju referuar kërkesave për blerje mallrash nga njësitë e vartësisë. E njëjta situatë paraqitet edhe për procedurat e prokurimit për kryerjen e riparimeve apo shërbimeve për të cilat nuk kanë argumentim lidhur me defektet e ndodhura përpara se të kërkohej prokurimi i riparimit të pajisjeve apo zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara sipas zërave përkatës për riparim ose shërbim. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar, neni 40, pika 3, paragrafi dytë dhe neni 59, fjalia e fundit.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat për justifikimin/argumentimin paraprak me dokumentacion vërtetues të nevojës së kryerjes së shërbimit/riparimit apo të blerjes së mallrave përpara fillimit të kryerjes së procedurave të prokurimit për blerje mallrash apo riparime pajisjesh, kjo me qëllim shmangien e kryerjes së shpenzimeve për mallra apo shërbime të pa nevojshme për institucionin.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm
Drejtoria e Përgjithshme Detare ka marrë masat për justifikimin/argumentimin paraprak me dokumentacion vërtetues të nevojës të blerjes së mallrave përpara fillimit të kryerjes së procedurave të prokurimit duke u bazuar në planifikimin paraprak të kërkesave të mbledhura nga të gjithë sektoret e drejtorive, magazinës. Gjithashtu nga nevojat e evitentuara nga viti i mëparshëm Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse administron të gjitha kërkesat në formë shkresore dhe elektronike e më pas vijon me procedurën e planifikimit me qëllim shmangien e kryerjes së shpenzimeve të panevojshme për institucionin.
Rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar plotësisht.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar plotësisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitet 2018-2019, rezultoi se informacionet sqaruese të tyre (bilancet), nuk kanë shënimet shpjeguese të plota me zbërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo problemet që kanë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. DPD nuk disponon dokument që të vërtetojë se aktivet e qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në llogarinë 212 *"Ndërtime dhe rikonstruksione"*, janë në pronësi apo në administrim të kësaj Drejtorie. Nga DPD janë kryer plan rilevimet për godinat e kapitenerive të porteve Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë. Planet e rilevimit janë dokumentet kryesorë që japin informacion mbi statusin e pronësisë së objekteve/godinave që institucionet kanë në përdorim, në pronësi apo administrim. Mos marrja e masave për regjistrimin e inventarit në përdorim nga DPD është tregues i menaxhimit jo të mirë të aseteve të njësisë publike dhe bie ndesh me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, neni 4, pika 1, pika 19.

-Pasqyrat financiare dhe Pasqyrat e realizimit të buxhetit për të dy vitet kanë mospërputhje të faktit të realizimit të buxhetit me faktin e pasqyruar në pasqyrat e kontabilitetit. Këto mospërputhje, kanë ardhur si rezultat i mos kuadrimit të llogarive analitike me llogaritë sintetike (të gjendjeve) që pasqyrohen në pasqyrat financiare në fund të vitit siç kërkohet në Udhëzimin nr. 8 të MFE *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, pika 8.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, nëpërmjet Drejtorisë të Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Financës, të marrë masa për:
- Sistemimin e diferencave të fondeve të veta, të cilat duhet të jenë të barabarta me pasqyrimin e tyre në bilanc.
- Saktësimin e detyrimeve afatshkurtra si detyrime, likuidimi i të cilave duhet të bëhet brenda një viti ose një cikli operativ (ekonomik) duke përdorur aktivet e veta afatshkurtra ose duke krijuar detyrime të tjera afatshkurtra.
- Kryerjen e veprimeve përkatëse rregulluese kontabël në llogaritë kreditore për detyrimet ndaj furnitorëve, ndaj detyrimeve tatimore e të tjera në vijimësi dhe të bëhet pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin 2020.
- Regjistrimin e aseteve në pronësi të DPD-së dhe pasqyrimin e tyre të drejtë në pasqyrat financiare.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Në bilancin e vitit 2021, me shkresën përcjellëse nr. 908 prot., datë 23.03.2021, është kryer sistemimi i llogarive me fondet, sipas pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto pozicioni 105 nga grandet e brendshme kapitale, sistemime nga rezultati ushtrimor 85, sistemime me fondet nga pozicioni financiar 1013 konsumi AAGj.
Gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit viti 2021, për aktivet që kishin plotësuar normën e amortizimit, dhe ishin të papërshtatshme për përdorim, janë asgjësuar si mbeturina me peshë (1180 kg x 37lekë =43,660 lekë)., që janë të ardhura nga shitja e aktiveve t ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme. Asetet në pronësi të DPD-së dhe investimet në proces pasqyrohen drejtë në pasqyrat financiare.
Në procesverbalin nr. 01, datë 31.12.2017 është nxjerrë jashtë përdorimit Moto gjeneratori 50 Ë, djegur nga rryma elektrike, e vërtetuar nga eksperti ligjor nuk mund të kthehet në gjendje pune. Në këto rrethana nuk është shkarkuar nga inventari për shkak se nuk është vazhduar procedura për shitjen e këtij aseti si mbeturinë (hekur), veprim që duhej urdhëruar nga Nëpunësi Zbatues (Drejtori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse) të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.
Me urdhrin nr. 118 prot., datë 12.11.2019 është ngritur komisioni për inventarizimin e pjesshëm dhe komisioni i vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të skafeve dhe automjetit të DPD-së. Gjithashtu është ngritur me Urdhrin nr. 62., datë 16.06.2021 "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pjesshëm dhe komisionit të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të skafeve dhe automjetit të DPD-së" dhe me Urdhrin nr. 107., datë 18.11.2021 "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pjesshëm dhe komisionit të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të skafeve dhe automjetit të DPD-së". Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se në periudhën objekt auditimi komisioni i ngritur nuk ka mbajtur procesverbalet e vlerësimit dhe relacionet përkatëse, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30., datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik.".
Për sa më sipër rekomandimi i KLSH-s do të konsiderohet i realizuar pjesërisht.
Zbatimi të rekomandimit: Realizuar pjesërisht

4.2 Rekomandimi: DPD Durrës, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Financës, të marrë masa për kryerjen e kuadrimeve të nevojshme me qëllim që raportimet faktike të buxhetit të rakordojnë me raportimet në pasqyrat financiare.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm
Janë kryer të gjitha kuadrimet e nevojshme ku raportimi faktik i buxhetit ka rakorduar me raportimet e pasqyrave financiare. Bilanci 2020 me shkresën përcjellëse nr. 908 prot.,Datë 23.03.2021 dhe Bilanci 2021 me shkresën përcjellëse nr.265 prot., Datë 23.03.2022.

Rekomandimi do të konsiderohet i realizuar.
Zbatimi të rekomandimit: Realizuar

5. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës nuk ka përcaktuar Grupin e Menaxhimit të Risqeve dhe planin e veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrim i neneve 8, pika 8/a dhe pika 10, e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar dhe nuk është përcaktuar koordinatori i risqeve në fushat e këtij institucioni. Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt negativ për përmbushjen e objektivave, rezultoi se nuk janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontrolleve ekzistuese dhe nevojave për kontrolle të reja, por nuk janë hartuar për çdo zotërues e sektor, sipas përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 "Menaxhimi i riskut", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Institucioni të rishikojë dhe përditësoje çdo vit Regjistrin e Risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioriteteve dhe qëllimeve afatmesme e afatgjata që ky institucion ka.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare, Nëpunësi Autorizues të marrë masa që të përcaktohet Grupi për Menaxhimin e Riskut dhe të miratojë koordinatorin e riskut të institucionit, konform përcaktimeve të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Institucioni të rishikojë dhe përditësojë çdo vit Grupin për Menaxhimin e Riskut dhe koordinatorin e riskut.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm
Është nxjerrë Urdhër nr. 62 datë 19.08.2020 "Për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Implementimin e Kërkesave të Ligjit 10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 16, Datë 20.07.2016 "Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatorit të Riskut në Njësitë Publike dhe është nxjerre Urdhër me nr. 1568/1 prot.,datë 19.08.2020 "Për Ngritjen dhe Funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, si dhe për vitin 2021 është ngritur Urdhër nr. 16 datë 11.03.2021 "Për Ngritjen dhe Funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme Detare".
Rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar plotësisht.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar plotësisht

5.2 Rekomandimi:, DPD Durrës, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, të marrë masa që të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, regjistri i riskut, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Ministrinë e linjës për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve për arritjen e objektivave të vendosura

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm

Është plotësuar me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, regjistri i riskut, është miratuar dhe është realizuar dërgimi i tij në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 72/1 prot datë 07.02.2020 "Shkresë përcjellëse për Plotësimin e regjistrit të riskut dhe planin e veprimit për vitin 2020, dhe për vitin 2021 është realizuar dërgimi i tij në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 116/2 prot datë 11.03.2021 "Shkresë përcjellëse për Plotësimin e regjistrit të riskut dhe planin e veprimit për vitin 2021.
Rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar plotësisht.
Zbatimi të rekomandimit: Zbatuar plotësisht.

6. Gjetje nga auditimi: Inventarët e mjeteve mbahen në mënyrë dokumentare/shkresore nga Drejtoria e Sigurisë Detare, Administrimit dhe Kontrollit Shtetëror (*Sektori i regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detare*) dhe nuk ka një regjistër elektronik. Dixhitalizimi i të dhënave, do të bënte të mundur informimin në kohë dhe kryerjen e detyrave me efektivitet nga punonjësit e institucionit.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare, Nëpunësi Autorizues, të informojë MIE mbi situatën e inventarizimit të mjeteve lundruese dhe në bashkëpunim me MIE të ndërmarrin hapat për propozimin e realizimit të një projekti të dixhitalizimit të inventarit të mjeteve lundruese dhe publikimin e tyre në mënyrë elektronike për stafin e institucionit.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise eshte e informuar mbi situaten e iventarizimit te mjeteve lundruese. Ky iventar bazohet ne 7(shtate) regjistra fizike dhe elektronike te anijeve/mjeteve lundruese sipas klasifikimit dhe qellimit te perdorimit, qe menaxhohet nga Zyra e Regjistrimit te Mjeteve Lundruese dhe Detareve.
Projekti i dixhitalizimit te inventarit te mjeteve lundruese, eshte nje projekt i perfunduar me 24.11.2020.
Zbatimi të rekomandimit: Pjesërisht

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj për riparimin, mirëmbajtjen apo shërbime të sistemeve IT, vlerën prej **2,674,420 lekë** ndërkohë që këto shpenzime duhej të ishin përballuar nga AKSHI. Titullari i AK por dhe Komisioni i blerjeve të vogla, si dhe Drejtoria e shërbimeve Mbështetëse dhe Sektorin Juridik, për mirëmbajtjen apo shërbimin e sistemeve IT të institucionit, duhej ti referoheshin VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *"Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit"* e ndryshuar dhe Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 *'Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Mos rakordimi i strukturave të institucionit të DPD-së, ka sjellë si rezultat rritjen e shpenzimeve të panevojshme për buxhetin e DPD. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej 2,674,420 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efiçensës, ekonomicitetit dhe efektivitetit.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare, të marrë masat e nevojshme, për të bashkëpunuar me AKSHI-n, referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke eliminuar kostot e panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve IT.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm
Drejtoria e Përgjithshme Detare i është drejtuar Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë dhe Informacionit me shkresën nr. 45 prot datë 14.01.2021 "Kërkesë për punonjësit (TIK) dhe me shkresën nr.prot 1690 datë 18.03.2021 "Njoftim" është përcjellë emërimi i specialistit TIK.
Zbatimi të rekomandimit: Është në Proces

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës për kontratën nr. 6811, datë 03.12.2018, të lidhur midis AKSHI-t dhe operatorit ekonomik "R. C." SHPK (me përfitues DPD) dhe objekt *"Vendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi"*, ka likuiduar vlerën prej 68,933,400 lekë me TVSH. Për mirëmbajtjen e sistemit apo riparimin e tij, DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj 1,267,200 lekë ndërkohë që këto shpenzime duhej të ishin përballuar nga AKSHI. Mos rakordimi i strukturave të institucionit të DPD-së, ka sjellë si rezultat rritjen e shpenzimeve të panevojshme për buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej 1,267,200 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efiçensës dhe efektivitetit të fondeve publike.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat e nevojshme, për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël si dhe eliminimin e kostove të panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm
Gjatë vitit 2020-2021 nuk kemi bërë veprime në lidhje me rekomandime2.1.
Zbatimi të rekomandimit: Nuk është zbatuar.

2.2 Rekomandimi: DPD, në bashkëpunim me AKSHI-n dhe MIE, të marrin masa për mbulimin e shpenzimeve për zërin "F.V. Raportimi Automatik i Pozicionit LRIT" dhe garantimin nga AKSHI të funksionimit të sistemit me kontrata shumë vjeçare të cilat të jenë njësoj në kohë si për mirëmbajtjen e sistemit por edhe të raportimit automatik, për të siguruar funksionimin e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi.

Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Është bërë nga AKSHI shërbimi i mirëmbajtjes së LRIT për 2020-2021
Zbatimi të rekomandimit: Pjesërisht

C. MASA DISIPLINORE

D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE
Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, kontratës kolektive dhe kontratave individuale të punës neni 15, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, që në varësi të kompetencave ligjore të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje", për:
1.z. B.Ç., në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla
2.znj. B.Ç., në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla
3.znj. M. K., në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla

4.znj. F. I., Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse, dhe
5.z. K. B., Specialisti i Sektorit Juridik
Qëndrimi i DPD-së për Rekomandimin e mësipërm:
Eshtë marrë masë disiplinore "Vërejtje" dhe është njoftuar znj. F.I. me shkresën nr. 122 prot datë 16.02.2022 "Njoftim masë disiplinore"
Eshtë marrë masë disiplinore "Vërejtje" dhe është njoftuar z. K. B. me shkresën nr. 122/1 prot datë 16.02.2022 "Njoftim masë disiplinore".
Përsa i përket masave disiplinore për punonjësit e tjerë nuk është vepruar me argumentimin se është bërë ankesë pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit si më poshtë: *Komisioni i prokurimit publik me vlerë të vogël për vitin kalendarik 2018 dhe 2019 ka përcjellë me shkresën drejtuar KLSH nr. 1366/11 datë 21.01.2022 "Për disa kundërshtime dhe revokimin e masës vërejtje në lidhje me Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin dhe përputhshmërinë të ushtruar në subjektin Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2019 për gjetjen "Copëtim fondi për grup mallrash të ngjashëm në procedurat e prokurimit për blerjet e vogla".*
Për sa më sipër rekomandimi do të konsiderohet në proces.
Zbatimi të rekomandimit: Proces

ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Entin Kombëtar të Banesave mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave ka hartuar planin e veprimit, me afate konkrete dhe persona përgjegjës për zbatimin e tyre, i cili është miratuar me Vendimin Këshillit Drejtues të EKB nr.34, datë 05.11.2021.
Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154 / 2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Enti Kombëtar të Banesave *ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.3707 prot, datë 09.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm, duke respektuar afatin 20 ditor.*

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar me shkresën nr.prot.4088, datë 31.12.2021, si edhe shkresën nr.998 datë 29.04.2022, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të Ligjit nr.154 /2 , datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, Enti Kombëtar të Banesave ka respektuar afatin 6 Mujor.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit nr.578/29 datë 20.10.2021, protokolluar në EKB nr.prot.3270/2 datë 22.10.2021 janë rekomanduar masat si më poshtë:

a. Janë rekomanduar **27 masa organizative**;

b. Janë rekomanduar **4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 2,887,031 lekë**;

c. Janë rekomanduar **6 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit.**

d. Janë rekomanduar **2 masa në formën e të ardhurave të munguara**;

e. Janë rekomanduar **1 masa administrative;**

f. Janë rekomanduar **6 masa disiplinore.**

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Organizative	27	27	-	-
2	Shpërblim dëmi	4	4	-	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	6	6	-	-
4	Të ardhura të munguara	2	2	-	-
5	Administrative	1	1	-	-
6	Masa disiplinore	6	6	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e EKB

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	27	20	-	7	-
2	Shpërblim dëmi	4	-	-	4	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	6	3	-	3	-
4	Të ardhura të munguara	2	2	-	-	-
5	Administrative	1	1		-	-
6	Masa disiplinore	6	6	-	-	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nr.	**Lloji i rekomandimit**	**Pranuar Plotësisht (numër)**	**Statusi i zbatimit**			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	27	20	-	7	-
2	Shpërblim dëmi	4	-	-	4	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	6	3	-	3	-
4	Të ardhura të munguara	2	2	-	-	-
5	Administrative	1	1		-	-
6	Masa disiplinore	6	6	-	-	-

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 74%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit*

nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave ka hartuar planin e veprimit, me afate konkrete dhe persona përgjegjës për zbatimin e tyre, i cili është miratuar me Vendimin Këshillit Drejtues të EKB nr.34, datë 05.11.2021.

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154 / 2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Enti Kombëtar të Banesave *ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.3707 prot, datë 09.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm, duke respektuar afatin 20 ditor.*

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar me shkresën nr.prot.4088, datë 31.12.2021, si edhe shkresën nr.998 datë 29.04.2022, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të Ligjit nr.154 /2 , datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, Enti Kombëtar të Banesave ka respektuar afatin 6 Mujor.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Aprovimi i pasqyrave financiare të periudhës 2018 nga Këshilli Drejtues, është kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 33/1. Vonesat në hartimin, aprovimin dhe depozitimin kanë pasoja në vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike si dhe për vendim-marrjet e palëve të interesuara *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 65-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të merren masa që në të ardhmen, pasqyrat financiare të aprovohen e të depozitohen brënda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike lidhur me vendim-marrjet që duhet të marrin palët e interesuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Bilanci vjetor 2021 është depozituar në organet tatimore në datë 30'03.2022. Është miratuar raporti i auditimit të bilancit kontabël, pasqyrave financiare dhe ndarja e fitimit neto të pashpërndarë për vitin 2021, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.10, datë 31.05.2022, prot. Nr.1196, datë 01.06.2022, dhe vendimi i pronarit është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve më datë 13.06.2022.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare u konstatua se: Zëri kontabël Subvencione në vlerën 3,218,981,973 lekë, i cili përbëhet nga fonde të akorduara për ndërtimin e banesave për të pastrehët, në periudhën 1993-2007, nga Buxheti i Shtetit, Kredia Greke, Banka Botërore e donatorë të tjerë. Nga vlera 3,287,493,319 lekë e subvencionit më

01.01.2020, pjesa 3,030,059,396 lekë nuk është amortizuar si shpenzim në pasqyrën e performancës së institucionit, por bartet e pandryshuar në vite.
-Në zërin kontabël të ardhura financiare, që janë interesat financiarë që EKB, u merr klientëve për apartamentet e shitura, u konstatua se të ardhurat njihen në momentin e arkëtimit dhe jo mbi bazën e parimit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
-Zëri kontabël në pasiv, "të ardhura të grumbulluara nga institucionet", në vlerën 121,170,125 lekë mbartet i pandryshuar në periudhat 2018-2020. Kjo vlerë ka lidhje me ndërtesa të ndërtuara nga shoqëri publike shtetërore për punonjësit e vet, dhe të dhëna për menaxhim EKB. Përderisa institucioni nuk disponon marrëveshje, ose kontrata detyrimi për pagesë për këto vlera, duhet të bëhet vlerësimi për sistemimin e zërit kontabël.
Në VKM nr. 470, datë 31.08.2000, "Për kalimin Entit Kombëtar të Banesave, banesat dhe objektet e kthyera në banesa, të ndërtuara dhe të blera me fondet e ish-shoqërisë Albpetrol SHA", në pikën 1 citohet: "*Banesat e ndërtuara dhe të blera, deri në fund të vitit 1999, me fondet e ish-shoqërisë Albpetrol SHA, si dhe objektet ndërtimore, të shndërruara në objekt banimi, që sot janë pronë e shoqërive Albpetrol SHA, Armo SHA dhe Servecom SHA, ti kalojnë Entit Kombëtar të Banesave. 2. Vlera e banesave, të ndërtuara e të blera, si dhe vlera e objekteve të kthyera në banesa, sipas lidhjeve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me kalimin e tyre Entit Kombëtar të Banesave, të llogariten si shlyerje e detyrimeve të prapambetura, që i ka buxhetit të Shtetit, ish-shoqëria Albpetrol SHA.*"
Në VKM e sipër përmendur nuk përcaktohet asnjë detyrim i EKB ndaj këtyre shoqërive për banesat dhe objektet e kthyera në banesa, të ndërtuara dhe të blera me fondet e ish-shoqërive publike.
-Në verifikimin e llogarisë 657, për periudhën 2019, u konstatua se është kontabilizuar me fletën kontabël nr. 1383, datë 11.09.2019, vlera 2,530,540 lekë si shpenzim i rezultatit vjetor.
Veprimi sa më sipër është kryer për të pasqyruar Vendimin e Gjykatës së Apelit, me shkresë nr. 1969 prot., datë 29.08.2019, lidhur me vlerën e rekomanduar nga KLSH, për tu dëmshpërblyer nga Andrea Dhimitri, me raportin me nr. 186/1 prot., datë 2302.2007, për të cilën EKB ka iniciuar procedurat ligjore, por afati është tejkaluar, kërkesat janë parashkruar dhe Gjykatat kanë vendosur anulimin e kërkesës. Kontabilizimi i mësipërm është kryer gabim, pasi nga verifikimi i zërave kontabël, vlera e mësipërme është, regjistruar në llogari të ardhura për tu arkëtuar dhe në llogari të ndërmjetme. Nga veprimi i mësipërm, EKB nuk ka pasur ulje ose zvogëlim të aktiveve, prandaj nuk duhet ta kontabilizonte në rezultatin ushtrimor. Rezultati i vitit 2019 është ulur me vlerën 2,530,540 lekë, duke u reflektuar dhe në detyrimet fiskale përkatëse, si tatimi mbi fitimin.
-Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, neni 5, dhe SKK nr. 1 e SKK nr. 2.
Parregullsitë dhe mos paraqitjet sipas SKK të zërave të pasqyrave financiare sjellin shtrembërime të rezultatit financiar dhe situatës ekonomike të institucionit *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 65-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrin masa që në të ardhmen, përgatitja dhe hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me përgjegjshmëri, vërtetësi e në afatet përkatëse, duke pasqyruar situatën financiare dhe performancën ekonomike, për disponimin e informacioneve palëve të interesuara në kohë, për vendim-marrjet përkatëse.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

1. Për pozicionin financiar "Subvencione të ndryshme ", shuma prej 3,218,981,973 lekë rrjedh nga subvencione të trashëguara nga viti 1993-2007, e cila akoma nuk rezulton e amortizuar në rezultatin ushtrimor. Nga auditimi, rezulton se për trajtimin të kësaj llogarie, nga ana e EKB është dërguar shkresa nr 4092 prot., datë 31.12.2021 "Kërkesë për konsultim, për trajtimin e

llogarisë “Subvencione të ndryshme” e trashëguar prej vitit 1993 e në vazhdim” Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. Për sa i përket kontabilizimit të “të ardhurave nga interesat” mbi bazën e parimit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe jo në momentin e arkëtimit, më 1 Janar 2022 është kryer kontabilizimi i interesave vjetore në te ardhura për vitin përkatës 2022.
-Me shkresën nr.208 prot., datë 28.01.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të EKB “Mbi kontabilizimin e interesave të kredisë”, dërguar degëve rajonale, është trajtuar me detaje mënyra e sistemimit të llogarisë 411 “Klientë” për pjesën e interesave.
Përsa më sipër, janë kontabilizuar interesat e kredive të papaguara deri në datën 31.12.2021, të cilat janë evidentuar në mënyrë extra kontabël. Në këtë mënyrë, sistemimi kryhet duke marrë parasysh detyrimet për interesat e pasqyruara në kartelat e planit të kredisë për çdo klient.
Kjo pikë e rekomandimit është realizuar.
3. Për sa i përket zërit “të ardhura të grumbulluara nga institucionet”, në vlerën 121,170,125 lekë e mbartur e pandryshuar në periudhën 2018-2020, është kryer sistemimi në kontabilitet dhe është paraqitur e sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2021.
Me shkresat nr.213, 214, 215 prot., datë 28.01.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të EKB Mbi sistemimin e llogarisë 4013 “Detyrime ndaj institucioneve për banesa” janë njoftuar degët rajonale Berat, Elbasan dhe Fier, për të kryer veprimet kontabël përkatëse.
Kjo pikë e rekomandimit është realizuar.
Komenti i grupit të auditimit:
Për shkak të gjëndjes alert të llogarisë “Subvencione të ndryshme”,
Rekomandimi është në proces.

3. Gjetje nga auditimi: Enti Kombëtar i Banesave, nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se institucioni nuk ka mbajtur regjistrin e aktiveve në përputhje me pikën 30 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30. Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim të aktiveve që ka në dispozicion *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 65-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1 Rekomandimi: Drejtori i përgjithshëm duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre. **Në vijimësi**
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me e-mail e datës 05.11.2021 nga ana e drejtorisë së përgjithshme të EKB është kërkuar plotësimi i formularëve tip të dërguar për krijimin e regjistrit e produkteve të gatshme, nga degët.
--Me e-mail e datës 11.01.2022 “Për pasqyrat e aktiveve dhe amortizimit”, nga ana e drejtorisë së përgjithshme të EKB është kërkuar plotësimi i tyre nga degët.
Nga auditimi, rezulton se për vitin 2021 është ndërtuar Regjistri i Produktit të Gatshëm (aktive qarkulluese), formati i të cilit përmban, të dhënat kadastrale të objekteve, sipërfaqen, datën e marrjes në dorëzim nga EKB, gjendjen kontabël të vitit paraardhës, etj.
Gjithashtu, regjistri i aktiveve (mjetet themelore), është në proces miratimi, me qëllim plotësimin e formatit sipas kërkesave të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30, i ndryshuar.

Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është në proces.

4. Gjetje nga auditimi: EKB nuk ka kryer inventarizimin e plotë të aktiveve afatgjata dhe detyrimeve për periudhat 2018, 2019,2020, duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës*përkatës. EKB ka në pasqyrat financiare zërat produkt i gatshëm, për periudhën 2020, vlerën 395,028,918 lekë, ku përveç banesave të ndërtuara vetë në vitet e fundit ka dhe shumë objekte banimi të përfituara nga VKM të ndryshme gjatë viteve. Për këto zëra kontabël nga EKB nuk është kryer inventarizimi duke u siguruar që posedohen dokumentet e pronësisë, nëse prona është e lirë apo është e zënë, gjendja e saj dhe detaje të tjera. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, inventari i aktiveve dhe detyrimeve dhe pika 74 e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 65-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe detyrimeve e të drejtave për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre. **Në vijimësi**
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Drejtoria e Përgjithshme ka ngritur urdhërin nr.353, datë 04.11.2021, prot nr.3673, "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve afatgjata, produktit të gatshëm dhe inventarit të Imët në Degët Rajonale të EKB-së për vitin 2021";
-Drejtoria e Përgjithshme ka ngritur urdhërin nr.354, datë 04.11.2021, prot nr.3674, "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve afatgjata dhe inventarit të imët në Drejtorinë e Përgjithshme për vitin 2021";
- Në datën 20.12.2021 është kryer inventarizimi i *aktiveve (mjete themelore)* dhe inventarizimi i *produktit të gatshëm* në të gjitha degët rajonale dhe drejtorinë e përgjithshme të EKB.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

5. Gjetje nga auditimi: Në zërin kërkesa të arkëtueshme ku për periudhën 2020 në zërin kontabël të tjera të arkëtueshme në vlerën 18,190,959 lekë, përveç detyrimeve të cilat po ndiqen me veprime administrative dhe ligjore, ka dhe zëra debitorë të tjerë për të cilët nuk disponohen dokumente të mjaftueshëm justifikues për ndjekje ligjore. Gjithashtu në këtë zë ka dhe vlera materialisht të vogla për të cilat nuk është efektive për ndjekje në organet gjyqësore.
Lidhur me zërin klientë, nga EKB nuk janë llogaritur provizione dhe në rastet kur ka klientë të cilët i kanë kaluar 365 ditë mos pagesash duke kaluar në statusin e debitorit pa shpresë arkëtimi sipas manualit të ndjekjes së klientëve aprovuar nga Këshilli Drejtues. Dega Berat deri më 31.12.2020 ka 13 klientë, dega Dibër 21 klientë, dega Durrës 65 klientë, dega Elbasan 45 klientë, dega Gjirokastër 41 klientë, dega Korçë 45 klientë, dega Kukës 54 klientë, dega Lezhë 133 klientë, dega Shkodër 59 klientë, dhe klientë (përmbytje) 171, dega Tiranë 30, dhe dega Vlorë 45 klientë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me SKK3, "Instrumentet Financiare", pika 22. Mos kryerja e zhvlerësime të aktiveve financiare sjell mos paraqitje të besueshme të situatës ekonomike të institucionit *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 65-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Drejtori i përgjithshëm të marrë masa që sektori i financës gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Në funksion të llogaritjes së provizioneve rezulton si më poshtë:

-Drejtoria e Përgjithshme ka kryer paraprakisht evidentimin e debitorëve me statusin "pa shpresë arkëtimi", duke i ndarë në 3 nëngrupe:

-Debitorë që paguajne rregullisht por për shkak se kanë mbi 365 ditë pa paguar kanë këtë status;

-Debitorë që paguajnë por jo rregullisht;

-Debitorë që nuk paguajnë për një kohë të gjatë, me qëllim evidentimin e debitorëve më problematik, që paraqesin nje risk të larte moslikuidimi;

Përsa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme ka krijuar provizionet si më poshtë:

-Provizionet për zhvlerësimin e llogarisë "Klientë";

-Provizionet për zhvlerësimin e llogarisë "Debitorë të tjerë";

-Provizione për proceset gjyqësore;

Provizionet janë pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, dërguar me shkresën nr.754, datë 30.03.2022, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i respektimit të afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se nga ana e Entit Kombëtar të Banesave nuk është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.*

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 477/10 prot., datë 13.09.2018 janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar 19 masa organizative nga të cilat janë pranuar 16 masa ose 84% dhe nuk janë pranuar 3 masa ose 16%. Nga 16 masat e pranuara rezulton se 12 masa janë zbatuar plotësisht ose 75%, 2 masa pjesërisht ose 12.5% dhe 2 masa janë në proces ose 12.5%

c. Janë rekomanduar 9 masa për shpërblim dëmi në vlerën 4,459 mijë lekë; të cilat janë pranuar në masën 100%, 6 masa janë zbatuar plotësisht në vlerën 1450346 lekë ose 32.2%, 1 masë është zbatuar pjesërisht në vlerën 40,781 lekë ose 1.3% dhe 2 masa janë në proces zbatimit 2,967,873 lekë ose 66.5%

d. Janë rekomanduar 7 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 61,470 mijë lekë, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 2 masa në vlerën 53,258,084 lekë ose 86,6% dhe janë në proces zbatimi 5 masa 8,211,916 lekë ose 13.4%;

e. Janë rekomanduar 1 masë administrative e cila është zbatuar plotësisht ose 100%

f. Janë rekomanduar 5 masa disiplinore nga të cilat janë pranuar 3 ose 60% dhe nuk janë pranuar 2 ose 40%, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 1 ose 33% dhe pjesërisht 2 ose 67% *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 13-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i EKB të marrë masa që të raportojë pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve duke zbatuar afatin 6-mujor si dhe të përshpejtojë procesin e realizimit të rekomandimeve që janë në proces zbatimi.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Është respektuar afati 6 mujori për raportimin në KLSH përkatësisht është informuar KLSH me shkresën nr.4088, datë 31.12.2021 "Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna

nga KLSH gjatë auditimit të veprimtarisë ekonomike-financiare, të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të EKB në vitin 2021" si dhe në vazhdimësi me shkresën nr.998, datë 29.04.2022.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit i 19 dosje personale, rezultoi se niveli i lartë i menaxhimit i ka dosjet e pa plota, disa dosje edhe pse me dokumentacion të plotë në brendësi të dosjeve kanë dokumentacion të panevojshme duke krijuar konfuzion brenda dosjeve në kundërshtim me *pikën 4 të Rregullores së Brendshme miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 50, datë 30.09.2014 "Mbi miratimin e Rregullores së Brendshme për shpalljen e vendeve të lira të punës dhe kritereve" (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1 Rekomandimi: Nga Drejtori e Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për plotësimin e të gjitha dosjeve personale dhe sistemin e tyre duke krijuar një arkiv me dosje personale të plotë dhe të azhurnuar.

Në vijimësi dhe në raste të tjera

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Vendimi nr.34, datë 05.11.2021 i Këshillit Drejtues ka miratuar në planin e veprimit drejtorinë e shërbimeve mbështetëse përgjegjës për sistemimin e të gjitha dosjeve të personelit dhe heqjen e dokumentacionit të panevojshëm.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është në proces.

8. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi rezulton se në EKB janë shtuar në strukturë 4 poste pune për specialistë rindërtimi. Specialistët e emëruar në këto pozicione janë dërguar me shkresë nga ministri me emrat përkatës dhe EKB ngarkohet për mbulimin e efektit financiar. Të gjithë punonjësit e emëruar në këto struktura në periudha të ndryshme (8 punonjës) paguhen nga EKB.
Këta punonjës nuk kanë zyrat në EKB, nuk kanë një përshkrim pune dhe nuk raportojnë në EKB mbi prezencën e tyre. Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse harton një listë prezencë mujore për këta punonjës pa u bazuar mbi një raportim nga vetë Ministria e Shtetit për Rindërtimin.
Punësimi i këtyre punonjësve është bazuar në Vendimi e Këshillit Drejtues nr. 8, datë 02.03.2020 "Për emërimin në detyrë për dy specialistë në Drejtorinë Teknik të EKB-së, me kontratë pune me afat kohor të caktuar një vit" dhe miratimin e fondit shtesë prej 1,358,000 lekë për mbulimin e shpenzimeve për pagat e tyre.
Në Relacionin e vënë në dispozicion nga EKB, pa numër protokolli dhe pa datë, që i është paraqitur Këshillit Drejtues është kërkesa për 2 specialist në Drejtorinë Teknike si pasojë e volumit të madh të punë të punës dhe për ndjekjen e problematikave si: Shpronësim në zonën e Laçit, apartamente të dhuruara, projektet model, partner i heshtur i TOKI – turk, dhe në asnjë rast nuk është përmendur për specialist për ministrinë e rindërtimit.
Nga grupi i auditimit u mor në shqyrtim protokolli i mbledhjes së zhvilluar për këtë qëllim në datë 02.03.2020 dhe u konstatua se në mbledhje është diskutuar mbi shtimin e strukturës me tre specialistë si nevojë për përballimin e punës pas tërmetit dhe mbështetjen nga Ministria e Rindërtimit.
Aktualisht të gjithë specialistët e rindërtimit në strukturën e EKB-së nuk kanë asnjë formimin profesional të nevojshëm për ti shërbyer qëllimit për të cilën u bë shtesa në strukturë pasi janë me formim sociologji, histori, gjuhësi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Rindërtimit të marrin masa që të raportohet rregullisht prezenca e punonjësve në punë, puna e kryer nga gjithsecili, përputhja e formimit profesional me qëllimin e vet shtesës në strukturë të EKB, si dhe hartimi i kontratave të punës në përputhje me postin konkret që mbulojnë.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Janë marrë masa të menjëhershme për raportimin muaj pas muaji të listprezencave të punonjësve të rindërtimit të firmosura nga Ministria e Shtetit për Rindërtimin, që nga muaji Shtator 2021 dhe deri në Muajin Maj 2022.

-Aktualisht specialistëve të rindërtimit i ka përfunduar kontrata e punës.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi rezulton se, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm janë dhënë 22 masa disiplinore për punonjëst e EKB, konkretisht 16 masa disiplinore në vitin 2018 dhe 6 masa disiplinore në vitin 2019. Periudha në vijim nuk ka masa disiplinore.

U audituan të gjitha procedurat e dhënies së masave disiplinore dhe rezulton se në asnjë rast procedura e dhënies së masës disiplinore nuk ka nisur nga eprori direkt por masa është dhënë direkt nga titullari i institucionit.

Nuk ka asnjë procesverbal mbi dokumentimin e shkeljes së kryer, komunikimi me punëmarrësin.

Gjithashtu nga aktet ligjore të hartuar nga vet institucioni (Statut, Rregullore e Brendshme, Udhëzime) nuk ka të parashtruar ngritjen e asnjë strukture (Komision Shqyrtim Ankese) mbi apelimin e masës disiplinore nga ana e punëmarrësit.

Dhënia e masës disiplinore bazohet vetëm në Statutin e Entit Kombëtar të Banesave, nr. 325/1 prot., datë 20.02.2019, neni 16, gërma "h" dhe "i"

a."Vendos masa disiplinore për Drejtorët/Përgjegjësit e Sektorëve në Drejtorinë e Përgjithshme dhe për Drejtorët e Degëve Rajonale, të cilët mund të ushtrojnë të drejtën e ankimimit pranë organit që i ka emëruar, si dhe vendos masa disiplinore për të gjithë punonjësit e EKB-së.

b. Nxjerr urdhra, udhëzime dhe rregullore të brendshme në zbatim të akteve ligjore e nën ligjore për drejtimin e EKB-së, si dhe ndjek e kontrollon zbatimin e tyre."

Dhe Rregulloren "Për organizimin dhe Funksionimin e EKB-së", neni 5, pika 12 dhe pika 13.

c."Vendos masa disiplinore për Drejtorët/Përgjegjësit e Sektorëve në Drejtorinë e Përgjithshme dhe për Drejtorët e Degëve Rajonale, të cilët mund të ushtrojnë të drejtën e ankimimit pranë organit që i ka emëruar, si dhe vendos masa disiplinore për të gjithë punonjësit e EKB-së.

d. Nxjerr urdhra, udhëzime dhe rregullore të brendshme në zbatim të akteve ligjore e nën ligjore për drejtimin e EKB-së, si dhe ndjek e kontrollon zbatimin e tyre."

Veprimet e mësipërm janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar me ligj nr. 136/2015, datë 05.12.2015

Nga auditimi rezulton se punonjësin e EKB – së vlerësohen në lidhje me performancën në punë bazuar në një formular vlerësimi të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 4, datë 28.02.2017

Nga auditimi rezulton se kjo procedurë nuk parashikohet në asnjë akt rregullativ të institucionit (Rregullore) dhe nuk është e përshkruar qartë mënyra e vlerësimit. Punonjësve nuk u komunikohen objektiva të qarta edhe të matshme në fillim të periudhës dhe më pas të vlerësohet plotësimi i tyre, por bazohen vetëm te formulari tip duke e bërë procesin formal dhe jo efektiv

për përmirësimin e punës *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa që të azhornojnë aktet rregullative të institucionit duke shtuar dispozitat përkatëse mbi procedurën e dhënies së masës disiplinore (nga dokumentimi i shkeljes, inicimi i masës nga eprori direkt deri tek komisioni i apelimit të masës disiplinore) dhe vlerësimin e periodik të punës (përshkrim procedure të qartë bazuar në objektiva të matshëm).

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me Urdhërin nr.402 datë 16.12.2021, nr.4005 prot., datë 16.12.2021 "Për ngritjen e komisionit të apelimit", nga Drejtoria e Përgjithshme është ngritur Komisioni i Apelimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi rezulton se janë punësuar 78 punonjës, nga të cilat janë audituar 22 procedura rekrutimi.

Rekrutimi i punonjësve në EKB bazohet mbi Rregulloren e Brendshme për shpalljen e vendeve të lira të punës dhe kriteret e emërimit në detyrë për punonjësit e EKB-së, miratuar me Vendimin nr. 50, datë 30.09.2014 të Këshillit Drejtues.

Nga auditimi rezulton se në asnjë rast nuk është bërë shpallja e vendit vakant pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) në kundërshtim me pikën 3.3 të Rregulloren e Brendshme për shpalljen e vendeve të lira të punës dhe kriteret e emërimit në detyrë për punonjësit e EKB-së, miratuar me Vendimin nr. 50, datë 30.09.2014 të Këshillit Drejtues.

Mos shpallja e vendeve vakante në Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) ka sjell informim të pakët të individëve të pa punë dhe që mund të jenë të interesuar për vendin e punës, ulje konkurrence dhe rekrutimin e stafit të kualifikuar.

Në asnjë rast nuk është dokumentuar intervistimi i kryer nga titullari, (edhe në rastet kor komisioni ka kualifikuar dy ose më shumë kandidat).

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit nuk është përcaktuar vjetërsia e punës dhe niveli arsimor *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.a Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për shpalljen e vendeve vakante pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit duke rritur shkallën e njohjes së vendit vakant me punëmarrësit potencial si dhe të dokumentojë çdo fazë gjatë procesit të rekrutimit.

10.b. Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa për përcaktimin e vjetërsisë në punë dhe nivelit arsimor për çdo post pune dhe/ose nxitjen e rekrutimit të stafit nga studentët e ekselencës me qëllim rritjen e performancës institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me shkresat nr.4010 prot, datë 16.12.2021, nr.132/1 prot, datë 19.01.2022, nr.79 prot, datë 13.01.2022, nr.1302/1 datë 02.06.2022 është njoftuar Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive lidhur me nevojën e rekrutimeve;

-Në Urdhërin Nr.253, datë 28.06.2022, nr.1581 prot, "Për emërimin në detyrë specialist arkive", pika 3 e urdhërit përcaktohet paga e pozicionit, paga e grupit, vjetërsia 2%.

-Në borderonë e çdo muaji është evidentuar vjetërsia në punë.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

11. Gjetje nga auditimi: Niveli i pagave në EKB është vendosur me Vendimin e Këshillit Drejtues të EKB-së nr. 13, datë 04.04.2017 "Mbi kategorizimin dhe nivelin e pagës mujore të punonjësve të EKB-së", dhe është njehsuar me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", në këtë Vendim është miratuar një shtesë page në vlerën 5,000 lekë për kategoritë Specialistë –Sekretar i Këshillit Drejtues, Specialist –Asistent i Drejtorit, Protokoll/Arkivist në Drejtorinë e Përgjithshme, Specialist i Financës në Drejtoritë Rajonale. Ky nivel pagash është miratuar nga Ministria me shkresën nr. 2281/1, datë 24.04.2017.
Nga auditimi konstatohet se për sektorin e auditimit, i cili ka 1 përgjegjës sektori dhe 2 audituese niveli i pagave përcaktohet:
Përgjegjësi i sektorit e ka pagën III-a/1 njësoj si çdo përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme. Audituesi e ka pagën III-b të barabartë me një kategori pagash me specialistët e nivelit të lartë në Drejtori të Përgjithshme, specialistin e financës, specialist i menaxhimit të riskut, specialist arkitekt si kategori e veçantë nga specialistët e tjerë në EKB, ndërkohë që përgjegjësi i sektorit të auditit ka pagesë të njëjtë me përgjegjësit e tjerë të sektorit, ndërkohë që paga në sektorin e auditit duhet të jetë më e lartë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa që për sektorin e auditit të brendshëm të bëjnë një ri-kategorizim të nivelit të pagave ose miratimin e një shtese mbi pagë për vetë natyrën sensitive dhe vështirësisë së punës së kryer nga ky sektor.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me Vendimin nr. 38 datë 30.12.2021, nr.4032/2 prot., të Këshillit Drejtues,.është miratuar shtesa mbi pagën e punonjësve të Sektorit të Auditit të Brendshëm.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

12. Gjetje nga auditimi: Me Vendimin nr. 24, datë 28.06.2019 "Mbi Shpërblimin Suplementar të punonjësve të Strukturave të Entit Kombëtar të Banesave, nga Fitimi i Realizuar në Vitin 2018" është miratuar fondi prej 6,000,000 lekë shpërblim suplementar për punonjësit e EKB nga një pagë.
Me shkresën nr. 1642, datë 08.07.2018 "Për miratim shpërblimi suplementar për punonjësit e EKB-së nga ndarja e fitimit të realizuar për vitin 2018" Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së i është drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për miratim dhënie shpërblimi.
Me Urdhrin nr. 13215/1, datë 26.09.2019 "Për miratimin e shpërblimit për punonjësit e Entit Kombëtar të Banesave" i Ministrit duke miratuar dhënien e një page shpërblim për punonjësit.
Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 214, datë 27.09.2019 "Mbi shpërblimin suplementar të punonjësve të Entit Kombëtar të Banesave nga Fitimi i realizuar në vitin 2018" ka caktuar mënyrën e ndarjes së shpërblimit, si përqindje e pagës mujore bazuar mbi performancën por është në kundërshtim me Urdhrin nr. 13215/1, datë 26.09.2019 "Për miratimin e shpërblimit për punonjësit e Entit Kombëtar të Banesave" të Ministrit duke miratuar dhënien e një page shpërblim për punonjësit.
Me Vendimin nr. 21, datë 19.06.2019 "Mbi Shpërblimin Suplementar të punonjësve të Strukturave të Entit Kombëtar të Banesave, nga Fitimi i Realizuar në Vitin 2019" është miratuar fondi prej 5,400,000 lekë shpërblim suplementar për punonjësit e EKB nga një pagë.

Me Urdhrin nr. 20248, datë 27.10.2019 "Për miratimin e shpërblimit për punonjësit e Entit Kombëtar të Banesave" i Ministrit duke miratuar dhënien e një page shpërblim për punonjësit. Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 308, datë 29.10.2020 "Mbi shpërblimin suplementar të punonjësve të Entit Kombëtar të Banesave nga Fitimi i realizuar në vitin 2019" ka caktuar mënyrën e ndarjes së shpërblimit, si përqindje e pagës mujore bazuar mbi performancën por është në kundërshtim me Urdhrin nr. 13215/1, datë 26.09.2019 "Për miratimin e shpërblimit për punonjësit e Entit Kombëtar të Banesave" i Ministrit duke miratuar dhënien e një page shpërblim për punonjësit *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që diferencimi i shpërblimeve të punonjësve të kryhet vetëm pasi të sigurohet procesi i vlerësimit objektiv i bazuar në aktet rregullative të insitucionit. ***Në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Në Vendimin nr.11, datë 31.05.2022 të Këshillit Drejtues "Për miratimin e dhënies së shërblimit suplementar të punonjësve të EKB-së, nga fitimi i realizuar në vitin 2021" është miratuar dhënia e shpërblimit deri në një pagë muore.

-Pritet miratimi nga Ministri Financave dhe Ekonomisë për veprim të mëtejshëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është në proces.

13. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm në EKB është e ngritur në nivel sektori në varësi strukturore nga Këshilli Drejtues, tek i cili raportohet dhe miratohet çdo raport auditimi.

Sektori është i përbërë nga 3 auditues (1 përgjegjës dhe 2 specialist auditues). Aktualisht në Sektorin e Auditimit të Brendshëm e certifikuar si Audituese e Brendshme në Sektorin Publik është vetëm përgjegjësia e sektorit. Dy specialist auditues pjesë të sektorit janë të punësuar rishtaz në këtë sektor. Të dy këta specialit auditues nuk kanë certifikatën e audituesit të brendshëm publik, dhe titullari i institucionit ka informuar Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me qëllim përfshirjen e audituesve në sezonin e ardhshëm kualifikues. Nga auditimi rezulton se Përgjegjësia e Sektorit të Auditimit është pjesë e grupit të auditimit në vazhdimësi duke qenë se dy specialist auditues janë të pa certifikuar dhe nuk mund të punojnë në mënyrë të pavarur dhe pa mbikëqyrjen e një audituesi të certifikuar dhe me eksperiencë si auditues. Por përfshirja e përgjegjëses së sektorit në auditim, konkretisht përgjegjëse e grupit të auditimit nuk siguron rishikimin e cilësisë së punës së grupit të auditimit në kundërshtim me Kapitulli 7 "Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm" e Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar. Të dy specialistët e punësuar rishtas në sektorin e audititmit të brendshëm janë punonjës që kanë punuar në drejtori të përgjithshme në funksione të tjera (jurist, specialiste e riskut) dhe si të tillë ata paraqiten në kushtet e konfliktit të interesit në kundërshtim me Neni 18 "Konflikti i interesave për audituesit e brendshëm" i Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik,, kur auditojnë Drejtorinë e Përgjithshme të EKB *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa që punësimi i stafit auditues të kryhet nga jashtë insitucionit duke evituar konfiktin e interesit si dhe punësimi i stafit të pa certifikuar njëkohësisht pasi sjell anomali në funksionimin e sektorit të auditimit.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Kërkesë nr.1003 prot, datë 02.03.2021 dhe nr.2066 prot, datë 17.05.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të EKB "Për pjesëmarrje në procesin e certifikimit të AB", drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është në proces.

14. Gjetje nga auditimi: Planifikimi Strategjik 2020– 2022 dhe Planifikimi vjetor janë përcjellë tek Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 2131/1, datë 31.10.2019.
Plani është dërguar me vonesë tek Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pas duhet të dorëzohej brenda datës 20 tetor në kundërshtim me pikën 3.3 të Kapitullit III "Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm" të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.
Me shkresën nr. 138/1, datë 20.01.2021 është dërguar për shqyrtim dhe vlerësim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm raporti vjetor. Me shkresën nr. 3/2, 22.01.2021 kanë shqyrtuar dhe kanë dhënë rekomandimin pozitiv për raportin dhe miratimin është bërë me Vendimin nr. 04, datë 22.01.2021. Raporti i aktivitetit është dërguar me shkresën nr. 138/3, datë 29.01.2021 në Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
Raporti është dërguar me vonesë tek Komiteti i Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi duhet të ishte dërguar brenda datës 15 janar, në kundërshtim me pika 4.3 të Kapitullit IV "Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit" të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
14.1 Rekomandimi: Sektori i Auditit të Brendshëm të marrë masa që të hartojë dhe dorëzojë pranë organeve eprore planin vjetor dhe strategjik si dhe raportin vjetor brënda afateve të përcaktuara. ***Në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Sektori i Auditimit të Brendshëm ka hartuar dhe dërguar për shqyrtim planin vjetor 2022 dhe strategjik 2022-2024 pranë KAB me shkresën nr.3369, datë 29.09.2021;
-Plani vjetor dhe strategjik është miratuar në KD me vendimin nr.31, datë 18.10.2021, prot.nr.3483/2;
-Me shkresën nr.3369/3, datë 18.10.2021, është dërguar pranë MFE (brenda afateve ligjore);
-Është hartuar Raporti mbi Veprimtarinë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm të EKB-së për vitin 2021, i cili është dërguar zyrtarisht dhe në KAB me shkresën nr.96, datë 14.01.2022;
-Raporti vjetor është shqyrtuar dhe miratuar nga Këshilli Drejtues i EKB-së me VKD nr.3, datë 28.01.2022, prot nr.133/2. (brenda afateve ligjore).
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

15. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit: Objekt banimi dhe shërbimi 8 kate me një parkim nëntokë në Qytetin e Hasit, objekt banimi dhe shërbimi 6 kate përfshirë 1 kat njësi shërbimi dhe një parkim nëntokë në Qytetin e Tropojës", ndërtim i dy objekteve banimi dhe shërbimesh 8 kate, në Qytetin e Vlorës" dhe objekt banimi dhe shërbimi 8 kat me një kat parkimi nëntokë dhe objekt banimi 8 kat dhe 1 kat parkimi nëntokë, në Qytetin e Vlorës", u konstatuan kritere të cilat nuk janë në përputhje natyrën dhe volumin e kontratës si më poshtë:
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.
- Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me Licencë Kodi 1.2.A për mbrojtjen nga zjarri, të lëshuar nga QKL

- Ofertuesi të ketë të punësuar një Inxhinier Auditues të Energjisë (i pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë), e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
Vendosja e kritereve të mësipërme është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 92-142, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: EKB të marrë masa rishikimin e dokumentacionit të projekt-preventivave të cilat përgatiten nga konsulentët e përzgjedhur, për të përshtatur dokumentacionin sipas kërkesave ligjore. ***Në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri Prokurimit Nr.292, datë14.09.2022, nr.3244 prot, për prokurimin me objekt "Ndërtimi objekt banimi 6 kate në qytetin e Shijakut", ku ndër të tjera, për këtë procedurë është krijuar njësia e prokurimit me kryesues përgjegjësin e sektorit të prokurimeve inxhinier ndërtimi.

-Dokumentet Standarte të Tenderit, Maj 2022, për tenderin e hapur punë publike me objektin e sipërcituar, përfshijnë kriteret e veçanta të kualifikimit në faqe 20-28, ku janë përcaktuar të argumentuara të gjitha kushtet dhe kërkesat e veçanta, në pajtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me vlerë të vogël, e iniciuar me urdhrin e prokurimit nr. 36, datë 20.02.2019, me objekt " Karburant Gazoil (10 ppm ULSD) në sasinë 5,000 litra", u konstatua se: -Në procedurën e përcaktimit të fondit limit, në dokumentacionin e testimit të tregut, ofertat e OE në përcaktimin e vlerës mesatare nuk kishin datë ose numër protokolli. -Nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, në dokumentet e procedurës është kërkuar që OE fitues duhet të paraqesë licencë që vërteton të drejtën për ushtrimin e aktivitetit (tregtim karburantesh) të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.
Komisioni duhet të përcaktonte qartë llojin e lejes së tregtimit nga QKB, sipas Ligjit nr. 8450, dt. 24.02.1999 "Për përpunimin, transportin e naftës dhe nënproduktet e tjera", me ndryshimet përkatëse, dhe VKM 970, datë 02.12.2015, i ndryshuar "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", pikat I dhe II. Afati i lëvrimit të mallit është kërkuar brenda 3 ditëve, duke filluar nga paraqitja e operatorit ekonomik fitues pranë autoritetit kontraktor. Duke qenë se sasia e prokuruar është parashikuar është për të gjithë vitin, afati i lëvrimit të mallit është përcaktuar në mënyrë jo korrekte. -AK nuk ka vendosur si kusht për vlerësimin, marzhin e fitimit të shprehur në përqindje. -Kërkesa për fletë analize e produktit është e formuluar në mënyrë jo të saktë dhe nuk përmbush qëllimin kryesor që është cilësia e produktit. Fletë-analizat e lëshuara nga ISHTI, janë për një sasi të limituar, në një nga depozitat e OE, dhe nuk mund të justifikojnë faktin që karburanti do të furnizohet në gjithë vendin si dhe sasia e planifikuar është për një periudhë 1 vjeçare. Lidhur me këtë, mund të kërkohej se operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ISHTI**,** që subjekti ka importuar dhe tregtuar karburante sipas standardeve të Legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë për periudhat e mëparshme. Më datë 22.02.2019 komisioni pasi ka vlerësuar ofertat ka shpallur si fitues OE G. C. G. ShPK, me ofertën ekonomike më të ulët. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues, u vërejt se licenca për ushtrimin e aktivitetit ishte e tipit VII. 1. A. për subjektin G. O., për tregtim me shumicë gazoil kategoria II/A, pra kjo licencë nuk i përkiste OE G. C. G. ShPK, me të cilin u lidh dhe kontrata e mallrave.

-Komisioni i blerjeve me vlera të vogla duhet të skualifikonte OE G. C. G. dhe të vazhdonte me OE pasardhës në renditje. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 31 dhe Ligji nr. 8450, dt. 24.02.1999 "Për përpunimin, transportin e naftës dhe nënproduktet e tjera", me ndryshimet përkatëse, pikat I dhe II.
-Nga auditimi i procedurës e kryer nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, me datë 11.07.2019, me vlerë 75,360 lekë me TVSH, u konstatuan parregullsi në lidhje me përdorimin e formularit tip nr.4, për "emergjencë". Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me pikën 6, të nenit 40, Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përdorimi i procedurave të emergjencës në rastet kur nuk është e nevojshme rrit riskun për shpërdorim të fondeve të institucionit.
-Në auditimin e procedurës me vlerë të vogël, e iniciuar me urdhrin e prokurimit nr. 95, datë 24.04.2019, me objekt "Materiale higjeno sanitare", me vlerë të fondit limit 83,337 lekë pa tvsh, e anuluar u konstatua se nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, Specifikimet teknike të produkteve të kërkuara janë jo të bazuara në standardet kombëtare, jo të qarta dhe të verifikueshme. Këto veprime janë në kundërshtim pikën 3, neni 23 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "Për prokurimin publik" dhe Udhëzimi nr. 3 , datë 8.01.20181, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 5. Mos përcaktimi i saktë i specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara mund të sjellë anulimin e procedurave ose/dhe ofertimin e produkteve që nuk plotësojnë nevojat e kërkuara
-Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje karburant Gazoil", me fond limit 800,000 lekë pa TVSh, iniciuar me urdhrin nr. 76, datë 16.03.2021, u konstatuan parregullsitë: -Në ftesën për ofertë datë 17.03.2021, me nr. Prot., 1363/1, është përcaktuar si datë e zhvillimit të tenderit data 19.03.2021, por procedura nuk është kryer në këtë datë. -Kërkesat për paraqitje kopje të certifikuara të bilanceve, xhirove vjetore, eksperiencave të ngjashme janë të panevojshme dhe ulin konkurrencën për sa kohë që AK ka zgjedhur llojin procedurë "blerje me vlerë të vogël".
-Lidhur me kapacitetet teknike nuk është kërkuar disponimi i licencës për zhvillimin e aktivitetit për tregtimin e hidrokarbureve me pakicë, kërkesë thelbësore për realizimin e kontratës. -Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues, u konstatua se mungonte kontrata e furnizimit e realizuar gjatë tre viteve të fundit, për të vërtetuar përvojat e mëparshme, nuk dokumentonte se zotëronte pikat e shitjes me pakicë të karburantit. -Komisioni i blerjeve me vlera të vogla duhet të skualifikonte OE fitues dhe të vazhdonte me OE pasardhës në renditje.
16.1 Rekomandimi: Drejtimi i institucionit të marrë masa për trajnimin e punonjësve lidhur me procedurat e prokurimit për trajnimin e tyre dhe realizimin e procedurave të blerjeve me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm. ***Në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me datë 20.10.2021, Drejtoria e Përgjithshme i ka dërguar e-mail ASPA, kërkesa për trajnimin e stafit të institucionit gjatë vitin 2021-2022;
-Njëkohësisht janë dërguar shkresat drejt KPP-së me nr.3800 prot. dhe APP-së nr.3801. prot., datë18.11.2021, për trajnimin e punonjësve;
Më datë 21.06.2022 është kryer on-line trajnimi i specialistes së prokurimeve nga ASPA.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

17. Gjetje nga auditimi: Më datë 25.02.2019 është lidhur kontrata me nr.397/1 Prot., me OE fitues G. C. G.. Gjithashtu më datë 25.02.2019, OE ka lëshuar faturën tatimore me nr.397 dhe vlerë 795,000 lekë me Tvsh. Komisioni i blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga L. Gj., E. S.,

dhe R. B., me proces verbalin nr.2, ka marrë në dorëzim 500 copë tollona, (5000 litra), të ndara në dhjetë blloqe. Më datë 05.03.2019 është kryer pagesa 795,000 lekë në llogarinë bankare të OE G. C. G.. Titullari i EKB nuk duhet të kryente pagesën e plotë të faturës pasi marrja e tollonave nuk përfaqëson marrjen e mallit si dhe sasia e prokuruar ishte planifikuar për tu përdorur për të gjithë vitin 2019. Veprimi sa më sipër është në kundërshtim me nenin 6, të kontratës së lidhur mes palëve, ku cilësohet se pagesa do të kryhet pas marrjes së sasisë së karburantit dhe jo tollonave *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 69-78, të Projektraportit të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Drejtimi i institucionit të marrë masa për rritjen e kontrollit të brendshëm financiar, në mënyrë që ndjekja dhe zbatimi i kontratave të blerjeve, të zhvillohen me përgjegjshmëri nga personat përgjegjës për të ulur risqet e institucionit për keqpërdorimin e burimeve financiare. ***Në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

- Kontrata Nr.868/3 datë 28.04.2022 për blerje karburant gaz oil, me vlerë 675,000 lekë pa TVSH;
-Fletë-Hyrje nr.19 datë 11.05.2022 në shumën 600 lit ose 60 tollona (10 lit) gazoil me një vlerë prej 134,611 lekë;
-Fatura elektronike nr.3175/2022, datë 11.05.2022;
-Procesverbali i marrjes në dorëzim datë 12.05.2022;
-Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm EKB nr.256, datë 29.06.2022 "Për kryerje pagese";
-Sigurimi i kontratës 10 %, datë 28.04.2022.

Likujdimi i OE kryhet periodikisht sipas furnizimit me mallin (tollona karburanti) në përputhje me pikat e kontratës.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

18. Gjetje nga auditimi: Plotësimi i dokumentacionit justifikues për shpenzimet e karburantit është kryer, jo konform udhëzimeve përkatëse. Në procesin e dokumentimit të shpenzimeve për karburant, në Drejtorinë Rajonale Tiranë, u konstatua se në 28 raste në fletët e udhëtimit nuk është shënuar emri i personit që ka përdorur makinën si dhe fletët e udhëtimit nuk janë kontrolluar dhe firmosur nga personi i autorizuar për këtë procedurë. Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 35,45 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Mos plotësimi i dokumenteve justifikuese për shpenzimet e kryetarit riskun për shpërdorim të fondeve të institucionit *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 69-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marrë masa për plotësimin e procedurave përkatëse që sigurojnë me dokumente vërtetues, kryerjen faktike të veprimeve ekonomike të institucionit.

Brënda vitit

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Procesverbal nr.1075 prot., datë 10.05.2022 "Mbi konsumin e muajit prill të karburantit, baskëngjitur dokumentet vërtetues magazina, formularët e udhimeve , urdhërat e punës.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të vlerësimit të aktiveve afatgjata dhe inventarit të imët, të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, u konstatuan parregullsi.

Nga shqyrtimi i raportit përkatës dhe proces verbaleve të mbajtura nga komisioni u konstatua se: Proces verbalet e vlerësimit nuk janë hartuar duke argumentuar arsyet nëse është i nevojshëm ose jo për njësinë, si dhe nëse duhet të nxirret jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturinë apo asgjësimit përfundimtar. Në proces verbale është përdorur si kriter i

vlerësimit të aktiveve termi "humbja e cilësisë së standardit shtetëror", por pa e cilësuar se cilat standarde. Në raportin e hartuar nga komisioni, nuk janë shpjeguar arsyet e zgjedhjes së procedurave të ndjekura, të kritereve të vlerësimit, si dhe mungojnë efektet ekonomike të masave për ri-aftësimet e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me nenet 104 e 106 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Nga shqyrtimi i proces verbaleve të komisionit për tjetërsimin e aktiveve u konstatua se nuk ishte përcaktuar destinacioni përfundimtar i asgjësimit të aktiveve *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 73-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Nga drejtimi i institucionit të merren masa që procesi i vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve për tu nxjerrë jashtë përdorimit të kryhet me përgjegjshmëri, duke kryer analizat dhe argumentimet e bazuara në kriteret përkatëse dhe me relacionet shoqëruese.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Vendimi nr.34, datë 05.11.2021 i Këshillit Drejtues ka miratuar planin e veprimit, në të cilin drejtoria ekonomike është caktuar për ndjekje dhe veprim. Nga auditimi, nuk rezulton praktikë vlerësimi dhe azgjesimi të aktiveve.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është në proces.

20. Gjetje nga auditimi: Lidhur me ndjekjen e debitorëve u konstatua se në Drejtorinë e Përgjithshme të EKB nuk ishin gjendje të dokumentonin hapat e marra nga degët rajonale për trajtimin e klientëve të cilët nuk janë të rregullt në pagesat e kësteve sipas kontratave të shitjeve. EKB ka klientë të cilët i kanë kaluar 365 ditë mos pagesash duke kaluar në statusin e debitorit pa shpresë arkëtimi sipas manualit të ndjekjes së klientëve aprovuar nga Këshilli Drejtues. Dega Berat deri më 31.12.2020 ka 13 klientë, dega Dibër 21 klientë, dega Durrës 65 klientë, dega Elbasan 45 klientë, dega Gjirokastër 41 klientë, dega Korçë 45 klientë, dega Kukës 54 klientë, dega Lezhë 133 klientë, dega Shkodër 59 klientë, dhe klientë (përmbytje) 171, dega Tiranë 30, dhe dega Vlorë 45 klientë.

Në relacionet e degëve rajonale dorëzuar në qendër, problematikat trajtoheshin në mënyrë statistikore dhe jo me shpjegime qartësuese për klientët problematikë duke mos reflektuar gjurmën e auditimit. Këto veprime janë në kundërshtim me shkronjën dh, të pikës 3, të nenit 12 të Ligjit Nr. 10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Mos dokumentimi i gjurmës së auditimit rrit riskun e qëndrimeve subjektive ndaj klientëve problematikë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 82-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi: Nga drejtimi i institucionit të merren masa që procesi i dokumentimit të gjurmës së auditimit, lidhur me veprimet për klientët jo të rregullt, të kryhet me përgjegjshmëri, me relacionet shoqëruese dhe dokumentet përkatëse.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me shkresat nr.3733-3742, datë 11.11.2021 drejtuar degëve të EKB me objekt "Lista e debitorëve, me statusin *pa shpresë arkëtimi* , për hapjen e proceseve gjyqësore;

-Informacion nr.3787, datë 17.11.2021 drejtuar Këshillit Drejtues me objekt "Situata e debitorëve pa shpresë arkëtimi";

Nga auditimi, Enti Kombëtar i Banesave kishte vepruar në zbatim të dokumentit "Mbi politikat dhe procedurat e menaxhimit të debitorëve", miratuar me vendimin nr.07, datë 29.04.2016, me nr.953/1 prot, datë 06.05.2016.

Gjatë periudhës Qershor - Tetor 2021 ka evidentuar si më poshtë:

-Debitorët me statusin "pa shpresë arkëtimi", duke i ndarë në 3 nëngrupe:

a-debitorë që paguajne rregullisht por për shkak se kanë mbi 365 ditë pa paguar janë klasifikuar në këtë status,
b-debitorë që paguajnë por jo rregullisht, pra me risk të lartë
c-debitorë që nuk paguajnë për një kohë të gjatë,
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar raste të veçanta që nuk gjejnë zgjidhje konkrete ligjore në VKM Nr. 898, datë 18.11.2020 "Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të pa privatizuara"
Në pikën 1 të VKM citohet se, Qëllimi dhe fusha e veprimit.
Qëllimi i këtij vendimi është finalizimi i procedurave të privatizimit të objekteve të pa privatizuara për:
a) banesat e ndërtuara me fonde publike nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim EKB-ja), pavarësisht nëse kanë kaluar ose jo në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore ku ato ndodhen, të cilat, deri në fund të vitit 2007, kanë rezultuar me kontrata të palidhura, si dhe banesat e ndërtuara me fonde publike nga EKB-ja, që rezultojnë me kontrata të zgjidhura e të liruara me vendim gjykate;
b) banesat dhe objektet e kthyera në fond banese, që, me vendime të Këshillit të Ministrave, i kanë kaluar në administrim EKB-së, me qëllim privatizimin e tyre;
c) banesat ose objektet e kthyera në fond banese me vendime të organeve të vetëqeverisjes vendore, ato që kanë kaluar në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe ato që figurojnë ende në pronësi të shtetit, ku, me autorizime të dhëna nga organet kompetente, janë sistemuar me strehim banorët përpara vitit 2004;
ç) objektet që kanë mbetur të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura, përveç rasteve kur me ligj të veçantë janë përcaktuar procedura të tjera për privatizimin e tyre.
Nga evidentimi i rasteve të paraqitura nga degët rajonale të EKB-së rezulton si problematikë e evidentuar në një pjesë të konsiderueshme të apartamenteve që trajtohen sipas nenit 1, shkronja (a) të VKM nr. 898/2020 janë në situatën, ku 159 apartamente të ndarë sipas qarqeve, Dibra 2 apartamente, Durrës 28 apartamente, Korça 1 apartament, Shkodra 87 apartamente, Kukës 2 apartamente, Tirana 22 apartamente, Lezha 17 apartamente, nga të cilët në 61 apartamente, qytetarët që banojnë aktualisht në këto apartamente nuk disponojnë autorizime për këto banesa dhe asnjë dokument ligjor për posedimin e banesës. Enti Kombëtar i Banesave duhet të fillonte procedurat e lirimit të pronës sipas Kodit Civil por nga viti 2007 e deri me miratimin dhe hyrjen në fuqi të këtij akti nënligjor nuk ka qenë i mundur pasi përcaktimet ligjore të mëparshme (dispozitat tranzitore të Ligjit nr. 9232/2004 "Për programet sociale të strehimit" i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar)), parashikonin procedurat e kalimit të këtyre apartamenteve që rezultonin me kontrata të palidhura, në pronësi të njësive vendore dhe privatizimin e tyre nga këto të fundit. (Neni 39/1, Dispozita tranzitore, pika 2 Banesat, që janë ndërtuar me fonde publike nga EKB, të cilat deri në fund të vitit 2007, rezultojnë me kontrata të palidhura, kalojnë në pronësi të organeve të qeverisjes vendore ku ndodhen.) Megjithëse EKB, me urdhër të Ministrit dhe Këshillit Drejtues i ka kaluar organeve të qeverisjes vendore ku ndodhen, nga këto nuk është kryer procesi i privatizimit, duke i lënë në pronësi të Entit.
Pavarësisht procedurave ligjore të ndjekura nga EKB një pjesë e këtyre bashkive nuk kanë vepruar dhe zbatuar ligjin duke bërë që këto apartamente të mbeten në pronësi të EKB-së por pa pasur kompetencat ligjore për veprime administrative dhe të drejtën e privatizimit të tyre.
Në situatën aktuale, pjesa më e madhe e apartamenteve kanë qenë në përdorim nga 1995-2000, dhe për qarkun Tiranë nga 2006-2008.
Akti nënligjor nuk ka të përcaktuar shprehimisht procedurat që do të kryhen, për apartamentet me kontrata të palidhura në rastet e mungesës së miratimit nga organet e qeverisjes vendore.

-Problematikë tjetër rezulton se në një pjesë të apartamenteve që kanë mbetur pa u privatizuar me aktet ligjore/nënligjor të mëparshme të shfuqizuara dhe që do trajtohen për privatizim me VKM nr. 898/2020 jetojnë familjet të cilat me autorizim (për zgjerim) nga ana e Këshillit Bashkiak kanë përfituar të drejtën për të privatizuar apartamentet me kushtin për të dorëzuar apartamentin që kanë pasur në pronësi. Qytetarët të cilët kanë përfituar zgjerim nuk kanë lidhur kontratë me EKB-në, pasi nuk kanë dorëzuar "de jure" sipas legjislacionit përkatës të mëparshëm pranë EKB-së apartamentet që kanë në pronësi. Pavarësisht se me hyrjen në fuqi të VKM nr. 898/2020 janë shprehur të gatshëm të kryejnë procedurat e dorëzimit të apartamentit që kanë në pronësi dhe të lidhin kontratë për apartamentin për të cilin kanë përfituar autorizimin me zgjerim, ky akt nënligjor nuk parashikon procedurën e cila do të ndiqet për dorëzimin dhe vlerësimin e apartamenteve të dorëzuara. Për këtë pengesë i jemi drejtuar edhe MFE duke e evidentuar si problematikë dhe duke kërkuar udhëzime dhe zgjidhje ligjore.
-Problematikë tjetër është evidentuar edhe në rastet e privatizimeve që do të kryhen për objektet e forcave të Armatosura pasi për këto objekte në rastet e evidentuara deri tani nuk është kryer procedura e kthimit në fond banese nga Këshillat Bashkiakë përkatës dhe në VKM 898/2020 nuk është parashikuar apo përcaktuar mënyra në kthim banese të këtyre objekteve dhe ndërkohë dokumentacioni shkresor i dërguar deri tani nga Ministria e Mbrojtjes për identifikimin e objekteve të ushtrisë që do të duhet të futen në proces privatizimi është jo i plotë, jo i saktë, i papërpunuar dhe i papërgatitur në formën e duhur ligjore duke pasur parasysh edhe faktin që këto objekte duhet të kalohen në pronësi të EKB-së që të vijohet me procedurat e privatizimit. VKM aktuale nuk i ka përcaktuar qartë hapat për këtë procedurë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 82-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të shqyrtojë mangësitë e konstatuara për implementimin e pikës nr. 1, të VKM Nr. 898, datë 18.11.2020 "Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të paprivatizuara", duke përcaktuar qartë procedurat që do të ndjekin Enti Kombëtar i Banesave, njësitë e qeverisjes vendore për finalizimin e privatizimit të objekteve të mbetura të paprivatizuara.

Në vazhdimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

- Me shkresën nr.3565/1 prot., datë 25.10.2021, "Pasqyra e akteve të evidentuara për ndryshime" , Drejtoria Juridike e EKB informon Drejtorinë e Strehimit në MFE.
- Me shkresën nr.1026, datë 29.04.2022, Drejtoria e Përgjithshme i ka dërguar MFE, propozimet për iniciativë ligjore lidhur me disa ndryshime në VKM-në nr.898/2020, duke paraqitur dhe projekt-vendimin përkatës, për t'u vijuar prej këtij institucioni (MFE) me të gjitha hapat e nevojshëm ligjorë për implementimin dhe miratimin e ndryshimeve ligjore në VKM nr.898 datë 18.11.2020.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është në proces.

22. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është ngritur me Urdhër të Titullarit të AK nr. 15, datë 06.03.2018, ndërkohë që ky komision duhet të ngrihej në fillim të vitit. Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 76, datë 07.06.2018, "Për caktimin e personit përgjegjës për prokurimin nga Enti Kombëtar i Banesave", ka caktuar me urdhër të veçantë personin përgjegjës për prokurimin, me një vonesë disamujore dhe jo në afatet e parashikuara në VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Neni 57, Pika 1, si dhe Udhëzimin nr. 3 i APP, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj

me mjete elektronike", i ndryshuar, Pika 2 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 18-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i EKB, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të garantojë ngritjen në kohë të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, si dhe të caktojë në afat personin përgjegjës për prokurimin. ***Në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri nr.4, datë 10.01.2022 "Krijimi i komisionit të prokurimit me vlerë të vogël"

- Urdhëri nr.8, datë 11.01.2022 për caktimin e personit përgjegjës për prokurimin.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

23. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua, se Vendimi i Këshillit Drejtues nr 48, datë 27.12.2019, mbi miratimin e programit të veprimtarisë së tij, për vitin 2020", nuk është zbatuar plotësisht nga vetë Këshilli Drejtues, meqë tematika nr.15, "Analiza e veprimtarisë ekonomiko financiare të EKB – së për 6/mujorin e vitit 2020" e "Programit vjetor të veprimtarisë të Këshillit Drejtues" e cila ishte parashikuar të përfshihej në rendin e ditës të mbledhjes së KD në muajin korrik të vitit 2020, nuk u bë as temë e Njoftimit nr. 1379 prot., datë 29.06.2020 dhe as çështje e diskutuar në mbledhjen e mbajtur nga KD, më datë 08.07.2020, në vijim të njoftimit të mësipërm.

Ky veprim është në kundërshtim me *Rregulloren "Mbi funksionimin e Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave",* Pika 1.3, Pika 1.6, Pika 2.2 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 18-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues për të realizuar përmbushjen e objektivave të programuar dhe parashikuar në aktivitetin e EKB –së, të zbatojë me përgjegjshmëri programin vjetor të veprimtarisë së tij. ***Në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Vendimi Nr.39, datë 29.12.2021, dhe nr. 4032/2 prot., datë 30.12.2021 i Këshillit Drejtues "Miratimi i Programit të Këshillit për vitin 2022";

-Njoftimet nr.133 prot., datë 19.01.2022, nr.360 prot., datë 15.02.2022, nr.992 prot.,datë 28.04.2022, nr.1196 prot., datë 20.05.2022 për zhvillimin e mbledhjeve të KD të EKB.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

24. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se në ekzemplarin e parë të Vendimit nr. 34 datë 31.07.2019, përcjellë me shkresën nr 1772/1, datë 02.08.2019, ndërkohë që në procesverbalin e mbledhjes janë të pranishme nënshkrimet e anëtarëve të KD, me përjashtim të firmës së një anëtari i cili nuk ishte i pranishëm, mungojnë firmat e anëtarëve të Këshillit Drejtues,.

Kjo është në kundërshtim me Rregulloren "Mbi funksionimin e Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave", Kapitulli IV, pika 4.3; Kapitulli V, Pika 5.4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 18-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1 Rekomandimi: Sekretari i Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave të sigurojë mbajtjen e përpiktë dhe të kujdesshme të dokumentacionit përkatës për përgatitjen e vendimeve të Këshillit Drejtues. ***Në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Vendimi nr.07, datë 22.02.2022, nr.360/2 prot., datë 23.02.2022 i Këshillit Drejtues. Nga auditimi ekzemplari i këtij vendimi është firmosur nga të gjithë anëtarët.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

25. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se nuk është miratuar asnjëherë "Raporti vjetor (analiza vjetore) i/(e) veprimtarisë ekonomike dhe financiare të EKB – së, (përkatësisht për vitet 2018, 2019, 2020)", por thjeshtë këto raporte vjetore (analiza) janë bërë temë diskutimi në mbledhjen e çdo fillim viti nga Këshilli Drejtues, i cili ka lënë detyra për zbatim, sikurse referuar për secilin vit.
Ky veprim është në kundërshtim me: Ligjin Nr. 7582, datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", i ndryshuar, Neni 10, Pika 2, si dhe me Rregulloren "Mbi funksionimin e Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave", Pika 1.3; Pika 1.8; Pika 1.11; Pika 3.3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 18-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
25.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues i EKB – së të marrë masa që raportet vjetore të veprimtarisë ekonomiko financiare të miratohen dhe më tej këto raporte t'i dërgohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. ***Në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me VKD nr.5, datë 22.02.2022 është miratuar analiza vjetore e veprimtarisë ekonomike financiare të institucionit;
- Me shkresën nr.650, datë 16.03.2022 dërgohet Raporti "Mbi plotësimin e treguesve ekonomikë dhe financiar të EKB për vitin 2021" në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

26. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se, periodiciteti i gjenerimit të raporteve/analizave mbi veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Entit, nuk është i rregulluar, nga ndonjë akt i brendshëm, urdhër apo udhëzim.
Ky mosveprim është në shkelje të "Rregullores "Mbi organizimin dhe funksionimin e Entit Kombëtar të Banesave", Neni 5, Pika 13, si dhe me Nenin 25, Pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 18-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
26.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të Entit të miratojnë një Urdhër apo Udhëzim të Brendshëm, me të cilin të përcaktohet normativisht, se me cilin periodicitet kohor duhen bërë raportet/analizat e veprimtarisë ekonomike e financiare të EKB - së. ***Në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri Nr.401, datë 15.12.2021, me nr.4004 prot, datë.15.12.2021, i Drejtorit të Përgjithshëm të EKB për periodicitetin kohor të kryerjes së analizave të veprimtarisë ekonomike financiare të EKB gjatë vitit kalendarik.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua, se "Programi Ekonomik Vjetor i Entit Kombëtar të Banesave", "Raporti vjetor ekonomik i Entit Kombëtar të Banesave", si dhe "Raporti për programin e të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve të EKB-së", i detyrueshëm për t'u gjeneruar çdo 3 muaj, në moszbatim të nenit 7/1/e të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", nuk janë publikuar në faqen zyrtare të EKB – së.
Ky mosveprim është në kundërshtim me Programin e Transparencës të EKB –së dhe zbatimin e Ligjit Nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit", Neni 7, Pika 1, Germa e). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 26-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
27.1 Rekomandimi: EKB të marrë masa për mirëmbajtjen e faqes zyrtare, duke përmirësuar dhe gjeneruar informacionin periodik, me synim rritjen e transparencës duke publikuar dokumentacione të cilat përfshijnë "Programin ekonomik vjetor të Entit Kombëtar të Banesave", "Raportin vjetor ekonomik i Entit Kombëtar të Banesave", si dhe "Raportin për programin e të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve të EKB-së".

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Në faqen ëeb zyrtare e EKB-së është publikuar programi ekonomik 2022. Drejtoria e Përgjithshme e EKB-së ka marrë masa për përditësimin e informacionit.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të Kontratës "Grup banesash sociale me kosto të ulët dhe eficiencë energjie me dy kate + Papafingo, Pukë", kanë rezultuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me:

1. Sipas zërit të punimeve V.3. Ulluk shkarkimi horizontal llamarinë xinkato 33 mm", në librezën e masave është certifikuar sasia 560.4 m. Në këtë sasi është përfshirë sasia 182.4 (3.8 m x 2 x 4 x 6 godina), e cila nuk përbën ulluk, por parapet metalik, i përfshirë në zërin e çatisë. Është certifikuar dhe likuiduar më shumë vlera 118,560 lekë (182.4 m x 650 lekë/m).

2. Sa i takon zërit VIII. 3 "Suvatim me grafiato" përllogaritja e sipërfaqeve anësore, pjesa trekëndore është përllogaritur si katrore me sipërfaqe 202.8 m^2 (5.2 m x 3.25 m x 2 anë x 6 godina), ndërkohë që kjo sipërfaqe rezulton 101.4 m^2. Është certifikuar dhe likuiduar më shumë vlera 50,700 lekë (101.4 m^2 x 500 lekë/m^2).

3. Sa i takon zërit të punimeve II.1 "Mur me bllok flor BET AACC 30 cm", për një godinë, për muret anësore, kat përdhe dhe kat i parë dhe kat i dytë është përfshirë më shumë sasia 16.25 m^3 (8.52 + 7.73). Për 6 godina është përfshirë më shumë sasia 97.5 m^3. Për këtë zë punimi është certifikuar dhe likuiduar më shumë vlera 645,937 lekë (97.5 m^3 x 6,625 lekë/m^3).

4. Sa i takon zërit III.2 "kolona b/a monolite C 20/25, h = 4 m", në librezën e masave është përshkruar sasia 57 m^3, ndërkohë që në situacionin përfundimtar rezulton sasia 68.5 m^3, me një diferencë 11.5 m^3, me vlerë 111,584 lekë (11.5 m^3 x 9703 lekë/m^3). Për zërin III.1 "Plinta e bazamente b/a monolite-20m^3, C 20/30", në librezën e masave është sasia 102 m^3, ndërsa në situacionin përfundimtar 100 m^3, me diferencë të realizuar por të pa likuiduar me sasi 2 m^3 dhe vlerë 18,404 lekë (2 m^3 x 9,203 lekë/m^3). Është certifikuar dhe likuiduar më shumë vlera 93,178 lekë (111,584 lekë – 18,404 lekë).

5. Sa i takon zërit V.1 "Hidroizolim me emulson bitumi dhe dy shtresë katrama (çati + dysheme)", bazuar në librezën e masave, për daljet në çati është shtuar sasia 108 m^2 (3.6 m x 1.25 m x 4 dalje x 6 godina), por nuk është zbritur po kjo pjesë e cila i përket daljes në ballkon. Është certifikuar dhe likuiduar më shumë vlera 83,808 lekë (108 m^2 x 776 lekë/m^2).

- Sipas zërit të punimeve V.3. "Ulluk shkarkimi vertikal llamarinë zinkato 100 mm",në librezë masash është përshkruar sasia 10 tuba vertikal për godinë, ndërkohë që janë ndërtuar nga 6 copë. Sasia e përcaktuar, duke përjashtuar daljet në çati është 342 m (5.7 m x 10 copë x 6 godina). Është certifikuar dhe likuiduar më shumë sasia 136.8 m (5.7 m x 4 copë x 6 godina), me vlerë 75,240 lekë (136.8 m x 550 lekë/m). Gjithashtu këto ulluqe nuk janë realizuar me dimension Ø 100 mm, siç përshkruhet në situacionin përfundimtar dhe librezën e masave por Ø 80 mm.
- Sipas zërit "Shkarkim uji nga çatia" janë parashikuar XII.6 "Tub kanalizimi PVC Ø 90 mm" dhe XII.7 "Tub kanalizimi PVC Ø 110 mm, ndërkohë që shkarkimi i ujërave nga çatia bëhet nëpërmjet tubave zinkato të përshkruara më sipër. Nga verifikimi në objekt nuk rezultojnë të vendosur tuba shkarkimi nga çatia, po ashtu këto dy zëra punimesh nuk janë të reflektuara në librezën e masave. Vlera e likuiduar për këto dy punime në shumën 337,500 lekë (97,560 lekë + 239,940 lekë), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", kreu III, pika 4 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 142-154, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: EKB, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **1,321,063 lekë**, nga Kontraktori BOE **"B. dhe Sh." SHPK,** për punime të pa realizuara dhe në mos respektim të specifikimeve teknike. ***Menjëherë***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Drejtoria e Përgjithshme e EKB, i ka dërguar Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "Sh." SH.P.K. & "B." SH.P.K, shkresat me nr.3638 prot., datë 01.11.2021 dhe nr.3638/2 prot., datë 09.12.2021, shkresë për takim sqarues me nr. prot.3638/4 datë 14.02.2022, si dhe procesverbal takimi me nr.prot. 457 datë 23.02.2022, me qëllim që prej tyre të depozitohet vullnetarisht vlera **1,321,063 lekë me TVSH,** për llogari të Entit Kombëtar të Banesave.

-Pas dërgimit të shkresave zyrtare, meqënëse vlera e detyrimit nuk u depozitua vullnetarisht nga BOE "Sh." SH.P.K. & "B." SH.P.K, Drejtoria e Përgjithshme e EKB-së ka përgatitur draftin e padisë me provat përkatëse. Ndërkohë, duke qenë se ky bashkim i shoqërive sipërmarrëse, pas njoftimeve zyrtare që i janë dërguar kanë hapur më përpara proces gjyqësor ndaj EKB-së.

-Kundërpadia datë 07.06.2022 e EKB pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për detyrimin në rrugë gjyqësore të këtij bashkimi operatorësh, për të arkëtuar vlerën e sipërcituar në llogari të EKB-së.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është në proces.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës "Ndërtim objekt banimi 8 kate dhe një kat parkimi nëntokë, në Qytetin e Gramshit", kanë rezultuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me:

-Në lidhje me pagesën e situacionit përfundimtar, me shkresë nr. 2792/3 ptot., datë 02.12.2020, i është kërkuar Kontraktorit BOE "G." SHPK dhe "A. K." SHPK, përmirësimin e volumeve të paraqitura për pagesë, pasi janë konstatuar volume të pa justifikuara, si dhe gabime aritmetikore. Nga ana e kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk është reaguar për rishikimin e librezës së masave dhe situacionit përfundimtar, megjithatë nga ana e institucionit është zbritur vlera 1,479,216 lekë.

- Sipas zërit 4.18 "Shtresë termoizoluese me polisterol 8 cm", është përllogaritur edhe sipërfaqja e murit të betonit për bodrumin, pjesa në të djathtë të derës së aksesit. Po ashtu, lartësia e llogaritur është 2.72 m, ndërkohë që lartësia e duhur është 2.42 m. Sasia e përfshirë është në masën 32 m^2. Vlera 37,120 lekë (32 m^2 x 1,160 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "G. dhe A. K." SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

- Sipas zërit 7. 43 "F.V derë metalike", dera hyrëse e bodrumit (parkimit të automjeteve) është ndërtuar me materiale të përdorura më parë, si dhe pa cilësinë e duhur. Sipërfaqja e kësaj dere është 10 m^2. Vlera 38,800 lekë (10 m^2 x 3,880 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "G. dhe A. K." SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

- Sipas zërit 8.49 "Parapet shkalle mur tulle + suva + korimano druri", në vend të korimano druri, janë vendosur pllaka mermeri, të llogaritura në zë tjetër punimi. Sasia e likuiduar është 48 m^2. Bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit, viti 2015, çmimi për metër korimano druri është 700 lekë për ml. Vlera 33,600 lekë (48 ml x 700 lekë/ml), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "G. dhe A. K." SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

- Sipas zërit 8.47 "Trotuar shtruar me pllaka çimento", është likuiduar sasia 82 m^2. Nga verifikimi në objekt rezulton se nuk janë vendosur pllaka çimentoje, por është realizuar vetëm

një shtresë betoni. Vlera 71,340 lekë (82 m^2 x 870 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "G. dhe A. K." SHPK dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit "Montim grup presioni i sistemit kundërzjarrit (Pompë elektrike+pompë me motor diesel + pompë pilot – jockey pump) Q = 20 m^3/orë P(H)=5 bar (50 m), Qpilot = 4 m^3/orë, P(H)5.5 bar (55 m)", rezulton se është vendosur vetëm një pompë elektrike me lartësi ngritje 23 m, fuqi 2.2 kË, HP 3.0. Nuk është vendosur pompë me motor diesel për funksionim në kushtet e mungesës së energjisë elektrike. Mos plotësimi në tërësi i kërkesave për këtë sistem, konsiderohet si punë e pa realizuar. Lartësia e banesës është mbi 25 m, ndërkohë që e vetmja pompë e vendosur e ka lartësinë maksimale të dërgimit 23 m.
Për sa më sipër është likuiduar vlera 750,000 lekë për zërin material dhe 17,000 lekë për pagesë vendosje. Vlera 767,000 lekë (750,000 lekë + 17,000 lekë), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", kreu III, pika 4 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 142-154, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: EKB, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **947,860 lekë me TVSH**, nga Kontraktori BOE "**G. dhe A. K.**" SHPK**,** për punime të parealizuara dhe në mos respektim të specifikimeve teknike. ***Menjëherë***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me shkresën me nr.3636 prot., datë 01.11.2021 dhe shkresën me nr.3636/1 prot., datë 09.12.2021, dhe shkresë për takim sqarues me nr. prot.3636/2 datë 14.02.2022, Drejtoria e Përgjithshme e EKB, i ka dërguar Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "G." SH.P.K. & "A. K." SH.P.K., me qëllim depozitimin vullnetarisht të vlerës **947,860 lekë me TVSH**, për llogari të Entit Kombëtar të Banesave.
-Shoqëria ndërtuese "G." SH.P.K me shkresën e dërguar prej saj me nr.prot. 18/2 datë 18.02.2022, ka dakordësuar që vlera e detyrimit prej 947,860 lekë t'i mbahet nga vlera e ngurtësuar si garanci e objektit. Pra, Drejtoria e Përgjithshme e EKB në përfundim të afatit të garancisë së objektit i cili mban datën **04.02.2023**, do të mbajë këtë vlerë detyrimi nga kjo garanci para se të bëjë zhbllokimin e saj në favor të shoqërisë sipërmarrëse, gjë e cila do të reflektohet në Urdhërin për likujdim respektiv.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është në proces.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës "Godinë banimi dhe shërbimesh 7 kate, Lagje 17 Durrës", kanë rezultuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me:
- Sipas zërit 7 "Davancale dritare mermeri 3 cm", trashësia e tyre nuk është 3 cm, por 2 cm. Referuar situacionit çmimi për furnizim-vendosje pllaka mermeri 3 cm është 3,600 lekë/m^2, ndërsa për furnizim-vendosje pllaka mermeri 2 cm është 3,100 lekë/m^2. Vlera 34,700 lekë [69.4 m^2 x (3,600 lekë/m^2 – 3,100 lekë/m^2)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit 5 "Veshje bazamak shkalle në banesat me mermer 3 cm", është likuiduar sasia 8.5 m^2. Vlera 30,600 lekë (8.5 m^2 x 3,600 lekë), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit 7 "Parapet shkalle e ballkone hekur", është likuiduar sasia 4.64 ton. Nga verifikimi dhe rillogaritja rezulton se është certifikuar më shumë rezulton 0.61 ton konstruksion metalik. Vlera 104,920 lekë (0.61 ton x 172,000 lekë/ton), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit 7 "Parapet në ballkone", është likuiduar sasia 70.76 m^2. Ky zë është certifikuar tek zëri 2 "Mur tulle me bira 12 cm, llaç bastard M-25". Vlera 268,888 lekë (70.6 m^2 x 3,800

lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit 2 "Mur tulle me bira 12 cm, llaç bastard M-25", është certifikuar më shumë sasia 4.4 m^3. Vlera 35,910 lekë (5.4 m^3 x 6,650 lekë/m^3), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit 3 "Kasetë shkarkimi parapet tarrace", ulluqet vertikale të shkarkimit janë lidhur direkt me tarracën nëpërmjet tub PVC. Vlera 9,730 lekë e likuiduar për 7 pileta është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit 7 "Trotuar betoni shtruar me pllaka betoni vetëbllokuese", është përfshirë sasia e betonit me trashësi 5.4 m^3 (0.06 m x 89 m^2), ndërkohë që ky punim nuk është realizuar. Vlera 35,640 lekë (5.4 m^3 x 6,600 lekë/m^3), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit 7 "Bordura trotuari", për një gjatësi 25 m, janë vendosur bordura të vjetra e të dëmtuara. Vlera 16,250 lekë (25 ml x 650 lekë/ml), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit 6 "Suvatim mur i jashtëm" është përfshirë parapeti i taracës me sipërfaqe 80 m^2, parapet i cili është hidroizoluar në të gjithë lartësinë. Vlera 57,600 lekë (80 m^2 x 720 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik.
- Sipas zërit 5 "Veshje bazamakë shkalle të jashtme me mermer 3 cm", është likuiduar sasia 12.19 m^2, punim i cili nuk është realizuar. Vlera 43,884 lekë (12.19 m^2 3,600 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A. SHPK dhe B. SHPK" dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", kreu III, pika 4 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 142-154, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: EKB, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **592,752 lekë**, nga Kontraktori BOE **"A. SHPK dhe B. SHPK",** për punime të pa realizuara dhe në mos respektim të specifikimeve teknike. ***Menjëherë***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me shkresat për shlyerje detyrimi me nr.prot. 3637 datë 01.11.2021 dhe nr.prot. 3637/1 datë 09.12.2021, shkresë për takim sqarues me nr. prot.3637/2 datë 14.02.2022 si dhe procesverbal takimi me nr.prot. 3637/3 datë 18.02.2022, Drejtoria e Përgjithshme e EKB, i ka kërkuar Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "A." SH.P.K. & "B." SH.P.K, depozitimin vullnetarisht të vlerës **592,752 lekë me TVSH,** për llogari të Entit Kombëtar të Banesave.

-Me padinë nr. 497/1 prot., datë 31.03.2022 është kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë arkëtimi i vlerës së detyrimit **592,752 lekë me TVSH** nga BOE "A." SH.P.K. & "B." SH.P.K.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është në proces.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës **"**Pika e furnizimit me EE, furnizimit me ujë të pijshëm, shkarkimet e KUZ, KUB nga rrjeti i jashtëm, bllok banesash Pukë", kanë rezultuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me:
- Bordurat e trotuarit janë vendosur me dimensione 12 x 25 cm, ndërkohë që në preventiv janë 20 x 30 cm. Çmimi i ofertës për këtë zë punimi është 680 lekë për ml. Sasia e situacionuar është 345.9 ml. Bazuar në manualet e çmimeve të ndërtimit 2015, analiza 2.291, çmimi për burdurë me dimensione 12 x 25 cm (e derdhur në vend jo e parapërgatitur), është 623 lekë për

ml. Vlera 19,716 lekë [345.9 ml x (680 lekë/ml – 623 lekë/ml)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "A." SHPK dhe përbën dëm ekonomik.
- Nga verifikimi i punimeve në lidhje me realizimin e dhomës së shërbimit rezulton se sipas zërit B.17 "Ulluk shkarkimi vertikal me zinkato Ø 100 mm", janë vendosur 6 ml, ndëkohë që në situacion përfundimtar janë përfshirë 12 ml. Vlera 5,640 lekë (6 ml x 940 lekë/ml) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "A." SHPK dhe përbën dëm ekonomik.
- Shtresat e betonit të trotuareve janë realizuar me cilësi të dobët. Kanë pësuar çarje si dhe është dëmtuar sipërfaqe e lustrës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", kreu III, pika 4 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 142-154, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1-Rekomandimi: EKB, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **25,356 lekë**, nga Kontraktori BOE **"A." SHPK,** për punime të pa realizuara dhe në mos respektim të specifikimeve teknike. ***Menjëherë***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

- Me shkresën me nr. prot.3637/2 datë 14.02.2022 , si dhe procesverbalin e takimit me nr.prot. 3637/3 datë 18.02.2022, është kërkuar nga shoqëria "A." SH.P.K likuidimi vullnetarisht i vlerës **25,356 lekë me TVSH**, për llogari të Entit Kombëtar të Banesave.
-Nga auditimi, rezulton se garancia e kontratës **"**Pika e furnizimit me EE, furnizimit me ujë të pijshëm, shkarkimet e KUZ, KUB nga rrjeti i jashtëm, bllok banesash Pukë" ende e pazhbllokuar. EKB-ja, sqaron se do të mbajë këtë vlerë detyrimi nga garancia e objektit.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është në proces.

C. <u>MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE</u> NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e këtij produktit të gatshëm, banesa të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave duke marrë në konsideratë dhe shitjet e kryera në ankandet e shtatorit 2021, konstatohet se janë gjendje në Degën Korçë, 2 njësi shërbimi, 4 garazhe dhe një apartament, në Degën rajonale Berat ka 3 njësi shërbimi të marra në dorëzim në vitin 2016 e të pashitura në Degën rajonale Elbasan (Librazhd) ka gjendje 4 njësi shërbimi të marra në dorëzim në vitin 2017, në Degën rajonale Fier ka gjendje 3 njësi shërbimi, të marra në dorëzim në vitin 2015, në Dega rajonale Durrës (Kavajë) ka gjendje 4 apartamente të marra në dorëzim në vitin 2012, të gjitha me vlerë totale 44,987,059 lekë. Për të gjitha njësitë janë kryer disa herë procedura ankandesh për shitje, të cilat kanë dështuar për arsye të pozicionimit të ambienteve në periferi. Ndërtimi i garazheve dhe njësive të shërbimit është kryer jo i studiuar dhe i argumentuar duke pasur si pasojë mbetjen e ambienteve stok dhe bllokim të likuiditeteve duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë. Nga kjo veprimtari është shkaktuar **efekt negativ financiar me vlerë 44,987,059 lekë** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 65-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>1.1 Rekomandimi</u>: Këshilli Drejtues të marrë masa për mos përsëritjen në të ardhmen të praktikave të ngjashme duke eliminuar efektet negative të konstatuara me **vlerë 44,987,059 lekë** dhe menaxhimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Vendimi Nr.21, datë 28.07.2021 i Këshillit Drejtues "Për miratimin e ndryshimit të destinacionit që ndërtohet në Maliq dhe përshtatjen dhe blerjen e katit përdhe për nevojat e Bashkisë", e shoqëruar me relacionin përkatës të DP të EKB.
-Vendimi Nr.26, datë 27.08.2021 i Këshillit Drejtues "Për adoptimin e 3 njësive të shërbimit në apartamente banimi, në banesën ekzistuese 8 katëshe në Berat dhe miratimin e draft-marrëveshjes me bashkinë Berat ", e shoqëruar me relacionin përkatës të DP të EKB.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

2. Gjetje nga auditimi: Nga procesi i vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit "Objekt nr. 1 banimi dhe shërbimi 8 kate me një kat parkim nëntokë dhe objekt nr. 2 banimi 8 kate dhe një kat parkim nëntokë" ne qytetin e Kukësit", janë skualifikuar pesë OE dhe kualifikuar një.
Është shpallur fitues BOE "G. & K. K." SHPK me vlerën më të ulët në shumën 215,004,450 lekë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së procedurës dhe në rrugë elektronike rezulton se BOE si më sipër ka paraqitur dokumentacionin e ofertës me mangësi të cilat kanë të bëjnë me:
Listë pagesat e punonjësve të paraqitura nga shoqëria "K. K." SHPK për periudhën Shkurt-Mars 2020 nuk janë të rregullta sepse nuk përmbajnë vulë elektronike.
Listë pagesat e punonjësve të paraqitura nga shoqëria "G." SHPK për periudhën Shkurt 2020 - Prill 2020, nuk janë të rregullta sepse nuk përmbajnë vulë elektronike.
Vërtetimi i lëshuar nga Sigurimet shoqërore Nr. T02523714 datë, 01.07.2020 i paraqitur nga shoqëria "G." SHPK nuk është i rregullta sepse nuk përmbajnë vulë elektronike.
- Nga ana e operatorit ekonomik "K. K." SHPK për grejderat e marrë me qira nuk është paraqitur dokumentacioni i cili ka të bëjë me regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), dokumentacion i cili duhet plotësuar pasi kemi të bëjmë me mjet me rrota.
- Licenca e paraqitur nga BOE për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis, sipas Kodit III.2. B, nuk është për zonën në të cilën realizohen punimet.
Duke qenë se kemi të bëjmë vetëm me një ofertues të kualifikuar, i cili nuk plotëson kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit, duhet të propozohej anulimi i procedurës së prokurimit dhe rishpallja e saj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore të LPP dhe vlera 215,004,450 lekë konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet (3 E). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 92-142, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Komisionet e vlerësimit të ofertave duhet të shqyrtojnë me korrektësi dokumentacionin e paraqitur nga OE në tendera të ndryshëm, me synim organizimin e garave të drejta dhe realizimin e shpenzimeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, që për këtë rast janë me vlerë **215,004,450 lekë**. ***Në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Vendimi nr.34, datë 05.11.2021 i Këshillit Drejtues ka miratuar planin e veprimit, në të cilin është caktuar KVO për ndjekje dhe veprim.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është në proces.

3. Gjetje nga auditimi: Me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 7, datë 26.02.2020 "Mbi disa shtesa dhe ndryshime në strukturën e Entit Kombëtar të Banesave dhe miratimin e fondit përkatës për shtesat në strukturë" ka miratuar ndryshim dhe fondin shtesë në vlerën 2,636,253 lekë. Dhe në vendim është parashtruar edhe kushti që në analizën 9 mujore të shihet rezultati i efektshmërisë së ndryshimit të strukturës.

Bazuar në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria Juridike, Drejtoria Teknike dhe Zv. Drejtori i Përgjithshëm ku shprehen se në bazë të gjykimit dhe vlerësimit të Drejtorit të Përgjithshëm ndryshimet e miratuara nuk kanë qenë efektive dhe është propozuar kthimi i te gjithëve specialistëve brenda drejtorive.
Me vendimin nr. 56, datë 16.11.2020 "Mbi disa ndryshime në strukturën e Entit Kombëtar të Banesave" ka miratuar ndryshimin e strukturës duke hequr pozicionet e përgjegjësve të sektorëve.
Nga auditim rezulton se ndryshimi i kryer në strukturë ja qenë i pa mirë arsyetuar dhe argumentuar, pa përcaktuar objektiva të qarta dhe pa ndonjë efekt në arritjen e objektivave institucionale dhe si e tillë pagesa e kryer për përgjegjësit e sektorit është shpenzim jo efektiv **në vlerën 420,120 lekë,** veprim në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa që të miratojnë një strukturë të qëndrueshme brenda institucionit me qëllim krijimin e një fryme mirëkuptimi dhe bashkëpunimi midis stafit dhe eliminimin e efekteve financiare me ndryshime jo frytdhënëse, që për këtë rast janë me vlerë 420,120 lekë. ***Në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Vendimi Nr.09, datë 29.04.2022 i Këshillit Drejtues "Mbi miratimin e strukturës së re të EKB";
-Relacion nr.988 prot., datë 28.04.2022, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse "Mbi strukturën e re të Entit Kombëtar të Banesave.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se janë larguar 7 punonjës me shkarkim nga detyra duke mos zbatuar procedurat e parashikuara nga Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë. Rezulton se gjatë periudhës objekt auditimi ka 7 procese gjyqësore për marrëdhëniet e punës, nga të cilat:
- 1 është për punonjësin e larguar nga ristrukturimi dhe procesi ndodhet për gjykim në Gjykatë e Apelit dhe në shkallë të parë është fituar nga EKB.
- 6 procese gjyqësore janë hapur nga punonjësit e larguar me shkarkim nga detyra, 1 është në proces gjykimi në Gjykatën e Lartë (vendimi i apelit i formës së prerë dhe është ekzekutuar në disfavor të EKB), 5 janë në gjykatën e
apelit në pritje për caktim date (3 janë fituar nga EKB në gjykatë të shkallës së parë, 2 janë humbur nga EKB në shkallë të parë)
Gjatë periudhës objekt auditimi nga EKB është kryer një pagesë për vendim gjyqësor të apelit në vlerë **208,386 lekë** ndaj V. Gj. (punonjës i shkarkuar nga detyra), vlerë e cila përbënë shpenzim jo efektiv për buxhetin e EKB-së, veprim në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1 Rekomandimi: Drejtori i Pëgjithshëm i EKB dhe Drejtoria Juridike të marrin masa që të administrojë me efektivitet marrëdhëniet e punës dhe ndjekin me përgjegjësi procedurat e shkëputjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, për eliminimin e efekteve negative që për këtë rast janë me vlerë 208,386 lekë.
Në vijimësi
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Vendimi nr.34, datë 05.11.2021 i Këshillit Drejtues ka miratuar planin e veprimit, në të cilin është caktuar Drejtori Përgjithshëm, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Shërbimeve Mbështetëse për ndjekje dhe veprim.
-Urdhëri Nr.402, datë 16.12.2021, nr4005 prot., i Drejtorit të Përgjithshëm "Për ngritjen e komisionit të apelimit".
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është në proces.

5. Gjetje nga auditimi: Më datë 17.04.2020, është paguar vlera 152,305 lekë, si shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore për procesin që ka iniciuar EKB, ndaj A. Dh., më shtator 2016. Nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe Gjykatës së Apelit, duket qartë se kanë kaluar të gjitha afatet e parashkrimit, si për marrëdhëniet e punësimit, deri më 3 vjet dhe afatin 10 vjeçar të përcaktuar nga Kodi Civil pasi A. Dh. ka qenë i punësuar pranë EKB, në periudhën 2000-2004. Në këto kushte EKB nuk duhet të fillonte procedurën për shpërblimin e dëmit 2,530,540 lekë, si zbatim i rekomandimit të KLSH-së, me raportin me nr. 186/1 prot., datë 2302.2007, por të vlerësonte përgjegjësitë përse nuk ishin kryer në kohë veprimet e duhura për mbledhjen e tij. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 1. ***Vlera 152,305 lekë përbën efekt financiar negativ*** për institucionin *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 47-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Këshilli Drejtues të marrë masa për mos përsëritjen në të ardhmen të praktikave të ngjashme duke eliminuar efektet negative të konstatuara me vlerë 152,305 lekë dhe menaxhimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Vendimi nr.34, datë 05.11.2021 i Këshillit Drejtues ka miratuar planin e veprimit, në të cilin është caktuar Drejtori Përgjithshëm, Këshilli Drejtues për ndjekje dhe veprim.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është në proces.

6. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës 2020, u konstatuan se nga organet tatimore janë vënë gjoba për:-Lidhur me periudhën tatimore 2019, vendimi i ortakut është paraqitur me vonesë në organet tatimore, duke u penalizuar me 10,000 lekë gjobë.-Lidhur me periudhën tatimore 2020, EKB është penalizuar me 2 gjoba, me vlerë totale 30,000 lekë për arsye të mos deklarimit të aktivitetit të parkingut në qendrën e ish Autoparkut, në rrugën 5 Maji, si dhe 50,000 lekë për mos pajisje me kasa fiskale. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. **Vlera 90,000 lekë përbën efekt financiar negativ për EKB** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 65-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për trajnime dhe përditësime të personelit lidhur me detyrimet e institucionit për zbatimin e procedurave tatimore e fiskale, për eliminimin e efekteve financiare të cilat në këtë rast janë me vlerë 90,000 lekë.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Punonjësit e Drejtorisë Ekonomike gjatë muajit Nëntor 2021 dhe deri në Qershor 2022 kanë kryer trajnimin e organizuar nga Ministria e Financës në bashkëpunim me CIPFA (The Chartered Institut of Public Finance & Accountancy) "Mbi trajnimin e stafit të financës dhe kontabilitetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbi raportimin financiar dhe kontabilitetin në sektorin publik bazuar në IPSAS".
Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

D. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2018-2021, EKB ka zhvilluar 25 procedura ankandi për shitjen e ambienteve të shërbimit. Lidhur me procedurat e ankandeve për shitjen e njësive të shërbimit u konstatua se EKB ka zgjedhur procedurën e ankandit të hapur për shitjen e ambienteve të shërbimit. Në procedurën e shitjes së ambienteve të shërbimit, u konstatua se gjatë periudhës 2018-2020, për 25 njësi shërbimi, në qarqet Berat, Librazhd, Fier, Kavajë dhe Sarandë, Këshilli Drejtues ka aprovuar uljen e çmimeve të shitjes me 20 % pas dështimit të procedurës së parë, duke ju referuar për analogji ligjit të ankandit publik.
Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 1718, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave në ankandet publike", i ndryshuar, kreu VI. Vlera e uljeve të çmimeve, të kryera deri në momentin e shitjeve, rezulton me **të ardhura të munguara për EKB me vlerë 28,758,260 lekë** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 65-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Këshilli Drejtues të marrë masa për përcaktimin e çmimeve sa më favorizuese dhe rritjen e të ardhurave, duke qenë se deri në këtë periudhë auditimi institucioni rezulton me të ardhura të munguara me vlerë 28,758,260 lekë.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
- Me Vendimin nr.7, datë 22.02.2022 Këshilli Drejtues ka miratuar çmimin fillestar të shitjes në ankand të njësive të shërbimit duke u bazuar në çmimet e tregut.

Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

2. Gjetje nga auditimi: Në ankandet e kryera mënyra e pagesës ka qenë 10 % të vlerës të përcaktuar në kontratën e shitjes do të paguhet menjëherë dhe pjesa tjetër 90% do të paguhet me këste me afat kohor deri në 5 vjet. Shlyerja e vlerës 90% me këste deri në 5 vjet është një formë huadhënie për të cilën Këshilli Drejtues nuk ka vendosur normë interesi për përfitim nga EKB, kur në kontratat e shitjes së banesave është vendosur norma e interesit prej 3%.
Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 1718, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave në ankandet publike", i ndryshuar, kreu VII, ekzekutimi i kontratës 7.
Nga 15 njësi shërbimi të shitura në periudhën 2019-2020, vetëm 2 prej tyre janë likuiduar totalisht, pjesa tjetër për vlerën 49,698,214 lekë janë lënë afatet nga 5-6 vite për tu shlyer. Nga llogaritjet e kryera rezulton se vlera interesit me normën 3 %, që do duhej të paguanin klientët është **4,245,389 lekë, vlerë e cila është e ardhur e munguar** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 65-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Këshilli Drejtues të marrë masa për rritjen e të ardhurave si pasojë e mos shlyerjes së vlerës së ambienteve të shërbimit, pasi deri në këtë periudhë nga ky proces rezulton me të ardhura të munguara me vlerë 4,245,389 lekë.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me Vendim të Këshillit Drejtues Nr.22, datë 28.07.2021, nr.2794/1 30.07.2021, norma e interesit prej 4% në vit, për shitjen e njësive të shërbimit.

Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

E. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*

i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Gramsh, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:
Shoqëria **"R. 95" SHPK**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin "Ndërtim objekt banimi 8 kate dhe një kat parkimi nëntokë, në Qytetin e Gramshit", ka certifikuar punime me vlerë 947,860 lekë, të cilat nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, po ashtu kanë rezultuar edhe punime të pa realizuara *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 142-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me anë të shkresës nr.prot.3654 datë 03.11.2021 është përcjellë Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH në Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit Gramsh.
Rekomandimi është zbatuar.

F. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, neni 10, Pika 1, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të EKB fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:
"Vërejtje", për:
1. O. Ç., në cilësinë e anëtarit të njësisë së Prokurimit, **për arsye se:**
Në procedurën e prokurimit "Ndërtim Objekt banimi dhe shërbimi 8 kate dhe 1 kate parkimi nëntokë ne qytetin e Gramshit", ka hartuar kritere të cilat nuk përputhen me natyrën dhe volumin e kontratës.
2. A. M.
3. O.B.
4. L. P., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së Prokurimit, **për arsye se:**
Në procedurat e prokurimit "Objekt 6 kate nga te cilat 5 kate banim dhe një kat alternuar me njësi shërbimi me ambiente banimi dhe 1 kat parkim nëntoke", ne qytetin e Maliqit" dhe "Objekt nr.1 banimi dhe shërbimi 8 kate me një kat parkim nëntokë dhe objekt nr.2 banimi 8 kate dhe një kat parkim nëntokë" ne qytetin e Kukësit" kanë hartuar kritere të cilat nuk përputhen me natyrën dhe volumin e kontratës.
5. R.Y.
6. A. H., në cilësinë e anëtarëve të KVO**, për arsye se:**
Në procedurën e prokurimit "Objekt nr.1 banimi dhe shërbimi 8 kate me një kat parkim nëntokë dhe objekt nr.2 banimi 8 kate dhe një kat parkim nëntokë", kanë kualifikuar OE i cili nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhër Nr.339, datë 25.10.2021 Dhënie masë disiplinore për punonjësin Znj. L. P.
-Urdhër Nr.340, datë 25.10.2021 Dhënie masë disiplinore për punonjësin Znj. A. H.
-Urdhër Nr.341, datë 25.10.2021 Dhënie masë disiplinore për punonjësin Z. O.B.
-Urdhër Nr.342, datë 25.10.2021 Dhënie masë disiplinore për punonjësin Z. A. M.

-Urdhër Nr.343, datë 25.10.2021 Dhënie masë disiplinore për punonjësin Znj.R. Y.
- Urdhër Nr.344, datë 25.10.2021 Dhënie masë disiplinore për punonjësin Znj.O. C.
Komenti i grupit të auditimit:
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT PËR PROJEKTET:
1. PROJEKTI "KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE"
2. PROJEKTI "FUMIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE III"
3. PROJEKTI "ZHVILLIMI I INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMI"

Kontrolli i lartë i shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në FSHZH për projektet "Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale", "Fumizimi me ujë i zonave rurale III", projekti "Zhvillimi i integruar urban dhe turizmi" mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, për periudhën nga fillimi i projektit deri në 30.06.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

1. PROJEKTI "KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE"

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", FSHZH, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 675/17 prot., datë 25.10.2021, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, <u>Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre</u>, paragrafi 2, ku përcaktohet se:
"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 254/8, datë 30.09.2021 dhe në FSHZH nr. 675/16 prot., datë 05.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **8 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **1 masa për shpërblim dëmi në vlerën 373,975 lekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **0 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **3 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	8	5	-	3
3	Shpërblim dëmi	1	1	-	-
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	-	-	-	-
7	Masa disiplinore	3	-	-	3

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e FSHZH

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	5	2	0	3	0
3	Shpërblim dëmi	1	1	0	0	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në	0	0	0	0	0

	administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit					
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0

2. PROJEKTI "FUMIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE III"

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", FSHZH, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.1882/12 prot., datë 18.10.2021, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:
"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. nr. 581/7, datë 04.10.2021 dhe në FSHZH nr. 1882/11 prot. , datë 05.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **14 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **0 masa për shpërblim dëmi në vlerën 0 lekë**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar 0 **masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	0	0	-	-
2	Organizative	14	12	-	2
3	Shpërblim dëmi	0	0	-	-

4	Të ardhurave të munguara	0	0	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	0	0	-	-
7	Masa disiplinore	0	0	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e FSHZH

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	12	5	0	6	1
3	Shpërblim dëmi	0	0	0	0	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	0	0	0	0	0
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0

3. PROJEKTI "ZHVILLIMI I INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMI"

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", FSHZH, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 6/1 prot., datë 12.01.2022, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë

e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: *"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna"*.

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 325/11, datë 31.12.2021 dhe në FSHZH nr. 6 prot. , datë 05.01.2022, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **12 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **0 masa për shpërblim dëmi në vlerën 0 lekë**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar 0 **masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	0	0	-	-
2	Organizative	12	12	-	-
3	Shpërblim dëmi	0	0	-	-
4	Të ardhurave të munguara	0	0	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	0	0	-	-
7	Masa disiplinore	0	0	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e FSHZH

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	12	3	0	9	0

3	Shpërblim dëmi	0	0	0	0	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	0	0	0	0	0
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L..

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

1. PROJEKTI "KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE"
Nga auditimi i zbatimit të rekomandimve rezulton se FSHZH nga 8 masa organizative ka pranuar 5 prej tyre ose 62.5% të masave dhe 3 prej tyre nuk janë pranuar ose 37.5% dhe nga 5 masat e pranuara 2 janë zbatuar plotësisht ose 25% e masave të rekomanduara dhe janë 3 masa

janë në proces zbatimi ose 37.5% e masave të rekomanduara. Nërsa për sa u përket masave disiplinore rezulton se nga 3 masa të rekomanduara të 3 masat nuk janë pranuar ose 100% e tyre.

2. PROJEKTI "FUMIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE III"
Nga auditimi i zbatimit të rekomandimve rezulton se FSHZH nga 14 masa organizative ka pranuar 12 prej tyre ose 85.7% të masave dhe 2 prej tyre nuk janë pranuar ose 14.3% dhe nga 12 masat e pranuara 5 janë zbatuar plotësisht ose 35.7% e masave të rekomanduara, janë 6 masa janë në proces zbatimi ose 42.8% e masave të rekomanduara dhe 1 masë nuk është zbatuar ose 7.2% ne masave të rekomanduara.

3. PROJEKTI "ZHVILLIMI I INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMI"
Nga auditimi i zbatimit të rekomandimve rezulton se FSHZH nga 12 masa organizative ka pranuar 12 prej tyre ose 100% të masave dhe nga 12 masat e pranuara 3 janë zbatuar plotësisht ose 25% e masave të rekomanduara, janë 9 masa janë në proces zbatimi ose 75% e masave të rekomanduara.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

1. PROJEKTI "KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE"
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 25 %, një nivel ky shumë i ulët i cili tregon për mos vlerësimin e këtij procesi nga ana e FSHZH.

2. PROJEKTI "FUMIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE III"
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 37.5 %, një nivel ky shumë i ulët i cili tregon për mos vlerësimin e këtij procesi nga ana e FSHZH.

3. PROJEKTI "ZHVILLIMI I INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMI"
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 25 %, një nivel ky shumë i ulët i cili tregon për mos vlerësimin e këtij procesi nga ana e FSHZH.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

1. PROJEKTI "KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE"
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", FSHZH, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 675/17 prot., datë 25.10.2021, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

2. PROJEKTI "FUMIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE III"
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", FSHZH, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.1882/12 prot., datë 18.10.2021, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

3. PROJEKTI "ZHVILLIMI I INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMI"

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", FSHZH, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 6/1 prot., datë 12.01.2022, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

1. PROJEKTI "KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE"

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:
"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna",

2. PROJEKTI "FUMIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE III"

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:
"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

3. PROJEKTI "ZHVILLIMI I INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMI"

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:
"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

PROJEKTI "KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE"

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së projektit "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale", sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve

të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e FSHZH sa i përket Projektit "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale" janë evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000).

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikes së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e projektit rezultoi se:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka të meta dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë së tij që lidhen me menaxhimin e projektit. Problematikat e evidentuara i referohen mos përcaktimit të Personelit të Dedikuar për projektin siç është parashikuar në marrëveshjen e financimit me Bankën Botërore, mos realizim të objektivave të përcaktuara në marrëveshjet e financimit me qëllim vlerësimin e rezultateve të punës së deritanishme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka kërkuar shpjegime për tre procedura me oferta anomalisht të ulëta të cilat mund të ndikojnë në realizimin e punimeve civile me cilësi dhe në kohën e parashikuar. Gjithashtu në dy projekte, ku punimet janë në proces, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në pagesat e ndërmjetme janë certifikuar punime të pa kryera dhe pa dokumentacioni justifikues, në vlerën totale 16,370,294 lekë pa TVSH.

Përgjegjësitë e Audituesve Shtetëror të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse paraqiten anomali materiale si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të shoqërisë. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Në Marrëveshjen e Huas nr.8850-Al datë 05.06.2018, me vlerë 50 mil US$, ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Qeverisë Shqiptare, në Skedulin 2 të saj, është përcaktuar se Personeli i Dedikuar për projektin "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale" (RLRCP) përbën një organizim institucional në FSHZH. Në Manualin Operacional, datë 30.08.2018, pika 1, shkronja (d) FSHZH, është përcaktuar se në përbërje të Personelit të Dedikuar duhet të jenë përfshirë një Projekt Menaxher Inxhinier, një Specialist Menaxhimi Financiar, një Specialist Prokurimesh, një Specialist Mjedisi, një Specialist Social dhe inxhinierë të fushës. Përveç kësaj, FSHZH mund të punësojë konsulentë ose mbështesë me staf, të cilët do të punojnë sipas mënyrës on-call basis, në varësi nga nevojat specifike të aktiviteteve. Në Vendimin nr.186, datë 25.07.2019 të Këshillit Drejtues është vendosur për disa ndryshime në strukturën organizative dhe manualin e procedurave administrative të FSHZH, kapitulli "Njësitë e Menaxhimit të Projekt Programeve" shkronja (d) pika 78 është vendosur se: "Në varësi të llojit, fazës dhe volumit të projekt/programeve, që përfshihen në një njësi menaxhimi, Drejtori Ekzekutiv mund të vendosë edhe përcaktimin e një menaxheri që do të ndjekë në mënyrë specifike një prej projekt/programeve që përfshihen brenda një njësie. Nga auditimi rezulton se është shpërndarë personeli, i cili rezulton të jetë përgjegjës për disa projekte të ndryshme, gjithashtu është shpërndarë edhe përgjegjësia që duhet të ketë Drejtori Ekzekutiv i FSHZH, i cili në zbatim të Manualit Operacional (aneks 2) të projektit duhet të ketë në varësi direkt Njësitë e Menaxhimit të Projekt/Programeve si dhe nuk rezultojnë akte emërimi ose urdhra specifikisht për menaxhimin e projektit "Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale" (RLRCP) P163239. Për sa më sipër është në kundërshtim me Marrëveshjen e Huas, Skeduli 2, Seksionin I A, pika 1, nr.8850 datë 05.06.2018, si edhe Manuali Operacional, pika 1, shkronja (e) dhe Aneksi 2 i saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për identifikimin dhe emërimin e personelit të dedikuar projektit "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale", me qëllim koordinimin e aktiviteteve në përbërje të tij.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: FSHZH sqaron se *"Për kryerjen e aktivitetit kryesor, menaxhimit të projekteve dhe programeve të ndryshme, FSHZH është e organizuar në një formë tre-dimensionale, matricore e cila garanton që të sigurohet në të njëjtën kohë një vëmendje më e madhe në menaxhimin e projekteve/ programeve dhe të ruhet cilësia në zbatimin e secilës fazë të menaxhimit të tyre. Organizimi i strukturës së projektit / programit bëhet si më poshtë:*

Dimensioni i parë i strukturës ku përfshihen Njësitë Funksionale (NJF) të FSHZH, ato janë përgjegjëse për kryerjen me cilësi të funksionit të tyre në të gjitha aktivitetet e NJMP-së (prokurim, specialist teknik/menaxher kontrate, specialist mjedisi, etj). Nga njësitë funksionale alokohen punonjës me kohë të plotë ose të pjesshme sipas nevojave të NJMP-së.

Dimensioni i dytë i strukturës janë Njësitë e Menaxhimit të Projekteve/Programeve të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e Projekteve/Programeve sipas parashikimeve në Manualin e Procedurave. Në këtë dimension NJMP e Ndërhyrjeve të Infrastrukturës rrugore është përgjegjëse për të gjitha projektet e kësaj fushe, pra edhe për projektin "Konektiviteti i Rrugëve rajonale dhe Lokale".

Dimensioni i tretë i strukturës janë Njësitë Rajonale (NJR), të cilat janë përgjegjëse për ndjekjen, përfaqësimin, koordinimin dhe mbikqyrjen e aktivitetit në katër rajone. Për ndjekjen në terren të projekteve të infrastrukturës rrugore NJMP bashkëpunon me njësitë rajonale ku shtrihet projekti.

Në vijim të sa mësipër është e nevojshme të sqarojmë se çfarë është struktura matricore dhe si zbatohet ajo. Strukturat matricore janë struktura menaxhimi që krijohen në lidhje me nevojën për të përshpejtuar ritmin dhe për të rritur efiçencën në zbatimin e projektit. Thelbi i strukturave të matricës është që grupe të përkohshme të punës të krijohen në strukturat ekzistuese, ndërsa burimet dhe punonjësit e departamenteve të tjera transferohen tek kreu i grupit në vartësi të dyfishtë.

Me një strukturë të menaxhimit të matricës, ekipet e projektit (të përkohshëm) formohen për të zbatuar projekte dhe programe të synuara. Këto grupe janë në vartësi të dyfishtë, ato krijohen përkohësisht. Kjo arrin fleksibilitetin në shpërndarjen e personelit dhe zbatimin efektiv të projekteve.

Këto grupe përbëhen nga specialistë të departamenteve përkatëse funksionale. Ndërveprimi i menaxherëve të projektit me departamentet funksionale kryhet horizontalisht, si dhe përgjatë lidhjeve tradicionale vertikale, si rezultat, formohet një matricë ndërveprimi.

Struktura e matricës bën të mundur manovrimin fleksibël të burimeve njerëzore duke i rishpërndarë ato ndërmjet projekteve, por me kusht që të ruhet përkatësia e tyre administrative në departamentet përkatëse funksionale. Një tipar i strukturës së menaxhimit të matricës është që menaxheri i projektit nuk ka kontroll mbi personelin e përfshirë në projekt.

Menaxheri i projektit përcakton se çfarë duhet të bëhet dhe kur, dhe udhëheqësi funksional vendos kush do ta bëjë punën dhe si. Menaxheri i projektit është përgjegjës për të gjitha produktet përfundimtare të projektit, përfshirë kostot e realizimit/zbatimit, kohën e kaluar dhe cilësinë e projektit.

Duke përdorur këtë lloj strukture, është e rëndësishme të monitorohet vazhdimisht që të dhënat aktuale korrespondojnë me ato të planifikuara, për të krijuar një sistem të mirë kontrolli për ecurinë e punës në projekt, cilësinë e ekzekutimit, kostot dhe kohën.

Punëmarrësi në një strukturë matricë raporton te dy menaxherë: drejtuesi i tij i menjëhershëm i njësisë strukturore dhe menaxheri i projektit. Në këtë rast, menaxheri i projektit nuk ka nevojë të kontrollojë drejtpërdrejt ekzekutorët. Ai përqendron përpjekjet e tij në koordinimin dhe pjesën metodologjike të projektit, domethënë, ai monitoron se çfarë duhet të bëhet dhe kur. Një menaxher i njësisë funksionale, përkundrazi, nuk ka nevojë për të koordinuar pjesët individuale të projektit.

Në rastin konkret është me vend të sqarohet se emërimi në njësinë funksionale nuk duhet të konfondohet me caktimin e tyre në kryerjen e detyrave në njësitë përkatëse të menaxhimit të projekteve. Meqenëse struktura e matricës bën të mundur manovrimin fleksibël të burimeve njerëzore duke i rishpërndarë ato ndërmjet projekteve, në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për të rritur rendimentin e punëmarrësve në realizimin e objektivave kemi raste që një punonjës i emëruar pranë një njësie funksionale mund të jetë i caktuar në më shume se në një njësi menaxhimi të projektit. Kjo në varësi të nevojave të menaxherit të projektit për realizimin e objektivave të tij.

Në përputhje me strukturën tredimensionale matricore, Njësitë funksionale (NJF) të përfshira drejtpërdrejtë në strukturën matricore si dhe Njësitë e Menaxhimit të Projekteve/Programeve (NJMP) ku është dhe NJMP e Ndërhyrjeve Rrugore janë krijuar, funksionojnë dhe kryejnë aktivitetet sipas përcaktimeve në Manualin e Procedurave (MP) të Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Kjo marrëdhënie tre dimensionale është e rregulluar plotësisht në kapitullin 2.7 të MP që rregullon mënyrën e funksionimit të Njësive të Menaxhimit të Projekteve dhe përgjëgjësitë e tyre.

Më konkretisht procedura e ndjekur për alokimin e burimeve njerëzore kryhet sipas hapave të mëposhtëm:

- *Përgjegjësi i NJMP i kërkon drejtuesve të njësive funksionale staf për projektin e tij*
- *Dakordohet ndërmjet Përgjegjësit të NJMP dhe drejtuesve të njësive funksionale lista e stafit të alokuar dhe koha në dispozicion të projektit*

- *Kjo matricë e rakorduar si dhe çdo informacion tjetër në lidhje me burimet njerëzore, që mund të ketë ndikim në menaxhimin e projektit i njoftohet Njësisë së Burimeve Njerëzore.*

Në këtë kuptim projekti i audituar ka staf të dedikuar sipas rregullave të brendshme të funksionimit të organizatës, pavarësisht se meqenëse Fondi Shqiptar i Zhvillimit implementon projekte të shumta, jemi të detyruar që shpesh të ketë lëvizje në numrin e punonjësve dhe të profesioneve, që është e nevojshme për zbatimin e projektit, pra praktikisht zbatimi i projektit realizohet nepërmjet stafit të dedikuar.

Vetë struktura matricore mbi te cilën zhvillon aktivitetin e tij FSHZH i jep kësaj organizate dinamikën dhe fleksibilitetin që në çdo moment të ketë punëbërës (punonjës) të dedikuar për zbatimin e çdo projekti.

Ju kemi sqaruar edhe gjatë kohës që keni kryer auditimin se caktimi i stafit të Njësisë së Menxhimit të Projektit është realizuar si mëposhtë:

1- Projekt menaxheri është i emëruar me vendimin Nr. 19, datë 18.03.2019 "Për emërim në pozicion të ri pune" në zbatim të Manualit të Procedurave.

2- Stafi i projektit është i emëruar me vendimin Nr 53/1 datë 05.08.2019 "Për emërim në pozicion pune pranë Njësisë së Menaxhimit të Projekteve dhe Programeve të ndërhyrjeve të infrastrukturës rrugore". "

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

2. Gjetje nga Auditimi: Referuar niveleve të parashikuar sipas viteve ne Marrëveshjet e Financimit dhe Manualin Operacional të nivelit të realizimit të objektivave të projektit dhe nivelet konkrete aktuale të arritura për çdo vit deri në përfundimin e periudhës objekt auditimi Dhjetor 2020 rezulton se objektivat që lidhen me komponentin e parë të projektit që është përmirësimi i aksesueshmërisë dhe me indikatorët e progresit fizik të tij si, kilometra rrugë të rehabilituara, numrin e qendrave të banuara të lidhura nëpërmjet rrugëve të rehabilituara apo koha e reduktuar e udhëtimit në rrugët e projektit, pavarësisht se kanë një përqindje realizimi ato nuk janë arritur sipas përcaktimeve fillestare. Objektivat që lidhen me komponentin e dytë dhe të tretë të projektit pra indikatorët e ndërmjetëm që kanë të bëjnë me kapacitete bashkiake të përmirësuara për menaxhimin e aseteve rrugore, apo mbështetje për menaxhimin e zbatimit me trajnime, përmirësime dhe politika, rezultojnë ende të pa realizuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 **Rekomandimi:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të projektit, të marrë masa që kontraktori të rrisë kapacitetet në mënyrë që të arrihet realizimi i objektivave dhe përfundimi në kohë i projektit. Gjithashtu të koordinojë punën për realizimin e indikatorëve të ndërmjetëm.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: FSHZH sqaron se "Objektivi kryesor i Programit eshte realizimi i infrastrukturës rrugore për objektet e miratuara. Për Bankën Botërore objektivi është realizimi i 45 km rrugë të asfaltuara dhe për EBRD është realizimi i 3 objekteve të miratuara. Ne fazën qe flasim jemi në vitin e tretë te programit për Banken Botërore dhe të dytin per EBRD dhe deri tani janë ne perfundim 45 km rrugë si dhe pritet prokurimi per dy objektet te tjera te cilat e çojnë numrin e km në mbi 60 km (Rrugët paralele Golem për të cilën priten ofertat ekonomike). Për EBRD 2 objektet jane në ndërtim dhe një në prokurim dhe në saj të uljes së ofertave do të realizohen më shumë rrugë se objektivi. Pra, nga te dy financuesit, ne momentin kur jemi ne mesin e zbatimit jane tejkaluar objektivat e Programit.

Konsulencat qe lidhen me supervizionin dhe pergatitjen e projekteve jane po ashtu në zbatim ose të realizuara. (komponenti 2 i BB apo supervizioni i EBRD).

Lidhur me gjetjen e pretenduar nga ju per realizimin, komponenti i cili nuk është prokuruar akoma është ngritja e kapaciteteve për Bashkitë. Kjo si pasojë e pandemise shkaktuar nga COVID-19 dhe kufizimeve të organizimeve dhe lëvizje të ushtruara në shumë shtete. Për më

tepër BB nuk ka miratuar ende termat e referencës për këto komponent. Departamenti i Menaxhimit së bashku me atë të Zhvillimit janë në komunikim për miratimin e këtyre termave. Theksojmë se ky komponent nuk ka afat të zhvillimit të tij dhe duke qënë se asistenca e bashkive do të kryhet për pak muaj, mendojmë se jemi në kohë për zbatimin e tij dhe dorëzimi i një produkti sa më të përdorshëm. Realizimi i këtij komponenti do të realizohet në momentin më të përshtatshëm." Do të verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

3. Gjetje nga Auditimi: Në procedurën e prokurimit për kontratën *"Shërbime Mbikëqyrje për rrugën Pogradec-Tushemisht"* rezulton se mënyra e prokurimit ka qenë procedurë kombëtare me metodën e përcaktuar "Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentit (CQS)". Zhvillimi i kësaj procedure referuar rregullores së Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FP1, 1.07 2016, Seksioni VII, Metoda të Aprovuara të Përzgjedhjes së Shërbimeve të Konsulencës, pika 7.*12 është e përshtatshme për detyra të vogla ose situata emergjente për të cilat nuk justifikohet vlerësimi i propozimeve konkurruese,* gjithashtu referuar Manualit Operacional të Projekt, Pika 3, tabela 3.1 është përcaktuar kushti *Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentin nën 300,000$,* në *varësi të natyrës se detyrave.* Për më tepër në Strategjinë për Zhvillimin e Prokurimeve të Projektit PPSD, pika IV-Objektivat e Prokurimeve, pika 2.2 specifikohet për *(CQS) afati i përllogaritur është afërsisht 4-6 muaj përfshirë periudhën e nevojshme për përgatitjen dhe dakortësimin e termave të referencës.* Mbështetur në Udhëzimet për Prokurime të Bankës Botërore, dokumenti "Strategjia për Zhvillim të Prokurimeve të Projektit, Udhëzues i Detajuar Format i Shkurtër, Korrik 2016", rekomandohet argumentimi dhe logjik për Mënyrën e Prokurimit të zgjedhur. Konkretisht kjo procedure prokurimi ka zgjatur 9 muaj pra më shumë sesa periudha e përcaktuar si kriter për përzgjedhjen e saj, gjithashtu nuk është argumentuar përzgjedhja e kësaj metode për këto shërbime mbikëqyrje nga ana e Klientit duke mos marrë në konsiderate natyrën e detyrës për shërbimin e mbikëqyrjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia Prokurimit, të marrë masa që të analizojë metodologjitë e përzgjedhjes së mënyrave të prokurimit e ti argumentoje ato sipas kritereve për zgjedhjen e tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Për këtë rekomandim FSHZH sqaron **"***Fillimisht sqarojmë se ashtu si përshkruhet në Raport, CQS është e përshtatshme për detyra të vogla ose situata emergjente në të cilat përgatitja dhe vlerësimi i Propozimeve Konkurruese nuk është i justifikuar.*

Vlera e parashikuar për këtë shërbim është 200,000 $, çka përbën një detyrë të vogël (Vlera e parashikuar për supervizionin e rindërtimit të rrugëve (af. 45 km) është 1,200,000 $).

Shpjegimi i Tabelës 3.1

Për asnjë nga kontratat e konsulencës, përfshirë edhe CQS, nuk ka një limit monetar të mirëpërcaktuar nga WB për këtë proçedurë, pasi kjo vlerësohet rast pas rasti dhe për këtë arsye në kolonën Vlera e kontratës (Contract value) është shënuar n.a. – not applicable. Kjo pasi vetëm vlera e kontratës nuk është përcaktuese për llojin e prokurimit.

Përjashtimisht nëpërmjet footnote, për CQS përcaktohet se limiti maksimal është 300,000 $. Duke pasur parasysh se vlera e parashikuar për këtë shërbim është 200,000 $, përzgjedhja e formës së prokurimit është bërë në respektim të këtij kushti.

1. Note: a. CQS beloë US$300,000 depending on the nature of assignment.

Në lidhje me PPSD, sqarojmë se tabela të cilës i referoheni V. Recommended Procurement Approach for the Project, është një tabelë udhëzuese. Tabela e përfshirë në PPSD e FSHZH, miratuar nga WB, është në fakt plani i prokurimit.

*Sqarojmë se të gjitha dokumentat që përmbajnë përcaktimet fillestare të këtij projekti (Operation Manual, PPSD, etj.) janë miratuar nga WB, pra WB ka miratuar formën e prokurimit. Në rrethanat kur WB ka miratuar formën e prokurimit mendojmë se do të ishte në tejkalim të kompetencave FSHZH dhe të të tretëve për të diskutuar këtë proces, rrjedhimisht***"***
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

4. Gjetje nga auditimi: Në 10 (dhjetë) procedurat e prokurimit, në tre raste rezultuan se ofertat e operatorit fitues janë anomalisht të ulëta, konkretisht:
Për procedurën e prokurimit *"Rehabilitimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll"* rezulton se oferta e dhënë nga OE fitues *"G. 2 l."* me vlerë 15,001,025.77 US$ me tvsh është 14,123,79 US$ me TVSH, më e ulët se vlera e fondit limit ose 48.4% më e ulët.
Për procedurën e prokurimit *"Rikonstruksion i rrugës Lekdush-Bençë-Tepelenë, Loti 2"* rezulton se oferta e dhënë nga OE fitues *"C. O. I. S. V. T. A."* me vlerë 2,474,793 US$ me TVSH është 2,240,907 US$ më e ulët se vlera e fondit limit ose 47.5% me e ulët.
Për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht"* rezulton se oferta e dhënë nga BOE fitues *"4.-M." shpk dhe "G. L." shpk* me vlerë 377,388,382 lekë me TVSH është 243,342,298 lekë më e ulët se vlera e fondit limit ose 40% me e ulët.
Në gjykimin e grupit të auditimit ofertat vlerësohen si anomalish të ulëta në krahasim me koston e planifikuar dhe me ofertat e ofertuesve të kualifikuar në secilën procedurë si dhe krahasimet e çmimeve të dhëna me manualet e miratuar. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit të këtyre procedurave nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion justifikues apo analizë të detajuar për të mbështetur ofertën e OE, përpara se të merrte vendim për kualifikimin e tyre duke ju referuar metodologjisë së vlerësimit. Për sa më sipër në kundërshtim me Manualin e Prokurimeve të BB për huamarrësit e EFP1 datë 01.07.2016, pika 5.66 dhe 5.77. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa që të analizojë ofertat e OE, dhe në rastet kur ato janë anomalish të ulëta të kërkojë dokumentacion justifikues shtesë dhe analizë të detajuar të çmimeve, përpara se të marrë vendim për kualifikimin, me qëllim eliminimin e risqeve në realizimin e kontratave në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Në vijimësi
Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Për këtë rekomadim FSHZH *"lidhur me ofertën anomalisht të ulët, rikujtojmë se procedura është sipas standarteve të bankës dhe nuk ka vend formula sipas LPP. Përpara lidhjes së kontratës, ofertat janë kontrolluar dhe nga stafi i Bankës të cilët kane vlerësuar se nuk ka risk dhe mund të vazhdohet me lidhjen e kontratës duke dhënë NO përkatës.*
Për të gjitha ofertat e marra është bërë llogaritja me formulën e miratuar sipas standartit të donatorit dhe në rastet kur oferta ka qënë anomalisht e ulët është kërkuar konfirmim ose shpjegim i ofertës.

Për rastet ku pretendohet se ofertat janë anomalisht te ulëta është bërë llogaritja e vlerave sipas procedurës së miratuar nga Banka Botërore në Korrik 2016 për oferta të cilat janë potencialisht anormalisht të ulëta.
Sipas këtij udhëzimi llogaritja matematikore e ofertave anomalisht të ulëta kryhet në mënyra të ndryshme në varësi të pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi. Në rastet kur kemi më pak se 5 ofertues, anomalisht të ulët do të quhen ata të cilët kanë një devijancë më të madhe se 20% në vlerë krahasuar me vlerën e preventivuar.
Në rastet kur kemi më shumë se 5 ofertues (gjë e cila ka ndodhur në të githa prokurimet tona) llogaritja e ofertave anomalisht të ulëta kryhet me anë të një formulë me komplekse

matematikore e cila ka në përbërje mesataren e ofertave, devijim standart në raport me pjesemarrësit. Me konkretisht në rastin tonë:
Objekti "Rikonstruksioni i rrugës Benç – Lekdush" ka pasur dhjetë oferta me vlera konkretisht:
1. 2,770,587 $
2. 4,504,304 $
3. 2,584,667 $
4. 3,007,185 $
5. 2,835,000 $
6. 2,474,793 $
7. 2,967,648 $
8. 2,690,974 $
9. 4,164,885 $
Vlera e përcaktuar nga formula nën të cilën do të cilësohet si anomalisht i ulët është 2,433,410.49 $, ndërkohë që vlera me e ulët është 2,474,793 $.
Objekti "Rikonstruksioni i rrugës Gusmar – Kuç" ka pasur shtatë oferta me vlera si më poshtë:
1. 6,205,341 $
2. 7,193,399 $
3. 5,766,824 $
4. 6,413,137 $
5. 6,023,204 $
6. 5,813,685 $
7. 5,784,038 $
Vlera e përcaktuar nga formula nën të cilën do të cilësohet si anomalisht i ulët është 5,660,212.73 $, ndërkohë që vlera më e ulët është 5,766,824 $.
Objekti "Rikonstruksioni i rrugës Qafë Thorë – Theth" ka pasur gjashtë oferta si më poshtë:
1. 626,155,260 $
2. 826,474,000 $
3. 905,803,121 $
4. 690,491,990 $
5. 613,585,590 $
6. 686,341,790 $
Vlera e përcaktuar nga formula nën të cilën do të cilësohet si anomalisht i ulët është 608,313,788.52 $, ndërkohë që vlera më e ulët është 613,585,590 $.
Sic shihet nga llogaritjet e mësipërme, në asnjë nga rastet nuk është evidentuar ofertë anomalisht e ulët dhe si rrjedhojë nuk i është kërkuar sqarim operatorit të renditur i pari."
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

5. Gjetja nga auditimi: Ndryshim i termave të referencës në procesin e lidhjes së kontratës për "Shërbimet të Supervizionit për Rikonstruksionin e Rrugëve, afërsisht 45 km" RLRCP/1/1.6/2018Në datën 06.06.2019.
Në Seksionin 7 Termat e Referencës, pika III "Kontrata e Shërbimit" janë përcaktuar 3 segmente rrugore në rikonstruksion, prej të cilave 2 segmente janë Fier-Seman dhe Qafë Thorë-Theth, ndërkohë segmenti i tretë i papërcaktuar. Në datën 12 Qershor 2019 është dakortësuar ndryshimi i termave të referencës mbi përbërjen e stafit të ekspertëve dhe kërkesat për ekspertët kryesor. Afati për dorëzimin e Kërkesës për Propozim për kontratën RLRCP/1/1.6/2018 është vendosur data 26.07.2019. Me Urdhrin Nr.07 datë 20.07.2019 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH, është ngritur komisioni i hartimit të fondit limit dhe termave të referencës për segmentin rrugor Gusmar-Kuç.
Në zbatim të Marrëveshjes së Huasë me Bankën Botërore IBRD Nr.8850-AL datë 05.06.2018 janë nënshkruar marrëveshjet e investimit të FSHZH me bashkitë Tepelenë dhe Himarë në

datat 11 Korrik 2019 dhe 18 Korrik 2019 lidhur me segmentet rrugore Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë.
Në datën 03 Mars 2020, nga ana e FSHZH, është kërkuar negocimi për lidhjen e kontratës "Shërbimi i Supervizionit për rikonstruksionin e rrugëve (afërsisht 45 km)", Ref.Nr. RLRCP/1/1.6/2018 me kandidatin potencial të radhës së dytë "Eptisa Servicios de Ingenieria" s.l. Në Minutat e Takimit, "Pjesa Teknike" pika 2, datë 06 Mars 2020, është vendosur për ndryshimin e segmenteve rrugore, në të cilin është hequr segmenti Qafë Thorë-Theth dhe në vend të tij është vendosur segmenti Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë.
Referuar "Udhëzimit të Prokurimeve" të Bankës Botërore, Prill 2018, botimi i pare, seksioni IV, pika 6 "Lidhja e Kontratës", nuk është parashikuar ndryshim i termave të referencës në këtë hap të procesit të prokurimit, por vetëm njoftimi i qëllimit të lidhjes, i cili përfshin periudhën e pauzës së procesit për ankimet e mundshme, përfundimi i kësaj periudhe dhe njoftimi për lidhjen e kontratës.
Ndryshimi i qasjes teknike, apo ndryshimi i segmenteve rrugore në momentin e lidhjes së kontratës, ka shkaktuar deformim në procesin e prokurimit, për arsye se ndryshimi i termave të referencës, apo kushteve të kontratës kryhen përpara skadimit të afatit përfundimtar (deadline) të dorëzimit të Kërkesës për Propozim. Gjithashtu, pavarësisht nga ngjashmëria e kompleksitetit, segmentet ndryshojnë nga njëri tjetri dhe për pasojë ndryshon edhe kompozimi i stafit të ekspertëve, ditët e punës efektive të tyre, apo metodologjia e hartuar.
Ndryshimi i termave të referencës në procesin e lidhjes së kontratës ka shkaktuar si pasojë mungesën e njohjes me ndryshimet për të gjithë konsulentët potencial pjesëmarrës në tender. Sa sipër, në kundërshtim me pikën 13 "Sqarime dhe ndryshime të Kërkesës për Propozim, Seksioni 2 "Instruksionet për Konsulentët", në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, si edhe në kundërshtim me Udhëzimin e Bankës IBRD "Rregullat e Prokurimit" 1 Korrik 2016, Seksioni V Sqarime të Dokumenteve të Prokurimit, Paragrafi 5.31 dhe 5.32. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për koordinimin e aktiviteteve, pjesë e prokurimit të kontratave për projektin "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale". Gjithashtu, kompozimi i Komisioni të Vlerësimit për prokurimin e projekteve të huaja duhet ti shërbejë forcimit të objektivitetit të vlerësimit, duke përfshirë punonjës të dedikuar me qëllim rritjen e llogaridhënies edhe gjatë procesit të prokurimeve.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Në lidhje me këtë rekomandim FSHZH sqaron se "Për konsulencën e supervizionit shpjegojmë se procedurat e prokurimit si pasojë e përftimit të projekteve teknike nga burime të ndryshme, jo gjithmonë janë në përputhje me kërkesat standarte të FSHZH dhe si të tilla nuk ecin paralel me procedurat e supervizionit. Në rastin konkret, projekti i Bënç Lekdushit dhe i Gusmar Kuç është rishikuar disa herë. Për pasojë në ToR e supervizimit është cilësuar si segment i tretë. Duke qene se në momentin e hartimit të TOR dihej afati dhe zona e investimit, ToR kanë përcaktuar muajtë e nevojshem të shërbimit dhe kanë përshkruar zonën. Ky format i ToR nuk ka disavanatazhuar asnjë prej konsulentëve pjesëmarrës dhe nuk ka sjellë kosto për projektin. Theksojmë se është parashikuar një objekt infrastrukture e tipit rrugë me kohëzghatje 12 muaj dhe është zëvendësuar po me një objekt të tipit rrugë me të njejtat parametra dhe me afat zbatimi po 12 muaj dhe po në të njejtën pozitë gjeografike. Si i tillë, nuk bie në kundërshtim me asnjë nga kriteret e bankës. Amendimi i TOR-eve dhe zgjatja e afatit, do të sillte vetëm vonesa në proçes pasi propozimet teknike do të ishin po të njejtat duke qënë se informacioni në ToR ka qenë i mjaftueshëm dhe muajt e shërbimit janë njësoj. Objekti i papercaktuar është përsëri rrugë me parametrat e përshkruara dhe nuk ndryshon në metodologji apo kompleksitet me rrugët e tjera të specifikuara. Për më tepër

vendimi për zëvendësimin e objektit Fier – Seman është marrë nga Bordi Drejtues i FSHZH dhe i miratuar në planin e prokurimit nga Banka Botërore. Nëse do të kishte pabarazi apo dizavntazh do të kishte qënë Banka Botërore e para që do të ngrinte problemin. Për më tepër procedurat e prokurimit janë audituar nga ekspertët e bankës dhe nuk kanë evidentuar shkelje apo problemaitka në lidhje të.
Komisioni i vlerësimit për çdo program përbëhet gjithmonë nga njerëzit kyç të dedikuar dhe të miratuar nga Banka për programin dhe me shumë përvojë në vlerësimin e ofertave të shumë procedurave të prokurimit në kuadër të projekteve të financuara nga donatorët e huaj. Pikërisht për të rritur përgjegjësinë dhe profesionalitetin këta persona janë të përfshirë që nga hapat e para të projektit deri në përfundimin e tij."
Statusi i zbatimit do të auditohet në auditimet në vijim të projekteve.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

6. Gjetja nga auditimi: Ndryshimi i kushteve të pagesës së konsulentit jashtë kërkesave të termave të referencës për "Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore", Kontrata RLRCP/1/1.9/2018.
Në raportin e vlerësimit datë 11 Shtator 2019, është rekomanduar lidhja e kontratës me konsulentin JV "Fred engineering" srl & "I." sh.p.k. me vlerën prej 187,680 USD përfshirë TVSH.
Negociatat për lidhjen e kontratës me aplikantin potencial fitues të sipërcituar janë kryer në datat 12 dhe 18 Shtator 2019.
Gjatë këtyre negociatave në datën 18.09.2019 është vendosur për ndryshimet si më poshtë:
-Në pikën 6 të Minutave të Takimit, është hequr pagesa në avancë (paradhënie) e konsulentit dhe pagesat për konsulentin janë ndryshuar si më poshtë:
-Fatura e dorëzuar pas përgatitjes të Raportit Fillestar dhe Raportet e Auditimit për tre segmentet e para të jetë 30 % e shumës totale të kontratës;
-Fatura pas dorëzimit të projektit dhe planit të ndërhyrjes për zonën pilot të jetë 40 % e shumës totale të kontratës;
-Fatura pas Raportit të Auditimit për segmentin e katërt rrugor të jetë 20 % e shumës totale të kontratës;
-Pagesa e mbetur 10 % pas mbikëqyrjes së zonës pilot dhe pranimit të Raportit përfundimtar.
Por, në Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 "Termat e Referencës", pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH) është përcaktuar se lidhur me pagesat për Konsulentin, ai duhet të dorëzojë faturat sipas programit si më poshtë:
(i) Financimi paradhënie: Konsulenti ka të drejtë që me nënshkrimin e kontratës të paguhet me një paradhënie prej 20 % të çmimit total të vlerësuar përkundrejt një garancie bankare për shumën e marrë dhe e vlefshme deri në përfundimin e punës së kryer.
(ii) Pagesa e faturës: Konsulenti do të lëshojë 3 fatura për shërbimet e kryera pas miratimit nga FSHZH deri në madhësinë prej 70 % të kontratës. Shuma prej 10 % e mbetur do të jetë paguar pas përfundimit dhe pranimit të Raportit Përfundimtar.
(iii) Pagesa prej 10 %: Pas mbikëqyrjes të masave të implementuara dhe dorëzimit të Raportit Përfundimtar.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, gjithashtu, është në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 "Termat e Referencës", pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH).
Veprimet e mësipërme kanë sjellë si pasojë mospërputhje midis dispozitave të parashikuara gjatë procesit të prokurimit dhe situatës së krijuar. Sa sipër, ndryshimi i mënyrës së pagesës së Konsulentit ka sjellë si pasojë rritjen e riskut për përfundimin e detyrave të tij. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ardhmen në drejtim të menaxhimit me risk sa më të ulët të kontratave të konsulencës.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Për këtë rekomandim stafi i FSHZH ka dhënë këtë arsyetim "*Lidhur me gjetjen tuaj për konsulentët e Auditit të Sigurisë, sqarojmë se: Në asnjë dokument standart të Bankës Botërore, Dokument Tenderi apo formë nuk kërkohet që kontratat me konsulentet të lidhen me garanci bankare. Një dokument i tillë nuk kërkohet në procedurat e bankës për këto lloj konsulencash. Rikujtojmë se si dokumenti i tenderit ashtu dhe kontrata marrin miratimin e Bankës përpara çdo veprimi dhe si e tillë nuk mund të kalonte pa vëmndje mungesa e një dokumenti të tillë.*
Lidhur me paradhënien theksojme se ajo është fakultative dhe shërben për të ndihmuar operatorët në fillimin e punës. Duke qënë së kjo konsulencë nuk ka nevojë për blerje, mjete, materiale apo shërbime të veçanta në fillimet e saj, nuk është parë e arsyeshme të jepet paradhënie. Nuk qëndron dhe është e pa arsyeshme të diskutohet disavantazhimi apo shkelja që të mos paguhet paradhënie dhe pagesa të jepet me kryerjen e punës dhe pas dorëzimit të materialeve objekt i kontratës.
Lidhur me Amendimin e ToR ju njoftojme se: Bazuar në Task 2 të termave të referencës thuhet se segmenti i 4 që do të auditohet do të vendoset gjatë fazës së përgatitjes së Inception Report, dhë kështu jemi në përputhje me ToR e publikuara dhe të gjithë konsulentët kanë qënë në të njetat kushte për të përgatitur ofertat. Për më tepër, audituesi ka kryer shërbimin për segmentin Gusmar – Kuç si segmenti i katërt dhe segmentin e pestë Bënç – Lekdush pa pagesë, brenda të njejtës paketë."

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

7. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës *"Rikonstruksion i rrugës Gusmar-Kuç"* konstatohet se referuar Vendimit Nr. 5 datë 28.02.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit i cili vendos miratimin me kusht të lejes së ndërtimit të infrastrukturës "Rikonstruksioni i segmentit të Rrugës Gusmar-Kuç" me vendndodhjen në Bashkinë Tepelenë dhe Himarë, me zhvillues Bashkinë Tepelenë dhe Bashkinë Himarë, subjekti nuk rezulton të jetë pajisur me Dokumentin e Lejes së ndërtimit. Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" neni 27 dhe 28, dhe VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 'Për Miratimin E Rregullores së Zhvillimit së Territorit' të ndryshuar, neni 25 pika 11 dhe 13. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: FSHZH dhe strukturat përkatëse, të marrin masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit, nga të gjitha palët e përfshira në projekt, për pajisjen me leje ndërtimore sipas legjislacionit në fuqi për shmangien e problematikave që mund të lindin gjatë zbatimit të punimeve.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Grupit të auditimit iu vendosë në dispozicion Leja e Ndërtimit të Infrastrukturës me nr.871 Prot., datë 25/02/2022 nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

8. Gjetje nga Auditimi: Në objektin *"Rindërtimi i Rrugës Qafë Thorë-Theth",* sipas kontratës të lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe BOE "G. C." shpk & "G." shpk me referencë RLRCP/1/l.l/ 2018 datë 08.07.2019, në lidhje me zbatimin e punimeve civile, me vlerë 613,585,590 lekë pa TVSH ose 736,302,708 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 10 muaj, rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm *(IPC nr. 4)* volume

pune jo të pasqyruara në librezat e masave *(Measurement Sheets)* dhe të pa shoqëruara me dokumentacionin plotësues. Këto diferenca rezultuan në 5 (pesë) zëra punimesh në shumën 15,137,872 Lekë pa TVSH të cilat janë reflektuar në situacionin pasardhës. Pavarësisht rregullimit, certifikimi i tyre pa dokumentacionin justifikues është në kundërshtim me Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit sipas amendamenteve Nr.1 datë 08.07.2019 dhe Nr. 2 date 02.04.2020 me objekt "Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht", për supervizionimin e kontratës së zbatimit të rrugës Qafë Thorë-Theth. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: FSHZH të marrë masa që në të ardhmen të mos kryej pagesa situacionesh pa dokumentacion justifikues duke mos tejkaluar buxhetin e programuar kohor e shmagur kështu vendosjen në vështirësi të likuiditeteve të saj.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin:

Grupit të auditimit ju vendosën në dispozicion për objektin "Rindërtimi i Rrugës Qafë Thorë-Theth", dokumentacioni:

Librezë masash e saktësuar për zërat e situacionit të ndërmjetëm (IPC nr. 4), të 5 (pesë) zërave të punimeve në shumën 15,137,872 lekë pa TVSH të cilat janë reflektuar në situacionin pasardhës.

Libreza e masave përfundimtare.

Situacioni përfundimtar i punimeve.

Për tu verifikuar në auditime të ardhshme.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në objektin *"Rikonstruksion i Rrugës Pogradec-Tushemisht"*, sipas kontratës të lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe BOE "4.-M." shpk & "G. L." shpk me referencë RLRCP/1/1.2/2018 datë 27.05.2019, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë 314,490,318 lekë pa TVSH ose 377,388,382 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 8 muaj, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionin përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera për dy zëra në shumë **373,975 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si dhe 10 zëra punimesh të dëmtuara që duhet të riparohen gjatë fazës së garancisë në shumën **858,447 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit me objekt "Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht", Nr. RLRCP/1/1.5/2018 datë 27.05.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: FSHZH të kërkoj në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **373,975 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE "4.M." SHPK & "G. L." SHPK, si dhe kryerjen e punime të dëmtuara brenda afatit të garancisë së tyre në shumën **472,447 lekë pa TVSH**, e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të

likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. RLRCP/1/1.2/2018 datë 27.05.2019 me objekt *"Rikonstruksion i Rrugës Pogradec-Tushemisht"*.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin:
Urdhër nr.48, datë 01/11/2021 i DE, "*…për ndjekjen e proçedurave administrative dhe ligjore për kthimin në Buxhetin e Shtetit të vlerës prej 373.975 lekë pa tvsh, në objektin "Rikonstruksion i rrugës Pogradec -Tushemisht….."*.
Relacion teknik i Mbikqyrësit të punimeve për pagesën e dytë të mbajtur të Kontraktorit të punimeve, me datë 15/11/2021, në të cilin shprehimisht thuhet: "*…Klientit nëpërmjet urdhërit nr.48, datë 01/11/2021 të DE të FSHZH, urdhëron ti mbahet nga pagesat shuma prej 373.975 lekë pa tvsh ose 448.770 lekë me tvsh".*
Formular Urdhër Transferte me datë 18/11/2021, Kërkesë pagese, Raport, Amendim Garanci bankare.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

C. MASA DISIPLINORE
C.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE
C.1.1 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.
Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", Manualin e Procedurave të FSHZH, pika 7.11, germa g, kontratat individuale të punës, neni 12, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore ***"Vërejtje"*** *për personat si më poshtë:*

1. *Z. E. O.* me detyrë Drejtor Departamentit të Menaxhimit të Projekteve, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
2. *Z. D. M.* me detyrë specialist në Njësinë e Zbatimit, Departamenti i Infrastrukturës, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
3. *Z. L. M. i* me detyrë P/Njësinë e Zbatimit të Projektit Utilitare, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin : Në vijim të arsyetimit ligjor të përdorur për rekomandimin 8.1, të Kreut B. Masa Organizative sqarojmë se shkaku për rekomandimin e masave disiplinore nuk qëndron, sepse në të gjitha prokurimet për konsulencat e përmendura nga KLSH, janë ruajtuar standartet dhe është marrë më tepër shërbim sesa është paguar. Konformiteti i procedurave është vërtetuar nga auditimet e Bankës Botërore që është vetë hartuese e dokumentit të prokurimit të cilit ju i referoheni.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pa pranuar

PROJEKTI "FUMIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE III"

A: OPINIONI I AUDITIMIT MBI PËRPUTHSHMËRINË

Opinion mbi përputhshmërinë (I kualifikuar me theksim çështje)
Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të fazës së tretë për Projektit "Furnizimi me ujë i zonave rurale III", financuar me fondet e financuar me fondet Bankës Gjermane për Zhvillim, Bashkimit Evropian përmes programit IPA dhe Republikës së Shqipërisë në formën e Kontributit Lokal nëpërmjet Njësive të Vetëqeverisjes Vendore përfituese të Projektit, bazuar në Marrëveshjet e Financimit të ratifikuara respektivisht me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, dhe Marrëveshjen e Huas të ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit

të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000 dhe 4100.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se Projekti (faza e tretë) për shkak të rëndësisë të anomalive të trajtuara në këtë Projekt Raport Auditimi, ka devijime materiale por jo të përhapura. Megjithatë grupi i auditimit tërheq vëmendjen për disa çështje të rezultuara gjatë auditimit dhe për këtë arsye gjykojmë dhënien e **Opinionit të kualifikuar me theksim çështje.**

Baza për opinion

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ***ISSAI 4100*** *- Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta dhe* ***ISSAI 4200*** *- Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin "Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë" të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga ARRSH, theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Ne duam të tërheqim vëmendjen e përdoruesve për disa çështje të cilat ndikojnë në cilësinë e informacionit financiar të paraqitur për menaxhimin financiar të projektit, duke përfshirë dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe anomalitë e identifikuara.

Konkretisht:

- Për detyrimet në formën e Kontributit Lokal nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përfituese të Projektit në vlerën 89,425,931 lekë.
- Për mos furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë të zonave të evidentuara në këtë Projekt Raport, duke mos arritur objektivin e marrëveshjes/kontratës atë të furnizimit pa ndërprerje me ujë të zonave të përzgjedhura si zona që nuk kanë pasur ujë të pijshëm 24 orë.
- Në përgjithësi strukturat e FSHZH-së, janë angazhuar në etapat e projektit por jo në të gjitha rastet ky angazhim është i verifikueshëm. Strukturat e Menaxhimit të Projektit pranë FSHZH, duhet të angazhohen me qëllim lënien e gjurmës së auditimit në konformitet të plotë me kapitullin nr. 9, nën kapitullin nr. 9.1, Fazat e Procesit të Prokurimit, nënapitullin nr. 9.1.6, pika 593 dhe 594 të Manualit të Procedurave të FSHZH mitatuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar, përsa i përket hartimit të DST-ve, dhënien e mendimeve ligjore përpara nënshkrimit të kontratave apo amendimeve të tyre por dhe për dhënien e mendimeve teknike lidhur me hartimin e projektit teknik duke dhënë kontributin e tyre, pse jo në përmirësimin e specifikimeve teknike, kritereve juridike për kualifikimin e operatorëve ekonomikë apo edhe përmirësimin e projektit teknik si p.sh në përmirësimin e kushteve të funksionimit të depove të ujit duke sygjeruar përforcim të rrethimit të jashtëm, rehabilitim të ambientit të jashtëm apo monitorim me kamera dhe sisteme syrvejimi për objekte të një

rëndësie të veçantë siç është uji i pijshëm për popullatën. Mund të sugjerohej vendosja e sensorëve për monitorimin e cilësisë së ujit apo vendosja e sensorëve për monitorimin apo komandimin elektronik të furnizimit me ujë të banorëve.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të Projektit

Drejtimi i projektit është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet referuar Marrëveshjeve të Financimit të ratifikuara respektivisht me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, dhe Marrëveshjes së Huas të ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015. Gjithashtu drejtimi i projektit është përgjegjës kryesor për ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive në realizimin e objektivave të këtij projekti, duke nisur nga hartimi i rregullave të brendshme, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të kushteve të marrëveshjeve të financimit të projektit, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse realizimi i projektit nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (marrëveshjet e financimit).

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të projektit.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren konstatohet se objektivi i përcaktuar në marrëveshjet midis KFW dhe Qeverisë Shqiptare i cili është furnizimi me uji të pijshëm 24 orë nuk është arritur në të gjitha zonat. Më konkretisht në qytetin e Peshkopisë, fshati Çetush, u konstatua se ky fshat nuk ka furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, konstatim i cili u konfirmua edhe nga banorët e fshatit gjatë verifikimit në terren. Gjithashtu gjatë auditimit të investimit në Depon e ujit të pijshëm në këtë fshat u konstatua se depo ishte e boshatisur dhe furnizimi me ujë të pijshëm për këtë fshat bëhej me orare të kufizuara. Nga verifikimi në terren në datën 18.06.2021 për investimin e kryer në zonën e qytetit Durrës, më konkretisht në fshatin Katundi i Ri ku ndodhen 2 depo uji të pijshëm të cilat furnizojnë me ujë të pijshëm disa fshatra siç janë Katundi i ri, Jubë, Qerret, Katund Sukth dhe Lagje e Mirditoreve, u konstatua se të 2 depot e ujit ishin të boshatisura dhe furnizimi me uji të pijshëm në fshatrat e lartpërmendura kryhet me orare të kufizuara dhe jo 24 ore në ditë siç është e përcaktuar në Marrëveshjen e Huas ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.05.2015, për projektin "Furnizimi me ujë i zonave rurale III", si dhe Manuali Operacional i Projektit, Seksioni 2, pika 2.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 17-19 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrë masa në bashkëpunim me Institucionet Vendore që të evidentojnë mangësitë në sistemet dhe impiantet hidraulike të furnizimit me ujë për zonat përkatëse me qëllim realizimin e furnizimit me ujë pa ndërprerje për këto zona.
1.2. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marri masat që në të ardhmen të angazhohet maksimalisht në rankimin e zonave ku do të investohet për projektet e ngjashme të furnizimit me ujë 24 orë, me qëllim që në ato zona burimet natyrore të ujit në sasi dhe cilësi furnizim të ujit duke pasur parasysh furnizimin me vetërrjedhje, për pasojë uljen e kostos së furnizimit me ujë për banorët.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin 1.1: FSHZH sqaron se "në lidhje me rekomandimet sqarojmë se këto dy skema janë me "Pikë Lidhje" të caktuar nga Ndërmarjet e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Bashkitë përkatëse. Para fillimit të investimit Bashkitë dhe UK-të kanë garantuar që do të japin prurjen e nevojshme për furnizimin e sistemeve 24 orë/ditë. Në të dy rastet, Bashkitë janë pronarë të sistemeve të ujësjellësit dhe të pikës së lidhjes së sistemit të ri. Skemat aktualisht janë në operim nga UK-të përkatëse dhe si të tilla ato në periudhën ku mungojnë sasitë e parashikuara të ujit për furnizim, bëjnë menaxhimin e sistemeve të ujësjellësave me orare. FSHZH si Njësi zbatuese e projektit e ka realizuar detyrimin e tij në zbatim të marrëveshjes me KfW. Kjo është vërtetuar me prurjet sipas projektit të zbatuar gjatë periudhës së garancisë dhe më tej.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin 1.2: Ky rekomandim do te konsiderohet per programet e ujesjellesave ne vijim. Në vijimësi FSHZH do të nxisë NjVV-të për implementimin e rekomandimeve duke i konsideruar ato në punën e saj.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2. Gjetje nga auditimi: Ndryshimi i afateve për realizimin e disbursimeve për marrëveshjet e projektit është dakordësuar midis palëve sipas amendimeve si më poshtë:
- Më datë 28.02.2019, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Huas me nr. 201166370, të ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më 30.06.2021.
- Më datë 27.01.2020, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit me nr. 202061133, të ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më datë 19.02.2022.
- Më datë 29.01.2021, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit me nr. 201470137, të ratifikuar me Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më datë 30.12.2022.
Në zbatim të nenit 3, pika 3.2, të marrëveshjeve të financimit konkretisht, me nr. 202061133, dhe nr. 201470137, afati përfundimtar për kryerjen e disbursimeve është data 30.06.2019. Amendimet për ndryshimin/shtyrjen e disbursimeve është realizuar sipas shkresave të datës 27.01.2020, dhe datës 29.01.2021. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, disbursimet kanë vazhduar edhe pas datës 30.06.2019, në kushtet kur midis palëve nuk është dakordësuar amendim për ndryshimin e afateve për disbursimin e fondeve. Referuar shkresave të sipërpërmendura amendimet janë kryer pas 7 muajve për Marrëveshjen e Financimit me nr. 202061133, dhe pas 19 muajve për marrëveshjen e financimit me nr. 201470137, veprime këto jo sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit të ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, dhe Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, për Projektin "Furnizimi

me ujë i zonave rurale III", pikat 8.5, të secilës marrëveshjeje. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 20-35 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit, në vijim të zbatimit të projektit "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" si dhe për të gjitha projektet të cilat do të menaxhohen nga FSHZH, në të ardhmen të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative për informimin e MFE në cilësinë e përfaqësuesit të Qeverisë Shqiptare për përfundimin e afateve të disbursimeve financiare referuar marrëveshjeve të financimit në kushtet që nga MFE dhe donatorët të kryen amendimet në kohë reale.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: FSHZH sqaron se: "në bazë të komunikimeve verbale, Menaxheri i Projektit ka marrë konfirmim për vazhdim të disbursimit dhe përtej datës së përcaktuar në marrëveshje. Gjatë video konferencave të mbajtura me KfW është theksuar që në asnjë praktikë të disbursimit të fondeve nga Grantet nuk aplikohen sanksione për disbursime jashtë afatit fillestar, kjo është evidente edhe në faktin që KfW ka vijuar me disbursimet edhe pas datës së caktuar në marrëveshjen fillestare. Pas disa komunikimeve, KfW ka dërguar konfirmimin e saj Ministrisë së Financave për shtyrjen e kësaj Marreveshje. FSHZH në çdo rast ka ndjekur proçedurat administrative për informimin e MFE në cilësinë e përfaqësuesit të Qeverisë Shqiptare për përfundimin e afateve të disbursimeve financiare, referuar marrëveshjeve të financimit për të krijuar kushtet përkatëse që nga MFE dhe donatorët të kryhen amendimet në kohë reale. Donatori gjithsesi për arsye të dinamikës së zhvillimit të projektit ka vazhduar me rimbursimet."

Zbatimi i plotë do të verifikohen në auditimet e ardhshme.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

3. Gjetje nga auditimi: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion në lidhje me likuidimin e TVSH-së nga Qeveria Shqiptare, referuar kontratës të datës 26.02.2019, ndërmjet FSHZH-së dhe OE JV "T. E." & "S." me objekt "Ndërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit dhe furnizimin me ujë 24 orë për 15,883 banorë, Lot 1" në vlerën 8,601,883 euro pa TVSH konstatohet se:

Për situacionin e punimeve nr. 6, të kontratës të sipërpërmendur OE ka lëshuar faturën tatimore seria 77032493, nr. 42, datë 29.06.2020, në shumën 795,398 euro me TVSH. Për këtë faturë, TVSH-ja është në shumën 132,566.48 euro konvertuar sipas kursit të Bankës së Shqipërisë (1 euro këmbehet me 124.77 lekë) ose në shumën 16,474,036.47 lekë. Likuidimi i TVSH për këtë faturës është kryer me Urdhër Shpenzimin nr. 108/1, datë 07.07.2020, në shumën 16,747,036 lekë me një diferencë më tepër në shumën 273,000 lekë në favor të OE JV "T. E." & "S.". Kjo problematikë është bërë me dije përfaqësuesve të FSHZH-së më datë 28.06.2021, ku më datë 29.06.2021, janë kryer veprimet rregulluese në Raiffeisen Bankë sipas transaksionit me referencë nr. P210629EUPOP08, datë 29.06.2021, ku OE ka arkëtuar në llogari të FSHZH-së shumën 273,000 lekë. Pavarësisht kthimit të shumës nga OE, në pasqyrat financiare të vitit 2020, regjistrimi i kësaj pagese nuk është kryer në përputhje me vlerën e saktë të faturës tatimore, veprime këto jo sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, Ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 48. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 20-35 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës në pasqyrat financiare të vitit 2021 të kryejë sistemimin e vlerës 273,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me regjistrimin e gabuar të likuidimit të TVSH-së për situacionin e punimeve nr. 6, për kontratën e zbatimit të punimeve Lot 1 të lidhur midis OE JV "T. E." & "S." dhe FSHZH, për Projektin "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" duke u bazuar në Urdhër Shpenzimin nr. 108/1, datë

07.074.2020, referuar sistemimit të trajtimit kontabël dhe funksionimit të llogarive të grupit 23 "Investime në proces", si dhe të bëhen rakordimet me Degën e Thesarit Tiranë.

Deri më datë 31.03.2022

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Pas konstatimit, kontraktori ka kthyer menjëherë shumën e paguar më tepër, pra vlerën prej 273,000 Lekë, kjo e konfirmuar sipas transaksionit me referencë Nr. P210629EUPOP08 nëpërmjet Raiffeisen Bank më datë 29.06.2021.
Gjithashtu në të njëjtën datë ky transaksion është pasqyruar në sistemin kontabel në llogarinë e grupit 23 "Investime ne proces", në kartelën përkatese të furnitorit. Në bazë të Ligjit 9936 datë 26.06.2008, Udhëzimi 14 datë 28.12.2006 si dhe Udhëzimit Nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatijes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave vjetore në njësitë e qeverisjes së pergjithshme".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Bazuar në kontratën e datës 09.11.2015, ndërmjet FSHZH-së dhe OE "P. & P." me objekt "Përgatitjen e projektit dhe studimet e fizibilitetit" në vlerën 663,070 euro pa TVSH, likuidimi i pagesave të rimbursueshme është kryer referuar aplikimit nr. 6, datë 19.06.2017, disbursuar respektivisht në shumën 9,542.64 euro nga KfW-ja Gjermane dhe shumën 153,609 lekë nga Qeveria Shqiptare me Urdhër Shpenzimin nr. 127, datë 04.07.2017, sipas faturës tatimore nr. 12, datë 01.06.2017. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për katër raste si më poshtë:
- Fatura tatimore nr. 119, datë 23.03.2016, në shumën 17,500 lekë me TVSH me objekt "Work Shop akomodim në hotel G. K., marrje salle me qira".
- Fatura tatimore nr. 352, datë 25.03.2016, në shumën 33,600 lekë me TVSH me objekt "Shërbim aktiviteti dhe shërbim kafeje Shkodër".
- Fatura tatimore nr. 141, datë 18.03.2016, në shumën 18,000 lekë me TVSH me objekt "Work Shop akomodim në H. G. T.".
- Fatura tatimore nr. 19, datë 29.03.2016, në shumën 17,000 lekë me TVSH me objekt "Shërbim kateringu në E.M. V.".
Bashkëlidhur likuidimit të pagesave me objekt "Workshop, akomodim në hotel, shërbime kateringu", nuk ndodhet dokumentacioni i plotë shoqërues si, lista e nënshkruar nga personat të cilët kanë qenë pjesëmarrës në këto aktivitete, veprime këto jo sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 20-35 të Raportit të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës dhe Menaxheri i Projektit, të marrin masa të menjëhershme për plotësimin me përgjegjësi të dokumentacionit shoqërues për këtë praktikë dhe për të gjitha praktikat e tjera në vazhdim në zbatim të kuadrit rregullator ligjor në fuqi.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: FSHZH sqaron se çdo kërkesë për pagese që paraqitet në Departamentin e Financës është fillimisht e konfirmuar nga Menaxheri i kontratës dhe Menaxheri i Projektit në bazë të faturave mbështetëse si dhe relacionit mbi miratimin e pagesave në përputhshmeri me kushtet dhe klauzolat e kontrates duke siguruar mos tejkalimin e zërave buxhetorë të kontratës.
Lidhur me pagesat e rimbursueshme për pjesëmarrjet në workshop/aktivitet nga konsulenti i kontraktuar i cili është dhe organizator i këtyre aktiviteteve janë miratuar nga PM i gjithë dokumentacioni mbështetës (fatura sipas aktivitetit, detajuar në përshkrim për çdo shërbim të ofruar).
Numri i pjesmarresve dhe aktiviteteve dhe workshop-eve të organizuara është miratuar paraprakisht nga PM dhe nga donatori, në respektim të kushteve të përcaktuara në Termat e referencës, Aneksi A, pika 2.2, faqja 21. Praktika e pagesave të rimbursueshme ka pasur çdo

faturë te rregullt për çdo shpenzim të kryer. Pagesat e kryera do të auditohen në auditimet e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

5. Gjetje nga auditimi: Duke u bazuar në angazhimet e përcaktuara në Marrëveshjet e Financimit sipas donatorëve, Manualit Operacional të Projektit dhe Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit në lidhje me financimin në formën e Kontributit Lokal nga NJVV të cilat janë përfituese nga Projekti drejt FSHZH-së për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.06.2021, sipas rastit është arkëtuar Kontribut Lokal në shumën totale 308,963,708 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se nëntë NJVV nuk kanë shlyer ende detyrimin në shumën 89,425,931 lekë për Kontributin Lokal në llogari të FSHZH-së *(shiko listën në tabelën nr. 9, pikën nr. 3, të Raportit të Auditimit)*. Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos respektimit të afatit për derdhjen e detyrimeve referuar Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit të lidhur me NJVV respektive neni 3, pikat 3.1, 3.2, dhe 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 20-35 të Raportit të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrin të gjitha masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët procedurale dhe administrative për mbledhjen e detyrimeve/Kontributin Lokal në shumën 89,425,931 lekë nga NJVV përfituese të projektit të cilat janë debitorë ndaj FSHZH-së, në zbatim të përcaktimeve të Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Në zbatim të Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit të lidhur me NJVV respektive neni 3, pikat 3. 1 , 3.2, dhe 3.3, FSHZH vazhdimisht ka iniciiuar dhe këmbëngulur në kërkesën për të arkëtuar kontributin lokal nga NJVV-të përfituese të ujësjellësve. Korrespondeca me bashkitë përfituese është vënë në dispozicion të grupit të auditimit. Bashkëlidhur materiali "Rikujtesë për pagesën e pjesës së mbetur të kontributit lokal për skemat e ujësjellësave për Bashkitë-Devoll, Prrenjas, Ura Vajgurore, Klos, Tropojë, Dibër, Mat, si dhe shkresa drejtuar Ministres së Financave dhe Ekonomisë zj.D. I. për ndërhyrje për shpejtimin e kësaj proçedure.
Procedurat vazhdojnë me shkresat:

- Shkresë me nr.1779 prot., datë 21/06/2022, me Lëndë: Mbi detyrimet e prapambetura të 6 Bashkive për kontributin lokal të skemave të ujësjellësave, në kuadër të "Programit të Ujësjellësave Ruralë III", drejtuar Zj. D. I., Ministre e Financave dhe Ekonomisë, për dijeni Z.A. A., Zëvendëskryeministër & Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Kryetar i Këshillit Drejtues të FSHZH-së.
- Shkresë me nr.1821 prot., datë 22/06/2022, me Lëndë: Mbi detyrimin e prapambetur të kontributit lokal për skemat e ujësjellësave në kuadër të "Programit të Ujësjellësave Ruralë III", drejtuar z. N. B., Kryetar i Bashkisë Prenjas, për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Shkresë me nr.1822 prot., datë 22/06/2022, me Lëndë: Mbi detyrimin e prapambetur të kontributit lokal për skemat e ujësjellësave në kuadër të "Programit të Ujësjellësave Ruralë III", drejtuar z. R. B., Kryetar i Bashkisë Tropojë, për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Shkresë me nr.1823 prot., datë 22/06/2022, me Lëndë: Mbi detyrimin e prapambetur të kontributit lokal për skemat e ujësjellësave në kuadër të "Programit të Ujësjellësave Ruralë III", drejtuar z. I. H., Kryetar i Bashkisë Klos, për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Shkresë me nr.1824 prot., datë 22/06/2022, me Lëndë: Mbi detyrimin e prapambetur të kontributit lokal për skemat e ujësjellësave në kuadër të "Programit të Ujësjellësave Ruralë

III", drejtuar z. A. M., Kryetar i Bashkisë Mat, për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

- Shkresë me nr.1825 prot., datë 22/06/2022, me Lëndë: Mbi detyrimin e prapambetur të kontributit lokal për skemat e ujësjellësave në kuadër të "Programit të Ujësjellësave Ruralë III", drejtuar z. R. S., Kryetar i Bashkisë Dibër, për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Shkresë me nr.1826 prot., datë 22/06/2022, me Lëndë: Mbi detyrimin e prapambetur të kontributit lokal për skemat e ujësjellësave në kuadër të "Programit të Ujësjellësave Ruralë III", drejtuar zj.J. M., Kryetare e Bashkisë Dimal, për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Raportimet për realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.05.2021, janë dorëzuar në MFE-së, ku në përgjithësi janë kryer mbi bazën e dispozitave ligjore përkatëse por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, në 11 raste konkretisht për muajin shkurt, maj, qershor, dhjetor 2016, janar, shkurt, qershor, dhjetor 2017, dhjetor 2018, dhjetor 2019, dhjetor 2020, nga FSHZH nuk janë respektuar afatet mbi raportimin e realizimit të disbursimeve në MFE-së sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003, "Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj", pika 5.5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 20-35 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës të marrë masa që të raportojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizimin e disbursimeve financiare dhe shpenzimeve të Projektit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator ligjor përkatës.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Raportimi mujor është kryer në përputhje me Udhëzimin Nr. 8, datë 17.02.2003, të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "Për evidentimin, rregjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donator të huaj".

Ky Udhezim përcakton se raportimi mujor duhet të dorëzohet cdo muaj brënda datës 5 të muajit pasardhës, ndërsa për dorëzimin e raportit përfundimtar afati është brenda datës 15 Janar të vitit pasardhës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit pranë Ministrisë së Financave.

Do të verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të projektit "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" u konstatuar se, dosjet e prokurimit nuk ishin te inventarizuara dhe arkivuara, gjithashtu shumë prej shkresave, kontratave amendamenteve rezultuan të pa protokolluara, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 36-44 të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa për protokollimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të zhvilluara për këtë Projekt në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Përsa i përket dosjeve teknike të zbatimit, ato janë protokolluar dhe dorëzuar Bashkive përkatëse. U vendosën në dispozicion shkresat e përcjelljes

së dokumentacionit për Bashkitë Prrenjas, Korçë, Kolos, Dibër, Lezhë, Tropojë, Mat, Tiranë dhe Durrës por jo për inventarizimin e dosjeve të prokurimit,
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për projektin "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" nuk është hartuar një Plan Prokurimi, veprime këto në kundërshtim me Kapitullin 9, nënpika 9.1, Fazat e procesit të prokurimit të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 36-44 të Raportit të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, strukturat përkatëse të prokurimit sipas rastit, të marrin masa që në të ardhmen përpara kryerjes së procedurave të prokurimit për realizimin e projekteve të miratuara më parë, të planifikojnë dhe dokumentojnë prokurimet që do të kryhen në fazën e parashikimit në konformitet me ligjet, rregullat dhe manualet në fuqi.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: FSHZH sqaron se për mungesën e planit të prokurimit, ju sqarojmë se referuar Marrëveshjes së Huasë, KfW nuk parashikon hartimin e plan prokurimit, ashtu siç e kërkojnë donatorë të tjerë.
Nëse plani i prokurimit do të ishte kërkese ligjore, atëherë ne do kishim detyrimin ta drA.nim, dhe ta dërgonim për NO tek donatori, per të avancuar me hapat tjerë. Por fakti që nuk kërkohet, FSHZH në bashkëpunim me donatorin ka avancuar më tej. Nuk mund të kryejmë procedura dhe të prodhojmë dokumente të cilat nuk kërkohen nga donatori (KfW në rastin konkret).
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurat e realizimit të projekteve që në fazën e studimit të fizibilitetit, referuar edhe skeduleve apo manualeve për zbatim të projekteve të miratuara nga donatori, u konstatua se angazhimi i strukturave përkatëse të FSHZH në projektin "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" ka qenë i pjesshëm dhe megjithatë në këto raste është shoqëruar nga mungesa e gjurmës së auditimit, veprime këto në kundërshtim me Appendix 2, RWSP IMPLEMENTATION FRAMEWORK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 36-44 të Raportit të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Drejtoria Juridike, Drejtoria Teknike, të marrin masa që në të ardhmen të angazhohen në çdo projekt në konformitet me manualet dhe rregulloret në fuqi me qëllim përmirësimin e cilësisë së ekzekutimit të projekteve si nga ana ligjore por edhe nga ana teknike duke pasur parasysh lënien e gjurmës së auditimit.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: FSHZH sqaron se se proçedurat e përzgjedhjes së skemave, hartimit të fizibiliteteve dhe projekteve të zbatimit janë ndjekur sipas parashikimeve në marrëveshjen për implementimin e programit dhe inputi i FSHZH është në përputhje me Marrëveshjen.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, shumë prej zërave të listuara në listën e punimeve të vogla të pakryera (Snagging List) që shoqëron certifikatën e marrjes në dorëzim, nga krahasimi i bërë me verifikimin në terren të grupit të auditimit rezultuan ende të pakryera dhe nga ana e FSHZH nuk është marrë asnjë masë për të nisur një rinspektim për të verifikuar gjendjen sipas afatit të përcaktuar në të më 10.06.2021, veprime këto në kundërshtim me Kontratën No. RWSP-WC-ICB-2018-4 lidhur midis Fondit Shqiptar te Zhvillimit dhe BOE ANK shpk & A. Group OJSC me 18.04.2019 me objekt "Ndërtim/Rikonstruksion i

Ujësjellsave ne zonat rurale LOT 4". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-49 të Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësisë së menaxhimit të Projektit të marrë masat për të kryer inspektimin për verifikimin e gjendjes dhe të adresohen shkaqet e përgjegjësitë e punimeve të mbetura ende pa kryer si dhe adresohen mënyrat e përfundimit të tyre referuar kontratës.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion raporte kontrolli në terren në prill 2022, janar 2022, tetor 2021, shtator 2021, gusht 2021, qershor 2021, në lidhje me gjetjet dhe riparimet e difekteve. Gjithashtu nga ana e FSHZH, është realizuar dorëzimi përfundimtar i skemave të ujësjellsave për Bashkitë. U vendosën në dispozicion Çertifikatat përfundimtare të marrjes në dorëzim nga Bashkitë përkatëse.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për projektin "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" u konstatua se, rrethimet e depove të ujit nuk ishin të sigurta nga ndërhyrjet e kafshëve (zvarranikëve) duke rritur riskun për ndotje të depove të ujit. Gjithashtu nuk kishte asnjë pajisje monitorimi të ambienteve të ujit të pijshëm, veprim ky në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes dhe VKM nr. 379, datë 25.05.2016, Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm", neni 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-49 të Raportit të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projekteve në të ardhmen, të marrin masa që të angazhohen seriozisht që në fazën e hartimit të projektit me qëllim propozimet përkatëse për përfshirjen në projekte specifike që kanë ndikim në jetën apo sigurinë e jetës së njeriut, të elementeve të sigurisë për sigurimin e garancisë së shëndetit publik në radhë të parë në konformitet me ligjet, rregullat apo marrëveshjet e miratuara nga palët.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: Rekomandimi është konsideruar për objektet që do të jenë pjesë e programeve të ujësjellësave në të ardhmen.
Siç jeni në dijeni, këto dy zëra punimesh nuk kanë qenë pjesë e preventivit të zbatimit dhe për më tepër rekomandimi është bërë në një periudhë ku fondet e programit ishin të ezauruara.
Në këto kushte kemi komunikuar me Bashkitë dhe UK-të, që kanë qenë pjesë programit RWSP III dhe u kemi kërkuar që të financojnë dy zërat e rekomanduara nga ana juaj.
Vetëm në UK Tiranë është bërë vendosja e kamerave.
Bashkëlidhur foto me vendosjen e kamerave të sigurisë dhe rrjetës rretuese.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

12. Gjetje nga auditimi: Për realizimin e skemave të furnizimit me ujë, ndërmjet FSHZH-së dhe operatorëve ekonomikë janë nënshkruar katër kontrata punimesh për secilin Lot. Deri në momentin e auditimit kanë përfunduar Lotet 1, 2 dhe 4, ku aktualisht janë në periudhë garancie, përsa i përket Lotit 3 është në proces punimesh. Në zbatim të angazhimeve të kontratave të punimeve, për lotet që kanë përfunduar punimet nga supervizori janë lëshuar certifikatat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve, marrë këto në dorëzim nga NJVV sipas rastit dhe skemave përkatëse. Për kalimin veprave të marra në dorëzim si aset në pronësi të NJVV, ndërmjet palëve janë nënshkruar marrëveshjet përfundimtare të investimit me çdo njësi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, pas përfundimit të punimeve dhe marrjes në veprave në dorëzim bazuar në certifikatat përkatëse nga NJVV përfituese ende nuk ka nisur procesi i regjistrimit si aset në pronësi të tyre, siç parashikohet në marrëveshjet përfundimtare të investimit të datës 17.09.2018, datë 11.10.2018, dhe datës 23.01.2019, nënshkruar ndërmjet

FSHZH-së dhe NJVV respektive, neni 2, pika 2.12, neni 3, pika 3.4, dhe pika 3.5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 50-56 të Raportit të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projekteve, të merren të gjitha masat administrative të nevojshme për Projektin "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" dhe për Projektet në vazhdim që gjatë procesit të transferimit kapital të investimeve, të kërkohet nisja e menjëhershme e regjistrimit të aseteve në llogari të përfituesve të këtyre investimeve konform akteve ligjore dhe rregullave ne fuqi.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: FSHZH ka dërguar me shkresë përcjellëse dosjen e plotë pranë Bashkive përkatëse.

U venndosën në dispozicion shkresat,për Lotin 1, 2 dhe 4, për Bashkitë Prrenjas, Korçë, Klos, Dibër, Lezhë, Tropojë, Mat, Tiranë dhe Durrës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të përcaktimeve të marrëveshjes së funksionimit të mirëmbajtjes NJVV përfituese nga Projekti përgjatë vitit të parë të vënies në funksionin të ujësjellësit, duhet të raportojnë çdo tre muaj pranë FSHZH-në një raport ku të pasqyrohet mënyra si do të kryhet funksionim mirëmbajtja e skemave konkretisht, mjetet financiare, pajisjet, personeli dhe metodologjia. Këtë kriter e plotëson Lot 1 dhe Lot 2 të cilat përfshijnë UK Korçë, Përrenjas, Devoll, Dibër, Klos, Mat, Tropojë dhe Lezhë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, ky raportim është kryer vetëm për një tremujor nga UK Devoll. Dibër dhe Tropojë sipas shkresave:

- Me shkresën nr. 62 prot., datë 25.03.2021, të OE "A. G." dërguar pranë FSHZH-së Raportin Mujor të Monitorimit nga Ujësjellës Kanalizime Devoll.
- Me shkresën nr. 63 prot., datë 26.03.2021, të OE "A. G." dërguar pranë FSHZH-së Raportin Mujor të Monitorimit nga Ujësjellës Kanalizime Dibër.
- Me shkresën nr. 64 prot., datë 26.03.2021, të OE "A. G." dërguar pranë FSHZH-së lidhur me Raportin Mujor të Monitorimit nga Ujësjellës Kanalizime Tropojë.

Ndërkohë që, nga Ujësjellës Kanalizimet e tjerë pjesë e Lotit 1 dhe 2, nuk kanë përmbushur detyrimet për raportimin çdo tre muaj drejt FSHZH-së në zbatim të references pikës 4.2, të Marrëveshje Funksionim Mirëmbajtje me NJVV. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 50-56 të Raportit të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit të FSHZH-së të marrë të gjitha masat administrative ku t'u kërkojë ujësjellësve përfitues nga Projekti referuar Lotit 1 dhe 2, raportet e monitorimit për funksionimin dhe mirëmbajtjen e skemave të ujësjellësve në zbatim të përcaktimeve ligjore në marrëveshjet e funksionim mirëmbajtjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin: FSHZH sqaron **se** raportimet gjatë vitit të kaluar nuk kanë ardhur me shkresë përcjellëse siç po vijohet këtë vit, por me poste elektronike në versionin excel. Ky rekomandim është detyrim që është zbatuar rregullisht nga FSHZH me përfundimin e garancisë së difekteve, meqenëse është pjesë e qenësishme e punës së organizatës. Donatori në asnjë rast nuk ka ngritur shqetësime për zbatimin e këtij detyrimi nga FSHZH.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

PROJEKTI "ZHVILLIMI I INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMI"

A. MASA ORGANIZATIVE

1. **Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e Njësisë së Zbatimit të Projektit nuk janë kryer raportimet periodike në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjis dhe mbledhje e Komitetit Drejtues të Projektit, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e marrëveshjes Ligiin nr. 19/2017 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes Së Huasë Ndërmjet Republikës Së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare per Rindëflim dhe Zhvillim per Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmit" (Trajtuar më hollësisht në faqet 9-17 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

1.1. **Rekomandimi:** Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa per përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e përcaktimeve të parashikuara në marveshje per sa i përket raportimeve kjo në frymën e mirmenaxhimit dhe mbarëvajtjes së projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin

FSHZH sqaron se në kuadër të projektit PZHIUT, FSHZH është në rolin e agjensisë zbatuese të projektit, duke siguruar që planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve të investimeve të projektit të bëhen në përputhje me marrëveshjen e huasë. Ndërkohë, në lidhje me raportimet për Komitetin Drejtues, FSHZH është pjesë përbërëse e Komitetit Drejtues, ndërkohë që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet Njësisë së Koordinimit të Projektit "PCU" është përgjegjëse për mbikëqyrjen e përgjithshme të projektit dhe sipas Manualit Operacional, do të sigurojë udhëheqje teknike dhe koordinim me partnerët e projektit si dhe do të shërbejë si sekretariat i mbledhjeve të Komitetit Drejtues, duke siguruar raportimet dhe takime periodike të Komitetit Drejtues të Projektit, me pjesëmarrjen e partnerëve kryesorë të projektit.

Në takimin e parë të Komitetit Drejtues të Projektit të mbajtur më 11.06.2018, FSHZH nuk ka qenë prezent për të raportuarr në mbledhje, por duke filluar nga thirrja për takimin e dytë e mbajtur më 11.09.2019, FSHZH është siguruar të jetë prezent dhe pjesëmarrëse në mbledhjen e mbajtur, ka raportuar sa herë është kërkuar nga Njësia e Koordinimit të Projektit mbi mbarëvajtjen e projektit të PZHIUT, dhe duke marrë shkas nga problematika në fjalë, është angazhuar për përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e përcaktimeve të parashikuara në marrëveshje për sa i përket raportimeve.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

2. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se enti zbatues i projektit (FSHZH) nuk ka respektuar frekuencën e auditimeve te parashikuara ne "Ligjin nr.19/2017 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes Së Huasë Ndërmjet Republikës Së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit per Zhvillimin e Integruar Urban dhe te Turizmit" (Trajtuar me hollësisht në faqet 9-17 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

2.1. **Rekomandimi:** Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa që te përgatisë, dhe t'i dorëzojë Bankës jo me vonë se 45 ditë pas mbarimit te tremujori kalendarik, raporte te ndërmjetme financiare të paaudituara për Projektin që përmbledhin tremujorin, ne forme dhe me përmbajtje te pranueshme per Bankën", për ecurinë e këtij projekti i cili ka rëndësi te veçantë per turizmin ne zonat ku aplikohet.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm

FSHZH sqaron se gjatë periudhës 04.05.2020 deri 30.06.2020 që KLSH ka qenë në FSHZH për auditim, Departamenti i Financës në FSHZH, ka vënë në dispozicion, të gjitha raportet 3 mujore të dërguara në BB sipas periudhave respektive brenda afateve dhe standarteve të kërkuara. Raportet u vendosën në dispozicion grupit të auditimit për zbatimin e rekomandimeve.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

3. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i realizimit te objektivave dhe komponentëve të projektit u konstatua se: realizmi i projektit sipas zërave te marrëveshjes paraqitet ne nivelet e 26% praktikisht shumë të ulëta krahasuar me afatin e përfundimit të projektit i cili ka kaluar 3/4 e tij. Edhe pse në këto kushte nisur nga zgiatjet dhe kalimi i më shumë se 3/4 e kohës së projektit ecuria e tij është në nivelet e 26% tregues i mos përfundimit ne afat, kjo e mbështetur dhe në realizmin e kostove operative që paraqiten në nivelet e 75%. E gjithë kjo situatë krijon mundësine per rritjen e kostove operative te tij nisur nga ecuria e dobët ne kategoritë e tjera te financuara (Trajtuar më hollësisht në faqet 17-20 të Raportit Përfimdimtarë të Auditimit).

3.1. **Rekomandimi:** Njësia e menaxhimit te projekti, Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrin masat per përfundimin sa me shpejt te fazës së projektimit me qëllim respektimin e afateve dhe realizimin e procedurave për pune civile ne cilësi dhe afat, si dhe monitorimin dhe ndjekjen në vijimësi të qdo kontrate në proces për shmangien e pengesave dhe tejkalimit të afateve.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm

Në përgjigje të rekomandimit nga Auditimi, FSHZH ka vendosur si prioritet përfundimin sa më shpejt të fazës së projektimit me qëllim respektimin e afateve dhe realizimin e procedurave për punët civile në cilësi dhe afat, gjithashtu monitorimin dhe ndjekjen në vijimësi të çdo kontrate në process. Duhet mbajtur ne konsiderate se:

- Projekti PZHIUT, për shkak të shpërndarjes në disa fusha (Kulturë, Turizëm, Infrastrukturë) dhe për shkak të natyrës së projekteve që janë "Participatory Planning" kërkon koordinim të cdo faze, jo vetëm me Qeverite Lokale, por edhe me Ministritë dhe palët e tjera të interesit.
- Kontratat e konsulencës, pavarësisht kërkesës që i është bërë Bankës Botërore, nuk lejojnë mbajtjen e penaliteteve për vonesat apo performancë, gjë që ka ndikuar gjithashtu në vonesa në dorëzimin e projekteve.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

4. **Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi u konstatua se Enti i zbatimit te projektit nuk ka krijuar te plotë njësinë e menaxhimit të projektit, pra me 11 punonjës, kjo sipas specifikave te miratuara në "Ligiin nr.19/2()17 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes Së Huasë Ndërmjet Republikës Së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare per Rindërtim dhe Zhvillim per Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe te Turizmit" shojca 2 pika 2, si dhe organigramat e funksionimit të projektit te konfirmuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energiisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Banka Botërore, si më poshtë: menaxher projekti, një arkitekt, një inxhinier, një specialist për administrimin financiar , një specialist prokurimi, një specialist per angazhimin qytetar, një specialist mjedisi dhe një specialist per problemet sociale (Trajtuar më hollësisht në faqet 9-17 të Raportit Përfundimtarë te Auditimit).

4.1. **Rekomandimi:** Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa në krijimin e strukturës së plotë te njësisë së projektit, me qëllim implementimin në kohë dhe cilësi të këtij projektit si dhe për realizimin e objektivave dhe shmangien e shtyrjes së afatit për arritjen e efiçencës së parashikuar.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm

Me Vendimin nr. 122, datë 06.05.2022 "Krijimi i njësisë së menaxhimit të projektit/programit "Për zhvillimin urban dhe turizimit"" është krijuar njësia e menaxhimit të prjektit dhe përgjegjësi i njësisë.

Me Vendimin nr. 122/1, datë 16.05.2022 "Caktimi në pozicion pune pranë Njësisë së menaxhimit të projektit/programit "Për zhvillimin urban dhe turizimit"" është krijuar njësia e menaxhimit të prjektit dhe përgjegjësi i njësisë.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar

5. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i planit të prokurimeve u konstatua se në te nuk janë reflektuar ndryshimet dhe nuk është njoftuar banka per informim ecurinë e projekti siç parashikohet ne "Ligjin nr.19/2017 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare per Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe te Turizmit" shtojca II seksioni III pika 2, Udhëzuesi i Bankës Botërore pika 1.25 (Trajtuar më hollësisht në faqet 29-39 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

5.1. **Rekomandimi:** Njësia menaxhuese e projektit, ne të ardhmen të pasqyrojë ecurinë e secilit projekt në zbatim e sipër si dhe te reflektojë ndryshimet e mundshme të projekteve të tjera për pasqyrimin sa me korrekt të situatës dhe fazës në të cilën ndodhet ky projekt.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm

Pika 3 – Proçedura e Prokurimit per projektim dhe supervizim i kontrates se konsulences per rehabilitimin e qytetit te Gjirokastres.

Menjëherë pas amendimit, Drejtori Ekzekutiv, nisur nga performanca e dobët e Konsulentit, nuk ka ndërprerë Kontratën, por referuar Nenit 18 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, “Pezullimi”, kontraktorit i është komunikuar Pezullimi i Kontratës, jo ndërprerja, ku qartësisht i referohet se duhet të përmirësojë cilësinë e produktit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e njoftimit te pezullimit.

Duke qenë se edhe pas lëshimit të njoftimit për pezullim, në vazhdimësi Kontraktori ka vazhduar me performancën e dobët, me datë 23.08.2019, pas negociatave është dakortësuar ndërprerja e kontratës.

Pika III D 1 – Mos reflektim i ndryshimeve ne planin e prokurimit.

Njesia e Menaxhimitr te Projektit do te pasqyroje me kujdes ecurine e projektit dhe do te reflektoje ndryshimet e duhura ne kohe reale per nje pasqyrim sa me te sakte te situates dhe ecurise se projektit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

6. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i IPC u konstatua se ne 6 raste të shpërndara në dy kontrata hartimi i situacionit pjesor nga Kontraktori, miratuar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës si dhe mbajtja e garancisë së punimeve prej 10% të situacionit pa TVSH nga departamenti i financës është kryer në shkelje të kushteve të përgjithshme të kontratës pika 50.1 "Garancia bankare 10 % e çmimit të kontratës" i cili është me TVSH, situatë e sistemuar në IPC e fundit (Trajtuar më hollësisht në faqet 20-29 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

6.1. **Rekomandimi:** Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), Menaxherët e kontratave dhe Departamenti Ekonomik në çdo rast të verifikoj detyrimin per pagesë duke respektuar kushtet e kontratës dhe mirmenaxhuar fondet në dispozicion.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm

FSHZH dhe Menaxherët e kontratave kanë verifikuar në çdo rast detyrimin per pagesë, duke theksuar dhe situaten e sistemuar ne IPC e fundit e cila eshte me TVSH, ne perputhje te plote me kushtet e kontratës. Nga dokumentaioni i vendosur në dispozicion me Kërkesën për pagesë datë 26.01.2021 është mbajtur vlera e TVSH.

Zbatimi të rekomandimit: Në proces

7. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave dhe disbursimeve në zbatim të marrëveshjes u konstatua se për të gjithë vlerën e padisbursuar për huamarrësin për çdo vit aplikohet tarifa e angazhimit e barabartë me një të katërtën e një përqind (0.25%) në vit të shumës së pa tërhequr. Nga aplikimi i tarifës së angazhimit dhe disbursimet në nivele kaq të ulëta huamanësi detyrohet të paguaj një shumë të përafërt me 519,689 euro nese kjo do aplikohej nga huadhënësi.

Disbursimi në nivele të ulëta e ekspozon huamarrësin për pagesat të tarifave të angazhimit tejet të larta krahasuar me ato që mund të aplikohen nëse kemi një ecuri normale të disbursimeve, veprim ky në kundërshtim me "Ligjin nr. 19/2017 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare per Rindërtim dhe Zhvillim per Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmit" neni II pika 2.04. (Trajtuar më hollësisht nëf aqet 20-29 të Raportit Përfundimtarë te Auditimit).

7.1. **Rekomandimi:** Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa të menjëhershme per ecurinë në fazat e projektimit dhe zbatimit të projektit ne përfundimin e procedurave të prokurimit dhe realizimin e punimeve të ndërtimit me qëllim respektimin e afateve dhe kosatove të miratuara.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm

Në përgjigje të rekomandimit nga Auditimi, FSHZH është angazhuar dhe ka vendosur si prioritet përfundimin sa më shpejt të fazës së projektimit dhe zbatimit të projektit, me qëllim respektimin e afateve. Sidoqofte, sic theksohet dhe në pikën 3, duhet mbajtur në konsideratë se:

- Projekti PZHIUT, për shkak të shpërndarjes në disa fusha (Kulturë, Turizëm, Infrastrukturë) dhe për shkak të natyrës së projekteve që janë "Participatory Planning" kërkon koordinim të cdo faze, jo vetëm me Qeveritë Lokale, por edhe me Ministritë dhe palët e tjera të interesit, gjë që ka rritur cilësinë e produktit final, por sjell vonesa të theksuara në koordinim.
- Kontratat e konsulencës, pavarësisht kërkesës që i është bërë Bankës Botërore, nuk lejojnë mbajtjen e penaliteteve për vonesat apo performancë, gjë që ka ndikuar gjithashtu në vonesa në dorëzimin e projekteve.
- *Probleme të lidhura me procesin e shpronësimeve*

Procedurat e shpronësimeve për kontratat e implemenetuara në kuadër të "Projektit të Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turistik" kanë sjellë vonesa të dukshme në shtrirjen kohore të tij.", psh. "Rindërtim i rrugës automobilistike Muzak Topia për në kalanë e Beratit" e cila është një nga kontratat që ka sjellë vonesa (gati dy vjecare) në implementimin e projektit, për shkak të mos finalizimit të procedures së shpronësimeve. Duke qenë së këto kontrata janë pjesë e PZHIUT, procesi i shpronësimeve dhe i kompensimit duhet të zhvillohet nga MIE sipas procedurave të donatorit, Bankës Botërore, dhe jo të Shtetit Shqiptar. Për këtë arsye kanë nisur procedurat për përshtatjen e tij dhe mundësimin e zbatimit të procedurave të Bankës Botërore duke sjellë edhe shtyrje të afatit kohor për implementimin e punimeve

- **Vonesa të lidhura me procesin e lejeve të ndërtimit**

Në rastin e projektit të "Rehablitimit të Shëtitores Naim Frashëri në Sarandë", kontrata është lidhur në datë 16 Shtator 2019, ndërsa zbardhja e lejes së ndërtimit nga ana e insitutcioneve përkatëse është dhënë në datë 4 Mars 2020 duke sjellë vonesë dhe shtyrje të afatit në kohë të implementimit dhe të përfundimit të punimeve. Per kete arsye jemi ne diskutime konstante me Bashkite dhe Institucionet perkatese per pershpejtimin e afateve te lejeve.

- *Vonesa të lidhura me procedurat e "safeguards" të donatorit*

Lidhur me problematiken e vonesave nga procedurat e Bankës Botërore, është edhe kompleksiteti i procedurave të Safeguards të donatorit, pasi si rrjedhoje e ankesave të banorëve, projektet ndërpriten dhe shtyhen në kohë, duke sjellë vonesë të përgjithshme në projekt.

Gjithashtu, vonesa të konsiderueshme kanë sjellë edhe nën-projektet e komponentit 2, si "Projekti për zhvillimin e Sitit Turistik të Syrit të Kalter" "Siti Turistik" apo "Siti Turistik I Orikut", për të cilet janë investuar muaj të tera kohë duke bërë pergatitjet e safeguard screening, Termave të References, koordinimet me institucionet përkatëse etj. nderkohë që për shkak të Safeguards, Banka Botërore ka vendosur që ti heqë nga lista e investimeve.

- *Vonesa të lidhura me lejimin e aksesit në objekt, dhe mos-koordinim midis institucioneve.*

Rasti i projektit te qytetit të vjeter të Orikut. Arsyet kryesore për shtyrjen në kohë të ketij projekti kanë qenë diskuktimet me ministrite dhe mbi të gjitha me Ministrine e Mbrojtjes dhe të Kultures, persa I perket aksesit në këtë objekt, duke qenë së aksesi i vetem ndodhet brenda zones ushtarake të Bazes detare të Pash Alimanit. Ministria e Kultures me Ministrine e Mbrojtjes u angazhuan të gjenin një zgjidhje të pranueshme lidhur me aksesin e sitit turistik të Orikut por pa rezultat. Këto probleme, të lidhura me aksesin, kanë sjellë edhe vonesa të tjera, si rrjedhim i diskutimeve, marreveshjeve dhe marrjes së vendimit nga ana e donatorit. Pavarsisht se FSHZH ka investuar muaj të tera kohë duke bërë pergatitjet e safeguard screening, Termave të References, koordinimet me institucionet përkatëse etj. për shkak të mos-koordinimit midis institucioneve dhe mungeses se aksesit, Banka Botërore vendosi që ta heqë nga lista e investimeve këtë projekt dhe u shpenzuan disa muaj ne vijim per te ri-filluar pergatitjet per safeguard screening, Termave të References, koordinimet me institucionet përkatëse per sitet e reja te perzgjedhura .
Vonesat nuk kanë ardhur vetem për shkak të arsyeve të larte permendura të cilat kanë lidhje me procedurat e donatorit, me performancën e kontraktoreve ose me ndryshimin e fokusit të Qeverise Shqiptar, por edhe me aryse të tjera të cilat kanë ndodhur dhe janë jashte kontrollit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Këto arsye janë:

- Termeti i Nentorit, i cili uli vëmendjen e burimeve njerëzore
- Pandemia Covid-19, e cila uli angazhimin, kohën e punës jo vetem të stafit dhe institucioneve, por edhe të kontraktoreve, pasi rregullat e vendosura gjatë pandemisë kanë kufizuar ndjeshem oraret e punës dhe të levizjes.

Nga FSHZH u vendosën në dispozicion komunikime të ndryshme me institucionet përfituese.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

8. **Gjetje nga auditimi:** *Nga auditimi i zbatimit te kontratës së konsulentit "Projektim dhe supervrzim i kontratës se konsulencës Rehabilitimi i qytetit të Gjirokastrës" u konstatua se kjo kontratë ka dështuar por njoftimi për prishje kontrate është kryer pas 8 muajsh dhe prishja e kontratës pas 10 muajsh, duke sjellë vonesa ne realizimin e procedurës projektim dhe supervizim. Mos realizimi i kësaj kontrate ka sjellë dhe shtyrjen e afateve në zbatimin e projekteve që do miratohen. Veprime këto në kundërshtim me Termat e Referencës (TOR) pika 62 Plani i punës, ku për detyrën 1 konsulenti ka 1 muaj afat për përgatitjen e saj së bashku me komentet dhe miratimin, pika 14 përfundimi i kontratës nënpika 14.1 ku i referohet kushteve të përgiithshme pika 19.1.1 kontrata mund të ndërpritet nëse konsulenti dështon në kryerjen e detyrave të tij. Sipas pikës 18 të GCC kushteve të përgjithshme kontraktori duhet të njoftoj me shkrim konsulentin dhe ti japë 1 muaj kohë per riparimin e problemeve te krijuara (Trajtuar më hollësisht në faqet 29-39 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*
8.1. **Rekomandim:** Drejtori i projektit në te ardhmen te informoj per situata te ngjashme huadhënësin per dhënien e një zgjidhje sa me të shpejt ne kohë me qëllim eleminimin e vonesave te tjera.

Në vijimësi

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm
PM i kontratës ka informuar Bankën Botërore lidhur me problematikën e saj. Gjithashtu, koha që i është dhënë konsuletit për të përmirësuar produktin e tij është bërë duke u konsultuar me ekspertizën më të mirë të Bankës Botërore.
Kontrata e firmosur, është Kontratë tip konsulence e Bankës Botërore, e bazuar në udhëzimet përkatëse. Draft nuk parashikon në asnjë moment penalitete në vlerë monetare, të cilat do të shfrytëzoheshin nga ana e FSHZH-së si masë shtrënguese për detyrimin e konsulentit për kryerjen e shërbimit. Gjithashtu kjo lloj kontrate e Bankës Botërore nuk njeh Sigurim Kontrate, që do ishte një instrument më tepër për menaxhimin sa me efikas të kontratës.

Në mungesë të masave të tjera shtrënguese, elementi i vetëm dhe i fundëm në këtë rast, ndërprerja e kontratës është parë si masë drastike e cila nuk do sillte përfitimin e duhur për kontratën.
Pas një sërë analizash, në bashkëpunim me Bankën Botërore për benefitet dhe humbjet e ndërprejes së kontratës, është konsideruar dhënia e kohës së mjaftueshme dhe tërheqja e vëmendjes ndaj konsultetit, në krahasim me ripërsëritjen e procedurave të tenderit dhe humbja e kohës përsëri për një produkt të ngjashëm.
Ndërpreja e kontratës është bërë në momentin kur nga BB, PCU dhe Autoriteti Kontraktor, u pa se se kjo konsulencë nuk mund të prodhonte produkte që ishin në përputhje me zhvillimet e pritshme të qytetit të Gjirokastrës dhe u vendos që në mënyrë miqësore të ndërpritet kontrata. Më pas ndërpreja u realizua në përputhje të plotë të parashikimeve të kontratës të cituara edhe në raportin e audituesit.
Të ndodhur në këtë situatë, në datën 15 Maj 2019, në përputhje me Article 18/GCC of Contract "Suspension", FSHZH morri vendimin për t'i komunikuar konsulentit pezullimin e shërbimeve të kontratës duke kërkuar ndreqjen e këtij dështimi dhe përmirësimin e cilësisë së përformancës së tij, duke akomoduar komentet e adresuara nëpërmjet Letrës së Komenteve, brënda një periudhe kohore prej tridhjetë (30) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit për pezullim. Referuar informacionit marrë nga Menaxheri i Projektit dhe Menaxheri i Kontratës të datës 16.07.2019 ku rezulton që kontraktori nuk ka performuar mirë dhe si rezultat i kësaj, kjo kontratë është ndërprerë.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

9. **Gjetje nga auditimi:** *Nga auditimi i dokumentacionit teknik per zbatimin e punimeve në objekt te kontraten bazë, me objekt "Rikonstruksioni dhe zgierimi i nugës "Muzak Topia" segmenti nga rreth rrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari ne kala" u konstatua se:*
– Në dosje nuk ndodhet dokumentacioni mbi urdhër ndryshimin (VO) per disa zëra punimesh dhe konkretisht: F.V. Bordura betoni (20 x 35) cm; Struktura monolite betoni (mure betoni shtesë kufizuar me varrezat) dhe Linja e K.U.Z.
– Në projektin e zbatimit aktual të miratuar nga AK, nga FSHZH nuk janë marrë në konsideratë propozimet e bëra nga Instituti i Ndërtimit, per Oponencën Teknike, kjo tepër e domosdoshme sepse: ne disa pjesë, rruga është me qendrueshmëri te dobët.
– Referuar Projektit Teknik për te dy segmentet e nugës, planimetria nuk është e plotësuar me parametrat gjeometrik rrugorë (gjerësi nuge, gjerësi trotuari dhe gjerësi bankine).
Veprimet e mesipërme janë ne kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes Së punimeve me Nr. Ref. No. AL- ADF-62551-CW-RFB, datë 12.09.2018, te lidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Operatorit Ekonomikë (OE) "E. H." SHPK. (Trajtuar më hollësisht në faqet 36-51 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

9.1. **Rekomandim:** Autoriteti Kontraktor FSHZH, nisur nga fakti që punimet e ndërtimit ti kontratës "Rikonstruksioni dhe zgierimi i rtugës "Muzak Topia" segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari ne kala" janë ne proces pune, te marrë masa dhe të fillojë procedurën mbi ndryshimet ne volumet e punimeve te ndërtimit sipas propozimeve të kontraktorit e mbikëqyrësit dhe te bëjë miratimin me urdhër ndryshimi (V.O.) me qëllim përmirësimin ne sasi dhe cilësi të projekt-preventivit të miratuar pas ballafaqimit me terrenin si dhe per miratimin e gmimeve te zërave te rinj të punimeve (nese do jetë e nevojshme), duke rishikuar vlerën e kontratës pas rishikimit te preventivit.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm
Gjatë zbatimit të projektit, ka pasur kërkesa shtesë të paraqitura nga përfituesi, Bashkia Berat dhe njëkohësisht ka vështirësi në implementim (për shkak të terrenit, formimit gjeologjik por

edhe mangesive në projekt), të cilat kaë kërkuar amendim të konsiderueshëm të projektit fillestar.
Duke parë impaktin që ka në shpronësime, projekti "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës "Muzak Topia", segmenti nga rrethrrotullimi te ish rezervat e Shtetit deri tek lapidari në kala", është rishikuar me kërkesë të Bashkisë Berat, duke marë në konsideratë dhe argumentat e oponencës për problemet që ka patur projekti. Për këtë arsye, është gjykuar që këto ndryshime do të përfshiheshin në një Urdhër Ndryshimi më të madh, ku reflektohen të gjitha ndryshimet njëkohësisht. U vendosën në dispozicion VO1 dhe VO2 me materialin dokumentues.
Referuar rekomandimit mbi Projektin Teknik, Projekti Teknik i Ripunuar nr.2, i azhornuar, i zbatimit të punimeve, është i plotësuar me parametrat gjeometrikë rrugorë si gjerësi rruge, gjerësi trotuari dhe bankine si dhe parametra të tjerë të plotë.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: zbatuar

10. **Gjetje nga auditimi:** *Nga auditimi i dokumentacionit teknik për kontratën bazë, me objekt "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës "Muzak Topia" segmenti nga rreth rrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kala" konstatohet se Leja e Infrastrukturës me nr. 6268, datë 20.12.2019, Iështuar nga Bashkia Berat për nënobjektin "Rikonstruksioni dhe zgierimi i nugës "Muzak Topia" segmenti nga rreth rrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kala" Berat, në kuadër te projektit për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit, hua nga IBRD: Nr. 8656-AIb) është Iështuar në mënyrë të pjesshme per segmentin: "Segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek Kisha e Shën Ilias" per shkak të problematikave mbi shpronësimet e pronarëve te ligishëm të cilët preken nga zbatimi i kontratës. Mos Iështimi i lejes se infrastrukturës, për të giithë objektin ka ndikuar ne shtyrjen e afatit te punimeve me 12 muaj, ngadalësimin e punimeve dhe aktualisht po bëhet pengesë për ecurinë e punimeve te ndërtimit per pjesën ne vazhdim, deri tek Lapidari ne Kala. Veprimet e mësipërme janë ne kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes se punimeve me Nr. Ref. No. AL-ADF-62551-CW-RFB, datë 12.09.2018, të Iidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Operatorit Ekonomikë (OE) "E. H." SHPK. (Trajtuar më hollësisht nëfaqet 36-51 te Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

10.1. **Rekomandim:** FSHZH në cilësinë e Autoriteti Kontraktor, në bashkëpunim me Bashkinë Berat si përfituese direkte e këtij investimi, të intensifikojnë veprimet per te mundësuar shpronsimin e pronarëve të ligjshëm te cilët u cënohet prona private per shkak të zbatimit të punimeve të kontratës "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës "Muzak Topia" segmenti nga rrethrrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kala" dhe të realizohet dhënia e lejes se infrastrukturës per të gjithë objektin, per te mundësuar përfundimin e punimeve te kontratës në përputhje me kushtet e lejes së infrastrukturës dhe grafikut të punimeve.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm
Projekti është pajisur me Leje Ndertimi me nr.186, datë 24/03/2021, lëshuar nga Bashkia Berat. VKM nr.43, datë 27/01/2021 "Për shpronësimin për interes publik të pronareve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga realizimi i objektit: Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës "Muzak Topia", segmenti nga rrethrrotullimi tek ish-rezervat e shtetit deri te kisha e Shën Ilias, Berat".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: zbatuar

11. **Gjetje nga auditimi:** *Nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi administrimin e veprave te përfunduara u konstatua se:*

– Për nënobjektin: "Ndërtimi i shkallareve ne Sarandë" nga FSHZH te bashkëpunojë me Bashkinë Sarandë, per te finalizuar marrjen në dorëzim përfundimtar te investimit edhe pse ka përfunduar periudha e garancisë dhe pse AK me shkresën me nr. 141 prot, date 20.01.2020 ka njoftuar Titullarin e Bashkisë Sarandë për marrjen përfundimtare në dorëzim te nënobjektit.
– Për nënobjektet: "Ndërtimi i shkallareve në Sarandë"; "Rehabilitimi i nugës hyrëse Mihal Komneno per në Kala dhe Tabja"; "Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës" nga Bashkitë përkatëse si përfituese te këtyre investimeve, aktualisht, nuk ka filluar procedura e mirëmbajtjes së investimeve, sipas një plani të detajuar mirëmbajtjeje që buron nga Manualet e Operimit dhe Mirëmbajtjes (te cilat aktualisht nuk janë realizuar dhe nuk janë dorëzuar zyrtarisht në protokollin e FSHZH), Aktualisht konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim, objektivat dhe nuk është atTitur qëllimi i parashikuar në Marrëveshjet e Funksionimit dhe të Mirëmbajtjes midis FSHZH dhe Bashkive Berat, Sarandë dhe Gjirokastër.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat e sipërmanjes së punimeve, me Marrëveshjet e Investimit si dhe Marrëveshjet e Mirëmbajtjes, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Bashkive Berat, Sarandë dhe Gjirokaster (Trajtuar më hollësisht në faqet 36-51 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

11.1. **Rekomandim:** FSHZH në cilësinë e Autoriteti Kontraktor, në vazhdimësi të bashkëpunojë me Bashkitë Sarandë, Berat dhe Gjirokastër, per të intensifikuar veprimet per të mundësuar manien në dorëzim përfundimtar te investimeve respektive si dhe të zbatojnë kërkesat e Marrëveshjes së Investimit dhe te Mirëmbajtjes per fillimin e menjëhershëm të procesit të Operimit dhe të Mirëmbajtjes në zbatim të një Plani dhe grafiku te detajuar, per te mundësuar rritjen e anes funksionale ne përputhje me objektivat dhe kushtet e marrëveshjeve të nënshkruara.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm
Në përgjigje të ketij rekomandimi, marëdhëniet midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Sarandë janë të definuara në Marrëveshjen Kuadër të Bashkëpunimit (nënshkruar më dt. 12.06.2017) dhe Marrëveshjen e Investimit (nënshkruar me dt. 16.08.2017) , të nënshkruara midis Bashkisë Sarandë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe te dakordësuara me Bankën Botërore. Sic referohet në Marrëveshjen e Investimit, përkatësisht:
(Nëni 4 – Realizimi i Punimeve)
Në përfundim të periudhës së korrigjimit të defekteve, punimet e nënprojektit janë gati për tú marrë në dorëzim nga Bashkia. Kjo marrje në dorëzim do të shoqërohet me një inspektim të Punimeve në prani të Kontraktorit, Supervizorit, Bashkisë dhe FSHZH.
(Nëni 5 – Dispozita të Funksionimit dhe Mirëmbajtjes):
Bashkia do te angazhohet te firmose MFM dhe në respektim të saj në mënyrë të vecantë të përgatisë Planin e Funksionimit dhe Mirëmbajtjes.
Të përfundojë procedurën e prokurimit për lidhjen e Kontratës së Mirëmbajtjes midis tij dhe subjektit privat të përzgjedhur për mirëmbajtjen e infrastrukturës, brenda datës së përfundimit të punimeve, ose të angazhojë strukturat e nevojshme te Mirëmbajtjes brenda institucionit.
- Bazuar në Marrëveshjen e Investimit , Bashkisë Sarandë i është dërguar shkresë zyrtare me Nr. 141 Prot. që Përfaqësuesit e saj të jenë prezent në Marrjen Përfundimtare në dorëzim në datë 20.01.2020 nga ana e FSHZH-së.
Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në rolin e Agjencisë Implementuese të Projektit PIUTD i ka ndërmarë të gjitha hapat e nevojshme sic janë parashikuar në Marrveshjen Kuadër të Bashkëpunimit dhe Marrëveshjen e Investimit. Në përfundim, mbas disa takimeve me përfaqësues të Bashkisë Sarandë referuar problematikës në fjalë, FSHZH ka bërë të mundur nënshkrimin e "Certifikatës së Marrjes Përfundimtare në Dorëzim të Punimeve nga të gjitha

palët e interesit. Në vijim, për të evituar vonesa të kësaj natyre, FSHZH ka ndryshuar formatin e Certifikatave duke lejuar vetëm 15 ditë kohë për komentet e palëve (në rast kontestimesh), duke e bërë automatikisht të vlefshme Certifikatën, në rast se nuk ka komunikime të mëtejshme nga përfituesi.

- Për nën-objektet: "Ndërtimi i shkallareve në Sarandë"; "Rehabilitimi i rrugës hyrëse Mihal Komneno për në Kala dhe Tabja"; "Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës", nga Bashkitë përkatëse si përfituese të këtyre investimeve, Manualet e Operimit dhe Mirëmbajtjes, kanë qenë të dorëzuara në Bashkitë përkatëse dhe Bashkitë e kanë të mundur në cdo moment të fillojnë procedurën e mirëmbajtjes së investimeve. Gjithashtu, sqarojmë se Manualet e Operimit dhe Mirëmbajtjes, janë dorëzuar zyrtarisht në protokollin e FSHZH sipas rekomandimit te Auditit të KLSH

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

12. **Gjetje nga auditimi:** *Nga auditimi i dokumentacionit mbi dhënien e Lejes së Ndërtimit konstatohet se përfituesi i investimit, Bashkia Gjirokastër, nuk ka kryer oponencën teknike per projektin e zbatimit për nënobjektin "Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës". Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, date 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve te Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6, ku përcakton se: "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha Ilojet e ndërtimeve, me vlerë të prevenivtuar së paku I00 milionë Iekë nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve", me Urdhrin e Ministrit Nr. 197, date 09.10.2014 "Për miratimin e kushteve te përgiithshme te marrëveshjes per kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit" (Trajtuar më hollësisht në faqet 36-51 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

12.1. **Rekomandim**: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masa që për nënprojektet në vazhdim te "Projektit per Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit" t'i kërkojnë Bashkive përfituese të investimeve, të kryejnë Oponencën Teknike, me qëllim përmirësimin dhe arritjen e garancisë së Projekteve të Zbatimit, për të siguruar cilësinë, qëndrueshmërinë, anën funksionale dhe jetëgjatësinë e tyre, ne përputhje me Kushtet Teknike te Projektimit dhe Kushtet Teknike te Zbatimit.

Menjëherë

Qëndrimi i FSHZH për Rekomandimin e mësipërm

Bashkia Gjirokastër nuk ka kryer oponencën teknike në lidhje me projektin "Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës", por ka lëshuar Lejen e Infrastrukturës. Për më tej ky projekt ka përfunduar dhe i është dorzuar Bashkisë Gjirokastër nga ana e FSHZH.

Për projektet në vijim janë realizuar dhe po realizohen Oponencat Teknike të tyre.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

Me shkresën nr. 1747/6, datë 03.10.2022 (protokolluar në KLSH me nr. 600/65, datë 03.10.2022), të paraqitur nga FSHZH ku pretendohet se një pjesë e gjetjeve dhe rekomandimeve nuk qëndrojnë, ju sqarojmë se në këtë fazë të auditimit nuk mund të gjykohet por auditohet zbatimi i tyre. Observacioni juaj nuk qëndron.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA (KESH) PËR PROJEKTIN "PLANI I RISTRUKTURIMIT TË KESH"

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Korporata Elektroenergjitike Shqiptare SHA (KESH) për projektin "Plani i ristrukturimit të KESH" mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", KESH, nuk ka kthyer përgjigje duke mos respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 878/6, datë 28.09.2021 dhe në KESH nr. 4803 prot., datë 04.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **4 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **0 masa për shpërblim dëmi në vlerën 0 lekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **2 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 694,084,472 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-

2	Organizative	4	4	-	-
3	Shpërblim dëmi	-	-	-	-
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	2	2	-	-
7	Masa disiplinore	-	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e KESH

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	4	1	0	3	0
3	Shpërblim dëmi	0	0	0	0	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	2	0	0	2	0
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,

3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI
Në përfundim të procesit të auditimit, nga në Korporata Elektroenergjitike Shqiptare SHA (KESH) për projektin "Plani i ristrukturimit të KESH", rezulton se janë rekomanduar 4 masa organizative dhe janë pranuar 4 masa organizative ose 100% nga të cilat 1 masë është zbatuar ose 25% dhe 3 masa janë në proces zbatimi ose 75% dhe 1 masë për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit dhe 1 masë është në proces zbatimi ose 100% e tyre.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 25%, por pjesën tjetër të rekomandimeve janë në proces zbatimi.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM
III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", KESH, nuk ka kthyer përgjigje duke mos respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për*

rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Për Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH SHA)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, sa i përket Projektit "Plani i ristrukturimit të KESH", mbi shkallën e zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe kushteve, mbi të cilat KESH, menaxhon proceset e zbatimit të marrëveshjes së huas.

Opinioni i modifikuar/ i kualifikuar.

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin OST SHA, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një Opinioni të modifikuar/ i kualifikuar.

Baza për opinionin e modifikuar/ i kualifikuar.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000[3], me ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në INTOSAI - P10, "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 130 "Kodi Etik". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetin për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e projektit, rezultuan disa mangësi dhe parregullsi të cilat kanë sjell shtesë të kostove të borxhit në vlerën totale rreth 708,533,749 Lekë[4] dhe konsistojnë në:

- KESH SHA ka paguar 548,277,597 lekë interesa overdraftesh si rezultat i mos plotësimit në kohë të kushteve të vëna nga banka për bërjen efektive të parave, vlerë e e cila përbën efekt negative financiar për buxhetin e shoqërisë.
- KESH SHA nuk ka përllogaritur humbjen që i shkaktohet nga tarifa e angazhimit për të cilën KESH SHA ka paguar shumën prej 1,166,455.10 Euro, e cila përbën efekt negative financiar për buxhetin e shoqërisë (me vlerë 1,066,455.10 Euro pas lëvrimit të tranzhit A dhe me vlerë 100,000 Euro për tranzhin B). Për tranzhin B, nga KESH SHA janë përdorur 89,740,094 Euro nga 100,000,000 Euro të parashikuara, pasi për diferencën vlerë 10,259,906 Euro, KESH SHA ka negociuar me Intesa Sanpaolo Bank duke e strukturuar OD sipas kushteve të marrëveshjes me BERZH. Komisioni fillim-mbarim është parashikuar në masën 1%. Komisioni fillim mbarim që BERZH për tranzhi B është përllogaritur me vlerë 1,000,000 Euro, ndërkohë që duhet të llogaritej me vlerë 897,401 Euro (89,740,094 Euro x 1%). Vlera e mbajtur më tepër është në shumën 102,599 Euro.

[3] Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

[4] Kursi i këmbimit për vlerat në Euro i referohet kursit të përdorur nga KESH në momentin e shlyerjes së overdraftit datë 30.05.2018, 1Euro = 126.28 lekë.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve financiare dhe përmbushjes së objektivave, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në ligjin nr. 125/2016, është ratifikuar marrëveshja "Për ratifikimin e marrëveshjen e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropianë për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e Huas ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Zhvillim (BERZH), për Projektin "Shqipëria: Plani i strukturimit të KESH", seksioni 1.02 "Përkufizimet", paragraf 2, përcaktohet: "Përfaqësues i autorizuar i huamarrësit do të thotë Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Huamarrësit". Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, në lidhje me menaxhimin e projektit, organizimi është bërë sipas departamenteve përkatëse dhe jo nga një organ i krijuar i cili të mbulojë të gjitha fushat e përfshira në zbatimin e projektit. Po ashtu, nuk është krijuar një njësi, e cila do të zbatonte, menaxhonte apo koordinonte aktivitetin e projektit, duke patur parasysh se në zbatimin e programit për mundësimin e huas, janë të përfshirë edhe institucione të tjerë si Enti Rregullator i Energjisë dhe OSHEE *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: KESH SHA të marrë masa për ngritjen e strukturave të menaxhimit për projektet në vazhdimësi, me synim zbatimin me korrektësi të përcaktimeve në marrëveshjet me huadhënësin, si dhe me cilësinë dhe afatin e parashikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i KESH për Rekomandimin: Ky rekomandim do të verifikohet në auditimin e projekteve të tjera me financime të huaja.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nuk është realizuar ndonjë procedurë për analizimin e kostos dhe përfitimit nga huaja, detyrim i përcaktuar në Marrëveshjen e financimit, seksionin 4.01.a *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: KESH SHA të marrë masa për analizimin e kostos dhe përfitimeve nga marrja e huas dhe shlyerja e overdrafteve të përcaktuara. Të nxirren përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i KESH për Rekomandimin: Relacion për projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në lidhje me Marrëveshjen e huas, ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin "Shqipëria: plani i ristrukturimit të KESH-it"

Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportimin e pasqyrave financiare të audituara nga një audites i pëlqyeshëm nga Huadhënësi konstatohet se, KESH SHA për shkak të kësaj kërkese të huadhënësve të cilët janë Institucione Financiare Ndërkombëtarë, realizon auditim të pasqyrave me një grup audituesish të njohur nga këto institucione. Për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2017-2019 KESH SHA me fondet e veta nëpërmjet një procedure prokurimi ka lidhur kontratën nr. 5904/5 prot., datë 28.05.2018, me Shoqërinë "E.." me vlerë kontrate 27,468,000 lekë me TVSH. Për periudhën e audituar konstatohet se pasqyrat e raportuara për

Huadhënësin kanë qenë vetëm pasqyrat e vitit 2017, të cilat janë dërguar pranë Bankës së bashku me raportin e auditimit sipas shkresës nr. 5856 prot., datë 14.11.2018. Pasqyrat e vitit 2018 dhe 2019 nuk janë raportuar pranë Huadhënësit për shkak se ato nuk kanë qenë të përfunduara. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se pasqyrat e vitit 2018, janë mbyllur nga Shoqëria "E. & Y." në muajin Qershor të vitit 2020, por deri në muajin Shtator të këtij vitit raporti i audituesit të caktuar nuk ishte përfunduar. Ndërkohë pasqyrat financiare për vitin 2019 deri në muajin Shtator të vitit 2020 rezultojnë të pa mbyllura nga Shoqëria "E. ..". Këto vonesa kanë ardhur si pasojë se procesi i ndjekur nga Shoqëria "E. .." për realizimin e veprimeve rregulluese në pasqyrat e KESH SHA, bazuar në kualifikimet e lëna nga audituesit e këtyre pasqyrave, veprim ky me qëllim përmbushjen e detyrimit të KESH SHA si huamarrës pranë huadhënësve të tij. Në veçanti 35 huadhënësve institucione financiare ndërkombëtare. KESH SHA ka kontraktuar nëpërmjet një granti, shërbim konsulence për realizimin e veprimeve rregulluese në pasqyrat financiare të tij. Shoqëria "D." ka qenë shoqëria që ka dhënë këtë shërbim. Veprimet për rregullimin e pasqyrave financiare janë përfunduar në muajin Shkurt të vitit 2020 nëpërmjet miratimit të këtyre veprimeve nga ana e Këshillit Mbikëqyrës dhe në muajin Mars të vitit 2020 këto veprime janë miratuar dhe nga Asambleja e Aksionarëve. Vetëm pas këtyre rregullimeve shoqëria mundi të përmbyllte pasqyrat e vitit 2018. Kjo shtyrje në kohë solli edhe vonesë në paraqitjen dhe përfundimin e veprimtarisë së rivlerësimit të aseteve të KESH SHA, që zhvillohej paralel me datë rivlerësimi 01.01.2019. Rrjedhimisht këto vonesa kanë sjellë si efekt edhe shtyrjen e përfundimit të pasqyrave financiare të vitit 2019. Megjithatë nga ana e KESH SHA evidentohet se vonesat në raportimin e pasqyrave financiare ka qenë e njohur edhe nga Huadhënësi, për shkak se vetë veprimet rregulluese realizoheshin për qëllime të përmbushjes së detyrimeve me vetë huadhënësin dhe nuk kanë sjellë asnjë pengesë në ecurinë e disbursimeve të huas. Vonesat nuk janë bërë shkak i shtyrjes së disbursimeve. Shkak kryesor kanë qenë kushtet e vendosura për tu përmbushur për qëllime disbursimi të Transhit A dhe B. Mos dërgimi i raporteve financiare dhe jo financiare, si dhe progresive në afatet kohore të parashikuara, ndikon në monitorimin e projektit sipas përcaktimeve, si dhe evidentimin e detyrimeve realizuara dhe të pa realizuara nga institucioni. Për sa më sipër veprime këto në kundërshtim të Ligjit nr. 125/2016, datë 15.12.2016, për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas për Projektin "Plani i ristrukturimit të KESHit", seksioni 3.04, germa a, si dhe seksioni 4.01, pika 2, germa a *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 25-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare në vijim të zbatimit të Projektit të marrë masat e nevojshme organizative dhe mbikëqyrëse, duke shmangur të gjitha praktikat penguese, për dërgimin e Raporteve Social Mjedisore si dhe të Raporteve të Auditimit të Pasqyrave Financiare pranë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim brenda afateve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas.

Në vijimësi

Qëndrimi i KESH për Rekomandimin: Ky rekomandim do të verifikohet në auditimin e rradhës pasi gjatë kësaj periudhe nuk ka raportime

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Marrëveshjes së Huasë së EBRD të ratifikuar me Ligjin Nr. 125/2016 "Për projektin" Shqipëria: Plani i Ristrukturimit të KESH-it" rezulton se, KESH SHA ka paguar 548,277,597 lekë interesa overdraftesh si rezultat i mos plotësimit në kohë të kushteve të vëna nga banka për bërjen efektive të parave, vlerë e cila e cila përbën efekt

negative financiar për buxhetin e shoqërisë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: KESH SHA në të gjitha rastet të tregojë angazhim maksimal në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave apo kushteve të përcaktuara në marrëveshje si dhe te nxisë organet e tjera për plotësimin e tyre sipas rastit, me qëllim respektimin e afateve të miratuara për mënjanimin e kostove shtesë në këtë projekt të cilat deri në këtë fazë arrijnë vlerën 548,277,597 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i KESH për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, KESH SHA nuk ka përllogaritur humbjen që i shkaktohet nga tarifa e angazhimit për të cilën KESH SHA ka paguar shumën prej 1,066,455 Euro pas lëvrimit të tranzhit A vlerë e cila përbën efekt negative financiar për buxhetin e shoqërisë. Për tranzhin A, KESH SHA iu kanë rritur kostot me tarifën e angazhimit si rezultati i tërheqjes me vonesë të shumës së akorduar si rezultat i mos plotësimit të kushteve të vëna nga banka, kryesisht të kushteve të tregut energjetik për tu plotësuar nga ERE, rakordimin me detyrimet që OSHEE ka ndaj KESH, rritjen e çmimit të shitjes së energjisë nga KESH sha e cila miratohet nga ERE, etj. Për Tranzhin B KESH SHA i janë rritur kostot me tarifën e angazhimit si rezultati i tërheqjes me vonesë prej 72 ditësh sipas shkresës nr. 1034 datë 03.04.2020 të EBRD me 100,000 Euro. (100,000,000 Euro x (72/360 x 0.5%) = 100,000 Euro.) Është vepruar në kundërshtim me Nenin 2 "Afatet Kryesore të Huasë", Seksionin 2.02 Afate të tjera Financiare të kredisë pika g) Huamarrësi do ti paguajë Bankës tarifën e angazhimit prej 0.5% në vit mbi totalin e shumës së disponueshme për çdo këst. Tarifa e angazhimit për Këstin A do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së Marrëveshjes të Kredisë dhe Tarifa e angazhimit për Këstin B do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës në të cilën Banka konfirmon me shkrim disponueshmërinë e Këstit B dhe do të mblidhet dhe llogaritet në të njëjtën bazë të interesit sipas Seksionit 3.04 (b)(ii) *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: KESH SHA të marrë masa për angazhim maksimal në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave apo kushteve të përcaktuar si dhe te nxisë organet e tjera për plotësimin e detyrimeve të tyre të adresuara nga zbatimi i marrëveshjes, me qëllim respektimin e afateve dhe mënjanimin e kostove shtesë në këtë projekt të cilat kanë krijuar efekt financiar negativ në vlerën 1,166,455 Euro.

Në vijimësi

Qëndrimi i KESH për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

C. VLERA TË RIKUPERUESHME

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për Tranzhin B, huamarrësi KESH SHA ka përdorur vetëm 89,740,094 Euro nga vlera e akorduar prej 100,000,000 Euro, ndërsa komisionet nga ana e huadhënësit janë mbajtur mbi vlerën e plotë dhe jo atë të lëvruar. Diferencën prej 10,259,906 Euro të palëvruara KESH SHA e ka negociuar me Intesa Sanpaolo Bank duke e strukturuar OD sipas kushteve të marrëveshjes me BERZH. Komisioni fillim mbarim që BERZH duhet të mbante nga TRANZHI B llogaritet në 89,740,094 Euro x 1% = 897,401 Euro ndërkohë që është mbajtur vlera prej 1,000,000 Euro ose 102,599 Euro më tepër. Mbajtja e komisioneve bëhet sipas Nenit 2 "Afatet Kryesore të Huas", Seksionin 2.02 "Afate të tjera Financiare të kredisë", pika h), huamarrësi do ti paguajë bankës një komision fillimmbarim të barabartë me një përqind (1%) të shumës së principalit për çdo këst *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: KESH SHA të marrë masat e nevojshme me Huadhënësin për rakordimin e shumave të mbajtura për komisionet e huasë, fillim-mbarim, dhe rikuperimin e vlerës prej 102,599 Euro gjatë pagesave në vijim duke kryer dhe sistemimet përkatëse.

Menjëherë

Qëndrimi i KESH për Rekomandimin: KESH SHA ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me donatorin dhe ka kërkuar mendim nga donatori.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE (MSHMS) PËR PROJEKTIN "MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE"

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Moderinizimi i Asistencës Sociale" mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, për periudhën nga fillimi i projektit deri në 30.06.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", MSHMS, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 4476/3 prot., datë 17.01.2022, Zv Ministri ka kthyer përgjigje duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me shkresën nr. 2803, date 01.07.2022 "Raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e vitit 2021"

III. Rekomandimet e KLSH

Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 1080/7, datë 30.12.2021 dhe në MSHMS nr. 4476/2 prot., datë 05.01.2022, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **2 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **0 masa për shpërblim dëmi në vlerën 0 lekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;

e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **0 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	2	2	-	-
3	Shpërblim dëmi	-	-	-	-
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	-	-	-	-
7	Masa disiplinore	-	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e KESH

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	2	2	0	0	0
3	Shpërblim dëmi	0	0	0	0	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	0	0	0	0	0
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI
Në përfundim të procesit të auditimit, nga në Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Moderinizimi i Asistencës Sociale", rezulton se janë rekomanduar 2 masa organizative dhe janë pranuar 2 masa organizative ose 100% nga të cilat 2 masa është zbatuar ose 100% .

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 100%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM
III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", MSHMS, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 4476/3 prot., datë 17.01.2022, Zv Ministri ka kthyer përgjigje duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të*

auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me shkresën nr. 2803, date 01.07.2022 "Raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e vitit 2021"

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar raportet financiare të subjektit PMU për projektin *"Modernizimi i Asistencës Sociale",* për vitin 2020, të cilat përmbajnë raportin e gjeneruar nga Sistemi i Thesarit për fondet e shpenzuara për programin e ndihmës ekonomike dhe raportimet e drejtorive rajonale në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social. Në opinionin tonë, raportimi financiar është kryer mbi bazën e kuadrin raportues sipas përcaktimeve të bëra në marrëveshjet e financimit Ligjit 84/2012 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale",* i ndryshuar dhe Ligjit nr. 53/2018 *"Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Shtesën e Financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale"* dhe paraqesin drejtë situatën financiare. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare për qëllime të veçanta ne lidhje me projektin *"Modernizimi i Asistencës Sociale",* (MSHMS) për periudhën 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2020, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat për raportim në marrëveshjen në mes të palëve, duke respektuar parimet kontabilitetit të bazuar në "cash". Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten tek paragrafi "Theksimi i Çështjes".

Baza për opinionin mbi raportet financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI's). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e raporteve financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Theksimi i Çështjes

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë strukturat e përfshira në projektin *"Modernizimin i Asistencës Sociale",* sa i takon përfshirjes në raportim edhe të rialokomeve të fondeve për programin e ndihmës ekonomike pasi rezulton se për vitin 2020 bazuar në analizën e riskut dhe materialitetit janë evidentuar se në bazë të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e financimit, PMU ka raportuar mbi fondet

e alokuara në fillim të vitit për programin e NE nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për vitin 2020 bazuar në analizën e riskut dhe materialitetit janë evidentuar se për 61 Bashki, duke krahasuar vlerën e alokimit të raportuar në Bankën Botërore me vlerën e alokuar deri në fund të vitit sipas DPSHSSH nga ku rezulton se ka diferenca midis vlerave të raportuara si të alokuar dhe alokimit përfundimtar në shumën **82,678,340 lekë.** Duke qenë se raportimi nga PMU ndaj Bankës Botërore bëhet 6-mujor progresiv e vjetor për vitin financiar dhe është pas faktit, si i tillë ky raportim duhet të kishte përfshirë këto ndryshime shumash të alokuara. Nga auditimi u konstatua se në bazë të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e financimit, PMU ka raportuar mbi fondet e shpenzuara për programin e NE nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për vitin 2020 bazuar në analizën e riskut dhe materialitetit janë evidentuar se për 61 Bashki, të përzgjedhura, duke krahasuar vlerën e shpenzimeve të raportuar në Bankën Botërore me vlerën e rakorduar deri në fund të vitit nga DPSHSSH, me MSHMS nga ku rezulton se në 29 raste ka diferenca midis vlerave të raportuara si të shpenzuara dhe shpenzimit faktik që DPSHSSH ka, në shumën 60,825,090 lekë. Nga informacionet e MFE, për të dhënat e NE, e cila përfaqësohet me kod projekti 91307 AA nga viti 2020, diferenca vjen pasi në llogarinë 6061003 janë përfshirë dhe pagesa të tjera që nuk i përkasin NE, për kompensime speciale të tjera, fondit social për Këshillat e Qarqeve dhe Bashkive, Drejtorinë Arsimore Lushnje, etj.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Struktura e PMU brenda MSHMS, përgjegjëse për menaxhimin e Projektit;
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror;
Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
Drejtoritë e Shërbimit Social pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore;
Strukturat e mësipërme janë përgjegjëse për përgatitjen e raportimeve financiare në lidhje me Ndihmën Ekonomike në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të këtij raportimi, konkretisht marrëveshjeve të ratifikuara me Ligjin nr. 84/2012 'Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale', i ndryshuar dhe Ligjin nr. 53/2018 'Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Shtesën e Financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale', për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të raportimeve financiare si dhe për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e audituesve

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse paraqiten anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi shpenzimet e ligjshme sipas programit (NE) të cilat mbulohen nga Projekti për agjencitë pjesëmarrëse. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit. Përveç Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI-t), ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale agjencive pjesëmarrësve të Projektit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me

auditimin financiar dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se në bazë të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e financimit, PMU ka raportuar mbi fondet e alokuara në fillim të vitit për programin e NE nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për vitin 2020 bazuar në analizën e riskut dhe materialitetit janë evidentuar se për 61 Bashki, duke krahasuar vlerën e alokimit të raportuar në Bankën Botërore me vlerën e alokuar deri në fund të vitit sipas DPSHSSH nga ku rezulton se ka diferenca midis vlerave të raportuara si të alokuar dhe alokimit përfundimtar në shumën **82,678,340 lekë.**

Duke qenë se raportimi nga PMU ndaj Bankës Botërore bëhet 6-mujor progresiv e vjetor për vitin financiar dhe është pas faktit, si i tillë ky raportim duhet të kishte përfshirë këto ndryshime shumash të alokuara. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 84/2012 *'Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale'*, Seksioni II, Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi i projektit, germa A Raportet e Projektit, pika 2 dhe germa B Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe auditimet, pika 2, ligjin nr. 53/2018 *'Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Shtesën e Financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale'*, seksioni II si dhe Manualin Operacional i Projektit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 7-37 të Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror dhe PMU të marrin masa që në raportet e dorëzuara pranë donatorit (Banka Botërore) të pasqyrojnë vlerat e plota të alokuara për programin e NE ku të përfshihen fondet e çelura dhe rialokimet e ndodhura gjatë vitit, si detyrim që rrjedh nga marrëveshja e financimit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSH për Rekomandimin: SHSSH ka marrë të gjitha masat që të dhënat për NE me çeljen dymujore për 2021, e në vijim përgjatë 2022 t'i dërgohen Njësisë së Projektit sa herë u nevojitet informacioni, si detyrim që rrjedh nga marrëveshja e financimit, sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në përputhje të plotë të dhënash midis 2 insitucioneve MSHMS dhe MFE ku përfshihen fondet e çelura dhe vlerat e plota të alokuara për NE.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se në bazë të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e financimit, PMU ka raportuar mbi fondet e shpenzuara për programin e NE nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për vitin 2020 bazuar në analizën e riskut dhe materialitetit janë evidentuar se për 61 Bashki, të përzgjedhura, duke krahasuar vlerën e shpenzimeve të raportuar në Bankën Botërore me vlerën e rakorduar deri në fund të vitit nga DPSHSSH, me MSHMS nga ku rezulton se në 29 raste ka diferenca midis vlerave të raportuara si të shpenzuara dhe shpenzimit faktik që DPSHSSH ka, në shumën 60,825,090 lekë.

Nga informacionet e MFE, për të dhënat e NE, e cila përfaqësohet me kod projekti 91307 AA nga viti 2020, diferenca vjen pasi në llogarinë 6061003 janë përfshirë dhe pagesa të tjera që nuk i përkasin NE, për kompensime speciale të tjera, fondit social për Këshillat e Qarqeve dhe Bashkive, Drejtorinë Arsimore Lushnje, etj. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 84/2012 *'Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e Projektit të Modernizimit*

të Asistencës Sociale', Seksioni II, Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi i projektit, germa A Raportet e Projektit, pika 2 dhe germa B Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe auditimet, pika 2, ligjin nr. 53/2018 *'Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Shtesën e Financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale'*, seksioni II si dhe Manualin Operacional i Projektit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 7-37 të Raportit të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: PMU të marrë masa që në raportet e dorëzuara pranë donatorit (Banka Botërore) të pasqyrojnë vlerat e plota të shpenzimeve për programin e NE ku të përfshihen shpenzimet faktike vetëm për programin e NE-së, të ndodhura gjatë vitit, si detyrim që rrjedh nga marrëveshja e financimit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSH për Rekomandimin: Në raportimin e bërë për vitin 2021, janë pasqyruar të dhënat faktike të shpenzuara për NE me kod produkti, në rakordim edhe me Drejtorinë e Buxhetit në MSHMS si dhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE PËR PROJEKTIN "PËRMIRËSIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR"

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Përmirësimi i sistemit shëndetësor" mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", MSHMS, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 2377/64 prot., datë 18.01.2022 *"Kthim përgjigje", Zv Ministri* duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin*

dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: *"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna"*.

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 579/40, datë 28.12.2021 dhe në MSHMS nr. 2377/62 prot. , datë 30.12.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **22 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **1 masa për shpërblim dëmi në vlerën 2,089,995.6 lekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar 0 **masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **11 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	22	21	-	1
3	Shpërblim dëmi	1	1	-	-
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	6	6	-	-
7	Masa disiplinore	11	11	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e MSHMS

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	21	4	0	16	1
3	Shpërblim dëmi	1	1	0	0	0

4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	6	2	0	4	0
7	Masa disiplinore	11	4	0	3	4

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimve rezulton se MSHMS nga 22 masa organizative ka pranuar 21 prej tyre ose 95.5% të masave dhe nga 21 masat e pranuara 4 janë zbatuar plotësisht ose 18% e masave të rekomanduara, janë 16 masa janë në proces zbatimi ose 72.7% e masave të rekomanduara dhe 1 masa nuk janë zbatuar ose 4.8% e masave të rekomanduara. Nga 1 masë

shpërblim dëmi që është rekomanduar ajo është pranuar pra 100% e masave janë pranuar dhe 100% janë zbatuar. Nga 6 masa 3-E, 2 janë zbatuar plotësisht ose 33% e masave të rekomanduara, 4 janë në proces ode 67% e masave të rekomanduara.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 18%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", MSHMS, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 2377/64 prot., datë 18.01.2022 *"Kthim përgjigje", Zv Ministri* duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:
"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Projektit *'Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor'* për periudhën nga fillimi i Projektit (2015) deri më 31.05.2021 nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator. Krahas parregullsive materiale sasiore, në arritjen e opinionit, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.
Në përfundim të auditimit, pasi u morën dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një ***opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.***
Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale. Konkluzionet dhe opinioni ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Zyra e Koordinimit të Projektit *'Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor'*, e cila konsiderohet nga ana jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme. Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 "Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë", ISSAI 1500 (ISA 500)[5] dhe ISSAI 1530 (ISA 530)[6]; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinioni në këtë auditim përputhshmërie. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinioni të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

- Si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të zyrtarëve dhe punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të Projektit prej **2,089,995 lekë** në procedurat e zbatimit të kontratave;
- Janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve të Projektit dhe menaxhim pa ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet i tyre në vlerën prej **45,600,000 lekë** në drejtim të procedurave të kryera për kontratat e shërbimeve;
- Janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve të Projektit dhe menaxhim pa ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet i tyre në vlerën prej **22,901,284 lekë** në drejtim të zbatimit të kontratave të punimeve civile;
- Mangësi në drejtim të hartimit të kritereve dhe specifikimeve teknike gjatë procedurave të prokurimit;
- Etj.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të MSHMS:

Strukturat drejtuese të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Koordinatori i Përgjithshëm i Projekti, Zyra e Koordinimit të Projektit, Koordinatorët e Projektit si dhe Grupet e Punës të angazhuar me procedurat e Prokurimit, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike. Strukturat drejtuese të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

[5] *Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.*

[6] *Objektivi i audituesit është të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.*

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[7], nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në kuadër të projektit "Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë" është nënshkruar kontrata HSIP/G/SH/02-2015 nr. 578/4 prot., datë 23.02.2016 me OE IMB, për blerjen dhe instalimin e programit financiar Alfa PMR për njësinë e koordinimit të projektit (PCU) në shumën 576,000 lekë (me TVSh) ose 4,608 euro. Fondi i parashikuar për këtë program është 5,000 euro. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe raporteve tremujore u konstatua se programi financiar Alfa PMR, i kontraktuar dhe i blerë nga kompania IMB, ka shfaqur problematika në lidhje me saktësinë e të dhënave dhe gjenerimit të raporteve të ndryshme. Referuar informacionit përmbledhës së datës 07.06.2021, të specialistes së financës së projektit HSIP, në lidhje me problematikat e shfaqura të programit Alfa PMR, ndër të tjera informon se: "… *Në shkurt të 2020, gjatë përpjekjes për gjenerimin e raportit 3 mujor, është konstatuar se sistemi ka pasur një problematik në gjenerimin e një raporti për të cilin vlera nuk dilte e saktë. Që nga ky moment sistemi Alfa PMR nuk gjeneron raportime me të dhëna të sakta (të cilat i realizojmë në Excel) ....jemi në kushtet kur çështja e gjenerimit të raporteve mbetet e pazgjidhur dhe raportet po gjenerohen me Excel ndërkohë që sistemi vijon të mos gjenerojë raporte të sakta sipas kërkesës së bankës Botërore*.".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 25-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: MSHMS të marrë masa që programi financiar Alpha PMR të vihet në funksion të plotë sipas kërkesave të prokuruara dhe të ofertuara. Në rast se kompania IMB nuk e vendos në funksion programin Alpha PMR, vlera prej 460,800 lekë do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: ALFA PMR është funksional dhe gjeneron raporte të sakta. Referuar gjetjeve te audituesve të KLSH mbi funksionalitetin e programit Alpha PMR, si dhe kontratës së nënshkruar midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe kompanisë Instituti i Modelimeve në Biznes (IMB) me Nr. Prot 578/4 Tiranë më 23.02.2016, kompanise i eshte vene ne dispozicion akt konstatimi në lidhje me këto gjetje me anë të shkresës Nr.Prot 2377/53 date 29.10.2021 si dhe email-it të datës 08.11.2021.

[7] *ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të tij/saj.*

IMB shpk ka shprehur gadishmërinë në observacionet e datës 11.11.2021 mbi asistencën e nevojshme për kthimin e sistemit në funksionalitet të plotë. Në datë 14.12.2021 i është bërë me dije kompanisë disponibiliteti i Projektit për të pritur ekspertët për të filluar procesin e mirëmbajtjes së sistemit. Takimi është zhvilluar në datë 17.12.2021 ora 9.00 në zyrat e projektit HSIP, ku ekspertët janë ri-informuar mbi problematikën, duke hyrë në serverin në të cilin është instaluar sistemi. Pas disa seanca pune online kompania realizoi sistemimin e diferencës për raportin "Uses of Funds by Activity", e konfirmuar kjo në emailin e datës 24.01.2022. Pasi u popullua sistemi me të dhënat e prapambetura, në fund të tremujorit të parë të vitit 2020, u vu re problematika në lidhje me gjendjen e bankës së nivelit të dytë problem i cili rezultonte që në vitin 2019. Në datë 1 Mars 2022 u kontaktua me kompaninë IMB shpk, për zgjidhjen e problematikës. Pas disa seancash online në datë 16.03.2022 u realizua shërbimi i mirëmbajtjes dhe raporti tremujor gjeneroi vlerat e sakta.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me objektivat rezultoi se në MSHMS janë dorëzuar të gjitha materialet sipas kontratës por nuk ka dokument të plotë të realizuar, dhe me shtyrjen e vazhduar në fund mund të mos mbetet kohë edhe për periudhën e nevojshme të implementimit të tij. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit HSIP fillestar (viti 2015) dhe Manuali Operacional i Projektit HSIP i rishikuar (viti 2019).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 36-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: MSHMS të botojë versionin final të Master Planit të përbërë nga materialet e hartuara si dhe të ngrejë ekipin që do të vërë në jetë implementimin e tij duke përfshirë dhe kryerjen e trajnimeve për stafet e spitaleve.

Në vijimësi
Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1237/10, datë 09.06.2022 "Mbi zbatimin dhe publikimin e Urdhërit për hartimin e Planit të veprimit për zbatimin e Planit të Racionalizimit Spitalor" Zv Ministri D. S. ka bërë me dije se botimi nuk është detyrim ligjor.
Urdhërin e zëvendësministrit Nr. 160 datë 07.03.2022 "Për hartimin e Planit të veprimit për zbatimin e planit të racionalizimit të rishikuar" është ngritur grupi i punës për hartimin e planit të veprimit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me objektivat rezultoi se këto të fundit janë ndryshuar vazhdimisht dhe nuk janë realizuar plotësisht. Projekti për përmirësimin e sistemit shëndetësor ka pasur që nga fillimi shumë vonesa në realizimin e objektivave duke ndryshuar vazhdimisht objektivat dhe afatet e duke vënë kësisoj në pikëpyetje realizimin e tyre, gjë kjo e cila përbën risk për mos përmbushje/realizim të Projektit brenda afateve të parashikuara dhe rritjen e kostove të tij me pasojë përdorim pa efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit HSIP fillestar (viti 2015) dhe Manuali Operacional i Projektit HSIP i rishikuar (viti 2019).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 36-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Nga ana e Zyrës së Koordinimit të Projektit në bashkëpunim me Grupet Teknike për secilin komponent dhe me dakordësinë e Bankës Botërore, të bëhet një analizë e plotë në lidhje me arsyet dhe përgjegjësitë konkrete të mosrealizimit të objektivave që kanë mbetur të parealizuara që nga fillimi i projektit dhe të hartohet një plan me objektiva konkrete e të matshme, me afate reale dhe të arritshme si dhe me persona përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Ekipet teknike kanë bërë analizën e kërkuar e cila është miratuar dhe nga Zëvendës Ministrja e Shëndetësisë sipas shkresës 1237/13 datë 21.06.2022. Gjithaashtu si rrjedhojë e vendosjes së afateve, është hartuar dhe Plani i Rishikuar i Prokurimit i cili përcakton afate të reja për zbatimin e aktiviteteve, i miratuar gjithashtu edhe nga BB. Me shkresën nr. 5222, datë 28.12.2021 është kërkuar rialokim fondeve në bazë të ecurisë së aktiviteteve dhe me shkresën nr.18/1, datë 19.01.2022 "Kthim përgjigje" është kërkuar zgjatja e afatit të projektit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)'* rezultoi se nga ana e Grupit Teknik të Punës të ngritur për përcaktimin e specifikimeve teknike, janë vendosur si kritere për aplikantët dhe ofertuesit mbi ato të nevojshme për kryerjen e këtij investimi. Konkretisht këto kritere rezultuan në lidhje me kategoritë e licencave të kërkuara jo në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të preventivit duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes së aplikantëve ne këtë fazë si dhe në lidhje me xhiron minimale vjetore e cila është kërkuar 1,010,521,744 lekë më tepër (sa dyfishi i vlerës së nevojshme 2,038,000,000 lekë – 1,027,478,256 lekë) se ai i përcaktuar sipas rregullave të parashikuara nga Banka Botërore. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit, konkretisht pikën 3.5.4 *Specifikimet Teknike* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi
Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Të gjitha kriteret e kualifikimit si pjesë përbërëse e dokumentit të procedurave respektive janë miratuar nga Banka Botërore, duke konfirmuar se kriteret janë në përputhje me nevojat (pa miratimin e të cilës nuk do të vijohej më tej me hapat e parashikuar për procedurat respektive).
MSHMS në vijim gjatë realizimit të procedurave të tjera do të mbajë në konsideratë të shtuar rekomandimin e dhënë nga ana juaj. Do të verifikohet në auditimin e radhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

5. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *'Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se në raportin e vlerësimit nga ana e Komisionit përkatës është cituar se: *'... çmimet janë plotësisht në përputhje me Manualin e Ndërtimit (sipas ligjit shqiptar) dhe në përputhje me BoQ të Projektit në lekë...'*. Gjithashtu, në faqen 13 të këtij materiali, paragrafi *Analizat e Çmimeve*, është cituar se *"Komisioni i Vlerësimit ka rishikuar me kujdes analizat e çmimeve nga të dy ofertuesit dhe arriti dhe gjithashtu bëri një krahasim me çmimet e përgatitura nga ana e shoqërisë e cila përgatiti hartimin e projektit'*. Në fakt, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e BOE të shpallur fitues S. T.L. S. & 4 .M. ShPK nuk disponohen në dosje të gjitha analizat e çmimeve të preventivit pasi janë paraqitur të tilla vetëm një material me 108 faqe e cila përmban 496 analiza çmimesh nga 1865 të tilla që duhet të ishin paraqitur. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional

i Projektit, konkretisht pikën 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë,* paragrafi i katërt si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: MSHMS në vijim gjatë realizimit të procedurave të tjera do të mbajë në konsideratë të shtuar rekomandimin e dhënë. Do të shihet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

6. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit'*, rezultoi se në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës janë paraqitur për ofertuesit e mundshëm disa kërkesa të cilat nuk janë në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të preventivit duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes së aplikantëve ne këtë fazë. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional i Projektit, konkretisht pikën 3.5.4 Specifikimet Teknike si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Të gjitha kriteret e kualifikimit si pjesë përbërëse e dokumentit të procedurave respektive janë miratuar nga Banka Botërore, duke konfirmuar se kriteret janë në përputhje me nevojat (pa miratimin e të cilës nuk do të vijohej më tej me hapat e parashikuar për procedurat respektive).
MSHMS në vijim gjatë realizimit të procedurave të tjera do të mbajë në konsideratë të shtuar rekomandimin e dhënë nga ana juaj. Do të verifikohet në auditimin e radhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

7. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se nuk konfirmohet kërkesat për Inxhinierin Elektrik të Terrenit si dhe për Inxhinierin Supervizor të Terrenit. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional i Projektit, konkretisht pikën 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë,* paragrafi i katërt si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: MSHMS në vijim gjatë realizimit të procedurave të tjera do të mbajë në konsideratë të shtuar rekomandimin e dhënë. Do të shihet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

8. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale, Loti 3 Radiologjia'*, rezultoi se në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës të dorëzuara Njësisë së Koordinimit të Projektit konstatohet se këto specifikimet nuk i janë referuar në asnjë rast standardeve të kërkuara për pajisjet objekt prokurimi. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se specifikimet teknike të vendosura nga ana e grupit teknik të punës nuk janë konform kërkesave të Manualit Operacional të Projektit pasi nuk përmbushin në mënyrën e duhur detyrimet e pikës 3.5.4 *Specifikime Teknike*. Me përjashtim të një rasti të vetëm ku është përmendura standardi EN 60601 – 1 – 1 – 3, në asnjë rast tjetër, këto specifikime nuk i janë referuar standardeve dhe nuk janë japin një deklaratë të qartë pasi në të gjitha rastet janë vendosur kufij minimal, maksimal apo kërkesa për parametra brenda një diapazoni të caktuar. Nga ana e Grupit Teknik nuk janë marrë masa për përdorimin e Standardeve ndërkombëtare apo shqiptare në hartimin e specifikimeve teknike. Sipas paragrafit 3.5.4 është kërkuar që gjatë hartimit të specifikimeve teknike duhet të merren në konsideratë:

- Konfirmimi me standardet;
- Përcaktim i qartë i natyrës së kërkesës;

Këto kritere, të cituara në mënyrë të tillë, përveç se nuk përmbushin kërkesat për të qenë të qarta dhe që ti referohen standardeve, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura për paracaktimin e operatorit ekonomik fitues. Sa më sipër është në kundërshtim me Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.5.4 *Specifikimet Teknike*, si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Të gjitha kriteret e kualifikimit si pjesë përbërëse e dokumentit të procedurave respektive janë miratuar nga Banka Botërore, duke konfirmuar se kriteret janë në përputhje me nevojat (pa miratimin e të cilës nuk do të vijohej më tej me hapat e parashikuar për procedurat respektive).

MSHMS në vijim gjatë realizimit të procedurave të tjera do të mbajë në konsideratë të shtuar rekomandimin e dhënë nga ana juaj. Do të verifikohet në auditimin e radhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

9. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale., Loti 3 Radiologjia'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se BOE S. M. ShPK dhe H. & L. ShPK nuk përmbushin

kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii), nuk disponojnë në certifikatën e konformitetit sipas Normës ISO 9001:2008, tek *Qëllimi*, Importim të pajisjeve teknologjike, nuk kanë specifikuar datën e saktë të fillimit dhe përfundimit të kontratave kryesore të furnizimit si dhe nuk përmbush kriterin në lidhje me referencën pasi kontrata për të cilinë ky subjekt ka paraqitur referencën përkatëse ka si objekt *"Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për vitin 2016"*. Kjo kontratë, nuk është kontratë furnizimi në radhë të parë por është kontratë mirëmbajtjeje dhe së dyti nuk cilëson zërat (pajisjet e mirëmbajtura). Edhe referenca për kontratën me objekt *"Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësorë për vitin 2015"* është me të njëjtën problematikë si më sipër.
Marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur me datë 15.03.2017 midis subjekteve H. & L. ShPK dhe S. M. ShPK rezulton se ka parashikuar në Draft përshkrimin e kontratës edhe kontributin mes palëve i cili do të jetë në raportet 85 % subjekti S. M. ShPK dhe 15 % subjekti H. & L. ShPK, në fakt referuar preventivit të kontratës dhe autorizimeve për të cilat këta subjekteve kanë marrë miratimin në lidhje me tregtimin e produkteve rezulton se ky raport është në masën 81 % S. M. ShPK dhe 19 % H. & L. ShPK. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: MSHMS në vijim gjatë realizimit të procedurave të tjera do të mbajë në konsideratë të shtuar rekomandimin e dhënë. Do të shihet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

10. Gjetje nga Auditimi: Për procedurën me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale., Loti 3 Radiologjia'*, në vijim të konkluzionit të arritur në lidhje me specifikimet teknike të cilat rezultuan se nuk janë zbatuar në përputhje me kërkesat e paragrafit 3.5.4 ku është kërkuar që këto specifikime ti referohen Standardeve dhe të jenë të tilla që të përfaqësojnë një deklaratë të qartë, grupi i auditimit krahasoi këto specifikime me ato të pajisjeve të JV S.M. ShPK & H. & L. ShPK të shpallur fitues (më hollësisht tabela e paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pika 2.4, gjetja nr. 7). Nga krahasimi si më sipër rezulton se këto parametra përveçse nuk janë të tilla që të kenë referencë standardet përkatëse apo të jenë një deklaratë e qartë e asaj çka kërkohet, por njëkohësisht ato janë të tilla që përputhen saktësisht me parametrat e ofruar nga ana e bashkimit të subjekteve të shpallur fitues duke mbështetur kështu konkluzionin e arritur në paragrafin e mësipërm sipas të cilit, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura me qëllim kualifikimin dhe shpalljen fitues të subjekteve S. M. ShPK & H. & L. ShPK. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit, konkretisht pikën 3.5.4 *Specifikimet Teknike* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Të gjitha kriteret e kualifikimit si pjesë përbërëse e dokumentit të procedurave respektive janë miratuar nga Banka Botërore, duke konfirmuar se kriteret janë në përputhje me nevojat (pa miratimin e të cilës nuk do të vijohej më tej me hapat e parashikuar për procedurat respektive).
MSHMS në vijim gjatë realizimit të procedurave të tjera do të mbajë në konsideratë të shtuar rekomandimin e dhënë nga ana juaj. Do të verifikohet në auditimin e radhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

11. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale,* Loti 1 *"Kujdesi Intensiv"*; Loti 4 *"Oftalmoskopi"*; Loti 6 *"Angiografi"*, rezultoi se specifikimet teknike të përcaktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës të dorëzuara Njësisë së Koordinimit të Projektit, nuk i janë referuar standardeve të kërkuara për pajisjet objekt prokurimi. Për të gjitha pajisjet dhe pjesët shoqëruese të tyre për Lotin 1, Lotin 4 dhe Lotin 6 rezulton se janë kërkuar parametra konkretë dhe/ose diapazone të tyre por në asnjë rast nuk janë cituar standarde referuese. Kjo situatë është konstatuar në të gjitha Lotet për pajisje si:
Loti 1: Defibrilator; Inkubator; Transportues inkubatori; Pompë infuzioni;
Pompë shiringash; Elktro-kirurgji; Nebulizator; Monitor; Makineri anestezie; Ventilatorë; EEG;
Loti 4: Auto refraktometër; Set lentesh; Kornizë lentesh; Etj;
Loti 6: Krahu – C; Imazhet digjitale dhe post – procesimi; Etj;
Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se specifikimet teknike të vendosura nga ana e grupit teknik të punës nuk janë konform kërkesave të Manualit Operacional të Projektit pasi nuk përmbushin në mënyrën e duhur detyrimet e pikës 3.5.4 *Specifikime Teknike*. Këto specifikime nuk i janë referuar standardeve dhe nuk janë japin një deklaratë të qartë pasi pothuajse në të gjitha rastet janë vendosur kufij minimal, maksimal apo kërkesa për parametra brenda një diapazoni të caktuar. Nga ana e Grupit Teknik nuk janë marrë masa për përdorimin e Standardeve ndërkombëtare apo shqiptare në hartimin e specifikimeve teknike. Sipas paragrafit 3.5.4 është kërkuar që gjatë hartimit të specifikimeve teknike duhet të merren në konsideratë:
- Konfirmimi me standardet;
- Përcaktim i qartë i natyrës së kërkesës;

Këto kritere, të cituara në mënyrë të tillë, përveç se nuk përmbushin kërkesat për të qenë të qarta dhe që ti referohen standardeve, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit, konkretisht pikën 3.5.4 *Specifikimet Teknike* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Të gjitha kriteret e kualifikimit si pjesë përbërëse e dokumentit të procedurave respektive janë miratuar nga Banka Botërore, duke konfirmuar se kriteret janë në përputhje me nevojat (pa miratimin e të cilës nuk do të vijohej më tej me hapat e parashikuar për procedurat respektive).
MSHMS në vijim gjatë realizimit të procedurave të tjera do të mbajë në konsideratë të shtuar rekomandimin e dhënë nga ana juaj. Do të verifikohet në auditimin e radhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

12. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale,* Loti 1 *"Kujdesi Intensiv"*; Loti 4 *"Oftalmoskopi"*; Loti 6 *"Angiografi"*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se:
Loti 1: OE M. SHPK nuk përmbush kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii), nuk ka specifikuar datën e saktë të fillimit dhe përfundimit të kontratave kryesore të furnizimi;
Loti 4: OE F. SHPK nuk përmbush kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii);
Loti 6: OE SH. d.o.o nuk përmbush kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii), në dokumentin e paraqitur me titull *Artikull i regjistrimit* nuk është në gjuhën angleze por në gjuhën kroate, veprim ky në kundërshtim me pikën G.C.C 5.1, nuk disponon certifikatën e konformitetit sipas Normës ISO 9001:2008, e cila është kërkuar të jetë për ofertuesin pasi certifikata e paraqitur ka si të përshkuar tek *Qëllimi, Shitje dhe shërbim të sistemeve mjekësore dhe pajisje analitike dhe pajisje mjekësore; shitje e produkteve medicinale* duke mos përmbushur kështu kriterin sipas të cilit është përcaktuar se: *"Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 për* ***import****, tregtim, instalim, mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore"*, nuk ka përcaktuar monedhën në të cilën janë shprehur çmimet e ofruar për pjesët në rast nevoje për periudhën 7 vjeçare pas periudhës së garancisë. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit, konkretisht pika 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi
Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: MSHMS në vijim gjatë realizimit të procedurave të tjera do të mbajë në konsideratë të shtuar rekomandimin e dhënë. Do të shihet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

13. Gjetje nga Auditimi: Projekti për objektin *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"*, është hartuar nga ana e BOE *R. S. & A. 4*, me të cilin sipas aktit me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, me datë 30.11.2016, është lidhur kontrata për shërbime konsulence mes këtij BOE dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Në zbatim të kontratës së shërbimit si më sipër nga ana e konsulentit është hartuar Projekti i ndërtimit të godinës së re dhe rikonstruksionit të godinës ekzistuese me një vlerë totale të parashikuar investimi 1,114,813,908 lekë me TVSH ose 7,987,879 euro me TVSH. Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *"4 ..M. & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 € me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se preventivi i hartuar nga ana e konsulentit përmban gabime në

metodologjinë e përdorur në hartimin e analizave të kostos për zërat e përfshirë në preventiv. Si përfundim, rezulton se nga ana e konsulentit janë preventivuar tepër shuma prej 31,396,973 lekë pa TVSH. (Aneksi 5.1, Tabelat 5.1.1, 5.1.2, 5.1.3 dhe 5.1.4). Sa më sipër është në kundërshtim:

- Me kontratën e shërbimit me objekt *"Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin pediatrik ekzistues"* me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016, konkretisht detyra 2 *Studimi dhe hartimi i projektit inxhinierik, Specifikimet Teknike dhe Preventivi*, sipas të cilës Projektuesi duhet të përgatisë edhe koston e investimit;
- Me VKM me nr. 629 datë 15.07.2015 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"*, Pika 1;
- Me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar: Pika 2; Pika 9 dhe Pika 11;
- Me Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*:

Kreu I, germa A, paragrafi i fundit, Kreu II, Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit, Germa B;

- Me Urdhrin nr. 410 datë 26.09.2016, administruar në MSHMS me nr. 2493/3 prot., datë 28.09.2016, pika 2 përgjegjësitë e Koordinatorit të Kontratës, paragrafi i dytë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 82-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve të personave me kualifikimet, njohuritë, angazhimin dhe nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Nuk ka pasur kontrata të reja deri në datën e aktkonstatimit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

14. Gjetje nga Auditimi: Projekti për objektin *"Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit"*, është hartuar nga ana e OE *A. 4*, në zbatim të kontratës për shërbime konsulence me objekt *"Vlerësim teknik, hartim projektesh civile, specifikime teknike, përllogaritje kostoje për Rikonstruksionin e një prej ndërtesave ekzistuese në Spitalin Pediatrik (objekti ekzistues Nr.2) në QSUT, Godinës së Kardiokirurgjisë (Angiologji) në QSUT – Tiranë dhe Spitalit Krujë dhe Spitalit Laç"* sipas aktit me nr. 236/3 prot., datë 16.01.2020. dhe me nr. reference HSIP/CS/SSS/07-2019. Për supervizimin e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit sipas aktit me nr. 140/5 prot., datë 28.01.2021 me nr. reference HSIP/CS//CQ/02-2020 mes MSHMS dhe A. 4 me vlerë të kontratës 45,000 Euro me TVSH. Aktualisht në lidhje me kontratën e konsulencës nuk është paraqitur asnjë kërkesë për pagesë. Në përfundim të procedurës së prokurimit të punimeve është shpallur fitues BOE *'C. N. C. D. P. E L. "C. M." S. C. P. A.'* me të cilin është lidhur kontrata me nr. 25/6 prot., datë 29.01.2021 me vlerë të kontratës 349,210,674 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të kontratës 4 muaj nga data e fillimit të punimeve. Aktualisht, deri në momentin e hartimit të këtij akt konstatimi nuk është paraqitur për miratim të palëve asnjë situacion pjesor. Sipas shkresës me nr. 140/8 prot., datë 01.06.2021 të përfaqësuesit të MSHMS drejtuar Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit, është kërkuar aprovimi i ndryshimit të stafit teknik dhe shtyrje afati të përfundimit të punimeve. Sipas shkresës me nr. 140/9 prot., datë 01.06.2021 të Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit është autorizuar zëvendësimi i stafit teknik për shtyrjen e afatit të përfundimit të kontratës duke ngarkuar kështu zyrën e Njësinë e Koordinimit të Projektit të kryejë procedurat për amendimin

e Kontratës. Në vijim sipas shkresës me nr. 25/27 prot., datë 08.06.2021 është amenduar kontrata *"Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit"* në lidhje me dy çështje:

1. Zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve nga 4 muaj në 5.5 muaj;
2. Ndryshimin e personelit të kontraktorit si më poshtë:

Nga sa më sipër rezulton se në asnjë rast të vetëm nuk dokumentohet të kenë qenë prezent në terren stafi teknik kryesor i sipërmarrësit me ata punonjës për të cilët ai është shpallur. Në kushte të tilla stafi teknik ka punuar pa marrë ende miratimin nga ana e konsulentit, menaxherit të kontratës të emëruar nga ana e MSHMS dhe vet Autoritetit Kontraktor MSHMS. Sipas amendamentit të kontratës punimet duhet të kishin përfunduar me datë 20.07.2021 kur në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, stafit të Zyrës së Koordinimit të Projektit dhe supervizorit të punimeve rezultoi se punimet ishin ende në fazat fillestare të saj. Konkretisht rezultoi se ishin në proces punimet për konstruksionin metalik dhe rezultuan të përfunduara punimet fillestare të saj vlera e të cilave është jo më shumë se 85,332,690 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përbën më pak se 30 % të vlerës se punimeve (pa TVSH dhe pa fond rezervë). Aktualisht rezulton se kontrata është në procedurat e miratimit të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve e lidhur me BOE *'C. N. C. DI P. E L. "C.M." S. C.P.A.'* me nr. 25/6 prot., datë 29.01.202, pikën 9.9.1 të kushteve të përgjithshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 95-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS dhe strukturave të ngritura për monitorimin e kontratave të merren masa për miratimet në kohë të ndryshime të kontratave me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve të Projekteve me financime dhe huaja.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Nuk ka pasur shtesa kontratash deri në datën e aktkonstatimit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

14.2 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për identifikimin e saktë të nevojave për realizimin e kohës të investimeve, duke marrë në konsideratë edhe situatat e veçanta siç ishte rasti i pandemisë së COVID 19, kjo me qëllim shmangien e afateve të shkurtra kohore të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në kriteret e vendosura në procedurat e prokurimit për këto investime.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Nuk ka pasur shtesa kontratash deri në datën e aktkonstatimit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

15. Gjetje nga Auditimi: Ekipi teknik i kontratës *"F.V. Rezonanca magnetike (MRI) për spitalin e Elbasanit"*, krahas ndryshimit të parametrave teknik, duke vendosur parametra më të ulëta se specifikimet teknike fillestare të hartuara për MRI, duhej njëkohësisht të reflektonte edhe ndryshimin e fondit të parashikuar për blerjen e rezonancës magnetike MRI, sipas specifikimeve teknike të reja të reflektuara dhe të miratuara nga BB. Për sa më lart, ekipi teknik ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e Manualit Operacional të Projektit HSIP, seksioni Technical Working Groups (TWG) *"Changes to ToR's and/or technical specifications including qualification criteria (including clarifications to these documents) and cost estimations are also responsibility of the TWG"*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 97-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rastet e ndryshimit të specifikimeve teknike, krahas tyre duhet të kërkoj nga komisioni përkatës reflektimin dhe ndryshimin edhe të fondit të parashikuar për atë procedurë prokurimi.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Nga data e hartimit të planit të veprimit është hapur vetëm një tender i hapur ndërkombëtar (ICB) ku përcaktimi i fondit të parashikuar është bërë nëpërmjet një studimi tregu.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

16. Gjetje nga auditimi: Ekipi i menaxhimit të kontratës ka miratuar kërkesën e konsulentit duke pranuar që punën e ngarkuar për ekspertin (KE5) të mbulohet dhe të realizohet nga dy ekspertë të tjerë ekzistues të ekipit z. M. W. dhe z. M. M., të cilët kanë detyra specifike dhe profesion jo të ngjashëm me z. M. F. (Quality Improvement Expert), si dhe CV jo të përshtatshme me kërkesat për pozicionin e ekspertit KE5. Gjithashtu këta dy ekspert kanë një angazhim të lartë kohorë, gjë që e bënë të pamundur edhe sikur të kishin ekspertizën, kualifikimin dhe përvojën ekuivalente me pozicionin e KE5, ata nuk mund të realizonin me sukses detyrën për shkak të ngarkesës që kanë në pozicionet e tyre fillestare, kryesisht z. M. W.. Për më tepër që në asnjë pikë të kontratës nuk është parashikuar shpërndarja e detyrave brenda ekipit për ekspertët që largohen, por është parashikuar me të drejtë zëvendësimi i tyre me një person me kualifikim e përvojë ekuivalente ose më të mirë, dhe masë shpërblimi të njëjtë, sipas parashikimit të nenit 19.1.1 pika f dhe nenit 30 të kontratës, si më poshtë e cituar:
Zëvendësimi i ekspertit kryesor:
Përveç rastit kur klienti me shkrim deklaron ndryshe, eksperti kryesor nuk mund të zëvendësohet.
Pavarësisht paragrafit më lart, gjatë ekzekutimit të kontratës, bazuar vetëm në kërkesën me shkrim të konsulentit, mund të bëhet edhe zëvendësimi i ekspertit kryesor.
Ky zëvendësim i ekspertit kryesor do te behet për arsye shëndetësore apo rast vdekje, të paparashikuara më parë nga konsulenti.
Në një rast të tillë, konsulenti menjëherë do të gjejë zëvendësues, person me kualifikim e përvojë ekuivalente ose më të mirë, dhe masë shpërblimi të njëjtë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 106-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rast të kërkesave të konsulenteve për zëvendësim të eksperteve kryesor të tyre, të miratoi vetëm zëvendësimet me ekspert të tjerë, që kanë kualifikim të njëjtë ose më të lartë se ata që zëvendësojnë dhe mos të miratoi kërkesa për shpërndarje të detyrave tek ekspertët ekzistues të kontratës.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Deri në mbajtjen e këtij Aktkonstatimi nuk ka pasur kërkesa për ndryshim.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

17. Gjetje nga auditimi: Sistemi i Menaxhimit Financiar për 420 QSH nuk funksionon dhe për këtë arsye, në lidhje me zbatimin e kontratës së shërbimit, grupi i auditimit bëri verifikime në FSDKSH, DRF Tiranë, QSH nr. 5, dhe nr. 8, DRF Shkodër, QSH nr. 2 dhe nr. 4, DRF Kukës si dhe DRF Elbasan. Gjithashtu, mbi funksionimin e këtij sistemi, u krye një tjetër verifikim në prani të specialistit të IT të FSDKSH mbi funksionalitetin e sistemit në serverat e Fondit ku është instaluar aplikacioni dhe databaza e tij. Gjatë verifikimit, u konstatua se aksesimi në Server Mananger administrohet nga IMB si për aplikacionin ashtu dhe për data bazën. Për shkak të administrimit të serverit nga IMB, grupi i auditimit dhe specialisti i IT të Fondit, nuk mundën të logoheshin për të marrë log-in. Gjithashtu edhe specialistit i IT të FSDKSH nuk u aksesua dot as në nivel user. Nga auditimi rezulton se aktiviteti ekonomiko financiar në Drejtoritë Rajonale të Fondit dhe në Qendrat Shëndetësore, vazhdon të realizohet njësojë, si përpara kryerjes së këtij investimit përmes programit Excel. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe konstatimeve të bëra nga vetë përdoruesit final

të këtij programi, trajnimet e zhvilluara për përdorimin e sistemit të menaxhimit financiar në QSH nga IMB kanë qenë të pa mjaftueshëm.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 98-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
17.1 Rekomandimi: MSHMS në bashkëpunim me FSDKSH të marrin masa për vendosjen në funksion të sistemit të menaxhimit financiar në 420 qendrat shëndetësore.

Menjëherë

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: MSHMS ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e FSDKSH për vënien në funksionalitet të softit të menaxhimit fiannciar në 420 Qendra Shëndetësore. Me shkresën Nr. 2377/65 datë 18.02.2022 është njoftuar zyrtarisht FSDKSH për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

- Më datë 13.05.2022 MSHMS ka ridërguar kujtesë tek FSDKSH për marjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.
- Më datë 01.06.2022 MSHMS ka ridërguar kujtesë tek FSDKSH për marjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.
- Më datë 08.06.2022 FSDKSH ka njoftuar MSHMS se sistemi ende nuk është funksional.
- Sipas shkresës Nr. 1237/12 prot datë 20.06.2022 MSHMS pret nga FSDKSH marrjen e masave institucionale për vënien në funksion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

17.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me FDSKSH të hartojnë planin e punës për trajnimin e specialistëve të financës së Qendrave Shëndetësore dhe Drejtorive Rajonale të Fondit, që do jenë përdorues të sistemit të menaxhimit financiar.

Menjëherë

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: me Urdhrin nr. 430, datë 21.07.2022 të Zv Ministrit është ngritur grupi i punës për hartimin e planit të trajnimeve të specialistëve.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

18. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, kontrata për *"Mbështetjen e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë se re për menaxhimin e QSUT"* nuk është realizuar me sukses. Në zbatim të kushteve të kontratës klauzolës 9.1, konsulenti Coseil Sante, duhej të dorëzonte brenda afateve kohore të përcaktuara në kontratë dhe të pasqyruara në tabelën nr. 2 aneksi nr. 5. Pas dorëzimit të raporteve respektive sipas fazave dhe kërkesave të përcaktuara në Termat e Referencës (TOR) dhe të pasqyruara në kontratë, konsulenti duhet ti dorëzonte pranë ekipit te menaxhimit të kontratës në formatin hard copy dhe elektronik me e-mail raportet dhe dokumentacionin e kërkuar. Ekipi i menaxhimit në zbatim të klauzolës (kushtet specifike) neni 41.2 afati i komenteve, duhet që brenda 21 ditëve nga dita e dorëzimit të raporteve të bej komentet. Të dhënat analitike mbi dorëzimin e raporteve respektive sipas fazave dhe datave gjenden në aneksin nr. 5 tabela nr. 2. Për sa më lart, kontrata me konsulentin ndërkombëtar për një strategji të re të menaxhimit të QSUT, do të konsiderohet e pasuksesshme në drejtim të dorëzimit të produkteve/raporteve sipas fazave dhe respektimit të afatit kohorë të përfundimit të kësaj kontrate, brenda datës 06.06.2021. Nga auditimi i kësaj praktike rezultoi gjithashtu se kontrata e lidhur mes palëve nuk ka të përfshirë penalitete për dorëzimin me vonesë të produkteve kontratës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 106-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për përfundimin e kontratës "Mbështetja e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i

strategjisë se re për menaxhimin e QSUT" dhe në bashkëpunim me QSUT, të hartojë planin e veprimeve për fillimin e implementimit të saj.

Menjëherë

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Me shkresën nr. 23.06.2021 është bërë miratimi i produkteve finale të kontratës të cilat ishin paraqitur në në prill dhe maj 2021 dhe fatura finale 04.06.2021(afati i përfundimit datë 06.06.2021). QSUT sipas shkresës hyrëse Nr. 1332 prot datë 18.03.2022 ka vënë në dispozicion planin e masave të QSUT si dhe na ka vënë në dispozicion Urdhërin Nr.386 datë 07.09.2021 "Për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë së re të menaxhimit të QSUT. Do të konsiderohet e zbatuar edhe do të verifikoet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Zbatuar

18.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për përfshirjen në kontratat e ardhshme të klauzolave në lidhje me aplikimin e penaliteteve për dorëzimin me vonesë të produkteve këtyre kontratave.

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: me emailin e datës 13.06.2022 BB ka konfirmuar se nuk aplikohen penalitete për kontratat e shërbimeve të konsulencës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar nga BB

19. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se emërimi i Drejtores së Kabinetit znj. E. H., me Urdhër nr. 96, datë 11.03.2016 të Ministrit të MSHMS në pozicionin e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit është kryer në kundërshtim me kërkesat e parashtruara nga Manuali Operacional i Projektit të vitit 2015 si dhe atyre të Manualit Operacional të ndryshuar në vitin 2019, sipas të cilit është shprehur se në këtë pozicion duhet të emërohet Zv. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Njëkohësish duhet theksuar fakti se ky emërim është kryer në kundërshtim edhe me Rregulloren e Brendshme të MSHMS, pasi funksionaret e Kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional i Projektit, varianti i parë i vitit 2015 si dhe ai i ndryshuar në vitin 2019, pika 2.1 Angazhimet Institucionale dhe Zbatuese, paragrafi i parë si dhe me Rregulloren e Brendshme *"Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale"*, neni 3, pika 2, germa c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për zëvendësimin e Koordinatorit të Përgjithshëm aktual të Projektit dhe emërimin në këtë pozicion të funksionarëve sipas kërkesave të parashtruara nga Manuali Operacional i Projektit.

Menjëherë

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Projekti HSIP ka ndryshuar strukturën organizative sipas Manualit Operacional të miratuar nga Banka Botërore më datë 17 Qershor 2022, dhe në kaudër të riorganizimit të strukturës Koordinatorja e Përgjithshme e Projektit është liruar nga pozicioni i saj (sipas Urdhërit të Zëvendës Ministrit nr. 374 datë 20.06.2022) dhe pozicioni i Koordinatorit të Përgjithshëm të projektit nuk është më pjesë e organigramës së projektit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Pagesa e mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit financiar në 420 QSH për garanci 11 muaj Nëntor 2018-Shtator 2019" në shumën **2,089,995.60 lekë**, është bërë nga

zyra e financës së projektit HSIP mbi bazën e shkresës nr. 3371/1 datë 22.05.2020, të ish Drejtoreshës së FDSKSH mbi konfirmimin e funksionalitetit të sistemit nga ish Drejtoresha e FDSKSH. (shiko aneksin nr. 5 foto nr. 5). Pra sipas ish Drejtoreshës së FDSKSH, sistemi i menaxhimit financiar në 420 QSH, duhet të shërbente për menaxhimin e procesit të planifikimit, miratimin dhe ekzekutimit të buxhetit financiar të alokuara nga FDSKSH për Drejtorit Rajonale të Fondit dhe Qendrave Shëndetësore, për të realizuar më konkretisht:

1. Planifikimin e Buxhetit në nivel Drejtorie dhe qendre;
2. Miratimin e buxhetit në nivel Drejtorie dhe qendre;
3. Detajimin e buxhetit vetjak nga QSH dhe miratimi i tij nga Drejtoria Rajonale;
4. Shpërndarjen e buxhetit nga ana e QSH;
5. Ekzekutimin e buxhetit në nivel Qendre Shëndetësore;
6. Regjistrimin e transaksioneve kontabël në çdo QSH;
7. Raportimin në nivel Fondi, DRF dhe QSH;
8. Raportimin për çdo modul, në nivel përmbledhës dhe analitik.

Pra, nga sa ka konfirmuar ish Drejtoresha e FSDKSH, nënkupton që këto objektiva janë realizuar nga sistemi i menaxhimit financiar për të 420 QSH. Në lidhje me zbatimin e kontratës, grupi i auditimit bëri verifikime në FSDKSH, DRF Tiranë, QSH nr. 5, dhe nr. 8, DRF Shkodër, QSH nr. 2 dhe nr. 4, DRF Kukës si dhe DRF Elbasan për sistemin e menaxhimit financiar. Krahas verifikimit mbi funksionalitetin e sistemit të menaxhimit financiar në QSH dhe DRF e sipërcituara, Grupi i Auditimit të KLSH kreu një verifikim në serverin e FSDKSH të sistemit të menaxhimit financiar, ku edhe është instaluar aplikacioni dhe data baza e tij. Në këtë verifikim pranë FSDKSH, grupi u shoqërua nga specialisti IT i Fondit. Nga verifikimi rezultoi se aksesimi në Server Mananger administrohet nga kompania IMB si për aplikacionin ashtu dhe për databazën. Për shkak se administrimi i serverit bëhet nga IMB, grupi i auditimit dhe specialisti i IT i Fondit, nuk mundën të logoheshin për të marrë log-inet e gjeneruara për sistemin e menaxhimit financiar në 420 Qendrat Shëndetësore. Gjithashtu specialisti i IT të FSDKSH, nuk u aksesua dot as në nivel user, çka tregon që sistemi i menaxhimit financiar në 420 QSH, **nuk funksionon dhe nuk është i aksesueshëm për përdoruesit e sistemit të kujdesit shëndetësor parësor**. Pra, shuma prej **2,089,995.60 leke** e shpenzuar si pagesë për garancinë e sistemit konsiderohet dëm ekonomik, pasi sistemi nuk aksesohet dhe nuk funksionon dhe nuk ka realizuar qëllimin dhe objektivat për të cilat është prokuruar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 98-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: MSHMS në bashkëpunim me FDSKSH të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **2,089,995.60 lekë** nga ana e bashkimit të operatoreve "IMB-Instituti i Modelimeve në Biznes & BNT Electronics" për mos sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar për 420 QSH dhe mos aksesimin dhe funksionimin e tij, duke përfituar këtë shumë në mënyrë të padrejtë dhe të pa meritуar dhe në mospërputhje me kushtet e kontratës për mirëmbajtjen e sistemit.

Menjëherë

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Datë 29.04.2022 IBM ka kthyer shumën 2,089,995.6 lekë.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me investimin me objekt *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* nga auditimi rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *"4 .M. & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr.

HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 € me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Supervizimi i punimeve është kryer nga BOE *"R. S. & A. 4"*, për të cilin kontrata e konsulencës si më sipër, ka pasur të parashikuar edhe këtë lloj shërbimi. Deri në përfundim të punës audituese në terren u konstatuar se nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë dorëzuar në total 4 pagesa pjesore (IPC) me vlerë totale progresive 733,789,828.26 lekë me TVSH, ose 66.8 % e vlerës totale të kontratës. Punimet e situacionuara lidhen me ato që i takojnë ndërtimit të shtesës anësore pasi punimet për rikonstruksionin e godinës ekzistuese nuk kanë filluar akoma për shkak të ndryshimeve të nevojshme që kanë lindur për projektin prej tërmetit të vitit 2019. Nga analiza e preventivit të punimeve si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ana e sipërmarrësit të punimeve (BOE) rezultojnë disa problematika në lidhje me zërat

- *Ngritje, mobilim dhe kompletim me pajisje, mirëmbajtje, furnizim me tërë komponentët e nevojshëm dhe çmontim e zyrave te menaxhimit te kantierit. Këto zyra duhet të kenë ambiente të mjaftueshme pune për kontraktorin, supervizorin dhe investitorin. Në këto ambiente përfshihet edhe një hapësirë e mjaftueshme për ruajtjen në kushte të përshtatshme të mostrave dhe kampioneve që do të merren për provë apo testim gjatë kryerjes së punimeve;*
- *F.V. Të dy tabelave informuese për projektin+ bazamentin përkatës +çmontim në përfundim të punimeve. Gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve kontratave kontraktori obligohet që të marrë të gjitha masat për rregullimin e komunikacionit, sigurisë në kantier dhe sigurisë së mjeteve dhe këmbësorëve;*
- *F.V. Rrethim i përkohshëm me llamarinë të valëzuar + aksesoret. Rrethimi do bëhet me zona sipas plan organizimit të punimeve. Në çmim përfshihet, furnizimi dhe vendosja e llamarinës, menaxhimi i hyrje daljeve në kantier, sigurimi i lëvizjes së këmbësorëve gjatë ndërtimit, heqja e rrethimit, pastrimi i zonës në përfundim të punimeve. Çdo dëmtim i rrethimit nga banorët apo mjetet do të zëvendësohet nga kontraktori pa kosto shtesë;*

Në total rezulton se janë likuiduar për këto tre zëra shuma prej 1,800,000 lekë pa TVSH. Në fakt, referuar metodologjisë së ndjekur nga ana e hartuesve të Projekt – preventivit e cila i është referuar strukturës së kostos me nën-zërat *Punëtori*, *Transport*, *Makineri* dhe *Materiale*, kontratës së lidhur mes MSHMS dhe Projektuesit, neni 12 citon se ligji udhëheqës i kontratës do të jetë ai shqiptar. Për rrjedhoje shuma e mësipërme përbën përdorim pa efektivitet eficniencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit pasi punimet për zërat e mësipërm janë të përfshira në realizimin e punimeve të ndërtimit (shpenzimet plotësuese) dhe si të tilla nuk mund të parashikohen si zëra më vete. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 08.05.2002 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*"*, Kreu II, germa B *SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI*, paragrafi, *Shpenzime të Përgjithshme* si dhe me kontratën e Zbatimit të Punimeve Specifikimet Teknike, pika 1.3 *ELEMENTËT E PËRFSHIRË TEK ÇMIMET*, paragrafi i katërt.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 87-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve, në grupet e ngritura për vlerësimet e ofertave si dhe në grupet e ngritura për monitorimin e kontratave të personave me kualifikimet, njohuritë, angazhimin dhe nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit siç është ai rastit në shumën **1,800,000 lekë pa TVSH.**

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Deri në datën e mbajtjes së Aktkonstatimit nuk ka kontrata të reja.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me investimin me objekt *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* nga auditimi rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *"4.M .& U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 € me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Nga auditimi rezultoi se për 26 zëra punimesh analizat e kostove për këto zëra janë hartuar si të ishin punime të mirëfillta ndërtimi, kur në fakt këto janë punime të nënkategorisë *Punime të Teknologjisë dhe të Montimit*, nënkategoria *Punime Montimi.* Duke bërë korrigjimet përkatëse rezulton se shuma prej 4,018,027 lekë pa TVSH përbën përdorim pa efektivitet, eficinencë dhe ekonomicitet i fondeve të Projektit. Sa më sipër është në kundërshtim:

- Me kontratën e shërbimit me objekt *""Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin Pediatrik ekzistues" dhe me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016*, konkretisht Aneksi A Termat e Referencës dhe Qëllimi i Shërbimeve, pika 3 *Objektivat Specifikë* , nënpika 4, pika 3 *Detyrat e Shërbimit*, nënpika 4 si dhe pika 6, Faza III;
- Me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, neni 1, neni 2 dhe neni 3;
- Me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7;
- Me VKM nr. 514, date 15.8.2007 *"Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar*, pika 10;
- Me Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, germa A, paragrafi pas pikës 7;
- Kreu II, *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Shpenzimet e Përgjithshme dhe Fitimi*, Kreu II *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Fitimi i Sipërmarrësit*, Germa B *SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI*, paragrafi, *Shpenzime të Përgjithshme*;
- Me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3;
- Me Urdhrin nr. 670, me nr. 3629/13 prot., datë 02.10.2019 sipas të cilit janë emëruar inxhinier të kontratës së punimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 87-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve, në grupet e ngritura për vlerësimet e ofertave si dhe në grupet e ngritura për monitorimin e kontratave të personave me kualifikimet, njohuritë, angazhimin dhe nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit siç është ai rastit në shumën **4,018,027 lekë pa TVSH.**

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Deri në datën e mbajtjes së Aktkonstatimit nuk ka kontrata të reja.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

3. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me investimin me objekt *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* nga auditimi rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *"4 .M .& U. I.T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 € me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Punimet për rikonstruksionin e godinës nuk kanë filluar akoma për shkak të ndryshimeve të nevojshme që kanë lindur për projektin

prej tërmetit të vitit 2019. Në mënyrë të ngjashme me konstatimin e përshkruar si më sipër, i njëjti gabim në strukturën e kostos është kryer edhe për zërat e ofertuar për punimet e godinës ekzistuese, sikurse edhe për ato të godinës shtesë. Konkretisht, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e BOE, edhe për punimet e rikonstruksionit të godinës ekzistuese, për ato raste që është paraqitur analiza teknike e çmimeve, problematika e metodologjisë së hartimit të strukturës së kostos dhe ato për punimet për ngritjen e kantierit, tabelën informuese dhe rrethimin e përkohshëm janë të njëjta me ato të përshkruara si më sipër për punimet e ndërtimit të shtesës anësore. Duke bërë llogaritjet, rezulton se janë kontraktuar punime në shumën 1,200,000 lekë pa TVSH për punimet e ngritjes së kantierit, vendosjes së tabelës dhe punimeve të rrethimit si dhe shuma prej 14,634,264 lekë pa TVSH për punime të ndryshme, vlera totale e të cilave është në masën **15,834,264 lekë pa TVSH**, shumë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet, eficinencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit si rrjedhojë e mos respektimit të strukturës së kostos për disa prej zërave të preventivit. Sa më sipër është në kundërshtim:

- Me kontratën e shërbimit me objekt *""Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin Pediatrik ekzistues" dhe me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016*, konkretisht Aneksi A Termat e Referencës dhe Qëllimi i Shërbimeve, pika 3 *Objektivat Specifikë* , nënpika 4, pika 3 *Detyrat e Shërbimit*, nënpika 4 si dhe pika 6, Faza III;
- Me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, neni 1, neni 2 dhe neni 3;
- Me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7;
-Me VKM nr. 514, date 15.8.2007 *"Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar*, pika 10;
- Me Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, germa A, paragrafi pas pikës 7;
- Kreu II, *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Shpenzimet e Përgjithshme dhe Fitimi*, Kreu II *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Fitimi i Sipërmarrësit*, Germa B *SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI*, paragrafi, *Shpenzime të Përgjithshme*;
- Me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3;
- Me Urdhrin nr. 670, me nr. 3629/13 prot., datë 02.10.2019 sipas të cilit janë emëruar inxhinier të kontratës së punimeve.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 87-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve, në grupet e ngritura për vlerësimet e ofertave si dhe në grupet e ngritura për monitorimin e kontratave të personave me kualifikimet, njohuritë, angazhimin dhe nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit siç është ai rastit në shumën **15,834,264 lekë pa TVSH.**

Në vijimësi

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Deri në datën e mbajtjes së Aktkonstatimit nuk ka kontrata të reja.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

4. Gjetje nga auditimi: Në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 377 date 08.09.2015 është përcaktuar që adresa e Njësisë së Koordinimit të Projektit HSIP të jetë Ministria e Shëndetësisë:

Bulevardi "Barjam Curi" nr. 1. Ndërkohë njësia e koordinimit te projektit (PCU) ushtron aktivitetin në një apartament të marrë me qira me adresë: Rruga "Shyqyri Bërxolli" Ap. 24A, Tiranë. MSHMS me pretendimin e mungesës së ambienteve për njësinë e koordinimit të projektit HSIP, fillimisht e ka akomoduar në godinën e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (akomoduar përkohësisht) dhe më pas nëpërmjet Koordinatores së përgjithshme të projektit HSIP, znj. E. H. drejtuar njësisë së koordinimit të projektit HSIP me shkresën nr. 2553 prot. datë 29.05.2020 me objekt "Mbi nevojën e përdorimit nga zëri i kostove operative të projektit HSIP" duke propozuar përdorimin e zërit të kostove operative të projektit të një shume, për kosto qiraje për zyra dhe kosto të tjera operative të lidhura me to (si shpenzime energji elektrike, uji, internet, transportim materialesh dhe dokumentacioni etj.) me qellim garantimin e vijimësisë së punës së PCU. Koordinatorja e përgjithshme e projektit HSIP, ka autorizuar njësinë e koordinimit të projektit që të ndjek procedurat e miratimit pranë Bankës Botërore, për përdorimin e këtij zëri për kostot operative. **Vlera 672,993 lekë** [(1,390,567-(1,390,567*0.51603)] e përllogaritur si diferencë e shumës totale të shpenzuar të realizuara nga njësia e koordinimit të projektit HSIP dhe shumes potenciale të shpenzimeve që duhet të bëhej nga njësia e koordinimit të projektit HSIP për shpenzimet e qirasë së ambientit në përputhje me parashikimet e VKM 469 date 03.06.2015 *"Për përcaktimin e vlerës minimale te çmimit te referencave te qirave te ndërtesave për qëllime tatimore"* do të konsiderohet si shpenzim jo efektiv, i cili ka rritur artificialisht kostot e shpenzimeve të projektit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 30-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa që njësia e koordinimit të projektit HSIP, të akomodohet në ambientet e saj, në rast të pamundësisë së ambienteve, të nisë një procedurë të re ligjore për lidhjen e kontratës së qerasë për një ambient privat për zyra, duke patur parasysh optimizimin e shpenzimeve për këtë zë buxhetor të projektit.

Deri më datën 01.07.2022

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Draft Projekt Raporti i KLSH me Nr. Prot 2377/52 datë 13.10.2021 parashikonte se afati për zbatimin e rekomandimit të mësipër ishte data 31 Dhjetor 2021. Meqenëse deri në këtë datë PCU nuk kishte dijeni mbi raportin përfundimtar dhe shtyrjen e afatit për këtë rekomandim nga 31.12.2021 në 01.07.2022, PCU filloi një procedurë të re si më poshtë:

- Më datë 25.12.2021 është publikuar në faqen e Web-it të MSHMS dhe në gazetën Panorama (për 4 ditë) kërkesa për ofertë me afat deri më 29.12.2021, me qëllim përfundimin e procedures Brenda afateve të përcaktuara nga KLSH.
- Më datë 29.12.2021 sipas procesverbalit me të njëjtën datë, ekipi i blerjeve me vlera të vogla (ngritur me Urdhër Ministri Nr.3 datë 14.10.2021) ka shqyrtuar tri ofertat e paraqitura.

- Çmimi fitues ka qenë sërisht 600 Euro në muaj me fitues z. F. K. i cili ka rezultuar fitues pas publikimit të kërkesës për ofertë.
- Më datë 31 Dhjetor 2021, është lidhur kontrata midis MSHMS dhe z. F. K..

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Aktiviteti financiar i projektit HSIP mbahet dhe përpunohet me programin Excel dhe jo me programin Alfa PMR. Mungesa e përdorimit të këtij programi financiar nga ana e Njësisë së Koordinimit të Projektit është në mospërputhje me përcaktimet: POM-Annex 22- Accounting Software Technical Specification TECHNICAL SPECIFICATION - Project Accounting Software Application, ku është përcaktuar që aktiviteti financiar i projektit dhe gjenerimi i raporteve financiare do të bëhet me Programe software-ike për menaxhimin e projekteve duke përcaktuar programin Alpha PMR. Për rrjedhojë shuma **576,000 lekë** do të konsiderohet si një shpenzim jo efektiv që ka rritur kostot e shpenzimeve të projektit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 27-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: MSHMS të analizojë problematikën në lidhje me programin financiar Alpha PMR për projektin *"Për përmirësimin e sistemit shëndetësor"*, pasi mosfunksionimi i tij e ka bërë jo efektiv shpenzimin prej **576,000 lekë**, duke rritur artificialisht kostot e shpenzimeve të këtij projekti.

Menjëherë

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: ALFA PMR është funksional dhe gjeneron raporte të sakta. Referuar gjetjeve te audituesve të KLSH mbi funksionalitetin e programit Alpha PMR, si dhe kontratës së nënshkruar midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe kompanisë Instituti i Modelimeve në Biznes (IMB) me Nr. Prot 578/4 Tiranë më 23.02.2016, kompanise i eshte vene ne dispozicion akt konstatimi në lidhje me këto gjetje me anë të shkresës Nr. Prot 2377/53 date 29.10.2021 si dhe email-it të datës 08.11.2021.

IMB shpk ka shprehur gadishmërinë në observacionet e datës 11.11.2021 mbi asistencën e nevojshme për kthimin e sistemit në funksionalitet të plotë. Në datë 14.12.2021 i është bërë me dije kompanisë disponibiliteti i Projektit për të pritur ekspertët për të filluar procesin e mirëmbajtjes së sistemit. Takimi është zhvilluar në datë 17.12.2021 ora 9.00 në zyrat e projektit HSIP, ku ekspertët janë ri-informuar mbi problematikën, duke hyrë në serverin në të cilin është instaluar sistemi. Pas disa seanca pune online kompania realizoi sistemimin e diferencës për raportin "Uses of Funds by Activity", e konfirmuar kjo në emailin e datës 24.01.2022. Pasi u popullua sistemi me të dhënat e prapambetura, në fund të tremujorit të parë të vitit 2020, u vu re problematika në lidhje me gjendjen e bankës së nivelit të dytë problem i cili rezultonte që në vitin 2019. Në datë 1 Mars 2022 u kontaktua me kompaninë IMB shpk, për zgjidhjen e problematikës. Pas disa seancash online në datë 16.03.2022 u realizua shërbimi i mirëmbajtjes dhe raporti tremujor gjeneroi vlerat e sakta.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: i zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha QSH apo DRF respektive në të cilat u kryer verifikim fizik mbi funksionalitetin e sistemit të menaxhimit financiar në Tiranë, Elbasan, Shkodër dhe Kukës u konstatua se, këto njësi nuk aksesoheshin në sistemin e menaxhimit financiar, pasqyruar në prt.scr në aneksin nr. 5 foto nr. 8 dhe foto nr. 9. Gjatë verifikimit për funksionalitetin e sistemit financiar Drejtori i DRF Kukës konfirmoi që sistemi nuk funksionon dhe QSH vazhdojnë të operojnë me programin Excel. Gjithashtu dhe në DRF Elbasan dhe QSH rezulton e njëjta situatë. Për sa më sipër, vlera e blerjes së sistemit prej **45,600,000 lekë** konsiderohet si një shpenzim jo eficent dhe efektiv, pasi sistemi nuk funksionon dhe nuk plotëson kërkesat e kërkuar sipas specifikimeve teknike dhe qëllimit të tij për të shërbyer për menaxhimin e procesit të planifikimit, miratimin dhe ekzekutimit të buxhetit financiar të alokuara nga FDSKSH për Drejtorit Rajonale të Fondit dhe Qendrave Shëndetësore duke mos realizuar edhe objektivat kryesor siç janë Efektiviteti, Digjitalizimi, strukturimi i të dhënave, administrimi, reduktim i kostove menaxheriale, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 98-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: MSHMS të analizojë problematikën në lidhje me sistemin e menaxhimit financiar në 420 qendrat shëndetësore, pasi mosfunksionimi dhe mospërdorimi i tij, nga sistemi i kujdesit shëndetësor parësor, e ka bërë jo efektiv shpenzimin prej **45,600,000 lekë**, duke mos realizuar qëllimin dhe objektivat për të cilat është prokuruar.

Menjëherë

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: MSHMS ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e FSDKSH për vënien në funksionalitet të softit të menaxhimit fiannciar në 420 Qendra Shëndetësore. Me shkresën Nr. 2377/65 datë 18.02.2022 është njoftuar zyrtarisht FSDKSH për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

- Më datë 13.05.2022 MSHMS ka ridërguar kujtesë tek FSDKSH për marjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.
- Më datë 01.06.2022 MSHMS ka ridërguar kujtesë tek FSDKSH për marjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.
- Më datë 08.06.2022 FSDKSH ka njoftuar MSHMS se sistemi ende nuk është funksional.
- Sipas shkresës Nr. 1237/12 prot datë 20.06.2022 MSHMS pret nga FSDKSH marrjen e masave institucionale për vënien në funksion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

E. MASA DISIPLINORE

E/I. Për punonjësit marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Ligjin "Për nëpunësin civil":

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", germat (b, c, ç) e nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën nga fillimi i Projektit (2015) deri më 31.05.2021, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore ***"Vërejtje"*** për **8 punonjës**, si më poshtë:

1. Znj. J. D., **me detyrë Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse**

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1470, datë 29.03.2022 është njoftuar nëpunësi civil për ecurinë disiplinore, Procedura ende nuk finalizuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2. Znj. J. J., **me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Koncesioneve, PPP dhe Prokurimeve.**

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

3. Znj. F. B., **me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**.

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1082, datë 01.03.2022 "Njoftohet nisja e ecurisë disiplinore dhe data e zhvillimit të seancës dëgjimore".

Me shkresën nr. 1082/1, datë 08.03.2022 ""Procesverbal për seancën dëgjimore në kuadër të procedimit ...

Procesverbal nr. 1082/4, datë 20.04.2022 "Për seancën dëgjimore..."

Vendimi Përfundimtar nr. 1082/5 datë 26.04.2022 është konfirmuar mos fillimi i masës disiplinore.

Me shkresën nr. 1082/6, datë 18.05.2022 "Dërgohet Njoftimi i Vendimit" në DAP

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

4. Znj. D. K., **me detyrë Përgjegjëse Sektori**.

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1086/3, datë 08.04.2022 "Përcillet për njohje edhe zbatim", Nuk ka filluar ecuria disiplinore ende.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

5. Z. O. A., me detyrë Përgjegjës Sektori:
Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1086/4, datë 14.04.2022 "Njoftohet nisja e ecurisë disiplinore dhe data e zhvillimit të seancës dëgjimore".
Me shkresën nr. 1086/5, datë 21.04.2022 "Procesverbal për seancën dëgjimore në kuadër të procedimit ..."
Vendimi Përfundimtar nr. 1086/6 datë 21.04.2022 është konfirmuar mos fillimi i masës disiplinore.
Me shkresën nr. 1086/7, datë 26.04.2022 "Dërgohet Njoftimi i Vendimit" në DAP.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

6. Znj. B. M., me detyrë Specialist
Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1086/8, datë 13.05.2022 "Njoftohet nisja e ecurisë disiplinore dhe data e zhvillimit të seancës dëgjimore".
Me shkresën nr. 1086/9, datë 19.05.2022 "Procesverbal për seancën dëgjimore në kuadër të procedimit ... "
Vendimi Përfundimtar nr. 1086/10 datë 29.05.2022 është konfirmuar mos fillimi i masës disiplinore.
Me shkresën nr. 1086/11, datë 29.05.2022 "Dërgohet Njoftimi i Vendimit" në DAP
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

7. Znj. L. P., me detyrë Specialiste.
Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1083, datë 01.03.2022 "Njoftohet nisja e ecurisë disiplinore dhe data e zhvillimit të seancës dëgjimore".
Me shkresën nr. 1083/1, datë 08.03.2022 "Procesverbal për seancën dëgjimore në kuadër të procedimit ... "
Procesverbal nr. 1083/4, datë 20.04.2022 "Për seancën dëgjimore..."
Vendimi Përfundimtar nr. 1083/5 datë 26.04.2022 është konfirmuar mos fillimi i masës disiplinore.
Me shkresën nr. 1083/6, datë 18.05.2022 "Dërgohet Njoftimi i Vendimit" në DAP
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar

8. Znj. V. H., me detyrë Specialiste:
Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1086/3, datë 08.04.2022 "Përcillet për njohje edhe zbatim", Nuk ka filluar ecuria disiplinore ende.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

E/II. <u>Për punonjësit marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës</u>:
Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 *"Kodi i Punës"*, i ndryshuar, kontratës individuale të punës dhe Rregullores së Brendshme të institucionit, **i rekomandojmë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, të marrë masat për vendosjen e masave disiplinore si më poshtë, pas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, konkretisht:

"Ndërprerje e menjëhershme e marrëdhënieve të punës" *për:*
1. Znj. E. H., me detyrë Drejtore Kabineti

Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

"Vërejtje me shkrim" për:
1. Znj. M. C., me detyrë Drejtore e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.
Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

2. Znj. M. Ç., me detyrë Drejtore e Qendrës së Akreditimit.
Qëndrimi i MSHMS për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

Me shkresën nr. 2606/5, datë 25.08.2022 (protokolluar në KLSH me nr. 600/29 prot., datë 29.08.2022), observacione të paraqitur nga MSH por që nuk janë trajtuar në fazën e hartimit të projektraportit pasi kanë qenë jasht afatit dhe do të trajtohen në fazën e raportit.
Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga PIU i projektit janë paraqitur edhe zbatimi i rekomandimeve. Për dokumentacionin shtesë që ju paraqitët janë reflektuar.

Me shkresën nr. 2606/8, datë 05.10.2022 (protokolluar në KLSH me nr. 600/66 prot., datë 29.08.2022) janë ripërcjell observacionet.

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA PËR PROJEKTIN "EFIÇENCA ENERGJITIKE, PROGRAMI PËR SEKTORIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Operatori i Sistemit të Transmetimit SHA për projektin "Efiçenca energjitike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike" mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", OST, ka kthyer përgjigje në KLSH, duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

- Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve,

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 281/7, datë 31.12.2021 dhe në OST nr. prot. 9, datë 05.01.2022, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **8 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **1 masa për shpërblim dëmi në vlerën 4,745,742.21 lekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **0 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	8	7	-	1
3	Shpërblim dëmi	1	-	-	1
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	-	-	-	-
7	Masa disiplinore	-	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e OST

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.			Statusi i zbatimit

	Lloji i rekomandimit	**Pranuar Plotësisht (numër)**	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	7	0	0	5	2
3	Shpërblim dëmi	0	0	0	0	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	0	0	0	0	0
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimve rezulton se OST nga 8 masa organizative ka pranuar 7 prej tyre ose 87.5% të masave dhe nga 7 masat e pranuara 0 janë zbatuar plotësisht ose 0% e masave të rekomanduara, janë 5 masa janë në proces zbatimi ose 62.5% e masave të rekomanduara dhe 2 masa nuk janë zbatuar ose 25% e masave të rekomanduara.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 0%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", OST, ka kthyer përgjigje në KLSH, duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve,

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të projektit "Efiçenca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike", bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi, në Marrëveshjen e Huas, për financimin e programit të efiçencës së energjisë elektrike në sistemin e transmetimit për shumën prej 40 milion euro, nënshkruar midis Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe bankës gjermane KfW. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI *4000 dhe 4100.*

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se implementimi i projektit për shkak të rëndësisë së mangësive të trajtuara në këtë Raport Auditimi, ka devijime materiale por jo të përhapura, kjo referuar kërkesave të Marrëveshjes së Huas miratuar me ligjin nr. 88/2015, si edhe aktet

e tjera rregullatore në zbatim të kësaj Marrëveshje, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***opinionit të kualifikuar***.

Baza për Opinionin

Mbështetur në gjetjet nga auditimi, kemi arritur në konkluzionin se për realizimin e projektit janë bërë ndryshime të marrëveshjes me disa amendime për riskedulimin e pagesave dhe zgjatjen e afatit të disbursimit, ndryshime të komponentëve, nuk janë realizuar indikatorët për secilin komponent, vonesa të theksuara në ecurinë e projektit dhe kjo ka çuar në nivelin e ulët të disbursimeve si edhe në mos përfundimin në afatin e parashikuar të tij me 3 vjet vonesë, të cilat janë shoqëruar me rritje të kostos së projektit. Shuma e disbursuar deri në 03.03.2020 është në nivelin 13% e shumës së huas, disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta, Në lidhje me procedurat e prokurimit, kemi konstatuar mangësi dhe shkelje të Udhëzuesve të bankës KfW, ku procedura e tenderit zhvilluar me objekt "Shërbimi i konsulencës" është kryer me zgjatje të afatit kohor prej 1 vit, si pasojë e një parregullsie të ndodhur gjatë procedurës së vlerësimit të ofertës teknike, mbi hapjen e zarfit të ofertës financiare para afatit kohor të përcaktuar.

Kemi konstatuar efekte negative financiare të cilat kanë rezultuar nga komisione angazhimi mbi planin si rezultat i mosrealizimit të afateve dhe objektivave të projektit, penalizime nga banka KfW, etj, ***në shumën 892,049 Euro*** dhe mosrespektim i kushteve të kontratave për paraqitjen e raporteve të konsulentit në shumën ***38,973 €***.

B.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimet e Marrëveshjes së huas, shkaqeve dhe argumentimit të tyre, u konstatua se subjekti në auditim OST në rolin e huamarrësit dhe KFW-ja ne rolin e huadhënësit, kanë realizuar amendime të shumta të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015, ku në mënyrë të përmbledhur, ato pasqyrohen sa më poshtë vijon:

Amendimi i marrëveshjes së huas për riskedulimin e pagesave

Administratori i OST me shkresën nr. 2728 Prot. datë 13.04.2018, ka paraqitur kërkesën pranë KfW për rishikimin e termave të huas, mbi rishqyrtimin e afatit të disbursimeve dhe skedulit të pagesave të huas. Këshilli Mbikëqyrës[8] dhe Asambleja[9] e Përgjithshme, miratoi ndryshimet e kërkuara nga administratori i OST për ndryshimet e marrëveshjes së huas.

Amendimi i marrëveshjes së huas për zgjatjen e afatit të disbursimit të huas.

Administratori i OST ka kërkuar përsëri shtyrjen e afatit të disbursimit deri më datë 30.12.2022 nga KfW[10]. KfW zgjatjen e afatit të disbursimit të huas, e kishte kushtëzuar, me detyrimin e OST për kryerjen e pagesës në shumen 861,206 euro si tarifë kompensimi. Pas përfundimit të negociatave të OST me KfW, tarifa e kompensimit është përcaktua në vlerën 377,519 euro, e cila përbën kosto shtesë për këtë projekt dhe është paguar nga buxheti i OST si kosto shtesë për këtë projekt.

Amendimi i marrëveshjes së datës 27.09.2019, ka shtyrë, afatin e disbursimit deri më datë 31.12.2022

Këshillit Mbikëqyrës ka miratuar me vendim nr. 80 datë 16.09.2019, amendimin e marrëveshjes për shtyrjen e afatit të disbursimit. Vlera e penalitetit të vendosur për shkak të shtyrjes së afatit të disbursimit nuk është argumentuar nga ana e KfW, por edhe administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i OST, nuk kanë kërkuar shpjegime mbi mënyrën e llogaritjes së penalitetit në vlerë 377,519 euro nga KfW

Amendimi i aneksit 6 i marrëveshjes së veçantë.

[8] Vendimi nr.38 datë 27.06.2018

[9] vendim Nr. 94 datë 29.06.2018,

[10] Me shkresën nr. 3888 Prot., date 11.06.2019

Marrëveshja e veçantë është amenduar pas miratimit dhe dhënies së autorizimit për miratimin e saj nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 12, datë 14.04.2017 dhe asambleja e përgjithshme e aksionarëve me nr. 4160/1, datë 5.05.2017. Në këtë amendim është ndryshuar aneksi 6 (gjashtë) ku janë përfshirë komponentët kryesor të projektit dhe kërkesat për procedurën e tenderit për konsulencën dhe kontraktorët.
(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 13, të Raportit të Auditimit)
1.1. Rekomandimi: Drejtoria e projekteve të huaja, në bashkëpunim me njësinë e zbatimit të projekteve të bëjnë parashikime të sakta për kostot e financimit dhe afatet e realizimit të projektit mbi bazën e studimit të fizibilitetit apo rishikimit të komponentëve të projektit në Këshillin Teknik, dhe pasi ti miratojnë në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, të pasqyrohen në marrëveshjet e huas.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST për Rekomandimin: Ky rekomandim do të verifikohet kur OST të ketë projekte të tjera me financim të huaj.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimin e komponentit II të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015 u konstatua se, Këshilli Teknik i OST në mbledhjen e datës 14.11.2016 ka shqyrtuar dy opsione të paraqitura nga ana e konsulentit të projektit *"Fischtner"*, si më poshtë:
Opsioni i parë: Lidhet me kërkesën e konsulentit për ndryshimin e linjave të hyrjes në nënstacionet 110KV nga linja ajrore (OHL[11]) në linja kabllore për komponentin II të përcaktuar në marrëveshjen e huas, me objekt: "Ndërtimi/fuqizimi i linjave të reja të transmetimit 110 kV: Tirana 1-Traktori-Tirana 3, Tirana 3-Selitë dhe Tirana 3-Farkë"
Opsioni i dytë: Paraqet kërkesën e konsulentit, mbi nevojën e realizimit të një studimi të plotë për koordinimin e mbrojtjes rele për rrjetin 110 kV të rajonit të Tiranës (ku përfshinë të gjitha nënstacionet dhe linjat në këtë projekt). Anëtarët e Këshillit Teknik[12] shprehën dakordësi, kryesisht për kërkesën e konsulentit për opsionin e dytë, duke marrë vendimin:
Të negociohen të dy opsionet dhe ti hapet rrugë konsulentit për realizimin e një studimi të koordinimit të mbrojtjes rele për një pjesë sa më të gjerë të sistemit të transmetimit (opsioni i dytë).
Pra, anëtarët e Këshillit Teknik miratuan kërkesën e konsulentit për kryerjen e një studimi të plotë, për koordinimin e mbrojtjes rele për rrjetin 110 KV të rajonit te Tiranës, e cila sipas tyre, do ti shërbejë qëndrueshmërisë së sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në afat gjatë. Pavarësisht vendimit të Këshillit Teknik nr. 7096 prot., datë 14.11.2016, OST ka bërë amendimin e kontratës së konsulentit me nr. 1585/1 prot, datë 24.03.2017, duke pasqyruar vetëm opsionin e parë të propozuar nga konsulenti. Ndërkohë që në Marrëveshjen e Huas komponenti II "Ndërtimi/fuqizimi i linjave të reja të transmetimit 110 kV: Tirana 1-Traktori-Tirana 3, Tirana 3-Selitë dhe Tirana 3-Farkë" është parashikuar që hyrjet në këto nënstacione të jenë linja ajrore. Në dokumentet e tenderit për termat e referencës (ToR) të përgatitura nga Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me OST dhe të dakordësuara nga KfW, për komponentin II, hyrja në nënstacionet 110 kV është përcaktuar me linjë ajrore. Amendimi i kontratës së konsulentit rriti kostot e shërbimit të konsulencës me 326,645 euro mbi vlerën e kontratës fillestare[13] si rrjedhim i ndryshimit te konfigurimit te komponentit te dytë të parashikuar ne marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015 dhe në studimin e fizibilitetit të këtij projekti. Si pasojë Amendimi i kontratës së konsulentit rriti kostot e shërbimit të konsulencës me 326,645 euro, mbi vlerën e kontratës fillestare, ku vlera totale e kontratës së konsulentit pas amendimit

[11] OHL-Overhead Line
[12] Proces verbali me nr. 7096 prot. Date 14.11.2016
[13] Kontrata me konsulentin Fischtner është nënshkruar 05.09.2016 në vlerën 2,131,970 euro

është 2,458,615 euro, ose 208,615 euro më shumë se vlera e planifikuar në Marrëveshjen e Huas së datës 30.06.2015.
(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 14-15, të Raportit të Auditimit)
2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Projekteve të Huaja, gjatë fazës së hartimit të termave të referencës për tenderin e shërbimit të konsulencës së projekteve duhet të bashkëpunoj me Këshillin Teknik të OST, për të analizuar dhe reflektuar ndryshime të mundshme, të komponentëve të projektit të përcaktuara në marrëveshjen e huas.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST për Rekomandimin: Gjatë periudhës pas raportit përfundimtar dhe rekomandimeve nuk ka pasur tendera.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: proces

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimin e "Komponentit I" të Marrëveshjes së huas, u konstatua se: Në Marrëveshjen e Huas[14], objekti për "komponentin I" ishte "Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tirana2 - Rrashbull dhe unaza 110 kV e Tiranës". Pra sipas përcaktimit në Marrëveshjen e huas, ndërtimi i linjës Tirana2-Rrashbull me dy qarqe duhej të realizohej me bazamente, shtylla të tensionit të lartë, izolatorë dhe përcjellës me tension 220 kV. Këshilli Teknik në mbledhjen[15] e datës 14.11.2016 ka marrë në shqyrtim studimin e shkurtuar për opsionet e ndërtimit të linjës Tirana 2-Rrashbull, hartuar nga konsulenti Fichtner[16]. Në përfundim Këshilli Teknik ka marrë vendim që ndërtimi i linjës Tirana 2 - Rrashbull me dy qarqe, të realizohet me bazamente dhe shtylla për tensionin 400 KV dhe me përcjellës me tension 200 kV. Këshilli Teknik në mbledhjen[17] e datës 12.11.2018 ka marrë në shqyrtim vlerësimin e 2 (dy) konfigurimeve për ndërtimin e linjës 220 kV me dy qarqe Tirana2-Rrashbull, të cilat paraqiten si më poshtë:
Konfigurimi A[18], parashikon që ndërtimi i linjës Tirana2-Rrashbull me dy qarqe, të bëhet me: *"Bazament dhe shtylla të tensionit të lartë për tension 400kV, por me izolator dhe përcjellës për tension 220 kV".* Pra ndryshe nga parashikimi i komponentit I, në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015, "Konfigurimi A" ndryshon shtyllat e tensionit të lartë nga 220 kV në 400kV.
Konfigurimi B, parashikon që ndërtimi i linjës Tirana2-Rrashbull me dy qarqe, të bëhet me:
"Shtylla të tensionit të lartë për tension 400kV, ku njëri qark të ketë izolator dhe përcjellës për tension 400 KV, kurse qarku tjetër të ketë izolator dhe përcjellës për tension 220 kV".
Pra ndryshe nga parashikimi i "komponentit I", në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015, me "Konfigurimin B", do të kemi shtylla të tensionit 400 kV, ku në njërin qark do të ketë izolator dhe përcjellës për tension 400 kV dhe në qarkun tjetër do të ketë izolator dhe përcjellës për tension 220 kV.
Pavarësisht zgjedhjes së konfigurimit A apo B, linja Tirana2 -Rrashbull, të dyja qarqet, do të operojnë vetëm me tension 220 kV, edhe për një kohë të gjatë sipas anëtarëve të Këshillit Teknik
Këshilli Teknik në mbledhjen e datës 12.11.2018 nuk ka marrë vendim për asnjë nga opsionet e propozuara, pasi nga 10(dhjetë) anëtarë pjesëmarrës në mbledhje, 5(pesë) prej tyre pranuan konfigurimin A dhe 5 (pesë) të tjerët konfigurimin B. Në këto kushte është rënë dakord nga anëtarët e këshillit teknik, që ti paraqesin opinionet e tyre administratorit dhe në varësi të situatës financiare të kompanisë, të vendoset për variantin që do të implementohet.

[14]Miratuar më date 30.06.2015
[15] Proces verbal me nr. 7096 prot. Date 14.11.2016
[16] Short System Study for Tirana- Rrashbull Transmission Line, Rev. 07.11.2016
[17] Proces verbal me nr. 7786 prot date 12.11.2018
[18] Miratimi për "Konfigurimin A" është marrë me vendim të Këshillit Teknik të datës 14.11.2016

Në mbledhjen e Këshillit Teknik të datës 23.11.2018, janë risjellë për rivlerësim të dyja konfigurimet për projektin " Linja 220 kV me dy qarqe Tirana2-Rashbull dhe unaza 110 kV e Tiranës". Në përfundim Këshilli Teknik është shprehur me vendimin:
Linja me dy qarqe Tirana 2-Rashbull të ndërtohet sipas variantit të dytë (konfigurimi B), pra njeri qark për tension 220 kV dhe qarku tjetër për tension 400 kV.
Disa prej anëtareve të këshillit teknik, nuk ishin dakord me implementimin e konfigurimit B, pasi sipas tyre, ky opsion do të rriste kostot e financimit me 141,726.36 Euro mbi vlerën e huas.
Zv/Kryetar[19] i këshillit teknik i përmbahet variantit të parë (konfigurimit A) pasi: vërtetë tendenca në perspektiv është për zhvillimin e rrjetit 400 kV, por edhe varianti i parë (konfigurimi A) nuk e përjashton këtë mundësi nëse perspektiva e zhvillimit e kërkon në të ardhmen. Rrjeti 220 kV tek ne është shumë i zhvilluar dhe do të mbetet ende në operim për një kohë të gjatë. (Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 15-17, të Raportit të Auditimit)
3.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me këshillin teknik dhe konsulentin, të dakordësojnë termat referencës për kontraktorët e zbatimit të projektit, mbi bazën e studimit të fizibilitetit, dhe nëse ky i fundit ka nevojë për ndryshime ato të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe të pasqyrohen në amendimin e marrëveshjes para se të përfshihen në dokumentet e tenderit për kontraktorët e zbatimit të projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST për Rekomandimin: Pas ndryshimeve të kryera i është propozuar donatorit ndryshimi në marrëveshje nga komunikimet me email donatori ka shprehur se aprovimet e dhëna me email janë të mjaftueshme për ta.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në stafin e PIU-t nuk ka specialistë të fushës së inxhinierisë, të cilët janë të nevojshëm përgjatë gjithë fazave të zhvillimit të projektit. Sipas përcaktimeve të *seksionit 2* të Marrëveshjes së veçantë (zbatimi i projektit), struktura përgjegjëse për zbatimin e projektit në OST është njësia e përhershme e zbatimit të projektit (PIU). Njësia e zbatimit të projektit (PIU) është në varësi të Drejtorisë se projekteve te huaja.
Në rregulloren e OST Seksioni VII.2 dhe VII.2.1, detyrat[20] funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në aparatin qendror të OST ShA, përcaktohet se:
Drejtoria e projekteve të huaja garanton implementimin optimal të projekteve të zhvillimit të rrjetit, të financuara nga komuniteti i donatoreve të huaj. Ndjek dhe zbaton legjislacionin përkatës për përmbushjen dhe implementim e projektit te huaj që në fazat e para të financimit, e deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim të veprës.
Sektori i projekteve PIU ndjek projektet me financim të huaj që nga procedurat e Marrëveshjes së kredisë, hartimin e dokumenteve të tenderit, procesin e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit apo konsulencës, menaxhimin implementimin e projektit deri në finalizimin dhe dorëzimin e tij, dhe marrjen në shfrytëzim nga strukturat përkatëse.
Nga auditimi konstatohet se, njësia e zbatimit të projektit përbehet nga:
- Shefi i sektorit të njësisë së zbatimit të projektit (PIU);
- 2(dy) jurist;
- 2(dy) ekonomist;
- 1(një) sekretar/arkivist.

Pra, ky sektor ka në përbërjen e vet 6 (gjashtë) specialistë te fushave të ndryshme, por nuk ka asnjë specialist të fushës së inxhinierisë elektrike në përbërjen e vet.
(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 12, të Raportit të Auditimit)

[19] Në këtë mbledhje kanë marre pjese 8 anëtarë të këshillit Teknik. Mbledhjen e kryesonte zv.Kryetari në mungesë të kryetarit të KT.
[20]Miratuar me nr. 2404/5 Prot. date 24.07.2019.

4.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë të marrë masa për të plotësuar strukturën e njësisë së zbatimit të projekteve me specialistë inxhinier të fushës së zbatimit për projektin "Efiçenca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike"**.**

Brenda vitit 2020

Qëndrimi i OST për Rekomandimin: me shkresën nr. 435, datë 20.01.2022, Administratori i është drejtuar KLSH duke kundërshtuar masën.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e shkallës së realizimit të objektivave dhe komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuar në marrëveshjen e huas, grupi i auditimit konstatoi se:

Nuk janë realizuar objektivat e parashikuara në marrëveshjen e huas.

I. Objektivi për arritjen e rezultateve të pritshme në drejtim të rritjes së fuqisë së transmetimit të energjisë elektrike, sigurisë dhe cilësisë së furnizimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

Pasi bazuar në treguesit e performancës për vlerësimin sasior të këtij objektivi, parashikohet që kapaciteti i transmetimit në rrjetën midis Tiranë - Rrashbull dhe Fier të rritet me të paktën 155 MW në vitin e dytë të funksionimit të dy komponentëve.

Nga auditimi konstatohet se brenda periudhës së auditimit, ky objektiv nuk është realizuar, për shkak të mos implementimit të të dy komponentëve të projektit.

II. Në marrëveshjen e veçantë të Huas së datës 02.07.2015, në aneksin 2 të saj, është përcaktuar skeduli kohor i realizimit të projektit përgjatë viteve 2015 – 2018, sipas dy komponentëve te saj, te pasqyruar ne piken a dhe b, sa më poshtë

a. Faza e zbatimit për Komponentin parashikohej të zgjaste 3(tre) vjet, dhe të përfundonte në fund të vitit 2017.

b. Faza e zbatimi për Komponentit II parashikohej të zgjaste 4 (katër) vjet, dhe të përfundonte në fund të vitit 2018.

Ky objektiv nuk është realizuar dhe shtyrja në kohë e tij, është shoqëruar me kosto të shumta shtesë mbi vlerën e huas.

III. Nga auditimi konstatohet se, afati i ri për realizimin e këtij projekti respektivisht sipas dy komponentëve nuk është pasqyruar në amendimet e marrëveshjes së veçantë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 18-20, të Raportit të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, të analizojë ecurinë dhe problematikat e shfaqura gjatë implementimit të projektit "Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike", si dhe të autorizojë administratorin e shoqërisë për nënshkrimin e amendimit të marrëveshjes së veçantë, ku të përcaktohet afati i përfundimit të projektit sipas të dy komponentëve të tij.

Brenda vitit 2020

Qëndrimi i OST për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST nr. 388, datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Banka KfW, me letrën e datës 26.08.2019, ka pranuar në parim shtyrjen e afatit të disbursimit, por thekson pagesën e një vlerë kompensimi si pasojë e shtyrjes së afatit të disbursimit, ku Huadhënësi pranon se kjo vlerë është bazuar në kushtet e tregut të kapitalit që ka prevaluar në kushtet e llogaritjes së kësaj vlere, duke theksuar se asnjë kosto shtesë nuk përfshihet në vlerën prej 861,206 Euro. KfW në kuadër të bashkëpunimit afatgjatë me OST pranon të mbulojë 50% të shumës dhe pjesa tjetër të mbulohet nga OST, dhe për këtë nuk ka asnjë llogaritje ose mënyra e llogaritjes nga banka

KfW për caktimin e vlerës prej 377,519 Euro. Huamarrësi (OST) ka rënë dakord për të paguar detyrimin e paraqitur nga banka KfW dhe ka likuiduar vlerën 377,779 Euro (377,519 Euro + 260 Euro komision banke), e cila përbën efekt financiar negativ për OST. Për këtë vlerë nuk është paraqitur nga KfW asnjë dokument për mënyrën e llogaritjes si edhe nga Drejtoria Ekonomike e OST nuk disponohet dokumentacion mbi përcaktimin e vlerës. Referuar Marrëveshjes së nënshkruar nga palët me amendimet përkatëse plani i disbursimeve është shtyrë deri në korrik të vitit 2022, ose me 3 vjet nga afati i parashikuar si pasojë e vonesave të ardhura nga procedurat e tenderimit. Vlera e detyrimit në favor të KfW është kontabilizuar në llogarinë 233 "Investime të projektit", veprimet në kontabilitet janë kryer në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 17.02.2003 "Për evidentimin regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj".
(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 22, të Raportit të Auditimit)
6.1. Rekomandimi: Drejtoria e menaxhimit të projekteve, në të ardhmen të marrë masat e duhura që ecuria e disbursimeve për projektet e financuara nga KfẀ apo donatorë të tjerë të huaj, të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë që mbart zgjatja në kohë e afatit të disbursimit, si dhe shmangien e procedurave të tej zgjatura që nevojiten për miratimin e ndryshimeve financiare në marrëveshjet e ratifikuara.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST për Rekomandimin: Do të verifikohet në projektet e ardhshme.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

7. Gjetje nga auditimi: Nga shuma e kredisë prej 40 milionë euro, deri në datën 03.03.2020 është disbursuar 5,231,789 Euro, dhe shuma e pa disbursuar është në nivelin e 34,768,211 Euro, ose 13% e shumës së kredisë. Pra, është disbursuar vetëm 13% e shumës së kredisë në një kohë që është konsumuar koha e efektshmërisë së përdorimit të Huas sipas Marrëveshjes.
-Disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta dhe vonesa të theksuara nga ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim ato janë në nivelin 0.
-Projekti është parashikuar të përfundojë në dhjetor të vitit 2018 dhe ende nuk ka filluar faza e implementimit, pra projekti është me vonesë prej 18 muaj deri në periudhën e auditimit.
Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST Nr. 388, datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Në datën 29.06.2018 është nënshkruar amendimi i parë i Marrëveshjes së Huas referuar skedulit të ripagesave, duke lënë të pandryshuar termat e tjerë të saj.
-Miratimi për shtyrjen e afatit të disbursimit deri në vitin 2022, nuk do të jetë i mjaftueshëm pasi nisur nga ecuria dhe problematikat në faza të ndryshme të projektit ku ende nuk janë kryer procedurat e shpronësimeve dhe kontratat e nënshkruara për kryerjen e punimeve ende nuk kanë filluar, nuk dihet ecuria e tyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 23, 25,të Raportit të Auditimit)
7.1.Rekomandimi:OST dhe NJZP të marrin masa që në të ardhmen, për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare, me qëllim minimizimin e kostove shtesë dhe krijimin e një opinioni pozitiv ndaj huadhënësit në përdorimin e financimit.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST për Rekomandimin: Do verifiohet në projektet me financim të huaj.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

8. Gjetje nga auditimi: Shkelje e procedurave të tenderit në procesin e prokurimit për shërbimin e konsulencës.
Në proces-verbalin nr.4944 prot., datë 26.08.2015, ora 16:20, i mbajtur nga z. Y. D. Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit është deklaruar hapja gabimisht, nga ana e punonjëses së protokollit, e kutisë dhe e zarfit të ofertës ekonomike për ofertuesin MVV Decon-Consulectra. Por, me e-mail[-in] e datës 26 Gusht 2015 ora 14:05 nga Njësia e Zbatimit të Projekteve (PIU) të OST është njoftuar agjenti i tenderit per mbërritjen e ofertave të aplikantëve Fichtner, Consortium MVV Decon dhe GOPA Intec.
Hapja e tenderit ka qenë parashikuar në datën 28 Gusht 2015. Në këtë mënyrë, nga ana e Njësisë së Zbatimit të Projekteve (PIU) të OST nuk është marrë asnjë masë për ruajtjen e tyre në gjendje të vulosur deri në momentin e hapjes.
Hapja e ofertës sa më sipër është kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në pikën 2.3, paragrafi 2.12 "Udhëzuesit për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnere", ku përcaktohet se: *Oferta e shërbimeve do të jetë hapur menjëherë pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Zarfet, që përmbajnë kuotimet e çmimeve do të mbahen të vulosur dhe do të jenë hapur vetëm me miratimin e K f W për ato ofertues, që kanë arritur të paktën 75 % të pikëve.*
Me shkresën Nr.5056 Prot. datë 1/09/2015, të Administratorit të OST z. E. Z. është njoftuar përfaqësuesi i bankës KFW mbi ngjarjen e ndodhur sa më sipër, si edhe për këtë shkak është kërkuar njëkohësisht anulimi i procedurës së tenderit për shërbimin e konsulentit.
Sa sipër, kërkesa per anulimin e tenderit nuk është mbështetur në asnjë nga rastet e parashikuara në Paragrafin 2.6 në "Udhëzimin për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere".
Në aneksin 2 bashkëlidhur "Udhëzuesit për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnere", pika 2, paragrafi "*përpara një anulimi të mundshëm të tenderit"* është parashikuar se: propozimi nga klienti që tenderi të anulohet duhet të jetë me arsyetim, i cili duhet të ndjekë kriteret e këtij udhëzuesi dhe duhet të shoqërohet me dokumentet përkatëse si kërkohet nga Banka.
Sa sipër, për shkak se procesi i vlerësimit të ofertave nuk ka mundur të realizohej, nuk ka rezultuar pasoja në vlerë. Gjithashtu, për shkak të mangësive në menaxhimin e procedurave të tenderit nga njësia përgjegjëse, është konstatuar vonesa për rreth 1 vit për realizimin e prokurimit për caktimin e konsulentit.

9. Gjetje nga auditimi: Deformim i procesit të vlerësimit të ofertave të kontraktorëve.
Në procesverbalin të mbajtur nga KVO nr.53/8 prot. datë 06.04.2017, kanë kaluar fazën e pare të para-kualifikimit si më poshtë:
- K. P. P. E.T. E. Inc. është kualifikuar pa kushte;
-A. S.p.A, E. E. e S., C. GE G. GmbH M. S.A me kushtin, që mangësitë respective të konstatuara do të rregullohen në fazën vijuese të tenderit.
Në raportin paraprak të vlerësimit të ofertave teknike, të prezantuar nga Konsulenti dhe miratuar nga OST në Mars 2018, është ngritur pretendimi i verifikimit te saktësisë në kriteret para-kualifikuese për K. P. P. E.T. E. Inc si më poshtë:
-është kanstatuar se në dokumentacionin e dorëzuar prej tij ka mospërputhje të dhënash(datat) për përfundimin e projektit "Ndërtimi i N/st Zerjanevic" (viti 2007 apo viti 20o5) dhe për këtë arsye është kërkuar plotësim dokumentacioni.
Për këtë arsye pas saktësimeve, është kërkuar skualifikimi i këtij aplikanti.
Gjithashtu, në e-mail e saj, datë 26 Mars 2018 banka (KfW) ka sqaruar se:
Më e-mail e KfW datë 11. Maj 2018 jepet dokordësia (No-Objection) e Raportit të Vlerësimit Final me shënimin "*se ne nuk do të ndajmë plotësisht opinionin e punëdhënësit dhe konsulentit*

lidhur me mospërmbushjen e ofertës së prezantuar nga K. P. P. E.T. E. *Inc në lidhje me kriterin e para-kualifikimit".*
Seksioni 2.7 i "Udhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere"-Gusht 2016, nuk është përjashtues në thelbin e tij, por lejon krahasimin e të gjithë ofertuesve për të përcaktuar avantazhet më të dobishme.
Pra, sa sipër në rastin e aplikantit Koncar nuk qëndron argumentimi se ekziston dyshimi për përmbushjen e kushteve minimale të parashikuara në fazën para-kualifikuese, për arsyen e thjeshtë se ky aplikant ka kaluar fazën e para-kualifikimit në mënyrë të pakushtëzuar.
Pra, edhe në këtë faze të procesit të përzgjedhjes të kontraktorit janë vërejtur mangësi në ushtrim të detyrave funksionale nga ana e OST për koordinimin dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit.
9.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës duhet të marrin masat e nevojshme për të implementuar një sistem efiçent të menaxhimit të projekteve të huaja, duke përfshirë të gjitha proceset e zhvillimit të projektit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve që kërcënojnë shoqërinë.

Në vijimësi
Qëndrimi i OST për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokument në dispozicion
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Penalitete të pa mbajtura, gjatë zbatimit të kontratës së Konsulentit.
Me anën e faturave D17/1327 dhe D17/1328 datë 24.04.2017, është kërkuar nga "F. G. & C.K." pagesa prej **371,169.00 €** ,ose 60 % nga fondi i fazës A prej 618,615.00 €, si edhe pagesa prej **27,041.25 €,** ose 75 % të shtesës nga amendamenti nr.01 i kontratës nr.1585/1 prot., datë 24.03.2017, prej 36,055 € për fazën A.
Raporti mbi mjedisin (ESIA Report) është dorëzuar nr.1210 prot. datë 03.03.2017 me një vonesë prej 11 javësh;
Raporti i Detajuar i Projektimit dhe Planifikimit (Detailed Planning and Design Report) është dorëzuar nr. 2301 prot. datë 26.04.2017, me një vonesë prej 19 javësh.
Referuar pikës Ad 3.4 te "kushtet speciale" të kontratës, janë përcaktuar afatet kur konsulenti duhet të raportojë mbi progresin e shërbimeve që ka kryer, si më poshtë:
-Raporti i Fillestar 8 javë pas hyrjes në fuqi ose 11.11.2016;
-Raporti mbi ambjentin ESIA 8 javë pas hyrjes në fuqi ose 11.11.2016;
-Raporti i Planifikimit dhe Projektimit të Detajuar 12 javë pas hyrjes në fuqi ose 09.12.2016.
Veprimet për dorëzimin e shërbimev të kryera nga konsulenti bien në kundërshtim me kushtet speciale paragrafin Ad.3.4 të kontratës së konsulentit.
Për këtë arsye:Referuar paragrafit 4.2 "Penalitete për Vonesën", në kontratën e konsulentit, si edhe periudhës së vonesës nga data 11.11.2016 - 26.04.2017, ose 21 javë, llogaritja e penalitetit në **ngarkim të F. G. & C.K..** është **38,973 €** ose **4,745,742.21 lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 35-35, të Raportit të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Projekteve të Huaja, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **38,973 euro**, si penalitet për vonesat e shkaktuara në prezantimin e Raportit të Mjedisit *ESIA dhe Raportit të Projektimit dhe Planifikimit të Detajuar (Detailed* Planning and Design Report).nga konsulenti F. G. & C.K...

Qëndrimi i OST për Rekomandimin: me shkresën nr. 435, datë 20.01.2022, Administratori i është drejtuar KLSH duke kundërshtuar masën.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:
S. D., me detyrë Administrator i OST SHA
D. S., me detyrë Drejtor i Projekteve të Huaja.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi datë 11.08.2022, cili është dorëzuar në zyrën e protokollit të OST me nr. 3837/1 prot, datë 11.08.2022.

Nga subjekti OST SHA është paraqitur observacioni nr. 4062/3, datë 22.09.2022 protokolluar në KSH me nr. 600/61 datë 23.09.2022 i paraqitur nga S. D., Administrator i OST SHA ku pretendoni se:
Ku pretendoni se struktura e OST është e plotësuar, dhe mos pranimin e demit ekonomik.
Ju sqarojmë se nuk keni sjell asnjë dokumentacion shtesë dhe observacioni juaj nuk merret parasysh.

RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në RTSH mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, për periudhën nga data 01.07.2017 deri më datë 31.12.2019, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", RTSH, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH duke nuk respektuar afatin 20 ditor.
"*të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*;"

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, <u>Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre</u>, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 947, datë 06.08.2021 dhe në RTSH nr. 1693/19 prot., datë 11.08.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b.Janë rekomanduar **58 masa organizative**;
c.Janë rekomanduar **16masa për shpërblim dëmi në vlerën 23,761,927 lekë**;
d. Janë rekomanduar **2 masa shpërblimi dëmi me kusht në vlerën 38,278,500 lekë**;
e.Janë rekomanduar **1 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 20,992,259lekë**;
f. Janë rekomanduar **6masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 29,770,126 lekë**;
e. Janë rekomanduar **29 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor				
2	Organizative	58	58	-	-
3	Shpërblim dëmi	16 23,761,927	16 23,761,927		
4	Të ardhurave të munguara	1 20,992,259	1 20,992,259		
5	Shpërblimi dëmi me kusht	2 38,278,500	2 38,278,500		
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	6 29,770,126	6 29,770,126		
7	Masa disiplinore	29	29		

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e RTSH

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-	-
2	Organizative	58	12	4	24	18
3	Shpërblim dëmi	16 23,761,927	-	-	-	16 23,761,927
4	Shpërblimi dëmi me kusht	2 38,278,500	-	-	-	2 38,278,500

5	Të ardhurave të munguara	1 20,992,259	1 20,992,259	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	6 29,770,126	2 1,319,460	-	-	4 28,450,666
7	Masa disiplinore	29	27	-	2	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI
a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b.Janë rekomanduar **58 masa organizative nga të cilat janë pranuar 58 masa ose 100% dhe statusi izbatimit të tyre është 11 masa janë zbatuar plotësisht ose 19%, 25 masa janë në proces zbatimi ose 43%, 4 masa janë zbatuar pjesërisht ose 7% dhe 18 masa nuk janë zbatuar ose 31%**;
c.Janë rekomanduar **16 masa për shpërblim dëmi në vlerën 23,761,927 lekë të cilat janë pranuar 16 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 0 masa të zbatuara ose 0%, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 6 masa të pa zbatuara ose 100% në vlerën 23,761,927 lekë**;
d. Janë rekomanduar **2 masa shpërblimi dëmi me kusht në vlerën 38,278,500 lekëtë cilat janë pranuar 2 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 0 masa të zbatuara ose**

0%, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 2 masa të pa zbatuara ose 100% në vlerën 38,278,500 lekë;
e.Janë rekomanduar **1 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 20,992,259 lekë e cila është pranuar 1 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të saj është 0 masa të zbatuara ose 0%, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 1 masa e pa zbatuara ose 100% në vlerën 20,992,259 lekë;**
f. Janë rekomanduar **6masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 29,770,126 lekë të cilat janë pranuar 6 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 2masa të zbatuara ose 33% në vlerën 1,319,460 lekë, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 4 masa të pa zbatuara ose 67% në vlerën 28,450,666 lekë;**
e. Janë rekomanduar **29 masa disiplinore të cilat janë pranuar 29 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 27 masa të zbatuara ose 93%, 2 masa në proces ose 7%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 0 masa të pa zbatuara ose 0%.**

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 20%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", RTSH, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH duke nuk respektuar afatin 20 ditor.
"*të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*;"

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:
"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna"

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

F. OPINIONI I AUDITIMIT

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar për periudhën 01.07.2017 deri më 31.12.2019 nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator. Krahas parregullsive materiale sasiore, në arritjen e opinionit, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

Në përfundim të auditimit, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një **opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.**

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.
Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.
Konkluzionet dhe opinioni ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Radio Televizionit Shqiptar, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme.
Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 "Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë", ISSAI 1500 (ISA 500) dhe ISSAI 1530 (ISA 530) ; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinioni në këtë auditim përputhshmërie. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinioni të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:
-Si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të zyrtarëve dhe punonjësve të Radio Televizionit Shqiptar është shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit tij prej **23,761,927 lekë** që përfaqëson kryesisht vlera monetare në procedura prokurimi dhe zbatimin e kontratave, si dhe në zbatimin e projekteve artistike etj.;
-Janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të tyre në vlerën prej **92,291,493 lekë** në zbatimin e procedurave të prokurimit publik, nga gjyqet për largimet e padrejta nga puna të punonjësve etj.;
-Janë konstatuar mungesë e sigurimit të mirëpërdorimit të fondeve publike dhe transparencë për shpenzimet e parashikuara në shumën **122,576,825 lekë pa TVSH** për tre investime;

-Veprimtaria Këshillit Drejtues të RTSH e tyre ka shfaqur mangësi në drejtim të pjesëmarrjes në mbledhje të anëtarëve, hartimin dhe miratimin e dokumenteve të ndryshme si Kodi i sjelljes, Deklarata njëvjeçare qëllimit etj.;
-Radio Televizioni Shqiptar e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në mungesë të planeve të zhvillimit dhe planit të biznesit, si një element bazë në organizmin e punës dhe operacionet e biznesit; nuk ka pasur raportim me shkrim nga drejtuesit e njësive çdo tre muaj mbi realizimin e planeve të prodhimit të programeve dhe të transmetimit të tyre;
-Bordi i Administrimit ka dhënë miratimin për të gjitha projektet artistike të paraqitura sipas propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme pa pësuar asnjë ndryshim, e lidhur kjo dhe me përbërjen e tij: nga 5 anëtarë gjithsej, 3 caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH;
-Struktura organike ka pësuar ndryshime të shpeshta, duke mos qenë e konsoliduar; ka pasur një numër të konsiderueshëm të pozicioneve të punës të paplotësuara që lëviz nga 3 % (2018) deri 11 % në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2017, duke ndikuar në performancën e RTSH; janë mbajtur jashtë strukturës 17 punonjës në 2017, 9 në 2018 dhe 22 në vitin 2019;
-Ka një numër të konsiderueshëm të punonjësve në organikë të RTSH që kanë përfituar njëkohësisht pagën si dhe honorarë për projekte (23 gjashtëmujori e dytë 2017, 32 në 2018 dhe 71 në 2019) duke ulur ndjeshëm jo vetëm efektivitetin e shpenzimeve për pagat, por edhe performancën individuale dhe institucionale, krahas diferencimit në trajtimin financiar të punonjësve të të njëjtit vend pune;
-Gjatë zbatimit të projekteve artistike nuk janë vendosur dhe nuk janë zbatuar kritere në lidhje me përzgjedhjen dhe kontraktimin subjekteve fizike dhe juridike për sa i përket statusit të tyre profesional, fiskal dhe gjyqësor.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të RTSH:
Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike.
Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.
Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e

sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

G. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 842/7 prot., datë 31.12.2013 për periudhën e auditimit të veprimtarisë ekonomiko – financiare të subjektit (RTSH) nga data 01.01.2010 deri më datën 30.06.2013 grupi i auditimit konstatoi se rekomandimet e lëna për përmirësimet ligjore janë zbatuar në masën 100 %, masat organizative janë zbatuar në masën 87.5 %, ndërsa masat shpërblim dëmi dhe masat disiplinore nuk janë zbatuar. RTSH/strukturat drejtuese të saj nuk i kanë ndjekur dhe monitoruar rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, deri në plotësimin e zbatimit të tyre në masën 100 %. Për shkak të periudhës së gjatë (gati 10 vjeçare) e cila ka kaluar që nga dërgimi i rekomandimeve, disa prej tyre nuk janë më aktuale për shkak të ndryshimit në vite të bazës ligjore ku referojnë, afateve të parashkrimit referuar Kodit Civil, si dhe dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: RTSH/Drejtoria Juridike të marrë masa për të siguruar trajtimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke i monitoruar dhe zbatuar ato brenda afateve të përcaktuara, me qëllim përmirësimin e situatës së funksionimit të institucionit dhe shmangien e afateve të parashkrimit të përcaktuara.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Për këtë rekomandim nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

2. Gjetje nga Auditimi: KDRTSH nuk ka hartuar një kod sjelljeje lidhur me rregullimin e veprimtarisë së vet, në kundërshtim me ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, neni 97, pika 4; në kundërshtim me ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, neni 99, pika 2, KDRTSH nuk është mbledhur në periudhën korrik-gusht të vitit 2018 dhe 2019; sipas procesverbaleve të mbledhjeve, rezulton se kanë munguar më shumë se 1/3 e mbledhjeve dy anëtarë të tij, të cilët referuar nenit 100, pika 1/c të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013, të ndryshuar, duhej të liroheshin nga detyra për shkak se mungesat nuk janë të arsyetuara dhe të dokumentuara.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të hartojë kodin e sjelljes lidhur me rregullimin e veprimtarisë së tij për çdo interes apo lidhje me ndonjë subjekt, si dhe çdo interes të mundshëm në ndonjë kontratë, që RTSH-ja ka realizuar ose synon të realizojë; të marrë masa për t'u mbledhur sa herë të jetë e nevojshme por jo më pak se njëherë në dy muaj, si dhe të dokumentojë cilësimin e mungesës së anëtarëve në çdo rast.

Brenda datës 30.09.2021 dhe në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nga RTSH nuk u vendos asnjë dokumetacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

3. Gjetje nga Auditimi: KDRTSH: - nuk ka miratuar deklaratat njëvjeçare në lidhje dhe në përputhje me Deklaratën e Qëllimit, në kundërshtim me nenin 102, pika 9 të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013, të ndryshuar;

- nuk ka miratuar kriteret kryesore për vlerësimin e punës dhe shpërblimin e punonjësve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 102 të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013, të ndryshuar pika 12;
- në kundërshtim me nenin 16 të statutit: "Rendi i ditës së mbledhjes, së bashku me materialet përkatëse, i dërgohet çdo anëtari të Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, materialet janë shqyrtuar pothuajse në çdo rast në një afat 1-2 ditor, e rezultuar kjo nga data dhe numri i protokollit të relacioneve përkatëse, në kundërshtim me ligjin nr. 97/2013, datë 04.03.2013, i ndryshuar, neni 102, pika 9; nenit 102; Statutin i RTSH neni 17, germën "ç", nenin 16;
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të miratojë deklaratat njëvjeçare në lidhje dhe në përputhje me Deklaratën e Qëllimit, të miratojë kriteret kryesore për vlerësimin e punës dhe shpërblimin e punonjësve si dhe të respektojë afatin për dërgimin e materialeve anëtarëve të këshillit para zhvillimit të mbledhjes.

Brenda datës 31.10.2021

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nga RTSH nuk u vendos asnjë dokumetacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

4. Gjetje nga Auditimi: Drejtori i Përgjithshëm gjatë ushtrimit të detyrës:
- në një pjesë të projekteve artistike të audituara, rezulton se kontratat me të tretë nuk janë nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm, veprim ky në kundërshtim me shkronjën "dh", pika 1 e nenit 105 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar;
- për vitet 2018 dhe 2019 nuk ka përgatitur një raport për AMA-n brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit financiar, për prodhimet e porositura gjatë vitit të kaluar nga fondi i prodhimit të pavarur, dhe të dhënat për shoqërinë ose personat e kontraktuar për këtë qëllim etj., veprime dhe mosveprime në mospërputhje me kërkesat e nenit 123, pika 8 e ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 të ndryshuar;
- në periudhën e auditimit nuk ka raportuar në KDRTSH për zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin të RTSH, sipas kërkesave të nenit 17, germa "a" të Statutit.
- ka menaxhuar dhe organizuar biznesin e RTSH pa pasur një plan biznesi, si dhe nuk ka hartuar dhe për rrjedhojë nuk ka kryer të dokumentuar çdo muaj mbledhjen e drejtorëve për të bërë orientimin dhe analizën e realizimit të planeve mujore, siç e kërkon pika 1, si dhe germa "c" e pikës 6 të nenit 18 të Statutit.
- nuk ka hartuar dhe për rrjedhojë nuk ka raportuar rregullisht Këshillit Drejtues të RTSH-së për realizimin e planeve të zhvillimit të programeve e të biznesit siç e kërkon germa "ç" e pikës 6 të nenit 18 të Statutit;
- për periudhën e audituar, nuk ka zbatuar plotësisht kërkesat e paragrafit të dytë të pikës 2 të nenit 35 të Statutit, pasi RTSH-ja nuk ka bërë publike në faqen zyrtare të internetit: vendet e lira të punës, rezultatet e vlerësimit të kandidatëve dhe shpalljen e fituesit; planin strategjik të miratuar nga KD i RTSH-së, burimet e financimit dhe shpenzimet vjetore, kontratën e lidhur me AMA-n, si dhe raportet vjetore të Këshillit të Dëgjuesve dhe Shikuesve dhe atij të Bordit të Administrimit.
- RTSH dhe KD nuk kanë vënë në qarkullim një botim periodik, ku publikohen të dhëna të hollësishme për situatën financiare të institucionit dhe të dhëna testuese që opinioni ka për veprimtarinë programore të RTSH-s, sipas kërkesave të pikës 5 të nenit 35 të Statutit, pasi RTSH nuk ka vënë qarkullim;

- nuk ka përgatitur aktin e përgjithshëm për bazat dhe kriteret e vlerësimit të performancës së punës, për t'i miratuar më pas në KDRTSH, sipas kërkesave të pikës 2, 3 dhe 4 të nenit 46 të Statutit;
- Drejtuesit e Njësive nuk kanë raportuar me shkrim çdo tre muaj Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e planeve përkatëse: planeve të prodhimit të programeve dhe të transmetimit të tyre dhe për defektet teknike dhe ndërprerjet e transmetimeve kombëtare të programeve audio dhe audiovizive të RTSH-së, sipas kërkesave të germave përkatëse të neneve 24, 25 dhe 26 të Statutit;
- megjithëse KDRTSH me vendimin nr. 57, datë 11.10.2017 i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshme të RTSH paraqitjen brenda 3 javëve në KD të informacionit mbi ecurinë e procesit të ristrukturimit, nga dokumentet nuk rezulton të jetë kryer një kërkesë e tillë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa dhe të organizojë punën për nënshkrimin e kontratave me të tretë; informimin e AMA në afat për çështje të prodhimeve të porositura dhe fondin e prodhimit të pavarur; për të raportuar për zbatimin e strategjisë; hartimin dhe zbatimin e plan biznesit për zhvillimin e veprimtarisë; hartimin rregullisht të planeve mujore të punës dhe raportimin në KDRTSH-së për realizimin e planeve të zhvillimit të programeve e të biznesit; raportimin dhe dokumentimin e Drejtuesve të Njësive me shkrim çdo tre muaj Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e planeve përkatëse; si dhe paraqitjen në KD të informacioneve sa herë të kërkohet prej tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Njësia e Programeve ka raportuar për tremujorin dhjetor 2021 - shkurt 2022 dhe do të vijojë me raportimet tremujore, njësoj edhe strukturat e tjera si Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve dhe Njësia Teknike. AMA është informuar për çështjet në lidhje me prodhimet e pororsitura dhe fondin e prodhimit të pavarur për 2021 me shkresën nr. 1240, datë 30.03.2022. Plani i biznesit 2021 – 2025 nr. 4152, datë 10.12.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

5. Gjetje nga Auditimi: për aktivitetin e Bordit të Administrimit:
- Në mbledhjet e Bordit të Administrimit nuk ka marrë pjesë znj. E. D., e cila në referencë të nenit 108, germa "c" duhej liruar nga detyra që në datën 1.10.2017 dhe është zëvendësuar pas pak më shumë se dy viteve;
- Bordi i administrimit nuk ka përpiluar rregulla për të gjitha çështjet financiare, të cilat janë në juridiksionin e Drejtorit të Përgjithshëm në mospërputhje me pikën 1 dhe 6 të nenit 111 të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013 i ndryshuar.
- Bordi i administrimit në mospërputhje me germën "ç" të nenit 20 të Statutit, nuk i ka paraqitur Këshillit Drejtues raportin për shpenzimet dhe të ardhurat e RTSH-së, në formë raportesh financiare mujore.
- Materialet e shqyrtuara në mbledhje kanë ardhur në Bordin e administrimit ditën e zhvillimit të mbledhjes, veprim i cili është dhe në kundërshtim me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Bordit të administrimit të RTSH, neni 13;
- Miratimi preventivave të projekteve dhe emisioneve nga Bordi i Administrimit është bërë në çdo rast sipas propozimeve të Sektorit të projekteve, pa i analizuar në referencë të librit të tarifave, si dhe nuk ka miratuar tarifat e reja duke vepruar në kundërshtim me pikën 2 të nenit 49 të statutit;
- Ka dhënë pëlqimin për çdo çështje të paraqitur për shqyrtim sipas formës dhe përmbajtjes së prezantimit të materialeve nga ana e Drejtorisë së përgjithshme të RTSH, duke mos pasur ndikim në veprimtarinë e tij në zhvillimin dhe përparimin institucional të RTSH. Dhënia e pëlqimit dhe e vendimeve për çështje të veçanta pa ndryshime është e lidhur me vetë përbërja

e Bordit të Administrimit, pasi në shumicë janë nëpunës të brendshëm të RTSH, pra në një far mënyre japin pëlqime për vet-veten;

– - Nuk ka përgatitur planin e biznesit si një element bazë në organizimin e punës dhe operacionet e biznesit, në kundërshtim me nenin 52 dhe 53 të Statutit, në përgjegjësi të plotë edhe të Bordit të Administrimit,

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23 - 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtuesi RTSH të marrë në shqyrtim veprimtarinë e deritanishme të Bordi i Administrimit, dhe mbi bazën e problematikave të evidentuara në këtë Raport auditimi, të marrë masat e nevojshme organizative në drejtim të funksionimit efektiv të kësaj strukture.

Brenda datës 31.10.2021

5.2 Rekomandimi: Bordi i Administrimit të marrë masa për të zhvilluar veprimtarinë e vet me kapacitet të plotë, duke përpiluar rregulla për çështje financiare; për raportimet financiare mujore, respektimin e afatit për shqyrtimin e dokumentacionit për mbledhje; shqyrtimin e vëmendshëm të projekteve dhe preventivave si dhe hartimin, miratimin dhe më pas zbatimin e plan-biznesit.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Bordi i Administrimit nuk ka kryer raportime mujore por 3-mujore, ka analizuar situatën dhe ka rekomandime përkatëse.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Pjesërisht

6. Gjetje nga Auditimi: RTSH e ka zhvilluar veprimtarinë ekonomike dhe financiare në mungesë të planit të biznesit; ka prirje të planifikimit në rënie të të ardhurave vjetore; ka mangësi në planifikim; mungesë të mekanizmave kontrollues dhe verifikues për tarifën e aparatit televiziv; nuk ka hartuar dhe ndjekur një strategji të caktuar në lidhje me strukturën e të ardhurave nga reklamat në cash dhe me klering; ka një nivel të konsiderueshëm të detyrimeve të tretëve ndaj RTSH, nuk ka pasur fond për prodhimin e pavarur etj., veprime këto në kundërshtim meligjin nr. 97/2013, i ndryshuar, neni 123; Statuti i RTSH, neni 52, pika 2; neni 53.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 32 - 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese dhe Bordi i Administrimit të RTSH të marrin masa për hartimin e planit të biznesit; planifikimit e të ardhurave me trend rritës dhe bashkërendim dhe koordinim midis tyre për të hartuar planifikim real treguesish dhe performancë institucionale opimale; gjetjen e mekanizmave kontrollues dhe verifikues për tarifën e aparatit televiziv që arkëtohet nga OSHEE SHA; hartimin e një strategjie të caktuar në lidhje me strukturën e të ardhurave nga reklamat në cash dhe me klering; bashkëpunimi më efikas midis Njësisë Teknike, Drejtorisë së Marketingut, Drejtorisë Ekonomike dhe asaj Juridike për uljen e detyrimeve të tretëve ndaj RTSH; si dhe krijimin e fondit për prodhimin e pavarur.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Për sa i përket marrjes së masave për hartimin e planit të biznesit Drejtoria Ekonomike ka hartuar dokumentacionin e kërkuar dhe dërguar pranë personit të ngarkuar për hartimin e plan biznesit të RTSH me emailet përkatëse .Plan biznesi i RTSH është hartuar për periudhën 2021-2025 dhe protokolluar me nr 4152 dt 10.12.2022.
Ka përgatitur dhe derguar Udhëzimin për përgatitjen e projektbuxhetit për vitet 2021me shkresë nr 4022 dt 28.12.2020 dhe për vitin 2022 me shkresë 4697 dt 24.12.2021,Drejtorive /Njësive të RTSH.

Drejtoria Ekonomike për vitin 2021 e në vijim ka përgatitur projektbuxhetin derguar Drejtorit të Pëgjithshëm me shkresë 4022/1 dt 10.02.2021 duke bërë planifikimin e të ardhurave të veta me strukturë :
-Kontratat me subjektet për transmetimet në kanalet analoge ,
-Kontratat e dhënies me qera të ambienteve transmetuese të RTSH,
-Transmetimi në radio për të tretë,
-Reklamat,njoftimet,kronikat,sponsorizimet etj,
-Të ardhura të tjera.
Ka bërë planifikimin e shpenzimeve duke përfshirë dhe shpenzimet për fondin e prodhimit të pavarur në zbatim të nenit 123 "Fondi i Prodhimit të Pavarur" të Ligjit 97/2013dt 04.03.2013,'Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë".
Ka dërguar shkresa për arkëtimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive nr 4230 dt15.12.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve, OSHEE, Furnizuesit Shërbimit Universal.
Drejtoria Ekonomike ka bashkëpunuar për uljen e detyrimeve me Drejtorinë e Shitjes dhe Menaxhimit të Trafikut dhe Njësinë Teknike ,duke u dërguar listën e subjekteve debitore me të dhënat për shumën e detyrimit dhe periudhat përkatëse me shkresën nr 2074/6 dt 11.01.2022 si dhe listat me subjektet që janë në përmbarim dhe në proçese gjygjësore për detyrimet e mbartura, si dhe hartimin e njoftimeve për cdo debitor. Drejtoria Ekonomike ka bashkëpunuar me Drejtorinë Juridike duke i dërguar njoftim me shkrim për detyrimet kontraktore të subjekteve ndaj RTSH, njoftim për fillimin e proçedurave gjygjësore për subjektet duke bashkëngjitur dokumentat përkatëse, njoftime herëpashere sipas rastit për likujdimet e bëra nga subjektet për të cilat ka filluar proçes gjygjësor, me shkresat nr 1417/7 datë 20.01.2021, nr1901 datë 03.06.2021, nr 169 datë 11.01.2022, nr 685 datë 16.02.2022 etj. Këto raportime janë të përmuajshme në bazë të Urdhrit nr. 3011, datë 24.10.2019. Raportimi i fundit është me shkresë nr. 2718, datë 13.07.2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i administrimit të marrëdhënieve të punës konstatohet se:
- Në kontratën individuale të punës mungojnë çështjet e afatit dhe të mënyrës së pagesës, si dhe është trajtuar njëlloj kontrata me kohë pune të pjesshme si ajo me kohë të plotë, përfshirë dhe afatet, në kundërshtim me Kodin e punës, neni 115, pika 4;
- Struktura organike e RTSH ka pësuar ndryshim të shpeshta, punonjësit nuk janë të grupuar në 3 sektorë, ka një numër të konsiderueshëm punonjësish të paplotësuar, nuk ka kritere për marrjen në punë të punonjësve të rinj dhe për vlerësimin e performancës vjetore, pagat e orkestrës janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe frekuente, si dhe trajnimet kanë qenë në numër të vogël pjesëmarrësish dhe jo në mënyrë të vazhdueshme, në kundërshtim me Statutin neni 31, pika 1; neni 29, pika 2; neni 46, pika 2;
- Janë mbajtur jashtë strukturës 17 punonjës në vitin 2017, 9 në vitin 2018 dhe 22 në 2019 në kundërshtim me Vendimit të KDRTSH nr. 37, datë 18.04.2017, në mungesë të përcaktimit të kritereve, duke ndikuar në rritjen e shpenzimeve për pagat jashtë planifikimit;
- Një numër i konsiderueshëm i punonjësve të RTSH kanë përfituar njëkohësisht pagën për vendin e punës, si dhe honorarë për projekte, duke ulur ndjeshëm efektivitetin e shpenzimeve për pagat;
- RTSH nuk ka shkëputur marrëdhëniet e punës për 12 punonjës edhe pas plotësimit të moshës së daljes në pension, në kundërshtim me VKM nr. 478, datë 16.06.2010 "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie", pika 4;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 38 - 46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa për rishikimin e kontratës individuale të punës, për të përfshirë të gjithë elementët përkatës, si dhe të diferencojë kontratat e punës me kohë të pjesshme; të plotësohet dhe të konsolidohet struktura organike, duke përcaktuar kriteret e marrjes në punë si dhe ato të performancës së punës; të sigurohet një trajnim i vazhdueshëm dhe sa më masiv; të zbatohen rigorozisht vendimet e KDRTSH, si dhe të shkëputen marrëdhëniet e punës së punonjësve që kanë plotësuar moshën e pensionit.

Brenda datës 31.10.2021 dhe në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Përsa i takon kontratës individuale të punës, nga ana e kësaj drejtorie janë reflektuar ndryshimet dhe është dërguar në Bordin e Administrimit për miratim me shkresë nr 3433 datë 11.10.2022 por nuk ka një përgjigje, për rrjedhojë kontrata nuk ka pësuar ndryshime dhe vazhdon të jetë ne formatin ekzistues. Aktulisht është në proces zbatimi, por nga ana e kësaj drejtorie në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike është kryer si detyrim nga ana e tyre. Po kështu në përsa i takon konsolidimit të strukturës, aktualisht po bëhen lajmërime për vendet vakante, bazuar në kriteret e pozicionit përkatës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

8. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla për periudhën objekt auditimi konstatohet se në 12 raste janë kryer procedura të cilat tejkalojnë shumën totale prej 800,000 lekë. Këto procedura për arsye se konsiderohen grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme duhet të prokuroheshin njëherësh dhe t'u nënshtroheshin procedurave normale të tenderimit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu IV, neni 40, pika 1; me Udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar, pika 3 dhe 4, Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 46 - 54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Prokurimeve të marrin masat që, në hartimin e regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Janë marrë masat që në hartimin e regjistrave të analizojë dhe grupojë emërtimin e e procedurave duke shmangur copëzimine fondeve, referuar dhe regjistrit të hartuar dhe protokolluar me nr 850 datë 25.02.2022.

DO të verifikohet në auditimin e ardhshëm.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

9. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla rezultoi se:

- Në të gjitha rastet e audituara rezulton se nuk është verifikuar, dokumentuar dhe argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve iu është dërguar ftesa për ofertë.
- Në 5 (pesë) raste në vitin 2018 dhe në 6 (gjashtë) raste për vitin 2019 rezulton se nuk ka urdhër nga titullari për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimeve.
- Në 6 (gjashtë) raste për vitin 2017, në 4 (katër) raste për vitin 2018 dhe në 5 (pesë) raste për vitin 2019 rezulton se nuk dokumentohet kërkesa përkatëse për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit, i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.

- Në 6 (gjashtë) raste për vitin 2017 dhe në 2 (dy) raste për vitin 2018 rezulton se nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e llogaritjes së fondit limit.
- Në 6 (gjashtë) raste për vitin 2017, në 9 (nëntë) raste në vitin 2018 dhe në 5 (pesë) raste në vitin 2019 konstatohet se, faturat tatimore nuk janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, ndërkohë që verifikimi i faturës është pranuar dhe është likuiduar nga nëpunësi zbatues i cili kontrollon veprimet para kryerjes së shpenzimeve.
- Në 2 (dy) raste për vitin 2017, në 3 (tre) raste për vitin 2018 dhe në 3 (tre) raste për vitin 2019 konstatohet se, për procedurat e blerjeve me vlerën nën 100,000 lekë nuk është nxjerrë urdhër prokurimi nga titullari i AK apo zyrtari i autorizuar prej tij për përcaktimin e objektit të prokurimit dhe sasinë e cila do të prokurohet për mallra apo shërbime. Situata e mësipërme është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, nenin 4, nenin 40, pika 3, nenin 57, pika 3, neni 77, pika 3, me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, pika 42, me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 *"Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"*, i ndryshuar, pika 5, 7, 19.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 46 - 54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike e RTSH, Drejtoria e Planifikimit dhe Prokurimeve dhe zyrtarët e prokurimeve të blerjeve me vlera të vogla të marrin masat që, për këto procedura prokurimi, të veprohet duke shmangur shkeljeve e konstatuara më sipër.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Prokurimeve urdhëri i prokurimit shoqërohet me ftesë për ofertë drejtuar operatorëve me të dhënat e nevojshme bazuar në objektin e prokurimit referuar procedura e prokurimit e sipërcituar tek shqyrtimi i rekomandimeve tëk Drejtoria Ekonomike.

Drejtoria e Planifikimit dhe Prokurimeve për Blerjet e vogla ka dërguar me shkresë zyrtare për blerjet e vogla pranë Drejtorisë Ekonomike dokumentacionin (fotokopje) të proçedurës së kryer për likujdim sipas objektit përkatës të blerjes referuar shkresës nr. 53/8 dt 24.08.2020 "Blerje materiale të ndryshme për Studion e grimit"si më poshtë :

Urdhër prokurimi Proçes verbalin e kualifikimit për operatorin ekonomik Faturën e shitjes Proçesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit.Fletë hyrjen e magazinës.

Drejtoria Ekonomike ka ushtruar kontrollin e dokumentacionit dhe ka kryer pagesën përkatëse. në mënyrë që procedurat për blerjet e vogla të realizohen sipas ligjit për Prokurimin Publik dhe VKM përkatëse.

Do verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

10. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të konsumit të karburantit, dhe shpenzimeve të kryera për automjetet, rezultoi se: Nga ana e administrimit të RTSH, drejtori i financës dhe buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe përgjegjësi i sektorit e caktuar për menaxhimin e aktiveve nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të RTSH, nuk janë kryer kontrolle dhe analiza për llogaritjen e konsumit real të karburantit. Për automjetet që disponon RTSH rezulton se nuk kanë kartela përkatëse të këtyre aktiveve, në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to ku, gjithashtu duhet të jetë evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike përkatëse, në cilësinë e dokumenteve të kontabilitetit. Këto shpenzime të cilat nuk mund të përllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, neni 12, Udhëzimin nr.

30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar, pikat 5-10, 35 dhe 36.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 46 - 54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Administratës, të marrin masat e duhura për hartimin e kartelave përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet periodike, për të bërë të mundur monitorimin e tyre.

Brenda datës 31.10.2021

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të mësipërm Drejtoria Ekonomike shprehet se mban kartelat e konsumit të karburantit për çdo automjet ndërsa, kartelat e automjeteve, përditësimi i të dhënave, shpenzimet periodike dhe monitorimi janë detyrë e Drejtorisë së Administratës.
Drejtoria e Administratës ka filluar punën duke mbledhur informacionet për çdo automjet për të dhënat e përgjithshme dhe specifike si dhe riparimet e kryera për të bërë të mundur hartimin e kartelave.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i prokurimeve publike në tenderin me objekt *"Rikonstruksioni i Godinës Radiotelevizionit Korçë"* konstatohet se në dosje nuk figuron deklarata paraprake për punime, apo ndonjë gjurmë për aplikimin e saj, veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"* i ndryshuar, neni 7, germa "i". Nga auditimi i DT, konstatohet se janë vendosur kritere që kufizojnë pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomikë (OE), konkretisht: nuk përmban grafikun për realizimin e punimeve, sipas kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni 11, pika 3/a neni 26, pika 4 dhe neni 57/ 4 si dhe DST publikuar nga APP; kriteri 2.3,5 për drejtuesin teknik me përvoje pune mbi 10 vjet", jo në përputhje me Ligjin Nr. 8402, date 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" neni 7 dhe VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 "*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*", neni 23, pika 5 si dhe Ligjin "Për prokurimin publik" me ndryshime neni 20 dhe neni 46, pika 1.b; për të cilin ka qëndrime të ndryshme në procedurat e tjera të prokurimit. Nga auditimi i DT me objekt: *"Rikonstruksion i Stacioneve Ekzistuese..."* konstatohet se ka kritere që kufizojnë pjesëmarrjen e OE të tilla si:
- Kriteri (për 6 lote), pika 2.3.6. për audituesenergjie dhe mjedisor, pasi në preventiv nuk parashikohet asnjë zë për matjen e eficiencës së energjisë apo auditimin e energjisë dhe të mjedisit, por ashtu për termin certifikatë etj. Për procedurën *"Blerje Sistemi Satelitor (DVS-S2)"*: -Kriteret e veçanta, pika 2.3.5. *për inxhinier elektronik, mekanik, elektrik, megatronik (bachelor) dhe telekomunikacioni (master shkencor)"*, duke i diferencuar midis tyre për nivelin, është jo në përputhje me ligjin nr. 9643, datë20.11.2006 i ndryshuar, neni 20 dhe DT, pika 2.3.5. Për procedurën *"Blerje Licenca për përdorues sistemi MAM Etere playout si dhe support"*: - Kriteri 2.2.3 *"...punonjës të siguruar jo më pak se 25 ..."*, nuk është në përputhje me objektin dhe llojin e kontratës etj. Për procedurën*"Kryerje e Shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë me Roje Private në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH, në Drejtorinë e Stacioneve Transmetuese RTV, në Radiostacionin Shijak e Radiostacionin Fllakë"*: - Kriteret e veçanta, shtojca 8, pika 3.2 germa "c", **"***Operatori.. duhet të ketë të siguruar jo më pak se 62 punonjës...*", jo në përputhje me kriterin 3.1 germa "d" dhe me shtojcën 9, duke sjellë që kriteret të jenë konfuze dhe jo të qarta për operatorët, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 28, pika 2. -Kriteri 3.3, pika 3, të cilat nuk janë në përputhje me objektin e tenderit sipas detyrimit ligjor parashikuar në ligjin nr. 9643,

datë20.11.2006 i ndryshuarneni 46, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 28, pika 2 etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1 Rekomandimi: Të merren masa në të ardhmen nga RTSH, që në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në rastet e prokurimit për punë publike, para fillimit të procedurave të aplikojë për Deklaratë paraprake të punimeve, konform detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, me qëllim shmangien e risqeve të mundshme nga ndërtimi i objekteve pa leje ndërtimi.

Në vijimësi

11.2 Rekomandimi: RTSH në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të analizojë parregullsitë e konstatuara nga auditimi i KLSH-së në hartimin e dokumenteve të tenderit, të vlerësojë përgjegjësitë e hartuesve në çdo rast dhe në vijim, në varësi të këtij vlerësimi, t'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik vendosjen e masave administrative/disiplinore.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën në dispozicion asnjë dokumentacion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

12. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i prokurimeve publike në tenderat me objekt: *"Rikonstruksion i Stacioneve Ekzistuese-ndarë në 6 lote"* konstatohet se hartimi i Urdhrit nr. 478/1, datë 14.02.2017 për ngritjen e grupit të punës për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, nuk është i qartë nga përmbajtja, pasi referenca ligjore ku bazohet urdhri është Statuti i RTSH dhe jo VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 56. Kjo ka sjellë si pasojë që Urdhri të mos përcaktojë qartë detyrimet e grupit të punës, pasi kërkohet "verifikimi i çmimeve" për blerje pajisje dhe shërbim dhe jo llogaritja e fondit limit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1 Rekomandimi: Të merren masa nga RTSH në cilësinë e Autoritetit Kontraktor që në të ardhmen, hartimi i urdhrave për ngritjen e grupeve të punës për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, të bëhet në përputhje të plotë me detyrimet ligjore të prokurimeve publike, në mënyrë që të mos krijohen paqartësi në zbatim të tij.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

13. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit me objekt: - *'Rikonstruksioni i stacioneve ekzistuese'*;- *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'*, - *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'*: rezulton se nga ana e Titullarit të AK janë ngritur grupe pune me punonjës jo sipas profesioneve të domosdoshme për hartimin e preventivave në përputhje me kuadrin përkatës ligjor e rregullator. Situata e mësipërme është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, neni 56.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masa për angazhimin e punonjësve me profesione të përshtatshme sipas nevojave të investimit të planifikuar me qëllim garantimin e strukturave të nevojshme për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

14. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimet me objekt: *"Rikonstruksioni i stacioneve ekzistuese, 6 lote"*; "*Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018"*; "*Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019"* rezultoi se nuk janë marrë masat e nevojshme për nxjerrjen e lejes së ndërtimit nga ana e RTSH në rolin e investitorit. Gjithashtu, për investimin me objekt: *'Rikonstruksion i tarracës dhe dritareve të Godinës së Radio Kukësit'*, rezultoi se nuk janë marrë masat as për njoftimin nëpërmjet deklaratës paraprake për punimet e ndërtimit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, neni 39, pika 1.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
14.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masa për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme për aplikimin dhe pajisjen me leje ndërtimi në rastet e investimeve në të cilat janë të përfshira punime ndërtimi, ku termi *punime ndërtimi* kuptohet ai sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

15. Gjetje nga Auditimi: Lidhur me realizmin e investimeve rezultoi se:
- Në investimin me objekt *"Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese"* preventivi i kërkuar nga ana e ish-Drejtor i Drejtorisë së Stacioneve Transmetuese dhe njëkohësisht i përgatitur nga grupi i punës si dhe vetë ofertuesit në të cilët është marrë oferta për përllogaritjen e fondit limit nuk është hartuar nëpërmjet një analize kostoje, për disa zëra të preventivit në vlerën prej 67,217,625.54 lekë pa TVSH, ose 80 % e preventivit. Konkretisht rezulton se nuk është realizuar një analizë kostoje për kategoritë Punëtori, Transport, Makineri dhe Materiale.
Gjithashtu, zërat nuk janë ndarë sipas kategorive përkatëse të cilat duhet të ishin pasqyruar si: Punime ndërtimi; Punime teknologjike dhe të montimit etj.
- Në investimin me objekt *"Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018",* zërat e punimeve në preventiv nuk janë ndarë sipas kategorive përkatëse të cilat duhet të ishin pasqyruar si: punime ndërtimi; Punime teknologjike dhe të montimit, Punime teknologjike dhe punime të montimit;
Për përllogaritjen e fondit limit nuk është hartuar nëpërmjet një analize kostoje, kjo për zërat sipas preventivit përkatës të cilët përbëjnë shumën prej 14,966,160 lekë pa TVSH, ose 100 % e preventivit, sipas kategorive të mësipërme. Formati i preventivit është hartuar duke përfshirë në listën e zërave të ngarkuar me TVSH edhe ato për pajisjet. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave *'Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit'*, ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011.
- Në mënyrë të ngjashme si në rastin e procedurës me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'* është vepruar edhe me procedurën me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'* për të cilën Autoriteti Kontraktor nuk ka siguruar mirë përdorimin e fondeve publike dhe transparencë për shpenzimet e parashikuara në shumën 40,393,040 lekë pa TVSH.

Për rrjedhojë rezulton se Grupi i Punës i cili ka bërë edhe përcaktimin e fondit limit në lidhje me këto tre procedura nuk ka siguruar mirë përdorimin e fondeve publike dhe transparencë për shpenzimet e parashikuara në shumën **122,576,825 lekë pa TVSH**. Situata e mësipërme është në kundërshtim me:
- Ligjin nr. 9643 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 1, pika 2; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave '*Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit'*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, konkretisht, pika b, e këtij Udhëzimi ndryshues; Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, e ndryshuar, pikat 2, 3, 9; Udhëzimin nr. 2 datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu I.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
15.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të punës për përllogaritjen e fondit limit të merren masa për marrjen e ofertave dhe më tej hartimin e preventivave me çmime të cilat duhet të rezultojnë nga shuma e nevojshme e çmimeve të ofruara/preventivuara për çdo kategori që është pjesë e strukturës së kostos, për kategoritë Punëtori, Makineri etj. me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

16. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, rezultoi se specifikimet teknike për punimet/shërbimet e parashikuara për tu kryer në lidhje me zërin *"FTV ndërtim kulla"* (furnizim transport vendosje ndërtim kulla) nuk janë shoqëruar me një projekt të mirëfilltë ndërtimi ku të paraqiten të detajuara të gjitha elementët/detajet e kullës për tu realizuar. Duke qenë se nuk është paraqitur asnjë detaj nga projekti dhe në specifikime teknike janë kërkuar vetëm rezultatet e punës së përfunduar rezulton se Detyra e Projektimit të kullës i është lënë firmës sipërmarrëse të punimeve. Në fakt referuar Kritereve të Veçanta të Kualifikimit sipas DST – ve përkatëse për këtë procedurë nuk rezulton që si kriter të jetë vendosur kushti i disponimit të OE pjesëmarrës në tender të licencës përkatëse për Projektim. Situata e mësipërme është në kundërshtim VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, neni 26, pika 2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
16.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masa për trajnimin e stafit të angazhuar në procedurat e prokurimit si dhe angazhimin e punonjësve me profesione të përshtatshme sipas nevojave të investimit të planifikuar.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

17. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh në dosjen teknike të zbatimit për këtë lot rezultuan mangësitë si më poshtë: - Procesverbalet e provave me ngarkesë nuk janë firmosur nga ana e stafit të RTSH për zërat: Gjeneratori; Sistemi ATS; Stabilizatori i tensionit; Sistemi i radrizatorit; Sistemi i kamerave; Sistem fikje zjarri automatik; Sistemi i kondicionimit; Sistem fikje zjarri automatik.
- Procesverbali i përfundimit të punimeve i mbajtur të prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe sipërmarrësit nuk përshkruan datën e mbajtjes së tij dhe as datën e përfundimit të punimeve;

- Akti i kolaudimit nuk përshkruan datën e mbajtjes së tij dhe as datën e përfundimit të punimeve;
Dokumentet e cituara më sipër përmbajnë të dhëna kontradiktore në lidhje me datën e përfundimit të punimeve. Konkretisht, referuar njoftimeve të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit.
Gjithashtu, për Lotet I, III u konstatuan mangësi në dokumentacion si më poshtë:
Loti I – MIDE: Nuk disponohet software për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes;
Loti III – CERVENAKE: Nuk disponohet software për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes; Nuk disponohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve/furnizimeve; Nuk disponohet libreza e masave;
Loti IV – GLLAVË: Nuk disponohet software për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes; Nuk disponohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve/furnizimeve; Nuk disponohet libreza e masave;
Loti V – SOPOT: Nuk disponohet software për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes; Në dosje nuk disponohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve/furnizimeve;
Loti VI – LLOGARA: Nuk disponohet sofware për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes; Në dosje nuk disponohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve/furnizimeve.
Situata e mësipërme është në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara nga Drejtori i Drejtorisë së Stacioneve Transmetuese, konkretisht pika 7, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar,* pika 4, si dhe me Kontratat respektive të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH si dhe strukturat e ngritura për monitorimin e investimeve të merren masa për shmangien e pranimit të dosjeve teknike me mangësi në dokumentacion me qëllim sigurimin e transparencës dhe besueshmërisë në drejtim të furnizimit të AK për mallrat e blerë dhe dokumentimit të punës së kryer.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

18. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimet me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'* dhe *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'* konstatohet se nga ana e Autoritetit Kontraktor, edhe pse vlera e përllogaritur në fondin limit prej 17,316,156 lekë me TVSH (procedura e vitit 2018) dhe 47,580,840 lekë me TVSh(procedura e vitit 2019), janë mirëfilli punime ndërtimore dhe/ose punime ndërtimore, por të kategorisë punime teknologjike dhe të montimit, deri në përfundim të kontratës dhe marrjes në dorëzim nga ana e grupeve të ngritura, nuk janë emëruar apo lidhur kontratat përkatëse të shërbimit të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë

10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masa për emërimin e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në rastet e investimeve në punime ndërtimi.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

19. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'*, rezultoi se në praktikën e marrjes në dorëzim nuk disponohet dokumentacioni si më poshtë: Autorizim prodhuesi; Katalogun; Dokumentin e testimit të lyerjes së jashtme etj., si dhe nuk ka një dokumentacion fotografik për punimet e maskuara. Situata e mësipërme është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 67/12 prot., datë 07.11.2019, si dhe me Urdhrin nr. 775/1 prot., datë 15.11.2018 për marrjen në dorëzim të mallrave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1 Rekomandimi: Nga ana e strukturave të ngritura për monitorimin e investimeve të merren masa për shmangien e pranimit të dosjeve teknike me mangësi në dokumentacion me qëllim sigurimin e transparencës dhe besueshmërisë në drejtim të furnizimit të AK për aktivet e furnizuara.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

20. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'*, rezultoi se në praktikën e marrjes në dorëzim nuk disponohet dokumentacioni si më poshtë: Dokumentimi me material fotografik lyerjen me bojë antiruxhio një dorë dhe me bojë bituminoze dy duar e depozitave, trashësia minimale 5 mm, Autorizim prodhuesi, Katalogu përkatës; Dokumentin e testimit të lyerjes së jashtme, Dokumenti i testimit hidrostatik etj. Situata e mësipërme është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 20/13 prot., datë 26.04.2019 si dhe me Urdhrin nr. 319/1 prot., datë 26.04.2019 për marrjen në dorëzim të mallrave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
20.1 Rekomandimi: Nga ana e strukturave të ngritura për monitorimin e investimeve të merren masa për shmangien e pranimit të dosjeve teknike me mangësi në dokumentacion me qëllim sigurimin e transparencës dhe besueshmërisë në drejtim të furnizimit të AK për aktivet e furnizuara.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

21. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit: *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'*; *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'* sipas DST konstatohet se nga ana e anëtarëve të NJP është përcaktuar lloji i kontratës *Kontratave Publike*

për Mallra. Në fakt referuar specifikimeve teknike të hartuara nga ana e Grupit të Punës, përshkrimi i punimeve tregon se kemi të bëjmë mirëfilli me punime ndërtimi dhe punime teknologjike dhe të montimit. Në kushte të tilla këto dy procedura nuk duhet të ishin prokuruar si kontrata *Kontratave Publike për Mallra* por si *Kontrata për Punë Publike*. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 3 përkufizime; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, neni 26, pika 2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
21.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, strukturat e ngritura në cilësinë e NJP, të marrin masa në të ardhmen e identifikimit e drejtë të natyrës së investimit me qëllim përzgjedhjen e saktë të procedurës së prokurimit.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

22. Gjetje nga Auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit rezultoi se për periudhën objekt auditimi, në 2 raste, përkatësisht në procedurat *"Blerje Led Wall dhe aksesorë shtesë"* dhe *"Blerje guidë elektronike të Programeve EPG – viti 2017"*,me vlerë të fondit limit 7,990,823 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 7,777,990 lekë pa TVSh nr. 183/5 prot., datë 24.11.2017 mes Autoritetit Kontraktor RTSH, dhe sipërmarrësit të punimeve BOE *"A. E."* ShPK &*"E.-F."* ShPK nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave janë kualifikuar OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht ato në lidhje me certifikatat, punët e ngjashme, objekti i aktivitetit me atë të prokurimit etj. Në këto dy raste, procedurat e prokurimit duhet të ishin anuluar dhe të rinisnin një të re.
Situata për këto dy procedura prokurimi është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 1 *"Objekti dhe qëllimi"* pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 53, pika 3 dhe 5, germa c si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar, neni 66, pika 3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
22.1 Rekomandimi: Komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të marrin masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: RTSh në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, janë marrë masa që komisionet e ngritura për vlerësimin e ofertave të paraqesin përgjegjësi dhe profesionalizëm gjatë shqyrtimit, vlerësimit të procedurës. Do të vlerësohet në auditimin e rradhës
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

23. Gjetje nga Auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit rezultoi se për periudhën objekt auditimi, në procedurën e prokurimit me objekt *"Blerje licencë për përdorues në sistemin EPG dhe integrimin në sistemin aktual si dhe trajnimi i punonjësve – viti 2018"*,me vlerë të fondit limit 2,890,891.7 lekë pa TVSH. Sipas dokumentacionit të administruar në SPE *(Sistemi i Prokurimit Elektronik)*, konstatohet se është favorizuar padrejtësisht dhe shpallur fitues ky OE pasi nuk përmbush disa prej kritereve si për kapacitetin ekonomik dhe financiar, për kapacitetin teknik etj., në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 1 *"Objekti dhe qëllimi"*

pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 53, pika 3 dhe 5, germa c si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar, neni 66, pika 3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
23.1 Rekomandimi: Komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të marrin masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: RTSh në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, janë marrë masa që komisionet e ngritura për vlerësimin e ofertave të paraqesin përgjegjësi dhe profesionalizëm gjatë shqyrtimit, vlerësimit të procedurës. Do të verifikohet në auditimin e rradhës

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

24. Gjetje nga Auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit rezultoi se për periudhën objekt auditimi, në 1 rast, përkatësisht në procedurën me objekt *"Blerje Led Wall dhe aksesorë shtesë"*,rezultoi se nga dokumentacioni i dorëzuar fizikisht nga ana e OE përpara lidhjes së kontratës nuk disponohet certifikata *'Certifikatë për sistemin e menaxhimin e cilësisë së organizatës'*, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, neni 57, pika 3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
24.1 Rekomandimi: Personat e emëruar si përgjegjës për prokurimin të marrin masa për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar të ofertuesve të shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Në vijim janë marrë masa që komisionet e ngritura për vlerësimin e ofertave të paraqesin përgjegjësi dhe profesionalizëm gjatë shqyrtimit, si dhe me qëllim rritjen e efektivitetit të konkurrencës do të argumentojnë, vlerësojnë, verifikojnë dokumentacionet e dorëzuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e përcaktuara në DST. Gjithashtu, përpara lidhjes së kontratës, në vijim do të merren masa për dërgimin e kërkesave për ofertë nga operatorë në tregun e fushës së objektit prokurimit. Komisionet e ngritura për hartimin e kritereve do të marin masa të argumentojnë cdo kriter të vendosur.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

25. Gjetje nga Auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit rezultoi se për periudhën objekt auditimi, në 2 raste, përkatësisht në procedurat me objekt:
- *'Blerje guidë elektronike të Programeve EPG – viti 2017'*,me vlerë të fondit limit 7,990,832.67 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 9,333,480 lekë me TVSh, të lidhur sipas aktit me nr. 183/5 prot., datë 24.11.2017 rezultoi se, u është dërguar ftesë pesë OE me argumentin se *"...këta OE mendohet të jenë operatorë të fuqishëm në treg si dhe duke pasur parasysh mallin i cili po prokurohet..."*. Në lidhje me këta OE konstatohet se janë ftuar mes tyre 3 OE ndër të cilët: OE A. E. i cili figuron i regjistruar si OE në fushën objekt prokurimi 3 muaj përpara zhvillimit të procedurës; WONDERWALL SOFTWARE HOUSE i cili figuron i regjistruar si OE në fushën objekt prokurimi 5 muaj përpara zhvillimit të procedurës; P. I. i cili nuk ka të përfshirë në ekstraktin e QKB, konkretisht në *Objektin e Aktivitetit* objektin e prokurimit i cili ka të bëjë me programet software EPG.

- *'Blerje licencë për përdorues në sistemin EPG dhe integrimin në sistemin aktual si dhe trajnimi i punonjësve'*,me vlerë të fondit limit 2,890,891.7 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 2,642,802 lekë me TVSh, të lidhur sipas aktit me nr. 27/7 prot., datë 23.05.2018 rezultoi se, janë ftuar për të marrë pjesë 5 OE njëlloj si më sipër. Në lidhje me këta OE konstatohet se janë ftuar mes tyre 2 OE ndër të cilët: OE A. E. i cili figuron i regjistruar si OE në fushën objekt prokurimi më pak se 9 muaj përpara zhvillimit të procedurës; P. I. i cili nuk ka të përfshirë në ekstraktin e QKB, konkretisht në *Objektin e Aktivitetit* objektin e prokurimit i cili ka të bëjë me programet software EPG. Nga sa më sipër rezulton se nga ana e NJP nuk janë marrë për zbatimin korrekt të nenit 34 të LPP. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 34 si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 39.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1 Rekomandimi: Personat e emëruar si përgjegjës për prokurimin të marrin masa për dërgimin e kërkesave për ofertë vetëm nga OE të cilët operojnë në tregun e fushës së objektit të prokurimit.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Në vijim janë marrë masa që komisionet e ngritura për vlerësimin e ofertave të paraqesin përgjegjësi dhe profesionalizëm gjatë shqyrtimit, si dhe me qëllim rritjen e efektivitetit të konkurrencës do të argumentojnë, vlerësojnë, verifikojnë dokumentacionet e dorëzuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e përcaktuara në DST. Gjithashtu, përpara lidhjes së kontratës, në vijim do të merren masa për dërgimin e kërkesave për ofertë nga operatorë në tregun e fushës së objektit prokurimit. Komisionet e ngritura për hartimin e kritereve do të marin masa të argumentojnë cdo kriter të vendosur.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

26. Gjetje nga Auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit rezultoi se për periudhën objekt auditimi, në 2 raste, përkatësisht:
- Në procedurën me objekt *'Blerje guidë elektronike të Programeve EPG – viti 2017'*,rezultoi se është vendosur si kriter për tu përmbushur nga OE pjesëmarrës listë pagesat për periudhën prill-shtator 2017. Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht.
- Në procedurën me objekt *'Blerje licenca për përdorues të Sistemit MAM Etere dhe Playout ETX'– viti 2018'*,rezultoi se nga ana e NJP janë vendosur ndër të tjera kriteri: *"Operatorit Ekonomik të vërtetojë që ka në përbërje të tij, punonjës të siguruar jo më pak se 25 (njëzetë e pesë) punonjës për periudhën Nëntor 2017 – Shtator 2018"*. Vendosja e një kriteri të tillë nuk është e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, kjo si për numrin e të punësuarve prej 25 personash (kur në fakt të punësuar me certifikata dhe kualifikime janë kërkuar 10 persona) ashtu edhe për afatin e prezencës në listë-pagesa për periudhën nëntor 2017 – shtator 2018, ose 11 muaj. Gjithashtu të paargumentuara janë dhe kërkesat për stafin teknik dhe kualifikimet e tyre etj. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 1 *"Objekti dhe qëllimi"* pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 20 si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, ndryshuar, neni 27, pika 3 si dhe neni 61, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1 Rekomandimi: Komisionet e ngritura për hartimin e Kritereve të Përgjithshme/Veçanta të marrin masat e duhura për të argumentuar çdo kriter të vendosur.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Në vijim janë marrë masa që komisionet e ngritura për vlerësimin e ofertave të paraqesin përgjegjësi dhe profesionalizëm gjatë shqyrtimit, si dhe me qëllim rritjen e efektivitetit të konkurrencës do të argumentojnë, vlerësojnë, verifikojnë dokumentacionet e dorëzuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e përcaktuara në DST.

Gjithashtu, përpara lidhjes së kontratës, në vijim do të merren masa për dërgimin e kërkesave për ofertë nga operatorë në tregun e fushës së objektit prokurimit. Komisionet e ngritura për hartimin e kritereve do të marin masa të argumentojnë cdo kriter të vendosur.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

27. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve në lidhje me zërin (Tokë, truall) të cilat paraqiten në kontabilitetin e RTSH, rezulton se: Nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori ekonomik nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje dhe ndërtesa për drejtorinë e përgjithshme dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, pra nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Radio Kukësi, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për zërin ndërtesë dhe truall nuk disponohet dokumentacion pronësor për të gjitha pronat që disponon RTSH (certifikatë pronësie). Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*, neni 11 dhe nenin 15; me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, kreu IV, pika 74.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 125 - 131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>27.1 Rekomandimi</u>: Nga drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të RTSH-së, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën në dispozicion dokumentacion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

28. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitet 2017 dhe 2018 rezulton se: nga RTSH nëpunësi zbatues i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim drejtoria e përgjithshme dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 125 - 131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>28.1 Rekomandimi</u>: Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Drejtoria Ekonomike të marrin masat që, të kryejë procesin e hartimit të regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së RTSH-së dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: U vendos në në dispozicion urdhri i brendshëm nr. 39, datë 13.05.2022 në bazë të ndryshimit të strukturës financa do të kaloi në një drejtori ekonomike, vec 4 qendrave rajonale.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit për vitin 2018, konstatohet se: Në urdhrin e krijuar për kryerjen e procesit të inventarizimit rezulton se janë caktuar persona të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë nënshkruar në procesin e kryerjes së inventarizimit, në kushtet e konfliktit të interesit. Gjithashtu në Radio Kukësi rezulton e njëjta situatë pasi në urdhrin e krijuar për kryerjen e procesit të inventarizimit të vitit 2018 dhe vitit 2019, rezulton se janë caktuar persona të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë nënshkruar në procesin e kryerjes së inventarizimit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 81-82.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 125 - 131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
29.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Drejtoria Ekonomike, të marrin masa që në të ardhmen, në procesin e inventarizimit, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, dhe kryerjen e saktë të procesit, përbërja e komisioneve të jetë në përputhje me kuadrin rregullator ligjor.

Në vijimësi
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Drejtoria Ekonomike për vitin 2021 ka hartuar urdhërin e Inventarizimit nr 4698 dhe 4699 dt 24.12.2021 në zbatim të rekomandimit për përbërjen e komisioneve .
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme në Njësitë vartëse dhe anasjelltas të Radio Televizionit Shqiptar, rezultoi se nga sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program excel dhe jo me "Bartës informatik", të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mosbesueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 11.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 125 - 131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
30.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar të marrë masa për pajisjen e Njësive të Varësisë, me programe të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave kontabël.

Menjëherë
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me email të gjitha qendrat vendore kanë konfirmuar që mbajtja e llogarive bëhet me programin kontabël Financa 5.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit për vitin 2018, konstatohet se: në dy raste komisionet e vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve,

në përbërje të tij kanë më pak se 5 persona. Gjithashtu në të dy rastet rezulton se kryetar i komisionit nuk është caktuar nëpunësi zbatues i njësisë, e konkretisht në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve komisioni i inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme të njësisë. Nga dokumentacioni i verifikuar rezulton se, kryetari i komisionit të vlerësimit nuk është vendosur nëpunësi zbatues i njësisë. Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit është i njëjti i cili ka kryer dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit duhet të kishte 5 persona në përbërje dhe jo 3 persona. Gjithashtu në Njësinë e Programeve komisioni i inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme të njësisë në përbërje nuk është caktuar nëpunësi zbatues i njësisë. Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit është i njëjti i cili ka kryer dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit duhet të kishte 5 persona në përbërje dhe jo 4 persona.Situata e mësipërme është në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 96-100.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 125 - 131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, Drejtuesit e Njësive, Drejtori Ekonomik, të marrin masat e duhura që, në krijimin e komisioneve për procesit të inventarizimit, komisioni i verifikimit/vlerësimit të jetë i ndryshëm nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit, gjithashtu, përbërja e anëtarëve të jetë konform parashikimeve të udhëzimeve përkatëse, me qëllim kryerjen e një procesi të saktë, të plotë dhe objektiv.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Drejtoria Ekonomike për vitin 2021 ka hartuar urdhërin e Inventarizimit nr 4698 dhe 4699 dt 24.12.2021 në zbatim të rekomandimit për përbërjen e komisioneve .

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit kontabël dhe inventarizimit të aktiveve në njësinë e Radio Kukësit, si dhe nga verifikimi në terren rezultoi se:në katin e parë ndodheshin disa transformatorë të cilët nuk i përkisnin institucionit të RTSH-së po njësive të tjera shtetërore, të vendosura në një prej zyrave me sipërfaqe rreth 40 m^2. Në këtë ambient sipas diskutimeve verbale me drejtuesit e njësisë, rezulton se këto pajisje ndodhen prej kohësh edhe përtej periudhës objekt auditimi. Në lidhje me shfrytëzimin e aseteve të Radio Kukësit nga subjekte të tjera konstatohet se nuk ka asnjë marrëdhënie juridike nga e cila, nëse do të jepen me qira do të gjenerohen të ardhura për njësinë. Gjithashtu referuar hartës treguese të regjistrimit sipas identifikimit në regjistrat e pasurisë së zonës Kadastrale të rrethit Kukës në të cilën është pronar RTSH, konstatohet se: në ambientet e jashtme të regjistruara si zë truall, një sipërfaqe prej afro 300 m² nuk ishte e rrethuar si e gjithë pjesa territoriale të cilën ka në dokumentacion RTSH por, disponohej dhe posedohej nga subjekt fizik (shtëpi private) ndodhur në pjesën verilindore të godinës së RK. Nga nëpunësit autorizues e zbatues nuk janë marrë masat e duhura për përdorimin sa më eficient dhe shmangien nga përdorimi i paautorizuar i subjekteve të tretë të aktiveve shtetërore. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 9 pika 4/ë, e nenin 12 pika 3/f.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 125 - 131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, të rregullohet me marrëdhënie kontraktore, shfrytëzimi i aseteve në pronësi të saj, me qëllim rritjen e të ardhurave të institucionit dhe shmangien e përdorimit nga të tretët.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

33. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi konstatohet se drejtoresha e Auditimit të Brendshëm është komanduar në këtë funksion me vendimin nr. 295 datë 19.07.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
Në momentin që është ngritur në detyrë *(pasi më parë, deri në datën e komandimit ka punuar si juriste pranë Drejtorisë Juridike në RTSH për një periudhë prej afër 3 vjetësh (Shkurt 2015 – Korrik 2018))* dhe është komanduar në pozicionin e drejtoreshës, znj. B. nuk ka patur eksperiencën e nevojshme për këtë pozicion dhe certifikatën e Audituesit të Brendshëm kërkesa këto referuar pikës c, neni 11 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" ku citohet se "Kandidatët e përzgjedhur për pozicionin "Drejtor i njësisë së auditimit të brendshëm" duhet të jenë pajisur me dëshminë "Auditues i brendshëm në sektorin publik" dhe të kenë një përvojë pune 5-vjeçare si auditues". Aktualisht znj. B. është regjistruar pranë drejtorisë së harmonizimit të auditimit të brendshëm për kryerjen e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm të sektorit publik për vitin 2020-2021 por, edhe pse është aktualisht në proces certifikimi ky fakt nuk e justifikon paligjshmërinë e emërimit të saj në postin e Drejtoreshës së Auditit të Brendshëm. Këtë problem e ka vënë në dukje edhe Ministria e Financave me shkresën me nr. 18355 prot, datë 14.10.2019 (protokolluar në RTSH me nr. 2941 prot, 14.10.2019) firmosur nga Ministri i Financave "Mbi zbatimin e kritereve të punësimit për Drejtuesin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm" ku citohet se: Është konstatuar se drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe bazuar në nenin 23, ligji nr. 114/2015 kërkohet shqyrtimi i kësaj problematike dhe njoftimin e MFE për masat e ndërmarra për zbatimin e kritereve ligjore lidhur me këtë çështje.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 131 - 143 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).
33.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e RTSH dhe Drejtoria Burimeve Njerëzore të marrin masa për emërimin e Drejtuesit të Njësisë së Auditit të brendshëm në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

34. Gjetje nga Auditimi: Veprimtaria e auditit të brendshëm rregullohet me rregulloren e auditimit të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të RTSH me nr. 41 datë 07.11.2018 dhe me dispozitat e tjera të sanksionuara në aktet ligjore dhe nënligjore për funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Në nenin 15 të rregullores se Auditimit të Brendshëm "Pavarësia Organizative" sqarohet se brenda njësisë publike drejtoria e auditimit të brendshëm raporton direkt tek titullari i njësisë publike. Referuar strukturës së miratuar të RTSH, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm është e përfshirë brenda strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH, është drejtori e pavarur dhe ka varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm, pra kjo drejtori raporton tek Drejtori i Përgjithshëm i RTSH. Bazuar në ligjin 114/2015 *"Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"*, drejtoria e auditimit të brendshëm ka funksionuar në *kundërshtim me nenin 4 pika 19 e këtij ligji*, pasi në zbatim të ligjit kreu IV neni 10 pika 2, njësia e auditimit të brendshëm është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike. Titullar i njësisë publike për RTSH, që drejtohet me organ vendimmarrës kolegjial në zbatim të nenit 4 pika 19 është Këshilli Drejtues. Pra, në këtë pikë ka një mospërputhje të ligjit 114/2015 *"Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik"*, me rregulloren e Auditimit të Brendshëm të RTSH, pasi në zbatim të ligjit për auditin, drejtoria e auditit duhet të raportojë në Këshill Drejtues.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 131 - 143 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

34.1 Rekomandimi: RTSH të iniciojë të gjitha procedurat e nevojshme për rregullimin e procedurës së raportimit të drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Këshillin Drejtues të RTSH, me qëllim mos cenimin e pavarësisë funksionale të kësaj drejtorie

Brenda datës 31.12.2021

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Janë hartuar të gjitha aktet e nevojshme si: rregulloren, kartën e auditimit të brendshëm për rregullimin e procedurës së raportimit të kësaj drejtorie dhe ia ka bërë me dije Drejtorit të Përgjithshëm me shkresë nr 3712 datë 28.10.2021, si dhe i janë dërguar si propozim për miratim në Këshillin Drejtues me shkresë nr 3971 datë 12.11.2021. Me shkresën nr. 963, datë 03.03.2022 "Kujtesë në lidhje me propozimet që i janë dërguar Këshillit Drejtues" por nuk ka përgjigje.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

35. Gjetje nga Auditimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë RTSH nuk i kushton rendësi procesit të zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi për periudhën objekt auditimi nuk u evidentua asnjë auditim me tematikë *"Auditim i rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga auditimet e mëparshme"*. Gjithashtu mangësi tjetër është edhe mos përfshirja në këto vite e auditimit të detyrimeve të prapambetura në planet e auditimeve, mangësi në vite e kësaj drejtorie e cila është vënë në dukje në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria e Harmonizimit ne Ministrinë e Financave nëpërmjet shkresave në periudha të ndryshme. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm nuk i është përmbajtur kërkesave metodologjike lidhur me hartimin e planit strategjik dhe vjetor, të përcaktuar në kuadrin rregullator të miratuar mbi sistemet dhe fushat e vlerësuara me risk të lartë. Karta e Auditimit të Brendshëm nuk është e përditësuar dhe plotësuar sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Nga auditimi i dosjeve të auditimit rezultoi se dokumentacioni i hartuar për njoftimin e fillimit të angazhim auditimit, evidentimin dhe ndarjen e detyrave të audituesve nuk janë përgatitur për çdo rast, si dhe jo në përputhje me standardet. Nuk janë hartuar për të gjitha auditimet grupi i punës dhe memot. Në përgatitjen e projektraportit dhe raportit nuk janë zbatuar formatet me përshkrimet e duhura në zbatim të Manualit të Auditimit Brendshëm. Për çdo auditim u evidentua dosja individuale, por jo në të gjitha rastet me inventarin përkatës në mospërputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 131 - 143 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

35.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marri masa për përfshirjen në planin e auditimeve, auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, auditimin e detyrimeve të prapambetura dhe auditime të tjera të parashikuara me risk të lartë.

Në vijimësi

35.2 Rekomandimi*:* Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masa për ndjekjen e hapave korrekte lidhur me procesin e auditimit, hartimin e letrave të punës dhe për çdo rast t'i përditësojë dhe plotësojë ato sipas përcaktimeve metodologjike në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion dosjen e auditimit per zbatimin e rekomandieve dhe detyrimet e prapambetura për 2020, 2021.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: U vendos në dispozicion dosje e plotë e auditimit e inventarizuar me gjithë dokumentat standarde të Manualit të auditimit të brendshëm.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

36. Gjetje nga Auditimi: Auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptarë u krye në

bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*. Grupi i auditimit i ka paraqitur institucionit një pyetësor në lidhje me komponentët bazë të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe Auditimin e Brendshëm, përgjigjet e të cilit u plotësuan nga drejtori ekonomik në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe drejtorët e drejtorive dhe njësive, në bazë të përgjigjeve të tyre nga grupi i auditimit konstatohet se, -nuk është hartuar regjistër risku për vitet 2018 dhe 2019; - nuk është hartuar gjurma e auditit për vitin 2017 RTSH, -plani i veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin është hartuar vetëm për vitin 2019; -njësia për periudhën objekt auditimi nuk ka pasur sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave, në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, *"Monitorimi"*; - nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave; - për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve nuk janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës dhe vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 "Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafët "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore" dhe "Profesionalizmi i stafit"; - Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave; - Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit, brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 131 - 143 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).
36.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH të merren masa për plotësimin e të gjitha kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar në drejtim të njohjes nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentët e tij, delegimin e kompetencave, hartimin e regjistrit të riskut dhe koordinatorit për menaxhimin e tij, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve të cilat mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohen programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit, si dhe rregulla të shkruara në rastet e largimeve nga puna të punonjësve. Gjithashtu të merren masa për përcaktimin e saktë të detyrave ndërmjet pozicioneve të punës për çështje të raportimit, delegimit dhe përgjegjësive, si dhe të regjistrit të riskut e strategjisë së njësisë.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Njësa Teknike dhe Drejtoria e Programeve ka hartuar rregjistrin e rriskut çdo vit. Drejtoria Ekonomike ka hartuar regjistrin e riskut për vitin 2021 duke identifikuar risqet dhe përcaktuar kontrollet për Drejtorinë. Ka hartuar udhëzimin për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave të veprimtarisë ekonomike financiare vjetore dhe të llogarive të vitit 2021 dhe dërguar Njësive të Varësisë, referuar shkresës me nr 4671 dt 23.12.2021. Ka analizuar realizimin e treguesve financiare në periudha tremujore për vitin 2021 referuar shkresës nr 2441/1 dt 22.10.2021 me bazë risku për realizimin e të ardhurave si ndërprerja e shërbimit ose moslikujdimi të detyrimeve kontraktuale të subjekteve.
Eshtë hartuar regjistri i riskut për RTSH sipas kërkesave të formatit përkatës për Drejtoritë dhe Njësitë, janë pëcaktuar hyrja, përgatitja e regjistrit,zbatimet në menaxhimin e riskut,objektivat risk për RTSH.Materiali i është dërguar Bordit të Administrimit, referuar shkresës nr 1453 dt 26.04.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Pjesërisht

37. Gjetje nga auditimi: Në rregulloret e brendshme të funksionimit të drejtorisë ekonomike, njësisë së marketingut dhe njësisë teknike nuk është i qartë procesi i komunikimit ndërmjet

drejtorive për sa i përket procedurave që lidhen me ndjekjen dhe verifikimin e detyrimeve të subjekteve të cilat marrin shërbim nga RTSH, fakt i cili shmang përgjegjësinë e drejtorive përkatëse në lidhje me vjeljen e debitorëve dhe shtimin e detyrimeve të mbartura. Në fund të vitit 2019, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH me shkresën nr. 3010 datë 24.10.2019 drejtuar Drejtorisë Ekonomike, Njësisë Teknike dhe Drejtorisë së Marketingut, ka urdhëruar që brenda datës 15 të çdo muaji Drejtoria Ekonomike të verifikojë faturat e lëshuara dhe detyrimet e pashlyera të subjekteve që marrin shërbim nga RTSH. Nëse këto subjekte nuk shlyejnë detyrimet brenda afateve Drejtoria e Marketingut të aplikojë kamatën ligjore për vonesë në shlyerjen e detyrimit. Gjithashtu Drejtoria Ekonomike të Njoftojë Njësinë Teknike për ndërprerjen e shërbimit nëse detyrimet e subjekteve nuk shlyen brenda 45 ditëve. Vlera e proceseve gjyqësore të ndjekura nga drejtoria juridike në lidhje me mos arkëtimet e kontratave të qirave dhe atyre të marketingut për vitin 2017 është 7,214,394 lekë. Gjatë këtij viti kanë nisur procedura për dy subjekte (Eurosig dhe Kelmend) në vlerën 3,906,000 lekë. Ndërsa arkëtime janë bërë në vlerën 3,362,000 lekë nga Ministria e Mjedisit, D.S. dhe pjesërisht E.. Vlera e mbartur nga vitet e kaluara është 6,294,748 lekë; - për vitin 2018 është 4,413,912 lekë. Gjatë këtij viti janë arkëtuar detyrimet nga subjektet Eurosig në vlerën 2,512,482 lekë dhe Roland Delia në vlerën 288,000 lekë; - për vitin 2019 është 13,850,091 lekë. Gjatë këtij viti janë arkëtuar 330,740 lekë nga Drejtoria e Policisë të Qarkut Vlorë. Ndërkohë është shtuar vlera 9,767,335 lekë konkretisht nga Drejtoria e Marketingut lidhur me subjektin G. 2 në vlerën 1,062,880 lekë dhe nga Njësia Teknike subjekte me vlerë totale 8,704,455 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 143 - 148 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

37.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e RTSH të marrë masa për të rregulluar situatën e paqartë për procesin e ndjekjes dhe vjeljes së detyrimeve të subjekteve debitore të krijuara nga kontratat e qirave dhe kontratat e marketingut me qëllim vjeljen e debitorëve dhe evidentimin e përgjegjësive për krijimin e tyre, përfshirë dhe aplikimin e kamatave.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Drejtoria e Shitjes dhe Menaxhimit të Trafikut ka bashkëpunuar me me Drejtorinë Ekonomike, për ndjekjen dhe vjeljen e detyrimeve referuar shkresave nr. 4189-4189/17 datë 13.12.2021, të hartuara drejtuar subjekteve debitorë. Nuk janë aplikuar kamat vonesat

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Pjesërisht

38. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dosjeve të projekteve konstatohet mungesa e inventarit fizik të dokumentacionit. Sektori i Projekteve dhe Administrimit të të Drejtave si dhe Drejtoria e Financës, në dokumentacionin e administruar prej tyre nuk kanë listën e dokumenteve që duhet të përmbajë dosja, dhe për pasojë administrimi i tij nga këto njësi paraqet parregullsi. Shkak për mos kryerjen e inventarizimit të dosjeve është mos parashikimi në "*Rregulloren e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave*", me ndryshime, miratuar me Vendimin nr. 10, datë 23.08.2018 të Këshillit Drejtues të RTSH, i procedurës së inventarizimit të dosjeve si dhe miratimit të listës së dokumenteve që duhet të përmbajë dosja që administrohet nga njësitë zbatuese të projekteve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqe nr. 148 – 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

38.1 Rekomandimi: RTSH të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e "Rregullores", duke përcaktuar procedurën për inventarizimin e dokumentacionit si dhe miratimin e listës së dokumenteve që duhet të përmbajë dosja që administrohet nga njësitë zbatuese të projekteve.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Janë hartuar amendamentet për përmirësimin e "Rregullores së miratimit dhe zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe blerjes së të drejtave, të miratuara me vendimin nr. 10, datë 26.03.2018"

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

39. Gjetje nga Auditimi: - Ngaauditimi i projekteve artistike dhe filmikenë lidhje me blerjen e të drejtaveekskluzive të transmetimit audioviziv të serialit televiziv "S.", Projektiartistik"Java–RTSH" dhe "Rreth mesnatës" konstatohet sevendimet përkatëse të Bordit Artistik, në pjesën arsyetuese të tij, nuk shprehen në lidhje me domosdoshmërinë e blerjes së të drejtave ekskluzive të transmetimit audioviziv të serialit "S." si dhe mbi përputhshmërinë me strukturën programore të RTSH dhe parimet themelore të veprimtarisë audiovizive, duke mos dhënë argumentim nga pikëpamja artistike mbi domosdoshmërinë e blerjes së të drejtave, apo mbi vlerësimin nga pikëpamja artistike e projektit por mjA.het duke u shprehur vetëm *"miratohet nga pikëpamja artistike*", veprim jo në përputhje me "Rregulloren" me ndryshime neni 5, pika 2.
Gjithashtu këto dy projekte janë miratuarnë të njëjtën datëme Vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, bazuar në Vendimin e Bordit Artistik, duke krijuar mundësinë e fiktivitetit në agjendën e vendim-marrjes.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqe nr. 148 – 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
39.1 Rekomandimi: RTSH të marrë masa në të ardhmen që vendimet e Bordit të Administrimit të shprehen duke bërë argumentim të plotë nga pikëpamja artistike për projektet që miratohen apo në rastet e blerjes së të drejtave.

Në vijimësi

39.2 Rekomandimi: RTSH si subjekt i iniciativës ligjore të marrë masa për përmirësimin e "Rregullores", neni 7, ku të përcaktohet afati ligjor brenda të cilit duhet të miratohet projekti artistik/filmik vlera financiare të cilave është deri në 1% të vlerës së buxhetit vjetor të RTSH-së, nga Bordi Artistik dhe Drejtori Përgjithshëm i RTSH, me qëllim minimizimin e veprimeve burokratike në vendimmarrje.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me amendamentet e Rregullores së re, do të propozohet riformatimi total i Bordit Artistik, me detyrat përkatëse
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me amendamentet e Rregullores së re, do të propozohet riformatimi total deri në total datë 31.07.2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

40. Gjetje nga Auditimi: - Ngaauditimi i projekteve artistike dhe filmikenë lidhje medokumentacionin shoqërues në procedurën e paraqitjes së projektit artistik "Java–RTSH" konstatohet se Drejtuesi i Njësisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve RTSH me shkresën nr. 338, datë 11.09.2019 ka përcjellë në zbatim të nenit 7, pika 3 të "Rregullores", te Drejtori i Përgjithshëm propozimin për miratimin e projektit artistik si prodhim ekskluziv i RTSH. Procedura e ndjekur nga kjo Njësi për paraqitjen e projektit i është referuar pa të drejtë nenit 7, pika 1 të "Rregullores" dhe jo nenit 8, pasi është projekt i paraqitur nga persona fizikë/juridikë jashtë RTSH (*sinopsi nga staf jashtë RTSH*). Dokumentacioni i paraqitur nuk ka bashkangjitur: kërkesën me shkrim për miratimin e projektit artistik, jo në përputhje me "Rregulloren", neni 7, pika 1 dhe mungon bashkangjitur kërkesës sipas detyrimeve të "Rregullores",neni 7, pika 2, skenari, përshkrimi narrativ, etj.
- Projektiartistik "Java–RTSH" sipas preventivit ka komponentë si "drejtues emisioni" dhe "regjisor" që janë punonjës të RTSH. Konstatohet se për komponentin "regjisor" është lidhur kontrata nr. 348/7 Prot., datë 16.9.2019 e cila bie në kundërshtim me kontratën individuale të punësdatë 01.02.2017, për znj. E. J., që ka të njëjtën emërtesë "regjisor" në Njësinë e Programeve RTSH (*deri në datën 26.6.2020).* Për të njëjtin përshkrim të vendit të punës ("regjisor") me këtë punonjëse, padrejtësisht janë lidhur kontratat e sipërcituara, të cilat bien

në kundërshtim me njëra tjetrën pasi nuk ka ndryshim të specifikave nga ato të përcaktuara në kontratat e lidhura me këtë punonjëse. Kontrata nr. 348/7 prot., datë 16.9.2019, është kontradiktore dhe nga përmbajtja, pasi neni 2 "të drejtat që kalohen" të cilat nënkuptojnë detyrimin e "regjisorit" për kalimin tek Njësia/RTSH-ja e të gjitha të drejtave ekskluzive pasurore në lidhje me regjinë, bie në kundërshtim me nenin 3, pika 1. Në këtë kontekst krijohet një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave por tashmë të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni "regjisor" sipas Kontratës individuale të punës. Për pasojë bazuar në kontratën nr. 348/7 prot., datë 16.9.2019 është kryer pagesa në formën e shpërblimit në vlerën 63,750 lekë për periudhën shtator-dhjetor 2019. Për të njëjtin pozicion/përshkrim pune si "regjisor", janë kryer 2 pagesa (page mujore dhe shpërblim). Vlera prej 63,750 lekë përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.

- Në realizimin e projektitartistik "Rreth mesnatës" sipas preventivit ka komponentë si "drejtues emisioni" dhe "regjisor" që janë punonjës të RTSH. Konstatohet se për komponentin "regjisor" është lidhur kontrata nr. 350/6 prot., datë 16.9.2019, me znj. E. J. e cila bie në kundërshtim me kontratën individuale të punësdatë 01.02.2017, për znj. E. J., që ka të njëjtën emërtesë "regjisor" në Njësinë e Programeve RTSH (*deri në datën 26.6.2020)*. Për të njëjtin përshkrim të vendit të punës ("regjisor") me këtë punonjëse, padrejtësisht janë lidhur kontratat e sipërcituara, të cilat bien në kundërshtim me njëra tjetrën pasi nuk ka ndryshim të specifikave nga ato të përcaktuara në kontratat e lidhura me këtë punonjëse. Kontrata Nr. 350/6 prot., datë 16.9.2019, është kontradiktore dhe nga përmbajtja, pasi neni 2 "të drejtat që kalohen" të cilat nënkuptojnë detyrimin e "regjisorit" për kalimin tek Njësia/RTSH-ja e të gjitha të drejtave ekskluzive pasurore në lidhje me regjinë, bie në kundërshtim me nenin 3, pika 1. Në këtë kontekst krijohet një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave por tashmë të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni "regjisor" sipas Kontratës individuale të punës. Për pasojë bazuar në kontratën nr. 350/6 Prot., datë 16.9.2019 është kryer pagesa në formën e shpërblimit në vlerën 31,875lekë për periudhën shtator-dhjetor 2019. Për të njëjtin pozicion/përshkrim pune si "regjisor", janë kryer 2 pagesa (page mujore dhe shpërblim). Vlera prej **31,875** lekë përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqe nr. 148 – 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

40.1 Rekomandimi: Titullari i RTSH nisur nga parregullsitë dhe mungesat e konstatuara në përcjelljen e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues në procedurën e paraqitjes së projektit *"Java–RTSH",* për miratimin e projektit artistik, të analizojë përgjegjësitë e Njësisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve RTSH, me qëllim që në të ardhmen propozimi për miratimin e kërkesës për miratim projektit të shoqërohet me dokumentacionin e plotë konform kërkesave të "*Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave*", me ndryshime.

40.2 Rekomandimi: Të merren masa nga titullarët e njësive përkatëse që në të ardhmen të mos nënshkruhen kontrata për projektet artistike/filmike që bien në kundërshtim me detyrimet kontraktore që rrjedhin nga Kontrata individuale e punës në kushtet e mos ndryshimit të emërtesës/ përshkrimit të vendit të punës, për rastet e pjesëmarrjes së stafit të RTSH, të cilat sjellin pasojë përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore si në Projektin "Java–RTSH" në vlerën 63,750 lekë dhe për Projektin "Rreth mesnatës" në vlerën **31,875** lekë.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: vazhdon akoma të ketë raste ku persona pjessë të projektit janë punonjës me kontratë individuale pune pranë RTSH.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Pjesërisht

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Për shqyrtim është marrë projekti bashku me preventivin sipas kontratës nr 3690 datë 27.10.2021, ku identifikohen saktë përdorimi i tarifave sipas librit dhe kontrata është e firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

41. Gjetje nga Auditimi: Projekti "Asambleja e Përgjithshme e EBU"- nuk ka kaluar për miratim në Bordin Artistiknë kundërshtim me nenin 7 -Procedura e paraqitjes së projekteve filmike dhe artistike, që janë prodhime të RTSH, miratimi dhe zbatimi i tyre, të Rregullores së miratimit dhe zbatimit të projekteve filmike dhe artistike dhe të blerjes së të drejtave, miratuar me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1026 prot., datë 10.04.2018;
- Preventivi i hartuar nuk mban në konsideratë librin e tarifave dhe as kalendarin e aktiviteteve dhe kuadrin rregullator për çmimet duke sjellë për pasojë 552,500 lekë shpenzime të panevojshme; nuk mban në konsideratë vlerën e shpenzimeve për dreka e darka zyrtare të personaliteteve të ftuara nga RTSH të përcaktuara me Vendimin e KD nr. 36, datë 16.05.2007, kapitulli III, pika 1 shkronja "a" duke shpenzuar 341,200 lekë mbi këtë vendim;
- Nuk është respektuar kuota në vlerë për dhurata e përcaktuar VKM nr. 327, datë 26.06.1995 "Për një shtesë në pikat 8 dhe 9 të VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", pika 9 paragrafi i dytë;
Janë kryer shpenzimet për dreka dhe darka në vlerën 1,370,000 lekë të cilat ishin preventivuar për t'u paguar nga bashkëpunëtorët;
- Ka mangësi në dokumentacionin e zbatimit dhe atë financiar, në kundërshtim me pikën 35, shkronja b, dhe pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" të ndryshuar duke sjellë për pasojë ulje të efektivitetit të fondeve publike.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148- 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
41.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë në lidhje me mungesën e miratimit nga ana e Bordit artistik, duke marrë masa për eliminimin e kësaj parregullsie; për moszbatimin e vendimit të KDRTSH për kryerjen e pagesës prej 1,370,000 lekë e cila ishte preventivuar për t'u bërë nga bashkëpunëtorët në aktivitetet e programit social; për zbatimin e kuotave të përcaktuara nga KDRTSH për dhuratat, si dhe për parregullsitë e faturave financiare të zbatimit të këtij projekti.

Brenda datës 31.10.2021 dhe Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

42. Gjetje nga Auditimi: Përprojektin "Eurovision Song Contest 2018", konstatohet se:
- Bordi i Administrimit ka dhënë pëlqimin për preventivin me vlerë gjithsej 15,972,500 lekë, në një kohë që shuma e zërave analitikë është 332,000 lekë më shumë, po kështu ka marrë vendim dhe KDRTSH;
- Në preventiv nuk janë respektuar çmimet e përcaktuara në librin e tarifave;
- Janë kryer pagesa për honorarë dhe fatura nga arka në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 64;
- Është kryer pagesë fikse për një punonjës të RTSH, kur dihej të paguhej me orë jashtë orarit;
- Janë paguar fatura të pashoqëruara me situacionin përkatës, si dhe me mangësi plotësimi;
- Janë paguar për hotel dhoma për dy persona, kur në fakt duhej të ishin për një person; pa dokument vërtetues të shpenzimeve, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 34/b;
- Me 5 mandat pagesa janë paguar paradhënie 5 persona në shumën 1,870 euro, për të cilat nuk ka dokumente justifikues për shlyerjen e tyre, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 66:

- Është paguar me bankë prenotimi i hotelit në Lisbonë për 6 persona për 15 ditë në dhoma dyshe, me çmimin 180 euro për dhomë, gjithsej 16,200 euro, në kundërshtim me vendimin e KDRTSH nr. 36, datë 16.05.2007 i ndryshuar, kreu i I, pika 2/B.a, i cili përcakton për fjetje 110 euro për person, pra mbi këtë vendim më shumë gjithsej 6,300 euro, duke ulur efektivitetin e përdorimit të fondeve në këtë vlerë;
- Janë paguar dieta për qëndrimin në Lisbonë për 15 ditë sipas kërkesës së datës 09.03. 2018 të Drejtorit të Festivalit sipas Urdhër- shërbimeve të plotësuar në datën e nisjes dhe jo në kthim që të vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve pra provojnë vetëm paradhënien;

- Janë paguar me mandat pagesën nr. 103, date 27.04.2018 gjithsej 950 euro për z. K. D., me cilësimin "Shpenzime sipas Vendimit 168, datë 30.11.2016" e cila është vetëm me firmën e financierit (pa emër dhe mbiemër), pa firmën e marrësit dhe nuk ka asnjë dokument bashkëlidhur; me mandat-pagesat nr. 54, datë 09.03.2018 me vlerë 400 euro dhe nr. 101, datë 27.04.2018 me vlerë 1500 euro, vetëm me emrin e marrësit K. D. pa firmën e tij, është paguar paradhënie për këtë aktivitet K. D., e cila nuk justifikohet me dokumentet e shpenzimeve të sjella;

- Janë paguar dhurata me vlerë gjithsej 110,000 lekë, në kundërshtim me vendimin e KDRTSH nr. 36, datë 16.05.2007 i ndryshuar, kreu i III, pika 5;

- Janë paguar 15 bileta për 3 netët e festivalit, në një kohë që numri i pjesëmarrësve të parashikuar dhe faktik ka qenë për 10 persona, duke ulur efektivitetin e shpenzimeve me vlerën e 5 biletave prej 1,075 euro.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
42.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Administrimit të shqyrtojnë me vëmendje sipas zërave përkatës të preventivave të projekteve artistike dhe filmike, me qëllim që të harmonizohet zbatimi i akteve të dala për këtë qëllim, duke rritur efektivitetin e përdorimit të parasë publike.
42.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrin masa për të shqyrtuar të gjithë dokumentacionin justifikues dhe argumentues të këtij projekti, duke nxjerrë përgjegjësitë financiare dhe funksionale për preventivin dhe shpenzimet e këtij projekti.

Brenda datës 31.10.2021 dhe Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Në programin vjetore të DAB është parashikuar auditimi i projekteve të Eurosong.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Pjesërisht

43. Gjetje nga Auditimi: Për projektin "Festivali i 58 i këngës në RTSH 2019", konstatohet se:
- Rregullorja e Festivalit, është miratuar me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH me nr. 2462 prot., datë 06.09.2019 pa përcaktuar kritere as për emërimin dhe as për shkarkimin e tyre stafit të festivalit, në kundërshtim me nenin 24 dhe germa "f" nenit 46 të Statutit;
- Në dosje ndodhet kërkesa për regjistrim transmetim të festivalit 58 nga drejtuesi i Njësisë së projekteve me nr. 722/1 prot., datë 15.11.2019, cilësuar e bazuar në kërkesën (shkresën) e sotme (pra të kësaj date) të regjisores së Festivalit për një regji që të suportojë 13 kamera, pasi RTSH disponon regji lëvizëse që suporton maksimalisht 8 kamera, e cila është miratuar menjëherë nga Drejtori i Përgjithshëm. Nuk gjendet në dosje një kërkesë e tillë dhe as në

platformën regjisoriale, nuk ka referenca protokollimi nga drejtuesi i njësisë teknike dhe për më tepër, në preventivin e miratuar një ditë më parë, (14.11.2019), Bordi i administrimit ka miratuar preventivin përkatës stafi teknik dhe mjete me qira me vlerë 2,400,000 lekë, duke e bërë formale procedurën për këtë zë të preventivit;
- Nuk ka gjurmë shkresore për ofertat në rastin e blerjeve apo marrjeve me qira për mënyrën e përzgjedhjes, dërgimit të kërkesës për ofertë etj., duke e bërë këtë proces formal, si dhe kontratat e nënshkruara nuk kanë mbajtur në konsideratë detyrimet e subjekteve ndaj organeve tatimore apo gjyqësore;
- Vendosja e çmimeve në preventiv nuk ka ndonjë referencë të saktë në librin e tarifave, si dhe për ato që nuk gjendet në librin e tarifave është marrë më pas miratimi i bordit të administrimit dhe KDRTSH, me diferenca të theksuara për disa zëra nga 75,000 lekë deri në 140,000 lekë;
- Kontratat për stafin dhe disa për mallra dhe shërbime janë nënshkruar para miratimit të preventivit në Bordin e administrimit; nuk mbajnë në konsideratë për pagesë kohën e punës nga nënshkrimi; nuk janë të koordinuara me janë protokolluar me vonesë, hyjnë në fuqi para nënshkrimit etj.;
- Është paguar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm subjekti "Screen AD" në shumën 7,200 euro për pajisjen "Tavani kinetik" sipas kontratës përkatëse, megjithëse një gjë e tillë nuk ka qenë e parashikuar në zërat e preventivit të dekorit, dhe nuk ka dokumentacion që justifikon lindjen e një kërkese të tillë;
- Është paguar Drejtori i Fotografisë nëpërmjet dy kontratave të sponsorizimit në shumën gjithsej 10,750 euro, në kundërshtim me Ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, neni 3, pika 37; nenin 45, pika 1, pasi me përcaktimin e destinacionit të pagesës është prekur përgjegjësia dhe pavarësia editoriale e shërbimit mediatik;
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
43.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të propozojë dhe më pas të miratoj në KD Rregulloren e Festivalit; të bashkërendojë dhe të koordinojë në kohë nënshkrimin e kontratave për materiale dhe stafin përkatës, duke përcaktuar kritere të qarta ofertimi dhe siguruar gjurmën dokumentare përkatëse; si dhe respektimin e çmimeve të librit të tarifave dhe të kritereve në rastin e sponsorizimeve.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: DMPJ në bashkëpunim me Zv Drejtorin e Përgjithshëm po hartojnë rregulloren e re te festivalit të këngës dhe i është kërkuar asistencë RAI.Deri në 31.07.2022 do paraqitet Rregullorja e re te DP.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

44. Gjetje nga Auditimi: Për projektit "Gjyshet milionere" 2018-2019, konstatohet se: - Drejtori i Njësisë së Programeve ka nënshkruar kontratë me subjektin Person fizik P. Sh., me objekt të ndërtojë skenografinë në mjediset e brendshme të objektit (neni 2, pika 1), në vlerën 2,500,000 lekë, në një kohë që është i vetëpunësuar, si dhe ka për fushë të veprimtarisë "Riparime shërbime të ndryshme të mobilieve", gjë që nuk ka lidhje me veprimtari skenografike; nga mungesa e vendosjes së kritereve të përzgjedhjes së subjekteve, personi fizik i cilësuar më sipër ka urdhër ekzekutimi për sekuestro nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë;
- Kontratat e nënshkruara nuk janë të koordinuara në kohë lidhur me rritjen efektivitetit të shpenzimeve për mallrat dhe shërbimet e marra me qira; një pjesë e kontratave për krijuesit dhe ekipin administrativ nuk janë të protokolluara dhe kanë mospërputhje midis përcaktimeve për shumën e shpërblimit e kohën e shpërblimit dhe atyre si është vepruar në fakt, të cilat janë sipas preventivit, por jo sipas kontratës nuk është mbajtur në konsideratë mënyra e likuidimit sipas përcaktimeve kontraktore; disa kontrata të këtij projekti janë nënshkruar nga Drejtor i

Njësisë së Programeve, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 105, pika 1, germa "dh";
- Blerjet e materialeve nuk kanë asnjë dokument (fletë-hyrje) për këto asete, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 35/b;
- Për personelin krijues dhe stafin administrativ prej 19 nëpunësish nuk ka të përcaktuara kritere për mënyrën e punësimit me projekte, duke rriskuar trajtimin e pabarabartë në përfitime dhe pasoja negative dhe në performancën e punës në RTSH;
- Sipas Kontratës së bashkëpunimit me Radiotelevizionin e Kosovës me nr. 18 prot., datë 09.01.2019, përfundimi i spektaklit televiziv, kopja e parë standarde e 9 emisioneve televizive të tjera duhet të realizohet jo më vonë se data 30.01.2019, gjë që tregon se është e pakuptimtë pagesa e qirasë edhe për dy muaj të tjerë, deri me datë 02.03.2019;
- Faturat e pagesave janë likuiduar edhe për mallra dhe shërbime që nuk përkojnë me periudhën e zbatimit të projektit, kanë mangësi plotësimi, janë nënshkruar jo nga persona të autorizuar nga projekti etj., si për pajisjet me qira, artikuj ushqimore, pije alkoolike etj., në kundërshtim me pikën 61 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
- Janë kryer pagesa për çmimet nga arka për 5 persona pjesëmarrës në shumën gjithsej 868,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e pikës 63 dhe 64 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
44.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për nënshkrimin e kontratave me të tretë vetë ose me autorizim, si dhe të ngarkojë Drejtoritë që të përcaktojnë kritere dhe gjurmën e auditimit për përzgjedhjen e subjekteve dhe personelit të projekteve, duke nënshkruar dhe vepruar në kohë me kontratat përkatëse, si dhe të ngarkojë me përgjegjësi nëpunësin zbatues në rastet e mosrespektimit të kritereve ligjore dhe financiare në menaxhimin e projekteve.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumetacion
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

45. Gjetje nga Auditimi: Për projektin "Kongresi i Lushnjës" konstatohet se: - Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për mbledhjen e BA në datën 06.12.2019, nuk ka analizuar në mënyrë të detajuar secilin zë të preventivit, por e ka miratuar ashtu siç është sjellë nga Drejtoria e Përgjithshme.
- Në preventivin e përgatitur nuk ka asnjë përputhje të tarifave për stafin e krijuesve dhe realizuesve me ato të librit të tarifave, duke rritur koston e projektit me së paku 1,573,000 lekë ose 22%, megjithëse këto tarifa janë miratuar më pas nga bordi i administrimit dhe KDRTSH.
- Në honorarët për krijuesit janë parashikuar shpenzime për 3 punëtorë të dekorit të jashtëm dhe të brendshëm me vlerë gjithsej 105,000 lekë, në një kohë që kjo ishte parashikuar në kontratat e ofertuesve të dekorit, neni 2, pika 3 e saj, duke ulur efektivitetin e shpenzimeve publike;
- Në shpenzimet e preventivit janë parashikuar dhe shpenzimet për dy shoferë me gjithsej 140,000 lekë për 10 ditë pune ose pothuajse me pagën e dy muajve në RTSH; krahas pagesës së 40 figurantëve me kuotën 3,000 lekë në ditë, janë planifikuar dhe dieta në vlerën prej 120,000 lekë, gjë që është e pakuptimtë dhe me pasoja në rritjen e kostos e së preventivit në këtë vlerë;
- Kostoja e këtij projekti është e lartë, pasi një pjesë e stafit të krijuesve dhe realizuesve janë punonjës të RTSH dhe paguhen për këto funksione, si regjisori, asistent regjisori, drejtori

organizativ etj., dhe janë paguar nga projekti me shpërblime të konsiderueshme, si p.sh. regjisori është shpërblyer për 10 ditë me pagën e pothuajse 8 muajve.
- Kontratat me stafin janë shoqëruar me parregullsi nënshkrimesh, të datave etj.,
- Faturat tatimore nuk janë lëshuar me kryerjen e veprimit ekonomik por më vonë, gjë që nuk përkon me zbatimin e projektit, situacionet nuk janë nënshkruar nga marrësi (RTSH) etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
45.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorët e Njësive dhe Sektori i Projekteve të marrin masa për hartimin e preventivit në përputhje me librin e tarifave dhe shqyrtimin e atyre të reja me qëllim realizmin e projekteve artistike me kosto optimale, për rritjen e efektivitetit të shpenzimeve publike.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 24, datë 04.04.2022 "Rishikimi i traifave ..." por nuk u vendos në dispozicion asnjë produkt i grupit të punës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

46. Gjetje nga Auditimi: Për projektin "Lart e poshtë" konstatohet se: - Megjithëse janë zbatuar tarifat sipas sistemit në librin përkatës, për 2 operator zëri tarifat janë më të ulëta, gjë e cila tregon se në përgatitjen e preventivave të projekteve, sektori përkatës nuk e ka përdorur si kriter strikt librin e tarifave, por e ka zbatuar atë me subjektivizëm;
- Kontratat e nënshkruara nga Drejtori i Njësisë së Programeve me punonjës të tjerë jashtë strukturës së RTSH, është jashtë kompetencave të tij të përcaktuara në nenin 24 të Statutit, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98, datë 22.12.2016;
- Nuk janë respektuar kushtet kontraktore lidhur me këstet e pagesave, pasi në kundërshtim me kushtet kontraktore (neni 3 pika 1) janë paguar për dy të tilla.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
46.1 Rekomandimi: Strukturat përkatëse të ngarkuara me zbatimin e projekteve të marrin masa për përdorimin strikt të librit të tarifave, nënshkrimin e kontratave nga Drejtori i Përgjithshëm ose personi i autorizuar prej tij, dokumentimin e plotësimit të kritereve për personelin që aktivizohet në realizimin e projekteve, si dhe respektimin rigoroz të zbatimit të kontratave.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Në të gjitha rastet janë firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

47. Gjetje nga Auditimi: Për projektin "Masterchef Junior" 2017-2018, konstatohet se: Është paraqitur në Bordin e administrimit një program televiziv me vlera të padiskutueshme, duke rritur audiencën dhe të ardhurat nga marketingu, por që nuk ka të dhëna të dokumentuara cilat kanë qenë rezultatet përkatëse, megjithëse është kërkuar dhe nga KD një vlerësim i tillë;
- Drejtori i përgjithshëm e ka nënshkruar dhe paguar licencën pa kaluar për miratim projektin në BA, si dhe koha në këtë licencë është përcaktuar 60 minuta, dhe jo 90 minuta, duke rrezikuar jo vetëm penalizimin për shkelje të Licencës, por duke sjellë për pasojë të rritje të kostos së projektit, pasi normalisht tarifat duhet të jenë në referencë të kohëzgjatjes së episodit;

- Megjithëse në preventivin e miratuar në Bordin e administrimit, nga vlera gjithsej e projektit prej 31 milion lekë, 6.3 milion kanë qenë miratuar të realizohen me kontrata shkëmbimi, janë
- Për së paku 6 zëra nuk ka referenca në librin e tarifave duke rritur ndjeshëm koston e këtij projekti;
- Janë nënshkruar kontrata komplekse duke përfshirë njëkohësisht blerje dhe marrje me qira materiale të ndryshme, çmimet vendosura në të cilën kanë diferenca të ndjeshme për zëra të njëjtë, duke e bërë kontratën praktikisht të pa menaxhueshme dhe me efektivitet të ulët;

- Është marrë me qira studio për 146 ditë, në një kohë që në preventiv ishte parashikuar për 90 ditë, si dhe për 3 muaj studio nuk ka shërbyer për xhirime, pasi nuk ka qenë e pajisur me skenografinë dhe elementët e saj për xhirime; po kështu dhe kontrata blerje materiale logo të formateve të ndryshme për rreth 16 ditë para se të kenë në dispozicion studion, ose janë mbajtur dhe paguar qira për materiale pas përfundimit të afatit të studios;
- Kontrata me ekonomistin dhe magazinierin e projektit janë për gati 3 muaj më pas nga kontratat e tjera, në një kohë që e kanë për detyrë menaxhimin e proceseve të kontrollit të brendshëm, menaxhimin financiar, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportimin për shpenzimet;
- Faturat financiare të paguara për llogari të shpenzimeve të këtij projekti kanë mangësi në kohë për përputhjen me ndodhjen e veprimit ekonomik, janë nënshkruar nga persona të paautorizuar, mungon transportuesi, nuk është përshkruar lloji i mallit apo shërbimit, mungojnë fletëhyrjet për mallrat e blera, etj., në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 37;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

47.1 Rekomandimi:. Drejtori i Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme për të kryer veprimet e duhura pas miratimit final të projekteve, të garantojë respektimin e kushteve kontraktore, reflektimin e librit të tarifave për çmimet e preventivit, si dhe respektimin e kuadrit ligjor dhe rregullator ekonomik dhe financiar.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion mbi gjurmë auditimi apo procese pune.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

48. Gjetje nga Auditimi: Nga punonjëset e zyrës së protokoll arkivës në regjistrat e korrespondencës në çdo praktikë të regjistrimit të një dokumenti lihen 4-5 rreshta për të regjistruar dokumentet me fraksion të praktikës të dhënë. Situata e mësipërme është në kundërshtim me manualin zyrtar *"Manual për trajnimin e punonjësve të zyrës të Arkivit dhe Protokollit"* të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, faqe 30. Kjo praktikë nuk është ndjekur vetëm për shkresat me fraksion, por edhe për shkresa të cilat nuk parashikohet të kenë fraksione dhe nuk e kanë të nevojshme rezervimin e rreshtave, si p.sh: kërkesa dorëheqje, leje të zakonshme, vërtetime page, informacione për prezencën në punë, autorizime, shkresa për trajnim, lidhje kontratash pune, shpërblime për punonjës për raste të ndryshme, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 11 faqet nr. 184 - 186 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)

48.1 Rekomandimi: Drejtoria e Administratës/zyra e protokoll arkivës, rezervimi i 4-5 rreshtave në regjistrin e korrespondencës të bëhet për ato shkresa për të cilat vlerësohet nga përmbajtja e vetë shkresës se do të ketë dokumente me fraksion dhe jo për të gjitha shkresat e regjistruara.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nga zyra e protokoll arkivës **është zbatuar rekomandimi** i lënë është bërë regjistrimi i korrespondencës duke vlerësuar përmbajtjen e shkresës për rezervim të rrjeshtave.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

49. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se materialet të cilat përbëjnë fondin arkivor të RTSH, që prej muajit Qershor të vitit 2018 e në vazhdim hyjnë në arkiv nëpërmjet platformës Etere (MAM) në formatin digjital, ku nga të cilat, janë zbardhur dhe redaktuar rreth 80% e tyre. Nga intervistimi i punonjësve të zyrës së arkivit rezultoi se deri tani janë digjitalizuar dhe hedhur në ETERE material të formatit Beta dhe DVCAM, kaseta ku përmbajnë: (dokumentarë, teatër, telenovela, filmi i huaj, muzikë, emisione ekonomike,

material sportive që i përkasin viteve 1996-2017. Ndërsa për pjesën e mëparshme nuk është kryer ky proces. Një pikë tjetër tepër e rëndësishme është edhe arkivimi dhe konvertimi në formate digjitale i materialeve të viteve 70-90 në formatin Ampex, Film, Bosch dhe audio shirit CPR, DISK, CD dhe LGR, të cilat kanë vlera jashtëzakonisht të rëndësishme. Është tepër e rëndësishme që këto formate të digjitalizohen në mënyrë sa më të shpejtë me qëllim ruajtjen dhe mosdegradimin e mëtejshëm të formatit Film, Ampec, Bosch etj. mos riskimin dhe humbjen e tyre pasi, kushtet aktuale ku këto materiale mbi 50 vjeçare ruhen nuk janë të mira, kjo si pasojë e mos investimeve në vite dhe e dëmtimeve të ambienteve të ruajtjes që kanë ndodhur se fundmi nga tërmeti i vitit 2020.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 11 faqet nr. 184 - 186 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)
49.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arkivit pranë RTSH të studiojnë situatën dhe të marrin të gjitha masat e duhura që të digjitalizohen të gjitha materialet e ndodhura në arkivin e filmit, edhe për periudhën para vitit 1996 si dhe të arkivohen dhe konvertohen në formate digjitale materialet e viteve 70-90 në formatin Ampex, Film, Bosch dhe audio shirit CPR, DISK, CD dhe LGR në mënyrë sa më të shpejtë me qëllim ruajtjen, mosdegradimin e mëtejshëm dhe mos humbjen e tyre.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Në datë 04.04.2022 është mbajtur akt verifikim dhe rezulton që, nga ana e kësaj Drejtorie në periudhën Shkurt- Prill 2022 janë hartuar Urdhërat nr 11, datë 10.2.2022 dhe nr. 23 datë 01.04.2022 si dhe nr. 26, datë 04.04.2022 për ngritjen e grupeve të punës për përpilimin e listave të materialeve arkivore sipas formateve përkatëse. Brenda muajit Tetor 2022 do të evidentohen materialet sipas gjinive, dhe do të fillojë përpilimi i dokumentave digjitale sipas të dhënave përkatëse.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

50. Gjetje nga Auditimi: Bordi Artistik i RTSH nuk e ka zbatuar plotësisht rregulloren përkatëse, pasi nuk i janë përcjellë projektet nga Drejtori i Përgjithshëm, projektet nuk kanë pasur dokumentacionin e plotë shoqërues, janë miratuar të gjitha projektet e sjella pa ndryshime (kjo dhe për shkak të përbërjes së këtij bordi), duke e bërë këtë veprimtari formale.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqet nr. 186 - 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
50.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë veprimtarinë e deritanishme të Bordit artistik dhe të marrë masa për që veprimtaria e tij të jetë funksionale në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale të RTSH

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

51. Gjetje nga Auditimi: Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit nuk ka zhvilluar aktivitet mbi një vit nga krijimi; si dhe nuk është mbledhur jo më pak se një herë në dy muaj; nuk ka paraqitur një herë në tre muaj një raport para Këshilli Drejtues mbi zbatimin e strukturës programore; nuk ka organizuar vëzhgime dhe studime lidhur me ndjekjen e shërbimeve të transmetimeve nga ana e kategorive të veçanta të shoqërisë; nuk ka organizuar seanca dëgjimore në transmetime të drejtpërdrejta, për çështje të programacionit; si dhe nuk ka hartuar një raport vjetor, në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij, që i duhej paraqitur KDRTSH-së, AMA-s, ministrit dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqet nr. 186 - 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
51.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të shqyrtojë dhe të analizojë në mënyrë të veçantë veprimtarinë e deritanishme të Këshillit për shikuesit dhe dëgjuesit, duke marrë masa për vënien në eficiencë të plotë të kësaj strukture për të siguruar përfaqësimin e shikuesve dhe dëgjuesve.

Në vijimësi
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

52. Gjetje nga Auditimi: Përfitimi i rimbursimit të shpenzimeve celulare nuk ka kritere për operatorin e kontraktuar, janë evazive për numrin dhe punonjësit sipas pozicioneve, si dhe nuk janë ndjekur me rigorozitet shpenzime të kësaj natyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqet nr. 186 - 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
52.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për të rishqyrtuar dhe për t'ia paraqitur më pas Këshillit Drejtues vendimin për rimbursimin e shpenzimeve të telefonisë celulare duke vendosur kritere për to, për punonjësit përfitues dhe saktësimit të pozicioneve përkatëse, me qëllim rritjen e efektivitetit të shpenzimeve.

Brenda datës 31.10.2021
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

H. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga auditimi i veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar të periudhës së aktivitetit 01.07.2017 – 31.12.2019, kanë rezultuar shkelje të kuadrit ligjor dhe rregullator me pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e RTSH në vlerën gjithsej 23,761,927 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga Auditimi: Në procedurën me objekt *'Blerje licenca për përdorues të Sistemit MAM Etere dhe Playout ETX'– viti 2018'*,me vlerë të fondit limit 31,483,143.33 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 31,085,000 lekë pa TVSh, të lidhur sipas aktit me nr. 75/9 prot., datë 17.12.2018 mes RTSH dhe furnitorit të mallrave *"M.N."* SHPK rezultoi si më poshtë:
Për marrjen në dorëzim të zërave objekt kontrate është ngritur Grupi i punës sipas Urdhrit nr. 75/11 prot., datë 21.12.2018 me përbërje z. B. M., E. B. dhe z. A. A.. Sipas shkresës me nr. 4239 prot., datë 21.12.2018 me lëndë *'Dorëzimi i licencave, referuar kontratës me nr. 75/9 prot., datë 17.12.2018'* është bërë dorëzimi nga ana e OE për zërat si më poshtë: Licencë për përdorues në Sistemi MAM ETERE – sasia 150 copë; Licencë për Playout ETX – sasia 3 copë.
Me shkresën me nr. 75/13 prot., datë 17.01.2019 grupi i punës i ngritur për marrjen në dorëzim ka konstatuar disa mangësi si dhe dy kërkesa:
Data e publikuar për suportin aktiv nga 6 muaj duhet në 4 vite;
Kohëzgjatja e aktivitetit të licencave me funksione të ndryshme nga (client) duhet të jetë pa limit (unlimited);
Numri i licencave aktive për ETX ishte 2 dhe sipas kontratës duhet të jenë në panel dhe 3 licenca të reja ETX;
Me shkresën me nr. 75/14 prot., datë 22.01.2019 Titullari i AK ka vënë në dijeni sipërmarrësin në lidhje me pretendimet e mësipërme. Me shkresën me nr. 75/15 prot., datë 28.01.2019 nga ana e sipërmarrësit *"M. N."* SHPK i është kthyer përgjigje kërkesës së Titullarit. Me shkresën me nr. 58/1 prot., datë 28.12.2018 të Njësisë Teknike, administruar në RTSH me nr. 75/16 prot., datë 30.12.2018 është vënë në dijeni Titullari i AK nga ana e Drejtorit të kësaj njësie z. H. M. në lidhje me faktin se pretendimet e sipërmarrësit sipas shkresës me nr. 75/15 prot., datë 28.12.2018 qëndrojnë pasi aktualisht RTSH e merr shërbimin e kërkuar duke kërkuar edhe ndryshimin e grupit të marrjes në dorëzim nga 3 në 5 anëtarë. Në përgjigje të kësaj shkrese nga ana e Titullarit është ngritur Urdhri nr. 75/17 prot., datë 30.01.2019 për marrjen në dorëzim të mallrave dhe ndjekjen e kontratës me përbërje z. A. K., E. K., E. B., z. B. M. dhe z. K. S. nga

ana e të cilëve është mbajtur procesverbali përkatës i datës 75/18 prot., datë 01.02.2019 për marrjen në dorëzim. Sipas këtij procesverbali ka pasur objeksione nga ana e z. B. M.
Nga verifikimi i praktikës së mësipërme, nisur nga kërkesat e cituara në specifikimet teknike sipas shkresës me nr. 75/1 prot., datë 17.09.2018, paragrafi i dytë *Software përgjegjës për Playout ETX*, pika 4 është cituar se: *"Software mund të instalohet në versionet Windows 7, 10"*.
Nga verifikimi në RTSH në prezencë të përfaqësuesve të KLSH si dhe punonjësve të RTSH u konstatua se nuk janë realizuar instalime të Softwareve të rinj Playout në sasinë 3 copë, por janë zgjeruar kanalet në software – in Playout (Main/Backup) të realizuar në një procedurë tjetër të vitit 2016.
Nga verifikimi në SPE, rezulton se në lidhje me procedurën me objekt *"Furnizim – vendosje e materialeve teknologjike në studio e prodhimit për server room, storage mam, ott"*, për të cilën është shpallur fitues BOE *"A. B. S."* SHPK &*"S. A."* SHPK &*"M. N."* SHPK është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3536/11 prot., datë 17.01.2017 me afat 90 ditë. Sipas zgjidhjes teknike (faqe 63 – 65 e materialit) të ofruar nga sipërmarrësi i kësaj kontrate rezulton se në përshkrimin e bërë për software – in Playout janë parashikuar instalimi i këtij të fundit si më poshtë:
Fq. 63 – Playout - Sistemi playout duhet një sistem qendror server plus multiple clients për të bërë playout në disa kanale të ndryshme njëkohësisht.
Fq. 65 – Sistemi i playout duhet të ofrojë mundësinë e skedulimit të Playlistave në mënyrë kronologjike bazuar mbi kohen (Date-Time) të Serverit. Ky funksion duhet të përfshijë një set feature si:
Pika e: Deri në 8 kanale paralele për playlist të ndryshme
E thënë ndryshe, në këtë rast nuk janë blerë 3 software Playout ETX të kërkuar, siç edhe është cituar në specifikimet teknike të hartuara në fillim të procedurës, por në sistem rezulton se janë shtuar tre kanale video të reja në Playoutin ETX ekzistues të blerë më parë me procedurën e nisur në vitin 2016.
Nga ana e grupit të auditimit është kërkuar vënia në dispozicion e dokumentacionit përkatës vërtetues dhe justifikues i marrjes në dorëzim të këtyre aktiveve në lidhje me zërin *Licencë për Playout ETX*. Ky dokumentacion nuk disponohej dhe as nuk faktohet se aktualisht RTSH disponon 3 Playout të rinj ETX dhe **për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër nga ana e furnitorit *"M. N."* shuma prej 11,700,000 lekë pa TVSH, shumë kjo e cila përbën dëm ekonomik** dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e furnitorit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me kontratën e furnizimit e lidhur sipas aktit me nr. 75/14 prot., datë 22.01.2019, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, i ndryshuar, pika 35 dhe 36si dhe Urdhrin nr. 75/17 prot., datë 30.01.2019 për marrjen në dorëzim të mallrave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **11,700,000 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"M. N."* SHPK, si furnizime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 75/9 prot., datë 17.12.2018 me objekt *'Blerje licenca për përdorues të Sistemit MAM Etere dhe Playout ETX'*.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën nr. 3552, datë 20.10.2021 subjekti është njoftuar për detyrimin. Me shkresën nr. 3552/1, datë 26.10.2021 subjekti ka kthyer përgjigje duke kërkuar vendosjen në dispozicion të materialeve. Nuk është vijuar komunikimi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh rezultoi se i janë likuiduar sipërmarrësit të punimeve për 7 zëra punimesh *(shiko aneksin 1.1)* shuma prej **3,092,885 lekë pa TVSH** për volume të pakryera në fakt. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 161/1 prot., datë 31.07.2017. Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3; UKM nr. 2, datë 8.5.2003 *"Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu I/I *"Klasifikimi i punimeve të ndërtimit"*, germa "A", paragrafi i fundit, *Kreun I, germa B Punime teknologjike dhe të montimit, Kreun II, pika B Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi;* VKM nr. 514, datë 15/8/2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 *"Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, të ndryshuar, pika 1, germa "c", paragrafi i fundit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **3,092,885 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"S."* ShPK si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresë nr. 3554 dhe 3555, datë 20.10.2021 subjekti është njoftuar por nuk ka reagim.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'*, rezultoi se:

- *Stacioni Zvërnec:* Sipas situacionit përfundimtar në këtë stacion janë vendosur tre sensorë për dyert. Edhe sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim rezulton se janë marrë në dorëzim tre sensorë. Referuar specifikimeve teknike rezulton se janë parashikuar për t'u vendosur tre sensorë. Në fakt sipas verifikimit në terren rezultoi se për këtë stacion ishte vendosur vetëm një i tillë. Për rrjedhojë duke bërë korrigjimet përkatëse rezulton se janë përfituar padrejtësisht dy copë sensorë për dyert, ose vlera prej **17,200 lekë** pa TVSH.

- *Stacioni Treblovë:* Sipas situacionit përfundimtar në këtë stacion janë vendosur tre transformatorë rryme. Edhe sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim rezulton se janë marrë në dorëzim tre transformatorë rryme. Referuar specifikimeve teknike rezulton se janë parashikuar për tu vendosur tre transformatorë rryme. Në fakt sipas verifikimit në terren rezultoi se për këtë stacion ishin vendosur vetëm dy të tillë. Për rrjedhojë duke bërë korrigjimet përkatëse rezulton se janë përfituar padrejtësisht një copë transformatorë rryme, ose vlera prej **10,500 lekë** pa TVSH.

- Nga sondazhet e kryera për depozitat e vendosura në 8 stacione rezultoi se nuk është kryer në asnjë rast zëri me nr. rendor 6 *'F.V lyerja me primer izolues e pusetës të depozitës'*. Për rrjedhojë vlera prej **345,600 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit.
- Nga verifikimi i listës së zërave në preventiv konstatohet se është likuiduar midis të tjerave edhe zëri me nr. rendor 7 *"Kolaudimi i impiantit prova dhe vënia në punë"*. Në fakt referuar emërtimeve të zërave të cilët janë konsideruar si furnizim vendosje si dhe ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, neni 12 rezulton se likuidimi i këtij zëri në shumën **168,000 lekë pa TVSH** është likuiduar tepër dhe në kundërshtim me kuadrin ligjor të sipërpërmendur. Për sa më sipër kjo vlerë përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit të punimeve.
- Konstatohet se i janë likuiduar sipërmarrësit të punimeve mes të tjerave edhe zëri *'Vendosja e rezervuarit në gropë'* kur në fakt referuar zërit me nr. rendor 1 është likuiduar si zë më vete *'F.V Depozitë karburanti V 3300 lt, ≥ 500 kg'* duke bërë që çdo vendosje depozite të paguhet dy herë, kur në fakt është kryer një herë. Për rrjedhojë vlera prej **201,600 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pas verifikimeve të kryera në qendrën e monitorimit në RTSH nuk dokumentohet marrja e licencave nga ana e sipërmarrësit të punimeve për 722 copë ose vlera **1,025,240 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit të punimeve.

Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, neni 12; Urdhrin nr. 319/1 prot., datë 26.04.2019 për marrjen në dorëzim të mallrave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,768,140 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE *"S. C."* ShPK, *"R. C."* ShPK dhe *"A. T."* si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 20/13 prot., datë 26.04.2019 me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'*.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën nr. 3556, datë 20.10.2021 subjektet janë njoftuar për detyrimin. Me shkresën 3556/1 datë 01.11.2021 ka kërkuar venjen në dispozicion të informacionit të detajuar. Nuk ka vijim komunikimi.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të blerjeve me vlera të vogla u konstatua se: Për 6 procedurat e prokurimit me objekt *"Mbikëqyrja e punimeve supervizioni në objektin rikonstruksioni i stacionet ekzistues Gllavë, Tarabosh, Sopot, Mide, Llogara dhe Cervenake"* me fond limit në shumën totale në shumën 2,097,584 lekë pa TVSH, dhe vlerë kontrate në shumën totale 2,144,000 lekë pa TVSH rezultoi se: Këto procedura janë anuluar dy herë sipas komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për arsye se, ofertat e paraqitura janë më pak se VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit". Pasi janë kualifikuar operatorët dhe janë renditur në klasifikimin përfundimtar, nga komisioni janë skualifikuar dhe janë njoftuar në sistem brenda një periudhe prej 3-4 minuta, me pretendimin se kanë paraqitur oferta anomalisht të ulëta. Në udhëzimin e APP, për procedurat e blerjeve me vlera të vogla përcaktohet se nuk zbatohen dispozitat e nenit 56 të LPP për ofertat anomalisht të ulëta. Bazuar në vlerësimin e procedurës së parë, komisioni i prokurimeve të blerjeve me vlera të vogla, duhet të priste 24 orë sikurse parashikohet në ftesën për ofertë të paraqitur në SPE për secilin

operator deri duke argumentuar kalimin tek operatori i radhës dhe arsyet përkatëse të cilat duhet të dokumentoheshin në një procesverbal, ose të kërkoheshin argumentim i paraqitjes së ofertës përpara se të s'kualifikoheshin. Më pas këto procedura janë kryer me blerje të drejtpërdrejtë me testim tregu duke marrë oferta dhe kanë përcaktuar fituese ofertën më të ulët të marrë, sipas procesverbalit përkatës të udhëzimit. Nga sa më sipër rezulton se nga vlera e secilës kontratë të lidhur me vlerën e OE fitues në procedurën e parë, për secilën procedurë, është konsideruar shpenzim i paligjshëm për buxhetin subjektit, dhe në total ***shuma prej 1,470,800 lekë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH***. Situata e mësipërme është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, neni 1, neni 40; si dhe me Udhëzimin nr., datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 46 - 54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,470,800 lekë**, shkaktuar si dëm ekonomik nga veprimet dhe mosveprimet e z. Th. G., në cilësinë e Titullarit të AK dhe z. G. A., z. A. M. dhe znj. G. H., në cilësinë e Komisionit të procedurave të blerjeve të vogla.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Asnjë punonjës nuk është aktualisht në RTSH dhe nuk është kryer asnjë njoftim zyrtar i tyre.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

5. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti VI Llogara rezultoi se nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë zbatuar specifikimet teknike të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes në lidhje me zërin *"Punime rrjetë xingato d=4 mm të vendosur në profile të xinguara"*. Konkretisht sipas specifikimeve teknike është përcaktuar që vendosja e kolonave të rrethimit të kryhet në kubikë betoni C 12/15 me dimensione 0.5 ml x 0.5 ml x 0.5 m. Në fakt sipas verifikimit rezultoi se nuk janë respektuar këto dimensione pasi janë realizuar më të vogla, jo në formë kubike dhe nuk konfirmohet marka e betonit pasi materiali i përdoruar është pa përforcim me hekur betoni, siç përshkruajnë specifikimet teknike për këtë zë. Gjithashtu, në vend të betonit është përdorur material tjetër (mbushës me material rrethanor) jashtë çdo standardi duke mos arritur markën e kërkuar. Aktualisht rrethimi është shembur në masën 80 % të tij pas veprimit të forcave të erërave në atë zonë. Për rrjedhojë, në gjykim të grupit të auditimit ky zë punimesh konsiderohet si volum pune i pakryer dhe vlera prej **1,081,600 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik**. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Kontratat e shërbimit të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,081,600 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE *"2. C. & S. C."* ShPK si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/26 prot., datë 05.07.2017 me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti IV Llogara.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën 3557, datë 20.10.2021 është njoftuar subjekti është njoftuar për detyrimin dhe nuk ka përgjigje.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

6. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i Godinës së Radio Televizionit të Korçës'*, nga inspektimi në terren i punimeve të ndërtimit rezultoi se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve vlera prej **1,005,706 lekë pa TVSh** për diferenca volumesh në 4 zëra punimesh. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3;Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3; VKM nr. 514, datë 15/8/2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 *"Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, të ndryshuar, pika 1, germa "c", paragrafi i fundit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,005,706 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"H.-2."* ShPK, si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 29/10 prot., datë 18.05.2017 me objekt *'Rikonstruksion i Godinës së Radio Televizionit të Korçës'*.

Menjëherë
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën 3562, datë 20.10.2021 është njoftuar subjekti me postë por në njoftimin e postës ka shkruar do vijë ta marr vet. Nuk ka komunikim
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

7. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, për sa i përket vlerës së fondit limit, rezultoi se kjo shumë është parashikuar në vlerën 22,613,430 lekë pa TVSH. Në këtë shumë rezulton të jetë përfshirë edhe një vlerë prej 5 % në masën 788,300 lekë pa TVSH. Sipas preventivit të pasqyruar në DST rezulton se formati i preventiv – ofertës për t'u plotësuar nga ana e OE përmban zërat dhe jo fondin rezervë prej 5 %. Në kushte të tilla, nga ana e NJP janë ngarkuar në sistem Dokumente Standarde të cilat pasqyrojnë si vlerë të fondit limit shumën prej 22,613,430 lekë pa TVSH dhe një preventiv që nuk parashikon fond rezervë me pasojë rritjen fiktive të fondit limit në masën 788,300 lekë pa TVSH, kjo për shkak se kjo NJP nuk i është referuar saktë preventivit të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 478/1 prot., datë 14.02.2017 i cili ka paraqitur atë sipas shkresës me nr. 478/2 prot., datë 27.02.2017. Duke bërë korrigjimet për efekt të uljes së ofertës nga ana e OE fitues *"S."* ShPK prej 56,008 lekë pa TVSH, rezulton se diferenca prej **732,292 lekë pa TVSH***(788,300 lekë pa TVSH – 56,008 lekë pa TVSH)***përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të RTSH. Situata e mësipërme është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 57, pika 4.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit

për arkëtimin e vlerës **732,292 lekë pa TVSH** ndaj grupit të punës të përbërë nga z. G. A., z. A. B. dhe znj. G. H., në cilësinë e anëtarëve të NJP, për rritje fiktive të fondit limit me pasojë dëm ekonomik në procedurën me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

8. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'*, rezultoi se:
- Nga verifikimi i listës së zërave në preventiv konstatohet se është likuiduar midis të tjerave edhe zëri *"Kolaudimi i impiantit prova dhe vënia në punë"*. Në fakt referuar emërtimeve të zërave të cilët janë konsideruar si furnizim vendosje si dhe ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, kolaudimi i punimeve të ndërtimit nuk mund të kryhet nga ana e firmës sipërmarrëse dhe në kushte të tilla likuidimi i këtij zëri në shumën **46,200 lekë pa TVSH** është përfituar padrejtësisht dhe në kundërshtim me kuadrin ligjor të punimeve të ndërtimit.
- Konstatohet se i janë likuiduar sipërmarrësit të punimeve mes të tjerave edhe zëri *'Vendosja e rezervuarit në gropë'* kur në fakt referuar zërit me nr. rendor 1 është likuiduar si zë më vete *'F.V Depozitë karburanti V 3300 lt, ≥ 500 kg'* duke bërë që çdo vendosje depozite të paguhet dy herë, kur në fakt është kryer një herë. Për rrjedhojë vlera prej **92,400 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit.
- Nga sondazhet e kryera për depozitat e vendosura në 3 stacione rezultoi se nuk është kryer në asnjë rast zëri me nr. rendor 6 *'F.V lyerja me primer izolues e pusetës të depozitës'*. Për rrjedhojë vlera prej **158,400 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pas verifikimeve të kryera në qendrën e monitorimit në RTSH nuk dokumentohet marrja e licencave nga ana e sipërmarrësit të punimeve, vlera e të cilave është në masën 275 copë ose vlera **426,250 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e përfituar padrejtësisht e cila përbën dëm ekonomik. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, neni 12; Urdhrin nr. 775/1 prot., datë 15.11.2018 për marrjen në dorëzim të mallrave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **723,250 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE *"L."* ShPK, *"R. C."* ShPK dhe *"A. T."* si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 67/12 prot., datë 07.11.2018 me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'*.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën nr. 3563, datë 20.10.2021 subjektet janë njoftuar për detyrimin. Me shkresën datë 08.11.2021 këto subjekte kanë bërë me dije se janë të gatshme për bashkëpunim për zgjidhjen e problemit. Nga RTSH nuk është vijuar korrespondenca.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

9. Gjetje nga Auditimi: Për projektin "Masterchef Junior" 2017-2018, lidhur me pagesat e personelit konstatohet se:

- Sipas kontratës me nr. 1101/31 prot., date 07.02.2018 me znj. Xh. K. në cilësinë e ekonomistes, me objekt menaxhimin e procesit të kontrollit të brendshëm financiar, raportimin e rregullt për situatën dhe shpenzimet financiare, menaxhimin e kontabilitetit dhe te financave, mirëmbajtja e llogarisë dhe përgatitja e raporteve financiare (neni-2) nuk ka asnjë gjurmë dokumentare në dosje dhe është shpërblyer me **271,368 lekë** me firmën e drejtorit R. A.;
- Sipas kontratës me nr. 1101/32 prot., date 07.02.2018 me znj. E. B., në cilësinë e magazinieres së projektit, me objekt magazinimin e prodhimeve ushqimore, pajisjet që merren me qira, pjesët përbërëse të skenografisë etj., si dhe të regjistrojë të gjithë këta artikuj dhe të nxjerrë prej magazinës artikujt vetëm me urdhër të personave të autorizuar, nuk ka asnjë gjurmë dokumentare në dosje për shpërblimin në shumën **169,320 lekë**;
- Sipas kontratës me nr. 1101/15 prot., date 07.02.2018 me znj. Xh. K., në cilësinë e specialistit të marrëdhënieve me publikun, me objekt menaxhimin marrëdhënieve me publikun për rritjen e auidencës, duke menaxhuar me komunikimin e mesazheve kyçe për të arritur audience e synuar, si dhe kryerjen e hulumtimeve për të zbuluar prirjet e audiencës, nuk ka asnjë gjurmë dokumentare në dosje për shpërblimin në shumën **66,400 lekë;** dhe sipas kontratës me nr. 1101/21 prot., date 07.02.2018 me znj. M. T. si më lartë në shumën **132,800 lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 – 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **639,888 lekë** nga peronat si më poshtë, pasi nuk ka gjurmë dokumentare të ofrimit të shërbimit të kontraktuar për këtë projekt:
1. Xh. K., në cilësinë e ekonomistes, 271,368 lekë;
2.E. B., në cilësinë e magazinieres, 169,320 lekë;
3. Xh. K., në cilësinë e specialistit të marrëdhënieve me publikun, 66,400 lekë;
4. M. T., në cilësinë e specialistit të marrëdhënieve me publikun, 132,800 lekë;

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk janë njoftuar për detyrimin.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

10. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, referuar njoftimeve të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit për përfundimin e punimeve, këto dokumente citojnë datën 03.11.2017 dhe referuar aktit të marrjes së përkohshme në dorëzim citohet data 03.11.2017 kur në fakt sipas korrespodencave të vetë Titullarit rezulton se puna nuk është përfunduar për shkak të vendosjes së pajisjeve të kondicionimit jo në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Nga sa më sipër rezulton se pavarësisht shkresave dhe korrespodencave të cilat rezultojnë të jenë fiktive pasi nuk pasqyrojnë situatën reale arrihet në konkluzionin se punimet janë konfirmuar si të përfunduara (në lidhje me sistemin e kondicionimit) me datë 19.12.2017, datë pas së cilës më 22.12.2017 Grupi i marrjes në dorëzim ka konfirmuar edhe punimet për vendosjen e sistemit të kondicionimit. Për rrjedhojë në këtë rast, në kundërshtim me ato çka thuhet në Aktin e kolaudimit, i cili është pa datë, dhe ndryshe nga sa përshkruhet në aktin e marrjes së përkohshme në dorëzim, punimet kanë përfunduar me 46 ditë vonesë. Në lidhje me këtë situatë nga ana e AK, në zbatim të nenit 38 të kontratës me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 për zbatimin e punimeve lidhur mes RTSH dhe sipërmarrësit, duhet të ishte aplikuar penaliteti në vlerën **368,000 lekë pa TVSH**. Situata e mësipërme është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 mes Autoritetit Kontraktor RTSH, dhe sipërmarrësit të punimeve *"S."* ShPK, neni 38 i kontratës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masat e duhura që, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **368,000 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"S."* ShPK si penalitet për vonesa në përfundimin në afat të kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresë nr. 3554 dhe 3555, datë 20.10.2021 subjekti është njoftuar por nuk ka reagim.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

11. Gjetje nga Auditimi: Përprojektin "Eurovision Song Contest 2018", konstatohet se, janë paguar dieta me mandat-pagesën nr. 146, datë 27.04.2018 **gjithsej 330,000 lekë** sipas listë-pagesës për 3 persona nga 20 ditë pa asnjë dokument financiar justifikues, thjeshtë dhe vetëm mbi bazën e preventivit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 34/b.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 – 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **330,000 lekë** të përfituar padrejtësisht nga 3 persona për dieta, paguar pa asnjë dokument financiar justifikues.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i tarracës dhe dritareve të Godinës së Radio Kukësit'*, rezultoi se Kontrata për këtë investim është lidhur sipas aktit me nr. 28/9 prot., datë 22.05.2017 mes Autoritetit Kontraktor RTSH, dhe sipërmarrësit të punimeve OE *"D. I."* ShPK me vlerë të kontratës 2,226,722 lekë me TVSh**.** Nga inspektimi në terren i punimeve të ndërtimit rezultoi se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve vlera prej **271,993 lekë pa TVSh** për diferenca volumesh në 4 zëra punimesh. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3; VKM nr. 514, datë 15/8/2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 *"Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, të ndryshuar, pika 1, germa "c", paragrafi i fundit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **271,993 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"D. I."* ShPK, si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 28/9 prot., datë 22.05.2017 me objekt *'Rikonstruksion i tarracës dhe dritareve të Godinës së Radio Kukësit'*.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën nr. 3561, datë 20.10.2021 është njoftuar subjekti për detyrimin dhe nuk ka asnjë përgjigje.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti IV Gllavë rezultoi se nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë zbatuar specifikimet teknike të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes në lidhje me zërin *"Punime rrjetë xingato d=4 mm të vendosur në profile të xinguara"*. Konkretisht sipas specifikimeve teknike është përcaktuar që vendosja e kolonave të rrethimit të kryhet në kubikë betoni C 12/15 me dimensione 0.5 ml x 0.5 ml x 0.5 m. Në fakt sipas verifikimit rezultoi se nuk janë respektuar këto dimensione pasi janë realizuar më të vogla, jo në formë kubike dhe nuk konfirmohet marka e betonit pasi materiali i përdoruar është pa përforcim me hekur betoni, siç përshkruajnë specifikimet teknike për këtë zë. Gjithashtu, materiali i përdorur për themelin e rrethimit është jashtë çdo standardi dhe nuk ka arritur markën e kërkuar pasi është i shkrifërueshëm. Për rrjedhojë, duke bërë korrigjimet përkatëse për efekt të mos realizimit të mureve b/a për kolonat e rrethimit rezulton se janë përfituar tepër vlera prej **212,110 lekë pa TVSH** në total e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të RTSH. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Kontratat e shërbimit të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3;Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **212,110 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE *"2. C. & S. C."* ShPK si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/24 prot., datë 05.07.2017 me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti IV Gllavë.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën 3557, datë 20.10.2021 është njoftuar subjekti është njoftuar për detyrimin dhe nuk ka përgjigje.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

14. Gjetje nga auditimi: NëProjektin "Asambleja e Përgjithshme e EBU", në faturën e datës 06.07.2018, me nr. 739, vetëm me firmën e nënshkruesit të blerësit, bashkëlidhur të të cilit gjendet situacioni i datës 06.07.2018 me 14 zëra, zëri 12 Aktivitet tek salla Dora D'istria me vlerë 175,000 lekë, ka mbivendosje të shpenzimeve, pasi të gjitha aktivitetet e zhvilluara në këtë sallë janë të mbuluar me koston përkatëse analitike në preventiv. ***Pra 175,000 lekë për qira salle janë përfituar padrejtësisht nga subjekti "P." SHPK.***

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **175,000 lekë** si pagesë e dubluar për sallën në projektin "Asambleja e Përgjithshme e EBU", pasi janë përfituar padrejtësisht nga subjekti "P." SHPK.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën 3551, datë 20.10.2021 është njoftuar subjekti është njoftuar për detyrimin dhe me shkresën 3551/1 datë 26.10.2021 kërkojnë më tepër informacion. Nuk ka vijim komunikimi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

15. Gjetje nga Auditimi: Në Drejtorinë e Përgjithshme janë paguar më tepër se sa kuota mujore në vitin 2018 për Drejtorët e Drejtorive 115,263 lekë (pagesa në fakt për këtë vit 483,263 lekë, duhej 368,000 lekë: 92 muaj/drejtorë x 4,000 lekë kuota mujore). Vlera prej **115,263 lekë** është përfituar padrejtësisht nga Drejtorët e Drejtorive të RTSH për shpenzime telefonike mbi kuotën e përcaktuar me vendimin e KDRTSH nr. 44, datë 09.05.2017 dhe përbën dëm ekonomik për RTSH.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqet nr. 186 - 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
15.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **115,263 lekë** nga stafi i Drejtorisë së Përgjithshme, si vlerë e përfituar padrejtësisht mbi kuotën mujore të shpenzimeve për telefoninë celulare.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

16. Gjetje nga Auditimi: Në mbledhjet e Bordit të Administrimit nuk ka marrë pjesë znj. E. D. për periudhën 01.07.2017 deri më 15.11.2019 dhe ka përfituar padrejtësisht shpërblimin për pjesëmarrje në aktivitetin e Bordit **në vlerën prej 75,000 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për RTSH.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe nr. 23 - 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1 Rekomandimi: Nga ana eDrejtorit të Përgjithshëm të RTSH, Drejtoria ekonomike dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **75,000 lekë** nga znj. E.D. si vlerë të përfituar padrejtësisht për shkak të mungesës së pjesëmarrjes në mbledhjet e Bordit të Administrimit.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI ME KUSHT

1. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Blerje Led Wall pajisje ndriçimi për studion e re të lajmeve në RTSH'*, rezultoi se kontrata për këtë investim është lidhur sipas aktit me nr. 80/17 prot., datë 08.11.2019 mes Autoritetit Kontraktor RTSH, dhe sipërmarrësit të punimeve OE *"P. I."* ShPK me vlerë të kontratës 41,640,000 lekë me TVSh. Sipas Urdhrit me nr. 719/1 prot., datë 13.11.2019 është ngritur Komisioni për ndjekjen e punimeve të kontratës së mësipërme dhe me procesverbalin nr. 719/2 prot., datë 16.12.2019 është bërë verifikimi i mallrave dhe marrja në dorëzim e tyre nga komisioni përkatës. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren, materialeve të sjella me observacion, takimit ballafaques të kryer në KLSH si dhe materialeve të ardhura me postë elektronike rezultoi se nga ana e OE të kualifikuar dhe shpallur fitues, në zbatim të kriterit të DST sipas të cilit është cituar se: *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë për materialet e përcaktuara me yje tek numri rendor në tabelën e vendosur në Shtojcën 12 (per Led Wall dhe Pajisjet e ndriçimit), ku të jenë të specifikuara qartë materialet"*, është paraqitur një katalog i cili përshkruan modelin nr. YXD49P. Sipas këtij katalogu paneli është i markës Samsung model nr. LTI460HN11, sipërfaqe aktive ekrani

1018.08 mm x 572.67 mm. Në fakt gjatë verifikimit në ambientet e RTSH në të cilat ishte realizuar ky zë rezultoi se produktet ishin me kodet PJ-B461P, dhe jo sipas variantit të katalogut me model nr. nr. YXD49P .

Nga sa më sipër rezulton se nga ana e sipërmarrësit është furnizuar RTSH më një produkt jo sipas atij për të cilin është paraqitur katalogu përkatës gjatë fazës së ofertimit, dokument mbështetur në të cilin ky OE edhe është shpallur fitues. Përmes postës elektronike u dërguan katalogët e produkteve të paraqitura nga ana e furnitorit në momentin e marrjes në dorëzim të Viedo Wall – eve nga ana e grupit të marrjes në dorëzim të ngritur me Urdhrin nr. 719/1 prot., datë 13.11.2019. Këta katalogë rezultuan përsëri ato për të cilat nga ana e ofertuesit janë ngarkuar në sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE). Nga verifikimi i bërë në faqen zyrtare të prodhuesit për produktin rezulton se ky produkt ka të dhëna të ndryshme dhe që nuk janë në përputhje me kërkesat e parashtruara nga Autoriteti Kontraktor RTSH siç janë përmasat e ekranit, të cilat janë 1024*578.6*141mm sipas DST dhe 1020*574*136 sipas katalogut online të produktit apo të dhënat e ndriçimit nga *450 cd/m^2* në *500 cd/m^2*. Nisur nga sa më sipër, në gjykim të grupit të auditimit nga ana e OE të shpallur fitues rezulton se nuk janë ofruar produktet për të cilat ky OE është shpallur fitues dhe që njëkohësisht nuk përmbushin kërkesat e AK në lidhje me këto produkte. Gjithashtu, në kushtet kur marrja në dorëzim e mallrave është kryer përmes krahasimit të cilësive të produktit të sjellë me ato të katalogut (të cilat janë të ndryshme nga njëra tjetra), ky fakt konfirmon edhe një herë gjetjen e Grupit të Auditimit se produktet e sjella me vlerën **27,900,000 lekë pa TVSH, ose 80 % e preventivit** duhet të zëvendësohen me ato për të cilat furnitori është shpallur fitues. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Kontratën e furnizimit e lidhur sipas aktit, nr. 80/11 prot., datë 14.11.2018, Specifikimet Teknike; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, i ndryshuar, pika 45 dhe 47; Urdhri nr. 723/1 prot., datë 14.11.2018 për marrjen në dorëzim të mallrave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH ti kërkohet OE *"P. I."* ShPK zëvendësimi i artikullit *Video Wall i përbërë nga panele për studio,* me artikullin e kerkuar nga AK referuar sasisë dhe specifikimeve teknike të kërkuara dhe në rast mosdakoresie me OE mbi këtë zëvendësim, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i shumës prej **27,900,000 lekë pa TVSH** OE *"P. I."* ShPK, si furnizim i kryer në kundërshtim më kushtet e përcaktuara në kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 80/17 prot., datë 08.11.2019 me objekt *'Blerje Led Wall pajisje ndriçimi për studion e re të lajmeve në RTSH'* për artikullin e mësipërm.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën nr. 3557, datë 20.10.2021 është njoftuar dhe nuk ka asnjë përgjigje.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me investimin me objekt *'Blerje Led Wall dhe aksesorë shtesë'*, rezultoi se kontrata për këtë investim është lidhur sipas aktit me nr. 80/11 prot., datë 14.11.2018 mes Autoritetit Kontraktor RTSH dhe sipërmarrësit të punimeve OE *"S. A."* ShPK me vlerë të kontratës 14,224,200 lekë me TVSh. Sipas Urdhrit me nr. 723/1 prot., datë 14.11.2018 është ngritur Komisioni për ndjekjen e punimeve të kontratës së mësipërme nga i cili është bërë verifikimi i mallrave dhe marrja në dorëzim e mallrave. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren, materialeve të sjella me observacion, takimit ballafaques të kryer në KLSH si dhe materialeve të ardhura me postë elektronike rezultoi se marrja në dorëzim e artikullit *Video Wall i përbërë nga panele për studio,* është kryer duke u mbështetur tek katalogu i produktit sipas të cilit është model YXD49P. Sipas këtij katalogu paneli është i markës Samsung model nr. LTI460HN11, sipërfaqe aktive ekrani

1018.08 mm x 572.67 mm. Në fakt gjatë verifikimit në ambientet e RTSH në të cilat ishte realizuar ky zë rezultoi se produktet ishin me kodet PJ-B461P dhe jo sipas variantit të katalogut. Nga verifikimi i bërë në faqen zyrtare të prodhuesit për produkti model PJ-B461P rezulton se ky produkt ka të dhëna të ndryshme dhe që nuk janë në përputhje me kërkesat e parashtruara nga Autoriteti Kontraktor RTSH siç janë përmasat e ekranit, të cilat janë 1024*578.6*141mm sipas DST dhe 1020*574*136 sipas katalogut online të produktit apo të dhënat e ndriçimit nga *450 cd/m²* në *500 cd/m²*. Nisur nga sa më sipër, në gjykim të grupit të auditimit nga ana e OE të shpallur fitues rezulton se nuk janë paraqitur produktet për të cilat ky OE është shpallur fitues dhe që njëkohësisht nuk përmbushin kërkesat e AK në lidhje me këto produkte. Gjithashtu, në kushtet kur marrja në dorëzim e mallrave është kryer përmes krahasimit të cilësive të produktit të ofruar me ato të katalogut (të cilat janë të ndryshme nga njëra tjetra), ky fakt konfirmon edhe një herë gjetjen e Grupit të Audtimit se produktet e sjella me vlerën **10,378,500 lekë pa TVSH, ose 87 % e preventivit** duhet të zëvendësohen me ato për të cilat furnitori është shpallur fitues. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Kontratën e furnizimit e lidhur sipas aktit, nr. 80/11 prot., datë 14.11.2018, Specifikimet Teknike; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, i ndryshuar, pika 45 dhe 47, si dhe Urdhrin nr. 723/1 prot., datë 14.11.2018 për marrjen në dorëzim të mallrave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH ti kërkohet OE *"S. A."* ShPK zëvendësimi i artikullit *Video Wall i përbërë nga panele për studio*, me artikullin e kërkuar nga AK referuar sasisë dhe specifikimeve teknike të kërkuara dhe në rast të mos dakordësie me OE mbi këtë zëvendësim, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i shumës prej **10,378,500 lekë pa TVSH** OE *"S. A."* ShPK, si furnizim i kryer në kundërshtim më kushtet e përcaktuara në kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 80/11 prot., datë 14.11.2018 me objekt *'Blerje Led Wall dhe aksesorë shtesë'* për artikullin e mësipërm.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Shkresën nr. 3553, datë 20.10.2021 është refuzuar njoftimi i RTSH sipas njoftimit nga shërbimi postar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

J. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerësimit të ofertave në tenderat me objekt: - **"Rikonstruksion i Stacioneve Ekzistuese-ndarë në 6 lote",** konstatohet se KVO ka klasifikuar ofertën fituese "*S."* edhe pse nuk përmbush kriteret e vendosura në Dokumentet e Tenderit të tilla si: kriterin 2.3.7 "*për… Auditues energjie...*" pasi ka paraqitur kontratë noteriale pune dhe certifikatë kualifikimi pasuniversitar nga Universiteti Politeknik, Tiranë (diplomë) e cila nuk është e barasvlershme me licencë për auditimin e energjisë, në kuptim të Ligjit Nr. 124/2015, datë 12.11.2015, Neni 17, pika 1 dhe 2; -kriterin 2.3.15 "*mjetet*" pasi nuk ka paraqitur dokument pronësie apo kontratë qiraje për: depozitë uji 5000 litra copë 2 dhe zyrë e lëvizshme copë 1; leja e qarkullimit për mjetin manitouskopik universal, nuk përmban modelin, tipin, foto e mjetit nuk paraqet qartë 3 funksionet si ekskavator, fadromë e vogël dhe pirun.
Në kushtet kur asnjë nga operatorët nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, KVO duhet të kishte s'kualifikuar edhe operatorin "S." bazuar nëLigjin nr. 9643, datë20.11.2006 i ndryshuar neni 46, të anulonte procedurën sipas kërkesave të nenit 24, pika 1, germa "ç" të ligjit dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/1, si dhe të analizonte shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës, në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/2. Diferenca në vlerën ***4,742,587*** *lekë që rezulton nga kualifikimi i ofertës*

me vlerë më të lartë me ofertën me vlerën më të ulët, përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore në prokurimin publik.

- "<u>Blerje pajisje për kanalin RTSH Agro</u>", oferta fituese "T." nuk përmbush kriteret e vendosura në Dokumentet e Tenderit të tilla si: Autorizim prodhuesi nga kompania "R.", Autorizim prodhuesi nga kompania "N. E.A." dhe Autorizim prodhuesi nga kompania F.-A., nuk është për produktet e specifikuara në kriterin2.2.4 si dhe nuk është njësuar me origjinalin nga noteri, sipas kriterit 2.2.6 DT dhe Ligjit Nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, neni 129, pika 2; Certifikata ISO 9001:2015**,** nuk ka përkthim të noterizuar jo në përputhje me kriterin 2.2.6 dhe Ligjin Nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, neni 129, pika 2; Certifikata ISO 27000:2013 nuk është përkthyer dhe noterizuar sipas kërkesave të kriterit 2.2.6 dhe ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, neni 129, pika 2.

*Në kushte të tilla KVO duhet të kishte s'kualifikuar dhe operatorin "**TBS 96**" për mos përmbushje të kritereve të veçanta për kualifikim (kriteri 2.2.4) bazuar nëligjin nr. 9643, datë20.11.2006 i ndryshuar neni 46 dhe nenin 53, pika 3, të anulonte procedurën e prokurimit bazuar nënenin 24, pika 1, germa "ç", të ligjit,* si dhetëanalizonte shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës, në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/2. *Diferenca në vlerën **19,500,280** lekë që rezulton nga kualifikimi i ofertës me vlerë më të lartë me ofertën me vlerën më të ulët, përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore në prokurimin publik.*

<u>- "Blerje Led Wall dhe pajisje ndriçimi për studion e re të lajmeve në RTSH",</u> oferta fituese "Power Industries" nuk përmbush kriteret e vendosura në Dokumentet e Tenderit të tilla si: autorizim prodhuesi nga kompania "Sh.Y. L. D. E. C.L." nuk është sipas specifikimeve teknike shtojca 10 dhe kriterit 2.3.4 të DT. Autorizimi për ekrane LCD nuk plotëson tërësinë e produktit të kërkuar si produkt i autorizuar nga prodhuesi, pasi ekrani LED i kërkuar është vetëm një lloj specifik i ekranit LCD (*nuk përbën të njëjtin produkt*); deklaratë konformiteti për kompaninë "Sh. Y. L. D. E. C. Ltd nuk është specifikisht për produktin sipas kriterit 2.3.4 si dhe të gjitha specifikimeve të publikuara në shtojcën 10; certifikatë EN-ISO 9001:2015, nuk është e përkthyer dhe noterizuar konform Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", neni 129, pika 2, si dhe **nuk përmbush** kriterin 2.3. DT.

*Në kushtet, kur asnjë nga operatorët nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, KVO duhet të kishte skualifikuar edhe operatorin "**P. I.**" bazuar nëligjin nr. 9643 ,datë20.11.2006 i ndryshuar neni 46, të anulonte procedurën sipas kërkesave të nenit 24, pika 1, germa "ç" të ligjit dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/1, si dhe të analizonte shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/2. Diferenca në vlerën **5,050,000** lekë që rezulton nga kualifikimi i ofertës me vlerë më të lartë me ofertën me vlerën më të ulët, përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore në prokurimin publik.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<u>1.1 Rekomandimi</u>: Drejtori i Përgjithshëm i RTSH të marrë masat e nevojshme për eliminimin e efekteve negative në përdorimin e fondeve publike, duke përzgjedhur dhe trajnuar zyrtarët e prokurimeve, për fusha specifike, me qëllim vlerësim e procedurave në përputhje me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'*, rezultoi se nga analiza e zërave në preventiv përveç zërave të tjerë është marrë një ofertë tregu nga tre operatorë ekonomik edhe për zërin

"Monitorim në distancë". Specifikimet teknike për procedurën e vitit 2018 për këtë zë janë përshkruar gjerësisht në aneksin nr. 1.3. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky zë është ofertuar me këto çmime:
L. SHPK – 380,000 lekë pa TVSH;
SH. 90 L. SHPK – 342,000 lekë pa TVSH;
M. P. L. SHPK – 418,000 lekë Pa TVSH;
Prej këtej rezulton çmimi mesatar prej 380,000 lekë pa TVSH. Ky çmim është përdorur edhe për përllogaritjen e vlerës së fondit limit. Vlera totale e punës për vendosjen e 11 monitorimeve në distancë është në shumën 4,180,000 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përbën 28 % të vlerës së preventivit total. Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në vitin 2017 është realizuar një investim me objekt *"Rikonstruksioni i stacioneve, Loti 1 Mide, Loti III Cervenake, Loti IV Gllavë, Loti V Sopot dhe Loti VI Llogora"*. **Pjesë e këtij investimi ka qenë edhe zëri i mësipërm** i emërtuar si *"FTV Sistem monitorimi dhe menaxhimin në distancë sipas specifikimeve teknike"*. Referuar specifikimeve teknike për procedurën e vitit 2017 kërkesat (specifikimet teknike) për këtë zë janë përshkruar gjerësisht në aneksin nr. 1.3. Ky zë, me këto specifikime, në bazë të ofertave të marra nga OE e ndryshëm në treg në vitin 2017, është përllogaritur me çmim mesatar prej 142,800 lekë pa TVSH/njësi. Nga krahasimi i këtyre dy praktikave *(specifikimet teknike sipas anekseve 1.3 dhe 1.4)* për vitet 2017 dhe 2018 rezulton se për të njëjtin zë, nga ana e Grupit të Punës të ngritur sipas Urdhrit nr. 67 datë 04.09.2018 për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike është zbatuar ligji në mënyrë formale dhe jo duke përdorur hapësirën e mundshme ligjore të përdorimit të studimit të tregut të kryer një vit më parë për të njëjtin zë pune/shërbimi e duke mos përdorur as vlerën mesatare të 6 kontratave të mëparshme të lidhura në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt *"Rikonstruksioni i stacioneve, Loti 1 Mide, Loti III Cervenake, Loti IV Gllavë, Loti V Sopot dhe Loti VI Llogora"* sipas të cilave ky zë ka qenë i ofertuar *(çmimi mesatar i të cilave është në masën 110,500 lekë pa TVSH)*. Si rrjedhojë vetëm ky zë, i cili përbën 28 % të të gjithë preventivit final, nga një kontratë e vitit 2017 në një tjetër të vitit 2018, rezulton të jetë rritur me gati 2.7 herë. Konkretisht vlera totale e rritur e fondit limit si rrjedhojë e mos përdorimit të mënyrën e duhur të hapësirës së mundshme ligjore është 2,609,200 lekë pa TVSH *[(380,000 lekë pa TVSH – 142,800 lekë pa TVSH) x 11 copë]*. Nga këto duke bërë korrigjimet për efekt të uljes së vlerës së kontratës nga vlera e fondit limit *(shuma 536,030 lekë pa TVSH)*, rezulton se vlera prej **2,073,170 lekë pa TVSH përbën përdorim pa efektivitet efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike** nga ana e Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin nr. 67/1 datë 04.09.2018 për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike pasi nga ana e tyre nuk janë ezauruar në mënyrën e duhur të gjitha hapat për përdorimi e fondeve. Në mënyrë të ngjashme me procedurën e viti 2018 është vepruar edhe në vitin 2019 gjatë përllogaritjes së fondit limit për procedurën e ngjashme me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'*. Nga krahasimi i këtyre dy praktikave, pra ajo e vitit 2017 dhe asaj të vitit 2019 rezulton se për të njëjtin zë, nga ana e Grupit të Punës të ngritur sipas Urdhrit nr. 20 datë 06.02.2019 për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike ka vepruar në mënyrë formale dhe jo duke përdorur hapësirën e mundshme ligjore duke rritur vlerën e fondit limit për shkak të mos përdorimit të studimit të tregut të kryer dy vite më parë për të njëjtin zë pune/shërbimi e duke mos përdorur as vlerën mesatare të 6 kontratave të mëparshme të lidhura në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt *"Rikonstruksioni i stacioneve, Loti 1 Mide, Loti III Cervenake, Loti IV Gllavë, Loti V Sopot dhe Loti VI Llogora"* sipas të cilave ky zë ka qenë i ofertuar *(çmimi mesatar i të cilave është në masën 110,500 lekë pa TVSH)*. Si rrjedhojë vetëm ky zë i cili përbën 38 % të të gjithë preventivit final, nga një kontratë e vitit 2017 në një tjetër të vitit 2019, rezulton të jetë rritur me gati 2.7 herë. Konkretisht vlera totale e rritur e fondit limit është 9,888,000 lekë pa TVSH *[(390,000 lekë pa TVSH – 142,800 lekë pa TVSH) x 40 copë]*. Nga këto duke bërë korrigjimet

për efekt të uljes së vlerës së kontratës nga vlera e fondit limit *(shuma 742,340 lekë pa TVSH)*, rezulton se vlera prej **9,145,660 lekë pa TVSH përbën përdorim pa efektivitet efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.** *(më gjerësish trajtuar në aneksin 1.5)*. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 9643 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germat b dhe c; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar, neni 59, pika 2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të ngritura për përllogaritjen e fondit limit të ezaurohen të gjitha hapat e duhur me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike siç është ai i rasteve të mësipërme në shumën **11,218,830 lekë pa TVSH** *(2,073,170 lekë pa TVSH + 9,145,660 lekë pa TVSH)*si dhe sigurimin e mirë përodimit të tyre dhe transparencës në drejtim të planifikimit të vlerës së investimeve nëpërmjet përdorimit të çmimeve të marra nga kontratat e mëparshmeose/dhe çmimeve të tregut, kjo nisur nga interesi publik dy ndër të cilat janë edhe rritja e eficiencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, në lidhje me këtë praktikë grupi i auditimit bëri një analizë të vlerës së fondit limit ku u konstatua mos respektim i strukturës së kostos për çmimet e marra për zërat jashtë preventivit dhe nga ana tjetër u krye një vlerësim i punës përfundimtare të kryer nga ana e sipërmarrësit të punimeve. Konkretisht, nëse nga ana e AK do të ishin respektuar metodologjia e hartimit të preventivit, ajo e strukturës së kostos për zërin *F.V Kulla* çmimi total i do të ishte 721,700 lekë.
Preventivi dhe më pas situacionit përfundimtar i firmës sipërmarrëse është paraqitur e likuiduar për këto zëra në vlerën 7,098,000 lekë. Në lidhje me zërat *Transport i materialeve*, *Montim i bulonave*, *Beton special për bulonat*, *Fornitura e materialeve*, duke bërë analizën sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit e duke marrë në konsideratë se vetë manuali ka parashikuar çmime për konstruksione metalike të përbëra siç është rasti në fjale rezulton se, sipas analizës së mëposhtme, çmimi do të ishte 142,967 lekë për ton, ose vlera 1,715,604 lekë për 12 ton *(shiko aneksin 1.2)*. Për rrjedhojë rezulton se si pasojë e mos përcaktimit të volumeve të punimeve por emërtimit të tyre në mënyrë të përgjithshme *F.V Kulla* si dhe mos hartimit të analizës së kostos së detajuar rezulton se vlera prej **6,104,096 lekë pa TVSh përbën përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomicitet** të fondeve në lidhje me këtë investim *(721,700 lekë pa TVSh + Diferenca [7,098,000 lekë pa TVSh – 1,715,604 lekë pa TVSh])*. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 9643 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germat b dhe c; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave *'Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit'*, ndryshuar me Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011, konkretisht, pika b, e këtij Udhëzimi ndryshues; Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, e ndryshuar, pikat 2, 3, 9; Udhëzimin nr. 2 datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu I.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të punës për përllogaritjen e fondit limit të merren masa për marrjen e ofertave dhe më tej hartimin e preventivave me çmime të cilat duhet të rezultojnë nga shuma e nevojshme e çmimeve të ofruara/preventivuara për çdo kategori që është pjesë e strukturës së kostos. Konkretisht, këto kategori janë Punëtori (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Transport (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Makineri (sasi e orëve të punës

x çmimin përkatës), Materiale (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Shpenzime Plotësuese 8% dhe Fitim 10 % (këto dy të fundit ndryshojnë në varësi të kategorisë së punimeve të ndërtimit). Gjithashtu, përpara marrjes së ofertave në treg për zëra pune, të analizohen këto preventiva për vlerësimin e tyre në përputhje me çmimet e manualit teknik të çmimeve për punimet e ndërtimit.

Menjëherë

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

4. Gjetje nga Auditimi: Sipas të dhënave të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ka pasur 7 raste të punonjësve që kanë ankimuar në gjykatë ndaj RTSH për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme ligjore, për të cilët ka përfunduar gjykimi dhe në Gjykatën e Apelit për shumën **6,077,740 lekë**, një pjesë e të cilave i përkasin periudhave të para këtij auditimi. *Kjo vlerë financiare e përfituar nga punonjësit e larguar nga puna pa shkaqe të arsyeshme të cilësuara si të tilla me vendime të gjykatës, përbën efekt financiar negativ në buxhetin e RTSH duke ndikuar në performancën e tij financiare dhe funksionale.*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 38 - 46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të analizojë situatën e krijuar nga largimet e padrejta nga puna, duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I pazbatuar

5. Gjetje nga Auditimi: NëProjektin "Asambleja e Përgjithshme e EBU", preventivi i hartuar nuk i është referuar librit të tarifave dhe as kalendarit të aktiviteteve dhe kuadrit rregullator për çmimet, duke sjellë për pasojë **552,500 lekë** shpenzime të panevojshme. Gjithashtu, nuk mban në konsideratë vlerën e shpenzimeve për dreka e darka zyrtare të personaliteteve të ftuara nga RTSH të përcaktuara me Vendimin e KD nr. 36, datë 16.05.2007, kapitulli III, pika 1 shkronja "a" nga mbështetje, duke shpenzuar 341,200 lekë mbi këtë vendim.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148- 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për eliminimin e veprimeve dhe mosveprimeve të strukturave gjatë hartimit dhe zbatimit të projekteve artistike dhe filmike për të shmangur efektin financiar negativ prej 552,500 lekë për zëra të ndryshëm të preventivit të projektit "Asambleja e Përgjithshme e EBU".

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën nr. 5215/1, datë 04.07.2022 i është komunikuar mbajtja në vëmendje e fondeve publike.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacioni në lidhje me shpenzimet e kryera me bankë, rezultoi se janë paguar fatura për fjetje në hotel në tre raste në shumën gjithsej **766,960 lekë** pa asnjë dokument shoqërues për personat, datat e fjetjes në hotel, pa vulën e subjektit shitës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen më shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit" i ndryshuar, kreu i III, pika 3, germa "b";
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148- 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa të ngarkojë me përgjegjësi nëpunësin zbatues në rastet e mosrespektimit të kritereve ligjore dhe financiare në menaxhimin e projekteve.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me shkresën nr. 5215/1, datë 04.07.2022 i është komunikuar mbajtja në vëmendje e fondeve publike.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

K. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit konstatohet se për kontratat e shfrytëzimit të infrastrukturës së lirë të transmetimit të RTSH, arkëtimet në fund të vitit janë më pak se vlerat e kontratave, përveç detyrimit të muajit të fundit të vitit (dhjetor) faturimi i të cilit paguhet në janarin e vitit pasardhës, subjektet e kontraktura kanë edhe detyrime të mbartura. Detyrimi i subjekteve reklamuese dhe subjekteve që përdorin Shërbimet për Infrastrukturën Transmetuese të RTSH-së për periudhën 2017 – 2019, është në total 48.828.018 lekë. Nga kjo vlerë 27,836,059 lekë janë detyrime të faturuara më 31 Dhjetor 2019, për shërbimin e Reklamave 17,916,414 lekë dhe qira shfrytëzimi infrastrukturës transmetuese 9,919,645 lekë. Pra, në total kjo vlerë shkon në **20,992,259 lekë** të ardhura të munguara për institucionin. Për subjektet që nuk kanë paguar brenda afatit të përcaktuar, nuk është bërë ndalimi i funksionimit të aparaturave, veprim në kundërshtim me kontratat e lidhura, ku në nenin 6 "Mënyra e pagesës" përcaktohet se: "... në rast vonese të pagesave më tepër se 45 ditë nga faturimi, RTSH ka të drejtë ndalojë funksionimin e aparaturave...".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 143 - 148 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, Drejtorinë Teknike dhe Drejtorinë e Marketingut të marrin masa për sanksionimin e subjekteve debitore nga kontratat e qirave dhe kontratat e marketingut me qëllim shmangien e krijimit te detyrimeve dhe mos përsëritjen në të ardhmen.

Në vijimësi

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: U vendos në dispozicion komunikimi midis drejtorive duke evidentuar subjektet debitore dhe njoftimet e tyre.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar

L. MASA ADMINISTRATIVE

G. I - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Vlorë, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:

3. Subjektit ***"A. M."*** **ShPK** me përfaqësues ligjor E. M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2892/2, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti VI Llogara, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **1,081,600 lekë pa TVSH** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;

4. Subjektit ***"G."*** **ShPK** me përfaqësues ligjor G. S., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2928/5, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektin *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti VI Llogara, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **1,081,600 lekë pa TVSH** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;

G. II - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Korçë, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara:**

5. Subjektit ***"G."*** **ShPK** me përfaqësues ligjor G. S., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2928/5, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin *'Rikonstruksion i Godinës së Radio Televizionit të Korçës'*, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **1,005,706 lekë pa TVSH** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;
6. Subjektit ***"I."*** **ShPK** me përfaqësues ligjor F. V., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1706/6, në cilësinë e kolaudatores së punimeve në objektin *'Rikonstruksion i Godinës së Radio Televizionit të Korçës'*, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **1,005,706 lekë pa TVSH** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

G. III - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Shkodër, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara:**

7. Subjektit ***"G. C. E."*** **ShPK** me përfaqësues ligjor G. B., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2811/3, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin *''Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **3,460,885 lekë pa TVSH***(nga të cilat vlera 3,092,885 lekë pa TVSH si punime të pakryera dhe vlera prej 368,000 lekë pa TVSH si pasojë e mos aplikimit të penaliteteve për vonesa në përfundimin e punimeve)(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***;**

8. Subjektit ***"H.-C."*** **ShPK** me përfaqësues ligjor G. P., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2720/5, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektin *''Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, për certifikimin e punimeve të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **3,460,885 lekë pa TVSH***(nga të cilat vlera 3,092,885 lekë pa TVSH si punime të pakryera dhe vlera prej 368,000 lekë pa TVSH si pasojë e mos aplikimit të penaliteteve për vonesa në përfundimin e punimeve)(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;

M. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe në nenin 14 të kontratës individuale të punës kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

H. I – "Vërejtje me shkrim" për:

1. Zj. A. M., **me detyrë Drejtore e Burimeve Njerëzore**
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3253, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
2. Z. S. G., me detyrë Drejtor Juridik, pasi:
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3252, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
3. Z. H. M., me detyrë Drejtor i Njësisë Teknike, pasi:
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin i KD nr. 34, datë 23.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
4. Z. G. A., me detyrë Drejtor i sektorit të prokurimeve,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3244, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
5. Znj. E. K., me detyrë Drejtor i drejtorisë ekonomike,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3251, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
6. Z. O. H., me detyrë Specialistë IT
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3254, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
7. Z. E. B. me detyrë Specialist
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3255, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
8. Z. E. P. me detyrë Specialist (ekonomist)
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3256, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
9. Z. B. M. me detyrë Përgjegjës departamenti
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3257, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"

Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
10.Znj. S. Ç., me detyrë Preventivuese,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3246, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
11. Znj. I. B., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3241, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
12. Znj. B. S., me detyrë (specialiste në sektorin e prokurimeve dhe anëtarit të prokurimit për procedurat blerje me vlera të vogla).
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 399, datë 24.06.2022 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
13. Znj. M. Th., (specialiste në sektorin e prokurimeve dhe anëtarit të prokurimit për procedurat blerje me vlera të vogla).
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: është e larguar me dëshirë
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
14. Z. O. T., me detyrë Përgjegjës regjistrimi
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3250, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
15. Z. G. N., me detyrë Përgjegjës Departamenti,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3249, datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
16. Z. A. B., me detyrë Përgjegjës Sektori,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: është e larguar me dëshirë
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar

H. II – "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna" për:
1. Z. R. A., me detyrë Drejtor i Njësisë së Programeve, pasi:
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin i KD nr. 33 datë 23.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
2. Z. K. D., me detyrë Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3240 datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
3. Z. A. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Projekteve dhe Administrimit të të Drejtave
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3238 datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
4. Z. P. R. me detyrë Përgjegjës i financës në Njësinë e Programeve,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3242 datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
5. Z. F. Z. me detyrë (specialist në sektorin e prokurimeve dhe anëtarit të prokurimit për procedurat blerje me vlera të vogla),

Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3237 datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
6. Z. A. B. me detyrë Përgjegjës sektori, pasi:
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3243 datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
9. **Znj. R. K.** me detyrë Juriste
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3239 datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
8. **Z. B. A.** dhe
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3245 datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
9. **Z. A. H.** me detyrë Përgjegjës Turni
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3248 datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar
10. **Z. K. P.**, me detyrë Përgjegjës Turni, detyrë Teknik ndriçimi, pasi:
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3247 datë 30.09.2021 është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna"
Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar

H. III – "Ndërprerje e paralajmëruar, ose e menjëhershme, e marrëdhënieve të punës"
1. **Z. E. K.**, me detyrë Specialist,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Me Vendmin nr. 3368 datë 06.10.2021 është bërë ndërprerje e e mardhënieve të punës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:I zbatuar
2. **Z. K. S.**, me detyrë Specialist,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës nr. 2445, datë 13.07.2021
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces
3. **Z. E. B.**, me detyrë Specialist,
Qëndrimi i RTSH për Rekomandimin: Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës nr. 2445, datë 13.07.2021
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se:
a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b.Janë rekomanduar **58 masa organizative nga të cilat janë pranuar 58 masa ose 100% dhe statusi izbatimit të tyre është 11 masa janë zbatuar plotësisht ose 19%, 25 masa janë në proces zbatimi ose 43%, 4 masa janë zbatuar pjesërisht ose 7% dhe 18 masa nuk janë zbatuar ose 31%**;
c.Janë rekomanduar **16 masa për shpërblim dëmi në vlerën 23,761,927 lekë të cilat janë pranuar 16 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 0 masa të zbatuara ose 0%, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 6 masa të pa zbatuara ose 100% në vlerën 23,761,927 lekë**;
d. Janë rekomanduar **2 masa shpërblimi dëmi me kusht në vlerën 38,278,500 lekëtë cilat janë pranuar 2 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 0 masa të zbatuara ose**

0%, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 2 masa të pa zbatuara ose 100% në vlerën 38,278,500 lekë;
e.Janë rekomanduar **1 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 20,992,259 lekë e cila është pranuar 1 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të saj është 0 masa të zbatuara ose 0%, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 1 masa e pa zbatuara ose 100% në vlerën 20,992,259 lekë;**
f. Janë rekomanduar **6 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 29,770,126 lekë të cilat janë pranuar 6 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 2masa të zbatuara ose 33% në vlerën 1,319,460 lekë, 0 masa në proces ose 0%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 4 masa të pa zbatuara ose 67% në vlerën 28,450,666 lekë;**
e. Janë rekomanduar **29 masa disiplinore të cilat janë pranuar 29 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 27 masa të zbatuara ose 93%, 2 masa në proces ose 7%, 0 masa të zbatuara pjesërisht ose 0% dhe 0 masa të pa zbatuara ose 0%.**

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

- Këshilli Drejtues për mos marrjen e masave për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të KLSH.
- M. L., Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar për periudhën 11.08.2021 (protokollimi i raportit të KLSH) – 03.12.2021 (larguar nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Komanduar) dhe 04.02.2022 (larguar nga detyra si zv Drejtor i Përgjithshëm);
- E. J., Drejtor i Përgjthshëm për peridhën nga 03.12.2021 (emërimi në detyrë) – e në vazhdim;
- R. N., Zv Drejtor i Përgjithshèm për periudhën 15.02.2022 (emërimi në detyrë) – e në vazhdim;
- E. K., në cilësinë e Drejtorit Ekonomik të komanduar për periudhën 11.08.2021 (protokollimi i raportit të KLSH) – 21.02.2022 (largimi nga detyra).
- E. D., me detyrë Drejtor Ekonomik për periudhën 22.02.2022 e në vazhdim
- E. V., në cilësinë e Drejtorit Juridik të komanduar për periudhën 11.08.2021 (protokollimi i raportit të KLSH) – 26.01.2022 (largimi nga detyra)
- D. D., me detyrë Drejtor Juridik dhe i Prokurimeve për periudhën 26.01.2022 e në vazhdim.

RTSH ka paraqitur observacion me nr. 2288/60, datë 30.09.2022, protokolluar në KLSH me nr. 600/69, datë 05.10.2022 ku pretendoni keni hartuar një plan masash pas arrdhjes së projektraportit duke rindarë detyrat midis sektorëve por që nuk ka asnjë dokumentacion shtesë që nuk ju vendos në dispozicion grupit të auditimit apo masa të marra nga ana juaj për zbatimin e rekomandimeve që do të ndryshonte statusin e tyre.
Për sa më sipër ju sqarojmë se për pjesën e Masave Organizative nuk keni sjell asnjë dokumentacion të ri, i cili do të ndryshojë statusin e zbatimit të masave organizative ndërsa për sa i përket masave shpërblim dëmi ju keni dërguar shkresë rinjoftim subjekteve pas datës që grupi i auditimit ka lenë aktkonstatimin, për statusin e zbatimit të tyre do të rishikohet kur të kryhet auditimi i rradhës nga KLSH.

SPITALI PSIKIATRIK VLORË

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", SPV, ka kthyer përgjigje në KLSH, duke respektuar afatin 20 ditor me shkresën nr. 1746/1, datë 05.11.2021 "Shkresë Përcjellëse".

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 805, datë 27.04.2022 "Shkresë përcjellëse".

III. Rekomandimet e KLSH
- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **36masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **11 masa për shpërblim dëmi në vlerën 28,804,773 lekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **3 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 6,104,869 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH
Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	36	36	-	-
3	Shpërblim dëmi	11	11	-	-
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-

6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	3	3	-	-
7	Masa disiplinore	-	-	-	-
8	Masa Administrative	-	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e SPV

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	36	13	0	18	5
3	Shpërblim dëmi	11	0	0	6	5
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	3	0	0	0	3
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0
8	Masa Administrative	0	0	0	0	0

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nr.	**Lloji i rekomandimit**	**Pranuar Plotësisht (numër)**	**Statusi i zbatimit**			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	36	13	0	18	5
3	Shpërblim dëmi	11	0	0	6	5
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	3	0	0	0	3
7	Masa disiplinore	0	0	0	0	0
8	Masa Administrative	0	0	0	0	0

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 27.7 %.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", SPV, ka kthyer përgjigje në KLSH, duke respektuar afatin 20 ditor me shkresën nr. 1746/1, datë 05.11.2021 "Shkresë Përcjellëse".

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

- Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 805, datë 27.04.2022 "Shkresë përcjellëse".

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

I. Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i kualifikuar[21])

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, në rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, garantimin e të drejtave për mbrojtje e përfshirje sociale dhe për përkujdesje sociale, (kriteret e auditimit Përputhshmërie), në të cilën janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit. Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit Përputhshmërie së KLSH-së, i kryer në subjektin Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinioni të kualifikuar mbi përputhshmërinë.***

Baza për kualifikimin e opinionit mbi përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit Përputhshmërie". Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe

[21]-*Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së",* dhe MAP të KLSH-së kapitulli VII, pika 7.3.3: *Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura*

të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen **e opinionit të kualifikuar të auditimit**[22]**.**
Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:
- Nga auditimi i zërave të aktiveve u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto te aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.
- Keqklasifikimi i regjistrimit kontabël së shumës 9,677,600 lekë në llogarisë 202 "Studime e kërkime" ka ndikuar në mbivlerësimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime" si dhe nënvlerësimin e "Aktiveve Afatgjata Materiale".
- Shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
- Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2019 dhe 2020 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë.
-Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 2,245,711 lekë me TVSH nga keq interpretimi i aplikimit të inflacionit dhe vlerësimit të çmimeve për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse.
- Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 3,216,180 lekë lekë me TVSH nga keq interpretimi i aplikimit të inflacionit dhe vlerësimit të çmimeve për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse.
-Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,686,701 lekë me TVSH nga keq interpretimi i aplikimit të inflacionit dhe vlerësimit të çmimeve për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse.
- Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,814,456 lekë për mos përllogaritje e saktë e sipërfaqeve të ambientit, për të cilën realizohet "Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme", si dhe mos zbritja e sipërfaqeve të ambienteve të dhëna me qera në procesverbalet e monitorimit si dhe në situacionet e realizimit të shërbimit.
-Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 201,894 lekë me TVSH ndaj sipërmarrësit "C. F." shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për "Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme" të cilat janë dhanë me qira.
-Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 159,400 lekë me TVSH, e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve ndaj kontraktorit BOE "E. B." dhe "A." Shpk.
- Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 15,626,549 lekë me TVSH nga s'kualifikimi i padrejtë i Operatorëve ekonomik me oferte më të ulët.
- Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 997,152 lekë me TVSH nga mbivendosja e kontratës së Shërbimit Evadim i mbetjeve urbane & Shërbim pastrim gjelbërimi
- Dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit në vlerën 3,498,119 lekë nga mos rakordimi mbi shpenzimet me karburantin në fletë udhëtimet e shoferëve dhe sistemit elektronik të kartave të karburantit.
-Shpenzim pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet në vlerën 5,490,480 lekë, nga mosverifikimi i shpenzimeve të kryera.
-Shpenzim pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet ne vlerën 614,389 lekë, pasaktësi në

[22]***ISSAI 1500–*** *Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij. Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.*

përzgjedhjen e fituesit.
-Vlera në total e dëmit ekonomik shkaktuar nga SPV prej situatave të trajtuara në material është 29,448,162 lekë.
-Vlera në total e shpenzime të kryera nga SPV pa efikasitet, ekonomicitet si dhe eficence është 6,104,869 lekë me TVSH.
Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:
Menaxhimi i SPV është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.
Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme. Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Spitali Psikiatrik i Vlorës, për periudhën objekt auditimi (vitet 2017,2018,2019 & 2020) nuk ka hartuar dhe dorëzuar në MSHMS raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm e cila ndikon në mos paraqitjen si dhe deklarimin e ndryshimeve brenda programeve ne lidhje me realizimin apo jo të artikujve të parashikuar, në kundërshtim me neni 65, i ligjit nr. 57 datë 02.06.2016 "*Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 9936, Datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin E Sistemit Buxhetor Në Republikën E Shqipërisë", Të Ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 44-52 të Raportit të Auditimit)*

<u>1.1 Rekomandimi</u>: Nëpunësi autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të SPV të marrë masa për të hartuar dhe dorëzuar raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues (MSHMS), deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare, pas rakordimeve me Ministrinë përgjegjëse për Financat.

Në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 176, datë 1663 prot., datë 25.10.2021 NA dhe NZ kanë marrë masa për punën në vijimësi për hartimin dhe dorëzimin e raportit për

çdo 4-mujor si dhe për raportin e monitorimit vjetor. Me shkresën nr. 164, datë 28.01.2022 është dorëzuar në MFE raporti vjetor.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit mbi rregullshmërinë e plotësimit të dosjeve të punonjësve grupi i auditimit konstatoi së Titullari i Institucionit nuk ka kryer vlerësimin e punonjësve si dhe depozituar ato në MSHMS ku për pasojë nuk janë bërë pjesë e dosjeve të personelit, veprim kynë kundërshtim me VKM Nr. 109, datë 26.2.2014 për "Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë (ndryshuar me VKM nr. 252, datë 30.3.2016)". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 52-56 të Raportit të Auditimit).*
2.1 Rekomandimi: Spitali Psikiatrik, Vlorë në bashkëpunim me MSHMS, të kryejë vlerësimet periodike të punonjësve të SPV, me qëllim ndjekjen e angazhimit dhe performancës së punonjësve.

Në vijimësi
Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 177, me nr.1664 prot, datë 2510.2021 është pranar dhe kaluar për zbatim te strukturat përkatëse. Me shkresën nr. 1704 prot., datë 29.10.2021 për marrjen e masave për vlerësimin periodik të puonjësve.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi analitik i llogarive të aktiveve afatgjata, konstatohet se në zërin 202 "Studime dhe kërkime" në vlerën prej 9,677,600 lekë janë kontabilizuar shpenzimet për "Studime e projektime" të realizuara nga institucioni ndër vite (2007-2016). Vlera prej 9,677,600 lekë nuk ka të bëjë me AAGJ Jo-materiale por janë "Studim e projektime", të cilat në momentin e konstatimit si investim nga SPV duhet të ishin regjistruar në zërin 230 "Investime për Aktive Afatgjata jo materiale" dhe pasi institucioni ka përfunduar dhe marrë në dorëzim godinat për të cilën janë realizuar "Studim projektimet" duhej të ishte kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit duke bërë veprimin kontabël: debituar llogarinë 212 "Ndërtesa e Konstruksione" dhe kredituar llogarinë 230. Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime" si dhe nënvlerësimin e "Aktiveve Afatgjata Materiale" në shumën 9,677,600 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" i ndryshuar, neni 6, 9 dhe 10; dhe konkretisht me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, pika "c". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*
3.1 Rekomandimi: Sektori i financës së SPV të marrë masa për sistemimin e shumës 9,677,600 lekë nga llogaria 202 "Studime dhe kërkime" në llogarinë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", sipas zërave për të cilën janë realizuar "Studim e projektime".

Në vijimësi
Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 179, nr. 1666 prot, datë 25.10.2021 rekomandimi është pranuar dhe kaluar për zbatim te struktura përkatëse. Për zbatimin e këtij rekomandimi ka dal edhe Urdhri nr. 2052 prot., datë 29.12.2021. Vlera 9,677,600 lekë ka kaluar nga llogaria 230 në logarinë 212
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2017, 2018 dhe 2019 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlerën 0 lekë. Nga Institucioni nuk disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion për periudhën objekt auditimit dhe kjo sipërfaqe nuk rezulton të jetë e regjistruar në zyrat e kadastrës shtetërore dhe në hipotekë në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "*Për pasuritë e paluajtshme*

shtetërore", i ndryshuar si dhe ligjit nr. 33/2010 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*". Sipërfaqja totale e tokës prej 11620m^2, që ka SPV në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)" , paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*

4.1 Rekomandimi: Nga SPV të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 182, datë 26.10.2021 është ngritur grupi i punës për veprimet ligjore.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

4.2 Rekomandimi: Nga SPV të merren masa për përllogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës, dhe më pas Sektori i Financës të ndërmarrë veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Pas regjistrimeve përkatëse sektori i financës do të bëj regjistimet përkatëse.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

5. Gjetje nga auditimi: Një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.

- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e pajisjeve elektronike (IT) janë klasifikuar në llogarinë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune*", dhe jo në llogarinë 2186000 "*Inventar ekonomik*", ku rezulton se amortizimi vjetor për këto aktive është llogarit me normën 5% dhe jo me normën 25%.
- Një pjesë e aktiveve të tjera janë klasifikuar në llogarisë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune*", vlerë e cila duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 218 "*Inventar ekonomik*", nga ku rezulton se amortizimi vjetor për këto aktive është llogaritur me normën 5% dhe jo me normën 20%. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 25 datë 20.01.2011 "*Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik*" dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*" pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*

5.1 Rekomandimi: Sektori i Financës së SPV të marri masat për ri-klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Sektori i Financës ka bërë riklasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse dhe vlerësimin e vlerës së mbetur. Këto veprime janë pasqyruar te rregjistrat kontabël 2021.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Gjatë procesit të kalimit të aktiveve për periudhën 2017-2019, nga një

subjekt në tjetrin mbështetur në Urdhrat për "Kalim kapitali pa pagesë" u konstatua mungesë dokumentacioni si: kartela e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, Akt konfirmimi i njësisë pritëse dhe fletë-hyrja e regjistrimit të aktivit, si dhe në rastin e kalimit te mjeteve të transportit pa pagesë, autorizimin i personit për tërheqjen e mjeteve të transportit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre".
Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*
6.1 Rekomandimi: Sektori i financës të marri masat, ku përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Do të verifikohet zbatimi në auditimin e rradhës. Deri në fund të periudhës objekt auditimi nuk janë kryer veprime të tilla.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

7. Gjetje nga auditimi: Në llogaritë 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" janë kontabilizuar detyrimet e krijuara si rezultat i të ardhurave të konstatuara në bazë të kontratave për qiratë e ambienteve, të cilat janë arkëtuar në vitin pasardhës. Shumat prej 109,939 lekë për vitin 2018 dhe shuma prej 106,401 lekë në vitin 2019 duhet të ishin kontabilizuar në momentin që janë konstatuar, duke debituar llogarinë 411 ose 468 dhe duke kredituar klasën 7. Këto të ardhura në fund te periudhës ushtrimore nuk janë arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi, duke debituar llogarinë 8424 "Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm" dhe duke kredituar llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*
7.1 Rekomandimi: Sektori i financës në SPV të marrë masa në vijimësi, që për të ardhurat e konstatuara në bazë të akteve ligjore dhe të pa arkëtuara në fund të periudhës ushtrimore, të kontabilizohen duke debituar llogarinë 411 ose 468, dhe duke kredituar llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)".

Në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Në llogaritë financiare të vitit 2021 është pasqyrtuar situata konatbël në llogaritë përkatëse.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, veprim ky në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 34 dhe 42.
1. Si rrjedhojë, llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Konkretisht nga viti 2017 deri në vitin 2020, ky zë reflektohet me vlerë 0 (zero), ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare përkatësisht:

- në vitin 2017 në shumën prej 973,643 lekë
- në vitin 2018 në shumën prej 1,139,216 lekë
- në vitin 2019 në shumën prej 1,324,270 lekë

2. Duke ju referuar pagesave të kryera nga SPV për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*

8.1 Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masa të menjëhershme për të rakorduar me sektorin e çështjeve juridike, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditmin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

8.2 Rekomandim: Sektori i Financës në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

8.3 Rekomandim: Sektori/njësia që mbulon çështjet juridike, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të mund të provigjionojë fonde për shpenzime të këtij lloji, si edhe të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me urdhrin nr. 180, datë 25.10.2021 është përcjell për zbatim rekomandimi në strukturat përkatëse. Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

9. Gjetje nga auditimi: Fondi neto në vlerën 282,080,681 lekë përbëhet nga llogaritë 101 "Fondi bazë" në vlerën 281,806,702 lekë dhe llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 273,979 lekë që përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, *që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t'u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës*. Nga analiza e pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto rezulton një keq klasifikim i llogarive, i cili nuk ka efekt material në pasqyrën financiare.

- Shuma e mbetur prej 273,979 lekë e kontabilizuar në llogarinë 85 është e mbartur dhe e pa sistemuar që nga viti 2010 e cila ka të bëjë me një sponsorizim, të cilën institucioni e ka gjendje në Llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar". Në mbylljen e pasqyrave financiare nga institucioni në formatin nr. 2 "*Pasqyra e performancës financiare*" në zërin 7207 "*Sponsorizime te brendshme (nga te trete)*" vendose shumën prej 273,979 lekë si sponsorizim të periudhës ushtrimore, ku kjo shumë është konstatuar një herë si e ardhur që në vitin 2010.
- Në "*Pasqyrën e performancës financiare*" në zërin "*Ndryshimi i gjendjes se inventarit të produkteve"* nga SPV është debituar dhe kredituar njëkohësisht.

Llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*"* në fund të vitit ushtrimor duhet të paraqitej me vlerën e ndryshimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, ku për vitin 2018 duhet të reflektohej në vlerën 706,305 lekë dhe për vitin 2019 duhet të reflektohej në vlerën (2,389,549) lekë.

Llogaria nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 0 lekë. Për vitin 2019 duhej të paraqitej për vlerën (706,305) lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në SPV të marrë masa, që në fillim të çdo vitit ushtrimor të saktësojë pozicionin e çeljes së llogarive nga vitet e mëparshme, të kryejë sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomike kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Do të auditohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

10. Gjetje nga auditimi: Në fund të procesit të inventarizimit u konstatua se komisioni nuk ka përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik te aktiveve, ku të japë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes se tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, veprime këto në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.
- Nga komisioni para fillimit të inventarit u konstatua se, nuk ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, veprim ky në kundërshtim me pikën 83, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.
- Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i vlerësimit për aktivet e institucionit, të cilat i ka vlerësuar për jashtë përdorimi nuk ka mbajtur procesverbale në vete për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, ku të përcaktohet shkaqet e daljes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve, vlerën e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve. Veprime në kundërshtim me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*

10.1 Rekomandimi: Komisioni i inventarizimit i ngritur nga Titullari i Institucionit të SPV-së të marrë masa në vazhdimësi, që në fund të procesit të inventarizimit, të përpiloj një relacionin me komentet, në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes se tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit. Nëpunësi Autorizues me mbylljen e rezultateve të inventarizimeve të aktiveve detyrimisht duhet të lejë gjurmë për mbikëqyrjen e procesit dhe miratimin e procedurave deri në veprimet përkatëse të sistemit të diferencave apo kryerjes së veprimeve përkatëse për materialet që janë jashtë përdorimit.

Në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Procesi i invetarizimin është zhvilluar në fund të vitit 2021. Relacioni nr. 2050 prot., datë 2021 “Mbi vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit” i bazuar në Raportin Përfundimtar nr. 1999, datë 21.12.2021 të invetarizimit fizik.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

10.2 Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit i ngritur nga titullari të marrë masa në vazhdimësi, që për çdo aktive të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, të mbajë procesverbale në vete, ku të përcaktohet shkaqet e daljes jashtë përdorimi të aktiveve, vlerën e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Procesi i invetarizimin është zhvilluar në fund të vitit 2021. Relacioni nr. 2050 prot., datë 2021 "Mbi vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit" i bazuar në Raportin Përfundimtar nr. 1999, datë 21.12.2021 të invetarizimit fizik.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

11. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se Spitali Psikiatrik Vlore ka dërguar shkresën nr. 351 prot. datë 15.02.2019 në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, për nevojat e parashikuara për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, impjantistikës, pajisjeve të zyrave dhe hotelerisë për një periudhë 24 mujore me situacionin përkatës. Situacioni përkatës për punimet e nevojshme është hartuar dhe firmosur nga punonjësi A. L. me profesion teknik i mesëm. Nga auditimi konstatohet se kërkesa e dërguar për mirëmbajtjen nuk është e argumentuar, konkretisht: -nuk përcaktohet se në cilat godina do kryhet riparimi si dhe gjendja aktuale e këtyre godinave (volumet e punimeve të shoqëruara me vizatimet dhe planimetritë e tyre, fotografi, etj.). -nuk ka gjurmë që vërteton kërkuesin dhe miratuesin për nevojën e kryerjes së këtyre punimeve; -mungon urdhri për caktimin e z. A. L. ose të një grupi pune për hartimin preventivit. Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 26. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*
11.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa, që në të ardhmen, për parashikimin e punimeve të nevojshme në mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore të kryejë një vlerësim dhe dokumentim real të tyre, nisur nga fakti i amortizimit të madh të këtyre objekteve.

Në vijimësi
Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Në fillim të procedurës së prokurimit "Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore" ka nisur me:
- Kërkesa e kryeinfermjerëve.
- Nxjerrja e urdhërit nr. 115, datë 23.06.2021 "Për konstatimin në terren të këresave ...."
- Dorëzimi i procesverbalit të komisionit
- Miratim i Drejtorit për fillimin e procedurës
- Etj.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për kontratën e zbatimit nr. 34 me objekt *"Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019"* me nr. 1842/1 prot. datë 15.10.2019 konstatohet se Formulari i Garancisë së Kontratës nr. 0002494 datë 15.10.2019 lëshuar nga kompania e sigurimit "S. I." ka afat deri më datë 15.10.2020. Afati i përfundimit të kontratës është 24 muaj, datë përfundimi 15.10.2021. Kontrata me objekt *"Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019"* nuk është e mbuluar me garanci gjatë gjithë kohës së zbatimit të saj e cila e krijon risk për AK në rast të mosplotësimit të detyrimeve kontraktuale nga sipërmarrësi. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 24, pika 1 dhe 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*
12.1 Rekomandimi: SPV të kërkoj nga sipërmarrësi i punimeve BOE "E. B." ShPK dhe "A." ShPK sigurimin e kontratës deri në afatin përfundimtar të saj.

Menjëherë
Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Kontrata ka përfunduar në 15.10.2021, përpoara ardhjes së RP të auditimit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, ku për procedurën me objekt *"Kërkesë për propozim" me objekt: " Mirëmbajtje e kaldajave, kondicionerve dhe cillerave" për vitin 2017,2018,2019; procedurën me objekt " Mirëmbajte e objekteve ndërtimore, impjanistikes, pajisjeve të hotelerisë"* për vitin 2018, 2019 si dhe procedurën me objekt *"Shërbimi i lavanderisë dhe zëvendësimi me inventar të imët"* nga dokumentacionit i vendosur në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se në hartimin e dokumenteve të tenderit janë vendosur kritere jo ne përputhje me objektin e prokurimit dhe disa kritere nuk jane argumentuar në kundërshtim me ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratat për punë publike " Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit të marrë masa ku kriteret e vendosura për plotësimin e dokumenteve standard të tenderit, të hartohen në mënyrë jo diskriminuese apo orientuese në mënyrë që të sigurojë trajtim të barabartë për OE duke nxitur pjesëmarrjen dhe konkurencës ndërmjet tyre. AK duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj OE.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 181, datë 25.10.2021 rekomandimi është pranuar dhe përcjell për zbatim në sektorin përkatës. Do verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën 2017-2020 dhe 2020 në hartimin e dokumenteve të tenderit në urdhrin e ngritjes së njësisë së prokurimit dhe KVO miratuar nga Titullari i Institucionit u konstatua se nuk ka të përcaktuar person përgjegjës (Kryetar) i cili është përgjegjës për organizimin e punës dhe mirëfunksionimin e komisioneve në kundërshtim me nenin 57, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar "*Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Nga Titullari i SPV ose personi i autorizuar prej tij te merren masa ku, për çdo procedurë prokurimi në përbërjen të njësisë së prokurimit apo Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit të përcaktojë personi përgjegjës të grupit (Kryetar grupi).

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: U vendosën disa urdhëra për ngritje komisionesh do ka të përcaktuar kryetarin e grupit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje për periudhën objekt auditimi u përzgjodhën disa urdhër shërbime për shpenzime udhëtime e dieta, nga ku konstatohet se ***në të gjitha rastet nuk është evidentuar qëllimi i shërbimit,*** pavarësisht se këto shërbime janë kryer me autorizim të titullarit në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit", i ndryshuar, kreu V, pika 2, me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, kreu III, pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Institucioni në bashkëpunim me sektorin e Hotelerisë të marrë masa ku për çdo udhëtim të planifikuar dhe autorizuar nga NA, te plotësohet ne mënyre shkresore

kërkesa e argumentuar nga personi përgjegjës, ku të citohet data e kërkesës, arsyeja e lëvizjeve të planifikuara si dhe ditët e qëndrimit.
Sektori i financës të marrë masa në plotësimin e dokumenteve justifikues shkresore që argumentojnë lëvizjet e punonjësve, para likuidimit të tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

16. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstatoi se për automjetin tip Mercedez-Benz me targa VL 8505 B janë kryer shpenzime për të dy vitet e fundit 2019 dhe 2020 në shumën 156,400 lekë (124,100 lekë për vitin 2019 dhe 32,300 lekë për vitin 2020). Ndërsa vlera e mbetur e automjetit është ne 32,000 lekë.
Për Autoambulancën tip Volsëagen 70x Multivan me targa VL 9512 B janë kryer shpenzime për të dy vitet e fundit 2019 dhe 2020 në shumën 261,300 lekë (124,100 lekë për vitin 2019 dhe 137,200 lekë për vitin 2020). Ndërsa vlera e mbetur e autoambulancës ne vitin 2020 është në 119,253 lekë.
Shpenzime të cilat janë në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efiçencës, ***pasi kostoja e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjetit tejkalon vlerën e mbetur te tyre.*** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*
16.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues (NA) të marrë masa për ngritjen e një komisioni me ekspertë të fushave, për artikujt respektive, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të tyre, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi I vlerës së makinave. Mbi bazën e aktivit të rivlerësuar, institucioni të realizoje regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 186, datë 29.10.2021 është pranuar dhe përcjell për zbatim rekomandimi sektorit përkatës. Në fund të vitit 2021 është llogaritur vlera e automjeteve pas amortizimit përkatës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020, me autorizimin nr. 80/9 prot. datë 27.03.2020, nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara si Organ Qendror Blerës, pas përfundimit të procedurës së prokurimit "*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë,* ka autorizuar SPV të lidhi kontratën me OE "shpallur fitues "S.-A." me ofertë ekonomike **166,021,272** lek pa TVSH. SPV ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 13, datë 03.04.2020, me objekt "*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë,* për periudhën 4 vjeçare 03.04.2020-03.04.2024, me vlerë të pritshme të parashikuar **166,856,450.4** lekë pa TVSh, me operatorin ekonomik "S.-A." SHPK.
- Nga titullari i AK dh OE "C. F." shpk është lidhur kontrata nr. 24, datë 20.07.2020 "*Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të SPV Vlorë*" me afat 20.07.2020-31.12.2020 në vlerën 6,394,248.2 lekë pa TVSH (7,673,097.84 lekë më TVSH), si dhe kontratën nr.48, datë 30.12.2020, me afat 30.12.2020-31.12.2021 ne vlerën 14,775,887 lekë pa TVSH (17,731,064.40 lekë më TVSH).
- Nga titullari i AK dh OE "A." shpk është lidhur kontrata me nr. 43, datë 30.12.2020 "*Shërbim Lavanderie dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV*" për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 me fond limit në vlerën 26,546,722.85 lekë pa TVSH.
Në tre kontratat e sipërpërmendura në pikën "Vlera e Kontratës" citohet se..." *Palët bien dakord që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të* ***periudhës së mëparshme*** *dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen*",

Në bazë të këtij neni të kontratës së pranuar mes palëve, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, duke cënuar parimin e sigurisë juridik, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë*" në neni 105 "*Efektet prapavepruese*", si dhe të VKM-së nr. 914/14 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", në nenin 9 "*Llogaritja e vlerës së kontratës*" pika 2, si dhe me marrëveshjen kuadër të lidhur midis ABP dhe OE pika 1.4, ku citohet se "*Kontraktuesi nuk do të ketë të drejt kompensimi dhe nuk do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë.....*" e përcaktuar në kontratën "*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali". (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të SPV-së të marrë masa të menjëhershëm në ndryshimin e kontratës dhe përkatësisht në nenin ku citohet se".....*të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të* ***periudhës së mëparshme*** *dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen*", duke hequr togfjalëshin "*të* ***periudhës së mëparshme",*** me qëllim shmangien e krijimeve të dëmeve ekonomike të mundshme në të ardhmen.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Rekomandimi është zbatuar për kontrata e vitit 2021 dhe 2022.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar.

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit ne terren i zbatimit të kontratës së shërbimit të lavandërisë u konstatua se, ndërrimi si dhe ripërtëritja e materialeve të buta për nevoje të pacienteve të SPV nuk kryhej në kohë ashtu si dhe shume materiale të buta si, çarçafë, jastëk, kuverta te cilat janë domosdoshmëri e përditshme e pacienteve, si dhe detyrim nga OE për furnizimin e tyre referuar kontratës, ishin në gjendje të konsumuar në kundërshtim me Kontrata nr. 1 protokolluar me shkresën nr. 1589/32, datë 27.01.2020 "Draft marrëveshja kuadër, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për "*Shërbim Lavanderisë dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

18.1 Rekomandimi: Nga ana e përgjegjësve të materialit mbi ndërrimin dhe ripërtëritjen e materialeve, të kushtohet një vëmendje e veçantë mbi ndërrimin dhe shërbimin në kohë ndaj pacientëve, të cilët në mungesë të aftësive për ti kërkuar këto kushte, tu plotësohen nga punonjësit përgjegjës për kryerjen e shërbimit.

Grupi i monitorimit ngritur nga titullari i institucionit të marrë masa për realizimin e kontrolleve sistematike dhe në mënyrë vigjilente, me qëllim minimizimin e rasteve të cilat sjellin ndikim tek cilësia e shërbimit ndaj pacientit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me Urdhri nr. 178, datë 25.10.2021 është pranuar dhe përcjell për zbatim rekomandimi dhe relacionin nr. 1665/1, datë 02.11.2021 grupi i punës informon se janë marr masat për kontrolle periodike. Procesverbale kontrolli kryhen edhe nga Shefja e Hotelerisë, Nën Dr. Ekonomike.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

19. Gjetje nga auditimi: Në urdhër shpenzimet mbi likuidimin e shërbimit të kontratës "Shërbim Lavanderie" konstatohet se proces verbalet e mbajtura nga komisioni i monitorimit të kontratës dhe subjektit, artikujt janë të shënuar në copë pa peshën specifike të secilit artikull, çka sjell mos evidentim të peshave përkatëse për secilën nga produktet me totalin e shënuar në procesverbalin e likuidimit të shërbimit, firmosur nga OE dhe AK në kundërshtim me *Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik" i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Nga ana e përgjegjësve të materialit për secilin pavijon si dhe shefit të hotelerisë, të merren masa që ne procesverbalin ditor si dhe në përmbledhjen mujore, të

shkruhet sasia dhe pesha përkatëse për çdo artikull, pas peshimit te secilit nga produktet e tërhequra nga lavanderia, me qëllim përcaktimin e saktë mbi vërtetësisë dhe rakordimin me tabelën përmbledhëse mujore, si dokument justifikues dhe argumentues për likuidimin e shërbimit. Struktura përgjegjëse për financat përpara se të kryej likuidimin duhet të kontrollojë dokumentet shoqërues justifikues në lidhje me produktin apo shërbimin e kryer.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Në procesverbalin ditor shkruhet rregullisht sasia dhe pesha për çdo artikull, pas peshimin dhe tërheqjes nga lavanteria. Do verifikohet praktika në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

20. Gjetje nga auditimi: SPV ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 13, datë 03.04.2020, me objekt "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, për periudhën 4 vjeçare 03.04.2020-03.04.2024, me vlerë të pritshme të parashikuar **166,856,450.4** lekë pa TVSh, me operatorin ekonomik "S.-A." SHPK. Nga auditimi u konstatua se fondi limit i autorizuar sipas ABP, për ofertën ekonomike të shpallur fituese OE "S.-A." shpk për periudhën 4 vjeçare nuk është i njëjtë me fondi limit të caktuar në kontratën që SPV me OE kanë lidhur, me një diference **prej 835,178.40** lekë në kundërshtim me VKM-në nr. 914/14 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" në nenin 47, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

<u>20.1 Rekomandimi</u>: Nga Titullari i Institucionit të merren masa në ri-ndryshimin e vlerës së lidhur të kontratës për shërbimin e Kateringut me OE, ku ne zbatim të procedurës së kryer nga organi qendror Blerës për këtë shërbim, të lidhet nënkontrata ne vlerën 166.021.272 lekë e cila është oferta ekonomike e shpallur fitues dhe jo në vlerën 166,854,450.4 lekë, e cila përfaqëson fondin e përgjithshëm.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Është firmosur Amendimi i Kontratës nr. 1686, datë 27.10.2021.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Referuar konstatimeve mbi zbatimin e kontratës së lidhur midis AK dhe OË për "Shërbimin Katering", grupi i auditimi konstatoi se një pjesë e kushteve të kontratës nuk janë zbatuar, kushte të cilat nën gjykimin e grupit të auditimit përbejnë themelin e krijimit të kësaj kontrate si dhe ofrimi i një shërbimi, i cili është jetik për pacientët në kundërshtim me kontratën nr. 13 prot me nr. 692 datë 03.04.2020 "*Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Spitalin Psikiatrik, Vlorë*. Nga grupi i auditimit u konstatua se grupi i monitorimit, mbante proces verbale në formë tabelare vetëm në lidhje me numrin e pacientëve dhe numrin e ofrimit të racioneve ditore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).

<u>21.1 Rekomandimi</u>: Titullari i Institucionit të SPV si dhe grupet e ngritura nga Titullari për monitorimin e kontratës "Shërbimit Katering", te marrin masa të menjëhershme për shërbimin e ushqimit, si një shërbim jetik për pacientët i cili duhet të kryhet në standardet dhe kushtet e përcaktuara në kontratë.

Grupi i monitorimit të marrë masa të realizojë kontrolle të herëpashershme, ne lidhje me cilësinë e ushqimit si dhe shërbimit duke mbajtur proces verbale të trajtuara në mënyre narrative në lidhje me konstatimet apo jo te tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

22. Gjetje nga auditimi: Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", nuk ka funksionuar, pasi ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë, ndërsa punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion. Spitali Psikiatrik nuk ka miratuar dhe as depozituar "Deklaratën dhe Raportin Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për asnjë nga vitet 2017,2018,2019 dhe 2020" në kundërshtim me neni 18, të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).*

22.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues për çdo vit duhet të përgatisë deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në të cilin ai deklaron se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomik ashtu si dhe të trajtojë dobësitë e sistemit të kontrollit e planet për trajtimin e tyre. Gjithashtu Nëpunësi Autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi tek NPA në MF. NA të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe i raportojnë NA, sipas shkallës hierarkike, deri te NA i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Nuk ka gjetur zbatim
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar

23. Gjetje nga auditimi: Nga SPV nuk është hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike plani strategjik për periudhën objekt auditimi pra praktikisht plani strategjik 2017-2019, 2018-2020, 2019-2021 si dhe plani strategjik 2020-2022**,** i cili përmban objektivat strategjikë, prioritetitet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndërsektoriale, veprim ky në kundërshtim me nenin 9, i ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).*

23.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa në krijimin e Planit Strategjik i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se me gjithë ndryshimet strukturore që Spitali psikiatrik ka pasur në pozicione të reja apo sektorë të ndryshëm, ka vazhduar të funksionojë me të njëjtën rregullore dhe konkretisht me rregulloren e brendshme të miratuar nga Drejtori i Spitalit me urdhrin nr. 11 datë 10.10.2013. Kjo sjell mos pasqyrimin e detyrave funksionale dhe përgjegjësitë për secilin punonjës sipas funksionit që ka, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar.
Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa për ndryshimin e rregullores së brendshme, duke reflektuar ndryshimet përkatëse, për të ndihmuar anëtarët e institucionit të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, si

dhe të njihen me të drejtat dhe detyrimet të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre. Gjithashtu, institucioni të marrë masa ku pas hartimit te rregullores, miratimi i saj të kryhet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Procesi i hartimit të rregullores nuk ka përfunduar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces.

25. Gjetje nga auditimi: Referuar ndryshimeve të strukturës së miratuar nga MSH, me shkresën nr.2269/. datë 26.04.2018 "Struktura Organizative e SPV Vlorë", është shtuar pozicioni i Nën Drejtor Ekonomik dhe nga ku sektori i financës ka kaluar në varësi direkte të tij.
Si rezultat i ndryshimit të strukturës, nëpunësi zbatues i institucionit (SPV) duhet të emërohet, *Nëndrejtori Ekonomik i cili është në varësi direkte nga (NA) Titullari i institucionit. Shefi i sektorit të financës i cili aktualisht është emëruar si NZ është në varësi direkte të zv. Drejtorit Ekonomik dhe jo nga Titullarit i Institucionit, në kundërshtim me* Nenin 12 i ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).*
25.1 Rekomandimi: Nëpunësi autorizues në të gjitha nivelet e njësisë publike në fushën e MFK-së kanë përgjegjësi ***caktimin dhe shkarkimin*** e NZ. Shkarkimi i NZ kryhet vetëm pas marrjes së mendimit paraprak nga NPA në rastet e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve. Titullari i Inastitucionit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të marrë masa në saktësimin dhe emërimin konform ligjit për Nëpunësin Zbatues.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 10365/1, datë 21.06.2022 të MFE është refuzuar caktimi i Nën Drejtorit Ekonomik si NZ pasi ai nuk është drejtues i strukturës së financës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar.

26. Gjetje nga auditimi: a. SPV për asnjë nga vitet objekt auditimit, ***nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit***, e cila duhet të përgatitet nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NZ për garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi si dhe përgjegjësi e NA për miratimin e saj. Gjurma e auditimi është një instrument i cili jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.
b. Grupi i auditimit konstatoi se edhe pse është ngritur GMS për vitin 2019-2020, nuk ka asnjë proces verbal të mbajtur për takimet e kryera, apo për problematikat e trajtuara duke konkluduar se nuk është kryer asnjë mbledhje e GMS, veprim ky në kundërshtim me pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr. 16 datë 16.07.2016 "*Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Kordinatorit të Meanxhimit Financiar.....*"
c. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues si dhe menaxherët e tjerë te institucionit, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 15 "Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave", si dhe Kapitulli III "Delegimi i detyrave", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, *institucioni nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e* dokumentimit *të tyre*
d. Nga auditimi u konstatua se SPV *nuk ka program specifike për trajnimin* e punonjësve të administratës i cili duhet të përgatitet çdo fillim viti mbi nevojat për trajnim për secilin nga Drejtoritë apo Sektorët si dhe duke përgatitur në fund të çdo viti planin mbi realizimin e

trajnimeve nga punonjësit e institucionit, fakt ky i cili nëse do të ishte realizuar, punonjësit nuk do të kishin mangësi të thella në njohuritë mbi te drejtat dhe detyrimet te cilat lindin nga ligji i MFK, por dhe jo vetëm.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).*

26.1 Rekomandimi: NA në bashkëpunim me NZ të marrin masa në hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimin në mënyrë që të sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Pazbatuar

26.2 Rekomandimi: Nëpunësi autorizues, gjatë mbledhjeve të GMS të marrë masa mbi mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, mbi problematikat e trajtuara nga anëtarët e grupit të GMS, më qëllim dokumentimin e tyre.

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion dokumentat e mbledhjes së 22.01.2022.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

26.3 Rekomandimi: Sektori i burimeve njerëzore për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve duhet të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1707 prot., datë 29.10.2021 i është kërkuar ministrisë organizimi i trajnimeve

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

26.4 Rekomandimi: Gjithashtu NA ne bashkëpunim me NZ të marrin masa në hartimin dhe miratimin lidhur me delegimin e kompetencave në rregulloren e brendshme duke trajtuar delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre

Menjëherë dhe në Vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me miratimin e Rregullores së re do të gjej zbatim.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve te prokurimit për periudhën objekt auditimit në të gjithë rastet, dosjet nuk janë te inventarizuara dhe nuk janë arkivuar, por janë mbajtur në zyrat e specialistes se prokurimeve të institucionit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

27.1 Rekomandimi: Nga njësia e prokurimit te merren masa të menjëhershme për inventarizimin dhe arkivimin e te gjitha dosjeve të prokurimeve publike te përfunduara për vitin 2017,2018,2019 dhe 2020 si dhe për procedurat ne vijimësi

Menjëherë dhe në Vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion dokumentacion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Pazbatuar

28. Gjetje nga auditimi: Spitali Psikiatrik i Vlorës kryen procedurë prokurimi (blerje e vogël) çdo vit (viti 2017,2018,2019,2020) për "Evadimin e Mbetjeve Urbane". Nga auditimi u konstatua se koshat e vendosur nga Bashkia e Tiranës ndodhen afër ambientit të SPV, me pozicion në rrugën kryesore ku dhe është ndërtesa e Spitalit, nga ku referua kontratës së lidhur

nga Bashkia me operatorin ekonomik, kryhet pastrimi i mbetjeve urbane të zonës, por referuar shkresës së Bashkisë, SPV nuk përfshihet në këtë kontratë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

28.1 Rekomandimi: Spitali Psikiatrik në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës të marrë masa ku për pastrimin e Mbetjeve Urbane e cila kryet si procedure prokurimi nga SPV, dukë qenë së ky shërbim kryhet nga Bashkia e Tiranës (por SPV është e përjashtuar), gjatë kalimit në rrugën urbane "Reshat Osmani", të bëjë mbledhjen edhe të mbetjeve urbane të spitalit, në funksion të mire menaxhimit dhe përdorimit me efikasitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në Vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 832, datë 21.04.2022 SPV i është drejtuar Bashkisë Vlorë. Në pritje të përgjigjes.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

29. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga ngrupi i mëparshëm i auditimit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është relativish i ulët, tajtuar si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 9 masa organizative, të cilat, janë zbatuar 2 zbatuar pjesërisht 1, në proces 5 dhe janë pa zbatuar 1.
- Masa për shpërblim dëmi janë lënë 14 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar pjesërisht 2, në proces 12.
- Masa për eliminimin e efekteve negative 3E janë lënë **7** rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 2, në proces 1 dhe pazbatuar 4.
- Janë rekomanduar 6 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;
- -4 masa disiplinore nuk janë zbatuar , 2 masë disiplinore janë zbatuar.
- -Sipas Statusit të Nëpunësit Civil janë lënë 0 masa disiplinore
- -Sipas Kodit të Punës, janë lënë 6 masa disiplinore e përkatësisht 4' *vërejtje me shkrim*' deri në '*largim nga puna'* dhe 2 masa '*largim nga puna'*.

29.1 Rekomandimi: Nga Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë *rikërkojmë,* zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, rezultuan të pazbatuara si dhe për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen *të zbatuara pjesërisht* ose *në proces zbatimi,* inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

Menjëherë dhe në Vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Nuk u vendos doumetacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatar

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE "A." ShPK për kontratën bazë nr. 26, datë 29.03.2016 *"Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik"* rezulton se nga SPV janë likuiduar në favor të subjektit "A." ShPK vlera prej 2,245,711 lekë, si rrjedhojë e rivlerësimit të çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke i dhënë akteve fuqi me efekt prapaveprues, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë" në neni 105 "Efektet prapavepruese". Vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese. Pikat 2.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar

për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 2.2* e Kontratës Tip dhe as ndonjë *dispozitë tjetër ligjore* nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerën **2,245,711 lekë me TVSH** nga sipërmarrësi "A." Shpk, e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit të periudhave paraardhëse.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1673, datë 25.10.2021 SPV ka informuar operatorin. Me shkresën nr. 1673/1, datë 28.10.2021 OE ka kthyer përgjigje. Me shkresën nr. 429, datë 24.02.2022 është bërë padia.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2. Gjetje nga auditimi: Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE "S. A." shpk për kontratën bazë nr. 568, datë 30.04.*2013 "Shërbim kateringu për "Spitalit Psikiatrik" Vlorë* rezulton se nga SPV janë likuiduar në favor të subjektit "S. A." ShPK vlera prej 3,216,180 lekë, si rrjedhoje e rivlerësimit të çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke i dhënë akteve fuqi me efekt prapaveprues. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë" në neni 105 "Efektet prapavepruese". Vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese. Pikat 4.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 4.2* e Kontratës Tip dhe as ndonjë *dispozite tjetër ligjore* nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerës **3,216,180 lekë me TVSH** nga sipërmarrësi "S. A." ShPK, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin e shërbimit të periudhave paraardhëse.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1671, datë 25.10.2021 SPV ka informuar operatorin. Me shkresën nr. 1671/1, datë 28.10.2021 OE ka kthyer përgjigje. Me shkresën nr. 425, datë 24.02.2022 është bërë padia.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

3. Gjetje nga auditimi: Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE "S. A." shpk për kontratën bazë nr. 77/13, prot. datë 08.04.2016 "*Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik"* rezulton se nga SPV janë likuiduar në favor të subjektit "S. A." ShPK vlera prej **1,686,701** lekë, si rrjedhoje e rivlerësimit të çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke i dhënë akteve fuqi me efekt prapaveprues. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë" në neni 105 "Efektet prapavepruese". Vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese. Pikat 2.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 2.2* e Kontratës

Tip dhe as ndonjë *dispozite tjetër ligjore* nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerës **1,686,701 lekë me TVSH** nga sipërmarrësit "S. A." ShPK, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit te periudhave paraardhëse.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1672, datë 25.10.2021 SPV ka informuar operatorin. Me shkresën nr. 1672/1, datë 28.10.2021 OE ka kthyer përgjigje. Me shkresën nr. 423, datë 24.02.2022 është bërë padia.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

4. Gjetje nga auditimi: Nga Spitali Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë janë likuiduar për zërin e shërbimit "*Pastrim i brendshëm*", sipërfaqe të brendshme prej 218.5 m^2 që disponohen nga SPV, por që janë dhënë me qera. Nga periudha 01.03.2017 deri me 13.07.2020 në lidhje me zbatimin e kontratës "*Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë* konstatohet se SPV ka paguar OE "S. A." ShPK për "Pastrim i brendshëm" të ambienteve të dhëna me qira, ku për pastrimin e këtyre sipërfaqeve duhej të përgjigjeshin vetë qiramarrësit, në **vlerën prej 1,767,275 lekë me TVSh** duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e shtetit** përkatësisht për ambientin**:** a. *Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m^2* në vlerën 715,807 lekë me TVSh dhe për b) *Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m^2* **në vlerën** 1,051,469 lekë me TVSh.

1.1. Nga auditimi i zbatimit të kontratës "*Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë* konstatohet se për zërin "Pastrim i brendshëm " çdo muaj nga periudha 01 Mars 2017 deri më 20.07.2020 është paguar për sipërfaqen 7354 m^2. Në kontratën e lidhur midis AK dhe OE, si dhe në DT është përcaktuar se sipërfaqja "Pastrim i brendshëm" është në sasinë 7,347 m^2, çka rezulton me një tejkalim të kontratës prej 7m^2. Nga SPV për këtë periudhë ka paguar OE "S.-Al" shpk më tepër për vlerën 47,181 lekë pa TVSh (56,618 lekë me TVSH) duke shkaktuar **dëm ekonomik buxhetit të shtetit,** veprime këto në kundërshtim me kushtet e kontratës së lidhur midis OE dhe AK, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimet publike*" i ndryshuar, neni 59 dhe neni 6060, pika 1, e cila përcakton se: "*Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese". (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerës **1,814,456 lekë me TVSH** nga sipërmarrësit "S.A." ShPK, për vlerën e përfituar padrejtësisht "Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme" të cilat janë dhanë me qira, si dhe të tejkalimit të sipërfaqes së pastrimin përtej kushteve të kontratës dhe Dokumentet e Tenderit (DT).

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1670, datë 25.10.2021 SPV ka informuar operatorin. Me shkresën nr. 1670/1, datë 28.10.2021 OE ka kthyer përgjigje. Me shkresën nr. 421, datë 24.02.2022 është bërë padia.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

5. Gjetje nga Auditimi: Spitali Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë për periudhën 20.07.2020 deri me 31.01.2021 në lidhje me zbatimin e kontratës "*Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë* konstatohet se ka paguar

OE "C.E." shpk për "Pastrim i brendshëm" të ambienteve të dhëna me qira, prej 218.5 m^2, ku për pastrimin e këtyre sipërfaqeve duhej të përgjigjeshin vetë qiramarrësit, në **vlerën prej 201,894 lekë me TVSh** duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e shtetit** përkatësisht për ambientin a. *Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m^2* në vlerën **81,774 lekë me TVSh** dhe *b. Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m^2* në vlerën 120,120 lekë me TVSh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerës **201,894 lekë me TVSH** ndaj sipërmarrësit "C.E." ShPK, për vlerën e përfituar padrejtësisht për "Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme" të cilat janë dhanë me qira.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1678, datë 25.10.2021 SPV ka informuar operatorin. Me shkresën nr. 421, datë 24.02.2022 është bërë padia.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për kontratën me objekt *"**Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore në Spitalin Psikiatrik 'Ali Mihali' Vlorë",*** të lidhur midis Spitalit Psikiatrik Vlorë dhe BOE "E.B." dhe "A." ShPK, nr. 34/nr.1842/1 prot. datë 15.10.2019 me vlerë 4,380,000 lekë pa TVSH ose 5,256,000 lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 24 muaj si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të komisionit të mbikëqyrjes së kontratës rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt si dhe të kryera jo sipas specifikimeve teknike, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën **159,400 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa për kryerjen e punime brenda afatit të kontratës dhe garancisë së tyre në shumën **159,400 lekë pa TVSH,** e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve ndaj kontraktorit BOE "E. B." dhe "A." ShPK me Nr.34/Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1679, datë 25.10.2021 SPV ka informuar operatorin. Nuk ka veprime të mëtejshme.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se KVO ka s'kualifikuar në mënyrë të padrejtë OE me ofertë me të ulët, veprim ky në kundërshtim me *ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar neni 1 "Objekti dhe qëllimi pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c),neni 41 pika 1, Neni 46, Neni 53 pika 4, Neni 55 pika 2. VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, I Ndryshuar, Kreu III neni 10 si dhe neni 66 pika 3*,nga ku konkretisht:

- ***Procedurës së prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt: "Mirëmbajtja e kaldajave, kondicionerëve dhe cillerave" e hapur me date*30/03/2018.**

Nga shqyrtimi i dokumenteve ne SPE konstatohet se OE ka paraqitur një kontrate shërbimi te lidhur me një ent publik, kontrata është lidhur me nr.3476/1 prot date 14.08.2015 midis Qendrën Spitalore "Nene Tereza" dhe BOE "C." shpk dhe "A. konstruksion". Ne kontrate citohet se 95% te shërbimit do ta kryej "C." shpk ndërsa 5% "A. konstruksion". Ndërkohe me

shkrese nr.2720/1 prot date 20.05.2016 ku citohet Vërtetim për realizimin e kontratës: Kontrata është realizuar në vlerën 1,018.850 lek pa tvsh dhe 1,222.620 lek me tvsh shkresa është firmosur nga titullari i QSUT me kërkesë te OE. Tek specifikimet teknike citohet: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjate viteve 2015, 2016, 2017 te aktivitetit financiar shërbime te ngjashme me objektin e këtij prokurimi në vlerën 40% të vlerës së fondit limit. Sasia e punimesh prej 95% te kryera nga ku OE vërteton shërbimet e ngjashme të kryera në masën 40% të vlerës së fondit limit. Kjo vendimmarrje ka çuar në s'kualifikim e OE me vlerë më të ulet i cili do ti kursente buxhetit të shtetit vlerën ***27,000*** **lekë**, diferencë midis OE të shpallur fitues dhe OE te s'kualifikuar me ofertë më të ulët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

- ***Procedura e prokurimit "E hapur" me objekt: "Shërbimi i lavanderisë dhe zëvendësimi me inventar te imët", e hapur me date 26.09.2019.***

Komisioni i vlerësimit të ofertave e ka skulifikuar pa të drejtë OE "U. S." me ofertë më të ulët për pikat .

1. Mungese deklarate për paraqitjen e ofertës se pavarur, sipas shtojcës 1/1.

2. Ofertuesi ka paraqitur certifikata ISO ne gjuhe te huaj, te pa përkthyera ne gjuhen shqipe.

Përkatësisht për pikën e parë pavarësisht se nga Njësia e hartimit të dokumentave standard është kërkuar tek kriteret e veçanta Shtojca 1/1, por nga auditimi rezultoi se ne dokumentat e tenderit nuk gjendet e bashkangjitur kjo shtojce si pjesë përbërëse e dokumentave standarde, fakt i cili nga KVO është trajtuar si arsye skualifikimi për OE.

Ndërkohe për pikën e dytë konstatojmë se ISOT janë hedhur në Sistemit Elektronik të Prokurimeve por nuk janë të përkthyera ne gjuhen shqipe, por theksojmë se ISOT janë certifikata ndërkombëtare dhe në to mund të përkthehet vetëm numri i ISOS. Referuar nenit 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar i cili citon se: "*Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj*" nga grupi i auditimit është gjykuar së ky është një devijim i vogël i cili nuk prek themelin e procedurës. Kjo vendimmarrje ka çuar në skualifikim e OE me vlerë më të ulet i cili do ti kursente buxhetit të shtetit vlerën **14,985,160** lekë, diferencë midis OE të shpallur fitues dhe OE te s'kualifikuar me ofertë më të ulët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

7.1 Rekomandimi: Nga SPV të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 15,012,160** lekë, nga Komisionet e Vlerësimit si dhe grupi i punës, për skualifikim të padrejtë të OE me ofertë me të ulet të përcaktuar si më poshtë vijon:

1.Procedurës së prokurimit "Kërkese për propozim" me objekt: "Mirëmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave" **arkëtimi i *vlerës 27,000 lekë*** *nga* Znj.S. N., Znj.M. C., Z. E. B. dhe ish titullari i AK z. K. Ll.

2.Procedura e prokurimit "E hapur" me objekt: "Shërbimi i lavanderisë dhe zëvendësimi me inventar te imët" **arkëtimi i vlerës 14,985,160**.

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1580, datë 06.10.2021 Vendimi i Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

8. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Kërkesë për propozim" me objekt: "*Evadimi i mbetjeve urbane", për vitin 2017,2018,2019, u konstatua se për pikën 2 "Sipërfaqe fshirëse për 2 pika ($2*20m^2$)" dhe pikën 3 "Disinfektim për 2 pika (1*2)", të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt "Shërbimi i pastrimit të

brendshëm dhe të jashtëm" në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik "S.a.", me kontrate shërbimi nr.11 nr.77/13 prot., datë 08.04.2016 dhe nr.11 nr549/10 prot date 13.03.2020. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtme brenda territorit te spitalit psikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim te jashtëm janë te gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te kuptojmë te gjithë sipërfaqen e hapësirës rreth e përqark godinave (Objekt ndërtimi) qe aktualisht janë ne funksion te këtij spitali. O.E do te pastroj çdo dite gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here ne dite, OE kryen larjen e rrugëve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para orës 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne çdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për ne vend grumbullimin e plehrave behet çdo dite, transporti behet me kosha te mëdhenj, te posaçëm, te mbyllur me kapak.*
Gjithashtu për vitin 2018 dhe vitin 2019 janë kryer nga një procedurë për secilin vit, shtesë kontrate "Evadim i mbetjeve Urbane", nga ku vlera e likuiduar për vitin 2018 është 232,943 lekë si dhe vlera e likuiduar për vitin 2019 është 76,933 lekë.
Për vitin 2020 nga auditimi i procedurës blerje e vogël "Evadimi i mbetjeve urbane" për piken 2 "Sipërfaqe fshirëse për 2 pika (2*20m^2)" dhe piken 3 "Disinfektim për 2 pika (1*2)", të dyja janë mbivendosje kontratës me objekt "Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm" në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me te cilën operon Operatori Ekonomik "S.-a.", me kontrate shërbimi nr.11 nr549/10 prot., datë 13.03.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **783,244.37 lekë**, nga ish-titullari z. K.Ll., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali"Vlorë".

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1675, datë 25.10.2021 është kryer njoftimi i K. L.. Ska veprime të mëtejshme.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar

8.2 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **30,504 lekë**, nga ish-titullari z. K. Ll. dhe ish shefi i financës z. V. N. për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali"Vlorë".

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1676, datë 25.10.2021 është kryer njoftimi i V.N.. Me shkresën nr. 1676/1, datë 02.11.2021 ka kthyer përgjigje. Ska veprime të mëtejshme. Me shkresën nr. 1675, datë 25.10.2021 është kryer njoftimi i K. L.. Ska veprime të mëtejshme.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar

8.3 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 183,404 lekë**, titullari i Institucionit znj. O. G. dhe Shefja e financës znj. L. B. për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë".

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1674, datë 25.10.2021 është bër njoftimi dhe e shkresën nr. 1674/1. Me Urdhër nr. 71, datë 21.02.2022 dhe është kthyer përgjigje me nr. 436, datë 25.02.2022 nuk është pranuar rekomandimi.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i kartelave të automjeteve ku pasqyrohen kilometrat e përshkruara dhe totali i litrave të harxhuara për udhëtimet e kryera, për periudhën 2018, 2019 dhe 2020, rezultoi se sasia e karburantit të harxhuara dhe të evidentuar në këto kartela shoqëruar me fletë udhëtimet nuk korrespondon me sasinë e evidentuar në sistemin e kartave elektronike të karburanti, duke mos pasqyruar vlerën reale të sasisë së konsumuar.
Nga përllogaritja e litrave të karburantit të konsumuar për një nga automjetet (me targe VL8505B) u konstatua se ne sistemin elektronik të karburantit janë hedhur me shume litra, sesa sasia e konsumuar e karburantit të shënuar në fletët udhëtimit të automjeteve, i cili është dokument vërtetues për lëvizjet dhe kilometrazhin e automjeteve.
Për vitin 2018, nga përllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr ne karte elektronike te karburantit dhe flete udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diference hedhur me shumë në kartat elektronike prej 3410 litra * 147,985 lekë/litër = 504,629 lekë.
Për vitin 2019, nga përllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr ne kartën elektronike te karburantit dhe flete udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diference hedhur me shumë në kartat elektronike prej 11062 litra * 150,565 lekë/litër = 1,665,550 lekë.
Për vitin 2020, nga përllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr ne kartën elektronike te karburantit dhe flete udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diference hedhur me shumë në kartat elektronike prej 8979 litra * 147,894 lekë/litër = 1,327,940 lekë.
Nga përllogaritja e litrave të karburantit të konsumuar u konstatua se ne sistemin elektronik të karburantit janë hedhur me shume litra me një diferencë **në masën 23,451** litra, sesa sasia e konsumuar e karburantit të shënuar në fletët udhëtimit të automjeteve, i cili është dokument vërtetues për lëvizjet dhe kilometrazhin e automjeteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit.)*
9.1 Rekomandimi: Nga SPV të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,498,119 lekë**, si një përfitim i marrë padrejtësisht nga personat përgjegjës si dhe autorizues nga ish Titullari i AK z. K. Ll., Titullari i AK znj. O. G., ish magazinierja znj. E. P., ish shefi i financës z. V. N., znj. O. M., znj. E. M., znj. L. B. dhe z. Q. K..

Menjëherë

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Me shkresën nr. 1669, datë 25.10.2021 janë njoftuar personat përgjegjës. Me shkresën nr. 1669/1, datë 05.11.2021 kanë kthyer përgjigje. Me urdhërin nr. 240, datë 31.12.2021 "Evidentim dhe konstatim" dhe është kthyer përgjigje me shkresën nr. 692, datë 05.04.2022 ku nuk është pranuar konstatimi i KLSH.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar.

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave te prokurimit me vlerë te vogël për vitet 2017,2018,2019,2020 për procedurën me objekt prokurimi *Blerje e vogël "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh", "Mirëmbajte automjetesh dhe gjeneratorësh" për vitin 2018 si dhe* "*Mirëmbajtja e kondicionerëve, kaldajave dhe cillerave*" për vitin 2018 dhe vitin 2020 nga grupi i auditimit u konstatua se nuk verifikohet nevoja e kryerjes së shërbimeve për automjetet,

mungon gjurma e auditimit, kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara, nuk ka procesverbale të mbajtura për problemet e defekteve të këtyre automjeteve, nuk janë argumentuar dhe dokumentuar fakte se përse duhet të kryhet shërbimi ashtu si dhe nuk mund të përcaktohet preventivi i një shërbimi përpara se të ndodhë një defekt, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik" fakte të cilat kanë shkaktuar një shpenzim të realizuar nga AK pa efektivitet, ekonomicitet dhe eficente, referuar Pika 2, neni 1 i Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktuar ne vlerë janë si më poshtë vijon:
1. Procedura "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh" viti 2017 AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi në **vlerën 899,160** lekë;
2. Procedura "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh" viti 2018 AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi, kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një defekt ose avari, apo nevojë për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorëve **në vlerën 870,720** lekë.
3. Shtesë kontrate të "Mirëmbajtja e kondicionerëve, kaldajave dhe cillerave" viti 2018, shpenzimet për kryerjen e preventive të shërbimit të mirëmbajtjes së kondicionerëve, kaldajave dhe **cillerave në vlerën 345,600 lekë**, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi.
4. Blerje e vogël "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh" viti 2019 nga ku AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi **në vlerën 826,800 lekë**.
5. Blerje e vogël "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh" viti 2020 nga ku AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi **në vlerën 742,440 lekë.**
6. Blerje e vogël "Mirëmbajte kondicionerësh, frigoriferësh dhe rezistencash elektrike" viti 2020 nga ku AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi si dhe këto shërbime janë po te njëjtat shërbime dhe pjese qe ndërrohen çdo vite në **vlerën 905,880** lekë
7. Blerje e vogël "Mirëmbajte e sistemit qendror (ngrohës-ftohës)" viti 2020 AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi si dhe këto shërbime janë po te njëjtat shërbime dhe pjese qe ndërrohen çdo vit në **vlerën 899,880 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit.)*

1.1 Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë ***vlerën 5,490,480 lekë*** (me tvsh). Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë të konstatuara mbi shpenzime të kryera nga Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, gjatë procedurës se prokurimit për rastet e sipërpërmendura. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Menjëherë dhe ne vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar

1.2 Rekomandim: Nëpunëse Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të marrë masa ku për çdo nevoje të Spitalit, nga personat përgjegjës të behet analiza e nevojave të spitalit si dhe kërkesat e justifikuara me dokumentat plotësues për shërbimin/mallin e kërkuar.

Menjëherë dhe ne vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: 1.Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Kërkesë për propozim" me objekt: "Mirëmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave"* grupi i auditimi nga

dokumentet e hedhura ne SPE nga OE "C." konstatohet se Vërtetimi i realizimit të kontratës me një ent publik është origjinal. OE ka paraqitur një kontratë pune e lidhur me nr. 2738 prot., datë 20.12.2016 midis BOE "C." SHPK dhe Ministria e Integrimit Europian. KVO nuk duhet te s'kualifikonte OE pasi ai ka paraqitur vërtetim të realizimit nga një ent publik, por duhet ti kërkonte informacion në lidhje me kontratën mbi ndarjen e punimeve dhe do të vërtetonte shërbimet e ngjashme dhe kapacitetet e tij. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 2, neni 1 i Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; *VENDIM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 66 pika 3.* Referuar më sipër diferenca midis OE *"J. Z."* ofertuesi i shpallur fituese dhe s'kualifikimi i OE *"C*." me oferte me të ulët, është në mospërputhje me parimet e ***efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vlerën 74,928 leke me TVSh.*** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit.)*

2. Nga auditimit i procedurës së prokurimit "Me negocim, pa shpallje paraprake të kontratës me objekt: "Shërbimi i lavanderisë dhe zëvendësimi me inventar të imët", Skualifikimi i OE "U. S." me ofertë me të ulët është i pa drejtë pasi KVO duhet të kërkonte informacion për Certifikatat ISO që ka dorëzuar OE të cilat janë në gjuhe të huaj dhe janë përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, të cilat mbajnë vulën dhe firmën e përkthyeses në çdo faqe të dokumentacionit si dhe gjithashtu janë të noterizuara me vërtetim noterial të përkthimit te certifikatave ISO por në dokumentin e noterizuar nuk rezulton të jetë të shkruara të dhënat e noterit por këto dokumente përmbajnë pullën, firmën dhe vulën e tij si dhe numrin e repertorit dhe koleksionit në kundërshtim me pikën 2, neni 1 i Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; *VENDIM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 66 pika 3* . Referuar me sipër OE "A." diferenca midis ofertuesit të shpallur fituese dhe s'kualifikimi i OE "U. S." me oferte me te ulet, është në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vlerën 539,461 leke me TVSh.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit.)*

2.1 Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë ***vlerën* 614,389 *lekë*** (me TVSh). Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë të konstatuara mbi shpenzime të kryera nga Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, gjatë 2 procedurave të prokurimit. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Menjëherë dhe ne vijimësi

Qëndrimi i Spitali për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar

Me shkresën nr. 1452/1, datë 18.08.2022 (protokolluar në KLSH me nr. 600/28, datë 22.08.2022) janë paraqitur observacione për Aktkonstatimin nr. 1452/1 prot, datë 12.08.2022 që nuk janë trajtuar në Projektraport pasi kanë ardhur në KLSH pasi ishte përgatitur projektraporti nga grupi i auditimit. U morrën parasysh pretendimet në hartimin e raportit përfundimtar ku vetëm në një rast u soll dokumentacion shtesë.
Me shkresën nr. 1539/1, datë 03.10.2022, protokolluar në KLSH me nr. 600/67, datë 05.10.2022 keni paraqitur planin e masave të hartuar nga ana juaj mbi projektraportin e dërguar "Mbi zbatimin e rekomandimeve"
Dhe për një pjesë të rekomandimeve ju keni thënë që do të merren parasysh në të ardhmen, por statuasi i tyre nuk ndryshon deri në datën e hartimit të raportit përfundimtar të auditimit. Për sa i përket kundërshtimeve tuaja në lidhje me masat dëm ekonomik, ju sqarojmë edhe një here se:

Në këtë faze nuk mund të shqyrtohen dokmenta të cilat nuk kanë lidhje me zbatimin konkret të rekomandimevedhe të periudhave përpara ardhjes së raportit përfundimtar, të cilat janë shqyrtuar nga grupi i mëparshëm i auditimit.
Gjithashtu për personat / subjektet të cilat ju i keni njoftuar për detyrimet ka kaluar çdo lloj afafti për pritje përgjigje nga ana e tyre dhe duhet të vijohet me rrugën gjyqësore.

SPITALI RAJONAL DURRËS

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Spitalin Rajonal Durrës mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", SRD, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 184/11 prot., datë 08.11.2021, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
- Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 847/1 prot., datë 06.05.2022.

III. Rekomandimet e KLSH
Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 132/11 port., datë 15.10.2021 dhe në Spitalin Rajonal Durrës me nr. 184/9 prot., datë 18.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:
a. Janë rekomanduar **29 masa organizative**;
b. Janë rekomanduar **5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,198,100 lekë**;
c. Janë rekomanduar **12 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit.**
d. Janë rekomanduar **23 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Organizative	29	29	-	-
2	Shpërblim dëmi	5	5	-	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	12	12	-	-
4	Masa disiplinore	23	23	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e SRD

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	29	19	0	10	0
2	Shpërblim dëmi	5	3	0	2	0
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	12	1	-	8	3
4	Masa disiplinore	23	23	-	-	

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,

3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nr.	**Lloji i rekomandimit**	**Pranuar Plotësisht (numër)**	**Statusi i zbatimit**			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	29	19	0	10	0
2	Shpërblim dëmi	5	3	0	2	0
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	12	1	-	8	3
4	Masa disiplinore	23	23	-	-	

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 62%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", SRD, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 184/11 prot., datë 08.11.2021, Drejtori Ekzekutiv duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe*

funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 847/1 prot., datë 06.05.2022.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ligjshmërinë e vendimmarrjeve të Bordit të Spitalit Rajonal Durrës (BSRD) u konstatua:
- BSRD, gjatë vitit 2019 ka marrë 25 vendime gjithsej, nga të cilat 9 vendime i ka marrë në mënyrë qarkulluese dhe gjatë vitit 2020 ka marrë 19 vendime gjithsej të cilat i ka marrë të gjitha në mënyrë qarkulluese. Marrja e vendime qarkulluese nuk mundëson pasqyrimin e mendimeve dhe diskutimeve të secilit prej anëtarëve të bordit, në kundërshtim kjo me nenet 3; 8 dhe 11, të VKM nr.237, datë 12.04.2006 "Për disa ndryshime në VKM nr.560, datë 23.10.2000 "Për Miratimin e Projektit Pilot Për Përfshirjen e Spitalit të Durrësit në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor" dhe nenin 16, të rregullores së Bordit Drejtues.
- Po kështu, ky Bord në vitin 2019 nuk është mbledhur 4 herë por është mbledhur 3 herë, në kundërshtim kjo me nenin 8, të statutit të Spitalit Rajonal Durrës dhe me kërkesat e VKM nr.237, datë 12.04.2006.

1.1 Rekomandimi: Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që në respektim të rolit dhe detyrës si organi më i lartë ekzekutiv i SRD, të shmangë vendimmarrjen e vendimeve qarkulluese përveçse në rastet kur e ka të pamundur mbledhjen si dhe të pasqyrojë me transparencë diskutimin e anëtarëve të bordit gjatë vendimmarrjes, duke argumentuar çdo çështje në relacione shpjeguese dhe diskutime mbi këto vendime.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
SRD sqaron se nga ana e drejtorisë së SRD-së u morën masat dhe u zhvilluan mbledhjet e Bordit Drejtues ku u diskutuan në rend dite rekomandimet e KLSH. Lidhur me këtë rekomandim, Bordi Drejtues e ka vleresuar dhe për shkak të natyrës emergjente të vendimit ka marr vetem 1 Vendim Qarkullues gjatë vitit 2022 dhe janë zhvilluar 2 mbledhje deri me tani konkretisht me datë 10.03.2022 dhe datë 07.04.2022.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

2. Gjetje nga auditimi: Për sa i përket respektimit të strukturës organizative të Spitalit Rajonal Durrës konstatohet se për periudhën objekt auditimi, struktura është ndryshuar nga Bordi Drejtues i Spitalit, dymbëdhjetë herë. Këto ndryshime konsistojnë në lëvizjet e pozicioneve të punonjësve të spitalit, si në administratë dhe në stafin mjekësor. Këto ndryshime tregojnë se struktura organizative nuk është e mirë studiuar dhe e konsoliduar, duke krijuar kështu pasiguri dhe performancë të ulët lidhur me pozicionet e punës.
Sa më sipër bie në kundërshtim me misionin e Spitalit Rajonal Durrës: "Misioni i Spitalit Rajonal Durrës është të përmirësojë shëndetin e komunitetit duke ofruar një standard të ri në kujdesin shëndetësor, kujdesin klinik dhe ngritjen profesionale të mjekëve specialistë duke

siguruar një qendër mjekësore për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve."

2.1 Rekomandimi : Bordi Drejtues dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të analizojnë situatën e krijuar për shkak të ndryshimeve të shpeshta dhe të marrin masa lidhur me konsolidimin dhe unifikimin e strukturës të spitalit.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Ky rekomandim u shqyrtua në mbledhjen e Bordit me datë 07.04.2022. Me Vendimin Nr. 08 datë 07.04.2022 dhe Nr. 667 prot, datë 07.04.2022 u miratua Stuktura Organike dhe Organizative e Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

3.Gjetje nga auditimi : Nga auditimi konstatohet se nga Spitali Rajonal Durrës, janë dhënë 75 vërejtje gjatë vitit 2019 dhe 38 vërejtje gjatë vitit 2020. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk këto procedura nuk janë transparente, dhe nuk ka nuk ka komision apelimi për dhënien e masave disiplinore.
-Nga grupi i auditimit konstatohet se në Spitalin Rajonal Durrës, për vitin 2019 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 68 punonjës dhe për vitin 2020 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 79 punonjës.
-Referuar të dhënave të më sipërme rezulton se ndërprerja e marrëdhënieve të punës në pjesën më të madhe të rasteve është me arsyen "dorëheqje". Konkretisht nga numri total i të larguarve nga detyra në vitin 2019 (68 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 41% infermierë/laborantë dhe 25% mjekë. Kurse për vitin 2020 (79 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 31% infermierë/laborantë dhe 22% mjekë.
Po ashtu, referuar të dhënave për dhënien e masave disiplinore, nga grupi i auditimit konstatohet se për vitin 2019 (75 masa disiplinore në total), 60% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 8% mjekëve. Për vitin 2020 (38 masa disiplinore në total) 18% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 10% i janë dhënë mjekëve.
-Pra sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se për periudhën objekt auditimi, situata e krijuar në Spitalin Rajonal Durrës, për shkak të masave disiplinore të dhëna pa kriter dhe pa mundësi apelimi, mund të ndikojë në performancën e punës, në motivimin e punonjësve, dhe për më tepër të mjekëve dhe infermierëve të cilët përbëjnë 62% të stafit të larguar për periudhën objekt auditimi. Duke pasur parasysh dhe periudhën e pandemisë Covid – 19, ku nevoja për mjekë është jashtëzakonisht e rëndësishme, situata e krijuar në SRD, ndikon negativisht në plotësimin e nevojave emergjente për staf të specializuar në përmbushjen e detyrës funksionale të këtij spitali.
-Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit (u audituan 158 dosje personeli me përzgjedhje rastësore, nga 662 punonjës që ka Spitali Rajonal Durrës, pra 23 % e dosjeve) konstatohet se në përgjithësi kontrata individuale e punës nuk është ripërsëritur, Dëshmia e Penalitetit mungon në pjesën më të madhe të rasteve, mungon raporti mjeko ligjor, vërtetimi nga gjykata mungon në 20 raste, vërtetimi nga prokuroria mungon në 25 raste.
-Mos zbatimi i procedurave të dhënies masave disiplinore sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015 sjell parregullsi dhe mangësi dhënien e masave disiplinore duke ndikuar në performancën dhe motivimin e punonjësve të spitalit. Parregullsitë në plotësimin e dosjeve të personelit sjell parregullsi procedurale.
3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me dhënien e masave disiplinore në këtë spital.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Drejtoria e SRD me urdhërin nr.789 datë 05.05.2021 ka ngritur Strukturën Mbikqyrëse të etikës. Në zbatim të Rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit", Neni 56 pika "e" e regullave të marrëdhënies me personelin, "Titullari institucionit rast pas rasti pas ankesës së punonjësit do të autorizojë ngritjen e një komisioni "ad hoc" për shqyrtimin e ankesës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

3.2.Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marri masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Ka filluar rishikimi dhe iventarizimi i dosjeve për stafin e punësuar para 2015, për plotësim të ndonjë mangësie. Nga auditimi i disa dosjeve të personelit me perzgjedhje, rezultoi se keto dosje ishin të plota sipas kërkesave ligjore, për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet i realizuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

4.Gjetje nga auditimi : Nga auditimi konstatohet se në Pasqyrat Financiare të Spitalit Rajonal Durrës janë regjistruar të dhëna të gabuara sa i takon zërit të numrit të punonjësve dhe zërit të të ardhurave dytësore. Në bilancin e shoqërisë rezultojnë 82 punonjës të larguar nga detyra në vitin 2020. Bazuar në verifikimin e të dhënave me burimet njerëzore rezulton se numri i të larguarve është 79 punonjës. Po ashtu, rezulton se dhe numri i të punësuar te rinj në vitin 2020 në bilanc është regjistruar 78, në fakt nga verifikimet rezultojnë të jenë 73 të punësuar. Po ashtu nga regjistrimi në zërin "të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh" në vlerën 2,866,327 lekë. Për vitin 2019 nuk ka asnjë vlerë lidhur me këtë zë të bilancit. Nga ana e Spitalit Rajonal të Durrësit është e paqartë se në cilin zë janë regjistruar këto të ardhura për vitin 2019.Veprimet e më sipërme bien në kundërshtim me pikën 12, Udhëzimi Nr.30 "Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" datë 27.12.2011, i ndryshuar

4.1Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për rakordimin dhe korrigjimin e të dhënave të punonjësve të marrë rishtas në punë, atyre të larguar, si dhe të verifikojë dhe sistemojë vlerën e të ardhurave dytësore të spitalit.
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdhëri me Nr. 1875 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Sektorit të Financës. Nga Sektori i Financës në zbatim të urdhrit të sipërcituar ka vijuar puna për rakordimin dhe korrigjimin e të dhënave të punonjësve të marrë rishtas në punë, atyre të larguar, si dhe verifikimin dhe sistemimin e vlerës të të ardhurave dytësore të spitalit. Është paraqitur relacion mbi realizimin e detyrës me shkresë nr 804/11 Dt 4/5/2022 ku detyrat e kërkuara janë zbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pronave të Spitalit Rajonal Durrës u konstatua se: Në aktivet e SRD figurojnë 8 godina. Të gjitha këto godina ndodhen brenda territorit të Spitalit me përjashtim të godinës së poliklinikës. Gjithashtu SRD zotëron edhe një pjesë të godinës së ish-brefotrofit pa qenë në inventarin e objekteve. Gjatë vitit 2003 nga ana e ASHK-së nëpërmjet fotografimit satelitor është bërë riazhornimi i të gjitha pronave dhe si pasojë edhe godinat që përfshin SRD. Për sa më sipër statusi juridik i tyre është "Sheshe" dhe pronar "Shtet" gjë e cila ka sjellë që në sipërfaqen e ndërtimit është përfshirë vetëm njolla e objekteve (kati përdhe). Duke qenë se nga fotografimi satelitor nuk ishte përfshirë edhe godina e katërkatëshit, pasi është ndërtuar në vitin 2007, nga ana e SRD është kryer hipotekimi i saj.

Nga personat përgjegjës në vijimësi, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për pajisjen me të gjithë dokumentacionin hipotekar të saktë të Spitalit Rajonal Durrës.

5.1Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme për përfundimin e regjistrimit të pronave në ASHK me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plotë hipotekar.
Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme, për përditësimin dhe azhurnimin e statusit ligjor dhe fizik të pronave të SRD me qëllim përfundimin e regjistrimit të pronave në ASHK dhe pajisjen me Titullin e Pronësisë.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Nga titullari i SRD-së është ridërguar shkresa me Nr.773 prot, datë 26.04.2022 drejtuar ASHK për dijeni MSHMS me objekt "Kërkesë për përditësimin, inventarizimin, dhe përfundimin e rregjistrimit të pronave të paluajteshme publike që administron Spitali Rajonal Durrës. Bashkëlidhur kërkesa me nr 25002.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

6.Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit u konstatua se inventarizimi fizik nuk është kryer sipas planit të përcaktuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës, për shkak të situatës të pandemisë Covid–19. Komisionet përkatëse të inventarizimit janë ngritur gjatë 2020. Komisioni vlerësimit ka bërë dalje nga përdorimi të aktiveve të cilat nuk janë në gjendje pune, ka paraqitur raportin përmbledhës të shoqëruar me proces verbalet përkatëse për miratim tek Titullari. Pas miratimit të raportit përmbledhës komisioni për daljen nga përdorimi të aktiveve, i ngritur me urdhër të brendshëm nga titullari, ka bërë verifikimin dhe asgjësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë nga përdorimi duke hartuar dhe procesverbalet përkatëse. Në disa raste mungon fletë – hyrja në magazinë lidhur me materialet të cilat janë kthyer në hekurishte për tu shitur në ankand si skrap, ky veprim janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 7, Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, ku citohet:*1. në pasqyrat financiare vjetore.",* dhe pikat 73 e 74 Inventarizimi i aktiveve**,** të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30.
-Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.
Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

6.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për realizimin e procesit të inventarizimit fizik në Spitalin Rajonal Durrës, dhe të ndjekë e plotësojë me përgjegjshmëri hapat e proceseve të cilat lindin pas këtij procesi, si asgjësimin, plotësimi i dokumentacionit justifikues etj.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdhër Nr. 1875 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Sektorit te Financës. Gjithashtu përgjatë vitit 2021 ka filluar normalisht procesi inventarizimit sipas urdhërave të nxjerra nga titullari. Është paraqitur relacion mbi realizimin e detyrës me shkresë nr 804/11 Dt 4/5/2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

7.Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Durrës nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga spitali nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103. Këto veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.
-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre.
Mos shqyrtimi dhe vlerësimi i vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve si dhe mos evidentimi i linjave të vjetra të dala jashtë përdorimit, ka si pasojë mos pasjen e saktë dhe objektive të situatës së Aktiveve Afatgjata Materiale, si dhe planifikimit të investimeve për periudhat e ardhshme.

7.1.Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës dhe Sektori i Financës të merren masa për verifikimin e vlerës së mbetur dhe jetës të dobishme të AAM-ve me vlera materiale, të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë dhe evidentimin.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdhër Nr. 1872 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Sektorit të Financës dhe Sektorit Teknik. Llogaritja e amortizimit zbatohet sipas udhëzimit nr 30 dt 27/12/2011.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

8.Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit konstatohet në datën 07.04.2021 hyrje daljet në Farmacinë e Spitalit Rajonal Durrës mbahen me programin financiar "Financa 5". Gjendja e farmacisë nga ekstrakti i datës 07.04.2021 rezulton: 628,854 copë medikamente në vlerën 46,866,206 lekë. Bazuar në përzgjedhjen rastësore, nga grupi i auditimit u bë ballafaqimi i numrit faktik të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme, me numrin e tyre sipas regjistrimit në sistem.
-Nga grupi i auditimit konstatohet se programi financiar "Financa 5" është lehtësisht i aksesueshëm, dhe i modifikueshëm, duke mos dhënë kështu sigurinë e arsyeshme, rreth faktit të gjendjes të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme.
- Hyrjet dhe daljet në farmacinë e spitalit nuk mbahen me një libër të posaçëm regjistrimi, lidhur me hyrje daljet e bëra sipas kërkesave spitalore për medikamente.
-Nga grupi i auditimit u konstatua se dalja e medikamenteve nga farmacia, lidhur me nevojat spitalore nuk bëhet në çdo rast me kërkesë me shkrim dhe fletë daljen përkatëse. Kërkesa bëhet verbale nga mjekët, infermierët apo imazheristët, në varësi të kërkesave. Pasqyrimi i këtyre lëvizjeve në farmaci nuk është i menjëhershëm, por ka vonesa të cilat variojnë nga 1 – 21 ditë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", i ndryshuar, dhe pika 12, Udhëzimi Nr.30 "Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" datë 27.12.2011, i ndryshuar "Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi ne dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim."

8.1. Rekomandimi: Sektori i Farmacisë së Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa lidhur me aksesin dhe modifikimin në programin Financa 5, duke specifikuar punonjësin dhe kriteret e caktuara, bazuar në të cilat do të kryhen modifikimet. Të hartohet dhe mbahet libri i posaçëm i hyrje – daljeve, si dhe të merren masa lidhur me regjistrimin dhe pasqyrimin në kohë reale të lëvizjeve në farmaci, duke bashkëlidhur dokumentacionin e plotë justifikues.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdhëri me Nr. 1873 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Shërbimit te Farmacisë. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e Llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" në fund të vitit 2020 paraqitet me vlerën **9,146,697 lekë,** krahasuar me vlerën e vitit 2019 prej **10,452,818 lekë**, pra ka një rritje prej **1,306,121 lekë** krahasuar me periudhën ushtrimore pasardhëse. Kjo rritje vjen si pasoje e njohjes së debitorëve të viteve të kaluara.
Konstatohet se Sektori i Financës nuk e ka të qartë afatin dhe kohën në cilin duhet kryer kontabilizimi i këtyre detyrimeve, duke sjellë kështu pasiguri për shkak të paqartësisë lidhur me afatet e kontabilizimit të debitorëve lidhur me vlerën e paraqitur në Pasqyrat Financiare të Spitalit Rajonal Durrës për llogarinë 468.
Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, pika 3, shkronjat g dhe gj, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

<u>9.1. Rekomandimi</u>: Nga Sektori i Financës të merren masa për analizimin e vlerës prej **9,146,697 lekë** të debitorëve, ndjekjes të procedurave të regjistrimit të tyre referuar afateve të përcaktuara në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdhëri me Nr. 1875 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Sektorit të Financës. Sipas llogarisë për debitorët për vitin 2019 dhe 2020, dokumentohet së llogaria debitoreve është pakësuar në vitin 2020, konkretisht nga 9,390,065 lekë në vitin 2019 në 9,146,697 lekë në vitin 2020. Ky pakësim prej 402,260 ka ardhur nga shlyerja e detyrimeve të debitoreve. Theksojmë së disa prej debitoreve janë krijuar shumë vite përpara, por gjithësesi shuma e mbetur është konsiderueshme, për pasojë nga strukturat dretjuese të SRD nevojitet marrja e masave për të gjithë debitorët, të ndiqen me përparësi të gjitha veprimet ligjore nëpërmjet ndjekjes së proceseve gjyqësore për likuidimet e detyrimeve.
Në lidhje me respektimin e afateve të regjistrimit të debitorëve, ky rekomandim do të shikohet në vijimësi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së këtij Sektori, për pasojë konsiderohet në proces.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstauan mangësi në lidhje me argumentimin teknike dhe ligjor të specifikimeve teknike, si dhe të dokumentimin e tyre në procesverbalin e mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, konkretisht:
"*Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës, viti 2020 – 2 lote", me fond limit 1,689,000 lekë, kanë marrë pjesë 2-4 operator për çdo lot*
"*Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës, viti 2019 – 6 lote", me fond limit 9,264,000 lekë, kanë marr pjesë në 6 lote i njëjti operator*
"*Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës viti 2020 – 7 lote", me fond limit 10,500,000 lekë, kanë marr pjesë 1 – 2 operatorë në çdo lot*
"*Shërbim i evadimit të mbetjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës" viti 2019, me fond limit 1,444,930 lekë, kanë marr pjesë 3 operator ekonomik*
"Blerje Funizim vendosje Llampe skaneri viti 2019", me fond limit 11,207,182 lekë ka marrë pjesë vetë një operator ekonomik
"*Blerje protoksid azoti për SRD për nevojat e vitit 2020"me fond limit 4,568,400 lekë ka marrë pjesë 1 operator ekonomik*
Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet se vendosja e kritereve të pa

argumentaura ligjërisht dhe teknikisht ka sjell uljen e konkurencës dhe paraqitjen e ofertës nga vetëm një operator i cili kishte ofertën më të ulët gjatë fazës së studimit të tregut (përllogaritja e fondit limit) dhe oferta e ofruar nga ky operator është në kufirin e fondit limit. Në kundërshtim me neni 61, pika 2, paragrafi II e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe nenin 20 "Mosdiskriminimi" i Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

10.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës të marri masa që grupet e ngritura për hartimin e specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit të argumentojnë ligjërisht dhe teknikisht kriteret e vendosura në procedurat e prokurimit duke shmangur konfuzion, ankesa gjatë procedurës së prokurimit, rritjen e konkurencës si dhe tejzgjatje të procedurave.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdhëri me Nr. 1874 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Sektorit të Prokurimeve. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektori i Prokurimeve gjatë organizimit të procedurave të prokurimit në vijimësi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1328/7, datë 17.07.2019 me objekt *"Blerje Funizim vendosje Llampe skaneri 2019"* me garanci 1 vit për pjesët e blera, lidhur me OE "H. & L." me vlerë 11,207,000 lekë pa TVSH me afat zbatimi 7 ditë, u konstaua se:
Mallrat kanë ardhur shoqëruar me Faturën nr. 8237215, datë 18.07.2019 me vlerë 13,448,400 lekë me TVSH.
Bazuar në dokumentacionin e mësipërm me Urdhër Shpenzimin nr. 3, datë 02.08.2019 është kryer pagesa në vlerën 13.448,400 lekë
Relacioni i ekzekutimit te kontratës nr. 1851, datë 04.10.2019 i komisioni i marrjes në dorëzim shprehet se kontrata është realizuar në kohë dhe cilësi.
Me kryerjen e pagesës në vlerë të plotë (100% të vlerës) institucioni nuk ka siguruar garancinë prej 1 viti të pjesëve të blera të skanerit në kundërshtim me specifikimet teknike të Kontratës nr. 1328/7, datë 17.07.2019.

11.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës, Grupet e Monitorimit të Kontratës dhe Sektori i Financës të marrin masa që në të ardhmen të mos kryejnë pagesa të plota të vlerave të kontratave kur në specifikimet e kontratave përfshihet periudhë garancie duke siguruar mbrojtje të Spitalit në rastet e defekteve brenda periudhës së garancisë.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Memo me Nr. 1876 prot, datë 03.11.2021, drejtuar të gjithe shefave të Sektorëve të SRD-së. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së "*Shërbim i evadimit të mbetjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës"* konstatohet se grupi i monitorimi i kontratës kryen matjen e mbetjeve me volum të cilat grumbullohen në cdo pavion me thasë mbetjesh urbane të siguruara nga kontraktori (thasë 50 litra), dhe mbushja e tyre meret e mirëqenë pa siguruar ngjeshjen e mbetjeve dhe eleminuar volumet e krijuara midis mbejteve apo edhe brenda mbetjeve (kuti, bidona, etj.), sipas deklaratës verbale të grupit të monitorimit matja e

thasëve dhe mbushjes së tyre bëhet apriori në mënyrë subjektive.

12.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës si dhe grupet e ngritura për hartimin e specifikimeve teknike të marrin masa që në kontratat e evadimit të mbetjeve urbane të ndryshojnë mënyrën e matjes nga volum (subjektive) në peshë duke shmangur subjektivizmin në matjen e tyre gjatë zbatimit të kontratës.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Me shkresën nr.1805/3 prot, datë 28.10.2021, **k**thim përgjigje, Përgjegjësja e Sektorit të Mjedisit, sqaron se do të parashikohet për kontratën e re që mbetjet urbane të maten me kg. Për këtë qëllim, fillimisht do të bëhen matje ditore të sasisë së mbetjeve në kg për të nxjerr një peshë mesatare ditore e cila do të shërbejë për procedurën e të prokurimit për vitin 2022. Konkretisht është lidhur kontrata nr prot 526/4 dt 24.03.2022 ku është përcaktuar që matja të bëhet me kg.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

13. Gjetje nga auditimi: Shmangja e procedurave të prokurimit , mosevidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen nga Titullari i SRD-së dhe strukturat e ngarkuara me prokurimin e këtij malli, në Spitalin Rajonal Durrës **për vitin 2019.**
Në nëntor të vitit 2018, Spitali Rajonal Durrës për mbulimin e nevojave me oksigjen ka filluar procedurën e prokurimit me Objekt "**Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019"**, me fond **6,085,206 lekë pa TVSH**. Sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit të kësaj procedure, furnizimi me oksigjen do të mbulojë nevojat për oksigjen për gjithë vitin 2019. Procedura e prokurimit ka përfunduar me lidhjen e kontratës së furnizimit datë 30.04.2019 me vlere me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH me operatorin fitues JV H. & A. sh.p.k dhe GTS – Gazra Teknike Shqiptare.
Ndërsa, furnizimi i Spitalit Rajonal Durrës me oksigjen për periudhën nga data 01.01.2019 deri në datën e lidhjes se kësaj kontrate (30.04.2019), është bërë faktikisht nga operatori "M. A.". Spitali Rajonal Durrës me këtë operator nuk kishte lidhur kontratë furnizimi (nëpërmjet procedurave të prokurimit) , por furnizimi bëhej dhe evidentohej vetëm në bazë të procesverbaleve të marrjes në dorëzim. Referuar dokumentacionit që ju vu në dispozicion grupit të auditimit mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratës për furnizimin e SRD me oksigjen , u konstatua se në lidhjen e dokumentacionit të likuidimit të operatorit fitues JV H. & A. sh.p.k dhe GTS –Gazra Teknike Shqiptare, ka 12 procesverbale furnizimi me oksigjen të mbajtura midis operatorit "M. A." në cilësinë e shitësit por jo të operatorit fitues që sipas tenderit të zhvilluar në datën 19.04.2019 është shpallur bashkimi i operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS –Gazra Teknike Shqiptare me ofertë **6,085,206 lekë pa TVSH.**
Kështu deri në datën 19.04.2019, operatori furnizues "M. A." ka furnizuar spitalin me 47,073 litra oksigjen, me anë të procesverbaleve ku deklarohet si furnizues dhe huadhënës i oksigjenit duke ju vënë si kusht që pagesa do t'i kryhet menjëherë kur SRD t'i akordohet fondi në buxhetin e tij për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e këtij malli.
Konkretisht:
Në datën datë 20.05.2019, një muaj më pas lidhjes se kontratës më operatorin e shpallur fitues H. & A. sh.p.k dhe GTS –Gazra Teknike Shqiptare, Drejtori i Spitalit ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me nr.967, datë 20.05.2019 për shlyerjen e detyrimit që kishte ndaj operatorin "M. A." i cili kishte furnizuar spitalin me oksigjen deri në 19.04.2019. Kjo marrëveshje është nënshkruar edhe nga operatori fitues H. & A. sh.p.k dhe GTS –Gazra Teknike Shqiptare. Me dokumentin nr.967, datë 20.05.2019 është nënshkruar marrëveshje për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga ana e Spitalit Rajonal Durrës të një sasie lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për

mirëfunksionimin e Spitalit Rajonal Durrës midis Drejtorit të Spitalit, operatorit "M. A." sh.p.k në cilësinë e furnizuesit dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS –Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k, në cilësinë e operatorit fitues të tenderit.
Sipas kësaj marrëveshje subjekti bashkimi i operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS –Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k shlyen detyrimin vetëm për sasinë 45,000 litra oksigjen lëng dhe mbeten për likuidim edhe 2073 litra. Sasia në litra e furnizuar nga H. & A. sh.p.k dhe GTS – Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k për SRD është 8830 litra oksigjen në total.
Sa sipër lidhja e marrëveshje tre palëshe mirëkuptimi me nr.967, datë 20.05.2019 ka shmangur procedurat e prokurimit duke krijuar precedent për marrëveshje midis operatorit fitues të tenderit, operatorit furnizues dhe titullarit të Spitalit Rajonal Durrës, në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.
Për gjithçka më sipër, del qartë se, furnizimi me oksigjen deri në datën 19.04.2019 për sasinë 47,073 litra oksigjen është bërë pa procedura prokurimi në kundërshtim të hapur LPP, në një kohë Autoriteti Kontraktor i ka pasur të gjithë mundësitë që deri në përfundimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjes së kontratës të realizonte procedurat prokurimi me negocim pa shpallje te kontratës të parashikuara në Ligjin për Prokurimin Publik nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.
Për shkeljet dhe parregullsitë e mësipërme mban përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor, për shmangie të procedurave të rregullta të prokurimit për mos evidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kritereve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

13.1 Rekomandimi : Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në raport me planifikimet , nevojat dhe realizimet e kontratave të oksigjenit të analizojë dhe të identifikojë nëpërmjet strukturave përkatëse të ngarkuara me këtë proces, kronologjinë e gjendjes reale të këtij malli në magazinat e SRD-së, shpërndarjen e tij dhe shmangien e procedurave që nuk sanksionohen në kontratat e lidhura me operatorët fitues të tenderit.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Memo me Nr. 1876 prot, datë 03.11.2021, drejtuar të gjithë shefave të Sektorëve të SRD-së. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

13.2 Rekomandimi : Titullari i Autoritetit Kontraktor në SRD, të marrë masa që të organizojë strukturat që ka ngarkuar me përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në Spitalin Rajonal Durrës, për të ndjekur trajnimet që organizohen nga Agjencia e Prokurimit Publik, në mënyrë që të shmangë parregullsitë në procedurat e prokurimit në të ardhmen.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Në zbatim të kërkesës së Titullarit të Spitalit Rajonal Durrës, për përfshirjen e stafit të Spitalit Rajonal Durrës në trajnime lidhur me procedurat e prokurimit publik, stafi i Sektorit të Prokurimeve kanë ndjekur të gjithë trajnimin bazë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik. Gjithashtu, i është drejtuar dhe ka kërkuar te marre pjese ne trajnime te ndryshme prane Shkolles Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), por vazhdimisht iu eshte refuzuar pjesëmarrja me arsyetimin se "....trajnimet ofrohen vetëm për nëpunësit civil. Shkolla është duke u përgatitur për ta shtrirë ofertën e saj trajnuese edhe jashtë shërbimit civil."
Po ashtu, më date 18.10.2021, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) ka

dërguar thirrje në mënyre elektronike në adresën e Spitalit Rajonal Durrës për të dërguar numrin e punonjësve që kanë nevojë për trajnim për vitin 2021-2022, në mënyrë që të zhvillojë proçesin e vlerësimit të nevojave për trajnim nga institucioni jonë. Spitali Rajonal Durrës, brenda afateve u ka dërguar përgjigje duke bashkangjitur dhe listën emerore të kërkuar.
Informacioni Nr. 1805/7 prot, datë 28.10.2021 i Zv. Drejtorit të Edukimit në Vazhdim.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

14. Gjetje nga auditimi: Dorëzim i mallit ("Furnizim vendosje me një ashensor të ri per godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe) të SRD", për vitin 2020 pas **53 ditëve** kalendarike ose **35 ditë pune me vonesë** në Spitalin Rajonal Durrës.
Për procedurën e prokurimit "Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe)", viti 2020 u konstatua: Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratën nr.1675/8, datë 28.10.2020 me operatorin fitues H. K. sh.p.k. me vlerë oferte 2,600,000 lekë pa TVSH me afat realizimi 30 ditë nga dita e nënshkrimit të saj.
Titullarja e Autoriteti Kontraktor me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 ka ngritur komisionin për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje: A. F., N. M., R. Ç.. Me shkresën nr.1675/10, datë 29.10.2020,Titulllari i AK ka nxjerrë njoftimin e kontratës i cili është botuar në buletinin e APP nr.94, datë 2.11.2020.
Operatori ekonomik me shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor për pamundësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur dhe realizuar në kohë zbatimin e kontratës për shkak të vonesave në realizimin e disa pjesëve të ashensorit si dhe në ardhjen e pjesëve të tjera nga Italia për arsye të pandemisë Covid-19, dhe i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor shtyrjen e afatit të parashikuar në kontratë deri më datë 31.12.2020.
Amendimi kontratës bazuar në shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 të operatorit ekonomik dhe nenin 23 të kontratës është nënshkruar nga AK dhe operatori ekonomik më datë 31.12.2020 dhe realizimi i saj është shtyrë deri më datë 31.12.2020.
Me procesverbalin e datës 22.02.2021 nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje: A. F., N.M., R. Ç., ngritur me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 nga titullarja e AK është marrë në dorëzim ashensori nga vetëm dy anëtarë të komisionit të monitorimit të kontratës së mësipërme A. F. dhe R. Ç., ndërsa anëtari tjetër i grupit N. M. është larguar nga puna në datë 04.02.2021.
Përsa më sipër ashensori është dorëzuar në SRD pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj. Nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës nuk ka një relacion shpjegues për vonesën e shkaktuar në dorëzimin e mallit "**Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe)"**, në Spitalin Rajonal Durrës por thjesht në procesverbalin e mbajtur në datë 22.02.2021 nga grupi i monitorimit të kontratës shprehet se malli i përmbush gjithë specifikimet teknike.
Referuar ditarit të furnitorit për datën 22.02.2021 , me faturën nr.150, furnitori "H. K." ka sjellë vlerën e prokurimit për likuidim **3,120,000 lekë me TVSH**, por nuk është kryer akoma likuidimi. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kryer një analizë mbi vonesat dhe penalitetet që duhet t'i mbahen operatorit ekonomik "H. K." sh.p.k që ka sjellë mallin me vonesë. Referuar kushteve të kontratës neni 23 , pika 23.3 shprehet në formë eksplicite se "Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesin me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes".
Ashensori është dorëzuar në SRD pas **53 ditëve kalendarike** ose **35 ditë pune me vonesë**, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj, referuar nenit 24, pika a të kontratës

“Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës” për rrjedhojë vlera që SRD duhet t’i zbresë faturës së likujdimit për operatorin H. K. sh.p.k nga vlera totale e kontratës **është 661,440 lekë.**
Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet.Për pasojë vlera e penalitetit 661,440 lekë lekë përbën dëm ekonomik për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga “OE H. K.” sh.p.k.Për mosevidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës.

14.1Rekomandimi : Strukturat përkatëse të SRD-së të ngarkuara me monitorimin, ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratave të prokurimeve të marrin masa që në të ardhmen të raportojnë në kohë vonesat mbi dorëzimin e mallit/shërbimit apo punëve publike dhe arsyet mbi këto vonesa duke mbajtur procesverbale dhe raporte me operatorët fitues të këtyre procedurave duke i parashtruar detyrimet që rrjedhin nga kontratat përkatëse dhe penalitetet nëse nuk përmbushin kushtet e kontratave.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Memo me Nr. 1876 prot, datë 03.11.2021, drejtuar të gjithë shefave të Sektoreve të SRD-së. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të programimit të buxhetit nga ana e SRD në shpenzimet korrente, fillimisht në PBA planifikohet në nivele të përafërta me vitin ushtrimor paraardhës konkretisht për vitin 2020 në vlerën 1,282,250 mijë lekë ose në vlerën 79,737 mijë lekë më shumë se vitin 2019 planifikuar në vlerën 1,202,513 mijë lekë. Ndërkohë që plani përfundimtar pas shtesave, pakësimeve dhe rialokimeve shkon për vitin 2019 në vlerën 903,656 mijë lekë realizuar në masën 100%, për vitin 2020 në vlerën 1,004,515 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 972,385 ose në masën 96.8%.
- Për vitin 2020 konstatohen nivele të ulta në realizimin e llogarive konkretisht, 600 “Paga personeli” në masën 98.7% ose ka mosrealizim në vlerën 6,734 mijë lekë, 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në masën 95.96% ose ka mosrealizim në vlerën 3,398 mijë lekë dhe 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në masën 94.46% ose ka mosrealizim në vlerën 22,000 mijë lekë. Nga analiza e artikujve buxhetor konstatohen diferenca ndërmjet planifikimit përfundimtar dhe realizimit faktik referuar veprime të kryera me bankë sipas shpenzimeve për llogaritë 600, 601 dhe 602 në nivel 7-shifror.
- Për vitet 2019 dhe 2020 në disa zëra të artikujve buxhetor kryesisht paga personeli (raporte mjekësore, shtesë turne të dyta, shtesa page, shtesë pune jashtë orarit, shpërblime) mallra dhe shërbime të tjera (pagesa të energjisë, shpenzimet për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna) konstatohet angazhim më i madh gjatë vitit në krahasim me planifikimin përfundimtar të buxhetit. Ndërkohë në disa zëra të llogarive buxhetore paga personeli (shpërblime, paga të personelit të përkohshëm) mallra dhe shërbime të tjera (materiale dhe shërbime zyre dhe të përgjithshme, materiale dhe shërbime special, shpenzime për detyrime dhe kompensime legale) konstatohet angazhim më i ulët gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar si pasojë e tjetërsimit të destinacionit të fondit buxhetor. Në të dy rastet, situata tregon një planifikim jo të saktë në fillim të vitit dhe shpenzimin më të madh në këto grup llogarish në krahasim me llogari të tjera pavarësisht ruajtjes në total të limit për angazhim buxhetor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 3, pika 29, dhe Kontratën “Për

financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore" për vitet 2019 dhe 2020, miratuar me VKA të FSDKSH nr. 20, datë 19.12.2018, dhe nr. 37, datë 19.12.2019, neni 11, pika 14, neni 12, pika 14.

15.1. Rekomandimi: Nga SRD të merren masa që në raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajnë një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi në vlerë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi për zbatimin e buxhetit.
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Memo me Nr. 1876 prot, datë 03.11.2021, drejtuar të gjithë shefave të Sektoreve të SRD-së. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi.
Për vitin 2022 është paraqitur relacion mbi detajimin të hollësishëm të buxhetit për vitin 2022 me nr 465/1 prot, datë 09.03.2022.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

15.2. Rekomandimi: Nga ana e SRD të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve buxhetorë.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Memo me Nr. 1876 prot, datë 03.11.2021, drejtuar të gjithë shefave të Sektoreve të SRD-së. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

15.3. Rekomandimi: Nga SRD të merren masa që strukturat/struktura që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të eliminojnë planifikimet formale, dhe të kryejnë parashikime të besueshme, duke kryer analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatëse për këtë qëllim, me qëllimin e eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Memo me Nr. 1876 prot, datë 03.11.2021, drejtuar të gjithë shefave të Sektoreve të SRD-së. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi.
Është ngritur urdhëri me nr 225 prot, datë 04.02.2022 mbi dërgimin e kërkesave për hartimin e buxhetit për vitin 2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 107 prot., datë 14.01.2020, dhe shkresën nr. 97 prot., datë 15.01.2021, SRD ka raportuar pranë FSDKSH realizimin e buxhetit për vitet 2019 dhe 2020. Nga auditimi konstatohet se, në këto raporte nuk është raportuar pasqyra e të ardhurave dytësore sipas burimit të realizimit të natyrës së përdorimit, veprime këto në kundërshtim me Kontratën "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore" për vitet 2019 dhe 2020

miratuar me VKA të FSDKSH nr. 20, datë 19.12.2018, dhe nr. 37, datë 19.12.2019, neni 13, pika 6, neni 14, pika 6, aneksi 2, pasqyra 12.

16.1. Rekomandimi: Nga SRD të merren masa në mënyrë që raportimi i të ardhurave dytësore të bëhet sipas burimit të realizimit të natyrës së përdorimit, referuar përcaktimeve në kontratën dypalëshe midis Spitalit dhe FSDKSH.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdhëri me Nr. 1875 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Sektorit të Financës. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi. **Cdo muaj raportohet periodikisht mbi realizimin e të ardhurave dytësore. sipas kontratës me FSDKSH.**
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës në lidhje me arkëtimet konstatohet se, midis SRD dhe OE "Sh." SHPK është lidhur kontrata nr. 4371, datë 29.08.2019, për dhënien me qira të sipërfaqes prej 62 m^2 për ushtrimin e aktivitetit "Mencë" në shërbim të punonjësve/pacientëve dhe qytetarëve për shërbimet spitalore. Për këtë kontratë OE ka paguar detyrimin mbi konsumin e energjisë elektrike dhe ujit konkretisht:
- Për periudhën nga data 27.01.2020 - 30.11.2020, nga OE "Sh." SHPK janë arkëtuar pagesa si detyrim ndaj SRD për konsumin e energjisë elektrike në vlerën 611,320 lekë.
- Për periudhën nga data 27.01.2020 - 30.11.2020, nga OE "Sh." SHPK janë arkëtuar pagesa si detyrim ndaj SRD për konsumin e ujit në vlerën 206,120 lekë.
Për kryerjen e këtyre veprimeve si dokumentacion justifikues shërbejnë procesverbalet e mbajtura nga përfaqësuesi inxhinier z. E. P. me përfaqësuesit e OE, për konsumin mujor të energjisë elektrike dhe ujit.
Procesverbalet e mbajtura sipas muajve respektive i referohen matësit të vendosur për konsumin e energjisë elektrike dhe pagesës afrofe për konsumin e ujit. Në të dy rastet nuk disponohet asnjë urdhër apo procesverbal për vendosjen e matësit dhe caktimit të tarifës afrofe për pagesën e ujit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, deri në fund të periudhës objekt auditimi matësi i energjisë elektrike nuk është i kolauduar nga OSHEE SHA, por konsumi i saj regjistrohen në linjën kryesore të energjisë të Spitalit.
Kjo situatë vjen si pasojë se në kontratën e qiradhënies nuk janë përcaktuar detyrimet kontraktuale midis palëve të cilat lindin për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit. Nga pjesa menaxheriale e SRD nuk janë marrë masat e nevojshme për ndarjen nga linja kryesore e Spitalit të matësit për energjinë elektrike si dhe vendosjen e një matësi për konsumin e ujit, ku të lidhen kontratat respektive me OSHEE SHA për energjinë dhe UKD SHA për ujin, dhe mbi bazën e këtyre faturave të kryen pagesat respektive nga OE.

17.1. Rekomandimi: Drejtori i Spitalit dhe Sektori Juridik, të marrin masa për kryerjen e amendimit të kontratës nr. 4371, datë 29.08.2019, të lidhur midis SRD dhe OE "Sh." SHPK për dhënien me qira të sipërfaqes prej 62 m^2 për ushtrimin e aktivitetit "Mencë", duke përcaktuar në të edhe detyrimet për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit sipas përcaktimeve të enteve rregullator përkatës.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Për lidhjen e kësaj kontratë SRD është bazuar në draftin TIP bashkëlidhur VKM Nr.54 datë 05.02.2014 i ndryshuar. Pavaresisht përdorimit të kontratës TIP nga SRD-ja, subjektit i janë mbajtur sipas procesverbalit përkatë detyrimet për drita dhe ujë.
Kjo kontratë nuk mundet më të amendohet sepse Spitali Rajonal Durrës, bazuar në "Kërkesën

për Pezullim" me Nr. 41 prot, datë 12.05.2020 e rregjistruar pranë nesh me Nr.843 prot, datë 13.05.2020 ka pranuar pezullimin e Kontratës së Qirasë me Nr. 4371 Rep, datë 29.08.2019, deri më datën 28.08.2020, sipas Kthimit Përgjigjes Nr.843/1 prot datë 20.05.2020. Kërkësa e paraqitur nga OE ka qënë e bazuar në Urdhër 164 prot datë 12.03.2020 të MSHMS Tiranë dhe piken 7 të Aktit Normativ Nr. 3 datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave. Me kalimin e këtij afati nuk është paraqitur asnjë kërkesë për rinovimin e saj nga ana e OE dhe si rrjedhim kontrata ka humbur të gjitha fuqitë juridike vepruese. Aktualisht ky ambjent përdoret nga SRD për Shërbimin e Mikrobiologjisë.
Sa sipër ky rekomandim nuk mund të zbatohet, pasi nuk ekzistojnë më të njëjtat rethana juridike si më parë.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Zbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se:
- Në 10 raste kryesisht përgjatë vitit 2019, mungojnë kërkesës/transaksionit për likuidimin e pagesave për shpenzimet e kryera ndaj operatorëve ekonomikë.
- Në të gjitha rastet për vitet 2019 dhe 2020, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë pa numër protokolli.
- Në 20 raste për vitet 2019 dhe 2020, nuk është bërë regjistrimi i saktë i skadencave së barnave dhe kite reagentëve në farmacinë e institucionit, kjo situatë vërtetohet nga rakordimet midis regjistrimeve sipas fletë-hyrjeve në magazinën e farmacisë, faturave tatimore dhe certifikatave të analizës së mallrave.
- Për 40 raste (transaksione) në vlerën 113,316,417 lekë për vitet 2019 dhe 2020, nga ana e SRD ka vonesa në likuidimin e operatorëve ekonomikë (në pagesave të caktuara pjesore ka vonesa nga ana e SRD deri në 3-4 muaj në likuidimin e tyre) duke mos respektuar afatet e parashikuara në detyrimet kontraktuale të kontratave dypalëshe respektive si dhe përcaktimeve të Ligjit nr. 48/2041, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare". Mos likuidimi në kohë i pagesave ndaj operatorëve ekonomik ekspozon SRD ndaj penaliteteve të mundshme.
- Në të gjitha rastet për vitet 2019 dhe 2020, në setin e dokumentacionit justifikues së bankës bashkëngjitur nuk ndodhet urdhri për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.
- Në gjitha raste për vitet 2019 dhe 2020, për sa i përket kontratave të lidhura për barnat, kite reagentëve, medikamenteve, bashkëngjitur dokumentacionit justifikues nuk ndodhet relacioni shpjegues ku duhet të evidentojë kronologjinë për likuidimet e kryera sipas pagesave të faturave pjesore referuar kontratave respektive të sipërpërmendura.
- Në 5 raste për vitet 2019 dhe 2020 për kontratat e barnave, kite reagentëve dhe medikamenteve, për sa i përket likuidimit të faturave pjesore seti i dokumentacionit justifikues nuk është i sistemuar sipas çdo kontrate respektive, por bashkëngjitur likuidimit ndodhen fatura pjesore për kontrata të ndryshme të cilat i përkasin të njëjtit operator ekonomikë.
- Në 5 raste për vitet 2019 dhe 2020 në setin e dokumentacionit justifikues të bankës nuk janë bashkëngjitur certifikatat e analizave të barnave, të cilat gjendeshin në farmacinë e institucionit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale tregtare" neni 4, neni 6, gërma a, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 37 dhe pika 54.

18.1. Rekomandimi: SRD, Sektori i Financës, të marrë masa për pasqyrimin e të gjithë kronologjisë, regjistrimin në magazinë, plotësimin dhe sistemimin e dokumentacionit justifikues për kontratat e barnave, medikamenteve dhe kite reagentëve referuar përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdhëri me Nr. 1875 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Sektorit të Financës. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektori Financës në SRD
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

18.2. Rekomandimi: SRD, Sektori i Financës, të marrë masa për likuidimin në kohë të furnitorëve sipas afateve të përcaktuara në kontratat dypalëshe respektive si dhe referuar afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale tregtare", duke shmangur penalitet e mundshme.
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdhëri me Nr. 1875 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Sektorit të Financës. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektori Financës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij në vijimësi
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

19. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i mallrave e shërbimeve të prokuruara dhe kategorizimi i tyre rezultoi se, për të njëjtin grup mallrash, është tejkaluar limiti ligjor prej 800,000 lekë, si më poshtë:
- Për vitin 2019, janë realizuar 3 procedura prokurimi me vlerë të vogël në shumën 1,420,435 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin konkretisht, "Blerje tonera" me fond limit 716,666 lekë pa TVSH, "Blerje letër + kancelari" me fond limit 666,666 lekë pa TVSH, "Blerje shtypshkrime" me fond limit 345,641 lekë pa TVSH duke e ndarë në procedura të tjera me të njëjtin objekt.
- Për vitin 2020, janë realizuar 4 procedura prokurimi me vlerë të vogël në shumën 2,086,628 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin konkretisht, "Blerje letër" fond limit 557,668 lekë pa TVSH, "Blerje shtypshkrime" me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, "Blerje shtypshkrime" me fond limit 221,660 lekë pa TVSH, "Blerje tonera" me fond limit 507,300 lekë pa TVSH, duke e ndarë në procedura të tjera me të njëjtin objekt.
- Për vitin 2020, janë realizuar 3 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit në shumën 801,120 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin konkretisht, "Shërbime riparimi për automjete" me fond limit 692,700 lekë pa TVSH, "Shërbime riparimi për automjete" me fond limit 100,000 lekë pa TVSH, "Frena dhe pjesë të frenave" me fond limit 98,500 lekë pa TVSH.
- Për vitet 2019 dhe 2020, të gjitha praktikat e dosjeve të prokurimit me vlerë të vogla nuk janë të arkivuara në protokollin e institucionit por ndodheshin në Zyrën e Prokurimit si dhe procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë pa numër protokolli, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 28, pika 2, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 40, pika 1, pika 8, neni 59, pika 1.
19.1 Rekomandimi: SRD, Sektori i Prokurimeve, të marrin masa që në hartimin e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike, shmangien e copëzimit të fondeve, për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh, arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit me vlera të vogla si dhe protokollimin e procesverbaleve për marrjen e mallrave apo shërbimeve në dorëzim.
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Urdheri Nr. 1874 prot, datë 03.11.2021, drejtuar Sektorit të Prokurimeve. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga **Sektori i Prokurimeve** në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij në vijimësi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

20. Gjetje nga auditimi : Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2019 dhe vitin 2020 konkretisht referuar kontratës së lidhur me subjektin "A. B.", SRD ka lidhur me këtë subjekt kontratën me nr. 611/1, datë 31.03.2017 me afat 1 vjecar, per vitin 2018 nuk ka kontratë, dhe as për vitin 2019 nuk ka kontratë. Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2020, konkretisht referuar kontratës nr.728/1, datë 23.12.2019 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti "A. B." për llogari të SRD është 221, 640 lekë, referuar detyrimeve nga kontrata nr.135, datë 17.01.2020 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti "B. C." për llogari të SRD është 101,160 lekë.Për pasojë për çdo detyrim kontraktor të pashlyer përsa më sipër për vitin 2019 dhe vitin 2020, Spitalit Rajonal ***Durrës i janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 322,800 lekë***, vlerë e cila duhej kërkuar dhe arkëtuar për llogari të SRD nga shoqëritë "A. B." dhe "B. C.".

20.1.Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që në bashkëpunim me strukturat e ngritura për monitorimin e kontratave të ambjenteve me qira dhe sektorin e financës të analizojë problematikat e mbartura vit pas viti për mosshlyerjen e detyrimeve kontraktore të operatorëve qiramarrës së ambjenteve të Spitalit Rajonal Durrës.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-se eshte nxjerr Urdheri me Nr. 1875 prot, date 03.11.2021, drejtuar Sektorit te Finances, dhe Memo Nr. 1876 prot, date 03.11.2021 drejtuar të gjithë sektorëve të SRD-së. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektori Financës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij në vijimësi.
Bashkangjitur kartela nga zyra financës ku pasqyrohet arkëtimet përkatëse.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

20.2 Rekomandimi : Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që të ngrejë një grup pune për amendimin e Kontratave të Qirasë duke hartuar te drejta dhe detyrime të qarta në raportin e ndërsjellë qiramarrës/qiradhënës gjithashtu shtimin në kontratën e qirave penalitetet, në raste të mosrespektimit të detyrimeve të ndërsjella kontraktore.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Në lidhje me kontratat e qerave Sektori Juridik ka marrë masat dhe në kontratat e qerave që ka lidhur deri më tani ka përfshirë në to penalitete me të përshtatshme për palët. *Bashkëlidhur gjeni kontratat e lidhura me subjektet L. K. PF, "M.-T." Shpk dhe "U. S." Shpk*
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

21.1 Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi, si dhe monitorimi, në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Nga auditimi u konstatua se në Spitalin Rajonal Durrës, nuk janë implementuar plotësisht procedurat për respektimin e ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Nga ana e subjektit u paraqit vetëm urdhëri për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik por asnjë akt shkresor mbi veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. U konstatua se grupet e menaxhimit strategjik janë ngritur rregullisht çdo vit por nuk u provua me asnjë dokumentacion ligjor që grupi i menaxhimit strategjik të ketë zhvilluar mbledhje për diskutimin e çdo komponenti për të zbatuar ligjin për Menaxhimin Strategjik dhe Financiar. U

konstatua se nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave. Shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit nuk funksionojnë mirë si në mënyrë shkresore dhe elektronikisht, kjo gjë u konstatua edhe gjatë auditimit pasi departamentet nuk rakordonin në kohë me njëra tjetrën për paraqitjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

21.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Spitalit Rajonal Durrës, të merren masa për të implementuar sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim rritjen e kontrollit vertikal të SRD për dhënien e sigurisë së arsyeshme në veprimtarinë ekonomiko-financiare të tij.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Nga Drejtoria e SRD-së është nxjerr Memo Nr. 1876 prot, datë 03.11.2021 drejtuar të gjithë sektorëve të SRD-së. Është miratuar "Manual për menaxhimin e riskut për vitin 2022" nr 113/1 prot, dt 4/5/2022. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi. Është miratuar Manuali Për Menahimin e Riskut për vitin 2022 me nr. 113/1 prot, datë 04.05.2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

22.1 Gjetje nga auditimi : Nga auditimi u konstatua se auditi i brendshëm është krijuar më Urdhrin nr. 915 Prot., datë 29.04.2016 duke emëruar vetëm një specialist i lartë auditi, struktura ka ndryshuar duke e krijuar si sektor por përsëri brenda periudhës objek auditimi ka funksionuar vetëm me një auditues. U konstatua se nga mos plotësimi i kritereve ligjore, auditimi është kryer vetëm me një punonjës në kundërshtim me ligjin për auditin e brendshëm gjë e cila nuk siguron pavarësinë e plotë të auditimeve të kryera. Nuk sigurohet kontrolli i cilësisë, raportet e auditimit nuk janë hartuar sipas afateve të përcaktuara në manual duke mos u lenë mundësinë e observacioneve njësisë që auditohet në kundërshtim me Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", VKM nr. 83 datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, pika 3 ku ndër të tjera përcaktohet se: "3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë". Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar.

22.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, të merren masa për plotësimin e zyrës së auditit të brendshëm, me qëllim dhënien e sigurisë objektive dhe për përmirësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të Spitalit Rajonal Durrës, duke kryer veprimtarinë sipas Standardeve të Auditimit dhe zbatimin e afateve sipas manualit.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
Me Urdhër nr. 822/2 prot, datë 24.05.2021 është emëruar Përgjegjese e Sektorit të Auditit Znj. S. I.; - Me urdhër nr.419/10 prot, datë 07.06.2021 është emëruar specialiste e lartë auditi Znj. D. F.; - Me urdhër nr. 1824 prot, datë 26.10.2021 është emëruar Specialiste e Lartë Auditi Znj. S. D.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

22.2 Gjetje nga auditimi: Pagesat e mjekëve të shërbimit të kirurgjisë si pjesë e një spitali universitar duke u bazuar në VKM nr. 70, datë 15.02.2001, ndryshuar me VKM nr.448, datë 09.07.2004, pika 1 "...dhe shërbimi kirurgjikal i spitalit të Durrësit janë qendra kombëtare mjekimi, arsimimi dhe kërkimi, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të

Tiranës ...", dhe VKM nr.555, datë 11.08.2011 për "Miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë spitalit Universitar të Traumës, si dhe për Trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura", pika1, 12/1, shërbimi i kirurgjikal i Spitalit Rajonal të Durrësit trajtohet si pjesë e një spitali universitar.

-Pagesat për turnet 24 – orëshe të mjekëve roje të parë, në shërbimin e kirurgjisë, për ditë të zakonshme paguhen 6,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 5,600 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të shtuna paguhen 7,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 6,000 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të diela paguhen 8,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 7,000 lekësh të spitaleve rajonale.

-Pagesat për turnet 24 – orëshe të mjekëve roje të dytë, në shërbimin e kirurgjisë, për ditë të zakonshme paguhen 5,600 lekë, përkundrejt pagesës prej 5,200 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të shtuna paguhen 6,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 5,600 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të diela paguhen 7,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 6,600 lekësh të spitaleve rajonale.

-Sa më sipër, për periudhën objekt auditimi, duke u bazuar në VKM – të e sipërpërmendura, për mjekët e Shërbimit të Kardiologjisë në Spitalin Rajonal Durrës, për çdo shërbim roje 24 orë pa ndërprerje, pagesat janë kryer duke e konsideruar këtë pavijon si qendër spitalore universitare, në vlerën **9,492,800 lekë**.

-Nga kontratat e lidhura me FSDKSH rezulton se në asnjë nga nenet nuk përcaktohet fakti se shërbimi i kirurgjisë trajtohet si spital universitar. Nga grupi i auditimit është bërë përllogaritja e vlerës që do të paguhej nëse mjekët e shërbimit të kirurgjisë do të paguheshin si pavijonet e tjera, vlerë e cila rezulton të jetë **8,563,800 lekë**. Referuar këtij fakti rezulton vlera e paguar shtesë prej **929,000 lekësh**. Po ashtu, dhe niveli i pagesës të mjekëve në këtë spital trajtohet si në spitalet universitare.

- Nga auditimi është konstatuar se stafi i këtij spitali është i paqartë lidhur me shërbimin 24 – orësh pa ndërprerje të mjekëve të këtij pavijoni, duke bërë kështu që këto pagesa të kryhen në kushtet e pasigurisë dhe të pa qartësisë lidhur me statusin e pavijonit në fjalë.

22.2.Rekomandimi: Spitali Rajonal i Durrësit në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe FSDKSH – në të marrin masa për sqarimin e statusit të shërbimit kirurgjikal në këtë spital, dhe për përcaktimin e saktë të nivelit të pagave mjekëve të shërbimit kirurgjikal.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:

Është përgatitur dhe dërguar shkresa Nr.1809 prot, datë 25.10.2021 drejtuar MSHMS dhe FSDKSH, për sqarimin e statusit të shërbimit të kirurgjisë së SRD-së. Në lidhje me korrigjimin e pagesave të mjekeve SRD-ja do të veproje pasi të marri nje përgjigje nga institucionet e sipercituara.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

C.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës "Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinen e hotelerise (godine 4 kateshe)", viti 2020 është konstatuar dorëzim i mallit ("Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinën e hotelerise (godine 4 katëshe) të SRD", për vitin 2020 pas **53 ditëve** kalendarike ose **35 ditë pune me vonesë** në Spitalin Rajonal Durrës.

Për procedurën e prokurimit "Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinen e hotelerise (godine 4 kateshe)", viti 2020 u konstatua: Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratën nr.1675/8, datë 28.10.2020 me operatorin fitues H. K. sh.p.k. me vlerë oferte 2,600,000 leke pa tvsh me afat realizimi 30 ditë nga dita e nënshkrimit të saj.

Titullarja e Autoriteti Kontraktor me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 ka ngritur komisionin për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje : A. F., N. M., R. Ç..Me shkresën nr.1675/10, datë 29.10.2020, titullarja e AK ka nxjerrë njoftimin e kontratës i cili është botuar në buletinin e APP nr.94, datë 2.11.2020.
Operatori ekonomik me shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor për pamundësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur dhe realizuar në kohë zbatimin e kontratës për shkak të vonesave në realizimin e disa pjesëve të ashensorit si dhe në ardhjen e pjesëve të tjera nga Italia për arsye të pandemisë Covid-19, dhe i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor shtyrjen e afatit të parashikuar në kontratë deri më datë 31.12.2020.
Amendimi kontratës bazuar në shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 të operatorit ekonomik dhe nenin 23 të kontratës është nënshkruar nga AK dhe operatori ekonomik më datë 31.12.2020 dhe realizimi i saj është shtyrë deri më datë 31.12.2020.
Me procesverbalin e datës 22.02.2021 nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje:A. F., N. M., R. Ç., ngritur me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 nga titullarja e AK është marrë në dorëzim ashensori nga vetëm dy anëtarë të komisionit të monitorimit të kontratës së mësipërme A. F. dhe R. Ç., ndërsa anëtari tjetër i grupit N. M. është larguar nga puna në datë 04.02.2021.
Përsa më sipër ashensori është dorëzuar në SRD pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj. Nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës nuk ka një relacion shpjegues për vonesën e shkaktuar në dorëzimin e mallit *"**Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe)"**, në Spitalin Rajonal Durrës por thjesht në procesverbalin e mbajtur në datë 22.02.2021 nga grupi i monitorimit të kontratës shprehet se malli i përmbush gjithë specifikimet teknike.*
Referuar ditarit të furnitorit për datën 22.02.2021, me faturën nr.150, furnitori "H. K." ka sjellë vlerën e prokurimit për likujdim **3,120,000 lekë me TVSH**, por nuk është kyer akoma likujdimi. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kryer një analizë mbi vonesat dhe penalitetet që duhet t'i mbahen operatorit ekonomik "H. K." sh.p.k që ka sjellë mallin me vonesë. Referuar kushteve të kontratës neni 23 , pika 23.3 shprehet në formë eksplicite se "Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesin me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes".
Ashensori është dorëzuar në SRD pas **53 ditëve kalendarike** ose **35 ditë pune me vonesë**, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj, referuar nenit 24, pika a të kontratës "Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës" për rrjedhojë vlera që SRD duhet t'i zbresë faturës së likujdimit për operatorin H. K. sh.p.k nga vlera totale e kontratës **është 661,440 lekë.**
Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet. Për pasojë vlera e penalitetit **661,440 lekë lekë përbën dëm ekonomik për SRD** si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE H. K. sh.p.k. Për mosevidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës.

1.1Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës **661,440 lekë** lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE H. K. sh.p.k.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm

SRD sqaron se **sipas urdhër xhirimit** datë 14.05.2021 është bërë xhirimi OE H. K. me vlere 2,302,560 lekë, pra duke i zbritur shumën 661.440 për 53 ditet që ka ardhur malli me vonesë.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

2. Gjetje nga auditimi: Në farmacinë e Spitalit Rajonal të Durrësit janë audituar me zgjedhje në total 29 lloje medikamentesh duke u orientuar drejt vlerës ekonomike dhe rëndësisë së përdorimit. Saktësisht u verifikuan: Sonde blakmore, Metmorfin, Carboplatin, Cefotaxim, Enalapril malate, Cefazoline 1 gr, Human Anti Imuglobine, Sevofluran 250 ml, Kontrast ct, Metoclopramid 10 mg, Vitamina C, Oxytocin, Kontrast Ct 370 mg / 100 ml, Diatro Cleaner, Bilirubine totale GA, Bilirubine direkte GA, Maglumi total PSA, Magnazium, Mesh PVDF/PP, Mesh PVDF, Adrenaline, pllakë dhs/scs, bombul intensive oksigjeni 3 – 5 litra, Cefepim, Cordaron, Dopamine, Docetacel, Isosorbit dinitrate 10 mg tab, Viper Venom.
Gjatë verifikimit të faktit rezultoi se lidhur me medikamentin e përdorur për skanerin me kontrast "Kontrast ct", rezultoi se nga 140 copë në programin Financa 5, në fakt në farmaci ishin vetëm 120. Kjo u justifikua nga ana e stafit të farmacisë me faktin se ka nevoja urgjente për skaner, dhe se ky medikament ishte dhënë me urdhër verbal. Ditën e nesërme KLSH-së nga ana e punonjësve të farmacisë u vunë në dispozicion fletë dalja me nr.dok 1936, datë 07.04.2021, sipas së cilës ishte bërë shkarkimi i 5 copë medikamente "kontrast ct". Pra përsëri rezultonte mungesë prej 15 copë medikamentesh. Pas konstatimit, u bë modifikimi ku fletëdalja nr.dok. 1936, datë 07.04.2021 paraqiste shkarkimin e 20 copë medikamentesh "kontrast ct".
Nga auditimi i ushtruar në magazinën e farmacisë së spitalit, u konstatua se:
-Në 1 rast kishte teprica në sasitë e medikamenteve.
-Në 4 raste kishte mangësi në sasitë e medikamenteve në vlerën **89,565** lekë.
Diferencat e konstatuara janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve", pika 89. Për pasojë vlera 84,006 lekë, që përbën vlerën e medikamenteve të munguara, përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.**
2.1.Rekomandim: Spitali Rajonal Durrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës **89,565 lekë** lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik për diferencat e konstatuara duke nxjerre dhe përgjegjësitë konkrete.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Nga Drejtoria është nxjerr Urdhëri për mase zhdëmtimi nr. 1878 prot., datë 03.11.2021 për shumën 89,565 lekë drejtuar personelit të farmacisë B. S., K. H. dhe N. P. Është arkëtuar shuma 89,565 lekë me mandat nr 936 prot, dt 8/11/2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

3. Gjetje nga auditimi: Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2019 dhe vitin 2020 konkretisht referuar kontratës së lidhur me subjektin "A. B.", SRD ka lidhur me këtë subjekt kontratën me nr. 611/1, datë 31.03.2017 me afat 1 vjeçar, për vitin 2018 nuk ka kontratë, dhe as për vitin 2019 nuk ka kontratë. Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2020, konkretisht referuar kontratës nr.728/1, datë 23.12.2019 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti "A. B." për llogari të SRD është 221, 640 lekë, referuar detyrimeve nga kontrata nr.135, datë 17.01.2020 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti "B. C." për llogari të SRD është 101,160 lekë.
Për pasojë për çdo detyrim kontraktor të pashlyer përsa më sipër për vitin 2019 dhe vitin 2020, Spitalit Rajonal Durrës i janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 322,800 lekë, vlerë e cila duhej kërkuar dhe arkëtuar për llogari të SRD nga shoqëritë "A. B." dhe "B. C.". Për sa më sipër mban përgjegjësi Njesia Monitoruese te Kontratave te

Qirasë për vitin 2019, ngritur me urdhrin nr.4 prot 50 dt 07.01.2019 dhe Njësia Monitoruese te Kontratave te Qirasë për vitin 2020, ngritur me urdhrin nr.41 prot dt 09.01.2020.

3.1.Rekomandim: Spitali Rajonal Durrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës **322,800 lekë** vlerë e cila përbën dëm ekonomik për SRD si detyrim kontraktor i pashlyer nga kontratat e qiramarrjes së ambienteve të Spitalit Rajonal Durrës, dhe duhet të dëmshpërblehet nga subjekti "A. B." në vlerën 221, 640 lekë dhe nga subjekti "B. C." në vlerën 101,160 lekë .

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
SRD sqaron se OE janë realizuar likuidimet për secilin nga detyrimet. 1.A. B. ka derdhur detyrimin shumën 221,640 lekë me datë 08.06.2021. 2.B. C. ka derdhur detyrimin prej 89,340 lekë me datë 09.082021. C. B. ka derdhur 11,820 leke me pak, pasi ne fatuën nr.11, date 01.12.2019 me vlerë 101,160 është dubluar qeraja janar, shkurt 2019.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Realizuar

4. Gjetje nga auditimi: Duke u bazuar dhe në problematikën e trajtuar nga auditimi i kryer në vitin 2019 nga FSDKSH Tiranë konstatohet se, nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës për vitin 2020 për 25 transaksione në vlerën totale 18,131,495.16 lekë referuar kontratës për furnizimin me karburant naftë me bot dhe me kartë elektronike, SRD ka paguar në llogari të operatorëve ekonomikë "K." SHPK dhe "K." SHA vlerën e taksës së markimit (0.614 lekë/litër) në vlerën 69,295 lekë e cila nuk parashikohet në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare" i ndryshuar, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr. 200, datë 13.03.2013, "Për miratimin e kontratës...", VKM nr. 498, datë 30.05.2013, "Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës" pika 1.3, pika 4.1, gërma b. **Vlera totale 69,295 lekë përbën dëm ekonomik për SRD dhe Buxhetin e Shtetit** vlerë e cila është përfituar padrejtësisht respektivisht nga OE "K." SHPK në vlerën 53,869 lekë dhe OE "K." SHA në vlerën 15,425 lekë.
4.1. Rekomandimi: SRD të marri masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës **69,295 lekë** si përfitim i padrejtë nga operatorët ekonomikë, konkretisht shuma 53,869 lekë nga OE "K." SHPK dhe shuma 15,425 lekë nga OE "K." SHA.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës është dërguar njoftimi OE K. shpk mbi shperblimin e dëmit ekonomik të konstatuar nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Larte i Shtetit me shkresën nr. 1893 prot., datë 05.11.2021, nga dokumentacioni I vendosur në dispozicion nuk rezulton që OE të ketë reaguar mbi njoftimin e kryer. Në njoftimin e dërguar Drejtoria e SRD-së ka vendosur një afat 30 ditorë nga momenti i marrjes njoftim për shlyerjen e detyrimit, në të kundërt ka ngarkohet Sektori Juridik mbi ndjekjen e çështjes në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës duke përgatitur dhe depozituar kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Nga ana e Sektorit Juridik nuk është zbatuar Vendimi i nxjerrë nga Drejtoria e SRD për përgatitjen e Kërkesë Padisë por është dërguar njoftim i dytë OE K. shpk me shkresën nr. 844 prot., datë 05.05.2022. Me shkresën nr. 844/1 prot., datë 21.06.2022 është përgatitur Kërkesë Padi për në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, u konstatua se Kërkesë Padia pranë kësaj Gjykate është depozituar me datë 05.07.2022. Mos depozitimi i Kërkesë Padisë pranë gjykatës mbi shpërblimin e dëmit ekonomik për një periudhë kohore nga momenti i njoftimit të OE me datë 05.11.2021 pra 8 Muaj me vonesë është i pa justifikuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

5. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 571/5 prot., datë 30.04.2020, titullari i SRD ka urdhëruar KPVV për zhvillimin e procedurës "Sigurim automjetesh" me fond limit 259,500 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 571/8 prot., datë 05.05.2020, është shpallur fitues OE "A." me fond limit 259,500 lekë pa TVSH. OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 187, datë 05.05.2020, në vlerën 259,500 lekë. Bashkëngjitur dokumentacionit justifikues të bankës ndodhen edhe siguracionet e automjeteve. Ky shpenzim është likuiduar më datë 10.08.2020, datë 17.11.2020, dhe datë 18.12.2020, në ABI Bankë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:
- Më datë 29.05.2019, është mbajtur procesverbali për konstatim defekti për Autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR 6279 D, nga z. L. Z. me detyrë shofer, z. M. Gj. me detyrë shofer dhe z. G. K. me detyrë Koordinator i Urgjencës.
- Më datë 25.06.2019, është mbajtur procesverbali për konstatim defekti për Autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR 6281 D, nga z. G. D. Z. me detyrë shofer, z. H. O. me detyrë shofer dhe z. G. K. me detyrë Koordinator i Urgjencës.
- Referuar procesverbaleve të përmendura më sipër, është mbajtur aktverifikimi nr. 712 prot., datë 23.04.2021, ku është konstatuar se të dy automjetet nuk janë në gjendje pune, ku bashkëlidhur këtij aktverifikimi ndodhen dhe fotografitë përkatëse për secilin automjet.
- Për autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR 6279 D është tërhequr karburant për herë të fundit sipas fletë-daljes nr. 23, datë 08.02.2019, 400 litra/naftë me tollon elektronik.
- Për autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR 6281 D është tërhequr karburant për herë të fundit sipas fletë-daljes nr. 22, datë 08.02.2019, 400 litra/naftë me tollon elektronik.
- Për të dy automjetet përgjatë vitit 2020, nuk është tërhequr karburant.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, për Autoambulancën MB CDI Model 211 DR 6279 D, dhe Autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR 6281 D, nga SRD janë paguar siguracione në vlerë totale 55,000 lekë ndërkohë që të dy automjetet nuk janë në gjendje pune që prej muajve respektive Maj dhe Qershor të vitit 2019. **Vlera 55,000 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik,** veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, ndryshuar me Ligjin nr. 10455, datë 21.07.2011" neni 4.

5.1. Rekomandimi: Nga Bordi Drejtues i SRD të analizohet kjo situatë duke nxjerrë përgjegjësitë respektive dhe të merret vendimi përkatës, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës 55,000 lekë.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm

Nga Drejtoria është nxjerrë Urdhëri për masë zhdemtimi Nr. 1896 prot, datë 05.11.2021 për shumën 55.000 lekë drejtuar anëtareve të komisionit të specifikimeve G. K., A. Xh. dhe N. M. Veprime të cilat u shqyrtuan në mbledhjen e Bordit Dretjues me datë 20.12.2021 dhe u lanë për ndjekje nga Drejtoria e SRD-së.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: Me vendimin e Bordit Drejtues nr.06, datë19.03.2018 është miratuar sistemi i punës 12–orë për shërbimin e Urgjencës në Spitalin Rajonal Durrës, dhe VKM nr.555, datë 11.08.2011 për "Miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë spitalit Universitar të Traumës, si dhe për Trajtimin e personelit

mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura", pika 1, 12/1, si dhe 12/2, pika c "për punonjësit e infermieristikës".
Nga auditimi u konstatua se duke u bazuar nga VKM nr.555, datë 11.08.2011, Bordi Drejtues me vendimin e nr.21, datë 09.06.2011 ka caktuar pagesën e shoferëve me sistemin e shërbimit 12 – orësh, me qëllim motivimin e këtij stafi, konkretisht për ditë të zakonshme 1,880 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 2,350 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 3,055 lekë/ditë shërbimi. Kjo vlerë është më e lartë krahasuar me përcaktimet e VKM nr.555, datë 11.08.2011 lidhur me pagesat e mjekëve të urgjencës dhe infermierët, të cilët për të njëjtin shërbim paguhen si më poshtë:
-Mjek urgjence: për ditë të zakonshme 1,800 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 2,000 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 2,300 lekë/ditë shërbimi,
-Infermierë roje urgjence: për ditë të zakonshme 1,100 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 1,400 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 1,700 lekë/ditë shërbimi.
Pra vendimi i Bordit është jokoherent dhe i pa argumentuar dhe i kategorizuar sipas niveleve të pagave e kritereve përkatëse, dhe bie në kundërshtim me përcaktimet në pikën 1 dhe 2, neni 80 "Shtesa mbi Pagë" i Kodit të Punës, në të cilin citohet se: "1. Me punë nate kuptohet puna e kryer nga ora 22 ^{00} deri në orën 6 ^{00} të mëngjesit. Vlera e paguar për periudhën objekt auditimi prej **15,001,225 lekë** përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e Spitalit Rajonal të Durrësit.

1.1.Rekomandim: Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të analizojë efektin financiar negativ prej **15,001,225 lekësh** dhe të marri masa për korrigjimin e pagesave të shoferëve për orët shtesë sipas turneve dhe ditëve përkatëse.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Ky rekomandim sipas detyrës së lënë nga Kryetarja e Bordit në mbledhjen e datë 14.12.2021 u shqyrtua në mbledhjen e Bordit Drejtues me datë 20.12.2021 sipas materialit me Nr. 2122/5 prot, datë 20.12.2021 të përgatitur nga grupi i punës me Kryetar anëtarin e bordit A. H.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

2.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 8 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **8,466,291 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për vitin 2019 janë humbur 5 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit, me vlerë **5,652,881** lekë, dhe për vitin 2020 janë humbur 3 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit, me vlerën **2,818,410**. Këto çështje janë dërguar për rekurs në Gjykatën e Shkallës të Lartë në Tiranë.
Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **8,466,291 lekë** *e cila konsiderohet efektit financiar negativ* për buxhetin e shoqërisë.
2.1.Rekomandim: Nga Drejtori, sektori Juridik dhe sektori i Burimeve Njerëzore të Spitalit Rajonal Durrës të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave te shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Sipas informacionit të dhënë nga Sektori Juridik me shkresën nr. 1805/2 prot, datë 27.10.2021, nga ky sektor janë evidentuar rastet (proceset) të cilëve i referohet auditi në raportin e kontrollit.

Gjithashtu janë përcaktuar detyrimi në vlerë monetare për secilin rast dhe vlera përkatëse e shërbimit përmbarimor. Vlerë kjo e fundit e cila nëse do të likujdohej vullnetarisht nga SRD-ja, do të ishte me e ulet. Nga viti 2018 e në vazhdim nuk është bërë asnjë shkëputje e marrdhënieve të punës të punonjësve të SRD-së. Vlera prej 8,466,291 Lekë, e konstatuar si efekt negativ i referohet 8 proceseve të filluara kohë më parë, jashtë periudhes së auditimit, konkretisht përgjatë viteve 2015 dhe 2016.
Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektori Juridik dhe strukturat drejtuese në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij në vijimësi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave lidhur me shpërblimin për situatën e krijuar nga pandemia COVID – 19, rezultoi se shpërblimet e punonjësve të angazhuar sa i takon kësaj periudhe janë dhënë pas faktit. Nga Spitali Rajonal i Durrësit janë bërë verifikimet e pacientëve të cilët janë paraqitur në urgjencën e spitalit, apo të pacientëve të cilët janë shtruar në spital, me listat që vinin nga Instituti i Shëndetit Publik, për të nxjerrë në një moment të dytë se cilëve nga pacientët që u është ofruar shërbimi mjekësor, kanë rezultuar me Covid – 19. Pas verifikimit të pacientëve të cilët kanë rezultuar të infektuar me COVID - 19, bëhet rakordimi se cili mjek, infermier, mami, sanitare kanë pritur dhe kanë pasur kontakt me të infektuarit. Nga shefat e pavijoneve hartohen listat e punonjësve të cilët kanë qenë në kontakt ne të infektuarit, dhe lista përfundimtare lidhur me shpërblimin përpilohet nga sektori i financës. Kjo listë miratohet nga titullari i institucionit, dhe dërgohet në mënyrë elektronike (me e-mail) në Ministrinë e Shëndetësisë. Në disa raste punonjësve ju janë dhënë më pak ditë nga sa ka qenë parashikuar në listën paraprake të dërguar në ministri, pra ka mos përputhje të dhënash. Nuk është hartuar një rregullore, plan veprimi dhe dhënia e shpërblimeve Covid – 19 është bërë në mënyrë rastësore bazuar në listat e paraqitura nga shefat e pavijoneve.
- Nga auditimi i listave të shpërblimeve rezulton se janë paguar në vlerën 735,096 lekë, punonjësi i krematorit dhe koordinatori. Në shpërblimeve rezulton se ka paqartësi në funksionin e kryer nga punëtori i krematoriumit gjatë periudhës të pandemisë. Në disa raste ky punonjës paraqitet si sanitar, punonjës dezinfektimi , mirëmbajtës, sanitar i mbetjeve spitalore. ashtu janë dhënë shpërblime për Koordinatorin pa pasur dokumentacion justifikues. Sa më sipër, vlera ***735,096 lekë*** konsiderohet ***efekt financiar negativ***.
3.1 Rekomandim: Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa lidhur me hartimin dhe miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të spitalit për periudhën e pandemisë Covid – 19, të hartohet plan veprimi lidhur me stafin mjekësor dhe atë mbështetës, bazuar në cilin më pas do të alokohen dhe shpërblimet. Po ashtu, nga Drejtoria të merren masa lidhur me analizimin vlerës të ***efekt financiar negativ*** prej ***735,096*** lekë të shkaktuar nga shpërblimet e dhëna ndaj stafit mbështetës të spitalit.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Rekomandimi nuk u shqyrtua për shkak se kjo gjetje nuk është lënë detyrë për Bordin Drejtues të SRD. Nuk është dhënë asnjë shpërblim që nga Muaji Qershor 2021. Referuar Urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë nr. 3080/2 prot., datë 07.07.2021 dhe Urdhrit nr. 3080/1 prot., datë 06.07.2021. Për çdo Muaj dërgohet Urdhër nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë mbi shpërblimet.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

4.Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Shërbim i evadimit të mbetjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës" për vitin 2019, me fond limit 1,608,029 lekë konstatohet se KVO ka skualifikuar OE A. P. me ofetë 1,188,000 lekë pasi ka paraqitur ofertë vetëm për një nga zërat e kërkuar dhe jo për shërbimin e "Transport dhe evadim dysheke" si

dhe OE F. – 2. me oferë 1,240,050 lekë është skualifikuar pasi ka ofruar më shumë se sasia e kërkuar

Nr.	Emërtim	Sasia	Cmimi/njësi	Cmimi total
1	Transport dhe evadim i mbejtjeve urbane	2409	450	1,084,050
2	Transport dhe evadim dysheke	130	1200	156,000
Totali pa TVSH		**1,240,050**		
Totali me TVSH		**1,488,060**		

Sasia e kërkuar është 2079 m3
Operatori i F.-2. është skualifikuar pasi ka ofertuar më shumë njësi si edhe shumatore e çmimit për njësi është më i madh por realisht zëri "Transport dhe evadim dysheku" është fiks në sasi dhe nuk është objekt ndryshim sasie në marrëveshjen kuadër. Zëri që është objekt ndryshimi sasie është "Transport dhe evadim i mbetjeve urbane" dhe cmimi për njësi i cili duhet të krahasuar. Gjithashtu kriteri i vlerësimit në DST është "cmimi më i ulët" dhe jo "cmimi më i ulët për njësi". Baza për vlerësim nga KVO janë kriteret dhe metodat e përshkruara në DST.
KVO nuk ka komunikuar apo kërkuar spjegime nga OE duke qenë se oferta e paraqitur është ekonomikisht më e favorshme dhe nga një rillogaritje e ofertës duke ulur sasinë e kërkuar oferta është 1,091,550 lekë ose 353,380 lekë më pak se OE i shpallur fitues në kundërshtim me Neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" i Vendimit të KM nr. 941, datë 29.12.2014 "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar
Neni 1 "Objekti dhe qëllimi", Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

4.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës, komisionet e vlerësimit të ofertave të marrin masa që rast pas rasti të shqyrtojnë dhe vlerësojnë me përgjegjësi duke kërkuar shpjegime nga OE në rastet kur e gjykojnë të nevojshme dhe ofertat janë ekonomikisht të favorshme për institucionin dhe eleminimin e shpenzimeve jo efektive prej 353,380 lekë.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Për procedurën "Shërbimi evadimit të mbetje urbane për SRD për vitin 2019", nga Drejtoria janë marrë Vendimet për masë disiplinore, Nr.1895 prot, datë 05.11.2021 drejtuar Znj. R. C. dhe Nr.1880 prot, datë 05.11.2021 per Znj. E. C.. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektori i Prokurimeve dhe KVO gjatë realizimit të procedurave të prokurimit në vijimësi.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të furnizimit u konstatua se në 2 raste grupet e marrjes në dorëzim nuk kanë verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave të marrë në dorëzim, konkretisht:
- Për zbatimin e Marrëveshjes Kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019 lidhur midis SRD të përfaqësuar nga G. K. (në mungesë me porosi) dhe z. B. C., administrator i G. shpk, në asnjë rast grupi i marrjes në dorëzim nuk ka dokumentuar verifikimin e kite/reagenteve në lidhje me origjinën e mallrave dhe kompanisë prodhuese në përputhje me kërkesat e kontratave të lidhura.
Si dhe grupi i marrjes në dorëzim ka pranuar kite dhe reagente jo sipas afatit të skadencës të specifikuar në kontratë në vlerën 1,223,100 lekë me TVSH, që janë në kundërshtim me specifikimet teknike të Ankesit nr. 1 të Marrëveshjes Kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019.
- Nga auditimi i zbatimit të Marrëveshjes Kuadër nr. 1535/1 datë 31.08.2020 për 5 lote, me

operatorin G. shpk me Lotin 1-4 dhe me operatorin K. shpk për Lotin 5 rezulton se deri në fund të periudhës objekt auditimi janë marrë në dorëzim kite dhe reagente në vlerë 1,794,360 lekë për të cilat nga grupi i marrjes në dorëzim nuk ka verifikuar plotësimin e kushtit të skadencës dhe si e tillë nuk mund të shprehemi zbatimin e kësaj kontrate në kundërshtim me Marrëveshjen Kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019 lidhur midis SRD dhe G. shpk, Marrëveshjes Kuadër nr. 1535/1 datë 31.08.2020 për 5 lote, me operatorin G. shpk me Lotin 1-4 dhe me operatorin K. shpk për Lotin 5.

5.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës dhe Grupet e Marrjes në Dorëzim të marrin masa që të verifikojnë plotësimin e të gjitha kritereve dhe të shprehen në mënyrë eksplicite në procesverbalet e hartuara për këtë qëllim.
Spitali Rajonal Durrës të analizojë situatën për pranimin e mallrave jo sipas specifikimeve teknike në vlerën **1,223,100 lekë** me TVSH dhe mos shprehjen e plotësimit të kritereve në vlerën **1,794,360** lekë për të cilat nga grupi i marrjes në dorëzim nuk ka verifikuar plotësimin e kushtit të skadencës.
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Për pikën e parë të rekomandimit do të mbahet në konsideratë nga Grupet e Marrjes në dorëzim të mallit gjatë realizimit të procedurave të prokurimit në vijimësi.
Për pikën e dytë nga SRD është analizuar situate dhe janë nxjerrë përgjegjësi duke marrë vendimet për masa disiplinore, me Nr. 1907 prot, datë 05.11.2021 për punonjësen A. I., Nr. 1906 prot, datë 05.11.2021 për punonjësen B. S., dhe Nr. 1908 prot, datë 05.11.2021 për punonjësen S. K..
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se:
- Për kontratën nr. 20795/5 prot., datë 18.09.2018, të lidhur midis SRD dhe OE "M." SHPK për procedurën "B11-Blerje barna anestezi renimacion dhe sistem kardiovaskular" me fond limit 104,040 pa TVSH, për Lot 2 afati i skadimit të barnave (Adrenalinë në vlerën 36,393 lekë) është 8.5 muaj, pra më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës (9.5 muaj) dhe më pak se 12 muaj, referuar të dy klauzolave të përcaktuara në specifikimet teknike në kontratë.
- Për kontratën nr. 2079/6 prot., datë 18.09.2019, të lidhur midis SRD dhe OE "M." SHPK për procedurën "Blerje barna sistemi nervor" me fond limit në vlerën 1,407,888 lekë pa TVSH, për Lot 1 afati i skadimit të barnave (Morfine 10mg/1mlx10amp në vlerë 211,680 lekë) është 9.5 muaj, pra më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës (10.5 muaj) dhe më pak se 12 muaj, referuar të dy klauzolave të përcaktuara në specifikimet teknike në kontratë.
- Për kontratën nr. 2308/7 prot., datë 04.10.2018, të lidhur midis SRD dhe OE "G." SHPK për procedurën "Blerje Kite Reagent (teste) për analizën e astrupogrames dhe elektroliteve" me fond limit në vlerën 768,000 lekë pa TVSH, afati i skadimit të Kiteve Reagentëve (Kartixhe Ph PO2PCO2 në vlerën 364,875 lekë) është më pak se 12 muaj.
- Për kontratën nr. 1836/6 prot., datë 01.08.2018, të lidhur midis SRD dhe OE "G." SHPK për procedurën "Blerje Kite dhe Reagent për SRD" me fond limit në vlerën 9,999,999 lekë pa TVSH, për Lot 8 afati i skadimit të Kiteve Reagentëve (Blood-Agrar në vlerën 36,000 lekë dhe X.L.D. Agrar në vlerën 30,552 lekë) të marra në dorëzim është më pak se 24 muaj.
Referuar kontratave të sipërpërmendura Barnat dhe Kite Reagentëve të cilat janë marrë jashtë afateve të skadencës jo sipas përcaktimeve në specifikimet teknike, **vlera 679,500 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi,** veprime këto në kundërshtim me afatet e skadencave të përcaktuara

Aneksi nr. 2, (sipas DST ref. Shtojca nr. 10) referuar kontratave respektive të lidhura midis SRD dhe OE.

6.1. Rekomandimi: Drejtori i Spitalit dhe Bordi Drejtues i SRD, të analizojnë efektin negativ financiar në vlerën 679,500 lekë si dhe të marrin masa për të ngritur një grup pune për verifikimin nëpërmjet sistemit të fletëdaljeve nga Farmacia e Spitalit, sasinë e medikamenteve të konsumuara brenda afatit të skadencës referuar kontratave të sipërpërmendura. Në rast evidentimi të sasisë së mbetur të skaduar nga këto medikamente, të llogaritet vlera e tyre dhe t'i kërkohet operatorëve ekonomikë sipas kontratave përkatëse si dhe të ngarkohen me përgjegjësi personat përgjegjës për pranimin e mallit jashtë kushteve kontraktuale. Nga komisionet e marrjes në dorëzim të barnave, të zbatohen me përpikëmëri marrja e tyre konform të gjithë kërkesave dhe specifikimeve teknike të kontraktuara.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm

Ky rekomandim sipas detyrës së lënë nga Kryetarja e Bordit në mbledhjen e datë 14.12.2021 u shqyrtua në mbledhjen e Bordit Drejtues me datë 20.12.2021 sipas materialit me Nr.2163 datë 20.12.2021 të përgatitur nga grupi i punës me Kryetar anëtarin e Bordit Dr. F.Sh. dhe u konkludua së praktika nuk ka sjell dëm financiar për arsye sepse të gjitha barnat janë konsumuar brënda afatit të skadencës por u la në vëmendje të Drejtorisë për mos përsëritjen e rastit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se, për një rast të përfitimit të shërbimit nga OE "A.", për të cilën nuk është përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimit publik" i ndryshuar, neni 4. SRD për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 21.11.2019, ka përfituar shërbim nga OE "A." për përdorimin e telefonave fiks. Në total për këtë shërbim SRD i ka paguar vlerën 211,590 lekë OE "A.". Për këtë shërbim nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet palëve. Pagesa për këtë shërbim kryhet vetëm me dorëzimin e faturave mujore nga operatori ekonomik. **Vlera 211,590 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike,** veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 4.

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit dhe Sektori i Financës të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për kontratat e lidhura pa i'u nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike siç është ai i rastit të mësipërm në vlerën 211,590 lekë.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm

Nga drejtoria e SRD-së, sipas rekomandimit të lënë janë nxjerrë përgjegjësit duke marr Vendimin për masë disiplinore nr. 1911 prot, datë 05.11.2021 për Znj. I. V., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektori të Financës në SRD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vijimësi.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se, për procedurën **"Punime hidroizolim tarrace për godinën e Kirurgjisë së SRD"** me fond limit 8,679,321 lekë pa TVSH, më datë 29.06.2018, është shpallur fitues OE "M." SHPK me fond limit 5,034,331 lekë pa TVSH. Midis SRD dhe OE "M." SHPK është lidhur kontrata dypalëshe nr. 2208/2 prot., datë 04.09.2018. Më datë 02.10.2018, nga OE është mbajtur situacioni

përfundimtar i punimeve. OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 94, datë 02.10.2018, në vlerën 5,921,933 lekë me TVSH, likuiduar me transaksionin më datë 24.01.2019, në ABI Bankë.
Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, SRD nuk ka bërë zbritje garancinë në masën 5% në vlerën 296,097 lekë por likuidimi është kryer për të gjithë vlerën e faturës tatimore dhe kontratës duke shkëputur marrëdhëniet kontraktuale me OE "M." SHPK duke tejkaluar angazhimet e kontratës dypalëshe ku përcakton se pagesa e garancisë duhet të kryhet pasi të përfundojë afati prej 24 muaj i garancisë për mbulimin të defekteve. Sipas të dhënave të pasqyruara në certifikatën e marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve, "Shuma prej 296,097 lekë me TVSH", ekuivalente me 5% të vlerës me të cilën mbyllen punimet do të zhbllokohet në favor të Kontraktuesit pas përfundimit të periudhës së garancisë së defekteve me (24 muaj pas certifikimit të marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve).
Vlera 296,097 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe krijon risk të lartë për garantimin e defekteve të punimeve brenda periudhës së garancisë, veprimeve këto në kundërshtim me Kontratën dypalëshe lidhur midis SRD dhe OE "M." SHPK nr. 2208/2 prot., datë 04.09.2018, neni 14.1.
8.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit dhe Bordi Drejtues i SRD të analizohet efekti negativ financiar në vlerën 296,097 lekë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara për mos mbajtjen e garancisë së punimeve për procedurën e prokurimit "Punime hidroizolimi tarrace për godinën e Kirurgjisë së SRD", si dhe është e domosdoshme marrja e masave urgjente për evidentimin dhe korrigjimin e të gjitha praktikave, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen referuar akteve ligjore në fuqi.
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Për këtë rekomandim u konstatua se periudha e garancisë ka perfunduar pa problematika dhe në fund të saj vlera e garancisë gjithësesi do ti kthehej OE. Sipas rekomandimit të lënë nga ana juaj është marr Vendimi për masë disiplinore nr.1911 prot, datë 05.11.2021 për Znj. I. V. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës. Veprime të cilat u shqyrtuan në mbledhjen e Bordit Dretjues me datë 20.12.2021 dhe u ngarkua Drejtoria e SRD-së për mospërsëritje të rastit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

9. Gjetje nga auditimi: Për automjetet që disponon SRD konstatohet se, nuk kanë kartela përkatëse, në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to ku, gjithashtu duhet të jetë evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime të cilat nuk mund të përllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre. Nga verifikimi dhe përllogaritja e të dhënave të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, sasia e tërhequr nuk përputhet me kilometrat e përshkruara dhe nuk justifikohet me dokumentacion justifikues konkretisht janë tërhequr më tepër 1452 litra/naftë në vlerën 235,581 lekë, të cilat nuk janë plotësuar me dokumentacion justifikues. Nga ana menaxheriale e administrimit të SRD, Drejtori i Spitalit në cilësinë e nëpunësit zbatues, Përgjegjësit të Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, Sektori Teknik, pjesa menaxheriale e caktuar për menaxhimin e aktiveve nuk janë marra masat për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të SRD, nuk janë kryer kontrolle për llogaritjen e konsumit real të karburantit. **Vlera 235,581 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.**

9.1. Rekomandimi: SRD, Sektori i Financës, Sektori Teknik, të marrë masa, për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe efiçencë të tij.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:

Nga Drejtoria e SRD është nxjerr Urdhëri me Nr. 1910 prot, datë 05.11.2021 drejtuar sektorëve përkatës për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike.
Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë nga Sektorët përkatës në vijimësi.
Nga ana e SRD-së u paraqit dokumentacioni mbi monitorimin e konsumit të karburantit që nga momenti që është dhënë rekomandimi nga KLSH e deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit dokumentacioni i paraqitur nuk është mbajtur sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet i pa zbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pa zbatuar

9.2 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës dhe Sektori Teknik të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Nga Drejtoria është nxjerr Urdhëri me Nr. 1910 prot, datë 05.11.2021 drejtuar sektorëve përkatës. Nga koordinatori i urgjencës nuk administrohet relacioni apo dokumentacion justifikues mbi ecurin e zbatimit të rekomandimit, nëse janë hartuar kartelat e automjeteve.
Nga ana e SRD-së u paraqit dokumentacioni mbi monitorimin e konsumit të karburantit që nga momenti që është dhënë rekomandimi nga KLSH e deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit dokumentacioni i paraqitur nuk është mbajtur sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pa zbatuar

10.Gjetje nga auditimi: Në vitin 2019, numri mesatar faktik i punonjësve në SRD ka qenë 656 punonjës dhe fondi total i realizuar për pagat ka rezultuar në vlerën 493,405,888 lekë.
Sipas programit ekonomik për vitin **2019**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2017 është realizuar 655 punonjës. Fondi i pagave i planifikuar është 493,014,000 lekë, pra **391,888 lekë** më shumë se programi.
Sipas programit ekonomik për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 648.8 punonjës. Fondi i pagave është 508,000,000 lekë, kurse realizimi është 491,796,305, pra 16,203,695 lekë më pak se programi.
Sipas programit ekonomik për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në **Janar 2021** është realizuar 669 punonjës. Fondi i pagave është 53,475,000 lekë, kurse realizimi është 47,833,915 lekë, pra 5,641,085 lekë më pak se programi.
-Lidhur me nivelin e pagave, nga auditimi konstatohet se për **vitin 2019**, parashikimi i nivelit mesatar të pagave është 58,692 lekë/punonjës, kurse fakti është 61,599 lekë/ punonjës, pra **tejkalim** në vlerën **2,907 lekë/punonjës.**
-Për **vitin 2020**, parashikimi i nivelit mesatar të pagave është 60,476 lekë/punonjës, kurse fakti

është 63,167 lekë, pra ka **tejkalim** në vlerën **2,691 lekë/ punonjës**.
-Për **muajin Janar 2021**, parashikimi i nivelit të pagave është mesatarisht 76,393 lekë/punonjës, kurse fakti është mesatarisht 71,500 lekë, pra ka **mos realizim** në vlerën **4,893 lekë/ punonjës**.
Sa më sipër tejkalimi i fondit të parashikuar të pagave për vitin 2019 përbën efekt **financiar negativ** në vlerën **391,888 lekë.**

10.1.Rekomandim: Bordi Drejtues dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të merren masa për analizimin e vlerës të efektit financiar prej **391,888 lekësh** dhe për plotësimin e nevojave për punonjës të shoqërisë referuar parashikimeve të programit ekonomik.
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Pagesat janë kryer sipas Vendimeve të Bordit në zbatim të Udhëzimeve të dërguara nga Ministria e Shëndetësisë.
-Shkresa Nr.5106 prot, datë 07.10.2016, regjistruar me tonën me nr.2099 prot, datë 12.10.2016. Për pagesën e mjekut të rojes 24 orësh, në shërbimet spitalore të vendit;
-Shkresë Përcjellëse Nr. 811/1 prot, datë 10.07.2019 i DRFSDKSH Durrës;
-Shkresa nr.614/1 prot datë 05.02.2018 i Zv.Ministrës së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
-Vendimi nr.07 datë 13.03.2019 i Bordit Drejtues dhe Nr. 540 prot, datë 13.03.2019;
-Dërgim urdhëri për zbatim nr. 5058/1 prot, datë 10.10.2016 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe tonën me nr. 2058 prot, datë 12.10.2016; - Shkresa nr.1844 prot, datë 12.07.2018 i DRFSDKSH; -Dërgim shkresë nr.1719 prot, datë 27.06.2018 nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës; Urdhëri i Brendshëm nr.2098/1 prot, datë 16.10.2016 i Ish titullarit të SRD-së;-Për pagesën e MPF që kryejnë shërbimin e pediatrisë pranë SRD-së me nr. 1142 prot, datë 13.06.2019 i DRFSDKSH; - Miratimi kërkesës për shtyrje të kohës së daljes në pension me Nr. 420 prot, datë 03.03.2021 i Zv.Ministri i MSHMS; - Kontratat për punësim me kohe të pjesshme nr.892/4 prot, datë 17.05.2016; - Kontratat për punësim me kohë të pjesshme nr.1580/3 prot, datë 12.08.2016; - Kontratat për punësim me kohë të pjesshme nr.781/4 prot, datë 01.06.2016;
Veprime të cilat u shqyrtuan në mbledhjen e Bordit Dretjues me datë 20.12.2021 dhe u lanë për ndjekje nga Drejtoria e SRD-së.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

11. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi për sa i përket furnizimit me ujë të vet institucionit, SRD operon nëpërmjet dy kontratave të lidhura me UKD SHA konkretisht, kontrata nr. 1527002 dhe kontrata nr. 1088586. Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se, për 61 transaksionet e kësaj periudhe (2019-2020) në vlerën 31,399,200 lekë rezultojnë kamatëvonesa të akumuluara të mbartura para periudhës objekt auditimi të cilat lindin detyrimin në vlerën 380,114 lekë ndaj UKD si pasojë e mos likuidimit në kohë të faturave për konsumin e ujit. Shlyerja e detyrimeve në vlerën **380,114 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit, do të sjellë efekt negativ financiar.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002, "Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv" i ndryshuar, neni 1.

11.1. Rekomandimi: Nga Bordi Drejtues i SRD të analizohet vlera 380,114 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me mos likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj UK Durrës SHA, si detyrime të mbartura. Të evidentohen përgjegjësit dhe të merret vendimi përkatës. Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në mos likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj UK Durrës SHA, është e domosdoshme marrja e masave urgjente për korrigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Nga drejtoria e SRD-së, janë marr masat për korrigjimin e kësaj praktike me qëllimin likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj UK Durrës sha.
Bashkangjitur kartele për vitin 2022 ku paraqiten likuidimet në kohë reale.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces

E. MASA DISIPLINORE

E.1 Mbështetur në nenin 12 të statutit të Spitalit Rajonal Durrës miratuar me VKM nr.560, datë 23.10.2000 ndryshuar me VKM nr.237, datë 12.04.2006 dhe VKM nr.76, datë 19.01.2007, i rekomandojmë Bordit të Spitalit të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive dhe shkallës së përgjegjësisë për Drejtorin e Spitalit Rajonal Durrës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore **"Largim nga detyra"** për :

Znj. N. J. me detyrë Drejtoreshë e Spitalit Rajonal Durrës
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm
Ky rekomandim sipas Vendimit me Nr.22 datë 14.12.2021 dhe nr. 2122 prot, datë 14.12.2021 të Bordit Drejtues, u shqyrtua në mbledhjen e Bordit Drejtues me datë 20.12.2021 sipas materialit me Nr.2164 prot, datë 20.12.2021 të përgatitur nga Komisioni perkatës. Ku u konstatua se Komisioni i Vlerësimit ka vlersuar se masa disiplinore "Largim nga Detyra" nuk qëndron dhe ka vendosur të propozojë "Rishikimin e masës së rekomanduar nga grupi i auditimit të KLSH-së nga masa "Largim nga Detyra" në "Verejtje me shkrim".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar (ezauruar)

E.2 Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, Kontratën Kolektive të Punës neni 19, si dhe Kontratat Individuale të Punës , i rekomandojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive dhe shkallës së përgjegjësisë për punonjësit si vijojnë, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore **"Vërejtje me shkrim"** për :

1. **E. M.**, me detyrë shefe e Laboratorit Biokimik

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **E. M. nuk është dhënë masë disiplinore pasi ka shkëputur marrdhëniet e punës me Spitalin Rajonal Durrës datë 05.07.2021**
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar (ezauruar)

2. **S. K.**, Laboratori i Anatomisë Patologjike, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike,

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **S. K. është dhënë masë disiplinore "Vërejtje me shkrim" me shkresën nr.** 1908**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

3. **A. I.**, ekonomiste, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:

Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **A. I. është dhënë masë disiplinore "Vërejtje me shkrim" me shkresën nr. 1907 ., datë 05.11.2021.**

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

4. D. M., Laboratori i Mikrobiologjisë, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **D. M. nuk është dhënë masë disiplinore pasi ka shkëputur marrdhëniet e punës me Spitalin Rajonal Durrës me shkresën nr. 1276/4., datë 19.07.2021.**
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar (ezauruar)

5. B. S., Farmaciste, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **B. S. është dhënë masë disiplinore "Vërejtje me shkrim" me shkresën nr.** 1906 **., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar
6. M. K., shefe e Laboratorit Biokimik, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike dhe grupit të marrjes në dorëzim për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **M. K. nuk është dhënë masë disiplinore pasi ka shkëputur marrdhëniet e punës me Spitalin Rajonal Durrës datë 19.07.2021.**
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pazbatuar

7. F. I., ekonomiste, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **F. I. nuk është dhënë masë disiplinore pasi ka shkëputur marrdhëniet e punës me Spitalin Rajonal Durrës datë 19.07.2021.**
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar (ezauruar)

8. A. M., Farmaciste, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **A. M. nuk është dhënë masë disiplinore pasi ka shkëputur marrdhëniet e punës me Spitalin Rajonal Durrës, datë 19.07.2021.**
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar (ezauruar)

9. E. R. me detyrë Shef Sektori i Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për arsye se :
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **E. R. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vemendje" me shkresën nr.** 1915 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

10. G. K. me detyrë Zv.Drejtor i Shërbimeve Klinike në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për arsye se :
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **G. K. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vemendje" me shkresën nr.** 1914 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

11. E. P. me detyrë Inxhinier Elektrik në cilësinë e anëtarit të grupit të monitorimit të kontratës "Furnizimi i SRD për me oksigjen për vitin 2019"
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **E. P. është dhënë masë disiplinore "Vërejtje me shkrim" me shkresën nr.** 1900 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

12. M. M., me detyrë farmaciste në cilësinë e e anëtarit të grupit të monitorimit të kontratës "Furnizimi i SRD për me oksigjen për vitin 2019"
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **M. M. është dhënë masë disiplinore "Vërejtje me shkrim" me shkresën nr.** 1909 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

13. M. Xh. me detyrë specialiste e lartë në sektorin e financës në SRD në cilësinë e anëtarit të grupit të monitorimit të kontratës "Furnizimi i SRD për me oksigjen për vitin 2019"
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **M. Xh. është dhënë masë disiplinore "Vërejtje me shkrim" me shkresën nr.** 1905 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

E.3 Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, dhe Kontratës Kolektive të punës me nr. 1308/1 prot., datë 26.02.2018, neni 19, "Masat disiplinore", pika a, i rekomandojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive dhe shkallës së përgjegjësisë për punonjësit si vijojnë, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore **"Tërheqje vëmendje"**, për:

1. znj. A. D., përgjegjëse e sektorit të mjedisit, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **A.D. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vëmendje" me shkresën nr.** 1902 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

2. znj. B. K., specialiste e sektorit të shërbimeve mjedisore, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **B. K. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vëmendje" me shkresën nr.** 1903 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

3. znj. G. Q., ekonomiste, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **G. Q. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vëmendje" me shkresën nr.** 1897 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

4. z. I. D., në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **I. D. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vëmendje" me shkresën nr.** 1898 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

5. z. H. P., në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **H. P. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vëmendje" me shkresën nr.** 1901 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

6. z. E. K., në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **E. K. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vëmendje" me shkresën nr.** 1899 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

7. **z. B. M.**, në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **B. M. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vëmendje" me shkresën nr.** 1904 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

9.znj. E. C., në cilësinë e anëtares së grupit për hartimin e specifikimeve teknike, për arsye se:
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. **E. C. është dhënë masë disiplinore "Verejtje me shkrim" me shkresën nr.** 1880 prot**., datë** 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

10. znj. I. V. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës të Spitalit Rajonal Durrës.
Qëndrimi i SRD për Rekomandimin e mësipërm:
SRD sqaron se për znj. I.V. është dhënë masë disiplinore "Terheqje Vemendje" me shkresën nr. 1911 prot., datë 05.11.2021.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

Me shkresën nr. 1142/7, datë 01.08.2022 (protokolluar në KLSH me nr. 600/26, datë 08.08.2022) janë parqtiur observacione në lidhje me Aktkonstatimin por që nuk janë trajtuar në projektraport dhe po trajtohen në raport përfundimtar dhe u morrë parasysh. Me shkresën nr. 1608/2, datë (protokolluar në KLSH me nr. 600/64, datë 03.10.2022) u paraqitën observacione të cilat u morrën parasysh.

SPITALI RAJONAL SHKODËR

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në SRSH mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", SRSH, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, duke mos respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
- Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III. Rekomandimet e KLSH
- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 131/9, datë 21.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:
a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **30 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 3,925,541** l**ekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **8 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 56,952,412 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH
Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	30	30	-	-
3	Shpërblim dëmi	4	4	-	-
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-

5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	8	8	-	-
7	Masa disiplinore	22	22	-	-
8	Masa Administrative	2	2	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e SRSH

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	30	11	0	10	9
3	Shpërblim dëmi	4	0	0	4	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	8	0	0	4	4
7	Masa disiplinore	22	20	0	0	2
8	Masa Administrative	2	0	0	0	2

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*

2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI
Nga auditimi i zbatimit të rekomandimve rezulton se SRSH nga 30 masa organizative ka pranuar 30 prej tyre ose 100% të masave dhe masat e pranuara 2 janë zbatuar plotësisht ose 6% e masave të rekomanduara, janë 16 masa janë në proces zbatimi ose 53% e masave të rekomanduara dhe 12 masa nuk janë zbatuar ose 41% e masave të rekomanduara. Nga 8 masa 3-E, 4 janëë në proces ose 50% e masave të rekomanduara dhe 4 nuk janë zbatuar ose 50% e masave të rekomanduara.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 6%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", SRSH, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, duke mos respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

B. OPINIONI I AUDITIMIT

Auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko financiare të Spitalit Rajonal Shkodër, është bazuar në ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003, "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik *ISSAI 4000, ISSAI 4100* dhe *ISSAI 4200.* Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se veprimtaria e aktivitetit të Spitalit Rajonal Shkodër, janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, kjo referuar kërkesave në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera rregullator në zbatim të veprimtarisë së institucionit, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **opinionit të kualifikuar.**

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale. Konkluzionet dhe opinioni ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Strukturat përgjegjëse të Spitalit Rajonal Shkodër, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme.

Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme. Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në parimet themelore të auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të standardeve ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit. Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 "Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë", ISSAI 1500 (ISA 500)[23] dhe ISSAI 1530 (ISA 530)[24] ; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinioni në këtë auditim përputhshmërie. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinioni të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

Mbështetur në gjetjet nga auditimi, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar, për aspekte të ndryshme, kryesisht të lidhura me shkelje të procedurave të prokurimit në shumën 50,362,661 lekë, të krijimit të

[23] Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.

[24] Objektivi i audituesit është të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.

stokut të barnave në shumën 11,116,722 leke, si dhe të rritjes së shpenzimeve operative kryesisht për energjinë elektrike dhe ujin, i konsumuar nga koncesionari "S. S." në shumen 9,599,040 leke, dhe mungesës së arkëtimit të të ardhurave nga përdorimi i ambientit nga koncesionari "S. S." në shumën 1,598,400 leke. Gjithashtu dhe për shkak të pushimeve të pajustifikuara nga puna të punonjësve, te cilët do te përfitojnë 2,299,192 lekë nga buxheti i shtetit mbi bazën e vendimeve gjyqësore., etj.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SRSH, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
Nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 56 rekomandime te pranuara plotësisht nga SRSH, nga te cilat :
-31 masa organizative, 20 prej tyre janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 9 masa janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.
-Për zhdëmtim e dëmit ekonomik të shkaktuar janë rekomanduar 11 masa, 7 prej tyre janë ne proces, 1 është zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht dhe 2 nuk janë zbatuar.
-Për eliminimin e efekteve negative financiare ne buxhetin e shtetit, janë lënë 2 rekomandime, nga të cilat 1 është zbatuar pjesërisht dhe 1 rekomandim është proces zbatimi.
-Për parregullsitë e konstatuara janë rekomanduar 12 masa disiplinore për personat përgjegjës, të cilat janë zbatuar plotësisht.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 13-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Nga Spitali Rajonal Shkodër, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultojnë në proces, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në nenin 15 pika 2 e Kontratës me nr. 45/2 date 13.01.2020, Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, për vitin 2020 nuk ka ngritur komision "ad hoc" për planifikimin e barnave dhe materialeve të mjekimit, komisioni duhet të hartonte në bazë të kërkesave të shefave të shërbimit, listën vjetore të nevojave për barnave dhe materialeve të mjekimit për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit normal të shërbimeve spitalore deri në realizimin e procedurave të blerjes për vitin pasardhës. Lista e medikamenteve dhe materialeve të mjekimit duhet të jetë e saktë dhe realiste për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur krijimin e stokut të barnave të skaduara.
Drejtori i SRSH z. A. D. me shkresën nr.44 prot. date 09.01.2020 dhe nr.158 date 20.01.2020, ka përcjell në MSHMS listën me kërkesa për barna dhe materiale mjekimi për vitin 2020-2021. Por kjo listë nuk është hartuar nga asnjë komision. Veprime këto në mospërputhje me Kontrata/S nr. 45/2 date 13.01.2020, neni 15 pika 2 të kontratës për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore për vitin 2020 ndërmjet FDSKSH dhe SRSH, ku përcaktohet se:
"Lista e barnave që propozohet për planifikim për blerje për vitin ushtrimor, miratohet fillimisht nga grupi teknik i ngritur "Ad hoc" nga drejtori i spitalit dhe më pas dërgohet për miratim në MSHMS"
(Më hollësisht trajtuar në pikën pika 2.3.3, faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Drejtori i Spitalit, të përcjell pranë MSHMS, listën e barnave dhe materialeve të mjekimit për vitin ushtrimor, vetëm pas miratimit paraprak nga grupi teknik i ngritur për planifikimin e tyre**.**

Në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 195, datë 02.12.2021 "Për planifikimin e medikamenteve dhe materialeve mjekesore" ♪7shtë ngritur grupi teknik dhe me shkresën nr. 2850/1, datë 10.12.2021 janë miratuar nga komisioni. Me shkresën nr. 2850/2, datë 10.12.2021 "Dërgohet planifikimi dhe lista e medikamenteve" janë përcjell në ministri.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i zbatuar.

2.2 Rekomandimi: SRSH të fillojë hartimin e rregullores për shërbimin farmaceutik duke përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësit e këtij shërbimi për gjithë fushën e veprimtarisë së vet sipas standardeve të miratuara për ruajtjen dhe qarkullimin e barnave.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 24, datë 16.12.2021 "Miratimi i rregullores" nga Drejtori i SRSH dhe me shkresën nr. 2388/4, datë 16.12.2021 "Dërgohet për miratim Rregullorja e Brendshme", ku pjesë e rregullores së përgjithshme është edhe rregullorja farmaceutike.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2018 dhe 2019 është krijuar vlera më e madhe stokut të medikamenteve materialeve të mjekimit, të cilat kanë skaduar në farmacinë e Spitalit Rajonal te Shkodrës, si rezultat i kërkesave jo reale të shërbimeve dhe të planifikimit dhe menaxhimit jo eficent të tyre nga strukturat përgjegjëse të SRSH, duke shkaktuar një efekt negativ ne buxhetin e SRSH. Si pasoj e planifikimit dhe menaxhimit jo të mirë përgjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020 kanë skaduar dhe janë gjendje në farmacinë qendrore të Spitalit Rajonal Shkodër barna dhe materiale mjekimi ne vlerën totale 11,116,722 lekë.
Mungesa e koordinimit të grupit të punës, përgjegjësit të farmacisë dhe shefave të shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit, gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre për barna dhe materiale mjekimi, ka ndikuar në mos reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve dhe si rezultat të mos tërheqjes së tyre nga shërbimet përkatëse. Grupi i punës për planifikimin e barnave dhe materialeve të mjekimit është mjaftuar vetëm me plotësimin e kërkesave të paraqitura nga shefat e shërbimit pa analizuar gjendjen në magazinën e farmacisë dhe të qarkullimit të tyre në dy vitet e fundit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH të përcaktoj të drejtat dhe përgjegjësit e shefit të shërbimit duke i sanksionuar në aktet administrative (kontratë, urdhër ose udhëzim), dhe në rastet e barnave të skaduara të cilat janë kërkuar prej tyre, të propozojë masa dhe penalitete në masën e dëmit të krijuar.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk parashikohet në rregulloren përkatëse të miratuar deri në fund të periudhës së hartimit të raportit përfudnimtar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga ana e drejtuesit të institucionit nuk është marrë asnjë masë disiplinore për strukturat e ngritura për mos realizimin e inventarizimit sipas afateve të vendosura nga vet drejtuesja e institucionit, për më tepër që nga ana e saj ka patur informacion për mos zbatim të UB nr. 09 datë 16.01.2019, pasi me Urdhrin nr. 61 datë 02.04.2019 ka bërë një ndryshim të një anëtari të komisionit qendror të inventarizimit. Gjithashtu anëtarët e komisionit qendror që kanë patur detyrë të koordinojnë punën e 6 komisioneve, nuk kanë respektuar afatet e paraqitjes së relacionit përfundimtar për inventarizimin. Anëtarët e komisionit qendror për inventarizimin periodik të aktiveve për vitin 2018, nuk kanë zbatuar UB nr. 09 datë 16.01.2019 dhe kanë tejkaluar kompetencat e përcaktuara duke marrë

kompetencat e Titullarit të institucionit për shtyrjen e afatit të dorëzimit të relacionit të inventarizimit për komisionin nr. 5, veprime këto në mospërputhje ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" rregullores se Spitalit Rajonal Shkodër, Rregulloren e funksionimit Teknik (nr. 882 prot., datë 19.09.2011) si dhe Urdhrin e Brendshëm nr. 09 datë 16.01.2019 për inventarizimin periodik të aktiveve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH-së të marr masat që në të ardhmen procesi i inventarizimit periodik të aktiveve, të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në aktet administrative të nxjerra nga vet institucioni, për të mundësuar që aktivet e propozuara jashtë përdorimit të reflektohen në evidencën kontabël të vitit ushtrimor.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 8, datë 19.01.2022 "Mbi inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve", nuk është finalizuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

5. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi konstatohet se Spitali Rajonal Shkodër, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike për mjetet themelore (asetet) dhe pajisjet mjekësore diagnostikuese dhe laboratorike. Regjistri aktual kontabël i aktiveve referuar kartelave të tyre nuk i plotëson kërkesat e nenit 30 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, të marrë masat për hartimin dhe përditësimin e regjistrit kontabël sipas standardeve ligjore të kërkuara.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 22, datë 27.01.2022 Sektori i Financës është ngarkuar për këtë rekomandim.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

6. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me zërin "ndërtesa dhe troje" të cilat paraqiten në kontabilitetin e institucionit SRSH, rezulton se për këto aktive nuk ka asnjë dokumentacion pronësie dhe nga ana e drejtuesve të këtij institucioni, për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për ti regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, të marrë të gjitha masat e nevojshme, për identifikimin, inventarizimin fizik dhe regjistrimin e aseteve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër, si dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

Deri më datën 31.12.2021

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me urdhrin e brendshëm nr. 26, datë 27.01.2022 është ngritur komisioni për inventarizimin e pronave të patundshme. Me shkresën nr. 1046, datë 17.05.2022 "Kërkesë për informacion dhe dokumentacion", me shkresën nr. 5460/1, datë 01.07.2022 DVSH ka kërkuar planin e qartë të rilevimit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

7. Gjetje nga auditimi: Një numër i konsiderueshëm i pajisjeve mjekësore nuk funksionojnë dhe për një pjesë të tyre, nga komisioni është propozuar nxjerrja jashtë përdorimit dhe më pas

asgjësimi i tyre, sipas procedurave ligjore në fuqi. Disa nga aparaturat mjekësore janë pa dokumente dhe disa të tjera nuk janë të regjistruar në inventarin e SRSH. Nga shqyrtimi i të dhënave mbi inventarin e pajisjeve mjekësore dhe përpunimit të tyre nga pikëpamja sasiore nga grupi i auditimit rezulton:
-SRSH posedon 471 pajisje mjekësore, nga këto 156 pajisje ose 33.1 % e tyre nuk funksionojnë dhe qëndrojnë prej vitesh në ambientet e brendshme të reparteve të SRSH duke ndikuar në ndotjen e ambientit për shkak të problematikave që ato kanë në drejtim të mundësisë së rrezatimit etj., duke ndikuar në cilësinë e shëndetit të pacienteve dhe personelit të spitalit;
-Të gjitha pajisjet mjekësore nuk janë regjistruar sipas formularit tip të inventarizimi, sipas standardit të kërkuar nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKIB) të pasqyruar në udhëzuesin e saj;
-Qendra Kombëtare Inxhinierisë Biomjekësore disponon sistemin e informacionit kompjuterik për pajisjet mjekësore CLINGO, njësia e inxhinierisë klinike pranë SRSH ka regjistruar 287 pajisje ose 61 % te tyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: SRSH në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore të bej vlerësimin mbi gjendjen aktuale të funksionimit të pajisjeve mjekësore dhe mundësisë së vënies së tyre në funksion për pajisjet mjekësore që nuk punojnë dhe njëkohësisht nga ana e SRSH të ndiqen procedurat ligjore në fuqi për asgjësimin e pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 23, datë 27.01.2022 është ngritur komisioni. Komisioni i ngritur nuk ka zhvilluar asnjë procedurë. Dokumentacioni shtesë i vendosur në dispozicion nuk i shërben auditimit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i pazbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor gjatë vitit 2018, për disa procedura prokurimi ka bërë copëzim të fondit limit dhe shmangie nga procedurat konkurruese të prokurimit duke realizuar më shumë se një procedurë me blerje të vogël për mallra, shërbime, pune me të njëjtin objekt prokurimi. Më poshtë paraqitet copëzimi i fondit limit prej 1,764,178 lekë për realizimin e blerjeve të materialeve të kancelarisë të cilat nga AK janë parashikuar dhe realizuar në tre procedura të blerjeve të vogla, në kundërshtim me nenin 8, 29 dhe 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si më poshtë:
a. Procedura me objekt *"Blerje kancelari"* me fond limit 800,000 lekë, me vlerë të kontratës 372,000 lekë e zhvilluar me datën 20/09/2018.
b. Procedura me objekt *"Blerje shtypshkrime (Letër shkrimi)"* me fond limit 800,000 lekë, me vlere te kontratës 697,000 lekë e zhvilluar me datë 20/06/2018.
c. Procedura me objekt *"Blerje shtypshkrime (Letër shkrimi dhe sende të tjera)"* me fond limit 164,178 lekë, me vlere te kontratës 164178 lekë e zhvilluar me datë 08/02/2018.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 108-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH në cilësinë e Titullarit të AK, të kërkojë relacion shpjegues nga strukturat përgjegjëse të hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, që të parandaloj mundësinë e copëzimit të fondeve, nëpërmjet përdorimit të procedurave të blerjeve të vogla për blerje dhe shërbime me të njëjtin objekt prokurimi.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Marrja në dorëzim e sistemit të radhës ku përfshihet kompjuteri server, printer dhe TV Led nga komisioni përkatës i marrjes në dorëzim dhe kolaudimit pa verifikuar

dhe identifikuar specifikimet teknike dhe markën e pajisjeve përbërëse të sistemit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*. Marrja në dorëzim e mallit është bërë sipas Aktit Teknik nr. 1624 prot datë 08.05.2018 nga komisioni i marrjes ne dorëzim. Akti Teknik nuk është miratuar nga Titullari i institucionit ish – Drejtori V. M., pasi nuk është nënshkruar prej tij.
Lidhur me marrjen në dorëzim të mallrave rezulton se pajisjet e lëvruara janë të përshkruara sipas listës, pjesë e aktit por pa përcaktuar vendin e origjinës, markën (Brand Name). Po ashtu për sa i përket njësisë së prenotimit me monitor me prekje dhe printer POS (fig. nr. 1), monitor salle pritje (fig. nr. 2) dhe terminal thirrje numër radhë në shërbime (fig. nr. 4) janë përcaktuar si shembuj ilustrues, çka nënkupton se në momentin e hartimit të aktit dhe marrjes në dorëzim të mallit produktet nuk kanë qenë disponibël fizikisht. Për sa cituar më lart, rezulton se jemi para të njëjtave dokumenteve identik (formulari nr. 3 me nr. 837 prot., datë 01.03.2018 "ftese për ofertë") miratuar nga Titullari i AK z. V. M. dhe kontratës së shërbimit nr. 1323 prot., datë 13.04.2018 të nënshkruar nga Titullari i AK V. M. dhe BOE O. shpk përfaqësuar nga R. K. dhe S.&S. përfaqësuar nga A. K.. Në këto kushte nuk rezulton e dokumentuar se cilat produkte hardëare-ike apo pajisje janë marrë në dorëzim dhe si kanë funksionuar ato në momentin e hartimit të aktit teknik dhe të marrjes në dorëzim.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 108-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së SRSH të ngrihet grupi i punës për të verifikuar dhe identifikuar markën dhe specifikimet teknike të pajisjeve përbërëse hardware-ike të sistemit të radhës ku përfshihet kompjuter server, printer dhe TV Led të dorëzuar nga BOE "O. shpk" dhe "S.&S.".

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 24. datë 27.01.2022 është ngritur grupi i punës, i cili ka hartuar relacionin nr. 228/2, datë 31.01.2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Kontrata e qirasë nr. 368/1 prot., datë 07.08.2002, ka afat 20 vjeçar dhe përfundon më datë 10.07.2022. Kjo kontratë është lidhur kundërshtim me referencën ligjore të kohës për sa i përket periudhës së vlefshmërisë. Afati i vendosur për një periudhë 20 vjeçare, është në tejkalim të kompetencave të ish Titullarit të Spitalit të asaj periudhe, pasi për kontratat me afat mbi 1 vit të drejtën e lidhjes së saj i takon organit që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit, në këtë rast të drejtën e përfaqësimit të pronarit e ka Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1 Rekomandimi: Drejtori dhe zyra juridike e Spitalit, të hartojnë dhe të lidhin kontratë qiraje sipas akteve nën ligjore në fuqi për objektin *"ish punti i gjakut, spitali i vjetër"*.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me udhrin nr. 25, datë 27.01.2022 "Zbatim i rekomandimeve" për ngritjen e grupit për lidhjen e kontratës, në proces
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi fizik që u krye nga grupi i auditimit, i mbajtur me Akt Verifikim nr. 4 datë 14.05.2021 (nr. 230/19 prot., datë 14.05.2021) rezultoi se një pjesë e sipërfaqes së truallit të pasurisë së paluajtshme prej 66.72 m^2 përdoret nga një subjekt privat i cili ushtron aktivitet privat Bar-Bufe. Në lidhje me këtë SRSH nuk ka marrë asnjë masë (njoftim të subjektit), me qëllim ndalimin e ushtrimit të këtij aktiviteti dhe lirimin e sipërfaqes, pranë pasurisë që ka në përdorim, mosveprim i cili bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 195 të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 "Për

ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1 Rekomandimi: SRSH të bëjë inventarizimin dhe përditësimin e pasurisë së paluajtshme dhe aksesorëve të saj si dhe në bashkëpunim me MSHMS, të marrin masat e nevojshme për regjistrimin e pasurisë (truall ndërtesë) pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me urdhrin e brendshëm nr. 26, datë 27.01.2022 është ngritur komisioni për inventarizimin e pronave të patundshme. Me shkresën nr. 1046, datë 17.05.2022 "Kërkesë për informacion dhe dokumentacion", me shkresën nr. 5460/1, datë 01.07.2022 DVSH ka kërkuar planin e qartë të rilevimit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

11.2 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH, t'i drejtohet zyrtarisht subjektit privat, i cili është duke përdorur sipërfaqe të truallit të pasurisë së paluajtshme të spitalit, me qëllim lirimin e saj dhe në rast të mosveprimit nga subjekti privat, t'i drejtohet Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, (IMTV)

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 27, datë 27.01.2022 është ngritur komisioni për zbatimin e rekomandimeve. Me shkresën nr. 231/1, datë 09.03.2022 "Njoftim" është njoftuar z. P. B. për lirimin e ambienteve. Me kërkesën nr. 18.03.2022 z. P. B. ka kërkuar që sipërfaqen në fjalë ta marri me qera. Me shkresën nr. 671, datë 28.03.2022 "Kërkesë për prishje objekti" Spitali i ka kërbuar IVMT prishjen e objektit në tokën e Spitalit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi fizik që u krye nga grupi i auditimit, i mbajtur me Akt Verifikim nr. 3 datë 14.05.2021 (nr. 230/18 prot., datë 14.05.2021) rezultoi se:
Në ambientet e brendshme të spitalit shfrytëzohet nga subjekti Credins Bank një sipërfaqe prej 5.6 m^2 prej datës 03.02.2014. Në lidhje me këtë çështje SRSH nuk ka lidhur kontratë qiraje me subjektin bankar duke vepruar në mospërputhje me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" për të lidhur kontratë qiraje sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së SRSH të analizohet shkaqet dhe të merren masa për personat përgjegjës, që nuk kanë lidhur kontratë qiraje me C. B. dhe për pasojë nuk është arkëtuar shuma 71,400 lekë, e cila konsiderohet një e ardhur e munguar për spitalin. Gjithashtu Drejtori dhe zyra juridike e Spitalit, të hartojë dhe të lidhin kontratë qiraje me subjektin C. B. për shfrytëzimin e ambienteve të brendshme të spitalit.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 28, datë 27.01.2022 "Zbatimin e rekomandimeve" është ngritur grupi i punës. Me Shkresën nr. 237/1, datë 17.03.2022 "Njoftim për shpërblim dëmi". Me C. B. është lidhur kontrata nr. 1953, datë 16.09.2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

13. Gjetje nga auditimi: Nga ana e drejtuesve të SRSH brenda periudhës së auditimit nuk është kërkuar kopje e kontratës koncesionare dhe ajo financiare të cilat rregullojnë marrëdhënien kontraktuale. Nga evidenca dokumentare konstatohet se nuk ka komunikim nga SRSH me MSHMS për evidentimin e problemeve të zbatimit të kontratës., veprime këto në

mospërputhje me kontratën Spitalore të FSDKSH dhe SRSH, neni 9, pika 1 "Detyrime të spitalit në lidhje me kontratën koncesionare S. S.", parashikohet:
Spitali është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në Kontratën Koncesionare nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015, "Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimshme në sallat kirurgjikale", të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Koncesionare "S. S." Sh.p.k.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të plotë për kontratën koncesionare me objekt "Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterile, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale".

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin e Brendshëm nr. 29, datë 27.01.2022 është ngritur komisioni për plotësimin e dokumentacionit të kontratës. Me Urdhrin nr. 30, datë 27.01.2022 për ndjekjen e plotësimin e dokumentacionit të "S. S.". Ka një komunikim midis institucioneve SRSH, MSHMS, FSKDSH. Me Shkresën nr. 686/2, datë 08.07.2022 është përcjell kontrata
Statusi i zbatimit të rekomandimit: zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se OE S. S. SHPK nuk ka dorëzuar pranë SRSH dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme, e konkretisht:
a. Nuk ka dorëzuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", Kreu II, pika 7.1.
b. Nuk ka dorëzuar Planin për administrimin e mbetjeve spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"", Kreu II, pika 7.2.
c. Nuk ka dorëzuar Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010, Kreu III, pika 8.13 dhe Kreu VI, pika 12.2, germa ç.
d. Nuk ka dorëzuar Formularin e veçantë "Dokumenti transferimit të mbetjeve të rrezikshme", në kundërshtim me VKM nr. 371, datë 11.06.2007.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
14.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për plotësimin nga koncensionari "S. S." SHPK të dokumentacionit të plotë mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin e Brendshëm nr. 29, datë 27.01.2022 është ngritur komisioni për plotësimin e dokumentacionit të kontratës. Me Urdhrin nr. 30, datë 27.01.2022 për ndjekjen e plotësimin e dokumentacionit të "S. S.". Ka një komunikim midis institucioneve SRSH, MSHMS, FSKDSH. Me shkresën nr. 234/3, datë 10.03.2022 është përcjell dokumentacioni.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Mungesa e gjurmueshmërisë së përdorimit të seteve kirurgjikale të sterilizuara nga SRSH. Autoklava nuk është e certifikuar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore dhe vazhdon të bëjë sterilizimin e seteve kirurgjikale

kryesisht me kompleksitet të ulët. Administrimi i seteve të sterilizuara në autoklavën e spitalit bëhet në mungese të një urdhri dhe procedure të miratuara nga Drejtori i SRSH, gjithashtu setet kirurgjikale të sterilizuara nga kjo autoklavë nuk pajisen me pullën e sigurisë për evidentimin e cilësisë së sterilizimit. Përveç kostove të harxhimit të energjisë elektrike dhe ujit, nga sektori teknik për autoklavën është parashikuar shpenzime për mirëmbajtje. Nga drejtuesit e SRSH nuk është hartuar rregullore apo udhëzim mbi administrimin dhe evidentimin e ndërhyrjeve në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuar nga autoklava e SRSH. Nga ana e drejtorisë së SRSH nuk është marrë miratim nga MSH, për përdorimin e autoklavës, krahas shërbimit të koncesionarit, duke vepruar në mospërputhje me termat e kontratës koncesionare të lidhur midis MSH dhe Koncesionarit. Nuk ka evidence në lidhje me ndërhyrjet në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuara në autoklavën e spitalit, duke e bërë të vështirë për të përcaktuar setet e përdorura nga koncesionari apo Spitali. Raportimi periodik i SRSH për FDSKSH mbi numrin ndërhyrjeve kirurgjikale të realizuara nga koncesionari për rastet e planifikuar dhe rasteve të urgjencës, gjatë vitit 2018, 2019 është raportuar sipas sektorit të kostos në SRSH vetëm numri total i ndërhyrjeve dhe jo të ndara sipas nivelit të kompleksitetit të ndërhyrjeve, veprim ky në mospërputhje me parashikimet e kontratës. Sektori i kostos në SRSH has vështirësi për të pasqyruar saktë numrin e seteve të përdorura të koncesionarit pasi në regjistrin e operacioneve nuk ka ndarje për instrumentet dhe setet kirurgjikale të sterilizuara dhe nga autoklava e SRSH.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH të përcaktojë në aktet administrative (rregullore e veçantë, urdhra, udhëzime, etj.) mënyrën e përdorimit të seteve kirurgjikale që janë në inventarin e spitalit dhe sterilizohen në autoklavën e Spitalit, për të mundësuar evidentimin e gjurmueshmërisë së përdorimit të tyre, në sallat kirurgjikale sipas planifikimit apo rasteve urgjente, si dhe dokumentimin e tyre në regjistrin e ndërhyrjeve kirurgjikale**.**

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumenta në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Pazbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Drejtimi i SR Shkodër nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore për shkak të mosfunksionimit të Këshillit Administrativ.
Një nga problematikat e hershme të SRSH është mosfunksionimi i Këshillit Administrativ, duke cenuar sigurinë dhe efektivitetin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Këshilli Administrativ megjithëse është ngritur me vendim me nr. 1716 prot., datë 15.05.2019, mbi bazën e rekomandimit të përsëritura të KLSH, rezulton që nuk është mbledhur dhe nuk ka vendimmarrje sipas parashikimeve te neneve 13, 14, 15 te ligjin 9106 "Për shërbimin spitalor në RSH".
Sistemi i kontrollit të brendshëm të SRSH për periudhën objekt auditimi rezulton jo efektiv. Nga ana e drejtimit institucional nuk është vënë në funksionim të plotë ligji i MFK-së sipas parashikimeve të tij, për pasojë strukturat përgjegjëse kanë njohuri të pakta me kërkesat dhe parashikimet për zbatimin dhe krijimin e një mjedisi të brendshëm efektiv të kontrollit të veprimtarisë se tyre ekonomiko administrative.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH, të bëj funksional veprimtarinë e këshillit administrativ duke planifikuar dhe thirrur në mbledhje anëtarët e Këshillit Administrativ për të bërë të mundur që çdo vendimmarrje që është kompetence e KA, të merret dhe të miratohet nga ky organ i parashikuar nga ligji organik.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumeta në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Pazbatuar.

17. Gjetje nga auditimi: Dega e financës mban dhe përpunon të dhënat kontabël në format Excel dhe jo në një sistem informatik profesional të miratuar kontabël. SRSH nuk ka përgatitur hartën e proceseve dhe gjurmëve të auditit, veprim ky në kundërshtim me nenin 16 të ligjit të MFK. Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 22 pika 1 e ligjit të MFK nga titullarët e institucionit për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, ku është parashikuar që:
Titullarët e njësive publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, të planifikojë dhe të realizojë blerjen e një sistemi informatik financiar në gjuhen shqipe të certifikuar sipas standardeve të miratuara të mbajtjes së evidencës kontabël.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin e Brendshëm nr. 35, datë 27.06.2022 "Blerje sistemit financiar" ka filluar procedura e e blerjes së sistemi e cila është finalizuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Zbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Në SRSH nuk ka strategji të zhvillimit institucional dhe profesional; nuk ka hartuar, strategji të riskut, në përputhje me kërkesat e ligjit të MFK; nuk ka hartuar, regjistër risku, si dhe Strukturat dhe sektorët e SRSH nuk janë angazhuar në identifikimin e risqeve potencial të sektorëve përkatës. Për sa më lart, drejtuesit e SRSH, në cilësinë e nëpunësit autorizues, për periudhën respektive brenda periudhës se auditimit, nuk kanë përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 10 të ligjit të MFK, "Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 130-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH nëpërmjet grupeve të ngritura të punës, të fillojë hartimin e strategjisë së zhvillimit të spitalit duke përcaktuar objektiva afat shkurtra dhe afat gjata për arritjen dhe realizimin e misionit dhe objektivave të vendosura në drejtim të përmirësimit të kujdesit shëndetësor spitalor.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumenta në dispozicion
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

19. Gjetje nga auditimi: SRSH nuk ka zhvilluar një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv. Në Rregulloren e brendshme të SRSH, nuk është përcaktuar mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave të saj. SRSH nuk posedon faqe ŵeb-i zyrtar, për pasoj nuk ka të publikuar online programin e transparencës, në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", veprime këto në mospërputhje me nenin 23 të ligjit të MFK nga titullarët e institucionit për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, ku është përcaktuar që:
Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë…"
(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 130-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1 Rekomandimi: SRSH të filloj procedurat për ndërtimin e faqes së Web-it zyrtar, ku të pasqyrojë programin e transparencës, gjithashtu e gjithë struktura administrative, mjekësore e miratuar e spitalit duhet të komunikoj vetëm me adresë e-mail-i zyrtar, si brenda institucionit po ashtu dhe jashtë saj.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 32, datë 27.01.2022 "Zbatim e rekomandimeve të KLSH" është ngritur komisioni për faqen e internetit. Me Relacionin nr. 235/1, datë 15.02.2022 është finalizuar procesi i sistemimeve në faqen e internetit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Shkodër kanë vetëm një specialist auditi "jo të certifikuar". Në SRSH njësia e AB nuk është plotësuar sipas parashikimeve të VKM nr. 83 datë 3.2.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", ku çdo njësi publike që plotëson kriteret përcaktuar në VKM duhet të ngrejë njësinë e auditimit të brendshëm e cila duhet të përbehet nga jo më pak se 3 (tre) auditues, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë së auditit të brendshëm.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 130-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
20.1 Rekomandimi: SRSH të bëjë të gjitha përpjekjet, dhe në bashkëpunim me MSHMS të ngrejë, dhe të bëjë efektiv njësinë e auditit të brendshëm për të monitoruar dhe kontrolluar veprimtarinë ekonomiko financiare.

Menjëherë e në vijimësi
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumenta në dispozicion
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Pazbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Nga intervistimi i punonjësve të Spitalit Rajonal Shkodër ku përfshihet dhe Drejtori i Spitalit, u konstatua një problematikë mbi dypunësimin e disa punonjësve të Spitalit (Mjek të urgjencës, mjek të përgjithshëm) të cilët gjatë orarit të punës kryenin vizita ndaj pacientëve të cilët janë të shtruar në ambientet e Hemodializës "D." Sh.p.k. Pas intervistimit të këtyre mjekëve, ato pranuan para grupit të auditimit që kishin lidhur kontratë dhe me shoqërinë private të hemodializës "D." Sh.p.k kundrejt pagesës. Me gjithë pretendimet për një kontratë part-time (e cila nuk u vu në dispozicion) e cila është e pavlefshme në momentin që Titullari i Institucionit nuk është zyrtarisht në dijeni për shërbimet që këto mjek bëjnë në ambientet e kësaj shoqërie private si edhe pasi orari zyrtar i vizitave dhe konsultave në ambientet e Hemodializës është nga ora 07:00-16:00.
Nga vetë deklaratat e këtyre punonjësve rezulton se gjatë orarit zyrtar për të cilin kanë lidhur dhe kontratën individuale me Drejtorin e Spitalit Rajonal Shkodër, ata kryejnë shërbime të ndryshme dhe paguhen dhe nga shoqëria private "D.88" sh.p.k, veprime këto në kundërshtim me nenin 110 dhe 119 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
21.1 Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, të marrë masa duke analizuar këtë situatë me qëllim shmangien e këtij fenomeni në të ardhmen.

Menjëherë e në vijimësi
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Relacionin nr. 936, datë 29.04.2022 "Mbi dy punësimin e stafit" është analizuar situata dhe janë marr deklaratat që ata punojnë jashtë orarit të punës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Zbatuar

22. Gjetjet nga auditimi: Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, janë larguar 21 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 30 punonjës të rinj. Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë larguar 34 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 63 punonjës të rinj.
Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë larguar 57 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 69 punonjës të rinj. Për sa i përket largimeve nga puna për periudhën e auditimit, janë hapur procese gjyqësore në 2 raste ku

gjykata i ka dhënë të drejtë punonjësve të larguar dhe deri më sot për të dy këta punonjës është likuiduar shuma totale prej **2,299,192 lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
22.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Shkodër, të marri masa që në të ardhmen në rastin e vendimit për largimin nga detyra të ndonjë punonjësi të ndiqen në mënyrë rigoroze të gjitha procedurat e përshkruara qartë në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

23. Gjetje nga auditimi. Në lidhje me dosjet e personelit, u kërkuan me zgjedhje 40 dosje, ku nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua mungesa e dokumentacionit duke mos respektuar të gjitha kriteret e Urdhrit nr. 511 datë 13.12.2011 të Ministrisë së Shëndetësisë, "Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik". Emërimet dhe largimet e punonjësve në SRSH janë në mospërputhje me Urdhrin nr. 506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë "Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore" pika 1 dhe 2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
23.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Shkodër, të analizoj këtë situatë ku janë punësuar punonjës në mospërputhje me kuadrin ligjor dhe të nxjerri përgjegjësitë për mungesën e dokumentacionit të konstatuar nga grupi i auditimit për këto punonjës në dosjet e tyre personale.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me relacionin nr. 949, datë 04.05.2022 Përgjegjësja e Burimeve Njerëzore njofton sistemimin e dosjeve
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Zbatuar

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit për prokurimet, blerje me vlerë të vogël, për vitin 2020 konstatohet problematika e copëzimit të fondit për mallra që përfshihen në të njëjtin grup dhe kanë të njëjtin funksion kryesor. Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurat, *"Riparim mirëmbajtje objekte ndërtimore"* me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, *"Riparim, asfaltim i territorit para shërbimit të Urgjencës"* me fond limit 800,000 pa TVSH. Vlera totale prokuruar e copëzuar prej 1,600,000 lekë pa TVSH duhej të prokurohej në një procedure të vetme, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Neni 40, pika 8 dhe Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 108-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
24.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masat që, në hartimin e regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë mallrat dhe shërbimet e të njëjtit funksion në një procedurë të vetme për realizimin e një oferte sa më të favorshme ekonomike

Në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

25. Gjetje nga auditimi: Të gjitha regjistrimet kontabël, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen në programin Excel pasi institucioni nuk ka të instaluar program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit

elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij. Nga ana e institucionit nuk janë marrë iniciativa për instalimin dhe implementimin e një programi financiar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 29-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
25.1 Rekomandimi: Nga drejtori i Spitalit të merren masa që drejtoria e financës të pajiset me një program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij.

Deri më datën 31.12.2021

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin e Brendshëm nr. 35, datë 27.06.2022 "Blerje sistemit financiar" ka filluar procedura e e blerjes së sistemi e cila është finalizuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

26. Gjetje nga auditimi: Drejtimi i SR Shkodër nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore, Sipas strukturës së vitit 2018 e vijim të dërguar nga MSH, ka ndryshim të emërtesës së Zv. Drejtorëve, kur në fakt, ligji organik specifikon përbërjen e Drejtorisë së SRSH në: Drejtori Ekzekutiv; Zv. Drejtori Ekonomik; Zv. Drejtori Teknik, si dhe Kryeinfermieri i Përgjithshëm. Pozicioni i 2 ZV është riemërtuar ndryshe dhe konkretisht në Zv/Drejtor i Shërbimeve Administrative dhe Zv/Drejtor i Shërbimeve Klinike, kur ligji nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" neni 18 pika 2 specifikon se: *"Struktura dhe rregullat e funksionimit të administratës së autoritetit spitalor të qarkut përcaktohen me VKM".* Ndryshimi në emërtesë, nuk mund të bëhet pa një VKM, edhe pse funksionet hamendësohen të njëjta. Ndryshimi në emërtesë, përveç keqfunksionimit në strukturat drejtuese të SRSH, krijon një situatë joligjore në përcaktimin e nëpunësit zbatues sipas MFK, ku kjo kompetencë i takon drejtuesit më të lartë ekonomik, ZDE, që në rastin e ndryshimit të emërtesave pa VKM ky pozicion nuk ekziston.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
26.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, me qëllim drejtimin e SRSH në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërpërmendura, të marrë masa për rregullimin e strukturës dhe emërtimeve si dhe arritjes së sigurisë dhe efektivitetit të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumenta në dispozicion
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 - 31.12.2020, është konstatuar se është prokuruar për "Blerje ushqime 2020", *(Loti 1 Ushqime koloniale - REF-60461-06-08-2020; Loti 2 Buke Gruri - REF-60463-06-08-2020; Loti 3 Bulmeti - REF-60465-06-08-2020; Loti 4 Mish Vici - REF-60467-06-08-2020; Loti 5 Fruta, perime, zarzavate etj - REF-60469-06-08-2020).* Autoriteti Kontraktor në titull i ka emërtuar si procedura me lote, por janë zhvilluar si procedura me "Blerje me vlerë të vogël" dhe pavarësisht emërtimit në përshkrimin e të dhënave rezultojnë se janë procedura pa lote. Procedurat e zhvilluara janë të lidhura me njëra tjetrën, ndaj rezulton që është pjesëtuar fondi për shmangien e procedurës së prokurimit, veprime këto në kundërshtim me nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 5, nenin 29 dhe nenin 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
27.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

28. Gjetje nga auditimi: Në Kontrollin e Lartë të Shtetit është paraqitur ankesa/kërkesa e administruar me nr. 1016, datë 28.9.2021, e punonjëses L. Gj., me objekt "Kërkesë për verifikimin e ligjshmërisë së Urdhrit nr. 135, datë 15.9.2021 të Drejtorit të SRSH". Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikës rezulton se znj. L. Gj., është larguar nga detyra e Përgjegjëses të Sektorit të Burimeve Njerëzore të SRSH me urdhrin e Drejtorit nr. 135, datë 15.9.2021 "Lëvizje në detyrë", urdhër i referuar në ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në RSH", ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", Rregullores së SRSH, ligjit nr. 9125, datë 29.07.2003 "Kodi i Punës së RSH", në **zbatim të rekomandimeve të KLSH**, si dhe për përmirësimin e punës. Urdhri i sipërcituar rezulton akt i nxjerrë pa referim ligjor pasi nuk ka të përcaktuar asnjë dispozitë konkrete e cila përligj titulli i SRSH miratimin e tij, duke e bërë aktin lehtësisht të cenueshëm administrativisht dhe gjyqësish. Akti citohet se ka dalë në zbatim të rekomandimeve, fakt i pa vërtetë, për sa KLSH nuk ka dalë me një vendim duke mos rekomanduar SRSH për masa disiplinore. Përdorimi i pa drejtë/ligjshëm i një institucioni si KLSH, (në kushtet kur nuk ka asnjë rekomandim të miratuar) por dhe institucione të tjera përbën shkak për precedentë pasoja të cilat duhet ti dëmshpërblej përdoruesi i paautorizuar (miratuesi i urdhrit nr. 135) dhe jo institucioni apo buxheti i shtetit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
28.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, drejtuesi aktual i tij, në cilësinë e personit i cili ka miratuar dhe nxjerrë urdhrin nr. 135, datë 15.9.2021, të marrë masa për eliminimin e të gjitha pasojave të krijuara nga momenti i nxjerrjes së aktit, duke e kthyer znj. L. Gj. në pozicionin e mëparshëm, dhe institucionin në ligjshmërinë e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Menjëherë
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 3009, datë 20.12.2021 "Në zbatim të Raportit Përfundimtar nr. 131/9, datë 20.12.2021" është rikthyer zj. L. Gj..
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetja nga auditimi: Deri në fund të vitit 2018 është akumuluar një debi që kanë punonjës ose ish punonjës së SRSH, si detyrim ndaj institucionit në shumën që kap vlerën 3,487,621 lekë. Ky detyrim është konstatuar nga auditimet të ushtruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Drejtoria Rajonale e Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor Shkodër. Në lidhje me këto detyrime SRSH nuk ka ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e këtyre detyrimeve të punonjësve ndaj SRSH.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, Sektori Juridik, të marrin masa, të analizojnë situatën e debitorëve dhe të ndjekë të gjitha hapat administrative për arkëtimin e shumës **3,487,621 lekë**.

Deri më datën 31.12.2021
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin e Brendshëm nr. 36, datë 28.01.2022 është ngritur grupi për analizimin e debitorëve. Është hartuar relacioni nr. 250/2, datë 15.06.2022 ku është analizuar situata dhe mundësinë e fitimit të cështjeve ligjore.
Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

2. Gjetje nga auditimi: OE "F." ka dorëzuar pranë Spitalin Rajonal Shkodër 10 Lap Top, model "ACER A315-31-C6FN". Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit, me përzgjedhje

rastësore i tre laptop-ve mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike nëpërmjet funksionit "System Informatin" të SO Windows 10, në prezencë të komisionit të prokurimit, anëtarë e të cilit ishte edhe specialistja e IT. Pas verifikimit të specifikimeve teknike të tre laptop të përzgjedhur rastësisht duke përfshirë dhe laptop-in që posedon specialistja e IT, respektivisht me numrat serial (S/N); Nxntex01674616ad17600; Nxntex01674616ac87600; Nxntex01674616ac57600, rezultojë që:
10 (dhjetë) Lap top-ët kanë RAM-in 4 GB, pra në mospërputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike te kërkuara nga AK dhe të ofertës së paraqitur nga vete OE fitues "F." nërkohë që AK në dokumentet e tenderit ka kërkuar blerjen e 10 laptop-ve me RAM 8 GB nga ana e Fastech janë dorëzuar 10 laptop-Model ACER A315-31-C6FN me RAM-in 4 GB.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 108-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: SRSH të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **35,395 lekë** nga z. A. P., në cilësinë e përfaqësuesit të OE F. sh.a, si personi përgjegjës për dorëzimin e një malli me specifikime teknike të ndryshme nga ai i ofertuar dhe i ndryshëm nga specifikimet teknike të përcaktuara nga AK në DST.

Deri më datën 31.12.2021

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 32, datë 27.01.2022 është ngritur grupi i punës. Me shkresën nr. 236/1, datë 11.02.2022 "Njoftim arkëtim shume" është njoftuar OE për detyrimin.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

3. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në SRSH është vendosur një ATM pa kontratë qiraje nga subjekti C. B.. Bazuar në të dhënat e sektorit të shërbimeve të SRSH, ATM ka një konsum fuqie elektrike prej 0.8 Kŵh. Çmimi i energjisë elektrike për vitin 2018 ka qenë 14 lekë për Kŵh (pa TVSH) dhe 11 lekë për Këh (pa TVSH) për vitin 2019, 2020, 2021, çmime të referuara nga faturat e energjisë elektrike të faturuara nga OSHEE për SRSH.
Nga analiza dhe përllogaritja e konsumit të energjisë elektrike ATM ka konsumuar energji elektrike sa më poshtë vijon:
Për vitin 2018 ne vlerën **116,122 lekë** {(0.8kŴh*24h*360dite*16.8lekë/kŴh(me Tvsh)};
Për vitin 2019 ne vlerën **116,122 lekë** {(0.8kŴh*24h*360dite*16.8lekë/kŴh(me Tvsh)};
Për vitin 2020 ne vlerën **91,238 lekë** {(0.8kŴh*24h*360dite*13.2 lekë/kŴh(me Tvsh)};
Për periudhën nga 01.01.201 deri 31.01.2021 në vlerën **7,603** lekë {(0.8kŴh*24h*30*13.2lekë/KŴh (me Tvsh)} *(llogaritja e konsumit të energjisë elektrike është bere nga data e vendosjes se ATM deri në përfundim te periudhës se auditimit)*. Vlera totale prej **331,085 lekë** konsiderohet dëm ekonomik.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: SRSH të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **331,085 lekë** nga C. B., Dega Shkodër si detyrim i përllogaritur për shfrytëzimin e ambienteve të brendshme pa kontratë qiraje dhe përdorimit të energjisë elektrike të SRSH.

Deri më datën 31.12.2021

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 28, datë 27.01.2022 "Zbatimin e rekomandimeve" është ngritur grupi i punës. Me Shkresën nr. 237/1, datë 17.03.2022 "Njoftim për shpërblim dëmi". Është lidhur kontrata por nuk është kryer ende arkëtimi
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2018, të llojit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje ushqimesh", me vlerë të prokuruar 7,009,992 lekë dhe vlerë kontrate 6,921,840 lekë, ose më pak se fondi limit prej 88,152 lekë dhe OE fitues "S. S." SHPK, është konstatuar se nga KVO dhe Titullari i AK nuk është bërë shpallja fituese e

ofertës më të favorshme ekonomike, duke u s'kualifikuar ajo, për të njëjta mangësi si dhe oferta e shpallur fituese. Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike "N." SHPK & "K." SHPK me vlerë oferte prej 6,850,400 lekë dhe shpalljen fitues dhe lidhur kontrata me OE "S. S." SHPK me vlerë ofertë prej 6,921,740 lekë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe SRSH për vlerën prej **71,440 lekë**, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, veprime këto në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa për eleminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, si dhe të fillojë procedurat për arkëtimin e vlerës **71,440 lekë** nga anëtarët e KVO të përbërë nga M. K., në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe A. I. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor z. V. M., shkaktuar si pasojë e mos shpalljes fituese të ofertës më të favorshme ekonomike.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 34, datë 27.01.2022 është ngritur grupi i punës. Më datë 02.02.2022 A. I. ka shkyer detyrimin. Më datë ... (nuk është e dallueshme) M. K. ka shlyer detyrimin. Dy ish punonjësit janë informuar me shkresë zyrtare

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Janë konstatuar efekte negative financiare në shumën 75,313,230 lekë si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Në periudhën përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 (brenda periudhës së auditimit) kanë skaduar barna dhe materiale mjekimi për shkak të mos përdorimit të tyre, por dhe të planifikimit të gabuar dhe menaxhimit jo efektiv të medikamente dhe materiale mjekimi nga strukturat përgjegjëse pranë SRSH, si më poshtë:

a. Gjatë vitit 2018 në farmacinë e SRSH janë krijuar barna dhe materiale të skaduara në vlerë **4,952,140.30 lekë .**

b. Gjatë vitit 2019 janë krijuar barna dhe materiale mjekimi stok të skaduara në vlerë **5,747,180.76 lekë.**

c. Gjatë vitit 2020 janë krijuar barna dhe materiale mjekimi të skaduara në vlerë **169,326.00 lekë.**

d. Përgjatë viteve 2015/16/17 të marra së bashku janë krijuar barna dhe materiale mjekësore të skaduara në vlerën **248,075.24 lekë.**

e. Në total në magazinën e farmacisë së Spitalit, gjenden të skaduar medikamente dhe materiale të mjekimit në vlerë **11,116,722 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH të analizoj shkaqet e krijimit të stokut të barnave dhe materialeve të mjekimit të skaduar në vlerën **11,116,722 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficent për SRSH duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e stokut të ri në të ardhmen.

Deri më datën 31.12.2021

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumenta në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Koncesionari "S. S." përdor energjinë elektrike dhe ujin nga spitali, shpenzimet e te cilave mbulohen nga buxheti i SRSH.
Për konsumin e energjisë elektrike:
Në mungese të matësve, konsumi i përafërt i përllogaritur mbi bazën e të dhënave të SRSH është: [200KËh*4 ore*22 ditë*13.2 lekë/kWh (me TVSh)] * 36 muaj= 8,363,520 lekë
Pra në përllogaritjen e përafërt të konsumit të energjisë elektrike është supozuar që autoklavat punojnë 4 orë mesatarisht në ditë dhe çmimi i energjisë elektrike për 1kËh është 13.2 lekë (me TVSH) sipas faturës së energjisë elektrike që paguan SRSH.
Për konsumin e ujit:
Konsumi i përafërt i përllogaritur mbi bazën e të dhënave të SRSH dhe në mungesë të matësit të ujit, është: Konsumi i ujit: 10 m^3/ditë*22ditë*36 muaj *156 lekë/m^3=1,235,520 lekë.
Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga OE S. S. SHPK, **në vlerën 9,599,040 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të SRSH.**
Përllogaritja e përafërt nga grupi i auditimit është bërë mbi bazën e të dhënave të siguruara nga sektori i teknik në SRSH, tregon që koncesionari krahas kostove të seteve kirurgjikale ka rritur kostot e shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë nga buxheti i shtetit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: SRSH të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore ***në vlerën 9,599,040 lekë,*** si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5., ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë detyrime të Koncensionarit dhe jo buxhetit të spitalit

Deri më datën 31.12.2021

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk dëshmon marrjen e masave për zbatimin e r ekomandimit, pasi ju thjesht e keni përcjell te kompania rekomandimin ndërkoë rekomandimi kërkon "SRSH të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore ***në vlerën 9,599,040 lekë,*** si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5., ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë detyrime të Koncensionarit dhe jo buxhetit të spitalit"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se sipërfaqja totale në përdorim nga koncesionari është 296 m^2 brenda ambienteve të Spitalit. Koncesionari e ka përdorur këtë sipërfaqe nga data 20.11.2017 e në vazhdim, pa paguar qira.
Në nenin 19.4, të kontratës koncesionare, ndër të tjera përcaktohet se: *"Autoriteti duhet të japë në përdorim, kur është e nevojshme për arsye logjike, hapësirat në zonat spitalore që mund ti lejojnë operatorit koncesionar dhe operatorëve të saj akses dhe përdorim të të gjitha strukturave të ndërtuara si magazina ose aktivitete produktive të back-up, pa u kërkuar një qera dhe/ose rimbursim financiar".i* Në kontratë është përcaktuar që "Autoriteti" është "Ministria e Shëndetësisë" SRSH në lidhje me ambientet e dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk ka ndjekur procedurat ligjore në zbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar. Në lidhje me ambientet e dhëna në përdorim të koncesionarit, nuk është mbajtur nga SRSH detyrimi për marrjen e qerasë për këto ambiente, duke qenë se Spitali nuk është palë në këtë kontratë, por vetë Ministria e Shëndetësisë. Për periudhën në

auditim dhe për sipërfaqen prej 296 m^2 duke llogaritur si tarifë dysheme, mbi bazën e përcaktimeve të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar. Spitali Rajonal Shkodër nuk ka përfituar vlerën financiare nga qiraja e ambientit brenda SRSH, ku koncesionari zhvillon aktivitetin. E ardhura e munguar nga mos përftimi i shumës së qerasë e cila llogaritet: (296m^2*150 lekë/m^2=44,400 lekë/muaj). Koncesionari brenda periudhës së auditimit ushtron aktivitetin prej 36 muaj. Pra ne total kemi 44,400 lekë/muaj*36 muaj= 1,598,400 lekë. Për sa më lartë shuma **1,598,400 lekë** përbën efekt financiar negativ për SRSH.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: SRSH të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën **1,598,400 lekë** si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumenta në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018 janë larguar 21 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 30 punonjës të rinj. Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë larguar 34 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 63 punonjës të rinj.
Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë larguar 57 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 69 punonjës të rinj.
Përsa i përket largimeve nga puna për periudhën e auditimit, janë hapur procese gjyqësore në 2 raste , ku gjykata i ka dhënë të drejtë punonjësve të larguar dhe deri më sot për të dy këta punonjës është likuiduar shuma totale prej **2,299,192 lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 17-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH të analizoj shkaqet e krijimit të detyrimit prej **2,299,192 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficent për SRSH duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e detyrimeve të reja në të ardhmen.

Deri më datën 31.12.2021

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumenta në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 - 31.12.2018, materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, grupi auditoi **8 procedura** me vlerë të prokuruar mbi 1 milion lekë, pa TVSh dhe vlerë të fondit limit prej **88,512,654** lekë. Nga 8 procedura të audituara, konstatohet se në **3** procedura me vlerë kontrate **9,036,290 lekë,** ose **10%** e vlerës së kontratave të audituara, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **9,036,290 lekë.** Procedurat e audituara dhe konstatuara me problematika janë:
-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje ushqimesh", me vlerë të prokuruar 7,009,992 lekë dhe vlerë kontrate 6,921,840 lekë, ose më pak se fondi limit prej 88,152 lekë dhe OE fitues "S. S." SHPK.

-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Riparim mirëmbajtje automjetesh", me vlerë të prokuruar 1,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 990,000 lekë, ose më pak se fondi limit prej 10,000 lekë dhe OE fitues "K." SHPK.
-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje medikamente-Marrëveshje kuadër e ndarë në 23 Lote", me vlerë të prokuruar 22,588,665 lekë, nga ku është konstatuar se për Lotin 1 në vlerën e kontraktuar prej 600,000 lekë, me OE fitues "C. P." SHPK si dhe lotin 3 dhe 8 me vlerë të kontraktuar prej 524,450 lekë, me OE fitues "M. Ph." SHPK
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike për shumën **9,036,290 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 - 31.12.2019, materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, grupi auditoi **8** procedura me vlerë të prokuruar mbi 1 milion lekë, pa TVSh dhe vlerë të fondit limit prej **36,627,042** lekë. Nga 8 procedura të audituara, konstatohet se në **3** procedura me vlerë kontrate **14,655,553 lekë,** ose **54%** e vlerës së kontratave të audituara, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **14,655,553 lekë.** Procedurat e audituara dhe konstatuara me problematika janë:
-Procedura e prokurimit "E Hapur" me objekt "Blerje ushqimesh", me vlerë të prokuruar 8,883,208 lekë dhe vlerë kontrate 8,194,820 lekë, ose më pak se fondi limit prej 688,388 lekë dhe OE fitues "S. S." SHPK.
-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Riparim mirëmbajtje automjetesh", me vlerë të prokuruar 2,078,000 lekë dhe vlerë kontrate 1,980,500 lekë, ose më pak se fondi limit prej 97,500 lekë dhe OE fitues "K." SHPK.
-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Shërbimi i impiantistikës", me vlerë të prokuruar 4,496,261 lekë dhe vlerë kontrate 4,480,233 lekë, ose më pak se fondi limit prej 16,028 lekë dhe BOE fitues "N. 2014 dhe N." SHPK.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike për shumën **14,655,553 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 - 31.12.2020, materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, grupi auditoi **4** procedura me vlerë të prokuruar mbi 1 milion lekë, pa TVSh dhe vlerë të fondit limit prej **16,406,690** lekë. Nga 4 procedura të audituara, konstatohet se në **1** procedura me vlerë kontrate **8,310,000 lekë,** ose **42%** e vlerës së kontratave të audituara, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO, nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **8,310,000 lekë.** Procedura e audituar dhe konstatuar me problematikë është:
-Procedura e prokurimit "E Hapur" me objekt "Blerje pajisje mjekësore SRSH", me vlerë të prokuruar 8,322,000 lekë dhe vlerë kontrate 8,310,000 lekë, ose më pak se fondi limit prej 12,000 lekë dhe OE fitues "A." SHPK.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike për shumën **8,310,000 lekë** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2019, të llojit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje shtypshkrime", me vlerë të prokuruar 1,249,999 lekë dhe vlerë kontrate 1,150,215 lekë, ose më pak se fondi limit prej 99,784 lekë dhe OE fitues "R.-G." SHPK, është konstatuar se nga KVO dhe Titullari i AK nuk është bërë shpallja fituese e ofertës më të favorshme ekonomike, por asaj me vlerë më të lartë, duke ju referuar vetëm shumatores së çmimeve për njësi e cila në OE e shpallur fitues rezulton më e ulët. Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike "K. K." SHPK me vlerë oferte prej 813,001 dhe shpalljen fitues dhe lidhur kontrata me OE "R.-G." SHPK me vlerë ofertë prej 1,150,216 lekë, përbën efekt financiar negativ për SRSH në vlerën **337,215 lekë**, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, SRSH, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kritereve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSH, të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse dhe të analizoj efektin financiar negativ në vlerën prej **337,215 lekë**.

Menjëherë

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Do vlerësohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

D. MASA ADMINISTRATIVE

Masa që u rekomandohen, Organeve apo Strukturave të cilat, sipas legjislacionit në fuqi kanë në kompetencë vendosjen e tyre si:

E.1 Masa administrative të rekomanduara Agjencisë Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike., të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe konstatimeve të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe vërejtjeve, komenteve dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitura nga subjekti i audituar, mbështetur në nenet 23 të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër ti kërkoj Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljen e konstatuara, fillimin e procedimit administrativ, për përjashtimin e operatorit ekonomik **"F."** shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për sa më poshtë:

-"F." SHPK është shpallur fitues i procedurës së prokurimit realizuar nga Spitali Rajonal Shkodër për 10 Lap Top, procedurë për të cilën OE pas nënshkrimit të kontratës ka dorëzuar pranë SRSH lap-top të Markës/model "ACER A315-31-C6FN".

Grupi i auditimit, me përzgjedhje rastësore ka verifikuar tre laptop mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike nëpërmjet funksionit "System Informatin" të SO Ŵindoŵs 10, proces i kryer në prezencë të komisionit të prokurimit, anëtarë e të cilit ishte edhe specialistja e IT.

Pas verifikimit të specifikimeve teknike te tre laptop të përzgjedhur rastësisht duke përfshirë dhe laptop-in që posedon specialistja e IT, respektivisht me numrat serial (S/N); Nxntex01674616ad17600; Nxntex01674616ac87600; Nxntex01674616ac57600, rezultojë që: 10 (dhjetë) Lap top-ët kanë RAM-in 4 GB, pra në mospërputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike te kërkuara nga AK dhe të ofertës së paraqitur nga vete OE fitues "F.".

Ndërkohë që AK në dokumentet e tenderit ka kërkuar blerjen e 10 laptop-ve me RAM 8 GB nga ana e F. janë dorëzuar 10 laptop-Model ACER A315-31-C6FN me RAM-in 4 GB.

Modeli "ACER A315-31-C6FN" i ofertuar dhe dorëzuar nga OE Fastech, nga kërkimi në internet ne adresën: "https://ŵŵŵ.bcgroup-online.com/laptopovi/acer-aspire-a315_31_c6fn-%28nx.gntex.016%29-intel-n3350.-4gb.-500gb-43929", përdor memorien **RAM 4GB LPDDR3 1600MHz**. Për dorëzimin e një malli të ndryshëm nga ai i ofertuar dhe i ndryshëm nga specifikimet teknike të përcaktuara nga AK në DST si dhe deklarim të pa vërtetë/saktë sipas shtrojsës 6 (deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike datë 08.05.2018 prot. AK me nr. 930 prot. datë 08.03.2018) dhe shtrojsa nr.1 (formulari i ofertës, ku përshkrimi mallit është bërë për lap top me RAM 8 GB), duhet të ngarkohet me përgjegjësi OE "F." dhe përfaqësuesi i tij z. A. P..

Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumenta në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

E.2 Masa administrative të rekomanduara Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, (IMTV).

Nga verifikimi fizik që u krye nga grupi i auditimit, i mbajtur me Akt Verifikim nr.4 datë 14.05.2021 (nr. 230/19 prot., datë 14.05.2021) rezultoi se, një pjesë e sipërfaqes së truallit të pasurisë së paluajtshme prej 66.72 m^2, përdoret nga një subjekt privat i cili ushtron aktivitet privat bar-bufe. Në lidhje me këtë SRSH nuk ka marrë asnjë masë (njoftim të subjektit, njoftim të IKMT/IMT), me qëllim ndalimin e ushtrimit të këtij aktiviteti dhe lirimin e sipërfaqes, pranë pasurisë që ka në përdorim, mosveprim i cili bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 195 të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 506, datë 18.09.2013 "Për ndalimin e

procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore".
Sa sipër, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, të përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme"*, i ndryshuar, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, **Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër, t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Shkodër**, vendosjen e masave administrative "Gjobë", dhe në bashkëpunim të realizojnë pastrimin e territorit të Spitalit Rajonal Shkodër nga të gjitha ndërtimet e ngritura në mënyrë të kundërligjshme.
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendosën dokumenta në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

E. MASA DISIPLINORE

F.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

F.1.1 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statuse të parashikuar në ligje të veçanta.

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar dhe kontratës kolektive të punës nr. 313 prot, datë 16.09.2016, neni 8 si dhe kontratave individuale dhe rregullores së brendshme të institucionit nr. 882 prot. datë 19.09.2011. Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, të marrë masat disiplinore ***"Vërejtje"***, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm për:
1. Z. L. M., me detyrë ZV/Drejtor i Shërbimeve Administrative
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 04, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
2. Z. E. V., në cilësinë e anëtarit të komisionit qendror për inventarizimin për vitin 2018 dhe në cilësinë e anëtarit të KVO
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 05, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
3. Znj. E. H., në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të Lap Top-ve; në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Riparim Mirëmbajtje Automjetesh".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 06, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
4. Znj. G. N., në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim te Lap Top-ve, si dhe në cilësinë e anëtarit të NJP për procedurat e prokurimit me objekt "Blerje ushqime 2020",
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 07, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
5. Znj. N. L. (specialiste IT), në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes ne dorëzim te Lap Top-ve.
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 08, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
6. B. T., në cilësinë e anëtarit të NJP për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje materiale konsumi mjekësore e ndare ne 2 lote".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 09, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
7. Znj. K. M., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private", në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje detergjente të ndryshëm".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 10, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
8. Z. A. H., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Blerje medikamente MK e ndare ne 23 lote".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion dokumentacion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Pazbatuar
9. Z. G. K., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurat e prokurimit "Riparim Mirëmbajtje Automjetesh".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 11, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
10. Z. I. Ç., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurat e prokurimit "Riparim Mirëmbajtje Automjetesh".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 12, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
11. Z. V. F., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Riparim Mirëmbajtje Automjetesh".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 13, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
12. Znj. S. K., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Blerje shtypshkrime".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Pazbatuar
13. Znj. E. P., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Blerje shtypshkrime".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 14, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
14. Znj. L. Z., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Blerje shtypshkrime".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 15, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
15. Znj. Dh. K., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i Impiantistikës"
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 16, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
16. Znj. S. R., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje pajisje mjekësore për Spitalin Rajonal Shkodër*".*
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 17, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar

17. Znj. G. G., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje pajisje mjekësore për Spitalin Rajonal Shkodër*".*
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 18, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
18. Z. A. D., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje pajisje mjekësore për Spitalin Rajonal Shkodër*".*
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 19, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
19. Znj. N. Gj., në cilësinë e anëtarit të NJP për procedurat e prokurimit me objekt "Blerje ushqime 2020",
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 20, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
20. Znj. M. K., në cilësinë e anëtarit të NJP për procedurat e prokurimit me objekt "Blerje ushqime 2020",
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 21, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
21.Znj. M. K., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Blerje ushqimesh".
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 22, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar
22.Znj. A. I., në cilësinë e anëtarit të KVO
Qëndrimi i SRSH për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 23, datë 05.11.2021 "Për dhënie mase disiplinore" është dhënë masa disiplinore "Vërejtje".
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Zbatuar

Me shkresën nr. 1290/3, datë 29.09.2022 (protokolluar në KLSH me nr. 600/62, datë 03.10.2022) ku janë paraqitur disa fakte për zbatimin e rekomandimeve.
Për rekomandimin 1.1 është treguar vetëm satusi i proceseve gjyqësore por jo hapat e marrë nga SRSH.
Për rekomandimin 3.1 nuk është vendosur asnjë pjesë nga rregullorja e miratuar ku të verifikohet zbatimi i rekomandimit.
Pjesa tjetër është marr parasysh dhe janë kryer reflektimet në material.

SPITALI RAJONAL VLORË

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në SRV mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", SRV, ka kthyer përgjigje në KLSH, duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
- Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III. Rekomandimet e KLSH
- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 148/14, datë 11.10.2021 protokolluar në SRV me nr. 4415, datë 15.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:
a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 1 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **49 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **2 masa për shpërblim dëmi në vlerën** 990,722 l**ekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **4 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 193,627,045 lekë;**
e. Janë rekomanduar **9 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH
Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	1	1	-	-
2	Organizative	49	49	-	-
3	Shpërblim dëmi	2	2	-	-
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e	4	3	-	1

	fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit				
7	Masa disiplinore	9	9	-	-
8	Masa Administrative	-	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e SRV

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	1	1	0	0	0
2	Organizative	49	10	2	31	6
3	Shpërblim dëmi	2	0	0	2	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	3	0	0	3	0
7	Masa disiplinore	9	7	0	0	2
8	Masa Administrative	0	0	0	0	0

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	1	0	0	0
2	Organizative	49	10	2	31	6
3	Shpërblim dëmi	2	0	0	2	0
4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	4	0	0	4	0
7	Masa disiplinore	9	7	0	0	2
8	Masa Administrative	0	0	0	0	0

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 16.3%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", SRV, ka kthyer përgjigje në KLSH, duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

- Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i auditimit mbi Përputhshmërinë

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së SRV, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, në rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, garantimin e të drejtave për mbrojtje e përfshirje sociale dhe për përkujdesje sociale, (kriteret e auditimit Përputhshmërie), në të cilën janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë[25]

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin SRV, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinioni të kualifikuar mbi përputhshmërinë.***

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000[26]*)*

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit Përputhshmërie". Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

[25] Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së"

[26] **ISSAI 4000** – Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e Spitalit Rajonal Vlorë rezultoi se:
Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen kryesisht me veprimet dhe mosveprimet e administratës së Spitalit nga të cilat janë konstatuar **dëme ekonomike në vlerën prej 990,722 lekë dhe efekt financiar negativ në vlerën 198,853,808 lekë.** Efektet e mësipërme konstatohen kryesisht në zbatimin e procedurave të prokurimit publik, mos ndërmarrja e veprimeve për të shmangur çështjet gjyqësore dhe mos likuidimi në kohë i tyre, mos ndjeka me rigorozitet e zbatimit të kontratave, mungesat e raportimeve periodike, etj.
Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.
Konkluzionet dhe opinioni ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Spitalit Rajonal Vlorë, e cila në më të shumtën e rasteve konsiderohet përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin profesional dhe ushtruar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme.
Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinioni në këtë auditim përputhshmërie.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi u konstatua se vendimet e Këshillit Administrativ janë marrë kryesisht në lidhje me miratimin e buxheteve ndër vite, për ndarjen e fondeve, planifikimi i zërave në projektbuxhet për medikamente, oksigjen, shërbimin e lavanterisë, investimi i rikonstruksionit të depos së farmacisë dhe investimi në pajisjet e hotelerisë, prokurimin e shërbimit catering të ushqimit në pavione, por njëkohësisht, janë marrë vendime për rregulloren teknike për marrëdhëniet e punës së personelit apo rregullorja e brendshme e spitalit. Nga auditimi rezulton se Spitali Rajonal Vlorë, pavarësisht se mban këtë emërtim, nuk funksion dhe nuk është përcaktuar si Autoritet Spitalor i Qarkut dhe për këtë arsye Këshilli Teknik Administrativ është ngritur për efekt të zbatimit të ligjit, por nuk ka funksion miratues e vendimmarrës. Po kështu, ka pa qartësi në përcaktimet ligjore dhe rregullatore në fuqi mbi këtë çështje, pasi referuar nenit 14 të ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003 i ndryshuar, ndër të tjera Këshilli Administrativ miraton politikat, harton programet tekniko-financiare, propozon projektbuxhetin, ndarjen dhe destinacionin e tij, etj. Ndërkohë neni 19 i këtij ligji përcakton se titullari i spitalit përgatit planet e punës në fillim të vitit dhe ia paraqet këshillit administrativ për miratim, si dhe drejton punën për hartimin e projektbuxhetit ekonomik dhe financiar dhe i paraqet për miratim këshillit administrativ buxhetin e zbërthyer për çdo spital. Pra, për sa më lart në brendësi të ligjit ka kontradikta nëse këshilli propozon apo miraton planet e punës apo projekt buxhetet. Në funksion të detyrave miratuese të Këshillit, SRV ka hartuar edhe Rregulloren e Brendshme të Funksionimit, në pikën 16 të të cilës përcaktohet se, njësia përgjegjëse për hartimin e projekt buxhetit është sektori i planit, i cili në vijim ja paraqet për miratim titullarit të SRV.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1, faqe 7 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 1.1: SRV të marrë masa për adresimin në instancat përkatëse nga të cilat ka varësi, të nevojës për përcaktime të qarta dhe përmirësime ligjore sa i takon kompetencave të ngritjes së Këshillave Administrativ, si dhe detyrimeve dhe funksioneve që duhet të kenë Këshillat Administrativ në Spitalet që nuk janë të përcaktuar si Autoritete Spitalore të Qarkut

dhe për rrjedhojë kanë vështirësi në zbatimin e Ligjit aktual për Shërbimin Spitalor dhe konkretisht rishikimin e neneve 12-16 të Ligjit të sipërcituar.

Menjëherë

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 4514 prot, datë 25.10.2021 rekomandimi është pranuar dhe ka filluar zbatimi. Me shkresën nr. 4500 prot. datë 22.10.2021 SRV i është drejtuar MSHMS për përmirësimin ligjor në lidhje me zbatimin e ligjit për spitalorin. Si dhe shkresën nr. 356, datë 25.01.2022 "Kërkesë për përmirësim të legjislacionit në fuqi"

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

B. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1: Nga hierarkia e pozicioneve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003 i ndryshuar, Këshilli Administrativ është mbi Drejtorinë, si dhe në përbërje të tij është edhe drejtori i spitalit.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtori i Spitalit Rajonal Vlorë, z. A. C., me shkresën nr. 38 prot. datë 04.01.2018, urdhëron krijimin e Këshillit Administrativ, në kundërshtim me kreun II, "Struktura dhe Administrimi i Autoritetit Spitalor Publik të Qarkut" të ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Me urdhrin nr. 243 datë 19.03.2018 të Ministrit të MSHMS, riemërohet znj. B. M. Drejtor i Spitalit Rajonal Vlorë, e cila me shkresën nr. 1117 prot. datë 26.03.2018, kryen të njëjtin veprim duke u bazuar n*ë ligjin nr. 9106 datë 17.07.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 12,13,14,15,16 dhe 17 si dhe në Standardet e Akreditimit kapitulli 3, Menaxhimi i Përgjithshëm(..).*

Nga auditimi u konstatua se, në përbërje të Këshillit Administrativ është zgjedhur 1 përfaqësues nga Këshilli i Qarkut, gjithashtu është shtuar 1 përfaqësues, shefja e poliklinikës së qytetit, në kundërshtim me nenin 13, të ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003 i ndryshuar, ku anëtarët janë të caktuar. Me shkresën nr. 482 prot. datë 07.01.2019, Drejtori i Spitalit Rajonal Vlorë, urdhëron krijimin e Këshillit Administrativ duke shtuar në përbërje të tij, Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetit Publik.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1, faqe 7 të Raportit të Auditimit.

Rekomandimi 1.1: Titullarët e SRV të marrin masa për mos devijimin nga struktura e përcaktuar mbi përbërjen e Këshillit Administrativ, si dhe të respektojnë hierarkinë në lidhje me kompetencat për ngritjen e KA.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me shkresën nr. 320, datë 21.01.2022 "Krijimi i Këshillit Administrativ" Drejtori i SRV ka ngritur këtë këshill, me email janë informuar institucionet përkatëse.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi u konstatua se, të gjitha mbledhjet e Këshillit Administrativ janë thirrur nga drejtori dhe jo me kërkesë të kryetarit ose të shumicës së anëtarëve, në kundërshtim me nenin 15 "Rregullat e funksionimit të Këshillit Administrativ", të ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003 i ndryshuar. Për periudhën Prill – Dhjetor 2017, nga auditimi i kryer, nuk rezulton që Këshilli Administrativ të jetë mbledhur dhe të ketë marrë vendime. Për periudhën Mars 2018 (me krijimin e këshillit të ri me shkresë nr.1117, datë.26.03.18) – Dhjetor 2018, Këshilli është mbledhur 5 herë. Për vitin 2019, Këshilli është mbledhur 3 herë. Për vitin 2020, Këshilli është mbledhur vetëm 1 herë dhe jo 6 herë siç parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1, faqe 7 të Raportit të Auditimit.

Rekomandimi 2.1: Të merren masa që në të ardhmen, kryetarja e Këshillit Administrativ të mbledhë dhe drejtojë mbledhjet e këshillit dhe të marrë përgjegjësitë për mbarëvajtjet e tyre për diskutimin e çdo problematike të veprimtarisë së SRV.

Në vijimësi.

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion dokuentacioni i një mbledhje të zhvilluar, njoftim dhe procesverbal mbledhje.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

Gjetje nga auditimi 3: Komisioni mjekësor është organ këshillimi teknik i drejtorisë dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve. Komisioni mjekësor kryesohet nga kryetari i zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të kritereve të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë dhe ushtron veprimtarinë e tij për tre vjet. Komisioni Mjekësor i SRV është ngritur me urdhrin nr. 1506 prot, datë 12.04.2018, të drejtorit të spitalit znj. B. M., me përbërje 9 anëtarë dhe kryetar znj. B. M.. Me urdhrin nr. 798 prot, datë 23.01.2019 të drejtorit të spitalit, komisioni është ri-ngritur për arsye të zëvendësimit të një anëtari, pas lirimit të tij nga shef shërbimi, si dhe shtimin e një anëtari të ri në komision, me përbërje (10+1) në total. Në mbledhjet e komisionit mjekësor mbi vendimet për blerje të vogla, në disa raste u konstatua se në praktikat bashkëngjitur me urdhër shpenzimet, këto vendime nuk janë marrë në unanimitet, por bazuar vetëm në kërkesat e mjekëve të specialiteteve të caktuara, të cilët kanë ndjerë të nevojshme pasjen e pajisjeve mjekësore. Komisioni mjekësor ka marrë vendime në lidhje me shpërblimet nga fondi i veçantë në raste sëmundje, fatkeqësi familjare dhe dalje në pension. Në rastin e vendimit të marrë nga komisioni, për marrje shpërblimi nr. 2882 prot, datë 14.07.2020, konstatohet se përmbajtja e shkresës është hartuar gabim, pasi në të shkruhet se është mbledhur Këshilli Tekniko - Administrativ dhe jo Komisioni Mjekësor._Nga auditimi u konstatua se, nuk ka gjurmë të funksioneve të kryera nga komisioni mjekësor, kryesisht për blerje pajisje mjekësore, në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe pika 36 e udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1, faqe 7 të Raportit të Auditimit.

Rekomandimi 3.1: Të merren masa nga drejtori i spitalit, në cilësinë edhe të kryetarit të komisionit mjekësor, që në kërkesat për blerje me vlerë të vogël të pajisjeve mjekësore, propozimet të merren nga komisioni mjekësor.

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 319 datë 21.01.2022 "Krijimi i Komisionit Mjekësor" është ngritur komisioni dhe janë përcaktuar detyrat por zbatimi i këtij urdhri do të verifikohet auditimin e rradhës

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Rekomandimi 3.2: Të merren masa, që mbledhjet dhe vendimet e marra të komisionit mjekësor, të dokumentohen.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Në dispozicion u vendosën procesverbalet e dy mbledhjeve të mbajtura në datat 27.01.2022 dhe 28.01.2022

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

Gjetje nga auditimi 4: Në procesverbalin e mbajtur në mbledhjen e Këshillit Administrativ, me nr. 1120 prot. datë 26.03.2018, është zgjedhur kryetarja e Këshillit Administrativ të Spitalit Rajonal Vlorë znj. V. Sh., përfaqësuese nga Këshilli Bashkiak. Nga auditimi u konstatua se, në Rregulloren e Brendshme të miratuar me nr. 1396 prot, datë 21.02.2019, në detyrat dhe

kompetencat e drejtorit të spitalit rajonal Vlorë, citohet se: *Drejtori, drejton këshillin tekniko-administrativ*.
Rezulton se, drejtori merr kompetencat e Kryetarit të Këshillit Administrativ dhe bie në kundërshtim me nenin 16, pika 3 të ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003 i ndryshuar., ku citon se*: (...) drejtori i autoritetit spitalor të qarkut nuk mund të zgjidhet kryetar i këshillit administrativ. Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1, faqe 7 të Raportit të Auditimit*.
Rekomandimi 4.1: Titullari i SRV të marrë masa për rishikimin e rregullores së brendshme, duke saktësuar detyrat dhe kompetencat e drejtorit të spitalit, në mënyrë që mos të ketë tejkalim kompetencash referuar kuadri ligjor në fuqi.

Menjëherë

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendos në dispozicion rregullorja dhe pjesa takuese me detyrat e drejtorit të insitucionit të cilat janë riparë.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

Gjetje nga auditimi 5: Nga auditimi me përzgjedhje rastësore janë përzgjedhur 6 (gjashtë) dosje për punonjësit e administratës (Juristë, Ekonomistë, Llogaritarë, Specialist, Përgjegjës Sektori) dhe 10 (dhjetë) nga stafi mjekësor (Mjek, Infermierë, Farmacistë) të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi.
U konstatua që administrimi i dosjeve të personelit nuk bëhen sipas kërkesave të rregullores së brendshme të SRV dhe legjislacionit, pasi dokumentacioni i kërkuar nuk është pjesë e dosjeve personale për të gjithë punonjësit (por i shpërndarë). Në kundërshtim me VKM nr. 117, datë 05.03.2014, "Për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020, "Për Rregullat e Hollësishme për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", për këtë mban përgjegjësi përgjegjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2, faqe 14 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 5.1: Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin dosjeve me të gjithë dokumentet sipas kërkesave të sanksionuara në rregulloren e brendshme si dhe legjislacionit për të gjithë punonjësit e SRV-së.

Brenda 31.12.2021

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Ky rekomandim do të verifikohet në auditimin e rradhës së SRV për plotësinë e dosjeve të presonelit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 6: Nga auditimi në tërësi të listë-pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se, listë-prezencat e punonjësve dorëzoheshin rregullisht nga drejtorët, shefat e shërbimeve dhe përgjegjësit e sektorëve sipas varësisë, megjithatë në disa prej rasteve të audituara mungojnë nënshkrimi nga Drejtuesit, Nën-Drejtori Ekonomik dhe/ose Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore. Listë-pagesat e punonjësve ishin të rregullta të përpiluara, sipas shërbimeve përkatëse në bazë të strukturës të miratuar nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe të plotësuara me gjithë elementët, por mungon nënshkrimi i Përgjegjëses së Sektorit të Panit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli III, pika 69, ku citohet se: "Listë-pagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë-prezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij".
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2, faqe 14 të Raportit të Auditimit.

Rekomandimi 6.1: Spitali Rajonal Vlorë të marrin masa që në vijimësi të gjithë listë-pagesat të jenë të nënshkruara nga personat e përcaktuar sipas kërkesave të legjislacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Në dispozicion u vendosën listë pagesa të firmosura nga strukturat dhe drejtuese të SRV.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

Gjetje nga auditimi 7: Për periudhën objekt auditimi u konstatua që për llogaritjen e sigurimit shoqëror të detyrueshëm, gjatë hartimit të listpagesave të pagave për punonjësit e Spitalit Rajonal Vlorë nuk është zbatuar siç duhet pasi ndalesa e sigurimit shoqërorë është përllogaritur mbi pagën bruto për çdo punonjës, çka bën që ndalesa e sigurimeve shoqërore të jetë më e lartë, si rrjedhojë paga neto e punonjësve, të cilët e kalojnë këtë pagë maksimale, pra këtyre punonjësve u është kaluar një pagë më e ulët se ajo që duhet të ishte në fakt si rrjedhojë e përllogaritjes së gabuar të ndalesave. Kjo nuk ka ndikuar në deklarimin e kontributeve të sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatimin e të ardhurave në sistemin e tatimeve, pasi ky sistem i përllogarit automatikisht ndalesat sipas kërkesave ligjore vit pas viti, në kundërshtim me Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 10.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2, faqe 14 të Raportit të Auditimit.

Rekomandimi 7.1: Spitali Rajonal Vlorë, Sektori i Planit dhe Sektori i Financës të marrin masa që përllogaritja e sigurimeve shoqërore në listpagesat mujore të bëhet sipas kërkesave ligjore duke respektuar kufirin e pagës maksimale për efekt kontributi të sigurimeve shoqërore.

Menjëherë

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Nuk u vendos dokuemtacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

Gjetje nga auditimi 8: Nga auditimi konstatohet se Projekt Buxhetet Afatmesme për vitet 2018-2020, 2019-2021, 2020-2022 dhe 2021-2023 të hartuara nga Spitali Rajonal Vlorë paraqiten me mangësi referuar kërkesave ligjore, pasi nuk është përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat, treguesit e performancës për programin dhe aktivitetet e planifikuara sipas kërkesave buxhetore. Kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA".

Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 22 të Raportit të Auditimit.

Rekomandimi 8.1: Sektori i Planit të marrë masa që hartimi i Projekt Buxheteve Afatmesme të kenë në përbërje përveç formateve të miratuara edhe misionin e njësisë, përshkrimin e programit së bashku me qëllimin dhe objektivat, treguesit e performancës për programin dhe aktivitetet e planifikuara sipas kërkesave buxhetore.

Menjëherë.

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendos në dispozicion formati i misionit për projekt buxhetin i cili përmban elementët e përcaktuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

Gjetje nga auditimi 9: Nga auditimi rezulton që për vitin 2017 dhe 2018 Spitali rajonal Vlorë nuk ka paraqitur raporte monitorimi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto raporte paraqiten çdo tre mujor, por nga SRV nuk janë paraqitur jo vetëm raportet progresive të monitorimit për vitin 2017 por dhe raporti vjetor i monitorimit, përgjegjësi kjo e NA (titullar i institucionit). Për vitet 2018-2020 rezultojnë të dërguara MSHMS me shkresar nr. 1173, datë 08.02.2019, nr. 679, datë 11.02.2020 dhe 675, datë 17.02.2021 raporte vjetore monitorimi për zbatimin e buxhetit nga SRV. Mos paraqitja e raporteve të monitorimit është në kundërshtim

me Nenin 65 i ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 22 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 9.1: Spitali Rajonal Vlorë, Sektori i Financës të marri masa që të hartojë dhe përcjellë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit periodikisht sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit 3 – mujore nga përgjegjësia e financës dhe shkresat përcjellës të raporteve në Ministri
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

Gjetje nga auditimi 10: Nga auditimi rezultoi se, Spitali Rajonal Vlorë nuk është i përfshirë në sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ). Mbajtja e evidencës kontabile e kësaj njësie publike bëhet me programin Excel, të krijuar e mirëmbajtur nga Sektori i Financës. Sistemi i IT, mbulohet tërësisht nga struktura e brendshme, në kundërshtim me Organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4, faqe 28 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 10.1: Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë të marrë masa, që në të ardhmen, raportimi financiar të kryhet në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ). Procedurat e zbatimit të fondeve buxhetore të evidentohen në SIFQ, të administruar nga Ministria përgjegjëse për Financat dhe Ekonominë.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

Gjetje nga auditimi 11: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vjetore individuale u konstatua se në bilancin e vitit 2017, në formatin e tyre mungon "Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave (Formati nr. 7)". Në pasivin e bilancit kontabël nuk pasqyrohet në llogarinë e fondeve të tjera të veta, rezultati i mbartur nga viti i kaluar si dhe ai i vitit aktual. Në këtë zë të pasqyrës së pasivit nuk është pasqyruar rezultat i mbartur për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korrente apo kapitale, në kundërshtim me Ligjin 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Udhëzimin nr. 14 datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4, faqe 28 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 11.1: Të merren masa nga Nëpunësi Zbatues i institucionit, që në vijimësi, pasqyrat financiare të hartohen në mënyrë të plotë, si dhe të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Ky rekomandim do të verifikohet në auditimin e rradhës për pasqyrat financiare.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 12: Nga auditimi i pasqyrave financiare, u konstatua se llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" me kundërpartinë llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar" ka gjendje vlerën 335,873 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat u mbahen operatorëve ekonomik si garanci për kontratat e nënshkruara. Kjo shumë rezulton ende e pa tërhequr edhe pse nga verifikimi analitik i kësaj llogarie, kjo vlerë i përket viteve 2010-2016. Nga sa më sipër, konstatohet se këto garanci punimesh janë të vjetra, dhe normalisht ose duhet të ishin paguar në favor të operatorëve ekonomik ose duhet të ishin mbajtur si penalitet për shkak të mos përmbushjes së kontratës në kohë apo defekteve gjatë periudhës së garancisë. Nga Spitali Rajonal Vlorë, edhe pse kanë kaluar disa vite, nuk janë marrë masat e nevojshme për sistemimin e vlerës 335,873 lekë nga kjo llogari, pasi garancia duhet të shlyhet ndaj operatorëve ekonomik ose të kalojë në favor të autoritetit kontraktor me përfundimin e afatit të garancisë.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4, faqe 28 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 12.1: Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë dhe Nëpunësi Zbatues të ndjekin hapat e nevojshme për verifikimin nëse punimet janë marrë në dorëzim konform përcaktimeve dhe më pas të bëjnë njoftimin ndaj debitorëve.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Kryerja e veprimeve kontabël do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 13: Referuar informacionit të vendosur në pasqyrat financiare ka rezultuar se SPV ka një numër të konsiderueshëm të furnitorëve (50), të kontraktuar para vitit 2014, të rezultuar të pa likuiduar në vlerën 17,470,394 lekë gjatë vitit dhe deri në fund të vitit 2017.
Në pasqyrat financiare të vitit 2018, rezultuan 49 furnitorë të kontraktuar, të cilët rezultojnë të pa likuiduar me vlerë 17,100,893 lekë. Gjatë auditimit të bankës së vitit 2019, rezulton se gjatë këtij viti është krijuar një detyrim në vlerën 222,881 lekë, e cila është likuiduar në shkurt të 2021. Për vitin 2020, është krijuar një detyrim i ri me vlerën 178,628 lekë, e likuiduar në shkurt 2021.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4, faqe 28 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 13.1: Titullari i SRV dhe Këshilli Administrativ të marrin në analizë situatën, duke vijuar me marrjen e masave të menjëhershme për shlyerjen e detyrimeve ndaj furnitorëve dhe shmangien e shlyerjes së tyre me procese gjyqësore, të cilat do të sillnin shpenzime shtesë në buxhetin e SRV.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokument në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

Gjetje nga auditimi 14: Në procedurat e inventarizimit të aktiveve, të kryera në vitet 2017-2020, me urdhrin e brendshëm nr. 4749 prot. datë 12.12.2017 të titullarit të institucionit, "Për invetarizimin e aktiveve dhe kapitaleve të veta", është urdhëruar ngritja e 13 komisioneve të inventarizimit për gjendjen pasurore të institucionit, të ndarë sipas reparteve, administratës e magazinës. Nga auditimi u konstatua se, komisioni i inventarizimit të magazinave nuk ka mbajtur procesverbal me përgjegjësit e materialeve, për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit në magazinë. Në fletët e inventarizimit nuk ishin mbajtur shënimet e nevojshme për gjendjen fizike, si dhe relacioni i përgatitur në fund të procesit të inventarizimit nuk ka datë dhe numër protokolli. Në procesin e inventarizimit të aktiveve, për vitin 2020, u konstatua se, relacioni i mbajtur më datë 31.12.2020, nuk është i firmosur nga nëpunësi zbatues. Në procedurat e vlerësimit të aktiveve, të kryera në vitet 2017-2020, me urdhrin e brendshëm nr. 2589 prot, datë 06.06.2017, titullari i institucionit ka urdhëruar "Ngritjen e komisionit të

vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve", me përbërjen e 5 anëtarëve. Nga auditimi i funksioneve të punonjësve të cilët janë caktuar në komisionin e vlerësimit u konstatua se, një nga anëtarët, është me përgjegjësi materiale në sektorët ku ato janë caktuar për të kryer vlerësimin e materialeve.
Me urdhrin e brendshëm nr. 2565 prot, datë 06.06.2018, titullari i institucionit ka urdhëruar "Ngritjen e komisionit të vlerësimit të materialeve". Më datë 18.01.2019 është mbajtur procesverbali nga komisioni i vlerësimit të materialeve me propozimet, për llogaritë me vlerat përkatëse:
Llogaria 214/1 pajisje dhe instrumenta e vegla mjekësore - 12,667,564 lekë
Llogaria 218 inventar ekonomik - 8,568,555 lekë
Llogaria 327 inventar i imët - 7,594,050 lekë.
Në procesverbalin e mbajtur me zërat e materialeve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi, u konstatua se, nuk ishin pasqyruar të gjitha të dhënat si: vlera e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerën e mbetur, norma e amortizimit. Nga auditimi u konstatua se, në procesverbalin e mbajtur në përfundim të procesit të vlerësimit, nuk janë shënuar specifikimet teknike të aseteve si (lloji i pajisjes, marka, përmasat etj). Gjithashtu, relacioni i firmosur nga kryetarja e komisionit të vlerësimit,(nëpunësi zbatues), me nr. 691 prot., datë 18.01.2019, nuk paraqet me vërtetësi dhe transparencë raportin e mbajtur pas procesit të vlerësimit të materialeve për nxjerrje jashtë përdorimi, pasi u konstatua se, ky relacion ka në përmbajtje të tij numrat e urdhrave dhe numra protokolli të vitit 2016, si dhe materialet dhe vlerat për të cilat është përshkruar nuk kanë qenë objekt i këtij procesi vlerësimi.
Në procedurat e nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimi, vitet 2017-2019. Më datë 15.06.2017, komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi ka mbajtur procesverbalin dhe një përmbledhëse të llogarive në të cilën janë materialet, me vlerat përkatëse si më poshtë:
Llogaria 214/1 pajisje dhe instrumenta e vegla mjekësore – 12,457,221 lekë
Llogaria 218 inventar ekonomik - 12,229,332 lekë
Llogaria 327 inventar i imët - 60,808,8 lekë.
Nga auditimi u konstatua se, procedura e nxjerrjes së pajisjeve dhe instrumenteve e vegla mjekësore (llogaria 214/1), nuk ka ndjekur hapat e duhur, pasi, titullari i institucionit nuk ka raportuar siç përcakton pika 112/b, të udhëzimit 30.
Nga auditimi u konstatua se, nuk ka gjurmë të dokumentuara, për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, si: marrëveshja e nënshkruar midis autoriteteve të spitalit dhe firmës që ka dërguar materialet në vendgrumbullimin e mbetjeve urbane të qyteti, pagesa e kryer, procesverbali i mbajtur me këtë rast si dhe foto. Instrumentat mjekësorë nuk mund të grumbullohen në depot e spitalit për tu përdorur si pjesë zëvendësuese. Gjithashtu, mungon raporti për ndryshimin e gjendjes së inventarit (prurje ose nxjerrje jashtë përdorimi), i cili dërgohet në Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Mjekësore, në zbatim pikës 4, të urdhrit nr. 50 datë 12.02.2014 të ministrit të Shëndetësisë.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4, faqe 28 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 14.1: Nënpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i institucionit, në të ardhmen të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet të tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion procesverbal i komisionit dhe Lista e pajisjeve. Praktika e plotë do të auditohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 15: Në procedurën e prokurimit të shërbimit katering, me proces verbalin nr. 1912, datë 08.05.2020, grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 1884, datë 07.05.2020 (shkruar gabimisht në shkresë 07.06.2020) ka bërë dorëzimin tek operatori ekonomik fitues të 4

ambienteve kuzhinash në përdorim për mbajtjen e inventarëve dhe shpërndarjen e ushqimeve. Ndërkohë komisioni i ngritur për mbikëqyrjen e kontratës ka mbajtur procesverbalin me nr. 2363, datë 10.06.2020 për dokumentimin e investimeve të nevojshme që duhet të bëjë operatori ekonomik lidhur me pajisjet e kuzhinës, të cilat janë kryer një muaj pas fillimit të shërbimit, në kundërshtim me përcaktimet e kontratës dhe DST.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 51 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 15.1: Komisionet e ngritura për monitorimin e zbatimit të kontratës të jenë vigjilentë dhe të kërkojnë zbatimin në kohë dhe me rigorozitet të çdo përcaktimi të kontratës në funksion të një shërbimi sa më eficient.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion gjithë urdhërat e ngritjeve të komisioneve për monitorimin e kontratave dhe detyrat e ngarkuara. Puna e kryer nga këto komisione do të verifikohet në auditimin e rradhës kur të auditohen zbatimi i kontratave.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 16: Komisioni për zbatimin e kontratës dhe operatori ekonomik S.-A., nuk kanë marrë masa për lidhjen e kontratave të furnizimit me OSHEE dhe UKT veçmas për katër ambientet e mini-kuzhinave që i janë dhënë në përdorim operatorit ekonomik.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 51 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 16.1: Në kontratat e ardhshme, komisionet për monitorimin e zbatimit të tyre, të marrin masa për lidhjen e kontratave të veçuara për ambientet të cilat për atë periudhë ja kanë lënë në përdorim OE.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Spitali Rajonal Vlorë ka zhvilluar një kumunikim të vijueshëm me OE S.-A.:
Me shkresën nr. 1674, datë 15.04.2022 "Informacion mbi rekomandimin e KLSH" SRV i është drejtuar OE.
Me email datë 15.06.2022 i është komunikuar detyrimi sipas matjeve të specialistëve.
Me shkresën nr. 2953, datë 01.07.2022 "Informacion mbi vijimin e zbatimit të rekomandimit të KLSH" SRV ka vijuar kërkesën e saj.
Me Shkresën nr. 117, datë 21.07.2022 "Kthim përgjigje" OE refuzon vijimin me zbatimin e rekomandimit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 17: Në dokumentimin e zbatimit të kontratës së shërbimit katering, në asnjë rast proces verbalet, check-listat, apo tabelat përmbledhëse për forcën ditore nuk ishin të protokolluara, në kundërshtim me nenin 13 i "Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e Shqipërisë".
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 51 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 17.1: Spitali Rajonal Vlorë të marrë masa për regjistrimin në regjistrin e protokollit të çdo dokumenti të prodhuar i cili lidhet drejtpërdrejt dhe fakton veprimtarinë e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces.

Gjetje nga auditimi 18: Komisioni për monitorimin e kontratës së shërbimit katering nuk ka mbajtur procesverbale dhe dokumentacion justifikues për plotësimin e standardeve dhe kërkesave ligjore, si dhe specifikimeve teknike për produktet ushqimore të përdorura për përgatitjen e ushqimeve dhe fletë analizat shoqëruese për artikujt ushqimorë. Dokumentacioni

që disponon ky komision merret i mirëqenë siç dorëzohet nga OE dhe nuk i nënshtrohet një shqyrtimi mbi vlefshmërinë dhe plotësinë e tij.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 51 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 18.1: Komisionet e monitorimit të zbatimit të kontratës për shërbimet katering, të marrin masa për vlerësimin dhe verifikimin që çdo dokumentacion i paraqitur nga OE është i vlefshëm dhe mbulon të gjithë periudhën e kontraktuar duke verifikuar origjinën e tregtuesit dhe faktin nëse analizat e bëra i takojnë produkteve që po përdor OE.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicon.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I Pazbatuar

Gjetje nga auditimi 19: Procesverbalet për ruajtjen e kampionëve ushqimor 24 orë janë standard dhe tepër formale. Nga shqyrtimi i këtyre procesverbaleve u vu re se ato hartohen çdo ditë për të 3 vaktet me të njëjtat artikuj ushqimorë dhe pa specifikuar çdo dietë veçmas, ndërkohë që mungojnë kampionët ushqimor për vaktet e ndërmjetme në shërbimin e pediatrisë të cilat janë 5 në total.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 51 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 19.1: Komisioni për monitorimin e zbatimit të kontratës të kryej me rigorozitet dokumentimin e ruajtjes së kampionëve ushqimor, duke saktësuar çdo artikull sipas secilës dietë dhe vakt të shërbyer.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion procesverbalet e mbajtjes së kampionëve ushqimor për muajin janar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar.

Gjetje nga auditimi 20: Një dietë ushqimore specifike e përcaktuar sipas standardeve kalorifike dhe vlerave ushqyese të nevojshme, përbëhet nga 3 vakte për secilin pacient. Si përllogaritja, ashtu edhe likuidimi i vlerës së kontratës është bërë duke përcaktuar një kosto fikse për secilën dietë ushqimore dhe jo për secilin vakt. Në këtë mënyrë, likuidimi bëhet në vlerën e plotë të dietës pa marrë parasysh ndryshimet e numrit të pacientëve nga vakti në vakt, referuar edhe check listave ditore.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 51 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 20.1: Në funksion të garantimit të transparencës dhe ekonomicitetit, në kontratat e ngjashme në vijim, SRV të marrë masa për përllogaritjen e detajuar të vlerës së kontratës bazuar në secilin prej vakteve që do të konsumohen dhe jo në total të dietës. Në këtë mënyrë të bëhet edhe likuidimi i tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës për zbatimin e kontratave të ngjashme.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 21: Nga shqyrtimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit në procedurën e prokurimit për shërbimin e evadimit të mbetjeve spitalore për vitin 2020, konstatohet se AK nuk jep arsyet e zgjedhjes së marrëveshjes kuadër dhe kushtet e përcaktuara për këtë marrëveshje. Për këtë konstatim edhe APP nëpërmjet e-mail të datës 19.11.2019 ka kërkuar të plotësohen këto dy përcaktime, por kjo kërkesë nuk është marrë parasysh.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 56 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 21.1: Njësia e prokurimit të jetë e kujdesshme për zbatimin me rigorozitet të çdo përcaktimi të DST dhe të arsyetojnë me transparencë përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 22: Njësia e prokurimit për procedurën e prokurimit të shërbimit të evadimit të mbetjeve spitalore ka kërkuar që operatori ekonomik të kryej aktivitetin në një sipërfaqe ndërtese jo më të vogël se 300 m^2 sipas lejes mjedisore. Në proces verbalin e hartimit të kritereve të kualifikimit, njësia e prokurimit shprehet se për këtë kriter i është referuar përcaktimeve të nenit 12 të Ligjit nr. 9537, datë 18.05.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme". Për sa më lart, konstatohet se:
- Së pari kriteri për zotërimin nga ana e OE e një sipërfaqe ndërtese prej 300 m^2 nuk ka asnjë lidhje me bazën ligjore të cituar nga njësia e prokurimit, duke përbërë një kriter diskriminues dhe të pa bazuar, pasi trajtimi, evadimi, asgjësimi apo çdo lloj veprimtarie tjetër mbi mbetjet spitalore lidhet me standarde impiantesh, aparaturash, sipërfaqesh depozitimesh apo landfillesh dhe në asnjë rast me sipërfaqe ndërtese. Për këtë rast është vepruar në kundërshtim me nenin 20 të LPP dhe nenin 30 të VKM nr 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar;
- Së dyti, njësia e prokurimit i është referuar një ligji të shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (neni 69).
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 56 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 22.1: SRV të marrë masa në të ardhmen për njohjen dhe zbatimin me rigorozitet të kuadrit ligjor të prokurimeve, si dhe arsyetim të bazuar në dokumente ligjore apo rregullatore në përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifkohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 23: Në asnjë rast grupi i monitorimit të kontratës nuk ka mbajtur procesverbalet përkatëse për konfirmimin e përmbushjes së tyre, në prani edhe të operatorit ekonomik. Ky konstatim lidhet edhe me faktin se kontenitorëve dhe koshave të paraqitur në sistemin elektronik nëpërmjet fotove nga "E.-r. shpk" u mungojnë pjesa më e madhe e elementëve të sigurisë të etiketave, të cilët këto mjete grumbulluese kanë detyrimin ti kenë. Po kështu, këto etiketa nuk janë as në gjuhën shqipe. Pavarësisht nënshkrimit të deklaratës së operatorit ekonomik se plotëson të gjitha specifikimet teknike, ky fakt nuk është vërtetuar nga grupi i monitorimit të kontratës gjatë zbatimit dhe as nuk rezulton i tillë në fotot e paraqitura nga vetë operatori ekonomik.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 56 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 23.1: Komisionet e vlerësimit të ofertave në të ardhmen të vlerësojnë me seriozitet dhe kujdes maksimal çdo detaj teknik që është është kërkesë e DST dhe përbën masë sigurie për shërbimin në fjalë.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 24: KVO përgjegjëse për procedurën e prokurimit për evadimin e mbetjeve të rrezikshme, me shkresën nr. 835, datë 18.02.2020 ka hartuar dhe miratuar raportin përmbledhës, i cili në përmbajtjen e tij nuk pasqyron rastet e ankimimeve dhe vendimmarrjen lidhur me to, në kundërshtim me nenin 68 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave për prokurimin publik", i ndryshuar.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 56 të Raportit të Auditimit.

Rekomandimi 24.1: Në raportet përmbledhëse në vijim, KVO sipas rastit të marrin masa për hartimin dhe pasqyrimin e detajuar dhe të plotë të të gjithë procedurës së ndjekur hap pas hapi.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e procedurave të prokurimit në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 25: Në procedurën e prokurimit për blerje kite&reagentë, mungojnë çertifikimet ISO 9001-2015 për produktet e prokuruara. Certifikimet e dorëzuara janë të ndryshme nga ajo e kërkuar nga njësia e prokurimit në kriteret e kualifikimit. Certifikimet e dorëzuara nga prodhuesi H. L. skadojnë më 28.02.2019, pra rreth 20 ditë pas lidhjes së kontratës, ndërsa për prodhuesin B. M. Inch më datë 31.10.2019, pra 4 muaj përpara përfundimit të kontratës. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët për kitet dhe reagentët që disponon, në të cilët të markohen me ngjyrë kitet dhe reagentët e kërkuar nga SRV. Në këtë kriter përcaktohet shprehimisht se mos markimi i kiteve dhe reagentëve të kërkuar përbën kusht për s kualifikim dhe këta katalogë do të pranohen elektronikisht të ngarkuara vetëm në SPE. Për sa më lart rezultoi se, operatori ekonomik i shpallur fitues ka ngarkuar në SPE katalogët nga 9 prodhues nga të cilët nuk janë markuar kitet dhe reagentët nga katalogët e 5 prodhuesve. Katalogu i dorëzuar nga prodhuesi S. D. është për llojet e aparaturave që kryejnë analizën dhe jo për kitet dhe reagentët. Nga shqyrtimi i këtij katalogu rezulton se përmenden të gjithë llojet e analizave që mund të kryejnë aparaturat e këtij prodhuesi, por nuk përcaktohen formatet e dozës apo njësia matëse e tyre. I ngjashëm është edhe rasti i katalogut të prodhuesit B. M. I., i cili përmban llojet e aparaturave që kryejnë/lexojnë analizat dhe pavarësisht se në këtë katalog përmenden llojet e analizave që mund të kryhen në këto pajisje, nuk është katalog që përmban reagentët që prodhon ky prodhues. Po kështu artikujt e markuar në pjesën më të madhe të rasteve nuk janë të formë dozës së kërkuar në DST. Konkretisht, një pjesë e tyre janë markuar në formë dozën "numër testesh/paketim" ndërkohë që janë kërkuar në formë dozën "ml/paketim" dhe një pjesë e tyre janë të formë dozave më të mëdha se ajo e kërkuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 66 të Raportit të Auditimit)

Rekomandimi 25.1: Komisionet e vlerësimit të ofertave në të ardhmen të vlerësojnë me seriozitet dhe kujdes maksimal çdo detaj teknik që përbën një kusht kualifikimi në dokumentacionet e dorëzuara.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e procedurave të prokurimit në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 26: Nga auditimi por edhe nga observacionet e mbërritura u konstatua se pavarësisht se grupi për monitorimin e zbatimit të kontratës, mban procesverbale në momentin e grumbullimit dhe peshimit të mbetjeve, këto procsverbale nuk konsiderohen "ligjore" dhe nuk i dërgohen sektorit të financës për kryerjen e likujdimeve përkatëse. Dokumentacioni që i dërgohet sektorit të financës për këtë qëllim është vetëm përmbledhja mujore e sasive të mbetjeve të grumbulluara çdo javë, situacioni i dërguar nga operatori ekonomik dhe dokumenti për transportimin e mbetjeve që është një detyrim ligjor i çdo transportuesi mbetjesh të rrezikshme dhe nuk lidhet me detyrimet e monitorimit të zbatimit të kontratës. Duke mos i dhënë rëndësi këtij lloj dokumenti, SRV nuk paraqiti plotësisht pranë grupit të auditimit të gjitha procesverbalet e mbajtuar, por i plotësoi ato nëpërmjet observacioneve edhe pse nga grupi i auditimit ishin kërkuar prej kohësh gjatë auditimit. Për sa më lart, grupi i auditimit shprehet me rezerva për vërtetësinë e tyre për sa kohë ato janë dokumente lehtësisht të hartueshme në çdo moment pasi nuk përmbajnë numër protokolli dhe plotësoshen me dorë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 66 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 26.1: Titullari i institucionit të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj komisioneve të monitorimit të zbatimit të kontratës, duke kërkuar mbajtjen e procesverbaleve të detajuara dhe konfirmuara nga të gjitha palët që kanë detyrim në këtë proces, si dhe të rakordojë këto procesverbale me çdo dokumentacion tjetër që paraqitet nga operatori ekonomik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion një kontratë "Blerje medikamentesh për nevoja të SRV" nr. 1248, datë 17.03.2022. Plan i Zbatimit të Kontatës dhe Formular i zbatimin të Kontartës. Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 27: Marrja në dorëzim dhe verifikimi i kiteve dhe reagentëve të dorëzuar për të dy lotet, është bërë nga grupi i ngritur me Urdhër nr.1165, datë 08.02.2019 për marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e aktiveve të furnizuara apo dhuruara, i cili ngrihet një herë në vit dhe funksionon për çdo transaksion. Ky grup ka mbajtur proces verbalet përkatëse në ditët e dorëzimit të mallrave, duke pasqyruar sasitë, njësitë dhe datat e skadencës, por nuk pasqyrohet vendi i origjinës. Sa i takon grupit të punës për monitorimin e zbatimit të kontratës, ngritur me Urdhrin nr. 1098, datë 07.02.2019 të titullarit, u vunë në dispozicion vetëm 3 procesverbale të mbajtura nga ky komision, konkretisht në datat 31.03.2019, 31.05.2019 dhe 31.08.2019, të pa protokolluar. Procesverbalet e mbajtura, janë tepër formale, nuk janë mbajtur në datat e lëvrimit të mallit në SRV dhe nuk përmbajnë asnjë emërtim artikujsh, sasish apo verifikime të tjera për artikujt e dorëzuar. Në to përshkruhet shkurtimisht procedura që ndiqet për shpërndarjen e mallrave nëpër laboratorë, kushtet e ruajtjes së tyre, si dhe fakti se furnizimi ka qenë konform kushteve të kontratës.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 66 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 27.1: Titullari i SRV të marrë masa për përcaktimin e qartë të detyrimeve të grupeve të punës që ngre në funksion të monitorimit të zbatimit të kontratave, duke mbajtur parasysh se Ligji për Prokurimin Publik njeh vetëm një komision për monitorimin e zbatimit të kontratës, i cili ngrihet rast pas rasti sipas specifikave dhe shmangies së konflikteve të interesit nga anëtarët.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion gjithë urdhërat e ngritjeve të komisioneve për monitorimin e kontratave dhe detyrat e ngarkuara. Puna e kryer nga këto komisione do të verifikohet në auditimin e rradhës kur të auditohen zbatimi i kontratave.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 28: Nga auditimi rezultoi se në disa raste shërbimet janë kryer përpara afatit periodik të përcaktuar, me arsyetimin se ka qenë i nevojshëm për shkak të problemeve, megjithatë këto raste nuk janë dokumentuar me procesverbale të veçanta nga ato të shërbimeve periodike që ishin në radhë për tu kryer. Po kështu, në disa raste konstatohet se shërbimet janë kryer rreth 2 muaj me vonesë nga afati i përcaktuar në planin e veprimit. Në planin e veprimit të mirëmbajtjeve të pajisjeve mjekësore Skaner dhe Rezonancë përcaktohen shërbimet dhe periodiciteti me të cilin do kryhen ato, por nuk është hartuar një grafik periodik se cilat shërbime do të kryhen në ditë apo muaj të caktuar.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 73 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 28.1: Për këtë lloj shërbimi, njësitë e prokurimit të marrin masa për përcaktimin e një grafiku punimesh me emërtimin, frekuencën dhe datën e saktë në cilën do të kryhet shërbimi i parë dhe ata pasardhës, në mënyrë që të shmangen konfuzionet dhe mangësitë në përmbushjen e të gjithë numrit të shërbimeve që nevojiten.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me email datë 27.04.2022 dhe 16.06.2022 SRV i është drejtuar për mendim MSHMS por ska përgjigje.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 29: Nga auditimi i proces verbaleve dhe formularëve të mirëmbajtjes të mbajtur nga palët, rezulton se për periudhën 24 mujore të zbatimit të kontratës së mirëmbajtjes nuk janë kryer plotësisht shërbimet sipas frekuencës së përcaktuar në aneks për 3 raste dhe konkretisht:

- Për shërbimin "kontrolli i sistemit të sigurisë së LCC" është përcaktuar një frekuencë prej 12 muaj, pra dy herë për periudhën e zbatimit të kontratës, ndërkohë është kryer vetëm 1 herë;
- Për shërbimin "kontrolli i DPS" është përcaktuar një frekuencë prej 12 muaj, pra dy herë për periudhën e zbatimit të kontratës, ndërkohë është kryer vetëm 1 herë;
- Për shërbimin "kontrolli për saldime të prishura" është përcaktuar një frekuencë prej 12 muaj, pra dy herë për periudhën e zbatimit të kontratës, ndërkohë është kryer vetëm 1 herë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 73 të Raportit të Auditimit.

Rekomandimi 29.1: SRV të marrë masa për monitorimin dhe zbatimin me korrektësi të kontratës së mirëmbajtjes së pajisjeve, duke pasqyruar me hollësi numrin e shërbimeve që duhet të kryhen për secilin zë, ose dokumentimin e arsyeve përse shërbimet nuk janë kryer, në rast se këto nuk kanë qenë të nevojshme.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion Formulari i Mirëmbajtjes dhe Procesverbalet përkatës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 30: Hartimi i kontratës midis SRV dhe shoqërisë "G. S." për procedurën "Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike", për vitin 2020, duke përfshirë një nen që favorizon një operator tjetër jo pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Kontrata nr.2917,datë 15.07.2020 e lidhur midis SRV dhe operatorit fitues të tenderit të zhvilluar më datë 02.07.2020 "G. S.", është e llojit Marrëveshje Kuadër me afat 15.07.2020-14.07.2021 për 12 muaj. Në nenin 2 të kësaj kontrate përcaktohet se kohëzgjatja e kësaj kontrate do të konsiderohet e përfunduar nëse shoqëria "I. G." e krijuar në bazë të VKM nr.177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë "I. G." sha, merr përsipër ofrimin e këtij shërbimi, për rrjedhojë kontrata e lidhur midis "G. S." dhe Spitalit Rajonal Vlorë do të konsiderohet e zgjidhur nga hyrja në fuqi e kontratës me "I. G." sha. Për sa më sipër grupi i auditimit konstaton se referuar korrespondencës së SRV-së me shoqërisë "I. G."sha e krijuar në bazë të VKM nr.177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë "I. G." sha, kjo e fundit është shprehur se nuk do të marrë përgjegjësinë për organizimin dhe kryerjen e shërbimit të sigurisë së objekteve të SRV deri në datën 25.09.2020, gjithashtu shoqëria "I. G.", do të njoftojë zyrtarisht gatishmërinë e saj 1 muaj përpara se SRV të ndërpresë marrëdhëniet kontraktore në mënyrë korrekte , të cilat do ti lejohen nga APP, mbi shtyrjen e afatit për ofrimin e shërbimit të kërkuar nga SRV. Megjithatë Spitali Rajonal Vlorë kur ka hartuar kontratën nr.2917, datë 15.07.2020 e lidhur midis SRV dhe operatorit fitues të tenderit të zhvilluar më datë 02.07.2020 "G. S.", me afat lëvrimi 12 muaj dhe sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST dhe ofertës së shpallur fituese të operatorit "G. S.", ka përcaktuar në nenin 2 të saj se kohëzgjatja e kësaj kontrate do të konsiderohet e përfunduar nëse shoqëria "I. G." e krijuar në bazë të VKM nr.177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë "I. G." sha, merr përsipër ofrimin e këtij shërbimi, për rrjedhojë kontrata e lidhur midis "G. S." dhe Spitalit Rajonal Vlorë do të konsiderohet e zgjidhur nga hyrja në fuqi e kontratës me "I. G." sha. Në këtë kontratë nuk përcaktohet mbi cilat kushte do të vazhdojë shërbimin shoqëria "I. G." e

krijuar në bazë të VKM nr.177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë "I. G." sha, kur e gjithë procedura e mësipërme deri në lidhjen e kontratës ka inicimin, termat e referencës dhe DST-të mbi bazën e një studimi dhe është kryer sipas një procedure konkuruese me një operator fitues, dhe në DST-të e kësaj procedure nuk përcaktohet paraprakisht përfundimi i paracaktuar i kontratës nëse shoqërisë "I. G." e krijuar me VKM nr.177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë "I. G." sha i krijohet mundësia për ofrimin e këtij shërbimi. Referuar pikës 11 të VKM nr.177, datë 04.04.2019"Për krijimin e shoqërisë "I. G." sha, thuhet në mënyrë eksplicite se "Nëse kjo shoqëri merr vendim për pamundësinë e ofrimit të shërbimit të kërkuar, institucionet dhe subjektet publike mund ta sigurojnë këtë shërbim në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi".
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 76 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 30.1: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen të hartojë DST dhe Kontrata me terma të qarta reference mbi objektin e prokurimit për të garantuar trajtim të barabartë të ofertuesve ose kandidatëve, transparencë në procedurat e prokurimit dhe barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve në procedurat e prokurimit.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 31: Likuidimi i kontratës për procedurën "Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike", për vitin 2020, pa bashkëlidhur regjistrat e marrjes së turnit sipas shërbimit të rojeve, gjithashtu nuk ka një procesverbal të detajuar nga grupi i monitorimit të zbatimit të kontratës mbi grafikun mujor të shërbimit sipas regjistrave të marrjes së turnit. Referuar zbatimit të Kontratës nr.2917, datë 15.07.2020 e lidhur midis SRV dhe operatorit fitues të tenderit të zhvilluar më datë 02.07.2020 "G. S.", me afat lëvrimi 12 muaj, likuidimi i saj ndaj "G. S.",monitorohet nga grupi i monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nga verifikimi i likuidimeve konstatohet se prezenca e rojeve sipas ditëve të shërbimit kryhet vetëm me kohëshënues dhe nuk janë bashkëlidhur regjistrat e marrjes së turnit sipas shërbimit të rojeve, gjithashtu nuk ka një procesverbal të detajuar nga grupi i monitorimit të zbatimit të kontratës mbi grafikun mujor të shërbimit sipas regjistrave të marrjes së turnit. Skema e ruajtjes së sigurisë së objektit është e vizatuar pa elementët teknikë mbi sipërfaqen reale të Spitalit Rajonal Vlorë. Për shkeljet dhe parregullsitë e mësipërme sa i përket zbatimit të kontratës sa i përket argumentimit të shërbimit të ruajtjes së sigurisë të rakorduara kohëshënues / regjistër marrje turni, ngarkohet me përgjegjësi Grupi i Monitorimit të Zbatimit të Kontratës dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 76 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 31.1: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen të përcaktojë qartë detyrimet kontraktore në Dokumentet Standarde të Tenderit dhe Kontratë, gjithashtu të monitorojë zbatimin e kontratave që lidh me operatorët ekonomikë sipas kushteve të përcaktuara në grafikun e lëvrimit dhe termat e referencës së kontratës.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 32: Mos planifikim i duhur i nevojave të Spitalit Rajonal Vlorë për evadimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore për vitin 2020. Autoriteti Kontraktor/ Spitali Rajonal Vlorë referuar relacionit me nr.300, datë 22.01.2020 të kryer nga specialistja e sektorit të mjedisit , me urdhrin nr. 394, date 28.01.2020 ka iniciuar procedurën me negocim pa shpallje "Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore për nevoja të SRV", viti 2020. Arsyeja e përdorimit

të kësaj procedure referuar argumentimit të AK ka qenë faza e magazinimit 45 ditor i mbetjeve të rrezikshme spitalore prej datës 11.12.2019 dhe pritja për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore për nevoja të SRV" e cila është hedhur në sistemin e APP për vitin 2020, por nuk ishte realizuar akoma. Nga grupi i auditimit është konstatuar se Kontrata e mëparshme që Autoriteti Kontraktor ka lidhur me operatorin "E. R." nr.1036, datë 05.02.2019 me vlerë 8,708,004 lekë pa TVSH me afat realizimi 12 mujor sigurimi i kësaj kontrate fillon në datë 10.01.2019 dhe mbaron 10.01.2020 pra sigurimi i kontratës përfundon një muaj para përfundimit të realizimit të kontratës, në kundërshtim me nenin 28.3, të kontratës nr.1036, datë 05.02.2019, ku përcaktohet se "sigurimi i kontratës do t'i kthehet kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së shërbimeve".
Në kontratën nr.1036, datë 05.02.2019 nenin 22 "Ndryshimi i Porosisë" parashikohet që AK rezervon të drejtën të porosisë shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20 % të çmimit total të kontratës" por AK nuk e ka marrë parasysh këtë fakt dhe ka iniciuar procedurën Negocim pa Shpallje "Evadim i mbetjeve te rrezikshme spitalore", viti 2020, pa pritur përfundimin e afatit 12 mujor të kontratës së mëparshme me nr.1036, datë 05.02.2019 me vlerë 8,708,004 lekë pa TVSH me afat realizimi 12 mujor, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit dhe titullari i AK.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 81 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 32.1: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen të planifikojë sipas parashikimeve dhe nevojave të Spitalit Rajonal Vlorë duke respektuar përfundimet e kontratave të mëparshme, për nisjen e procedurave të reja për shërbimet për evadimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 33: Kontrata midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit fitues të tenderit "M. A." sh.p.k është lidhur më datë 12.03.2020 me nr.1290.Referuar likuidimit të operatorit "M. A." sh.p.k, nga Spitali Rajonal Vlorë janë kryer 46 likuidime nga data 30.03.2020 deri në datën 15.12.2020 për gjithë vlerën e kontratës, pra Spitali Rajonal Vlorë ja ka likuiduar operatorit "M. A." sh.p.k gjithë vlerën e kontratës për 10 muaj nga 12 muaj lëvrim oksigjeni, që parashikohet në kontratë dhe në DST.
Autoriteti Kontraktor ka lidhur një aktmarrëveshje me operatorin "M. A." sh.p.k me nr.4859, datë 10.12.2020 duke përcaktuar se sasia e ngelur nga kontrata ka qenë 106,600 litra me çmim për njësi 34.56 lekë/litër pa TVSH dhe sipas kësaj akt marrëveshje ndodhur në kushte emergjente dhe të paparashikuar nga rritja e pacientëve me COVID-19 Autoriteti Kontraktor është detyruar të ketë garanci për sasinë e oksigjenit dhe sasia 106,600 litra me vlerë 3,684,096 lekë pa TVSH, do të realizohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor me një faturë. Për këtë sasi oksigjeni Spitali Rajonal Vlorë pretendon se s'kishte mundësi magazinimi referuar aktmarrëveshjes sa më sipër. Referuar kontratës midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit fitues të tenderit "M. A." sh.p.k të lidhur më datë 12.03.2020 me nr.1290, në nenin 3, pika 2 përcaktohet se "Autoriteti Kontraktor është i detyruar të krijojë kushtet për marrjen e mallit në dorëzim me mbërritjen në magazinën e tij", gjithashtu në këtë kontratë nuk është i përfshirë asnjë nen që të lejojë Autoritetin Kontraktor të amendojë kontratën apo të lidhë aktmarrëveshje me operatorin fitues të tenderit. Për parregullsitë dhe shkeljet e mësipërme mban përgjegjësi njësia e prokurimit dhe titullari i Autoritetit Kontraktor.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 88 të Raportit të Auditimit)

Rekomandimi 33.1: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen të planifikojë saktë nevojat e tij për oksigjen dhe të përcaktojë detyrime të qarta në kontratat që do lidhë me operatorët fitues që lëvrojnë mallrat për nevojat e SRV-së.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e procedurave të prokurimit në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 34: Autoriteti Kontraktor ka lidhur me operatorin fitues "E. F." sh.p.k ,Draft Kontratën/ Marrëveshje Kuadër nr.1434, date 30.03.2020 me vlerë 2,499,822 lekë pa TVSH kontraktori ka rënë dakord të furnizojë mallrat ashtu siç janë të përcaktuara në këtë kontratë, formularin e deklarimit të ofertës, specifikimet teknike, formularin e çmimit të ofertës, konkretisht sipas ofertës së kontraktorit të publikuar më datë 06.03.2020 çmimi total i ofertës ka qenë 2,498,850 lekë për 11 mallra për një totale vlere kontrate prej 2,090,300 lekë pa TVSH dhe 2,508,360 lekë me TVSH. Me urdhër shpenzimin nr.271, datë 24.04.2020 Spitali Rajonal Vlorë ka likuiduar operatorin E. sh.p.k në vlerën 2,090,300 lekë pa TVSH dhe 2,508,360 lekë me TVSH për 6 artikuj sipas vlerave dhe sasive që ka kontrata, me operatorin fitues "E. F." sh.p.k, por referuar kërkesave nga Farmacia e Spitalit Rajonal Vlorë kur është iniciuar procedura e prokurimit ,nuk përkojnë mallrat e dorëzuara në Spitalin Rajonal Vlorë me ofertën e operatorit dhe mallrat që kërkohen në kontratë. Pavarësisht faktit që Autoriteti Kontraktor ka lidhur marrëveshje kuadër me një operator ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 1 vjeçar, operatori fitues është likuiduar për të gjithë vlerën e kontratës 2,090,300 lekë pa TVSH dhe 2,508,360 lekë me TVSH brenda datës 24.04.2020.
Kontrata nr.1434, datë 30.03.2020 me vlerë 2,090,300 lekë pa TVSH, është lidhur për 6 artikuj dhe jo për 11 artikuj që janë kërkuar që në kërkesën e bërë nga Farmacia e Spitalit Rajonal Vlorë dhe në dosjen e prokurimit ,nuk ka asnjë Kontratë nr.2, amendim kontrate apo relacion shpjegues mbi ndryshimin e zërave të Kontratës, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar , neni 47, pika 2 në të cilën përcaktohet se "Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatitë ofertën e tij vetëm në lidhje me kushtet për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër në përputhje me LPP dhe këto rregulla". Për shkeljet dhe parregullsitë e mësipërme sa i përket hartimit të DST-ve dhe mos argumentimit të ndryshimit të tyre para dhe gjatë lidhjes së kontratës, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 84 të Raportit të Auditimit)

Rekomandimi 34.1: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen të planifikojë saktë nevojat e tij për materiale mbrojtëse për nevoja të SRV dhe të përcaktojë detyrime të qarta në kontratat që do lidhë me operatorët fitues që lëvrojnë mallrat për nevojat e SRV-së gjithashtu të rakordojë me Ministrinë e linjës kontratat aktive të të njëjtit mall apo shërbim që MSHMS kryen për llogari të Spitalit Rajonal Vlorë, në mënyrë që të mos ketë dublime procedurash dhe përdorim pa efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e procedurave të prokurimit në auditimin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 35: Në procedurën e prokurimit për ri-konstruksionin e reanimacionit është vendosur kriteri që shoqëria pjesëmarrëse të ketë në stafin e kompanisë, ndër të tjera, inxhinier strukturist dhe inxhinier materialesh dhe me kushtin që këta inxhinierë të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera publike gjatë kohës së kryerjes së realizimit të kësaj procedure (deri në fund të punimeve). Megjithëse edhe nga APP ky kriter është kundërshtuar, duke u shprehur që "AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e së cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve në fjalë", përsëri nga ana e AK, ky kriter është lënë, duke u justifikuar me shmangien e problemeve teknike gjatë zbatimit, si dhe me kontrollin e cilësisë së materialeve që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Ky kriter është i panevojshëm, pasi për tu siguruar për shmangien e problemeve teknike dhe cilësinë e materialeve, AK duhet që këta inxhinierë ti kishte kërkuar gjatë zhvillimit të procedurës së mbikëqyrjes së punimeve. Është mbikëqyrësi i punimeve i ngarkuar me përgjegjësinë që vjen nga problematikat e sipërpërmendura, në zbatim të UKM Nr.3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
Është vendosur kriteri që shoqëria pjesëmarrëse të disponojë Drejtues Teknik, Inxhinier Ndërtimi që të jetë i certifikuar me certifikatë trajnimi me titull; "Specialist për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit", e dhënë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar ose i huaj me modulet e më poshtme:
Moduli 2 "Standardet për sigurimin e cilësisë së produkteve të ndërtimit"
Moduli 4 "Standartet për metodat e testimit të produkteve të ndërtimit".
Edhe përsa i përket këtij kriteri, konstatohet që është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku cilësohet që *çdo kriter duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës*, pasi cilësinë e materialeve të përdorura në vepër, e certifikojnë laboratorët specifikë dhe materialet kontrollohen nga mbikëqyrësi i punimeve. Janë vendosur kritere, që shoqëria pjesëmarrëse të disponojë një mjek dhe një Auditues të Energjisë, kritere që, edhe pse ka pasur kundërshtime nga APP, përsëri kanë qëndruar në KVK. Edhe këto dy kritere janë në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit të prokurimeve, të cituara më sipër.
Është kërkuar kamion vetëshkarkues 8 – 10 ton, pa argumentuar se pse 8 – 10 ton dhe jo më shumë apo më pak këtyre kufijve. Konstatohet që ky kriter është një nga arsyet për skualifikimin e një operatori që ka paraqitur dy mjete, nga të cilat njëra është me kapacitet më të vogël se 8 ton (5.85 ton) dhe tjetra më të madhe se 10 ton (14.2 ton).
Është kërkuar një automjet ATP dhe një makineri betoni, pa e përcaktuar se çfarë janë.
Është kërkuar një teknik ndërtimi, pa cilësuar alternativë (inxhinier ndërtimi).
Është kërkuar një deflektometër shtresash, i cili përdoret për të matur saktësinë e niveletës së shtresave rrugore dhe nuk ka asnjë lidhje me shtresat që do të vendosen në këtë objekt. Ky kriter është në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit të prokurimeve.
Janë kërkuar një sërë pajisjesh si vidator, saldatriçe, troko, instrument nivelimi, makineri shpuese, prerëse dhe sharrë për punim metali, si dhe pajisjet e punëtorëve (rrobat e punës), të cilat nuk mund të vihen si kritere për realizimin e kontratës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 90 të Raportit të Auditimit)
Rekomandim 35.1: Nga ana e Spitalit Rajonal Vlorë të merren masa për vendosjen e kritereve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e procedurave të prokurimit në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 36: Në preventiv, në kapitullin "Impianti i kondicionimit", zëri me nr. an A-50" (me vlerë të preventivuar 4,502,914 lekë, ose 10.4% e vlerës totale të objektit), është konstatuar se përshkrimi i zërit është:
"Ambienti i reanimacionit
-"FV Pajisje e jashtme nxehtësie, VRS me gaz ftohës R410A
-Sistemi i monitorimit dhe funksionimit të sistemit, nga pajisja e jashtme VRF ngrohje 33.5 kW, ftohje 30.5 kW
- Antivibrantë, ***etj.****"* , duke e lënë të hapur dhe të papërcaktuar se çfarë ka pas fjalës "etj.".
Gjithashtu, -Në preventiv, në kapitullin "Sistemi i rrjetit të gazit mjekësor", zëri me nr. an A-2.1" (me vlerë të preventivuar 4,077,558 lekë, ose 9.4% e vlerës totale të objektit), është konstatuar se përshkrimi i zërit është:
"F.V. pajisjet mjekësore (oksigjen, vakum, ajër) me panel bllok vertikal i kompletuar, me kanaline për përdorim në ambiente spitalore për trajtim pacientit e montuar në mur. L=3 ml
- 3 x priza shiko 16A, 250V (rrjeti)
- 1 x priza shiko 16A, 250V (ups-i)
- 2 x priza RJ45 F/FTP CAT6
- 1x 36 kW me llambe fluoreshente
- Celes 2 polar per ndricim anesor,
- 3 x dalje për gara mjedisore
- 1x çelës me tërheqje për thirrje të infermieres
- 1 telekomande kontrolli për lajmërim infermiere, kontroll ndriçimi, ***<u>etj.</u>****",* duke e lënë të hapur dhe të papërcaktuar se çfarë ka pas fjalës "**<u>etj.</u>**", në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 90 të Raportit të Auditimit.
Rekomandim 36.1: Nga ana e Spitalit Rajonal Vlorë të merren masa për ngritjen e grupeve të punës, në përbërje të të cilëve të jenë punonjës të specializuar në fushat e investimeve/shërbimeve, për kontrollin e projekt preventivave para hedhjes së tyre në tender, me qëllim realizimin e investimit/shërbimit me fonde sa më afër realitetit.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e procedurave të prokurimit në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 38: Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë u konstatuan shumë fatura tatimore të pa firmosura nga institucioni, gjithashtu në veprimet e muajit dhjetor 2017 në shumicën e autorizimeve të lëshuara nga drejtori i spitalit, për mjekët ose infermierët të cilët kanë shoqëruar pacientët drejt spitaleve në Tiranë, mungon data dhe numri i protokollit të tyre. Në veprimeve të kryera me bankë të muajit mars 2019, në të gjitha autorizimet e lëshuara nga përgjegjësja e financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, mungon numri i protokollit dhe në shumicën prej tyre dhe data e lëshimit të autorizimit, gjithashtu në disa raste mungojnë dokumente justifikues, kur punonjësit kanë kryer shërbim për trajnime jashtë rrethit. Në praktikën bashkëngjitur për blerjen e 19 copë UPS 600VA dhe 1 copë UPS 1000VA u konstatua se, nuk është mbajtur procesverbali i vlerësimit të UPS-ve nga specialisti i fushës, për testimin e tyre, nëse mund të riparoheshin ose jo. Në praktikën bashkëngjitur blerjes me vlerë të vogël për FV. dyer automatike, mungojnë katalogu me foto dhe specifikimet teknike të kompanisë prodhuese të mallit si dhe garancia 1 vjeçare, të kërkuar në specifikimet teknike në ftesën për ofertë. Gjithashtu, u konstatua se, në 3 procesverbalet të datës 07.10.2020 të mbajtur nga komisioni i llogaritjes së fondit limit, ka mos rakordim në data veprimesh. PV mban në krye datën 07.10.2020, në brendësi citohet: *I mbajtur sot më datën 05.10.2020...*

Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6, faqe 113 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 38.1: Nëpunësi zbatues i institucionit të marrë masa, që në të ardhmen, veprimet ekonomike të cilat kryhen në SRV si dhe faktet që sjellin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, të pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 39: Për Urdhër Shpenzimin nr. 687 dhe 687/1, datë 06.12.2018 "Blerje materiale mjekimi", është likuiduar vlera 1,847,520 lekë dhe 1,150,920 lekë, kundrejt OE "M. shpk" dhe "B. A.". Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur likuidimit krahas të tjerave është dhe kontrata nr. 4543, datë 07.11.2018 për "Furnizime me materiale mjekimi" për Spitalin Rajonal Vlorë nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive "M. & B. A.". Nuk është përcaktuar as në faturën tatimore të OE, as në Proces-Verbalin "për marrjen në dorëzim të mallrave dhe kolaudimi i tyre" afati i skadencës për 20 artikujt e likuiduar për operatorin ekonomik "M.", me faturë nr. 12113 datë 12.11.2018 dhe për 5 artikujt e likuiduar për operatorin ekonomik "B. A.", me faturë nr. 338, datë 20.11.2018.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6, faqe 113 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 39.1: Spitali Rajonal Vlorë të marri masa që komisioni i marrjes në dorëzim në të ardhmen të zbatojë me rigorozitet parashikimet e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion gjithë urdhërat e ngritjeve të komisioneve për monitorimin e kontratave dhe detyrat e ngarkuara. Puna e kryer nga këto komisione do të verifikohet në auditimin e rradhës kur të auditohen zbatimi i kontratave.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 40: Nga auditimi vihet re që urdhër shpenzimet:
nr. 688-694, datë 06.12.2018; nr. 697, datë 07.12.2018; nr. 715, datë 13.12.2018; nr. 723-729, datë 14.12.2018; nr. 731, datë 17.12.2018; nr. 734, datë 18.12.2018; nr. 743-753, datë 19.12.2018; nr. 755-756, datë 19.12.2018; nr. 761-766, datë 20.12.2018; nr. 770, datë 21.12.2018; nr. 793, datë 22.12.2018; nr. 796, datë 24.12.2018; nr, 798, datë 25.12.2018.
kanë përgjithësisht bashkëlidhur dokumente vërtetues; faturën tatimore, fletë-hyrja dhe proces-verbalin e marrjes në dorëzim. Për këto likuidime vërehet që dokumentacioni bashkëlidhur nuk është plotësuar për të gjithë pagesat, pasi dokumentet origjinale në shumicën e rasteve janë vendosur tek likuidimi i parë i kryer nga SRV për të njëjtën kontratë. Si dhe në një pjesë të likuidimeve mungon numri i protokollit dhe data e autorizimit ose shkresës. Spitali Rajonal Vlorë për Urdhër Shpenzimet e lartpërmendura të muajit Dhjetor 2018, nuk ka bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin vërtetues për pagesat e kryera. Kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik", kreu III, pika 35 dhe për këtë mban përgjegjësi Titullari i Institucionit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6, faqe 113 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 40.1: Sektori i Financës të marri masa sipas kërkesave ligjore që për çdo urdhër shpenzim bashkëlidhur të jenë të gjithë dokumentet e nevojshme justifikuese.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 41: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për Dhjetor 2018 u konstatua se me Urdhër Shpenzimin nr. 804, datë 27.12.2018, është likuiduar pjesërisht vlera 5,100,000 lekë

për vendime gjyqësore dhe shpenzime përmbarimore. Urdhri i përmbaruesit për likuidimin e këtij detyrimi nuk është shoqëruar me faturën tatimore përkatëse për tarifën përmbarimore prej 739,532 lekë. Pra SRV ka vepruar pa dokumentacion të rregullt lidhur me pagesën e vlerës së mësipërme, duke krijuar në këtë mënyrë mundësinë për hapësira, për evazion.
Kjo në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik", kreu III, pika 35.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6, faqe 113 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 41.1: Sektori i Financës të marrë masa sipas kërkesave ligjore që të mos kryej pagesa pa praninë e faturave tatimore përkatëse, pavarësisht urdhrave të ndryshme shkresore.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 42: Nga auditimi rezulton që, Spitali Rajonal Vlorë me Urdhër Shpenzimi nr. 766, datë 25.11.2019, ka likuiduar OE "K. shpk dhe K. sha" për shumën 596,992 lekë, me faturë nr. 53, datë 01.11.2019, e cila faturon 3.400 litra naftë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur likuidimit rezulton që, me kërkesë të n/drejtorit të SRV z. S. A., nr. 5224, datë 01.11.2019, dhe ekzekutuar nga përgjegjësja e Sektorit të Planit F. B., janë zbritur nga sasia e naftës së mbetur në sistem 200 litra naftë të cilat janë konvertuar me benzinë në këtë sasi. Kërkesa nga n/drejtori është bërë me arsyetimin se sasia e benzinës nevojitet për nevojat e autoambulancës me targa AA238G e cila funksionon me benzinë, nþ kundërshtim me parashikimet e kontratës.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6, faqe 113 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 42.1: SRV të marrë masa që në ardhmen të kryej planifikime të sakta për nevojat për karburant dhe të shmangë devijimet nga objekti i kontratës.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 43: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:
"Mjedisi i kontrollit" Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Spitalit Rajonal Vlorë e cila është shqyrtuar në mbledhjen e mbajtur nga Këshilli Administrativ me procesverbal nr. 1396 prot datë 21.02.2019, por nuk është miratuar akoma nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pavarësisht kërkesave zyrtare të bëra nga Titullarja e Autoritetit Spitalor Vlorë. Trajnimet për stafin e administratës lënë për të dëshiruar, pasi mungojnë trajnime për fusha si: për MFK, prokurimet publike, për menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për kontabilitetin e buxhetin, për menaxhimin e aktiveve. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm. Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Përmbledhje e titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse nuk janë mbajtur në çdo rast procesverbale.
"Menaxhimi i Riskut" Nga verifikimi i veprimtarisë së grupit të menaxhimit të MFK dhe menaxhimit të riskut në lidhje me zbatimin e plan-veprimit të riskut rezultoi se nuk është ndërmarrë dhe dokumentuar asnjë veprim për të adresuar mangësitë. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Mungon gjurma e auditit për sektorët e administratës, të miratuar nga Drejtorja e Spitalit si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB.

"Informimi dhe komunikimi" Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.
"Monitorimi" Në Spitalin Rajonal Vlorë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme. Në Spitalin Vlorë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.8, faqe 126 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 43.1: Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë, me atributet e Kryetarit të GMS e të Nëpunësit Autorizues si dhe Kordinatorit të Riskut, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për miratimin e Rregullores së Brendshme të funksionimit nga MSHMS, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion:
Urdhri i Brendshëm nr. 303, datë 25.01.2021 "Për ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut në SRV"
Urdhri i Brendshëm nr. 1236, datë 16.03.2022 "Për ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut në SRV"
Rregjistri i risqeve
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pjesërisht.

Rekomandimi 43.2: Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit të administratës. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendosën në dispozicion kërkesa e SRV për trajnime drejtuar Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pjesërisht.

Gjetje nga auditimi 44: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Spitalin Rajonal Vlorë u konstatua se: në të gjitha dosjet e auditimit mungon Memo e planifikimit, Projekt-raportet dhe raportet finale nuk janë përcjellë me shkresë, pavarësisht se janë miratuar nga Titullari. Nuk ka një vlerësim të sistemeve të kontrollit të brendshëm të argumentuar me kampionet e marra për testim në bazë të nivelit të riskut të përllogaritur, në lidhje me funksionimin e e aktiviteteve të kontrollit në fushat e trajtuara në auditim. Në auditimet e kryera nuk janë planifikuar auditime me të shpeshta dhe më të thelluara për sektorët me risk të lartë (prokurimet, zbatimet e kontratave të shërbimeve apo blerjeve të mallrave, Sektorët e shërbimeve sipas specialiteteve, magazinat e qarkullimi i aktiveve në lidhje me to etj.) si dhe nuk është dokumentuar dhe kontrolluar si funksionon sistemi i kontrollit të

brendshëm në fusha të ndryshme të veprimtarisë së SRV, për këtë arsye nuk janë dhënë rekomandime se si të përmirësohen procedurat e kontrollit e të jenë më funksionalë për parandalimin e mashtrimeve. Në procesin e planifikimit nuk është vlerësuar si duhet risku dhe për rekomandimet e lëna nuk është bërë analiza e tyre, pasi nuk është kryer monitorim apo një verifikim i veçantë për shkallën e zbatimit të tyre, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuara në raportet e auditimit. Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar nuk ka të përcaktuar rastet konkrete (date dhe punonjës) të konstatimit të problematikës e argumentuar me evidencën përkatëse, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i mospërputhshmërisë dispozita ligjore apo rregullore. Gjetjet janë të formuluara në terma të përgjithshëm, si rrjedhojë rekomandimet e adresuara janë shprehur në terma të përgjithshëm, gjë që nuk e orienton subjektin e audituar drejt zgjidhjeve konkrete.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.9, faqe 143 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 44.1: Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve dhe formulimit konkret të rekomandimeve.
Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendos në dispozicion Formati Standard nr. 4, datë 09.03.2022.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

Rekomandimi 44.2: NjAB të kryeje vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari, që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: U vendos në dispozicion gjithë dosja e auditimit të zbatimit të rekomandimeve.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

Gjetje nga auditimi 45: Nga grupi i auditimit konstatohet se në listat e shpërblimeve për fondet e akorduara për situatën e COVID-19, rezulton se ka paqartësi në mënyrën e shpërndarjes së tyre sepse referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion për disa muaj nuk ka asnjë dokument mbi shpërndarjen e shpërblimeve, konkretisht për muajt Prill, Maj, dhe Janar 2021 dhe në çdo listë është e paqartë kuadrimi i periudhës së shpërblimit, vërtetuar kjo dhe me korrespondencën me MSHMS, referuar mënyrës së shpërblimit të përfituesve të këtij shpërblimi. Referuar mbajtjes së dokumentacionit mbi argumentimin dhe shpërndarjen e shpërblimeve ndaj personelit të angazhuar nga SRV dhe detajimit të shpenzimeve të alokuara për blerje për pandeminë COVID -19, ai është i pa sistemuar dhe jo kronologjik gjithashtu, grupi i auditimit kërkoi informacion nga sekretaria e Spitalit Rajonal Vlorë dhe ju vu në dispozicion lista e miratuar nga titullari i institucionit, dhe dërgimi i saj (konfirmimi) në mënyrë elektronike (me e - mail) në Ministrinë e Shëndetësisë, vetëm për muajt Mars, Korrik dhe Dhjetor 2020.Për parregullsitë në mbajtjen e kronologjisë dhe rakordimit të listave me shpjegimet e nevojshme mbi argumentimin dhe shpërndarjen e shpërblimeve ndaj personelit të angazhuar nga SRV dhe mungesës së e-maileve të konfirmimit të listave të shpërblimit,

ngarkohen me përgjegjësi Sektori i planit në Spitalin Rajonal Vlorë dhe Grupi i Monitorimit dhe Verifikimit të listave të përfituesve të këtij shpërblimi.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.10, faqe 154 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 45.1: Autoriteti Kontraktor /Sektori i Planit dhe Grupi i Monitorimit dhe Verifikimit të listave të përfituesve të këtij shpërblimi, të marrin masa që të paraqesin në mënyrë kronologjike dhe të saktë evidencat për shpërblimin e e personelit dhe shpenzime operative për nevojat e SRV për përballimin e situatës COVID-19.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

Gjetje nga auditimi 46: Në datën 14.06.2021 dhe datën 17.04.2021 nga auditimi në terren grupi i auditimit u konstatua se në Farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë, hyrje daljet e medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme mbahen me programin SIIS/ PENTAHO. Gjendja e farmacisë në datën 14.06.2021 nga ekstrakti i sistemit të instaluar në Farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë SIIS/ PENTAHO rezulton në 9,815,797 copë medikamente në vlerën 70,534,378 lekë. Gjendja e farmacisë në datën 17.06.2021 nga ekstrakti i sistemit të instaluar në Farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë SIIS/ PENTAHO rezulton në 10,469,017 copë medikamente në vlerën 71,523,221 lekë. Nga auditimi konstatohet konstatohet se programi SIIS/ PENTAHO nuk jep siguri rreth faktit të gjendjes fizike dhe kontabël të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme, gjithashtu referuar shkarkimit të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme nga sistemi , ky proces nuk kryhet në kohë reale duke mos e pasqyruar saktë gjendjen fizike të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme në farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë sepse nga krahasimi i dy ekstrakteve të sistemit P SIIS/ PENTAHO për periudhën kohore 3 ditore nga data 15.06.2021 deri më datë 17.06.2021 sipas sistemit SIIS/ PENTAHO në farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë kanë hyrë 653,220 artikuj në vlerën 988,843 lekë. Këto diferenca nuk janë të justifikuara pasi sipas këtyre të dhënave, vlera e një artikulli rezulton të jetë mesatarisht 1.5 lekë.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.11, faqe 157 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 46.1: Spitali Rajonal Vlorë dhe Sektori i Farmacisë të marrë masa të rakordojë në kohë reale gjendjen fizike dhe gjendjen kontabël të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme ne sistemin SIIS/Pentaho të Farmacisë së Spitalit.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar.

Gjetje nga auditimi 47: Për periudhën objekt auditimi u konstatuan pasaktësi dhe mos koordinim në hartimin e listë-pagesave dhe listë-prezencave, të cilat rezultojnë në vlera të pa përfillshme dhe jo materiale për opinionin e auditimit, të paguara më tepër apo më pak ndaj personelit si vijon:
Për vitin 2017:
Punonjësja L. M. tek listë-prezenca repartit të Reanimacionit për muajin Maj është shënuar me 19 ditë punë, por kjo nuk është reflektuar në listë-pagesën e muajit;
Punonjësja A. S. është emëruar me datë 24.05.2017 dhe në listë-prezencë është reflektuar me 6 ditë punë, aq sa i takon në fakt, por është paguar me 9 ditë punë në listë-pagesë;
Punonjësja K. S. në listë-pagesën e muajit Maj është shënuar me ditë të plota pune (22 ditë), por sipas listë-pagesës është paguar me 19 ditë;
Punonjësit P. S., A. M., E. A. dhe I. Rr. janë paguar sipas listë-pagesës së muajit Maj, por nuk janë të shënuar në listë-prezencë për këtë muaj.
Për vitin 2018:

Punonjësja V. D. për muajin Mars ka marrë pagë të plotë së bashku me vlerën e raportit mjekësor;
Për muajin Mars repartet Infektivi, Farmacia, Banka e Gjakut, Dispanseria dhe Mjekët Vullnetarë mungojnë listë-prezencat;
Punonjësit F. G. dhe F. Gj. në listë-prezenca e muajit Mars që është nënshkruar nga Shef i Shërbimit të Urgjencës, Krye Infermieri dhe përgjegjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore janë shënuar pa ditë pune, por në listë-pagesë janë paguar me pagë të plotë;
Punonjëset S. S. dhe L. G. janë paguar sipas listë-pagesës së muajit Mars por nuk janë të përfshira në listë-prezencën e reparti të Pranimit të Urgjencës;
Punonjësja N. Ç. është paguar sipas listë-pagesës së muajit Dhjetor por nuk është e përfshira në listë-prezencën e Administratës;
Punonjësit E. C. dhe N. Gj. janë paguar sipas listë-pagesës së muajit Dhjetor por nuk janë të përfshira në listë-prezencën e reparti të Poliklinikës.
Për vitin 2019:
Punonjësja J. S. për muajin prill ka marrë raport mjekësorë për datat 23-28 dhe për këtë i janë hequr ditët e punës por nuk është shënuar vlera e raportit mjekësorë.
Për vitin 2020:
Punonjësja F. R. nuk është e përfshirë në listë-prezencë por është paguar në listë-pagesën e Administratës në muajin Nëntor;
Punonjësit M. S/ dhe E. D. kanë marrë pagë të plotë për muajin Nëntor së bashku me vlerën e raportit mjekësor.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2, faqe 14 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 47.1: Personat përgjegjës për hartimin e listë-pagesave të marrin masa për hartimin e kujdesshëm të tyre, duke bërë rakordimin e nevojshëm me listë prezencat e dërguara dhe nënshkruara nga personat përgjegjës.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksioni i Poliklinikës së Specialiteteve, Spitali Rajonal Vlorë",* me vlerë të kontratës (me tvsh) 83,311,934 lekë, fituar nga OE "C." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 944,232 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4045 prot datë 30.08.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Vlorë dhe OE "C." SHPK.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 103 të Raportit të Auditimit.
Rekomandim 1.1: Nga Spitali Rajonal Vlorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 944,232 lekë pa TVSh nga OE "C." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4045 prot datë 30.08.2018, me objekt "Rikonstruksioni i Poliklinikës së Specialiteteve", Spitali Rajonal Vlorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda 2021

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me shkresën nr. 4606, datë 01.11.2021 OE është njoftuar për rekomadimin e KLSH. Me shkresën nr. 5290, datë 23.12.2021 OE është njoftuar mbi arkëtimin e shumës. SRV ka ngritur kërkesë padi. Në datën 11.05.2022 ka qenë seanca gjyqësore.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 2: Mangësi në farmacinë e SRV të gjendjes fizike të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme në farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë, " në vlerën 46,490 lekë. Gjatë auditimit faktik në datën 14.06.2021 dhe në datën 17.06.2021 të sistemit dhe gjendjes fizike të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme në farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë, grupi i auditimit në prani të farmacisteve të sektorit të farmacisë të Spitalit Rajonal Vlorë verifikoi me zgjedhje në total 30 lloje medikamentesh, kite dhe pajisje të ndryshme duke u orientuar drejt vlerës ekonomike dhe rëndësisë së përdorimit dhe barnave të protokollit Covid-19. Saktësisht u verifikuan medikamentet, kitet dhe pajisje të ndryshme si vijon: Dopaminë; Morfinë; Adrenalinë; Heparinë; Insulinë; Cyclolux (Lëndë për Rezonancë); Levofloxacine; KontrastSkaner (Gadopentetik); Ekipim (Cefepim); Enoxaparine; Ultrakorten (Prednizolon); Vankomycine; Cyclophosfamide; Cisplatin; Detroxintralipid; Furosemid; Atenolol; Nifedipine; Tramadol; Vitamine B6; Ansa Koagulimi; Aparat Tensioni me manometer; Bende Pambuk Absorbent; Elektroda EKG Neonatale; Hemostatik Kolageni i Absorbueshëm; Kateter Epidural; Letër Printeri ECHO; Metformine Hydrochlorid 850 mg/500 mg; Omeprazol Human; Human Albumin Serum.Bazuar në përzgjedhjen rastore, nga grupi i auditimit u bë ballafaqimi i numrit faktik të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme, me numrin e tyre sipas rregjistrimit në këtë sistem.Mangësitë e konstatuara janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve". Vlera 46,490 lekë përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal Vlorë, dhe në bazë të udhëzimit të mësipërm pika 89, ku citohet "Në rast se pas inventarizimit dalin ndryshime në vleftë, mungesa mbetet në ngarkim të punonjësit me përgjegjësi materiale, kurse tepricat bëhen hyrje në magazinë dhe shkojnë në dobi të njësisë", përgjegjësia për këtë vlerë i ngarkohet sektorit të farmacisë së SRV dhe grupeve të inventarizimit të farmacisë për mosrakordim dhe mosparaqitje të saktë të gjëndjes faktike dhe gjëndjes në sistemin e farmacisë *për vitet 2019, 2020 referuar urdhrave nr.5663, datë 02.12.2019 dhe nr.4785, datë 4.12.2020*.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.11, faqe 157 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 2.1: Nga ana e Titullarit të Spitali Rajonal Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 46,490 lekë, sektorit të farmacisë së SRV dhe grupeve të inventarizimit të farmacisë për mosrakordim dhe mosparaqitje të saktë të gjendjes faktike dhe gjendjes në sistemin e farmacisë për vitet 2019, 2020 referuar urdhrave nr.5663, datë 02.12.2019 dhe nr.4785, datë 4.12.2020.

Menjëherë

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Stafi i SRV ka shprehu dakordësinë për shlyerjen e detyrimit vullnetarisht pas njoftimit zyrtar të kryer por nuk u vendos në dipozicion listë pagesa me mbajtjen e detyrimit nga paga.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Gjetje nga auditimi 1: Deri në fund të periudhës objekt auditimi u konstatua se ka 17 procese gjyqësore që kanë efekt për marrëdhëniet e punës. Në total 6,860,851 lekë nga të cilat 6,261,169 lekë janë për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i gjykatës dhe 599,682 lekë shpenzime për shërbim përmbarimor.

Vlera prej 6,860,851 lekë efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", për këtë mban përgjegjësi Titullari i Institucionit.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2, faqe 14 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 1.1: Spitali Rajonal Vlorë të marrin masa që largimet nga puna të jenë konform Kodit të Punës, Kontratës dypalëshe të punës dhe përcaktimeve në rregullore dhe të mos shkelet asnjë e drejtë e punonjësit për asnjë rast. Gjithashtu, të ketë një planifikim buxheti të saktë që Vendimet e Gjykatës të ekzekutohen pa lindur nevoja e shpenzimeve për shërbimin përmbarimor.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi rezultoi se, Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor më datë 21.01.2021, i ka dërguar SRV e-mail, në të cilin i kërkohet *"në kuadër të marrjes së masave për kryerjen e procedurave të nevojshme për nxjerrjen jashtë përdorimi të autoambulancave të cilat janë jashtë funksioni",* institucioni ngarkohet për dorëzimin e inventarit të autoambulancave. Në tabelën bashkëngjitur email-it, u konstatua se autoambulanca me targa AA005CF dhe VL1443B kanë marrë shërbime mirëmbajtjeje deri në vitin 2020. Në regjistrin e realizimeve të prokurimit publik të vitit 2018, rezulton se, janë kryer prokurime me vlerë të vogël për: Blerje goma për automjetet e Spitalit Rajonal Vlorë me vlerë 368,000 lekë, si dhe Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të SRV-së me vlerë 580,000 lekë dhe 199,800 lekë. Vlera e shërbimeve të kryera, për autoambulancat me targa AA005CF dhe VL1443B të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi, përfshirë në vlerën totale prej 1,147,800 këtyre tre prokurimeve është përdorim pa efektivitet.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6, faqe 113 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 2.1: Të merren masa në të ardhmen që llogaritja e fondit limit në rastet e mirëmbajtjes së automjeteve, të kryhet me saktësi vetëm për mjetet që janë në përdorim dhe jo për mjetet që janë vlerësuar për t'u nxjerrë jashtë përdorimi.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 3: Përgjegjësja e laboratorit merr në dorëzim menjëherë nga farmacia kitet dhe reagentët e mbërritur dhe nuk bëhen dalje sipas nevojave me kërkesa periodike. Për vlerësimin e përdorimit të artikujve të blerë u morën në shqyrtim të dhënat që laboratori ka paraqitur pranë zyrës së statistikave mbi ekzaminimet e kryera me reagentët e kërkuar për vitin 2019, nga ku rezulton se ka skaduar ende pa u përdorur një sasi reagentësh në vlerë totale prej 367,608 lekë. Grupit të auditimit nuk i'u vu në dispozicion asnjë dokumentim që pasqyron këtë situatë, qoftë njoftim tek eprorët nga përgjegjësit e laboratorit që afati i skadimit po afrohet, qoftë dokumentim për nxjerrjen jashtë përdorimi të sasive të skaduara. Për sa më lart, vlera prej 367,608 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 66 të Raportit të Auditimit.
Rekomandimi 3.1: Përgjegjësit e laboratorit të marrin masa për dokumentimin e saktë dhe të detajuar të përdorimit të reagentëve hap pas hapi, që nga momenti i hapjes së ambalazhit dhe deri në pasqyrimin e dozave të përdorura për çdo ekzaminim. Ky dokumentim të shoqërohet me udhëzues përdorimi të prodhuesit për nivelet e konsumit të reagentëve.
Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Rekomandimi 3.2: SRV të marrë masa për parashikimin në kontratë të grafikëve specifik të lëvrimit të artikujve sipas nevojës, në mënyrë që të shmangen problematikat me datat e skadencave.

Menjëherë dhe në vijim

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

Gjetje nga auditimi 4: Për shërbimin e lavanderisë, nga këqyrja e dokumentacionit në SPE, të OE të shpallur fitues "D." SHPK, ka rezultuar se mungojnë listë pagesat në formatin E-sig 025a, për muajin Shtator, si dhe ky OE ka bërë kontratë furnizimi me detergjente me shoqërinë "Ë." SHPK, shoqëri pjesëmarrëse në tender, në kundërshtim me nenin 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,
Nga sa sipër, KVO duhet të kishte bërë skualifikimin e OE "D." SHPK dhe duhet të kishte njoftuar Titullarin e AK për anulimin e procedurës dhe shpalljen e një procedure të re. Ky veprim ka shkaktuar paligjshmëri në zbatimin e procedurës së prokurimit të fondeve publike në vlerën 185,250,786 lekë.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 98 të Raportit të Auditimit.
Rekomandim 4.1: Në të ardhmen SRV të marrë masa për shqyrtimin e kujdesshëm të dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesit dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet për anulimin e procedurave në rastet kur kriteret e kualifikimit nuk plotësohen nga asnjë prej ofertuesve.

Në vijimësi

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Ky rekomandim nuk është pranuar
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

E. MASA DISIPLINORE

E.1 Për punonjësit në marrëdhënie pune

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, Kontratës Individuale, i rekomandojmë Titullarit të Spitalit Rajonal Vlorë, të ngrejë një grup për të vlerësuar shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të Përputhshmërisë të ushtruar në SRV, në varësi të analizës së përgjegjësive, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga "Tërheqje vëmendje" deri te "Ulje në detyrë", për personat që gjenden me përgjegjësi në mënyrë të përsëritur në Raportin Përfundimtar të Auditimit, e konkretisht:

1. Znj. F. B.;

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me shkresën nr. 4529, datë 26.10.2021 i është dhënë masa "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

2. Znj. S. B.;

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me shkresën nr. 4530, datë 26.10.2021 i është dhënë masa "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

3. Znj. T. J.;

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Komisioni i ngritur nga Drejtori ka vendosur unanimisht për masën disiplinore "Vërejtje me shkrime" me procesverbalin nr. 4516, datë 25.10.2021. Por nuk u vendos në dispozicion vendimi i drejtorit për masën.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

4. Znj. E. L.;

Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me shkresën nr. 4542, datë 27.10.2021 i është dhënë masa "Vërejtje me Shkrim"

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar
5. Znj. G. P.;
Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me shkresën nr. 4543, datë 27.10.2021 i është dhënë masa "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar
6. Z. R. M.;
Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Komisioni i ngritur nga Drejtori ka vendosur unanimisht për masën disiplinore "Vërejtje me shkrime" me procesverbalin nr. 4516, datë 25.10.2021. Por nuk u vendos në dispozicion vendimi i drejtorit për masën.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar
7. Z. E. Z.;
Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me shkresën nr. 4544, datë 27.10.2021 i është dhënë masa "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar
8. Znj. N. R.;
Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me shkresën nr. 4565, datë 28.10.2021 i është dhënë masa "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar
9. Znj. E. H..
Qëndrimi i SRV për Rekomandimin: Me shkresën nr. 4581, datë 29.10.2021 i është dhënë masa "Vërejtje me Shkrim"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar

SPITALI UNIVERSITAR "SHEFQET NDROQI"

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi" mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Raporti Përfundimtar mbi Auditimin e Përputhshmërisë në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", është dërguar me shkresën nr.133/22 prot, datë 18.10.2021, regjistruar në SUSN me nr.22/47 prot, datë 25.10.2021.

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", *ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën* nr.22/76 prot, datë 08.11.2021 *të Drejtorit Ekzekutiv,* duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar me shkresën nr.22/81 prot, datë 21.04.2022 në Kontrollin e Lartë të Shtetit "Për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", sipas Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30*. Raportimi është kryer brënda afatit prej 6 Muaj.

III. Rekomandimet e KLSH

Në Raportin Përfundimtar mbi Auditimin e Përputhshmërisë në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", të dërguar me shkresën nr.133/22 prot, datë 18.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:

b. Janë rekomanduar **24** masa organizative;

c. Janë rekomanduar **9** masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit;

d. Janë rekomanduar **1** masë administrative;

e. Janë rekomanduar **11** masa disiplinore;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Organizative	24	24	-	-
2	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	9	9	-	-
3	Masa Administrative	1	1		
4	Masa disiplinore	11	11	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e SUSHN

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	24	15		9	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për	9	7		2	-

	menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit					
3	Masa Administrative	1	1		-	-
4	Masa disiplinore	11	8 3 larguar	-	-	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nr.	**Lloji i rekomandimit**	**Pranuar Plotësisht (numër)**	**Statusi i zbatimit**			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	24	15		9	-
3	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet,	9	7		2	-

	eficiencës dhe efektivitetit					
3	Masa Administrative	1	1		-	-
4	Masa disiplinore	11	8 3 larguar	-	-	-

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 62.5%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Raporti Përfundimtar mbi Auditimin e Përputhshmërisë në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", është dërguar me shkresën nr.133/22 prot, datë 18.10.2021, regjistruar në SUSN me nr.22/47 prot, datë 25.10.2021.
Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", *ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën* nr.22/76 prot, datë 08.11.2021 *të Drejtorit Ekzekutiv,* duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar me shkresën nr.22/81 prot, datë 21.04.2022 në Kontrollin e Lartë të Shtetit "Për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", sipas Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30*. Raportimi është kryer brënda afatit prej 6 Muaj.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për proçedurën e prokurimit "FV makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e S.U "Shefqet Ndroqi", rezulton se janë vendosur kritere që nuk janë në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës, përsa i takon disponimit të liçencave profesionale si më poshtë:

- Sipas pikës 2.3.2.a, ndër të tjera është kërkuar që OE duhet të jetë pajisur me liçencen me drejtime si më poshtë:
NP-11 (E) "Ndërtime për N/Stacione, kabina transformatori linja e TN të mesëm dhe shpërndarje energjisë.
NS-12 (E) "Impiante teknologjik termike dhe të kondicionimit".
NS 14 (E) "Impiante të brendshme elektrike telefoni radiotelefoni".
Përcaktimi A, B, C, D, E ka të bëjë me nivelin e pjesëmarrjes së Operatorëve Ekonomikë, sipas vlerës së kontratës. Duke marrë në konsideratë fondim limit me vlerë 177 milionë lekë, klasa D (101 milionë deri 200 milionë lekë) është e mjaftueshme për të marrë pjesë në këtë proçedurë prokurimi, ndërsa klasa E, i përket kontratave me vlerë nga 201 milionë deri në 400 milionë lekë.
- Sipas pikës 2. 3. 2 shkronja e) ndër të tjera është kërkuar që OE duhet të ketë makineri si më poshtë:
Makineri linjë prodhimi tub fleksibël, komplet (në pronësi ose me qira).
Makineri linjë prodhimi tub alumini komplet (në pronësi ose me qira).
Kërkesa për linja prodhimi, ndërkohë që materialet janë parashikuar furnizim dhe vendosje, është e paargumentuar.
Nga auditimi i proçedurës së prokurimit "Rikonstruksion i disa ambienteve të Spitalit "Shefqet Ndroqi", konstatohet se janë hartuar kritere të paargumentuara si më poshte:
- Është vendosur si kriter disponimi ose marrja me qira e automjeteve "Kamion vetëshkarkues me kapacitet 1-3 ton, Kamionçinë vetëshkarkuese me kapacitet 3-5ton dhe Kamion vetëshkarkues mbi 10 ton", nderkohë që volumi i përafërt për transport për të 2 lotet është 100 m^3, si për furnizim me materiale ashtu dhe për largim materiale të dala nga mbeturinat.
- Skelë metalike të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë dhe rrjetë mbrojtëse në sasinë 2000 m^2, ndërkohë që punimet që realizohen janë në ambiente të brendshme dhe proçesi i vetëm për të cilin kërkohen skela është suvatimi në tavane, i cili është parashikuar në sasinë 120 m^2.
- Është kërkuar të ketë të punësuar 2 specialist druri, ndërkohë që nuk ka punime të tilla.
Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 46, pika 3, si dhe VKM 914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 61.
Vendosja e kritereve, të cilat nuk janë në përputhje me volumin e punës së kontratës, ndikojnë në uljen e konkurrencës, pra pamundesinë e nje pjese të operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në tender.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 1.1 SUSHN të marrë masa për trajnimin e punonjësve që angazhohen në realizimin e proçedurave të prokurimit, me synim realizimin e tyre me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet, si edhe vendosjen e kritereve të cilat ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. ***Në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masat si më poshtë:
-Kërkesa për trainime nr.22/75, datë 08.11.2021 të SUSN;
-Shkresa nr.4849/1, datë 07.12.2021 të Sekretares së Përgjithshme të MSHMS në lidhje me trainimin e administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit publik;
-Shkresa nr.6489/7, datë 25.11.2021 e DAP „Mbi trainimin e nëpunësve të administyratës publike;
-E-mail datë 23.12.2021 dhe datë 10.12.2021 mbi planifikimin e trainimeve për vitin 2022;
Në zbatim të kalendarit të trajnimeve të ASPA 28 Mars-1 Prill 2022 dhe 19-22 prill 2022 janë kryher trainimet on-line.
Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

2. **Gjetje nga auditimi:** Në tenderin e zhvilluar me objekt "Marrje me qira e 2 kaldaja ngrohje me pellet" u konstatua se llogaritja e fondit limit është kryer bazuar në të dhënat e kontratës së mëparshme në qiranë ditore. Në llogaritjen e fondit limit janë përcaktuar vlera totale e shërbimit të 2 kaldajave, që përfshin koston e kaldajeve, shpenzimet për vendosjen e tyre, si edhe vendosja e silosit 10 ton, vendosja e dy paneleve elektrike, vendosja e dy shnekëve, përgatitja e bazamentit për vendosjen e silosit dhe vlerën e shpenzimeve për mirëmbajtjen e tyre në rast defektes. Pra qiradhënësi do të përgjigjet edhe për defektet që lindin gjatë punës në kaldaja dhe bën riparimin e tyre me shpenzimet e veta në afatin prej 2 orë nga moment i marrjes së njoftimit. Për këta zëra, mungon llogaritja e çmimit dhe vlerës. Fondi Limit është i paargumentuar, nuk ka asnjë projekt, preventiv apo analizë të hollësishme çmimesh në lidhje me këtë strukturë. Grupi i punës nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me nenin 59 "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës", të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 2.1: Përllogaritja e vlerës së kontratës nga njësia e prokurimit/komisionet e ngritura për këtë qëllim, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, llogaritje të sakta të vlerës së kontratës që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve si edhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës në raport me specifikimet teknike, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masat si më poshtë:

-Urdhëri Nr. 335, datë 08.11.2021 dhe nr.22/48 Prot., i Drejtorit të Përgjithshëm, "Verifikimi për rekomandimet e lëna nga KLSH" pika 1. a , nëpërmjet të cilit është caktuar AB për ndjekje;

Nga prokurimet e 6/mujorit të parë 2022, u përzgjodh procedura e prokurimit me objekt „Riparim dhe mirëmbajtje krevate, barela dhe karoca pacienti" , nga ku është evidentuar si më poshtë:

-Kërkesë shërbimi nr.33/1, datë 16.05.2022 , në të cilën parashikohen nevojat dhe përcaktohen specifikimet teknike;

-Oferta ekonomike nr.33/2, nr.33/3, nr.33/4 datë 17.05.2022 në 3 OE të ndryshëm, që operojnë në treg në këtë fushë.;

-Raport nr.33/5, datë 08.06.2022 „Përllogaritja e fondit limit", ku fondi limit është përllogaritur nga një analizë e hollësishme tregu dhe nga ku është përcaktuar për çdo zë shërbimi çmimi mesatar i tregut;

-Urdhër Prokurimi Nr.33/6, datë 09.06.2022;

-Njoftimi i OE ne Sistemin Elektronik të Prokurimeve datë 09.06.2022;

-Profili i shpalluar REF-32355-06-09-2022;

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

3. **Gjetje nga auditimi:** Në tenderin e zhvilluar me objekt "Marrje me qira, 2 kaldaja ngrohje me pellet", u konstatua se nuk janë hartuar drejt dhe nuk janë argumentuar kriteret e kualifikimit. Referuar Proçesverbalit të datës 20.12.2017, për miratimin e dokumentave të tenderit konstatohet se nuk është kërkuar asnje kriter vlerësues në pikën 2 "Kriteret e veçanta për kualifikim" pika 2.1 "Kapaciteti ligjor / profesional i operatorëve ekonomikë". Nuk janë kërkuar bilance, kopje të çertifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse neni 28/4.a VKM nr.914 për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike. Nuk janë argumentuar kriteret e kualifikimit, në kundershtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Per

miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 11 "*Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit*". Gjithashtu, në kundërshtim me *nenin 22"Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës*", pika 3 e nenit 27, nenin 59 "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës", neni 61/2 "Hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 3.1: Njësia e Prokurimit, për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që kërkesat e veçanta kualifikuese, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kritere kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të Prokurimit Publik. Gjithashtu të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim detyrimisht të argumentuara, për të arritur rezultatet e dëshiruara në efektivitetin e përdorimit të fondeve. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masat si më poshtë:
-Urdhëri Nr. 335, datë 08.11.2021 dhe nr.22/48 Prot., i Drejtorit të Përgjithshëm, "Verifikimi për rekomandimet e lëna nga KLSH" pika 1. b ;
Nga prokurimet e 6/mujorit të parë 2022, u përzgjodh procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022", nga ku është evidentuar si më poshtë:
-Kërkesë nr.235/4, datë 14.01.2022 për nevojën e materialeve të mjekimit për vitin 2022 në shërbimin e kardiokirurgjisë në SUSN;
-Raporti nr.235/33, datë 02.03.2022 i komisionit të përllogaritjes të fondit limit, kushtet e veçanta dhe specifikimet teknike për prokurimin me objekt „Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022";
-Urdhër Prokurimi Nr.235/38, datë 20.04.2022;
-Dokumentet Standarde të Tenderit, me objekt „Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022", në të cilin janë përcaktuar kushtet e veçanta në pajtim me natyrën e objektit të prokurimit.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.
4. **Gjetje nga auditimi:** Komisioni i vlerësimit të ofertave në tenderin e zhvilluar me object *"Furnizim Vendosje kaldaje për ngrohje", ka vlerësuar operatorin ekonomik pa plotësuar kriterin/kualifikimin* për kapacitetin teknik, pika 2.3., sipas të cilit kërkohet që OE të paraqesë kontrata për furnizime të mëparshme të ngjashme me vlerë 40% të prokurimit, dhe realizuar gjatë 3 viteve të fundit. OE "L." ka paraqitur si kontrata të ngjashme, 2 kontratat e realizuara me SUSHN për vitet 2017 dhe 2018, të cilat kanë objekt *"Marrje 2 kaldaja me qira për ngrohje me lëndë djegëse Pellet"* që nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit. Në këto kushte OE "L." është vlerësuar dhe shpallur fitues, në kundërshtim me dokumentet e tenderit *kriteret e veçanta/kualifikim "kapaciteti teknik"* neni 66/3 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" i VKM nr 914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 4.1 Strukturat Drejtuese të SUSN, në të ardhmen të marrin masa për përcaktimin në Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të Operatorëve Ekonomikë, të punonjësve specialistë të fushës me qëllim arritjen e rezultateve të kërkuara. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri Nr. 335, datë 08.11.2021 dhe nr.22/48 Prot., i Drejtorit të Përgjithshëm, "Verifikimi për rekomandimet e lëna nga KLSH" pika 1. c ;
Nga auditimi u përzgjodh procedura e prokurimit me objekt „Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022" , nga ku është evidentuar si më poshtë:

-Kërkesë Nr.235 Prot, datë 09.12.2021 drejtuar Qëndrës Spitalore Universitare „Nënë Tereza“ për „Caktimin si specialistë të fushës në Komisionin e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt „Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022“;
-Përgjigje Nr.3118/1 Prot., datë 14.12.2021 e shërbimit të kardiologjisë të QSUT mbi propozimin për caktimin e dy specialistëve të fushës si anëtarë të komisioneve në procedurën e prokurimeve sa më sipër;
-Kthim përgjigje Nr.02 Prot., datë 05.01.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT për caktimin e dy specialistëve të fushës si anëtarë të komisioneve në procedurën e prokurimeve sa më sipër;
-Urdhër Nr.235/2 Prot., datë 10.01.2022 i Drejtorit të përgjithshëm të SUSN për krijimin e komisionit të përllogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt „Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022“;
-Raporti nr.235/33, datë 02.03.2022 i komisionit përllogaritjes së fondit limit, kushtet e veçanta dhe specifikimet teknike për prokurimin me objekt „Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022“;
-Urdhër Prokurimi Nr.235/38, datë 20.04.2022;
-Urdhëri Nr.235/39 Prot., datë 20.04.2022 „Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt „Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022“;
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.
5. Gjetje nga auditimi: Në komisionin e hartimit të specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës së kontratës, me objekt "Shërbim me ushqim në pavijonet e spitalit" është caktuar i njëjti punonjës për zbatimin, ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të ushqimit, dhe konfirmimin nëse janë plotësuar specifikimet e kërkuara.
Kjo bie në kundërshtim me nenin 22/3 pika b, "Veprimtaritë e kontrollit" të ligjit nr.10296 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ku citohet se:*
Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht:
a) Proçedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta;
b) Ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjrgjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 5.1 Strukturat Drejtuese të SUSN, të marrin masa për ndarjen e detyrave dhe përcaktimin në grupet e punës për kryerjen e proçedurave të prokurimit e deri në zbatimin e kontratës, të punonjësve të cilët nuk janë përgjegjës në faza të ndryshme të proçesit që nga propozimi, miratimi, zbatimi dhe marrja në dorëzim i mallrave/punëve/shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri Nr.337, nr.22/50 Prot., datë 08.11.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit Universitar „Shefqet Ndroqi“, Pika 1, "Mbi ndarjen e detyrave dhe përcaktimin e përsonave përgjegjës në grupet e punës".
Nëndrejtori ekonomik dhe sektori i shërbimeve janë caktuar të marrin masat e nevojshme (ndryshimi i rregulloreve përkatëse, etj).
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.
6. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i mbajtur për kontrollin periodik të ushqimit është konstatuar se përmbajtja e të gjitha akteve të mbajtura nga komisioni i ngritur nga SUSN dhe përfaqësuesi i shoqërisë S.-a. citon vetëm katër tregues si: ushqimi është sipas menysë dhe

gramaturës, orari i ushqimit është sipas kontratës, me cilësi të mire, dhe është i paketuar. Në këto akte kontrolle nuk është pasqyruar në asnjë rast ndonjë mangësi në zbatimin e kontratës si edhe nuk janë pasqyruar kërkesa të tjera të kontraktuesit sipas neneve 6, 9, 10, 12 dhe 13, të kontratës në lidhje me transportin, pajisjet e përdorura, higjienën, treguesit matës të cilësisë, servirjen e ushqimit, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 6.1: Drejtoria e Shërbimeve në bashkëpunim me strukturat e caktuara në pavjonet e spitalit për monitorimin e kontratës së shërbimit "gatimi dhe shpërndarja e ushqimit të sëmurëve", të hartojnë dokumentacionin mbi të cilin do të kryhet monitorimi, duke pasqyruar të gjitha detyrimet e kontraktorit ndaj shërbimit, me qëllim arritjen e treguesve në parametra sasiorë dhe cilësorë të kontraktuar. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masat si më poshtë:

-Urdhëri Nr. 432, me nr. 22/79 Prot., datë 31.12.2021 Pika 2, "Për monitorimin dhe përcaktimin e Kritereve të Kontratës së Ushqimit";

-Në Kontratën e shërbimit nr.5, nr.175/68 prot., datë 31.12.2021, është parashikuar në nenin 9 „Kërkesa për gatimin dhe përgatitjen e ushqimit" (Pikat 9.1-9.4), në nenin 10 „Programi ushqimor" (Pikat 10. Dhe 10.2), në nenin 11 „Forca e përditshme e ushqimit" (Pikat 11.1-11.4), në nenin 12 „Kërkesa higjeno-sanitare" (Pikat 12.1-12.4), në nenin 13 „Servirja e ushqimit" (Pikat 113.1-13.4;

Nga auditimi, praktika e kontrollit ditor të ushqimit përfshin:

-Procesverbalin e mbajtjes së kampioneve të ushqimeve;

-Forcën ushqimore ditore, sipas dietave;

-Fletë-Dalje ditore;

-Procesverbali i shpërndarjes ditore të ushqimit

-Planifikimi i forcës ditore, 1 ditë më parë;

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

7. Gjetje nga auditimi: Për ambientet e vëna në dispozicion të operatorit ekonomik "S.-A.", nuk janë përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale detyrimet mes palëve, përsa i takon qirasë së ambientit dhe shpenzimeve për ujë dhe drita. Në nenin 6.4 të kontratës përcaktohet se porositësi në çdo pavijon ka caktuar një dhomë të veçantë (minikuzhinë) që përdoret për mbajtjen e inventarit dhe për shpërndarjen e ushqimit, i cili i është dhënë në përdorim kontraktuesit për ta mirëmbajtur në funksion të kryerjes së shërbimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi 7.1 Strukturat Drejtuese të SUSN, të marrin masa për të përcaktuar në kontratën e shërbimit me Operatorin Ekonomik "S.- a.", detyrimet e qirasë që rrjedhin nga përdorimi i ambienteve të spitalit dhe shpenzimet për ujë e energji elektrike, referuar legjislacionit në fuqi, me qëllim rritjen e të ardhurave dytësore. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Në bazë të Pikës 1, të Urdhërit Nr. 432, me nr. 22/79 Prot., datë 31.12.2021, "Për monitorimin dhe përcaktimin e Kritereve të Kontratës së Ushqimit" është përcaktuar që sektori juridik dhe i prokurimeve të marrin masa për të përcaktuar në kontratën e shërbimit me OE "S.- A.", detyrimet e qirasë që rrjedhin nga përdorimi i ambienteve të spitalit dhe shpenzimet për ujë e energji elektrike.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është në proces.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për shërbimin "Gatim dhe shpërndarje ushqimi" për periudhën objekt auditimi, konstatohet se dokumentacioni është

nënshkruar nga k/infermieri i çdo pavijoni dhe përmbledhësja nga përgjegjësi i kartotekës ku konfirmohet forca ushqimore e çdo pavijoni.
Dokumenti, ku pasqyrohet forca ushqimore ka të përcaktuar në ekstremitete se duhet nënshkruar nga k/infermieri dhe shefi i pavijonit, por janë në numër të pakët rastet ku dokumenti është nënshkruar nga shefat e pavijoneve rezulton të jetë nënshkruar vetëm nga k/infermieri. Këto veprime në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III/2 "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve" pika 35/b, 36 dhe 54. Punonjëset e kartotekës dhe sektori statistikës, të cilat hartojnë përmbledhëset mujore mbi bazën e këtij dokumentacioni kanë pranuar dokumentin "Forca ushqimore" të plotësuar dhe nënshkruar vetëm nga k/infermieri.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 8.1: Sektori i Statistikës në bashkëpunim me strukturat e caktuara në pavijonet e spitalit për monitorimin e kontratës së shërbimit "gatimi dhe shpërndarja e ushqimit të sëmurëve", të plotësojnë dhe pranojnë dokumentacionin mbi të cilin do të kryhet pagesa ndaj operatorit ekonomik "S.-A", duke pasqyruar saktë numrin e të shtruarve në çdo pavijon, lëvizjet ditore,etj, të nënshkruar nga personat përgjegjës për ti dhënë forcën e dokumentit vërtetues pagese. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Në bazë të Urdhërit me nr.196 Prot., datë 01.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SUSN "Për firmosjen e Dokumenacionit të kofirmimit të forcës së ushqimit" është përcaktuar, që dokumentacioni i konfirmimit të forcës ushqimore ditore të ushqimit të firmoset nga shefi i shërbimit dhe kryeinfermieri i shërbimit përkatës.
-Nga auditimi, Forca e Ushqimit e planifikuar 1 ditë më parë (praktika e datës 05.04.2022) rezulton e firmosur, për çdo pavion, nga shefat dhe kryinfermieri i shërbimit.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.
9. Gjetje nga auditimi: Departamenti i financës, regjistrimet e veprimeve kontabël të aktivitetit financiar të institucionit, i ka kryer me regjistra ose në programin Excel dhe jo me programe profesionale informatike, që njihen si "Bartës informatikë", të cilët janë programe të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Mungesa e programit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si edhe në cilësinë, saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 3, pika 14 që përcakton mënyrën se si mbahet dokumenti kontabël dhe pikën 15 për "Bartësit kontabël".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 9.1: Drejtoria ekonomike të marrë masa dhe të gjej mënyrat për përmirësimin e mbajtjes së kontabilitetit, për të rritur cilësinë e regjistrimit, përpunimit dhe hartimit të pasqyrave financiare. ***Brënda muajit Dhjetor 2021***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhërit Nr. 338, me nr. 22/51 Prot., datë 08.11.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm "Për marrjen e masave për përmirësimin e mbajtjes së kontabilitetit";
-Kërkesë nr.204/5 prot., datë 12.11.2021 e Sektorit të Fiancave" për blerjen e programit të kontabilitetit Financa 5.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proçes.
10. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të saktësisë së paraqitjes të zërave në pasqyrat financiare dhe formatet përkatëse, u konstatuan problematika dhe pasaktësi në vlerën e pasqyruar si amortizim të akumuluar, pasi nuk është llogaritur amortizimi vjetor për çdo aktiv. Nga auditimi, amortizimi i aktiveve të trupëzuara për periudhat 2018-2020, ka rezultuar se

hartuesit e pasqyrave financiare nuk kanë zbatuar normat e amortizimit të përcaktuara në pikën 36, plotësimin e pasqyrës së amortizimeve dhe informacionit të detajuar, sipas Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". Në amortizimin e llogaritur, mungojnë kategoria e pajisjeve informatike, kompjuterike dhe elektronike e cila e ka llogaritjen ndryshe nga zërat e tjerë të aktiveve në masën 25 %. Llogaritjet e shpenzimeve të amortizimit nuk janë kryer për çdo artikull në veçanti por si klasa aktivesh të përgjithësuara. Mos llogaritja e saktë në vlerat e llogaritura të amortizimit të zërave të aktiveve afatgjata, në pasqyrat financiare te viteve 2018, 2019 dhe në 2020, sjell mos paraqitje të saktë dhe të besueshme të rezultateve ushtrimore, kanë si efekt mos evidentimin e nevojave për investime kapitale dhe shtrembërim të kostove spitalore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 10.1: Strukturat Drejtuese të marrin masa për llogaritjen e saktë të vlerës së aktiveve gjendje dhe amortizimit për secilin grup mjetesh, si dhe pajisjeve kompjuterike e informatike duke pasqyruar me vërtetësi vlerën e mbetur pas rivlerësimeve përkatëse, pjesë e rëndësishme për përcaktimin e kostove të paketave spitalore dhe efekteve që sjell në Buxhetin e Shtetit. ***Brënda muajit Dhjetor 2021***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me Urdhërin Nr.339, me nr. 22/52 Prot., datë 08.11.2021 Pika 1, "Për llogaritjen e vlerës së aktiveve gjendje dhe amortizimit" është caktuar *sektori i financës* për përmisimin e situatës dhe rillogaritjen analitike të amortizimit për zërat e regjistrit të aktiveve.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është në proces

11. Gjetje nga auditimi: Institucioni nuk vërteton me dokumente, pronësinë e zërave kontabël që ka në llogarinë "Ndërtime dhe rikonstruksione", të cilat i ka në pronësi apo në administrim. Në shkresën e ZVRPP Tiranë, më datë 20.07.2018, në përgjigje të kërkesës së SUSHN, me nr.69282 Prot., datë 16.07.2018, për informacion, rezulton se në pronësi të institucionit është vetëm pasuria truall 19,625 m^2, në zonën kadastrale 8190, me numër pasurie 13/773.

Institucioni nuk ka vazhduar proçesin e regjistrimit të pronave në ZVRPP në zbatim të pikës 4 të metodologjisë së punës të vendosur bashkëlidhur Urdhrit 158, datë 15.04.2016. Në zërin toka, troje, terrene nuk ka asnjë regjistrim për vlerat sasiore dhe ekonomike, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018, "Për proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pikën 3.3 "Rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare, paragrafi 62 dhe paragrafi 91.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 11.1: Të merren masa nga strukturat drejtuese për kryerjen e veprimeve përkatëse për regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të ndërtesave dhe trojeve që SUSN zotëron dhe pasqyrimin e zërave kontabël përkatës në pasqyrat financiare.

Brënda muajit Dhjetor 2021

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me Urdhërin nr.22/53 Prot., datë 08.11.2021 "Për regjistrimin e ndërtesave dhe trojeve të SUSN", është caktuar sektori teknik për zbatimin e rekomandimit të KLSH.

-Në zbatim të këtij urdhëri, me Autorizimin nr. 46/1 prot., datë 15.02.2022 është caktuar juristja L. Y. për kryerjen e veprimeve pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

-Në përgjigjen e e Drejtorisë Vendore Tirana-Jug, nr.46/2 prot, datë 11.04.2022 është bërë me dije se: *Pasuria me nr.13/773, vol.24, faqe 42, Zona Kadestrale 8190, është truall me sipërfaqe 19,625 m^2 me shënimin në kartelën e pasurisë, seksioni E „ Kjo pasuri me pronar Shtet është okupuar nga Senatoriumi me një ndërtim të paligjshëm,".*

Gjithashtu, sipas kartelës së pasurisë, pronari figuron Bashkia Tiranë.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është në proces.

12. Gjetje nga auditimi: Nga SUSN nuk janë kryer analiza teknike të mbështetura në manualet përkatëse të pajisjeve, ekspertizave të specialistëve të fushës, të detajuara për caktimin e jetëgjatësisë për pajisjet gjendje dhe planifikimin për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 28.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në institucionet publike". Duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke mos vlerësuar zhvillimin e teknologjisë, SUSN rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 12.1: Të merren masa nga strukturat drejtuese për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.
Menjëherë dhe në vijimësi
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri Nr.341, me nr. 22/54 Prot., datë 08.11.2021 i Drejtorit SUSN "Vlerësimi i jetëgjatësisë së Aktiveve". Në zbatim të këtij urdhëri janë caktuar sektori i menaxhimit të teknologjisë dhe sektori i financës për bashkërendimin e masave për plotësimin e rekomanimit të KLSH.
-Nga auditimi, pajisjet mjekësore të Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi" janë regjistruar në programin për menaxhimin e aseteve CLINGO të Agjencisë Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Medikale (bashkëngjitur, shëmbull gjenerimi datë 04.07.2022 i pajisjes monitor pacienti).
Nga ana e sektorit të financës po punohet paralelisht për formatin e regjistrit të aktiveve.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

13. Gjetje nga auditimi: Nëpunësi zbatues si dhe sektori i financës, në lidhje me ndjekjen e pagesave të detyrimeve kontraktore nuk kanë ndërtuar një sistem gjurmimi skadencash, për të kontrolluar në mënyrë sistematike pagesat e kryera që të respektonin parimin e FIFO-s, si dhe garantimi i gjurmës së auditimit. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, të Ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 87-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 13.1: Strukturat Drejtuese të marrin masa për hartimin e një sistemi monitorimi të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë, si dhe gjurmën e auditimit. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me Urdhërin Nr.342, me nr. 22/55 Prot., datë 08.11.2021 "Për monitorimin e skadencave, Faturave & gjurmëve të Auditimit" janë caktuar sektorët përgjegjës shërbimi i farmacisë, sektori i financës dhe shërbimeve të përgjithshme, si edhe Auditi i Brendshëm për realizimin e rekomandimit.
-Sektori i financës ka realizuar regjistrimin e të dhënave në një data base exel, nga ku analizohet gjendja e detyrimeve. Grupi i auditimit administroi gjendjen nga data 01.02.2022-01.04.2022. Për periudhën Janar-Mars 2022 nuk ka detyrime të prapambetura.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

14. Gjetje nga auditimi: Në proçesin e iniciuar për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në periudhën 2018, me vlerë 13,995,516 lekë, u konstatua se vlerësimi i artikujve për tu nxjerrë

jashtë përdorimi, nuk është bërë në përputhje me udhëzimin përkatës. Në Proçesverbalin e mbajtur nga komisioni përkatës, nuk janë argumentuar arsyet e vlerësimit të artikujve nëse janë të nevojshëm ose jo për veprimtarinë e njësisë, vlerësimin e gjendjes fizike dhe mundësinë e përdorimit të mëtejshëm në njësi të tjera si dhe nëse do të nxirret përfundimisht jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material, mbeturinë apo asgjesimit përfundimtar.
Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë sipas kritereve, si p.sh. të plotësimit të kohës së shfrytëzimit, në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen, kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm.
Kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara, kur kanë humbur cilësitë e tyre te caktuara ne standardet shteterore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në një formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë. Relacioni i vlerësimit nuk përmban proçedurën e ndjekur për vlerësimin për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre, si dhe propozimin përkatës. Veprimet përsa më sipër janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 14.1: Strukturat Drejtuese të marrin masa që proçesi i vlerësimit të aktiveve për të nxjerrë jashtë përdorimi të kryhet me pergjegjshmëri, duke kryer analizat dhe argumentimet e bazuara në kriteret përkatëse dhe me relacione shoqëruese. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me Urdhërin Nr. 339, me nr. 22/52 Prot., datë 08.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm Pika 2, "Për llogaritjen e vlerës së aktiveve gjendje dhe amortizimit", është caktuar sektori i financës për zbatimin e rekomandimit;
-Urdhër nr.154/9, datë 23.11.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm Për Inventarizimet;
-Relacion nga Sektori i Financës i SUSN, nr. 154/10 prot., datë 01.12.2021, me lëndë: "Relacion mbi materialet e nxjerra jashtë përdorimi nga Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi";
-Procesverbali nr.154/11, datë 01.12.2021 i komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit;
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.
15. Gjetje nga auditimi: SUSN, nuk ka plotësuar regjistrin e aktivëve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ai, nuk ka një përshkrim të plotë të aktivit, thuajsë të gjitha përshkrimet janë të përcipta dhe me emëtime të thjeshta të pajisjeve. Mungon data e daljes në përdorim duke e bërë të pamundur përllogaritjen e vlerës së mbetur.
U konstatua se inventari i pajisjeve informatike është i përfshirë në inventarin e pajisjeve dhe aparaturave. Këto veprime janë të kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.2.2011 "Për menaxhimin e aktivëve në njësitatë e sektorit publik", pika 30. Ekzistenca dhe gjëndja në të cilën ndodhen aktivët fizike është një pjesë e rëndësishme në vlërësimin e riskut për arritjen e objektivave të institucionit. Mosplotësimi I regjistrit të aktivëve sjell risk të lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së institucionit, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim I aktivëve që kanë në dispozicion.
(Më hollësisht trajtuar ne pikën 4, faqe 32- 42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
Rekomandimi 15.1: Nëpunësi zbatues duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me Urdhërin Nr.339, nr. 22/52 Prot., datë 08.11.2021, pika 3 " Për llogaritjen e vlerës së aktiveve gjendje dhe amortizimit" është caktuar Nëpunësi Zbatues për zbatimin e rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është në proces.

16. Gjetje nga auditimi: Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet spitaleve për shfrytëzimin e barnave dhe materialeve mjekësore para datës së skadëncës nëpëmjet koordinimit me drejtorinë e politikave dhe strategjive të zhvillimit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, në MSHMS, është kryer shkëmbimi i tyre, me të drejtë kthimi ose dhurim. Kjo mënyrë bashkëpunimi ka sjellë reduktimin e barnave të skaduar në SUSHN, por procesi i dhurimit nuk është kryer sipas Udhëzimit Nr. 30, datë 28.11.2011 "Për menaxhimin e aktivëve në institucionet publike". Në lëvizjet e barnave mungojnë konfirmimi zyrtar i njësisë përfituese si dhe miratimii nëpunësit autorizues për daljen e tyre. Gjithashtu vlerat e barnave te falura si dhe pjesët me të drejtë kthimi nuk janë pasqyruar në zërin e shpanzimeve të pasqyrave në vlerën 935, 698 lekë, në përidhën 2019, në vlerën 2,366,289 lekë dhe në periudhën 2020 në vlerën 5,149,016 lekë. Veprimet përsa më sipër, janë kryer pa miratimin e Nëpunësit Autorizues, në kundërshtim me pikën 107, e 114 të Udhëzimit Nr. 30, datë 28.11.2011 "Për menaxhimin e aktivëve në institucionet publike", "Dhënia në përdorim/ tjetërsim i aktivëve të panevojshme dhe / ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktivëve 107.

(Më hollësisht trajtuar ne pikën 6, faqe 87- 94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi 16.1: Strukturat Drejtuese të marrin masa që proçesi i faljes/dhënies ose marrjes me të drejtë kthimi i medikamenteve, të jetë i shoqëruar me shkresat përkatëse të nëpunësit autorizues për daljen e tyre si dhe me konfirmimet zyrtare të njësive përfituese duke vërtetuar përfundimin e transaksionit. Vlerat e barnave dhe materialeve mjekësore të dhuruara të paraqiten me saktësi në hartimin e pasqyrave financiare. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri Nr.343, nr. 22/56 Prot., datë 08.11.2021, "Proçedurat e faljes/dhënies me të drejtë kthimi të medikamenteve", ku është përcaktuar se sektori i financës dhe i shërbimit të farmacisë janë përgjegjës për zbatimin e rekomandimit.

-Kërkesë për miratim kalimi me nr. 2/30 prot., datë 03.06.2022;

-Fletë-dalje nr. 11, datë 03.06.2022;

-Faturë-Dalje nr. 7640, datë 03.06.2022;

-Fletë-hyrje nr. 256, datë 03.06.2022; (dokumentacioni bashkangjitur).

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

17. Gjetje nga auditimi: Gjatë procesit të verifikimit të aktivëve afatgjata të SUSN, u konstatua se në kapitalizmin e disa aktivëve, mungojnë dokumentacioni shoqërues përkates.

Në shtesat e zërit të pajisjeve mjekësore, "monitorë" në vlerën 31,303, 800 lekë, në periudhën ushtrimore 2020, u konstatua se mungonte letra zyrtare e njësisë donator, (kalimi kapitali i pajisjeve). Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 57, të Udhëzimit Nr.30, datë 28.11.2011 "Për menaxhimin e aktivëve në institucionet publike". Mungesa e dokumentacionit zyrtar shoqërues mund të sjellë problematika lidhur me garancitë e materialeve të marra në dorëzim.

(Më hollësisht trajtuar ne pikën 4, faqe 32- 42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi 17.1: Strukturat Drejtuese të marrin masa që proçesi i marrjes në dorëzim të aktiveve të dhuruara, të jetë i shoqëruar me shkresat përkatëse të njësisë donatore, për të mundësuar kontabilizimin korrekt të aktiveve të dhuruara si dhe ushtrimin e të drejtave të garancisë ose shërbimeve të mirëmbajtjes të tyre. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri Nr.339, nr. 22/52 Prot., datë 08.11.2021 pika 4, "Për llogaritjen e vlerës së aktiveve gjendje dhe amortizimit", në të cilin është përcaktuar sektori i financës përgjegjës për zbatimin e rekomanduar. Nga auditimi, është evidentuar praktika si më poshtë:
- Kërkesa Nr. 194 Prot., datë 29.10.2021;
-Kërkesa për sponsorizim drejtuar O.E., nr. 194/1 prot., datë 01.11.2021;
-Kthim përgjigje pranim sposorizimi, me nr. 134/2 prot., datë 14.01.2022;
-Urdhër për krijimin e komisionit të pritjes së malli, nr. 21, nr. 194/3 prot., datë 17.01.2022;
-Fatura elektronik fiskale nr.990/2022 datë 02.02.2022;
-Fletë hyrja nr. 1, datë 02.02.2022 dhe
-Proçes-verbali i mbajtur nga komisioni i Pritjes së mallit, datë 02.02.2022
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

18. Gjetja nga auditimi: Njësia e SUSN, nuk ka hartuar plan strategjik për periduhat 2019 – 2020, i cili të përmbajë objektivat strategjikë, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.
Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësine e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", nuk është hartuar dhe dërguar në ministry deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Për periudhën 2018- 2020, SUSHN nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK në kukndërshtim me Ligjin e MFK dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhrin, e ministrit të Financave NR.8980, datë 15.07.2010, Kap. V "Shtojcat"m Shtojca 2 – Pyetësori i vetë - vlerësimit për komponentët e MFK-së.
Në kundërshtim me ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Kreu II, neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 8., b, dhe neni 27 SUSHN nuk ka bërë ndryshimet përkatëse në periudhën 2019- 2020, në grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
Mos plotësimi i këtyre hallkave rrit riskun e mos vlerësimit të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
(Më hollësisht trajtuar ne pikën 8, faqe 96-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
Rekomandimi 18.1: Strukturat Drejtuese të marrin masa për hartimin e sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi si pjesë e rëndësishme e realizimit të objektivave kryesore. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Me Urdhërin nr.22/57 Prot.,datë 08.11.2021 "Hartimin e planeve strategjike, objektivave & monitorimi i zbatimit të tyre" është caktuar Auditi i Brendshëm i SUSN-së përgjegjës për zbatimin e rekomandimit.
-Urdhëri nr.239,.,datë 02.06.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik të SUSH;
-Shkresa nr.152/3, datë 15.10.2021 „Plani i Vitit 2022 dhe 2022-2024 te vprimtarise së AB", dërguar Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve të kryera nga SUSN, për pagesat e detyrimeve kontraktore për barna, pajisje mjekësore, shërbime të ndryshme, për

periudhën 2018 – 2020, u konstatua 20 procedura të likujduara me vonesë, nga 1 deri 4 muaj. Operatorët ekonomikë që kanë kryer furnizimet, nuk e kanë ushtruar të drejtën e kërkimit të penaliteteve. Procesi i kryerjes me vonesë të pagesave, ekspozon dhe rrit riskun e penaliteteve ndaj institucionit. Veprimet mësipërme janë në kundërshtim me kushtet e vendosura për likujdimin e faturave, në kontratat përkatëse me OE.
(Më hollësisht trajtuar ne pikën 6, faqe 87-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
Rekomandimi 19.1: Strukturat Drejtuese të marrin të gjitha masat për të kryer likuidimet e detyrimeve kontraktore në afat, për të mos maturuar penalitete ndaj operatorëve ekonomikë.
Menjëherë dhe në vijimësi
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Në zbatim të rekomandimit të KLSH, nga ana e SUSN janë marrë masat si më poshtë:
-Me Urdhërin Nr.339, me nr. 22/52 Prot., datë 08.11.2021 pika 5, "Për llogaritjen e vlerës së aktiveve gjendje dhe amortizimit" është caktuar sektori i financës në zbatim të kësaj pike.
-Informacion nr.22/90 prot, datë 27.05.2022 i Drejtorisë Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme mbi realizimin e rekomandimin e dhënë.
- Model gjendje likujdimi nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme dhe Sektori i Fiancave i SUSN, datë 01.02.2022, datë 01.03.2022, si edhe datë 01.04.2022, nga ku është treguar ndjekja e vazhdueshme pagesave të faturave të furnitorëve brenda afatit për 30 ditë.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

20. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e blerjes me vlerë të vogël, "Rimbushje fikëse zjarri dhe kolaudimin e tyre ne SU "Shefqet Ndroqi", Tirane, 2020, u konstatua se në kërkesat për tu plotësuar nga OE, është theksuar se duhet të jetë i pajisur me License QKL, kodi 1.2. A., për shërbim ekspertize, pikë dhënia e asistencës teknike, si dhe të ketë ekspert privat zjarrfikës të pajisur me leje të lëshuar nga drejtoria MZSH në fushën e mësipërme.
- Në ofertën e kërkuar janë dhe 120 copë F.V. bateri për sinjalizuesit e zjarrit dhe F.V llampa LED me bateri 10 copë, për këto mallra nuk janë paraqitur të dhënat specifike si amperazhi, kapaciteti, fuqia në W.
- Nga auditimi, në procedurën e blerjes me vlerë të vogël, "Evadimi i mbejtjeve urbane në SU Shefqet Ndroqi, Tiranë, 2019, në kërkesat e hartuara nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, duhet qe bashkë me ofertën ekonomike të paraqisnin dhe opsioni/ opsionet se ku shkojnë mbetjet, shoqëruar me kontrata, lejet, dokumentet përkatëse që vërtetojnë plotësimin e tyre. Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet në bazë të kontratës midis palëve, në të cilën përcaktohet detyrimisht përgjegjësia për rastin e kthimit mbrapsht pjesërisht ose plotësisht të mbetjeve nga pritësi. Mos përcaktimii saktë i pjesës se ku shkojnë mbetjet mund të krijojë penalitete për SUSHN. Këto veprime janë në kundërshtim me seksionin C, të aneksit 1 të VKM-së Nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetejve jo të rrezishme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".
Në procedurën "Sigurimi i godinës së Spitalit Univeristar Shefqet Ndroqi", (shërbim mbrojtje kundër zjarrit), u konstatua se në përgatitjen e kërkesave të kërkuara nga OE, nga komisioni i blerjeve të vogla, nuk është kërkuar që ofertuesi duhet të ketë kontratë risigurimi për periudhën kohore në të cilën ofertuesi merrr përsipër sigurimin e dëmit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi.
Hartimi i termave të referencës është bërë në mënyrë të përgjithshme, nuk janë përcaktuar detajet apo karakteristikat për objektet e ndërtimit dhe konstruksionet të shoqëruara me foto, skica apo planimetri, gjendjen teknike të tyre, gjithashtu nuk janë përcaktuar karakteristikat për artikuj të përfshirë në llogarinë 214, instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune dhe llogarinë 218, inventarin ekonomik. Mangësitë në hartimin e termave të referencës, e bëjnë të

paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut. Mos percaktimi I termave të referencës në mënyrë të detajuar, krijon vështirësi në procedurën e rmbursimit, në rast se do të ndodhnin ngjarjet për të cilat po kryhet sigurimi.
Veprimet, si më sipër janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM –së 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, neni 59 Perllogaritja e vlerës limit të kontratës, neni 61 – Hartimi i dokumentave të tenderit, ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar ne pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
Rekomandimi 20.1: Strukturat Drejtuese të marrin masa për trajnimin e punonjësve lidhur me Procedurat e Prokurimit, për rritjen e aftësive profesionale të tyre dhe realizimin me përgjegjshmëri dhe koherencë. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhërit Nr. 336, me nr. 22/49 Prot., datë 08.11.2021 "Mbi trajnimin e punonjësve pjesë e Prokurimeve Publike", në zbatim të kësaj pike SUSN ka dërguar shkresën nr. 22/75 prot., datë 08.11.2021 në Shkollën e Administratës Publike, me lëndë: "Kërkesë për trajnime".
-Mbi planifikimin e trajnimeve për vitin 2022 dërguar MSHMS për nr e personelit që ne kerkojmë të trajnohet për vitin 2022;
-ASPA-Kalendari i trajnimeve 28 mars-1 Prill 2022; ASPA-Kalendari i trajnimeve 19-22 prill 2022; Trajnimet janë kryer online.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore në SUSN, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e barnave, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Rritja e sasive të barnave të porositura nuk është e shoqëruar me relacione shpjeguese dhe argumentuese për justifikimin e sasive shtesë. Mos kryerja e analizave dhe mos argumentimi i tyre, sjellin rritjen e barnave stok, si dhe rritjen e riskut për tu kaluar afati i skadencës. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.7 "Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA" datë 28.02.2018, pika 6. Metodologjia e përcaktimit të politikave ekzistuese dhe politikave të reja, dhe me ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 4, pika 19 dhe neni 16, "Gjurma e auditimit".
(*Me hollesisht trajtuar në pikën 3, faqe 26-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 21.1: Strukturat Drejtuese në vazhdimësi të marrin masa për ndjekjen e procedurave të hartimit të PBA, duke siguruar që planifikimet të kryhen mbështetur në analiza të dinamikës të vlerësimit të kostove të nevojshme për ruajtjen e sasisë dhe cilësisë të shërbimeve të ofruara, vlerësimin e të dhënave historike të shpenzimeve, kostove për njësi, parametrave e çmimeve vendosur nga MSHMS dhe efiçencës dhe argumentimin e tyre.
Menjëherë dhe në vijimësi
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri Nr. 345, nr. 22/58 Prot., datë 08.11.2021 "Hartimi PBA" i Drejtorit të Përgjithshëm;
Komenti i grupit të auditimit: Nga ana e SUSN po punohet për plotësimin sipas rekomandimit për PBA për vitin e ardhshëm.
Ky rekomandim është në proces

22. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2018-2020, SUSN nuk ka paraqitur raporte monitorimi në Ministrinë e Financave, në kundërshtim me ligjin për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjin për MFK. *(Me hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 96-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 22.1: Drejtori i institucionit, në cilësinë e nëpunësit autorizues, të marrë masa për hartimin e raporteve të monitorimit për proçeset e realizimit të objektivave dhe treguesve buxhetorë sipas formateve të Ministrisë së Financës, raportimin dhe publikimin e tyre ne faqen Web, për efekt të transparencës me publikun. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Masat e marra nga ana e S. U. "Shefqet Ndroqi", Tiranë:

-Urdhëri Nr. 347, nr. 22/60 Prot., datë 08.11.2021 "Publikimet në webin e institucioni".

-Plani Strategjik për periudhën 2022-2026 me nr.40/1 Prot., datë 28.01.2022.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdheniet e punës dhe pagave rezulton se:

Në listë pagesat e Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi" nuk reflektohet në kohë reale përmbushja e vjetërsisë duke krijuar diferenca ne nivelet e pagave të punonjësve.

Nga auditimi i punonjësve me kontratë dhe niveleve të pagave për mjekët me Tituj dhe grada shkencore është konstatuar së janë mbajtur 2 standarde në mënyrën e trajtimit të punonjësve me gradë shkencore. Për listën e pedagogeve, nga paga bruto ndalet vetëm tatimi në burim duke u konsideruar marrëdhënia e punësimit si shërbim. Ndërkohë, për listën e punonjësve me kontratë, edhe pse janë mjekë me tituj shkencor konsiderohen si të punësuar të përhershëm dhe mbi pagen e tyre bruto llogaritën dhe ndalen të gjitha kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.9136, date 11.9.2003 i ndryshuar, Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, Neni 8 Llogaritja e kontributeve për punëmarrësin.

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, brënda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pagës, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. *(Me hollesisht trajtuar ne piken 2, faqe 17-26, te Raportit Perfundimtar te Auditimit).*

Rekomandimi 23.1: Departamenti i Burimeve Njerëzore të marrë masa për përditësimin dhe transmetimin e informacionit në kohë reale të vjetërsisë së punës për çdo punonjës në muajin përkatës. Të kryhet përditësimi i vazhdueshëm i dosjeve të punonjësve dhe reflektimi i arsimit përkatës në bazë të të cilave hartohen edhe komponentët e pagës.

Rekomandimi 23.2: Strukturat Drejtuese të marrin masa për trajtim të barabartë dhe uniform të të punësuarve në referencë të bazës ligjore si dhe në respektim të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë për marrëdhëniet e punës dhe eleminimin e dy standardeve për punonjësit e tyre.

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri Nr. 348, nr. 22/61 Prot., datë 08.11.2021 "Evidentimi dhe përditësimi në kohë i vjetërsisë në punë të Punonjësve të SUSN".

-Evidentimi mujor i vjetërsisë në punë Janar-Maj 2022 nga Sektori i Burimeve Njërëzore dhe Sektorit të Financave.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

24. Gjetje nga auditimi: nga auditimi I vlerësimit të ofertave nga KVO u konstatua se: në ofertën teknike të OE L. S., DST pika 2.1 kapaciteti ligjor i OE pika 3, u konstatua se vetëm 32 punonjës janë me licenca active sipas ofertës së dorëzuar, nga 36 punonjës që kërkohen. Gjithashtu, nga auditimi në listëpagesa të këtyre punonjësve rezultoi se vetëm 35 prej tyre janë në listëpagesat e kompanisë dhe nga këto vetëm 16 punonjës rezultojnë me licenca aktive.
OE i kualifikuar nga kvo dhe shpallur fitues nga titullari i AK, nuk plotëson kapacitetin ligjor "punonjës me licenca", edhe pse me këtë devijim nga ana e KVO është kualfikuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 24.1: KVO të marrë masa që në të ardhmen të kryej vlerësimin sa më objektiv duke ruajtur paanshmërinë në procedurat që vlerësohen qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë, duke pasur në vëmendje plotësimin e të gjithë kritereve për kualifikimin e ofertuesve. ***Menjëherë dhe në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri Nr. 335, me nr. 22/48 Prot., datë 08.11.2021 Pika 1.d, "Verifikimi për rekomandimet e lëna nga KLSH";
-Kantrata e Shërbimit të Rojeve Nr.257/100 Prot., datë 31.12.2021 me shoqërinë „I. G.", e cila është lidhur në bazë të pikës 10 te VKM Nr.177, datë 04.04.2019.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

C. MASA PËR ELIMINIMI E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NE ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE FEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se SUSN për të gjithë periudhën e pandemisë ka shërbyer si spital COVID dhe si i tillë ka funksionuar i gjithi Jo i ndarë si institucionet e tjera spitalore. Nga shqyrtimi i dhënies së shpërblimeve COVID për punonjësit rezultoi se në këtë spital kanë përfituar shpërblim të gjithë punonjësit si rezultat dhe i pashmangshmërisë së kontaktit me të infektuarit me Covid. Për periudhën që institucioni u kthye në COVID punonjësit kanë përfituar si shpërblim për punën në kushte të tilla vlerën prej 19,980,409 lekë, e cila përbën efekt negativ financiar. Veprimet janë kundërshtim me VKM nr.207 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, datë 10.03.2020 "Për dhënie shpërblimi për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë" datë si dhe shkresën nr.1429/1, datë 12.03.2020 "Dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë".
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 17-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>Rekomandimi 1.1</u>: Nga Drejtoria e Spitalit Universitar "Shefqet Nroqi" në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa që shpërblimi për COVID-19 t'i jepet vetëm punonjësve të cilet kanë kontakt të drejtpërdrejtë me pacientë të kontaminuar dhe që kontribuojnë në diagnostikimin e të sëmurëve.
<u>Rekomandimi 1.2</u>: Strukturat Drejtuese dhe Departamenti i Financës të marrin masa dhe të ndërpritet dhënia e shpërblimit për çdo punonjës që nuk kontribuon drejtpërdrejtë në diagnostikimin e të sëmurëve me COVID-19. ***Menjëherë***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri Nr.349, nr. 22/62 Prot., datë 08.11.2021 Pika 1 dhe 2, "Marrja e msave për Shpërblimet covid-19".

-Njoftim nr. 22/91 prot., datë 27.06.2022 i Drejtorisë Finanës dhe Burimeve Mbështetëse "Për ndërprerjen e dhënies së shpërblimit për punonjësit që nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në diagnostikimin e të sëmurëve me COVID-19"
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

2. Gjetje nga auditimi: Procedurat e ankimimit, për tenderin me objekt "Furnizim vendosje" paisje për hapjen e sallës së kardio kirurgjisë" janë tejzgjatur duke kaluar afatet. Pprocedura ka zgjatur prej datës 17.07.2020 - 21.12.2020, ose 5 muaj me vonesë, pa kthyer përgjigje me vendim KPP, e cila ka sjellë vështirësi në lidhjen dhe zbatimin e kontratës, pasi në fund të vitit mbyllen fondet buxhetore të akorduara për vitin 2020.
KVO ka vlerësuar në vend të parë "B. A. dhe M." me ofertë ekonomike 58,597,000lekë pa TVSH, duke vlerësuar devijime të vogla mangësitë në dokumentet e kualifikimit. Anëtarët e KVO, edhe në ballafaqimin e kryer nga grupi auditimit konfirmuan se pajisjet e sjella dhe vlera e bashkimit të operatorëve "B. & M." përmbushnin parametrat dhe ishin pajisje cilësore të kompanisë "G. E.". Specifikimet teknike të hartuara nga AK, kanë pësuar disa ndryshime si pasojë e ankesave të operatorëve ekonomikë. Referuar dokumenteve në dispozicion dhe ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, vendimet e marra nga KPP, kanë vlerësuar pjesërsisht ankesat e paraqitura nga Operatori ekonomik "Biometric dhe Montal" për specifikimet teknike të ofruara, dhe vendimi i KPP ka gjeneruar fituesin me vlerë më të lartë prej 13,103,000 lekë.
Komisioni i Prokurimit Publik, nuk ka pranuar ankesën e bashkimit të operatorëve "B. & M.". Çështja e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar njëherë nga gjykata, iso lege, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim. Operatori ekonomik nuk legjitimohet për paraqitjen e ankesës në KPP, e rrjedhimisht pretendimet nuk merren në shqyrtim nga KPP. KPP, para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues, konstaton se ankimuesi nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë për skualifikimin e operatorit ekonomik "F." për shkak se nuk gëzon asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi, etj. Akoma më tej, KPP gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<u>Rekomandimi 2.1</u>: Autoriteti Kontraktor (SUSN), për procedurat e prokurimit kryesisht me objekt "pajisje mjekësore" që do të kryej në të ardhmen, të marrë masa **për përcaktimin e saktë të specifikimeve teknike** nga specialistë të fushës në bashkëpunim me mjekë specialistë që do t'i përdorin, me qëllim arritjen e prokurimit brenda afatit, me efektivitet dhe ekonomicitet.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masat si më poshtë:
-Kërkesë Nr.235 Prot, datë 09.12.2021 drejtuar Qëndrës Spitalore Universitare „Nënë Tereza" për „Caktimin si specialistë të fushës në Komisionin e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt „Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022";
-Përgjigje Nr.3118/1 Prot., datë 14.12.2021 e shërbimit të kardiologjisë të QSUT mbi propozimin për caktimin e dy specialistëve të fushës si anëtarë të komisioneve në procedurën e prokurimeve sa më sipër;

--Urdhër Nr.235/2 Prot., datë 10.01.2022 i Drejtorit të përgjithshëm të SUSN për krijimin e komisionit të përllogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt „Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022“;
--Raporti nr.235/33, datë 02.03.2022 i komisionit përllogaritjes së fondit limit, kushtet e veçanta dhe specifikimet teknike për prokurimin me objekt Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kardiokirurgjisë-viti 2022“;
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

3. Gjetje nga auditimi: Në SUSN, shërbimi me kaldajat e ngrohjes dhe avullit është ofruar nëpërmjet kontratave të qirasë prej vitit 2012-2017, me një vlerë prej 57,161,058 lekë të konsiderueshme. Për këtë, nga auditimet e kryera nga KLSH në vite, është theksuar blerja e kaldajave me qëllim uljen e shpenzimeve dhe vënien në përdorim të kaldajave të institucionit. Deri në vitin 2019, nuk është mundësuar nga Ministria e Shëndetësisë blerja e kaldajave, duke shtuar vlerën e shpenzuar vetëm për periudhën objekt auditimi me 12,096,439 lekë, e cila përbën efekt negativ për SUSHN.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 3.1: Strukturat Drejtuese të SUSN, njësia e prokurimit/ komisionet e ngritura për kryerjen e prokurimeve/shërbimeve, të analizojnë koston e mallrave/shërbimeve që do të prokurohen, duke zgjedhur vlerën e kontratave në favor të istitucionit, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme për të siguruar ekonomicitet dhe efektivitet në përdorimin e fondeve publike. ***Në vijimësi***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nga ana e SUST me Urdhërin Nr. 335, me nr. 22/48 Prot., datë 08.11.2021 Pika 2.b, është caktuar për ndjekje Auditi Brendshëm.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

4. Gjetje nga auditimi: Në procesin e monitorimit të kontratave të SUSHN me FSDKSH, për “Financimin e shërbimeve spitalore”, u konstatua mos realizim i detyrimeve të spitalit në lidhje me kontratën koncesionare S. Spitali është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në Kontratën Koncesionare Nr. 1440/ 40 Prot., datë 24.12.2015, “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumentave kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekesore sterile një përdorimësh në sallat kirurgjikale”, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Koncensionare S. S. shpk. Gjatë auditimit të dokumentacionit të mbajtur nga spitali për periudhën 2019 – 2020, për setet kirurgjikale të sterilizuara nga koncensionari dhe të përdorura në 78 operacione, u konstatua se, dokumentacioni I kërkuar nga FSDKSH, është plotësuar jo në përputhje me aneksin nr. 4., të kontratës lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me koncensionarin S. S. Në modulet administrative të shërbimit të plotësuara nga mjekët që kryejnë operacionet, lidhur me zgjedhjen e komplesitetit te setit kirurgjikal, përdoren diagnozat mjekësore të terminologjisë profesionale dhe jo klasifikimet e përcaktuara në aneksin nr. 4.
Vlera e sterilizimit të seteve kirurgjikale, varion nga kompleksiteti i ulët i seteve në vlerën 13, 900 lekë, në vlerën 22,300 lekë, për kompleksitetin e mesëm dhe në vlerën 37,700 lekë në kompleksitetin e lartë. Për periudhën 2019- 2020 janë kryer 78 operacione kirurgjikale, nga të cilat 54 me kompleksitet të lartë dhe 24 me kompleksitet të ulët, me vlerë financiare 2,369,400 leke, në të cilët modulet për gjurmueshmërinë klinike dhe administrative të shërbimit, lidhur me përzgjedhjen e kompleksitetit të setit, nuk I referoheshin aneksit nr.4 të kontratës me koncensionarin.

Këto veprime janë në kundështim me pikën 9, të kontratës koncensionare NR. 1440/40 Prot., datë 24.12.2015. Mos përcaktimi i saktë i seteve që do të përdoren, rrit riskun e subjektivizmit në përzgjedhjen e kompleksitetit të ryre, gjë e cila shoqërohet me kosto financiare shtesë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 87-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 4.1: Strukturat Drejtuese të marrin masa, për përcaktimin e ndërhyrjeve kirurgjikale shtesë, që nuk janë të përfshira në Aneksin 4, të kontratës koncesionare për sterilizimin dhe t'i kërkojë MSHMS për klasifikimin e kompleksitetit të seteve që përdoren në to, shoqëruar me amendimet përkatëse në kontratën me koncesionarin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nga ana e SUST është nxjerrë Urdhëri nr. 22/59 Prot., datë 08.11.2021, "Për interventet jashtë listës së Kontratës me Konçensionarin "S. S.", nëpërmjet të cilit parashikohen veprimet që do të merren në rastin e mospërputhjes së interventeve me nomeklaturën e kompleksitetit të seteve.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt "Shërbim me roje private për SUSN" është konstatuar se referuar listëpagesave punonjësit e ofrimit të shërbimit të rojeve në SUSN paguhen me 36,000 lekë/muaj pagë bazë pa përfshirë shtesat e përcaktuara për këtë pozicion pune. Konform ofertës dhe kontratës duhet të paguheshin me 48,793.95 lekë / roje/ muaj (sipas ofertës së "L.S." x 4.98 vend roje = 28,941 lekë në muaj x 7 vend roje = 202,586.8 lekë, përfitim i padrejtë nga paga e rojeve që mban OE "L. S.".
Nga verifikimi i kryerjes së shërbimit u konstatua se punonjësit e shërbimit të cilët kanë kryer shërbim me turne të dyta dhe të tretë janë paguar si punonjës shërbimi me një turn. Diferencën e shtesës mbi page për punë me turne të dyta e të tretë (5,811.44 lekë/roje/muaj x 4.98 vend roje = 28,941 lekë muaj / muaj x 7 vend roje = 202,586.8 leke).
Gjithashtu nga ky përvetësim i pagës është shmangur dhe pagesa e detyrimit për sigurime shoqërore e shëndetësore 16.7% ose 970.51 lekë/ muaj/ roje, ose 4,833.13 lekë për vendroje x 7 = 33.831 lekë/muaj shmangie nga detyrimi i pagimit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit me 3 turne / muaj. Në total, përvetësimi pagë + sigurime shoqërore e shëndetësore, është 236,417 x 9 muaj (kontratë) = 2,127,753 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
Rekomandimi 5.1: SUSN, të dërgojë informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi konstatimet e KLSH si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim me roje private për SUSN", fituar nga Operatori Ekonomik "L. S." (kontratë, specifikime teknike, etj) me qëllim verifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve tatimore konform legjislacionit në fuqi dhe shmangien e parregullsive në llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen në buxhet të detyrimeve për punonjësit e shoqërise.

Menjëherë

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nga ana e SUST është dërguar shkresa nr. 22/74 prot., datë 08.11.2021 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve "Kërkesë për verifikim".
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në përgjigjen e saj nr. 20987/1 prot., datë 07.12.2021, njofton se e ka kaluar për kompetencë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Blerje oksigjen për vitin 2020", konstatohet se kërkesa për blerje oksigjeni sipas procedurës së prokurimit "Blerje

oksigjen për vitin 2020" në sasinë 2072820 litra, me vlerë 280,286,720.4 lekë, për periudhën nga data 07.08.2020 deri me datë 01.08.2021 është bërë me datë 27.07.2020. Çmimi i përllogaritur është 135.22 lekë për litër. Kërkesa për blerjen e oksigjenit i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresë nr.117/1 Prot., datë 28.07.2020. Ministria i ka dhënë miratimin nëpërmjet komunikimit elektronik regjistruar me nr.117/2 Prot., datë 04.08.2020. Nga ana e SUSHN, krahas furnizimit të kontraktuar, është kërkuar furnizimi me 170,000 litra me oksigjen për arsye të rritjes së konsumit pasoje e Covid-19. MSHMS me shkresë nr. 3601/1prot., datë 03.08.2020, ka rekomanduar lidhjen e menjëhershme të kontratës së furnizimit me oksigjen, si dhe delegimin e të drejtës së zhvillimit të procedurës për furnizimin me afat 1 vjeçar. Bazuar në këtë shkresë përcaktohet që në kompetencat e deleguara përfshihet edhe përllogaritjet e fondit limit në total, sasitë, specifikimet teknike, llojin e procedurës së prokurimit, lidhje dhe ndjekje e kontratës etj. Bazuar në sa më sipër, është bërë ftesa për ofertë për BOE "G.- G. T. Sh. dhe M. A." "Blerje barna-B1", sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet MSHMS dhe BOF "G. G. T. Sh. dhe M. A.". Kontrata për sasinë 170,000 litra oksigjen është nënshkruar me nr.117 / 8 Prot., datë 05.08.2021, me OE "G. T. Sh.", me çmim njësi 135.4 lekë për litër. Afati i realizimit të kontratës është përcaktuar nga data 05.08.2020 deri me datë 21.08.2020. Theksojmë se kontrata e nënshkruar nga vetë SUSHN me OE "G. T. Sh.", për vitin 2019, ka rezultuar me çmimin për njësi 135.22 lekë për litër. Marrja për referencë e çmimit për njësi për kontrata të nënshkruara nga MSHMS dhe jo nga vetë institucioni, ka rezultuar me një rritje të çmimit të blerjes së oksigjenit të lëngshëm me 0.18 lekë për litër. Bazuar në Informacionin nr.117 / 17 Prot., datë 17.08.2020, të sektorit teknik, është kërkuar furnizimi me sasinë 630,000 litra oksigjen i lëngët, për një periudhë 70 ditore, për arsye të konsumit të lartë. Për këtë arsye, është lëshuar urdhri i prokurimit nr. 117/18 prot., datë 18.08.2020, për zhvillimin e procedurës së prokurimit "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", me fond limit 85,302,000 leke, për furnizimin e sasisë 630,000 litra oksigjen të lëngët (çmim njësi 135.4 lekë/liter). Kontrata përkatëse është nënshkruar me nr. 117/26 prot., datë 24.08.2020, për afatin e zbatimit 70 ditor. Sasia e furnizuar sipas procedurave të mësipërme është 2078820 litra. Vlera 374,187 lekë (2078820 litra x 0.18 lekë/litër) konsiderohet efekt negativ financiar. Veprimi bie në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2.

(*Me hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, te Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 6.1: SUSN të marrë masa që në realizimin e procedurave te prokurimit të merren për referencë çmimet/njësi për kontrata të nënshkruara nga vetë institucioni kur ai është ekonomikisht më i favorshëm, për të siguruar ekonomicitetin, efiçencen dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike. ***Në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e SUST me Urdhërin Nr. 335, me nr. 22/48 Prot., datë 08.11.2021 Pika 2.c, është caktuar për ndjekje dhe zbatim Auditi Brendshëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

7. Gjetje nga auditimi: Nga deklarimet e punonjësve të kaldajës dhe verifikimi fizik i kaldajës, u konstatua se 2 kaldajat e avullit dhe e ngrohjes të kontraktuara me qira nga SUSN, nuk janë lëvizur nga territori i spitalit, pasi këto dy kaldaja janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, kanë të përbashkët impiantin e marrjes së lëndës djegëse (silosin, shnekun etj) si rrjedhojë kaldaja e ngrohjes nuk është lëvizur nga vendi për periudhën mbas përfundimit të kontratës së qirasë. Nuk është marrë asnjë masë nga drejtoria e spitalit për lirimin e hapësirës prej 45m² (50% e sipërfaqes totale të dhomës së kaldajave të zënë nga

kaldaja e ngrohjes) aq më tepër nuk i është kërkuar operatorit fitues lirimi i ambienteve apo llogaritja e një qiraje mujore sipas përcaktimeve në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar. Referuar paragrafit III të kësaj VKM, ndryshuar me VKM nr. 992, datë 09.12.2015 Tarifat dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve, në qytetin e Tiranës tarifa dysheme është përcaktuar 300 lekë/m², (45m² x 300 lekë/m²) = 13,500 lekë/ muaj qira e pa llogaritur ndaj operatorit ekonomik për zënie hapësire përtej afatit kontraktor. Për periudhën Mars -Tetor 2018, kohë në të cilën kjo kaldajë nuk duhet të ishte në këto ambiente *operatori ekonomik i detyrohet Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi" vlerën prej 13,500 leke/muaj x 8 muaj = 108,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për institucionin, pasi operatori ekonomik ka shfrytëzuar asetet e spitalit pa asnjë detyrim.* Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar. "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu IX, neni 77 "Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës" dhe VKM nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
(*Me hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 7.1: Strukturat Drejtuese të SUSN, në të ardhmen të marrin masa për monitorimin e kontratave të shërbimit dhe përcaktimin e kushteve kontraktuale për qiradhënien për shfrytëzimin maksimal të hapësirës së spitalit sipas legjislacionit ne fuqi, me qëllim rritjen e të ardhurave dytësore. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Nga ana e SUST janë blere të dy kaldajat, për të cilat kishte përfunduar kontrata e qirasë, Fletë Hyrje nr.7, datë 25.04.2019 dhe fatura e blerjes së kaldajave nr.30202496 me vlerën 8,532,000 lekë me TVSH.
-Urdhëri Nr.350, me nr. 22/63 Prot., datë 08.11.2021 Pika 1.a, "Për monitorimin e kushteve kontraktuale të qirdhënies së ambjenteve Spitalore".
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

8. Gjetje nga auditimi: Kontrata "FV makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e SU "Shefqet Ndroqi", është nënshkruar me nr. 461/37 prot., datë 03.08.2018, me Kontraktorin "E. K." SHPK, me vlerë 175,416,638.4 lekë me TVSH. Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave dhe librezës së masave rezulton se ka mangësi si më poshtë:
-Sipas zërit A-3.1.ANM-64 "F.V llamarinë e galvanizuar për prodhimin e kanaleve të ajrit me trashësi nga 0.6 mm deri 1.2 mm, e kompletuar me gjithë fllanxha dhe të gjitha rakorderitë e nevojshme për prodhimin dhe montimin e kanaleve të ajrit", është certifikuar sasia 40841 kg. Në specifikimet teknike pika 2.10, përcaktohet: Të gjitha kanalet e ajrit përjashtuar rastet kur specifikohet ndryshe, duhet të ndërtohen me flete metalike te galvanizuar. Te gjithë fletët metalike të galvanizuara duhet të jenë të veshura me zink 275 g/m². Kapëset dhe mbajtëset duhet të jenë të mbrojtura të galvanizuara. Trashësia e fletëve metalike të galvanizuara duhet të përgjigjet në funksion të brinjës më të madhe të kanalit të ajrit, madhësia e te cilës jepet për gjerësi deri 30 cm, me trashësi 0.6 mm, për gjerësi nga 35 cm deri 57 cm, me trashësi 0.8 mm, për gjerësi nga 80 mm deri ne 120 mm me trashësi 1 mm dhe për gjerësi nga 125 cm deri ne 200 cm, me trashësi 1.2 mm.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se jo në të gjitha rastet janë respektuar përcaktimet e mësipërme, pasi për dimensione të ndryshme janë përllogaritur llamarinë me trashëi më të madhe. Gjithashtu pesha e marrë si reference ka diferenca me peshën e përcaktuar në manuale. Sa më sipër rezulton se diferenca e peshës e llogaritur më tepër është 15151 kg. kësaj peshe i zbritet veshja me zink në të dy anët e llamarinës me 275 g/m^2, në sasinë 2522 kg (sipërfaqe 4586 m^2 x dy anë x 0.275 g/ m^2). Rezulton se është certifikuar më shumë vlera 7,577,400 lekë [(15151 kg -2522 kg) x 600 leke /kg], veprim I cili bie në kundërshtim me specifikimet teknike. Sa I përket shmangies së specifikimeve teknike në lidhje me zgjedhjen e trashësisë së llamarinave sipas dimensioneve rakorduese, deri në këtë pikë periudhë të auditimit nuk disponohet dokumentacion që verteton ndonjë ndryshim gjatë zbatimit të kontratës, si ndonjë referencë e mundshme e gabuar në përcaktimin e trashësisë së tyre.

-Nga verifikimi i zërave A – 1.03 deri në A- 1.11 "F.v tubo celiku I zi pa tegel (Mannesmann)", rezultoi se pasha e përllogaritur referuar gjatësisë së tyre nuk rakordon me peshën që duhet të përcaktohej sipas referencave të manualeve, për standartet e përcaktuara në projektin e zbatimit.

Në projekt zbatim janë përcaktuar karakteristikat e tubacioneve "tub celiku I zi, pa saldim me karakteristika, permasa dhe peshë sipas UNI 10216-1". Llogaritja e peshës së tubave nuk është referuar në këtë standart, duke certifikuar më shumë 4882 kg tubacione me vlerë 2,196,900 lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Specifikimet teknike të kontratës pika 2.10, ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", I ndryshuar, neni 7.

(*Me hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Nga grupi i Auditimit nuk u krye verifikimi i përmasave, peshës së llamarinave dhe të tubacioneve të vendosura në objekt, përarsye të protokolleve Covid-19, pasi SUSN në përiudhën e auditimit funksiononte si spital Covid.

Rekomandimi 8.1: Nga SUSHN në bashkëpunim me mbikqyrësin e punimeve të marrë masa për verifikimin e trashësisë së llamarinave dhe tubacioneve të vendosura në objekt, verifikim i cili nuk është kryer nga KLSH për arsye të protokolleve Covid-19, pasi SUSN në periudhën e auditimit funksiononte si spital Covid. Bazuar në rezultatet e verifikimit, duke marrë në konsideratë se në dokumentacionin e dosjes teknike specifikimet teknike rezultojnë të pa zbatuara, të bëhet zbritja e vlerës 9,774,300 lekë, llogaritur si peshë llamarinash dhe tubacionesh të argumentuara, rezultat i cili duhet të reflektohet në situacionet progresive dhe situacionin përfundimtar.

Gjatë zbatimit të kontratës

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masat si më poshtë:

-Urdhëri Nr. 351, me nr. 22/64 Prot., datë 08.11.2021, i Drejtorit të Përgjithshëm të SUSN "Për kontraktimin e inxhinjerit mekanik për verifikimin e Rekomandimeve të KLSH";

-Procesverbali i punimeve me plus minuset, i mbajtur nga sipërmarrësi i punimeve dhe mbikëqyrësi i punimeve. Nga ana e kontraktorit janë zbritur punimet në masën 9,774,300 lekë pa TVSH të konstatuara nga KLSH;

-Shkresa nr.116 Prot., datë 11.04.2022 për dorëzimin e situacionit përfundimtar të punimeve për objektin „FV makineri e pajisje pë sistemin e kondicionimit në ambjentet e SUSN;

-Shkresa nr.117 Prot.,datë 11.04.2022 Dorëzimi i Dosjes teknike të Punimeve për objektin „FV makineri e pajisje pë sistemin e kondicionimit në ambjentet e SUST;

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndertimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit",* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1 shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme,* bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojme** kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Tiranë, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara:**

Shoqëria **"T." shpk,** në cilësinë e mbikqyrësit të punimeve në objektin "F.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e S.U "Shefqet Ndroqi" ka çertifikuar punime me vlerë 9,774,300 lekë, të cilat nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, përsa i përket përcaktimit të peshës së llamarinave për ndërtimin e tubove të ajrimit dhe tubacioneve. (*Me hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Shkresa nr. 22/73 prot., datë 08.11.2021 "Kërkesë për verifikim" drejtuar Kryeinspektorit të inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor.

-Kthim përgjigjes nr. 22/77 prot. Datë 01.12.2021.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar.

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153pikat 1 dhe 2 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi Punës", I ndryshuar, kontratës kolektive të punës nr.1528/1 Prot., datë 30.03.2021, neni 19, pika 1/a, pika 2/ a, b, c, "Masat Disiplinore", kontratave individuale të punës neni 15, kërkohet fillimi I procedurave për dhënien e masave disiplinore

"Vërejtje me Paralajmërim" për:

Z. S. Gj. me detyrë Zv/Drejtor ekonomik në cilësinë e NZ;

Znj. E. K. me detyrë përgjegjëse e sektorit të finances, në cilësinë e anëtarit të grupit për llogaritjen e fondit limit;

Z. A. P. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik, në cilësinë e anëtarit të grupit për llogaritjen e fondit limit;

Z. S. N. me detyrë specialist sektorit teknik, në cilësinë e specialistit të fushës;

"Vërejtje me shkrim" për:

Znj. M. B. me detyurë përgjegjëse e sektorit të kostos, në cilësinë e anëtarit të grupit për llogaritjen e fondit limit;

Znj. M. F. me detyrë përgjrgjës i sektorit të shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO;

Znj. S. T. me detyrë përgjegjës i sektorit të informacionit mjeksor dhe statistikës, në cilësinë e punonjësit të statistikës;

Z. A. I. me detyrë përgjegjës i sektorit bio-medikal, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve në vlerë të vogël;

Z. E. V. me detyrë farmacist, në cilësinë e anëtarit të grupit për llogaritjen e fondit limit;

Znj. A. M. me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të grupit për llogaritjen e fondit limit;

Znj. L. Y. me detyrë jurist e, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla;

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Nga ana e Spitalit Universitar „Shefqet Ndroqi" janë nxjerrë urdhërat nr.22/65-22/72 Prot., datë 08.11.2021 për dhënie mase disiplinore;

-Shkresa nr29/13 Prot., datë 19.10.2021 „ Kërkesë për ndërprerje marrëdhëni pune“ nga z. S. Gj. ;
-Shkresa nr29/06 Prot., datë 28.04.2021 „ Kërkesë për ndërprerje marrëdhëni pune“ nga znj. E. K. ;
- Zoti S. N. dalë në pension në datë 19.04.2018.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Spitalin Universitar të Traumës mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Raporti Përfundimtar mbi Auditimin e Përputhshmërisë në Spitalin Universitar të Traumës, është dërguar me shkresën nr.130/10 Prot. datë 14.10.2021 " *Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e ushtruar në Spitalin Universitar të Traumës*", protokolluar në SUT me Nr. 2207 Prot. Datë 15.10.2021.
Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* Spitali Universitar i Traumës, *ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën* nr.2207/3 prot, datë 01.11.2021, duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar me shkresën nr.843 prot, datë 19.04.2022 në Kontrollin e Lartë të Shtetit "Për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", sipas Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30*. Raportimi është kryer brënda afatit prej 6 Muaj.

III. Rekomandimet e KLSH
Në Raportin Përfundimtar, dërguar me shkresën nr.130/10 Prot. datë 14.10.2021 për auditimin në Spitalin Universitar të Traumës, janë rekomanduar gjithsej:
b. Janë rekomanduar **29** masa organizative;
c. Janë rekomanduar **2** masa për shpërblim dëmi;
d. Janë rekomanduar **21** masa disiplinore;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH
Sipas planit të veprimit të subjektit statisi i pranimit jepet sim ë poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Organizative	30	30	-	-
2	Masa për shpërblim dëmi	2	2	-	-
4	Masa disiplinore	21	21	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e Spitali Rajonal Durrës
Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	30	21	-	9	-
3	Masa për shpërblim dëmi	2	1	-	1	-
4	Masa disiplinore	21	21	-	-	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	30	21	-	9	-
3	Masa për shpërblim dëmi	2	1	-	1	-
4	Masa disiplinore	21	21	-	-	-

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 70%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Raporti Përfundimtar mbi Auditimin e Përputhshmërisë në Spitalin Universitar të Traumës, është dërguar me shkresën nr.130/10 Prot. datë 14.10.2021 " *Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e ushtruar në Spitalin Universitar të Traumës*", protokolluar në SUT me Nr. 2207 Prot. Datë 15.10.2021.
Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* Spitali Universitar i Traumës, *ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën* nr.2207/3 prot, datë 01.11.2021, duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

-Nga ana e subjektit të audituar është raportuar me shkresën nr.843 prot, datë 19.04.2022 në Kontrollin e Lartë të Shtetit "Për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", sipas Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30*. Raportimi është kryer brënda afatit prej 6 Muaj.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: KLSH ka rikërkuar zbatimin e tre rekomandimeve të cilat kanë rezultuar në proces zbatimi referuar shkresës së KLSH Nr. 470/38 prot. Datë 14.08.2019, protokolluar në SUT me nr. 2235 prot. Datë 20.08.2019, të cilat përsa i përket kompetencave ligjore të SUT janë pranuar dhe zbatuar plotësisht dy rekomandime, ndërsa një është zbatuar pjesërisht. Konkretisht është zbatuar pjesërisht rekomandimi: "*Të punohet për plotësimet në draftin e rregullores së re, të miratohet brenda një afati të shkurtër, me qëllim përputhjen e saj*

me strukturat aktuale të funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës", pasi Ministria e Shëndetësise dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), ka shfaqur një qasje aspak bashkëpunuese, ndaj kerkesave të persëritura të SUT, duke bere që angazhimi i Spitalit Universitar të Traumës për zbatimin e ketij detyrimi, te mbelet i pambeshtetur, per mungesë bashkëpunimi nga ana e MSHMS, në shkelje të parashikimeve normative, të cilat kushtëzojnë këtë dikaster të përmbushë detyrimet e veta funksionale. Konkretisht Drejtori i Spitalit A. Z., i ka kërkuar dhe rikerkuar zyrtarisht Ministres së MSHMS Znj. O. M., në cilësinë e Kryetares së Bordit, me shkresat nr. 1355 prot., datë 20.05.2019, nr. 2780 prot., datë 16.10.2019 dhe nr. 1365 prot, datë 14.07.2020, mbledhjen e bordit për miratimin e buxhetit të SUT, miratimin e statusit të SUT, miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të SUT, miratimin e organikës sipas propozimeve perkatëse, në zbatim të parashikimeve të nenit 10 të VKM nr. 66, datë 03.02.2017 "Per përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për ngritjen e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore Universitare". Deri në datën 07.05.2021 që përfundoj auditimi, nga Ministrja e MSHMS, Znj. O. M., në cilësinë e Kryetares së Bordit, nuk është kthyer asnjë përgjigje për sa kërkuar në menyrë të përsëritur nga SUT.

Rekomandimi1.1: Nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës, të merren masa për miratimin e statutit, rregulloren e organizimit dhe funksionimit, strukturës organizative, projektbuxhetin dhe buxhetin, raportin vjetor të veprimtarisë financiare, rregullat dhe procedurat e punësimit të strukturës shëndetësore universitare. ***Brenda datës 31.12.2021***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me shkresën Nr.2446 Prot., datë 16.11.2021 është kërkuar mbledhja e Bordit;

-Urdhëri Nr.319, datë 18.05.2022 i Ministrit SHMS "Për ngritjen e Bordit Drejtues të SUT;

-Kërkesë Nr.1195 Prot., datë 03.06.2022 i Drejtorit të Spitalit Universitar të Traumës "Per mbledhjen e Bordit te SUT-se";

-Vendimi Nr.1 datë 15.06.2022 i Bordit të SUT sipas të cilit është miratuar struktura e spitalit, statusi, rregullorja e funsionimit të SUT etj.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

2. Gjetje nga auditimi: Në 10 raste për vlerën 24,831 mijë lekë shpenzimet për blerje materiale, për shërbime etj, nuk janë paraqitur në llogarinë e duhur kontabel të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu janë kapitalizuar ne mbyllje të vitit ushtrimor.

Rekomandimi 2.1: Menaxhmenti, duhet të siguroj menaxhim të mirë dhe të forcojë kontrollet në realizimin e shpenzimeve, të siguroj klasifikimin e duhur të tyre për një pasqyrim të drejt dhe të saktë financiar. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Sektori i financës të Spitalit ka pasqyruar në përputhje me planin kontabël, veprimet financiare të realizuara gjatë kësaj periudhe dhe në vijimësi. Shpenzimet janë rregjistruar drejt dhe saktë, sipas planit 7 shifor të llogarive të kontabilitetit dhe kjo është reflektuar si në Urdhër Shpenzimet, Ditarin e bankës, Situacionet mujore dhe Evidencat e thesarit. Nga auditimi, u kontrollua Urdhër Shpenzimi nr.243 datë 08.06.2022, llogaria ekonomike 602/ nën llogaria 6027400.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

3. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste për vlerën 471,600 lekë me TVSH janë kryer shpenzime për shërbim gjelbërimi pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht nuk ka plan vendosje se ku do të mbillen pemët dekorative me distancat respektive, speciet përkatëse, preventiv, certifikata fito-sanitare qe do ti shoqërojnë. Veprime në kundershtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe

neni 4, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik', me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Ligjin nr. 8732, datë 24.01.2001 "Per materialin mbjellës bimor', me ndryshimet vijuese të tij', neni 7/b,c,ç, neni 20 pika 1 dhe 2, neni 23, VKM nr. 157, date 25.4.2002 "Për kriteret dhe rregulla të përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe permbajtjes se etiketës për materialin mbjellës, bimor", neni 6, Udhëzimin e Ministrisë së Bujqesisë dhe Ushqimit nr. 107 datë 2.12.2002 "Për krijimin, shumezimin, përpunimin, tregtimin, kontrollin, vleresimin e farave dhe fidaneve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor', neni 11, b,c,d, neni 21/a,d, neni 39/a,b,c.

Rekomandimi 3.1: Nga sektori i sherbimeve të brendshme të merren masa qe shpenzimet e sherbim gjelbërimit te kryhen me dokumentacion specifik që i perkasin këtij sherbimi.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Përgjegjës per zbatim është caktuar Grupi i punes së ndjekjes së kontratës së gjelberimit.

Shërbimi i gjelbërimit në SUT është kryer në bazë të minikontratës nr.54/17 Prot., datë 05.01.2022 me afat deri 30.06.2022, dhe mbështetet nga Marrëveshja Kuadër nr.68/8 Prot., datë 05.11.2021 Për arsye se Marrveshja Kuadër e ka afatin 36 muaj, deri në 04.11.2024, SUT është duke përgatitur ndryshimet në DST sipas rekomandimeve të KLSH.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është në proces.

4. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste për vlerën 69,000 lekë janë kryer shpenzime përmbarimore pa dokumentacion të plotë vërtetues (faturë) dhe nuk janë paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu janë kapitalizuar në mbyllje te vitit ushtrimor.

Rekomandimi 4.1: Nga sektori i financës të merren masa që shpenzimet permbarimore të kryhen me dokumentacion të plotë vërtetues (faturë) dhe të paraqiten në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Gjatë kësaj periudhe ka pasur vetëm një shpenzim përmbarimor i cili është realizuar në përputhje me llogarine e duhur kontabel 602/ nën llogaria 6027400 të klasifimit buxhetor ne nivel 7-shifror dhe me dokumentacionin vërtetues faturën nr.7/2022 datë 01.06.2022.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

5. Gjetje nga auditimi: Me urdher shpenzimin nr. 900, datë 18.12.2018 për vlerën 448,000 lekë, është likujduar Instituti i Modelimeve ne Biznes për shpenzimin që ka të bëjë me azhurnim soft ËEB Buxhetor (Program financiar që perdoret në kontabilitetin e këtij institucioni) me dokumentet vërtetuese përkatës. Nga auditimi konstatohet se grupi i përgatitjes së specifikimeve teknike, akt rakordimi për kryerjen e sherbimit dhe komisioni i blerjes me vlera të vogla, nuk kanë në përberjen e tyre specialist të IT.

Rekomandimi 5.1 Nga sektori i prokurimeve të merren masa që grupet e përgatitjes së specifikimeve teknike, komisionet e blerjes me vlera të vogla për procedurat e shërbimit të teknologjisë së informacionit të kenë në përbërjen e tyre specialist IT.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Për sa më lartë, nga ana e sektorit të prokurimeve janë marë masat që në procedurat e prokurimit që janë zhvilluar përgjatë periudhës Tetor 2021 dhe Janar 2022 e në vazhdimësi me objektin e prokurimit *azhornim soft WEB Buxhetor (Program financiar që perdoret në kontabilitetin e ketij institucioni),* të ketë të përfshirë specialist IT në grupin e punës.
Kjo procedurë prokurimi parashikohet të zhvillohet në muajt Korrik-Gusht 2022.
SUT ka zhvilluar procedura të ngjashme ku ka të përfshirë një specialist fushe (Inxhinier IT), më konkretisht në datën 26.01.2022 është ngritur një komision/grup pune për hartimin e specifikimeve teknike për blerje printera/fotokopje.
Specifikimet teknike janë protokolluar me shkresën nr. 5/1 Prot., datë 01.02.2022, ku në përbërjen e grupit të punës ka një specialist IT, specialist fushe që ka përgatitur specifikimet teknike sipas standartit të miratuar nga AKSHI.
Mbasi është shpallur fituesi për procedurën blerje me vlerë të vogël (nën 1,000,000 Lekë) është ngritur një grup pune për pritjen e mallit, me nr. 5/8 Prot., datë 18.02.2022, ku dhe në këtë rast ka një specialist IT si specialist fushe.
Kopje e këtyre shkresave do ti bashkangjiten këtij relacioni sipas numrit të fletëve si më poshtë:
1. Urdhër për ngritjen e grupit të punës 1 fletë
2. Specifikime teknike fletë
3. Urdhër për pritjen e mallit 1 fletë
5. Procesverbal pritje malli 1 fletë

Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

6. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare vjetore nuk janë miratuar nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumes (miratim i raportit vjetor të veprimtarisë financiare), veprim në kundërshum Vendimin e Këshillit ët Ministrave nr. 66, datë 03.02 2017 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave per ngritjen e organizimin e sherbimeve dhe strukturave shëndetesore universitare", pika 10/c
Rekomandimi 6.1: Nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës të merren masa për miratimin e pervitshem të pasqyrave financiare vjetore. ***Në vijimësi.***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Urdhëri Nr.319, datë 18.05.2022 i Ministrit SHMS "Për ngritjen e Bordit Drejtues të SUT;
-Vendimi Nr.1 datë 15.06.2022 i Bordit të SUT sipas të cilit është miratuar struktura e spitalit, statusi, rregullorja e funsionimit të SUT etj.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

7. Gjetje nga auditimi: Nuk janë përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara sipas udhëzimeve të MF-së. Pra pasqyrat financiare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kod buxheti "13" dhe Ministrisë së Mbrojtjes me kod buxheti "17", janë hartuar secila më vehte, pra nuk janë konsoliduar ose gjëndja e tyre financiare nuk është paraqitur në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të SUT, përpjestimisht me pjesën takuese, veprim në kundërshitm me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 8 datë 09.03.2018 "Per procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Rekomandimi 7.1: Nga sektori i financës të merren masa për për të përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të përvitshme dhe të paraqiten në përputhje me standartet kontabël kombetare, duke pasqyruar gjendjen e tyre financiare ne aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit te buxhetit SUT. ***Në vijimësi.***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Sektori i Finances ka hartuar pasqyrat financiare vjetore të SUT gjatë muajit mars 2022, në përputhje me standartet kontabël kombetare. Bashkëlidhur Pasqyrat Financiare viti ushtrimor 2021 nr.690 Prot., datë 30.03.2022.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

8. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare vjetore, edhe pse janë depozituar në Degën e Thesarit të Rrethit Tiranë, nuk provohet nga ana shkresore te jetë bërë konfirmimi nga kjo e fundit, pastaj të dërgoheshin në Ministrinë e Shëndetesisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ne Ministrnë e Mbrojtjes (vetem provohet protokollimi në Degën e Thesarit), veprim ne kundërshtim me Udhezimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 'Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Pergjithshme", kapitulli IV, pika 117.
Rekomandimi 8.1: Nga Drejtoria e SUT, sektori i financës të merren masa që pasqyrat financiare vjetore të dërgohen në Ministrinë e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrine e Mbrojtjes, pasi të jenë konfirmuar paraprakisht nga Dega e Thesarit të Rrethit Tiranë. ***Në vijimësi.***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Sektori i Financës ka dërguar pasqyrat financiare vjetore në Ministrinë e Shëndetësise dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën me nr.689, dt.30.03.2022 dhe në Ministrinë e Mbrojtjes me shkresën me nr.690, datë 30.03.2022 pasi janë konfirmuar me Nr.2213, 2214 Prot., datë 30.03.2022 nga Dega e Thesarit të Rrethit Tirane.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Formati 12 "Pyetësor dhe shenime shpjeguese" dhe relacioni shpjegues per pasqyrat financiare, në të dy bilancet Ministrisë së Shendetesisë dhe Mbrojtjes Sociale me kod buxheti "13" dhe Ministrisë se Mbrojtjes me kod buxheti "17" është plotësuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe të qartë të pasqyrave financiare.
Rekomandimi 9.1: Nga Sektori i Financës të merren masa që në vijimësi, pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati Nr. 12), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standartet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshëm të raportimit financiar të njësisë.
Në vijimësi.
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nga Sektori i Financës është plotesuar pyetesori me shënimet shpjeguese formati nr.12, pjesë e bilancit të konsoliduar nr.689 dhe 690 prot., date 30.03.2022 i Pasqyrave Financiare Vjetore, dhe është në përputhje me standartet kontabël kombëtare.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

10. Gjetje nga auditimi: Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes nuk pasqyrohet në llogarine 12, rezultat i mbartur nga viti i kaluar. Në këtë zë të pasqyrës së pasivit nuk është pasqyruar rezultati i mbartur për të bërë krahasimin ndermjet gjëndjes në celje të tij, shtesën pergjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale ne kundershtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e Përgatitjes, paraqitjes së

pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", aneksi 1, analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik. Ne pasiv është pasqyruar vetëm llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit sipastë cilës pasqyrohet në vlerën - 1,402,928 lekë për Bilancin Kontabel të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në vlerën 10,865,810 lekë për Bilancin Kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes, si pasojë e diferencës ndermjet të ardhurave dhe shpenzimeve korente. Nga lëvizja e pasqyruar në pasqyrën e lëvizjes së fondeve, veprimet e rregullimit të kësaj logarie janë ato të mbylljes së rezultatit të ushtrimit të vitit të kaluar dhe ato të njohjes së rezultatit të ketij viti.

Rekomandimi 10.1: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pasqyrat financiare të pergatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabel kombëtare duke pasqyruar në pasivin e bilancit rezultat i mbartur nga viti i kaluar "Llogaria 12", për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në celje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale. ***Në vijimësi.***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Sektori i financës ka marrë masa duke hartuar pasqyrat financiare vjetore të SUT në përputhje me standartet kontabël kombëtare, duke pasqyruar në pasivin e bilancit viti 2021 rezultatin e mbartur nga viti i kaluar "Llogaria 12" Rezultati i mbartur në vlerën 2,671,038 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

11. Gjetje nga auditimi: Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk është evidentuar shuma e ndalesave të tjera të mbajtura nga paga në shumën 23,000 lekë, si të pagueshme nga të tretët dhe që janë mbajtur nga paga, që për efekt raportimi duhet të dalin si llogari më vete të detyrimit në fund të periudhës, cka ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Financës. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Aneksi 1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik "Llogaritë e personelit, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe llogaritë e tatimeve e taksave me shtetin (42 e 43)" .

Rekomandimi 11.1: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabel kombëtare, duke evidentuar shumat e mbajtura nga paga si të pagueshme nga të tretët, dhe të dalin si llogari më vete të detyrimit në fund të periudhës, për efekt raportimi. ***Në vijimësi.***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga sektori i finances pasqyrat financiare vjetore janë përgatitur në përputhje me standartet kontabël kombëtare duke evidentuar shumat e mbajtura nga paga si llogari më vete nr.468 "Debitorë të ndryshëm" në vlerën të detyrimit në fund të periudhës 2,444,384 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

12. Gjetje nga auditimi: Në 7 procedura prokurimi për vlerën 522,153 mijë lekë, perllogarita e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në cmimet e tregut, por nuk është dhëne asnjë argumentim përse nuk i është referuar edhe alternativave të tjera, si cmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe cmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si per shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12 2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Rekomandimi 12.1: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përllogaritja e vleres se kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si një operacion mjaft i vështirë dhe në të njejten kohë mjaft i rëndesishëm, per shkak se zbatimi i procedurave të perzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatesisht nga përcaktimi i kesaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikerisht për këtë arsye, duhet zbatuar me rigorozitet legjislacioni i posacëm per ketë procedurë specifike, kjo edhe për të menjanuar shmangien nga rregullat e prokurimit nepermjet ndarjes apo pjesetimit të vleres së kontratave te prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhëri nr. 65/2 Prot., datë 09.07.2021 për përllogaritjen e fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje aparat anestezie për SUT";

-Kërkesë për dhënie cmimi tre OE - 6 fletë

- Ofertat e tre OE - 3 fletë

-Argumentimi i fondit limit - 3 fletë

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

13. Gjetje nga auditimi: Për 8 procedura prokurimi për vlerën 548,163 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e vecanta për kualifikimin nuk është dhenë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2.

Rekomandimi 13.1: Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të vecanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kritereve, duke parandaluar në këtë menyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që regullon prokurimin publik. ***Menjëherë dhe në vijimësi.***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Në procedurën e prokurimit me objekt "Trajtimi i mbetjeve spitalore per SUT" me nr. REF-21773-03-10-2022 është publikuar procesverbali i hartimit të kritereve të kualifikimit bashkë me dokumentet e tenderit.

Proces verbali argumenton teknikisht dhe ligjërisht vendosjen e cdo kriterei sipas LPP dhe kërkesave të SUT sipas procedurave të zhvilluara nga vetë AK dhe Institucione të tjera në RSH. Bashkangjitur këtij relacioni dhe një kopje e procesverbait tip (sipas formatit të kërkuar nga APP) në 7 fletë.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

14. Gjetje nga auditimi: Në 4 procedura prokurimi për vlerën 428,225 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomk nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin pubhik", i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit', i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligjin nr. 44 2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" nenet 108-118.

Rekomandimi 14.1: Nga Institucioni ti kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe

administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rendësi kapitale.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Në procedurën e prokurimit me objekt "Trajtimi i mbetjeve spitalore për SUT" me nr. REF-21773-03-10-2022 është dokumentuar i gjithë procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga ana e KVO sipas LPP dhe rekomandimeve të APP-së.

-Bashkangjitur këtij relacioni dhe një kopje e dokumentacionit të dosjes si më poshtë:

1. Procesverbal për hapjen e ofertave – 1 fletë;
3. Procesverbal për marje në dorëzim të mostrave – 4 fletë;
4. Procesverbal konstatimi- 2 fletë;
5. Kërkesë për paraqitjen e sigurimit të kontratës dhe dokumentacionit – 1 fletë;
6. Raport përmbledhës – 19 fletë;
7. Raport nga SPE – 14 fletë;

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

15. Gjetje nga auditimi: Për 8 procedura prokurimi për vlerën 557,425 mijë lekë lidhja e kontratave është realizuar mbi bazën e marrëveshjeve kuader, e cila pavarësisht se ka ndikuar në uljen e cmimit për njësi, por si shpenzim ka shkuar tek fondi limit, duke rritur numrin e pjesëve/njësive dhe në rastet e audituara asnjeherë uljen e numrit të pjesëve/njësive si dhe pakësimin jo vetëm të fondit limit por edhe as të vleres së prokuruar, dhe mbart në të ardhmen riskun e lart të përzgjedhjes së pjesëve/njësive me vlerë më të lart, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen e kostove të blerjeve/shërbimeve. Veprime në kundershtim me Udhëzim e APP nr. 6, datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3.

Rekomandimi 15.1: Lidhja e kontratave mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, duhet konsideruar si rast i vecantë dhe Autoriteti Kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me perdorimin e këtij instrumenti, me qellim shtrembërimin e konkurrences. Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrijë reduktimin e kostove transaksionale, permirësimin e vazhdueshem në harkun e marrëdhenieve afat-gjatë ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomik, në interes te konsumatoriit, në rastin konkret përmiresimin e sherbimit të pacientit ne spital.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Në procedurën e prokurimit me objekt "Kryerja e shërbimit të mirëmbajtjës së ashensorve në SUT" me nr. REF-89324-03-08-2021 është nënshkruar Marrveshja Kuadër me nr. 11/14 Prot., datë 16.04.2021 me fond limit të marrveshjes 2,071,650 (Dy milion e shtatedhjete e nje mije e gjashteqind e pesedhjete) Leke pa TVSH.

Grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave ka monitoruar 2 kontrata shërbimi të nënshkruara me OE fitues.

Vlera e këtyre kontratave të realizuara është më e ulët se fondi limit i Marrveshjes kuadër dhe përgjegjësit për prokurim kanë arkivuar dosjen e prokurimit.\Bashkangjitur këtij relacioni do të jenë dhe dokumentat provues si më poshtë:

1. Marrveshja kuadër – 7 fletë
2. Kontrata nr. 1 e shërbimit- 10 fletë
3. Kontrata nr. 2 e shërbimit - 10 fletë

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

16. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës "Blerje aparat radiografie me krah C" në vlerën 16,667 mijë lekë, viti 2020, pajisja nuk shoqërohet me etiketën e përkthyer në gjuhën shqipe, veprim në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 89 2014 "Për pajisjet mjekësore", i ndryshuar.
Rekomandimi 16.1: Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Pergjegjes per zbatimin e rekomandimit eshte caktuar Sektori i Prokurimeve Nga sektori i prokurimeve është reflektuar gjatë procedurave të prokurimit të sipërcituara, mbas auditimit nga KLSH-ja.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

17. Gjetje nga auditimi: Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020 "Për dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19", edhe pse i referohet pikave nr. 1 dhe 2 të VKM nr. 207/2020, është në kundërshtim me këto pika pasi në mënyrë eksplicite: Në pikën 1 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se "Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19". Në pikën 2 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se: "Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 65,000 lekë, për personelin mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19". Në pikën 6 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se "Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi". Së dyti. Që nga marsi 2020 që ka dal VKM nr. 207/2020, ky urdhër është dërguar nga Ministria e Mbrojtjes me nr. 7035/1 prot., datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020, pra 9-muaj me vonesë, duke krijuar një situatë të pa qartë për administraten e SUT, për shperblimin e mjekëve, pasi mjekët e të njëjtit spital për vonesën 9-muaj të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes, janë vënë në një standard të dyfishtë, mjekët civil të shpërblehen, ndërsa ushtarakët jo.
Rekomandimi 17.1: Nga Drejtor i Spitalit ti behet prezent Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, problematika e krijuar në SUT referuar Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020 "Për dhenien e shperblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19", me qellim marrjen e masave për korigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të ardhmen persëritjen e rasteve të tilla.

Brënda datës 30.11.2021.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nga sektori i *Finances* jane likujduar te gjithe personat e paraqitur ne listat e miratuara sipas urdherit te MM nr 1643 date 24.12.2020 "Per dhenien e shperblimit dhe miratimin e listes emerore te perfituesve, perfshire ditet e angazhimit dhe diagnostikimin trajtimin e personave te prekur me COVID-19"

Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

18. Gjetje nga auditimi: Me e-mailin e datës 24.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dërgohet urdhri i kesaj Ministrie nr. 196, datë 24 03 2020, për marrjen në dorëzim referuar kontratës të lidhur datë 18.03.2020 ndërmjet MSHMS dhe Bashkimit të Operatorëve Shoqëria "E." & Shoqëria "F. N. A.", Shpk, për blerje materiale dhe mbrojtje personale (MMP) për Covid-19, me vlerë 346,105,800 lekë. Shuma e barnave dhe pajisjeve mjekësore të ardhura në zbatim të kontratës së mësipërme është në vlerën 38,446,975 lekë. Të gjitha barnat dhe pajisjet mjekësore të furnizuara sipas kësaj kontrate nuk janë të shoqëruara me deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, veprim në kundershtim me nenin 4 kontratës ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Mallrat, të cilat do të furnizohen nga kontraktuesi, do të kenë specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit, formular të deklaratës mbi origjinën e mallit dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike". Për zbatimin e kësaj kontrate në farmaci më datën 04.03.2021, u krye verifikimi kontabël dhe fizik ku rezultuan gjendje katër artikuj, konkretisht: Cizme plastike mbrojtëse palë. 10 x 2160 lekë = 17280, disifektant steril flakon 14 x 556 = 7,7784, ekran mbrojtës copë 1517 x 415= 630,005 lekë dhe syze copë 2342 x 556 =1,302,090 lekë. U verifikua skadenca dhe specifikimet teknike të katër artikujve dhe u konstatua se artikulli cizme plastike mbrojtëse, me datë skadence të vendosur 31.01.2025 nuk është i saktë, pasi jo vetëm nuk ishte përfshirë në deklaratën mbi origjinën e mallit dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, por nuk kishte asnjë dokument provues për këtë datë skadence, si dhe nuk ishte në listën e artikujve të përcaktuar në kontratë.
Rekomandimi 18.1: Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës datë 18.03.2020 ndërmjet MSHMS dhe Bashkimit të operatorëve Shoqëria "E." & Shoqëria "F. N. A.", Shpk, për barnat dhe pajisjet mjekësore për Covid-19, është e domosdoshme marrja e masave urgjente për korrigjimin e kësaj praktike, por edhe per të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla. ***Menjëherë dhe në vijimësi.***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Blerje e materialeve mjeksore, fatura nr.604/2022, datë 02.06.2022.
-Kontrata nr.32/56 prot., datë 31.03.2022 furnizim mallra, sipas Marrëveshjes Kuadër Nr.511/20 Prot., datë 24.04.2020.
-Procesverbal datë 02.06.2022 i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit, i mbajtur nga grupi i punës.
-Fletë Hyrje nr.1415, datë 02.06.2022, e printuar nga platforma elektronike SIIS dhe e firmosur dhe vulosur nga Shefi i Shërbimi i Farmacisë, etj.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

19. Titulli i Gjetjes: Procedura e prokurimit "Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUT", eshtë zhvilluar në tetor të vitit 2018. Rikonstruksioni është bërë për arsye të amortizimit të madh të ambienteve të godinës së pavionit të këmbës diabetike. Fondi limit është përllogaritur me vlerë 66,125,510.8 lekë. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 9 OE, nga të cilët janë skualifikuar 4, Kontrata e rikonstruksiont është perfunduar dhe punimet janë marrë në dorëzim të përkohshëm me datë 17.09.2019. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se fond: limit është përllogaritur gabim, pasi nga vlera pa TVSH është nxjerrë nga shuma totale me TVSH, pjesetuar me 1.2, ndërkohë që një veprim t tillë ka ndikuar në pjesën e makineri pajisje të cilat nuk i nënshtrohen TVSH. Nga përllogaritja rezulton se fondi limit duhet të ishte me vlerë 56,749,042 lekë. Nga verifikimi i analizave të cmimeve të pergatitura per llogaritjen e fondit limit, rezulton se ka gabime

aritmetike për disa zera punimesh, konkretisht furnizim vendosje kondicioner'. Për shpenzime të parashikuara në masen 1 %, vlera e përfshirë i përket masës 10 %. Po ashtu per zërin M-1.33, sipas preventivit, cmimi është 788,088 leke per copë, ndërsa pas korrektimit cmuimt rezulton 98,081 leke për copë. Pas korrektumit të gabimeve në zerat e preventivit nga M-1.27 den M-1.37, rezulton se është përfshire në mënyre te pa argumentuar vlera 1,505,520 lekë. Kësaj shume i shtohet pjesa respektive e fondit rezerve 2,305,303 leke (2,195 527 lekë x 5 %). Veprim në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të cmimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika 2 dhe 11.
Rekomandimi 19.1: SUT të marrë masa që të verifikojë preventivat e paraqitura nga shoqëritë konsulente të përzgjedhura për realizimin e projekt preventivave, si në fazën e marrjes në dorëzim të shërbimeve konsulente, ashtu edhe në kuadër të përllogaritjes së fondit limit, me synim shmangien e gabimeve që shkaktojnë blerjen e shërbimeve, mallrave apo punimeve me cmime më të larta se ato të tregut, apo të përcaktuara në aktet ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Pësa më sipër, janë ngarkuar të marrin masat sektori i prokurimeve dhe inxhinierja e SUT, që për procedurat e prokurimit në kontratat e punës, në vazhdimësi (nga muaji Tetor 2021 e në vazhdim) të kenë parasysh që çdo çmim në preventivat e paraqitura nga OE e kontraktuar të jenë të argumentuara sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve/normativave ligjore në vazhdimësi.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

20. Gjetje nga auditimi: Në procesin e vlerësimit të ofertave në procedurën e prokurimit "Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, KVO ka kualifikuar OE "4 ." edhe pse një anëtar i komisionit ka kundërshtuar me argumentimin: "Oferta është e gabuar, pasi është bërë përllogaritja duke u nisur nga vlera totale me TVSH dhe e gjitha kjo është pjesëtuar me 1.2 dhe ka dalë vlera e ofertës pa TVSH. Kjo ofertë nuk është e saktë, pasi seksioni D "Pajisje dhe makineri" është pa TVSH". Ky argumentim është bërë për gjithë OE pjesëmarrës në tender. KPP është vënë në dijeni të një gabimi të tillë nepërmjet Informacionit të AK nr. 2414/1 prot, datë 07.11.2018. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, neni 24, pika 1ç., si dhe me Dokumentet Standarde të Tenderit, pika 3.2 "Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra".
Rekomandimi 20.1: SUT të marrë masa për rritjen e kontrollit të procedurave të auditimit të cilat rezultojnë me mangësi të dukshme dhe të identifikuara, si nëpërmjet strukturave të auditimit të brendshëm, ashtu dhe në shqyrtimin me pergjegjshmeri të raportit të vlerësimit të ofertave dhe ankesave që paraqiten. ***Menjëherë dhe në vijimësi.***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Nga Sektori i Auditimit jane mare masa qe ne planifikimin vjetor te vitit 2022 te kryhen auditime me te shpeshta per kontrollin e procedurave te prokurimit te cilat pasqyrohen ne programin vjetor te miratuar nr. 2282/3, date 26.10.2021.
Eshte hartuar programi i angazhimit nr. 1319/2 datë 20.06.2022 "Auditimi i sektorit te prokurimit dhe sektorit te sherbimeve te brendshme ne SUT" per periudhen Prill 2021 deri ne Maj 2022, ku perfshihen edhe rekomandi3838met e lena nga KLSH-ja, jemi ne proces auditimi.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.
21. Gjetje nga auditimi: Kontrata e sherbimeve konsulente "Pergatitje e projekt preventivit për rikonstruksionin e godinës trekatëshe dhe ndërtimin e urës lidhëse me korpusin qendror", është nënshkruar me nr. 54/16 prot., date 14.12.2020, me BOE "C. C." dhe "C. G.", me vlerë 14,743,800 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria konsulente,

rezulton se në preventivin e paraqitur i cili është bazë per fondin limit në procedurën që do zhvillohet për realizimin e punimeve, u konstatuan mangesi ne lidhje me referencat e cmimeve, duke e rritur atë në mënyrë te pa argumentuar si me poshte:
Për lot 1, sipas Zerit A.5.5 "Shtresë termoizoluese me polisterol t=10 cm", është aplikuar cmimi 2,658 lekë për m2, per sasinë 1090 m2. Për këtë ze punimi, referenca është marrë sipas analizes së cmimeve 2. 239/a. Kjo analizë cmimi është hartuar me gabime sa i takon sasisë se polisterolit që do të vendoset për njësine m2. Ne analizë eshte percaktuar sasia e polisterolit në masën 0.8 m3, ndërkohë që trashësia 10 cm i perket sasise 0.1 m3. Nga ribërja e llogaritjeve për sasinë 0,1 m3, rezulton se cmimi per njesi duhet te jetë ne shumën 511 lekë per m2. Per këtë ze punimi është parashikuar më shume vlera 2,340,230 leke [1090 m? x (2,658 leke/m3 — 511 lekë/m2)], vlerë e cila konsiderohet si e pa argumentuar në perllogantjen e fondit limit.
-Sipas zërit C.3.4 "F.V beton C 25/30, per soleten kompozite me h=14 cm, është aplikuar cmimi 15,615 lekë për m3, per sasinë 135 m2. Analiza e cmimit per këtë zë punimi, është përllogaritur per njesine m2, me cmim 1,173 leke për m2, nderkohë qe ne preventiv eshtë paraqitur cmimi 15,615 lekë për m3, pra është ndryshuar njësia nga m2 në m3. Nga ribërja e llogaritjeve rezulton se cmimi i duhur është 15,038 lekë/m2. Per këtë zë punimi është parashikuar më shumë vlera 77,895 lekë [135 m2 x (15,615 lekë m2 - 15,038 lekë m2), vlerë e cila konsiderohet si e pa argumentuar në përllogaritjen e fondit limit.
Për lot nr. 2 "Ndërtimi i depos së ujit të Spitalit Universitar të Traumës".
Sipas zërit të preventivit 1.22 "Shtresë termoizoluese me polisterol t=10 cm", është parashikuar sasia 85 m2. Për këtë zë punimi, referenca është marrë sipas analizës së cmimeve 2. 239 a. Për këtë ze punimi është parashikuar më shumë vlera 182.492 lekë [85 m2 x (2,658 lekë/m2 - 511 lekë/m2)]. VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të cmimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika 2 dhe 11.
Rekomandimi 21.1: SUT të marrë masa për analizimin e aplikimit të cmimeve të preventivave si në kuadrin e marrjes në dorëzim të shërbimeve konsulente, ashtu dhe në kuadër të hartimit të fondit limit, ku për referencë merret viera e preventivit e hartuar nga konsulentë të përzgjedhur.

Në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Ngarkohet për zbatim Inxhinieri i Ndërtimit dhe Sektori i Prokurimeve.
Për sa më lartë, sektori i prokurimeve (përgjegjësit për prokurim) dhe inxhinierja e SUT kanë marë masat që në procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në vazhdimësi të kenë parasysh që cdo çmim në preventivat e paraqitura nga OE e kontraktuar të jenë të argumentuara sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve/normativave ligjore në vazhdimësi.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.
Rekomandimi 21.2: Gjatë zbatimit të kontratës së punimeve civile, të kërkohet reflektimi i saktesisë faktike të polisterolit që vendoset në vepër, duke reflektuar cmimin e polisterolit, në mënyrë që të shmanget gabimi në analizën e cmimit në manualet e cmimeve të ndërtimit të miratuara në vitin 2015. Gjatë zbatimit të kontratës.
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Për sa më lartë,nuk kemi një procedure të re prokurimi pune, sektori i prokurimeve (përgjegjësit për prokurim) dhe inxhinierja e SUT kanë marë masat që në procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në vazhdimësi të kenë parasysh që çdo çmim në preventivat e paraqitura nga OE e kontraktuar të jenë të argumentuara sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve/normativave ligjore në vazhdimësi.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

22. Gjetje nga auditimit: Nga ana e SUT janë nënshkruar disa kontrata për dhënie me qira të aseteve në administrim. Nga ana e komisioneve të monitorimit, nuk është bërë monitorimi specifik në lidhje me destinacionin e përdorimit të pronës. Në ambientet e SUT të marra me qira nga një shoqëri, ushtrojnë aktivitet biznesi edhe subjekte të tjera të nën kontraktuara nga qiramarrësi, aktivitete për të cilat nuk ka miratim nga SUT, si dhe nuk i përkasin destinacionit për të cilin është nënshkruar kontrata e qirasë. Dhënia e ambienteve nga ana e qiramarrësit me nën qira pa miratim, si dhe për objekt veprimtarie që nuk ka lidhje me shëndetësinë, bie në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.04.2014 "Për percaktimin e kritereve, të procedurës e mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, Sek. VI, Pika 6. 2. (c, ç, d, dh), Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 13, datë 26.04.2018, si dhe Kontratën e Qirasë, pika 6.7.

Rekomandimi 22.1: SUT të marrë masa për ndjekjen e procedurave për shlyerjen e detyrimeve shoqëruar me kamatë vonesat perkatëse ndaj qiramarrësve të aseteve ne administrim. Kontraktorëve t'u kërkohet që të zhvilloje aktivitete sipas përcaktimeve në marrëveshje, duke mos lejuar ushtrimin e aktiviteteve tregtare që nuk ka lidhje me fushën e operimit.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Pergjegjes per zbatimin e rekomandimit eshte caktuar per zbatim Grupi i monitorimit të kontratave te qirase.

Deri ne momentin e verifikimit rezulton se SUT-ja eshte ne proces gjyqesor ndaj qeramaresve të asateve ne administrim (Spitali Amerikan)

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është në proces.

23. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018 Titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk ka ngritur në fillim të vitit kalendank 2018 komisionin për prokurimet me vlere të vogel, por ky komision është ngritur rast pas rasti për cdo procedurë specifike të prokurimi me vlerë të vogel. Mos ngritja në fillim të vitit kalendarik 2018, e komisiomit të prokurimit me vlerë të vogel ka lënë pa informacion APP - në per personat e ngarkuar fillimisht, me administrimin e procedurave të prokurimeve me vlerë të vogel, veprim në kundërshtm me Udhëzimin APP, nr. 3 datë 08.01.2018 "Mbi pëerdorimin e procedures së prokurimit me vlerë të vogel dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, pika 2.

Rekomandimi 23.1: Nga SUT-ja te meren masa qe ne fillim te cdo viti te ngreje komisionin per prokurimet me vlere te vogel. ***Menjehere dhe ne vazhdimesi***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Me Urdhërin Nr. 1/1 Prot., datë 14.01.2022, është ngritur komisioni i blerjeve me vlerë të vogël;

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

24. Gjetje nga auditimi: Raportet e monitorimit të buxhetit të vitit 2018, referuar shkresave nr. 1911 prot, datë 27.09.2018, nr. 1954 prot. datë 02.10.2018, nr. 834 prot., datë 25.03.2019, nr. 833 prot., datë 25.03.2019, kanë përcjellë tek MM dhe FSDKSH, një relacion jo të plotë, me mangësitë si më poshtë:

-Paraqitja e informacionit: "Relacion për monitorimin e buxhetit të SUT të 4 mujorit...." është bërë pa plotësimin e një liste përmbajtjeje të raportit të monitorimit;

-Mungon "Hyrja" ku jepet një përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit;

-Të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit nuk janë në përputhje me formatet e përcaktuara dhe specifikisht:

-Aneksi nr. 1, “Raporti i shpenzimeve sipas Programeve” mungon, dhe paraqitet versioni i vjetër, Format nr.7;
-Aneksi nr. 2. “Raporti i shpenzimeve të Programit sipas Artikujve buxhetorë” mungon, por paraqitet versioni i vjetër, Formati nr. 6;
-Aneksi or. 3, "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve të programit" mungon, etj.
-Relacionet e monitorimit dhe zbatimit të buxhetit për vitin 2018, nuk kanë analizë të produkteve, shumë nga produktet identifikohen me projektet e investimeve dhe raportohen këto të fundit si produkte, me arsyen se PBA për programin ““‘Mbështetja për Shëndetësinë” nuk është tajtuar në nivel objektivi, treguesish performance dhe produkteve të tyre, në mënyrë që të interpretohet në relacion mbi bazën e këtij standardi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Kreun IV, paragrafi 49.
Rekomandimi 24.1: Menaxhmenti i SUT duhet të sigurojë administrim të mirë, të forcojë kontrollet në monitorimin e buxhetit, si dhe të marrë masa që raportet e monitorimit të buxhetit të jenë të përpiluara me përfshirjen e të gjitha standarteve, si ato të formës, ashtu dhe ato të përmbajtjes, duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen**.** ***Në vijimësi.***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Përgjegjës për zbatim të këtij rekomandimi janë caktuar, Sektori i Financës Sektori i Planit dhe Sektori i Auditimit.
Auditimi është kryer nga njesia e AB ne SUT, sipas programit të miratuar nr.20/1 datë 15.02.2022 “Per ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së me shkresën nr. 130/1 date 14.10.2021.”
Nga auditimi, raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2021 janë përcjellë tek MM dhe FSDKSH si më poshtë:
1-Dërgim i raportit të monitorimitte buxhetit për vitin 2021 me nr 407 prot., datë 22.02.2022;
2-Aneksi nr 1 “Raportimi i shpenzimeve sipas programeve” sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimitte buxhetit për njësitë e qeverisjes qëndrore”
- Aneksi nr 2 “Raportimi i përmbledhes i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit” sipas udhëzimit nr.22 datë 17.11.2016 të MF “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njesite e qeverisjes qëndrore”
- Aneksi nr 3 “Raportimi i shpenzimeve te programeve sipas artikujve buxhetore”sipas udhezimit te ministries se financave nr 22 date 17.11.2016 “Per procedurat standarte te monitorimitte buxhetit per njesite e qeverisjes qendrore”
- Aneksi nr 4 “Raportimi i realizimit të objektivavete politikës së programit” sipas udhezimit te ministries se financave nr 22 date 17.11.2016“Per procedurat standarte te monitorimitte buxhetit per njesite e qeverisjes qendrore”
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

25. Gjetje nga auditimi: Raportet vjetor të monitorimit të buxhetit për 2018, referuar shkresave nr. 834 prot. dhe nr. 833 prot., janë përcjellë pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Kombetar Shëndetësor me vonesë, më datë 25.03.2019. Vonesa e dërgimit të raportit të monitorimit të buxhetit ndikon në proceset e vlerësimit e ecurisë financiare të institucionit dhe zbatimit të buxheteve të akorduara nga dy institucionet, ndaj të cilave SUT ka varësi buxhetore. Kjo vonesë është në shkelje të Udhezimit te Ministrise së Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Per procedurat standarde të zbatimit te buxhetit”, Kreu V1, paragrafi 270. **Rekomandimi 25.1:** Spitali Universitar i Traumës të marrë masa që raportet e

monitorimit të buxhetit te jene te perpiluara dhe dërguara në kohë tek dy institucionet ndaj të cilave SUT ka varësi buxhetore.

Në vijimësi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Pergjegjes per zbatim te ketij rekomandimi jane caktuar, Sektori i Finances Sektori i Planit dhe Sektori i Auditimit.

Nga auditimi rezultoi se raportet e monitorimit të buxhetit janë derguar në kohë tek dy institucionet ndaj te cilave SUT-ja ka varësi buxhetore, në zbatim të udhëzimit nr 9, datë 20.03.2018 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit" Ku thuhet:Nëpunesit autorizues të njësive të qeverisjes qëndrore, duhet të paraqesin raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues, deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katërmujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare, pas rakordimeve me Ministrinë përgjegjëse për Financat.

Duke u nisur nga kjo pikë u verifikuan afatet e dërgimit të Monitorimit të Buxhetit për vitin 2021 të cilat rezultonin: për MM nr 407 prot., datë 22.02.2022 dhe për FSDKSK nr 407/1 prot., datë 22.02.2022

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

26. Gjetje nga auditimi: Gjatë gjithë procesit të monitorimit të buxhetit nga njësia shpenzuese SUT, përkatësisht: të vitit 2018, të vitit 2019, të vitit 2020, paraqitja e informacionit, si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit të buxhetit për këto vite, me burim financimi nga FSDKSH, nuk ka qenë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin Nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", meqë tabelat financiare nuk janë ato të formateve të percaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi. Arsyet që kushtëzojnë një raportim jo të plotë, lidhur me zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, me burim financimi nga FSDKSH, sipas SUT - së, lidhen me këto argumente:

Në rastin e marrëdhënies buxhetore mes SUTsë dhe FSDKSH, nuk mund të flitet për një zbatim të mirëfilltë të një PBA je, me dy faza, sikurse realizohet në marredhënien buxhetore me Ministrinë e Mbrojtjes. Në marrëdhënien me FSDKSH realizohet zbatimi vetëm i Fazës së II i PBA-së, i cili bazohet në Shtojcën 7 A, që përmban në formatet e saj treguesit aktual të cdo viti, sipas artikujve buxhetorë përkatës dhe parashikim në një format të kërkesave për artikullin buxhetor 602. Nga FSDKSH, në lidhje me udhëzimet e PBA, shkresat vijnë për fazën e dytë, me kerkesën për plotësimin e Shtojcës 7A);

Nga ana e FSDKSH -së, njësisë shpenzuese SUT, nuk i dërgohen tavane buxhetore;

Nga ana tjetër, Shtojca 7-A nuk përmban formate në respektim të tavaneve në nivel qëllimi, objektivash, treguesish performance, produktesh, në mënyrë që të analizohet dhe raportohet cdo 4 muaj ecuria e treguesve, për buxhetin që i akordohet SUT — së, nga FSDKSH -ja, ndryshe nga si raportohet me raportet e zbatimit dhe monitorimit të buxhetit, me burim financimi nga MM; Kontratat e lidhura cdo vit, mes SUT dhe Drejtorisë së Sherbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor të FSDKSH, nuk referojnë në asnjë pikë apo paragraf, të dhëna mbi zbatimin dhe monitorimin e një PBA të mirefilltë, në rastin e buxhetimit nga FSDKSH, pavarësisht se SUT financohet nga MSHMS, me afro një vlerë fondesh që arrin në 30%, të fondeve të alokuara nga Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", Kreu IV, paragrafi 49

Rekomandimi 26.1: Spitali Universitar i Traumës të marrë masa dhe të bashkerendojë veprimet me Fondin e Sigurimit të Detyrueshem Kombetar Shendetësor dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në kërkim të një zgjidhjeje për plotësimin e formateve, për te

parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla. ***Menjëherë dhe në vijimësi.***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Pergjegjes per zbatim te ketij rekomandimi jane caktuar, Sektori i Finances Sektori i Planit dhe Sektori i Auditimit.

-E-mail date 15.08.2022 nga "Për parashikimin e pagave dhe sigurimeve dhe PBA për vitet 2023-2025 faza e dytë.

FSDKSH kërkon parashikimet buxhetore të PBA për SUT vetëm për fazëen e dytë të saj.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

27. Gjetje nga auditimi: Raportet e monitorimit të buxhetit, per periudhën objekt auditimi, janë afishuar, apo publikuar pjesërisht (vetem si Program "Mbështetje për Shendetësine"), në raportin financiar të MM-së, por nuk jane publikuar as në faqen Web të SUT, as integralisht në ndonjërën faqe të të dy ministrive, ndaj të cilave SUT ka varësi buxhetore.

Si i tillë keto raporte monitorimi janë të panjohur per të interesuarit dhe mospublikimi është në shkelje të parimit të transparences publike.

Veprim në kundershtrm me Udhezimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 "Per procedurat standarde të monitorimit te buxhetit per njesitë e qeverisjes qendrore", Kreu IV, neni 49.

Rekomandim 27.1: Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa që reportet e monitorimit te paraqiten në faqen zyrtare të institucionit, duke rritur kështu nivelin e transparencës dhe llogaridhënies si dhe duke nxitur debatin publik mbi menaxhimin e Institucionit. Kjo do të kontribuojë që grupet e interesit të monitorojnë më mirë zbatimin e planeve të Buxhetimit Afatmesëm me Bazë Performancën, apo orientimin e politikave në drejtim të objektivave strategjike të Sistemit Shëndetësor**.** ***Menjëherë dhe në vazhdimësi.***

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Pergjegjes per zbatim te ketij rekomandimi eshte caktuar Specialisti i Mardhenieve me Publikun

Nga verifikimi i grupit te auditimit u mor kontakt me Specialistin e Mardhenieve me Publikun dhe u verifikua se ishin paraqitur ne faqen zyrtare te institucionit raportet e monitorimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

28. Gjetje nga auditimi: Nuk funksionon sistemi i monotorimit për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nuk ka një procedure të shkruar për mënyrën e komunikimit brenda insutucionit dhe procedurat per qarkullimin e informacionit. Nuk ka procedurë të vecantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e tyre.

Nuk ka regjistra risku të hartuara specifikisht për cdo drejtori.

Nuk ka manuale të procedurave për aktivitetet operacionale dhe financiare të bazuara në harta dhe në procese pune dhe në procedurat e shkruara sipas formateve të ofruara nga manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe të miratuara nga nepunesi autorizues.

Rekomandim 28.1: Nga Drejtoria e SUT të merren masa për hartimin dhe menaxhimin e riskut për cdo drejtori, monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikim, kontrollin dhe reduktimin e risqeve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

Menjeherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga verifikimi i grupit te auditimit u mor kontakt me *menaxheret ku rezultoi se rregjistri i riskut per SUT-ne eshte hartuar ndersa per sektoret dhe pavionet e SUT-se eshte ne proces.*
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.
29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se SUT, nuk ka ngritur komisionin e ekspertizës, nuk ka aprovuar afatet e ruajtjes së dokumenteve, nuk ka kryer përpunimin tekmko-shkencor të dokumenteve të prapambetura, si përcaktimin e përkatësisë së fondit dhe klasifikimin e dokumenteve sipas fondit, nuk është kryer ekspertiza e vlerës së ruajtjes, nuk është kryer ruajtja e dokumenteve në përputhje me normativat, vecanërisht lidhur me temperaturën e ambjentit dhe lagështirën, në kundërshtim me nenin 5,6,8,9,10,11 të VKM nr 4, datë 19.06.2017 "Pë miratimin e e rregullores së njëhsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë.
Rekomandimi 29.1: Nga Drejtoria e SUT të merren masa përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të prapambetura dhe ruajtja e dokumenteve të bëhet në ambjente në përputhje me normativat e përcaktuara. ***Brenda datës 30.11.2021.***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Pergjegjes per zbatim te ketij rekomandimi eshte sekretaria e SUT-se.
Per zbatimin e rekomandimit eshte ngritur Grupi i ekspertizes.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces.

C. MASA PER SHPERBLIM DEMI

Rekomandimi: 1.1 SUT te kerkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallet e gjykimit, arkëtimin e vlerës 334,881 lekë nga Kontraktori "4." SHPK, perfituar si pasojë e referencave të gabuara në përcaktimin e cmimeve për zëra të rinj punimesh. ***Brenda datës 31.12.2021***
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Kontraktori, OE 4 . SHPK ka paguar vullnetarisht shumën në vlerën prej 334,881 lekë (pagesa datë 08.04.2022 Banka Kombëtare Tregtare , kodi thesarit 3535 në favor të SUT kthim shume)
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

Rekomandimi 2.1: SUT të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës së 3,536,421 lekë nga shoqëria "S. C." Shpk. Kjo vlerë ka të bëjë me mos zbatimin e specifikime teknike, pjesë e kontratave në marrëveshjen kuadër të lidhur me nr, 7/26 prot., datë 17.07.2020 "Per kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore".
Brenda datës 31.12.2021
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
-Çështja në proces gjyqësor, sipas Kërkesë Padisë nr.430 datë 23.02.2022 në Gjykatën Administrative Shkalla e Parw Tiranë;
-Autorizimi nr.428 prot., datë 23.02.2022;
-Prapësime në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë, datë 23.03.2022;
-Njoftimi Nr.2261 Akti, datë 06.07.2022 i Gjykatës për seancën e rradhës në datë 19.09.2022 ora 12:00.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është në proces

D. MASA DISIPLINORE

Sektori i Burimeve Njerëzore, duke zbatuar procedurat e Kodit të Punës (neni 37), në bazë dhe të kontratave individuale të punës, të japë masat disiplinore sipas rekomandimeve dhe për shkeljet e konstatuara nga Raporti Përfundimtar i KLSH si më poshtë:
- Vërejtje me me shkrim me paralajmërim për largim nga puna ose masa ekuivalente e saj e parashikuar ne kontraten individuale te punes:
V. S.
-Tërheqje vëmëndje ose masa ekuivalente e saj e parashikuar ne kontraten individuale te punes:

G. H.; G. P.; M. XH.; B. H.; M. S.; V.R.; M. P.; B. G.; B.V.; E. T.; E.XH.;
E.O.; B.P.; L.B.; I.P.; A.G.;
V.H.; D.LL.; S.K.;
Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit
Është mbajtur mbledhja me nr.71 Prot., datë 08.11.2021 në zbatim të Planit të Veprimit Nr.2207/2 datë 01.11.2021.
Në Procesverbalin nr.2207/4 Prot., datë 08.11.2021 janë komunikuar verbalisht nga Drejtoresha e SUT znj. E. B. masat disiplinore:
-Vërejtje me shkrim me paralajmërim për largim nga puna ose masa ekuivalente e saj për z. V.S.;
-Tërheqje vëmendje ose masa ekuivalente e saj për punonjësit e tjerë sipas rekomandimit KLSH.
Komenti i grupit të auditimit:
Ky rekomandim është zbatuar plotësisht.

UJËSJELLËS KANALIZME SHA KURBIN

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në UKK SHA mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:
- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", UKK, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 309 prot., datë 09.11.2021, UKK ka kthyer përgjigje duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

- -Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 539/7, datë 18.10.2021 dhe në UKK nr. prot. 309, datë 22.10.2021, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
b. Janë rekomanduar **27 masa organizative**;
c. Janë rekomanduar **0 masa për shpërblim dëmi në vlerën 0 lekë pa TVSH**;
d. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 0 lekë**;
e. Janë rekomanduar **0 masë në drejtim të të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi në vlerën 0 lekë**;
f. Janë rekomanduar **4 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit**;
e. Janë rekomanduar **8 masa disiplinore**;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	27	27	-	-
3	Shpërblim dëmi	-	-	-	-
4	Të ardhurave të munguara	-	-	-	-
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	-	-	-	-
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	4	4	-	-
7	Masa disiplinore	8	8	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e UKK

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	27	11	0	2	14
3	Shpërblim dëmi	0	0	0	0	0

4	Të ardhurave të munguara	0	0	0	0	0
5	Të ardhurave të munguara pa mundësi arkëtimi	0	0	0	0	0
6	Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit	4	2	0	1	1
7	Masa disiplinore	8	7	0	0	1

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT
Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT
Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI
Nga auditimi i zbatimit të rekomandimve rezulton se UKK nga 27 masa organizative ka pranuar 27 prej tyre ose 100% të masave dhe nga 27 masat e pranuara 11 janë zbatuar plotësisht ose 40.7% e masave të rekomanduara, janë 2 masa janë në proces zbatimi ose 7.4% e masave të rekomanduara dhe 14 masa nuk janë zbatuar ose 51.8% e masave të rekomanduara. Nga 4 masa

3-E, 2 janë zbatuar plotësisht ose 50% e masave të rekomanduara, 1 është në proces ose 25% e masave të rekomanduara dhe 1 nuk është zbatuar ose 25% e masave të rekomanduara.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 40.7%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", UKK, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 309 prot., datë 09.11.2021, UKK ka kthyer përgjigje duke respektuar afatin 20 ditor.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

- -Nga ana e subjektit të audituar është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, nuk ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

F. OPINIONI I AUDITIMIT

Për drejtimin e UKK.
Ne kemi audituar pasqyrat financiare të UKK, për vitin ushtrimor 2018-2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.
Opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje[27]**:**
Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të pamodifikuar për llogaritë vjetore të

[27] ***Opinioni i pamodifikuar*** *Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.*
Një opinion me "Theksim Çështjeje", jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

subjektit, UKK duke arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Theksimi i çështjeve:

- Ne duam të tërheqim vëmendjen e përdoruesve për disa çështje me gabimet materiale, por jo thelbësore të cilat ndikojnë në cilësinë e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare duke përfshirë dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe anomalitë e identifikuara në raportimin e pasqyrave financiare. Konkretisht:

- Përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomicitet në vlerën 7,367,468 lekë të cilat kanë ardhur si pasojë e keqmenaxhimit në mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit;

-Përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomicitet në vlerën **1.601.527 lekë** nga të cilat 1.240.727 lekë janë për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore dhe 360.800 lekë shpenzime gjyqësore dhe shpenzime për shërbim përmbarimor;

-Përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomicitet në vlerën **1.352.928 lekë** si gjoba nga pagesat dhe deklarimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe e tatimit për të ardhurat e punonjësve janë kryer vazhdimisht me vonesë;

-Për 4 prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën **420,941,416 lekë**, si rezultat i shpalljes fitues të BOE/OE të cilët nuk kanë plotësuar pjesërisht kriteret për kualifikim.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga UKK, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Nga auditimi mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla etj, u evidentuan raste si ai i shpenzimeve të karburantit, për të cilët grupi i auditimit është i pasigurt mbi materialitetin, pra nivelin real të konsumimit për realizimin e detyrave funksionale, por jo thelbësore për trajtimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të UKK:

Strukturat drejtuese të UKK, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike.

Strukturat drejtuese të UKK janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme , nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet

mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar, vërehen mangësi dhe devijime nga struktura dhe konkretisht janë evidentuar mungesa e juristit të institucionit, Drejtorit Teknik, tre faturistë të fshatrave; dhe gjashtë punëtorë, ka rezultuar se janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 punëtorë kolektori, 1 sanitare, 1 punëtor mirëmbajtje, 3 manovratorë saraçineskash, 2 elektropompist 1 Laç dhe 1 në Mamurras.
-Për vitin 2019, pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar, vërehen mangësi dhe devijime nga struktura dhe konkretisht janë evidentuar mungesa e Drejtorit Teknik; 3 faturistëve; 1 Përgjegjës Stacioni Pompe Laç, si dhe 7 punëtorëve, ka rezultuar se janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 hidraulik, 1 saldator, 1 sanitare, 1 punëtorë Kolektori, 4 Manovratorë dhe Klorifikues (nga 26 që duhet të jenë në fakt janë 31), 1 Elektropompist.
-Për vitin 2020, pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vërehen mangësi dhe devijime nga struktura dhe konkretisht janë evidentuar mungesa e Drejtorit Teknik, 1 Inxhinieri; 4 faturist; 1 përgjegjës stacion; 1 përgjegjës depo; 1 hidraulik dhe 1 elektropompist; ka rezultuar se janë emëruar jashtë strukturës së miratuar 4 punëtorë, 1 sanitare dhe 1 manovrator klorifikues *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 26-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Administratori i UK Kurbin të marrë masa për ri shqyrtimin e nevojave për pozicionet e shtuara në strukturë dhe propozimin e tyre për miratim pranë Këshillit Administrativ, duke shmangur emërimet e punonjësve në pozicione pune të pa miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 3, datë 02.09.2021 "Për disa ndryshime ne strukturën organizative nivelin e pagave të punojësve të shoqërisë SHA Ujësjellës Kanalizime Kurbin për vitin 2021", nuk janë shtuar vendet e punës por është vedosur edhe klauzola që pas daljes në pesnion vendet mos të plotësohen.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhjen 2 të nivelit të pagave të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 3, datë 23.01.2018 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të UKK, nuk pasqyrohet niveli i pagave për pozicionet arkiviste dhe arkëtare, pavarësisht se këto pozicione janë të miratuara në strukturë. Pagesa për këto 2 pozicione është bërë në nivelin e pagës së krye-arkëtares. Po kështu edhe për pozicionin e punëtorit të kolektorit nuk është përcaktuar niveli i pagës dhe pagesa për këtë pozicion është bërë në pagën minimale në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për

kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve" dhe neni 13, pika 1, e Statutit të Ujësjellës Kanalizime SHA Kurbin miratuar me Vendim nr. 2, datë 12.05.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 26-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli Administrativ i UK të marrin masa për shqyrtimin dhe miratimin e qartë të nivelit të pagave për çdo pozicion specifik në strukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 3, datë 02.09.2021 "Për disa ndryshime ne strukturën organizative nivelin e pagave të punojësve të shoqërisë SHA Ujësjellës Kanalizime Kurbin për vitin 2021" janë përcaktuar nivelet e pagave për çdo pozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Administratori i UKK ka lidhur Kontratë Pune me nr. 513, datë 03.10.2019, me znj. Sh. G., në pozicionin Mjeke e Përgjithshme, emërim i kryer pa procedurë rekrutimi dhe pa miratim të Këshillit Administrativ për përcaktimin e nivelit të pagës, veprime në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve" dhe neni 13, pika 1, të Statutit të UKK miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 2, datë 12.05.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 31-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Administratori i UK Kurbin të marrë masa për propozimin për miratim pranë Këshillit Administrativ të nevojës së punësimit të mjekut të ndërmarrjes dhe përcaktimin e nivelit të pagës, duke ndjekur të gjitha hapat e duhura për njoftimin dhe rekrutimin për këtë pozicion.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 4, datë 26.10.2021 të KD është miratuar në strukturë pozicioni i mjekut.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: i zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Në listë-pagesat dhe listë-prezencat e UKK, merret gjithmonë si referencë 21 ditë pune në muaj dhe jo 22 ditë. Ky veprim nuk ka efekt financiar gjatë përllogaritjes së pagës mujore me përjashtim kur pagesa për një punonjës nuk bëhet për ditët e plota të muajit (p.sh. punonjësi merr raport mjekësor, fillon punë në një ditë të caktuar të muajit, etj.) dhe si pasojë përpjesëtimi i ditëve të punës nuk bëhet i saktë, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore" i ndryshuar, kreu I, neni pikat 1-3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 33-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Sektori i Financës, të marrë masa që në përllogaritjen e pagave në rastet e mos pagesës së plotë mujore, të zbatojë përcaktimet ligjore për numrin mesatar të ditëve të punës prej 22 ditë. Ky përcaktim të zbatohet edhe nga personat përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e listë-prezencave pranë Sektorit të Financës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: U audituan me zgjedhje listë – pagesat e 2 muajve dhe rezulton se numeri mesatar i ditëve të punës është 22 ditë.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:i zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet që vjetërsia në punë është paguar vetëm për punonjësit të cilët janë me arsim të lartë në UKK, ndërsa punonjësit e tjerë nuk e kanë përfituar këtë të drejtë, në kundërshtim me nenin 6, pika 2, të Kodit të Punës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 33-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për përfshirjen e vjetërsisë për secilin punonjës në përllogaritjen e pagave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Për shkak të vështirësive financiare nuk paguahet.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Ngjarjet dhe veprimet ekonomike, si regjistrimet kontabël, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen manualisht, pasi institucioni nuk ka të instaluar një program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të saj, në kundërshtim me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 44-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandimi: Në mënyrë që të ruhet dhe garantohet siguria e informacioneve të saj, UKK të marrë masa për përdorimin e programeve financiare në mbajtjen dhe regjistrimin e veprimeve kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e pasqyrave financiare nuk përfshihet "Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave", duke mos paraqitur zyrtarisht informacionet mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave si numri mesatar i punonjësve, ndryshimin e këtij numri gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblimet e tjera, ndihmat shoqërore, kontributet për sigurimet dhe tatimet mbi të ardhurat personale, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 47-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandimi: Sektori i financave të marrë masa që në vijimësi pasqyrat financiare të hartohen në mënyrë të plotë, duke pasqyruar informacion mbi çdo element të aktivitetit të shoqërisë siç kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi.

Në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Formatet janë plotësuar në Bilancin e Vitit 2021
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Përgjatë të gjithë periudhës objekt auditimi rezulton se në grupet e punës të ngritura për inventarin e magazinës dhe aseteve të shoqërisë në fund të vitit, është pjesë edhe magazinieri i shoqërisë, në kundërshtim me paragrafin 99 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në NJSP", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: Administratori i UK të marrë masa që në të ardhmen të mos përfshijë në grupin e punës për procesin inventarizues magazinierin e shoqërisë i cili ka në ngarkim mallrat.

Në çdo proces inventarizues

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 42, datë 30.12.2021 "Për ngritjen e komisionit për invetarizimin faktik të materialeve të magazinës", nuk është përfshirë magazinieri. Me Urdhrin nr. 41, datë 30.12.2021 "Për ngritjen e komisionit për invetarizimin e mjeteve kryesore, ekonomik, transportit dhe të imët"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Për të tre vitet, nuk janë pasqyruar saktë vlerat sa i takon klientëve debitorë nga furnizimi me ujë dhe të ardhurat e arkëtuara si vijon:

Për vitin 2018
Zëri "Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit" (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 135.351.480 lekë, ndërkohë që rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë "Klientë debitor, familjar, privat, etj" paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 169.820.541 lekë.
UKK ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 44.588.799 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve rezulton se vlera e të ardhurave është 57.464.730 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Për vitin 2019
Zëri "Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit" (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 142.247.887 lekë, ndërkohë që rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë "Klientë debitor, familjar, privat, etj" paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 181.310.336 lekë.
UKK ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 42.396.568 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve rezulton se vlera e të ardhurave është 45.650.151 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Për vitin 2020
Zëri "Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit" (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 149.428.475 lekë, ndërkohë që rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë "Klientë debitor, familjar, privat, etj" paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 192.779.329 lekë.
UKK ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 38.809.129 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve rezulton se vlera e të ardhurave është 40.445.970 lekë.
Veprime këto në kundërshtim me pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Sektori i financës të marrë masa që në të ardhmen të rakordojë dhe pasqyrojë me vërtetësi dhe saktësi vlerat sipas të dhënave të gjeneruara nga sektorët dhe regjistrimet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Mos rakordimi midis sektorëve vijon.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Pazbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, në zërin "Toka dhe ndërtesa" në vlerën 27.240.574 lekë pasqyrohet vetëm vlera e ndërtesës, pasi UKK nuk ka të regjistruar në regjistrin e aseteve tokat në të cilat ushtron veprimtarinë e saj. Kjo situatë është trashëguar edhe në vitet në vijim. Në vitin 2018, UKK ka kryer me topografin e Bashkisë Kurbin matjet për stacionet e pompimit dhe rezervuarët, nga të cilat në ZVRPP përkatëse kanë rezultuar në pronë shtetërore. Në vijim janë ndjekur procedurat përkatëse për regjistrimin e tyre në pronësi të UKK, por deri në momentin e përfundimit të auditimit nuk është finalizuar ende ky proces, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". *Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli i Administrimit të shoqërisë të marrin masa për nxitjen e përshpejtimit të procesit të regjistrimit të pronave të UK Kurbin. Për këtë qëllim të kërkohet edhe angazhimi i aksionarit të vetëm të shoqërisë, Bashkisë Kurbin.

Menjëherë

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Në zërin detyrime afatshkurtra, UKK pasqyron edhe detyrimet e prapambetura që ka akumuluar nga mos likuidimi i energjisë elektrike që nga viti 2015, të cilat me përjashtim të atyre të periudhës ushtrimore duhej të kontabilizoheshin në zërin detyrime afatgjata, veprim në kundërshtim me SNK 1, paragrafi 69. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Në hartimin e pasqyrave financiare, **s**ektori i financës të marrë masa për sistemimin e llogarive të detyrimeve sipas periudhave të akumulimit të tyre dhe pasqyrimin e saktë të këtyre zërave në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Do të verifikohet në auditmin e rradhës.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

12. Gjetje nga auditimi: Nga organet drejtuese të UKK nuk është kryer asnjëherë analizë në lidhje me llogaritë debitore-kreditore, për të cilat rezulton se gjendja, evidentimi, ndjekja dhe arkëtimi paraqitet problematike, pasi nuk janë konsumuar të gjitha rrugët për vjeljen e tyre deri në ngritjen e padive në gjykatë për persona fizik apo juridik me detyrime të pashlyera. UKK nuk ka marrë masa as për analizimin dhe veçimin e vlerave të debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe zgjidhjen e kësaj situate. Në fund të vitit 2019, UKK nuk ka marrë masa për likuidimin e një pjese të detyrimeve edhe pse ka patur gjendje monetare në vlerën 7.277.546 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe neni 8 dhe 9 të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 50-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UKK të merret në analizë të vazhdueshme situata lidhur me gjendjen debitore dhe kreditore, të realizohet një plan konkret masash për të përmirësuar treguesit financiarë të shoqërisë, si dhe të merren masa për përcaktimin e kritereve të qarta në përzgjedhjen e debitorëve për dërgim në përmbarim për arkëtim të detyrueshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokument në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020 Administratori nuk ka marrë masa për ngritjen e grupit të inventarizimit dhe kryerjen e këtij procesi për aktivet e shoqërisë, në kundërshtim me pikën 80-101 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 51-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Shoqëria duhet të marrë masa për kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit për çdo vit për të gjitha aktivet që ka dispozicion duke krijuar komisionet përkatës për realizimin e këtij procesi.

Në mbyllje të çdo viti ushtrimor

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Për vitin 2021 komisionet janë ngritur por verifikimi për periudhat e arshme do të kryhet në auditimin e rradhës.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 dhe 2021 UKK, nuk ka hartuar apo miratuar programet ekonomiko-financiare vjetore dhe nuk ka reflektuar ndryshimet e tyre (sipas rasteve kur ka patur ndryshime), duke mos respektuar përcaktimet e ligjit nr. 9901,

datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të shkronjave "a" e "b", të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, për zbatimin e procedurave të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit. Shoqëria është mjaftuar vetëm me plan biznesin 5 vjeçar 2019-2024, dokument ky që nuk ka përfshirë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit, por vetëm për vitin 2019. Për këtë periudhë konstatohet se nga ana e Administratorit nuk është hartuar urdhri për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektprogrameve si dhe nuk janë dërguar, pranë Këshillit të Administrimit të UK Kurbin dhe Asamblesë Aksionare për miratim.

- Në programin ekonomiko financiar të vitit 2018 dhe plan biznesin 2019-2024 nuk janë përfshirë në këtë plan investimet e realizuara faktikisht, ku përmendim këtu projektin "Ndërtim i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit Laç", për shkak se këto dokumentacione nuk janë rishikuar në vijim për t'i shoqëruar ato me relacione shpjegues të faktorëve që nuk kanë mundësuar parashikimin e tyre në program sipas rastit, në mënyrë që të pasqyrohet domosdoshmëria e kryerjes investimeve të paparashikuara; tejkalimi i disa zërave të shpenzimeve në raport me shpenzimet e tjera.

Udhëzimi nr. 15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror" në kapitullin I të tij parashikon procesin e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik, detyrim ky i të gjitha shoqërive publike me kapital shtetëror për periudha 1 vjeçare, afatmesme dhe afatgjata. Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik duhet të mbështetet në objektivat e caktuara nga organet drejtuese dhe Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2019-2030 dhe 2020-2030 dhe të miratohen nga Asambleja Aksionare dhe Këshilli i Administrimit.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 9-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Administratori i UKK të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt programeve për çdo vit, dhe për t'ja dërguar ato Këshillit të Administrimit të UKK dhe Asamblesë Aksionare për miratim.

Në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

14.2. Rekomandimi: Grupet e punës për hartimin e planeve ekonomiko-financiare, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të shoqërisë, të marrin masa që në planin e biznesit 5 vjeçar të përfshijnë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit me qëllim përmirësimin e performancës dhe objektivave strategjik dhe vjetor të shoqërisë në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës – Kanalizime.

Në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Raportimi tek organet drejtuese mbi realizimin e treguesve të programit vjetor të zhvillimit ekonomik dhe financiar nuk është kryer në të gjitha rastet sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", neni 18 pika 7. Në ato raportime të kryera nga ana e Administratorit, jo në të gjitha rastet janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe në asnjë rast nuk rezulton të jenë përfshirë analiza krahasimore me planin financiar për periudhën respektive, shoqëruar me analiza për motivet e mos realizimit. Për vitin 2018 konstatohet se është kryer një raportim vetëm për vlerën totale të tyre, duke mos evidentuar realizimin sipas zërave. Gjithashtu, në raportimet e kryera, informacioni është bazuar vetëm në shpenzimet e kryera bazuar në të ardhurat e gjeneruara nga

vetë shoqëria, duke mos përfshirë në to informacion mbi subvencionet e përfituara, apo detyrimet e pa shlyera të njësisë. Në këto kushte nuk mundësohet monitorimi i realizimit të planit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 10-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Administratori i UKK të marrë masa për kryerjen e raportimeve mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar mujor dhe vjetor pranë Këshillit Administrativ me informacione të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, për të mundësuar analizimin e të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko-ekonomik të shoqërisë sipas planit dhe periudhave të mëparshme.

Brenda vitit 2021

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Financimi nga buxheti i shtetit, nga ana e UKK nuk rezulton të jenë përcjellë pranë institucioneve eprore projekt propozime për financim të investimeve, apo raportime të kryera si për detyrimet e prapambetura, si dhe për evidencat e shpenzimeve (rakordime periodike me thesarin) për pjesën e financimit nga buxheti i shtetit (kryesisht për investime).

-Drejtoria e Thesarit pranë MFE ka raportuar pagesa për detyrime të prapambetura nga UKK në vlerën 17,846 mijë lekë bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë si shuma të deklaruara "të paguara" gjatë vitit 2020, në zbatim të strategjisë në VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", kur nga ana e shoqërisë nuk rezulton të jetë kryer asnjë raportim lidhur me detyrimet e prapambetura pranë Bashkisë apo MIE; dhe në regjistrin e pagesave në SIFQ pagesat për detyrime të prapambetura nga UKK paraqiten në vlerën (zero). Për sa i përket stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura sipas të dhënave të Drejtorisë së Thesarit në MFE, dhe raportit vjetor për stokun e detyrimeve të prapambetura të hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, UKK në vitin 2019 rezulton ndër institucionet që deklarojnë detyrime të prapambetura, të cilat konkretisht konsistojnë në vlerën 13,986,204 lekë kur sipas pasqyrave financiare ato rezultojnë në vlerën 435,508,393 lekë dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 31,832,357 lekë në një kohë ku sipas pasqyrave financiare janë në vlerë 612,388,769 lekë, shifra këto të konsiderueshme krahasuar me buxhetin në dispozicion të kësaj shoqërie, të cilat sikundër vërehet paraqiten në rritje dhe nuk rezultojnë të bëhen pjesë e raportimeve periodike pranë KA, Asamblesë së Përgjithshme apo strukturave të tjera drejtuese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të UK Kurbin, duke përfshirë Administratorin, Këshillin e Administrimit, Asamblenë e Përgjithshme, etj të ngrenë grupe punë për analizimin e detyrimeve të prapambetura; përcjelljen e një informacioni të plotë të vlerës së tyre me qëllim raportimin real të tyre në raportin vjetor të hartuar nga MSHMS për stokun e detyrimeve të prapambetura, dhe hartimin e një plani veprimi dhe shlyerjeje për reduktimin e tyre.

Brenda vitit 2021

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit me përfitues UKK konstatohet se përgjatë vitit 2020 ka patur disa rishikime të fondeve buxhetore, konkretisht 4 rishikime për projekte që prekin investimet kapitale me një rritje të fondeve të këtyre projekteve me vlerë prej 52,776 mijë lekë. Sipas Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", pika 79: "*Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qëndrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit*", dhe në bazë të numrit të lartë të rishikimeve, referuar edhe vlerës totale të shpenzimeve të kryera në kuadër të investimeve kapitale të UKK, mund

të konkludojmë për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve për investime reflektuar edhe nga mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionin epror përgjatë procesit të planifikimit të buxhetit. Gjithashtu, nga kryqëzimi i të dhënave të kontratave të lidhura me përfitues UKK për vitin 2020, me PBA-në e institucioneve qendrore publikuara në ŵeb-in e MFE, u konstatuan 2 projekte me vlerë totale 12,276 mijë lekë, ku janë marrë angazhime për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA, pra plani i pagesave të kontratave për projekte investimesh në PBA e periudhës 2020-2022 për vitin 2020 nuk cilat kanë të përfshirë plan pagesash për këto projekte por përgjatë vitit janë rishikuar fondet për financimin e këtyre kontratave, veprim në kundërshtim me Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020", pika 19. e) e tij. Për rishikimet e kryera më sipër, nga ana e UK Kurbin nuk rezulton të jetë përcjellë asnjë kërkesë zyrtare pranë institucioneve eprore për kryerjen e këtyre ndryshimeve në buxhetet në dispozicion.

- Kontrata e investimit "Ndërtimi i rrjetit te jashtëm e te brendshëm ujësjellësit te qytetit Laç faza II" ka planifikuar kryerjen e shpenzimeve financuar nga buxheti i shtetit në kontratë (pa TVSH), si më poshtë:

Viti 2020 - 87 767 397 lekë; Viti 2021 - 70 000 000 lekë; Viti 2022 - 30 000 000 lekë

Pra në total sipas kontratës në vlerën 438,836 mijë lekë, në harkun 3 vjeçar janë planifikuar për t'u kryer pagesa në vlerë 187,767 mijë leke (ose 42%); dhe shuma e mbetur e financimit është përcaktuar në vitet ne vazhdim. Në kushtet kur faktikisht kontrata parashikon përfundimin e punimeve në harkun kohor 2 vjeçar, ky nivel planifikimi i fondeve i cili po kështu paraqitet edhe në planin buxhetor afatmesëm 3 vjeçar mund të bëhet shkak për krijimin në të ardhmen të detyrimeve të prapambetura. Për këtë projekt, me aktin normativ nr. 34, në datën 23 dhjetor është shtuar niveli i financimit edhe me 40,000,000 lekë, pra rreth 57% të planit të buxhetit që sipas PBA 2020-2022 ishte parashikuar për këtë kontratë në vitin 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 24-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për hartimin e projekt buxhetit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, në bashkëpunim me AKUK, të marrin masat për rritjen e bashkëpunimit gjatë procesit të planifikimit, dhe ekzekutimit të buxhetit duke bërë palë të këtij procesi edhe njësitë e varësisë përfituese të fondeve publike, në këtë rast UK Kurbin, me qëllim përmirësimin e performancës buxhetore në drejtim të përfshirjes në projektbuxhet të investimeve dhe shmangien e rishikimeve përgjatë vitit me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit, dhe që mund të bëhen shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen. Gjithashtu, këto struktura, të marrin masat për shmangien në të ardhmen të fenomenit ku planifikimi i fondeve për investime nuk garanton mbulimin e pagesave të pritshme që rrjedhin nga zbatimi i kontratave, referuar edhe periudhës kohore të implementimit të projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Iniciativat e ndërmarrja nga UKK për krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, u konstatuan me mangësi të konsiderueshme mbi sistemet e kontrollit të brendshëm si në aspekt të perceptimit të përgjegjësive menaxheriale sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar dhe Manualit të MFK, ashtu edhe në drejtim të hartimit dhe miratimit të dokumentacioneve të nevojshme. Shkak për këtë, është edhe mos përfshirja nën monitorim të shoqërive aksionare nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Më hollësisht:

-Nuk është hartuar dhe përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MFE Pyetësori i Vetëvlerësimit të Kontrollit të Brendshmëm Financiar Publik, Deklarata e Cilësisë dhe Raporti përkatës mbi sistemet e kontrollit të brendshëm.
-Nuk është hartuar Strategjia e Menaxhimit të Risqeve për përcaktimin e planit të punës dhe strategjisë që do të ndiqet për adresimin e risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave institucional dhe as regjistri i risqeve apo grupe për menaxhimin e riskut.
-Nuk është ngritur dhe të ketë funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), apo koordinatori i riskut dhe MFK
-Rregullorja aktuale e UK Kurbin, edhe pse në aktet vendimmarrëse për miratimin e saj citohet si një rregullore e brendshme, faktikisht ajo ka për qëllim sigurimin e marrëdhënieve mes konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe furnizuesit të këtij shërbimi, pra nuk është një rregullore e brendshme e funksionimit të UK Kurbin;
-Nuk është hartuar dhe miratuar Kodi Etik dhe nuk janë përfshirë çështje të etikës në aktet të tjera rregullatore të institucionit;
-Nuk është hartuar plani i aktivitetit për të detajuar objektivat strategjik, vjetor, prioritetet dhe planet e veprimit;
-Nuk është kryer asnjë trajnim për periudhën nën auditim, si dhe nuk disponohet asnjë plan dhe regjistër për kryerjen e trajnimeve të stafit. Si rezultat, nuk janë hartuar module trajnimi edhe mbi sistemet e kontrollit të brendshëm, në kuadër të forcimit të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të punonjësve mbi rëndësinë e instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm;
-Nuk është kryer monitorim të veprimtarisë institucionale për periudhën objekt auditimi, në përmbushje të misionit dhe detyrave të saj; konstatohet mungesa e raporteve periodike për identifikimin e çështjeve që kërkojnë ndërmarrjen e masave konkrete për adresimin e tyre.;
-Nuk janë përgatitur hartat e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK;
-Nuk janë hartuar gjurmët e auditimit me qëllim identifikimin e proceseve kyçeve të njësive dhe dobësive;
-Nuk janë parashikuar nga Administratori i shoqërisë rregulla për delegimin e detyrës;
-Nuk disponohet një ŵeb faqe zyrtare e shoqërisë për publikimin e informacioneve të aksesueshme për publikun;
-Nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, për detajimin e proceseve në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre;
-Evidentohet mungesa e një arkive për ruajtjen e dokumentacioneve të shoqërisë;
-Nuk janë implementuar strategji apo sisteme "back-up" për ruajtjen e informacionit dhe dokumentacioneve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 94-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Administratori i UKK, në bashkëpunim me strukturat e tjera drejtuese të shoqërisë, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar më sipër për të përmbushur detyrimet në kuadër të forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke hartuar aktet e brendshme administrative të nevojshme dhe implementimin e tyre në përputhje me politikave për monitorimin e objektivave dhe përmirësimin e situatës, sipas çështjeve të ngritura më sipër.

Në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi janë kryer pagesa në zbatim të Vendimeve të Gjykatës së Apelit për periudhën objekt auditimi për punonjës të cilët janë larguar pa shkaqe të përligjura, duke detyruar punonjësit të ndjekin procedurat ligjore dhe kanë paditur UKK në Gjykatë. Nga paditë e punonjësve kanë përfunduar me vendim të formës së

prerë duke e detyruar UKK të paguajë shumën 5,292,924 lekë, për të cilat nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar edhe detyrimet përmbarimore. Për veprime të tilla UKK ka dëmshpërblyer për periudhën objekt auditimi, konkretisht:
9 punonjës dhe zyrat përmbarimore për vitin 2018 në shumën 2,990,097 lekë;
7 punonjës dhe zyrat përmbarimore për vitin 2019 në shumën 2,027,527 lekë,
4 punonjës dhe zyrat përmbarimore për vitin 2020 në shumën 225,300 lekë;
4 punonjës dhe zyrat përmbarimore deri në 01.04.2021 në shumën 50,000 lekë
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 36-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1. Rekomandimi: Nga Administratori i UKK të merren masa që në vazhdimësi, për marrëdhëniet me punonjësit e shoqërisë të zbatohen kushtet e vendosura në kontratat individuale dhe kolektive, largimet të jenë për shkaqe të arsyeshme dhe të justifikuara, duke zbatuar afatet kohore përkatëse të njoftimit, gjithashtu të merren në konsideratë shmangia e shpenzimeve për detyrimet përmbarimore.

Në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Pas marrjes së rekomandimit nuk ka asnjë punonjës të larguar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Zbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Mungon Rregullorja e Ujit nënshkruar nga Asambleja e Aksionareve e Ujësjellës Kanalizimeve Kurbin" SH.A dhe nga Administratori i UKK. Në këtë mënyrë nuk sigurohet një marrëdhënie ligjore e drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UKK që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, në zonën e shërbimit, nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit te rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve SHA". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
20.1. Rekomandimi: Nga Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Administrimit, Administratori i Shoqërisë, për secilën periudhë përkatëse në funksion të ushtrimit të detyrës, të hartohet/miratohet Rregullorja e Ujit.

Menjëherë

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Pazbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Në UKK raportimi i ujit të prodhuar është i pasaktë, pasi puset e prodhimit të ujit dhe kaptazhe operojnë pa matës, ndërkohë që çdo vendburim e pus uji duhet të pajiset me matës ujit, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit. Në UKK, nuk ka asnjë mundësi teknike (për gjendjen në të cilin gjendet linja e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit), të jepet shifra e saktë e prodhimit të ujit në burime, hyrje/daljet në depot apo uji që shkon tek konsumatorët. Saktësia e prodhimit të ujit të deklaruar nuk mund të merret e mirëqenë. Si e tillë, UKK ka anashkaluar matjen dhe udhëzimet e ERRU për metodologjinë e matjes, duke mos dhënë informacion të verifikueshëm si për shoqërinë dhe për organet e kontrollit, që prodhimi i ujit dhe detyrimet rrjedhëse për buxhetin e shtetit nga ky prodhim janë të sakta si deklarohen. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 55-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime SHA Kurbin, të marrë masa që për çdo vendburim e pus uji të pajiset me matës ujit, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit.

Menjëherë

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk janë vendosur matësa.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

22. Gjetje nga auditimi: Nga UKK nuk janë kryer kontrolle sistematike për konstatimet dhe prerjen e lidhjet të paligjshme, gjithashtu nuk është marrë asnjë masë për konstatimin e përdorimit nga ana e subjekteve private të puseve të prodhimit të ujit me/pa leje. Kjo ka sjellë mos funksionim të grupeve të inspektimit në të gjithë territorin e Bashkisë Kurbin pa planifikime dhe shtrirje kohore në vijueshmëri, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, Kodi i ujit, pjesa e dytë "Sistemi i furnizimit me ujë". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 55-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
22.1. Rekomandimi: Nga Administratori i UKK dhe strukturat përgjegjëse, të kryhen në mënyrë të vazhdueshme inspektime për identifikimin e lidhjeve të paligjshme dhe të zbatohet kuadri ligjor për subjekte/konsumatorët që shfrytëzojnë puse për uji.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me Urdhrin nr. 16, datë 07.06.2022 "Për ngritjen e grupit të Task Forcës për disiplinomin dhe monitorimin e Ujit të Pijshëm si dhe prerjen e Lidhjeve të paligjshme në rrjet" është ngritur grupi i punës për verifikimin e lidhjeve.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

23. Gjetje nga auditimi: Në UKK efiçenca e stafit përfaqëson numrin e stafit të shoqërisë për 1000 lidhje. Ky tregues lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme ndaj totalit të kostove, prandaj dhe ky tregues merr një rëndësi të veçantë. Nga të dhënat, gjatë vitit 2020 numri total i punonjësve në sektorin UKK ka arritur në 120 punonjës dhe 7127 lidhje, kjo sipas raportime të ERRU. Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit për vitin 2020 është mesatarisht 16.8 staf/1000 lidhje UK.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 55-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
23.1. Rekomandimi: Nga UKK të vlerësohet mundësia e zvogëlimi të numrit të punonjësve në strukturën e UKK, duke menaxhuar më mirë burimet njerëzore, shfrytëzuar rritjen e eficiencës në punë dhe rritjen e performancës së shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me Vendimin nr. 3, datë 02.09.2021 "Për disa ndryshime ne strukturën organizative nivelin e pagave të punojësve të shoqërisë SHA Ujësjellës Kanalizime Kurbin për vitin 2021", nuk janë shtuar vendet e punës por është vedosur edhe klauzola që pas daljes në pesnion vendet mos të plotësohen.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

24. Gjetje nga auditimi: Numri i konsumatorëve që janë të pajisur me matës në Bashkinë Kurbin në raport me numrin total të konsumatorëve të ujit të pijshëm është relativisht i ulët (afërsisht 40%). Në vitin 2018 sasitë e ujit të faturuara me matës në Bashkinë Kurbin janë 182,163 m^3 në raport me numrin total të faturimeve që ishte 1,199,934 m^3. Si e tillë faturimi afrofe llogaritet në sasinë 1,017,771 m^3 ujë. ERRU ka vënë objektiv për të gjitha shoqëritë vlerën 85%, por sipas ecurisë ndër vite, mbetet ende shumë punë për arritjen e këtij treguesi. Është detyrë e UKK të instalojë matës edhe në konsumatorët e tjerë në mënyrë që të rritet numri i konsumatorëve që faturohen dhe ti afrohet mesatares së nivelit të matjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 60-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1. Rekomandimi: UKK të instalojë matësit e ujit të pijshëm për konsumatorët në mënyrë që të rritet numri i konsumatorëve të pajisur me matës ti afrohet mesatares së nivelit të matjes. Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë e treguesit "Uji pa të Ardhura". Të planifikohen/realizohen investime për vendosjen e matësve në UKK në mënyrë që të rritet niveli i matjes.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Janë instaliar matësat e rinjë në banesat e rikonstuktuara nga tërmeti.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: i zbatuar

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese rezultoi se mungonin regjistrat e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme (AP), në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar, neni 135, pika 4 si dhe Statuti i shoqërisë i miratuar me Vendimin nr. 2, datë 13.05.2019, neni 10 pika 1, në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar, neni 161, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 5-6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1. Rekomandimi: Asambleja e Përgjithshme e përfaqësuar nga Aksionari i vetëm Bashkia Kurbin, nëpërmjet Sekretarit të Këshillit të marrë masa për të mbajtur regjistrin e posaçëm të vendimeve të AP me qëllim shmangien e deklarimit të tyre si akte të pavlefshme. Gjithashtu, Këshilli i Administrimit (KA) dhe Administratori të marrin masat për plotësimin e regjistrit të pjesëmarrjes nga Sekretari i KA gjatë mbledhjeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Rregjistri është hartuar dhe mbahet në Bashki

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

26. Gjetje nga auditimi: Asambleja e Aksionarëve (AA) të UKK, rezulton të jetë mbledhur vetëm 4 herë për vitin 2019, dhe nuk është mbledhur as edhe një herë në vitin 2018 dhe 2020. AA nuk ka plotësuar detyrimin ligjor të përcaktuar në Statutin e Shoqërisë dhe konkretisht nenit 6 "Asambleja e përgjithshëm", pika 3, sipas të cilës "Asambleja e përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit", detyrim i cili sipas pikës nr. 2 thirret nga Kryetari i AP (Kryetarja e Bashkisë); Këshilli i Administrimit; Administratori i Shoqërisë, por mund të thirret edhe nga Eksperti Kontabël i Autorizuar; nga një mandat mbajtës i caktuar nga gjykata për raste emergjente, në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" , i ndryshuar dhe Statuti i Shoqërisë, neni 6 "Asambleja e përgjithshëm", pika 3, sipas të cilës "Asambleja e përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 6-7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1. Rekomandimi: UKK të marrë masa për realizimin e mbledhjeve të Asamblesë së Aksionerëve të paktën 1 (një) herë në vit, sipas përcaktimeve statutore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos dokumentacion në dispozicion

Statusi i zbatimit të rekomandimit: i Pazbatuar

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, për periudhën objekt auditimi referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti UKK SHA rezultoi se nga Drejtoria Tregtare, Zyra e

Financës dhe Dega Teknike nuk ka evidentuar kilometrazhin e mjeteve në fillim dhe në fund të çdo të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për zërin e karburantit. Nga dokumentacioni i daljeve të karburantit nga magazina e Shoqërisë rezultoi se:
Për vitin 2018 janë përdorur 15,206 litra naftë me vlerë 2,587,257 lekë;
Për vitin 2019 janë përdorur 16,063 litra naftë me vlerë 2,663,264 lekë;
Për vitin 2020 janë përdorur 16,270 litra naftë me vlerë 2,116,947 lekë;
për të cilat për grupin e auditimit nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion argumentues dhe justifikues si Urdhrin e Administratorit për miratimin e programeve të punës, Programet individuale të punës në të cilat të përshkruhet itinerari i lëvizjeve të automjetit, motivacioni i lëvizjes. Mungonin të dhënat e kilometrazhit në fillim dhe në fund të aktivitetit, normativa e konsumit të automjeteve dhe konsumi specifik sipas itinerarit shoqëruar me nënshkrimet përkatëse të shoferit. Nga ana e administrimit të shoqërisë (Administratori, Drejtoria Tregtare) si dhe nga inxhinieri i Drejtorisë Teknike, nuk janë kryer kontrolle për llogaritjen e konsumit real të karburantit, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë. Këto veprime vlerësuar në konsumin pa dokumentacion justifikues dhe argumentues në sasinë e 47,539 litra naftë vlerësuar me **7,367,468 lekë janë veprime që kanë sjellë përdorim të fondeve pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet** për buxhetin e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Nga Administratori i UKK dhe Drejtori Tregtar të merren masat që të rregullohet me urdhër struktura që menaxhon mbajtjen e karburantit, që në vijimësi të hartohen kartelat përkatëse të secilit automjet, të caktohen personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e shpenzimeve për automjetet, të kryhen kontrollet përkatëse periodike për monitorimin e shpenzimeve për karburantin dhe riparimin e automjeteve dhe të dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës në vazhdimësi.

Brenda 6-muajve nga marrja e Raporti Përfundimtar

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Urdhër nr. 8, datë 19.05.2021 "Për normativën e harxhimit të karburantit për mjetin Tip Passat me Targa AA", Urdhër nr. 8/1, datë 19.05.2021 "Për normativën e harxhimit të karburantit për mjetin Tip Passat me Targa AA", Urdhër nr. 8/2, datë 19.05.2021 "Për normativën e harxhimit të karburantit për mjetin fadrom", janë hartuar procesverbalet përkatëse dhe dokumentacioni justifikues i konsumit.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Për arsye të vështirësisë financiare të UK Kurbin, pagesat dhe deklarimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe e tatimit për të ardhurat e punonjësve janë kryer vazhdimisht me vonesë. Si pasojë UK Kurbin ka gjeneruar gjoba për vitin 2015-2017 në vlerën 1.352.928 lekë, nga të cilat në vitin 2018 janë trashëguar pa likuiduar 393.660 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për këtë vit. Situata ka vazhduar dhe për periudhën vijuese objekt auditimi (2019-2020) nga ku rezulton se për vitin 2019 janë gjeneruar gjoba në vlerën 304.545 lekë, dhe për vitin 2020 janë gjeneruar gjoba në vlerën 912.029 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", dhe nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: UKK të marrë masa për kryerjen me prioritet të pagesave nga transaksione që gjenerojnë gjoba për shkak të vonesave, si dhe të planifikojë saktë në buxhete apo nevoja për subvencione vlerat sa i takon këtyre transaksioneve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Për shkak të pamundësisë paguese.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka pasur 6 procese gjyqësore për ndërprerje të marrëdhënieve të punës me punonjësit. Nga këto procese gjyqësore janë gjeneruar detyrime në vlerën **1.601.527 lekë** nga të cilat 1.240.727 lekë janë për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i gjykatës dhe 360.800 lekë shpenzime gjyqësore dhe shpenzime për shërbim përmbarimor, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 35-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: UKK të marrë masa që largimet nga puna të jenë konform Kodit të punës dhe Kontratës dy palëshe të punës dhe të mos shkelet asnjë e drejtë e punonjësit për asnjë rast. Gjithashtu, të ketë një planifikim buxheti të saktë që vendimet gjyqësore të ekzekutohen pa lindur nevoja e shpenzimeve për shërbimin përmbarimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Pas marrjes së rekomandimit nuk ka largime nga puna.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: i zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-30.04.2021, materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, grupi auditoi 8 nga 8 procedura me vlerë të prokuruar mbi 800,000 lekë, dhe vlerë të fondit limit prej **429,369,999 lekë**.
Nga 8 procedura të audituara, konstatohet se në 3 procedura me vlerë kontrate 424,973,516, ose 98% e vlerës së kontratave të audituara, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO, nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-të}$) në vlerën 420,941,416 lekë. Procedura e audituar dhe konstatuara me problematikë janë:
1-Procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "Ndërtimi i Rrjetit të Jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçit", me vlerë të prokuruar 365,697,488 lekë dhe vlerë kontrate 363,692,924 lekë, ose më pak se fondi limit prej 2,004,563 lekë dhe BOE fitues "S.", "E." & "G. C." SHPK.
2-Procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "*Hapja e pus-shpimeve bashke me linjat transmetuese për furnizimin me ujë të Qytetit të Laçit si dhe ndërtimi i stacionit të pompimit* ", me vlerë të prokuruar 50,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 49,299,952 lekë, ose më pak se fondi limit prej 700,048 lekë dhe OE fitues "S." SHPK.
3-Procedura e prokurimit "Kërkesë për Propozim" me objekt "*Mbikëqyrje Punimesh "Hapja e pus-shpimeve bashke me linjat transmetuese për furnizimin me ujë te qytetit te Laçit* ", me vlerë të prokuruar 1,151,000 lekë dhe vlerë kontrate 1,019,625 lekë, ose më pak se fondi limit prej 131,375 lekë dhe OE fitues "E.-G" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 62-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: UK Kurbin, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën **420,941,416 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk kryer prokurime deri në përfundim të auditimit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

D. MASA DISIPLINORE
F.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statuse të parashikuar në ligje të veçanta.
Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar dhe kontratës kolektive të punës, neni 8 si dhe kontratave individuale dhe rregullores së brendshme të institucionit, Administratori i Ujësjellës Kanalizime SHA Kurbin, të marrë masat disiplinore ***"Vërejtje"***, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm për:

1. Z. D. A., në cilësinë e Drejtorit Tregtar të UKK
Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me shkresën nr. 309/15, datë 06.12.2021, i është dhënë masa "Vërejtje"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

2. Z. G. M., në cilësinë e Përgjegjësit të Financës dhe anëtarit të NJP
Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me shkresën nr. 309/16, datë 06.12.2021, i është dhënë masa "Vërejtje"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

3. Znj. J. E., në cilësinë e Inxhinierit të Degës Teknike dhe anëtarit të NJP
Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me shkresën nr. 309/17, datë 06.12.2021, i është dhënë masa "Vërejtje"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

4. Z. J. K., në cilësinë e Përgjegjësit të karburantit
Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Nuk u vendos në dispozicion dokumentacion
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar

5. Znj. B. N., në cilësinë e Juristes të UKK dhe anëtarit të NJP
Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me shkresën nr. 309/18, datë 06.12.2021, i është dhënë masa "Vërejtje"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

6. Z. D. A., në cilësinë e Kryetarit të KVO
Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me shkresën nr. 309/15, datë 06.12.2021, i është dhënë masa "Vërejtje"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

7. Znj. A. R., në cilësinë e anëtarit të KVO
Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me shkresën nr. 309/19, datë 06.12.2021, i është dhënë masa "Vërejtje"
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

8. Z. T. P., në cilësinë e anëtarit të KVO
Qëndrimi i UKK për Rekomandimin: Me shkresën nr. 309/20, datë 06.12.2021, i është dhënë masa "Vërejtje"

UJËSJELLËS KANALIZME SHA VLORË

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në UKV SHA mbi *"Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2021"* për auditimin e kryer në vitin 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***<u>Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se</u>*:**

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

Në zbatim të nenit 15, gërma "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 189 prot., datë 31.01.2022, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimime duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2, ku përcaktohet që:

2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë administruar në KLSH me nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, dhe protokolluar në UKV Sh.a me nr. 54 prot., datë 14.01.2022, janë rekomanduar gjithsej:

- **29** masa organizative.
- **8** masa për shpërblim dëmi në vlerën **1,297,954,897 lekë.**
- **11** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **38,413,174 lekë.**
- **9** masa disiplinore.

<u>IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:</u>

Sipas shkresës së administruar në Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë të Administratorit të Shoqërisë znj. E. H. me nr. 189 prot., datë 31.01.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	**29**	**29**	**0**
Masa për shpërblim dëmi	**8** 1,297,954,897 lekë	**8** 1,297,954,897 lekë	**0**
Masa për eliminimin e efekteve negative	**11** 38,413,174 lekë	**11** 38,413,174 lekë	**0**
Masa disiplinore	**9**	**9**	**0**
Totali	**57**	**57**	**0**

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit:

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara	Vlera e arkëtuar
Masa organizative	**29**	2	2	24	1	0
Masa për shpërblim dëmi	**8** 1,297,954,897 lekë	1	1	2	4	143,420
Masa për eliminimin e efekteve negative	**11** 38,413,174 lekë	1	0	10	0	0
Masa disiplinore	**9**	9	0	0	0	0
Totali	**57**	**13**	**3**	**36**	**5**	**143,420**
Totali në %	**100%**	**22.8%**	**5.26%**	**63.16%**	**8.78%**	**0.010%**

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe manualit "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve"*.
Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 600/22, prot., datë 21.06.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:
1. I.S., *(Përgjegjës grupi)*
2. A.R.,
3. E.S.,
4. Xh.L..

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara	Vlera e arkëtuar

Masa organizative	**29**	2	2	24	1	0
Masa për shpërblim dëmi	**8** 1,297,954,897 lekë	1	1	2	4	143,420
Masa për eliminimin e efekteve negative	**11** 38,413,174 lekë	1	0	10	0	0
Masa disiplinore	**9**	9	0	0	0	0
Totali	**57**	**13**	**3**	**36**	**5**	**143,420**
Totali në %	**100%**	**22.8%**	**5.26%**	**63.16%**	**8.78%**	**0.010%**

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 13%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

Në zbatim të nenit 15, gërma "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 189 prot., datë 31.01.2022, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

III/2-*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimime duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2, ku përcaktohet që:

> 2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA nuk ka përmbushur detyrimet e saj në rolin e saj si agjent tatimor i Bashkisë Vlorë. Sipas shkresës nr. 127, datë 18.01.2021 nga administratori i mëparshëm i UKV SHA drejtuar Asamblesë se Përgjithshme/Bashkisë Vlorë të UKV SHA, detyrimet totale për tu paguar nga UKV SHA ndaj Bashkisë Vlorë deri në fund të vitit 2020 janë në vlerën 169,960,610 lekë dhe deri në Janar të vitit 2021 janë likuiduar 46,883,127 lekë, ose 27,6 % e totalit të tyre dhe ngelen për tu likuiduar vlera 123,077,483 lekë. Mosveprimi nga UKV SHA, pretendohet se ka ardhur si pasojë e bllokimit të llogarive nga OSHEE SHA dhe ekzekutimi i kryer prej saj në vlerën 96,416,668 lekë. Këshilli i Administrimit, në rastet që është mbledhur, ka analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë por për problematikat e diskutuara nuk janë nxjerrë

konkluzione mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë për ta orientuar drejt në zgjidhjen e problematikave, nëpërmjet përshpejtimit të reformave të sektorit siç parashtrohet në VKM nr. 63, 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura".
-Referuar problematikave që janë diskutuar nga UKV SHA dhe kryesisht në mbledhjet e vitit 2021 të Asamblesë së Aksionarëve drejtuar Këshillit të Administrimit dhe punës menaxheriale të ish Administratorëve z. D. Xh. dhe z. Sh. L., është konstatuar kërkesa e vazhdueshme e Kryetarit të Asamblesë së Asamblesë së Përgjithshme, për marrjen e masave të UKV SHA, për të paguar detyrimet dhe taksat si agjent tatimor ndaj Bashkisë Vlorë, mosveprime këto në kundërshtim nenin 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e agjentit tatimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 33-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA të marrë masa për të analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar, me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë funksionale të saj dhe të propozojë plan masash për shlyerjen e detyrimeve që UKV SHA ka ndaj Bashkisë Vlorë.

Menjëherë e në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Detyrimet e taksave si pjesë e faturës mbi konsumin e ujit ndaj Bashkisë Vlorë për t'u paguar në vitin 2020 nga UKV Sh.a kanë qenë në shumën 169,960,610 lekë nga të cilat është likuiduar shuma 92,710,549 lekë si dhe është krijuar detyrimi në shumën 77,250,061 lekë si rezultat i bllokimit të llogarive bankare nga OSHEE për arsye të mos likuidimit të faturave të konsumit të energjisë elektrike. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, detyrimi i mbetur deri më datën 11.08.2022, ndaj Bashkisë Vlorë është në shumën 62,365,513 lekë.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

2. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të programeve ekonomike të UKV SHA të miratuara nga Këshilli i Administrimit të UKV SHA, rezultatit financiar shoqëria UKV SHA rezulton me humbje. Shoqëria UKV SHA ka programuar dhe ka kryer vit pas viti investime në rrjet, shpenzime pa mundësi likuidimi edhe pse me detyrime të prapambetura, ndërkohë që rezulton me detyrime ndaj OSHEE SHA, detyrime ndaj furnitorëve, detyrime përmbarimore dhe shlyerje detyrimesh sipas marrëveshjeve që kryen me furnitorët, me urdhra sekuestro të llogarive të shoqërisë. Referuar prodhimit dhe faturimit të ujit të pijshëm për vitin 2018 raporti i humbjeve prodhim/faturim është 75 %, ndërsa raporti i humbjeve prodhim/arkëtim (uji pa të ardhura) 77 %, për vitin 2019, referuar prodhimit dhe faturimit të ujit të pijshëm raporti i humbjeve prodhim/faturim është 78 %, ndërsa raporti i humbjeve prodhim/arkëtim (uji pa të ardhura) 76 %, për pesë mujorin e parë të vitit 2021, referuar prodhimit dhe faturimit të ujit të pijshëm raporti i humbjeve prodhim/faturim është 75 %, ndërsa raporti i humbjeve prodhim/arkëtim (uji pa të ardhura) 63%. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 38-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA, Drejtoria Tregtare, të marrin masa që në të ardhmen të bëhet menaxhimi sa më i mirë i prodhimit dhe shitjes së ujit me qëllim reduktimin e humbjeve duke pas parasysh ndjekjen e politikave tregtare, për ndërgjegjësimin e klientëve, për të mundësuar arkëtimin 100 % të të gjitha faturave ;
2.2. Rekomandimi: Drejtoria e Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA, të kontrollojë konsumin dhe faturimin e energjisë elektrike;
2.3. Rekomandimi: Drejtoria e Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA, të kryejë një analizë të efektivitetit në punë, me qëllim reduktimin e kostove jo efektive;

2.4. Rekomandimi: Drejtoria e Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA, të evidentojë çdo shpenzim që kryhet dhe të menaxhohet sa më mirë baza materiale.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimeve 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4: Të pranuara.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 187 prot., datë 31.01.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E.H. është hartuar një progarm (plan veprimi) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me shkresën nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, "Dërgohet Raporti i Auditimit".
Rekomandimet 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 janë në proces zbatimi.

3. Gjetje nga auditimi: Sipas programit ekonomik për vitin **2018**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 417, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve është realizuar 386 punonjës, pra 31 punonjës më pak. Fondi i pagave është **179,310,871 lekë**, pra **14,629,129 lekë më pak** se programi. Për vitin **2019**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 417, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve është realizuar 380 punonjës, pra 37 punonjës më pak. Fondi i pagave është **183,165,988 lekë**, pra **11,064,012 lekë më pak** se programi. Për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 417 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve është realizuar 401 punonjës, pra 16 punonjës më pak. Fondi i pagave është **189,325,477 lekë**, pra **12,035,523 lekë më pak se programi.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 66-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Burimet Njerëzore të merren masa për parashikimin e saktë të numrit të punonjësve, duke ju referuar nevojave specifike të shoqërisë, bazuar në funksionin e saj primar.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 5 prot., datë 06.04.2022, dhe Vendimin nr. 2, datë 06.04.2022, të Asamblesë Aksionare është miratuar struktura organizative e UKV Sh.a me numër 419 punonjës ndërsa realizimi deri më datën 11.08.2022, është 416 punonjës mesatarisht për periudhën prill-korrik të vitit 2022.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

4. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2019, konstatohet diferencë në zërin 'Impiante dhe Makineri', të cilit i është shtuar vlera prej 499,657,996 lekësh. Kjo vlerë i është pakësuar zërit 'Rrjeti ujësjellës dhe kanalizime', po në vlerën -499,657,996 lekë. Kjo vlerë rezulton se është ndryshuar në bilancin e vitit 2020. Diferenca nuk është pasqyruar në shënimet shpjeguese të vitit 2020, dhe nuk është konstatuar nga raportet e Audituesve Ligjorë, duke sjellë si pasojë pasiguri në mënyrën e hartimit dhe paraqitjes të vlerave reale të zërave të bilancit. Këto vlera ndikojnë në planifikimin e viteve të ardhshme, duke dhënë kështu një pamje jo reale të investimeve të kryera për periudhën objekt auditimi. Duke qenë se kemi të bëjmë me dy zëra të cilët jetëgjatësinë e tyre e kanë të ndryshme, kjo ndikon dhe në përqindjen e llogaritjes të vlerës të amortizimit, duke ulur kështu dhe vlerën e humbjes. Amortizimi i zërit impiante dhe makineri bëhet me 5 %, kundrejt amortizimit prej 3% të zërit Rrjet Ujësjellës dhe Kanalizime, dukë sjellë kështu një diferencë prej 2%, e cila në vlerë monetare paraqitet 9,993,160 lekë amortizim i llogaritur më tepër.
-Diferenca në vlerën e zërit të Rrjetit të ujësjellësit rezulton 1,356,570,163 - 499,657,996 = 856,912,167 lekë. Kjo diferencë rrjedh nga shtesat e rrjetit të ujësjellës kanalizime, konkretisht 1,044,190,364 lekë duke zbritur amortizimin 187,278,197 lekë, nga ku rezulton se vlera shtesë në pasqyrat financiare është 856,912,167 lekë. Sa më sipër rezulton se nuk ka faturë origjinale

lidhur me marrjen në dorëzim të grantit **Shtesë investime nga AKUK me fondet e BE**; është pakësuar vlera e grantit (rrjetit të ujësjellës – kanalizimeve) me 18% që në 6 mujorin e parë të marrjes në dorëzim të tij, duke sjellë si pasojë uljen e vlerës të këtij rrjeti, si dhe në shënimet shpjeguese dhe në raportet e ekspertëve financiarë nuk paraqitet marrja në dorëzim i këtij granti. Veprimet e më sipërme bien në kundërshtim me pikën 12, Udhëzimi Nr. 30 "Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" datë 27.12.2011, i ndryshuar "*Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi ne dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 99-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masa për rakordimin, analizimin dhe korrigjimin e diferencës që paraqitet si rezultat i mos paraqitjes të saktë të grantit në zërat e bilancit të shoqërisë, dhe pasqyrimi i saktë dhe i plotë i marrjes në dorëzim të grantit të AKUK.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, në pasyrat financiare të vitit 2021, është e njëjta situatë me pasqyrat financiare të vitit 2020. Gjithashtu me shkresën nr. 187 prot., datë 31.01.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E. H. është hartuar një progarm (plan veprimi) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me shkresën nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, "Dërgohet Raporti i Auditimit".
Rekomandimi është në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA, nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16. Gjatë investimeve në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 99-118,të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Nga Administratori dhe Sektori i Financës të merren masa për vlerësimin e vlerës së mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë dhe evidentimin.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, në pasyrat financiare të vitit 2021, është e njëjta situatë me pasqyrat financiare të vitit 2020. Gjithashtu me shkresën nr. 187 prot., datë 31.01.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E. H. është hartuar një progarm (plan veprimi) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me shkresën nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, "Dërgohet Raporti i Auditimit".
Rekomandimi është në proces zbatimi.

6. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të administruar, konstatohet se në Pasqyrat Financiare dhe Shënimet Shpjeguese të tyre, janë pasqyruar ndryshimet në kapitalin e shoqërisë, e cila ka pësuar **rënie prej 408 %,** nga vlera prej 141,138,606 lekë në vitin 2019 në – 249,044,083 lekë në vitin 2020, rënie e cila nga shoqëria argumentohet se ka ardhur nga rezultati me humbje për vitin 2020. **Rezultati financiar** i shoqërisë, për vitin **2020**, është me humbje në vlerën **188,046,746 lekë.** Rezultati financiar negativ dhe rënia prej 408% në Pasqyrën e Kapitalit të Shoqërisë, sjellin pasiguri dhe pa qëndrueshmëri të mundshme financiare në të ardhmen e saj, duke rrezikuar likuiditetin dhe përmbushjen e objektivave,

misionit dhe vizionit të saj, i cili është jetik për qytetin Vlorës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 99-118,të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Asambleja e Aksionareve dhe Administratori i shoqërisë të analizojnë situatën financiare të shoqërisë, shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të marren masa emergjente lidhur me përmirësimin e këtij rezultati.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga UKV Sh.a janë ngritur pretendimet se, në mbledhjen e muajit qershor të vitit 2021, Këshilli i Administrmit me shkresën nr. 1580 prot., datë 22.06.2021, në problematikat që do të shqyrtonte kanë qenë për t'u diskutuar, analiza financiare e shoqërisë për vitin 2020 dhe kërkesë për rritjen e kapitalit të shoqërisë. Me Vendimin e Kryetarit të Asamblesë të Shoqërisë nr. 5, datë 15.06.2021, është emëruar audituesi ligjor për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë. Në raportin e dhënies së sigurisë së pavarur për kontrollin e operacioenev të kryera për zmadhimin e kapitalit të UKV Sh.a janë pasqyruar veprimet kontabile me pasqyrat financiare të vitit 2020 gjendje me datën 31.12.2021, si më poshtë:
Në aktivin të pasqyrave financiare zëri "Shpenzime të shtyra" në vlerën 206,558,666 lekë bëhet zero dhe kalon në rezultatin financiar.
Në detyrimet dhe kapitali zëri Detyrime Afatgjata, detyrime ndaj institucioneve të kredisë, në të cilën është pasqyruar vlera e grantit nga 5,678,642,565 lekë është zvogëluar me vlerën 1,105,068,119 lekë e cila do të merret si e ardhur e grantit dhe do të pasyrohet në vlerën 4,573,574,446 lekë.
Humbjet e shoqërisë të mbartura deri më datë 31.12.2020, është në vlerën 961,304,121 lekë të cilës i shtohet dhe vlera 206,558,666 lekë dhe zvogëlohet të ardhurat nga grandi.
Në detyrimet dhe kapitali zëri rezerva statusore në 31.12.2020, është në vlerën 79,957,624 lekë e cila do të zvogëlohet në vlerën 75,507,254 lekë (62,794,668 lekë për mbulin humbje dhe 12,712,586 lekë për rritje të kapitalit të nënshkruar). Pas këtyre veprimeve situata e pasqyrave financiare për vitin 2020 do të jetë:
Shpenizmet e shtyra nga 206,558,666 lekë bëhet 0.
Humbjet e mbartura nga 961,304,121 lekë bëhet 0.
Rezerva statutore nga 79,957,624 lekë bëhet 4,450,370 lekë.
Kapitali i nënshkruar nga 632,287,414 lekë bëhet 645,000,000 lekë.
Për zmadhimin e kapitalit të nënshkruar është marrë vendimi i Kryetarit të Asamblesë nr. 11, datë 22.12.2021. Këto ndryshime janë pasqyruar dhe në pasqyrat financiare të vitit 2021.
Rekomandimi është zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rregullshmërinë e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë, në përputhje me disiplinën financiare dhe magazinimit rezultoi se:
Ujësjellës Kanalizime Vlorë sha ka tre arka dhe depozitimet në të janë nga të ardhurat nga shitja e ujit. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për transaksionet e arkës për shpenzimet e kryera për vitin 2018, për vitin 2019, për vitin 2020 si dhe për vitin 2021, rezultoi se: të ardhurat e mbledhura nga turni i dytë mbaheshin në një kasafortë pa procesverbal dhe pa siguri të mjaftueshme. Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 12 "*Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi ne dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 99-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe sektori i Financës, të merren masa për hartimin e një rregulloreje lidhur me administrimin e vlerave monetare në arkë.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 708 prot., datë 29.03.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E. H. është miratuar rregullorja për arkëtarët e Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë.
Rekomandimi është zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Lidhur me procedurat me blerje të vogla, për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nuk ka të dhëna lidhur me ngritjen e komisioneve të blerjeve të vogla dhe komisione kolaudimi; Dosjet fizike të viteve 2018 dhe 2019 nuk gjenden në protokoll apo në sektorin juridik; Procedurat e blerjeve të vogla kanë parregullsi procedurale; Në disa raste nuk ka gjurmë operatorëve ekonomik pjesëmarrës, të shpalljes të operatorit ekonomik fitues, etj.
Nga auditimi i dokumentacionit të bankës rezulton se për periudhën objekt auditimi janë kryer 53 procedura reklamash dhe publiciteti, në vlerën totale 2,632,333 lekë me TVSH, nga të cilat 15 procedura për vlerën 776,000 lekë për vitin 2018; 14 procedura për vlerën 689,333 lekë për vitin 2019; 19 procedura për vlerën 891,000 lekë për vitin 2020; dhe 4 procedura për vlerën 276,000 lekë për vitin 2021. Për kryerjen e këtyre procedurave televizionet njoftohen verbalisht, dhe zakonisht merren 3 oferta nga operatorët ekonomikë, duke përzgjedhur ofertën ekonomike më të vogël. Bashkëlidhur praktikave mungon në çdo rast kërkesa e sektorit përkatës për lindjen e nevojës, urdhri i prokurimit, ftesa për ofertë. Praktika e blerjes të reklamave dhe publicitetit është e pa rregullt. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 76-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Sektori i Juridik, të merren masa për analizimin e situatës të krijuar dhe hartimin e rregullt të procedurave të blerjeve të vogla.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

9. Gjetje nga auditimi: Shitja e ujit të pijshëm të prodhuar si dhe largimi i ujërave të ndotura janë dy sektorët ku realizohen të ardhurat kryesore të shoqërisë UK Vlorë. Prodhimi i ujit të pijshëm është i lidhur me kërkesat e konsumatorit. Duke ju referuar nevojës mesatare ditore 150 l/ditë/frymë dhe numrit të popullsisë në zonën e shërbimit e sipas të dhënave të vendosura në dispozicion janë 199,304 frymë rezulton se, nevojat për ujë janë 29,896 m^3/ditë ose 10,911,894 m^3/vit. Nga të dhënat konstatohet se prodhimi i ujit është shumë më i lartë nga nevojat e kërkuara sipas standardeve si dhe niveli i faturimit krahasuar me prodhimin është shumë i ulët. Veprimtaria e shoqërisë së UK Vlorë monitorohet nëpërmjet performancës dhe indikatorëve të saj për të garantuar përmbushjen e përgjegjësive dhe për të parë progresin që bëhet për të përmirësuar shërbimet. Nga krahasimi i indikatorët kryesorë të performancës për periudhën objekt auditimi si dhe objektivat e vendosura nga shoqëria konstatohet se:
- Mungojnë matësat në prodhim e cila sjell pasqyrim jo të saktë të prodhimit dhe të dhëna jo të besueshme te cilat ndikojnë në treguesit e performancës së shoqërisë.
- Niveli i faturimit i matur është në masën 60% mbi objektivin e vendosur nga shoqëria.
- Niveli i humbjeve shumë i lartë dhe gjatë periudhës audites ka ardhur duke u rritur nga 77% në vitin 2018 në 78.9% për viti 2020, pra më i lartë se objektivi i vendosur nga shoqëria 75%.

- Niveli i arkëtimit koherent është mesatarisht 63% për periudhën objekt auditimi i cili ka pësuar rënie nga viti 2018 me 10% në vitin 2020.
- Mbulimi i kostos direkte dhe totale të operimit janë poshtë objektivave të vendosura nga shoqëria.
- Kohëzgjatja e furnizimit me ujë ka një rritje me 2.2% nga fillimi i periudhës së audituar deri në fund të saj.
- Mbulimi i zonës së shërbimit me ujësjellës sipas të dhënave është ulur me 5% dhe mbulimi me kanalizime ka një rritje prej 3.3%, këto krahasuar me fillimin e periudhës së audituar deri në fund të saj. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 për shoqëritë tregtare; Strategjia Kombëtare e Ujit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 118-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë të merren masa për uljen e humbjeve teknike dhe administrative duke hartuar një plan veprimi të mirë përcaktuar duke grumbulluar të dhëna të besueshme me vendosjen e matësve në prodhim dhe faturim si dhe rritjen e arkëtimeve koherente për rritjen e të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 187 prot., datë 31.01.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E. H. është hartuar një progarm (plan veprimi) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me shkresën nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, "Dërgohet Raporti i Auditimit". Gjithashtu referuar të dhënave të paraqitura nga Dega Teknike e UKV Sh.a për vitin 2020 humjet e ujit janë në masën 79% si dhe për vitin 2021 humbjet teknike të ujit janë në masën 76%.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

10. Gjetje nga auditimi: Në procedurën së prokurimit me objekt "Blerje karburanti për vitin 2018", me fond limit në shumën 36,598,025 lekë pa TVSH, në DST është kërkuar që: *"operatori ofertues duhet të disponojë minimumi 3 (tre) pika shpërndarje të karburantit brenda territorit të Bashkisë Vlorë, ku të jetë përcaktuar adresa e saktë.* ***Kjo të provohet me dokument pronësie****, ose me kontratë noteriale qiraje, ose me akt-marrëveshje noteriale, ose me akt-përdorimi noterial"*. Për OE fitues pikat e shpërndarjes janë të shënuara në ekstraktin e QKB por këto nuk janë te vërtetuara me dokumente pronësie siç kërkohet. Dokumentet e pronësisë të paraqitura nga OE fitues janë vetëm dy ku një është për tokë arë në Mifol dhe një në lagjen "Lirimi" Vlorë e cila është truall dhe në to nuk përcaktohet se çfarë objektesh ka të ndërtuara mbi to dhe çfarë aktiviteti kryhet që mund të vërtetojnë pronësinë e pikave të karburantit. OE "F." SHPK është kualifikimit me pa të drejtë dhe procedura e prokurimit duhej të anulohej, për mosplotësim të kërkesave referuar DST. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 73 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-181, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Nga shoqëria UK Vlorë të merren masat e duhura që, komisionet e krijuara për procesin e vlerësimit të ofertave, të kryejnë vlerësimet e duhura ndaj ofertave të paraqitura bazuar në kriteret e hartuara dhe miratuara për çdo procedurë prokurimi

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

11. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt *"Blerje karburanti për vitin 2018"*, me fond limit në shumën 36,598,025 lekë pa TVSH konstatohet se në DST ku paraqitet lista e automjeteve dhe sasia totale e parashikuar e konsumit të tyre në fund të listës është shtuar sasia prej **15031 litra benzinë** e cila është e pa argumentuar dhe nuk ka një sqarim se cilat mjete përdorin naftë dhe cilat benzinë. Gjithashtu edhe specifikimet teknike janë kërkuar vetëm për gazoil (diezel) (10ppm) dhe jo për benzinën. Pra përllogaritja e fondit limit bazohet në specifikimet teknike që janë të pa argumentuara. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Nga shoqëria UK Vlorë të merren masat e duhura që, llogaritja e fondit limit të jetë e bazuar në specifikimet teknike dhe kriteret e hartuara dhe miratuara për çdo procedurë prokurimi.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

12. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara, referuar dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se urdhri i prokurimit për krijimin e KVO nuk është i veçantë për çdo procedurë prokurimi por është krijuar në fillim të vitit dhe shërben për të gjitha procedurat e ndryshme që do të zhvillohen gjatë tij. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58. Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt *"Furnizim vendosje matësash për vitin 2019"*, me fond limit në shumën 12,491,050 lekë pa TVSH, referuar dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se urdhri i prokurimit për krijimin e KVO nuk është i veçantë për këtë procedure prokurimi por është krijuar në fillim të vitit dhe shërben për të gjitha procedurat e ndryshme që do të zhvillohen gjatë tij. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Organet drejtuese të UK Vlorë të marrin masa për planifikimin e programeve të trajnimit për stafin në lidhje me procedurat e prokurimit duke rritur kështu kapacitetet saj dhe plotësimin e dosjeve sipas legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

13. Gjetje nga auditimi: Në 8 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit **250,466,974 lekë pa TVSH**, të audituara për periudhën objekt auditimi, referuar dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se, në DST janë kërkuar kritere për specifikimet dhe kapacitetet teknike, konkretisht licencat, N.P– 9: Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime "Kategoria C"; NS-16: Ndërtimi i impianteve te ujit te pijshëm dhe pastrimit te tij "Kategoria B"; NS -20 B; Shpime gjeologo-inxhinjerike, puse e shpime për ujë "Kategoria B" si dhe për stafin teknik, Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin teknik për

periudhën (Qershor 2020 - Nëntor 2020) stafin Inxhinier Gjeolog dhe Arkitekt Peisazhi; Operatori ekonomik duhet të ketë 3 (tre) ekspert për hartimin e raporteve të VNM-së për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problemet mjedisore dhe të thirret si ekspert për të vlerësuar një raport VNM apo rezultatet e auditimit, të shoqëruar me certifikatën e lëshuar nga autoriteti kompetent në bazë të VKM –së nr. 122, datë 17.02.2011, i ndryshuar. Kriteret e mësipërme janë të pa argumentuar teknikisht dhe ligjërisht si dhe jo në përputhje me tipologjinë e punimeve dhe objektin e zbatimit të kontratës të cilat kanë kufizuar numrin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në këto procedura. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.12.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: UK Vlorë dhe Njësia e hartimit të kritereve të kualifikimit, të marrë masat e duhura që, vendosja e kritereve të jetë në përputhje me objektin e kontratës si dhe tipologjinë e punimeve, me qëllim shmangien e pasojave financiare për shoqërinë në të ardhmen si dhe rritjen e pjesëmarrësve ofertues me qëllim përfitimin e një oferte sa më ekonomike.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të shpërndarjes të ujit të pijshëm dhe sistemit të kanalizimeve nëpërmjet verifikimeve të kryera në terren në prezencë të përfaqësuesve të UK Vlorë u konstatua se punimet infrastrukturore të kryera nga Bashkia Vlorë dhe nga institucione të tjera të varura nga pushteti qendror ndikojnë negativisht dhe nuk ka një koordinim midis tyre. Konkretisht u konstatua se: nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në rreth-rrotullimin e Skelës po **kryhen punime ku kanë dëmtuar akset e komandimit të saraçineskave** dhe mbjelljen e palmave mbi këto saraçineska që e bëjnë të pa mundur manovrimin e tyre si dhe rritje të kostos për riparimin e tyre në raste defektesh; punimet e kryera për rehabilitimin e rrugës Sheshi i Flamurit-Skelë kanë **dëmtuar pusetat e saraçineskave të tubave në të dy krahët e rrugës**, duke e bërë të pa mundur evidentimin e pozicionit të tyre; punimet e kryera për rikualifikimin e rreth-rrotullimeve në rrugën Transballkanike kanë **mbuluar saraçineskat** duke zvogëluar mundësinë e manovrimit si dhe rritje të kostos për riparimin e tyre në rast defektesh; gjatë punimeve të kryera për ndërtimin e Lungomares në tubim kryesor Ø 700mm janë bërë **lidhje për furnizimin me ujë të banorëve dhe bizneseve të zonës të cilat janë jashtë kushteve teknike të zbatimit**; punimet e kryera në disa rrugë nga Bashkia, për rehabilitimin e tyre, **shtresa e re e asfaltit ka mbuluar kapakët e pusetave të kanalizimeve** duke i bërë ato të pa evidentueshme dhe sjelljen e vështirësive në mirëmbajtjen e kanalizimeve në rastet e bllokimit të tyre. Gjatë implementimit të projektit "Rehabilitimi i infrastrukturës ujore-Vlorë" në sistemin e shpërndarjes janë **vendosur hidrantë kundra zjarrit të cilat, nga punimet infrastrukturore të kryera kanë humbur funksionin e tyre pasi janë dëmtuar** dhe mbuluar ku në rastet e emergjencës kundra zjarrit kanë një rol të rëndësishëm. Gjithashtu në këtë projekt është instaluar sistemi SCADA i cili bënte të mundur kontrollin e stacioneve të pompimit, sistemin e klorinimit në Ujin e Ftohtë dhe nivelin e rezervuarëve 4000 m3 dhe 6000 m3 në zonën e Kaninës si dhe sistemi GIS i cili përcaktonte me saktësi pozicionin e tubave dhe saraçineskave. Nga grupi i auditimit u konstatua se **sistemi SCADA dhe sistemi GIS janë jashtë funksionit**. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave

të ndotura" dhe VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të shoqërisë, për të gjitha investimet infrastrukturore që kryhen brenda territorit të veprimtarisë së saj, të marrin masa për koordinimin e zbatimit të punimeve pa dëmtuara sistemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve si dhe azhurnimin dhe integrimin e sistemeve të reja me atë aktual.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

15. Gjetja nga auditimi: Implementim në një nivel të pamjaftueshëm sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në rregulloren e brendshme të shoqërisë, miratuar me VKA nr. 3 prot, datë 09.01.2017, rregulla apo proceset të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën e punës dhe procedurat.

Mungon një politikë e miratuar për burimet njerëzore, që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt, si edhe nuk rezulton të ketë një plan vjetor trainimesh.

Nuk funksionon Grupi i Menaxhimit Strategjik. Nuk është krijuar struktura e koordinatorit të riskut, si dhe nuk ka regjistër risku. Menaxhmenti harton plane pune mujore dhe vjetore, por ato nuk hartohen me bazë risku.

Nuk janë hartuar listat e proceseve kryesore, në mënyrë që të parashikojnë realizimin e procesit, përfshirjen e sektorëve të ndryshëm, dokumentacionin përkatës, si edhe identifikimin e riskut. Gjithashtu, kapaciteti i i auditimit të brendshëm është ipamjaftueshëm.

Mungesa e zbatimit të kritereve të parashikuara në kuadrin ligjor ka ndikuar në mosrealizimin e objektivave të shoqërisë.

Sa sipër, bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 10, nenit 12, nenit 16 pika 2 dhe 3, nenit 27 të Ligjit Nr. 10296 datë 08,07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 172-174 të Projektraporit të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i shoqërisë SHA UK Vlorë të marrin të gjitha masat e nevojshme për implementimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për krijimin e Koordinatorit të Riskut, dhe të sigurojnë hartimin e regjistrit të risqeve, hartimin e gjurmëve të auditimit, si edhe funksionimin Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 14 prot., datë 26.06.2021, dhe Vendimin nr. 4, datë 23.06.2021, të Këshillit të Administrimit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

15.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë SHA UK Vlorë të marrë të gjitha masat e nevojshme për rritjen e kapacitetit dhe funksionimit të Auditit të Brendshëm.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në zbatimin e strukturës organizative Njësia e Auditit të Brendshëm është e përbërë vetëm nga një punonjës.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

16. Gjetja nga auditimi: Hartimi i paargumentuar i kushteve të veçanta në DST.
- Në hartimin e Dokumenteve të Tenderit me objekt prokurimi "Blerje materiale elektrike", për vitin 2019 nuk është argumentuar kërkesa për prezantimin e mostrave të mallrave objekt i prokurimit, duke kufizuar pjesëmarrjen e OE dhe ulur konkurencën.
- Në hartimin e Dokumenteve të Tenderit me objekt prokurimi "Blerje rroba pune viti 2020": nuk është argumentuar kërkesa për fletë analizë nga një laborator i akreditуar në Republikën e Shqipërisë, për mallrat objekt prokurimi, duke kufizuar pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit të OE^{ve} që importojnë, të cilët kanë çertifikatën e konformitetit CE nga vendet eksportuese.
Veprimet sa më sipër bien në kundërshtim me nenin 20, neni 23 pika 3, shkronja b) të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, neni 27 pika 6, neni 61 pika 2 të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 101-171 të Projektraportit të Auditimit).*
16.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë SHA UK Vlorë të marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e hartimit të kritereve të veçanta me karakter diskriminues në të ardhmen, me qëllim krijimin e kushteve për një proces vlerësimi objektiv, si edhe shmangien e kufizimit të pjesëmarrjes në tender.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

17. Gjetja nga auditimi: Në 2 procedura prokurimi me objekt "Blerje materiale ndërtimi", për vitin 2019 dhe 2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shpallur fitues OE të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e vendosura nga AK në DST, veprime në kundërshtim me nenin 46 Kualifikimi i Ofertuesve, pika 1 shkronja (b), në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, por dhe me nenin 27, pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, lidhur me mungesën e cilësimit të formës së dokumentacionit të kërkuar për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 101-171 të Projektraportit të Auditimit).*
17.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë SHA UK Vlorë të marrë të gjitha masat e nevojshme për hartimin e procedurave për kontrollin dhe mbikëqyrjen në procesin e hartimit të dokumenteve të tenderit, me qëllim uljen riskut të realizimit të kontratës, si dhe rritjen e përgjegjësive dhe cilësinë e vendimmarrjes gjatë procesit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

18. Gjetja nga auditimi: Mbikëqyrje e kontratës së shërbimit.
Në kontratën REF-56644-16-03-2018 me objekt "Furnizim vendosje të pjesëve të këmbimit dhe riparim shërbimi të mjeteve motorrike" nga subjekti "Andi Hamo", ka rezultuar se nuk ka përputhje midis situacioneve dhe faturave TVSH sipas artikujve. Procesverbalet, e hartuara nga komisioni i marrjes në dorëzim të UK Vlorë, korespondojnë vetëm me faturat e TVSH për çdo artikull, por nuk përputhen me situacionit përkatëse për çdo artikull, pavarësisht se korrespondon shuma e përgjithshme.

- Procesverbalet nuk kanë bashkëngjitur faturën analitike të shërbimit që kontraktori ka kryer, me qëllim garantimin se pika 2.3 Për kapacitetin teknik, paragrafi 4 (ekzistenca e personelit teknik të kërkuar në DST) plotësohet;
- Procesverbalet e marrjes në dorëzim pas riparim-shërbimit janë plotësuar konform faturës së TVSH të lëshuar nga kontraktori. Në këtë rast formati i plotësuar nga komisioni nuk është i nevojshëm meqenëse fatura e TVSH administrohet nga ana e blerësit.
- Procesverbali i marrjes në dorëzim nuk evidenton përshkrimin teknik të punës të kryer dhe problematikën e shërbimit.

Veprimet e mësipërme sjellin si pasojë rritjen e riskut për difekte për shkak të cilësisë, dhe janë kryer në kundërshtim me nenin 77, pika 1 dhe 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 101-171 të Projektraportit të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Administratori i SHA UK Vlorë dhe personi përgjegjës për transportin të marrin të gjitha masat e nevojshme për hartimin e procedurave të plota të procesit të mbikëqyrjes së kontratave për furnizim-vendosje të pjesëve dhe shërbimeve për mjetet motorrike të shoqërisë, me qëllim mbikëqyrjen e kushteve të kontratës dhe kontrollin e cilësisë së shërbimeve.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

19. Gjetje nga auditimi: Ujësjellës Kanalizime Vlorë Sh.A, krahas kategorive A-*për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik* dhe C-*për largimin e ujërave të ndotura,* kryen edhe shërbimin e kategorisë D-*për përpunimin e ujërave të ndotura*. Për licencimin me kategorinë D, UK Vlorë duhet të paraqesin kërkesën pranë ERRU-së si dhe raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) i cili nuk është realizuar nga ana e shoqërisë. Për sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi 01.04.2018 deri 30.05.2021 operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Vlorë ka kryer veprimtari të pa licencuar për kategorinë D e cila është në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar. Sipas shkresës të ERRU nr. 143 datë 16.04.2021, shoqëria e UK Vlorë ka shlyer një pjesë të detyrimeve financiare ndaj saj për vitin 2020 dhe detyrimi i prapambetur është 2,043,083 lekë. Detyrimi për vitin 2021 i cili është në vlerën 2,809,000 lekë, duhet të shlyhet me këste gjatë periudhës prill-tetor por UK Vlorë nuk ka kryer asnjë pagesë. Veprimtaria e përpunimit të ujërave të ndotura nga shoqëria është ne kundërshtim me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" dhe ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 118-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli Administrimit të marrin masa për përgatitjen e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pajisje me Leje Mjedisore për ITUN që është kusht paraprak për licencimin e shoqërisë nga ana e ERRU për trajtimin e ujërave të ndotura.

19.2. Rekomandimi: Drejtoria e UK SHA Vlorë duhet të përfshijë në prioritetet e veta shlyerjen e detyrimeve financiare dhe ato të prapambetura ndaj ERRU, duke shmangur bllokimin e llogarive bankare e për rrjedhoje vendosjen e shoqërisë në vështirësi financiare.

Menjëherë

Statusi i rekomandimeve 19.1 dhe 19.2: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë është pajisur me liçencat e reja për kategorinë A dhe kategorinë C, sipas Vendimit nr. 245 datë 02.06.2022 nga KKRR.
Rekomandimet 19.1 dhe 19.2 janë në proces zbatimi.

20. Gjetje nga auditimi: 1. Nga kontrolli fizik në Stacionin e Pompimit të zonës së Ujit të Ftohtë u konstatua se mbi kaptazhet (veprat e marrjes së ujit) janë ndërtuar godina të larta banimi si dhe shtëpi private. Godinat e larta të banimit si dhe hotelet janë të lidhur me sistemin e kanalizimeve. Për sa i përket shtëpive private një pjesë e tyre shkarkimin e ujërave të ndotura e bëjnë në gropa septike të cilat duhet të jenë të izoluara. Nuk gjenden gjurmë që nga ana e shoqërisë UK Vlorë të jenë marrë masa ose kontroll i gropave septike të objekteve të ndërtuara në zonën e mbrojtur të burimeve në Ujin e Ftohtë, për kushtet teknike të ndërtimit dhe funksionimit të tyre sipas legjislacionit në fuqi.
2. Dezinfektimi i ujit të pijshëm bëhet me metodën kimike me produktet dezinfektuese, hipokloriti i kalciumit dhe hipokloriti i natriumit. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i natriumit bëhet në mënyrë automatike me dozim, në varësi të prurjeve nga stacionet e pompimit nr. 4,6 dhe 7 në zonën e Ujit të Ftohtë. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i kalciumit bëhet në të gjitha stacionet e tjera të pompimit.
Për punonjësit që kryejnë dezinfektimin e ujit, konstatohet se nuk gjenden dëshmi të gjendjes shëndetësore të tyre, në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit te pijshëm". Gjithashtu konstatohet se pavarësisht kryerjes së analizave për përbërjen fiziko-kimike të ujit të pijshëm, nuk është bërë një analizë e thelluar për të përcaktuar trajtimin kimik e kështu përcaktimin/planifikimin sa më të drejtë të sasive të nevojshme të klorit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", dhe VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit te pijshëm".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 118-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
20.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë të krijojë një grup pune për evidentimin e të gjitha banesave, brenda zonës së mbrojtur të burimeve, të cilat shkarkimin e ujërave të ndotura e kanë në gropa septike si dhe kontrollin e kushteve teknike të ndërtuara e funksionimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.
20.2. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë dhe organet drejtuese duhet të marrin masat e nevojshme që punonjësit, të cilët kryejnë dezinfektimin e ujit të pijshëm dhe janë në kontakt me ujin të jenë të pajisur me dëshmi të gjendjes shëndetësore sipas rregullores për pajisjen me librezë shëndetësore profesionale.
20.3. Rekomandimi: Shoqëria në bashkëpunim me ISHP të hartojë një rregullore (metodikë) të kryerjes të analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm në mënyrë periodike, në burimet e ujit dhe sistemin shpërndarës, gjithashtu hartimin e një protokolli se si duhet të veprohet në rastet e ndotjes, marrjen e masave në mënyrë rigoroze dhe të menjëhershme, për mbrojtjen e shëndetit publik.

Menjëherë

Statusi i rekomandimeve 20.1, 20.2 dhe 20.3: Të pranuara.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 187 prot., datë 31.01.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E. H. është hartuar një progarm (plan veprimi) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me shkresën nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, "Dërgohet Raporti i Auditimit".
Rekomandimet 20.1, 20.2 dhe 21.3 janë në proces zbatimi.

21. Gjetje nga auditimi: Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) në Vlorë ka filluar funksionimin e tij në vitin 2018 dhe ai për Orikumin është në ruajtje (konservim) dhe nuk është vendosur në funksion. Për trajtimin e ujërave të ndotura në impiant përdoret metoda biologjike. Sipas projektimit kapaciteti i trajtimit të impianti është 33,856 m^3/ditë ose 12,357,440 m^3/vit. Në ITUN Vlorë ka sistem të kontrollit "SCADA" që shërben për komandimin e gjithë procesit në mënyrë automatike duke gjeneruar të dhënat e nevojshme mbi sasinë e ujit të ndotur për trajtim në impiant. Sasia e ujit të ndotur që duhet të hyjë në impiant duhet të jetë më e vogël ose e përafërt me sasinë e ujit të faturuar për qytetin e Vlorës duke marrë parasysh se jo të gjitha banesat mbulohen me shërbimin e kanalizimeve. Nga krahasimi i të dhënave të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se sasia hyrëse e ujit të ndotur për trajtim në impiant është shumë më e lartë se sasia e ujit të faturuar ku varion nga 54.56%-90% . Sasia e lartë hyrëse për trajtim në ITUN është si rezultat se sistemi i kanalizimeve të ujërave të bardha (reshjet) KUB nuk është plotësisht i ndarë nga sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura KUZ e cila sjell edhe rritjen e sasisë së ujit të ndotur që hyn në impiant për trajtim krahasuar atë me ujin e faturuar. Gjithashtu konstatohet se edhe në periudhën pa reshje sasia hyrëse në impiant është më e lartë se sasia e faturuar e cila vjen si rezultat i futjes së ujërave nëntokësore në sistemin e KUZ, pra ky sistem nuk funksionon sipas kushteve teknike. Si rezultat i fluksit të lartë në ITUN nga derdhja e ujërave të bardha dhe depërtimi i ujërave nëntokësore në sistemin KUZ sjell rritje të energjisë së harxhuar e kështu rritje të kostos të trajtimit në tërësi. Laboratori i ITUN kryen analizat e ujërave të ndotura, në hyrje dhe në dalje të impiantit. Analizat që kryhen janë vlerat e NKO-së (Nevoja Kimike për Oksigjen dhe të NBO-së (Nevoja Biokimike për Oksigjen) të shprehura në mg/l O_2 si dhe lënda e ngurtë pezull e shprehur mg/l. Vlerat e lejuara për shkarkimin e ujërave të ndotura në mjedisin pritës janë, për NKO 125 mg/l O2, për NBO 25mg/l O2 dhe për lendet e mbetura pezull 35mg/l. Nga të dhënat e analizave të kryera dhe të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se NKO dhe NBO, para se uji i trajtuar të derdhet në mjedisin pritës, janë mbi normat e lejuara të përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Pavarësisht se sasia hyrëse në impiant për trajtim është e përzier me ujërat e bardha nevoja për NKO dhe NBO është më e lartë se normat e lejuara. Mesatarisht për ujërat që derdhen në mjedisin pritës: NKO është 136-150mg/l ku norma e lejuar është 125mg/l dhe NBO 28-65 mg/l ku norma e lejuar është 25 mg/l. ITUN Vlorë nuk kryen proces të plotë të trajtimit të ujërave te ndotura, pavarësisht se sasia hyrëse që trajtohet është afërsisht sa gjysma e kapacitetit të projektuar. Kështu që nuk jep rezultatin e pritshmërisë së investimit, nuk plotëson normat standardin e cilësisë që duhet të plotësoj uji i trajtuar përpara se të derdhet në trupat ujore pritëse. Sa më sipër, shkarkimi i ujërave të ndotura në mjedisin pritës është në kundërshtim me ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"; ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"; VKM Nr. 177, dt. 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse", si dhe direktivën e Bashkimit Evropian 91/271/EEC. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë, të krijojë një grup pune, me specialist të fushës përkatëse, për evidentimin e problemeve dhe nevojave të ITUP të cilat mund të risin cilësinë e trajtimit të ujërave të ndotura me qëllim shkarkimin e tyre në mjedisin pritës ne përputhje me normat e lejuara.

21.2. Rekomandimi: UK Vlorë SHA të marrë masa për identifikimin e sistemit të ujërave të bardha që derdhen ne sistemin e kanalizimeve, hartimin e një plan veprimi për ndarjen e sistemeve të tyre duke minimizuar prurjet në ITUN e kështu zvogëlimin e kostove të trajtimit në të.

Menjëherë

Statusi i rekomandimeve 21.1 dhe 21.2: Të pranuara.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 187 prot., datë 31.01.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E. H. është hartuar një progarm (plan veprimi) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me shkresën nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, "Dërgohet Raporti i Auditimit".
Rekomandimet 21.1 dhe 21.2 janë në proces zbatimi.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit transfertat bankare, për periudhën objekt auditimi, konstatohet se bashkëlidhur pagesave për likuidimin e dietave për fjetje mungojnë faturat e hotelit dhe kuponi tatimor. Për vitin 2018, konkretisht; më datë 04.12.2018 janë likuiduar 42,000 lekë dieta brenda vendit për fjetjen në hotel për punonjësit, D. Xh. -2 netë x3,000 lekë, A. R. -2 netë x 3,000 lekë, D. L. -2 netë x3,000 lekë, A. Xh. -2 netë x3,000 lekë, R. A. -2 netë x3,000 lekë, A. B. -2 netë x3,000 lekë, D. T. -2 netë x3,000 lekë. Për vitin 2019, konkretisht; më datë 10.01.2019 janë likuiduar 18,000 lekë dieta brenda vendit për fjetje në hotel për punonjësit, D. Xh. -2 netë x3,000 lekë, A. R. -1 natë x3,000 lekë, R. A. -1 natë x3,000 lekë, A. B. -1 natë x3,000 lekë, D. T. -1 natë x3,000 lekë. Pra, vlera e përfituar nga punonjësit në shumën **60,000 lekë** e likuiduar pa dokumentacionin justifikues, faturë hoteli e shoqëruar me kuponin tatimor, **përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë.** Likuidimi i dietave pa dokumentacionin justifikues është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe VKM me nr. 329, datë 20.4.2016 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 76-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë UK Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **60,000 lekë** nga punonjësit; D. Xh. -12,000 lekë, A. R. -9,000 lekë, D. L. 6,000 lekë, A. Xh. -6,000 lekë, R. A. -9,000 lekë, A. B. -9,000 lekë, D. T. -9,000 lekë.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 918 prot., datë 15.04.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E. H. ka nxjerrë urdhrin për ndalesë nga paga për punonjësit znj. R. A., z. D. L. dhe z. A. R.
-Deri më datë 21.07.2022, për znj. R. A. është kryer ndalesa nga paga sipas listë pagesës të muajit maj të vitit 2022 në shumën 3,000 lekë dhe listë pagesës të muajit qershor të vitit 2022 në shumën 3,000 lekë ku ndalesa totale shkon në shumën 6,000 lekë.
-Deri më datë 21.07.2022, për z. D. L. është kryer ndalesa nga paga sipas listë pagesës të muajit maj të vitit 2022 në shumën 3,000 lekë dhe listë pagesës të muajit qershor të vitit 2022 në shumën 3,000 lekë ku ndalesa totale shkon në shumën 6,000 lekë.
-Deri më datë 21.07.2022, për z. A. R. është kryer ndalesa nga paga sipas listë pagesës të muajit maj të vitit 2022 në shumën 3,000 lekë dhe listë pagesës të muajit qershor të vitit 2022 në shumën 3,000 lekë ku ndalesa totale shkon në shumën 6,000 lekë.
-Deri më datë 21.07.2022, z. A. B. është kryer derdhja e detyrimit në arkës e UKV Sh.a nëpërmjet arkës sipas mandat arkëtimit nr. 36, datë 07.03.2022, në shumën 9,000 lekë.
-Deri më datë 21.07.2022, për znj. D. T. është kryer ndalesa është kryer ndalesa nga paga sipas listë pagesës të muajit janar të vitit 2022 në shumën 9,000 lekë
Në total për këtë rekomandim është arkëtuar **shuma 36,000 lekë.**
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shërbimit të karburantit nga OE*"F." SHPK* u konstatuan se mungojnë kuponët tatimor, konkretisht:
Në vitin 2018, OE *"F." SHPK* ka faturuar në total 136,630.15 litra naftë dhe mungojnë kuponët tatimor për sasitë: në muajin Prill për 506.79 litra në vlerë 70,122 lekë (506.79 litra*38.3653 lekë/litër); në muajin Maj për 706 litra në vlerë 99,648 lekë (706 litra*141.145 lekë/litër); në muajin Qershor për 567 litra në vlerë 79,287 lekë (567 litra * 139.8355 lekë/litër); në muajin Gusht për 547 litra në vlerë 77,053 lekë (547 litra*140.864 lekë/litër); në muajin Dhjetor për 1,620 litra në vlerë 203,290 lekë (1620 litra*125.4881 lekë/litër).
Në vitin 2019, OE *"F." SHPK* ka faturuar në total 188,756.75 litra naftë dhe mungojnë kuponi tatimor në muajin Maj për 90 litra në vlerë 12,769 lekë (90 litra*141.88 lekë/litër). Për sa më sipër në mungesë të kuponit tatimor OE *"F." SHPK* ka përfituar më tepër vlerën **542,196 lekë e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë.**
Gjithashtu, konstatohet se është pasqyruar konsum fiktiv jo në përputhje me kilometrat e përshkuara, konkretisht: në muajin Korrik 2019, 95 litra me vlerë 12,870 lekë (95 litra x135,4822 lekë/litër) dhe në muajin Gusht 2019, 12 litra me vlerë në vlerë 1,648 lekë (12 litra x137,3507 lekë/litër). Pra, vlera prej **14,518 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe shoqërisë.** Për sa më sipër është në kundërshtim me Kontratat e furnizimit me karburant, nr. 942 datë 13.09.2017 dhe nr. 183, datë 13.02.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 76 - 99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: UK Vlorë të kërkoj në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **542,196 lekë** ndaj OE *"F." SHPK* sipas kontratave të furnizimit me karburant nr. 942 datë 13.09.2017 dhe nr. 183, datë 13.02.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 101-174 të Raport përfundimtarit të Auditimit).*

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 478 prot., datë 03.03.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E. H. është drejtuar OE "F." SHPK me njoftim në zbatim të rekomandimeve të KLSH për arkëtimin e vlerës 542,196 lekë. Me shkresën nr. 1798 prot., datë 08.07.2022, Administratori i Shoqërisë znj. E. H. është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me Kërkesë-Padi OE "F." SHPK për arkëtimin e detyrimit në shumën 542,196 lekë ndaj Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

2.2. Rekomandimi: UK Vlorë të analizojë veprimet e punonjësve për pasqyrimin e konsumit fiktiv të karburantit, jo në përputhje me kilometrat e përshkuara, në sasisë 107 litra me vlerë **14,518 lekë** dhe arkëtimin e kësaj shume sipas përgjegjësive përkatëse.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Deri më datën 11.08.2022, nga UKV Sh.a nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit me objekt *"Furnizim vendosje matësish për vitin 2019"*, me fond limit në shumën 12,491,050 lekë pa TVSH me fitues OE *"A, S. G." SHPK* është lidhur kontrata për zbatimin e punimeve civile me nr. 1071 prot. datë 09.10.2019 me vlerë 12,290,145 lekë pa TVSH. Nga vizita në terren, për zbatimin e kontratës, në të gjitha pikat e verifikuara nga grupi i auditimit, u konstatua se kontraktori nuk ka kryer asnjë veprim për vendosjen e filtrave të cilët janë përcaktuar në preventivin fillestar. Sipas situacionit përfundimtar janë likuiduar vlera e filtrave sipas diametrave: për filtër i matësit 1/2" vlera 104,000 lekë pa TVSH (1600 copë x 65 lekë/copë); për filtër i matësit 3/4" vlera 2,000 lekë pa

TVSH (100 copë x 20 lekë/copë); për filtër i matësit 1" vlera 950 lekë pa TVSH (10 copë x 95 lekë/copë) dhe për filtër i matësit 1 1/2" vlera 470 lekë pa TVSH (5 copë x 94 lekë/copë) në vlerë totale 107,420 lekë pa TVSH e përfituar më tepër nga kontraktori. Pra, vlera e përfituar më tepër nga kontraktori për mos vendosjen e filtrave prej **107,420 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë** veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar; Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar si dhe kontrata nr. 1071, datë 09.10.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: UK Vlorë të kërkoj në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **107,420 lekë pa TVSH** ndaj OE *"A. S. G." SHPK* sipas kontratës nr. 1071, datë 09.10.2019 me objekt *"Furnizim vendosje matësash për vitin 2019".*

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me urdhër transfertën e datës 09.03.2022, është arkëtuar shuma 107,420 lekë nga OE "A. S. G." SHPK në Credins Bankë.
Rekomandimi është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit *"Rrethimi i depove të ujit dhe Stacionet e Pompimit të SH.A UK Vlorë*" me fond limit 2,667,082 lekë pa TVSH zbatimi i punimeve civile është kryer sipas kontratës nr. 808, datë 17.07.2019, me objekt: *"Rrethimi i depove të ujit dhe Stacionet e Pompimit të SH.A UK Vlorë",* të lidhur midis BOE "B." shpk & R. C." shpk, me vlerë oferte 2,192,507 lekë pa TVSH dhe AK me afat përfundimi 1 (një) muaj nga nënshkrimi i saj. Mbikëqyrja e punimeve është kryer nga ing. L. D. sipas urdhrit të brendshëm nr. 811 prot. datë 18.07.2019. Nga auditimi i dokumentacionit situacionit përfundimtar si dhe vizitës në terren në prezencë të përfaqësuesve të UKV u konstatuan diferenca në volume punimesh të likuiduara por të pa kryera në vlerën **260,124 lekë pa TVSH**. Konkretisht këto diferenca u konstatuan në: *Rrethimi i depos V=350 m^3 në Pusin e Mezinit.* për tre zëra punimesh në vlerën 82,406 lekë pa TVSH; Rrethimi i depos V=4000 m^3 te Bishti i kalldrëmit për tre zëra punimesh në vlerën 145,996 lekë pa TVSH dhe Rrethimi i Minifoldit në "Ujin e Ftohtë" për dy zëra punimesh në vlerën 71,722 lekë pa TVSH. Pra, vlera e përfituar më tepër nga kontraktori prej **260,124 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë** veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar; Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: UK Vlorë të kërkoj në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **260,142 lekë pa TVSH** ndaj BOE "*B." shpk & R. C." shpk*, sipas kontratës Nr. 808Prot. datë 17.07.2019 me objekt *"Rrethimi i depove të ujit dhe Stacionet e Pompimit të SH.A UK Vlorë".*

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 484 prot., datë 03.03.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E. H. është drejtuar OE "R. C. SHPK dhe OE "B." SHPK me njoftim në zbatim të rekomandimeve të KLSH për arkëtimin e vlerës 260,142 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 1795 prot., datë 08.07.2022, Administratori i Shoqërisë znj. E. H. është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me Kërkesë-Padi OE "R. C." SHPK dhe

OE “B.” SHPK për arkëtimin e detyrimit në shumën 260,142 lekë ndaj Ujësjellës Kanalizime Sh.a Vlorë në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit konstatohet se, UKV SHA si debitorë ndaj Shoqërisë F. Sh.U.SHA/ OSHEE SHA, gjatë vitit 2020 është përballur me disa urdhër ekzekutime përmbarimore dhe urdhër bllokime llogarish bankare. Detyrimi i lindur nga mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE SHA deri në muajin Prill 2021 ka arritur në vlerën 1,161,241,674 lekë dhe kamatëvonesat e këtij detyrimi në vlerën **950,709,193** lekë detyrim ky i cili përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UKV SHA dhe buxhetin e shtetit**. Duke filluar nga muaji tetor 2020 e në vazhdim çdo muaj, në marrëveshje me OSHEE SHA bëhen pagesat e késteve në vlerën 7,000,000 lekë çdo muaj. UKV SHA; si debitorë ndaj Shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA gjatë vitit 2020 është përballur me disa urdhër ekzekutime përmbarimore dhe urdhër bllokime llogarish bankare.
-**Kredia e shoqërisë** paraqitet në vlerën 1,729,183,906 lekë e cila është e përbërë, si më poshtë:
Kredi për projektin Holandez, për rrjetin e Ujësjellës Kanalizimeve në vlerën 1,578,554,626 lekë (e cila është e ndryshueshme çdo fund viti nga rivlersimi, si rezultat i ndryshimit të kursit të monedhës Euro, ku kredia është 12,761,153.75 €)
Interesa të pa paguara kredie në vlerën 150,629,119 lekë të krijuara për periudhën 01.01.2012-31.12.2020.
Penalitetet e kredisë shkojnë në vlerën **344,125,359 lekë**, vlerë kjo e cila përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UKV SHA dhe buxhetin e shtetit.**
- UKV SHA për vitin 2020, ka detyrim ndaj F.G. SHPK për kontratën "Blerje materiale elektrike 2019" për vlerën 8,988,204 lekë me TVSH. Sipas lajmërimit nr. 786, datë 01.04.2021 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin përsa i përket kamatëvonesave lidhur me këtë kontratë, sipas vendimit të gjykatës nr. 1350, datë 13.01.2021 dhe procedurave të mëtejshme nga ana e përmbaruesit, me anë të vendimeve për ekzekutim të detyrueshëm dhe vendosjes të sekuestros konservative drejtuar të gjitha bankave me të cilat operon UKV SHA. Ekzekutimi i këtij detyrimi është bërë në First Bank Vlorë në vlerën **1,104,523 lekë.** Kjo pagesë përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UKV SHA dhe buxhetin e shtetit**. Sa më sipër, situata e krijuar lidhur me detyrimet ndaj palëve të treta, rrezikon ndjeshëm performancën e shoqërisë, përmbushjen e funksioneve primare, pagesën e punonjësve dhe të detyrimeve të tjera, në kushtet e bllokimeve të vazhdueshme të llogarive të saj, e cila mund të rezultojë në pezullim të detyrimeve operacionale të Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 99 - 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandim: Asambleja e Aksionarëve dhe Administratori i shoqërisë të analizojnë **dëmin ekonomik** me vlerë **1,295,939,075 lekë**, shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të merren masa emergjente lidhur me likuidimin e këtyre detyrimeve, të cilat sjellin **si pasojë urdhër sekuestro të llogarive bankare** të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Deri më datën 11.08.2022, nga UKV Sh.a nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

5.2. Rekomandim: Asambleja e Aksionarëve dhe Administratori i shoqërisë, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Bashkinë Vlorë të kërkohet hartimi i marrëveshjeve disa paleshë me OSHEE SHA dhe Projektin Holandez, lidhur me ristrukturimin dhe riskedulimin e pagesave të detyrimeve dhe penaliteteve, në mënyrë që të shmangen urdhër sekuestro bankare dhe mungesa e likuiditetit.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Deri më datën 11.08.2022, nga UKV Sh.a nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

6. Gjetje nga Auditimi: UKV SHA ka lidhur kontrata për shërbimin e rojeve dhe referuar të dhënave të marra nga Zyra e Financës në UKV SHA ka pasur vonesa të njëpasnjëshme për mungesë fondesh në likuidimin e shërbimeve të rojeve në këtë hark kohor duke u bërë edhe objekt penalitetesh dhe krijim dëmi për shoqërinë dhe buxhetin e shtetit vërtetuar kjo edhe me paditë e ngritura nga operatori Semani & Star Security ndaj UKV SHA për mos likuidim të shërbimeve të ofruara sipas kushteve dhe afateve të kontratës. Me vendimin e përmbaruesit nr. 929, datë 18.05.2021 dhe aktit të ekspertimit UKV SHA duhet t'i likuidojë operatorit Semani &Star Security, referuar urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë deri në datën 30.12.2020 shumën e kamatëvonesave në vlerën **1,031,546.42 lekë**. Mungesa e një analize nga zyra e financës dhe Titullari i autoritetit kontraktor ka sjellë mosplanifikim të saktë të këtij shërbimi dhe detyrimet e papaguara ndaj operatorit ofrues të këtij shërbimi i kanë sjellë dëm shoqërisë UKV SHA dhe buxhetit të shtetit deri në datën 30.12.2020 në shumën e kamatëvonesave në vlerën **1,031,546.42 lekë.** Megjithatë UKV gjatë vitit 2021 nga Prilli deri në muajin Gusht 2021 edhe pse në proces gjyqësor me operatorin S. & S. S. ka vazhduar të marrë shërbime nga ky operator jashtë kontrate në vlerën 12,706,149 lekë, në kundërshtim me LPP. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandimi: Administratori dhe Zyra e financës e UKV SHA, të marrin masa për të parashikuar dhe realizuar procedura prokurimi sipas nevojave reale të shoqërisë në raport me plan buxhetet e saj me qëllim shmangien e pasojave financiare për shoqërinë në të ardhmen si dhe rritjen e pjesëmarrësve ofertues me qëllim përfitimin e një oferte sa më ekonomike, si dhe të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për evidentimin e personave përgjegjës dhe arkëtimin e dëmit ekonomik vlerën **1,031,546.42 lekë.**

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Deri më datën 11.08.2022, nga UKV Sh.a nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Referuar ndryshimeve vit pas viti të strukturës organizative, një nga sektorët që ka pësuar më shumë ndryshime është "Marrëdhënia me Publikun", pjesë e Stafit mbështetës, e cila nga 5 punonjës në vitin 2018, ka 11 punonjës në vitin 2021, zyrë e cila ka si funksion të punës së vetë: Hartimin, planifikimin dhe zbatimin e strategjive dhe platformave të komunikimit, nëpërmjet fushatave të rregullta informuese mbi çështje të lidhura me qëllimin e aktivitetit të Shoqërisë.
Nga analiza e treguesve të punës, konstatohet se:
-Në vitin 2018, zyra për Marrëdhëniet me Publikun ka patur 5 punonjës të cilët numrin total të ankesave e kanë patur 3136 ankesa, pra mesatarisht në 1 ditë pune (duke marrë parasysh dhe ditën e shtunë) 1 punonjës, ka pritur 2 ankesa.

-Në vitin 2019, zyra për Marrëdhëniet me Publikun ka patur 5 punonjës të cilët numrin total të ankesave e kanë patur 3832 ankesa, pra mesatarisht në 1 ditë pune (duke marrë parasysh dhe ditën e shtunë) 1 punonjës, ka pritur 2,44 ankesa.
-Në vitin 2020, zyra për Marrëdhëniet me Publikun ka patur 11 punonjës të cilët numrin total të ankesave e kanë patur 5128 ankesa, pra mesatarisht në 1 ditë pune (duke marrë parasysh dhe ditën e shtunë) 1 punonjës, ka pritur 1,48 ankesa.
Sa më sipër konstatohet se rritja e numrit të punonjësve në këtë zyrë nuk ka sjellë ndryshim në performancën e shoqërisë, dhe si e tillë është pa argumentuar dhe jo mirë menduar.
Vlera e paguar për periudhën objekt auditimi prej **2,880,000 lekë** (e përllogaritur 48,000 lekë*/punonjës *6 punonjës*10 muaj) përbën **efekt negativ** për buxhetin e UKV SHA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 66 - 76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandim: Nga Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë të merren masa për analizimin e **efektit financiar negativ** prej **2,880,000 lekësh** dhe numrin e punonjësve në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun, duke azhurnuar dhe koordinuar punën e kësaj zyre në mënyrë efektive dhe eficiente.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 187 prot., datë 31.01.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E. H. është hartuar një progarm (plan veprimi) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me shkresën nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, "Dërgohet Raporti i Auditimit".
Rekomandimi është në proces zbatimi.

2. Gjetje nga auditimi: Orët shtesë të punës janë orë pune të cilat kryhen në rastet e emergjencave të ndryshme të paparashikuara, si p.sh. avari në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm ose në rrjetin e kanalizimeve, në rastet e përmbytjeve ose të disa rrethanave/avarive të natyrave të ndryshme.
-Kryerja e orëve shtesë justifikohet me anë të një procesverbali që nënshkruhet nga drejtuesi i sektorit përkatës dhe nga punonjësi.
Duke u bazuar te relacionet e procesverbaleve, Administratori i UKV SHA, vendos për kompensimin e orëve shtesë të kryera ose ditë pushimi. Pas nënshkrimit nga Administratori procesverbali depozitohet në degën e financës.
-Llogaritja e orëve jashtë orarit të punës bëhet me masën 100% të pagës orare ditore duke u llogaritur mbi pagën baze sipas vendit të punës, dhe llogaritja është e njëjtë edhe në ditë feste.
Pasqyra nr. 1: *Të dhëna mbi orët e punës jashtë orarit*

UKV SHA	**Orë jashtë orari**	**Vlera ALL**
Periudha	**Ditë Normale**	**Ditë Normale**
01.04.2018 – 31.12.2018	1,752	302,376
Viti 2019	1,030	234,986
Viti 2020	5,635	1,497,410
01.01.2021 – 31.05.2021	3,539	767,759
Totali	**11,974**	**2,802,531**

Burimi i të dhënave*: Sektori i Financës, përpunoi grupi i auditimit*
Sa më sipër, bie në kundërshtim me Kodin e Punës, neni 87, pika 1 dhe 2 *"1. Puna e kryer në ditën e pushimit javor kompensohet me një shtesë page, jo më pak se 25 për qind, ose me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë, jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune. 2. Puna e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune, kompensohet me një shtesë mbi pagë, jo më pak se 25 për qind dhe me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare."*. Për rrjedhojë shuma prej **2,802,531 lekë** konsiderohet **efekt financiar negativ** në

buxhetin e Shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 66 -76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Sektori i Financës, të merren masa për analizimin e efektit financiar negativ dhe të marrë masa për korrigjimin e pagesave për orët shtesë sipas orëve dhe ditëve të punës, si dhe të nxirren përgjegjësitë për pagesën e vlerës prej **2,802,531 lekë**.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga UKV Sh.a janë ngritur pretendimet se,

Periudha	Orët jashtë orarit	Vlera me 100%	Vlera 125% në lekë	Diferenca
01.09.2021-31.12.2021	3,871	848,673	1,060,842	212,169
01.01.2022-31.08.2022	1,454	328,767	410,959	82,192
	5,325	1,177,440	1,471,801	294,361

Zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

3. Gjetje nga auditimi: Punonjësit që kanë dalë në pension kanë paditur në gjykatë ndaj UKV SHA lidhur me mos pagesën dhe mos njohjen e vjetërsisë në punë. Objekt i këtyre proceseve gjyqësore janë: pagesa e shtesës së pagës prej 2% për vjetërsinë në punë, detyrimi i pagesës lidhur me kontributet shoqërore dhe shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat personale TAP mbi shtesën e pagës të papaguar dhe pagesën e fitimit të munguar, vlerën e kamatës ligjore mbi shumën që rezulton nga përllogaritja e shtesës 2% të pagës. Lidhur me këto çështje nga UKV SHA është humbur **1 çështje** në Gjykatën e Shkallës të Parë, Vlorë në vlerën **1,574,208 lekë**, në **2 çështje** vlera e cila kërkohet pas aktit të ekspertimit është **4,691,253 lekë plus shpenzimet gjyqësore**, dhe për **3 çështje** janë në shqyrtim, pritet dalja e aktit të ekspertimit për tu përcaktuar vlera e mundshme. Sa më sipër vlera **1,574,208 lekë** konsiderohet **efekt financiar negativ** në buxhetin e Shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 66-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Nga Këshilli i Administrimit, Administratori, sektori i Financës dhe Burimet Njerëzore të Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA të merren masa lidhur me njohjen dhe përllogaritjen e saktë të vjetërsisë punë, të analizohet vlera e efektit financiar negativ prej 1,574,208 lekësh, në mënyrë që të shmangen në të ardhmen proceset gjyqësore lidhur me vjetërsinë në punë, si dhe të nxirren përgjegjësitë për pagesën e vlerës prej **1,574,208 lekë**.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga UKV Sh.a janë ngritur pretendimet se, për punonjësit që dalin në pension vazhdojnë procedurat në gjykatë për shpërblimin e vjetërsisë në punë nga shtatori 2021-korrik 2022 janë ekzekutar 3 vendime gjyqësore në vlerën 12,910,630 lekë. Për përfshirjen e vjetërsisë në punë në pagë është realizuar në programin ekonomik të vitit 2022 dhe në strukturën e pagave për vitin 2022 të cilat janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 2, datë 05.04.2022, "Miratimi i strukturës për vitin 2022", nr. 4, datë 05.04.2022, "Miratimi i programit ekonomik 2022", nr. 3, datë 06.04.2022, "Miratimi i programit ekonomik 2022". Për nëpunësit është vendosur shtesë vjetërsie në punë 2% në vit mbi nivelin e diplomës dhe për punonjësit 1% në vit mbi nivelin e pages bazë 18,000 lekë.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

4. Gjetje nga auditimi: Për proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, konstatohet se janë humbur 4 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **3,379,000 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe

shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë në gjykim 3 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlorë, të cilat në Gjykatën e Shkallës të Parë Vlorë janë fituar nga UKV SHA; në vlerën **5,584,500 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **3,379,000 lekë** *e cila konsiderohet efektit financiar negativ* për buxhetin e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 66-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Nga Administratori, sektori Juridik dhe Burimet Njerëzore të Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA, të merren masa për analizimin e vlerës prej **3,379,000 lekë**, të efektit negativ dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave te shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 187 prot., datë 31.01.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E. H. është hartuar një progarm (plan veprimi) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me shkresën nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, "Dërgohet Raporti i Auditimit". Zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Nga Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA është paguar përmbaruesi privat J. U. në vlerën **3,630,769 lekë**. Këto pagesa janë kryer për mbledhjen e detyrimeve të klientëve debitorë ndaj ujësjellësit. Marrëveshja me përmbaruesin privat lidhet individualisht për çdo klient rast pas rasti, dhe shpenzimet përmbarimore janë paguar nga UKV SHA, bazuar në klauzolën 7 të kontratës tip "*Shpenzimet përmbarimore janë kostot financiare që shërbejnë për të kryer veprime të caktuara përmbarimore dhe përmbajnë shpenzime të nevojshme për kryerjen e veprimeve proceduriale për ekzekutimin e titujve ekzekutivë në bazë të nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat paguhen nga pala që i ka shkaktuar ato, por në veprimtarinë e përditshme paguhen nga kreditori dhe/ose subjekti përmbarues dhe që në fund të ekzekutimit vilen së bashku me detyrimin nga debitori ose personi i barazuar me të.*"
Nga ana e përmbaruesit ligjor janë ekzekutuar 12 tituj ekzekutive (pra kanë shlyer debinë kundrejt UKV SHA), në vlerën **1,063,155 lekë**, dhe i janë **kthyer UKV SHA 247,783 lekë** shpenzime përmbarimore. Nëse i referohemi Udhëzimit Nr. 1276/5, datë 27.7.2017 "*Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror*", pika III.2 dhe Udhëzimit të Përbashkët "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat", pika III. 2, rezulton se nëse do të ishte kontraktuar përmbarimi shtetëror, tarifa fikse minimalisht do të ishte përgjysmuar, duke ulur në këtë mënyrë riskun dhe marzhin e humbjes të tarifës fikse.

	Përmbarimi Gjyqësor Privat	**Përmbarimi Gjyqësor Shtetëror**	**Diferenca (më pak) e shprehur në përqindje**
Vlera e detyrimit nga ... ALL deri në ... ALL	**Tarifa fikse (në lekë ose në përqindje mbi vlerën e detyrimit)**	**Tarifa fikse (në lekë ose në përqindje mbi vlerën e detyrimit)**	
1 - 100,000	15,000 lekë	7,000 lekë	47%
100,001 - 300,000	22,000 lekë	11,000 lekë	50%
300,001 - 500,000	30,000 lekë	15,000 lekë	50%
500,001 – 2,000,000	10 %	4.5%	5.5%
2,000,001 – 5,000,000	8 %	4%	4%
5,000,001 – 10,000,000	7 %	3.5%	3.5%
10,000,001 - 30,000,000	6 %	3%	3%
30,000,001 – 90,000,000	4 %	2.5%	1.5%
mbi 90,000,000	3 %, por jo më shumë se 15 milionë lekë	2%, por jo më shumë se 5 milionë lekë	1%

Sa më sipër, vlera e cila rrjedh nga diferenca mes pagesave që ka bërë Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA drejt përmbaruesit privat, me vlerën e kthyer mbrapsht nga përmbarimi, prej **3,382,986 lekë** konsiderohet efekt financiar negativ nga shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 76-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë, sektori i Financës dhe sektori Juridik, të merren masa për analizimin e vlerës të efektit negativ financiar dhe bashkëpunimin me organin e përmbaruesve shtetërorë lidhur me mbledhjen e detyrimeve të klientëve debitorë ndaj shoqërisë, si dhe të nxirren përgjegjësitë për pagesën e vlerës prej **3,382,986 lekë**.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga UKV Sh.a janë ngritur pretendimet se, nga periudha shtator 2021 e në vazhdim nuk kemi çuar asnjë debitor për vjeljen e detyrimeve të prapambetura, për këtë arsye nuk kemi paguar tarifa përmbarimore për vjeljen e detyrimeve. Zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

6. Gjetje nga auditimi: Nga UKV SHA më datë 04.11.2019, në bankën BKT, është **likuiduar ekzekutimi vullnetar** me nr. 1139, datë 29.10.2019, shlyerje detyrimi në vlerën **2,692,938 lekë**, ndaj Z. M. për 4 fatura tatimore shitjeje. Me vendimin e Gjykatës të Shkallës të Parë Vlorë nr. 1828, datë 24.10.2019, është lëshuar urdhri i ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes: nr. 04, datë 05,02,2019, fatura nr. 03, datë 05.02.2019, fatura nr. 62, datë 04.02.2019 dhe fatura nr. 205, datë 16.08.2021. Nga zyra e përmbaruesit privat gjyqësor Y. H., me shkresë nr. 1139, datë 29.10.2019 "Lajmërim për ekzekutim vullnetar", është kërkuar likuidimi i detyrimit ndaj kreditorit në vlerën **2,454,324 lekë** dhe shpenzime e tarifë fikse përmbarimore në vlerën **238,614 lekë**. Sa më sipër, vlera prej **238,614 lekë** konsiderohet **efekt financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 76-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe sektori i Financës, të merren masa për zbatimin e përcaktimeve të kontratave dhe shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj furnitorëve, si dhe të nxirren përgjegjësitë për pagesën e vlerës prej **238,614 lekë**.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga UKV Sh.a janë ngritur pretendimet se, nga periudha shtator 2021 deri më datë 11.08.2022, është likuiduar detyrimi i shoqërisë A. SHPK me NIPT K14229210F dhe vlera e tarifës përmbarimore është në shumën 933,363 lekë. Zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

7. Gjetje nga auditimi: Nga UKV SHA, me urdhër transfertën nr. 205/260, datë 09.10.2019, urdhër transfertën nr. 205/26087; datë 04.11.2019, dhe urdhër transfertën nr. 205/260667, datë 15.11.2019, në bankën BKT, janë likuiduar 3 gjoba për kundërvajtje në vlerën 45,000 lekë. Këto kundërvajtje vijnë si pasojë e mos njohjes dhe vonesave të aplikimit për depozitimin e Pasqyrave Financiare dhe Raporteve të Auditit. Refuzimi i aplikimit ka ardhur si pasojë e përfundimit të afatit të përfaqësimit të administratorit D. Xh., në datën 21.07.2019. Sa më sipër, vlera prej **45,000 lekë** konsiderohet **efekt financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 76-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe sektori i Financës, të merren masa për hartimin në kohë të Pasqyrave Financiare dhe zbatimin e afateve administrative, në mënyrë që

shmangen efektet negative që i shkaktohen shoqërisë, si dhe të nxirren përgjegjësitë për pagesën e vlerës prej **45,000 lekë.**

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Për pasqyrat financiare të viteve 2020-2021, konstatohet se nuk janë marrë gjoba si pasojë e mos deklarimit në kohë të depozitimit të pasqyrave financiare në QKB.
Rekomandimi deri më datë 11.08.2022, është zbatuar.

8. Gjetja nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton një mos argumentim i shpërblimit të ish administratorit të UKV SHA njëkohësisht dhe anëtarit të KAD të UKV SHA, D. Xh. në masën 20 % të pagës mujore të Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës për periudhën 21.07.2016 e në vijim",**(në vlerën 714,000 lekë), i cili është efekt financiar negativ për shoqërinë UKV SHA** referuar rezultatit financiar negativ të shoqërisë, situatën e bllokimit të llogarive nga palët e treta, detyrimet dhe likuidimet e taksave dhe tarifave vendore deri në vitin 2020, referuar shkresës nr. 127, datë 18.01.2021 nga ish administratori i UKV SHA Sh. L. drejtuar Asamblesë së Përgjithshme/ Bashkisë Vlorë të UKV SHA.
-Referuar vendimmarrjes së Këshillit të Administrimit të UKV SHA, Vendimit nr. 4, datë 10.01.2020 "Për shpërblimin e anëtarit te KAD njëkohësisht administratorit D. Xh. në masën 20% të pagës mujore të Sekretarit te Përgjithshëm te Prefekturës për periudhën 21.07.2016 e në vijim" , nuk ka një argumentim mbi ç'baza është marrë ky vendim për shpërblimin e ish administratorit të UKV SHA D. Xh. nga data 21.07.2016-06.08.2020, ku sipas shkresës nr. 127, datë 18.01.2021 nga ish administratori i UKV SHA Sh. L. drejtuar Asamblesë se Përgjithshme/ Bashkisë Vlorë të UKV SHA, detyrimet totale për tu paguar nga UKV SHA ndaj Bashkisë Vlorë deri në fund të vitit 2020 janë në vlerën 169,960,610 lekë. Nga këto deri në Janar të vitit 2021 janë likuiduar 46,883,127 lekë, pra janë likuiduar vetëm 27,6 % e totalit të tyre dhe ngelen për tu likuiduar vlera 123,077,483 lekë. Kjo pamundësi pagese nga UKV SHA, pretendohet se ka ardhur si pasojë e bllokimit të llogarive të UKV SHA nga OSHEE SHA dhe ekzekutimi i kryer prej saj në vlerën 96,416,668 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA gjatë veprimtarisë së tij të marrë masa për të analizuar **vlerën 714,000 lekë** të miratuar me vendimin nr. 4, datë 10.01.2020 "Për shpërblimin e anëtarit te KAD njëkohësisht ish administratorit D. Xh. në masën 20% të pagës mujore të Sekretarit te Përgjithshëm te Prefekturës për periudhën 21.07.2016 e në vijim", **i cili është efekt financiar negativ për shoqërinë UKV SHA** referuar performancës me humbje të shoqërisë vit pas viti, situatën e bllokimit të llogarive nga palët e treta, detyrimet dhe likuidimet e taksave dhe tarifave vendore deri në vitin 2020, si dhe të nxirren përgjegjësitë për pagesën e vlerës prej **714,000 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit për zbatimin e rekomandimeve nga UKV Sh.a janë ngritur pretendimet se, paga e ish-Administratorit të Shoqërisë z. Sh. L. si anëtar i Këshilit të Administrimit për periudhën nga data 07.08.2020, deri më 21.09.2021, është vlerën 229,499 lekë (17,000 është paga mujore) si dhe Administratori znj. E. H. për periudhën 22.09.2021, deri në muajin korrik 2022 është në vlerën 175,410 lekë (17,000 lekë është paga mujore).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

9. Gjetje nga auditimi: 1. Me kërkesën për transfertë datë 20.09.2018 drejtuar Intesa Sanpaolo Bank janë likuiduar faturat për riparim automjete si dhe faturat tatimore Nr.

160,176,169,173,170 për blerje materiale për automjete me vlerë totale 1,313,100 lekë. Për faturat e blerjes së materialeve, të cilat nuk janë pjesë e kontratës së mirëmbajtjes së mjeteve, duke qenë se janë nën vlerën limit 100,000 lekë për blerjeve te vogël, konstatohet se nuk i janë bashkëlidhur tre oferta. Gjithashtu për vlerën e likuiduar prej 268,210 lekë nuk dokumentohet kërkesa e nevojave për këto materiale nga sektori përkatës si dhe gjendja e magazinës në momentin e kryerjes së blerjes, konkretisht kjo e ndarë sipas faturave: nr. 160 datë 14.08.2018 me vlerë 236,350 lekë; nr. 169 datë 16.08.2018 me vlerë 7,760 lekë; nr. 170 datë 14.08.2018 me vlerë 8,000 lekë; nr. 173 datë 17.08.2018 me vlerë 10,500 lekë; nr. 176 datë 17.08.2018 me vlerë 5,900 lekë, pra mungon dokumentacioni mbështetës për nevojën e tyre.
2. Me urdhër transfertë datë 08.05.2019 janë likuiduar faturat për riparimin e mjeteve sipas kantatës dhe blerje materialesh te ndryshme vlerë 2,291,708 lekë. Për vlerën e likuiduar prej 144,150 lekë nuk dokumentohet kërkesa e nevojave për këto materiale nga sektori përkatës si dhe gjendja e magazinës në momentin e kryerjes së blerjes, konkretisht kjo e ndarë sipas faturave: nr. 41 datë 28.02.2019 me vlerë 68,150 lekë; nr. 27 datë 20.02.2019 me vlerë 10,500 lekë; nr. 02 datë 18.01.2019 me vlerë 33,000 lekë; nr. 305 datë 17.01.2019 me vlerë 22,500 lekë, pra mungon dokumentacioni mbështetës për nevojën e tyre.
Sa më sipër **vlera prej 412,360 lekë**, (268,210+144,150) pa dokumentacionin justifikues (kërkesa për nevojën e materialeve dhe gjendja e magazinës në momentin e blerjes) nga grupi i auditimit **konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për buxhetin e shoqërisë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 76 - 99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: UK Vlorë të marri masa, që në të ardhmen, për blerjet e vogla të kryhen sipas kërkesave dhe nevojave të veprimtarisë së saj duke shmangur kostot shtesë që mund të rendojnë në buxhetin e saj dhe të nxjerr përgjegjësitë për pagesën e vlerës prej **412,360 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022). **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit transfertat bankare, për periudhën objekt auditimi, konstatohet se bashkëlidhur pagesave për likuidimin e dietave mungojnë urdhrat e punës, arsyeja e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues. Konkretisht: për vitin 2018 janë kryer pagesa, likuidim dietash ditore, në vlerën 776,160 lekë; për vitin 2019 janë kryer pagesa, likuidim dietash në vlerën 1,120,365 lekë; për vitin 2020 janë kryer pagesa, likuidim dietash në vlerën 190,000 lekë; për vitin 2021 janë kryer pagesa, likuidim dietash në vlerën 142,950 lekë. Nga grupi i auditimit **vlera totale prej 2,229,475 lekë** e likuiduar pa dokumentacionin justifikues **konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për buxhetin e shtetit dhe shoqërisë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe VKM me nr. 329, datë 20.4.2016 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 76-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandimi: Shoqëria e UK Vlorë të marri masa, që në të ardhmen, likuidimet e dietave të kryhen të shoqëruara me dokumentacionin e plotë justifikues duke shmangur shpenzimet e pa nevojshme që rëndojnë në buxhetin e saj, si dhe të nxirren përgjegjësitë për pagesën e vlerës prej **2,229,475 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 187 prot., datë 31.01.2022, të administratorit të shoqërisë znj. E. H. është hartuar një progarm (plan veprimi) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me shkresën nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, "Dërgohet Raporti i Auditimit". Zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për t'u verifikuar në auditimet në vijim.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

11. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit me objekt: "*Blerje matësa uji për vitin 2018*", me fitues OE "F. G." SHPK me vlerë 16,695,000 lekë pa TVSH dhe *"Furnizim vendosje matësash për vitin 2019"*, me fitues OE *"A. S. G." SHPK* me vlerë 12,290,145 lekë pa TVSH, janë blerë dhe vendosur matësa uji me specifikime teknike *"Matësi i ujit duhet të ofrojë mundësinë dhe të jetë kompatibel me teknologjinë e Leximit Automatik te Matësit, të suportojë vendosjen e një moduli transmetues të të dhënave me valë në përputhje me standardin EN 13757-4 ose ekuivalent. Në rast se matësit do ti vendoset modul për transmetim të dhënash me valë matësi duhet të ketë mundësinë të sinjalizojë minimalisht për: rrjedhje të ujit, ndërhyrje në seksionin lidhës ndërmjet matësit dhe modulit, shkëputjen e modulit nga matësi ose dëmtimin e tij, rrjedhjen e ujit në drejtim të kundërt".* Blerja e matësave me specifikime teknike që të kenë pajisje për monitorimin në distancë është jashtë kapaciteteve të UK Vlorë dhe e pa argumentuar pasi nuk ka të instaluar një sistem monitorimi në distancë dhe as ka të parashikuar ndërtimin e një të tillë, për vetë kushtet financiare të saj si dhe jetëgjatësia e matësave është e vogël. Vlera e matësave në procedurën e prokurimit "*Blerje matësa uji për vitin 2018*" është 14,761,000 lekë pa TVSH dhe në procedurën *"Furnizim vendosje matësash për vitin 2019"* është 5,994,000 lekë pa TVSH, pra në total **20,755,000 lekë** pa TVSH. Sa më sipër vlera e matësave te blerë dhe të instaluar prej 20,755,000 lekë pa TVSH konsiderohet **shpenzim pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për buxhetin e shoqërisë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe Udhëzim 30 datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1. Rekomandimi: UK Vlorë të marrë masa që specifikimet teknike për mallrat e nevojshme që prokurohen të jenë në koherencë me sistemin e shpërndarjes të furnizimit me ujë si dhe brenda mundësive teknike e financiare të saj duke shmangur kështu efektet negative në buxhetin e shtetit e shoqërisë, si dhe të nxirren përgjegjësitë për pagesën e vlerës prej **20,755,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim është në proces verifikimi nga grupi i auditmit (Në zbatim të programit të auditimit nr. 553/1 prot., datë16.06.2022, me afat auditimi deri më datën 26.08.2022).
Rekomandimi është në proces zbatimi.

D. MASA DISIPLINORE

Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas personave përgjegjës i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit si dhe Administratorit të Shoqërisë, që mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme të Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA si dhe në Kontratën Individuale të Punës ,të marrë masat disiplinore si më poshtë:

I. Nga "**Vërejtje" deri në "Paralajmërim për ndërprerje të kontratës së punës", për:**

1. znj. R. A., me detyrë Drejtore Tregtare në UKV SHA, për periudhën objekt auditimi 2018 – 2021:

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, të Këshillit të Administrimit në pikën 5 citohet se, "Të ngarkojë Administratorin e Shoqërisë që nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore të aplikojë masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" për të gjithë punonjësit e përcaktuar në seksionin E të Raportit Përfundimtar të KLSH". Me shkresën nr. 357 prot., datë 21.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E. H. është dhënë masë disiplinore "Vrejtje me shkrim" për znj. R. A.
Rekomandimi është zbatuar.

2. z. K. R., me detyrë Kryetar i Degës Juridike në UKV SHA, për periudhën objekt auditimi 2020-2021:

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, të Këshillit të Administrimit në pikën 5 citohet se, "Të ngarkojë Administratorin e Shoqërisë që nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore të aplikojë masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" për të gjithë punonjësit e përcaktuar në seksionin E të Raportit Përfundimtar të KLSH". Me shkresën nr. 350 prot., datë 21.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E. H. është dhënë masë disiplinore "Vrejtje me shkrim" për z. K. R..
Rekomandimi është zbatuar.

3. znj. L. M., me detyrë shefe e Financës në UKV SHA, për periudhën objekt auditimi 2020-2021:

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, të Këshillit të Administrimit në pikën 5 citohet se, "Të ngarkojë Administratorin e Shoqërisë që nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore të aplikojë masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" për të gjithë punonjësit e përcaktuar në seksionin E të Raportit Përfundimtar të KLSH". Me shkresën nr. 356 prot., datë 21.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E. H. është dhënë masë disiplinore "Vrejtje me shkrim" për znj. L. M.
Rekomandimi është zbatuar.

4. znj. E. Ç., me detyrë Përgjegjëse e Marrëdhënieve me Publikun në UKV SHA, për periudhën objekt auditimi 2018 – 2021:

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, të Këshillit të Administrimit në pikën 5 citohet se, "Të ngarkojë Administratorin e Shoqërisë që nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore të aplikojë masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" për të gjithë punonjësit e përcaktuar në seksionin E të Raportit Përfundimtar të KLSH". Me shkresën nr. 355 prot., datë 21.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E. H. është dhënë masë disiplinore "Vrejtje me shkrim" për znj. E. Ç.
Rekomandimi është zbatuar.

5. z. P. Sh., me detyrë Përgjegjës i Mjeteve Motorike

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, të Këshillit të Administrimit në pikën 5 citohet se, "Të ngarkojë Administratorin e Shoqërisë që nëpërmjet

Sektorit të Burimeve Njerëzore të aplikojë masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" për të gjithë punonjësit e përcaktuar në seksionin E të Raportit Përfundimtar të KLSH". Me shkresën nr. 354 prot., datë 21.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E. H. është dhënë masë disiplinore "Vrejtje me shkrim" për z. P. S.
Rekomandimi është zbatuar.

6. z. N. Ç., me detyrë Përgjegjës i njësisë Novoselë,

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, të Këshillit të Administrimit në pikën 5 citohet se, "Të ngarkojë Administratorin e Shoqërisë që nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore të aplikojë masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" për të gjithë punonjësit e përcaktuar në seksionin E të Raportit Përfundimtar të KLSH". Me shkresën nr. 353 prot., datë 21.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E.H. është dhënë masë disiplinore "Vrejtje me shkrim" për z. N. C.
Rekomandimi është zbatuar.

7. z. A. M., me detyre taskë forcë në Menaxhim Shitje Terreni,

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, të Këshillit të Administrimit në pikën 5 citohet se, "Të ngarkojë Administratorin e Shoqërisë që nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore të aplikojë masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" për të gjithë punonjësit e përcaktuar në seksionin E të Raportit Përfundimtar të KLSH". Me shkresën nr. 352 prot., datë 21.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E.H. është dhënë masë disiplinore "Vrejtje me shkrim" për z. A. M.
Rekomandimi është zbatuar.

8. znj. L. M. me detyrë P/klorinimi, në cilësinë e anëtares të Komisionit të Vlerësimeve.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, të Këshillit të Administrimit në pikën 5 citohet se, "Të ngarkojë Administratorin e Shoqërisë që nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore të aplikojë masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" për të gjithë punonjësit e përcaktuar në seksionin E të Raportit Përfundimtar të KLSH". Me shkresën nr. 351 prot., datë 21.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E.H. është dhënë masë disiplinore "Vrejtje me shkrim" për znj. L. M.
Rekomandimi është zbatuar.

9. z. S. N. me detyrë P/Sektorit të Kanalizimeve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimeve.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, të Këshillit të Administrimit në pikën 5 citohet se, "Të ngarkojë Administratorin e Shoqërisë që nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore të aplikojë masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" për të gjithë punonjësit e përcaktuar në seksionin E të Raportit Përfundimtar të KLSH". Me shkresën nr. 358 prot., datë 21.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë znj. E.H. është dhënë masë disiplinore "Vrejtje me shkrim" për z. S. N.
Rekomandimi është zbatuar.

IV KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN "KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE"

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Në procedurën e prokurimit për kontratën *"Shërbime Mbikëqyrje për rrugën Pogradec-Tushemisht"* rezulton se mënyra e prokurimit ka qenë procedurë kombëtare me metodën e përcaktuar "Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentit (CQS)". Zhvillimi i kësaj procedure referuar rregullores së Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FP1, 1.07 2016, Seksioni VII, Metoda të Aprovuara të Përzgjedhjes së Shërbimeve të Konsulencës, pika 7.*12 është e përshtatshme për detyra të vogla ose situata emergjente për të cilat nuk justifikohet vlerësimi i propozimeve konkurruese*, gjithashtu referuar Manualit Operacional të Projekt, Pika 3, tabela 3.1 është përcaktuar kushti *Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentin nën 300,000$,* në *varësi të natyrës se detyrave.* Për më tepër në Strategjinë për Zhvillimin e Prokurimeve të Projektit PPSD, pika IV-Objektivat e Prokurimeve, pika 2.2 specifikohet për *(CQS) afati i përllogaritur është afërsisht 4-6 muaj përfshirë periudhën e nevojshme për përgatitjen dhe dakortësimin e termave të referencës.* Mbështetur në Udhëzimet për Prokurime të Bankës Botërore, dokumenti "Strategjia për Zhvillim të Prokurimeve të Projektit, Udhëzues i Detajuar Format i Shkurtër, Korrik 2016", rekomandohet argumentimi dhe logjik për Mënyrën e Prokurimit të zgjedhur. Konkretisht kjo procedure prokurimi ka zgjatur 9 muaj pra më shumë sesa periudha e përcaktuar si kriter për përzgjedhjen e saj, gjithashtu nuk është argumentuar përzgjedhja e kësaj metode për këto shërbime mbikëqyrje nga ana e Klientit duke mos marrë në konsiderate natyrën e detyrës për shërbimin e mbikëqyrjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia Prokurimit, të marrë masa që të analizojë metodologjitë e përzgjedhjes së mënyrave të prokurimit e ti argumentoje ato sipas kritereve për zgjedhjen e tyre.

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Në 10 (dhjetë) procedurat e prokurimit, në tre raste rezultuan se ofertat e operatorit fitues janë anomalisht të ulëta, konkretisht:

Për procedurën e prokurimit *"Rehabilitimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll"* rezulton se oferta e dhënë nga OE fitues *"G. 2 ltd"* me vlerë 15,001,025.77 US$ me tvsh është 14,123,79 US$ me TVSH, më e ulët se vlera e fondit limit ose 48.4% më e ulët.

Për procedurën e prokurimit *"Rikonstruksion i rrugës Lekdush-Bençë-Tepelenë, Loti 2"* rezulton se oferta e dhënë nga OE fitues *"C. O. I. S. Ve T. AS"* me vlerë 2,474,793 US$ me TVSH është 2,240,907 US$ më e ulët se vlera e fondit limit ose 47.5% me e ulët.

Për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht"* rezulton se oferta e dhënë nga BOE fitues *"4.M" shpk dhe "G.L." shpk* me vlerë 377,388,382 lekë me TVSH është 243,342,298 lekë më e ulët se vlera e fondit limit ose 40% me e ulët.

Në gjykimin e grupit të auditimit ofertat vlerësohen si anomalish të ulëta në krahasim me koston e planifikuar dhe me ofertat e ofertuesve të kualifikuar në secilën procedurë si dhe krahasimet e çmimeve të dhëna me manualet e miratuar. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit të këtyre procedurave nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion justifikues apo analizë të detajuar për të mbështetur ofertën e OE, përpara se të merrte vendim për kualifikimin e tyre duke ju referuar metodologjisë së vlerësimit. Për sa më sipër në kundërshtim me Manualin e Prokurimeve të BB për huamarrësit e EFP1 datë 01.07.2016, pika 5.66 dhe 5.77. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa që të analizojë ofertat e OE, dhe në rastet kur ato janë anomalish të ulëta të kërkojë dokumentacion justifikues shtesë dhe analizë të detajuar të çmimeve, përpara se të marrë vendim për kualifikimin, me qëllim eliminimin e risqeve në realizimin e kontratave në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Në vijimësi

3. Gjetja nga auditimi: Ndryshimi i kushteve të pagesës së konsulentit jashtë kërkesave të termave të referencës për "Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore", Kontrata RLRCP/1/1.9/2018.
Në raportin e vlerësimit datë 11 Shtator 2019, është rekomanduar lidhja e kontratës me konsulentin JV "Fred engineering" srl & "I." sh.p.k. me vlerën prej 187,680 USD përfshirë TVSH.
Negociatat për lidhjen e kontratës me aplikantin potencial fitues të sipërcituar janë kryer në datat 12 dhe 18 Shtator 2019.
Gjatë këtyre negociatave në datën 18.09.2019 është vendosur për ndryshimet si më poshtë:
-Në pikën 6 të Minutave të Takimit, është hequr pagesa në avancë (paradhënie) e konsulentit dhe pagesat për konsulentin janë ndryshuar si më poshtë:
-Fatura e dorëzuar pas përgatitjes të Raportit Fillestar dhe Raportet e Auditimit për tre segmentet e para të jetë 30 % e shumës totale të kontratës;
-Fatura pas dorëzimit të projektit dhe planit të ndërhyrjes për zonën pilot të jetë 40 % e shumës totale të kontratës;
-Fatura pas Raportit të Auditimit për segmentin e katërt rrugor të jetë 20 % e shumës totale të kontratës;
-Pagesa e mbetur 10 % pas mbikëqyrjes së zonës pilot dhe pranimit të Raportit përfundimtar.
Por, në Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 "Termat e Referencës", pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH) është përcaktuar se lidhur me pagesat për Konsulentin, ai duhet të dorëzojë faturat sipas programit si më poshtë:
(i) Financimi paradhënie: Konsulenti ka të drejtë që me nënshkrimin e kontratës të paguhet me një paradhënie prej 20 % të çmimit total të vlerësuar përkundrejt një garancie bankare për shumën e marrë dhe e vlefshme deri në përfundimin e punës së kryer.
(ii) Pagesa e faturës: Konsulenti do të lëshojë 3 fatura për shërbimet e kryera pas miratimit nga FSHZH deri në madhësinë prej 70 % të kontratës. Shuma prej 10 % e mbetur do të jetë paguar pas përfundimit dhe pranimit të Raportit Përfundimtar.
(iii) Pagesa prej 10 %: Pas mbikëqyrjes të masave të implementuara dhe dorëzimit të Raportit Përfundimtar.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, gjithashtu, është në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 "Termat e Referencës", pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH).
Veprimet e mësipërme kanë sjellë si pasojë mospërputhje midis dispozitave të parashikuara gjatë procesit të prokurimit dhe situatës së krijuar. Sa sipër, ndryshimi i mënyrës së pagesës së Konsulentit ka sjellë si pasojë rritjen e riskut për përfundimin e detyrave të tij. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ardhmen në drejtim të menaxhimit me risk sa më të ulët të kontratave të konsulencës.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE
C.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE
C.1.1 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", Manualin e Procedurave të FSHZH, pika 7.11, germa g, kontratat individuale të punës, neni 12, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore ***"Vërejtje"*** *për personat si më poshtë:*

1. *Z. E. O.* me detyrë Drejtor Departamentit të Menaxhimit të Projekteve, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
2. *Z. D. M.* me detyrë specialist në Njësinë e Zbatimit, Departamenti i Infrastrukturës, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
3. *Z. L. M.* me detyrë P/Njësinë e Zbatimit të Projektit Utilitare, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

2. FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN "FUMIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE III"

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të projektit "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" u konstatuar se, dosjet e prokurimit nuk ishin te inventarizuara dhe arkivuara, gjithashtu shumë prej shkresave, kontratave amendamenteve rezultuan të pa protokolluara, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 36-44 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa për protokollimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të zhvilluara për këtë Projekt në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për projektin "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" nuk është hartuar një Plan Prokurimi, veprime këto në kundërshtim me Kapitullin 9, nënpika 9.1, Fazat e procesit të prokurimit të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 36-44 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, strukturat përkatëse të prokurimit sipas rastit, të marrin masa që në të ardhmen përpara kryerjes së procedurave të prokurimit për realizimin e projekteve të miratuara më parë, të planifikojnë dhe dokumentojnë prokurimet që do të kryhen në fazën e parashikimit në konformitet me ligjet, rregullat dhe manualet në fuqi.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurat e realizimit të projekteve që në fazën e studimit të fizibilitetit, referuar edhe skeduleve apo manualeve për zbatim të projekteve të miratuara nga donatori, u konstatua se angazhimi i strukturave përkatëse të FSHZH në projektin "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" ka qenë i pjesshëm dhe megjithatë në këto raste është shoqëruar nga mungesa e gjurmës së auditimit, veprime këto në kundërshtim me Appendix 2, RWSP IMPLEMENTATION FRAMEWORK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 36-44 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Drejtoria Juridike, Drejtoria Teknike, të marrin masa që në të ardhmen të angazhohen në çdo projekt në konformitet me manualet dhe

rregulloret në fuqi me qëllim përmirësimin e cilësisë së ekzekutimit të projekteve si nga ana ligjore por edhe nga ana teknike duke pasur parasysh lënien e gjurmës së auditimit.

Menjëherë

3. AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (ACC)

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Me urdhrin nr. 152, datë 24.03.2021, është ngritur nga titullari AAC komisioni për hartimin e termave të referencës dhe përllogaritjes së fondit limit për procedurën "Asistencë për hartimin dhe negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës". Procedura për fillimin e procedurës nga urdhri i prokurimit, ftesat/ofertë, argumentimi i kritereve, hartimi i termave të referencës, datojnë më 24.03.2021, pra brenda 1 dite pa u konsumuar edhe afati 3 ditor i përcaktuar në urdhrin e prokurimit nga Titullari. Kjo procedurë është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 10.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Kreu II, pika 1 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 40, pasi nuk mund të kryhej nga AAC, por nga vetë Ministria, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Ministria duhet të zhvillonte procedurën dhe të mbulonte koston e procedurës së shërbimit "Asistencë për hartimin dhe negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Mbulimi i shpenzimeve të kësaj natyre e kthen AAC në rolin e financuesit duke sjellë rritje të shpenzimeve, për më tepër në vitin ku AAC ka rezultuar me humbje *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme të marrin masa që në të ardhmen të analizojnë kërkesat e ardhura nga MIE (për prokurime) dhe në çdo rast të përmbushen vetëm nëse ato janë në interes të AAC, si edhe në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi të përcaktuara për çdo Autoritet Kontraktor, me qëllim që mbulimi i shpenzimeve të kësaj natyre të mos kthej AAC në rolin e financuesit duke sjellë rritje të shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nuk është paraqitur në Këshillin Drejtues një raport i hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave, të dhënat e regjistrave, si dhe rastet e trajtimit të kërkesave të, qoftë nga operatorët, qoftë nga konsumatorët, që i janë paraqitur autoritetit. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 111.02.2010 "Për autoritetin e aviacionit civil", neni 13, pika iii. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 45-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, dërgimit të raportit të hollësishëm në Këshillin Drejtues për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave dhe të dhënave të regjistrave.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit"Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së" me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2020, Komisioni për llogaritjen e fondit limit ka hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës dhe fondin limit për procedurën e prokurimit "Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC" prej 2,198,500 lekë. Fondi i llogaritur nga komisioni i përbërë nga A. D., S. K. dhe E. K. është 232,534 lek më i lartë se kontrata aktuale, element që ngarkon me përgjegjësi komisionin pasi:

-Së pari vlera e aseteve të siguruar për vitin 2020 është 105,514,767 lekë ndërsa për vitin 2019 kjo vlerë arrinte në 111,909,234 lekë pra vlera e aseteve ka rënë me 6,394,467 lek ose me 0.5% ndërkohë që vlera e fondit limit e llogaritur nga komisioni është rritur me 11.8%. Kjo lidhje duhet të jetë e drejt e jo e zhdrejtë.
-Së dyti AAC ka një kontratë të realizuar me sukses dhe nuk është e nevojshme marrja e ofertave, madje duke marrë oferta dukshëm më të larta se kontrata e mëparshme ndërkohë që vlera e aseteve ka rënë;
-Veprimet e mësipërme kanë sjellë një fryrje të pa justifikuar të fondit limit me një efekt financiar për buxhetin e institucionit AAC në vlerën 2,197,950 lekë (oferta e suksesshme) - 1,964,600 lekë (kontrata e mëparshme) = **233,350 lekë , vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 pika b) VKM 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Neni 59 Përllogaritja e vlerës limit të kontratës 1 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi:AAC, në çdo rast përpara nxjerrjes së fondit limit duhet të analizoj të gjithë faktorët e nevojshëm të cilët kanë ndikim financiar, teknik dhe juridik në përllogaritjen e fondit me qëllim administrimin sa më të mirë të fondeve publike. AAC të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ato ligjore për arkëtimin e shumës **prej 233,350 lek** nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit.

Menjëherë

4. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

A. MASA ORGANIZATIVE

1 Gjetje nga auditimi. Bordi i menaxhimit ka dokumentuar veprimtarinë nëpërmjet vendimeve të marra dhe të nënshkruara. Bordi i menaxhimit ka shqyrtuar propozimet e dërguara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të ARrSh, dhe ka marrë vendimet në lidhje me miratimin e hartimit të buxhetit vjetor dhe ri-alokimet e fondeve financiare, kalimin kapital të aktiveve, ankandin e aseteve, miratimin e rregullores së parandalimit të konfliktit të interesave, unifikimin e çmimeve të mirëmbajtjes, ripunimin e aktit mbi rrjetin rrugor dhe transferimin e rrugëve, etj.
Nga auditimi i veprimtarisë së Bordit të Menaxhimit konstatohet se, ka funksionuar në mungesë të një rregulloreje të miratuar dhe veprimtarinë e tij mbi bazën e një programi vjetor të miratuar si dhe mospërcaktimi i detyrave të sekretarit të bordit të menaxhimit sipas kuadrit rregullator në fuqi. Për sa më sipër është në kundërshtim me; - Ligjin Nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", neni 8-11; - Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 4-7, 11, 16-18; - VKM nr.276, datë 16.5.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar", Kreu II, pika 1/ germat "ë" dhe "f", Kreu III pika 4, germa "c", , Kreu III pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Bordi i Menaxhimit të marrë masa për hartimin e një rregulloreje funksionimi, planifikimi, dokumentimi dhe raportimin e veprimtarisë tij; analizën e zbatimit të vendimeve të marra; ushtrimin e kompetencave në kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave në veprimtarinë e institucionit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën Janar 2019-Shtator 2020, nga ana e Drejtorëve të Përgjithshëm të ARrSh (sipas periudhave respektive), konstatohet se nuk janë marrë masat për

hartimin e raporteve për veprimtarinë ekonomike e financiare vjetore të institucionit. Si rrjedhojë, nuk janë dërguar për miratim në Bordin e Menaxhimit, për vitin 2018 dhe 2019, dhe nuk janë përcjellë as në Ministrinë e linjës administrative (MIE) raportet mbi performancën vjetore të institucionit ARrSh. Për sa më sipër është në kundërshtim me:, të ligjit Nr. 10164, datë 15.10.2009 *"Për Autoritetin Rrugor Shqiptar"*, neni 5, pika 2:, - VKM Nr. 276, datë 16.5.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të autoritetit rrugor shqiptar", pika 11 dhe 12 ; Kreu II. "Funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e Autoritetit Rrugor Shqiptar", pika 1/ë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për hartimin e raportit të veprimtarisë së institucionit duke e adresuar në arritjen e objektivave institucionale, paraqitjen e tij për miratim në Bordin e Menaxhimit dhe në ministrinë e linjës.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të kontabilitetit (llogaria 212), vlera e AQT "Ndërtesa" të regjistruar me koston historike është 34,520 mijë lekë, u konstatua se:

a. Në bilancet vjetore të institucioneve të varësisë të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të ARrSh për qëllime të konsolidimit të informacionit, përkatësisht në DRQ Tiranë, DRV Shkodër dhe DRJ Gjirokastër, rezulton se, në llogarinë 212 "Ndërtesa", në ***11 raste**, objektet që janë në inventar kanë ndërruar destinacionin, janë tjetërsuar apo janë zënë nga privat***i** duke mos pasqyruar në mënyrë të drejtë gjendjen e aktiveve te qëndrueshme të trupëzuara.

b. Konstatohet se, në zërin "Ndërtesa" janë përfshirë Kati II, Kati III, Kati IV , Kati V dhe Shtesë kati nga Godina e ARrSh, por nuk është përfshirë sipërfaqja dhe vlera e katit të parë dhe bodrum, që janë në përdorim nga ky institucion. Nga ana e ARrSh i janë dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të KM dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesat me nr. 2506, datë 13.03.2019 dhe 2465, datë 11.03.2019 për kalimin në përgjegjësi administrimi të katit të parë dhe bodrumit të kësaj godine, por nuk ka asnjë përgjigje dhe veprim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të ARrSh-së/Drejtoritë Rajonale, të marrin masat e nevojshme për kryerjen e procedurave dhe veprimeve kontabile për të gjitha ato aktive të cilat nuk eksitojnë më, me qëllim pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të llogarisë "Ndërtesa" në pasqyrat e konsoliduara financiare të institucionit.

Në vijimësi

3.2. Rekomandimi: Titullari i institucionit të RRSH-së, të vijojë komunikimin me MIE me qëllim kalimin në përgjegjësi administrimi të katit të parë dhe bodrumit të kësaj godine.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në relacionin që shoqëron bilancin e konsoliduar, është vendosur shënimi që, llogaria 210 **"Toka, Troje, Terrene"** me vlerë **547,460 mijë lekë** është vlerë e mbartur që nga llogaritë vjetore të vitit 2006 dhe përfaqëson shpronësimet për segmentet rrugore, dhe që **nuk ka patur ndryshime gjatë vitit 2019"**.

Nga auditimi u konstatua se,

-Gjatë **vitit 2019 dhe 2020**, rezulton se, sipas **15 VKM** të nxjerra **janë kryer shpronësime për interes publik** për ndërtimin e segmenteve rrugore , sipas dokumentacionit të dërguar nga ana e Sektorit të Sigurimit të Tokës/ Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacional arrin vetëm për vitin 2019 gjithsej **621,793 mijë lekë, që nuk janë pasqyruar në këtë llogari**.

-Gjithashtu konstatohet se, **nuk është pasqyruar në kontabilitet vlera e truallit** për ARrSh dhe Drejtoritë Rajonale në vlerën totale për **229,812 mijë lekë** dhe konkretisht: për objektet ARrSh Tiranë, Zyra Qendrore për 39,047 mijë lekë, ARrSh Tiranë, Laboratori në vlerën për

9,004 mijë lekë, DRQ Tiranë në vlerën për 151,402 mijë lekë, DRJ Gjirokastër në vlerën për 30,358 mijë lekë ndërkohë nuk ka informacion për RDRV Shkodër. Nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)", paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"

-Konstatohet se, nga ana e ARrSh **nuk është kryer asnjë veprim për marrjen në listën e inventarit të ARrSh të objekteve të përcaktuara në VKM nr.78, datë 3.2.2016** *"Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës,* ***për Autoritetin Rrugor Shqiptar****,* ***të disa sipërfaqeve të truallit funksional****, brenda territorit të pronës nr. 1019, me emërtim "Reparti Ushtarak nr. 4030, aerodromi", me vendndodhje në Urën Vajgurore, Berat, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së mbrojtjes", të ndryshuar*, (Fletorja Zyrtare, viti 2016 - numri 19. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të ARrSh-së/Drejtoritë Rajonale, të marrin masat e nevojshme për kryerjen e procedurave dhe veprimeve kontabile me qëllim përfshirjen në kontabilitetin e institucionit të të gjitha shpronësimeve të kryera për interes publik si dhe vlerës së truallit të pa regjistruar.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi **regjistrimin e pasurisë së paluajtshme,** *u konstatua se,* nga ana e strukturave drejtuese të ARRSH, për periudhën objekt auditimi, **pasuritë e paluajtshme rezultojnë të regjistruara në mënyrë jo të plotë** në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë dhe më pas në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë 07.01.2005.

-Nuk është regjistruar sipërfaqja totale e Ndërtesës së ARRSH prej 1379,92 m2, por është pasqyruar në kartelën dhe certifikatën e regjistrimit të pronësisë në ZVRPP vetëm 439 m2, ose nuk janë regjistruar në kartelat e pronësisë së institucionit 940.92 m2, Bazuar në Fletën e Inventarit të hartuar nga Komisioni i Inventarizimit të pasurisë, në inventarin e llog.212. "Ndërtesa" përfshihen 6 zëra (nga këto, një objekt është godina e ARRSH me përfshirjen e Katiti 2, 3, 4, 5 dhe shtesës) dhe objektit "Laboratori", me vlerë kontabile prej 3,622,664 lekë.

-Nga krahasimi i Hartës Treguese dt. 29.01.2019 që shoqëron Vërtetimin e Pronësisë ZVRPP Tiranë të datës 23.04.2019, me Planin e Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, konstatohen **kundërshtim** në pasqyrimin e objekteve ndërtimore, si vijon: Në Certifikatën për Vërtetimin e Pronësisë me nr. 1867034, datë 23.4.2019 për ZK nr. 8320, nuk janë pasqyruar dy objektet (objekti "H" sipas Plan Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, përkatësisht me sipërfaqe 401 m2 dhe një shtojcë ngjitur me zyrat 2 katëshe).

Për DRV Shkodër: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk është regjistruar pronësia dhe nuk disponohen certifikata për DRV Shkodër nga ZVRPP e përfshira në këtë rajon dhe sipas pasqyrave të inventarit të dërguara në ARrSh shumica e objekteve rezultojnë të dëmtuara..

Për DRJ Gjirokastër: Rezulton se bazuar në certifikatën e pronësisë sipërfaqja e truallit rezulton 3,556 m2, ndërsa sipas VKM nr. 3, datë 07.01.2005 rezultojnë sipërfaqe trualli prej 2,607 m2, duke mos patur përputhje të këtyre shifrave dhe arsyetim të gjurmës së auditimit për diferencën e sipërfaqes së regjistruar me atë sipas VKM përkatëse. Sipas VKM nr. 789, datë

07.10.2020 është vendosur ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të kësaj pasurie me sipërfaqe prej 3,556 m2 duke kaluar nga ARrSh të DPSHTR.
- për objektet e tjera të përfshira në këtë rajon nuk disponohen certifikatat e regjistrimit të pronësisë. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë 07.01.2005, gjë që tregon për parregullsi dhe pasaktësi dokumentare. Nuk kanë gjetur zbatim të plotë kërkesat e Kreut 3.7, paragrafi 85, i UMF nr. 8, 2018, në lidhje me shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore, pasi ato nuk japin informacion të përgjithshëm në lidhje me rakordimet financiare me debitorët dhe kreditoret në lidhje me elementë specifikë të pasqyrave financiare të dorëzuara, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARRSH-së, të marrin masat e nevojshme me qëllim regjistrimin e pasurisë për të gjitha rastet e konstatuara si të pa regjistruara si dhe rifreskimin e kartelave të regjistrimin të pasurisë së paluajtshme apo për të gjithë ato objekte për të cilat janë konstatuar problematika në drejtim të regjistrimit jo të saktë të tyre.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura, u konstatua se,

a. vlerat e raportuara si detyrime të pa likuiduara deri më datën 31.12.2019 nga ana e Ministrisë së linjës (MIE), ku integrohet dhe raportimi i ARrSh-së, nuk rakordojnë me pasqyrat financiare të konsoliduara të ARrSh Tiranë si dhe me sistemin e të dhënave të raportuara për detyrimet e prapambetura të ARrSh,(në vlerë dhe në strukturë), për vlerën prej **97 milionë lekë më shumë për ARRSH-në.** Sa sipër, nuk janë zbatuar përcaktimet e VKM nr. 50, datë 05.02.2015 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin edhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", UMF nr.5 datë 27.2.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetur", i ndryshuar dhe UMF nr. 28, datë 18.12.2014, i ndryshuar.

b. Konstatohet se**, ka një mospërputhje në vlerën e borxhit për 1.3 milion lekë** ndërmjet vlerës së paraqitur në bilancin e konsoliduar të institucionit prej 3,751 milion lekë me shumën e stokut të raportuar me datën 24 Janar 2020 si shifër e detyrimit të prapambetur prej 3,750 milion lekë. Nga ana tjetër, konstatohet se në bilanc, në kolonën 41, Formati 1 të Bilancit Kontabël 2019, llogaria 486 "Shpenzime për periudhat e ardhshme" është pasqyruar për 3,752 milion lekë, ose 2,6 milion lekë më shumë se stoku i detyrimeve. Sa sipër, nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i paragrafit nr.42, kapitulli 3.1,"Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të UMFE nr. 8, date 9.3.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"

c. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion evidentohet se, fondet operative (llogaria buxhetore 602) të papërdorura në datën 31.12.2019 ishin **90 milion lekë** një vlerë kjo e konsiderueshme, sidomos në kushtet e ekzistencës së një stoku të lartë borxhi, që nuk janë adresuar për likuidimin e detyrimeve të kontratave të mirëmbajtjes (brenda llogarisë së shpenzimeve operative, llog.602), e cila me 31.12.2019 ekspozonte saldon debitore prej **358 milion lekë**, detyrime të mbartura nga viti 2018 gjë që tregon për menaxhim joefektive të fondeve buxhetore nga ana e drejtorive rajonale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARrSh-së/Drejtori i Përgjithshëm, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim përmirësimin e situatës në lidhje me raportimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e strukturës janë përcaktuar detyrat funksionale të çdo drejtorie dhe sektori por:
- nuk është e përcaktuar dhe e ndarë për çdo post pune specialisti.
- nuk ka të përshkruar asnjë procedurë për vlerësim performancë në punë dhe nuk është kryer asnjë vlerësim pune periodik dhe as për ngritjen në detyrë apo përfundimit të periudhës së provës.
- nuk ka të përcaktuar llojin dhe nivelin e arsimimit, eksperiencën në punë që duhet të plotësojë çdo punonjës për postin e punës që mbulon.

Si dhe nuk është i bashkëlidhur si formular në vendimin nr. 21, datë 10.11.2020, "Mbi miratimin e formularit "Vlerësimi i Punës" për punonjësit në Autoritetin Rrugor Shqiptar". Gjithashtu, ARrSh-ja nuk ka të përcaktuar llojin dhe nivelin e arsimimit, eksperiencën në punë për çdo punonjës sipas kërkesave të punës që kryen. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 276, datë 16.05.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar", pika 6 dhe 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të marrin masa të përcaktojnë qartë çdo post pune, të miratojnë me dokumentat bashkëlidhur "Vlerësimin e Punës", sipas performancës së punës së çdo punonjësi për ngritjet në detyrë, përfundimin e periudhës së provës dhe vlerësimin periodik, si dhe të përcaktohet lloji i nivelit të arsimimit, eksperienca në punë që duhet të plotësojë çdo punonjës për pozicionin e punës që mbulon.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e emërimeve vërehet që ARrSh-ja nuk e ka të përcaktuar datën e fillimit të marrëdhënieve të punës për punonjësit. Gjithashtu, në kundërshtim me kërkesat e miratuara nuk përcakton pagën e punonjësit bashkë me elementët përkatës të pagës. Për çdo emërim në detyrë konstatohet se në urdhrin e emërim ka vetëm emërimin në postin e punës dhe datën e fillimit të marrëdhënieve të punës por mungon përcaktimi i pagës dhe elementët përbërës të saj, element i cili është përcaktuar në dokument të dytë të firmosur nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme. Për sa më sipër është në kundërshtim me Nenin 19 "Akti i emërimit" të Rregullores së Brendshme të Funksionimit të ARrSh-së, miratuar me Vendimin e Bordit të Menaxhimit nr. 10, datë 04/09/2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar).*

8.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të marrin masa të përcaktojnë qartë në çdo rast emërimesh datën e fillimit të marrëdhënieve të punës si dhe pagën bashkë me elementët përkatës të kësaj të fundit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i ngritjeve në detyrë nuk ka procedura vlerësimi performance dhe të marrëdhënieve të punës u konstatua se ka 12 raste ngritje në detyrë për të cilat nuk ka asnjë procedurë vlerësimi performance por vetëm me urdhër titullari duke mos siguruar transparencë dhe kushte të barabarta midis punonjësve.

Për sa më sipër në kundërshtim Kodin e Punës i Republikës së Shqipërisë, neni 9. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa që për çdo rast të ketë një procedurë të mirëfilltë për vlerësimin e performancës së punës së punonjësve menjëherë pas miratimit të formularit të "Vlerësimit të Punës".

Menjëherë pas miratimit të formularit "Vlerësimi i Punës"

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi rezulton se janë dhënë 17 masa disiplinore për marrëdhëniet e punës 5 masa "Vërejtje me shkrim" dhe 12 masa "Vërejtje me paralajmërim"), këto masa janë bazuar në nenin 11 "Masat disiplinore" të kontratës individuale, në Rregulloren e Brendshme të institucionin nuk ka asnjë nen që të parashikojë procedurën e plotë administrative për dhënien e masave disiplinore ku punëmarrësit ti garantohen e drejta për t'u informuar dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Për sa më sipër është në kundërshtim me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë dhe Kontrata Individuale e Punës së ARrSh-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa që të plotësohen dhe përmirësohen parashikimet e kontratës individuale të punës së institucionit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka 8 raste të uljes në detyrë nga Drejtor Drejtorie në Përgjegjës Sektori 1 rast dhe nga Përgjegjës Sektori në Specialist në 7 raste. U audituan me zgjedhje 3 prej tyre. Procedura nuk është e parashikuar në rregulloren e brendshme të institucionit si dhe nuk ka vlerësim pune dhe nuk është dokumentuar komunikimi i kësaj lëvizjeve dhe dakortësia e punonjësit. Për sa më sipër në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ARrSh-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin dhe përmirësimin e rregullores së brendshme për përfshirjen e procedurave të uljes në detyrë.

Menjëherë pas miratimit të formularit "Vlerësimi i Punës"

12. Gjetje nga auditim: Deri në fund të periudhës objekt auditimi u konstatua se ka 20 procese gjyqësore për marrëdhëniet e punës në proces në të dy shkallët e gjykimit (11 në shkallën e parë dhe 9 në shkallën e apelit). Për periudhën objekt auditimi janë ekzekutuar 5 vendime të gjykatës për marrëdhëniet e punës në total 9,793,030 lekë nga të cilat 9,126,599 lekë janë për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i gjykatës dhe 666,431 lekë shpenzime për shërbim përmbarimor. Vlera prej 9,793,030 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar me strukturat përkatëse, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, të marrin masa që largimet nga puna të jenë konform kërkesave të rregullores dhe kontratave. Gjithashtu, të ketë një planifikim buxheti të saktë që Vendimet e Gjykatës të ekzekutohen pa lindur nevoja e shpenzimeve për shërbimin përmbarimor.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Me përzgjedhje rastësore i dosjeve personale të stafit të ARrSh në lidhje me dokumentacionin që përmbanin u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

Në disa raste ka dokumente në lidhje me arsimimin të panoterizuara, libreza pune fotokopje, në dy rast mungon raporti mjeko-ligjor.

- Konstatohet se të gjithë punonjësit e ARrSh nuk kanë nënshkruar vetë deklarata në lidhje me "Lidhje të mundshme me Kontraktor të ARrSh" dhe "Lidhje familjare" në kundërshtim nenin 16 "Kërkesa të përgjithshme për punonjësit e " të Rregullores së Brendshme të Funksionimit të ARrSh miratuar me Vendimin e Bordit të Menaxhimit nr. 10, datë 04/09/2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 74-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin dosjeve me të gjithë dokumentet sipas kërkesave të sanksionuara në rregulloren e brendshme si dhe deklaratës së konfliktit të interesave për të gjithë punonjësit e ARrSh-së.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit rezultoi se; në 6 raste, nga Njësia e Prokurimit (NjP), në procesverbalin e mbajtur mbi hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, konstatohet se janë vendosur kritere të cilat janë konfuze në disa raste, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht, konkretisht për pajisje e automjete, pa dhënë shpjegimet përkatëse të cilat duhet të jenë në përputhje me grafikun e ekzekutimin e punimeve dhe volumin e tyre. Pra nga AK kriteret duhet të vendosen kritere sipas qëllimit të LPP në atë mënyrë që ti shërbejnë objektit të kontratës, të jenë në përputhje me punët apo shërbimet që do të kryhen dhe të argumentohen në mënyrë të kuptueshme për të gjithë OE pjesëmarrës. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.12.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 1, me nenin 2, parimet e përzgjedhjes, si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi II. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar).*

14.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i hartimit të kritereve të merren masat që në të gjitha rastet të argumentohet çdo kriter të vendosur me qëllim shmangien e paqartësive nga Operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit u konstatua se; në 6-raste fondi limit i evidentuar në regjistrin e parashikimeve, nuk është i njëjtë me fondin limit në fazën e shpalljes së procedurës, kjo për faktin se, në momentin e hartimit të regjistrit fondi limit është hedhur me TVSh, ndërkohë që FL duhet të evidentohej pa TVSh. Veprime në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 4 dhe neni 9, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Përgjegjësi i Prokurimeve të merren masat e duhura që, plotësimi i regjistrit të realizimeve dhe hedhja në sistem e fondit të secilës procedurë të evidentohet pa TVSh.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit konstatohet se; në 5 raste, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, publikimi i njoftimit të kontratës për shpalljet e procedurave të reja është kryer me datë 22.10.2019, çka do të thotë se janë marrë angazhime të cilat nuk mund të kryhen dhe likuidohen brenda mbylljes së vitit buxhetor, pra pas datës 15 tetor, për të cilën sipas DST-ve, kontrata me OE fitues i shtrin afatin për 12 muaj nga data e lidhjes së saj. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 51, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 76, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Përgjegjësi i Prokurimeve të merren masat e duhura që, shpallja e procedurave të reja të prokurimit të bëhet brenda afateve ligjore me qëllim shmangien e marrjes së angazhimeve jashtë afateve që shtrihen përtej vitit buxhetor.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Urës së Zemblakut", me fond limit në shumën 43,049,588 lekë pa TVSh, me OE fituese në shumën 32,370,126 lekë pa TVSh, u konstatua se; Vendimi KVO për rivlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar është bërë me datë 26.12.2019, në të cilin është klasifikuar OE fitues, gjeneruar gjithashtu edhe në sistemin elektronik të prokurimeve. Raporti përfundimtar i hartuar nga KVO dhe nënshkruar nga titullari i AK është mbajtur me datë 07.02.2020, administruar me shkresën nr. 1142prot. Formulari i njoftimit të fituesit është dërguar me shkresën nr. 1142/1prot, datë 07.02.2020, i cili është publikuar në Buletinin nr. 6, datë 17.02.2020 të APP. Pra nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se njoftimi i fituesit i cili duhet të dërgohej për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike, nuk është dërguar brenda 5 ditëve. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, referuar nenit 58, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar, të merren masat që, me përfundimin e procedurës dhe shpalljen e fituesit të dërgohet njoftimi në APP.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Urës së Leklit", me fond limit në shumën 10,852,985 lekë, me OE fituese në shumën 7,372,740 lekë pa TVSh, u konstatua se; Procesverbali i hartimit të kritereve të veçanta të kualifikimit dhe Dokumentet standarde të Tenderit nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e NjP, dhe konkretisht nga zj. Miranda Shkurti, në cilësinë dhe të përgjegjësit të prokurimeve. Veprim në kundërshtim me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Përgjegjësi i Prokurimeve të merren masat e duhura që të gjitha dokumentet e tenderit të nënshkruhen nga komisionet e krijuara për këtë qëllim.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit rezultoi se, në 3 raste me vlerë totale 708,731,493 lekë pa TVSH, ARrSh ka shpallur procedura prokurimi ndërkohë që sipas udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, është njoftuar që të gjitha procedurat e prokurimit ishin pezulluar për shkak të pandemisë së Covid-19, ku në njoftim përcaktohet se Autoritetet kontraktore, të pezullojnë të gjitha procedurat e prokurimit përfshirë këtu edhe ato procedura prokurimi me vlerë të vogël, objekti i të cilave nuk lidhen ngushtësisht me situatën, duke përfshirë edhe ato procedura që janë në proces, deri në një njoftim të dytë. *Edhe pse në komunikim të vazhdueshëm nga APP për pezullimin dhe mos kryerje të procedurave të prokurimit për objekte që nuk lidhen me situatën e pandemisë, nga AK konstatohet se ka vijuar procesi me shpallje të procedurave.* Veprime në kundërshtim me njoftimin e APP nr. 2371, datë 31.03.2020 "Për pezullimin e shpalljes së procedurave të reja të prokurimit publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar, të merren masat e duhura që, të respektohet çdo akt i dalë nga Agjencia e Prokurimit Publik, për përmbushjen e qëllimit për të cilat këto akte janë nxjerrë.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt *"Ndërtimi i rrugës Porto-Romano"*, me fond limit në shumën 669,384,858 lekë pa TVSh, sipas dokumentacionit të dosjeve përkatëse dhe sistemit të prokurimeve elektronike(SPE) u konstatua se; kjo procedurë është anuluar dy herë ku, referuar SPE rezulton të jetë paraqitur ankesë nga OE në lidhje me

Dokumentet Standarde të Tenderit Në lidhje me anulimin e të dy procedurave, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe sistemit të prokurimit elektronik, konstatohet se arsyet e të dy rastet kanë ardhur si rezultat i vetë Autoritetit Kontraktor, konkretisht për vendosje të kritereve jo sipas LPP dhe RrPP, të cilat nuk janë në frymën e objektit, qëllimit, parimeve të përzgjedhjes për trajtimin e kërkesave të barabarta dhe jo diskriminuese për operatorët ekonomikë si dhe nuk përmbushet asnjë kriteret e parashikuara për anulimin e procedurave të prokurimit publik. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenet 1 e 2, nenin 20, nenin 24, neni 55, neni 46, pika 1/c, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 25/1, neni 31/1, neni 61. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Kontraktor dhe Përgjegjësi i Prokurimeve të merren masat e duhura që, në vendosjen e kritereve dhe hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, të shmangen kriteret e panevojshme të cilat nuk janë në përputhje me objektin e kontratës, me qëllim trajtimin e barabartë ndërmjet operatorëve dhe shmangien e anulimit të procedurave të prokurimit.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 1049, datë 08.12.2019, në shumën 316,022 lekë është likuiduar fatura nr. 299, datë 30.11.2019 nda subjektit "E. S." ShPK. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion bashkëlidhur këtij shpenzimi konstatohet se; kjo pagesë është kryer bazuar në kontratën nr. 4839/11, datë 01.07.2019, për shërbimin e ruajtjes së sigurisë fizike e kryer për muajin nëntor 2019. Ky shpenzim është kryer pa patur asnjë dokumentacion justifikues për mbikëqyrjen e kontratës, pra nga titullari i AK nuk është krijuar komision për monitorimin e shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike, për të mbikëqyrur veprimtarinë e kontraktorit në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me zbatimin e kontratës. Nga nëpunësi zbatues nuk janë kryer kontrolli i duhur për plotësimin e dokumentacionit në lidhje me kryerjen e shpenzimit, për të siguruar vendimmarrjen se përdorimi i fondeve është justifikuar me dokumentacion përkatës. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4 pikat 17 dhe 26, dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 77, pikat 1 dhe 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit Përfundimtar).*

24.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masat që, për garantimin e zbatimit të kontratave të lidhura, të ngrihen komisionet përkatëse me qëllim monitorimin e veprimtarisë së kontraktorëve.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Në projektin me objekt ***"Ndërtim By-Pass Tepelenë, Loti 1"*** konstatohet se, Autoritetit Kontraktor, me Vendimet e Këshillit Teknik ka miratuar shtesë kontrate prej 19.7% në vlerën 470,058,451 pa TVSH. Krahas nevojave për punime shtesë për realizimin e kontratës fillestare, ARRSH sipas kërkesave të Bashkisë Tepelenë, me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.38 datë 28.10.2019, ka miratuar "*Ndërtimin e shëtitores mbi punimet e mbrojtjes lumore"*, me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.32 datë 08.06.2020, ka miratuar "*Ndërtimi i trotuarit me konstruksion metalik përreth kalasë dhe ndriçimi i saj me gjatësi 492 ml"*, "*Ndërtimi i rrugës së lagjes Gurës*" si dhe "*Rikonstruksioni i këmbëve të urës pasarelë mbi lumin Vjosë"*. Miratimi final për rikonstruksionin e urës pasarelë është bërë me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.51 datë 29.09.2020 pas miratimit të projektit nga Këshilli Kombëtar për Trashëgimisë Kulturore Materiale pranë Ministrisë së Kulturës. Miratimi i shtesës së kontratës me objekt *"Ndërtimi By-Pass Tepelenë, Loti 1",* ku përfshihen punimet sipas kërkesave të

Bashkisë Tepelenë kanë rritur vlerën e kontratës fillestare me **121,926,889 lekë pa TVSH** ose 5.1% të cilat nuk kanë qenë të përfshira në projektin fillestar dhe këto ndryshime nuk vijnë si domosdoshmëri e realizimit të kontratës. Në rast se punimet e kërkuara, nga Bashkia Tepelenë, do të kryheshin me fondet e saj ose institucioneve të tjera përgjegjëse do ti nënshtroheshin garës së prokurimit publik, pra kemi shmangie nga procedurat e prokurimit publik në vlerën **121,926,889 lekë pa TVSH.** Veprim në kundërshtim me: Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; Ligjin nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar"; VKM Nr.276, datë 16.05.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raporit të Auditimit).*

25.1. Rekomandimi: ARRSH të marri masa që në të ardhmen, për projektet e reja dhe ato në proces të mos miratojë ndryshime dhe shtesa punimesh, që nuk janë të lidhura me zbatimin teknik të punimeve dhe në funksion të objektit.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me politikat, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullator në fuqi u konstatua se, Rregullorja e brendshme e funksionimit administrativ të ARRSH si dhe disa akte të tjera, nuk janë të harmonizuar me kërkesat e legjislacionit për menaxhimin financiar publik si dhe VKM nr. 279, datë 16.5.2018, dhe kanë nevojë për përmirësim e plotësim për aspektet e mëposhtme:

a) Në kundërshtim me Kreun III, germa "ç", të VKM nr. 276, datë 16.05.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të ARRSH", në Rregulloren e Brendshme të ARRSH ***nuk janë përcaktuar "rregullat për mbledhjet, kuorumin dhe vendimet e bordit të menaxhimit të Autoritetit".*** Po kështu, në kundërshtim me Kreun I, "Organizimi dhe funksionimi", pika nr.8, të VKM nr. 276, datë 16.05.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të ARRSH", në Rregulloren e Brendshme të ARRSH ***nuk janë përcaktuar sistemi i masave disiplinore dhe procedurat disiplinore, të cilat sipas VKM përcaktohen në rregulloren e brendshme të Autoritetit.*** *Gjithashtu, ky veprim nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 37, të Nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, që sanksionon se masat disiplinore përcaktohen në kontratën kolektive të punës.*

b) Nuk gjejnë pasqyrim në dokumentin e Rregullores së brendshme ***detyrat dhe përgjegjësitë e oficerëve/zyrtarëve që ndjekin zbatimin e kontratave***, kur për to janë caktuar mbikëqyrës të kontratave të ndërtimit apo mirëmbajtjes. Gjithashtu, mungojnë në dokumentin e Rregullores së Brendshme (apo në ndonjë udhëzim apo akt tjetër administrativ), *kriteret e shkruara se, në cilat raste, proceset e mbikëqyrjes/ supervizionimit të punimeve të ndërtimit dhe mirëmbajtjes do të kryhen me punonjës të brendshëm të licencuar të ARRSH-së, (në çfarë situatash, për çfarë kufijsh monetarë, numri maksimal i kontratave që mund të mbikëqyren nga një punonjës i institucionit gjatë një viti kalendarik, etj),* kjo në përputhje me nenin 7, të ligjit Nr.8402, date 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit".

c) Gjithashtu, nuk gjejnë pasqyrim në dokumentin e Rregullores së Brendshme ***detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit të ngarkuar me magazinën dhe administrimin material***,

d) Mungon një rregullim i përgjithshëm mbi organizimin dhe funksionimin e **Këshillit Teknik të ARRSH-së. n**ë kundërshtim me Kreun II, pika 4, të VKM nr. 276, datë 16.5.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe Statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar": Konstatohet se, nuk ka gjetur zbatim detyrimi që "*Drejtori i Përgjithshëm nxjerr urdhrin për ngritjen e Këshillit Teknik dhe firmos rregulloren e përgjithshme të veprimtarisë dhe funksionimit të tij". Deri në datën e hartimit të këtij raporti, nuk është hartuar dhe miratuar rregullorja e përgjithshme të veprimtarisë dhe funksionimit të Këshillit Teknik të ARRSH-së.*

e) Rastet e delegimit të autoriteti dhe përgjegjësive tek nivelet e tjera menaxheriale, sa duhet plotësuar Kreu XI i Rregullores së brendshme, *duke vendosur afatin maksimal të delegimit të të drejtave dhe detyrave tek strukturat e varësisë si dhe afatin maksimal të komandimit në detyrë, etj*. Gjithashtu, në Rregulloren e Brendshme të ARRSH, (miratuar me Vendimin e BM nr. 10, datë 4 Shtator 2018 në kreun X "Mirëmbajtja e godinës, aktiveve dhe pajisjeve", neni 53 "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve", në pikën nr.4 referohet "Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse", duke mos reflektuar pozicionet e strukturës organike të miratuar me VKM nr. 276, datë 16 Maj 2018, ku në strukturë janë "Drejtoria e Planifikimit Buxhetor dhe Financës" dhe "Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme".

f) *Nuk ka një proces dhe gjurmë të qartë të auditimit mbi mënyrën e kalimit të objekteve (rrugë, akse rrugore, vepra arti etj), pas marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të tyre përfundimtar nga ARRSH, për mirëmbajtje nga Drejtoritë e Rajoneve, në bazë të përcaktimit të Kreut II, pikës 2.d, ku thuhet se Drejtoritë Rajonale* "Organizojnë programin e supervizionit të shërbimeve të mirëmbajtjes me performancë (rutinë dhe dimërore), të rehabilitimit të Rrjetit Rrugor Kombëtar në administrim si dhe ndjekin kontratat".

g) *Mungon një sistem i qartë raportimi dhe një dokument i miratuar mbi mënyrën e raportimit për shkeljet e rregullave në fuqi, apo rastet e raporteve mashtrues, shënime fiktive, humbja e pasurive, korrupsioni, etj., aspekte të pranuar dhe në paragrafin nr. 56, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit (dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 1140, datë 07.02.2020).*

e) Mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" i ndryshuar

f) Grupi i auditimit të KLSH konstaton se për Drejtorinë e Përgjithshme të ARRSH janë përcaktuar nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ) ne pozicionin e Drejtorit të Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, *si vijon:* Për periudhën objekt auditimi në pozicionin e Nëpunësit Autorizues është Z. E. V., me detyrë Zv/Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, i cili sipas Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Znj. B. B. me nr. 360, (nr. 8610 prot.), datë 04.10.2019 "*Për autorizimin e Zv./Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të ushtrojë kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH",* është urdhëruar autorizimi "të ushtrojë krahas detyrave funksionale edhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm me qëllim mbarëvajtjen e institucionit".

Referencat e vendosura në këtë urdhër janë ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për ARRSH" dhe neni 72, paragrafi 3, i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 (i ndryshuar), ***ndërkohë që neni 72, ka si objekt prokurat dhe ka vetëm dy paragrafë***. Ndonëse ka kaluar më shumë se një vit, ende nuk ka një emërim të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, pra, nuk kanë gjetur përcaktim dispozitat e Nenit 12, pika 2 të ligjit nr. 10164/2009, *Drejtori i Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes është njëkohësisht dhe Zv/Drejtor i Përgjithshëm. Pra, z. K. pas këtij delegimi, kryen njëkohësisht tre funksione: atë të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm, të Drejtorit të Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes dhe atë të Drejtorit të Drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë, gjë që efektivisht është e pa mundur dhe janë pozicione që mund të krijojnë konflikt midis tyre.*

g) Nga ana e institucionit, për vitin 2019, janë përgatitur Pyetësorët e Vetëvlerësimit, por mungon Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.

Më hollësisht ato janë përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave për gjithë vitet objekt auditimi. U testuan pyetësorët dhe raportet e plotësuara për vitin 2019 dhe rezultoi si më poshtë: **Nuk është dërguar në Ministrinë e linjës Raporti Vjetor mbi Sistemet e Kontrollit të Brendshëm,** sipas strukturës së parashikuar në Manualin e MFK (Kreu II, pika 2.2.7) dhe detyrimeve të Nenit 18/1, "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm", Kreu II, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 122-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>26.1. Rekomandimi:</u> Strukturat drejtuese të ARRSH-së, të marrin masat e nevojshme me qëllim përditësimin dhe harmonizimin e normave dhe akteve në fuqi mbi të cilat ngrihet dhe funksionon ARRSH me kuadrin nënligjor mbështetës.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna, ARRSH i ka kthyer përgjigje institucionit të KLSH me shkresën nr. 9789/1 prot. datë 18.12.2020, ku konstatohet se nuk është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor (20 ditë), pasi shkresa e KLSh është protokolluar në ARRSH me nr. 7532 datë 8.10.2020 dhe përgjigja është kthyer vetëm me datë 18.12.2020. gjithashtu konstatohet se akoma nuk ka gjetur zbatim 1 masë zhdëmtimi ku kërkohet që: *"ARrSh në bashkëpunim me MIE dhe me departamentin e Administratës Publike, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën 51,238,754 lekë"*, si dhe janë ende në proces zbatimi 4 rekomandime për eliminimin e efekteve negative në administrimin dhe menaxhimin e fondeve publike. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", neni 15(j). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>27.1. Rekomandimi:</u> ARrSh të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna të rikërkuara me shkresën KLSH me nr.675/36 prot. datë 06.10.2020 "Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve", për të cilat duhet të informohet në vijimësi institucioni i auditimit të jashtëm publik, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi analizimin e pretendimit të ankimuesit z. R.N. mbi ndryshimin e projektit të parë nga projekti i dytë pasi ka ndryshuar gjurma e projektit nga rruga ekzistuese në një rrugë krejtësisht të re, rezulton se; Nga ana e Ish-Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në vitin 2010 me fondet e buxhetit të shtetit është hartuar projekti i rrugës Korçë-Ersekë (loti 2), ku Projekt Ideja është miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të datës 8.7.2009, kurse projekti i zbatimit është miratuar me vendimin e Këshillit Teknik datë 06.07.2010, ku kanë marrë në shqyrtim projekt zbatimin e objektit "Studim, Projektim, Rruga Ersekë-Leskovik" Loti 2, hartuar nga firma konsulente "I. P." ShPK. Projekt zbatimi dhe preventivi përmbledhës, i objektit të projektit "Studim, Projekt Zbatimi Rruga Korçë-Ersekë Loti II, është përllogaritur me vlerë totale në shumën 2,832,157,151.53 lekë me TVSh, për një segment prej 17,894 metra, pra rreth 17.9 km, konkretisht;

<u>Sipas Projektit të Parë, (v.2010):</u> hartuar nga firma konsulente "I. P." ShPK dhe miratuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve me vendimin e Këshillit Teknik datë 06.07.2010, objekti "Rruga Ersekë-Leskovik" Loti 2" ka gjatësinë ekzistuese 22 km (shiko fq.3 e Raportit te Projekt-Zbatimit) dhe sipas projektit të këtij konsulenti rruga bëhet 17.894 km (shiko fq.7 e Raportit te Projekt-Zbatimit). ***Pra, ky segment rrugor sipas këtij varianti rruga shkurtohet 4.106 km.***

<u>Sipas Projektit të dytë (v.2020):</u>

-Pjesa e parë e Lotit të dytë është 4.15 km (në bazë të studimit dhe projektit të hartuar nga firma konsulente "A. E." SHPK dhe miratuar në Autoritetin Rrugor Shqiptar me vendimin e Këshillit Teknik Nr.43, datë 14.08.2020, objekti "Rruga Ersekë-Leskovik" Loti 2" ka gjatësinë ekzistuese 4.15 km.

Pjesa e dytë e Lotit të Dytë (sipas shkresës së ARrSh me nr. 8069/2, datë 17.12.2020 dërguar institucionit te Presidencës dhe institucioneve te tjera shtetërore), ka gjatësie L= 12.85 km. Pra, sipas këtij versioni, gjatësia e përgjithshme e rrugës bëhet 17 km, (4.15 +12.85 km). ***Pra, ky***

segment rrugor sipas këtij varianti rruga shkurtohet nga 22 km në 17, ose me 5 km. Hartimi i detyrës se projektimit dhe projekt zbatimit nga ana e Bashkisë Kolonjë nuk është i mbështetur në legjislacion në fuqi që rregullon funksionet, përgjegjësit dhe organiken e Qeverisjes Vendore, pasi aksi Korçë-Ersekë është rrugë ***interurbane shtetërore*** dhe është në inventarin dhe administrimin e entit pronar të rrugëve, ARrSh-së. ***Për sa më sipër, grupit të auditimit nuk i është vendosur ndonjë praktike shkresore që të argumentojë teknikisht ndryshimin e gjurmës së projektit të miratuar nga Këshilli Teknik i DP Rrugëve me vendimin e datës 06.07.2010, i cili është miratuar jashtë periudhës objekt auditimi.*** Për sa më sipër është në kundërshtim me, Neni 2, pika 2 dhe 6 e Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i RSH", i ndryshuar; VKM nr. 276, datë 16.5.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar"; Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandimi: Nga ARrSh të merren masat që, në të ardhmen projektet për rrugët e reja të hartohen nga vetë ARrSh dhe të mos pranohen projekte të hartuara nga pushteti vendor të cilët nuk kanë kapacitet teknike për miratimin e tyre.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm e ARrSh është organizuar në nivel sektori dhe përbëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe 2 auditues. Nga verifikimi i të dhënave të mbi përvojën në punë të përgjegjësit të sektorit, rezulton se nuk plotëson kriterin e përvojës profesionale si auditues i brendshëm ose i jashtëm, për tu zgjedhur drejtues i njësisë së auditimit, pasi *ka* gjithsej 2 vite e 8 muaj përvojë në fushën e auditimit të brendshëm e të jashtëm të sektorit publik, përkatësisht nga data 1 Janar 2010 deri 31 Gusht 2012 në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, (në pozicionin e Inspektores në Sektorin e Auditimit të Brendshëm). (Konstatim deri në fund të periudhës së auditimit)

Gjithashtu, procedura e emërimit të Përgjegjësit të SAB nuk është realizuar me konkurrim të hapur, mungon shpallja e pozicionit vakant dhe e kritereve për këtë pozicion punësimi dhe rezulton se nuk përmbushen kriteret minimale të përcaktuara në ligj për emërimin në këtë pozicion. Për sa sipër, është pjesë e dosjes një raport i hartuar nga Komisioni i ngritur për rekrutimin/intervistimin, i përbërë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, i cili nuk ka lidhje me profesionin e auditimit; Drejtori i DSHB, Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore të ARrSh, dhe specialisti i Sektorit të Burimeve Njerëzore, lidhur me *"plotësimin e kritereve të pranimit në punë në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm".* Për sa më sipër është në kundërshtim me: ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm të sektori publik", neni 11, pika 2/b & 2/c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 128-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme (Sektori i Burimeve Njerëzore) të marrin masa që në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm të emërojnë staf me përvojën e nevojshme profesionale si hallkë e rëndësishme në mirë funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së punës audituese.

29.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme (Sektori i Burimeve Njerëzore) të marrin masa që procesin e rekrutimit të Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm të zhvillojë procedurë konkurruese duke shpallur vendin vakant dhe kriteret specifike që duhet të plotësohet me qëllim që të sigurohet një procedurë transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Në vijimësi

B.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***"Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 4"*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe BOE "C." ShPK &"Gj. K." ShPK me Nr.6706/6Prot. datë 24.09.2018 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 2,359,623,275.6 lekë pa TVSH ose 2,831,547,930 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës Nr 6621/3Prot. datë 23.09.2020 ku shtohet me 6 (gjashtë), si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet pjesore, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 2 (dy) zëra punimesh, në shumën **1,756,456 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis ARrSh dhe *BOE "47.& I. P.K.S sh.p.k & GJ. & CO* me Nr. 3159/12Prot. datë 16.07.2018 me objekt *"Supervizion Punimesh Ndërtim Rruga Kardhiq - Delvinë, Loti 4, Loti 5, Loti 6"*, Neni 7 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: ARrSh në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **1,756,456 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik**,** në situacionin përfundimtar**,** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve *BOE "C. ShPK & Gj. K. sha"* me të cilin është lidhur kontrata Nr. 6706/6Prot. datë 24.09.2018 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***"Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 5"*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe OE "A.-S." ShPK me Nr.6707/5Prot. datë 24.09.2018 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 2,142,535,887.70 Lekë me TVSH ose 1,785,446,573 lekë pa TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës Nr.6766/2 Prot. datë 18.09.2020 ku shtohet me 6 (gjashtë) muaj, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet pjesore janë përfshirë volume punimesh, të pakryera në fakt për 4 (katër) zëra punimesh, në shumën **7,443,875 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis ARrSh dhe *BOE "47.& I. P.K.S sh.p.k & GJ. & CO* me Nr. 3159/12Prot. datë 16.07.2018 me objekt *"Supervizion Punimesh Ndërtim Rruga Kardhiq - Delvinë, Loti 4, Loti 5, Loti 6"*, Neni 7 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: ARrSh në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **7,443,875 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik**,** në situacionin përfundimtar**,** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve *OE* "A.-S." ShPK me të cilin është lidhur kontrata Nr. 6707/5 Prot. datë 24.09.2018 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Për projektin me objekt ***"Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 6"*** sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe *BOE "A. K. ShPK & A. ShPK"* me Nr. 6708/5 Prot. datë 24.09.2018. në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 2,378,643,105.31 lekë pa TVSH ose 2,854,371,726.37 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës Nr.6711/2Prot. datë 23.09.2020 ku shtohet me 6 (gjashtë) muaj, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet pjesore, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën **18,448,939 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis ARrSh dhe *BOE "47. & I. P.K.S sh.p.k & GJ. & CO* me Nr. 3159/12Prot. datë 16.07.2018 me objekt *"Supervizion Punimesh Ndërtim Rruga Kardhiq - Delvinë, Loti 4, Loti 5, Loti 6"*, Neni 7 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: ARrSh në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **18,448,939 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik**,** në situacionin përfundimtar**,** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve *BOE "A. K. ShPK & A. ShPK"* me të cilin është lidhur kontrata me Nr. 6708/5Prot. datë 24.09.2018 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

B.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt "*Largimi i inerteve të rrugës provizore dhe kthimi i bregut të liqenit në gjendjen e mëparshme në aksin Lin-Pogradec*", me fond limit në shumën 20,551,687 lekë pa TVSh, me OE fituese në shumën 13,166,167 lekë pa TVSh, u konstatua se; Referuar procesverbalit nr.1, datë 26.05.2020, mbi hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, e deri në vlerësimin e ofertave të OE konstatohet se; Vendosja e kriterit të Licencës e nënkategorisë III.2.A, e cila ka si veprimtari *"Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor me kodet respektive A.1 dhe A.2.",* nuk është e argumentuar dhe nuk është në përputhje me objektin e kontratës, janë kërkuar 5-Kamiona vetëshkarkues, si dhe 2-Ekskavatorë me zinxhirë pa përcaktuar kapacitetet e tyre, çka e bën dhe konfuze për OE këtë kriter. Është kërkuar rul 15 ton (***vlerë absolute***) pa asnjë argumentim teknik pasi në relacionin e grupit të punës është parashikuar përhapja dhe ngjeshja e inerteve për volumin dhe sasinë që do të zënë në vend depozitimin e përcaktuar, pra ky kriter është shumë kufizues për OE. Gjithashtu janë kërkuar 5 shoferë por nuk përcaktohet kategoria e tyre, gjë e cila përsëri e bën të paqartë këtë kriter dhe konfuz. Referuar kritereve të vendosura nga komisioni i përcaktimit të kritereve, dhe vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit të ofertave, rezulton se janë s'kualifikuar OE të cilët kanë dhënë oferta më të ulëta se OE fitues, të cilat konsiderohen si oferta me përparësi më të mëdha ekonomike për AK. Pra nëse kriteret do të vendoseshin të mirë argumentuara në përputhje me LPP dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave për prokurimin publik, ARrSh do të shpenzonte një **shumë 2,478,508 lekë pa TVSh më pak e cila**

konsiderohet efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit (si diferencë e ofertës fituese 13,166,167 lekë me ofertën më të ulët 10,687,659 lekë nga "N." shpk). Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.12.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 1, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi II. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 87-122të Projektraportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Njësia e hartimit të kritereve të kualifikimit, të merren masat e duhura që, vendosja e kritereve të jetë në përputhje me objektin e kontratës si dhe të argumentohet në mënyrë teknike e ligjore, me qëllim shmangien e pasojave financiare për autoritetin në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga veprimet bankare për likuidimin e detyrimeve kontraktuale për kontratën Nr. 1 562/5 Prot. datë 04.04.2018 me objekt *"Menaxhim e mirëmbajtja e shpenzimeve të operimit të Tunelit të Kërrabës"* u konstatua se:

Me urdhër shpenzimin Nr. 1061, datë 09.12.2019, nga pjesa e kontingjencës janë likuiduar 786,932 lekë për sasinë 5,977 litra karburant të pasqyruara në situacionin e muajit Dhjetor 2019. Me urdhër shpenzimin Nr. 1056, datë 09.12.2019, nga pjesa e kontingjencës janë likuiduar 438,814 lekë për sasinë 3,354 litra karburant të pasqyruara në situacionin e muajit Tetor 2018.

Në situacionin e muajit Dhjetor 2018 është pasqyruar konsum karburanti, me arsyen "Tension i lartë", 1720 litra me vlerë 226,352 lekë (1720 litra x 131.6 lekë/litër); në situacionin e muajit Nëntor 2019 është pasqyruar konsum karburanti, me arsyen "Tension i lartë", 3398 litra me vlerë 441,610 lekë (3398 litra x 131.6 lekë/litër); në situacionin e muajit Dhjetor 2019 është pasqyruar konsum karburanti, me arsyen "Shkëputje energjie", 361.2 litra me vlerë 46,959 lekë (361.2 litra x 130 lekë/litër) dhe në situacionin e muajit Janar 2020 është pasqyruar konsum karburanti, me arsyen "Tension i lartë", 3458 litra me vlerë 449,540 lekë (3458 litra x 130 lekë/litër).

Tabela që tregon ndërprerjeve të energjisë/ luhatjeve të tensionit nuk është shoqëruar me asnjë praktikë shkresore nga OSHEE dhe është bazuar në një raport të hartuar nga menaxheri i kontratës.

Rekordet në të cilat bazohet likuidimi i karburantit të konsumuar nga ndërprerje të energjisë dhe luhatje të tensionit nuk janë gjeneruar automatikisht nga sistemi SCADA por të eksportuara në pasqyra me shënimin "Tension i lartë", pasi ato janë me zona të ngjyrosura në disa vende, kanë një titull, si dhe kanë në fund emrin e kontraktorit dhe vulën e tij. Si të tillë ato nuk janë dokumente justifikues origjinal që të shërbejë për efekt të kryerjes së pagesës.

Vlera prej **1,124,461 lekë,** për sasinë 8,937 litra të karburantit të situacionuar dhe likuiduar të pa bazuar në dokumentacion justifikues, nga grupi i auditimit konsiderohet shpenzim **pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet** për buxhetin e shtetit.

Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me: - Kontratat Nr.1562/5 Prot. datë 04.04.2018 dhe Nr. 2279/10 Prot. datë 25.06.2019 me objekt *"Menaxhim e mirëmbajtja e shpenzimeve të operimit të Tunelit të Krrabës"* kreu C.2 te ToR, pika; - Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Neni 8, pika 8.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Projektraportit të Auditimit).*

2.2. Rekomandimi: ARrSh të marri masa për përmirësimin (Update) e sistemit SCADA në tunelin e Kërrabës, që të bëjë të mundur kontrollin/komandimin e pajisjeve elektro-mekanike dhe gjenerimin e të dhënave në mënyrë automatike duke realizuar një funksionim sa më të mirë të sistemit të operimit e kështu zvogëlimin e kostos të mirëmbajtjes së tunelit në tërësi.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me projektin e investimit "Instalimi i Sistemit Web Gis" në vlerën për **45.2 milion lekë** me bashkimin e operatorëve ekonomik "G. C." ShPK dhe "I." ShPK, ku sipas Aneksit "Shërbimet dhe Grafiku i realizimit" të kontratës, instalimi dhe mirëmbajtja e këtij sistemi duhet të kishte përfunduar në të gjithë komponentët e tij me ***datën 20 Qershor 2020,*** pasi "Krijimi dhe instalimi i sistemit" sipas pikës nr. 2 te grafikut, duhet të përfundonte brenda 6 muajsh, (pra më 20 maj 2016) dhe mirëmbajtja për 4 vite (20 qershor 2016 deri 20 qershor 2020) u konstatua se, **nga Qershori 2016 deri në Tetor 2020 nuk është finalizuar qëllimi i këtij projekti investimi,** për më tepër që prej 4 vitesh është kryer mirëmbajtja e këtij sistemi, por nuk ka një inventar përfundimtar të digjitalizuar të rrugëve të kolauduar dhe marrë në dorëzim në sistemin Web Gis. Si përfundim, ARrSh nuk ka përditësuar dhe përfunduar hartën për të saktësuar distancat kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë, sidomos kjo për situatat kur nuk ka asnjë udhëzim si do të veprohet për rastet e kundërshtimve të gjatësive të këtyre segmenteve rrugore (në Km) midis të dhënave të inventarit te rrugëve sipas emërtimeve dhe VKM-ve respektive dhe të dhënave mbi gjatësinë e rrugëve *(në km)* sipas sistemit Web Gis. Nga sa më sipër, ARrSh nuk ka kryer detyrimin ligjor të përditësimit të këtyre hartave dhe distancave kilometrike. Nisur nga numri i madh i Institucioneve të administratës shqiptare që operojnë me këtë udhëzim dhe VKM, *mos përditësimi i Hartës së Rrjetit Rrugor të Republikës së Shqipërisë si dhe tabelës së Distancës kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë shton risqet e përfitimit të padrejtë të fondeve të buxhetit të shtetit në trajtimin financiar të punonjësve.* Për sa më lart kemi një përdorim pa ekonomicitet, efikasitet dhe eficience të fondeve në vlerën **45,2 milion lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 41-74 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARrSh-së/Drejtori i Përgjithshëm, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim përfundimin e këtij procesi të tej zgjatur dhe nxjerrjen e përgjegjësive dhe nisjen e masave administrative apo disiplinore për personat përgjegjës.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në segmentin rrugor Vlorë – Sarandë, konkretisht në segmentin Kthesa e Fterës (Borsh)–Piqeras, progresivi km 54+185-54+275, ku ka ndodhur rrëshqitja, kontraktori BOE *"E. t. C. S. A." & "S." SHPK,* sipas Urdhër Ndryshimit ChO D12 datë 16.05.2019 në seksionin e dëmtuar në gjatësinë 90 m *ka bërë ndërhyrje për rehabilitimin e shtresave rrugore, por jo për mbrojtjen e trupit të rrugës.* **Vlera 16,531.09 Euro,** e shpenzuar për riparimin e shtresave, ndërkohë që nuk janë bërë punime të mbrojtjes së trupit të rrugës**, konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet** për buxhetin e shtetit.

4.1. Rekomandimi: ARRSH të marri masa që në të ardhmen, për projektet e reja dhe ato në proces të mos kryej punime pa marrë masa paraprake që investimi i tyre të jetë i qëndrueshëm dhe rezultativ.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

D.1.1Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe në nenin 11 të kontratës individuale të punës kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: ***"Vërejtje me shkrim"*** për personat si më poshtë:

2. *Zj. M. Sh.*, me detyrë Përgjegjëse e sektorit të prokurimeve, në cilësinë e Përgjegjësit të prokurimit dhe anëtar i Njësisë së Prokurimit në tenderat e zhvilluar si dhe në për procedurat blerje me vlera të vogla,
3. *Z. E. E.*, me detyrë Drejtor i Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve, në cilësinë e sekretarit të Këshillit Teknik.

5. RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 842/7 prot., datë 31.12.2013 për periudhën e auditimit të veprimtarisë ekonomiko – financiare të subjektit (RTSH) nga data 01.01.2010 deri më datën 30.06.2013 grupi i auditimit konstatoi se rekomandimet e lëna për përmirësimet ligjore janë zbatuar në masën 100 %, masat organizative janë zbatuar në masën 87.5 %, ndërsa masat shpërblim dëmi dhe masat disiplinore nuk janë zbatuar. RTSH/strukturat drejtuese të saj nuk i kanë ndjekur dhe monitoruar rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, deri në plotësimin e zbatimit të tyre në masën 100 %. Për shkak të periudhës së gjatë (gati 10 vjeçare) e cila ka kaluar që nga dërgimi i rekomandimeve, disa prej tyre nuk janë më aktuale për shkak të ndryshimit në vite të bazës ligjore ku referojnë, afateve të parashkrimit referuar Kodit Civil, si dhe dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: RTSH/Drejtoria Juridike të marrë masa për të siguruar trajtimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke i monitoruar dhe zbatuar ato brenda afateve të përcaktuara, me qëllim përmirësimin e situatës së funksionimit të institucionit dhe shmangien e afateve të parashkrimit të përcaktuara.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: KDRTSH nuk ka hartuar një kod sjelljeje lidhur me rregullimin e veprimtarisë së vet, në kundërshtim me ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, neni 97, pika 4; në kundërshtim me ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, neni 99, pika 2, KDRTSH nuk është mbledhur në periudhën korrik-gusht të vitit 2018 dhe 2019; sipas procesverbaleve të mbledhjeve, rezulton se kanë munguar më shumë se 1/3 e mbledhjeve dy anëtarë të tij, të cilët referuar nenit 100, pika 1/c të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013, të ndryshuar, duhej të liroheshin nga detyra për shkak se mungesat nuk janë të arsyetuara dhe të dokumentuara.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të hartojë kodin e sjelljes lidhur me rregullimin e veprimtarisë së tij për çdo interes apo lidhje me ndonjë subjekt, si dhe çdo interes të mundshëm në ndonjë kontratë, që RTSH-ja ka realizuar ose synon të realizojë; të marrë masa për t'u mbledhur sa herë të jetë e nevojshme por jo më pak se njëherë në dy muaj, si dhe të dokumentojë cilësimin e mungesës së anëtarëve në çdo rast.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: KDRTSH: - nuk ka miratuar deklaratat njëvjeçare në lidhje dhe në përputhje me Deklaratën e Qëllimit, në kundërshtim me nenin 102, pika 9 të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013, të ndryshuar;
- nuk ka miratuar kriteret kryesore për vlerësimin e punës dhe shpërblimin e punonjësve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 102 të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013, të ndryshuar pika 12;
- në kundërshtim me nenin 16 të statutit: "Rendi i ditës së mbledhjes, së bashku me materialet përkatëse, i dërgohet çdo anëtari të Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, materialet janë shqyrtuar pothuajse në çdo rast në një afat 1-2 ditor, e rezultuar kjo nga data dhe numri i protokollit të relacioneve përkatëse, në kundërshtim me ligjin nr. 97/2013, datë 04.03.2013, i ndryshuar, neni 102, pika 9; nenit 102; Statutin i RTSH neni 17, germën "ç", nenin 16;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të miratojë deklaratat njëvjeçare në lidhje dhe në përputhje me Deklaratën e Qëllimit, të miratojë kriteret kryesore për vlerësimin e punës dhe shpërblimin e punonjësve si dhe të respektojë afatin për dërgimin e materialeve anëtarëve të këshillit para zhvillimit të mbledhjes.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: për aktivitetin e Bordit të Administrimit:

- Në mbledhjet e Bordit të Administrimit nuk ka marrë pjesë znj. E. D., e cila në referencë të nenit 108, germa "c" duhej liruar nga detyra që në datën 1.10.2017 dhe është zëvendësuar pas pak më shumë se dy viteve;
- Bordi i administrimit nuk ka përpiluar rregulla për të gjitha çështjet financiare, të cilat janë në juridiksionin e Drejtorit të Përgjithshëm në mospërputhje me pikën 1 dhe 6 të nenit 111 të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013 i ndryshuar.
- Bordi i administrimit në mospërputhje me germën "ç" të nenit 20 të Statutit, nuk i ka paraqitur Këshillit Drejtues raportin për shpenzimet dhe të ardhurat e RTSH-së, në formë raportesh financiare mujore.
- Materialet e shqyrtuara në mbledhje kanë ardhur në Bordin e administrimit ditën e zhvillimit të mbledhjes, veprim i cili është dhe në kundërshtim me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Bordit të administrimit të RTSH, neni 13;
- Miratimi preventivave të projekteve dhe emisioneve nga Bordi i Administrimit është bërë në çdo rast sipas propozimeve të Sektorit të projekteve, pa i analizuar në referencë të librit të tarifave, si dhe nuk ka miratuar tarifat e reja duke vepruar në kundërshtim me pikën 2 të nenit 49 të statutit;
- Ka dhënë pëlqimin për çdo çështje të paraqitur për shqyrtim sipas formës dhe përmbajtjes së prezantimit të materialeve nga ana e Drejtorisë së përgjithshme të RTSH, duke mos pasur ndikim në veprimtarinë e tij në zhvillimin dhe përparimin institucional të RTSH. Dhënia e pëlqimit dhe e vendimeve për çështje të veçanta pa ndryshime është e lidhur me vetë përbërja e Bordit të Administrimit, pasi në shumicë janë nëpunës të brendshëm të RTSH, pra në një far mënyre japin pëlqime për vet-veten;
- Nuk ka përgatitur planin e biznesit si një element bazë në organizimin e punës dhe operacionet e biznesit, në kundërshtim me nenin 52 dhe 53 të Statutit, në përgjegjësi të plotë edhe të Bordit të Administrimit,

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23 - 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtuesi RTSH të marrë në shqyrtim veprimtarinë e deritanishme të Bordi i Administrimit, dhe mbi bazën e problematikave të evidentuara në këtë Raport auditimi, të marrë masat e nevojshme organizative në drejtim të funksionimit efektiv të kësaj strukture.

Menjëherë

4.2 Rekomandimi: Bordi i Administrimit të marrë masa për të zhvilluar veprimtarinë e vet me kapacitet të plotë, duke përpiluar rregulla për çështje financiare; për raportimet financiare mujore, respektimin e afatit për shqyrtimin e dokumentacionit për mbledhje; shqyrtimin e vëmendshëm të projekteve dhe preventivave si dhe hartimin, miratimin dhe më pas zbatimin e plan-biznesit.

Menjëherë

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i prokurimeve publike në tenderin me objekt *"Rikonstruksioni i Godinës Radiotelevizionit Korçë"* konstatohet se në dosje nuk figuron deklarata paraprake për punime, apo ndonjë gjurmë për aplikimin e saj, veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"* i ndryshuar, neni 7, germa "i". Nga auditimi i DT, konstatohet se janë vendosur kritere që kufizojnë pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomikë (OE), konkretisht: nuk përmban

grafikun për realizimin e punimeve, sipas kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni 11, pika 3/a neni 26, pika 4 dhe neni 57/ 4 si dhe DST publikuar nga APP; kriteri 2.3,5 për drejtuesin teknik me përvoje pune mbi 10 vjet", jo në përputhje me Ligjin Nr. 8402, date 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" neni 7 dhe VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 "*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*", neni 23, pika 5 si dhe Ligjin "Për prokurimin publik" me ndryshime neni 20 dhe neni 46, pika 1.b; për të cilin ka qëndrime të ndryshme në procedurat e tjera të prokurimit. Nga auditimi i DT me objekt: *"Rikonstruksion i Stacioneve Ekzistuese..."* konstatohet se ka kritere që kufizojnë pjesëmarrjen e OE të tilla si: - Kriteri (për 6 lote), pika 2.3.6. për auditues energjie dhe mjedisor, pasi në preventiv nuk parashikohet asnjë zë për matjen e eficiencës së energjisë apo auditimin e energjisë dhe të mjedisit, por ashtu për termin certifikatë etj. Për procedurën *"Blerje Sistemi Satelitor (DVS-S2)"*: -Kriteret e veçanta, pika 2.3.5. *për inxhinier elektronik, mekanik, elektrik, megatronik (bachelor) dhe telekomunikacioni (master shkencor)"*, duke i diferencuar midis tyre për nivelin, është jo në përputhje me ligjin nr. 9643, datë20.11.2006 i ndryshuar, neni 20 dhe DT, pika 2.3.5. Për procedurën *"Blerje Licenca për përdorues sistemi MAM Etere playout si dhe support"*: - Kriteri 2.2.3 *"...punonjës të siguruar jo më pak se 25 ...*", nuk është në përputhje me objektin dhe llojin e kontratës etj. Për procedurën*"Kryerje e Shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë me Roje Private në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH, në Drejtorinë e Stacioneve Transmetuese RTV, në Radiostacionin Shijak e Radiostacionin Fllakë"*: - Kriteret e veçanta, shtojca 8, pika 3.2 germa "c", **"***Operatori.. duhet të ketë të siguruar jo më pak se 62 punonjës…*", jo në përputhje me kriterin 3.1 germa "d" dhe me shtojcën 9, duke sjellë që kriteret të jenë konfuze dhe jo të qarta për operatorët, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 28, pika 2. -Kriteri 3.3, pika 3, të cilat nuk janë në përputhje me objektin e tenderit sipas detyrimit ligjor parashikuar në ligjin nr. 9643, datë20.11.2006 i ndryshuarneni 46, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 28, pika 2 etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Të merren masa në të ardhmen nga RTSH, që në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në rastet e prokurimit për punë publike, para fillimit të procedurave të aplikojë për Deklaratë paraprake të punimeve, konform detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, me qëllim shmangien e risqeve të mundshme nga ndërtimi i objekteve pa leje ndërtimi.

Menjëherë

5.2 Rekomandimi: RTSH në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të analizojë parregullsitë e konstatuara nga auditimi i KLSH-së në hartimin e dokumenteve të tenderit, të vlerësojë përgjegjësitë e hartuesve në çdo rast dhe në vijim, në varësi të këtij vlerësimi, t'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik vendosjen e masave administrative/disiplinore.

Menjëherë

6. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, rezultoi se specifikimet teknike për punimet/shërbimet e parashikuara për tu kryer në lidhje me zërin *"FTV ndërtim kulla"* (furnizim transport vendosje ndërtim kulla) nuk janë shoqëruar me një projekt të mirëfilltë ndërtimi ku të paraqiten të detajuara të gjitha elementët/detajet e kullës për tu realizuar. Duke qenë se nuk është paraqitur asnjë detaj nga projekti dhe në specifikime teknike janë kërkuar vetëm rezultatet e punës së përfunduar rezulton se Detyra e Projektimit të kullës i është lënë firmës sipërmarrëse të punimeve. Në fakt referuar Kritereve të Veçanta të Kualifikimit sipas DST – ve përkatëse për këtë procedurë nuk rezulton që si kriter të jetë vendosur kushti i disponimit të OE pjesëmarrës në tender të licencës përkatëse për Projektim.

Situata e mësipërme është në kundërshtim VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, neni 26, pika 2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masa për trajnimin e stafit të angazhuar në procedurat e prokurimit si dhe angazhimin e punonjësve me profesione të përshtatshme sipas nevojave të investimit të planifikuar.

Menjëherë

7. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh në dosjen teknike të zbatimit për këtë lot rezultuan mangësitë si më poshtë: - Procesverbalet e provave me ngarkesë nuk janë firmosur nga ana e stafit të RTSH për zërat: Gjeneratori; Sistemi ATS; Stabilizatori i tensionit; Sistemi i radrizatorit; Sistemi i kamerave; Sistem fikje zjarri automatik; Sistemi i kondicionimit; Sistem fikje zjarri automatik.
- Procesverbali i përfundimit të punimeve i mbajtur të prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe sipërmarrësit nuk përshkruan datën e mbajtjes së tij dhe as datën e përfundimit të punimeve;
- Akti i kolaudimit nuk përshkruan datën e mbajtjes së tij dhe as datën e përfundimit të punimeve;
Dokumentet e cituara më sipër përmbajnë të dhëna kontradiktore në lidhje me datën e përfundimit të punimeve. Konkretisht, referuar njoftimeve të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit.
Gjithashtu, për Lotet I, III u konstatuan mangësi në dokumentacion si më poshtë:
Loti I – MIDE: Nuk disponohet software për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes;
Loti III – CERVENAKE: Nuk disponohet software për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes; Nuk disponohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve/furnizimeve; Nuk disponohet libreza e masave;
Loti IV – GLLAVË: Nuk disponohet software për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes; Nuk disponohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve/furnizimeve; Nuk disponohet libreza e masave;
Loti V – SOPOT: Nuk disponohet software për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes; Në dosje nuk disponohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve/furnizimeve;
Loti VI – LLOGARA: Nuk disponohet sofware për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të sistemit të kondicionerëve; Nuk disponohet Manuali i motorit të gjeneratorit, diagramet elektrike për të gjitha panelet dhe instruktimet/mantelet e operimit dhe të mirëmbajtjes; Në dosje nuk disponohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve/furnizimeve.
Situata e mësipërme është në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara nga Drejtori i Drejtorisë së Stacioneve Transmetuese, konkretisht pika 7, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar,* pika 4, si dhe me Kontratat respektive të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 - 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH si dhe strukturat e ngritura për monitorimin e investimeve të merren masa për shmangien e pranimit të dosjeve teknike me

mangësi në dokumentacion me qëllim sigurimin e transparencës dhe besueshmërisë në drejtim të furnizimit të AK për mallrat e blerë dhe dokumentimit të punës së kryer.

Menjëherë

8. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve në lidhje me zërin (Tokë, truall) të cilat paraqiten në kontabilitetin e RTSH, rezulton se: Nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori ekonomik nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje dhe ndërtesa për drejtorinë e përgjithshme dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, pra nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Radio Kukësi, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për zërin ndërtesë dhe truall nuk disponohet dokumentacion pronësor për të gjitha pronat që disponon RTSH (certifikatë pronësie). Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*, neni 11 dhe nenin 15; me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 125 - 131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të RTSH-së, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit kontabël dhe inventarizimit të aktiveve në njësinë e Radio Kukësit, si dhe nga verifikimi në terren rezultoi se:në katin e parë ndodheshin disa transformatorë të cilët nuk i përkisnin institucionit të RTSH-së po njësive të tjera shtetërore, të vendosura në një prej zyrave me sipërfaqe rreth 40 m^2. Në këtë ambient sipas diskutimeve verbale me drejtuesit e njësisë, rezulton se këto pajisje ndodhen prej kohësh edhe përtej periudhës objekt auditimi. Në lidhje me shfrytëzimin e aseteve të Radio Kukësit nga subjekte të tjera konstatohet se nuk ka asnjë marrëdhënie juridike nga e cila, nëse do të jepen me qira do të gjenerohen të ardhura për njësinë. Gjithashtu referuar hartës treguese të regjistrimit sipas identifikimit në regjistrat e pasurisë së zonës Kadastrale të rrethit Kukës në të cilën është pronar RTSH, konstatohet se: në ambientet e jashtme të regjistruara si zë truall, një sipërfaqe prej afro 300 m² nuk ishte e rrethuar si e gjithë pjesa territoriale të cilën ka në dokumentacion RTSH por, disponohej dhe posedohej nga subjekt fizik (shtëpi private) ndodhur në pjesën verilindore të godinës së RK. Nga nëpunësit autorizues e zbatues nuk janë marrë masat e duhura për përdorimin sa më eficient dhe shmangien nga përdorimi i paautorizuar i subjekteve të tretë të aktiveve shtetërore. Situata e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 9 pika 4/ë, e nenin 12 pika 3/f.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 125 - 131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, të rregullohet me marrëdhënie kontraktore, shfrytëzimi i aseteve në pronësi të saj, me qëllim rritjen e të ardhurave të institucionit dhe shmangien e përdorimit nga të tretët.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se drejtoresha e Auditimit të Brendshëm është komanduar në këtë funksion me vendimin nr. 295 datë 19.07.2018 të Drejtorit të

Përgjithshëm të RTSH, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
Në momentin që është ngritur në detyrë *(pasi më parë, deri në datën e komandimit ka punuar si juriste pranë Drejtorisë Juridike në RTSH për një periudhë prej afër 3 vjetësh (Shkurt 2015 – Korrik 2018))* dhe është komanduar në pozicionin e drejtoreshës, znj. B. nuk ka patur eksperiencën e nevojshme për këtë pozicion dhe certifikatën e Audituesit të Brendshëm kërkesa këto referuar pikës c, neni 11 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" ku citohet se "Kandidatët e përzgjedhur për pozicionin "Drejtor i njësisë së auditimit të brendshëm" duhet të jenë pajisur me dëshminë "Auditues i brendshëm në sektorin publik" dhe të kenë një përvojë pune 5-vjeçare si auditues". Aktualisht znj. B. është regjistruar pranë drejtorisë së harmonizimit të auditimit të brendshëm për kryerjen e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm të sektorit publik për vitin 2020-2021 por, edhe pse është aktualisht në proces certifikimi ky fakt nuk e justifikon paligjshmërinë e emërimit të saj në postin e Drejtoreshës së Auditit të Brendshëm. Këtë problem e ka vënë në dukje edhe Ministria e Financave me shkresën me nr. 18355 prot, datë 14.10.2019 (protokolluar në RTSH me nr. 2941 prot, 14.10.2019) firmosur nga Ministri i Financave "Mbi zbatimin e kritereve të punësimit për Drejtuesin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm" ku citohet se: Është konstatuar se drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe bazuar në nenin 23, ligji nr. 114/2015 kërkohet shqyrtimi i kësaj problematike dhe njoftimin e MFE për masat e ndërmarra për zbatimin e kritereve ligjore lidhur me këtë çështje.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 131 - 143 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).
<u>10.1 Rekomandimi</u>: Drejtoria e Përgjithshme e RTSH dhe Drejtoria Burimeve Njerëzore të marrin masa për emërimin e Drejtuesit të Njësisë së Auditit të brendshëm në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptarë u krye në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*. Grupi i auditimit i ka paraqitur institucionit një pyetësor në lidhje me komponentët bazë të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe Auditimin e Brendshëm, përgjigjet e të cilit u plotësuan nga drejtori ekonomik në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe drejtorët e drejtorive dhe njësive, në bazë të përgjigjeve të tyre nga grupi i auditimit konstatohet se, -nuk është hartuar regjistër risku për vitet 2018 dhe 2019; - nuk është hartuar gjurma e auditit për vitin 2017 RTSH, -plani i veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin është hartuar vetëm për vitin 2019; -njësia për periudhën objekt auditimi nuk ka pasur sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave, në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, *"Monitorimi"*; - nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave; - për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve nuk janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës dhe vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 "Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafët "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore" dhe "Profesionalizmi i stafit"; - Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave; - Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit, brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 131 - 143 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH të merren masa për plotësimin e të gjitha kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar në drejtim të njohjes nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentët e tij, delegimin e kompetencave, hartimin e regjistrit të riskut dhe koordinatorit për menaxhimin e tij, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve të cilat mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohen programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit, si dhe rregulla të shkruara në rastet e largimeve nga puna të punonjësve. Gjithashtu të merren masa për përcaktimin e saktë të detyrave ndërmjet pozicioneve të punës për çështje të raportimit, delegimit dhe përgjegjësive, si dhe të regjistrit të riskut e strategjisë së njësisë.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në rregulloret e brendshme të funksionimit të drejtorisë ekonomike, njësisë së marketingut dhe njësisë teknike nuk është i qartë procesi i komunikimit ndërmjet drejtorive për sa i përket procedurave që lidhen me ndjekjen dhe verifikimin e detyrimeve të subjekteve të cilat marrin shërbim nga RTSH, fakt i cili shmang përgjegjësinë e drejtorive përkatëse në lidhje me vjeljen e debitorëve dhe shtimin e detyrimeve të mbartura. Në fund të vitit 2019, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH me shkresën nr. 3010 datë 24.10.2019 drejtuar Drejtorisë Ekonomike, Njësisë Teknike dhe Drejtorisë së Marketingut, ka urdhëruar që brenda datës 15 të çdo muaji Drejtoria Ekonomike të verifikojë faturat e lëshuara dhe detyrimet e pashlyera të subjekteve që marrin shërbim nga RTSH. Nëse këto subjekte nuk shlyejnë detyrimet brenda afateve Drejtoria e Marketingut të aplikojë kamatën ligjore për vonesë në shlyerjen e detyrimit. Gjithashtu Drejtoria Ekonomike të Njoftojë Njësinë Teknike për ndërprerjen e shërbimit nëse detyrimet e subjekteve nuk shlyen brenda 45 ditëve. Vlera e proceseve gjyqësore të ndjekura nga drejtoria juridike në lidhje me mos arkëtimet e kontratave të qirave dhe atyre të marketingut për vitin 2017 është 7,214,394 lekë. Gjatë këtij viti kanë nisur procedura për dy subjekte (E. dhe K.) në vlerën 3,906,000 lekë. Ndërsa arkëtime janë bërë në vlerën 3,362,000 lekë nga Ministria e Mjedisit, D. S. dhe pjesërisht E. Vlera e mbartur nga vitet e kaluara është 6,294,748 lekë; - për vitin 2018 është 4,413,912 lekë. Gjatë këtij viti janë arkëtuar detyrimet nga subjektet E. në vlerën 2,512,482 lekë dhe R. D. në vlerën 288,000 lekë; - për vitin 2019 është 13,850,091 lekë. Gjatë këtij viti janë arkëtuar 330,740 lekë nga Drejtoria e Policisë të Qarkut Vlorë. Ndërkohë është shtuar vlera 9,767,335 lekë konkretisht nga Drejtoria e Marketingut lidhur me subjektin G. 2 në vlerën 1,062,880 lekë dhe nga Njësia Teknike subjekte me vlerë totale 8,704,455 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 143 - 148 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e RTSH të marrë masa për të rregulluar situatën e paqartë për procesin e ndjekjes dhe vjeljes së detyrimeve të subjekteve debitore të krijuara nga kontratat e qirave dhe kontratat e marketingut me qëllim vjeljen e debitorëve dhe evidentimin e përgjegjësive për krijimin e tyre, përfshirë dhe aplikimin e kamatave.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projekteve artistike dhe filmikenë lidhje medokumentacionin shoqërues në procedurën e paraqitjes së projektit artistik "Java–RTSH" konstatohet se Drejtuesi i Njësisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve RTSH me shkresën nr. 338, datë 11.09.2019 ka përcjellë në zbatim të nenit 7, pika 3 të "Rregullores", te Drejtori i Përgjithshëm propozimin për miratimin e projektit artistik si prodhim ekskluziv i RTSH. Procedura e ndjekur nga kjo Njësi për paraqitjen e projektit i është referuar pa të drejtë nenit 7, pika 1 të "Rregullores" dhe jo nenit 8, pasi është projekt i paraqitur nga persona fizikë/juridikë jashtë RTSH (*sinopsi nga staf jashtë RTSH*). Dokumentacioni i paraqitur nuk ka bashkangjitur: kërkesën me shkrim për miratimin e projektit artistik, jo në përputhje me "Rregulloren", neni 7, pika 1 dhe mungon bashkangjitur kërkesës sipas detyrimeve të "Rregullores",neni 7, pika 2, skenari, përshkrimi narrativ, etj.

- Projektiartistik "Java–RTSH" sipas preventivit ka komponentë si "drejtues emisioni" dhe "regjisor" që janë punonjës të RTSH. Konstatohet se për komponentin "regjisor" është lidhur kontrata nr. 348/7 Prot., datë 16.9.2019 e cila bie në kundërshtim me kontratën individuale të punësdatë 01.02.2017, për znj. E. J., që ka të njëjtën emërtesë "regjisor" në Njësinë e Programeve RTSH (*deri në datën 26.6.2020).* Për të njëjtin përshkrim të vendit të punës ("regjisor") me këtë punonjëse, padrejtësisht janë lidhur kontratat e sipërcituara, të cilat bien në kundërshtim me njëra tjetrën pasi nuk ka ndryshim të specifikave nga ato të përcaktuara në kontratat e lidhura me këtë punonjëse. Kontrata nr. 348/7 prot., datë 16.9.2019, është kontradiktore dhe nga përmbajtja, pasi neni 2 "të drejtat që kalohen" të cilat nënkuptojnë detyrimin e "regjisorit" për kalimin tek Njësia/RTSH-ja e të gjitha të drejtave ekskluzive pasurore në lidhje me regjinë, bie në kundërshtim me nenin 3, pika 1. Në këtë kontekst krijohet një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave por tashmë të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni "regjisor" sipas Kontratës individuale të punës. Për pasojë bazuar në kontratën nr. 348/7 prot., datë 16.9.2019 është kryer pagesa në formën e shpërblimit në vlerën 63,750 lekë për periudhën shtator-dhjetor 2019. Për të njëjtin pozicion/përshkrim pune si "regjisor", janë kryer 2 pagesa (page mujore dhe shpërblim). Vlera prej 63,750 lekë përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.
- Në realizimin e projektitartistik "Rreth mesnatës" sipas preventivit ka komponentë si "drejtues emisioni" dhe "regjisor" që janë punonjës të RTSH. Konstatohet se për komponentin "regjisor" është lidhur kontrata nr. 350/6 prot., datë 16.9.2019, me znj. E. J. e cila bie në kundërshtim me kontratën individuale të punësdatë 01.02.2017, për znj. E. J., që ka të njëjtën emërtesë "regjisor" në Njësinë e Programeve RTSH (*deri në datën 26.6.2020).* Për të njëjtin përshkrim të vendit të punës ("regjisor") me këtë punonjëse, padrejtësisht janë lidhur kontratat e sipërcituara, të cilat bien në kundërshtim me njëra tjetrën pasi nuk ka ndryshim të specifikave nga ato të përcaktuara në kontratat e lidhura me këtë punonjëse. Kontrata Nr. 350/6 prot., datë 16.9.2019, është kontradiktore dhe nga përmbajtja, pasi neni 2 "të drejtat që kalohen" të cilat nënkuptojnë detyrimin e "regjisorit" për kalimin tek Njësia/RTSH-ja e të gjitha të drejtave ekskluzive pasurore në lidhje me regjinë, bie në kundërshtim me nenin 3, pika 1. Në këtë kontekst krijohet një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave por tashmë të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni "regjisor" sipas Kontratës individuale të punës. Për pasojë bazuar në kontratën nr. 350/6 Prot., datë 16.9.2019 është kryer pagesa në formën e shpërblimit në vlerën 31,875lekë për periudhën shtator-dhjetor 2019. Për të njëjtin pozicion/përshkrim pune si "regjisor", janë kryer 2 pagesa (page mujore dhe shpërblim). Vlera prej **31,875** lekë përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqe nr. 148 – 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Titullari i RTSH nisur nga parregullsitë dhe mungesat e konstatuara në përcjelljen e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues në procedurën e paraqitjes së projektit *"Java–RTSH"*, për miratimin e projektit artistik, të analizojë përgjegjësitë e Njësisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve RTSH, me qëllim që në të ardhmen propozimi për miratimin e kërkesës për miratim projektit të shoqërohet me dokumentacionin e plotë konform kërkesave të "*Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave*", me ndryshime.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Projekti "Asambleja e Përgjithshme e EBU"- nuk ka kaluar për miratim në Bordin Artistiknë kundërshtim me nenin 7 -Procedura e paraqitjes së projekteve filmike dhe artistike, që janë prodhime të RTSH, miratimi dhe zbatimi i tyre, të Rregullores së miratimit dhe zbatimit të projekteve filmike dhe artistike dhe të blerjes së të drejtave, miratuar me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1026 prot., datë 10.04.2018;

- Preventivi i hartuar nuk mban në konsideratë librin e tarifave dhe as kalendarin e aktiviteteve dhe kuadrin rregullator për çmimet duke sjellë për pasojë 552,500 lekë shpenzime të panevojshme; nuk mban në konsideratë vlerën e shpenzimeve për dreka e darka zyrtare të personaliteteve të ftuara nga RTSH të përcaktuara me Vendimin e KD nr. 36, datë 16.05.2007, kapitulli III, pika 1 shkronja "a" duke shpenzuar 341,200 lekë mbi këtë vendim;
- Nuk është respektuar kuota në vlerë për dhurata e përcaktuar VKM nr. 327, datë 26.06.1995 "Për një shtesë në pikat 8 dhe 9 të VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", pika 9 paragrafi i dytë;
Janë kryer shpenzimet për dreka dhe darka në vlerën 1,370,000 lekë të cilat ishin preventivuar për t'u paguar nga bashkëpunëtorët;
- Ka mangësi në dokumentacionin e zbatimit dhe atë financiar, në kundërshtim me pikën 35, shkronja b, dhe pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" të ndryshuar duke sjellë për pasojë ulje të efektivitetit të fondeve publike.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148- 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
14.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë në lidhje me mungesën e miratimit nga ana e Bordit artistik, duke marrë masa për eliminimin e kësaj parregullsie; për moszbatimin e vendimit të KDRTSH për kryerjen e pagesës prej 1,370,000 lekë e cila ishte preventivuar për t'u bërë nga bashkëpunëtorët në aktivitetet e programit social; për zbatimin e kuotave të përcaktuara nga KDRTSH për dhuratat, si dhe për parregullsitë e faturave financiare të zbatimit të këtij projekti.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Përprojektin "Eurovision Song Contest 2018", konstatohet se:
- Bordi i Administrimit ka dhënë pëlqimin për preventivin me vlerë gjithsej 15,972,500 lekë, në një kohë që shuma e zërave analitikë është 332,000 lekë më shumë, po kështu ka marrë vendim dhe KDRTSH;
- Në preventiv nuk janë respektuar çmimet e përcaktuara në librin e tarifave;
- Janë kryer pagesa për honorarë dhe fatura nga arka në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 64;
- Është kryer pagesë fikse për një punonjës të RTSH, kur dihej të paguhej me orë jashtë orarit;
- Janë paguar fatura të pashoqëruara me situacionin përkatës, si dhe me mangësi plotësimi;
- Janë paguar për hotel dhoma për dy persona, kur në fakt duhej të ishin për një person; pa dokument vërtetues të shpenzimeve, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 34/b;
- Me 5 mandat pagesa janë paguar paradhënie 5 persona në shumën 1,870 euro, për të cilat nuk ka dokumente justifikues për shlyerjen e tyre, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 66:
- Është paguar me bankë prenotimi i hotelit në Lisbonë për 6 persona për 15 ditë në dhoma dyshe, me çmimin 180 euro për dhomë, gjithsej 16,200 euro, në kundërshtim me vendimin e KDRTSH nr. 36, datë 16.05.2007 i ndryshuar, kreu i I, pika 2/B.a, i cili përcakton për fjetje 110 euro për person, pra mbi këtë vendim më shumë gjithsej 6,300 euro, duke ulur efektivitetin e përdorimit të fondeve në këtë vlerë;
- Janë paguar dieta për qëndrimin në Lisbonë për 15 ditë sipas kërkesës së datës 09.03. 2018 të Drejtorit të Festivalit sipas Urdhër- shërbimeve të plotësuar në datën e nisjes dhe jo në kthim që të vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve pra provojnë vetëm paradhënien;
- Janë paguar me mandat pagesën nr. 103, date 27.04.2018 gjithsej 950 euro për z. K. D., me cilësimin "Shpenzime sipas Vendimit 168, datë 30.11.2016" e cila është vetëm me firmën e

financierit (pa emër dhe mbiemër), pa firmën e marrësit dhe nuk ka asnjë dokument bashkëlidhur; me mandat-pagesat nr. 54, datë 09.03.2018 me vlerë 400 euro dhe nr. 101, datë 27.04.2018 me vlerë 1500 euro, vetëm me emrin e marrësit K. D. pa firmën e tij, është paguar paradhënie për këtë aktivitet K. D., e cila nuk justifikohet me dokumentet e shpenzimeve të sjella;

- Janë paguar dhurata me vlerë gjithsej 110,000 lekë, në kundërshtim me vendimin e KDRTSH nr. 36, datë 16.05.2007 i ndryshuar, kreu i III, pika 5;
- Janë paguar 15 bileta për 3 netët e festivalit, në një kohë që numri i pjesëmarrësve të parashikuar dhe faktik ka qenë për 10 persona, duke ulur efektivitetin e shpenzimeve me vlerën e 5 biletave prej 1,075 euro.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Administrimit të shqyrtojnë me vëmendje sipas zërave përkatës të preventivave të projekteve artistike dhe filmike, me qëllim që të harmonizohet zbatimi i akteve të dala për këtë qëllim, duke rritur efektivitetin e përdorimit të parasë publike.

Menjëherë

15.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrin masa për të shqyrtuar të gjithë dokumentacionin justifikues dhe argumentues të këtij projekti, duke nxjerrë përgjegjësitë financiare dhe funksionale për preventivin dhe shpenzimet e këtij projekti.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Për projektit "Gjyshet milionere" 2018-2019, konstatohet se: - Drejtori i Njësisë së Programeve ka nënshkruar kontratë me subjektin Person fizik P. Sh., me objekt të ndërtojë skenografinë në mjediset e brendshme të objektit (neni 2, pika 1), në vlerën 2,500,000 lekë, në një kohë që është i vetëpunësuar, si dhe ka për fushë të veprimtarisë "Riparime shërbime të ndryshme të mobilieve", gjë që nuk ka lidhje me veprimtari skenografike; nga mungesa e vendosjes së kritereve të përzgjedhjes së subjekteve, personi fizik i cilësuar më sipër ka urdhër ekzekutimi për sekuestro nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë;

- Kontratat e nënshkruara nuk janë të koordinuara në kohë lidhur me rritjen efektivitetit të shpenzimeve për mallrat dhe shërbimet e marra me qira; një pjesë e kontratave për krijuesit dhe ekipin administrativ nuk janë të protokolluara dhe kanë mospërputhje midis përcaktimeve për shumën e shpërblimit e kohën e shpërblimit dhe atyre si është vepruar në fakt, të cilat janë sipas preventivit, por jo sipas kontratës nuk është mbajtur në konsideratë mënyra e likuidimit sipas përcaktimeve kontraktore; disa kontrata të këtij projekti janë nënshkruar nga Drejtor i Njësisë së Programeve, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 105, pika 1, germa "dh";
- Blerjet e materialeve nuk kanë asnjë dokument (fletë-hyrje) për këto asete, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 35/b;
- Për personelin krijues dhe stafin administrativ prej 19 nëpunësish nuk ka të përcaktuara kritere për mënyrën e punësimit me projekte, duke rriskuar trajtimin e pabarabartë në përfitime dhe pasoja negative dhe në performancën e punës në RTSH;
- Sipas Kontratës së bashkëpunimit me Radiotelevizionin e Kosovës me nr. 18 prot., datë 09.01.2019, përfundimi i spektaklit televiziv, kopja e parë standarde e 9 emisioneve televizive të tjera duhet të realizohet jo më vonë se data 30.01.2019, gjë që tregon se është e pakuptimtë pagesa e qirasë edhe për dy muaj të tjerë, deri me datë 02.03.2019;
- Faturat e pagesave janë likuiduar edhe për mallra dhe shërbime që nuk përkojnë me periudhën e zbatimit të projektit, kanë mangësi plotësimi, janë nënshkruar jo nga persona të autorizuar nga projekti etj., si për pajisjet me qira, artikuj ushqimore, pije alkoolike etj., në kundërshtim

me pikën 61 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
- Janë kryer pagesa për çmimet nga arka për 5 persona pjesëmarrës në shumën gjithsej 868,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e pikës 63 dhe 64 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
16.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për nënshkrimin e kontratave me të tretë vetë ose me autorizim, si dhe të ngarkojë Drejtoritë që të përcaktojnë kritere dhe gjurmën e auditimit për përzgjedhjen e subjekteve dhe personelit të projekteve, duke nënshkruar dhe vepruar në kohë me kontratat përkatëse, si dhe të ngarkojë me përgjegjësi nëpunësin zbatues në rastet e mosrespektimit të kritereve ligjore dhe financiare në menaxhimin e projekteve.

Menjëherë

17. Gjetje nga Auditimi: Për projektin "Masterchef Junior" 2017-2018, konstatohet se: Është paraqitur në Bordin e administrimit një program televiziv me vlera të padiskutueshme, duke rritur audiencën dhe të ardhurat nga marketingu, por që nuk ka të dhëna të dokumentuara cilat kanë qenë rezultatet përkatëse, megjithëse është kërkuar dhe nga KD një vlerësim i tillë;
- Drejtori i përgjithshëm e ka nënshkruar dhe paguar licencën pa kaluar për miratim projektin në BA, si dhe koha në këtë licencë është përcaktuar 60 minuta, dhe jo 90 minuta, duke rrezikuar jo vetëm penalizimin për shkelje të Licencës, por duke sjellë për pasojë të rritje të kostos së projektit, pasi normalisht tarifat duhet të jenë në referencë të kohëzgjatjes së episodit;
- Megjithëse në preventivin e miratuar në Bordin e administrimit, nga vlera gjithsej e projektit prej 31 milion lekë, 6.3 milion kanë qenë miratuar të realizohen me kontrata shkëmbimi, janë
- Për së paku 6 zëra nuk ka referenca në librin e tarifave duke rritur ndjeshëm koston e këtij projekti;
- Janë nënshkruar kontrata komplekse duke përfshirë njëkohësisht blerje dhe marrje me qira materiale të ndryshme, çmimet vendosura në të cilën kanë diferenca të ndjeshme për zëra të njëjtë, duke e bërë kontratën praktikisht të pa menaxhueshme dhe me efektivitet të ulët;
- Është marrë me qira studio për 146 ditë, në një kohë që në preventiv ishte parashikuar për 90 ditë, si dhe për 3 muaj studio nuk ka shërbyer për xhirime, pasi nuk ka qenë e pajisur me skenografinë dhe elementët e saj për xhirime; po kështu dhe kontrata blerje materiale logo të formateve të ndryshme për rreth 16 ditë para se të kenë në dispozicion studion, ose janë mbajtur dhe paguar qira për materiale pas përfundimit të afatit të studios;
- Kontrata me ekonomistin dhe magazinierin e projektit janë për gati 3 muaj më pas nga kontratat e tjera, në një kohë që e kanë për detyrë menaxhimin e proceseve të kontrollit të brendshëm, menaxhimin financiar, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportimin për shpenzimet;
- Faturat financiare të paguara për llogari të shpenzimeve të këtij projekti kanë mangësi në kohë për përputhjen me ndodhjen e veprimit ekonomik, janë nënshkruar nga persona të paautorizuar, mungon transportuesi, nuk është përshkruar lloji i mallit apo shërbimit, mungojnë fletëhyrjet për mallrat e blera, etj., në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 37;
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1 Rekomandimi:. Drejtori i Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme për të kryer veprimet e duhura pas miratimit final të projekteve, të garantojë respektimin e kushteve kontraktore, reflektimin e librit të tarifave për çmimet e preventivit, si dhe respektimin e kuadrit ligjor dhe rregullator ekonomik dhe financiar.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Bordi Artistik i RTSH nuk e ka zbatuar plotësisht rregulloren përkatëse, pasi nuk i janë përcjellë projektet nga Drejtori i Përgjithshëm, projektet nuk kanë

pasur dokumentacionin e plotë shoqërues, janë miratuar të gjitha projektet e sjella pa ndryshime (kjo dhe për shkak të përbërjes së këtij bordi), duke e bërë këtë veprimtari formale.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqet nr. 186 - 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
18.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë veprimtarinë e deritanishme të Bordit artistik dhe të marrë masa për që veprimtaria e tij të jetë funksionale në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale të RTSH.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit nuk ka zhvilluar aktivitet mbi një vit nga krijimi; si dhe nuk është mbledhur jo më pak se një herë në dy muaj; nuk ka paraqitur një herë në tre muaj një raport para Këshilli Drejtues mbi zbatimin e strukturës programore; nuk ka organizuar vëzhgime dhe studime lidhur me ndjekjen e shërbimeve të transmetimeve nga ana e kategorive të veçanta të shoqërisë; nuk ka organizuar seanca dëgjimore në transmetime të drejtpërdrejta, për çështje të programacionit; si dhe nuk ka hartuar një raport vjetor, në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij, që i duhej paraqitur KDRTSH-së, AMA-s, ministrit dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqet nr. 186 - 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
19.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të shqyrtojë dhe të analizojë në mënyrë të veçantë veprimtarinë e deritanishme të Këshillit për shikuesit dhe dëgjuesit, duke marrë masa për vënien në eficiencë të plotë të kësaj strukture për të siguruar përfaqësimin e shikuesve dhe dëgjuesve.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Përfitimi i rimbursimit të shpenzimeve celulare nuk ka kritere për operatorin e kontraktuar, janë evazive për numrin dhe punonjësit sipas pozicioneve, si dhe nuk janë ndjekur me rigorozitet shpenzime të kësaj natyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqet nr. 186 - 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
20.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për të rishqyrtuar dhe për t'ia paraqitur më pas Këshillit Drejtues vendimin për rimbursimin e shpenzimeve të telefonisë celulare duke vendosur kritere për to, për punonjësit përfitues dhe saktësimit të pozicioneve përkatëse, me qëllim rritjen e efektivitetit të shpenzimeve.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën me objekt *'Blerje licenca për përdorues të Sistemit MAM Etere dhe Playout ETX'– viti 2018'*,me vlerë të fondit limit 31,483,143.33 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 31,085,000 lekë pa TVSh, të lidhur sipas aktit me nr. 75/9 prot., datë 17.12.2018 mes RTSH dhe furnitorit të mallrave *"M. N."* SHPK rezultoi si më poshtë:
Për marrjen në dorëzim të zërave objekt kontrate është ngritur Grupi i punës sipas Urdhrit nr. 75/11 prot., datë 21.12.2018 me përbërje z. B. M., E. B. dhe z. A. A. Sipas shkresës me nr. 4239 prot., datë 21.12.2018 me lëndë *'Dorëzimi i licencave, referuar kontratës me nr. 75/9 prot., datë 17.12.2018'* është bërë dorëzimi nga ana e OE për zërat si më poshtë: Licencë për përdorues në Sistemi MAM ETERE – sasia 150 copë; Licencë për Playout ETX – sasia 3 copë.
Me shkresën me nr. 75/13 prot., datë 17.01.2019 grupi i punës i ngritur për marrjen në dorëzim ka konstatuar disa mangësi si dhe dy kërkesa:
Data e publikuar për suportin aktiv nga 6 muaj duhet në 4 vite;
Kohëzgjatja e aktivitetit të licencave me funksione të ndryshme nga (client) duhet të jetë pa limit (unlimited);
Numri i licencave aktive për ETX ishte 2 dhe sipas kontratës duhet të jenë në panel dhe 3 licenca të reja ETX;
Me shkresën me nr. 75/14 prot., datë 22.01.2019 Titullari i AK ka vënë në dijeni sipërmarrësin në lidhje me pretendimet e mësipërme. Me shkresën me nr. 75/15 prot., datë 28.01.2019 nga

ana e sipërmarrësit *"M. N."* SHPK i është kthyer përgjigje kërkesës së Titullarit. Me shkresën me nr. 58/1 prot., datë 28.12.2018 të Njësisë Teknike, administruar në RTSH me nr. 75/16 prot., datë 30.12.2018 është vënë në dijeni Titullari i AK nga ana e Drejtorit të kësaj njësie z. H. M. në lidhje me faktin se pretendimet e sipërmarrësit sipas shkresës me nr. 75/15 prot., datë 28.12.2018 qëndrojnë pasi aktualisht RTSH e merr shërbimin e kërkuar duke kërkuar edhe ndryshimin e grupit të marrjes në dorëzim nga 3 në 5 anëtarë. Në përgjigje të kësaj shkrese nga ana e Titullarit është ngritur Urdhri nr. 75/17 prot., datë 30.01.2019 për marrjen në dorëzim të mallrave dhe ndjekjen e kontratës me përbërje z. A. K., E. K., E B., z. B. M. dhe z. K. S. nga ana e të cilëve është mbajtur procesverbali përkatës i datës 75/18 prot., datë 01.02.2019 për marrjen në dorëzim. Sipas këtij procesverbali ka pasur objeksione nga ana e z. B. M.

Nga verifikimi i praktikës së mësipërme, nisur nga kërkesat e cituara në specifikimet teknike sipas shkresës me nr. 75/1 prot., datë 17.09.2018, paragrafi i dytë *Software përgjegjës për Playout ETX*, pika 4 është cituar se: *"Software mund të instalohet në versionet Windows 7, 10"*.

Nga verifikimi në RTSH në prezencë të përfaqësuesve të KLSH si dhe punonjësve të RTSH u konstatua se nuk janë realizuar instalime të Softwareve të rinj Playout në sasinë 3 copë, por janë zgjeruar kanalet në software – in Playout (Main/Backup) të realizuar në një procedurë tjetër të vitit 2016.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se në lidhje me procedurën me objekt *"Furnizim – vendosje e materialeve teknologjike në studio e prodhimit për server room, storage mam, ott"*, për të cilën është shpallur fitues BOE *"A. B. S."* SHPK &*"S. A."* SHPK &*"M.N."* SHPK është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3536/11 prot., datë 17.01.2017 me afat 90 ditë. Sipas zgjidhjes teknike (faqe 63 – 65 e materialit) të ofruar nga sipërmarrësi i kësaj kontrate rezulton se në përshkrimin e bërë për software – in Playout janë parashikuar instalimi i këtij të fundit si më poshtë:

Fq. 63 – Playout - Sistemi playout duhet një sistem qendror server plus multiple clients për të bërë playout në disa kanale të ndryshme njëkohësisht.

Fq. 65 – Sistemi i playout duhet të ofrojë mundësinë e skedulimit të Playlistave në mënyrë kronologjike bazuar mbi kohen (Date-Time) të Serverit. Ky funksion duhet të përfshijë një set feature si:

Pika e: Deri në 8 kanale paralele për playlist të ndryshme

E thënë ndryshe, në këtë rast nuk janë blerë 3 software Playout ETX të kërkuar, siç edhe është cituar në specifikimet teknike të hartuara në fillim të procedurës, por në sistem rezulton se janë shtuar tre kanale video të reja në Playoutin ETX ekzistues të blerë më parë me procedurën e nisur në vitin 2016.

Nga ana e grupit të auditimit është kërkuar vënia në dispozicion e dokumentacionit përkatës vërtetues dhe justifikues i marrjes në dorëzim të këtyre aktiveve në lidhje me zërin *Licencë për Playout ETX*. Ky dokumentacion nuk disponohej dhe as nuk faktohet se aktualisht RTSH disponon 3 Playout të rinj ETX dhe **për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër nga ana e furnitorit *"MC NETWORKING"* shuma prej 11,700,000 lekë pa TVSH, shumë kjo e cila përbën dëm ekonomik** dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e furnitorit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me kontratën e furnizimit e lidhur sipas aktit me nr. 75/14 prot., datë 22.01.2019, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, i ndryshuar, pika 35 dhe 36si dhe Urdhrin nr. 75/17 prot., datë 30.01.2019 për marrjen në dorëzim të mallrave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **11,700,000 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"M. N."* SHPK, si furnizime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr.

75/9 prot., datë 17.12.2018 me objekt *'Blerje licenca për përdorues të Sistemit MAM Etere dhe Playout ETX'*.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh rezultoi se i janë likuiduar sipërmarrësit të punimeve për 7 zëra punimesh *(shiko aneksin 1.1)* shuma prej **3,092,885 lekë pa TVSH** për volume të pakryera në fakt. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 161/1 prot., datë 31.07.2017. Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3; UKM nr. 2, datë 8.5.2003 *"Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu I/I *"Klasifikimi i punimeve të ndërtimit"*, germa "A", paragrafi i fundit, *Kreun I, germa B Punime teknologjike dhe të montimit, Kreun II, pika B Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi;* VKM nr. 514, datë 15/8/2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 *"Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, të ndryshuar, pika 1, germa "c", paragrafi i fundit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **3,092,885 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"S."* ShPK si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'*, rezultoi se:

- *Stacioni Zvërnec:* Sipas situacionit përfundimtar në këtë stacion janë vendosur tre sensorë për dyert. Edhe sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim rezulton se janë marrë në dorëzim tre sensorë. Referuar specifikimeve teknike rezulton se janë parashikuar për t'u vendosur tre sensorë. Në fakt sipas verifikimit në terren rezultoi se për këtë stacion ishte vendosur vetëm një i tillë. Për rrjedhojë duke bërë korrigjimet përkatëse rezulton se janë përfituar padrejtësisht dy copë sensorë për dyert, ose vlera prej **17,200 lekë** pa TVSH.
- *Stacioni Treblovë:* Sipas situacionit përfundimtar në këtë stacion janë vendosur tre transformatorë rryme. Edhe sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim rezulton se janë marrë në dorëzim tre transformatorë rryme. Referuar specifikimeve teknike rezulton se janë parashikuar për tu vendosur tre transformatorë rryme. Në fakt sipas verifikimit në terren rezultoi se për këtë stacion ishin vendosur vetëm dy të tillë. Për rrjedhojë duke bërë korrigjimet përkatëse rezulton se janë përfituar padrejtësisht një copë transformatorë rryme, ose vlera prej **10,500 lekë** pa TVSH.

- Nga sondazhet e kryera për depozitat e vendosura në 8 stacione rezultoi se nuk është kryer në asnjë rast zëri me nr. rendor 6 *'F.V lyerja me primer izolues e pusetës të depozitës'*. Për rrjedhojë vlera prej **345,600 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit.

- Nga verifikimi i listës së zërave në preventiv konstatohet se është likuiduar midis të tjerave edhe zëri me nr. rendor 7 *"Kolaudimi i impiantit prova dhe vënia në punë"*. Në fakt referuar emërtimeve të zërave të cilët janë konsideruar si furnizim vendosje si dhe ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, neni 12 rezulton se likuidimi i këtij zëri në shumën **168,000 lekë pa TVSH** është likuiduar tepër dhe në kundërshtim me kuadrin ligjor të sipërpërmendur. Për sa më sipër kjo vlerë përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit të punimeve.

- Konstatohet se i janë likuiduar sipërmarrësit të punimeve mes të tjerave edhe zëri *'Vendosja e rezervuarit në gropë'* kur në fakt referuar zërit me nr. rendor 1 është likuiduar si zë më vete *'F.V Depozitë karburanti V 3300 lt, ≥ 500 kg'* duke bërë që çdo vendosje depozite të paguhet dy herë, kur në fakt është kryer një herë. Për rrjedhojë vlera prej **201,600 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit.

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pas verifikimeve të kryera në qendrën e monitorimit në RTSH nuk dokumentohet marrja e licencave nga ana e sipërmarrësit të punimeve për 722 copë ose vlera **1,025,240 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit të punimeve.

Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, neni 12; Urdhrin nr. 319/1 prot., datë 26.04.2019 për marrjen në dorëzim të mallrave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,768,140 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE *"S. C."* ShPK, *"R. C."* ShPK dhe *"A. T."* si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 20/13 prot., datë 26.04.2019 me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'*.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të blerjeve me vlera të vogla u konstatua se: Për 6 procedurat e prokurimit me objekt *"Mbikëqyrja e punimeve supervizioni në objektin rikonstruksioni i stacionet ekzistues Gllavë, Tarabosh, Sopot, Mide, Llogara dhe Cervenake"* me fond limit në shumën totale në shumën 2,097,584 lekë pa TVSH, dhe vlerë kontrate në shumën totale 2,144,000 lekë pa TVSH rezultoi se: Këto procedura janë anuluar dy herë sipas komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për arsye se, ofertat e paraqitura janë më pak se VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit". Pasi janë kualifikuar operatorët dhe janë renditur në klasifikimin përfundimtar, nga komisioni janë skualifikuar dhe janë njoftuar në sistem brenda një periudhe prej 3-4 minuta, me pretendimin se kanë paraqitur oferta anomalisht të ulëta. Në udhëzimin e APP, për procedurat e blerjeve me vlera të vogla përcaktohet se nuk zbatohen dispozitat e nenit 56 të LPP për ofertat anomalisht të ulëta. Bazuar në vlerësimin e procedurës së parë, komisioni i prokurimeve të blerjeve me vlera të vogla, duhet të priste 24 orë sikurse parashikohet në ftesën për ofertë të paraqitur në SPE për secilin operator deri duke argumentuar kalimin tek operatori i radhës dhe arsyet përkatëse të cilat duhet të dokumentoheshin në një procesverbal, ose të kërkoheshin argumentim i paraqitjes së ofertës përpara se të s'kualifikoheshin. Më pas këto procedura janë kryer me blerje të drejtpërdrejtë me testim tregu duke marrë oferta dhe kanë përcaktuar fituese ofertën më të ulët të marrë, sipas procesverbalit përkatës të udhëzimit. Nga sa më sipër rezulton se nga vlera e secilës kontratë të lidhur me vlerën e OE fitues në procedurën e parë, për secilën procedurë, është konsideruar shpenzim i paligjshëm për buxhetin subjektit, dhe në total ***shuma prej 1,470,800 lekë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH***. Situata e mësipërme është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar,

neni 1, neni 40; si dhe me Udhëzimin nr., datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar, pika 5.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 46 - 54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,470,800 lekë**, shkaktuar si dëm ekonomik nga veprimet dhe mosveprimet e z. Th. G., në cilësinë e Titullarit të AK dhe z. G. A., z. A. M. dhe znj. G. H., në cilësinë e Komisionit të procedurave të blerjeve të vogla.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti VI Llogara rezultoi se nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë zbatuar specifikimet teknike të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes në lidhje me zërin *"Punime rrjetë xingato d=4 mm të vendosur në profile të xinguara"*. Konkretisht sipas specifikimeve teknike është përcaktuar që vendosja e kolonave të rrethimit të kryhet në kubikë betoni C 12/15 me dimensione 0.5 ml x 0.5 ml x 0.5 m. Në fakt sipas verifikimit rezultoi se nuk janë respektuar këto dimensione pasi janë realizuar më të vogla, jo në formë kubike dhe nuk konfirmohet marka e betonit pasi materiali i përdoruar është pa përforcim me hekur betoni, siç përshkruajnë specifikimet teknike për këtë zë. Gjithashtu, në vend të betonit është përdorur material tjetër (mbushës me material rrethanor) jashtë çdo standardi duke mos arritur markën e kërkuar. Aktualisht rrethimi është shembur në masën 80 % të tij pas veprimit të forcave të erërave në atë zonë. Për rrjedhojë, në gjykim të grupit të auditimit ky zë punimesh konsiderohet si volum pune i pakryer dhe vlera prej **1,081,600 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik**. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Kontratat e shërbimit të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,081,600 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE *"2.C. & S. Co"* ShPK si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/26 prot., datë 05.07.2017 me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti IV Llogara.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i Godinës së Radio Televizionit të Korçës'*, nga inspektimi në terren i punimeve të ndërtimit rezultoi se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve vlera prej **1,005,706 lekë pa TVSh** për diferenca volumesh në 4 zëra punimesh. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3;Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3; VKM nr. 514, datë 15/8/2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 *"Për disa ndryshime në udhëzimin*

NR. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 1, germa "c", paragrafi i fundit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,005,706 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"H.-2."* ShPK, si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 29/10 prot., datë 18.05.2017 me objekt *'Rikonstruksion i Godinës së Radio Televizionit të Korçës'*.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, për sa i përket vlerës së fondit limit, rezultoi se kjo shumë është parashikuar në vlerën 22,613,430 lekë pa TVSH. Në këtë shumë rezulton të jetë përfshirë edhe një vlerë prej 5 % në masën 788,300 lekë pa TVSH. Sipas preventivit të pasqyruar në DST rezulton se formati i preventiv – ofertës për t'u plotësuar nga ana e OE përmban zërat dhe jo fondin rezervë prej 5 %. Në kushte të tilla, nga ana e NJP janë ngarkuar në sistem Dokumente Standarde të cilat pasqyrojnë si vlerë të fondit limit shumën prej 22,613,430 lekë pa TVSH dhe një preventiv që nuk parashikon fond rezervë me pasojë rritjen fiktive të fondit limit në masën 788,300 lekë pa TVSH, kjo për shkak se kjo NJP nuk i është referuar saktë preventivit të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 478/1 prot., datë 14.02.2017 i cili ka paraqitur atë sipas shkresës me nr. 478/2 prot., datë 27.02.2017. Duke bërë korrigjimet për efekt të uljes së ofertës nga ana e OE fitues *"S."* ShPK prej 56,008 lekë pa TVSH, rezulton se diferenca prej **732,292 lekë pa TVSH***(788,300 lekë pa TVSH – 56,008 lekë pa TVSH)***përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të RTSH. Situata e mësipërme është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 57, pika 4.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **732,292 lekë pa TVSH** ndaj grupit të punës të përbërë nga z. G. A., z. A. B. dhe znj. G. H., në cilësinë e anëtarëve të NJP, për rritje fiktive të fondit limit me pasojë dëm ekonomik në procedurën me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'*, rezultoi se:
- Nga verifikimi i listës së zërave në preventiv konstatohet se është likuiduar midis të tjerave edhe zëri *"Kolaudimi i impiantit prova dhe vënia në punë"*. Në fakt referuar emërtimeve të zërave të cilët janë konsideruar si furnizim vendosje si dhe ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, kolaudimi i punimeve të ndërtimit nuk mund të kryhet nga ana e firmës sipërmarrëse dhe në kushte të tilla likuidimi i këtij zëri në shumën **46,200 lekë pa TVSH** është përfituar padrejtësisht dhe në kundërshtim me kuadrin ligjor të punimeve të ndërtimit.
- Konstatohet se i janë likuiduar sipërmarrësit të punimeve mes të tjerave edhe zëri *'Vendosja e rezervuarit në gropë'* kur në fakt referuar zërit me nr. rendor 1 është likuiduar si zë më vete *'F.V Depozitë karburanti V 3300 lt, ≥ 500 kg'* duke bërë që çdo vendosje depozite të paguhet dy herë, kur në fakt është kryer një herë. Për rrjedhojë vlera prej **92,400 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e sipërmarrësit.

- Nga sondazhet e kryera për depozitat e vendosura në 3 stacione rezultoi se nuk është kryer në asnjë rast zëri me nr. rendor 6 *'F.V lyerja me primer izolues e pusetës të depozitës'*. Për rrjedhojë vlera prej **158,400 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pas verifikimeve të kryera në qendrën e monitorimit në RTSH nuk dokumentohet marrja e licencave nga ana e sipërmarrësit të punimeve, vlera e të cilave është në masën 275 copë ose vlera **426,250 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e përfituar padrejtësisht e cila përbën dëm ekonomik. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, neni 12; Urdhrin nr. 775/1 prot., datë 15.11.2018 për marrjen në dorëzim të mallrave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **723,250 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE *"L."* ShPK, *"R. C."* ShPK dhe *"A."* si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 67/12 prot., datë 07.11.2018 me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'*.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Për projektin "Masterchef Junior" 2017-2018, lidhur me pagesat e personelit konstatohet se:
- Sipas kontratës me nr. 1101/31 prot., date 07.02.2018 me znj. Xh. K. në cilësinë e ekonomistes, me objekt menaxhimin e procesit të kontrollit të brendshëm financiar, raportimin e rregullt për situatën dhe shpenzimet financiare, menaxhimin e kontabilitetit dhe te financave, mirëmbajtja e llogarisë dhe përgatitja e raporteve financiare (neni-2) nuk ka asnjë gjurmë dokumentare në dosje dhe është shpërblyer me **271,368 lekë** me firmën e drejtorit R. A.;
- Sipas kontratës me nr. 1101/32 prot., date 07.02.2018 me znj. E. B., në cilësinë e magazinieres së projektit, me objekt magazinimin e prodhimeve ushqimore, pajisjet që merren me qira, pjesët përbërëse të skenografisë etj., si dhe të regjistrojë të gjithë këta artikuj dhe të nxjerrë prej magazinës artikujt vetëm me urdhër të personave të autorizuar, nuk ka asnjë gjurmë dokumentare në dosje për shpërblimin në shumën **169,320 lekë**;
- Sipas kontratës me nr. 1101/15 prot., date 07.02.2018 me znj. Xh. K., në cilësinë e specialistit të marrëdhënieve me publikun, me objekt menaxhimin marrëdhënieve me publikun për rritjen e auidencës, duke menaxhuar me komunikimin e mesazheve kyçe për të arritur audience e synuar, si dhe kryerjen e hulumtimeve për të zbuluar prirjet e audiencës, nuk ka asnjë gjurmë dokumentare në dosje për shpërblimin në shumën **66,400 lekë;** dhe sipas kontratës me nr. 1101/21 prot., date 07.02.2018 me znj. M. T. si më lartë në shumën **132,800 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 – 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **639,888 lekë** nga peronat si më poshtë, pasi nuk ka gjurmë dokumentare të ofrimit të shërbimit të kontraktuar për këtë projekt:
1. Xh. K., në cilësinë e ekonomistes, 271,368 lekë;
2.E. B., në cilësinë e magazinieres, 169,320 lekë;
3. Xh. K., në cilësinë e specialistit të marrëdhënieve me publikun, 66,400 lekë;
4. M. T., në cilësinë e specialistit të marrëdhënieve me publikun, 132,800 lekë;

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, referuar njoftimeve të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit për përfundimin e punimeve, këto dokumente citojnë datën

03.11.2017 dhe referuar aktit të marrjes së përkohshme në dorëzim citohet data 03.11.2017 kur në fakt sipas korrespodencave të vetë Titullarit rezulton se puna nuk është përfunduar për shkak të vendosjes së pajisjeve të kondicionimit jo në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Nga sa më sipër rezulton se pavarësisht shkresave dhe korrespodencave të cilat rezultojnë të jenë fiktive pasi nuk pasqyrojnë situatën reale arrihet në konkluzionin se punimet janë konfirmuar si të përfunduara (në lidhje me sistemin e kondicionimit) me datë 19.12.2017, datë pas së cilës më 22.12.2017 Grupi i marrjes në dorëzim ka konfirmuar edhe punimet për vendosjen e sistemit të kondicionimit. Për rrjedhojë në këtë rast, në kundërshtim me ato çka thuhet në Aktin e kolaudimit, i cili është pa datë, dhe ndryshe nga sa përshkruhet në aktin e marrjes së përkohshme në dorëzim, punimet kanë përfunduar me 46 ditë vonesë. Në lidhje me këtë situatë nga ana e AK, në zbatim të nenit 38 të kontratës me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 për zbatimin e punimeve lidhur mes RTSH dhe sipërmarrësit, duhet të ishte aplikuar penaliteti në vlerën **368,000 lekë pa TVSH**. Situata e mësipërme është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 mes Autoritetit Kontraktor RTSH, dhe sipërmarrësit të punimeve *"S."* ShPK, neni 38 i kontratës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masat e duhura që, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **368,000 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"S."* ShPK si penalitet për vonesa në përfundimin në afat të kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Përprojektin "Eurovision Song Contest 2018", konstatohet se, janë paguar dieta me mandat-pagesën nr. 146, datë 27.04.2018 **gjithsej 330,000 lekë** sipas listë-pagesës për 3 persona nga 20 ditë pa asnjë dokument financiar justifikues, thjeshtë dhe vetëm mbi bazën e preventivit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 34/b.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 – 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **330,000 lekë** të përfituar padrejtësisht nga 3 persona për dieta, paguar pa asnjë dokument financiar justifikues.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i tarracës dhe dritareve të Godinës së Radio Kukësit'*, rezultoi se Kontrata për këtë investim është lidhur sipas aktit me nr. 28/9 prot., datë 22.05.2017 mes Autoritetit Kontraktor RTSH, dhe sipërmarrësit të punimeve OE *"D. I"* ShPK me vlerë të kontratës 2,226,722 lekë me TVSh**.** Nga inspektimi në terren i punimeve të ndërtimit rezultoi se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve vlera prej **271,993 lekë pa TVSh** për diferenca volumesh në 4 zëra punimesh. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3; VKM nr. 514, datë 15/8/2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 *"Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë*

15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 1, germa "c", paragrafi i fundit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **271,993 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE *"D. I."* ShPK, si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 28/9 prot., datë 22.05.2017 me objekt *'Rikonstruksion i tarracës dhe dritareve të Godinës së Radio Kukësit'*.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti IV Gllavë rezultoi se nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë zbatuar specifikimet teknike të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes në lidhje me zërin *"Punime rrjetë xingato d=4 mm të vendosur në profile të xinguara"*. Konkretisht sipas specifikimeve teknike është përcaktuar që vendosja e kolonave të rrethimit të kryhet në kubikë betoni C 12/15 me dimensione 0.5 ml x 0.5 ml x 0.5 m. Në fakt sipas verifikimit rezultoi se nuk janë respektuar këto dimensione pasi janë realizuar më të vogla, jo në formë kubike dhe nuk konfirmohet marka e betonit pasi materiali i përdoruar është pa përforcim me hekur betoni, siç përshkruajnë specifikimet teknike për këtë zë. Gjithashtu, materiali i përdorur për themelin e rrethimit është jashtë çdo standardi dhe nuk ka arritur markën e kërkuar pasi është i shkrifërueshëm. Për rrjedhojë, duke bërë korrigjimet përkatëse për efekt të mos realizimit të mureve b/a për kolonat e rrethimit rezulton se janë përfituar tepër vlera prej **212,110 lekë pa TVSH** në total e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të RTSH. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12; Kontratat e shërbimit të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3;Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **212,110 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE *"2. C. & S. Co"* ShPK si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/24 prot., datë 05.07.2017 me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti IV Gllavë.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: NëProjektin "Asambleja e Përgjithshme e EBU", në faturën e datës 06.07.2018, me nr. 739, vetëm me firmën e nënshkruesit të blerësit, bashkëlidhur të të cilit gjendet situacioni i datës 06.07.2018 me 14 zëra, zëri 12 Aktivitet tek salla Dora D'istria me vlerë 175,000 lekë, ka mbivendosje të shpenzimeve, pasi të gjitha aktivitetet e zhvilluara në këtë sallë janë të mbuluar me koston përkatëse analitike në preventiv. ***Pra 175,000 lekë për qira salle janë përfituar padrejtësisht nga subjekti "P." SHPK.***
(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqet nr. 148 - 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
14.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **175,000 lekë** si pagesë e dubluar për sallën në projektin "Asambleja e Përgjithshme e EBU", pasi janë përfituar padrejtësisht nga subjekti "P." SHPK.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e Përgjithshme janë paguar më tepër se sa kuota mujore në vitin 2018 për Drejtorët e Drejtorive 115,263 lekë (pagesa në fakt për këtë vit 483,263 lekë, duhej 368,000 lekë: 92 muaj/drejtorë x 4,000 lekë kuota mujore). Vlera prej **115,263 lekë** është përfituar padrejtësisht nga Drejtorët e Drejtorive të RTSH për shpenzime telefonike mbi kuotën e përcaktuar me vendimin e KDRTSH nr. 44, datë 09.05.2017 dhe përbën dëm ekonomik për RTSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqet nr. 186 - 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **115,263 lekë** nga stafi i Drejtorisë së Përgjithshme, si vlerë e përfituar padrejtësisht mbi kuotën mujore të shpenzimeve për telefoninë celulare.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Në mbledhjet e Bordit të Administrimit nuk ka marrë pjesë znj. E. D. për periudhën 01.07.2017 deri më 15.11.2019 dhe ka përfituar padrejtësisht shpërblimin për pjesëmarrje në aktivitetin e Bordit **në vlerën prej 75,000 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për RTSH.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe nr. 23 - 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, Drejtoria ekonomike dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **75,000 lekë** nga znj. E. D. si vlerë të përfituar padrejtësisht për shkak të mungesës së pjesëmarrjes në mbledhjet e Bordit të Administrimit.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI ME KUSHT

1. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Blerje Led Wall pajisje ndriçimi për studion e re të lajmeve në RTSH'*, rezultoi se kontrata për këtë investim është lidhur sipas aktit me nr. 80/17 prot., datë 08.11.2019 mes Autoritetit Kontraktor RTSH, dhe sipërmarrësit të punimeve OE *"P. I."* ShPK me vlerë të kontratës 41,640,000 lekë me TVSh. Sipas Urdhrit me nr. 719/1 prot., datë 13.11.2019 është ngritur Komisioni për ndjekjen e punimeve të kontratës së mësipërme dhe me procesverbalin nr. 719/2 prot., datë 16.12.2019 është bërë verifikimi i mallrave dhe marrja në dorëzim e tyre nga komisioni përkatës. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren, materialeve të sjella me observacion, takimit ballafaques të kryer në KLSH si dhe materialeve të ardhura me postë elektronike rezultoi se nga ana e OE të kualifikuar dhe shpallur fitues, në zbatim të kriterit të DST sipas të cilit është cituar se: *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë për materialet e përcaktuara me yje tek numri rendor në tabelën e vendosur në Shtojcën 12 (per Led Wall dhe Pajisjet e ndriçimit), ku të jenë të specifikuara qartë materialet"*, është paraqitur një katalog i cili përshkruan modelin nr. YXD49P. Sipas këtij katalogu paneli është i markës Samsung model nr. LTI460HN11, sipërfaqe aktive ekrani 1018.08 mm x 572.67 mm. Në fakt gjatë verifikimit në ambientet e RTSH në të cilat ishte realizuar ky zë rezultoi se produktet ishin me kodet PJ-B461P, dhe jo sipas variantit të katalogut me model nr. nr. YXD49P .

Nga sa më sipër rezulton se nga ana e sipërmarrësit është furnizuar RTSH më një produkt jo sipas atij për të cilin është paraqitur katalogu përkatës gjatë fazës së ofertimit, dokument mbështetur në të cilin ky OE edhe është shpallur fitues. Përmes postës elektronike u dërguan katalogët e produkteve të paraqitura nga ana e furnitorit në momentin e marrjes në dorëzim të Viedo Wall – eve nga ana e grupit të marrjes në dorëzim të ngritur me Urdhrin nr. 719/1 prot., datë 13.11.2019. Këta katalogë rezultuan përsëri ato për të cilat nga ana e ofertuesit janë ngarkuar në sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE). Nga verifikimi i bërë

në faqen zyrtare të prodhuesit për produktin rezulton se ky produkt ka të dhëna të ndryshme dhe që nuk janë në përputhje me kërkesat e parashtruara nga Autoriteti Kontraktor RTSH siç janë përmasat e ekranit, të cilat janë 1024*578.6*141mm sipas DST dhe 1020*574*136 sipas katalogut online të produktit apo të dhënat e ndriçimit nga *450 cd/m^2* në *500 cd/m^2*. Nisur nga sa më sipër, në gjykim të grupit të auditimit nga ana e OE të shpallur fitues rezulton se nuk janë ofruar produktet për të cilat ky OE është shpallur fitues dhe që njëkohësisht nuk përmbushin kërkesat e AK në lidhje me këto produkte. Gjithashtu, në kushtet kur marrja në dorëzim e mallrave është kryer përmes krahasimit të cilësive të produktit të sjellë me ato të katalogut (të cilat janë të ndryshme nga njëra tjetra), ky fakt konfirmon edhe një herë gjetjen e Grupit të Auditimit se produktet e sjella me vlerën **27,900,000 lekë pa TVSH, ose 80 % e preventivit** duhet të zëvendësohen me ato për të cilat furnitori është shpallur fitues. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Kontratën e furnizimit e lidhur sipas aktit, nr. 80/11 prot., datë 14.11.2018, Specifikimet Teknike; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, i ndryshuar, pika 45 dhe 47; Urdhri nr. 723/1 prot., datë 14.11.2018 për marrjen në dorëzim të mallrave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH ti kërkohet OE *"P. I."* ShPK zëvendësimi i artikullit *Video Wall i përbërë nga panele për studio,* me artikullin e kerkuar nga AK referuar sasisë dhe specifikimeve teknike të kërkuara dhe në rast mosdakoresie me OE mbi këtë zëvendësim, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i shumës prej **27,900,000 lekë pa TVSH** OE *"P. I."* ShPK, si furnizim i kryer në kundërshtim më kushtet e përcaktuara në kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 80/17 prot., datë 08.11.2019 me objekt *'Blerje Led Wall pajisje ndriçimi për studion e re të lajmeve në RTSH'* për artikullin e mësipërm.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me investimin me objekt *'Blerje Led Wall dhe aksesorë shtesë'*, rezultoi se kontrata për këtë investim është lidhur sipas aktit me nr. 80/11 prot., datë 14.11.2018 mes Autoritetit Kontraktor RTSH dhe sipërmarrësit të punimeve OE *"S. A."* ShPK me vlerë të kontratës 14,224,200 lekë me TVSh. Sipas Urdhrit me nr. 723/1 prot., datë 14.11.2018 është ngritur Komisioni për ndjekjen e punimeve të kontratës së mësipërme nga i cili është bërë verifikimi i mallrave dhe marrja në dorëzim e mallrave. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren, materialeve të sjella me observacion, takimit ballafaques të kryer në KLSH si dhe materialeve të ardhura me postë elektronike rezultoi se marrja në dorëzim e artikullit *Video Wall i përbërë nga panele për studio*, është kryer duke u mbështetur tek katalogu i produktit sipas të cilit është model YXD49P. Sipas këtij katalogu paneli është i markës Samsung model nr. LTI460HN11, sipërfaqe aktive ekrani 1018.08 mm x 572.67 mm. Në fakt gjatë verifikimit në ambientet e RTSH në të cilat ishte realizuar ky zë rezultoi se produktet ishin me kodet PJ-B461P dhe jo sipas variantit të katalogut. Nga verifikimi i bërë në faqen zyrtare të prodhuesit për produkti model PJ-B461P rezulton se ky produkt ka të dhëna të ndryshme dhe që nuk janë në përputhje me kërkesat e parashtruara nga Autoriteti Kontraktor RTSH siç janë përmasat e ekranit, të cilat janë 1024*578.6*141mm sipas DST dhe 1020*574*136 sipas katalogut online të produktit apo të dhënat e ndriçimit nga *450 cd/m^2* në *500 cd/m^2*. Nisur nga sa më sipër, në gjykim të grupit të auditimit nga ana e OE të shpallur fitues rezulton se nuk janë paraqitur produktet për të cilat ky OE është shpallur fitues dhe që njëkohësisht nuk përmbushin kërkesat e AK në lidhje me këto produkte. Gjithashtu, në kushtet kur marrja në dorëzim e mallrave është kryer përmes krahasimit të cilësive të produktit të ofruar me ato të katalogut (të cilat janë të ndryshme nga njëra tjetra), ky fakt konfirmon edhe një herë gjetjen e Grupit të Audtimit se produktet e sjella me vlerën **10,378,500 lekë pa TVSH, ose 87 % e preventivit** duhet të zëvendësohen me ato për të cilat furnitori është shpallur fitues. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Kontratën e furnizimit e lidhur sipas aktit, nr.

80/11 prot., datë 14.11.2018, Specifikimet Teknike; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, i ndryshuar, pika 45 dhe 47, si dhe Urdhrin nr. 723/1 prot., datë 14.11.2018 për marrjen në dorëzim të mallrave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH ti kërkohet OE *"S. A."* ShPK zëvendësimi i artikullit *Video Wall i përbërë nga panele për studio*, me artikullin e kërkuar nga AK referuar sasisë dhe specifikimeve teknike të kërkuara dhe në rast të mos dakordësie me OE mbi këtë zëvendësim, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i shumës prej **10,378,500 lekë pa TVSH** OE *"S. A."* ShPK, si furnizim i kryer në kundërshtim më kushtet e përcaktuara në kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 80/11 prot., datë 14.11.2018 me objekt *'Blerje Led Wall dhe aksesorë shtesë'* për artikullin e mësipërm.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerësimit të ofertave në tenderat me objekt: - **"Rikonstruksion i Stacioneve Ekzistuese-ndarë në 6 lote",** konstatohet se KVO ka klasifikuar ofertën fituese "*S."* edhe pse nuk përmbush kriteret e vendosura në Dokumentet e Tenderit të tilla si: kriterin 2.3.7 "*për… Auditues energjie...*" pasi ka paraqitur kontratë noteriale pune dhe certifikatë kualifikimi pasuniversitar nga Universiteti Politeknik, Tiranë (diplomë) e cila nuk është e barasvlershme me licencë për auditimin e energjisë, në kuptim të Ligjit Nr. 124/2015, datë 12.11.2015, Neni 17, pika 1 dhe 2; -kriterin 2.3.15 "*mjetet*" pasi nuk ka paraqitur dokument pronësie apo kontratë qiraje për: depozitë uji 5000 litra copë 2 dhe zyrë e lëvizshme copë 1; leja e qarkullimit për mjetin manitouskopik universal, nuk përmban modelin, tipin, foto e mjetit nuk paraqet qartë 3 funksionet si ekskavator, fadromë e vogël dhe pirun.
Në kushtet kur asnjë nga operatorët nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, KVO duhet të kishte s'kualifikuar edhe operatorin "S." bazuar nëLigjin nr. 9643, datë20.11.2006 i ndryshuar neni 46, të anulonte procedurën sipas kërkesave të nenit 24, pika 1, germa "ç" të ligjit dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/1, si dhe të analizonte shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës, në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/2. Diferenca në vlerën ***4,742,587*** *lekë që rezulton nga kualifikimi i ofertës me vlerë më të lartë me ofertën me vlerën më të ulët, përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore në prokurimin publik.*
- **"Blerje pajisje për kanalin RTSH Agro**", oferta fituese "T." nuk përmbush kriteret e vendosura në Dokumentet e Tenderit të tilla si: Autorizim prodhuesi nga kompania "R.", Autorizim prodhuesi nga kompania "N. E. A." dhe Autorizim prodhuesi nga kompania F.-A, nuk është për produktet e specifikuara në kriterin2.2.4 si dhe nuk është njësuar me origjinalin nga noteri, sipas kriterit 2.2.6 DT dhe Ligjit Nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, neni 129, pika 2; Certifikata ISO 9001:2015**,** nuk ka përkthim të noterizuar jo në përputhje me kriterin 2.2.6 dhe Ligjin Nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, neni 129, pika 2; Certifikata ISO 27000:2013 nuk është përkthyer dhe noterizuar sipas kërkesave të kriterit 2.2.6 dhe ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, neni 129, pika 2.
*Në kushte të tilla KVO duhet të kishte s'kualifikuar dhe operatorin "**T.**" për mos përmbushje të kritereve të veçanta për kualifikim (kriteri 2.2.4) bazuar nëligjin nr. 9643, datë20.11.2006 i ndryshuar neni 46 dhe nenin 53, pika 3, të anulonte procedurën e prokurimit bazuar nënenin 24, pika 1, germa "ç", të ligjit,* si dhetëanalizonte shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës, në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/2. *Diferenca në vlerën*

19,500,280 *lekë që rezulton nga kualifikimi i ofertës me vlerë më të lartë me ofertën me vlerën më të ulët, përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore në prokurimin publik.*

- "Blerje Led Wall dhe pajisje ndriçimi për studion e re të lajmeve në RTSH", oferta fituese "Power Industries" nuk përmbush kriteret e vendosura në Dokumentet e Tenderit të tilla si: autorizim prodhuesi nga kompania "Sh. LCD D. E. Co.Ltd" nuk është sipas specifikimeve teknike shtojca 10 dhe kriterit 2.3.4 të DT. Autorizimi për ekrane LCD nuk plotëson tërësinë e produktit të kërkuar si produkt i autorizuar nga prodhuesi, pasi ekrani LED i kërkuar është vetëm një lloj specifik i ekranit LCD (*nuk përbën të njëjtin produkt*); deklaratë konformiteti për kompaninë "Sh. Y. LCD D. E. Co.,Ltd nuk është specifikisht për produktin sipas kriterit 2.3.4 si dhe të gjitha specifikimeve të publikuara në shtojcën 10; certifikatë EN-ISO 9001:2015, nuk është e përkthyer dhe noterizuar konform Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", neni 129, pika 2, si dhe **nuk përmbush** kriterin 2.3. DT.

*Në kushtet, kur asnjë nga operatorët nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, KVO duhet të kishte skualifikuar edhe operatorin "**P. I.**" bazuar nëligjin nr. 9643 ,datë20.11.2006 i ndryshuar neni 46, të anulonte procedurën sipas kërkesave të nenit 24, pika 1, germa "ç" të ligjit dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/1, si dhe të analizonte shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73/2. Diferenca në vlerën **5,050,000** lekë që rezulton nga kualifikimi i ofertës me vlerë më të lartë me ofertën me vlerën më të ulët, përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore në prokurimin publik.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i RTSH të marrë masat e nevojshme për eliminimin e efekteve negative në përdorimin e fondeve publike, duke përzgjedhur dhe trajnuar zyrtarët e prokurimeve, për fusha specifike, me qëllim vlerësim e procedurave në përputhje me dokumentacionin përkatës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'*, rezultoi se nga analiza e zërave në preventiv përveç zërave të tjerë është marrë një ofertë tregu nga tre operatorë ekonomik edhe për zërin *"Monitorim në distancë"*. Specifikimet teknike për procedurën e vitit 2018 për këtë zë janë përshkruar gjerësisht në aneksin nr. 1.3. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky zë është ofertuar me këto çmime:

L. SHPK – 380,000 lekë pa TVSH;
SH. 90 LTD SHPK – 342,000 lekë pa TVSH;
M. P. LTD SHPK – 418,000 lekë Pa TVSH;

Prej këtej rezulton çmimi mesatar prej 380,000 lekë pa TVSH. Ky çmim është përdorur edhe për përllogaritjen e vlerës së fondit limit. Vlera totale e punës për vendosjen e 11 monitorimeve në distancë është në shumën 4,180,000 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përbën 28 % të vlerës së preventivit total. Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në vitin 2017 është realizuar një investim me objekt *"Rikonstruksioni i stacioneve, Loti 1 Mide, Loti III Cervenake, Loti IV Gllavë, Loti V Sopot dhe Loti VI Llogora"*. **Pjesë e këtij investimi ka qenë edhe zëri i mësipërm** i emërtuar si *"FTV Sistem monitorimi dhe menaxhimin në distancë sipas specifikimeve teknike"*. Referuar specifikimeve teknike për procedurën e vitit 2017 kërkesat (specifikimet teknike) për këtë zë janë përshkruar gjerësisht në aneksin nr. 1.3. Ky zë, me këto specifikime, në bazë të ofertave të marra nga OE e ndryshëm në treg në vitin 2017, është përllogaritur me çmim mesatar prej 142,800 lekë pa TVSH/njësi. Nga krahasimi i këtyre dy praktikave *(specifikimet teknike sipas anekseve 1.3 dhe 1.4)* për vitet 2017 dhe 2018 rezulton se për të njëjtin zë, nga ana e Grupit të Punës të ngritur sipas Urdhrit nr. 67 datë 04.09.2018 për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike është zbatuar ligji në mënyrë formale

dhe jo duke përdorur hapësirën e mundshme ligjore të përdorimit të studimit të tregut të kryer një vit më parë për të njëjtin zë pune/shërbimi e duke mos përdorur as vlerën mesatare të 6 kontratave të mëparshme të lidhura në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt *"Rikonstruksioni i stacioneve, Loti 1 Mide, Loti III Cervenake, Loti IV Gllavë, Loti V Sopot dhe Loti VI Llogora"* sipas të cilave ky zë ka qenë i ofertuar *(çmimi mesatar i të cilave është në masën 110,500 lekë pa TVSH)*. Si rrjedhojë vetëm ky zë, i cili përbën 28 % të të gjithë preventivit final, nga një kontratë e vitit 2017 në një tjetër të vitit 2018, rezulton të jetë rritur me gati 2.7 herë. Konkretisht vlera totale e rritur e fondit limit si rrjedhojë e mos përdorimit të mënyrën e duhur të hapësirës së mundshme ligjore është 2,609,200 lekë pa TVSH *[(380,000 lekë pa TVSH – 142,800 lekë pa TVSH) x 11 copë]*. Nga këto duke bërë korrigjimet për efekt të uljes së vlerës së kontratës nga vlera e fondit limit *(shuma 536,030 lekë pa TVSH)*, rezulton se vlera prej **2,073,170 lekë pa TVSH përbën përdorim pa efektivitet efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike** nga ana e Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin nr. 67/1 datë 04.09.2018 për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike pasi nga ana e tyre nuk janë ezauruar në mënyrën e duhur të gjitha hapat për përdorimi e fondeve. Në mënyrë të ngjashme me procedurën e viti 2018 është vepruar edhe në vitin 2019 gjatë përllogaritjes së fondit limit për procedurën e ngjashme me objekt *'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019'*. Nga krahasimi i këtyre dy praktikave, pra ajo e vitit 2017 dhe asaj të vitit 2019 rezulton se për të njëjtin zë, nga ana e Grupit të Punës të ngritur sipas Urdhrit nr. 20 datë 06.02.2019 për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike ka vepruar në mënyrë formale dhe jo duke përdorur hapësirën e mundshme ligjore duke rritur vlerën e fondit limit për shkak të mos përdorimit të studimit të tregut të kryer dy vite më parë për të njëjtin zë pune/shërbimi e duke mos përdorur as vlerën mesatare të 6 kontratave të mëparshme të lidhura në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt *"Rikonstruksioni i stacioneve, Loti 1 Mide, Loti III Cervenake, Loti IV Gllavë, Loti V Sopot dhe Loti VI Llogora"* sipas të cilave ky zë ka qenë i ofertuar *(çmimi mesatar i të cilave është në masën 110,500 lekë pa TVSH)*. Si rrjedhojë vetëm ky zë i cili përbën 38 % të të gjithë preventivit final, nga një kontratë e vitit 2017 në një tjetër të vitit 2019, rezulton të jetë rritur me gati 2.7 herë. Konkretisht vlera totale e rritur e fondit limit është 9,888,000 lekë pa TVSH *[(390,000 lekë pa TVSH – 142,800 lekë pa TVSH) x 40 copë]*. Nga këto duke bërë korrigjimet për efekt të uljes së vlerës së kontratës nga vlera e fondit limit *(shuma 742,340 lekë pa TVSH)*, rezulton se vlera prej **9,145,660 lekë pa TVSH përbën përdorim pa efektivitet efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.** *(më gjerësish trajtuar në aneksin 1.5)*. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 9643 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germat b dhe c; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të ngritura për përllogaritjen e fondit limit të ezaurohen të gjitha hapat e duhur me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike siç është ai i rasteve të mësipërme në shumën **11,218,830 lekë pa TVSH** *(2,073,170 lekë pa TVSH + 9,145,660 lekë pa TVSH)*si dhe sigurimin e mirë përodimit të tyre dhe transparencës në drejtim të planifikimit të vlerës së investimeve nëpërmjet përdorimit të çmimeve të marra nga kontratat e mëparshmeose/dhe çmimeve të tregut, kjo nisur nga interesi publik dy ndër të cilat janë edhe rritja e eficiencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me investimin me objekt *'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese'*, Loti II Tarabosh, në lidhje me këtë praktikë grupi i auditimit bëri një analizë të vlerës së fondit limit ku u konstatua mos respektim i strukturës së kostos për çmimet e marra për zërat jashtë preventivit dhe nga ana tjetër u krye

një vlerësim i punës përfundimtare të kryer nga ana e sipërmarrësit të punimeve. Konkretisht, nëse nga ana e AK do të ishin respektuar metodologjia e hartimit të preventivit, ajo e strukturës së kostos për zërin *F.V Kulla* çmimi total i do të ishte 721,700 lekë.
Preventivi dhe më pas situacionit përfundimtar i firmës sipërmarrëse është paraqitur e likuiduar për këto zëra në vlerën 7,098,000 lekë. Në lidhje me zërat *Transport i materialeve, Montim i bulonave, Beton special për bulonat, Fornitura e materialeve*, duke bërë analizën sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit e duke marrë në konsideratë se vetë manuali ka parashikuar çmime për konstruksione metalike të përbëra siç është rasti në fjale rezulton se, sipas analizës së mëposhtme, çmimi do të ishte 142,967 lekë për ton, ose vlera 1,715,604 lekë për 12 ton *(shiko aneksin 1.2)*. Për rrjedhojë rezulton se si pasojë e mos përcaktimit të volumeve të punimeve por emërtimit të tyre në mënyrë të përgjithshme *F.V Kulla* si dhe mos hartimit të analizës së kostos së detajuar rezulton se vlera prej **6,104,096 lekë pa TVSh përbën përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomicitet** të fondeve në lidhje me këtë investim *(721,700 lekë pa TVSh + Diferenca [7,098,000 lekë pa TVSh – 1,715,604 lekë pa TVSh])*. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: Ligjin nr. 9643 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germat b dhe c; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave *'Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit'*, ndryshuar me Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011, konkretisht, pika b, e këtij Udhëzimi ndryshues; Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, e ndryshuar, pikat 2, 3, 9; Udhëzimin nr. 2 datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu I.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 54 – 125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të punës për përllogaritjen e fondit limit të merren masa për marrjen e ofertave dhe më tej hartimin e preventivave me çmime të cilat duhet të rezultojnë nga shuma e nevojshme e çmimeve të ofruara/preventivuara për çdo kategori që është pjesë e strukturës së kostos. Konkretisht, këto kategori janë Punëtori (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Transport (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Makineri (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Materiale (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Shpenzime Plotësuese 8% dhe Fitim 10 % (këto dy të fundit ndryshojnë në varësi të kategorisë së punimeve të ndërtimit). Gjithashtu, përpara marrjes së ofertave në treg për zëra pune, të analizohen këto preventiva për vlerësimin e tyre në përputhje me çmimet e manualit teknik të çmimeve për punimet e ndërtimit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ka pasur 7 raste të punonjësve që kanë ankimuar në gjykatë ndaj RTSH për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme ligjore, për të cilët ka përfunduar gjykimi dhe në Gjykatën e Apelit për shumën **6,077,740 lekë**, një pjesë e të cilave i përkasin periudhave të para këtij auditimi. *Kjo vlerë financiare e përfituar nga punonjësit e larguar nga puna pa shkaqe të arsyeshme të cilësuara si të tilla me vendime të gjykatës, përbën efekt financiar negativ në buxhetin e RTSH duke ndikuar në performancën e tij financiare dhe funksionale.*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 38 - 46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të analizojë situatën e krijuar nga largimet e padrejta nga puna, duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

Në vijimësi

6. AUTORITETI PORTUAL DURRËS

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: KLSH me shkresën nr. 579/8, datë 05.10.2018, ka rekomanduar 81 masa gjithsej, nga këto 34 masa organizative, 31 masa për shpërblim dëmi, 9 masa për eliminimin e efekteve negative dhe 7 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga 34 masa organizative gjithsej, të rekomanduara dhe të pranuara, 20 janë zbatuar plotësisht, 13 janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.

-Nga 31 masa për shpërblim dëmi gjithsej, të rekomanduara dhe të pranuara, 5 janë zbatuar plotësisht, 3 janë zbatuar pjesërisht, 19 janë në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 4.

-Nga 9 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike të rekomanduara dhe të pranuara, 1 është zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 6 janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.

-Nga 7 masa disiplinore të rekomanduara dhe të pranuara, 6 janë zbatuar plotësisht dhe 1 është në proces zbatimi.

Autoriteti Portual Durrës (APD), nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH, nuk ka respektuar jo vetëm afatin 20 ditor dhe 6-mujor, mbi raportimin e planit të veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, por ende nuk ka asnjë korrespondencë për këtë qëllim, veprime në kundërshtim me nenet 15 germa "j" dhe 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Këshilli Drejtues i APD nuk ka vepruar për marrjen në shqyrtim dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, megjithëse nga Drejtoria Ekzekutive janë dërguar informacione të vazhdueshme shkresore shoqëruar me masat për përmirësimin e punës në APD. Drejtoria Ekzekutive, ka vepruar me ritme të ngadalta sa i takon zbatimit të rekomandimeve, referuar numrit të rekomandimeve në proces. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,1, faqe 32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekzekutive dhe Këshilli Drejtues, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara ose në proces zbatimi, si edhe të ndiqen në të gjitha shkallët e gjykimit, për ato që janë në procese gjyqësore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Koncensionari A. (Terminali Trageteve) ka në përdorim pajisje të sistemit të check-in elektronik në pronësi të APD – së në vlerën 12,537,316 lekë dhe nuk paguan asnjë detyrim ndaj APD-së. Drejtoria Juridike e APD-së, me shkresën nr. 527, datë 11.11.2016, drejtuar Drejtorisë Teknike dhe Drejtorisë Ekzekutive të APD-së, ka propozuar ngritjen e një grupi pune "*Për evidentimin dhe vlerësimin e pajisjeve të sistemit check-in elektronik për vlerën 12,537,316 lekë".* Konstatohet se nga kjo periudhë nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të bërë të mundur zgjidhjen e kësaj problematike. Në amendamentin nr. 3216, datë 27.12.2013, është përcaktuar që të hiqen asetet të cilat i përkasin Terminalit të Trageteve dhe që janë dorëzuar shoqërisë Koncensionare (A.). Në pikën 12.1.7 "Sistemi dhe rrjeti kompjuterik" i kontratës koncensionare midis APD-së dhe A.-s, *citohet se… koncensionari do të mirëmbajë sistemet aktuale të IT*…, këto sisteme janë asete në zotërim të APD-së. Në protokollin e dorëzimit me nr. 2373, datë 06.09.2013, midis APD-se dhe Koncensionarit A., nuk është përcaktuar nëse këto asete (Sistemi Multimedial & check-in elektronik) do të jepen në përdorim, me/pa qira ose ti propozohet Koncensionarit për shitje, por ka vetëm nënshkrimin si pajisje të instaluar në vepër. Këto sisteme kanë përdorim të përbashkët APD dhe A., mbi bazën e

përdorimit është ndarë edhe mirëmbajtja në %, nga operatori privat T. S. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike, Drejtoria e Zhvillimit dhe Drejtoria Ekonomike, të rishikojnë mundësinë, kundrejt kostos financiare për ndarjen e sistemeve të IT, që janë në përdorim të përbashkët, ndarjen në zotërim 100% nga A. ose APD, si edhe të rishikojnë protokollin e dorëzimit nr. 2373, datë 06.09.2013, midis APD-së dhe A., për sistemet e IT, në zotërim të APD dhe në përdorim të A., për tarifimin e vlerës për përdorim nga A..

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Shoqëria koncensionare "E.", nuk ka raportuar në lidhje me volumet e punës të kryera me operacionet (shërbimet) si: mbushja e kontejnerëve, transport ulje ngritje kontejnerëve, lëvizje ekstra/kapje bosh, magazinim peshime, veprime këto në kundërshtim me nenin 12.1.6 "Raportime" të kontratës koncensionare dhe Protokollit të dorëzimit nr. 1810, datë 12.07.2013 kapitulli "Shkëmbim informacioni". Këto shërbime iu janë faturuar përdoruesve të Portit Durrësit nga "E." në kundërshtim me nenin 8 të kontratës. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 8.4. pika 3, ku koncensionari duhet të lëshojë faturat për të ardhurat e tij për shërbimet e ofruara. Me vendimin e datës 24.04.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur që "E." të paguajë dëmin e shkaktuar si e ardhur e munguar për APD në shumën 91,852,869 lekë, dhe 3,294,231 lekë për kamatëvonesa (periudha korrik 2013-nëntor 2017). Koncensionari "E.", edhe për periudhën dhjetor 2017- 31 dhjetor 2020, vazhdon të kryejë këtë proces përpunimi dhe të gjenerojë të ardhura pa deklaruara, duke ndikuar në uljen e të ardhurave që përfitohen nga APD dhe Ministria. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria Juridike, të analizojnë situatën e krijuar nga koncensionari "E." për kryerjen e proceseve e volumeve të punës të pa deklaruara për periudhën dhjetor 2017- 31 dhjetor 2020, i cili vazhdon të kryej proces përpunimi jashtë kontratës koncensionare dhe të gjenerojë të ardhura pa i deklaruar, si edhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e të ardhurave të munguara.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Rezultatet në shfrytëzimin e shesheve të përdorimit, janë me efektivitet mjaft të ulët, si rezultat i mos-faturimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për kontrata të lidhura dhe të përfunduara, për "Kontrata Operacionale mbi dhënien në shfrytëzim të shesheve të përdorimit", 100 % e kontratave realizojnë të ardhura me çmimin 2 lek/m² dhe 0% e tyre japin produktivitet në vlerat maksimale (4 lekë/m², 6 lekë/m² dhe 10 leke/m²). Kjo përqindje e lartë (100%), e shfrytëzimit të shesheve në kufijtë minimal të pagesës (për 2 lekë/m² për 45 ditë), ka ardhur si rezultat i hartimit nga koncensionari E.-APO, të disa kontratave, brenda periudhës së të njëjtës kontratë (për sipërfaqe të njëjtë & subjekte të njëjtë dhe mallra të njëjtë) pa e tejkaluar kufirin 45 ditë. Bazuar në pikën 2 të Kontratës tip "Mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit" ku citohet... bazuar në Udhëzimin e MF dhe Ministrisë se PPTT, subjekti nënshkrues i kësaj kontrate ka të drejtë të shfrytëzojë sheshin e përdorimit brenda një afati kohor prej 180 ditë, (shesh të cilin nuk mund ta shfrytëzoj asnjë subjekt tjetër), pra kur afati kohor i shfrytëzimit të sheshit është deri në 180 ditë, koncensionari brenda periudhës, ka nënshkruar 4 (katër) kontrata duke shmangur faturimin e përshkallëzuar, në përputhje me Udhëzimin e MF dhe PPTT nr. 581/1, datë 06.02.2013 dhe Udhëzimi i Përbashkët i MTI & MF nr. 1568/3, datë 14.07.2015. Rezultatet, në shfrytëzimin e shesheve të përdorimit, janë me efektivitet mjaft të ulët, si rezultat i mos-faturimit në përputhje me Udhëzimin nr. 581/1, datë 06.02.2013 dhe nr. 1568/3, datë 14.07.2015, dhe me pikën 2, të "Kontratës mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e kontratave, të analizojnë dhe nënshkruajnë kontrata për shfrytëzimin e shesheve të përdorimit me faturim të përshkallëzuar, duke respektuar kërkesat e udhëzimit të MTI & MF nr. 1568/3, datë 14.07.2015 me qëllim rritjen e të ardhurave

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: APD deri në fund të vitit 2020, ka një total të llogarive të pa-arkëtueshme në vlerën 593,074,000 lekë. Nga këto vlera 107,766,982 lekë përbëhet nga debitorë të vjetër te periudhave të mëparshme deri më vitin 2009. Për këto llogari APD ka mungesë informacioni mbështetës me fatura tatimore për të realizuar ndjekjen e arkëtimit të tyre. Në vlerën 421,552,611 lekë, të debitorëve për të cilët po ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e tyre, vlera më e madhe e detyrimit përbëhet nga L. dhe N. M. Në vlerën 63,754,506 lekë, shoqëritë koncesionare A. dhe E., përbëjnë vlerën 38,628,894 lekë dhe në vlerën e mbetur 25,125,614 lekë janë detyrime të dërguara në përmbarim. Situata debitore konstatohet e përkeqësuar, e cila vështirësohet dhe për arsye se pjesa më e madhe e tarifave mblidhen te përdoruesit fundorë nga operatorët e ndryshëm, të cilët më pas i transferojnë fondet në llogaritë e APD-së, duke krijuar vonesa në pagesa. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3, g, të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Mos arkëtimi i borxheve rëndon situatën financiare të APD-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat ligjore për mbledhjen e borxheve që debitorët i detyrohen APD-së.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën për miratimin e lejeve dhe autorizimeve iniciuar me urdhrin nr. 3760, datë 08.10.2020 *"Mbi krijimin e komisionit për miratimin e lejeve dhe autorizimeve në Autoritetin Portual Durrës",* u konstatuan parregullsi në vlerësimin e OE të klasifikuar fitues, nga komisioni përkatës.

Referuar rregullores së miratuar me Vendimi Qarkullues të KD nr. 26, datë 16.09.2020, OE fitues nuk përmbush kriteret si përvoja për punë të ngjashme, nuk ka paraqitur punime apo eksperienca të ngjashme në fushën e ngarkim shkarkimit, nuk e ka objekt të aktivitetit në QKB shërbimin e ngarkim/shkarkimit. Asnjë nga mjetet apo automjetet e listuara nga OE nuk mund të kryej shërbimin e ngarkim shkarkimit të kontejnerëve, pasi nga të dhënat e tyre ato nuk përshtaten për këtë shërbim, ato janë automjete që përdorën për transport inertesh, dhe nuk kanë tonazhin e duhur. Komisioni i ngritur për miratimin e lejeve dhe autorizimeve nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë mbi dokumentacionin e OE duke e vlerësuar me pikët maksimale dhe shpallur fitues.

Lloji i Shërbimit	Oferta e OE B.-I. SHPK (me TVSH)	Tarifat ekzistuese të APD	Diferenca ofertë/tarifë ekzistuese
Mbushje Kontejneri 20 feet	144€	78€	+65€
Zbrazje Kontejneri 20 feet	144€	78€	+65€
Mbushje Kontejneri 40 feet	180€	103.2€	+76€
Zbrazje Kontejneri 40 feet	180€	103.2€	+76€

Nga krahasimi i tarifave të aplikuara më parë nga APD dhe tarifat e ofertës së pranuar nga OE B.-I. SHPK, rezulton që tarifat e propozuara të aplikohen nga OE janë më të larta se tarifat e aplikuara nga APD.

Për shërbimet Slokers, Mallra Gjeneralë, Mallra Rifurxho, etj, Transport Cargo brenda dhe jashtë hapësirës territoriale të Portit të Durrësit dhe Lashing-Unlashing, OE *"B.-I."* ShPK nuk ka paraqitur tarifat që do aplikojë për këto shërbime, dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

nuk ka argumentuar dhe dokumentuar vlerësimin në mënyrë individuale për këtë kriter, veprim në kundërshtim me rregulloren për lejet dhe autorizimet në Portin e Durrësit, miratuar me Vendimin Qarkullues të KD nr. 26, datë 16.09.2020 dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004, *"Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij"*, neni 9, *Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues*, pikat 9-13. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Të merren masa që në çdo rast, Komisioni i Autorizimeve të argumentojë dhe dokumentojë vlerësimin në mënyrë individuale për çdo kriter që kërkohet ndaj Operatorëve konkurrues.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Kontrata e shërbimeve konsulente "Shërbime konsulence për reformën rregullatore, nevojat e sigurisë dhe hartimin e Masterplanit Strategjik 2030", nënshkruar me OE "E. & Y." GmbH – Shtutgart, me vlerë 73,740,000 lekë, me afat për dorëzimin e masterplanit deri me datë 02.12.2020, ndërsa i dy shërbimeve të tjera deri me datë 02.01.2020 dhe likuiduar deri në momentin e auditimit për vlerën 200,792 euro, pagesë që i përket realizimit të komponentit të hartimit të masterplanit, nuk është dorëzuar brenda afatit kontraktor.

Kontraktori me shkresë e protokolluar në APD me nr. 4085/2 prot., datë 31.12.2020, ka kërkuar shtyrjen e afatit të shërbimit për 60 ditë, me argumentimin se: "Pandemia Covid-19, ka shkaktuar vonesa të papritura, duke përfshirë kufizime në mundësinë për të udhëtuar që ka kushtëzuar punën në distancë të ekipit. Këto rrethana kanë ndikuar në aftësinë e ekipit për të përfunduar dy zërat e kontratës. Kontraktori e konsideron ketë fakt si forcë madhore.

Kontraktori nuk ka përmbushur detyrimet për njoftimin menjëherë me shkrim, por 2 ditë para përfundimit të afatit kontraktor për dorëzimin e shërbimit, ose 58 ditë nga nënshkrimi i kontratës; nuk ndodhet në kushtet e forcës madhore, pasi pandemia ka ndodhur më parë nënshkrimit të kontratës; si dhe nuk ka paraqitur me detaje ose dokumentacion mbështetës për pretendimet e tij, veprime në kundërshtim me Kontratën e Shërbimeve, neni 18, pika 5, dhe neni 24, pika 2.

Bazuar në Kontratën e Shërbimeve Konsulente, neni 19 "Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar", **Kontraktori duhet të penalizohet për vonesa për një periudhë 30 ditë me vlerë 5,882,095** lekë (30 ditë (vonesa deri me datë 02.02.2021) x 4/1000 (koeficienti sipas kontratës) x 49,042,460 lekë (vlera e shërbimit të pa realizuar akoma) = 5,882,095 lekë) 2.c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, të marrë masa për zbritjen nga situacioni pasardhës dhe situacion përfundimtar të **vlerës 5,882,095 lekë**, Kontraktorit "E. & Y." GmbH– Shtutgart, llogaritur si penalitet për dorëzim të vonuar të produktit (masterplanit).

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, të marrë masa për përllogaritjen dhe zbritjen e penaliteteve të mëtejshme deri në përfundim të kontratës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit "Shërbimi i pastrimit të Akuatoriumit, për tre vite", Komisioni i përllogaritjes së fondit limit ngritur me Urdhërin nr. 2132, datë 19.06.2019, në përcaktimin e fondit limit me vlerë 23,239,185 lekë, është referuar në studimin e tregut, pa marrë në konsideratë kontrata e realizuar nga AK për vitin 2018 (me vlerë të prokuruar 7,500,000 lekë, dhe kontratë nënshkruar me vlerë 7,450,000 lekë, kontratë e cila përcakton shërbimin për një periudhë 1 vjeçare), me arsyetimin për të qenë sa më aktual me çmimin e tregut. Për vitin 2019, kontrata është parashikuar për një afat 3 vjeçar dhe fondi limit është përcaktuar mbi bazën vjetore e shumëzuar për tre vite. Theksojmë se shërbimi i përcaktuar për prokurim për vitin 2019 është i njëjtë me shërbimin e realizuar për vitin 2018. Fondi limit

sipas kësaj procedure është përllogaritur me vlerë 23,239,185 lekë (7,746,395 lekë mbi bazë vjetore. Kontrata është nënshkruar me vlerë 23,200,000 lekë (7,733,333 lekë mbi bazë vjetore). Diferenca me vlerë 670,000 lekë [(7,733,333 lekë – 7,500,000 lekë) x 3 vite], konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e APD dhe veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59 2.c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës, të marrë masa për shqyrtimin e përllogaritjes së fondit limit me mangësi dhe të fillojë procedurat për arkëtimin e **vlerës 670,000 lekë** nga z. E. Sh., z. O. M. dhe znj. H. M., shkaktuar si pasojë e mos dokumentimit të fondit limit.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në listë pagesat e dorëzuara në organet tatimore, janë konstatuar të punësuar mbi planin strukturor të miratuar nga KD, për periudhën 2018, korrik-dhjetor, 15 persona, për periudhën shkurt mars 2019, 5 persona, në total 20 të punësuar mbi strukturë. Veprimet sa më sipër kanë sjellë efekt financiar negativ në **vlerën 2,023,724 lekë**, dhe janë në kundërshtim me ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual" dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 "Për miratimin e statutit të APD dhe për Riorganizimin e tij", neni 9, pika 2. Vlera 2,023,724 lekë përbën efekt financiar negativ për APD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Këshilli Drejtues të shqyrtoj shkeljet e konstatuara në punësimin e personave mbi strukturën organike, për periudhën 01.07.2018-31.12.2020, të cilat kanë krijuar efekte negative në buxhetin e institucionit në vlerën 2,023,724 lekë.

Menjëherë

E. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv ti kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:

Subjektit BOE **"E. S." SHPK dhe "H.C." SHPK**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin "Prishje e godinave të amortizuara plotësisht në zonën e ish peshkimit dhe magazinën 4-5"për certifikimin e prishjes së materialit beton arme, ndërkohë që punimi ishte shtresë betoni, shoqëruar me rritje të çmimit me dëm ekonomik me vlerë ***821,756 lekë.*** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

F. MASA DISIPLINORE

Masa për "Anëtarit të Këshillit Drejtues", nga organet zgjedhëse (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, dy anëtarë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, një anëtarë prefektura Durrës, një anëtar dhe Këshilli Konsultativ i Autoritetit Portual Durrës dy anëtar) për:

V H., kryetare

I. C., zv. Kryetar
E. B,
E. E.,
A. R.,
A. R., anëtarë të Këshillit Drejtues

F/I. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, statutit të APD neni 12, i kërkojmë Këshillit Drejtues, që në varësi të kompetencave të Tij ligjore, të analizojë punën e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv **P. V.** dhe të marrë masat e nevojshme administrative dhe disiplinore në përputhje me statutin e Portit, sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit,të performancës së punës së tij.

7. SPITALI PSIKIATRIK "ALI MIHALI" VLORË

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", nuk ka funksionuar, pasi ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë, ndërsa punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion. Spitali Psikiatrik nuk ka miratuar dhe as depozituar "Deklaratën dhe Raportin Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për asnjë nga vitet 2017,2018,2019 dhe 2020" në kundërshtim me neni 18, të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues për çdo vit duhet të përgatisë deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në të cilin ai deklaron se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomik ashtu si dhe të trajtojë dobësitë e sistemit të kontrollit e planet për trajtimin e tyre. Gjithashtu Nëpunësi Autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi tek NPA në MF. NA të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe i raportojnë NA, sipas shkallës hierarkike, deri te NA i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga SPV nuk është hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike plani strategjik për periudhën objekt auditimi pra praktikisht plani strategjik 2017-2019, 2018-2020, 2019-2021 si dhe plani strategjik 2020-2022**,** i cili përmban objektivat strategjikë, prioritetitet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndërsektoriale, veprim ky në kundërshtim me nenin 9, i ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa në krijimin e Planit Strategjik i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre. Objektivat strategjike duhet

të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: a. SPV për asnjë nga vitet objekt auditimit, ***nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit***, e cila duhet të përgatitet nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NZ për garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi si dhe përgjegjësi e NA për miratimin e saj. Gjurma e auditimi është një instrument i cili jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.
b. Grupi i auditimit konstatoi se edhe pse është ngritur GMS për vitin 2019-2020, nuk ka asnjë proces verbal të mbajtur për takimet e kryera, apo për problematikat e trajtuara duke konkluduar se nuk është kryer asnjë mbledhje e GMS, veprim ky në kundërshtim me pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr. 16 datë 16.07.2016 "*Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Kordinatorit të Meanxhimit Financiar.....*"
c. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues si dhe menaxherët e tjerë te institucionit, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 15 "Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave", si dhe Kapitulli III "Delegimi i detyrave", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, *institucioni nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e* dokumentimit *të tyre*
d. Nga auditimi u konstatua se SPV *nuk ka program specifike për trajnimin* e punonjësve të administratës i cili duhet të përgatitet çdo fillim viti mbi nevojat për trajnim për secilin nga Drejtoritë apo Sektorët si dhe duke përgatitur në fund të çdo viti planin mbi realizimin e trajnimeve nga punonjësit e institucionit, fakt ky i cili nëse do të ishte realizuar, punonjësit nuk do të kishin mangësi të thella në njohuritë mbi te drejtat dhe detyrimet te cilat lindin nga ligji i MFK, por dhe jo vetëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit)*
3.1 Rekomandimi: NA në bashkëpunim me NZ të marrin masa në hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimin në mënyrë që të sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Menjëherë dhe në Vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve te prokurimit për periudhën objekt auditimit në të gjithë rastet, dosjet nuk janë te inventarizuara dhe nuk janë arkivuar, por janë mbajtur në zyrat e specialistes se prokurimeve të institucionit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*
4.1 Rekomandimi: Nga njësia e prokurimit te merren masa të menjëhershme për inventarizimin dhe arkivimin e te gjitha dosjeve të prokurimeve publike te përfunduara për vitin 2017,2018,2019 dhe 2020 si dhe për procedurat ne vijimësi

Menjëherë dhe në Vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga ngrupi i mëparshëm i auditimit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është relativish i ulët, tajtuar si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 9 masa organizative, të cilat, janë zbatuar 2 zbatuar pjesërisht 1, në proces 5 dhe janë pa zbatuar 1.
- Masa për shpërblim dëmi janë lënë 14 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar pjesërisht 2, në proces 12.
- Masa për eliminimin e efekteve negative 3E janë lënë **7** rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 2, në proces 1 dhe pazbatuar 4.
- Janë rekomanduar 6 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;
- -4 masa disiplinore nuk janë zbatuar , 2 masë disiplinore janë zbatuar.
- -Sipas Statusit të Nëpunësit Civil janë lënë 0 masa disiplinore
- -Sipas Kodit të Punës, janë lënë 6 masa disiplinore e përkatësisht 4‘ *vërejtje me shkrim*’ deri në ‘*largim nga puna’* dhe 2 masa ‘*largim nga puna’*.

5.1 Rekomandimi: Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë *rikërkojmë,* zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, rezultuan të pazbatuara si dhe për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen *të zbatuara pjesërisht* ose *në proces zbatimi,* inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

Menjëherë dhe në Vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1 Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për kontratën me objekt *“**Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore në Spitalin Psikiatrik ‘Ali Mihali’ Vlorë”,*** të lidhur midis Spitalit Psikiatrik Vlorë dhe BOE “E. B.” dhe “A.” ShPK, nr. 34/nr.1842/1 prot. datë 15.10.2019 me vlerë 4,380,000 lekë pa TVSH ose 5,256,000 lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 24 muaj si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të komisionit të mbikëqyrjes së kontratës rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt si dhe të kryera jo sipas specifikimeve teknike, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën **159,400 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”*, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa për kryerjen e punime brenda afatit të kontratës dhe garancisë së tyre në shumën **159,400 lekë pa TVSH,** e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve ndaj kontraktorit BOE “E. B.” dhe “A.” ShPK me Nr.34/Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Kërkesë për propozim” me objekt: “*Evadimi i mbetjeve urbane”, për vitin 2017,2018,2019, u konstatua se për pikën 2 “Sipërfaqe fshirëse për 2 pika (2*20m^2)” dhe pikën 3 “Disinfektim për 2 pika (1*2)”, të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik “S.-al”, me kontrate shërbimi nr.11 nr.77/13 prot., datë 08.04.2016 dhe nr.11 nr549/10 prot date 13.03.2020. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtme brenda territorit te spitalit psikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim te jashtëm janë te gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te kuptojmë te gjithë sipërfaqen e hapësirës rreth e përqark godinave (Objekt ndërtimi) qe aktualisht janë ne funksion te këtij spitali. O.E do te pastroj çdo dite gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here ne dite, OE kryen larjen e rrugëve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para orës 7:00. Gjithashtu grumbullimi i*

mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne çdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për ne vend grumbullimin e plehrave behet çdo dite, transporti behet me kosha te mëdhenj, te posaçëm, te mbyllur me kapak.
Gjithashtu për vitin 2018 dhe vitin 2019 janë kryer nga një procedurë për secilin vit, shtesë kontrate "Evadim i mbetjeve Urbane", nga ku vlera e likuiduar për vitin 2018 është 232,943 lekë si dhe vlera e likuiduar për vitin 2019 është 76,933 lekë.
Për vitin 2020 nga auditimi i procedurës blerje e vogël "Evadimi i mbetjeve urbane" për piken 2 "Sipërfaqe fshirëse për 2 pika (2*20m^2)" dhe piken 3 "Disinfektim për 2 pika (1*2)", të dyja janë mbivendosje kontratës me objekt "Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm" në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me te cilën operon Operatori Ekonomik "S.-al", me kontrate shërbimi nr.11 nr549/10 prot., datë 13.03.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **783,244.37 lekë**, nga ish-titullari z. K. Ll., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë".

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **30,504 lekë**, nga ish-titullari z. K. Ll. dhe ish shefi i financës z. V. N. për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë".

Menjëherë

2.3 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 183,404 lekë**, titullari i Institucionit znj. O. G. dhe Shefja e financës znj. L. B. për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë".

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i kartelave të automjeteve ku pasqyrohen kilometrat e përshkruara dhe totali i litrave të harxhuara për udhëtimet e kryera, për periudhën 2018, 2019 dhe 2020, rezultoi se sasia e karburantit të harxhuara dhe të evidentuar në këto kartela shoqëruar me fletë udhëtimet nuk korrespondon me sasinë e evidentuar në sistemin e kartave elektronike të karburanti, duke mos pasqyruar vlerën reale të sasisë së konsumuar.
Nga përllogaritja e litrave të karburantit të konsumuar për një nga automjetet (me targe VL8505B) u konstatua se ne sistemin elektronik të karburantit janë hedhur me shume litra, sesa sasia e konsumuar e karburantit të shënuar në fletët udhëtimit të automjeteve, i cili është dokument vërtetues për lëvizjet dhe kilometrazhin e automjeteve.
Për vitin 2018, nga përllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr ne karte elektronike te karburantit dhe flete udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diference hedhur me shumë në kartat elektronike prej 3410 litra * 147,985 lekë/litër = 504,629 lekë.
Për vitin 2019, nga përllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr ne kartën elektronike te karburantit dhe flete udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diference hedhur me shumë në kartat elektronike prej 11062 litra * 150,565 lekë/litër = 1,665,550 lekë.
Për vitin 2020, nga përllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr ne kartën elektronike te karburantit dhe flete udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës

me një diference hedhur me shumë në kartat elektronike prej 8979 litra * 147,894 lekë/litër = 1,327,940 lekë.
Nga përllogaritja e litrave të karburantit të konsumuar u konstatua se ne sistemin elektronik të karburantit janë hedhur me shume litra me një diferencë **në masën 23,451** litra, sesa sasia e konsumuar e karburantit të shënuar në fletët udhëtimit të automjeteve, i cili është dokument vërtetues për lëvizjet dhe kilometrazhin e automjeteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit)*
3.1 Rekomandimi: Nga SPV të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,498,119 lekë**, si një përfitim i marrë padrejtësisht nga personat përgjegjës si dhe autorizues nga ish Titullari i AK z. K. Ll., Titullari i AK znj. O. G., ish magazinierja znj. E. P., ish shefi i financës z. V. N., znj. O. M., znj. E. M., znj. L. B. dhe z. Q. K.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave te prokurimit me vlerë te vogël për vitet 2017,2018,2019,2020 për procedurën me objekt prokurimi *Blerje e vogël "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh", "Mirëmbajte automjetesh dhe gjeneratorësh" për vitin 2018 si dhe* "*Mirëmbajtja e kondicionerëve, kaldajave dhe cillerave*" për vitin 2018 dhe vitin 2020 nga grupi i auditimit u konstatua se nuk verifikohet nevoja e kryerjes së shërbimeve për automjetet, mungon gjurma e auditimit, kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara, nuk ka procesverbale të mbajtura për problemet e defekteve të këtyre automjeteve, nuk janë argumentuar dhe dokumentuar fakte se përse duhet të kryhet shërbimi ashtu si dhe nuk mund të përcaktohet preventivi i një shërbimi përpara se të ndodhë një defekt, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik" fakte të cilat kanë shkaktuar një shpenzim të realizuar nga AK pa efektivitet, ekonomicitet dhe eficente, referuar Pika 2, neni 1 i Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktuar ne vlerë janë si më poshtë vijon:
1. Procedura "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh" viti 2017 AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi në **vlerën 899,160** lekë;
2. Procedura "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh" viti 2018 AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi, kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një defekt ose avari, apo nevojë për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorëve **në vlerën 870,720** lekë.
3. Shtesë kontrate të "Mirëmbajtja e kondicionerëve, kaldajave dhe cillerave" viti 2018, shpenzimet për kryerjen e preventive të shërbimit të mirëmbajtjes së kondicionerëve, kaldajave dhe **cillerave në vlerën 345,600 lekë**, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi.
4. Blerje e vogël "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh" viti 2019 nga ku AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi **në vlerën 826,800 lekë**.
5. Blerje e vogël "Riparim dhe mirëmbajte automjetesh" viti 2020 nga ku AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi **në vlerën 742,440 lekë.**
6. Blerje e vogël "Mirëmbajte kondicionerësh, frigoriferësh dhe rezistencash elektrike" viti 2020 nga ku AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi si dhe këto shërbime janë po te njëjtat shërbime dhe pjese qe ndërrohen çdo vite në **vlerën 905,880** lekë

7. Blerje e vogël "Mirëmbajte e sistemit qendror (ngrohës-ftohës)" viti 2020 AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi si dhe këto shërbime janë po te njëjtat shërbime dhe pjese qe ndërrohen çdo vit në **vlerën 899,880 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë ***vlerën 5,490,480 lekë*** (me tvsh). Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë të konstatuara mbi shpenzime të kryera nga Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, gjatë procedurës se prokurimit për rastet e sipërpërmendura. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Menjëherë dhe ne vijimësi

1.2 Rekomandim: Nëpunëse Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të marrë masa ku për çdo nevoje të Spitalit, nga personat përgjegjës të behet analiza e nevojave të spitalit si dhe kërkesat e justifikuara me dokumentat plotësues për shërbimin/mallin e kërkuar.

Menjëherë dhe ne vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: 1.Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Kërkesë për propozim" me objekt: "Mirëmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave"* grupi i auditimi nga dokumentet e hedhura ne SPE nga OE "C." konstatohet se Vërtetimi i realizimit të kontratës me një ent publik është origjinal. OE ka paraqitur një kontratë pune e lidhur me nr. 2738 prot., datë 20.12.2016 midis BOE "C." SHPK dhe "Ministria e Integrimit Europian". KVO nuk duhet te s'kualifikonte OE pasi ai ka paraqitur vërtetim të realizimit nga një ent publik, por duhet ti kërkonte informacion në lidhje me kontratën mbi ndarjen e punimeve dhe do të vërtetonte shërbimet e ngjashme dhe kapacitetet e tij. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 2, neni 1 i Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; *VENDIM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 66 pika 3.* Referuar më sipër diferenca midis OE *"J. Z."* ofertuesi i shpallur fituese dhe s'kualifikimi i OE *"C.*" me oferte me të ulët, është në mospërputhje me parimet e ***efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vlerën 74,928 leke me TVSh.*** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit)*

2. Nga auditimit i procedurës së prokurimit "Me negocim, pa shpallje paraprake të kontratës me objekt**:** "Shërbimi i lavanderisë dhe zëvendësimi me inventar të imët", Skualifikimi i OE "U. S." me ofertë me të ulët është i pa drejtë pasi KVO duhet të kërkonte informacion për Certifikatat ISO që ka dorëzuar OE të cilat janë në gjuhe të huaj dhe janë përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, të cilat mbajnë vulën dhe firmën e përkthyeses në çdo faqe të dokumentacionit si dhe gjithashtu janë të noterizuara me vërtetim noterial të përkthimit te certifikatave ISO por në dokumentin e noterizuar nuk rezulton të jetë të shkruara të dhënat e noterit por këto dokumente përmbajnë pullën, firmën dhe vulën e tij si dhe numrin e repertorit dhe koleksionit në kundërshtim me pikën 2, neni 1 i Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; *VENDIM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 66 pika 3* . Referuar me sipër OE "A ." diferenca midis ofertuesit të shpallur fituese dhe s'kualifikimi i OE "U. S." me oferte me te ulet, është në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vlerën 539,461 leke me TVSh.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë ***vlerën* 614,389 *lekë*** (me TVSh). Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë të konstatuara mbi shpenzime të kryera nga Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, gjatë 2 procedurave të prokurimit. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Menjëherë dhe ne vijimësi

8. SPITALI RAJONAL DURRËS

A. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se:
- Për kontratën nr. 20795/5 prot., datë 18.09.2018, të lidhur midis SRD dhe OE "M." SHPK për procedurën "B11-Blerje barna anestezi renimacion dhe sistem kardiovaskular" me fond limit 104,040 pa TVSH, për Lot 2 afati i skadimit të barnave (Adrenalinë në vlerën 36,393 lekë) është 8.5 muaj, pra më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës (9.5 muaj) dhe më pak se 12 muaj, referuar të dy klauzolave të përcaktuara në specifikimet teknike në kontratë.
- Për kontratën nr. 2079/6 prot., datë 18.09.2019, të lidhur midis SRD dhe OE "M." SHPK për procedurën "Blerje barna sistemi nervor" me fond limit në vlerën 1,407,888 lekë pa TVSH, për Lot 1 afati i skadimit të barnave (Morfine 10mg/1mlx10amp në vlerë 211,680 lekë) është 9.5 muaj, pra më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës (10.5 muaj) dhe më pak se 12 muaj, referuar të dy klauzolave të përcaktuara në specifikimet teknike në kontratë.
- Për kontratën nr. 2308/7 prot., datë 04.10.2018, të lidhur midis SRD dhe OE "G." SHPK për procedurën "Blerje Kite Reagent (teste) për analizën e astrupogrames dhe elektroliteve" me fond limit në vlerën 768,000 lekë pa TVSH, afati i skadimit të Kiteve Reagentëve (Kartixhe Ph PO2PCO2 në vlerën 364,875 lekë) është më pak se 12 muaj.
- Për kontratën nr. 1836/6 prot., datë 01.08.2018, të lidhur midis SRD dhe OE "G." SHPK për procedurën "Blerje Kite dhe Reagent për SRD" me fond limit në vlerën 9,999,999 lekë pa TVSH, për Lot 8 afati i skadimit të Kiteve Reagentëve (Blood-Agrar në vlerën 36,000 lekë dhe X.L.D. Agrar në vlerën 30,552 lekë) të marra në dorëzim është më pak se 24 muaj.

Referuar kontratave të sipërpërmendura Barnat dhe Kite Reagentëve të cilat janë marrë jashtë afateve të skadencës jo sipas përcaktimeve në specifikimet teknike, **vlera 679,500 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi,** veprime këto në kundërshtim me afatet e skadencave të përcaktuara Aneksi nr. 2, (sipas DST ref. Shtojca nr. 10) referuar kontratave respektive të lidhura midis SRD dhe OE.

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Spitalit dhe Bordi Drejtues i SRD, të analizojnë efektin negativ financiar në vlerën 679,500 lekë si dhe të marrin masa për të ngritur një grup pune për verifikimin nëpërmjet sistemit të fletëdaljeve nga Farmacia e Spitalit, sasinë e medikamenteve të konsumuara brenda afatit të skadencës referuar kontratave të sipërpërmendura. Në rast evidentimi të sasisë së mbetur të skaduar nga këto medikamente, të llogaritet vlera e tyre dhe t'i kërkohet operatorëve ekonomikë sipas kontratave përkatëse si dhe të ngarkohen me përgjegjësi personat përgjegjës për pranimin e mallit jashtë kushteve kontraktuale. Nga komisionet e marrjes në dorëzim të barnave, të zbatohen me përpikëmëri marrja e tyre konform të gjithë kërkesave dhe specifikimeve teknike të kontraktuara.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për automjetet që disponon SRD konstatohet se, nuk kanë kartela përkatëse, në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to ku, gjithashtu duhet të jetë evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime të cilat nuk mund të përllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre. Nga verifikimi dhe përllogaritja e të dhënave të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, sasia e tërhequr nuk përputhet me kilometrat e përshkruara dhe nuk justifikohet me dokumentacion justifikues konkretisht janë tërhequr më tepër 1452 litra/naftë në vlerën 235,581 lekë, të cilat nuk janë plotësuar me dokumentacion justifikues. Nga ana menaxheriale e administrimit të SRD, Drejtori i Spitalit në cilësinë e nëpunësit zbatues, Përgjegjësit të Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, Sektori Teknik, pjesa menaxheriale e caktuar për menaxhimin e aktiveve nuk janë marra masat për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të SRD, nuk janë kryer kontrolle për llogaritjen e konsumit real të karburantit. **Vlera 235,581 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.**

2.1. Rekomandimi: SRD, Sektori i Financës, Sektori Teknik, të marrë masa, për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe efiçencë të tij.

2.2 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës dhe Sektori Teknik të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

Menjëherë

9. UJËSJELLËS KANALIZME SHA VLORË

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA nuk ka përmbushur detyrimet e saj në rolin e saj si agjent tatimor i Bashkisë Vlorë. Sipas shkresës nr. 127, datë 18.01.2021 nga administratori i mëparshëm i UKV SHA drejtuar Asamblesë se Përgjithshme/Bashkisë Vlorë të UKV SHA, detyrimet totale për tu paguar nga UKV SHA ndaj Bashkisë Vlorë deri në fund të vitit 2020 janë në vlerën 169,960,610 lekë dhe deri në Janar të vitit 2021 janë likuiduar 46,883,127 lekë, ose 27,6 % e totalit të tyre dhe ngelen për tu likuiduar vlera 123,077,483 lekë. Mosveprimi nga UKV SHA, pretendohet se ka ardhur si pasojë e bllokimit të llogarive nga OSHEE SHA dhe ekzekutimi i kryer prej saj në vlerën 96,416,668 lekë. Këshilli i Administrimit, në rastet që është mbledhur, ka analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë por për problematikat e diskutuara nuk janë nxjerrë konkluzione mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë për ta orientuar drejt në zgjidhjen e problematikave, nëpërmjet përshpejtimit të reformave të sektorit siç parashtrohet në VKM nr. 63, 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura".
-Referuar problematikave që janë diskutuar nga UKV SHA dhe kryesisht në mbledhjet e vitit 2021 të Asamblesë së Aksionarëve drejtuar Këshillit të Administrimit dhe punës menaxheriale të ish Administratorëve z. D. Xh. dhe z. Sh. L., është konstatuar kërkesa e vazhdueshme e Kryetarit të Asamblesë së Asamblesë së Përgjithshme, për marrjen e masave të UKV SHA, për të paguar detyrimet dhe taksat si agjent tatimor ndaj Bashkisë Vlorë, mosveprime këto në

kundërshtim nenin 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e agjentit tatimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 33-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA të marrë masa për të analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar, me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë funksionale të saj dhe të propozojë plan masash për shlyerjen e detyrimeve që UKV SHA ka ndaj Bashkisë Vlorë.

Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Implementim në një nivel të pamjaftueshëm sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në rregulloren e brendshme të shoqërisë, miratuar me VKA nr. 3 prot, datë 09.01.2017, rregulla apo proceset të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën e punës dhe procedurat.

Mungon një politikë e miratuar për burimet njerëzore, që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt, si edhe nuk rezulton të ketë një plan vjetor trainimesh.

Nuk funksionon Grupi i Menaxhimit Strategjik. Nuk është krijuar struktura e koordinatorit të riskut, si dhe nuk ka regjistër risku. Menaxhmenti harton plane pune mujore dhe vjetore, por ato nuk hartohen me bazë risku.

Nuk janë hartuar listat e proceseve kryesore, në mënyrë që të parashikojnë realizimin e procesit, përfshirjen e sektorëve të ndryshëm, dokumentacionin përkatës, si edhe identifikimin e riskut. Gjithashtu, kapaciteti i i auditimit të brendshëm është ipamjaftueshëm.

Mungesa e zbatimit të kritereve të parashikuara në kuadrin ligjor ka ndikuar në mosrealizimin e objektivave të shoqërisë.

Sa sipër, bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 10, nenit 12, nenit 16 pika 2 dhe 3, nenit 27 të Ligjit Nr. 10296 datë 08,07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 172-174 të Projektraporit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i shoqërisë SHA UK Vlorë të marrin të gjitha masat e nevojshme për implementimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për krijimin e Koordinatorit të Riskut, dhe të sigurojnë hartimin e regjistrit të risqeve, hartimin e gjurmëve të auditimit, si edhe funksionimin Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Në vijimësi

2.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë SHA UK Vlorë të marrë të gjitha masat e nevojshme për rritjen e kapacitetit dhe funksionimit të Auditit të Brendshëm.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit transfertat bankare, për periudhën objekt auditimi, konstatohet se bashkëlidhur pagesave për likuidimin e dietave për fjetje mungojnë faturat e hotelit dhe kuponi tatimor. Për vitin 2018, konkretisht; më datë 04.12.2018 janë likuiduar 42,000 lekë dieta brenda vendit për fjetjen në hotel për punonjësit, D. Xh. -2 netë x3,000 lekë, A. R. -2 netë x 3,000 lekë, D. L. -2 netë x3,000 lekë, A. Xh. -2 netë x3,000 lekë, R. A. -2 netë x3,000 lekë, A. B. -2 netë x3,000 lekë, D. T. -2 netë x3,000 lekë. Për vitin 2019, konkretisht; më datë 10.01.2019 janë likuiduar 18,000 lekë dieta brenda vendit për fjetje në hotel për punonjësit, D. Xh. -2 netë x3,000 lekë, A. R. -1 natë x3,000 lekë, R. A. -1 natë x3,000 lekë, A. B. -1 natë x3,000 lekë, D. T. -1 natë x3,000 lekë. Pra, vlera e përfituar nga punonjësit në shumën **60,000 lekë** e likuiduar pa dokumentacionin justifikues, faturë hoteli e shoqëruar me kuponin tatimor, **përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë.** Likuidimi i dietave pa

dokumentacionin justifikues është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe VKM me nr. 329, datë 20.4.2016 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 76-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë UK Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **60,000 lekë** nga punonjësit; D. Xh. -3,000 lekë, A. R.-3,000 lekë, A. Xh. -6,000 lekë, R. A. -3,000 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shërbimit të karburantit nga OE*"F." SHPK* u konstatuan se mungojnë kuponët tatimor, konkretisht:

Në vitin 2018, OE *"F." SHPK* ka faturuar në total 136,630.15 litra naftë dhe mungojnë kuponët tatimor për sasitë: në muajin Prill për 506.79 litra në vlerë 70,122 lekë (506.79 litra*38.3653 lekë/litër); në muajin Maj për 706 litra në vlerë 99,648 lekë (706 litra*141.145 lekë/litër); në muajin Qershor për 567 litra në vlerë 79,287 lekë (567 litra * 139.8355 lekë/litër); në muajin Gusht për 547 litra në vlerë 77,053 lekë (547 litra*140.864 lekë/litër); në muajin Dhjetor për 1,620 litra në vlerë 203,290 lekë (1620 litra*125.4881 lekë/litër).

Në vitin 2019, OE *"F." SHPK* ka faturuar në total 188,756.75 litra naftë dhe mungojnë kuponi tatimor në muajin Maj për 90 litra në vlerë 12,769 lekë (90 litra*141.88 lekë/litër). Për sa më sipër në mungesë të kuponit tatimor OE *"F." SHPK* ka përfituar më tepër vlerën **542,196 lekë e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë.**

Gjithashtu, konstatohet se është pasqyruar konsum fiktiv jo në përputhje me kilometrat e përshkuara, konkretisht: në muajin Korrik 2019, 95 litra me vlerë 12,870 lekë (95 litra x135,4822 lekë/litër) dhe në muajin Gusht 2019, 12 litra me vlerë në vlerë 1,648 lekë (12 litra x137,3507 lekë/litër). Pra, vlera prej **14,518 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe shoqërisë.** Për sa më sipër është në kundërshtim me Kontratat e furnizimit me karburant, nr. 942 datë 13.09.2017 dhe nr. 183, datë 13.02.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 76 - 99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.2. Rekomandimi: UK Vlorë të analizojë veprimet e punonjësve për pasqyrimin e konsumit fiktiv të karburantit, jo në përputhje me kilometrat e përshkuara, në sasisë 107 litra me vlerë **14,518 lekë** dhe arkëtimin e kësaj shume sipas përgjegjësive përkatëse.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit konstatohet se, UKV SHA si debitorë ndaj Shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA/ OSHEE SHA, gjatë vitit 2020 është përballur me disa urdhër ekzekutime përmbarimore dhe urdhër bllokime llogarish bankare. Detyrimi i lindur nga mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE SHA deri në muajin Prill 2021 ka arritur në vlerën 1,161,241,674 lekë dhe kamatëvonesat e këtij detyrimi në vlerën **950,709,193** lekë detyrim ky i cili përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UKV SHA dhe buxhetin e shtetit**. Duke filluar nga muaji tetor 2020 e në vazhdim çdo muaj, në marrëveshje me OSHEE SHA bëhen pagesat e kësteve në vlerën 7,000,000 lekë çdo muaj. UKV SHA; si debitorë ndaj Shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA gjatë vitit 2020 është përballur me disa urdhër ekzekutime përmbarimore dhe urdhër bllokime llogarish bankare.

-**Kredia e shoqërisë** paraqitet në vlerën 1,729,183,906 lekë e cila është e përbërë, si më poshtë:

Kredi për projektin Holandez, për rrjetin e Ujësjellës Kanalizimeve në vlerën 1,578,554,626 lekë (e cila është e ndryshueshme çdo fund viti nga rivlersimi, si rezultat i ndryshimit të kursit të monedhës Euro, ku kredia është 12,761,153.75 €)

Interesa të **pa paguara kredie** në vlerën 150,629,119 lekë të krijuara për periudhën 01.01.2012-31.12.2020.

Penalitetet e kredisë shkojnë në vlerën **344,125,359 lekë**, vlerë kjo e cila përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UKV SHA dhe buxhetin e shtetit.**
- UKV SHA për vitin 2020, ka detyrim ndaj F. G. SHPK për kontratën "Blerje materiale elektrike 2019" për vlerën 8,988,204 lekë me TVSH. Sipas lajmërimit nr. 786, datë 01.04.2021 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin përsa i përket kamatëvonesave lidhur me këtë kontratë, sipas vendimit të gjykatës nr. 1350, datë 13.01.2021 dhe procedurave të mëtejshme nga ana e përmbaruesit, me anë të vendimeve për ekzekutim të detyrueshëm dhe vendosjes të sekuestros konservative drejtuar të gjitha bankave me të cilat operon UKV SHA. Ekzekutimi i këtij detyrimi është bërë në First Bank Vlorë në vlerën **1,104,523 lekë.** Kjo pagesë përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UKV SHA dhe buxhetin e shtetit**. Sa më sipër, situata e krijuar lidhur me detyrimet ndaj palëve të treta, rrezikon ndjeshëm performancën e shoqërisë, përmbushjen e funksioneve primare, pagesën e punonjësve dhe të detyrimeve të tjera, në kushtet e bllokimeve të vazhdueshme të llogarive të saj, e cila mund të rezultojë në pezullim të detyrimeve operacionale të Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 99 - 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandim: Asambleja e Aksionarëve dhe Administratori i shoqërisë të analizojnë **dëmin ekonomik** me vlerë **1,295,939,075 lekë**, shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të merren masa emergjente lidhur me likuidimin e këtyre detyrimeve, të cilat sjellin **si pasojë urdhër sekuestro të llogarive bankare** të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA.

3.2. Rekomandim: Asambleja e Aksionarëve dhe Administratori i shoqërisë, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Bashkinë Vlorë të kërkohet hartimi i marrëveshjeve disa paleshë me OSHEE SHA dhe Projektin Holandez, lidhur me ristrukturimin dhe riskedulimin e pagesave të detyrimeve dhe penaliteteve, në mënyrë që të shmangen urdhër sekuestro bankare dhe mungesa e likuiditetit.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: UKV SHA ka lidhur kontrata për shërbimin e rojeve dhe referuar të dhënave të marra nga Zyra e Financës në UKV SHA ka pasur vonesa të njëpasnjëshme për mungesë fondesh në likuidimin e shërbimeve të rojeve në këtë hark kohor duke u bërë edhe objekt penalitetesh dhe krijim dëmi për shoqërinë dhe buxhetin e shtetit vërtetuar kjo edhe me paditë e ngritura nga operatori Semani & Star Security ndaj UKV SHA për mos likuidim të shërbimeve të ofruara sipas kushteve dhe afateve të kontratës. Me vendimin e përmbaruesit nr. 929, datë 18.05.2021 dhe aktit të ekspertimit UKV SHA duhet t'i likuidojë operatorit S. &S. S., referuar urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë deri në datën 30.12.2020 shumën e kamatëvonesave në vlerën **1,031,546.42 lekë**. Mungesa e një analize nga zyra e financës dhe Titullari i autoritetit kontraktor ka sjellë mosplanifikim të saktë të këtij shërbimi dhe detyrimet e papaguara ndaj operatorit ofrues të këtij shërbimi i kanë sjellë dëm shoqërisë UKV SHA dhe buxhetit të shtetit deri në datën 30.12.2020 në shumën e kamatëvonesave në vlerën **1,031,546.42 lekë.** Megjithatë UKV gjatë vitit 2021 nga Prilli deri në muajin Gusht 2021 edhe pse në proces gjyqësor me operatorin S. & S. S. ka vazhduar të marrë shërbime nga ky operator jashtë kontrate në vlerën 12,706,149 lekë, në kundërshtim me LPP. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Administratori dhe Zyra e financës e UKV SHA, të marrin masa për të parashikuar dhe realizuar procedura prokurimi sipas nevojave reale të shoqërisë në raport me plan buxhetet e saj me qëllim shmangien e pasojave financiare për shoqërinë në të ardhmen si dhe rritjen e pjesëmarrësve ofertues me qëllim përfitimin e një oferte sa më ekonomike, si dhe të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për evidentimin e personave përgjegjës dhe arkëtimin e dëmit ekonomik vlerën **1,031,546.42 lekë**

Menjëherë

10. SPITALI RAJONAL SHKODËR

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SRSH, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
Nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 56 rekomandime te pranuara plotësisht nga SRSH, nga te cilat :
-31 masa organizative, 20 prej tyre janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 9 masa janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.
-Për zhdëmtim e dëmit ekonomik të shkaktuar janë rekomanduar 11 masa, 7 prej tyre janë ne proces, 1 është zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht dhe 2 nuk janë zbatuar.
-Për eliminimin e efekteve negative financiare ne buxhetin e shtetit, janë lënë 2 rekomandime, nga të cilat 1 është zbatuar pjesërisht dhe 1 rekomandim është proces zbatimi.
-Për parregullsitë e konstatuara janë rekomanduar 12 masa disiplinore për personat përgjegjës, të cilat janë zbatuar plotësisht.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 13-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Nga Spitali Rajonal Shkodër, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultojnë në proces, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2018 dhe 2019 është krijuar vlera më e madhe stokut të medikamenteve materialeve të mjekimit, të cilat kanë skaduar në farmacinë e Spitalit Rajonal te Shkodrës, si rezultat i kërkesave jo reale të shërbimeve dhe të planifikimit dhe menaxhimit jo eficent të tyre nga strukturat përgjegjëse të SRSH, duke shkaktuar një efekt negativ ne buxhetin e SRSH. Si pasoj e planifikimit dhe menaxhimit jo të mirë përgjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020 kanë skaduar dhe janë gjendje në farmacinë qendrore të Spitalit Rajonal Shkodër barna dhe materiale mjekimi ne vlerën totale 11,116,722 lekë.
Mungesa e koordinimit të grupit të punës, përgjegjësit të farmacisë dhe shefave të shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit, gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre për barna dhe materiale mjekimi, ka ndikuar në mos reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve dhe si rezultat të mos tërheqjes së tyre nga shërbimet përkatëse. Grupi i punës për planifikimin e barnave dhe materialeve të mjekimit është mjaftuar vetëm me plotësimin e kërkesave të paraqitura nga shefat e shërbimit pa analizuar gjendjen në magazinën e farmacisë dhe të qarkullimit të tyre në dy vitet e fundit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH të përcaktoj të drejtat dhe përgjegjësit e shefit të shërbimit duke i sanksionuar në aktet administrative (kontratë, urdhër ose udhëzim), dhe në rastet e barnave të skaduara të cilat janë kërkuar prej tyre, të propozojë masa dhe penalitete në masën e dëmit të krijuar.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Një numër i konsiderueshëm i pajisjeve mjekësore nuk funksionojnë dhe për një pjesë të tyre, nga komisioni është propozuar nxjerrja jashtë përdorimit dhe më pas asgjësimi i tyre, sipas procedurave ligjore në fuqi. Disa nga aparaturat mjekësore janë pa dokumente dhe disa të tjera nuk janë të regjistruar në inventarin e SRSH. Nga shqyrtimi i të dhënave mbi inventarin e pajisjeve mjekësore dhe përpunimit të tyre nga pikëpamja sasiore nga grupi i auditimit rezulton:

-SRSH posedon 471 pajisje mjekësore, nga këto 156 pajisje ose 33.1 % e tyre nuk funksionojnë dhe qëndrojnë prej vitesh në ambientet e brendshme të reparteve të SRSH duke ndikuar në ndotjen e ambientit për shkak të problematikave që ato kanë në drejtim të mundësisë së rrezatimit etj., duke ndikuar në cilësinë e shëndetit të pacienteve dhe personelit të spitalit;
-Të gjitha pajisjet mjekësore nuk janë regjistruar sipas formularit tip të inventarizimi, sipas standardit të kërkuar nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKIB) të pasqyruar në udhëzuesin e saj;
-Qendra Kombëtare Inxhinierisë Biomjekësore disponon sistemin e informacionit kompjuterik për pajisjet mjekësore CLINGO, njësia e inxhinierisë klinike pranë SRSH ka regjistruar 287 pajisje ose 61 % te tyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1 Rekomandimi: SRSH në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore të bej vlerësimin mbi gjendjen aktuale të funksionimit të pajisjeve mjekësore dhe mundësisë së vënies së tyre në funksion për pajisjet mjekësore që nuk punojnë dhe njëkohësisht nga ana e SRSH të ndiqen procedurat ligjore në fuqi për asgjësimin e pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit.

Menjëherë e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor gjatë vitit 2018, për disa procedura prokurimi ka bërë copëzim të fondit limit dhe shmangie nga procedurat konkurruese të prokurimit duke realizuar më shumë se një procedurë me blerje të vogël për mallra, shërbime, pune me të njëjtin objekt prokurimi. Më poshtë paraqitet copëzimi i fondit limit prej 1,764,178 lekë për realizimin e blerjeve të materialeve të kancelarisë të cilat nga AK janë parashikuar dhe realizuar në tre procedura të blerjeve të vogla, në kundërshtim me nenin 8, 29 dhe 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si më poshtë:
a. Procedura me objekt *"Blerje kancelari"* me fond limit 800,000 lekë, me vlerë të kontratës 372,000 lekë e zhvilluar me datën 20/09/2018.
b. Procedura me objekt *"Blerje shtypshkrime (Letër shkrimi)"* me fond limit 800,000 lekë, me vlere te kontratës 697,000 lekë e zhvilluar me datë 20/06/2018.
c. Procedura me objekt *"Blerje shtypshkrime (Letër shkrimi dhe sende të tjera)"* me fond limit 164,178 lekë, me vlere te kontratës 164178 lekë e zhvilluar me datë 08/02/2018.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 108-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH në cilësinë e Titullarit të AK, të kërkojë relacion shpjegues nga strukturat përgjegjëse të hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, që të parandaloj mundësinë e copëzimit të fondeve, nëpërmjet përdorimit të procedurave të blerjeve të vogla për blerje dhe shërbime me të njëjtin objekt prokurimi.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Mungesa e gjurmueshmërisë së përdorimit të seteve kirurgjikale të sterilizuara nga SRSH. Autoklava nuk është e certifikuar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore dhe vazhdon të bëjë sterilizimin e seteve kirurgjikale kryesisht me kompleksitet të ulët. Administrimi i seteve të sterilizuara në autoklavën e spitalit bëhet në mungese të një urdhri dhe procedure të miratuara nga Drejtori i SRSH, gjithashtu setet kirurgjikale të sterilizuara nga kjo autoklavë nuk pajisen me pullën e sigurisë për evidentimin e cilësisë së sterilizimit. Përveç kostove të harxhimit të energjisë elektrike dhe ujit, nga sektori teknik për autoklavën është parashikuar shpenzime për mirëmbajtje. Nga drejtuesit e SRSH nuk është hartuar rregullore apo udhëzim mbi administrimin dhe evidentimin e ndërhyrjeve në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuar nga autoklava e SRSH. Nga ana e drejtorisë së SRSH nuk është marrë miratim nga MSH, për përdorimin e autoklavës, krahas shërbimit të koncesionarit, duke vepruar në mospërputhje me termat e kontratës koncesionare të lidhur

midis MSH dhe Koncesionarit. Nuk ka evidence në lidhje me ndërhyrjet në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuara në autoklavën e spitalit, duke e bërë të vështirë për të përcaktuar setet e përdorura nga koncesionari apo Spitali. Raportimi periodik i SRSH për FDSKSH mbi numrin ndërhyrjeve kirurgjikale të realizuara nga koncesionari për rastet e planifikuar dhe rasteve të urgjencës, gjatë vitit 2018, 2019 është raportuar sipas sektorit të kostos në SRSH vetëm numri total i ndërhyrjeve dhe jo të ndara sipas nivelit të kompleksitetit të ndërhyrjeve, veprim ky në mospërputhje me parashikimet e kontratës. Sektori i kostos në SRSH has vështirësi për të pasqyruar saktë numrin e seteve të përdorura të koncesionarit pasi në regjistrin e operacioneve nuk ka ndarje për instrumentet dhe setet kirurgjikale të sterilizuara dhe nga autoklava e SRSH.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
5.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH të përcaktojë në aktet administrative (rregullore e veçantë, urdhra, udhëzime, etj.) mënyrën e përdorimit të seteve kirurgjikale që janë në inventarin e spitalit dhe sterilizohen në autoklavën e Spitalit, për të mundësuar evidentimin e gjurmueshmërisë së përdorimit të tyre, në sallat kirurgjikale sipas planifikimit apo rasteve urgjente, si dhe dokumentimin e tyre në regjistrin e ndërhyrjeve kirurgjikale**.**

Menjëherë e në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Drejtimi i SR Shkodër nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore për shkak të mosfunksionimit të Këshillit Administrativ.
Një nga problematikat e hershme të SRSH është mosfunksionimi i Këshillit Administrativ, duke cenuar sigurinë dhe efektivitetin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Këshilli Administrativ megjithëse është ngritur me vendim me nr. 1716 prot., datë 15.05.2019, mbi bazën e rekomandimit të përsëritura të KLSH, rezulton që nuk është mbledhur dhe nuk ka vendimmarrje sipas parashikimeve te neneve 13, 14, 15 te ligjin 9106 "Për shërbimin spitalor në RSH".
Sistemi i kontrollit të brendshëm të SRSH për periudhën objekt auditimi rezulton jo efektiv. Nga ana e drejtimit institucional nuk është vënë në funksionim të plotë ligji i MFK-së sipas parashikimeve të tij, për pasojë strukturat përgjegjëse kanë njohuri të pakta me kërkesat dhe parashikimet për zbatimin dhe krijimin e një mjedisi të brendshëm efektiv të kontrollit të veprimtarisë se tyre ekonomiko administrative.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
6.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH, të bëj funksional veprimtarinë e këshillit administrativ duke planifikuar dhe thirrur në mbledhje anëtarët e Këshillit Administrativ për të bërë të mundur që çdo vendimmarrje që është kompetence e KA, të merret dhe të miratohet nga ky organ i parashikuar nga ligji organik.

Menjëherë e në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në SRSH nuk ka strategji të zhvillimit institucional dhe profesional; nuk ka hartuar, strategji të riskut, në përputhje me kërkesat e ligjit të MFK; nuk ka hartuar, regjistër risku, si dhe Strukturat dhe sektorët e SRSH nuk janë angazhuar në identifikimin e risqeve potencial të sektorëve përkatës. Për sa më lart, drejtuesit e SRSH, në cilësinë e nëpunësit autorizues, për periudhën respektive brenda periudhës se auditimit, nuk kanë përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 10 të ligjit të MFK, "Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 130-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
7.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH nëpërmjet grupeve të ngritura të punës, të fillojë hartimin e strategjisë së zhvillimit të spitalit duke përcaktuar objektiva afat shkurtra dhe afat gjata për arritjen dhe realizimin e misionit dhe objektivave të vendosura në drejtim të përmirësimit të kujdesit shëndetësor spitalor.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Shkodër kanë vetëm një specialist auditi "jo të certifikuar". Në SRSH njësia e AB nuk është plotësuar sipas parashikimeve të VKM nr. 83 datë 3.2.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", ku çdo njësi publike që plotëson kriteret përcaktuar në VKM duhet të ngrejë njësinë e auditimit të brendshëm e cila duhet të përbehet nga jo më pak se 3 (tre) auditues, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë së auditit të brendshëm.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 130-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
8.1 Rekomandimi: SRSH të bëjë të gjitha përpjekjet, dhe në bashkëpunim me MSHMS të ngrejë, dhe të bëjë efektiv njësinë e auditit të brendshëm për të monitoruar dhe kontrolluar veprimtarinë ekonomiko financiare.

Menjëherë e në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Drejtimi i SR Shkodër nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore, Sipas strukturës së vitit 2018 e vijim të dërguar nga MSH, ka ndryshim të emërtesës së Zv. Drejtorëve, kur në fakt, ligji organik specifikon përbërjen e Drejtorisë së SRSH në: Drejtori Ekzekutiv; Zv. Drejtori Ekonomik; Zv. Drejtori Teknik, si dhe Kryeinfermieri i Përgjithshëm. Pozicioni i 2 ZV është riemërtuar ndryshe dhe konkretisht në Zv/Drejtor i Shërbimeve Administrative dhe Zv/Drejtor i Shërbimeve Klinike, kur ligji nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" neni 18 pika 2 specifikon se: *"Struktura dhe rregullat e funksionimit të administratës së autoritetit spitalor të qarkut përcaktohen me VKM".* Ndryshimi në emërtesë, nuk mund të bëhet pa një VKM, edhe pse funksionet hamendësohen të njëjta. Ndryshimi në emërtesë, përveç keqfunksionimit në strukturat drejtuese të SRSH, krijon një situatë joligjore në përcaktimin e nëpunësit zbatues sipas MFK, ku kjo kompetencë i takon drejtuesit më të lartë ekonomik, ZDE, që në rastin e ndryshimit të emërtesave pa VKM ky pozicion nuk ekziston.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
9.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, me qëllim drejtimin e SRSH në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërpërmendura, të marrë masa për rregullimin e strukturës dhe emërtimeve si dhe arritjes së sigurisë dhe efektivitetit të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në periudhën përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 (brenda periudhës së auditimit) kanë skaduar barna dhe materiale mjekimi për shkak të mos përdorimit të tyre, por dhe të planifikimit të gabuar dhe menaxhimit jo efektiv të medikamente dhe materiale mjekimi nga strukturat përgjegjëse pranë SRSH, si më poshtë:
f. Gjatë vitit 2018 në farmacinë e SRSH janë krijuar barna dhe materiale të skaduara në vlerë **4,952,140.30 lekë .**
g. Gjatë vitit 2019 janë krijuar barna dhe materiale mjekimi stok të skaduara në vlerë **5,747,180.76 lekë.**
h. Gjatë vitit 2020 janë krijuar barna dhe materiale mjekimi të skaduara në vlerë **169,326.00 lekë.**
i. Përgjatë viteve 2015/16/17 të marra së bashku janë krijuar barna dhe materiale mjekësore të skaduara në vlerën **248,075.24 lekë.**

j. Në total në magazinën e farmacisë së Spitalit, gjenden të skaduar medikamente dhe materiale të mjekimit në vlerë **11,116,722 lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH të analizoj shkaqet e krijimit të stokut të barnave dhe materialeve të mjekimit të skaduar në vlerën **11,116,722 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficent për SRSH duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e stokut të ri në të ardhmen.

Deri më datën 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Koncesionari "S. S." përdor energjinë elektrike dhe ujin nga spitali, shpenzimet e te cilave mbulohen nga buxheti i SRSH.
Për konsumin e energjisë elektrike:
Në mungese të matësve, konsumi i përafërt i përllogaritur mbi bazën e të dhënave të SRSH është: [200KËh*4 ore*22 ditë*13.2 lekë/kWh (me TVSh)] * 36 muaj= 8,363,520 lekë
Pra në përllogaritjen e përafërt të konsumit të energjisë elektrike është supozuar që autoklavat punojnë 4 orë mesatarisht në ditë dhe çmimi i energjisë elektrike për 1kËh është 13.2 lekë (me TVSH) sipas faturës së energjisë elektrike që paguan SRSH.
Për konsumin e ujit:
Konsumi i përafërt i përllogaritur mbi bazën e të dhënave të SRSH dhe në mungesë të matësit të ujit, është: Konsumi i ujit: 10 m^3/ditë*22ditë*36 muaj *156 lekë/m^3=1,235,520 lekë.
Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga OE S. S. SHPK, **në vlerën 9,599,040 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të SRSH.**
Përllogaritja e përafërt nga grupi i auditimit është bërë mbi bazën e të dhënave të siguruara nga sektori i teknik në SRSH, tregon që koncesionari krahas kostove të seteve kirurgjikale ka rritur kostot e shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë nga buxheti i shtetit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1 Rekomandimi: SRSH të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore ***në vlerën 9,599,040 lekë,*** si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5., ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë detyrime të Koncensionarit dhe jo buxhetit të spitalit

Deri më datën 31.12.2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se sipërfaqja totale në përdorim nga koncesionari është 296 m^2 brenda ambienteve të Spitalit. Koncesionari e ka përdorur këtë sipërfaqe nga data 20.11.2017 e në vazhdim, pa paguar qira.
Në nenin 19.4, të kontratës koncesionare, ndër të tjera përcaktohet se: *"Autoriteti duhet të japë në përdorim, kur është e nevojshme për arsye logjike, hapësirat në zonat spitalore që mund ti lejojnë operatorit koncesionar dhe operatorëve të saj akses dhe përdorim të të gjitha strukturave të ndërtuara si magazina ose aktivitete produktive të back-up, pa u kërkuar një qera dhe/ose rimbursim financiar".i* Në kontratë është përcaktuar që "Autoriteti" është "Ministria e Shëndetësisë" SRSH në lidhje me ambientet e dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk ka ndjekur procedurat ligjore në zbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar. Në lidhje me ambientet e dhëna në përdorim të koncesionarit, nuk është mbajtur nga SRSH detyrimi për marrjen e qerasë për këto ambiente, duke qenë se Spitali nuk është palë në këtë kontratë, por vetë Ministria e Shëndetësisë. Për periudhën në auditim dhe për sipërfaqen prej 296 m^2 duke llogaritur si tarifë dysheme, mbi bazën e përcaktimeve të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.

Spitali Rajonal Shkodër nuk ka përfituar vlerën financiare nga qiraja e ambientit brenda SRSH, ku koncesionari zhvillon aktivitetin. E ardhura e munguar nga mos përftimi i shumës së qerasë e cila llogaritet: (296m^2*150 lekë/m^2=44,400 lekë/muaj). Koncesionari brenda periudhës së auditimit ushtron aktivitetin prej 36 muaj. Pra ne total kemi 44,400 lekë/muaj*36 muaj= 1,598,400 lekë. Për sa më lartë shuma **1,598,400 lekë** përbën efekt financiar negativ për SRSH.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1 Rekomandimi: SRSH të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën **1,598,400 lekë** si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5

Menjëherë e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018 janë larguar 21 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 30 punonjës të rinj. Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë larguar 34 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 63 punonjës të rinj.
Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë larguar 57 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 69 punonjës të rinj.
Përsa i përket largimeve nga puna për periudhën e auditimit, janë hapur procese gjyqësore në 2 raste , ku gjykata i ka dhënë të drejtë punonjësve të larguar dhe deri më sot për të dy këta punonjës është likuiduar shuma totale prej **2,299,192 lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 17-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH të analizoj shkaqet e krijimit të detyrimit prej **2,299,192 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficent për SRSH duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e detyrimeve të reja në të ardhmen.

Deri më datën 31.12.2021

C. MASA ADMINISTRATIVE

Masa që u rekomandohen, Organeve apo Strukturave të cilat, sipas legjislacionit në fuqi kanë në kompetencë vendosjen e tyre si:

E.1 Masa administrative të rekomanduara Agjencisë Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike., të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe konstatimeve të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe vërejtjeve, komenteve dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitura nga subjekti i audituar, mbështetur në nenet 23 të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër ti kërkoj Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljen e konstatuara, fillimin e procedimit administrativ, për përjashtimin e operatorit ekonomik **"F."** shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për sa më poshtë:
-"F." SHPK është shpallur fitues i procedurës së prokurimit realizuar nga Spitali Rajonal Shkodër për 10 Lap Top, procedurë për të cilën OE pas nënshkrimit të kontratës ka dorëzuar pranë SRSH lap-top të Markës/model "ACER A315-31-C6FN".
Grupi i auditimit, me përzgjedhje rastësore ka verifikuar tre laptop mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike nëpërmjet funksionit "System Informatin" të SO Ŵindoŵs 10, proces i kryer në prezencë të komisionit të prokurimit, anëtarë e të cilit ishte edhe specialistja e IT.

Pas verifikimit të specifikimeve teknike te tre laptop të përzgjedhur rastësisht duke përfshirë dhe laptop-in që posedon specialistja e IT, respektivisht me numrat serial (S/N); Nxntex01674616ad17600; Nxntex01674616ac87600; Nxntex01674616ac57600, rezultojë që: 10 (dhjetë) Lap top-ët kanë RAM-in 4 GB, pra në mospërputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike te kërkuara nga AK dhe të ofertës së paraqitur nga vete OE fitues "Fastech".
Ndërkohë që AK në dokumentet e tenderit ka kërkuar blerjen e 10 laptop-ve me RAM 8 GB nga ana e Fastech janë dorëzuar 10 laptop-Model ACER A315-31-C6FN me RAM-in 4 GB.
Modeli "ACER A315-31-C6FN" i ofertuar dhe dorëzuar nga OE Fastech, nga kërkimi në internet ne adresën: "https://ŵŵŵ.bcgroup-online.com/laptopovi/acer-aspire-a315_31_c6fn-%28nx.gntex.016%29-intel-n3350.-4gb.-500gb-43929", përdor memorien **RAM 4GB LPDDR3 1600MHz**. Për dorëzimin e një malli të ndryshëm nga ai i ofertuar dhe i ndryshëm nga specifikimet teknike të përcaktuara nga AK në DST si dhe deklarim të pa vërtetë/saktë sipas shtrojsës 6 (deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike datë 08.05.2018 prot. AK me nr. 930 prot. datë 08.03.2018) dhe shtrojsa nr.1 (formulari i ofertës, ku përshkrimi mallit është bërë për lap top me RAM 8 GB), duhet të ngarkohet me përgjegjësi OE "Fastech" dhe përfaqësuesi i tij z. A. P.

C.2 Masa administrative të rekomanduara Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, (IMTV).
Nga verifikimi fizik që u krye nga grupi i auditimit, i mbajtur me Akt Verifikim nr.4 datë 14.05.2021 (nr. 230/19 prot., datë 14.05.2021) rezultoi se, një pjesë e sipërfaqes së truallit të pasurisë së paluajtshme prej 66.72 m^2, përdoret nga një subjekt privat i cili ushtron aktivitet privat bar-bufe. Në lidhje me këtë SRSH nuk ka marrë asnjë masë (njoftim të subjektit, njoftim të IKMT/IMT), me qëllim ndalimin e ushtrimit të këtij aktiviteti dhe lirimin e sipërfaqes, pranë pasurisë që ka në përdorim, mosveprim i cili bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 195 të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 506, datë 18.09.2013 "Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore".
Sa sipër, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, të përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme"*, i ndryshuar, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, **Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër, t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Shkodër**, vendosjen e masave administrative "Gjobë", dhe në bashkëpunim të realizojnë pastrimin e territorit të Spitalit Rajonal Shkodër nga të gjitha ndërtimet e ngritura në mënyrë të kundërligjshme.

D. <u>MASA DISIPLINORE</u>
D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE
<u>D.1.1 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statuse të parashikuar në ligje të veçanta.</u>
Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar dhe kontratës kolektive të punës nr. 313 prot, datë 16.09.2016, neni 8 si dhe kontratave individuale dhe rregullores së brendshme të institucionit nr. 882 prot. datë 19.09.2011. Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, të marrë masat disiplinore ***"Vërejtje"***, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm për:
1. Z. A. H., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Blerje medikamente MK e ndare ne 23 lote".
2. Znj. S. K., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit "Blerje shtypshkrime".

11. DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitet 2018-2019, rezultoi se informacionet sqaruese të tyre (bilancet), nuk kanë shënimet shpjeguese të plota me zbërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo problemet që kanë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. DPD nuk disponon dokument që të vërtetojë se aktivet e qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në llogarinë 212 *"Ndërtime dhe rikonstruksione"*, janë në pronësi apo në administrim të kësaj Drejtorie. Nga DPD janë kryer plan rilevimet për godinat e kapitenerive të porteve Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë. Planet e rilevimit janë dokumentet kryesorë që japin informacion mbi statusin e pronësisë së objekteve/godinave që institucionet kanë në përdorim, në pronësi apo administrim. Mos marrja e masave për regjistrimin e inventarit në përdorim nga DPD është tregues i menaxhimit jo të mirë të aseteve të njësisë publike dhe bie ndesh me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, neni 4, pika 1, pika 19.
-Pasqyrat financiare dhe Pasqyrat e realizimit të buxhetit për të dy vitet kanë mospërputhje të faktit të realizimit të buxhetit me faktin e pasqyruar në pasqyrat e kontabilitetit. Këto mospërputhje, kanë ardhur si rezultat i mos kuadrimit të llogarive analitike me llogaritë sintetike (të gjendjeve) që pasqyrohen në pasqyrat financiare në fund të vitit siç kërkohet në Udhëzimin nr. 8 të MFE *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, pika 8.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, nëpërmjet Drejtorisë të Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Financës, të marrë masa për:
- Sistemimin e diferencave të fondeve të veta, të cilat duhet të jenë të barabarta me pasqyrimin e tyre në bilanc.
- Saktësimin e detyrimeve afatshkurtra si detyrime, likuidimi i të cilave duhet të bëhet brenda një viti ose një cikli operativ (ekonomik) duke përdorur aktivet e veta afatshkurtra ose duke krijuar detyrime të tjera afatshkurtra.
- Kryerjen e veprimeve përkatëse rregulluese kontabël në llogaritë kreditore për detyrimet ndaj furnitorëve, ndaj detyrimeve tatimore e të tjera në vijimësi dhe të bëhet pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin 2020.
- Regjistrimin e aseteve në pronësi të DPD-së dhe pasqyrimin e tyre të drejtë në pasqyrat financiare.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Inventarët e mjeteve mbahen në mënyrë dokumentare/shkresore nga Drejtoria e Sigurisë Detare, Administrimit dhe Kontrollit Shtetëror (*Sektori i regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detare*) dhe nuk ka një regjistër elektronik. Dixhitalizimi i të dhënave, do të bënte të mundur informimin në kohë dhe kryerjen e detyrave me efektivitet nga punonjësit e institucionit.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare, Nëpunësi Autorizues, të informojë MIE mbi situatën e inventarizimit të mjeteve lundruese dhe në bashkëpunim me MIE të ndërmarrin hapat për propozimin e realizimit të një projekti të dixhitalizimit të inventarit të mjeteve lundruese dhe publikimin e tyre në mënyrë elektronike për stafin e institucionit.

Menjëherë

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës për kontratën nr. 6811, datë 03.12.2018, të lidhur midis AKSHI-t dhe operatorit ekonomik "R. C." SHPK (me përfitues DPD) dhe objekt *"Vendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi"*, ka likuiduar vlerën prej 68,933,400 lekë me TVSH. Për mirëmbajtjen e sistemit apo riparimin e tij, DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj 1,267,200 lekë ndërkohë që këto shpenzime duhej të ishin përballuar nga AKSHI. Mos rakordimi i strukturave të institucionit të DPD-së, ka sjellë si rezultat rritjen e shpenzimeve të panevojshme për buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej 1,267,200 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efiçensës dhe efektivitetit të fondeve publike.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat e nevojshme, për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël si dhe eliminimin e kostove të panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: DPD, në bashkëpunim me AKSHI-n dhe MIE, të marrin masa për mbulimin e shpenzimeve për zërin "F.V. Raportimi Automatik i Pozicionit LRIT" dhe garantimin nga AKSHI të funksionimit të sistemit me kontrata shumë vjeçare të cilat të jenë njësoj në kohë si për mirëmbajtjen e sistemit por edhe të raportimit automatik, për të siguruar funksionimin e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi.

Menjëherë

12. UJËSJELLËS KANALIZME SHA KURBIN

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet që vjetërsia në punë është paguar vetëm për punonjësit të cilët janë me arsim të lartë në UKK, ndërsa punonjësit e tjerë nuk e kanë përfituar këtë të drejtë, në kundërshtim me nenin 6, pika 2, të Kodit të Punës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 33-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për përfshirjen e vjetërsisë për secilin punonjës në përllogaritjen e pagave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Ngjarjet dhe veprimet ekonomike, si regjistrimet kontabël, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen manualisht, pasi institucioni nuk ka të instaluar një program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të saj, në kundërshtim me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 44-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Në mënyrë që të ruhet dhe garantohet siguria e informacioneve të saj, UKK të marrë masa për përdorimin e programeve financiare në mbajtjen dhe regjistrimin e veprimeve kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për të tre vitet, nuk janë pasqyruar saktë vlerat sa i takon klientëve debitorë nga furnizimi me ujë dhe të ardhurat e arkëtuara si vijon:

Për vitin 2018

Zëri "Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit" (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 135.351.480 lekë, ndërkohë që rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë "Klientë debitor, familjar, privat, etj" paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 169.820.541 lekë.

UKK ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 44.588.799 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve rezulton se vlera e të ardhurave është 57.464.730 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Për vitin 2019

Zëri "Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit" (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 142.247.887 lekë, ndërkohë që rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë "Klientë debitor, familjar, privat, etj" paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 181.310.336 lekë.

UKK ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 42.396.568 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve rezulton se vlera e të ardhurave është 45.650.151 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Për vitin 2020

Zëri "Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit" (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 149.428.475 lekë, ndërkohë që rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë "Klientë debitor, familjar, privat, etj" paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 192.779.329 lekë.

UKK ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 38.809.129 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve rezulton se vlera e të ardhurave është 40.445.970 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Sektori i financës të marrë masa që në të ardhmen të rakordojë dhe pasqyrojë me vërtetësi dhe saktësi vlerat sipas të dhënave të gjeneruara nga sektorët dhe regjistrimet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, në zërin "Toka dhe ndërtesa" në vlerën 27.240.574 lekë pasqyrohet vetëm vlera e ndërtesës, pasi UKK nuk ka të regjistruar në regjistrin e aseteve tokat në të cilat ushtron veprimtarinë e saj. Kjo situatë është trashëguar edhe në vitet në vijim. Në vitin 2018, UKK ka kryer me topografin e Bashkisë Kurbin matjet për stacionet e pompimit dhe rezervuarët, nga të cilat në ZVRPP përkatëse kanë rezultuar në pronë shtetërore. Në vijim janë ndjekur procedurat përkatëse për regjistrimin e tyre në pronësi të UKK, por deri në momentin e përfundimit të auditimit nuk është finalizuar ende ky proces, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". *Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli i Administrimit të shoqërisë të marrin masa për nxitjen e përshpejtimit të procesit të regjistrimit të pronave të UK Kurbin. Për këtë qëllim të kërkohet edhe angazhimi i aksionarit të vetëm të shoqërisë, Bashkisë Kurbin.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga organet drejtuese të UKK nuk është kryer asnjëherë analizë në lidhje me llogaritë debitore-kreditore, për të cilat rezulton se gjendja, evidentimi, ndjekja dhe arkëtimi paraqitet problematike, pasi nuk janë konsumuar të gjitha rrugët për vjeljen e tyre deri në ngritjen e padive në gjykatë për persona fizik apo juridik me detyrime të pashlyera. UKK nuk ka marrë masa as për analizimin dhe veçimin e vlerave të debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe zgjidhjen e kësaj situate. Në fund të vitit 2019, UKK nuk ka marrë masa për likuidimin e një pjese të detyrimeve edhe pse ka patur gjendje monetare në vlerën 7.277.546 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe neni 8 dhe 9 të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 50-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UKK të merret në analizë të vazhdueshme situata lidhur me gjendjen debitore dhe kreditore, të realizohet një plan konkret masash për të përmirësuar treguesit financiarë të shoqërisë, si dhe të merren masa për përcaktimin e kritereve të qarta në përzgjedhjen e debitorëve për dërgim në përmbarim për arkëtim të detyrueshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 dhe 2021 UKK, nuk ka hartuar apo miratuar programet ekonomiko-financiare vjetore dhe nuk ka reflektuar ndryshimet e tyre (sipas rasteve kur ka patur ndryshime), duke mos respektuar përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të shkronjave "a" e "b", të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, për zbatimin e procedurave të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit. Shoqëria është mjaftuar vetëm me plan biznesin 5 vjeçar 2019-2024, dokument ky që nuk ka përfshirë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit, por vetëm për vitin 2019. Për këtë periudhë konstatohet se nga ana e Administratorit nuk është hartuar urdhri për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektprogrameve si dhe nuk janë dërguar, pranë Këshillit të Administrimit të UK Kurbin dhe Asamblesë Aksionare për miratim.

- Në programin ekonomiko financiar të vitit 2018 dhe plan biznesin 2019-2024 nuk janë përfshirë në këtë plan investimet e realizuara faktikisht, ku përmendim këtu projektin "Ndërtim i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit Laç", për shkak se këto dokumentacione nuk janë rishikuar në vijim për t'i shoqëruar ato me relacione shpjegues të faktorëve që nuk kanë mundësuar parashikimin e tyre në program sipas rastit, në mënyrë që të pasqyrohet domosdoshmëria e kryerjes investimeve të paparashikuara; tejkalimi i disa zërave të shpenzimeve në raport me shpenzimet e tjera.

Udhëzimi nr. 15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror" në kapitullin I të tij parashikon procesin e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik, detyrim ky i të gjitha shoqërive publike me kapital shtetëror për periudha 1 vjeçare, afatmesme dhe afatgjata. Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik duhet të mbështetet në objektivat e caktuara nga organet drejtuese dhe Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2019-2030 dhe 2020-2030 dhe të miratohen nga Asambleja Aksionare dhe Këshilli i Administrimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 9-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Administratori i UKK të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt programeve për çdo vit, dhe për t'ja dërguar ato Këshillit të Administrimit të UKK dhe Asamblesë Aksionare për miratim.

Në vijimësi

6.2. Rekomandimi: Grupet e punës për hartimin e planeve ekonomiko-financiare, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të shoqërisë, të marrin masa që në planin e biznesit 5 vjeçar të përfshijnë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit me qëllim përmirësimin e performancës dhe objektivave strategjik dhe vjetor të shoqërisë në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës – Kanalizime.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Raportimi tek organet drejtuese mbi realizimin e treguesve të programit vjetor të zhvillimit ekonomik dhe financiar nuk është kryer në të gjitha rastet sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", neni 18 pika 7. Në ato raportime të kryera nga ana e Administratorit, jo në të gjitha rastet janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe në asnjë rast nuk rezulton të jenë përfshirë analiza krahasimore me planin financiar për periudhën respektive, shoqëruar me analiza për motivet e mos realizimit. Për vitin 2018 konstatohet se është kryer një raportim vetëm për vlerën totale të tyre, duke mos evidentuar realizimin sipas zërave. Gjithashtu, në raportimet e kryera, informacioni është bazuar vetëm në shpenzimet e kryera bazuar në të ardhurat e gjeneruara nga vetë shoqëria, duke mos përfshirë në to informacion mbi subvencionet e përfituara, apo detyrimet e pa shlyera të njësisë. Në këto kushte nuk mundësohet monitorimi i realizimit të planit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 10-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
7.1 Rekomandimi: Administratori i UKK të marrë masa për kryerjen e raportimeve mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar mujor dhe vjetor pranë Këshillit Administrativ me informacione të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, për të mundësuar analizimin e të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko-ekonomik të shoqërisë sipas planit dhe periudhave të mëparshme.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Financimi nga buxheti i shtetit, nga ana e UKK nuk rezulton të jenë përcjellë pranë institucioneve eprore projekt propozime për financim të investimeve, apo raportime të kryera si për detyrimet e prapambetura, si dhe për evidencat e shpenzimeve (rakordime periodike me thesarin) për pjesën e financimit nga buxheti i shtetit (kryesisht për investime).
-Drejtoria e Thesarit pranë MFE ka raportuar pagesa për detyrime të prapambetura nga UKK në vlerën 17,846 mijë lekë bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë si shuma të deklaruara "të paguara" gjatë vitit 2020, në zbatim të strategjisë në VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", kur nga ana e shoqërisë nuk rezulton të jetë kryer asnjë raportim lidhur me detyrimet e prapambetura pranë Bashkisë apo MIE; dhe në regjistrin e pagesave në SIFQ pagesat për detyrime të prapambetura nga UKK paraqiten në vlerën (zero). Për sa i përket stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura sipas të dhënave të Drejtorisë së Thesarit në MFE, dhe raportit vjetor për stokun e detyrimeve të prapambetura të hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, UKK në vitin 2019 rezulton ndër institucionet që deklarojnë detyrime të prapambetura, të cilat konkretisht konsistojnë në vlerën 13,986,204 lekë kur sipas pasqyrave financiare ato rezultojnë në vlerën 435,508,393 lekë dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 31,832,357 lekë në një kohë ku sipas pasqyrave financiare janë në vlerë 612,388,769 lekë, shifra këto të konsiderueshme krahasuar me buxhetin në dispozicion të kësaj shoqërie, të cilat sikundër vërehet paraqiten në rritje dhe nuk rezultojnë të bëhen pjesë e raportimeve periodike pranë KA, Asamblesë së Përgjithshme apo strukturave të tjera drejtuese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të UK Kurbin, duke përfshirë Administratorin, Këshillin e Administrimit, Asamblenë e Përgjithshme, etj të ngrenë grupe punë për analizimin e detyrimeve të prapambetura; përcjelljen e një informacioni të plotë të vlerës së tyre me qëllim raportimin real të tyre në raportin vjetor të hartuar nga MSHMS për stokun e detyrimeve të prapambetura, dhe hartimin e një plani veprimi dhe shlyerjeje për reduktimin e tyre.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit me përfitues UKK konstatohet se përgjatë vitit 2020 ka patur disa rishikime të fondeve buxhetore, konkretisht 4 rishikime për projekte që prekin investimet kapitale me një rritje të fondeve të këtyre projekteve me vlerë prej 52,776 mijë lekë. Sipas Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", pika 79: "*Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qëndrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit*", dhe në bazë të numrit të lartë të rishikimeve, referuar edhe vlerës totale të shpenzimeve të kryera në kuadër të investimeve kapitale të UKK, mund të konkludojmë për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve për investime reflektuar edhe nga mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionin epror përgjatë procesit të planifikimit të buxhetit. Gjithashtu, nga kryqëzimi i të dhënave të kontratave të lidhura me përfitues UKK për vitin 2020, me PBA-në e institucioneve qendrore publikuara në ŵeb-in e MFE, u konstatuan 2 projekte me vlerë totale 12,276 mijë lekë, ku janë marrë angazhime për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA, pra plani i pagesave të kontratave për projekte investimesh në PBA e periudhës 2020-2022 për vitin 2020 nuk cilat kanë të përfshirë plan pagesash për këto projekte por përgjatë vitit janë rishikuar fondet për financimin e këtyre kontratave, veprim në kundërshtim me Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020", pika 19. e) e tij. Për rishikimet e kryera më sipër, nga ana e UK Kurbin nuk rezulton të jetë përcjellë asnjë kërkesë zyrtare pranë institucioneve eprore për kryerjen e këtyre ndryshimeve në buxhetet në dispozicion.

- Kontrata e investimit "Ndërtimi i rrjetit te jashtëm e te brendshëm ujësjellësit te qytetit Laç faza II" ka planifikuar kryerjen e shpenzimeve financuar nga buxheti i shtetit në kontratë (pa TVSH), si më poshtë:

Viti 2020 - 87 767 397 lekë; Viti 2021 - 70 000 000 lekë; Viti 2022 - 30 000 000 lekë

Pra në total sipas kontratës në vlerën 438,836 mijë lekë, në harkun 3 vjeçar janë planifikuar për t'u kryer pagesa në vlerë 187,767 mijë leke (ose 42%); dhe shuma e mbetur e financimit është përcaktuar në vitet ne vazhdim. Në kushtet kur faktikisht kontrata parashikon përfundimin e punimeve në harkun kohor 2 vjeçar, ky nivel planifikimi i fondeve i cili po kështu paraqitet edhe në planin buxhetor afatmesëm 3 vjeçar mund të bëhet shkak për krijimin në të ardhmen të detyrimeve të prapambetura. Për këtë projekt, me aktin normativ nr. 34, në datën 23 dhjetor është shtuar niveli i financimit edhe me 40,000,000 lekë, pra rreth 57% të planit të buxhetit që sipas PBA 2020-2022 ishte parashikuar për këtë kontratë në vitin 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 24-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për hartimin e projekt buxhetit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, në bashkëpunim me AKUK, të marrin masat për rritjen e bashkëpunimit gjatë procesit të planifikimit, dhe ekzekutimit të buxhetit duke bërë palë të këtij procesi edhe njësitë e varësisë përfituese të fondeve publike, në këtë rast UK Kurbin, me qëllim përmirësimin e performancës buxhetore në drejtim të përfshirjes në projektbuxhet të investimeve dhe shmangien e rishikimeve përgjatë vitit me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit, dhe që mund të bëhen shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen. Gjithashtu, këto struktura, të marrin masat për shmangien në të ardhmen të fenomenit ku planifikimi i fondeve për investime nuk garanton mbulimin e pagesave të

pritshme që rrjedhin nga zbatimi i kontratave, referuar edhe periudhës kohore të implementimit të projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Iniciativat e ndërmarrja nga UKK për krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, u konstatuan me mangësi të konsiderueshme mbi sistemet e kontrollit të brendshëm si në aspekt të perceptimit të përgjegjësive menaxheriale sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar dhe Manualit të MFK, ashtu edhe në drejtim të hartimit dhe miratimit të dokumentacioneve të nevojshme. Shkak për këtë, është edhe mos përfshirja nën monitorim të shoqërive aksionare nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Më hollësisht:
-Nuk është hartuar dhe përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MFE Pyetësori i Vetëvlerësimit të Kontrollit të Brendshmëm Financiar Publik, Deklarata e Cilësisë dhe Raporti përkatës mbi sistemet e kontrollit të brendshëm.
-Nuk është hartuar Strategjia e Menaxhimit të Risqeve për përcaktimin e planit të punës dhe strategjisë që do të ndiqet për adresimin e risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave institucional dhe as regjistri i risqeve apo grupe për menaxhimin e riskut.
-Nuk është ngritur dhe të ketë funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), apo koordinatori i riskut dhe MFK
-Rregullorja aktuale e UK Kurbin, edhe pse në aktet vendimmarrëse për miratimin e saj citohet si një rregullore e brendshme, faktikisht ajo ka për qëllim sigurimin e marrëdhënieve mes konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe furnizuesit të këtij shërbimi, pra nuk është një rregullore e brendshme e funksionimit të UK Kurbin;
-Nuk është hartuar dhe miratuar Kodi Etik dhe nuk janë përfshirë çështje të etikës në aktet të tjera rregullatore të institucionit;
-Nuk është hartuar plani i aktivitetit për të detajuar objektivat strategjik, vjetor, prioritetet dhe planet e veprimit;
-Nuk është kryer asnjë trajnim për periudhën nën auditim, si dhe nuk disponohet asnjë plan dhe regjistër për kryerjen e trajnimeve të stafit. Si rezultat, nuk janë hartuar module trajnimi edhe mbi sistemet e kontrollit të brendshëm, në kuadër të forcimit të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të punonjësve mbi rëndësinë e instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm;
-Nuk është kryer monitorim të veprimtarisë institucionale për periudhën objekt auditimi, në përmbushje të misionit dhe detyrave të saj; konstatohet mungesa e raporteve periodike për identifikimin e çështjeve që kërkojnë ndërmarrjen e masave konkrete për adresimin e tyre.;
-Nuk janë përgatitur hartat e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK;
-Nuk janë hartuar gjurmët e auditimit me qëllim identifikimin e proceseve kyçeve të njësive dhe dobësive;
-Nuk janë parashikuar nga Administratori i shoqërisë rregulla për delegimin e detyrës;
-Nuk disponohet një ŵeb faqe zyrtare e shoqërisë për publikimin e informacioneve të aksesueshme për publikun;
-Nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, për detajimin e proceseve në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre;
-Evidentohet mungesa e një arkive për ruajtjen e dokumentacioneve të shoqërisë;
-Nuk janë implementuar strategji apo sisteme "back-up" për ruajtjen e informacionit dhe dokumentacioneve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 94-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandimi: Administratori i UKK, në bashkëpunim me strukturat e tjera drejtuese të shoqërisë, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar më sipër për

të përmbushur detyrimet në kuadër të forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke hartuar aktet e brendshme administrative të nevojshme dhe implementimin e tyre në përputhje me politikave për monitorimin e objektivave dhe përmirësimin e situatës, sipas çështjeve të ngritura më sipër.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Mungon Rregullorja e Ujit nënshkruar nga Asambleja e Aksionareve e Ujësjellës Kanalizimeve Kurbin" SH.A dhe nga Administratori i UKK. Në këtë mënyrë nuk sigurohet një marrëdhënie ligjore e drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UKK që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, në zonën e shërbimit, nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit te rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve SHA". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1. Rekomandimi: Nga Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Administrimit, Administratori i Shoqërisë, për secilën periudhë përkatëse në funksion të ushtrimit të detyrës, të hartohet/miratohet Rregullorja e Ujit.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në UKK raportimi i ujit të prodhuar është i pasaktë, pasi puset e prodhimit të ujit dhe kaptazhe operojnë pa matës, ndërkohë që çdo vendburim e pus uji duhet të pajiset me matës ujit, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit. Në UKK, nuk ka asnjë mundësi teknike (për gjendjen në të cilin gjendet linja e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit), të jepet shifra e saktë e prodhimit të ujit në burime, hyrje/daljet në depot apo uji që shkon tek konsumatorët. Saktësia e prodhimit të ujit të deklaruar nuk mund të merret e mirëqenë. Si e tillë, UKK ka anashkaluar matjen dhe udhëzimet e ERRU për metodologjinë e matjes, duke mos dhënë informacion të verifikueshëm si për shoqërinë dhe për organet e kontrollit, që prodhimi i ujit dhe detyrimet rrjedhëse për buxhetin e shtetit nga ky prodhim janë të sakta si deklarohen. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 55-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime SHA Kurbin, të marrë masa që për çdo vendburim e pus uji të pajiset me matës ujit, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Asambleja e Aksionarëve (AA) të UKK, rezulton të jetë mbledhur vetëm 4 herë për vitin 2019, dhe nuk është mbledhur as edhe një herë në vitin 2018 dhe 2020. AA nuk ka plotësuar detyrimin ligjor të përcaktuar në Statutin e Shoqërisë dhe konkretisht nenit 6 "Asambleja e përgjithshëm", pika 3, sipas të cilës "Asambleja e përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit", detyrim i cili sipas pikës nr. 2 thirret nga Kryetari i AP (Kryetarja e Bashkisë); Këshilli i Administrimit; Administratori i Shoqërisë, por mund të thirret edhe nga Eksperti Kontabël i Autorizuar; nga një mandat mbajtës i caktuar nga gjykata për raste emergjente, në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" , i ndryshuar dhe Statuti i Shoqërisë, neni 6 "Asambleja e përgjithshëm", pika 3, sipas të cilës "Asambleja e përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 6-7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1. Rekomandimi: UKK të marrë masa për realizimin e mbledhjeve të Asamblesë së Aksionerëve të paktën 1 (një) herë në vit, sipas përcaktimeve statutore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për arsye të vështirësisë financiare të UK Kurbin, pagesat dhe deklarimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe e tatimit për të ardhurat e punonjësve janë kryer vazhdimisht me vonesë. Si pasojë UK Kurbin ka gjeneruar gjoba për vitin 2015-2017 në vlerën 1.352.928 lekë, nga të cilat në vitin 2018 janë trashëguar pa likuiduar 393.660 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për këtë vit. Situata ka vazhduar dhe për periudhën vijuese objekt auditimi (2019-2020) nga ku rezulton se për vitin 2019 janë gjeneruar gjoba në vlerën 304.545 lekë, dhe për vitin 2020 janë gjeneruar gjoba në vlerën 912.029 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", dhe nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: UKK të marrë masa për kryerjen me prioritet të pagesave nga transaksione që gjenerojnë gjoba për shkak të vonesave, si dhe të planifikojë saktë në buxhete apo nevoja për subvencione vlerat sa i takon këtyre transaksioneve.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statuse të parashikuar në ligje të veçanta.

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar dhe kontratës kolektive të punës, neni 8 si dhe kontratave individuale dhe rregullores së brendshme të institucionit, Administratori i Ujësjellës Kanalizime SHA Kurbin, të marrë masat disiplinore ***"Vërejtje"***, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm për:

1. Z. J. K., në cilësinë e Përgjegjësit të karburantit

13. MSHMS PËR PROJEKTIN "PËRMIRËSIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR"

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me objektivat rezultoi se në MSHMS janë dorëzuar të gjitha materialet sipas kontratës por nuk ka dokument të plotë të realizuar, dhe me shtyrjen e vazhduar në fund mund të mos mbetet kohë edhe për periudhën e nevojshme të implementimit të tij. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit HSIP fillestar (viti 2015) dhe Manuali Operacional i Projektit HSIP i rishikuar (viti 2019).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 36-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: MSHMS të botojë versionin final të Master Planit të përbërë nga materialet e hartuara si dhe të ngrejë ekipin që do të vërë në jetë implementimin e tij duke përfshirë dhe kryerjen e trajnimeve për stafet e spitaleve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, kontrata për *"Mbështetjen e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë se re për menaxhimin e QSUT"* nuk është realizuar me sukses. Në zbatim të kushteve të kontratës klauzolës 9.1, konsulenti Coseil Sante, duhej të dorëzonte brenda afateve kohore të përcaktuara në kontratë dhe të pasqyruara në tabelën nr. 2 aneksi nr. 5. Pas dorëzimit të raporteve respektive sipas fazave dhe kërkesave të përcaktuara në Termat e Referencës (TOR) dhe të pasqyruara në kontratë, konsulenti duhet ti dorëzonte pranë ekipit te menaxhimit të kontratës në formatin hard copy dhe elektronik me e-mail raportet dhe dokumentacionin e kërkuar. Ekipi i menaxhimit në zbatim të klauzolës (kushtet specifike) neni 41.2 afati i komenteve, duhet që brenda 21 ditëve nga dita e dorëzimit të raporteve të bej komentet. Të dhënat analitike mbi dorëzimin e raporteve respektive sipas fazave dhe datave gjenden në aneksin nr. 5 tabela nr. 2. Për sa më lart, kontrata me konsulentin ndërkombëtar për një strategji të re të menaxhimit të QSUT, do të konsiderohet e pasuksesshme në drejtim të dorëzimit të produkteve/raporteve sipas fazave dhe respektimit të afatit kohorë të përfundimit të kësaj kontrate, brenda datës 06.06.2021. Nga auditimi i kësaj praktike rezultoi gjithashtu se kontrata e lidhur mes palëve nuk ka të përfshirë penalitete për dorëzimin me vonesë të produkteve kontratës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 106-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për përfshirjen në kontratat e ardhshme të klauzolave në lidhje me aplikimin e penaliteteve për dorëzimin me vonesë të produkteve këtyre kontratave.

Në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

B/I. Për punonjësit marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Ligjin "Për nëpunësin civil":

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", germat (b, c, ç) e nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën nga fillimi i Projektit (2015) deri më 31.05.2021, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore ***"Vërejtje"*** për **8 punonjës**, si më poshtë:

1. Znj. J. J., **me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Koncesioneve, PPP dhe Prokurimeve**

B/II. Për punonjësit marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 *"Kodi i Punës"*, i ndryshuar, kontratës individuale të punës dhe Rregullores së Brendshme të institucionit, **i rekomandojmë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, të marrë masat për vendosjen e masave disiplinore si më poshtë, pas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, konkretisht:

"Ndërprerje e menjëhershme e marrëdhënieve të punës" *për:*
1. Znj. E. H., **me detyrë Drejtore Kabineti**

"Vërejtje me shkrim" për:

1. Znj. M. C., **me detyrë Drejtore e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor**.
2. Znj. M. Ç., **me detyrë Drejtore e Qendrës së Akreditimit**.

14. OST PËR PROJEKTIN "EFIÇENCA ENENRGJITIKE, PROGRAMI PËR SEKTORIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në stafin e PIU-t nuk ka specialistë të fushës së inxhinierisë, të cilët janë të nevojshëm përgjatë gjithë fazave të zhvillimit të projektit. Sipas përcaktimeve të *seksionit 2* të Marrëveshjes së veçantë (zbatimi i projektit), struktura përgjegjëse për zbatimin e projektit në OST është njësia e përhershme e zbatimit të projektit (PIU). Njësia e zbatimit të projektit (PIU) është në varësi të Drejtorisë se projekteve te huaja.
Në rregulloren e OST Seksioni VII.2 dhe VII.2.1, detyrat[28] funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në aparatin qendror të OST ShA, përcaktohet se:
Drejtoria e projekteve të huaja garanton implementimin optimal të projekteve të zhvillimit të rrjetit, të financuara nga komuniteti i donatoreve të huaj. Ndjek dhe zbaton legjislacionin përkatës për përmbushjen dhe implementim e projektit te huaj që në fazat e para të financimit, e deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim të veprës.
Sektori i projekteve PIU ndjek projektet me financim të huaj që nga procedurat e Marrëveshjes së kredisë, hartimin e dokumenteve të tenderit, procesin e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit apo konsulencës, menaxhimin implementimin e projektit deri në finalizimin dhe dorëzimin e tij, dhe marrjen në shfrytëzim nga strukturat përkatëse.
Nga auditimi konstatohet se, njësia e zbatimit të projektit përbehet nga:

- Shefi i sektorit të njësisë së zbatimit të projektit (PIU);
- 2(dy) jurist;
- 2(dy) ekonomist;
- 1(një) sekretar/arkivist.

Pra, ky sektor ka në përbërjen e vet 6 (gjashtë) specialistë te fushave të ndryshme, por nuk ka asnjë specialist të fushës së inxhinierisë elektrike në përbërjen e vet.
(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 12, të Raportit të Auditimit)
1.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë të marrë masa për të plotësuar strukturën e njësisë së zbatimit të projekteve me specialistë inxhinier të fushës së zbatimit për projektin "Efiçenca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike".

Brenda vitit 2020

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e shkallës së realizimit të objektivave dhe komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuar në marrëveshjen e huas, grupi i auditimit konstatoi se:
Nuk janë realizuar objektivat e parashikuara në marrëveshjen e huas.
II. Objektivi për arritjen e rezultateve të pritshme në drejtim të rritjes së fuqisë së transmetimit të energjisë elektrike, sigurisë dhe cilësisë së furnizimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.
Pasi bazuar në treguesit e performancës për vlerësimin sasior të këtij objektivi, parashikohet që kapaciteti i transmetimit në rrjetën midis Tiranë - Rrashbull dhe Fier të rritet me të paktën 155 MW në vitin e dytë të funksionimit të dy komponentëve.
Nga auditimi konstatohet se brenda periudhës së auditimit, ky objektiv nuk është realizuar, për shkak të mos implementimit të të dy komponentëve të projektit.

[28]Miratuar me nr. 2404/5 Prot. date 24.07.2019.

II. Në marrëveshjen e veçantë të Huas së datës 02.07.2015, në aneksin 2 të saj, është përcaktuar skeduli kohor i realizimit të projektit përgjatë viteve 2015 – 2018, sipas dy komponentëve te saj, te pasqyruar ne piken a dhe b, sa më poshtë

c. Faza e zbatimit për Komponentin parashikohej të zgjaste 3(tre) vjet, dhe të përfundonte në fund të vitit 2017.

d. Faza e zbatimi për Komponentit II parashikohej të zgjaste 4 (katër) vjet, dhe të përfundonte në fund të vitit 2018.

Ky objektiv nuk është realizuar dhe shtyrja në kohë e tij, është shoqëruar me kosto të shumta shtesë mbi vlerën e huas.

III. Nga auditimi konstatohet se, afati i ri për realizimin e këtij projekti respektivisht sipas dy komponentëve nuk është pasqyruar në amendimet e marrëveshjes së veçantë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 18-20, të Raportit të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, të analizojë ecurinë dhe problematikat e shfaqura gjatë implementimit të projektit "Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike", si dhe të autorizojë administratorin e shoqërisë për nënshkrimin e amendimit të marrëveshjes së veçantë, ku të përcaktohet afati i përfundimit të projektit sipas të dy komponentëve të tij.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Deformim i procesit të vlerësimit të ofertave të kontraktorëve.

Në procesverbalin të mbajtur nga KVO nr.53/8 prot. datë 06.04.2017, kanë kaluar fazën e pare të para-kualifikimit si më poshtë:

- K. P. P. E. T. E. Inc. është kualifikuar pa kushte;

-A. S.p.A, E. E. e S., C. GE G. GmbH M. S.A me kushtin, që mangësitë respective të konstatuara do të rregullohen në fazën vijuese të tenderit.

Në raportin paraprak të vlerësimit të ofertave teknike, të prezantuar nga Konsulenti dhe miratuar nga OST në Mars 2018, është ngritur pretendimi i verifikimit te saktësisë në kriteret para-kualifikuese si më poshtë:

-është kanstatuar se në dokumentacionin e dorëzuar prej tij ka mospërputhje të dhënash(datat) për përfundimin e projektit "Ndërtimi i N/st Zerjanevic" (viti 2007 apo viti 20o5) dhe për këtë arsye është kërkuar plotësim dokumentacioni.

Për këtë arsye pas saktësimeve, është kërkuar skualifikimi i këtij aplikanti.

Gjithashtu, në e-mail e saj, datë 26 Mars 2018 banka (KfW) ka sqaruar se:

Më e-mail e KfW datë 11. Maj 2018 jepet dokordësia (No-Objection) e Raportit të Vlerësimit Final me shënimin "*se ne nuk do të ndajmë plotësisht opinionin e punëdhënësit dhe konsulentit lidhur me mospërmbushjen e ofertës së prezantuar nga Koncar Power Plant Electrical Traction Engineering Inc në lidhje me kriterin e para-kualifikimit"*.

Seksioni 2.7 i "Udhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere"-Gusht 2016, nuk është përjashtues në thelbin e tij, por lejon krahasimin e të gjithë ofertuesve për të përcaktuar avantazhet më të dobishme.

Pra, sa sipër në rastin e aplikantit Koncar nuk qëndron argumentimi se ekziston dyshimi për përmbushjen e kushteve minimale të parashikuara në fazën para-kualifikuese, për arsyen e thjeshtë se ky aplikant ka kaluar fazën e para-kualifikimit në mënyrë të pakushtëzuar.

Pra, edhe në këtë faze të procesit të përzgjedhjes të kontraktorit janë vërejtur mangësi në ushtrim të detyrave funksionale nga ana e OST për koordinimin dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit.

3.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës duhet të marrin masat e nevojshme për të implementuar një sistem efiçent të menaxhimit të projekteve të huaja, duke përfshirë të gjitha proceset e zhvillimit të projektit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve që kërcënojnë shoqërinë.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Penalitete të pa mbajtura, gjatë zbatimit të kontratës së Konsulentit. Me anën e faturave D17/1327 dhe D17/1328 datë 24.04.2017, është kërkuar nga "F. G. & C." pagesa prej **371,169.00 €** ,ose 60 % nga fondi i fazës A prej 618,615.00 €, si edhe pagesa prej **27,041.25 €,** ose 75 % të shtesës nga amendamenti nr.01 i kontratës nr.1585/1 prot., datë 24.03.2017, prej 36,055 € për fazën A.
Raporti mbi mjedisin (ESIA Report) është dorëzuar nr.1210 prot. datë 03.03.2017 me një vonesë prej 11 javësh;
Raporti i Detajuar i Projektimit dhe Planifikimit (Detailed Planning and Design Report) është dorëzuar nr. 2301 prot. datë 26.04.2017, me një vonesë prej 19 javësh.
Referuar pikës Ad 3.4 te "kushtet speciale" të kontratës, janë përcaktuar afatet kur konsulenti duhet të raportojë mbi progresin e shërbimeve që ka kryer, si më poshtë:
-Raporti i Fillestar 8 javë pas hyrjes në fuqi ose 11.11.2016;
-Raporti mbi ambjentin ESIA 8 javë pas hyrjes në fuqi ose 11.11.2016;
-Raporti i Planifikimit dhe Projektimit të Detajuar 12 javë pas hyrjes në fuqi ose 09.12.2016.
Veprimet për dorëzimin e shërbimev të kryera nga konsulenti bien në kundërshtim me kushtet speciale paragrafin Ad.3.4 të kontratës së konsulentit.
Për këtë arsye:Referuar paragrafit 4.2 "Penalitete për Vonesën", në kontratën e konsulentit, si edhe periudhës së vonesës nga data 11.11.2016 - 26.04.2017, ose 21 javë, llogaritja e penalitetit në **ngarkim të Fichtner GmbH & Co.KG.** është **38,973 €** ose **4,745,742.21 lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 35-35, të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Projekteve të Huaja, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 38,973 euro, si penalitet për vonesat e shkaktuara në prezantimin e Raportit të Mjedisit *ESIA dhe Raportit të Projektimit dhe Planifikimit të Detajuar (Detailed* Planning and Design Report) nga konsulenti F. G.

Menjëherë

15. ALBCONTROL SHA

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pjesëmarrjen e anëtarëve dhe sekretares së Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e shoqërisë dhe shpërblimeve të përfituara, u konstatua se pavarësisht faktit se mund të mos kenë marr pjesë në mbledhje ose kanë marr pjesë në një numër të kufizuar mbledhjesh vjetore, pagesat e tyre vlerësohen mujore, kjo e mbështetur nga Neni 24 "Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës" i Statutit i cili parashikon se "anëtarët përfitojnë shpërblim mujor për pjesëmarrje në Këshillin Mbikëqyrës i cili jepet sipas akteve ligjore në fuqi" dhe pika 7 e VKM Nr. 570, datë 3.10.2018 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore" e cila parashikon se "Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e parë e Këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonime".
Për sa më sipër edhe pse pjesëmarrja në mbledhje nuk është mujore dhe sipas Statutit Këshilli Mbikëqyrës bënë të paktën 4 Mbledhje në vit, shpërblimi është caktuar që të jetë mujor. Për periudhën objekt auditimi shpërblimet për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe sekretares rezultojnë në vlerën 6,245,140 lekë bruto ose 5,308,369 lekë neto, pas mbajtjes së tatimit në burim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Nga administratori i shoqërisë Albcontrol SHA të merren masa për propozimin e rishikimit të VKM Nr. 570 datë 3.10.2018 me qëllim shpërblimin e anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhje.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës "***Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019***, u konstatua se kërkesa Nr. 228, dt. 25.01.2019, për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol SHA, për realizimin e këtij prokurimi, dhe nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.

-Kriteri për punimet e ngjashme konsiderohet i paargumentuar pasi sistemi i akses control dhe sistemi i evakuimit në raste alarmi nuk lidhen me aviacionin civil, por janë sisteme që funksionojë në mënyrë universale dhe kanë të njëjtët parime dhe standarde pune pavarësisht fushës ku aplikohen.

- Kriteret për zoterim të çertifikates **ISO 14001:2015** mbi "Sistemet e menaxhimit te ambjentit", të certifikates PAS 99:2012 për Sistemin e Integruar të Menaxhimit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anetaret e bashkimit duhet të jenë në zoterim të kësaj certifikate ose ekuvalente me to", të certifikates për sistemin e menaxhimit të energjisë ISO 50001:2011. Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jete e vlefshme në kohen e zhvillimit te tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kësaj certifikate. Ose ekuvalente me to", të certifikates për sistemin e menaxhimit të përgjegjshmërisë sociale SA 8000:2014 Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohen e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtaret e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kësaj certifikate. Ose ekuivalente me to" në opinionin e grupit të auditimit, përcaktimi i tyre si kriter për kualifikimin e operatorëve ekonomikë nuk nxit operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në këtë procedurë dhe konsiderohen si kritere që nuk lidhen me realizimin e objektit të procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 178-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës sipas objektit të prokurimit për të hartuar një raport për domosdoshmërinë e çdo kriteri të veçantë të përcaktuar në këtë procedurë. Në varësi të rezultateve të raportit të hartuar nga specialistët e fushës, sipas përgjegjësive përkatëse të merren masa administrative përkatëse nga ana e shoqërisë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës gjatë vitit 2019, lidhur me ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, janë marrë ose një ditë para, ose brenda të njëjtës ditë, me atë kur është miratuar relacioni përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm që i propozonte.

Referuar materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, konstatohet se miratimet e ndryshimeve me *Vendimet nr. 19 dhe nr. 22 e Këshillit Mbikëqyrës*, janë marrë brenda të njëjtës ditë me relacionet përkatëse të Drejtorit të Përgjithshëm, për ndryshimin e programit të zhvillimit ekonomik. Veç të tjerash, propozimet e përfshira në relacionet shpjeguese kanë qenë në të dyja rastet të shumta dhe koha brenda të cilës janë marrë vendimet nga Këshilli Mbikëqyrës, ka qenë e pamjaftueshme për anëtarët e tij, për të marrë informacion, për të bërë vlerësime dhe për të marrë vendime të kujdesshme në interes të aktivitetit të shoqërisë, duke anashkaluar parimin e përgjithshëm mbi ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, në shoqëritë tregtare të cilat menaxhohen nga një sistem administrimi me dy nivele, ku ndarja e funksioneve, ai i hartimit të politikave, i ushtruar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe ai i zbatimit të

politikave, i ushtruar nga Drejtori i Përgjithshëm, mbetet detyrim i cili duhet respektuar në thelb.
Konstatohet se, relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm japin një përshkrim të shkurtër të propozimeve, pa një analizë të hollësishme mbi domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve, në shtesa apo pakësimi të zërave të shpenzimeve, ndërsa nga procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës rezulton mospjesëmarrje e përfaqësuesve të Divizioneve që kanë lidhje me çështjet, objekt propozimi për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të cilët do të duhej të prezantonin materialin për pjesën teknike, e po kështu dhe mungesa e nënshkrimeve në relacionet propozuesve për ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, neni 163, neni 164, neni 166, të Statutit të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA, nenit 21 dhe me Rregulloren e Brendshme të "ALBCONTROL" SHA, miratuar me Vendimin nr. 9, datë 26.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, Kreu IV "Funksionimi i shoqërisë", nenet 21, 37, 38, 39. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 43-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
3.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për ushtrimin e kompetencave të tij për miratimin e propozimeve të ndryshimeve të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, vetëm pasi të jetë paraqitur nga shoqëria i gjithë dokumentacioni shpjegues për nevojën e këtyre ndryshimeve, duke marrë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe njohur relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm e duke shmangur vendimmarrjen e përshpejtuar.
Titullari i Albcontrol SHA dhe Departamentet e shoqërisë të marrin masa të hartojnë dhe administrojnë propozimet për ndryshimet e mundshme të ardhmen të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, shoqëruar me relacione të hollësishme teknike dhe financiare.

Në vijimësi

16. SPITALI RAJONAL VLORË

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua që për llogaritjen e sigurimit shoqëror të detyrueshëm, gjatë hartimit të listpagesave të pagave për punonjësit e Spitalit Rajonal Vlorë nuk është zbatuar siç duhet pasi ndalesa e sigurimit shoqërorë është përllogaritur mbi pagën bruto për çdo punonjës, çka bën që ndalesa e sigurimeve shoqërore të jetë më e lartë, si rrjedhojë paga neto e punonjësve, të cilët e kalojnë këtë pagë maksimale, pra këtyre punonjësve u është kaluar një pagë më e ulët se ajo që duhet të ishte në fakt si rrjedhojë e përllogaritjes së gabuar të ndalesave. Kjo nuk ka ndikuar në deklarimin e kontributeve të sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatimin e të ardhurave në sistemin e tatimeve, pasi ky sistem i përllogarit automatikisht ndalesat sipas kërkesave ligjore vit pas viti, në kundërshtim me Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 10.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2, faqe 14 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 1.1: Spitali Rajonal Vlorë, Sektori i Planit dhe Sektori i Financës të marrin masa që përllogaritja e sigurimeve shoqërore në listpagesat mujore të bëhet sipas kërkesave ligjore duke respektuar kufirin e pagës maksimale për efekt kontributi të sigurimeve shoqërore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Spitali Rajonal Vlorë nuk është i përfshirë në sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ). Mbajtja e evidencës kontabile e kësaj njësie publike bëhet me programin Excel, të krijuar e mirëmbajtur nga Sektori i Financës. Sistemi i IT, mbulohet tërësisht nga

struktura e brendshme, në kundërshtim me Organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4, faqe 28 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 2.1: Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë të marrë masa, që në të ardhmen, raportimi financiar të kryhet në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ). Procedurat e zbatimit të fondeve buxhetore të evidentohen në SIFQ, të administruar nga Ministria përgjegjëse për Financat dhe Ekonominë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Referuar informacionit të vendosur në pasqyrat financiare ka rezultuar se SPV ka një numër të konsiderueshëm të furnitorëve (50), të kontraktuar para vitit 2014, të rezultuar të pa likuiduar në vlerën 17,470,394 lekë gjatë vitit dhe deri në fund të vitit 2017.
Në pasqyrat financiare të vitit 2018, rezultuan 49 furnitorë të kontraktuar, të cilët rezultojnë të pa likuiduar me vlerë 17,100,893 lekë. Gjatë auditimit të bankës së vitit 2019, rezulton se gjatë këtij viti është krijuar një detyrim në vlerën 222,881 lekë, e cila është likuiduar në shkurt të 2021. Për vitin 2020, është krijuar një detyrim i ri me vlerën 178,628 lekë, e likuiduar në shkurt 2021.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4, faqe 28 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 3.1: Titullari i SRV dhe Këshilli Administrativ të marrin në analizë situatën, duke vijuar me marrjen e masave të menjëhershme për shlyerjen e detyrimeve ndaj furnitorëve dhe shmangien e shlyerjes së tyre me procese gjyqësore, të cilat do të sillnin shpenzime shtesë në buxhetin e SRV.

Menjëherë e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Komisioni për monitorimin e kontratës së shërbimit katering nuk ka mbajtur procesverbale dhe dokumentacion justifikues për plotësimin e standardeve dhe kërkesave ligjore, si dhe specifikimeve teknike për produktet ushqimore të përdorura për përgatitjen e ushqimeve dhe fletë analizat shoqëruese për artikujt ushqimorë. Dokumentacioni që disponon ky komision merret i mirëqenë siç dorëzohet nga OE dhe nuk i nënshtrohet një shqyrtimi mbi vlefshmërinë dhe plotësinë e tij.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 51 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 4.1: Komisionet e monitorimit të zbatimit të kontratës për shërbimet katering, të marrin masa për vlerësimin dhe verifikimin që çdo dokumentacion i paraqitur nga OE është i vlefshëm dhe mbulon të gjithë periudhën e kontraktuar duke verifikuar origjinën e tregtuesit dhe faktin nëse analizat e bëra i takojnë produkteve që po përdor OE.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:
"Mjedisi i kontrollit" Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Spitalit Rajonal Vlorë e cila është shqyrtuar në mbledhjen e mbajtur nga Këshilli Administrativ me procesverbal nr. 1396 prot datë 21.02.2019, por nuk është miratuar akoma nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pavarësisht kërkesave zyrtare të bëra nga Titullarja e Autoritetit Spitalor Vlorë. Trajnimet për stafin e administratës lënë për të dëshiruar, pasi mungojnë trajnime për fusha si: për MFK, prokurimet publike, për menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për kontabilitetin e buxhetin, për menaxhimin e aktiveve. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm. Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk

ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Përmbledhje e titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse nuk janë mbajtur në çdo rast procesverbale.

"Menaxhimi i Riskut" Nga verifikimi i veprimtarisë së grupit të menaxhimit të MFK dhe menaxhimit të riskut në lidhje me zbatimin e plan-veprimit të riskut rezultoi se nuk është ndërmarrë dhe dokumentuar asnjë veprim për të adresuar mangësitë. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Mungon gjurma e auditit për sektorët e administratës, të miratuar nga Drejtorja e Spitalit si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB.

"Informimi dhe komunikimi" Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.

"Monitorimi" Në Spitalin Rajonal Vlorë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme. Në Spitalin Vlorë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.8, faqe 126 të Raportit të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë, me atributet e Kryetarit të GMS e të Nëpunësit Autorizues si dhe Kordinatorit të Riskut, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për miratimin e Rregullores së Brendshme të funksionimit nga MSHMS, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

5.2 Rekomandimi: Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit të administratës. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit konstatohet se në listat e shpërblimeve për fondet e akorduara për situatën e COVID-19, rezulton se ka paqartësi në mënyrën e shpërndarjes së tyre sepse referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion për disa muaj nuk ka asnjë dokument mbi shpërndarjen e shpërblimeve, konkretisht për muajt Prill, Maj, dhe Janar 2021 dhe në çdo listë është e paqartë kuadrimi i periudhës së shpërblimit, vërtetuar kjo dhe me korrespondencën me MSHMS, referuar mënyrës së shpërblimit të përfituesve të këtij shpërblimi. Referuar mbajtjes së dokumentacionit mbi argumentimin dhe shpërndarjen e shpërblimeve ndaj personelit të angazhuar nga SRV dhe detajimit të shpenzimeve të alokuara për blerje për pandeminë COVID -19, ai është i pa sistemuar dhe jo kronologjik gjithashtu, grupi i auditimit kërkoi informacion nga sekretaria e Spitalit Rajonal Vlorë dhe ju vu në dispozicion lista e miratuar nga titullari i institucionit, dhe dërgimi i saj (konfirmimi) në mënyrë elektronike (me e - mail) në Ministrinë e Shëndetësisë, vetëm për muajt Mars, Korrik dhe Dhjetor 2020.Për parregullsitë në mbajtjen e kronologjisë dhe rakordimit të listave me

shpjegimet e nevojshme mbi argumentimin dhe shpërndarjen e shpërblimeve ndaj personelit të angazhuar nga SRV dhe mungesës së e-maileve të konfirmimit të listave të shpërblimit, ngarkohen me përgjegjësi Sektori i planit në Spitalin Rajonal Vlorë dhe Grupi i Monitorimit dhe Verifikimit të listave të përfituesve të këtij shpërblimi.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.10, faqe 154 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 6.1: Autoriteti Kontraktor /Sektori i Planit dhe Grupi i Monitorimit dhe Verifikimit të listave të përfituesve të këtij shpërblimi, të marrin masa që të paraqesin në mënyrë kronologjike dhe të saktë evidencat për shpërblimin e e personelit dhe shpenzime operative për nevojat e SRV për përballimin e situatës COVID-19.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në datën 14.06.2021 dhe datën 17.04.2021 nga auditimi në terren grupi i auditimit u konstatua se në Farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë, hyrje daljet e medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme mbahen me programin SIIS/ PENTAHO. Gjendja e farmacisë në datën 14.06.2021 nga ekstrakti i sistemit të instaluar në Farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë SIIS/ PENTAHO rezulton në 9,815,797 copë medikamente në vlerën 70,534,378 lekë. Gjendja e farmacisë në datën 17.06.2021 nga ekstrakti i sistemit të instaluar në Farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë SIIS/ PENTAHO rezulton në 10,469,017 copë medikamente në vlerën 71,523,221 lekë. Nga auditimi konstatohet konstatohet se programi SIIS/ PENTAHO nuk jep siguri rreth faktit të gjendjes fizike dhe kontabël të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme, gjithashtu referuar shkarkimit të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme nga sistemi , ky proces nuk kryhet në kohë reale duke mos e pasqyruar saktë gjendjen fizike të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme në farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë sepse nga krahasimi i dy ekstrakteve të sistemit P SIIS/ PENTAHO për periudhën kohore 3 ditore nga data 15.06.2021 deri më datë 17.06.2021 sipas sistemit SIIS/ PENTAHO në farmacinë e Spitalit Rajonal Vlorë kanë hyrë 653,220 artikuj në vlerën 988,843 lekë. Këto diferenca nuk janë të justifikuara pasi sipas këtyre të dhënave, vlera e një artikulli rezulton të jetë mesatarisht 1.5 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.11, faqe 157 të Raportit të Auditimit)
Rekomandimi 7.1: Spitali Rajonal Vlorë dhe Sektori i Farmacisë të marrë masa të rakordojë në kohë reale gjendjen fizike dhe gjendjen kontabël të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme ne sistemin SIIS/Pentaho të Farmacisë së Spitalit.

Në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për shërbimin e lavanderisë, nga këqyrja e dokumentacionit në SPE, të OE të shpallur fitues "D." SHPK, ka rezultuar se mungojnë listë pagesat në formatin E-sig 025a, për muajin Shtator, si dhe ky OE ka bërë kontratë furnizimi me detergjente me shoqërinë "Ë." SHPK, shoqëri pjesëmarrëse në tender, në kundërshtim me nenin 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,
Nga sa sipër, KVO duhet të kishte bërë skualifikimin e OE "D." SHPK dhe duhet të kishte njoftuar Titullarin e AK për anulimin e procedurës dhe shpalljen e një procedure të re. Ky veprim ka shkaktuar paligjshmëri në zbatimin e procedurës së prokurimit të fondeve publike në vlerën 185,250,786 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5, faqe 98 të Raportit të Auditimit)
1.1 Rekomandim: Në të ardhmen SRV të marrë masa për shqyrtimin e kujdesshëm të dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesit dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet për anulimin e procedurave në rastet kur kriteret e kualifikimit nuk plotësohen nga asnjë prej ofertuesve.

C. <u>MASA DISIPLINORE</u>

<u>C.1 Për punonjësit në marrëdhënie pune</u>

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, Kontratës Individuale, i rekomandojmë Titullarit të Spitalit Rajonal Vlorë, të ngrejë një grup për të vlerësuar shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të Përputhshmërisë të ushtruar në SRV, në varësi të analizës së përgjegjësive, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga "Tërheqje vëmendje" deri te "Ulje në detyrë", për personat që gjenden me përgjegjësi në mënyrë të përsëritur në Raportin Përfundimtar të Auditimit, e konkretisht:

1. Znj. T. J.;
2. Z. R. M.;

Për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të parë, të vitit 2023.

"Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi".

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

TË DHËNA PËR PËRMIRËSIMET LIGJORE
DHE MASAT ORGANIZATIVE

Nr	SUBJEKTI	Ndryshime dhe përmirësime legjislacioni							Masa organizative						
		Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuara				Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuara			
			Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar		Pa pranuar	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
	Të evaduara në vitin 2020	**1**	**1**	**0**	**1**	**0**	**0**	**0**	**563**	**8**	**555**	**200**	**19**	**247**	**89**
1	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për projektin "Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin"	**0**	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Moderinizimi i Asistencës Sociale"	**0**	0	0	0	0	0	0	2	0	2	2	0	0	0
3	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare për projektin "Plani i Ristrukturimit të KESH SHA"	**0**	0	0	0	0	0	0	4	0	4	1	0	3	0
4	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale"	**0**	0	0	0	0	0	0	8	3	5	2	0	3	0
5	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Funizimi me Ujë i Zonave Rurale III"	**0**	0	0	0	0	0	0	14	2	12	5	0	6	1
6	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizimit"	**0**	0	0	0	0	0	0	12	0	12	3	0	9	0
7	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (ACC)	**0**	0	0	0	0	0	0	18	1	17	5	0	11	1
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar	**0**	0	0	0	0	0	0	47	0	47	1	7	15	24
9	Radio Televizioni Shqiptar	**0**	0	0	0	0	0	0	58	0	58	12	4	24	18
10	Autoriteti Portual Durrës	**0**	0	0	0	0	0	0	57	0	57	26	1	25	5
11	Spitali Psikiatrik Vlorë	**0**	0	0	0	0	0	0	36	0	36	13	0	18	5

12	Spitali Rajonal Durrës	**0**	0	0	0	0	0	0	29	0	29	19	0	10	0
13	Spitali Universitar I Traumës	**0**	0	0	0	0	0	0	30	0	30	21	0	9	0
14	Spitali Rajonal Vlorë	**1**	1	0	1	0	0	0	49	0	49	10	2	31	6
15	Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”	**0**	0	0	0	0	0	0	24	0	24	15	0	9	0
16	Enti Kombëtar i Banesave	**0**	0	0	0	0	0	0	27	0	27	20	0	7	0
17	Ujësjellës Kanalizime Vlore SHA	**0**	0	0	0	0	0	0	29	0	29	2	2	24	1
18	Spitali Rajonal Shkodër	**0**	0	0	0	0	0	0	30	0	30	11	0	10	9
19	Drejtoria e Përgjithshme Detare	**0**	0	0	0	0	0	0	8	0	8	6	2	0	0
20	Ujësjellës Kanalizime Kurbin	**0**	0	0	0	0	0	0	27	0	27	11	0	2	14
21	MSH "Përmirësimi I Sistemit Shëndetësor"	**0**	0	0	0	0	0	0	22	1	21	4	0	16	1
22	OST “Efiçenca energjitike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”	**0**	0	0	0	0	0	0	8	1	7	0	0	5	2
23	Albcontrol SHA	**0**	0	0	0	0	0	0	24	0	24	11	1	10	2
	GRAND TOTAL	**1**	**1**	**0**	**1**	**0**	**0**	**0**	**563**	**8**	**555**	**200**	**19**	**247**	**89**
										1,42%	**98,58%**	**36,04%**	**3,42%**	**44,50 %**	**16,04%**

EVIDENCA PËR MASAT E ZHDËMTIMIT TË REKOMANDUARA DHE ZBATIMI I TYRE

Nr	**SUBJEKTI**	**Masa për shpërblim dëmi**													
		Gjithsej		**Nga këto**				**Nga rekomandimet e pranuara**							
				Pranuar		**Pa pranuar**		**Zbatuar plotësisht**		**Zbatuar pjesërisht**		**Në proces**		**Pa zbatuar**	
		Nr.	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**
	Të evaduara në vitin 2020	**79**	**1.441.649**	**77**	**1.436.671**	**2**	**4.978**	**11**	**7.796**	**1**	**36**	**35**	**69.372**	**30**	**1.359.467**
1	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për projektin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

	"Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin"														
2	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Moderinizimi i Asistencës Sociale"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare për projektin "Plani i Ristrukturimit të KESH SHA"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale"	1	472	1	472	0	0	1	472	0	0	0	0	0	0
5	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Funizimi me Ujë i Zonave Rurale III"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizimit"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (ACC)	1	233	0	0	1	233	0	0	0	0	0	0	0	0
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar	9	46.133	9	46.133	0	0	3	3.220	0	0	3	15.264	3	27.649
9	Radio Televizioni Shqiptar	16	23.762	16	23.762	0	0	0	0	0	0	0	0	16	23.762
10	Autoriteti Portual Durrës	13	23.184	13	23.184	0	0	1	498	0	0	9	16.134	3	6.552
11	Spitali Psikiatrik Vlorë	11	28.804	11	28.804	0	0	0	0	0	0	7	24.309	4	4.495
12	Spitali Rajonal Durrës	5	1.198	5	1.198	0	0	3	1.074	0	0	2	124	0	0
13	Spitali Universitar I Traumës	2	3.871	2	3.871	0	0	1	335	0	0	1	3.536	0	0
14	Spitali Rajonal Vlorë	2	991	2	991	0	0	0	0	0	0	2	991	0	0
15	Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
16	Enti Kombëtar i Banesave	4	2.887	4	2.887	0	0	0	0	0	0	4	2.887	0	0
17	Ujësjellës Kanalizime Vlore SHA	8	1.297.954	8	1.297.954	0	0	1	107	1	36	2	802	4	1.297.009
18	Spitali Rajonal Shkodër	4	3.925	4	3.925	0	0	0	0	0	0	4	3.925	0	0
19	Drejtoria e Përgjithshme Detare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
20	Ujësjellës Kanalizime Kurbin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

21	MSH "Përmirësimi I Sistemit Shëndetësor"	1	2.090	1	2.090	0	0	1	2.090	0	0	0	0	0	0
22	OST "Efiçenca energjitike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike"	1	4.745	0	0	1	4.745	0	0	0	0	0	0	0	0
23	Albcontrol SHA	1	1.400	1	1.400	0	0	0	0	0	0	1	1.400	0	0
	GRAND TOTAL	**79**	**1.441.649**	**77**	**1.436.671**	**2**	**4.978**	**11**	**7.796**	**1**	**36**	**35**	**69.372**	**30**	**1.359.467**
				97%		3%		14%		1%		45%		39%	

EVIDENCA PËR MASAT E PËRDORIMIT ME EFEKTIVITET TË FONDEVE DHE ZBATIMI I TYRE

Nr	SUBJEKTI	Masa për Përdorim me efektivitet													
		Gjithsej		Nga këto				Nga rekomandimet e pranuara							
				Pranuar		Pa pranuar		Zbatuar plotësisht		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
		Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë
	Të evaduara në vitin 2020	**105**	**4.103.286**	**104**	**3.918.036**	**1**	**185.250**	**22**	**118.494**	**1**	**0**	**60**	**3.676.016**	**22**	**308.774**
1	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për projektin "Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Moderinizimi i Asistencës Sociale"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare për projektin "Plani i Ristrukturimit të KESH SHA"	2	694084	2	694084	0	0	0	0	0	0	2	694084	0	0
4	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

5	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Funizimi me Ujë i Zonave Rurale III"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizimit"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (ACC)	3	24.193	3	24.193	0	0	2	10.259	0	0	1	13.934	0	0
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar	6	126.513	6	126.513	0	0	0	0	0	0	2	75.700	4	50.813
9	Radio Televizioni Shqiptar	6	29.770	6	29.770	0	0	2	1.319	0	0	0	0	4	28.451
10	Autoriteti Portual Durrës	22	2.044.930	22	2.044.930	0	0	2	4.727	0	0	19	2.038.179	1	2.024
11	Spitali Psikiatrik Vlorë	3	6.105	3	6.105	0	0	0	0	0	0	0	0	3	6.105
12	Spitali Rajonal Durrës	12	27.974	12	27.974	0	0	1	735	0	0	8	26.323	3	915
13	Spitali Universitar I Traumës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
14	Spitali Rajonal Vlorë	4	193.626	3	8.376	1	185.250	0	0	0	0	3	8.376	1	185.250
15	Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi"	9	59.933	9	59.933	0	0	7	45.709	0	0	2	14.224	0	0
16	Enti Kombëtar i Banesave	6	296.862	6	296.862	0	0	3	45.497	0	0	3	251.365	0	0
17	Ujësjellës Kanalizime Vlore SHA	11	38.413	11	38.413	0	0	1	45	0	0	10	38.368	0	0
18	Spitali Rajonal Shkodër	8	56.919	8	56.919	0	0	0	0	0	0	4	24.580	4	32.339
19	Drejtoria e Përgjithshme Detare	3	3.942	3	3.942	0	0	0	0	1	0	1	2.675	1	1.267
20	Ujësjellës Kanalizime Kurbin	4	431.521	4	431.521	0	0	2	8.969	0	0	1	420.941	1	1.610
21	MSH "Përmirësimi I Sistemit Shëndetësor"	6	68.501	6	68.501	0	0	2	1.234	0	0	4	67.267	0	0
22	OST "Efiçenca energjitike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
23	Albcontrol SHA	9	109.095	9	109.095	0	0	7	21.298	0	0	2	87.797	0	0
	GRAND TOTAL	**105**	**4.103.286**	**104**	**3.918.036**	**1**	**185.250**	**22**	**118.494**	**1**	**0**	**60**	**3.676.016**	**22**	**308.774**
				99%											

EVIDENCA PËR MASAT DISIPLINORE
DHE ZBATIMI I TYRE

Nr	SUBJEKTI	Masa disiplinore							Masa administrative						
		Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuara				Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuara			
			Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar		Pa pranuar	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
	Të evaduara në vitin 2020	**245**	**245**	**0**	**216**	**0**	**8**	**21**	**16**	**0**	**16**	**2**	**0**	**5**	**3**
1	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për projektin "Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin"	**0**	0	**0**	0	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
2	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Moderinizimi i Asistencës Sociale"	**0**	0	**0**	0	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
3	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare për projektin "Plani i Ristrukturimit të KESH SHA"	**0**	0	**0**	0	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
4	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale"	**3**	3	**0**	0	0	0	3	**0**	0	0	0	0	0	0
5	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Funizimi me Ujë i Zonave Rurale III"	**0**	0	0	0	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
6	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizimit"	**0**	0	0	0	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
7	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (ACC)	**0**	0	0	0	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar	**2**	2	**0**	0	0	0	2	**5**	0	5	0	0	5	0
9	Radio Televizioni Shqiptar	**29**	29	0	27	0	2	0	**6**	0	6	0	0	0	0
10	Autoriteti Portual Durrës	**86**	86	0	79	0	0	7	**1**	0	1	0	0	0	1
11	Spitali Psikiatrik Vlorë	**0**	0	0	0	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
12	Spitali Rajonal Durrës	**23**	23	**0**	23	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0

13	Spitali Universitar I Traumës	**21**	21	0	21	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
14	Spitali Rajonal Vlorë	**9**	9	**0**	7	0	0	2	**0**	0	0	0	0	0	0
15	Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”	**11**	11	0	11	0	0	0	**1**	0	1	1	0	0	0
16	Enti Kombëtar i Banesave	**6**	6	0	6	0	0	0	**1**	0	1	1	0	0	0
17	Ujësjellës Kanalizime Vlore SHA	**9**	9	**0**	9	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
18	Spitali Rajonal Shkodër	**22**	22	0	20	0	0	2	**2**	0	2	0	0	0	2
19	Drejtoria e Përgjithshme Detare	**5**	5	**0**	2	0	3	0	**0**	0	0	0	0	0	0
20	Ujësjellës Kanalizime Kurbin	**8**	8	0	7	0	0	1	**0**	0	0	0	0	0	0
21	MSH "Përmirësimi I Sistemit Shëndetësor"	**11**	11	0	4	0	3	4	**0**	0	0	0	0	0	0
22	OST “Efiçenca energjitike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”	**0**	0	0	0	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
23	Albcontrol SHA	**0**	0	**0**	0	0	0	0	**0**	0	0	0	0	0	0
	GRAND TOTAL	**245**	**245**	**0**	**216**	**0**	**8**	**21**	**16**	**0**	**16**	**2**	**0**	**5**	**3**

EVIDENCA PËR MASAT E SHPERBLIMIT TË DËMIT TË MUNDSHËM EKONOMIK

Nr	**SUBJEKTI**	**Masa për shpërblim dëmi të mundshëm ekonomik**													
		Gjithsej		**Nga këto**				**Nga rekomandimet e pranuara**							
				Pranuar		**Pa pranuar**		**Zbatuar plotësisht**		**Zbatuar pjesërisht**		**Në proces**		**Pa zbatuar**	
		Nr.	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**	**Nr.**	**Mijë/lekë**
	Të evaduara në vitin 2020	**2**	**38.278**	**2**	**38.278**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**2**	**38.278**
1	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për projektin “Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin”	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**

2	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin “Moderinizimi i Asistencës Sociale”	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
3	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare për projektin “Plani i Ristrukturimit të KESH SHA”	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
4	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
5	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin “Funizimi me Ujë i Zonave Rurale III”	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
6	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin “Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizimit”	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
7	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (ACC)	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
9	Radio Televizioni Shqiptar	**2**	**38.278**	**2**	**38.278**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**2**	**38.278**
10	Autoriteti Portual Durrës	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
11	Spitali Psikiatrik Vlorë	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
12	Spitali Rajonal Durrës	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
13	Spitali Universitar I Traumës	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
14	Spitali Rajonal Vlorë	**0**	0	**0**	0	0	0	0	0	0	0	**0**	0	0	0
15	Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
16	Enti Kombëtar i Banesave	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
17	Ujësjellës Kanalizime Vlore SHA	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
18	Spitali Rajonal Shkodër	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
19	Drejtoria e Përgjithshme Detare	**0**	0	**0**	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
20	Ujësjellës Kanalizime Kurbin	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
21	MSH "Përmirësimi I Sistemit Shëndetësor"	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**

22	OST "Efiçenca energjitike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike"	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
23	Albcontrol SHA	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
	GRAND TOTAL	**2**	**38.278**	**2**	**38.278**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**2**	**38.278**

MASA VLERA TE RIKUPERUESHME

Nr	**SUBJEKTI**	**MASA VLERA TE RIKUPERUESHME**						
		Gjithsej	**Nga këto**		**Nga rekomandimet e pranuara**			
			Pranuar	**Pa pranuar**	**Zbatuar plotësisht**	**Zbatuar pjesërisht**	**Në proces**	**Pa zbatuar**
	Të evaduara në vitin 2020	**1**	**1**	**0**	**0**	**0**	**1**	**0**
1	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për projektin "Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin"	**0**	0	**0**	0	0	0	0
2	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Moderinizimi i Asistencës Sociale"	**0**	0	**0**	0	0	0	0
3	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare për projektin "Plani i Ristrukturimit të KESH SHA"	**1**	1	**0**	0	0	1	0
4	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale"	**0**	0	**0**	0	0	0	0
5	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Funizimi me Ujë i Zonave Rurale III"	**0**	0	**0**	0	0	0	0
6	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin	0	0	0	0	0	0	0

	"Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizimit"							
7	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (ACC)	**0**	0	**0**	0	0	0	0
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar	**0**	0	**0**	0	0	0	0
9	Radio Televizioni Shqiptar	**0**	0	**0**	0	0	0	0
10	Autoriteti Portual Durrës	**0**	0	**0**	0	0	0	0
11	Spitali Psikiatrik Vlorë	**0**	0	**0**	0	0	0	0
12	Spitali Rajonal Durrës	**0**	0	**0**	0	0	0	0
13	Spitali Universitar I Traumës	**0**	0	**0**	0	0	0	0
14	Spitali Rajonal Vlorë	**0**	0	**0**	0	0	0	0
15	Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi"	**0**	0	**0**	0	0	0	0
16	Enti Kombëtar i Banesave	**0**	0	**0**	0	0	0	0
17	Ujësjellës Kanalizime Vlore SHA	**0**	0	**0**	0	0	0	0
18	Spitali Rajonal Shkodër	**0**	0	**0**	0	0	0	0
19	Drejtoria e Përgjithshme Detare	**0**	0	**0**	0	0	0	0
20	Ujësjellës Kanalizime Kurbin	**0**	0	**0**	0	0	0	0
21	MSH "Përmirësimi I Sistemit Shëndetësor"	**0**	0	**0**	0	0	0	0
22	OST "Efiçenca energjitike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike"	**0**	0	**0**	0	0	0	0
23	Albcontrol SHA	**0**	0	**0**	0	0	0	0
	GRAND TOTAL	**1**	**1**	**0**	**0**	**0**	**1**	**0**

MASA PER TE ARDHURA TE MUNGUARA

Nr	**SUBJEKTI**	**Masa për të ardhura të munguara**		
		Gjithsej	**Nga këto**	**Nga rekomandimet e pranuara**

				Pranuar		Pa pranuar		Zbatuar plotësisht		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
		Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë	Nr.	Mijë/lekë
	Të evaduara në vitin 2020	**8**	**527.334**	**8**	**527.334**	**0**	**0**	**3**	**62.774**	**0**	**0**	**3**	**345.153**	**2**	**119.407**
1	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për projektin "Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin"	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
2	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Moderinizimi i Asistencës Sociale"	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
3	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare për projektin "Plani i Ristrukturimit të KESH SHA"	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
4	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale"	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
5	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Funizimi me Ujë i Zonave Rurale III"	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
6	Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizimit"	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
7	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (ACC)	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
9	Radio Televizioni Shqiptar	**1**	**29.770**	**1**	**29.770**	**0**	**0**	**1**	**29.770**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
10	Autoriteti Portual Durrës	**5**	**464.560**	**5**	**464.560**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**3**	**345.153**	**2**	**119.407**
11	Spitali Psikiatrik Vlorë	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
12	Spitali Rajonal Durrës	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
13	Spitali Universitar I Traumës	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**

14	Spitali Rajonal Vlorë	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
15	Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
16	Enti Kombëtar i Banesave	**2**	**33.004**	**2**	**33.004**	**0**	**0**	**2**	**33.004**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
17	Ujësjellës Kanalizime Vlore SHA	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
18	Spitali Rajonal Shkodër	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
19	Drejtoria e Përgjithshme Detare	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
20	Ujësjellës Kanalizime Kurbin	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
21	MSH "Përmirësimi I Sistemit Shëndetësor"	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
22	OST “Efiçenca energjitike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
23	Albcontrol SHA	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
	GRAND TOTAL	**8**	**527.334**	**8**	**527.334**	**0**	**0**	**3**	**62.774**	**0**	**0**	**3**	**345.153**	**2**	**119.407**